

DORACA

PËR PËRGATITJEN E
PROVIMIT TË JURISPRUDENCËS

PËRMBAJTJA

Prof.Dr. Z. Arsim Bajrami dhe Mr.Sc.Z. Xhavit Shala	
1. SISTEMI KUSHTETUES DHE ORGANIZIMI I JURISPRUDENCËS	1
<hr/>	
Sc. Z. Fejzulla Hasani	
2. E DREJTA PENALE dhe E DREJTA E PROCEDURËS PENALE	49
<hr/>	
Z. Adem Vokshi	
3. E DREJTA CIVILE dhe E DREJTA E PROCEDURËS CIVILE	359
- E Drejta Sendore	
- E Drejta Familjare	
- E Drejta Trashëgimore	
- E drejta e Detyrimeve	
- E drejta e Procedures Civile	
<hr/>	
Znj.Suzana Sejdiu	
4. E DREJTA TREGTARE (EKONOMIKE)	649
<hr/>	
Znj. Meleqe Bexheti	
5. E DREJTA E PUNËS	741
<hr/>	
Dr.Sc. Znj.Mirlinda Batalli dhe SC. Z. Islam Pepaj	
6. E DREJTA ADMINISTRATIVE - Konflikti Administrativ	767
<hr/>	
Dr. Znj.Gjyljeta Mushkolaj	
7. E DREJTA NDËRKOMBËTARE DHE EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT	805
<hr/>	

SISTEMI KUSHTETUES DHE ORGANIZIMI I JURISPRUDENCËS

1

KUPTIMI I KUSHTETUTËS

Ç'është kushtetuta

Kushtetuta është një nocion i njohur për opinionin e gjërë. Ajo nënkupton aktin më të lartë juridiko-politik me të cilin përcaktohen dhe mbrohen vlerat themelore të një shteti. Për kushtetuen mund të jepen definicione nga me të ndryshmet, duke filluar nga ato juridike-normative, politike, juridiko-politike, sociologjike, filozofike dhe këndvështrimet tjera. Për nevojat praktike të këtij doracak do të përkufizohemi vetëm në disa qasje për kushtetutën.

Përkufizimi kushtetues-juridik, kushtetutën e koncipon si akt suprem juridik, ligj themelor të shtetit, me të cilin duhet të jenë në pajtim të gjitha aktet tjera me fuqi më të ultë se kushtetuta. Ky përkufizim nënkupton hierarkinë juridike dhe epërsinë e kushtetutës ndaj ligjeve dhe akteve tjera nënligjore. Piramida juridike e një shteti sipas hierarikisë juridike është Kushtetuta, Aktet Kushtetuese, Ligji Kushtetues, Amandamentet Kushtetuese, Ligjet, Aktet nënligjore-urdhëresat, Dekretet, Udhëzimet, Aktet e përgjithshme juridike-statutet dhe Rregulloret. Në shtetet ku funksionon shteti ligjor dhe ku respektohet parimi i kushtetutshmërisë, të gjitha aktet në fuqi nën kushtetutën duhet të jenë në pajtueshmëri me kushtetutën, përkatësisht me ligjin (parimi i ligjshmërisë).

Përkufizimi politik i kushtetutës, merr për bazë faktin se, kushtetuta paraqet akt të kufizimit të pushtetit, vendosjen e tij në kornizat e sjelljes kushtetuese dhe institucionalizimin e gjitha formave të manifestimit të pushtetit shtetëror. Kushtetuta ndërtohet mbi shtyllën e parimit të ndarjes së pushteteve, pavarësisë së tyre dhe funksionimit të parimit të kontrollit reciprok midis pushteteve. Duke kufizuar pushtetin, kushtetuta e shëndruron shtetin në një organizatë juridike që funksionon në bazë të rregullave kushtetuese.

Përkufizimi juridiko-politik është qasje e plotë e dimensionit të kushtetutës dhe nënkupton kushtetutën si akt me të lartë juridik, i cili miratohet nga organi më i lartë, ose populli për të mbrojtur vlerat themelore të shtetit dhe për të kufizuar vetë shtetin dhe sjelljen e tij në pajtim me kushtetuten. Qasja juridiko-politike është e plotë dhe shpreh në plotëni misionin e kushtetutës në një shoqëri demokratike, si një instrument i promovimit dhe garantimit të vlerave kryesore të një shteti demokratik.

Kushtetuta si kontratë publike, për shumë teoricientë, sidomos sociologë, krijon një llojë partneriteti midis qytetarëve dhe shtetit, të cilët duke arritur pëlqim për kushtetutën përcaktojnë të drejta dhe detyrat reciproke në funksionimin e shtetit dhe politikave publike. Qytetarët, përkatësisht populli si palë kontraktuese legjitimon kushtetutën përmes referendumit dhe i bartë sovranitetin shtetit, duke i krijuar atij legjitimitetin demokratik për ndërtimin dhe ushtrimin e politikave publike. Shteti si palë tjetër kontraktuese, me kushtetutë pajiset me tërë autoritetin e nevojshëm, që të ndërtojë legjislacionin dhe insitucionet e tij legjislativ, ekzekutive e gjyqësore dhe të qeverisjes së mirë në interes të përgjithshëm publik. Kjo teori e koncipon kushtetutën si kontratë sociale dhe është e pranishme në shtete që zbatojnë demokracinë e drejtpërdrejtë (referendare), ku kushtetuta miratohet nga qytetarët, dhe ku njëmend krijohet një marrëveshje kushtetuese midis qeverisë dhe qytetarit me të drejta dhe detyra reciproke.

Llojet e kushtetutave

Momenti i parë me të cilin do të ballafaqohen hartuesit e kushtetutës, është përcaktimi i llojit dhe modelit të Kushtetutës. Dilemat e para kanë të bëjnë me vëllimin e kushtetutës, një kushtetutë e gjatë apo e shkurtë? Në të kaluarën shtetet socialiste kanë përqafuar idenë e hipertrofisë kushtetuese, duke hartuar kushtetuta të gjata të cilat rregullojnë në detale jetën dhe me norma të stërngarkuara juridike ngulfatin qytetarin dhe lirinë e tij. Këto shtete kishin kushtetuta të gjata me nga 500 nene dhe me anekse shtesë (Kushtetuta e Indisë njihet si kushtetuta më e gjatë në botë me afër 500 nene dhe 15 anekse). Në anën tjetër ka raste të shteteve me kushtetuta të shkurta siç janë psh, SHBA-të, ku kushtetuta ka vetëm shtatë nene në formë parimeve kushtetuese, të cilat më vonë janë plotësuar me 27 amandamente.

Përvojat kushtetuese të Kosovës ishin të ndryshme. Kushtetuta e KSA të Kosovës kishte 480 nene, Kushtetuta e Republikës së Kosovës e vitit 1990 kishte 140 nene, Korniza Kushtetuese kishte 14 kapituj. Sa i përket përvojave ndërkombëtare shumica e kushtetutave janë të shkurta dhe rregullojnë vetëm materien kushtetuese, si psh; Kushtetuta e Francës ka 89 nene, Kushtetuta e Italisë 139 nene, Ligji Themelor i Gjermanisë 141 nene, Kushtetuta e Turqisë 160 nene, Kushtetuta e Spanjës 169 nene, Kushtetuta e Sllovenisë 174 nene, Kushtetuta e Federatës Ruse 137 nene, Kushtetuta e Norvegjisë 112 nene, Kushtetuta e Maqedonisë 134 nene, Kushtetuta e Kroacisë 142 nene, Kushtetuta e Holandës 142 nene, Kushtetuta e Austrisë 148 nene, etj.

Me rastin e përcaktimit të vëllimit dhe gjatësisë së Kushtetutës, hartuesit sugjerohen të marrin parasysh këto fakte relevante siq janë: Kushtetuta duhet të rregullojë vetëm vlerat themelore të vendit; Kushtetuta duhet të ofrojë garancionet kushtetuese

për liritë dhe të drejtat e qytetarëve. Kushtetuta përcakton bazat e funksionimit të institucioneve demokratike. Kushtetuta duhet t'i referohet legjislacionit të rregullt në detalizimin e parimeve të saj si dhe Kushtetuta duhet të reflektojë bazën e sistemit ligjor dhe të sigurojë mekanizmat adekuat për mbrojtjen e saj.

Dilema kushtetuta e butë apo e fortë

Dilema e dytë për hartuesit e kushtetutës, ka të bëjë me atë, se a do të hartojnë një kushtetutë të ngurtë, e cila do të ndryshohet në procedurë speciale dhe do të sigurojë një konsensus të gjërë, apo një kushtetutë të butë që ofron fleksibilitet të mjaftshëm në ndryshimin e shpejtë?

Në qoftë se hartuesit përcaktohen për modelin e ngurtë të kushtetutës, ata duhet të adoptojnë një procedurë të posaçëme të miratimit dhe ndryshimit të saj. Kjo procedurë nuk e bën kushtetutën të pandryshueshme fare, por për ndryshimin e saj kërkonë procedura të ndryshme, të cilat dallojnë nga procedurat e rëndomta legjislative. Modelin kryesor të Kushtetutës së ngurtë e paraqet ajo e SHBA-ve, sepse për ndryshimin e saj krahas pëlqimit me 2/3 të të dy dhomave të kongresit, kërkon mbështetje të njejtë nga 50 legjislaturat e shteteve federale. Edhe Kushtetuta e ish RSFJ-së e vitit 1974 ka përfaqësuar modelin e kushtetutave të ngurta, sepse për miratimin dhe ndryshimin e saj, krahas Kuvendit Federativ, kanë dhënë pëlqimin edhe kuvendet e tetë njësisive federale, pëlqim ky që ka nënkuptuar edhe të drejtën e vetos ndaj ndryshimeve kushtetuese. Edhe Projekt Kushtetuta evropiane i takon modelit të ngurtë, sepse kërkon ratifikimin e 25 shteteve antare të Bashkimit Kushtetues për hyrjen në fuqi.

Disa rregulla me rëndësi për modelin e kushtetutës së ngurtë dhe të butë

- a) *Nëse hartuesit e draftojnë një model të kushtetutës së ngurtë, do të zgjedhin një nga këto mekanizma për miratimin dhe ndryshimin e Kushtetutës, siq është: votimin e kushtetutës me 2/3 e antarëve të parlamentit dhe të parlamenteve të njësisive federale; votimin e kushtetutës në shtetet federative me pëlqimin e njësisive federale, votimin e kushtetutës në mënyrë konsensuale në unionet konfederale si dhe votimin e kushtetutës me shumicë të dyfishtë, shumicën e deputetëve të shumicës, dhe shumicën e deputetëve të pakicës (Shumica Badinter), etj.*
- b) *Nëse hartuesit do të përzgjedhin të draftojnë një kushtetutë të butë, ata do të kenë parasysh se mekanizmi për miratimin dhe ndryshimin e Kushtetutës nuk dallon shumë nga procedurat e rëndomta parlamentare. Kjo nuk nënkupton se procesi kushtetues do të jetë krejtësisht i njejtë me procesin ligjdhënës, por ndryshimet e kushtetutës janë më të shpejta dhe bëhen në parlamentë për një kohë relativisht të shpejtë me një shumicë absolute ose shumicë të kualifikuar. Në mënyrë të veçantë kushtetutat e buta liberalizojnë procedurën e amendamentimit të shpejtë, duke ju përshtatë ndryshimeve që kërkon realiteti i krijuar.*

Me rastin e draftimit të një kushtetute të butë hartuesit do të përcaktojnë se: miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës nuk kërkon procedurë të veçantë; miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës bëhet nga parlamenti në procedura parlamentare me votim absolut ose të kualifikuar; amandamenti i kushtetutës është i shpejtë dhe i ngajshëm me procedurat legjislative si dhe miratimi dhe ndryshimi i Kushtetutës nuk mund të pengohet me të drejtën e vetos, së njësisive federale, të njerës dhomë të parlamentit, nga presidenti etj.

Kushtetutë, fiktive, reale apo pragmatike

Në të kaluarën në sistemet komuniste, hartuesit e kushtetutës kanë qenë nën ndikimet politike dhe kanë draftuar kushtetuta ideologjike, të cilat kanë shërbyer si dekor për diktatorët dhe regjimet shtypse. Ata, në njëren anë me kushtetutë kanë proklamuar rendin demokratik, e në anen tjetër kanë zbatuar shtypjen, shpeshëherë në emër të kushtetutës, ose më qëllim të mbrojtjes së saj. Për këta diktatorë, kushtetuta ka qenë e rëndësishme vetëm për të ruajtur diktaturën e tyre, ata e kanë shkelur atë, sa herë që ka paraqitur pengesë për realizimin e synime të tyre (shembulli i ardhjes në pushtet të Hitlerit dhe Millosheviqit), duke shkelur kushtetutën dhe duke rrënuar atë, sa herë që ishte pengesë për realizimin e qëllimeve të tyre. Juristët me kredibilitet të lartë moral asnjëherë nuk do të pranojnë të draftojnë një kushtetutë fiktive, e cila pasqyron rrejshëm relitetin faktik dhe që nuk do të implementohet, ose do të prodhoj praktika diskriminuese në baza të ndryshme etnike, fetare etj.

Objektiv parësor i hartuesëve duhet të jetë hartimin i një kushtetute reale, që merr parasysh realitetin faktik shoqëror të një vendi, objektivat reale zhvillimore të tij, raportin e forcave shoqërore dhe siguron implementimin e saj në jetën praktike. Hartuesit me rastin e draftimit të çdo neni të kushtetutës duhet të mendojnë, se sa ai përputhet me realitetin, dhe a do të mund të implementohet në praktik. Të hartosh një kushtetutë reale, do të thotë të jesh i sinqertë me qytetarët dhe opinion e gjërë. Kushtetuta moderne nuk lejon demagogjinë politike të konjunkturave politike, ajo duhet të shprehë aspirat legjitime të popullit dhe nevojat e tij për një shtet ligjor, rend demokratik, prosperitet ekonomik dhe mirëqenie publike.

Jo rrallë hartuesit marrin udhëzime të hartojnë një kushtetutë realo- pragmatike. Ata krahas pasqyrimin të realitetit ekzistues japin një vizion për të ardhmen e shtetit dhe paraqesin një udhërrefim se kah deshiron shteti të shkojë në të ardhmen. Në këtë rast hartuesit jo vetëm në preambulë (e cila është tipike për qasje vizionare), por edhe në pjesën normative mund të normojnë kahjet e zhvillimi të ardhshëm të vendit. psh. *Kosova pretendon të aderohet brenda mekanizmeve euro-atlantik, Kosova do të nënshkruaj dhe bëhet pjesë e Konventave Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ose Evropa do të federalizohet me kushtetutën Evropiane etj.*

A i duhet një vendi një kushtetutë ideale apo funksionale?

Një kushtetutë ideale, apo një kushtetutë funksionale është një zgjedhje tjetër për hartuesit e kushtetutës. Sot edhe për juristët e rëndomtë, hartimi i kushtetutës ideale nuk do të ishte i vështirë. Ata për një kohë të shkurtë përmes internetit do të gjejnë me

dhjetra modele të kushtetutave dhe shumë shpejtë mund të kompilojnë një kushtetutë ideale. Ketë mund ta bëjnë duke kombinuar nenet e caktuar të këtyre kushtetutave, duke marrë pjesët që ju duken më të mira dhe të hartojnë një kushtetutë të re. Në këtë kontekst ata mund ta marrin Kushtetutën amerikane si një lidere botërore e kushtetutave, ta përshkruajnë atë dhe frymen e saj dhe ta shpallin si kushtetutë të vendit të tyre. Por, ky do të ishte një mashtrim, sepse kushtetuta nuk është një akt që mund të importohet, ajo duhet t'i përshtatet rrethanave specifike të çdo shteti.

Shtetari anglez Uilliem E. Gledstaum, e ka cilësuar Kushtetutën si *“veprën më të shkëlqyer që mund të ketë nxjerrë ndonjëherë mendja dhe vendosmëria njerëzore. Në një botë ndryshimesh dhe trazirash, populli amerikan nuk ka asgjë më të vlefshme se këtë dokument të madh”*.

Hartuesit e mirë do ti japin përparësi kushtetutës funksionale në raportë me ato ideale. Kushtetutë e mirë dhe ideale për një vend është ajo që shprehë aspiratat legjitime të popullit dhe që siguron një shtet funksional. Asnjë kushtetutë, qoftë edhe e përkryer e një vendi nuk mund të përshkruhet dhe të merret nga vendi tjetër. Ky do të ishte një mashtrim, sepse importimi i kushtetutës së një shteti, nuk sjellë realitetet, shkallën e zhvillimi ekonomik, kulturen politike të atij vendi. Shtrohet pyetja, e ekziston vërtetë një kushtetutë ideale? Përgjegjëja është e kuartë jo, nuk ka kushtetutë dhe shtet ideal, sepse edhe shtetet me traditë të gjatë demokratike përballen me konflikte shoqërore dhe konflikte interesash, të cilat në fakt paraqesin ligjshmëri të zhvillimit të shoqërisë dhe përsosjes së demokracisë. Për këtë arsye, hartuesit e kushtetutës, duhet të heqin nga vetja kompleksin e gjetjes së kushtetutës ideale, sepse në fakt ajo nuk ekziston.

Për një shtet, i cili ndodhet në një transicion demokratik, kushtetutë ideale, do të jetë ajo që përshpejton këtë transicion demokratik dhe që hapë perspektivat e zhvillimit ekonomik e demokratik dhe mundëson integrimet euro-atlantik. Secili vend dhe shoqëri ka veqoritë e saj dhe kushtetuta duhet t'i shprehë dhe mbrojë ato. Kushtetuta e mirë krahas përvojave kompatible të shteteve tjera duhet të shprehë karakterin burimor të saj, veqoritë social-politike të vendit dhe popullit që i dedikohet. Nisur nga kjo hartuesit duhet të zgjedhin kushtetutën funksionale e burimore, që nuk do të paraqet ndonjë zbulim të ri kushtetues, por do ti sintetizojë realitetet faktike dhe objektivat reale të shtetit. Vetëm në rastet e tilla ajo do të ishte kushtetuta ideale, të cilën hartuesit e ëndërrojnë.

Roli i Kushtetutës në sistemin juridik

Shumë konstitucionalistë përfaqësojnë teorinë sipas së cilës kushtetuta paraqet një kontratë e lidhur mes dy palëve, qytetarit në njëren anë dhe shtetit në anen tjetër. Ata pohojnë, se shteti dhe qytetarët përmes kushtetutës ndertojnë koalicion dhe partneritet duke caktuar të drejtat dhe detyrat reciproke. Qytetarët në njëren anë duke votuar kushtetutën legjitimojnë shtetin dhe atë e furnizojnë me pushtet të mjaftueshëm për të udhëhequr me punet publike dhe për mbrojtjen e interesave të përgjithshme. Duke votuar kushtetutën, qytetarët bëjnë kufizimin dhe institucionalizimin e shtetit dhe mbrohen nga arbitrariteti dhe keqpërdorimi i pushtetit. Në anen tjetër, shteti me kushtetutë merr

si detyrim të garantoj lirinë dhe të drejtat e qytetarëve, t'i mbrojë ato nga abuzimet e shtetit dhe shkeljet e qytetarëve të tjerë, të sigurojë pjesëmarrjen e qytetarëve në jeten publike dhe të krijojë një shtet ligjor që ofron siguri personale dhe publike.

Atributet e Kushtetutës shprehin rolin dhe funksionin e saj në shoqëri. Duke qenë akti më i lartë juridiko-politik, kushtetuta shquhet me një varg tiparesh që shprehin tri funksione kryesore të saj:

- a) *të qenurit dokument më i lartë juridik,*
- b) *akt politik që bënë institucionalizimin e pushtetit shtetëror dhe demokracisë, si dhe*
- c) *pakt i lirive dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit.*

Tiparet kryesore të kushtetutës janë:

Akti më i lartë juridiko-politik i një shteti; bazë e sistemit juridik e politik të një vendi; ligj themelor me të cilin duhet të jenë në pajtim të gjitha aktet tjera juridike; akt që miratohet në procedurë të veçantë parlamentare ose në mënyrë të drejtpërdrejt nepërmjet referendumit; akt që shprehë sovranitetin e popullit dhe të drejtën e tij për të zgjedhur dhe kontrolluar qeverinë; akt i kufizimit të pushtetit shtetëror dhe institucionalizimit të tij, akt që përcakton kufizimet kushtetuese të qeverisë; akt të cilit duhet t'i nënshtrohen të gjithë, që nga presidenti, e deri te qytetari i rëndomtë; akt i garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe qytetarit; bazë e demokracisë dhe proceseve politike të një shoqërie.

Kushtetuta promovon dhe mbronë vlerat fundamentale të një shteti demokratik. Këto vlera shprehin parimet dhe bazat e organizimit shtetit dhe të ndertimit të rendit demokratik.

Në epiqendër të çdo kushtetute është qytetari dhe të drejtat e tij kushtetuese për të qenë subjekt dhe bartës i të gjitha proceseve politike, duke filluar nga e drejta e tij për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur në organet përfaqësuese, e deri të vendosja e drejtpërdrejt përmes referendumit për çështjet më të rëndësishme politike të vendit. Gjithashtu, kushtetuta përcakton parimet e funksionimit të një shoqërie demokratike, të bazuar në parimet e sundimit të ligjit dhe barazisë së plotë të qytetarëve para ligjit. Vlerat që përcakton dhe mbron kushtetuta mundësojnë ndertimin e një shteti demokratik mbi bazën e rregullave demokratike në të gjitha format e manifestimit të tij.

Janë katër çështje kryesore që janë objekt i rregullimit të Kushtetutës:

Përkufizimi i shtetit, përcaktimi i formes së regjimit politik, i sistemit të qeverisjes, organizimit territorial, simboleve të shtetit etj; bazat e sistemit politik, ekonomik dhe social të shtetit (sundimi i ligjit, parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit, prona dhe ekonomia e tregut, politikat publike ndaj qytetarëve etj) dhe liritë dhe të drejtat e qytetarëve (standartet nderkombëtare e të drejtave të njeriut, njohja dhe mbrojtja

e këtyre të drejtave, mekanizmat ligjor, detyrat e qytetarëve etj) dhe institucionet demokratike të shtetit (legjislativi, ekzekutivi, gjyqësore, fushveprimi dhe kufizimet reciproke të tri pushteteve, forcat e sigurisë dhe rendit, ombduspersoni, agjensionet e pavarura, etj.

Mënyrat e miratimit dhe ndryshimit të kushtetutave

Procesi kushtetutdhënës në rradhë të parë paraqet një proces politik me të cilin shteti realizon qëllimet e caktuara politike. Fillimi i nxerrjes së kushtetutës, vlerat që ajo do të promovojë dhe mbrojë, qëllimet dhe pretendimet e saj gjithmonë manifestojnë një vullnet politik. Ky vullnet politik duhet të manifestojë dëshirat legjitime të popullit dhe qytetarëve, të cilat manifestohen dhe artikulojnë drejtpërdrejt ose përmes organeve përfaqësuese.

Dimensionimi politik i procesit kushtetues manifestohet në disa elemente siq janë:

Fillimi i procedurës së nxerrjes së Kushtetutës është një vendim politik i parlamentit ose organit tjetër; para fillimit të draftimit të kushtetutës ndërtohet konsensusi i nevojshëm politik për vlerat që do të promovojë dhe mbrojë kushtetuta; miratimi i kushtetutës bëhet përmes parlamentit si organ politik, ose nga qytetarët në referendum, ku ata drejtpërdrejt manifestojnë vullnetin politik për Kushtetutën si dhe procesi i amendamentimit të kushtetutës dhe përcaktimi i kahjeve të reformës kushtetuese paraqet një vendim politik të institucioneve kompetente.

Së këndejmi mund të konkludojmë, se hartimi i Kushtetutës paraqet një proces politiko-juridik, me të cilin institucionet dhe lidhshipi politik vendosin bazat politike të kushtetutës, kurse ekspertët kushtetues implemendojnë këto objektiva, përmes shkrimit profesional të kushtetutës dhe draftimit të një teksti kushtetues ku artikulojnë apiratat e popullit.

SUNDIMI I LIGJIT-SHTETI I SË DREJTËS

Parimi i kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë

Me kushtetutshmëri në kuptimin pozitiv-juridik, nënkuptohet harmonizimi i të gjitha akteve juridike me kushtetutën. Ky aspekt bazohet në “hierarkinë juridike”, me të cilën nënkuptohet harmonizimi, i të gjitha akteve të ulëta me ato të larta. Përkufizimi pozitiv-juridik përputhet me kuptimin formal të kushtetutës. Përderisa, kushtetuta në kuptimin formal është akt më i lartë juridik i shtetit, kushtetutshmëria është proces, me të cilin nënkuptohet respektimi i kushtetutës dhe harmonizimi, i të gjitha akteve juridike me aktet, me fuqi më të lartë juridike.

Në kuptimin formal, me kushtetutshmëri, kuptohet respektimi i kushtetutës dhe i akteve tjera juridike nga qytetarët dhe subjektet tjera të shoqërisë. Esenca e këtij kuptimi konsiston në zbatimin e kushtetutës si dokument themelor organik i një shteti, që përcakton kompetencat e degëve të ndryshme të pushtetit si dhe kufijtë e autoritetit shtetëror. Sipas këtij kuptimi, në një shoqëri ekziston kushtetutshmëria dhe ligjshmëria, nëse respektohet kushtetuta dhe ligji, nëse janë përcaktuar mekanizmat institucionale për mbrojtjen e tyre. Kuptimi politik i kushtetutshmërisë konsiston në rolin e saj, në kufizimin e pushtetit shtetëror, kufizimin e funksioneve të organeve dhe institucioneve shtetërore publike, në përcaktimin dhe mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të individit dhe qytetarit, etj.

Ligjshmëria si nocion dhe proces, është formë e kushtetutshmërisë, e bazuar në qeverisjen e së drejtës dhe respektimin e ligjit dhe akteve tjera nënligjore. Me ligjshmëri kuptohet procesi i harmonizimit të të gjitha akteve dhe veprimeve juridike me ligjin. Edhe ligjshmëria mund të vështrohet në aspekte të ndryshme, por ajo para së gjithash është proces juridiko-politik, në funksion të ndërtimit të shtetit modern ligjor.

Elementet kushtetuese që përcaktojnë kushtetutëshmerinë dhe ligjshmërinë

Parimi i kushtetutshmërisë, si bazë e rregullimit shoqëror dhe politik të shteteve bashkëkohore, bazohet në disa parime, nga të cilat po veçojmë: sistemi shoqëror dhe ekonomik i shtetit, bazohet dhe buron nga kushtetuta, e cila është bazë e institucionalizimit politik dhe shoqërisë; Qeverisja shtetërore e shoqërisë, përcaktohet me kushtetutë dhe i nënshtrohet asaj; Sistemi juridik i shtetit krijohet dhe bazohet në kushtetutë, si akti më i lartë juridik; Të drejtat dhe liritë e qytetarëve, përcaktohen me kushtetutë dhe ato mund të kufizohen vetëm në rastet e përcaktuara me ligj; Kujdesi për mbrojtjen e kushtetutshmërisë, është detyrë e organeve shtetërore, e institucioneve politike dhe e bartësve të funksioneve politike; Çdo qytetar, ka të drejtë të marrë nismën për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë; Në shtetet federative, kushtetuta federative ka përparësi ndaj kushtetutave të shteteve federale; Aktet juridike, për të cilat nga organi kompetent konstatohen se janë kundërkushtetuese, nuk mund të zbatohen dhe Mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe e ligjshmërisë është në kompetencë të gjykatave

kushtetuese dhe organeve tjera, të përcaktuara me kushtetutë. Ligjshmëria bazohet në harmonizimin e sistemit juridik dhe në bazueshmërinë e tij në ligj.

Ndër parimet kryesore të ligjshmërisë janë:

Parimi i supremacionit të ligjit, ndaj akteve tjera juridike dhe të gjitha këto akte me fuqi nënligjore, duhet të jenë në pajtim me ligjin; Parimi i epërsisë së ligjit federativ, ndaj ligjeve të njësisve federale. Ky parim vlen vetëm për shtetet federative, ku ligjet e njësisve federale, nuk mund të jenë, në kundërshtim me ligjet federative; Parimi i shpalljes së obligueshme të ligjeve, para hyrjes së tyre në fuqi. Ky parim, nënkupton obligimin e organit që nxjerr ligjet, për t'i botuar ato në publikim të posaçëm (Gazetën Zyrtare) para se të hyjnë në fuqi Shpallja dhe publikimi i ligjeve, ka dy qëllime kryesore: e para, t'i njoftojë qytetarët me përmbajtjen e tij dhe e dyta, t'i mundësojë organeve kompetente shtetërore përgatitjen për fillimin e zbatimit të ligjit; Parimi i ndalimit të efektit prapaveprues (retroaktiv) të ligjit. Ky parim, do të thotë se, ligjet kanë efekt që nga dita e miratimit të tyre dhe se marrëdhëniet juridike, të filluara pas para hyrjes në fuqi të ligjit të ri, zhvillohen dhe përfundojnë në bazë të ligjit të vjetër. Përrjashtim nga kjo, bëjnë ligjet penalo-juridike, të cilat mund të kenë efekt prapaveprues, vetëm në rast kur janë më të favorshme për kryesit e veprave penale, p.sh. nëse ligji i ri për veprën penale përcakton dënimin më të butë se ligji i vjetër; Ligjshmëria e akteve dhe veprimeve të organeve shtetërore. Të gjitha aktet dhe veprimet e ndërmarra nga organet shtetërore dhe institucionet që ushtrajnë autorizime publike, duhet të jenë në përputhje me ligjin; Procedura e organeve shtetërore për njohjen e një të drejte apo për përcaktimin e ndonjë detyrimi, duhet të zhvillohet në bazë të ligjit. Këtu nënkuptohet, obligimi i organeve shtetërore, që në afatet e caktuara të ndërmarrin, të gjitha veprimet procedurale për të mundësuar realizimin efikas të të drejtave të qytetarëve; E drejta e palës, që në procedurën para organeve shtetërore, të shërbehet me gjuhën amtare. Ky është parim ligjor, që duhet të sigurojë barazinë e të gjithë qytetarëve para ligjit dhe komunikimin e tyre me organet shtetërore, në gjuhën amtare. Mosnjohja e gjuhës zyrtare, në të cilën zhvillohet procedura, nuk guxon të jetë pengesë për palën në procedurën para organeve shtetërore. Organet shtetërore, janë të obligueshme që t'ia lehtësojnë përdorimin e gjuhës amtare, e në rast kur kjo gjuhë, nuk përputhet me gjuhën zyrtare, duhet t'i sigurojmë palës përkthyes, gjatë tërë rrjedhës së procedurës; dhe e drejta e qytetarëve për përdorimin e mjeteve juridike, për mbrojtjen e të drejtave të tyre individuale dhe kolektive. Me këtë parim, nënkuptohet e drejta e qytetarëve, për përdorimin e ankesave dhe të mjeteve tjera juridike, ndaj akteve të organeve shtetërore.

LEGJISLATIVI - KUVENDI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Kuvendi në aspektin kushtetues përkufizohet si organ ligjdhënës izgjedhur drejtpërdrejt nga qytetaret me drejtë vote. Funkzioni primar i parlamentit është ligjvënës, kurse funksione tipike për të janë edhe përcaktimi i politikave dhe vendimarrja për çështjet kryesore publike. Në Kosovë, Kuvendi është institucion ligjvënës i Republikës i zgjedhur drejtpërdrejtë nga populli.¹ Përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së deputetëve është e përcaktuar me Kushtetutë, neni 64, ku Kuvendi i Kosovës përbëhet nga 120 deputetë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura. Vendet në kuvend ndahen midis të gjitha partive, koalicionëve, nismave qytetare dhe kandidatëve të pavarura, në përpjestime me numrin e votave të vlefshme të fituara në zgjedhjet për kuvend. Në kuadër të kësaj ndarje, 20 vende janë të garantuara për përfaqësimin e komuniteteve pakice në Kosovë. Vendet e rezervuar dhe të garantuara për komunitete të cilat nuk janë shumicë në Kosovë, në mënyrën si në vijim: Dhjetë (10) ulëse do t'i ndahen partive, koalicionëve, iniciativave qytetare dhe kandidatëve të pavarur të cilët janë deklaruar se përfaqësojnë komunitetin serb të Kosovës dhe dhjetë (10) ulëse do t'i ndahen komuniteteve tjera si në vijim: komuniteti rom një (1) ulëse; komuniteti ashkali një (1) ulëse; komuniteti egjiptian një (1) ulëse; dhe një (1) ulëse shtesë do t'i jepet komunitetit rom, ashkali apo egjiptas, që ka numrin më të madh të votave të përgjithshme; komuniteti boshnjak tri (3) ulëse; komuniteti turk dy (2) ulëse dhe komuniteti goran një (1) ulëse.²

Kompetencat e Kuvendit në Kushtetutë përcaktohen sipas metodës së enumeracionit taksativ.³ Kushtetuta në mënyrë taksative përcakton fushën e veprimit të Kuvendit dhe jashtë kompetencave prekluzive kushtetuese, parlamenti nuk ka përgjegjësi. Pra nuk ka kompetenca të supozuara të parlamentit, por vetëm të kompetenca shprehimore të përcaktuara dhe të numëruara në mënyrë taksative, Kompetencat e parlamentit janë mjaft të gjëra dhe fillojnë me kushtetudhënien dhe ligjdhënien dhe përfundojnë me funksione të gjëra zgjedhore.

¹ *Burimi: kushtetuta e Republikës së Kosovës neni 63*

² *Po aty, neni 64 paragrafi, 1, 2, 3 dhe neni 148 dispozitat transicionale për Kuvendin e Kosovës*

³ *Po aty, Neni 65 Kompetencat e Kuvendit: (1) miraton ligje, rezoluta dhe akte të tjera të përgjithshme; (2) vendos të ndryshojë Kushtetutën me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij, përfshirë dy të tretat (2/3) e të gjithë deputetëve që mbajnë vendet e rezervuara dhe të garantuara për përfaqësuesit e komuniteteve që nuk janë shumicë në Kosovë; (3) shpall referendum, në pajtim me ligjin; (4) ratifikon traktatet ndërkombëtare; (5) miraton Buxhetin e Republikës së Kosovës; (6) zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe nënkryetarët e Kuvendit; (7) zgjedh dhe mund të shkarkojë Presidentin e Republikës së Kosovës në pajtim me këtë Kushtetutë; (8) zgjedh Qeverinë dhe shpreh mosbesimin ndaj saj; (9) mbikëqyr punën e Qeverisë dhe të institucioneve të tjera publike, të cilat, në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve, i raportojnë Kuvendit; (10) zgjedh anëtarët e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në pajtim me këtë Kushtetutë; (11) propozon gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese; (12) mbikëqyr politikën e jashtme dhe të sigurisë; (13) jep pëlqimin për dekretin e Presidentit mbi shpalljen e Gjendjes së Jasthëzakonshme; si dhe (14) vendos për çështjet me interes të përgjithshëm, të përcaktuara me ligj.*

Kompetenca e kontrollit parlamentar të qeverisë

Parashtrimi i pyetjeve parlamentare (parashtrimi i pyetjeve për kryeministrin, ministrat dhe titullarët tjerë të organeve dhe agjensioneve ekzekutive). Parimi inter partes raporti midis dy palëve; deputetit si parashtrues i pyetjes dhe kryeministrit ose ministrit si palë të cilës i adresohet pyetja. Te pyetja parlamentare nuk lejohet ndërhyrja e palës së tretë, nuk ka debat parlamentar dhe mocion të votimit. Interpelanca parlamentare (mocioni i interpelancës ndaj kryeministrit, ministrave dhe titullarve dhe agjensioneve ekzekutive të shtetit).

Parimi erga omnes- raporti shumëpalësh parlamentar, lejon pjesëmarrjen e palëve të treta në mocion, qoftë në mbështetje ose në kundërshtim të mocionit të interpelancës. Komisionet anketuese-investiguese kanë për detyrë të hetojnë akuzat për tejkalim kompetencash ose keqpërdorim të funksioneve të organeve dhe agjensioneve ekzekutive të shtetit. Si rregull komisionet anketuese udhëheqen nga opozita dhe pas investigimit parlamentar dorëzojnë raportin hetimor për shqyrtim dhe miratim parlamentar. Mocioni i mosbesimit të qeverisë⁴ si dhe fillimi i procedurës dhe ngritja e akuzës ndaj presidentit.⁵

Komisionet e Kuvendit janë trupa punues të parlamentit, të cilat ushtrojnë funksione të caktuara nga rrethi i fushëveprimit të tij. Numri, përbërja dhe funksionet e komisioneve parlamentare përcaktohen me rregulloren e punës së Kuvendit.⁶

Grupet parlamentare paraqesin trupat punues të parlamentit, të cilët tubojnë deputetet e një partie politike apo të një koalicioni politik. Këto grupe ha rmonizojnë qëndrimet e deputetëve të partive politike dhe marrin qëndrim për mënyrën e deklaramit të tyre, kur në seancë të parlamentit vendoset për çështje të ndryshme politike.

Shpërndarja e parlamentit paraqet një institucion parlamentar që nënkupton përfundimin e mandatit të parlamentit para skadimit të mandatit të rregullt për të cilin është zgjedhur. Shpërndarja e parlamentit vjen si pasojë e rrethanave të caktuara kushtetuese dhe politike, të cilat bllokojnë punën e tij, bëjnë të pamundshëm ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe si rezultat i krizave të thella parlamentare, të cilat nuk mund të tejkalohen me mjete tjera politike. Shumica e kushtetutave njohin institutin e shpërndarjes së parakohshme dhe përcaktojnë procedurat e shpërndarjes. Si rrethana kryesore kushtetuese që ndikojnë në shpërndarjen e parakohshme janë; konfliktet në mes presidentit dhe parlamentit rreth zgjedhjes së kryeministrit dhe qeverisë, votimi i mocionit të mosbesimit të qeverisë, mos zgjedhjes së presidenti të Republikës së Kosovës brenda afatit të përcaktuar si dhe krizat e thella parlamentare.⁷

4 *Po aty neni 100*

5 *Po aty neni 91*

6 *Po aty neni 77*

7 *Po aty, neni 82, paragrafi 1 dhe paragrafi 2*

SHEFI I SHTETIT

Presidenti i Republikës së Kosovës

Kushtetutat e përkufizojnë shefin e shtetit si kryetar individual të shtetit që përfaqëson unitetin e vendit. Në këtë mënyrë është përcaktuar edhe në kushtetutën e Kosovës. Presidenti është kreu i shtetit dhe përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës.⁸ Ai zgjedhet nga Kuvendi me votim të fshehtë. Të drejtën për t'u nominuar për kandidat për president e ka çdo shtetas i cili ka mbushur moshën tridhjetë e pesë (35) vjeq, dhe nëse arrin t'i sigurojë nënshkrimet e të paktën tridhjet (30) deputetëve. Kandidatët të cilët kanë nga tridhjet nënshkrime hyjnë në garë për t'u zgjedhur. Zgjedhja e presidentit bëhet me dy të tretat (2/3) e votave të gjithë deputetëve të Kuvendit.⁹

Kandidati i cili i merr dy të tretat (2/3) e votave zgjedhet president i Kosovës. Por, nëse asnjëri nga kandidatët nuk merr shumicën prej dy të tretave (2/3) në dy votimet e para, organizohet votimi i tretë në mes dy kandidatëve të cilët kane marre numrin me të larte të votave në votimin e dyte dhe kandidati që merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve, zgjedhet president i Republikës së Kosovës.¹⁰

Në raste kur edhe në votimin e tretë, asnjëri kandidat nuk zgjedhet president, kuvendi shpërndahet dhe shpallen zgjedhjet e reja, të cilat duhet të mbahen brenda dyzet e pesë (45) dite.¹¹ Mandati i presidentit është pesë (5) vjet dhe fillon pasi Presidenti të ketë dhënë betimin para Kuvendit. Gjatë mandatit, Presidenti i Republikës së Kosovës gëzon imunitet nga ndjekja penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet dhe vendimet brenda fushëveprimit të përgjegjësive të Presidentit të Republikës së Kosovës.¹² Kompetencat kushtetuese të Presidentit të Republikës së Kosovës janë përcaktuar me nenin 84 të Kushtetutës.

Bazuar në Kushtetutë, Presidenti i Kosovës përfaqëson Republikën e Kosovës brenda dhe jashtë; garanton funksionimin kushtetues të institucioneve të përcaktuara me Kushtetutë; shpall zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës dhe thërret mbledhjen e parë të tij; shpall ligjet e miratuara nga Kuvendi; ka të drejtën e kthimit për rishqyrtim të ligjeve të miratuara, nëse konsideron se janë të dëmshme për interesat legjitime të Republikës së Kosovës ose të një a më shumë komuniteteve të saj. Presidenti të drejtën e rikthimit të një ligji mund t'a shfrytëzojë vetëm një herë. Ai nënshkruan marrëveshjet ndërkombëtare në pajtim me Kushtetutën; propozon amendamente për Kushtetutën; mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese; udhëheq politikën e jashtme të vendit; pranon letrat kredenciale të shefave të misioneve diplomatike të akredituar në Republikën e Kosovës; është Komandant Suprem i Forcave të Sigurisë të Kosovës; udhëheq Këshillin Konsultativ për Komunitete; cakton mandatarin për formimin e Qeverisë, pas propozimit të partisë politike ose të koalicionit, që përbën shumicën e Kuvendit; emëron dhe shkarkon Kryetarin e Gjykatës Supreme të Kosovës

8 *Po aty, neni 83*

9 *Po aty, neni 86, paragrafi 4*

10 *Po aty, neni 86, paragrafi 5*

11 *Po aty, neni 86, paragrafi 6*

12 *Po aty, neni 89*

me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; emëron dhe shkarkon gjyqtarët e Republikës së Kosovës me propozimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës; emëron dhe shkarkon Kryeprokuroren e Shtetit të Republikës së Kosovës, me propozimin e Këshillit Prokuroial të Kosovës; emëron dhe shkarkon prokurorët e Republikës së Kosovës, me propozimin të Këshillit Prokurorial të Kosovës; emëron gjyqtarët për Gjykatën Kushtetuese, me propozimin e Kuvendit; emëron Komandantin e Forcave të Sigurisë të Kosovës, pas rekomandimit të Kryeministrit; së bashku me Kryeministrin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë; vendos për shpalljen e Gjendjes së jashtëzakonshme, në konsultim me Kryeministrin; mund të kërkojë mbledhje të Këshillit të Sigurisë të Kosovës dhe i kryeson ato në kohën e Gjendjes së jashtëzakonshme; vendos për formimin e misionëve diplomatike e konsullare të Republikës së Kosovës, në bazë të konsultimit me Kryeministrin; emëron dhe shkarkon shefat e misionëve diplomatike të Republikës së Kosovës, me propozimin e Qeverisë; emëron Kryetarin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve; emëron Guvernatorin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës i cili shërben edhe si Drejtor Menaxhues dhe emëron anëtarët e tjerë të Bordit të Bankës; jep medalje, mirënjohje dhe çmime, në pajtim me ligjin dhe shpall falje individuale, në pajtim me ligjin si dhe së paku një herë në vit i drejtohet Kuvendit të Kosovës përkitazi me fushëveprimtarinë e tij/saj.

Mungesa e Përkohshme dhe Shkarkimi i Presidentit është e përcaktuar në Kushtetutë në ato raste kur posti i presidentit për arsye të ndryshme mbetet i lire. Atë here Kryetari i Kuvendit të Kosovës do të shërbejë si ush- trues i detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës. në keto raste posti i ushtruesit të detyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës, nuk mund të ushtrohet për një periudhë më të gjatë se gjashtë (6) muaj.¹³

Gjithashtu, Presidenti i Republikës së Kosovës mund të shkarkohet nga Ku-vendi nëse ai/ajo është dënuar për kryerjen e krimit të rëndë; nëse nuk është i/e aftë për të ushtruar përgjegjësitë e këtij posti për shkak të sëmundjes së rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese ka përcaktuar se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës. Procedura për shkarkimin e tij mund të iniciohet nga një e treta (1/3) e deputetëve të Kuvendit, të cilët nënshkruajnë një peticion, i cili shpjegon arsyet për shkarkim. Në rast se peticioni supozon ndonjë shkelje të rëndë të Kushtetutës, peticioni duhet t'i dorëzohet menjëherë Gjykatës Kushtetuese, e cila vendosë për këtë çështje brenda shtatë (7) ditësh nga marrja e peticionit. Atëherë nëse Presidenti është dënuar për ndonjë krim të rëndë ose nëse Gjykata Kushtetuese konstaton se ajo/ai ka bërë shkelje të rëndë të Kushtetutës, Kuvendi mund të shkarkojë Presidentin me dy të tretat (2/3) e votave të të gjithë deputetëve të tij.¹⁴

13 Po aty, neni 90 paragrafi 3

14 Po aty, neni 91, paragrafi 1,2,3

EKZEKUTIVI-QEVERIA

Qeveria si organ ekzekutiv paraqitet me emërtime të ndryshme kush- tetuese. Ajo determinohet nga tradita shtetërore dhe modeli i funksionimi të qeverisë në një shtet.

Mënyra e zgjedhjes dhe format e organizimit të qeverisë si organ të pu- shtetit ekzekutiv në sistemet parlamentare zgjedhet e kontrollohet nga ana e parlamentit. Në shumicën e shteteve me sistem parlamentare rol të rëndësishëm në formimin e qeverisë, ka shefi i shtetit, i cili propozon mandatarin (kryeministrin) për formimin e qeverisë. Varësisht nga mënyra e zgjedhjes së qeverisë dhe pozita e saj në raport me parlamentin, në teorinë parlamentare janë të njohura dy modele themelore të funksionimit të qeverisë: qeveria parlamentare dhe qeveria që funksionon sipas modelit të kabinetit. Përpos këtyre dy modeleve janë të njohura edhe format tjera të qeverisë: qeveria teknike, qeveria e ekspertëve, qeveria e shpëtimit kombëtar, qeveria në hije etj.

Modelet kushtetuese të qeverisë: Qeveri parlamentare quhet ajo e cila formohet dhe funksionon sipas rregullave parlamentare. Kjo qeveri zgjedhet pas zgjedhjeve parlamentare, kur krahas konstituimit të parlamentit të ri zgjedhet edhe qeveria si organ ekzekutiv. Mandati i formimit të qeverisë në sistemet parlamentare i takon partisë politike, e cila i ka fituar zgjedhjet parlamentare. Kjo parti, në rast se fiton shumicën e mandateve parlamentare, ka të drejtë që nga radha e anëtarëve të saj të formojë qeverinë. Në rastet, kur asnjë parti parlamentare nuk ka shumicën e mandateve në parlament, vjen deri të formimi i qeverisë së koalicionit midis dy apo më shumë partive politike. Qeveria e koalicionit në përbërje të saj ka anëtar të partive politike të cilat kanë hyrë në koalicion politik me rastin e formimit të qeverisë.

Qeveria e kabinetit: Kjo formë e funksionimit të qeverisë, karakterizohet me pavarësinë më të madhe të saj në raport me parlamentin. Edhe pse formalisht emërohet nga parlamenti, qeveria e kabinetit funksionon si organ i pavarur shtetëror. Rolin dominues në konstituimin e kësaj qeverie e ka kry- eministri, i cili pas marrjes së mandatit nga ana e shefit të shtetit (monarkut apo kryetarit të Republikës) e formon kabinetin e tij nga personat, të cilët i zgjedh personalisht. Qeveria e cila funksionon në formë të kabinetit ka fun-ksione të gjëra shtetërore dhe politike. Ajo, praktikisht, qeverisë me pusht- etin shtetëror. Autorizimet e parlamentit në drejtim të kontrollit parlamentar të qeverisë së kabinetit janë të kufizuara dhe ai, si rregull, nuk mund të shtrojë çështjen e votëbesimit të saj.

Kabineti si organ ekzekutiv formohet sipas rregullave parlamentare. Kjo do të thotë se atë e formon partia politike e cila gjendet në pushtet. Ky sistem gjen aplikim në shtetet dypartiake, ku rivaliteti politik zhvillohet midis dy partive politike. Partia e cila i fiton zgjedhjet ka të drejtë të formojë kabinetin nga radhët e saj.

Qeveria e ekspertëve-teknike: Përpos organizmit të qeverisë në formë parlamentare dhe të kabinetit, në praktikë janë shënuar raste të formimit të të ashtuquajturës “qeveri teknike apo e ekspertëve”. Karakteristikë dominuese e këtij modeli të qeverisë është karakteri jashtëpartiak i saj. Në të vërtetë, kjo qeveri nuk formohet dhe funksionon në bazë të rregullave parlamentare. Atë nuk e përbëjnë pjesëtarët e partisë politike në

pushtet, por ekspertët nga radhët e partive të ndryshme politike, përkatësisht ekspertë që nuk i takojnë asnjë partie politike.

Mandati i këtyre qeverive është i kufizuar deri në eliminimin e shkaqeve që kanë shkaktuar krizën parlamentare. Qeveria teknike zgjedhet nga parlamenti në bazë të marrëveshjes dhe pëlqimit të partive politike parlamentare. Në praktikën parlamentare qeveritë teknike më së shpeshti formohen kur shtetet gjenden në krizë parlamentare, si pasojë e konflikteve ndërpartiake.

Qeveria e unitetit kombëtar: Sikurse qeveria teknike edhe ky model i qeverisë aplikohet në rastet e jashtëzakonshme, kur shteti gjendet në krizë të thellë politike dhe ekonomike, apo kur është i përfshirë në luftë civile dhe ndëretnike. Siç rrjedhë edhe nga vetë emërtimi i saj, kjo qeveri ka për qëllim shpëtimin e shtetit dhe kombit, në rastet, kur rrezikohet substanca e tij ekonomike dhe politike, si rezultat i faktorëve të brendshëm apo ndërkombëtar. Këto rrethana, bëjnë të pamundshëm funksionimin e sistemit kushtetues dhe institucional dhe shtrojnë nevojën e formimit të një qeverie gjithëkombëtare, të cilës i besohet qeverisja e shtetit në rrethana të jashtëzakonshme. Kjo qeveri zgjedhet jashtë rregullave parlamentare dhe në të hyjnë personalitetet më të shquara të një shteti (kombi). Mandati i kësaj qeverie është i kufizuar dhe limituar me kohëzgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme. Pas tejkalimit të kësaj gjendjeje, zakonisht mbahen zgjedhjet e jashtëzakonshme parlamentare. Me përfundimin e këtyre zgjedhjeve, i pushon mandati qeverisë së shpëtimit kombëtar dhe formohet qeveria parlamentare. Ky model i qeverisë është i rrallë në praktikë.

Qeveria e Republikës së Kosovës

Përbërja Qeverisë së Kosovës është përcaktuar me Kushtetutë ndërsa orga- nizimi dhe funksionimi saj, mënyra e punës dhe procedurat e vendimmarrjes në Qeveri si dhe bashkëpunimi ndërmjet Qeverisë dhe institucioneve të tjera të përcaktuara me Kushtetutë rregullohen me ligj dhe me rregulloren e Qeverisë.

Qeverinë e Kosovës e përbëjnë Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat. Ajo e ushtron pushtetin ekzekutiv në pajtim me Kushtetutën dhe ligj. Qeveria zbaton ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe ushtron veprimtari tjera brenda përgjegjësive të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj.

Qeveria ka këto kompetenca të përcaktuara me Kushtetutë. Ajo propozon dhe zbaton politikën e brendshme dhe të jashtme të vendit; mundëson zhvillimin ekonomik të vendit; propozon Kuvendit projektligje dhe akte të tjera; merr vendime dhe nxjerr akte juridike ose rregullore, të nevojshme për zbatimin e ligjeve; propozon Buxhetin e Republikës së Kosovës; udhëzon dhe mbikëqyr punën e organeve të administratës; udhëzon veprimtarinë dhe zhvillimin e shërbimeve publike; i propozon Presidentit të Republikës së Kosovës emërimet dhe shkarkimet për shefa të misioneve diplomatike të Kosovës; propozon amendamentimin e Kushtetutës dhe mund të referojë çështje kushtetuese në Gjykatën Kushtetuese si dhe ushtron edhe funksione të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore¹⁵.

¹⁵ Po aty, neni 93

Kryeministri i Kosovës ka këto kompetenca: përfaqëson dhe udhëheq Qeverinë; siguron që të gjitha Ministritë të veprojnë në pajtim me politikat qeveritare; siguron zbatimin e ligjeve dhe të politikave të përcaktuara të Qeverisë; ndërron anëtarët e Qeverisë, pa pëlqimin e Kuvendit; kryeson Këshillin e Sigurisë të Kosovës; emëron Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Kosovës; këshillohet me Presidentin e Republikës së Kosovës mbi çështjet e Inteligjencës; së bashku me Presidentin, emëron Drejtorin, Zëvendësdrejtorin dhe Inspektorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë dhe këshillohet me Presidentin për zbatimin e politikës së jashtme të vendit si dhe kryen edhe punë të tjera, të përcaktuara me Kushtetutë dhe me ligj¹⁶.

Pas zgjedhjeve ose kur Kryeministri jep dorëheqje ose kur posti i tij/saj mbetet i lirë, fillon procedura për formimin dhe zgjedhjen e Qeverisë. Presidenti i propozon Kuvendit mandatarin për Kryeministër, në konsultim me partinë politike ose koalicionin që ka fituar shumicën e nevojshme në Kuvend për të formuar Qeverinë. Kandidati për Kryeministër, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas emërimit, paraqet përbërjen e Qeverisë para Kuvendit dhe kërkon miratimin nga ana e tij. Në qoftë se Qeveria i merr shumicën e votave të të gjithë deputetëve konsiderohet e zgjedhur. Anëtarët e Qeverisë pas zgjedhjes e japin betimin para Kuvendit.¹⁷ Por, nëse përbërja e propozuar e Qeverisë nuk merr shumicën e votave të nevojshme, Presidenti, brenda dhjetë (10) ditësh emëron kandidatin tjetër sipas së njëjtës procedurë. Nëse as herën e dytë nuk zgjidhet Qeveria, atëherë Presidenti i Kosovës i shpall zgjedhjet, të cilat duhet të mbahen jo më vonë se dyzet (40) ditë nga dita e shpalljes së tyre.¹⁸

Qeveria për punën e vet, i përgjigjet Kuvendit, Kryeministri, zëvendës kryeministrat dhe ministrat mbajnë bashkëpërgjegjësinë për vendimet që merr Qeveria, dhe përgjegjësinë individuale për vendimet që marrin në fushat e përgjegjësisë së tyre.

Raporti i qeverisë dhe Instrumentet e kontrollit parlamentar të qeverisë janë: miratimi i buxhetit; raportet periodike të qeverisë, pyetjet parlamentare, Interpelanca parlamentare, komisionet anketuese parlamentare, mocioni i votë besimit dhe shkarkimi i qeverisë. Pushimi i mandait të qeverisë behet me dorë heqje e kryeministrit, votimi i mosbesimit të qeverisë nga parlamenti dhe shpërndarja e parlamentit.

¹⁶ Po aty, neni 94

¹⁷ Po aty, Neni 95, paragrafi 6

¹⁸ Po aty, neni 95

SISTEMI I DREJTËSISË

Parimet kushtetuese të gjyqësorit

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga gjykatat. Pavarësia e gjykatave garantohet dhe sanksionohet në Kushtetutë dhe në legjisllacionin e vendit. Të gjitha institucionet (legjisllative dhe ekzekutive) qeveritare dhe të tjera, kanë për detyrë të respektojnë pavarësinë e pushtetit gjyqësor. Gjykatat, gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit dhe ky parim është bazë dhe kornizë e pavarësisë së tyre. Pra, gjykatat realizojnë funksionin e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshem nga institucionet dhe subjektet e tjera të percaktuar me Kushtetutë dhe ligj. Gjykatat i zgjedhin çështjet që u parashtrohen me paanësi, duke u mbështetur në fakte dhe sipas ligjit, pa kufizime dhe pa qenë objekt ndikimesh, nxitjesh, presionesh ose ndërhyrjesh direkte ose indirekte.

Ne kuadër të parimeve të përgjithshme të sistemit gjyqësorit hyjnë: pavarësia e gjyqësisë nga legjisllativi dhe ekzekutivi paraqet parakushtin kryesor për ekzistimin e kushteve për pavarësinë e gjyqësisë. Ky parim konsiston në mos varësinë e gjykatave nga parlamenti dhe qeveria, dhe në mos ushtrimin e kontrollit politik ndaj punës së tyre; depolitizimi i gjykatave, paraqet një parim tjetër, për funksionimin e gjyqësisë së pavarur. Gjykatat dhe anëtarët e saj nuk mund të involvohen drejtpërdrejt, aktivisht në jetën politike. Pra, brenda organizimit gjyqësor është i ndaluar çdo veprim politik, në baza partiake ose në forma tjera të organizimit politik;²⁰ financimi i pavarur paraqet një garanci të funksionimit të gjyqësisë së pavarur. Kjo nënkupton se, gjykatat duhen të financohen nga një buxhet i pavarur i tyre, i cili nuk do të jetë nën kontroll të përhershëm të qeverisë, por do të administrohet dhe menaxhohet nga vetë gjykata; respektimi i procedurave gjyqësore është një kusht tjetër për ndërtimin e konceptit të gjyqësisë së pavarur dhe të shtetit gjyqësor në përgjithësi; zgjedhja e gjyqtarëve me afate të gjata, paraqet një element tjetër të ndërtimit të gjyqësisë së pavarur, i cili siguron sigurinë juridike të gjyqtarëve dhe ushtrimin e funksioneve të tyre. Duke qenë të zgjedhur për periudhat e gjata kohore,²¹ gjyqtarët marrin garanci se do të jenë të pavarur nga ndryshimet politike, të cilat pasojnë pas çdo cikli të zgjedhjeve parlamentare.

Mënyra e emërimit dhe shkarkimit të gjyqtarëve në Kosovë është e percaktuar me Kushtetutë. Gjyqtarët i emëron, riemëron dhe shkarkon Presidenti i Republikës me propozim e Këshillit gjyqësor.²² Gjyqtarët gëzojnë imunitet nga ndjekja penale, paditë civile dhe shkarkimi nga funksioni për vendimet e marra, votimet e bëra, mendimin e shprehur dhe për veprimet e tjera brenda fushëveprimit të detyrave dhe përgjegjësisive të tyre.

19 *Burimi: Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008, kapitulli VII, sistemi i drejtësisë neni 102*

20 *Burimi: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 106.*

21 *Po aty, neni 105*

22 *Po aty, Neni 104*

Ata nuk janë mbi ligjin. Gjyqtarët mund të shkarkohen nga funksioni për shkak të dënimit për një vepër të rëndë penale ose për mos respektimin e detyrës.

Në bazë të Kushtetutës, pavarësinë, paanëshmërinë e sistemit gjyqësorë e siguron Këshilli Gjyqësor i Kosovës.²³ Gjykata Supreme e Kosovës është autoriteti më i lartë gjyqësor. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave rregullohet me ligj.²⁴ Ky Ligj përcakton rregullat e organizimit dhe funksionimit të Gjykatave, statusin e gjyqtarit, parimet dhe rregullat e gjykimit, paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave, procedurat e veçanta, marrjen e vendimeve dhe ekzekutimin e tyre.²⁵

PROKURORI I SHTETIT

Prokurori i shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjesi për ndjekjen të personave të akuzuar për ndonjë vepër penale ose për ndonjë vepër tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.²⁶ Në përputhje me parimin e akuzativitetit në procedurën penale, kjo procedurë, në parim, nuk mund të fillojë dhe të zhvillohet, pa iniciativën e prokurorit të shtetit. Nga kjo, mund të konkludohet se, funksioni i ndjekjes penale, i është besuar subjektit të veçantë procedural, e ky është prokurori. Prokurori i shtetit është institucioni i paanshëm dhe vepron në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.²⁷

Organizmi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të shtetit rregullohen me ligjin²⁸ për Prokurorinë.²⁹ Emërimi i prokurorëve të shtetit bëhen nga Presidenti i Republikës të propozuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës.³⁰ Këshilli Prokurorial i Kosovës është insitucion i pavarur në kryerjen e funksioneve të tij dhe siguron që Prokurori i shtetit të jetë i pavarur, profesional, i paanshëm. Këshilli prokurorial i rekruton, propozon që t'i avancojë, transferojë, dic- iplinojë prokuroret në menyrën e rregulluar me ligj.³¹

Duke pasur parasysh natyrën dhe karakterin e funksionit që kryejnë, prokuroritë e shtetit janë të lidhura në vijë vertikale mes tyre. Në ushtrimin e funksionit të ndjekjes së kryesve të veprave penale dhe të veprave të tjera të dënueshme, të caktuara me ligj, prokurori i shtetit përcakton dhe merr masat e nevojshme, në bashkëpunim me organet tjera të autorizuara, lidhur me zbulimin e këtyre veprave dhe kryesve të tyre. Në pajtim me autorizimet e caktuara në ligj, prokurori orienton procedurën paraprake.

23 Po aty, Neni 108

24 Po aty, neni 103

25 Ligji për Gjykatat është në process të hartimit. Keshtu qe derisa të miratohet dhe të hyje në fyqi ky ligj, Gjykatat në Kosove, organizohen dhe funksionojn në baze të Rregulloreve të UNMIK-ut.

26 Burimi: Kushtetuta e Republikës se Kosoves, Neni 109 paragrafi 1.

27 Po aty, neni 109 paragrafi 2.

28 Po aty, neni 109 paragrafi 3

29 Ligji për Prokurinë është në process të hartimit. Keshtu qe deri sa të miratohet dhe të hyje në fyqi ky ligj, Prokurorit në Kosove, organizohen dhe funksionojn në baze të Rregulloreve të UNMIK-ut.

30 Burimi: Kushtetuta e Republikës se Kosoves, neni 84

31 Po aty. Neni 110

AVOKATI I POPULLIT (OMBUDSPERSONI)

Institucioni i Ombudsmanit si mbrojtës i të drejtave dhe lirive të individit dhe të personave juridik nga veprimet abuzive të organeve shtetërore dhe të administratës civile, i ka fillet e tij në Suedi, ku u formua për herë të parë në vitin 1809. Më vonë, gjatë shekullit XX, ky institucion u themelua në shumë shtete evropiane dhe në SHBA. Sot, shumica e shteteve anëtare të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian (OSBE), kanë të themeluar apo janë në themelim e sipër të institucionit të Ombudsmanit. Ka dallime prej shteti në shtet, sa i përket bazës ligjore të themelimit, organizimit, fushëveprimit, kompetencave dhe emërimit të institucionit të Ombudspersonit.

Disa shtete e kanë të rregulluar me kushtetutë, themelimin e institucionit të Ombudspersonit e disa të tjera, këtë e kanë rregulluar me ligj të veçantë. Në disa shtete, si në Kanada, Itali, Zvicër dhe në SHBA, nuk ka Ombudsman në nivel nacional, por atje ky institucion ekziston në nivel provincial apo lokal. Shtete të tjera, këtë institucion e kanë në nivel nacional. Në disa shtete Ombudsmani, është emërtuar edhe si avokat i popullit³². Avokatin e popullit të Kosovës e zgjedh kuvendi me shumicën e votave të të gjithë deputeteve të tije, për një mandat pesëvjeçar pa të drejtë rizgjedhje³³. Ai për punën e vet raporton para kuvendit me raport vjetor. Për të qenë efektiv dhe i respektuar nga njerëzit, Avokati i popullit është i pavarur nga institucionet dhe nga proceset politike dhe nuk duhet të jetë subjekt i ndërhyrjeve apo influencës, nga ata që mund të kenë interes për rezultatet e hulumtimit të ankesave.

Avokati i popullit mbikqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike³⁴ të Kosovës. Çdo institucion ose autoritet tjetër që ushtron pushtet legjitim në Kosovë është i detyruar t'i u përgjigjet kërkesave të avokatit të popullit dhe t'ia paraqes atyre të gjitha dokumentacionet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligjin. Është kompetencë kushtetuese e avokatit të popullit të bëjë rekomandime dhe të propozoj masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike si dhe organet e tjera shtetërore.

Por nëse, rekomandimet për masat e propozuara nga avokati i popullit nuk merren në konsideratë nga institucionet për t'i përmirësuar dhe evituar shkeljet e të drejtave dhe lirive të njeriut, ai/ajo bazuar në dispozitat kushtetuese ka të drejtë që çështjen të referoj në gjykatën kushtetuese³⁵. Avokati i popullit të Kosovës gëzon imunitet nga ndjekjet penale, paditë civile ose shkarkimi për veprimet ose vendimet që janë brenda fushës së përgjegjësive të avokatit të popullit.³⁶

32 *Arsim Bajrami, vep e cit. fq. 21*

33 *Po aty, neni 134, paragrafi 1*

34 *Po aty, neni 132, paragrafi 1*

35 *Po aty, Neni 135, paragrafi 3, 4*

36 *Po aty, neni 134, paragrafi 4*

GJYKATA KUSHTETUESE

Gjykata kushtetuese është organ i pavarur i mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe bënë interpretimin përfundimtar të kushtetutës.³⁷

Ajo është nje organ i veçantë kushtetues, të cilit i besohet mbrojtja e kushtetutshmërisë dhe ligjshmerisë. Gjykata kushtetuese në shumë vende paraqet mekanizmin kryesor institucional, që në mënyrë meritore mbronë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë dhe siguron parimin e sundimit të ligjit në shoqëri. Kushtetutat i japin autoritetin e nevojshëm kushtetues gjykatave kushtetuese, që të anulojnë të gjitha aktet jokushtetuese dhe joligjore, dhe të konstatojnë shkeljet e kushtetutës nga autoritetet udhëheqëse të shtetit. I takon gjykatës kushtetuese si autoriteti përfundimtar për interpretimin e kushtetutës dhe përputhshmërisë së ligjeve me kushtetutën dhe të vendos nëse është shkelur kushtetuta nga autoritetet publike.

Me kushtetutë është përcaktuar se autoriteti përfundimtar për interpretimin e kushtetues dhe përputhshmërisë së ligjeve me kushtetutën në Kosovë është Gjykata Kushtetuese.

Aktualisht janë të njohura disa forma kushtetese të mbrojtjes së kushtetutshmërisë dhe ligjshmerisë:

- a) *Mbrojtja e kushtetutës nga organi përfaqësues-parlamenti,*
- b) *Mbrojtja e kushtetutës nga gjykatat e rregullta-Gjykata Supreme (SHBA),*
- c) *Mbrojtja e kushtetutës nga një organ i veçantë kushtetues, Këshilli Kushtetues në Francë,*
- d) *Mbrojtja e kushtetutës nga ana e gjykatave kushtetuese,*
- e) *Mbrojtja dhe interpretimi i kushtetutës nga institucionet dhe mekanizmat ndërkombëtare, që zbatohet në vendet me administrim ndërkombëtar, ku prezenca ndërkombëtare ka të drejtat përfundimtare në interpretimin e kushtetutave të oktruara të këtyre shteteve, psh. Rasti i Bosnjës, ai i Kosovës me Kornizen Kushtetuese etj.*

Kompetencat e përgjithshme

Gjykatat kushtetuese kanë autorizime të gjëra në mbrojtjen e Kushtetutës. Ato bëjnë kontrollin e përgjithshëm të sistemit juridik nga aspekti i pajtueshmërisë të akteve dhe veprimeve me Kushtetutën. Gjithashtu, gjykatat kushtetuese vlerësojnë shkeljen e kushtetutës nga ana e institucioneve shtetërore dhe konstatojnë plotësimin e kushteve për shkarkimin dhe largimin nga detyra të zyrtarëve të lartë shtetëror, që nga presidenti, e gjerë tek zyrtaret e niveleve të ndryshme. Në disa sisteme kushtetuese, gjykatat kushtetuese vlerësojnë pajtueshmërinë kushtetuese të proceseve elektorale, të referendumëve dhe akteve tjera juridike dhe politike.

³⁷ Po aty, neni 4, paragrafi 6

Në aspektin e përgjithshëm kompetencat e gjykatave kushtetuese mund të ndahe në tri fusha kryesore:

Kontrulli i kushtetëshmërisë dhe ligjshmërisë dhe vlerësimi i ekzistimit të pajtueshmërisë së akteve juridike me kushtetutën dhe ligjin, Kontrulli i ekzistimit të shkeljeve, cenimit, ose mos rrespektimit të kushtetutës nga organet dhe institucionet shtetërore, përfshirë këtu edhe shkarkimin e zyrtarëve të lartë shtetëror, dhe Kontrulli i kushtetutëshmërisë³⁸ dhe ligjshmërisë së zgjedhjeve, referendumëve dhe akteve tjera juridike e politike.

Përbërja, organizimi dhe mënyra e zgjedhjes së gjyqëtarëve

Kushtetuta përcakton përbërjen, organizimin dhe mënyren e zgjedhjes së gjyqëtarëve të gjykatave kushtetuese. Gjykatat kushtetuese në përbërjen e tyre kanë një numer të kufizuar gjyqëtarësh, i përcaktuar me kushtetut. Përbërja e gjykatës kushtetuese e Kosovës është prej nente (9) gjyqëtarëve,³⁹ për zgjedhjen e tyre kërkohen kushtet të veçanta, të cilat kanë të bëjnë me pregaditjen profesionale, përvojën e gjatë kushtetuese dhe kredibilitetin e lartë moral të gjyqëtarëve. Zgjedhja e gjyqëtarëve bëhet nga dy organe: parlamenti i propozon dhe presidenti i emron për një mandat nentevjeçar, pa mundësi vazhdimi.⁴⁰ Zakonisht antarët e gjykatave kushtetuese zgjedhen për një periudhë të gjatë kohore. Gjykata kushtetuese e Kosovës udhëheqet nga kryetari dhe zëvendëskryetari i gjykatës të cilët zgjedhen me votim të fshehet të gjyqëtarëve të gjykatës për një mandat trevjeçar.⁴¹ Në këtë mënyrë ata zgjedhin njerin nga antarët e gjykatës për kryetarë për një periudhë trevjeçar. Por, zgjedhja në keto funksione, kryetar apo zëvendëskryetar nuk ia zgjate mandatin e gjyqtarit. Gjykata kushtetuese përcakton organizimin e vet të brendshëm, rregulloren e punës proceset e vendimmarrjes dhe çështjeve të tjera organizative në pajtim me ligjin.⁴²

Procedurat para gjykatës kushtetuese janë speciale dhe dallojnë nga rregullat klasike të gjyqësorit. Natyra e kontesteve të kjo gjykatë, është e karakterit të kontestit kushtetuese dhe procedurat gjyqësore janë të veçanta, dhe shprehin veçoritë e natyrës kushtetuese të kontesteve. Kështu që gjykata kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga palet e autorizuara siq është përcaktuar me kushtetut.

Përcaktimi i objektit të kontestit-padisë kushtetuese është një proces i vlerësimit të pajtueshmërisë së një akti, ose veprimi politik me kushtetutën. Ky kontest konsiston në konstatimin e ekzistimit të shkeljes së kushtetutës dhe në anulimin dhe shfuqizimin e një akti jo kushtetues, ose shpalljen jo kushtetuese të një veprimi të caktuar të organeve

38 Arsim Bajrami, *Draftimi i kushtetues, prishtine 2007, fq.23*

39 *Burimi: Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 114 paragrafi 1*

40 *Po aty, neni 114 paragrafi 2*

41 *Po aty, neni 114 paragrafi 5*

42 *Ligji për gjykatën kushtetuese është në proces të hartimit. Ky ligj do e rregullon organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, procedurat për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave pranë Gjykatës Kushtetuese, kushtet dhe procedurat për emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës, kualifikimet tjera përkatëse për emërimin e gjyqëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, parimet dhe rregullat themelore procedurale dhe çështje tjera organizative.*

dhe institucioneve shtetërore. Mbi bazën e këtyre shkeljeve mund të ngritet nga subjekti i autorizuar një padi kushtetuese.

Objekt i padisë kushtetuese mund të jenë: Aktet ligjore, aktet nënligjore, aktet e përgjithshme normative të parlamentit, Aktet nënligjore të qeverisë, dekretet, urdhëresat, udhëzimet, rregulloret, Aktet nënligjore të presidentit, dekretet, urdhëresat, rregulloret, Aktet e përgjithshme të organeve dhe agjencioneve ekzekutive, Aktet e përgjithshme të pushtetit lokal, statutet, rregulloret, etj, Shkeljet dhe mosrespektimi kushtetutës nga zyrtaret e lartë, shefi i shtetit, anëtarët e parlamentit në procedurat e revokimit dhe zyrtarëve të tjerë shtetëror, Vlerësimi i kushtetutëshmërisë së procesit të zgjedhjeve, zgjedhjes dhe shkarkimit të presidentit nga parlamenti, respektimi i procedurave kushtetuese, vlerësimi i kushtetutëshmërisë së referendumeve dhe proceseve tjera të rëndësishme, etj.⁴³

Palët e autorizuar që mund të fillojnë procedurën para gjykatës kushtetuese

Çështja e parë që parashtrohet të gjykata kushtetuese, ka të bëjë me përcaktimin e subjekteve që kanë të drejtë të fillojnë procedurën para kësaj gjykate. Propozuesit e autorizuar paraqesin subjekte primare të adresimit të gjykata kushtetuese. Këto subjekte paraqesin organet dhe institucionet kryesore kushtetuese, të cilat janë të detyruara ti drejtohen gjykatës kushtetuese për mbrojtjen e kushtetutëshmërisë, sa herë që në punën e tyre zyrtare ndeshen me dukuritë jo kushtetuese dhe jo ligjore. Shumica e kushtetutave parashikojnë si detyrime kushtetuese për organet dhe institucionet kushtetuese kujdesin për kushtetutëshmëri dhe ligjshmëri. Rrethi i këtyre organeve dhe institucioneve është mjaftë i gjërë dhe përfshinë këta propozues të autorizuar; Kuvendi (numri i caktuar të deputetëve); Presidenti dhe Qeveria, Gjykatat, Avokati i popullit, Komuna dhe Individët janë të autorizuar të ngrejnë shkeljet nga autoritetet publike për të drejtat dhe liritë e tyre individuale të garantuara me kushtetutë⁴⁴. Kur propozuesit e autorizuar parashtrojnë kërkesën për vlerësimin e kushtetutëshmërisë dhe ligjeshmërisë së një akti juridik ose veprimi të organeve shtetërore, gjykata kushtetuese do të nisë procedurën në mënyrë automatike dhe do të konstatojë ekzistimin e bazave të padisë kushtetuese.

Grupi i dytë i subjekteve, që mund të fillojnë procedurën e vlerësimit të kushtetutëshmërisë dhe ligjshmërisë japin të ashtuqjiturën iniciativë kushtetuese, e cila i nënshtrohet vlerësimit paraprak të gjykatës kushtetuese, lidhur me atë se, a ekziston baza e dyshimit për shkelje të kushtetutës dhe ligjit para se të fillojë procedura e vlerësimit kushtetues. Në këto raste pas marrjes së iniciativës, gjykata kushtetuese paraprakisht shqyrton nismën e arritur, dhe nëse ajo përmban elementet e nevojshme kushtetuese mund të fillojë procedurën e vlerësimit. Kjo dallon nga rasti i nismës së procedurës nga propozuesit e autorizuar, të cilët e obligojnë në mënyrë automatike gjykatën, që të nisë procedurën e vlerësimit kushtetues.

43 *Burimi: kushtetuta e Kosovës neni 113*

44 *Po aty, neni 113, paragrafi 2, 3, 4, 5, 6, 7,*

Të drejtën e parashtrimit të iniciativës e kanë edhe qytetarët, të cilët goditen me zbatimin e aktit jo kushtetues dhe jo ligjor. Ata kërkojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese të gjykatave kushtetuese.

Në praktikën e gjyqësisë kushtetuese është çështje e diskutueshme, se a mund qytetarët të kërkojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave kushtetuese të qytetarëve para gjykatave kushtetuese. Lidhur me këtë ekzistojnë dy praktika kushtetuese;

Në rastin e parë gjykata kushtetuese nuk merret me shkeljet individuale të të drejtave dhe lirive të qytetarëve, por vetëm me kontrollin e akteve të përgjithshme juridike. Mbrojtjen gjyqësore të të drejtave dhe lirive të qytetarëve e bëjnë gjykatat e regullta dhe organet administrative në procedurat gjyqësore dhe administrative.

Në rastin e dytë, disa kushtetuta po edhe kushtetuta e Republikës së Kosovës e përcaktojnë të drejtën e qytetarëve, që të kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të tyre kushtetuese edhe para gjykatës kushtetuese⁴⁵. Kjo praktikë bazohet në teorinë, se të drejtat e qytetarëve janë kategori kushtetuese dhe duhet të gëzojnë mbrojtje të gjykata kushtetuese.

Cilat janë palët në kontestin kushtetues para gjykatës kushtetuese

Kontesti kushtetues që ka për objekt vlerësimin e kushtetutëshmërisë dhe ligjshmërisë ka dy palë kryesore; e para, Propozuesin, që mund të jetë njeri nga propozuesit e autorizuar apo parashtruesit e iniciativës dhe dyta, Kundërpropozuesi, i cil është autori i aktit i cili kontestohet ose bartësi i veprimit jokushtetues dhe joligjor.

Kjo shpjegohet në këtë menyrë. Nëse kontestohet ndonjë ligj për shkak të mos pajtueshmërisë me kushtetuten, propozues mund të jetë presidenti, qeveria ose ndonjë propozues tjetër i autorizuar, kurse kundërpropozues në rastin konkret është parlamenti si autor i ligjit kontestues. Në rastin tjetër, nëse objekt i vlerësimit kushtetues janë shkeljet e kushtetutës nga zyrtaret e lartë, cilësinë e propozuesit psh, mund ta ketë parlamenti, kurse në cilësinë e kundërpropozuesit mund të jetë presidenti nëse bëhet vlerësimi i shkeljeve eventuale kushtetuese nga ana e tij.

Mënyra e marrjes së vendimeve nga gjykata kushtetuese

Gjykata kushtetuese merr vendimet e saj sipas mënyrës së përcaktuar me ligj ose kushtetutë. Vendimet e gjykatës kushtetuese merren me shumicën e votave të antarëve të saj, me përjashtim të disa rasteve kur shprehimisht kërkohet shumica e kualifikuar prej 2/3 e votave të antarëve të saj, psh, me rastin e vlerësimit të ekzistimit të shkeljeve kushtetuese nga shefi i shtetit dhe shkarkimit kushtetues të tij.

Vendimet e gjykatës kushtetuese merren në formë të aktvendimit, në të cilin konstatohet bazueshmëria e padisë kushtetuese dhe përcaktohet vendimi i gjykatës dhe natyra juridike e tij.

⁴⁵ Po aty, neni 113 paragrafi 7

Për dallim nga procedurat gjyqësore vendimi i gjykatës kushtetuese nuk kumtohet publikisht në seancë të gjykatës, por i dërgohet palëve në kontestin kushtetues. Vendimet e gjykatës kushtetuese të Kosovës shpallen në gazetën zyrtare

Natyra juridike e vendimeve të gjykatës kushtetuese - Vendimet e gjykatës kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqesorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Kosovës⁴⁶, të formës së prerë dhe të zbatueshme që nga momenti i marrjes. Gjyqësia kushtetuese vepron vetëm në një instancë dhe ndaj vendimeve të saja nuk mund të apelohej asnjë ankesë ose mjet tjetër juridik i rregullt ose i jashtëzakonshëm.

Për nga natyra juridike vendimet e gjykatës kushtetuese mund të ndahen në grupe:

- a) *Vendimet me të cilat anulohet legjislacioni ose akti tjetër juridik,*
- b) *Vendimi me të cilin bëhet shfuqizimi i një ligji ose akti juridik dhe*
- c) *Vendimi me të cilin konstatohet shkelja e kushtetutës nga autoriteti zyrtar dhe konstatohet plotësimi i kushteve kushtetuese për shkarkimin e tij,*
- d) *Vendimi me të cilin konstatohet jo kushtetutëshmeria ose kundërligjshmëria e një procesi elektoral, referendumi, ose shkelja e procedurës për zgjedhjen dhe shkarkimin e e ndonjë titullari të lartë shtetëror.*⁴⁷

Anulimi i legjislacionit - Nëse gjykata kushtetuese konstaton se një ligj ose akt tjetër i përgjithshëm juridik është në kundërshtim me kushtetutën dhe ligjin, krahas konstatimit të tillë, ajo vendos për anulimin e këtij akti. Anulimi nënkupton, jo vetëm shfuqizimin e menjëhershëm të ligjit ose aktit tjetër të përgjithshëm, por edhe anulimin e të gjitha pasojave juridike që ka prodhuar zbatimi i aktit ligjor ose aktit tjetër të përgjithshëm juridik që nuk ka qenë në pajtim me kushtetutën.

Shfuqizimi i legjislacionit - Nëse vendimi i gjykatës kushtetuese shfuqizon një ligj ose akt tjetër të përgjithshëm juridik, ai pushon të vlejë në të ardhmen, por kjo nuk nënkupton edhe anulimin e pasojave që më parë ka prodhuar zbatimi i këtij ligj ose akti të përgjithshëm. Pra, kjo është një masë më e butë e konstatimit të shkeljes kushtetuese dhe ligjore, që prodhon efekte juridike vetëm ndaj ligjit ose aktit kontestues⁴⁸.

Procedura e ngritjes së çështjes dhe konstatimi i përgjegjësisë së presidentit - Një nga përgjegjësitë e veçanta të gjykatave kushtetuese është konstatimi i shkeljeve kushtetuese nga ana e presidentit dhe shkarkimi kushtetues i tij. Kjo vjen në shprehje në procedurën e impiçmentit, i cili fillohet nga parlamenti, tridhjetë deputet apo më shumë⁴⁹ ose subjekti tjetër i autorizuar ndaj presidentit me padinë kushtetuese për shkelje të kushtetutës. Kushtetutat e shumë shteteve përcaktojnë tri baza kryesore për fillimi e impiçmentit ndaj presidentit; tradhëtia ndaj vendit, abuzimi i detyrës zyrtare (keqpërdorimet materiale, skandalet morale) dhe shkeljet e rënda të kushtetutës. Në procesin e impiçmentit roli i gjykatave kushtetuese është vendimtar dhe ato vendosin,

⁴⁶ Po aty, neni 116 paragrafi 1

⁴⁷ Po aty, neni 113 dhe neni 116

⁴⁸ Po aty, neni 116 paragrafi 2

⁴⁹ Po aty, neni 113, paragrafi 6

se a e ka shkelur presidenti kushtetutën, a ka përgjegjësi politike dhe kushtetuese për veprimet e tij. Nëse gjykata kushtetuese konstaton këto shkelje, ajo bënë edhe shkarkimin automatik të presidentit me vendimin e saj. Ky vendim kërkon një votim prej 2/3 të antarëve të gjykatës.⁵⁰

Implementimi i vendimeve të gjykatave kushtetuese - Vendimet e gjykatave kushtetuese janë të detyrueshme për të gjitha institucionet dhe personat të cilëve ju referohen këto vendime. Nëse gjykata kushtetuese anulon ose shfuqizon ndonjë ligj, parlamenti duhet t'i bindet këtij vendimi dhe të fillojë procedurat adekuate legjislative për harmonizimin e legjislacionit.

Në mënyrë të njejtë do të veprohet edhe kur janë në pyetje aktet nënligjore të qeverisë dhe shefit të shtetit. Në rastet kur gjykatat kushtetuese konstatojnë shkeljen e kushtetutës nga zyrtaret e lartë shtetëror, sipas fuqisë kushtetuese do të prodhohen pasoja të drejtpërdrejta kushtetuese, si psh: shkarkimi i presidentit, anulimi i zgjedhjes së presidentit për shkaqe të mos rrespektimit të procedurave kushtetuese, revokimi i deputetit, anulimi ose përsëritja e zgjedhjeve, referendumeve etj.

INSTITUCIONET E PAVARURA - AGJENCITË E PAVARURA

Agjencionet e pavarura të Republikës së Kosovës janë institucione të pavarura të krijuara me Kushtetutë apo me ligje. Institucionet e pavarura janë subjekte kyçe të funksionimit të pushtetit, duke garantuar dhe siguruar kontrollin dhe ekuilibrimin si dhe zbatimin e sundimit të ligjit. Në Kosovë ka disa agjenci dhe institucione të pavarura që kryejnë funksione të mbikëqyrjes të përcaktuar me ligj. Institucioni i pavarur kushtetues janë: Avokati i Popullit, Auditori i Përgjithshëm, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Banka Qendrore e Kosovës dhe Komisioni i Pavarur i Mediave.⁵¹

Avokati i popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individit, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike. Në përmbushjen e funksionit të tyre në monitorimin e institucioneve janë të pavarura, që do të thotë se puna e tyre nuk duhet të ndikohet politikisht apo të kontrollohet nga ndonjë organ i ekzekutivit. Institucion tjetër i pavarur kushtetues është Auditori i Përgjithshëm i Kosovës, si institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik dhe financiar. Auditori zgjedhet nga Kuvendi në bazë të propozimit të Presidentit të Republikës.⁵² Edhe komisioni qendror i zgjedhjeve është një institucion i pavarur, i përhershëm që përgadit, mbikëqyr, drejton dhe verifikon të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve e referendumit dhe shpall rezultatin e tyre.⁵³

Nje institucion tjetër i pavarur në Kosovë është Banka Qendrore e Republikës e cila i përgjigjet vetëm Kuvendit të Kosovës. Ajo ushtron kompetencat dhe pushtetin e vetë vetëm në pajtim me kushtetutën dhe me instrumentet e tjera ligjore të zbatueshme.⁵⁴

⁵⁰ Po aty, neni 91 paragrafi 3

⁵¹ Po aty, neni 132, neni 136, neni 137 neni 140 dhe neni 141

⁵² Po aty, Neni 136 paragrafi 1, 2

⁵³ Po aty, neni 139, neni paragrafi 1

⁵⁴ Po aty neni 140, paragrafi 1, 2

Organi i pavarur është edhe komisioni i pavarur i mediave i cili e rregullon spektrin e frekuencave transmetuese në Republikën e Kosovës, licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe ushtron kompetenca të tjera të përcaktuara me ligj.⁵⁵ Agjencitë e pavarura të Republikës janë institucionet e krijuara nga Kuve- ndi, në bazë të ligjeve përkatëse, të cilat rregullojnë themelimin, funksionimin dhe kompetencat e tyre. Këto i kryejnë funksionet në mënyrë të pavarura nga çdo organ ose autoritet tjetër në Kosovë.

Kushtet themelore që sigurojnë pavarësinë për agjencitë e pavarura janë:

- a) *Pavarësi financiare*⁵⁶
- b) *Pavarësi e zgjedhjes/emërimit dhe kohëzgjatjeje;*
- c) *Pavarësi në vendimmarrje.*

Këto institucione vazhdojnë të zbatojnë të gjitha ligjet dhe rregulloret që kanë të bëjnë me financimin publik. Ato për punën e tyre raportojnë dhe janë përgjegjës para Kuvendit të Kosovës. Kuvendi i mbikqyr që organet e pavarura janë duke e përmbushur mandatet e tyre ashtu siç parashihet me ligjet në fuqi.

PARIMET THEMELORE TË DRAFTIMIT TË KUSHTETUTËS

1. Përcaktimi i qëllimeve që deshiron ti arrij kushtetuta

Qëllimet e kushtetutës i përcakton kushtetutdhënësi dhe faktorët tjerë politik që janë aktor të procesit kushtetues. Kushtetutëdhënës është organi përfaqësues (parlamenti) që inicon procesin kushtetues dhe që miraton kushtetutën. Në rastet kur miratimi i kushtetutës bëhet përmes popullit në referendumin kushtetues, kushtetutëdhënës janë qytetaret dhe populli, por qëllimet e procesit kushtetues paraprakishtë i cakton parlamenti si organ përfaqësues i popullit. Përcaktimi i qëllimeve politike që pretendon t'i realizojë një proces kushtetues, bëhet në momentin e pranimit të nismës kushtetuese nga bartësi i kësaj nisme dhe pas konsensusit të arritur në parlament rreth kësaj nisme.

Qëllimet politike të reformës kushtetuese mund të konsistojnë në: themelimin e shtetit dhe realizimin e pavarësisë, psh., rasti i Sllovenisë, Estonisë, Lituaniës, Kroacisë, Maqedonisë, Bosnje e Hercegovinës, Kosovës; përmbysja e regjimeve antidemokratike dhe tranzicioni demokratik, psh. Shqipëria, Rumania, Hungaria, Bullgaria etj; bashkimin me një shtet tjetër dhe bartjen e sovranitetit, rasti i bashkimi të Gjermanisë, krijimi i Unionit federal ose konfederal, psh. kushtetuta evropiane-federalizimi i Evropës; ndryshimi i sistemit të qeverisjes, psh. kalimi nga qeverisja parlamentare në atë presidenciale; ndryshimi në kompetencat e organeve shtetërore;

⁵⁵ Po aty, neni 141, paragrafi 1.

⁵⁶ Po aty. Neni 142, paragrafi 1,2.

evitimi i krizave parlamentare dhe krizave politike; implementimi i marrëveshjeve nderkombëtare për përfundimin e armiqësive dhe luftimeve, rasti i Bosnjes, Maqedonisë, Kosovës etj; mbrojtja kushtetuese e minoriteteve, psh, Kroacia, Sllovenia, Maqedonia, Kosova etj si dhe reformat ekonomike, sociale, kulturele etj.

Hartuesit e Kushtetutës para fillimit të procesit të draftimit kushtetues marrin porosinë politike, për qëllimet dhe pretendimet që synon të arrijë kushtetuta. Ata nuk mund t'i shmangen kësaj porosie, por kanë mandat profesional që ata ta implementojnë në mënyren sa më efikase dhe adekuate përmes kushtetutës.

Qëllimet e kushtetutës zakonisht shprehen në preambulën e tekstit të saj, ku theksohen objektivat dhe pritjet kryesore nga kushtetuta. Hartuesit do të përdorin një gjuhë pragmatike në preambulë, për të justifikuar pse nxerret kushtetuta, çfarë synon të arrij ajo, dhe cilat janë pretendimet e saj strategjike për të ardhmen e vendit.

2. Përzgjedhja e modeleve kushtetuese që do të konsultohen

Të shkruarit e kushtetutës nuk paraqet një punë shkencore, e as një vepër akademike. Në rradhë të parë procesi i hartimi të kushtetutës kërkon demonstrimin e shkathësive teorike dhe praktike të draftimit të kushtetutës. Kjo kërkon ekspertë që njohin mirë teorinë kushtetuese, qasjen krahasuese të instituteve kushtetuese dhe shkathësitë praktike, pra aftësinë e normimit kushtetues me standardet e plota nderkombëtare.

Menjëherë pas marrjes së mandatit politik, anëtarët e Komisionit Kushtetues duhet të përzgjedhin modelet e kushtetutave, që do të konsultohen dhe të merren parasysh në procesin e draftimit të kushtetutës. Nuk ka kushtetutë plotësishtë burimore dhe të veçantë, dhe është iluzore pritja që draftuesit do të hartojnë një tekst unikat kushtetues. Por shtrohet pyetja, se cilat modele duhet të përzgjedhin hartuesit, cilët faktor përcaktojnë këto modele, a është kjo një zgjidhje e hartuesve, apo mandat politikë të cilin e kanë përcaktuar faktoret politikë. Nese faktoret politik kanë arritur konsensus për një republikë presidenciale, hartuesit duhet të konsultojnë kushtetutat e shteteve presidenciale, nese ata porosisin formën parlamentare do të konsultohen modelet e kushtetutave të këtyre shteteve etj. Mirëpo, hartuesit nuk duhet të pajtohen me rolin e tyre krejtësishtë teknik. Ata me kompetencen e tyre kushtetuese duhet të përzgjedhin modelet sa ma adekuate dhe sa ma kompatible me vendin e tyre dhe me realitetin faktik. Aftësia e ekspertëve konsiston në aftësinë e tyre që të bëjnë përzgjedhjen e zgjidhjeve kushtetuese të shteteve të ndryshme, t'i përshtatin ato realitetit vendor, duke i modifikuar, dhe ti bëjnë sa ma funksionale. Nuk ka vetëm një kushtetutë që duhet të merret si bazë, por duhet të konsultohen më shumë modele të më shumë vendeve.

Në përzgjedhjen e modeleve hartuesit duhet të marrin për bazë faktet vijuese: suksesin dhe qendrueshmerinë e kushtetutave të vendeve që merren si modele; kompatibilitetin kushtetuese të modeleve me kushtetutën e vendit; modifikimet e përvojave kushtetuese të vendeve të ndryshme me ralitetin e vendit të tyre; kompatibilitetin e transicionit dhe ndryshimeve kushtetuese midis modeleve të ndryshme; kompatibilitetin e teorisë dhe praktikës kushtetuese, gjuhës, terminologjisë dhe traditës kushtetuese; faktorët tjerë krahasues dhe analog që ndikojnë në përmbajtjen e tekstit të kushtetutës, etj. Praktika

kushtetuese ka vërtetuar se gjetja e modeleve kushtetuese sot është proces shumë i lehtë. Të gjitha kushtetutat e vendeve sot janë në web-faqe dhe ekspertët mund të kenë qasje shumë të lehtë⁵⁷. Por është e pamundur që një kushtetutë të importohet dhe nga ekspertët të konvertohet në kushtetutë vendore. Kjo do të ishte një iluzion i madh profesional e politik, sepse kjo kushtetutë nuk do të jetë funksionale. Nga modelet e konsultuara kushtetuese mund të merren zgjidhje konkrete kushtetuese dhe ato të integrohen në idenë vendore kushtetuese dhe të shprehin dhe plotësojnë pritjet vendore për kushtetuen. Pra, kjo na kthen tek teza jonë fillestare-dilema *kushtetuta ideale apo funksionale*.

3. Plotësimi i standardeve ndërkombëtare për kushtetutën

Për të qenë demokratike dhe gjithëpërfshirëse, kushtetuta duhet të plotësojë standardet ndërkombëtare që janë krijuar dhe që vlejné, qoftë sa i përket kushteve të një procesi demokratik kushtetues, ose përmbajtjes dhe kushteve që duhet t'i përmbush kushtetuta e një vendi demokratik. Standardet kushtetuese nuk janë të kodifikuara në një tekst të vetëm, por ato janë të ngjajshme me standardet legislative që po krijohen në nivel të Bashkimit Evropian.

Hartuesit e kushtetutës duhet t'i njohin dhe zotërojnë mirë standardet evropiane në sferen e legjislacionit dhe të kushtetutës, dhe t'i impementojné në mënyrë adekuate në procesin e draftimit të kushtetutës. Kushtetuta nuk lejohet të përmbajë zgjidhje që shprehimishtë janë ndaluar me konventa evropiane për të drejtat e njeriut, barazisë së qytetarëve etj.

Po cekim disa standarde evropiane në sferen kushtetuese që duhet të respektohen në procesin e draftimit: respektimi i plotë i parimit të mosdiskriminimit; parimi i ndarjes dhe kufizimit reciprok të pushteteve; barazia e qytetarëve para ligjit dhe mbrojtja e minoriteteve; raporti i shteti me religjionin; karakteri laik i shtetit; parimi i sundimit të ligjit, sfondi i lirive dhe të drejtave të qytetarëve dhe mekanizmat ligjor; kontrolli civil ndaj policisë dhe ushtrisë; gjyqësia e pavarur; ratifikimi dhe impeementim i Konventave Evropiane për të drejtat e njeriut; ndalim i torturës; gjykimi i drejtë dhe korrektë dhe heqja e denimit me vdekje.

4. Komisioni i Venecias dhe ekspertiza evropian e plotësimi të standardeve kushtetuese

Në nivelin e Bashkimit Evropian është themeluar Komisioni i Venecias⁵⁸ si një institucion i specializuar evropian që ofron asistencë dhe konsulencë profesionale kushtetuese shteteve të ndryshme në proceset kushtetutëdhënëse. Anëtarë të Komisionit janë shtete evropiane, të cilat si anëtarë të këtijë institucion kanë derguar në këtë institucion ekspertet e tyre kushtetuese nga radha e profesorëve universitarë, gjyqëtarëve të gjykatve kushtetuese dhe juristëve tjerë të shquar. Shtetet e Evropës Juglindore, pas përmbysjes së diktaturave komuniste dhe fillimit të një transicioni kushtetues kanë

57 Burimi: Shih pasqyren nr.3. Adresat elektronike të disa kushtetutave në botë.

58 Shih Pasqyra nr.2, Shtetet antare të Komisionit të Venedikut dhe Pjsëmarrësit e saj.

kërkuar asistencë profesionale të Komisionit të Veneciasë, qoftë në procesin e draftimit të kushtetutave të tyre të para demokratike, ose gjatë implementimit të kushtetutave dhe hartimit të legjislacionit organik. Një rol të veçantë ky Komision ka pasur në hartimin e Kushtetutës aktuale të Republikës së Shqipërisë, duke ofruar asistencë profesionale në fazën e hartimit të kushtetutës përmes kryetarit të saj La Pergola, dhe në fazën e mëvonshme duke dhënë komente rreth implementimit të kushtetutës. Fushëveprimi i këtij institucioni është shumë i gjërë dhe përfshinë këto angazhime kryesore si: ofron asistencën shteteve me rastin e hartimit të kushtetutave; zhvillon konsulentat profesionale në proceset e implementimit dhe rishikimit të kushtetutës; bënë ekspertizën e kushtetutave të vendeve të ndryshme nga aspekti i plotësisht të standardeve ndërkombëtare; organizimi i seminareve, konferencave kushtuar parimit të kushtetutshmerisë dhe ligjshmerisë, etj. Është i një rëndësie të veçantë që Komisioni vendor Kushtetues gjatë draftimit, të tekstit të vendos raporte të bashkëpunimit me Komisionin e Venecias.

Ky bashkëpunim në radhë të parë konsiston në përfshirjen e antarëve të këtij Komisioni në konsulentat ndërkombëtare, trajnimin e antarëve të komisionit vendor, organizimin e ndonji tryeze profesionale lidhur me segmentet e caktuara të hartimit të kushtetutës, etj.

5. Marrja parasysh e specifikave të vendit, nivelit të zhvillimit social ekonomik e politik

Me rastin e draftimit të kushtetutës, hartuesit duhet të marrin parasyshë veçoritë e vendit, të cilit i dedikohet kushtetuta, nivelin e zhvillimit ekonomik, social dhe politik, nivelin e kulturës politike e demokratike dhe atributet tjera identifikuese të shtetit. Çdo herë hartuesit duhet të kenë parasyshë, se si do të duket kushtetuta në implementim, a do të mund të zbatohet, cili është raporti real i forcave të akterëve politik, a siguron implementimin e saj ky raport, sa teksti është i kuptueshëm për opinionin e gjërë etj. Përkundrejt faktit se institucionet kushtetuese me modifikimet e caktuara kanë tendencën e standardizimit, hartuesit duhet të pretendojnë marrjen parasysh të veçorive të vendit të tyre dhe modifikimet e institucioneve kushtetuese të vendeve tjera t'i përshtasin realiteteve të shtetit të tyre.

6. Transparenca e procesit draftues kushtetues

Procesi kushtetudhënës është me interes të gjërë publik. Ai duhet të sigurojë transparencë të plotë në të gjitha fazat e zhvillimit të saj. Që nga miratimi i nismës kushtetudhënëse, e deri te shpallja e kushtetutës procesi duhet të jetë i hapur për opinionin e gjërë dhe të mundësoj kyqjen dhe pjesëmarrjen e qytetarëve në tërë rrjedhën e procesit kushtetues. Si rregull vetë shteti siguron transperencën e proceit kushtetues dhe krijon mekanizma për pjesëmarrjen e drejtpërdrejt të qytetarëve në diskutimin e kushtetutës.

Gjatë hartimit të kushtetutës, hartuesit duhet të pretendojnë një proces gjithëpërfshisë të hapur për qytetarë, duke krijuar qasje publike të qytetarëve në dhënjën

e propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve për zgjidhjet e caktuara kushtetuese. Gjatë draftimit të kushtetutës, në praktiken kushtetues preferohet që hartuesit të kenë një konfidencë, të mbrohen nga mediat, të mos i shprehin dallimet gjatë hartimit dhe mos japin deklarata publike gjerë në përmbylljen e procesit të draftimit. Kjo konfidencë gjatë draftimit synon të mbrojë hartuesit nga sulmet dhe presionet e opinionit dhe ndikimet tjera, që mund të jenë një lloj presioni i jashtëm në punën e tyre. Mirëpo, menjëherë me të përfunduar procesit të draftimit, teksti i kushtetutës duhet të bëhet publik dhe të mundësohet informimi i plotë i drejtë dhe i gjithanshëm i publikut të gjërë.

Praktika kushtetuese tregon nevojën e përmbushjes së kushtetve vijuese në sigurimin e transparencës së procesit kushtetues: informimi me kohë i qytetarëve për përmbajtjen e kushtetutës; krijimi i web-faqes së veçantë në të cilën botohet drafti i kushtetutës; dizajnimi i linkut elektronik në web-faqe ku qytetarët japin vërejtjet, kritikën dhe opinionet e tyre për kushtetutën në përgjithsi dhe nënën e caktuara të saj: organizimi i një forumi kushtetues, ku qytetarët, ekspertët dhe personalitetet tjera publike shfaqin opinionet e tyre për kushtetutën, botimi i tekstit në mjete të informimit, shtypin elektronik, televizionet, doracakë, broshura etj.; debati publik i kushtetutës, seminare, konferencat akademike vendore e ndërkombëtare, tribunat publike me qytetarët, organet e pushtetit të nivelit lokal e qendror dhe format tjera të komunikimit masiv me qytetarët; organizimi i emisioneve dhe debateve televizive, ku hartuesit shpjegojnë kushtetutën dhe japin shpjegime në kërkesat e opinionit dhe audiencës së gjërë; sigurimi i pjesëmarrjes së akterëve të gjërë në procesin e debatit kushtetues; transmetimi i seancës solemne të miratimit të kushtetutës, përcjellja e referendumit për kushtetutën etj.; botimi final i tekstit të kushtetutës pas miratimit në Fletoren Zyrtare, në botime të veçanta, përkthimin në gjuhë të huaja dhe botimi i materialeve tjera me të cilat jepen shpjegimet adekuate për kushtetutën dhe shpërndarja e tekstit të kushtetutës në opinionin e gjërë.

7. Gjuha e kuptueshme e hartimit të Kushtetutës

Hartuesit e Kushtetutës duhet të përdorin një gjuhë tipike kushtetuese, e cila është tradicionale në teorinë dhe praktiken kushtetuese të një vendi. Shkrimi kushtetues duhet ekskluzivisht të jetë normativ dhe t'i plotësojë të gjitha standardet e shkrimit të avansuar kushtetues. Formulimet kushtetuese duhet të jenë të karta, koncize, të plota dhe të kuptueshme për opinionin e gjërë. Hartuesit duhet t'i shmangin plotësisht formulimet e përgjithësuara dhe ato politike, të cilat janë atipike për tekstin e kushtetutës. Vetëm preambula është pjesë në të cilën hartuesit mund të shmangin gjuhën ekskluzive normative-kushtetuese. Duke qenë e karakterit ideor, preambula mund të shpreh aspirata politike dhe të përmbajë fjali që nuk kanë karakter normativ.

Edhe pse procesi i draftimit të kushtetutës kërkon zbatimin e plotë të metodës normative, ajo nuk guxon të shpije në mbylljen dogmatike të hartuesve të kushtetutës. Autorët e kushtetutës me rastin e shkrimit të çdo kaptine, neni, alineje, duhet të kenë parasysh lidhjen logjike të tërë tekstit, koherencën dhe kompozicionin e tërë tekstit kushtetues. Ata, gjatë hartimit të çdo neni duhet të shërbejnë me një ekuilibër ose pasqyrë, e cila duhet të tregojë, se si duket implementimi praktikë i dispozitës kushtetuese që po e hartojnë. Gjithnjë duhet të mendohet, se a do ta kuptojnë mirë

dhe drejtë dispoziten kushtetuese qytetarët që duhet t'a respektojnë dhe organet që do ta zbatojnë. Të shkruarit apstrakt i kushtetutës, gjatë implementimit praktikë do të shkaktojë interpretime të dyfishta dhe konflikte kushtetuese.

Gjuha e kushtetutës duhet të plotësojë këto standarde kryesore: gjuha kushtetuese njihkohësishtë duhet të jetë popullore. kushtetutën duhet ta kuptojnë qytetarët e kategorive të ndryshëm, të niveleve të ndryshme të shkollimit, të profesioneve të ndryshme; kjashtësia e formulimeve kushtetuese; formulimet kushtetuese të shkurta, koncize dhe të plota; shmangja e formulimeve politike dhe shprehjeve atipike për kushtetutë; evitimi i dykuptimësisë dhe shprehjeve abstrakte në kushtetutë; përdorimi i gjuhës tradicionale juridike, që i përgjigjet teorisë dhe praktikës kushtetuese të një vendi; si dhe përdorimi i dialektit, stilit rregullave gramatikore dhe elementeve tjera të drejtshkrimit të avansuar etj.

8. Terminologjia juridike

Shkrimi i kushtetutës kërkon përdorimin e terminologjisë adekuate kushtetuese dhe ligjore. Disa udhëzime terminologjike për hartues të kushtetutës: për një koncept konkret zgjidhni terminin e cili e shpreh atë në mënyrën më të saktë, duke patur në konsideratë në radhë të parë legjisllacionin në fuqi. Termit jo tërësisht juridike duhet të përdoren në kuptimin e tyre të zakonshëm (të përditshëm). Si dhe termit nga gjuha juridike ose nga një gjuhë teknike duhet të përdoren në mënyrë të përshtatshme, duke pasur në konsideratë kuptimin që i është dhënë atyre nga shkenca ose teknika që i mbulon (trajton).

Në veçanti, për termit juridike duhet mbajtur në konsideratë: kuptimi i tyre "ligjor" i dhenë në kode apo ligje të tjera; kuptimi që i është dhënë nga teoria e jurisprudencës së konsoliduar dhe nga doktrina mbizotëruese.

Nëse një term tekniko-juridik ka një kuptim të ndryshëm nga ai që ka në gjuhën e përditshme, duhet bërë e qartë nga konteksti, se në cilin kuptim është përdorur. Mandej, të njëjtat koncepte duhet të shprehen me të njëjtat terma, ndërsa termit e njëjtë nuk duhet të përdoren me përdorime (kuptime) të ndryshme. Kjo gjë vlen jo vetëm për dispozitat e të njëjtit tekst, por edhe në tekste të tjera të ngjashme (në veçanti tekste të cilat rregullojnë të njëjtën fushe ose që duhet të ndryshohen apo të integrohen me tekstin në fjale. Ndërsa, kur ndryshohen ose kur i referohesh teksteve të vjetra (që u ka kaluar koha) në terminologji ose edhe në stilin e përdorur, parapëlqehet të procedohet me riformulim të tekstit në tërësi me terma më të kjashtë. Duhet të shmangni përdorimin e termave të huaj, përveç rastit kur kanë hyrë në përdorimin e përditshëm të gjuhës shqipe dhe nuk kanë fjalë të tjera korresponduese në shqip. Aty ku është e nevojshme, edhe për termit e huaj jepni përkufizimin përkatës. Fjala e huaj, e pranuar nga gjuha shqipe nuk lakohet, përveç rastit kur një gjë e tillë është bërë e përdorshme në gjuhën e përditshme.

9. Debatet publike gjatë procesit të draftimit të kushtetutës-kontaktet me qytetarët

Një rëndësi të veçantë në procesin kushtetues kanë debatet publike dhe kontaktet me qytetarët. Procesi kushtetudhënës duhet të jetë transparentë ndaj qytetarëve dhe gjithpërfshirës, duke marrë për bazë opinionet e publikut të gjërë dhe duke debatuar publikishtë çështjet kritike të kushtetutës. Transparenca e procesit kushtetuese duhet të sigurohet gjatë tërë rrjedhes së procesit, që nga nisma, e deri në përmbylljen e tij.

Forma kryesore e komunikimit me publikun e gjërë rreth procesit kushtetuese janë debatet publike. Llojet e debateve publike: debatet me leadership, me parti të politike, debatet mes antarëve të komisionit kushtetuese, debatet akademike dhe shkencore, debatet me ekspertët vendor dhe ndërkombëtar, debatet me opinion të gjërë, debatet institucionale me organet e pushtetit lokal e qendror, debatet me shoqërinë civile, debatet me komunitete, me grupet e interesit, shoqatat dhe asociacionet tjera si dhe debati parlamentar.

Format e debateve kushtetuese me publikun janë: prezentimi i draftit kushtetues në media, forumet kushtetuese, emisionet tematike kushtetuese, paraqitja e mendimeve kritike në media, ballafaqimi mes përkrasësve dhe kundërshtuesve të kushtetutës dhe shfaqja e opionencës ndaj kushtetutës.

10. Mediat dhe procesi draftues

Faktor relevant në procesin kushtetudhënës paraqesin mediat, qoftë ato vizuale, apo elektronike. Mediat, që në shumë vende konsiderohen si pushteti i katërtë kanë rol të trefishtë në procesin kushtetudhënës; ato njoftojnë opinionin publik për përmbajtjen e tekstit të kushtetutës, mundësojnë debatin publik rreth çështjeve kritike të kushtetutës, duke siguruar opinionin e gjërë për aspektet kontraverse të reformës kushtetuese dhe paraqesin një lloj opionence në procesin kushtetuese, duke vënë në spikamë qasjen kritike ndaj zgjidhjeve të caktuara kushtetuese dhe dhënjën e hapësirës për paraqitjen publike të kritikës dhe alternativave kushtetuese.

Çështjet kryesore të raportit të kushtetutës me mediat janë: transparenca e kushtetutës ndaj medieve, mosshfaqja e dallimeve në media gjatë draftimit të kushtetutës, faza e konfidencës gjatë hartimit të kushtetutës, mbrojtja e hartuesve nga ndikimet mediale, njoftimi i rregulltë i mediave për procesin e hartimit të kushtetutës, konferencat e rregullta për shtyp me përfaqësuesit e medieve, dhe roli i zëdhënsit të grupit kushtetues në kontaktet me media.

FAZAT E PROCESIT TË DRAFTIMIT TË KUSHTETUTËS

1. Përcaktimi i dinamikës së procesit kushtetues

Procesi kushtetutdhënës duhet të ketë një dinamikë kohore me një agjendë, e cila parashikon afatet e fillimit, zhvillimit dhe përmbylljes së një procesi kushtetues. Të hartuarit e një kushtetute duhet të bëhet në një afat të kuptueshëm kohor, i cili mundëson një proces normal kushtetues. Dinamika e procesit kushtetues përcaktohet zakonisht nga parlamenti, i cili pas pra-nimit të nismës kushtetutdhënëse cakton dinamikën e procesit kushtetues. Dinamika e procesit kushtetues përcakton afatin e përfundimit të draftit kushtetues, afati brenda së cilit subjektet politike brenda parlamentit duhet të arrijnë konsensusin e nevojshëm politik, afatin përfundimtar të miratimit të kushtetutës në Kuvend, kohën e mbajtjes së referendumit dhe momentin e shpalljes dhe hyrjes në fuqi të kushtetutës.

Duke qenë se procesi kushtetutdhënës paraqet procesin kryesor juridiko-politik të një shteti, ai nuk mund të improvizohet dhe kryhet shpejtë, pa ndertimin e konsensusëve të nevojshme politike të të gjithë akterëve relevantë në skenën politike. Në anën tjetër, hartimi i kushtetutës nuk guxon të jetë një proces maratonik, që zgjatë më vite dhe që ngadalson procesin e ndryshimeve të domosdoshme shoqërore. Hartuesit e kushtetutës nuk janë subjekte që përcaktojnë dinamikën e procesit të miratimit të kushtetutës. Ata kanë mandatin për implementimin e një faze të procesit kushtetues. Kjo fazë përfshinë draftimin e kushtetutës dhe mund të kryehet relativisht shpejtë, nëse nderkohë janë ndërtuar konsensuset e nevojshme kushtetuese rreth procesit kushtetutdhënës. Praktika kushtetuese vërteton se një afatë normal brenda të së cilit do të përmbyllet një proces i miratimit të kushtetutës, do të ishte koha prej një viti. Brenda këtij afati, do të mund të përmbyllet procesi kushtetutdhënës me të gjitha fazat e zhvillimit të tij.

Po japim një shembull ideal të dinamikës së një procesi të miratimit të Kushtetutës sipas fazave: nisma kushtetudhënse dhe paraqitja dhe miratimi i insisivës për nxerrjen ose ndryshimin e kushtetutës-afati 1 muaj. Arritja e konsensusit politik rreth vlerave që do të mbron kushtetuta (leadershipi, partitë politike, komuniteti akademik, grupet e interesit, shoqëria civile) etj-2 muaj; formim i dhe emrimi i Komisioni Kushtetues- 1 muaj; draftimi i tekstit të Kushtetues nga ekspertët- 3 muaj; debati parlamentar për kushtetuten- 1 muaj; miratimi i kushtetutës në parlament- 1 muaj; pregaditja dhe implementimi i referendumit kushtetuese- 2 muaj dhe shpallja dhe implementimi i kushtetutës- 1 muaj. Në praktikën kushtetuese janë shënuar raste kur miratimi i kushtetutës ka zgjatur me vite të tëra dhe raste të procedurave urgjente të përfundimit të këtij procesi. Rasti i parë është tipik për Kushtetutën Evropiane, procesi i miratimit të saj për shkakë të divergjencave të saj pa zgjatë me vite të tëra dhe po hasë në rezistenca serioze nga shtetet evropiane (Franca dhe Holanda madje e refuzuan këtë kushtetutë). Edhe procesi i hartimit të kushtetutave të shteteve pas Luftës së Dytë Botërore ka zgjatë me vite. Në shtetet postkomuniste, pas përmbylljes së diktaturave komuniste, procesi kushtetutdhënës është implementuar relativisht shpejt brenda periudhës njëvjeqare. Përgjashtim nga kjo ishte Shqipëria, e cila tetë vite pas fitores së demokracisë arriti

të miratojë kushtetutën në vitin 1998, duke evituar krizen kushtetuese pas dështimit të referendumit kushtetutdhënës në vitin 1994. Praktika kushtetuese ka shënuar edhe raste të miratimit të përshpejtuar të kushtetutave, të cilat në faktë kanë arritur efektet politike të kushtetdhënsit, psh. Kushtetuta e Irakut, Kushtetuta e Bosnjë e Hercegovinës, e sidonos Kushtetuta e fundit e Serbisë e cila është miratuar në afatin rekord brenda 1 muaj dhe si e tillë mund të rradhitet në Librin e Ginisit si kushtetuta më e shpejtë në botë. Dinamika e procesit kushtetues është shumë e shpejt, nëse reforma kushtetuese ka të bëjë me amandamentimin e kushtetutës. Në këto raste procesi është shumë më i shpejtë dhe nese janë në pyetje amandamentet teknike ai mund të përmbylet brenda muajit, ndërsa në rastet e amandamenteve përmbajtësore ai mund të përmbillet brenda 3 muajve.

2. Faza e parë-fillimi i procesit të draftimit të kushtetutës –nisma kushtetutdhënëse

Nisma kushtetuese paraqet aktin e parë me të cilin fillon një proces kushtetutdhënës. Kushtetutat e vendeve të ndryshme përcaktojnë subjektet e autorizuar të cilat mund të paraqesin propozimin për nxerrjen e kushtetutës, ose ndryshimin e saj.

Në praktiken kushtetues të drejtën e paraqitjes së propozimit për nxerrjen e kushtetutës, ose pregaditjen e amandamenteve kushtetuese e kanë:

- a) *Qytetarët përmes nismës popullore;*
- b) *Parlamenti me mbështetjen e së paku 1/3 të antarëve;*
- c) *Shefi i shtetit;*
- d) *Qeveria; dhe*
- e) *Njësitë federale në shtetet federative, etj.*

Paraqitja e nismës për nxerrjen ose ndryshimin e kushtetutës kërkon arsyetimin e saj nga subjekti që inicon këtë proces. Arsyetim i nismës kushtetuese ka për qëllim elaborimin e shkaqeve të fillimit të procesit kushtetuese, përcaktimin e vëllimit të reformës kushtetuese dhe paraqitjen e objektivave kryesore që mëton të realizojë procesi kushtetues. Arsyetimi i nismës kushtetuese duhet të jetë i pregaditur mirë, të jetë bindës dhe të demonstrojë vendosshmërinë e inicuesit për të realizuar reformen kushtetuese. Praktika kushtetuese tregon se para paraqitjes formale të nismës kushtetuese, brenda shtetit krijohet një klimë e përshtatëshme e cila e bënë të domosdoshme reformën kushtetuese dhe i siguron asaj një mbështetje të gjërë politike. Jo rrallë, nisma kushtetuese motivohet me qëllimet e tejkalimit të krizave kushtetuese me të cilen ndodhet një shtet. Shpesh si mënyrë e menaxhimit të një krize kushtetuese paraqitet nevoja e ndryshimeve kushtetuese. Në këto raste me nismën formale të procesit kushtetues përcaktohen qëllimet e saj nga akteret kryesor të cilët marrin pjesë në zgjidhjen e krizes kushtetuese.

Në këtë rastë paraprakishtë arrihet një marrëveshje midis partive dhe liderve relevantë politikë për tejkalimin e krizës, mes tjerash edhe me procesin e ndryshimeve kushtetuese. Nisma kushtetudhënëse si fazë e parë e procesit kërkon një votim formal të parlamentit për aprovimin e saj. Në shtetet federale dhe ato që kanë kushtetuta të ngurta, miratimi i nismës kushtetuese kërkon pëlqimin e njësisve federale. Pas miratimit formal të nismës kushtetudhënëse formalishtë fillon procesi kushtetues dhe para draftimit formal të tekstit kërkon zgjidhjen e disa çështjeve paraprake kushtetuese.

3. Përcaktimi i formës së reformës kushtetuese-kushtetuta e re ose amandamentimi i kushtetutës

Dilema e parë e një reforme kushtetuese konsiston në vëllimin e ndryshimeve kushtetuese. Nëse reforma kushtetuese përfshinë ndryshime substanciale atëherë nxjerret kushtetuta e re si një akt i plotë kushtetues. Kur kjo reformë, paraqet ndryshime ose plotësime konkrete brenda sistemit ekzistues kushtetues, do të miratohen amandamentet kushtetuese të cilat do të ndryshojnë dhe plotësojnë dispozitat e caktuara kushtetuese. Përcaktimi i formës së reformës kushtetuese varet nga qëllimet që i parashtrojnë vehtes kushtetudhënësi. Në rastet historike që karakterizohen me krijimin e shteteve të reja, pavarësiminë ose bashkimin e tyre si dhe në rastë të ndryshimeve esenciale të sistemeve të qeverisjes, këto ndryshime do të përcillen me kushtetuta të reja si akte që përcaktojnë një epokë të re të zhvillimit kushtetues të një vendi. Në shtetet me demokraci të qëndrueshme, ndryshimet eventuale që janë rrjedhojë e zhvillimit të proceseve politike përcillen me amandamente kushtetuese të cilat dinamizojnë sistemin kushtetues të një vendi dhe e bëjnë atë të pajtushëm me zhvillimet e reja. Për nga natyra e saj, kushtetuta nuk paraqet një akt statik. Kushtetuta dinamizohet përmes amandamentimit të saj, i cili e bënë aktin kushtetues modern dhe eficient sa i përket zhvillimeve shoqërore.

Varësishtë nga fakti se reforma kushtetuese a konsiston në nxerrjen e kushtetutës së re, apo amandamentimit të saj, varet edhe dinamika e këtij procesi. Miratimi i kushtetutës së re paraqet një proces shumë më kompleks dhe më të gjatë, se sa kur është rasti i miratimit të amandamenteve kushtetuese.

4. Ndërtimi i konsensusit politik rreth reformës kushtetuese

Pas përcaktimit të vëllimit të reformës kushtetuese, pason akti i ndërtimit të konsensusit politik rreth ndryshimeve kushtetuese. Në procesin e nxerrjes së kushtetutës së re konsensusi politik i paraprinë fillimit të draftimit të tekstit të kushtetutës. Ekspertët kushtetues nuk mund të fillojnë draftimin kushtetues pa e marrë paraprakishtë mandatin politik rreth parimeve dhe vlerave kryesore që duhet t'i promovojë akti kushtetues. Konsensusi politik ndërtohet nga lidërshtipi i vendit dhe subjektet politike që janë akterë të procesit kushtetues. Ky konsensus paraqet një llojë kontrate parakushtetuese midis partive kryesore rreth ndryshimeve kushtetuese. Kur ekspertët kushtetues marrin këtë konsensus dhe mandat politik, ata e kanë lehtë të përzgjedhin modelin e kushtetutës

që do të draftojnë. Kështu nese partitë politike pajtohen më sitimin parlamentar të qeverisjes, ekspertët kushtetues do të draftojnë modelin e një kushtetute të një shteti parlamentar dhe do ti përshtasin shumë zgjidhje kushtetuese kësaj forme të qeverisjes shtetërore.

Ndërtimi i konsensusit paraprak politik rreth kushtetutës eviton krizat dhe kundërthënjet e mundshme politike rreth kushtetutës. Një kushtetutë moderne nuk do të reflektojë interesat e ngushta politike të një partie në pushtet, por do të reflektoj një vizion dhe strategji afatëgjate të zhvillimit politik. Konsensusi i gjërë politik dhe qytetar rreth kushtetutës siguron qendrueshmerinë dhe pragmatizmin e saj.

5. Identifikimi i çështjeve që janë objekt i normimit kushtetues

Fillimisht para fillimit zyrtar të draftimit të kushtetutës, ekspertët kushtetues duhet të identifikojnë çështjet që janë objekt i normimit kushtetues. Objekti i normimit kushtetues përfshinë të gjitha marrëdhëniet kushtetuese që përcaktohen me kushtetutë.

Disa rregulla për identifikimin e objektit të normimit kushtetues: normimi kushtetues përfshin çështjet thelbësore, jo edhe ato sekundare, nuk normohen në kushtetutë çështjet e legjislacionit. Mandej, normim kushtetues duhet të shmang hipertrofinë kushtetuese; normimi kushtetues siguron funksionimi e shtetit dhe degëve të pushteti dhe aty ku përfundon pushtetit duhet të fillojë liria absolute e qytetarit.

6. Referimi i Kushtetutës të legjislacionit organik dhe sekundar

Një nga tiparet qenësore të normimit kushtetues është referimi të legjislacioni organik dhe sekundar. Kushtetuta përcakton bazat e funksionimit të sistemit kushtetues. Por kushtetuta matrializohet dhe implementohet përmes një pakoje të gjërë të legjislacionit primar dhe sekundar. Duke përcaktuar bazat e funksionimit të sistemit kushtetuese, ekspertët kushtetues duhet të jenë të vemendëshëm, se çka duhet të rregullohet tërësisht në kushtetutë, e çka nepërmjet legjislacionit. Për ketë arsye, kushtetuta për çështjet detale i referohen legjislacionit dhe nuk e ngarkonë tekstin kushtetues me përmbajtje legjislative. Kështu psh, kushtetuta përcakton bazat e funksionimit, organizimit dhe pavarësisë së gjyqësorit, por referon tek ligji për gjykatat i cili rregullon detalet e nevojshme për funksionimin e kësaj dege të pushtetit. Rasti tjetër, i referohet lirive dhe të drejtave të qytetarëve, ku kushtetuta garanton një spektër të gjërë të këtyre lirive dhe të drejtave, por udhëzon në legjislacionin e rregullt për mënyren e realizimit të tyre, psh, kushtetuta garanton lirinë e bashkimit politik, kurse Ligji për partitë politike përcakton format dhe mënyrat e realizimit të kësaj lirie politike.

Me rasin e draftimit të kushtetutës, ekspertët kushtetues nuk mund të udhëzojnë dhe referojn legjislacionin e rregulltë për çështjet që janë të karakterit ekskluziv kushtetues si psh, fushëveprimi dhe kompetencat e kuvendit, presidentit, qeverisë. Me ketë rastë me norma kushtetuese matriale në mënyrë prekluzive dhe me metoden e enumeracionit taksativ përcaktohen kompetencat e këtyre organeve. Por, çështjet e karakterit organizativ dhe procedural, që kanë të bëjnë me këto organe (parlamenti, presidenti,

qeveria) i referohen legjislacionit ose rregullimit nën ligjor, si psh. Rregullorja e Punës së Kuvendit, Ligji për Qeverinë etj.

Detyrë parësore e ekspertëve kushtetues para fillimit të draftimit kushtetues është pra, identifikimi i kuartit të çështjeve që janë objekt i rregullimit kushtetues dhe çështjeve të cilat duhet të referohen legjislacionit të rregullt.

7. Përzgjedhja e Komisionit Kushtetues

Pas miratimit të nismës për fillimin e procesit kushtetutëdhënës, Kuvendi duhet të formojë trupin kushtetues të cilit do t'i besohet draftimi i kushtetutës. Praktikisht kushtetues tregojnë se modelet me të shpeshta të organeve që draftojnë kushtetutën janë: komisionet kushtetuese, këshillat kushtetuese, Asambleja Kushtetuese etj. Edhe pse pranë parlamenteve funksionojnë komisionet e rregullta kushtetuese, draftimi kërkon pjesëmarrjen e ekspertëve që nuk janë antarë të parlamentit, sepse parlamentet me përbërjen e tyre nuk plotësojnë kompetencat e nevojshme që kërkon ky proces.

Përzgjedhja e anëtarëve të Komisionit Kushtetues bëhet sipas procedurave, kritereve dhe kushteve të përcaktuara me aktet ligjore. Komisioni kushtetues edhe pse ka mandat ekskluziv për draftimin e kushtetutës shpeshherë përbëhet edhe nga përfqësuesit politik që ndërtojnë konsensusin e nevojshëm gjatë draftimit dhe personalitete tjera autoritative që gëzojnë besim të madh tek popull. Jo domosdoshmërishtë anëtarët e Komisionit Kushtetues duhet të jenë juristë të dalluar. Kjo kërkohet kryesisht nga individet që bëjnë draftimin kushtetues të tekstit. Përvojat ndërkombëtare tregojnë se numri i antarëve të komisioneve kushtetuese është i ndryshëm dhe sillet nga 10 deri në 50 anëtarë. Rast interesant ishte ai i Komisionit Kushtetues të Estonisë, i cili numëronte

50 anëtarë, në mesin e së cilëve gjendeshin edhe artistë, këngtar, sportistë dhe personalitete tjera me autoritet tek popull. Megjithatë, përkundrejt asaj se komisioni mund të ketë numër të madh, hartimi i kushtetutës i besohet një numri të kufizuar individësh 5-10, kurse anëtarët tjerë marrin pjesë në debatet kushtetues të komisionit gjatë draftimit. Në fillim të punës së tij, menjëherë pas konstituimit, Komisioni Kushtetues miraton Rregulloren e Punës, e cila përcakton mënyren e punës së komisionit, mënyren e udhëheqjes së komisionit, mandatin e tij, hartimin e versioneve të para të kushtetutës, mënyren e marrjes së vendimeve brenda komisionit, mënyren e informimit të opinionit për punën e komisionit, afatin e dorëzimit të tekstit në parlament dhe çështjet tjera teknike dhe organizative. Komisioni udhëhiqet nga një, ose më shumë kryesues, të cilët njëkohësisht janë edhe bartësit kryesor të draftimit. Fillimisht draftimi i kushtetutës bëhet nga ekspertët në nëngrupe sipas Kaptinave, e më vonë unifikohet teksti dhe sigurohet koherenca e tij logjike e kushtetuese. Para se kushtetuta të dorëzohet në parlament bëhet redaktura ligjore e saj, lektura gjuhësore dhe harmonizimi i saj me standarde ndërkombëtare.

8. Faza e tretë-Draftimi i i tekstit kushtetues

Fillimi i draftimit të kushtetutës paraqet fazën teknike dhe profesionale të shkrimit të tekstit të kushtetutës. Në praktikën kushtetuese procesi i fillimit të draftimit të

kushtetutës, niset me përcaktimin e strukturës së tekstit, duke caktuar kaptinat dhe pjesët e kushtetutës. Si rregull Komisioni Kushtetues ndahet në disa nëngrupe dhe bëhet ndarja e punëve sipas nëngrupeve për kaptinat përkatëse.

Fillimisht është e nevojshme që komisioni në përbërje të plotë të arrij pajtuesmeri për standardet e draftimit kushtetues, terminologjinë kushtetuese, stilin e normimit kushtetuese, etj. Nëngrupet do të përbëhen nga një numër anëtarësh dhe ekspertesh që kanë njohuri të thelluara për lëmitë e ndryshme që rregullon kushtetuta; psh. nëngrupi për parimet themelore të kushtetutës, për kaptinen e lirive dhe të drejtave të njeriut, nëngrupi për institucionet demokratike, pushtetin lokal, forcat e armatosura, sistemin gjyqësor, etj. Numri i nëngrupeve do të përcaktohet sipas lëmvive kushtetuese. Nëngrupet do të draftojnë kaptinen ose pjesen e caktuar të kushtetutës dhe do të sigurojnë ekspertizen e gjërë kushtetuese. Pas përfundimit të punës së nëngrupeve dorëzohen pjeset e kaptinave të kushtetutës dhe krijohet një draft i parë punues i kushtetutës. Duke qenë se nëngrupet mund të kenë përdorë gjuhë dhe stil kushtetues të ndryshme, dhe se tekstet e tyre mund të mos jenë të harmonizuara, është e nevojshme të krijohet një grup punues për unisimin e tekstit kushtetues dhe harmonizimin e tij. Ky grup duhet të përbëhet nga ekspertet kryesor kushtetues, të cilët janë njohës më të mirë të lëmisë kushtetuese. Detyrë parësore e këtij grupi është harmonizim i tekstit, unifikimi i terminologjisë dhe teknikës kushtetuese dhe redaktura profesionale e kushtetutës. Pas përfundimit të punës të këtij grupi mund të përfundojë drafti i parë i kushtetutës.

Pas përfundimit të draftit të parë Kushtetues, Komisioni Kushtetues mund të organizojë debate profesionale me ekspertet vendor dhe nderkombëtar për tekstin e kushtetutës, në mënyrë që të marrë opinionet e gjëra rreth tekstit të kushtetutës. Pas kësaj, teksti mund të jepet në debat publik në opinion të gjërë, në media dhe të bëhet publik përmes veb- faqes së veçantë elektronike. Komisioni përcjell me vemendje debatin publik verejtjet e arritura përmes mediave ose formës elektronike dhe para hartimit të verzionit të dytë do ti përfshi në tekstin e kushtetutës propozimet që pranohen si të arsyshme. Më pastaj, Komisioni mund të përfundojë versionin e tekstit dhe të pregadisë atë për dorëzim në parlament. Me këtë nuk përfundon puna e Komisionit Kushtetuese, sepse ai duhet të përcjell debatin parlamentar dhe inkorporojë të gjitha amandamentet e pranuar nga parlamenti dhe të plotësoj dhe ndryshoj tekstin e propozuar deri në momentin e votimit të tij në parlament. Pas votimit të tekstit në parlament, përkatësishtë miratimit të tij në referendum përfundon puna e Komisionit Kushtetues dhe procesi të draftimi të tekstit kushtetues.

9. Hartimi i tekstit shpjegues (komentarit) të Kushtetutës

Hartimi i tekstit shpjegues-komentarit kushtetues paraqet një punë shumë të dobishme për të shpjeguar në opinionin e gjerë përmbajtjen, kuptimin dhe qëllimin e kushtetutës. Të shkruarit e komentarit mund të fillojë vetëm pas miratimit dhe hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Teksti shpjegues (komentari) kushtetues do të ndihmoj në të kuptuarit sa më të mirë të kushtetutës në opinionin e gjërë. Komenti i kushtetutë është një formë e interpretimit të saj nga ekspertet që kanë hartuar tekstin e Kushtetutës.

Këtë koment mund ta hartojnë ekspertet kulminant kushtetues, që njohin shkelqyshëm, jo vetem draftimin kushtetues, por edhe teorinë kushtetuese. Komenti do të përfshijë shpjegimin e domethënies së çdo dispozitë të veçantë kushtetuese, nen për nen, duke spjeguar domethënjen e normes kushtetuese, kushtet që kërkohen për krijimin ose pushimin e një marrëdhënie kushtetues dhe shpjegime tjera përcjellëse që kompletojnë njohuritë për një institut kushtetuese. Roli i komentarit kushtetues shprehet më së miri tek implementimi i kushtetutës, si ndihmesë për organet kompetente që të kuptojnë drejtë kushtetutën dhe dispozitën e saj konkrete dhe për të hequr mundësin e interpretimeve të ndryshme dhe dykuptimësisë së normave kushtetuese. Për dallim nga teksti i Kushtetutës, Komentari i Kushtetutës është shumë më i gjerë dhe nganjeherë i përngjan një teksti të gjërë akademik.

Hartimi i komentarit është një praktikë e rregullt për legjislacionin organik, si psh. kodet penale, kodet civile, kodet administrative etj. Jo të gjitha kushtetutat kanë komentaret e tyre. Mirëpo, ato që kanë komentarin e vet janë shumë më të kuptueshme dhe lehtësojnë kuptimin e saj. Si rregull komentaret botohen nga institucionet e autorizuara të shtetit, parlamenti, presidenti, ministria përkatëse. Komentari i bashkangjitet tekstit të kushtetutës dhe shkruhet në atë mënyrë që pas çdo neni jepet pjesa shpjeguese e domethënies së tij. Në praktikë komentaret kushtetuese marrin për bazë edhe praktiken e gjykatave kushtetuese, të cilat duke mbrojtur kushtetutën bëjnë shpjegime të domethënies së saj. Gjykata kushtetuese, duke vlersuar kushtetutshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore bënë interpretimin kreativ të kushtetutës dhe ndihmon në krijimin e praktikës kushtetuese. Komentet e gjykatave kushtetuese në zgjidhjen e konteksteve të nderlikuara kushtetuese janë ndihmesë për hartuesit e kushtetutës në shkrimin e komentarit kushtetuese.

Krahas hartimit të komentarit kushtetues, shumë shtete publikojnë edhe publikime të veçanta për të popullarizuar tekstin e kushtetutës dhe sistemin kushtetuese. Këto publikime shpesh bëhen në publikime speciale në formë librash, broshurash, fletushkash dhe botohen edhe në gjuhët e huaja.

Së fundi, kushtetuta e re pas miratimit bëhet bazë për hartimin e teksteve shkollore dhe atyre universitare për të drejtën kushtetuese dhe deget tjera publike, të cilat afrojnë njohuritë e nevojshme, të cilat nxënësit dhe studentët duhet ti mësojnë për të kuptuar sistemi dhe organizimin e sistemit kushtetues të shtetit të tyre.

10. Faza e katërt- Debati Parlamentar lidhur me draftin kushtetues

Debati parlamentar paraqet pjesën finale të një procesi kushtetutdhënës. Pa marr parasysh faktin, se a është parlamenti autor i kushtetutës, apo ajo miratohet në referendum, debati parlamentar paraqet fazën vendimtare të miratimit të kushtetutës. Debati parlamentar për kushtetutën fillon pas dorëzimit të tekstit të kushtetutës, të hartuar nga Komisioni kushtetues. Për shkak të rëndësisë së kushtetutës debati parlamentar mund të zgjatë një kohë të gjatë për shkak të rëndësisë së kushtetutës. Për parlamentin nuk ka ngjarje dhe moment më të rëndësishëm, se sa miratimi i Kushtetutës. Për këtë arsye janë

me fat historik parlamentet të cilat në mandatin e tyre miratojnë kushtetuta. Praktika kushtetuese tregon, se para se kushtetuta formalishtë t'i dorëzohet parlamentit dhe para se të hapet debati, partitë relevante në parlament ndërtojnë qendrimet e nevojshme dhe arrinë konsensusin e nevojshëm politik, në mënyrë që të mos manifestohen divergjenca të thella parlamentare rreth tekstit të kushtetues. Këto konsensusë politike arrihen në fazen para kushtetuese, para fillimit të procesit të draftimit, duke i përcaktuar qëllimet e reformës kushtetuese, gjatë procesit të draftimit nëpërmjet antarëve të komisionit politik që përfaqësojnë spektrin politik të një vendi. Para fillimit të debatit parlamentar, verzioni final i draftit të kushtetutës i dorëzohet antarëve të parlamentit, grupeve parlamentare, komisioneve tjera parlamentare dhe mekanizmave të tjerë me qëllim të pregaditjes së tyre për një debat të kualifikuar kushtetues. Vendet demokratike dhe ato që shquhen me një sistem të qeverisjes së mirë, kujdesen në mënyrë të veçantë që rreth kushtetutës të mos lejojnë qendrim opozitar dhe të integrojnë opoziten dhe partitë e vogla në tërë rrjedhjen e procesit kushtetues, që nga fillimi i tij, e deri në miratimin e kushtetutës. Kjo qasje siguron departizimin e karakterit të kushtetutës dhe destinacionin e gjërë të saj për popullin dhe shtetin. Praktika ka treguar se çdo tendencë e partizimit të kushtetutës ka rezultuar me jo qendrueshmerinë e saj dhe krizat kushtetuese si pasojë e mbivotimeve partiake për çështjet esenciale kushtetuese.

Debati parlamentar për kushtetutën fillon me prezentimin e saj në seancë nga Komisioni Kushtetues që ka hartuar kushtetuten. Pas raportimit të komisionit fillon debati, ku fillimishtë partitë politike përmes kryetarëve të grupimeve politike shprehin qendrimet për përkrahjen, ose refuzimin e tekstit të kushtetutës. Sipas rregullave të debatit parlamentar, mendimin e tyre e shprehin komisionet parlamentare, fillimishtë komisioni legjislativ dhe kushtetues, e pastaj hapet debat i gjërë, ku marrin pjesë të gjithë anëtarët e parlamentit që deshirojnë të diskutojnë. Gjatë debatit parlamentar, çdo anëtar i parlamentit mund të paraqes amendamente për ndryshimin dhe plotësimin e çdo norme kushtetuese. Nëse këto amendamente para votimit pranohen ato hynë brenda tekstit të kushtetutës dhe nuk paraqiten si amendamente të veçanta pas votimit të kushtetutës. Duke qenë se, debati për kushtetutën zgjon interesimin e gjërë dhe ai nuk përfundon vetëm me një seancë parlamentare, por kërkon më shumë seanca.

11. Faza e pestë- Miratimi i Kushtetutës

Akti i miratimit të kushtetutës paraqet momentin final të një procesi kushtetudhënës. Pas përfundimit të debatit parlamentar bëhet votimi i kushtetutës, cili si rregull paraqet një akt solemn. Seanca parlamentare në të cilën miratohet kushtetuta paraqet një ngjarrje historike për një shtet. Në këtë seancë përpos antarëve të parlamentit, marrin pjesë të gjithë zyrtarët e lartë të një vendi, përfaqësues të institucioneve vendore dhe nderkombëtare, antarë të komisionit kushtetues, përfaqësues, personalitete dhe intelektual të shquar, përfaqësues diplomatik dhe musafirë tjerë të lartë. Kjo seancë paraqet një ngjarrje mediale dhe transmetohet drejtpërdrejtë nga televizionet, radiot dhe përcillet nga gazetaret e shumë të medive vendore dhe nderkombëtare. Në disa vende dita e miratimit të kushtetutës është shpall edhe si festë shtetërore dhe shënohet me jubile të ndryshëm. Si rregull seanca soleme për miratimin e kushtetutës thirret pas

përfundimit të debatit parlamentar dhe tejkalimit dhe evitimit të të gjitha kundërshtive rreth tekstit kushtetues. Kjo seancë hapet me procesin e votimit të kushtetutës. Votimi i kushtetutës bëhet në pajtim me dispozitat kushtetuese në fuçi që përcaktojnë mekanizmin e miratimit të kushtetutës dhe rishikimit të saj.

Kushtetutat e shteteve të ndryshme përcaktojnë këto forma kryesore të votimit dhe miratimit të kushtetutës:

- a) *votimi dhe miratimi i kushtetutës në mënyrë konsensuale nga dy dhomat e parlamentit;*
- b) *votimi i kushtetutës në parlamentet bikamerale me 2/3 e votave;*
- c) *votimi i kushtetutës paraprakishtë nga njësit federale, pastaj nga parlamenti federal;*
- d) *votimi i kushtetutës nga populli, pas miratimit të saj në parlament;*
- e) *votimi i kushtetutës me 2/3 e antarëve në parlamentet njëdhomëshe;*
- f) *votim me shumicën absolute të antarëve të parlamentit;*
- g) *votimi me mekanizmin e dyfishtë, shumicën e përgjithshme dhe shumicën e pakicave (shumica Badinter), etj.*

Nëse pas votimit të Kushtetutës nuk kërkohet edhe shpallja e referendumit, atëherë kushtetuta hynë në fuçi. Nëse pas miratimit të Kushtetutës, kërkohet shpallja e referendumit dhe deklarimi i popullit për tekstin e kushtetutës, parlamenti do të konvokohet sërish për të shpallur solemnisht Kushtetuten, nese referendumi është pozitiv.

12. Referendumi Kushtetues

Referendumi kushtetues paraqet formën më të rëndësishme të deklarimit të qytetarëve për miratimin e një akti juridik. Këtë formë të miratimit të kushtetutës e përcaktojnë shtetet e demokracisë së drejtpërdrejtë dhe ato gjysëmdirekte. Referendumi kushtetues në disa shtete është mekanizëm i vetëm, kurse në disa ai kombinohet me parlamentin, i cili paraprakisht deklarohet për miratimin e kushtetutës. Në të dy rastet e cekura referendumi kushtetues ka karakter të detyrueshëm dhe paraqet akt konstituitiv në procesin kushtetutdhënës. Rëndësia e referendumit kushtetues është e shumfishtë. Ai siguron një legjitimitet demokratik dhe krijon qendrueshmëri të gjatë të kushtetutës.

Përparësitë kryesore të referendumit kushtetues konsistojnë në këto fakte: sigurimi i legjitimitetit popullor të kushtetutës, koncentrimi i sovranitetit tek populli, departizimi i kushtetutës, konsensusi i gjërë qytetar dhe popullor i kushtetutës, vendosja e drejtpërdrejtë e qytetarëve për vlerat themelore të kushtetutës, qendrueshmerinë dhe vlefshmerinë afatgjate e kushtetutës, pamundësinë e ndryshimit të kushtetutës për interesa të ngushta politike, dhe sigurimi i sistemit të qeverisjes së mirë, etj.

Referendumi kushtetues, si një ngjarje kryesore politike dhe shtetërore duhet të pregaditet mirë, në mënyrë që ai të ketë sukses dhe të shpreh vullnetin burimor të qytetarëve për kushtetuten. Kjo kërkon që teksti i kushtetutës të bëhet me kohë transparent, në mënyrë që qytetarët të njoftohen me përmbajtjen e saj, të jetë zhvilluar paraprakisht një debat publik për çështjet më të rëndësishme të kushtetutës dhe të ndermerren të gjitha masat teknike për mirëvajtjen e referendunit. Deklarimi i qytetarëve në referendumin kushtetues, bëhet me deklarimin e tyre për, ose kundër tekstit të kushtetutës. Paraprakishtë definohet pyetja për referendumin kushtetues e cila vendoset në Fletëvotim, psh.:

*“A e jenë për tekstin e propozuar të Kushtetutës”, pason përgjegjëja
“Për” ose “Kundër.”*

Referendumi konsiderohet i sukseshëm nese marrin pjesë së paku gjysma e trupit votues, dhe nëse së paku gjysma prej atyre që votojnë pranojnë tekstin e propozuar të kushtetutës.

Edhe pse formë e deklarimit personal në referendumin kushtetues rëndësi të veçantë kanë qëndrimet politike të partive për tekstin e kushtetutës. Këto qëndrime, në mënyrë indirekte ndikojnë në disponimet politike të qytetarëve rreth kushtetutës dhe në përcaktimin e tyre për ketë tekstë. Mirëpo, janë shënuar edhe rastet kur teksti i kushtetutës është miratur në parlament nga mazhorancat parlamentare, por është refuzuar në referendum, kështu psh. Projekt Kushtetuta e Shqipërisë është miratur në Kuvend në vitin 1994, por është refuzuar në referendum nga qytetarët. Rasti më aktual i referendunit kushtetues paraqet Projekt Kushtetuta Evropiane, e cila është vendos të miratohet në dy mënyra; *me ratifikimin e saj në parlament e shteteve anëtare dhe me referendum*. Deri më tani referendumi kushtetues për ketë kushtetutë është mbajtur në disa shtete, prej të cilave Franca dhe Holanda kanë refuzuar ketë kushtetutë.

Në praktikën kushtetuese nuk ka qëndrime unike rreth dy aspekteve të referendunit kushtetues; dështimit të referendunit dhe rishikimit ose ndryshimit të kushtetutës.

Çështja e parë ka të bëjë me pasojat juridike të dështimit të referendunit kushtetues, përkatësishtë refuzimit të miratimit të saj nga qytetarët. Ky dështim mund të vije si rezultat i mosdaljes në referendum

të shumicës së kërkuar të qytetarëve në referendum dhe si rezultat i refuzimit të saj nga shumica e nevojshme e qytetarëve që marrin pjesë në referendum. Në rastin e parë, kur mungon numri i mjaftueshëm i zgjedhësve në referendum mund të vijë deri te përsëritja e referendunit pas një periudhe kohore të përcaktuar me kushtetutë, psh, pas tre-gjashtë muajve etj. Në rastin e dytë kur dështimi i referendunit është pasojë e kundërshtimit të tekstit nga zgjedhësit, përsëritja e sërishme e referendunit nuk mund të bëhet pa kalimin e një periudhe më të gjatë kohore, psh, jo brenda një viti.

Rishikimi i kushtetutës përmes referendunit bëhet në rastet kur kushtetuta shprehimishtë përcakton se miratimi i amandamenteve kushtetuese do të bëhet me

referendum. Kjo vjen në shprehje sidomos në rastet kur amandamentet kushtetuese prekin në parimet themelore të organizimit të shtetit

13. Faza e gjashtë- Hyrja në fuçi dhe periudha kalimtare

Shumica e kushtetutave në një kaptinë të veçantë, e cila titullohet si Dispozitat e fundit ose kalimtare, përcaktojnë kohën e hyrjes në fuçi të kushtetutës dhe të ashtuqujturën periudh kalimtare (të tranzicionit) brenda së cilës duhet të harmonizhet legjisllacioni me kushtetuten. Kushtetuta hynë në fuçi ditën e shpalljes së saj dhe si rregull ajo nuk mund të ketë efekt prapaveprues. Kushtetuta e hyrë në fuçi prodhon pasoja juridike nga momenti i shpalljes së saj. Krahas hyrjes në fuçi të kushtetutës, pushon të vlejë kushtetuta e mëparshme, përkatësishtë akti tjetër më i lartë kushtetues. Janë disa çështje problematike të zbatimit të kushtetutës së re dhe harmonizimit të legjisllacionit me te.

Në praktikën kushtetuese paraqiten këto raste të diskutushme të tranzicionit të kushtetutës së re: afati brenda së cilit duhet të miratohen ligjet e reja për zbatimin e kushtetutës së re, vlefëshmëria e legjisllacionit ekzistues, afati i harmonizimit të legjisllacionit të vjetër me kushtetutën, kompetencat dhe mandati i organeve dhe institucioneve pas miratimit të kushtetutës, afati kohor i formimit të institucioneve të reja kushtetuese dhe vlefëshmëria e dispozitave kushtetuese që janë të kufizuara në pikpamje kohore, etj.

Pas hyrjes në fuçi të kushtetutë së re *vazhdon të vlejë legjisllacioni ekzistues* nese ai nuk është në kundërshtim me zgjidhjet e reja kushtetuese. Ky legjisllacion nuk afektohet me zgjidhjet e reja kushtetuese dhe ai edhe pas miratimit të kushtetutës së re vazhdon të jetë i zbatueshëm dhe kompatibil me kushtetuten. Në praktikën kushtetuese me rastin e ndryshimeve kushtetuese, kur ndryshimet janë substanciale, kërkohet ndryshimi dhe plotësimi i vetëm një numri të kufizuar të ligjeve, si rregull të legjisllacionit organik, përderisa ligjet tjera vazhdojnë të vlejën edhe me tutje.

Legjisllacioni i cili është në kundërshtim me kushtetutën e re duhet të harmonizohet brenda periudhës kalimtare. Kushtetuta e re në mënyrë taksative cakton afatin kohor, si dhe listen e ligjeve të cilat duhet të miratohen pas miratimit të kushtetutës së re. Ky legjisllacion bije ndesh me zgjidhjet e reja kushtetuese dhe ai duhet të harmonizohet në afatin e caktuar kohor. Ky afat është prekluziv dhe kërkon nga parlamenti një agjendë urgjente legjisllative në mënyrë që të sigurohet harmonizimi i sistemit ligjor dhe kushtetues. Periudha kohore e tranzicionit kushtetues caktohet në një interval 3 deri në 6 muaj nga dita e miratimit të kushtetutës së re. Numri i ligjeve që duhet të harmonizohen me kushtetutën e re varet nga karakteri dhe vëllimi i reformës kushtetuese. Kështu psh, nese kushtetuta sjellë ndryshime në sistemin e qeverisjes, ose në sistemin gjyqësor atëherë duhet të ndryshohen ligjet organike për legjisllativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin, psh, 30 ditë pas hyrjes në fuçi të kësaj kushtetute do të ndryshohet Ligji për Gjykatat në pjesen që rregullon zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve.

Periudha tranzitore e zbatimit të kushtetutës së re përcakton edhe *mandatin dhe kompetencat e organeve ekzistuese*, e në radhë të parë të parlamentit, qeverisë dhe

presidentit. Shtrohet pyetja, a do të funksionojnë këto organe me kompetenca të vjetra sipas kushtetutës së vjetër, apo me kompetencat e parapara me kushtetutën e re. Kjo varet në rradhë të parë nga ajo, se a janë ndryshimet e reja esenciale në pikepamje të fushëveprimit të këtyre institucioneve. Nëse kompetencat e organeve dhe organizimi i tyre sjellë risi të ndishme kushtetuese atëherë si rregull, krahas miratimit të kushtetutës së re organizohen edhe zgjedhje të reja ta parakohëshme dhe konstituohen organet e reja. Kjo vjenë si pasojë e paraqitjes së dualizmit kushtetues dhe inkopatibilitetit të zgjidhjeve kushtetuese. Në një anë kemi organet e zgjedhura mbi bazen e kushtetutës së vjetër, kurse në anen tjetër kemi kushtetutën e re e cila ndryshon kompetencat e organeve ekzistuese. Në situatat e këtilla, krahas kushtetutës së re, kërkohet legjitimiteti i ri i organeve të shtetit përmes zgjedhjeve të reja dhe rritjes së kapacitetit të tyre qeverisëse, psh, *brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi i kësaj kushtetute do të mbahen zgjedhjet e reja parlamentare dhe presidenciale pas të cilave Kuvendi dhe presidenti do të ushtrojnë kompetencat kushtetuese në pajtim me kushtetutën e re.*

Në periudhën kalimtare të implementimit të kushtetutës së re shpesh caktohet afati kohor për themelimin e institucioneve të reja, të cilat i përcakton kushtetuta e re. Kjo vjenë në shprehje kur krijohen organe dhe institucione të cilat nuk kanë ekzistuar me kushtetutën e vjetër. Në këto raste, me dispozitat kalimtare caktohet në mënyrë prekluzive afati i themelimit të këtyre institucioneve. psh, *tre muaj pas hyrjes në fuqi të kushtetutës do të themelohet Gjykata Kushtetuese.*

Dispozitat kalimtare të kushtetutës përcaktojnë afatin e vlefshmërisë dhe shfuqizimit të dispozitave konkrete të kushtetutës që lidhen me afate kohore. Edhe pse limitimi kohor i *dispozitave kushtetuese nuk është një veçori e kushtetutave moderne, në disa shtete disa nene janë specifike dhe vlejné për një periudhë kohore.* Psh, rast tipik për këtë situatë është Kosova, përkatësisht Pakoja e Z. Marti Ahtisari, e cila ka përcaktuar se pas dy mandateve vendet e rezervuara në Kuvend shëndrrohen në vendet e garantuara, ose dispozitat të cilat përcaktojnë se pas një kohe kompetencat e mbikqyrjes nderkombëtare barten tek institucionet e Kosovës.

14 Kriza Kushtetuese- dështimi i miratimit të kushtetutës

Krizë kushtetuese konsiderohet gjendja juridike pa kushtetutë, ose gjendja ku kushtetuta nuk mund të zbatohet. Shteti gjendet në krizë kushtetuese nëse ballafaqohet me njëren nga format vijuese të problemeve kushtetuese si: dështimit të miratimit të tekstit të kushtetutës, refuzimi i kushtetutës nga parlamenti, refuzimit të kushtetutës në referendum, shkeljes së rëndë kushtetutës, dhe pamundësisë së realizimit të kushtetutës.

Paraqitja e krizës kushtetuese në një vend, ka për pasojë paraqitjen e pengesave në funksionimin e shtetit dhe realizimin e funksioneve të tij. Kriza kushtetuese reflekton edhe krizen e thellë politike në një vend dhe është burim i jostabilitetit të përgjithshëm politik. Varësishtë nga shkaqet që kanë shkaktuar krizen kushtetuese, varen edhe mënyrat e menaxhimit dhe tejkalimit të saj. Nëse kriza kushtetuese është rezultat i dështimit të miratimit të kushtetutës në parlament ose në referendum, vazhdon vlefshmëria e aktit të vjetër kushtetuese ose miratohet ndonjë akt i përkohëshëm, i cili vlen deri në

miratimin e Kushtetutës së re. Dështimi i miratimit të kushtetutës nga parlamenti ose në referendum, kërkon përsëritjen e këtij procesi, që nga fillimi dhe kjo merrë mjaftë kohë. Kriza kushtetuese në këtë rastë do të tejkalohet me miratimin e sërishëm të Kushtetutës.

Paraqitja e krizës kushtetuese si pasojë e shkeljes së rëndë, manifestohet në veprimet e njëanshme, me të cilen cenohen dispozitat kushtetuese lidhur me ndarjen e pushteteve dhe kompetencave dhe ajo tejkalohet me rivendosjen e fuqisë kushtetuese të organeve, anulimin e veprimeve kundërkushtetuese dhe marrjen e sanksioneve kushtetuese ndaj shkelësve të kushtetutës, psh, nese Presidenti shkel kushtetutën, ai mund të gjykohet dhe të largohet nga detyra.

Pamundësia e realizimit të kushtetutës si një krizë kushtetuese shfaqet kur nuk mund të implementohen dispozitat e kushtetutës si pasojë e krizave politike ose si pasojë e rrethanave të jashtzakonshme, psh.pamundësia e mbajtjes së zgjedhjeve të rregullta në përfundim të mandatit të parlamentit ose presidentit, pamundësia e realizimit të disa të drejtave politike të qytetarëve për shkak të rrethanave të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme. Në këto raste për shkak të krizave politike nuk mund të implementohen dispozitat kushtetuese, të cilat përcaktojnë detyrimet kushtetuese për organet dhe institucionet kushtetuese të shtetit. Tejkalmi i krizes kushtetuese në rastet e kështilla bëhet krahas menaxhimit të krizes politike, me marrëveshje politike dhe me ndryshime adekuate kushtetuese, të cilat krijojnë një legjitimitet të ri kushtetues.

BOTIMI I KUSHTETUTËS

Pas miratimit teksti i kushtetutës botohet dhe bëhet transparent për opinionin e gjërë. Format më të shpeshta të botimit të kushtetutës janë: Web-saiti i veçantë i kushtetutës,botimi në edicione të veçanta, botimi në shtypin ditor dhe periodik, botimi në fletore zyrtare, botimi në gjuhët e huaja, dhe botimi i materialeve propaguese për kushtetutën.

INTERPRETIMI I KUSHTETUTËS

Ç është interpretimi i kushtetutës?

Një nga kujdeset kryesore që duhet të kenë ekspertët kushtetues gjatë procesit të draftimit, është hartimi i dispozitave të qarta kushtetuese, me formulime të plota koncize dhe të kuptushme. Normat kushtetuese nuk guxojnë të kenë dy ose më shumë kuptime, por duhet të jenë decidive dhe prekluzive në rregullimin e marrëdhënieve kushtetuese. Mirëpo, në praktikën kushtetuese, janë të shpeshta rastet kur gjatë implementimit praktik të dispozitave kushtetuese ose në rastet e krizave kushtetuese shtrihet nevoja e përcaktimit të domethënies së saktë të një ose më shumë normave kushtetuese. Ky proces kërkon interpretimin kushtetues.

Interpretimi kushtetues është një proces juridiko-politik i përcaktimit të domethënies së normës kushtetuese. Norma kushtetuese shpesh ka nevojë për interpretim të saj, në rastet kur ajo nuk është e qartë, ka kuptime të ndryshme dhe në praktikë shkakton

dilema rreth domethënies së saktë të saj. Të interpretosh një dispozitë kushtetuese do të thotë të përcaktosh domethënien e saj dhe kuptimin që ajo ka. Nevoja e interpretimeve kushtetues, shtrohet zakonishtë gjatë zbatimit praktikë të kushtetutës, kur organet që janë përgjegjëse për zbatimin e kushtetutës nuk e kanë të qartë kuptimin dhe domethënien e një ose më shumë dispozitave kushtetuese, ose bëjnë interpretime të ndryshme të këtyre dispozitave.

Arsyet kryesore që kërkojnë interpretimin kushtetues të dispozitave kushtetuese janë:

- a) *Ekzistimi i vakumit kushtetuese;*
- b) *Paraqitja e krizave kushtetuese;*
- c) *Norma kushtetuese jo e plotë;*
- d) *Norma kushtetuese jo koncize dhe*
- e) *Norma kushtetuese me dy kuptimësi;*

Kush e bënë interpretimin e kushtetutës

Çështja e parë me rastin e nevojës së interpretimit kushtetuese është përcaktimi i organit ose subjektit që është kompetentë për të dhënë interpretimin zyrtar kushtetues.

Praktikat kushtetuese të vendeve të ndryshme përcaktojnë disa subjekte kompetente për të bërë interpretimin kushtetues:

- a) *Organi i cili ka bërë miratimin e kushtetutës-kushtetutdhënësi*
- b) *Komisioni kushtetues që ka hartuar kushtetutën*
- c) *Komisioni parlamentar për çështje kushtetuese*
- d) *Organi i posaçëm i themeluar nga parlamenti ose presidenti për të interpretuar kushtetutën*
- e) *Ekspertët nderkombëtar dhe institucionet nderkombëtare, psh Komisioni i Vendikut*
- f) *Gjykata kushtetuese ose gjykata supreme*
- g) *Organi ose institucioni tjetër i përcaktuar ose autorizuar në mënyrë të veçantë.*

Objekti i interpretimit kushtetues bëhet: Një nen i kushtetutës, Paragrafi i kushtetutës dhe Nënparagrafi kushtetues ose Një shprehje kushtetuese.

Llojet e interpretimit kushtetues

Interpretim autentik i Kushtetutës - Ky interpretim është burimor dhe bëhet nga ana e kushtetutëdhënësit, pra subjektit, i cili edhe e ka inicuar dhe udhëhequr procesin kushtetues. Si rregull interpretimin autentik e jep parlamenti ose organi special kushtetues. Me këtë rast vlen parimi se, kushtetutëdhënësi e ka të njohur më së mirë domethënien dhe qëllimin e kushtetutës dhe vetëm ai mund të bëjë interpretimin autentik të saj.

Interpretimi normativ-dogmatik - Interpretimi dogmatik bazohet në domethënien normative të kushtetues dhe bazohet ekskluzivishtë në të kuptuarit e drejtë të saj. Kjo metodë e interpretimit analizon dispozitën e caktuar kushtetuese nga aspekti i ndërtimit të normës kushtetuese, duke analizuar secilen pjesë të normës kushtetuese, pjesës përcaktuese, dispozitivit, sanksionit kushtetues dhe jep domethënien kushtetuese të saj.

Interpretimi gjuhësor dhe logjik i kushtetutës - Për dallim nga interpretimi dogmatik, kuptimi logjik i normës kushtetuese merret me domethënien logjike të normës, pra cili ka qenë shkak dhe pasoja e një raporti dhe marrëdhënie kushtetuese, cila është lidhja logjike midis pjesëve të normës kushtetuese dhe cili është konteksti i përgjithshëm i kushtetutës. Ndërkaq, interpretimi gjuhësor merr për bazë rregullat gramatikore dhe gjuhësor të shkrimit ligjor dhe interpreton normen kushtetuese në bazë të këtyre rregullave.

Interpretimi që merr për bazë praktikën kushtetuese - Praktika kushtetuese ka një rëndësi të veçantë në procesin e interpretimit kushtetuese. Jo rrallë krijohen praktika efikase kushtetuese, të cilat në zbatim praktikë bëjnë interpretimin e normës kushtetuese. Interpretimi praktik i kushtetutës merr për bazë realitetet faktike të krijuara nga institucionet shtetërore dhe qytetarët, në procesin e zbatimit të kushtetutës. Këto praktika ndihmojnë në tejkalimin e dykuptimësisë së normave kushtetuese dhe në tejkalimin e zbrastirave eventuale kushtetuese.

Interpretimi doktrinar dhe shkencor - Shkenca kushtetuese dhe studimet akademike dhe doktrinare kanë një rëndësi të veçantë në spjegimin dhe interpretimin e kushtetutës. Aspekti shkencor i spjegimit të kushtetutës merr për bazë të arriturat shkencore në lëminë e së drejtës kushtetuese pozitive dhe të drejtës kushtetuese krahasuese. Ky studim, jo vetëm që kontribon në studimin e kushtetutës dhe të instituteve kushtetuese, por kontribon edhe në inovacionet kushtetuese dhe avansimin e zgjidhjeve të caktuara kushtetuese. Interpretimi shkencor dhe doktrinar bëhet nga profesoret, ekspertet dhe studiuesit e së drejtës kushtetuese të cilët me publikimet e tyre shkencore, në formë të teksteve, artikujve, kumtesave shkencore etj, ndihmojnë në avansimin e mendimit shkencor në sferën kushtetuese.

Interpretimi nga gjykatat kushtetuese - Së fundi rol vendimtar në procesin e interpretimit kushtetues kanë gjykatat kushtetuese, të cilat duke mbrojtur kushtetutëshmerinë dhe ligjshmerinë dhe duke zgjidhur kontestet kushtetuese bëjnë interpretimin zyrtar të kushtetutës. Vendimet e gjykatave kushtetuese në shumë shtete pranohen si burime formale kushtetuese dhe bëhen pjesë e sistemit kushtetues të një vendi. Duke zgjidhë kontestet kushtetuese, gjykatat kushtetuese bëjnë kontrollin e kushtetutëshmerisë dhe shfuqizojnë dhe anulojnë të gjitha aktet që nuk janë në pajtim me kushtetutën. Vendimet e gjykatave kushtetuese, jo vetëm që mbrojnë kushtetutën nga shkeljet e ndryshme, por edhe bëjnë interpretimin e saj të gjithanshëm, duke treguar se cila ka qenë domethënia e vërtetë e kushtetutës dhe qëllimet e saj. Ky interpretim bëhet nga gjyqëtarët që kanë njohuri të larta kushtetuese dhe ka karakter të një interpretimi kreativ, sepse shpesh komentet që jep gjykata kushtetuese në mbrojtje të kushtetutës shërbejnë si bazë e ndryshimeve dhe plotësimeve të kushtetutës përmes amandamenteve kushtetuese dhe instrumenteve tjera kushtetuese.

BURIMET JURIDIKE KUSHTETUESE

Deklarata e Pavarësisë, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 17 shkurt 2008;
Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 2008;
Pakoja e Presidentit Ahtisari;
Konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
Ligjet sistimore dhe ligjet vitale të Kosovës;
Rregulloria e punës e Kuvendit të Kosovës;
Ligji për Qeverinë e Republikës së Kosovës;
Rregulloria e punës së Qeverisë (2007/1); Rregulloria 2001/9-UNMIK;
Rregulloria 2001/19-UNMIK;
Ligji për Gjykatën Kushtetuese të Kosovës;
Rregullorja e punës së gjykatës kushtetuese; Ligji për gjykatat;
Ligji për prokurorinë;
Ligji për qeverisjen lokale në Kosovë; Statuti i komunës;
Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës;

LITERATURA

Prof.dr.Arsim Bajrami, “*Demokracia Parlamentare*”, Prishtinë, 2006
Prof.dr. Arsim Bajrami, “*Draftimi i kushtetutes*”, Prishtinë, 2007
Prof.dr Arsim Bajrami, “*E Drejta e Kosovës në Tranzicion*”, Prishtinë, 2000
Doracaku për Përgaditjen e Provimit të Jurisprudencës, KIEAI- OSBE, Prishtinë, 2004

E DREJTA PENALE 2

Me dt. 01.01.2013, në Kosovë ka hyrë në fuqi Kodi i Penal i Kosovës, dhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës.

Duke u nisur nga fakti se në materialin për një doracak, nuk mund të përfshihet e tërë ajo çka nevojitet për një punim gjithëpërfshirës, këtu do të përqipem që të përfshijë vetëm atë pjesë nga e drejta penale që është paraparë në programin për provimin e jurisprudencës, me një hyrje të shkurtër për të drejtën penale, funksionin e së drejtës penale në shoqëri, burimet e së drejtës penale dhe veprimin e legjislacionit penal.

E drejta penale është një degë e legjislacionit pozitiv të shtetit dhe një degë e shkencës juridike.

Si degë e legjislacionit pozitiv, e drejta penale është sistem i normave juridike me të cilat përcaktohet se cilat vepra të njerëzve konsiderohen vepra penale, dhe çfarë lloje të sanksioneve penale do t'iu shqiptohen kryerësve të tyre.

E drejta penale ushtron mbrojtjen nga kriminaliteti, në atë mënyrë që me ligj përcakton se cilat vepra apo sjellje të rrezikshme të njeriut, konsiderohen vepra penale dhe çfarë lloje të dënimeve apo sanksione penale do t'iu shqiptohen. Funksioni mbrojtësi i së drejtës penale është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti. Në kuadrin e këtij funksioni, e drejta penale në radhë të parë ka për detyrë që të mbrojë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, rendin juridik dhe sigurinë e vendit. Këtë funksion e drejta penale e realizon duke i mbrojtur me mjetet penale juridike, përkatësisht me sanksionet penale dhe me masa të tjera jo penale, institucionet dhe marrëdhëniet e reja në drejtim të këtij zhvillimi të mëtejshëm në shoqërinë e caktuar.

Gjithashtu, e drejta penale ka për detyrë t'i mbrojë edhe të mirat juridike të posaçme, që i përkasin njeriut dhe qytetarit, siç janë: jeta e njeriut, integriteti trupor, liritë dhe të drejtat, nderi dhe autoriteti, barazia dhe siguria e qytetarëve.

Funksioni mbrojtës i së drejtës penale është fragmentar, ngase me këtë degë të drejtësisë mbrohen vlerat më të rëndësishme dhe më elementare të individit dhe të bashkësisë.

Prej kësaj që u tha, rezulton se funksioni mbrojtësi i së drejtës penale është i karakterit subsidiar, ngase shprehet vetëm në rastet kur vlerat e përmendura nuk mund të mbrohen me mjete apo mënyra të tjera.

Funksioni mbrojtës i së drejtës penale nga kriminaliteti shprehet edhe në rastin e shqiptimit, veçmas, gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit dhe sanksioneve tjera penale, ngase aplikimi i sanksioneve penale nuk ka për qëllim që vetëm të rrënojë apo t'i shkaktojë ndonjë të keqe tjetër kryerësit të veprës penale, por në radhë të parë të përmirësojë atë, që në të ardhmen të mos kryej vepra penale.

U tha se çka është funksioni i së drejtës penale, pra duhet thënë se çka është kriminaliteti dhe nocioni i tij.

Veprat e njeriut me të cilat dëmtohen, cenohen ose asgjësohen, vlerat juridike të njeriut dhe të bashkësisë së caktuar, quhen vepra penale apo me termë të përgjithshëm kriminalitet, dhe shoqëria mbrohet nga kriminaliteti me të drejtën penale.

Lënda e së drejtës penale

Lënda e së drejtës penale përbëhet nga: vepra penale, kryesi i veprës penale dhe sanksionet penale. Pra e drejta penale si degë e legjislacionit pozitiv të një shteti i përcakton se cilat vepra konsiderohen vepra penale, kushtet të cilat duhet të përmbushen për t'u konsideruar një person penalisht i përgjegjshëm dhe se çfarë lloji i sanksionit penal mund t'i shqiptohet.

Burimet e së drejtës penale

Burimet te së drejtës penale ndahen në dy lloje:

- Burimet materiale dhe
- Burimet formale.

Burimet materiale konsiderohen të gjitha marrëdhëniet shoqëro-ekonomike dhe marrëdhëniet e tjera shoqërore, që e karakterizojnë një shoqëri, sistemin e saj shoqëror – politik, ekonomik e tjera.

Burimet formale të së drejtës penale janë normat juridike veç e veç dhe tërësia e tyre. Ky në fakt është sistemi juridik i vendit të caktuar.

Burimi formal kryesor është kodi penal

Burimet tjera formale janë:

- Kushtetuta
- Konventat ndërkombëtare.
- Ligjet e tjera, normat nënligjore dhe aktet e përgjithshme,
- E drejta zakonore,
- Praktika gjyqësore,
- Shkenca e së drejtës penale.

Me fjalë të tjera si burim formal i së drejtës penale është legjislacioni penal që gjendet në fuqi, përkatësisht e drejta penale pozitive.

Nocioni i ligjit penal, kodit penal dhe legjislacionit penal.

Për t'i kuptuar këto tri nocione duhet dhënë nocionet e tyre.

Pra me ligj penal nënkuptojnë çdo dispozitë ligjore me të cilën rregullohen çështjet nga fusha e së drejtës penale.

Me kod penal nënkuptojmë ligjin e rëndësishëm në të cilin në mënyrë të tërësishme dhe të sistemuar përmbliken dispozitat penalo – juridike.

Me termin legjislacion penal nënkuptojmë të gjitha ligjet penale pra edhe kodin penal si dhe tërë sistemin e ligjeve dhe dispozitave të tjera penale, të cilat janë në fuqi, të cilat aplikohen në vendin tonë apo në sistemin e ligjeve penale që janë në fuqi në shtetet e tjera.

Pra nga nocionet që u dhanë, del se nocioni (ligji penal) ka domethënie më të gjerë së nocioni (kod penal) sepse ligji penal nënkupton çdo dispozitë ligjore të së drejtës penale materiale, pavarësisht se ajo dispozitë gjendet në kodin penal apo në ndonjë ligj tjetër.

Parimi i legalitetit

Parimi i legalitetit apo i ligjshmërisë që shprehet në aforizmin latin “Nullum crimen, nulla poena sine lege” në gjuhën shqipe do të thotë se “një veprë nuk mund të konsiderohet veprë penale dhe kryesi i saj nuk mund të dënohet nëse më parë nuk është paraparë me ligj”.

Ky parim shprehimisht është i paraparë në nenin 1 paragrafi 2 i KPK-së, ku thuhet “askujt nuk mund t'i shqiptohet sanksion penal ose masa e trajtimit të detyrueshëm për një veprë, nëse para kryerjes së veprës, ligji nuk e përcakton si veprë penale dhe nuk parasheh sanksionin penal ose masën e trajtimit të detyrueshëm për atë”.

Veprimi i legjislacionit penal

Veprimi i legjislacionit penal do të thotë se ai legjislacion penal është në fuqi dhe se gjykatat janë të obliguara ta zbatojnë.

Në legjislacionin penal njihen tri lloje të veprimit, është fjala për veprimin e ligjit penal në kohën e caktuar, në territorin e caktuar dhe ndaj personave të caktuar.

Veprimi i kodit penal në kohë do të thotë se si edhe ligjet tjera, kodi penal vepron në kohë të caktuar. Një kod penal fillon të veprojë prej momentit të hyrjes së tij në fuqi dhe aplikohet gjer sa të pushoj së vepruari. Zakonisht kodi penal hyn në fuqi tetë ditë pas shpalljes në gazetën zyrtare. Përbashimisht ligji penal sikundër edhe ligjet tjera për shkaqe posaçërisht të arsyeshme mund të hyjë në fuqi brenda afatit më të shkurtër se tetë ditë nga dita e shpalljes ose po atë ditë që është shpallur.

Koha që duhet të kaloj prej shpalljes së ligjit në gazetën zyrtare e gjerë të hyrja e ligjit në fuqi, quhet *vacatio legis*.

Ligji penal zakonisht vepron deri sa të abrogohet me ligjin e ri. Përkatësisht ai vepron deri në ditën kur hyn në fuqi ligji i ri i cili në mënyrë të heshtur e abrogon atë të mëparshmin.

Kështu, shprehimisht ligji penal abrogohet kur ligji i ri përmban dispozitë të posaçme me të cilën e abrogon atë të mëparshmin ose në rastet kur ligji i ri përmban klauzolë të përgjithshme me të cilën parashihet se pushojnë të veprojnë të gjitha dispozitat që janë në kundërshtim me të.

Në mënyrë të heshtur ligji penal abrogohet atëherë kur ligji i ri penal nuk përmban dispozitë mbi abrogimin e ligjit të mëparshëm, mirëpo çështjet e njëjta i rregullon në mënyrë të njëjtë apo të ndryshme.

Përveç këtyre dy mënyrave të abrogimit, ligji penal pushon të veprojë edhe në rastet kur i skadon afati për të cilin është nxjerrë. Kjo ndodhë kur ligji penal është nxjerrë me qëllim që të veprojë vetëm për një kohë të caktuar dhe se me kalimin e asaj kohe ai pushon së vepruari.

Rëndësia e përcaktimit të veprimit të ligjit penal në kohë

Rëndësia e përcaktimit të veprimit të ligjit penal në kohë është se prej kësaj varet se cili ligj penal do të aplikohet ndaj kryesit të veprës penale, ligji që ka qenë në fuqi kur është kryer vepra penale apo ligji i cili është në fuqi në kohën kur kryesi i veprës po gjykohe.

Këtë çështje Kodi penal i Kosovës e ka rregulluar me dispozitën e nenit 3 paragrafi 1 sipas të cilit është paraparë se, “Ndaj kryesit të veprës penale zbatohet ligji i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale”, ashtu që nëse ndërkohë ligji ndryshon, ndaj kryesit do të aplikohet ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Përfundimisht nga ky parim ekziston në rastet kur ligji i ri është më i favorshëm, më i butë për kryesin e veprës penale. Në këtë rast do të aplikohet ligji i ri edhe pse me dispozitat e kodit penal është aprovuar parimi i ndalimit të veprimit retroaktiv të ligjit penal.

Kjo mundësi shprehimisht është paraparë me dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të KPPK, në të cilin thuhet: “Në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm.

Në praktikën gjyqësore shtrohet vetëm pyetja se cili ligj është më i favorshëm, më i butë për kryesin, ligji që ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, apo ligji që është nxjerrë më vonë? Kjo situatë zgjidhet në atë mënyrë që duhet të krahasohet pozita e kryesit të veprës penale konkrete, sipas ligjit që ka qenë në fuqi në momentin e kryerjes së veprës penale dhe ligjit që është në fuqi në momentin e kryerjes së veprës penale dhe ligjit që është në fuqi në momentin e gjykimit. Në bazë të këtij krahasimi gjykata do të vendosë se cili ligj është më i favorshëm për kryesin e veprës penale që po gjykohe.

Nga kjo rezulton se gjykata nuk mundet për rastin konkret t'i aplikojë në mënyrë të kombinuar dispozitat e ligjit që ka pushuar së vepruari dhe ligjit që gjendet në fuqi, sepse po të lejohej mundësia e tillë, atëherë gjykata në fakt sajton ligj të ri penal, ligj i cili kurrë nuk ka qenë në fuqi.

VEPRIMI I LIGJIT PENAL NË TERRITOR

Ligji penal i një shteti, sikundër dhe ligjet tjera, zakonisht veprojnë në territorin e shtetit në të cilin janë nxjerrë. Pra sipas këtij parimi Kodi Penal i Kosovës vepron dhe aplikohet në territorin e Kosovës.

Pranimi se ligji apo kodi penal aplikohet në territorin e vendit është manifestim i sovranitetit të çdo shteti.

Çështjet të cilat shtrohen dhe rregullohen në kuadrin e institucionit të veprimit të legjislacionit penal në territor, më tepër kanë të bëjnë me elementet ndërkombëtare.

Këtu është fjala për veprim të Ligjit penal të Kosovës ndaj shtetasve të huaj që kryejnë vepra penale në territorin e Kosovës apo jashtë kufijve të Kosovës, por të cilët në ndonjë mënyrë gjenden në Kosovë, si dhe të personave që kryejnë vepra penale me të cilat dëmtojnë të mirat juridike të shtetasve tanë apo shtetit të huaj.

Pra shtrohet pyetja, sipas cilit ligj penal do të dënohen shtetasit e huaj që kryejnë vepra penale në territorin e Kosovës, apo shtetasit tanë që kryejnë vepra penale në territorin e vendit tjetër? Këto dhe shumë çështje të tjera lidhur me këtë i rregullon institucioni i veprimit të legjislacionit penal në territor.

Në rastet kur konstatohet se lerosini i caktuar hynë në sferën e legjislacionit tonë penal, duhet të përgjigjet sipas ligjeve penale të Kosovës dhe të gjykohet nga gjykatat tona.

Me dispozita penalo-juridike të parapara në nenin 99 deri 104 të Kodit penal të Kosovës, janë aprovuar pesë parime, të cilat njëherit aplikohen edhe në shumicën e të drejtave penale të shteteve të tjera bashkëkohore.

Këto janë:

- 1) Parimi territorial
- 2) Parimi real
- 3) Parimi i personalitetit aktiv
- 4) Parimi i personalitetit pasiv
- 5) Parimi universal

Parimi territorial është parim themelor, kurse parimet e tjera janë të natyrës plotësuese. Ky parim është themelor ngase për shkak të tipareve dhe dimensioneve të tij, më së shpeshti aplikohet në praktikë. Sipas këtij parimi, legjislacioni penal i Kosovës

zbatohet ndaj të gjithë personave që kryejnë vepra penale në territorin e Kosovës, pa marrë parasysh se a janë shtetas të tij, shtetas të huaj apo persona pa shtetësi.

Zbatimi i legjislacionit penal sipas parimit territorial rezulton nga sovraniteti i çdo shteti që në territorin e vet të ushtrojë pushtetin represiv dhe juridiksionin (që gjykatat e vendit ta gjykojnë dhe t'i shqiptojnë dënimin kryerësit të veprës penale sipas legjislacionit të vet). Arsyeshmëria e këtij parimi mbështetet edhe në efektin e preventivës së përgjithshme, ngase me të drejtë supozohet se është më efikase që personi të dënohet në vendin ku e ka kryer veprën penale. Gjithashtu, parimi i territorialitetit arsyetohet edhe nga shkaqet praktike, ngase e vërteta më së miri mund të konstatohet në vendin e ngjarjes.

Për aplikimin e parimit territorial duhet të konstatohet se vepra penal është kryer në territorin e vendit (shtetit). Së këndejmi, shtrohet pyetja se çka konsiderohet territor i një shteti. Sipas dispozitave të Kodit Penal, që janë të natyrës interpretuese, me territor të Kosovës nënkuptohet sipërfaqja tokësore, sipërfaqja ujore brenda kufijve dhe vijës kufitare si dhe hapësira ajrore mbi te (neni 120, par. 25). Territori tokësor i një vendi është caktuar me kufijtë shtetërorë.

Me dispozitën e paragrafit 2 të nenit 120 të KPK, është zgjeruar zbatimi i legjislacionit penal të Kosovës në territor. Kjo që është paraparë në këtë paragraf është parim i posaçëm i zbatimit territorial të legjislacionit tonë penal. Sipas këtij parimi, shteti e zbaton legjislacionin e vet ndaj secilit person i cili kryen veprën penale në aeroplan të regjistruar në atë shtet, pavarësisht nga vendi ku ndodhet aeroplani në kohën kur kryhet vepra penale. Kjo është në pajtim me të drejtën ndërkombëtare, nga se sipas konventave ndërkombëtare për sigurinë dhe rendin në qarkullimin ajror, shteti ku është regjistruar aeroplani është i obliguar të garantoj sigurinë dhe rendin në aeroplan.

Sipas paragrafit 2, Kodi Penal dhe ligjet tjera penale të Kosovës zbatohen edhe ndaj secilit që kryen veprën penale në aeroplan të regjistruar në Kosovë, pa marrë parasysh se ku gjendet aeroplani në kohën e kryerjes së veprës penale. Me këtë dispozitë duhet nënkuptuar që deri sa aeroplani fluturon në hapësirën ajrore të ndonjë shteti apo në hapësirën ajrore mbi detin e hapur, do të zbatohet legjislacioni penal i shtetit ku është i regjistruar. Ndërsa nëse vepra penale është kryer në aeroplanin i cili gjendet në aeroportin e shtetit të huaj, atëher do të zbatohet legjislacioni penal i shtetit në territorin (aeroportin) e të cilit është kryer vepra.

Në paragrafin 1, Kodi Penal e ka përvetësuar *parimin real* i cili ndryshe emërtohet parim mbrojtës. Zbatimi i legjislacionit tonë penal, sipas parimit real apo mbrojtës, shprehet në rastet kur veprat penale kryhen jashtë territorit të Kosovës, por me të cilat dëmtohen apo rrezikohen të mirat juridike ndërkombëtare. Rrjedhimisht, në paragrafin 1 të këtij neni, zbatimi i parimit real të legjislacionit penal të Kosovës është paraparë ndaj cilitdo person që jashtë territorit të Kosovës kryen këto vepra penale kundër të drejtës ndërkombëtare – nenet 148-153, 157-160, 164, 165, 166-169, 171, 173-175 të Kodit Penal. Sipas këtij paragrafi, parimi real aplikohet edhe në rastin e kryerjes së veprave penale të parapara në këto nene të Kodit Penal - 238, 241, 273, 280, 293, 294, 302-304, 336 dhe 337 falsifikimit të parasë (neni 244).

Sipas paragrafit 1, pika 1.2, legjislacioni i Kosovës zbatohet gjithashtu edhe për veprat penale të cilat në bazë të marrëveshjes ndërkombëtare e obligon Republikën e Kosovës që t'i gjykoj personat edhe pse veprat penale I kanë kryer jashtë territorit të Kosovës.

Në paragrafin 2 zbatimi i parimit real apo mbrojtës të legjislacionit penal të Kosovës është paraparë edhe për disa vepra penale shumë të rënda me të cilat rrezikohet siguria e Kosovës ose popullit të saj. Lidhur me këtë, në paragrafin 2 është paraparë se legjislacioni i Kosovës zbatohet ndaj cilitdo person që kryen vepër penale nga nenet 136-145. Këto inkriminime janë: kryerja e veprës terroriste (neni 136), ndihma në kryerjen e terrorizmit (neni 137), lehtësimi i kryerjes së terrorizmit (neni 138), rekrutimi për terrorizëm (neni 139), trajnimi për terrorizëm (neni 140), shtytja për kryerjen e veprave terroriste (neni 141), fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste (neni 142), organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist (neni 143), përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës (neni 144) dhe parëndësia e kryerjes së veprës terroriste (neni 145).

Supozim për aplikimin e parimit real apo mbrojtës është që kryerësi i veprës penale të haset në territorin e Kosovës ose që të ekstradohet nga shteti tjetër.

Në paragrafin 3 është paraparë zbatimi i legjislacionit penal të Kosovës sipas parimit të personalitetit aktiv apo parimit nacional. Sipas këtij parimi, legjislacioni ynë penal zbatohet edhe në rastet kur shtetasit e Kosovës kryejnë vepra penale jashtë territorit të Kosovës me kusht që ajo vepër po ashtu të jet e përcaktuar si vepër penale në vendin ku është kryer (identiteti i normave). Zbatimi i këtij parimi lajmërohet si plotësues në raport me parimin territorial dhe real.

Arsyeshmëria e aplikimit të parimit të personalitetit aktiv qëndron në faktin se qytetari i Kosovës, sipas kushtetutës sonë, nuk mund t'i ekstradohet shtetit ku edhe e ka kryer veprën penale, kurse në anën tjetër, nuk duhet të lejohet që personi i këtyllë të mos ndëshkohet për shkak se gjendet në vendin tonë. Me fjalë të tjera, po të mos parashihej parimi i personalitetit aktiv, shtetasit tanë që kryejnë vepra penale jashtë vendit dhe kthehen në vendin e tyre, nuk do të mund të ndëshkoheshin. Gjithashtu arsyeshmëria e ndëshkimit të qytetarëve tanë për veprat penale që i kryejnë në shtetin tjetër konsiston edhe në faktin se meqë shteti i ynë është i obliguar që të kujdeset për shtetasit e vet, është i autorizuar edhe t'i dënoj nëse kryejn vepra penale.

Gjithashtu parimi i personalitetit aktiv zbatohet edhe në rastet kur personi pas kryerjes së veprës penale në shtetin tjetër, bëhet banor qytetar (shtetas) i Republikës së Kosovës.

Në dispozitat e nenit 116 është paraparë zbatimi i ligjislacionit penal të Kosovës sipas parimit të personalitetit pasiv. Sipas këtij parimi Kodi Penal dhe ligjet tjera penale të Kosovës zbatohen edhe ndaj të huajve, të cilët jashtë territorit të Kosovës kryejnë vepra penale kundër shtetasit tonë ose kundër vendit tonë.

Quhet parim i personalitetit pasiv ngase në aspektin kriminal, qytetarët tanë apo Kosova janë pasiv, janë viktima të veprës penale. Me anë të këtij parimi shtetasit tanë dhe Kosova mbrohen nga veprat penale që kryhen jashtë vendit nga shtetas të huaj.

Aplikimi i këtij parimi kushtëzohet me parimin e identitetit të normave, ngase në pikën 2 të këtij neni është paraparë shprehimisht se vepra penale duhet të jetë e paraparë si e tillë edhe në vendin ku është kryer. Në rastet kur nuk ekziston identiteti i normave, ndjekja penale mund të fillohet vetëm me lejen paraprake të prokurorisë publike të Kosovës (neni 117, par. 3), me ç'rast, sikundër edhe te parimi i personalitetit aktiv, është paraparë mundësia e shmangies së këtij parimi, të mos zbatohet ky parim, me lejen e Kryeprokurorit të shtetit të Kosovës (neni 117, par. 1).

Parimi i personalitetit pasiv në fakt është parim real apo mbrojtës, por në këtë rast ky paraqitet si supsidiar, ngase legjislacioni penal i Kosovës aplikohet vetëm në rastet kur në vendin e huaj nuk është ushtruar mbrojtja e duhur juridike-penale. Karakteri i këtillë supsidiarë i parimit të personalitetit pasiv rezulton nga neni 117, par. 2 i Kodit Penal në të cilin është paraparë se procedura penale nuk do të fillohet nëse: kryerësi në tërësi e ka mbajtur dënimin e shqiptuar në një juridiksion tjetër; kryerësi në një juridiksion tjetër është liruar me aktgjykim të plotfuqishëm apo është liruar nga dënimi ose dënimi është parashkruar; procedura penale për veprën penale të kryer në një juridiksion tjetër mund të fillohet vetëm sipas kërkesës së të dëmtuarit dhe një kërkesë e tillë nuk është paraqitur.

Dispozitat e nenit 117. janë të karakterit plotësues në raport me nenet e mëparshme të këtij Kodi. Me këto dispozita përcaktohen disa kufizime lidhur me zbatimin e parimit territorial të legjislacionit penal. Gjithashtu me këto dispozita zgjidhen edhe disa çështje të posaçme të cilat janë të rëndësishme për zbatimin e legjislacionit tonë penal.

Paragrafi 1 e rregullon situatën kur ndonjë person, qoftë ai shtetas i Kosovës po person pa shtetësi, kryen vepër penale në territorin e Kosovës ndërsa për shkaqe të ndryshme ndaj tij është filluar apo është përfunduar procedura penale në shtetin e huaj dhe në ndërkohë ai haset në Kosovë. Në këso situata shtrohet pyetja nëse ai do të gjykohet sërish për të njejtën vepër në Kosovë.

Lidhur me këtë që u tha më sipër, nga paragrafi 1 rezulton se parimi territorial nuk është gjithmonë primar dhe absolut. Ky parim është fakultativ në rastet kur sipas nenit 114 procedura penale në shtetin e huaj është filluar apo është përfunduar. Rrjedhimisht, sipas dispozitës së këtij paragrafi, zbatimi i parimit të territorialitetit mvaret prej vlerësimit të Kryeprokurorit të shtetit të Kosovës. Përkatësisht, nëse do të fillohet procedura penale mvaret prej vlerësimit të Kryeprokurorit të shtetit se a është oportune që edhe te ne të zhvillohet procedura penale.

Me dispozitat e paragrafit 2 është përcaktuar se në rastet e parapara në nenin 115 dhe 116, nene këto me të cilat është parashikuar zbatimi i parimit të personalitetit aktiv dhe pasiv si dhe atij universal, procedura penale për të njejtën vepër penale nuk do të fillohet në këto raste: 1) nëse kryerësi në tërësi e ka vuajtur dënimin që i është shqiptuar jashtë vendit; 2) nëse kryerësi jashtë vendit me aktgjykim të formës së plotfuqishme është liruar ose dënimi i është parashkruar ose i është falur; 3) nëse për vepër penale, sipas ligjit të huaj, ndiqet në bazë të kërkesës së të dëmtuarit, ndërsa kërkesa e tillë nuk është ushtruar.

Siç shihet nga kjo që u tha më sipër, sipas paragrafit 2 vlenë parimi *ne bis in idem* dhe parimi i zbatimit të ligjit më të favorshëm.

Çështja nëse është mbajtur dënimi, është parashkruar apo është falë dhe çka konsiderohet kërkesë e të dëmtuarit, zgjidhet sipas të drejtës penale dhe të drejtës së procedurës penale të shtetit të huaj.

Dispozita e par. 3 gabimisht i referohet nenit 118. Kjo dispozitë duhet t'i referohet nenit 116 të Kodit Penal.

Paragrafi 4 parasheh një lloj përjashtimi nga parimi i veprimit territorial të legjisllacionit tonë penal. Përkatësisht, ky paragraf e akcepton parimin e juridiksionit përfaqësues, sipas të cilit në rastet kur shtetasi i huaj kryen veprë penale në territorin e Kosovës, edhe pse gjykatat tona kanë të drejtë ta dënojnë në bazë të parimit territorial, është paraparë mundësia që vendi ynë të heqë dorë nga kjo e drejtë dhe ndjekja penale t'i besohet shtetit të huaj, shtetit, shtetësinë e të cilit e ka kryesi i veprës penale, apo që në atë shtet ka vendqëndrim të përhershëm.

Si kusht që duhet të plotësohet për t'u aplikuar parimi i juridiksionit përfaqësues apo cedimi i ndjekjes penale, është që shteti i huaj të ndërmarrë ndjekjen penale dhe që i huaji në vendin tonë të ketë kryer veprë penale (neni 46 i Ligjit për Bashkëpunim Ndërkombëtar në Çështjet Penale. Gjithashtu sipas Kodit Penal si kusht për aplikimin e këtij parimi kërkohet reciprociteti, përkatësisht që edhe shteti, të cilit i besohet ndjekja penale, të veprojë në të njëjtën mënyrë ndaj shtetasve tanë (neni 117, par. 4.). Çështja e reciprocitetit mund të rregullohet me anë të marrëveshjeve bilaterale apo multilaterale, por ai mund të jet edhe faktik.

Juridiksioni përfaqësues nuk do të lejohet në rastet kur i dëmtuari është qytetar i Kosovës dhe ai e kundërshton këtë, përveç rasteve kur është siguruar kërkesa e tij pasurore juridike.

Arsyeshmëria e parimit të juridiksionit përfaqësues në botën bashkëkohore konsiston në faktin se mobiliteti i njerëzve prej një shteti në shtetin tjetër është i madh, andaj edhe krijohen mundësi që të kryhen vepra penale, posaçërisht vepra penale kundër sigurisë në komunikacion. Në anën tjetër, procedura penale dhe ekzekutimi i dënimit, vështruar në aspektin e resocializimit, kanë efekt më të madh në vendbanimin e kryesit të veprës penale.

VEPRA PENALE DHE NOCIONI I VEPRËS PENALE SIPAS KODIT PENAL TË KOSOVËS

Vepra penale, përgjegjësia penale dhe sanksionet penale janë tri institute qendrore, kryesore në të drejtën penale në të cilat ndërtohet e tërë arkitektura e kësaj dege të drejtësis. Në Kapitullin e dytë të Kodit Penal janë të rregulluara dy prej këtyre tri instituteve qendrore – vepra penale dhe përgjegjësia penale.

Në kuadër të këtij kapitulli, së pari është përcaktuar nocioni i përgjithshëm formalo-juridik i veprës penale (neni 7) dhe në vijim në nenin 11 është përcaktuar nocioni juridik material i veprës penale. Pas këtyre nocioneve, janë të parapara dispozita sipas të cilave përjashtohet ekzistimi i veprës penale në rastet e veprës së rëndësisë së vogël (neni 11,

të mbrojtjes së nevojshme (neni 12) të nevojës ekstreme (neni 13) dhe urdhërat nga lart (neni 16).

Vepra penale dhe përgjegjësia penale janë sistemuar në të njejtin kapitull edhe pse janë institute të mvetësishme. Kështu është vepruar ngase në të drejtën tonë penale është përvetësuar koncepti objektiv-subjektiv i veprës penale. Përkatësisht, për t'u konsideruar se ekziston një vepër penale, duhet të plotësohen elementet objektive dhe subjektive.

Duke u mbështetur në konceptin objektiv-subjektiv të veprës penale, me dispozita vijuese është rregulluar çështja e përgjegjësive penale (neni 17), paaftësia mendore dhe aftësia e zvogëluar mendore (neni 18), kryerja e veprës penale në gjendje të dehur (neni 19) dhe lidhja shkakore (neni 20).

Meqë vepra penale dhe përgjegjësia penale janë institute kryesore dhe shumë komplekse, po në këtë kapitull janë rregulluar format e fajit (dashja dhe pakujdesia), përgjegjësia për pasojat më të rënda si dhe lajthimi juridik dhe faktik.

Në kuadër të stadeve, fazave të kryerjes së veprës penale, po në këtë kapitull është rregulluar edhe çështja e tentativës, tentativës së papërshtatshme dhe heqja dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale.

Po në këtë kapitull, në mënyrë të veçantë është e rregulluar çështja e pjesëmarrjes së shumë personave në kryerjen e veprës penale. Si forma të bashkëpunimit, Kodi Penal e njeh bashkëkryerjen, shtytjen, ndihmën, bashkimin kriminal dhe marrëveshjen për të kryer vepër penale. Njëherit me këto dispozita e rregullon edhe çështjen e kufijve të përgjegjësive penale dhe të ndëshkimit për rastet e pjesëmarrjes në kryerjen e veprës penale.

Së fundi, në kuadër të këtij kapitulli gjenden dispozita me të cilat përcaktohet mënyra, koha dhe vendi i kryerjes së veprës penale.

NOCIONI I PËRGJITHSHËM I VEPRËS PENALE

Kjo dispozitë e ligjit nuk e përcakton nocionin e tërësishëm të veprës penale, ngase i përcakton vetëm disa elemente të saj: *veprën, kundërligjshmërinë dhe përcaktueshmërinë*. Elementet e tjera të nocionit të veprës penale derogojnë nga dispozitat e Kodit Penal lidhur me përgjegjësinë penale dhe dënimet dhe sanksionet tjera penale. Rrjedhimisht nga kjo dispozitë dhe dispozitat tjera të Kodit Penal rezultojnë se veprën penale e përbëjnë këto katër elemente themelore: *veprimi, kundërligjshmëria, përcaktueshmëria dhe fasia*. Në sensin e së drejtës penale, për t'u konsideruar një vepër vepër penale, duhet të përmbushen të këto katër elemente në mënyrë kumulative. Mungesa vetëm e njërit nga këto elemente nuk ekziston vepra penale.

Nga përbërja e këtyre katër elementeve themelore të cilat e sajojnë veprën penale, rezultojnë se, ngjashëm me të drejtat penale bashkëkohore të shteteve të tjera, e drejta e jonë penale e përvetëson *nocionin objektiv-subjektiv* të veprës penale.

Vepra penale është veprim, sjellje e njeriut e cila dëmton apo rrezikon vlerat elementare të njeriut, të shoqërisë dhe sistemit juridik. Këtu fjala është për vlerat vitale

nga të cilat varet ekzistenca e individit, e kombit dhe e shoqërisë. Së këndejmi, për t'u konsideruar një vepër si vepër penale, ajo patjetër duhet të arrijë një kuantum të demit apo të rrezikut. Në të kundërtën, nëse shkalla e demit apo rrezikut nuk e arrin kuantumin, vëllimin e caktuar, atëherë mund të bëhet fjalë për kundravajtje apo për ndonjë shkelje tjetër të ligjit.

Në bazë të shkallës së caktuar të demit apo të rrezikut të vlerave shoqërore me rëndësi të posaçme, me legjislacionin penal përcaktohet kufiri dhe sistemi i sanksioneve penale që do të aplikohen ndaj kryerësve të veprave të këtilla. Në këtë mënyrë përcaktohen edhe kufijt e mbrojtjes juridike-penale. Kjo nga fakti se çdo lloj dëmi apo rrezikim i vlerave shoqërore dhe të individëve, nuk mund të konsiderohet vepër penale.

Si element tjetër i përgjithshëm i nocionit të veprës penale është *kundërligjshmëria*, e cila sipas ligjdhënësit trajtohet si element më i rëndësishëm i këtij nocioni. Për t'u konsideruar një vepër penale duhet të jetë e *kundërligjshme*. Lidhur me këtë, nocioni i kundërligjshmërisë duhet kuptuar si kundërligjshmëri formale e cila, në mënyrë indirekte e inkludon, e përfshinë edhe elementin material. Sipas këtij kushti, ligjdhënësi mund t'i përcaktoj si vepra penale vetëm ato vepra, të cilat sipas Kushtetutës, konventave ndërkombëtare dhe sistemit juridik të vendit i dëmtojnë apo i rrezikojnë të mirat juridike të njeriut apo të shoqërisë. Ky kusht i përkufizimit ligjor të veprës penale është mekanizëm i theksuar i parimit të ligjshmërisë, ngase është digë që ligjdhënësi, sipas vlerësimit të tij subjektiv, në mënyrë arbitrare të mos i parashoh si vepra penale çfardo vepra. Kushti i tretë, i cili duhet të përmbushet konsiston në postulatin që vepra jo vetëm të *përcaktohet me ligj* si vepër penale, por njëherit duhet të përcaktohen me ligj edhe tiparet apo elementet constitutive të veprës penale konkrete (parimi i përcaktimit të veprës penale në ligj). Ky parim më për së afërmi i detyron gjykatat dhe organet e tjera shtetërore që ta respektojnë parimin e legalitetit në fushën e së drejtës penale. Gjithashtu ky kusht e obligon edhe ligjdhënësin që me rastin e formulimit të veprave penale që në masën më të madhe që është e mundur t'i përcaktojë saktësisht, në mënyrë sa më të qartë dhe precize figurat e veprave penale.

Meqë është e pamundur që të gjitha veprat penale të parashihen me Kodin Penal, sikundër edhe në shtetet tjera, edhe në Kosovë në rastet e caktuara edhe me ligje tjera parashihen vepra penale. Kështu p.sh. me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje (Nr. 03/L-182), është paraparë vepër penale shkelja e urdhërave mbrojtës e cila është e kanosur me dënim me gjobë deri në 2000 Euro ose me burgim deri në gjashtë muaj (neni 25), ndërsa me Ligjin për administratën tatimore dhe Procedura (Nr. 03/L-222), është paraparë si vepër penale e veçant mos raportimi i veprave në fushën e tatimeve (neni 65).

Kushti i katërt i cili duhet të shprehet në kuadër të nocionit të veprës penale, konsiston në faktin se ligjdhënësi duhet për çdo lloj të veprës penale të parashohë llojin e *sanksionit penal ose llojin e masës së trajtimit të detyrueshëm* i cili mund të shqiptohet. Ky kusht është i domosdoshëm nga se parimi i legalitetit kërkon që ligji nuk duhet t'i përcaktoj vetëm veprat penale dhe tiparet e tyre, por edhe llojin dhe masën e sanksionit penal që mund të shqiptohet. Me këtë kusht mund të parandalohet arbitrariteti i gjykatave me rastin e shqiptimit të llojit dhe lartësisë të sanksionit penal.

2. *Figura e veprës penale.* Me figurë të veprës penale nënkuptohet tërësia e elementeve të posaçme të cilat duhet të shprehen në veprën penale të caktuar. Këto elemente të posaçme të cilat ndryshe quhen edhe tipare e sajojnë veprën penale të posaçme, e sajojnë anatomicisht e saj, e cila e dallon prej veprave tjera penale. Elementet e posaçme të çdo vepre penale janë të cekura në dispozitën e normës penale-juridike. Thënë ndryshe, me figurë të veprës penale duhet nënkuptuar ato elementet e caktuara të cilat duhet të shprehen në veprimin njeriut për t'u konsideruar se është kryer vepra penale.

Figura e veprës penale sajohet duke përcaktuar elementet e posaçme veç e veç dhe duke bërë sintetizimin dhe përgjithësimin e tyre në dispozitën e caktuar penale-juridike. Kështu, p.sh. vepra penale e vjedhjes (neni 325), përbëhet prej këtyre elementeve të posaçme: marrjes; pasurisë së huaj të luajtshme dhe me qëllim që me përvetësimin e saj t'i sjellë vetes ose tjetrit fitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme. Vepra penale e marrjes së ryshfetit (neni 428) posedon këto elemente të posaçme: personi zyrtar; që kërkon, ose merr dhuratë ose ndonjë përfitim, ose që pranon premtimin e dhuratës; me qëllim që në kuadër të autorizimeve të tij zyrtare të kryejë veprimin zyrtar që nuk duhet ta kryej ose që të mos e kryej veprimin zyrtar që duhet ta kryejë.

Elementet e posaçme të figurës së veprës penale konkrete mund t'i referohen kohës apo vendit të kryerjes, mënyrës apo mjetit me të cilat kryhet vepra penale, vetive personale të kryerësit, motivit, marrëdhënies midis kryerësit dhe viktimës etj.

Elementet e posaçme të veprës penale ndahen në elemente *objektive* dhe *subjektive*.

Elemente objektive të figurës së veprës penale të caktuar janë p.sh. veprimi apo mosveprimi, pasoja, mjeti dhe mënyra e kryerjes, koha apo vendi i kryerjes, marrëdhënia e kryerësit me viktimën, statusi i kryerësit, profesioni etj.

Elemente subjektive të figurës së veprës penale janë p.sh. format e ndryshme të dashjes dhe pakujdesisë, lajthimi, motive, qëllimi, pëlqimi etj.

Më tutje elementet e figurës së veprës penale të caktuar ndahen në *themelore* dhe *plotësuese*. Elementet themelore e përbëjnë formën themelore të veprës penale, ndërsa elementet plotësuese e përbëjnë formën e kualifikaur apo të privilegjuar. Për shembull, formën themelore të vrasjes e përbën vetëm privimi i personit tjetër nga jeta, ndërsa formën e kualifikuar të vrasjes e përbëjnë mënyra mizore, dinakëria, urrejtja nacionale etj, ndërsa formën e privilegjuar të vrasjes e përbëjnë vrasja nga pakujdesia, në afekt etj.

3. *Objekti i veprës penale.* Të mirat juridike apo vlerat që janë të mbrojtuta me të drejtën penale janë objekt i veprës penale. Thënë ndryshe, objekt i veprës penale është e mira juridike kundër së cilës është e drejtuar vepra penale. Nocioni i figurës së veprës penale plotësohet me njohuritë që i përkasin objektit të veprës penale, ngase vetëm kur përcaktohet saktësisht objekti i veprës penale dhe të konstatohet se çka mbrohet me një dispozitë penale-juridike, atëherë bëhet i qartë kuptimi i asaj dispozite apo vepre penale. Andaj përcaktimi i objektit të veprës penale është pikënisje për çdo shpjegim, interpretim të normës së ligjit penal në të cilin parashihet vepra penale.

Objekt të veprës penale janë të mirat apo vlerat vitale të njeriut, të popullit të një vendi dhe të komunitetit ndërkombëtar. Këto janë jeta e njeriut, integriteti i tij trupor, liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit, siguria, paqja, barazia, prona, rregullimi shoqëroro-politik dhe siguria e vendit, martesë, familja, mjedisi, ekonomia, siguria e vendit etj. Për shkak të rëndësisë së madhe për qytetarët dhe shoqërinë, këto dhe vlerat e ngjashme janë të mbrojtura me të drejtën penale nacionale dhe me të drejtën penale ndërkombëtare.

Në të drejtën penale njihen dy lloje të objektit të veprës penale: *objekti i përgjithshëm* dhe *objekti grupor*.

Objekti i përgjithshëm i veprës penale, marrë në tërësi, është njeriu dhe bashkësia shoqërore. Përkatësisht, qytetari dhe sistemi kushtetues juridik si dhe siguria e vendit sipas legjislacionit tonë janë objekt i përgjithshëm i veprës penale. Gjithashtu sipas legjislacionit tonë penal, objekt i përgjithshëm i veprës penale janë edhe vlerat juridike ndërkombëtare, mbarë njerëzore. Së këndejmi, objekti i përgjithshëm është një lloj sinteze i të gjitha objekteve grupore dhe individuale të veprave penale. Me fjalë të tjera, tërësia e të gjitha të mirave juridike që janë të mbrojtura me të drejtën penale, paraqesin objekt të përgjithshëm të veprave penale.

Objekti grupor i veprës penale është konkretizim i objektit të përgjithshëm të veprave penale. Objekt grupor janë ato vlera të cilat janë të përbashkëta për grupin e caktuar të veprave penale. Kështu, p.sh. objekt grupor i veprave penale është jeta dhe trupi i njeriut, pasuria, rregullimi kushtetues- juridik dhe siguria e vendit etj.

Të gjitha llojet e veprave penale që janë të parapara në legjislacionin tonë penal, varësisht se cili objekt mbrohet nga to dhe varësisht nga afërsia dhe ngjashmëria e tyre, janë radhitur në grupe të cilat paraqesin kapituj të veprave penale. Së këndejmi, kapitujt e veprave penale që parashihen në legjislacionin tonë penal, në fakt paraqesin objekt grupor të veprave penale. Sistemi i objekteve grupore të veprave penale në pjesën e posaçme të Kodit Penal, është bërë varësisht prej shkallës së rrezikshmërisë dhe vlerës së objektit apo të mirës juridike që mbrohet nga veprat penale.

Objekti i veprimit është personin apo vlera tjetër juridike ndaj të cilit është ndërmarrë veprimi i kryerjes, me ç'rast dëmtohet apo rrezikohet objekti që mbrohet nga e drejta penale. Çdo vepër penale është e drejtuar ndaj të mirës së caktuar juridike. E mira apo vlera juridike ndaj së cilës është e drejtuar vepra penale paraqet objektin e veprimit. Kështu, p.sh. te vepra penale e vrasjes objekt i veprimit është njeriu konkret – jeta e tij, te vepra e spiunazhit, objekt i veprimit janë të dhënat sekrete ushtarake, ekonomike apo zyrtare; te vjedhja- objekt i veprimit është sendi i huaj i tundshëm, etj. Në të shumtën e herave objekti i veprimit paraqet element të figurës së veprës penale.

4.Subjekti i veprës penale. Personi që kryen vepër penale quhet subjekt i veprës penale. Përveç atyre që ndërmarrin drejtpërdrejt veprimin e kryerjes, subjekt të veprës penale konsiderohen edhe shtytësit, ndihmësit dhe organizatorët e shoqatës kriminale. Këta konsiderohen subjekt të këtillë ngase kontribuojnë në kryerjen e veprës penale.

Lidhur me moshën, subjekt të veprës penale konsiderohen vetëm personat që kanë mbushur moshën 14-vjeçare. Personat nën moshën 14- vjeçare, në të drejtën penale

konsiderohen fëmijë, këta janë penalisht të papërgjegjshëm dhe si të tillë gjenden jashtë sferës së të drejtës penale (neni 17, par. 3). Kjo kategori e personave nuk mund të merret në përgjegjësi penale, pa marrë parasysh se çfarë vepre penale kanë kryer.

Mënyra e kryerjes së veprës penale

Në shkencën e së drejtës penale, posaçërisht në doktrinën gjermane, i kushtohet rëndësi e madhe përcaktimit të nocionit të veprimit. Kjo është e kuptueshme nga fakti se veprimi apo sjellja e caktuar e njeriut është një ndër elementet themelore, konstitutive të çdo vepre penale, ngase pa veprim vepra penale nuk kryhet, nuk ekziston (*nullum crimen sine actione*). Veprimi është kushti thelbësor dhe themel i çdo vepre penale, ai është bosht i çdo vepre penale, ndërsa elementet tjera janë vetëm attribute të tij i cili i bashkon në një tërësi unike. Veprimi konsiderohet i këtillë ngase brendia e veprës penale konsiston në sjelljen e njeriut e jo vetit e t'ia personale.

Veprimi si element konstitutiv shprehet te veprat penale që kryhen me veprim dhe mosveprim, te veprat penale të kryera me dashje dhe nga pakujdesia, te tentativa apo vepra penale e kryer, te format e ndryshme të bashkëpunimit në kryerjen e veprës penale etj.

Me termin veprim, në të drejtën penale nënkuptojmë të gjitha *sjelljet* apo *veprimet* e njeriut që manifestohen në botën e jashtme dhe të cilat janë të përcaktuara me ligj si vepra penale. Veprimet që ngjajnë në psikën dhe vullnetin e brendshëm të njeriut, siç janë mendimi, dëshira, vendimi dhe qëllimi për të kryer vepër penale, nuk mund të konsiderohen veprime në kuptimin penalo-juridik dhe nuk mund të ndëshkohen po qe se ato nuk manifestohen në botën e jashtme.

Krahas kësaj, për t'u konsideruar një veprim revelant në të drejtën penale, ai duhet të jetë i *vullnetshëm*. I vullnetshëm konsiderohet ai veprim i cili është ndërmarrë dhe dirigjuar nga ana e personit të vetëdijshëm dhe në bazë të vullnetit të lirë. Edhe *mosveprimi* si mënyrë e kryerjes së veprës penale duhet të jetë i vullnetshëm. Së këndejmi vullneti konsiderohet si pjesë përbërëse e veprimit apo mosveprimit.

Veprat penale të kryera me veprim. Shumica e veprave penale kryhen me veprim. Në kuptimin penalo-juridik, veprimi është lëvizje trupore e vullnetshme e njeriut me të cilin kryhet vepra penale (p.sh. shkrepija me armë te vepra penale e vrasjes, marrja e sendit të huaj te vepra penale e vjedhjes etj.). Me anë të veprave penale të kryera me veprim, apo siç quhen ndryshe, *delikte komisive*, **cenohen normat penalo-juridike, të cilat e ndalojnë veprimin e caktuar. Këto norma ndryshe quhen norma prohibitive. Së këndejmi, me rastin e kryerjes së veprave penale me veprim, personi vepron në kundërshtim me normën që e ndalon veprimin e caktuar (p.sh. te vepra penale e vrasjes, cenohet norma e cila ndalon privimin e ndonjë personi nga jeta, te vepra penale e gjaktrazimit apo incestit, cenohet norma e cila ndalon marrëdhënien seksuale me personin që është në gjini gjaku në vijën e drejtë ose me vëllanë apo me motrën).**

Veprat penale të kryera me mosveprim. Veprat penale me mosveprim, apo siç quhen ndryshe deliktet omisive, kryhen me mosndërmarrjen apo abstenimin nga veprimi

që ka qenë i detyruar, i obliguar ta ndërmarrë. Përkufizimi i këtillë i delikteve omisive është përcaktuar në paragrafin 2. Kjo mënyrë e kryerjes së veprës penale shprehet si qëndrim pasiv i njeriut në rrethanat e caktuara, për shkak të cilit qëndrim shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme. Si vepër penale e kryer me mosveprim është p.sh. mosdhënia e ndihmës mjekësore (neni 261).

Koha e kryerjes së veprës penale

Zakonisht menjëherë pas ndërmarrjes së veprimit shkaktohet pasoja e veprës penale. Në këso raste, në të drejtën penale nuk paraqitet kurrfarë problemi lidhur me përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale, ngase përputhen koha e ndërmarrjes së veprimit dhe koha e shkaktuarjes së pasojës. Mirëpo, në paraktikë ndodh që veprimi të ndërmerret në një kohë, kurse pasoja të shkaktohet në kohën tjetër, më vonë. Për shembull, personi A. me qëllim që ta privojë nga jeta personin B. shkrep armën në të dhe e plagos rëndë dhe, përkundër përpjekjeve të mjekëve, personi B. vdes në spital pas një muaji. Në këtë rast dhe në rastet e këtilla të ngjashme shtrohet pyetja, a do të konsiderohet kohë e kryerjes së veprës penale koha kur është ndërmarrë veprimi i kryerjes, apo koha kur është shkaktuar pasoja.

Me rastin e zgjidhjes së çështjes se cila kohë konsiderohet kohë e kryerjes së veprës penale, në të drejtën penale nuk është e mundur të veprohet sikurse me rastin e përcaktimit të vendit të kryerjes së veprës penale. Këtu është e domosdoshme të konsiderohet kohë e kryerjes së veprës penale ose momenti kur është ndërmarrë veprimi i kryerjes, ose momenti kur është shkaktuar pasoja. Në të kundërtën, shkaktohen vështirësi të pakapërcyeshme me rastin e aplikimit të institucioneve të së drejtës penale.

Lidhur me përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale, në shkencën e së drejtës penale dhe në Kodin tonë Penal, sikundër në shumicën e legjislacioneve penale të shteteve tjera, është përvetësuar teoria e veprimit (*tempus commissi delcti*). Kështu, sipas nenit 9, vepra penale konsiderohet se është kryer në kohën kur personi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë, pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja. Me këtë dispozitë është zgjidhur një çështje shumë e rëndësishme praktike dhe në këtë mënyrë janë evituar dilemat e ndryshme lidhur me përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale. Nga kjo dispozitë del qartë se koha e kryerjes së veprës penale konsiderohet momenti kur personi ka vepruar, kurse te veprat penale të kryera me mosveprim, kur personi nuk e ka ndërmarrë veprimin të cilin ka qenë i detyruar ta ndërmarrë, ndërsa koha kur është shkaktuar pasoja është *irrelevante* për të drejtën penale.

Vendi i kryerjes së veprës penale

Përcaktimi i vendit të kryerjes së veprës penale është me rëndësi për këto shkaqe: 1) sipas vendit të kryerjes së veprës penale përcaktohet kompetenca territoriale e gjykatave, 2) te disa vepra penale, vendi i kryerjes së veprës penale konsiderohet element konstitutiv dhe 3) në disa raste, në aspektin e së drejtës penale ndërkombëtare,

është me rëndësi përcaktimi i vendit të kryerjes së veprës penale, kur veprimi i kryerjes është ndërmarrë në një shtet, kurse pasoja është shkaktuar në shtetin tjetër.

Në të shumtën e herave pasoja e veprës penale shkaktohet në vendin ku është ndërmarrë veprimi i kryerjes. Në këso raste nuk ka dilema, ngase si vend i kryerjes konsiderohet vendi ku është ndërmarrë veprimi dhe ku është shkaktuar pasoja. Mirëpo, në disa raste veprimi i kryerjes ndërmerret në një vend, kurse pasoja shkaktohet në vendin tjetër. Për shembull, personi A. e venë bombën në autobus që është nisë nga Peja e cila shpërthen në Prishtinë. Në këtë shembull veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është ndërmarrë në Pejë, kurse pasoja është shkaktuar në Prishtinë. Këto janë të ashtuquajturat *vepra penale distancionale*. Pikërisht te veprat penale distancionale, shtrohet pyetja cili vend konsiderohet vend i kryerjes së veprës penale, vendi ku është ndërmarrë veprimi i kryerjes apo vendi ku është shkaktuar pasoja.

Në rastet kur është fjala për *veprat penale të vazhduara, kolektive apo permanente*, si dhe çdo lloj tjetër i veprave penale që kryhen në vende të ndryshme, vend i kryerjes së veprës penale konsiderohet secili vend ku është ndërmarrë ndonjë veprim që bën pjesë në figurën e veprave të këtilla.

Në rastet kur është fjala për *veprat penale të vazhduara, kolektive apo permanente*, si dhe çdo lloj tjetër i veprave penale që kryhen në vende të ndryshme, vend i kryerjes së veprës penale konsiderohet secili vend ku është ndërmarrë ndonjë veprim që bën pjesë në figurën e veprave të këtilla.

PËRJASHTIMI I KUNDËRLIGJSHMËRISË

Vepra e rëndësisë së vogël

Instituti veprës së rëndësisë së vogël është institut i natyrës materiale i së drejtës penale. Shkalla e rrezikshmërisë apo e pasojës së dëmshme, si element material, në formën e vet të qartë shprehet me rastin e kryerjes së çdo vepre penale konkrete. Kësisoj mund të ndodhin raste që ndonjë person të kryejë një vepër e cila i ka të gjitha tiparet e veprës penale të përcaktuar me ligjin penal, mirëpo, për shkak se vepra posedon një vëllim (kuantitet-sasi) tejet të vogël të pasojës së dëmshme apo të rrezikshmërisë, ajo nuk konsiderohet si vepër penale. Rast i tillë shkollorë është p.sh. kur personi A. vjedh në vetëshërbim një qese bonbone apo një çokollatë. Në veprimin e personit A. janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes, mirëpo, meqë shkalla e rrezikshmërisë së kësaj vepre është e parëndësishme, tejet e imët, kjo vepër nuk konsiderohet si vepër penale, ngase kjo, apo veprat e ngjashme, e humbin karakterin kriminal dhe si të tilla dalin jashtë sferës së të drejtës penale.

Instituti i veprës së rëndësisë së vogël është paraparë për rastet e lehta të veprave penale të cilat jo rrallë kryhen në jetën e përditshme. Përkatësisht ky institut duhet të aplikohet për rastet e veprave penale të lehta siç janë p.sh. dëmtimi i pasurisë, vjedhjes, mashtrimit, fshehjes, të lëndimeve të lehta trupore, kanosjes, privimit të

kundërligjshëm të lirisë që zgjatë shumë shkurtë (një apo dy orë) etj. Veprat e këtilla e humbasin karakterin kriminal për shkak të rëndësisë së vogël, të parëndësishme të kundërligjshmërisë dhe fajësisë. Nga kjo del qartë se për të drejtën penale nuk është relevante çdo lloj i realizimit të figurës ligjore të veprës penale, çdo lloj i rrezikimit apo i dëmtimit të të mirës juridike. Përkundrazi, në të drejtën penale, si vepra penale konsiderohen ato vepra të cilat përmbajnë në vete një vëllim apo intensitet të caktuar të rrezikimit, apo të dëmtimit të të mirës juridike, që është e mbrojtur me të drejtën penale.

Nga e tërë dispozita e këtij neni, rezulton se që të mund të aplikohet në praktikë ky institut duhet të përmbushen dy kritere: *kriteri objektiv* dhe *kriteri subjektiv*.

Kriteri objektiv. Sipas dispozitës së nenit 11, rrezikshmëria e parëndësishme apo e vogël, si kriter objektiv, mund të konsiderohet në bazë të tri kushteve dhe atë: **a)** natyrës ose peshës së veprës; **b)** pasoja e dëmshme të jetë e parëndësishme ose të mungojë dhe **c)** rrethanat në të cilat është kryer vepra.

3. Kriteri subjektiv. Sipas kriterit subjektiv që të mund të konsiderohet një vepër e rëndësisë së vogël duhet të manifestohet **a)** *shkallë e ulët e përgjegjësisë penale të kryerësit* apo **b)** *rrethana personale të kryerësit*.

MBROJTJA E NEVOJSHME

Mbrojtja e nevojshme si e drejtë në vetëmbrojtje ka qenë e njohur qysh në të drejtën romake dhe në të drejtën e mesjetës. Ky institut i përgjithshëm sipas të cilit përjashtohet ekzistimi i veprës penale, në të drejtën romake dhe në mesjetë është shprehë dhe arsyetuar me sintagëmën *është e lejuar që dhuna të zbrapset me dhunë, por vetëm të jetë brenda kufijve të mbrojtjes së nevojshme dhe nuk guxon që t'i shërbej hakmarrjes*. Ciceroni, mbrojtjen e nevojshme e konsideronte si parim të së drejtës natyrore. Sipas tij, arsyeshmëria e mbrojtjes së nevojshme konsiston në natyrën e njeriut në vetëmbrojtje, përkatësisht në mbrojtjen e ekzistencës së njeriut. Edhe e drejta zakonore shqiptare e njëj mbrojtjen e nevojshme si bazë për përjashtimin e veprës penale.

Nga nocioni i mbrojtjes së nevojshme del se për t'u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme duhet të shprehet a) *sulmi* dhe b) *mbrojtja*. Sulmi dhe mbrojtja njëherit janë dy elemente kryesore të mbrojtjes së nevojshme, të cilat duhet t'i përmbushin kushtet e caktuara. Përndryshe, siç do të shohim në vazhdim, nëse këto dy elemente kryesore nuk shprehen në kushtet dhe sipas rregullave të caktuara me ligj, nuk mund të bëhet fjalë për ekzistimin e mbrojtjes së nevojshme.

Sulmi është çdo veprim i njeriut i cili është i drejtuar në dëmtimin apo rrezikimin e ndonjë të mire juridike. Zakonisht sulmi mund të kryhet vetëm me veprim. Mirëpo, përjashtimisht sulmi mund të kryhet edhe me mosveprim. Për shembull, mjeku i ndihmës së shpejtë refuzon t'i japë ndihmën mjekësore personit që gjendet në gjendje rreziku për jetë. Në raste të tillë, çdo person mund ta detyrojë mjekun që ta kryejë detyrën e vet.

1. Sulmues duhet të jetë njeriu. Për të ekzistuar mbrojtja e nevojshme, sulmi duhet të ndërmerret nga njeriu. Disa teoricienë janë të mendimit se sulmi mund të vijë edhe nga shtazët, egërsirat apo fuqitë mbinatyrore. Në të drejtën tonë penale, në rastet kur sulmi vjen nga shtazët, egërsirat apo fuqitë mbinatyrore, konsiderohet se ekziston nevoja ekstreme. Përndryshe, sulmi mund të ndërmerret nga çdo person, nga personi madhor, nga i mituri, nga fëmija apo personi i sëmurë psikik. Sulmi mund të ndërmerret me qëllim, nga pakujdesia, apo rastësisht. Në të gjitha këto raste është e lejuar mbrojtja e nevojshme. Gjithashtu mbrojtja e nevojshme është e lejuar edhe ndaj sulmit që ndërmerret nga personi i cili gëzon imunitet.

2. Sulmi mund të jetë i drejtuar kundër çdo të mire. Kodi ynë Penal nuk i cek të mirat juridike të cilat mund të jenë objekt i sulmit, por flet në përgjithësi për zmbarsjen e sulmit prej vetes apo tjetrit. Nga kjo rezulton se sulmi mund të jetë i drejtuar jo vetëm ndaj të mirave juridike që janë të mbrojtura me të drejtën penale, por edhe ndaj të mirave juridike që mbrohen edhe me degë të tjera të drejtësisë. Kësisoj, sulmi mund të jetë i drejtuar ndaj të mirave juridike që i përkasin personave fizikë, personave juridikë, sigurisë apo integritetit territorial të Kosovës etj. Mirëpo në jetën e përditshme më së shpeshti sulmohet jeta e njeriut, integriteti trupor dhe pasuria.

3. Sulmi duhet të jetë i kundërligjshëm. Sulmi është i kundërligjshëm kur është në kundërshtim me ndonjë normë juridike. Përkatësisht, sulmi është i kundërligjshëm kur sulmuesi nuk ka kurrfarë autorizimesh juridike për veprimet e veta, kur veprimet e veta e cenojnë sistemin juridik.

4. Sulmi duhet të jetë i atëçastshëm (aktual). Në kuptimin e mbrojtjes së nevojshme, sulmi konsiderohet i atëçastshëm në rastet kur në çdo moment pritet se do të fillojë, kur ka filluar të veprojë dhe gjersa të zgjasë, përkatësisht gjer të përfundojë. Së këndejmi del se nuk është e lejuar mbrojtja ndaj ndonjë sulmi që do të pasojë pas një kohe si dhe mbrojtja ndaj sulmit i cili ka përfunduar, ka pushuar së vepruari.

5. Sulmi duhet të jetë i vërtetë. Për t'u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme, sulmi duhet të jetë i vërtetë, që të ekzistojë realisht. Nëse ndokush gabimisht mendon se është i sulmuar dhe duke qenë në lajthitje e lëndon apo e privon nga jeta "sulmuesin", atëherë në këso raste është fjala për mbrojtjen e nevojshme fiktive, të kujtuar, apo siç quhet ndryshe në të drejtën penale, **mbrojtja e nevojshme putative**. Për shembull, nëse personi A. me qëllim që të tallet me personin B. në errësi të sulmon këtë me revole fëmijësh, kurse personi B. duke menduar se sulmi është i vërtetë e vret "sulmuesin" - personin A. Në këso rastesh nuk ekziston mbrojtja e nevojshme, ngase siç shohim, sulmi nuk është i vërtetë. Së këndejmi veprimet e ndërmarrura në situata të këtilla janë të kundërligjshme dhe konsiderohen veprë penale.

Mbrojtja e nevojshme putative nuk e përjashton ekzistimin e veprës penale, mirëpo mund të jetë bazë apo rrethanë që e përjashton fajësinë, e me këtë edhe ndëshkimin. Përkatësisht, te mbrojtja e nevojshme putative është fjala për veprën që është kryer në lajthim në fakt (real), andaj përgjegjësia penale zgjidhet në bazë të nenit 25 të Kodit Penal.

KUSHTET TË CILAT DUHET TË PËRMBUSHEN ME RASTIN E MBROJTJES (ZMBRAPSJES SË SULMIT)

Mbrojtja është çdo veprim i njeriut me të cilin dëmtohet apo rrezikohet ndonjë e mirë e sulmuesit. Zakonisht, me rastin e mbrojtjes sulmi zbrapset prej vetes apo prej të mirave juridike vetjake. Mirëpo, siç pamë nga përkufizimi i këtij institucioni, mbrojtja e nevojshme ekziston edhe në rastet kur sulmi zbrapset edhe nga personi i tretë. Për shembull, nëse personi A. e sulmon personin B., kurse personi C. me qëllim që ta zbraps këtë sulm, e dëmton apo e rrezikon ndonjë të mirë juridike të personit A. Në teorinë e së drejtës penale mbrojtja e nevojshme e këtitllë emërtohet edhe *si ndihmë e nevojshme* apo *e domosdoshme*. Në këso raste nuk është me rëndësi se a ka qenë personi i sulmuar ndonjë i afërt me personin i cili e mbron.

1. *Mbrojtja duhet të jetë e drejtuar kundër sulmuesit.* Për t' u konsideruar se ekziston mbrojtja e nevojshme, veprimet e mbrojtjes duhet të jenë të drejtuara kundër sulmuesit, kundër asaj të mirë juridike të sulmuesit, e cila është e nevojshme për zbrapsjen e sulmit (p.sh. kundër trupit, jetës, pasurisë etj.). Në rastet kur gjatë mbrojtjes është dëmtuar e mira juridike e personit të tretë, atëherë nuk ekziston mbrojtja e nevojshme, por eventualisht mund të shprehet nevoja ekstreme. Mirëpo, nëse sulmuesi si mjet për sulm përdor mjetet e personit të tretë, atëherë i sulmuari gjatë mbrojtjes ka të drejtë që t' i dëmtojë apo asgjësojë edhe këto të mira juridike (mjetet e personit të tretë).

2. *Mbrojtja duhet të jetë domosdo e nevojshme për zbrapsjen e sulmit.* Për t' u konsideruar një mbrojtje si mbrojtje e nevojshme ajo duhet të jetë domosdo e nevojshme që personi prej vetes apo tjetrit të zbraps sulmin. Rrjedhimisht, një mbrojtje konsiderohet e nevojshme në rastet kur konstatohet se nuk ka mundur të zbrapset sulmi pa iu shkaktuar ndonjë dëmtim sulmuesit. Se a ka qenë mbrojtja domosdo e nevojshme, është çështje faktike të cilën gjykata e konstaton në çdo rast konkret. Për shembull, nëse një fëmijë i moshës 12- vjeçare e sulmon me shkop një person të rritur dhe fizikisht të zhvilluar, i sulmuari nuk mund të arsyetohet se ka vepruar në mbrojtje të nevojshme nëse me rastin e zbrapsjes së sulmit fëmijës i ka shkaktuar plagë të rënda apo e ka privuar nga jeta. Mbrojtja e këtitllë në këtë rast nuk ka qenë domosdo e nevojshme, sepse personi i rritur sulmin e fëmijës ka mundur ta zbraps edhe pa shkaktuar plagosje apo vrasje.

3. *Mbrojtja duhet të jetë proporcionale me intensitetin e sulmit.* Ky kusht duhet të vlerësohet në kontekstin e domosdoshmërisë së mbrojtjes. Për të qenë mbrojtja domosdo e nevojshme, ajo duhet të ekzistojë në proporcionalitet (përpjesëtuueshmëri) midis intensitetit të sulmit dhe mbrojtjes. Parimi i proporcionalitetit është parim i përgjithshëm i drejtësisë i cili vlen jo vetëm në situatat konflikte, siç është rasti me mbrojtjen e nevojshme, por vlen edhe për organet shtetërore gjatë ushtrimit të funksioneve të mbrojtjes së të mirave juridike.

Tejkalimi i mbrojtjes së nevojshme

Tejkalimi apo kapërcimi i mbrojtjes së nevojshme shprehet në rastet kur mbrojtja nuk është proporcionale me sulmin apo kur mbrojtja ndërmerret pasi që është zbrapsur ose ka pushuar së vepruari sulmi. Se kur nuk është mbrojtja proporcionale me intensitetin e sulmit, pamë në shembujt e cekur kur personi i kopshtit vret fëmijën e zënë në vjedhjen e qershive etj. Kurse konsiderohet se mbrojtja është ndërmarrë pasi që sulmi është zbrapsur (zotëruar) në rastin kur p.sh. i sulmuari ka sukses që t'ia thyejë dorën dhe t'ia marrë thikën sulmuesit, e mandej po me atë thikë i shkakton plagë vdekjeprurëse. Ndërsa sulmi ka pushuar së vepruari kur p.sh. sulmuesi pasi që i shkakton disa të qëlluara të sulmuarit e ndërpreu veprimin dhe fillon të tërhiqet, kurse i sulmuari vrapon në drejtim të tij dhe i shkakton plagë të rënda apo e privon nga jeta, e vret. Lidhur me situatat e këtilla, në paragrafin 3 të nenit 12 të Kodit Penal parashihet: “Disproporcioni ndërmjet sulmit dhe zbrapsjes së sulmit konsiderohet tejkalim i kufijve të mbrojtjes së nevojshme”. Në të gjitha rastet kur i sulmuari i kapërcen, i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme, çdo dëmtim që i shkakton sulmuesit konsiderohet veprë penale dhe personi i këtillë përgjigjet penalisht sikur për çdo veprë tjetër penale.

NEVOJA EKSTREME

Nevoja ekstreme është rrethanë apo shkak i tretë që e përjashton kundërligjshmërinë e veprës, edhe pse vepra e kryer përmban të gjitha tiparet e veprës penale. Në krahasim me mbrojtjen e nevojshme, nevoja ekstreme është institut më i ri në të drejtën penale. Nevoja ekstreme, për nga natyra dhe efekti i saj juridiko-penal, është shkak i përgjithshëm që përjashton kundërligjshmërinë, përkatësisht ekzistimin e veprës penale.

Nevojën ekstreme në të drejtën penale e arsyetojnë rastet nga jeta e përditshme. Rjedhimisht, në bashkëndodhje të rrethanave të ndryshme, mund të krijohen aso gjendje (situata) të rrezikshme, të cilat mund të mënjanojnë vetëm me dëmtimin apo asgjësimin e të mirave juridike të personave të tretë. Për shembull: personi A. me qëllim që ta shpëtojë jetën e fëmijës, depërton me dhunë në shtëpinë e personit B. të cilën e ka kapluar zjarri; duke ikur personi nga salla e kinemasë së ndezur e lëndon personin tjetër; personi A. e merr barkën e huaj me qëllim që ta shpëtojë jetën e fëmijës që është duke u fundosur në ujë; shoferi i cili me shpejtësi të lejuar dhe me kujdes të duhur, me qëllim që ta shpëtojë jetën e fëmijës, i cili papritmas i del para automobilit, del në trotuar me ç'rast lëndon këmbësorin.

Sikundër te mbrojtja e nevojshme, shkencëtarët e së drejtës penale pajtohen se edhe për veprën e kryer në nevojën ekstreme personi nuk duhet dënuar.

Kodi Penal nuk cek bazat dhe arsyet për shkak të të cilave përjashtohet ekzistimi i veprës penale me rastin e nevojës ekstreme, por vetëm konstaton se nuk është veprë penale ajo veprë që është kryer në nevojën ekstreme (neni 13, par. 1). Mirëpo, edhe pse Kodi Penal nuk i cek shkaqet e përjashtimit të ekzistimit të veprës penale, teoria dhe praktika pajtohen se vepra e kryer në nevojën ekstreme nuk është veprë e rrezikshme

dhe as e kundërligjshme, andaj për shkak të mungesës së këtyre elementeve nuk mund të bëhet fjalë as për vepër penale.

Nga përkufizimi i nevojës ekstreme, që është përcaktuar me Kodin penal, del se për ekzistimin e këtij institucioni duhet të shprehet **a) rreziku** dhe **b) mënjanimi i rrezikut**.

a) Rreziku. Si parakusht për ekzistimin e nevojës ekstreme është ekzistimi i rrezikut. Rreziku zakonisht përkufizohet si situatë në të cilën, në bazë të rrethanave ekzistuese objektive, me arsye supozohet se në çdo moment, aty për aty, mund të dëmtohet e mira juridike e personit fizik apo juridik. Përkatësisht, rreziku përkufizohet si gjendje e cila aty për aty dhe drejtpërdrejt mund ta dëmtojë apo ta asgjësojë të mirën juridike

Rreziku nuk duhet të jetë i provokuar apo i shkaktuar. Nuk mund të konsiderohet se personi i cili ka vepruar në nevojën ekstreme nëse me fajin e tij, me dashje apo nga pakujdesia, e ka shkaktuar rrezikun. Për shembull, nëse personi A. me dashje apo nga pakujdesia e shkaktonte zjarrin dhe duke u gjendur edhe vetë në rrezik, për ta shpëtuar veten e lëndonte tjetrin; ose nëse personi A. në vendin e banuar vozit me shpejtësi të madhe me ç'rast papritmas i del në rrugë fëmija, nuk mund të thirret në nevojën ekstreme nëse për ta shpëtuar fëmijën, del në trotuar dhe me atë rast u shkaktonte lëndime të rënda disa këmbësorëve. Gjithashtu nuk konsiderohet se vepron në nevojën ekstreme shoferi i cili e di se automjetin nuk e ka në rregull - nuk i punojnë frenat dhe për t'i ikur ndeshjes, ngase nuk mund të frenojë, del në anën e kundërt të rrugës dhe këmbësorit të rastit i shkaktonte plagë të rënda apo vdekjen.

2. *Rreziku mund t'i kanoset çdo të mirë juridike.* Sikundër edhe te mbrojtja e nevojshme, edhe te nevoja ekstreme Kodi Penal nuk përmban asnjë kufizim lidhur me të mirat juridike që mund të rrezikohen. Së këndejmi, parimisht rreziku mund t'i kanoset çdo të mirë juridike që është e mbrojtur me sistemin juridik, mirëpo në praktikë rreziku më së shpeshti është i drejtuar kundër jetës, trupit, shëndetit, lirisë dhe pasurisë.

3. *Rreziku duhet të jetë i vërtetë.* Rreziku konsiderohet se është i vërtetë në rastet kur ai realisht ekziston, është objektiv. Rreziku është i vërtetë apo real kur ka filluar të veprojë apo në çdo moment pritet të veprojë. Nëse personi gabimisht mendon se ekziston rreziku për ndonjë të mirë të tij apo të ndonjë personi tjetër, atëherë është fjala për të ashtuquajturën **nevojë ekstreme putative**, apo nevojë ekstreme fiktive, të kujtuar.

b) Mënjanimi i rrezikut. Mënjanimi i rrezikut konsiderohet veprimi që ndërmerret me qëllim që të shpëtohet e mira juridike së cilës i kanoset rreziku. Kjo është në fakt komponentja e dytë e nevojës ekstreme e cila konsiston në evitimin e situatës apo gjendjes së rrezikshme.

Kushtet që duhet përmbushur me rastin e mënjanimit të rrezikut

1) *Të mos ketë ekzistuar mundësia që rreziku të mënjanohet në ndonjë mënyrë tjetër.* Ndryshe nga mbrojtja e nevojshme ku, siç pamë, nuk kërkohet që të ketë ekzistuar ndonjë mundësi tjetër që sulmi të zbrapset, për t'u konsideruar se ekziston nevoja ekstreme duhet të konstatohet se në rastin konkret rreziku nuk ka mundur të mënjanohet pa u dëmtuar apo asgjësuar e mira juridike e personit tjetër. Përndryshe, nëse në rastin konkret konstatohet se rreziku ka mundur të mënjanohet në ndonjë mënyrë tjetër, p.sh. duke ikur, duke thirrur në ndihmë, duke i skajuar sendet, duke e organizuar mbrojtjen etj., kurse personi nuk i ka shfrytëzuar këto mundësi, por rrezikun e ka mënjanuar duke e dëmtuar të mirën juridike të personit tjetër, nuk do të ekzistojë nevoja ekstreme.

2) *Mënjanimi i rrezikut duhet të jetë i atëçastshëm, aktual me ekzistimin e rrezikut.* Një ndër kushtet e nevojës ekstreme është edhe atëçastshmëria e mënjanimit të rrezikut dhe ekzistimit të rrezikut. Konsiderohet se është përmbushur ky kusht në rastet kur veprimi me të cilin mënjanohet rreziku është ndërmarrë gjatë kohës kur vepron rreziku ose kur pritet, kanoset që rreziku të fillojë (të paraqitet) në çdo moment. Atëçastshmëria e rrezikut dhe e mënjanimit të rrezikut do të thotë që të veprohet me kohë, në mënyrë që mbrojtja të mos jetë e vonë dhe pa efekte.

Rreziku duhet të jetë aktual, i pranishëm, akut apo rrezik ky i cili në çdo moment mund të dëmtoj apo asgjësoj të mirën juridike. Thënë ndryshe, rreziku duhet të jetë i tillë që aty për aty kërkon kundërveprim në mënyrë që mbrojtja të mos bëhet me vonesë.

3) *Në mes të keqes së kanosur dhe të keqes së shkaktuar duhet të ekzistojë proporcionaliteti i caktuar.* Proporcionaliteti apo përpjesëshmëria midis të keqes së kanosur dhe të keqes së shkaktuar me rastin e mënjanimit të rrezikut, është një ndër elementet më qenësore të institucionit të nevojës ekstreme. Në nenin 13, par. 2 të Kodit Penal, fjalia e fundit, shprehimisht parashihet se nevoja ekstreme ekziston kur "... e keqja e shkaktuar nuk është më e madhe se e keqja që është kanosur".

c) *Tejkalimi i nevojës ekstreme.* Sikundër te mbrojtja e nevojshme, edhe te nevoja ekstreme mund të shprehet tejkalimi, përkatësisht kapërcimi i kufijve të nevojës ekstreme (paragrafi 3). Tejkalimi, apo siç quhet ndryshe ekscesi i nevojës ekstreme, shprehet në rastet kur mënjanimi i rrezikut nuk është bërë në pajtim me kushtet që janë përcaktuar me Kodin Penal. Përkatësisht, tejkalimi apo ekscesi i nevojës ekstreme shprehet në këto raste: a) kur e keqja e shkaktuar është më e madhe se e keqja e kanosur; b) kur rreziku ka mundur të mënjanohet duke e dëmtuar në përmasa më të vogla të mirën juridike të personit tjetër dhe c) kur dëmtimi i të mirës juridike të personit tjetër është bërë pasi që ka pushuar, pasi që ka kaluar rreziku.

Vepra e cila kryhet me rastin e tejkalimit të kufijve të nevojës ekstreme konsiderohet vepër penale. Nëse tejkalimi është bërë me dashje, kryerësi do të dënohet për vepër penale të kryer me dashje, kurse nëse tejkalimi është bërë nga pakujdesia, kryesi do të dënohet vetëm po qe se ligji parashih përgjegjësi penale edhe kur vepra është kryer nga pakujdesia.

DHUNA OSE KANOSJA

Nocioni dhe llojet e dhunës. Dhuna është përdorim i forcës ndaj një personi me qëllim që të detyrohet të ndërmerret apo të mos ndërmerret një veprim me të cilin realizohen tiparet e një vepre penale. Dhuna e cila ndërmerret ndaj një personi mund të jetë forcë fizike apo mekanike. Ndërsa sipas legjislacioneve penale bashkëkohore dhe sipas Kodit tonë Penal, si dhunë konsiderohet edhe përdorimi i hipnozës ose mjeteve të tjera dehëse me qëllim që ndokush kundër vullnetit të vet të vehet në gjendje të pavetëdijshme ose të bëhet i paafitë për rezistencë. Dhuna mund të shkaktohet edhe me veprimin e forcave natyrore. Në këso raste dhuna e këtillë quhet vis maior.

Dhuna konsiderohet si rrethanë e cila përjashton ekzistimin e veprës penale në rastet kur personi ka qenë i detyruar të ndërmerret veprimin e caktuar apo të mos veprojë dhe nëse ajo ka qenë e papërballueshme.

Dhuna konsiderohet e papërballueshme atëherë kur personi nuk ka pasur mundësi t'i kundërvehet dhe kështu nuk ka mundur të veprojë ndryshe. Nga kjo rezulton se çdo lloj dhune nuk e përjashton fajësinë, së këndejmi edhe veprën penale. Se kur dhuna është e papërballueshme, është çështje faktike të cilën gjykata duhet ta konstatojë në çdo rast konkret.

Si dhunë e papërballueshme zakonisht duhet të konsiderohet ajo e cila në literaturën juridike penale emërtohet si **dhunë absolute** (vis absoluta).

Për t'u konsideruar se dhuna kompulsive përjashton ekzistimin e veprës penale, duhet të konstatohet se ajo nuk ka mundur të evitohet në ndonjë mënyrë tjetër, p.sh. me anë të mbrojtjes së nevojshme, duke thirrë në ndihmë, duke ikur etj.

Ndryshe nga dhuna absolute e cila është e drejtuar vetëm ndaj personit që duhet të ndërmerret veprimin, pra është gjithëherë direkte, dhuna kompulsive mund të jetë direkte dhe indirekte. Dhuna kompulsive është direkte në rastet kur përdoret ndaj personit i cili detyrohet të veprojë apo të mosveprojë, kurse indirekte është në rastet kur p.sh. ndërmerret ndaj fëmijës në mënyrë që të detyrohet prindi i tij të kryejë ndonjë veprim. Në disa raste dhuna kompulsive mund të ndërmerret edhe ndaj sendeve apo pasurisë, me qëllim që pronari kundër vullnetit të tij të ndërmerret ndonjë veprim të cilin dhunuesi e kërkon prej tij.

Nocioni i Kanosjes. Kanosja është deklaratë apo ndonjë veprim tjetër me të cilën i vehet në dukje, i bëhet me dije ndokujt se do ta gjejë një e keqe nëse nuk vepron ashtu si dëshiron personi që kanoset. Kanosja, sikundër edhe dhuna, nëse plotësohen kushtet e caktuara e përjashton ekzistimin e veprës penale. Thënë ndryshe, vepra e cila kryhet nën ndikimin e kanosjes nuk konsiderohet vepër penale. Përkatësisht, personi i cili i kanoset tjetrit konsiderohet kryerës i veprës penale (neni 14, par. 3).

Kanosja është një lloj presioni, një lloj dhune psikike me të cilën ndikohet në vullnetin e personit tjetër që të ndërmerret një veprim i cili i ka tiparet e veprës penale. Personi ndaj të cilit është e drejtuar kanosja gjendet pranë alternativës, ose të kryejë veprimin e caktuar ose të pranojë ta godas e keqja që i kanoset.

Kanosja më së shpeshti kryhet në mënyrë verbale, me gojë. Me anë të deklaratave të ndryshme. Mirëpo, mund të kryhet edhe me shkrim, me telefon, me internet, me SMS apo veprime konkludente.

Për ekzistimin e kanosjes nuk është e domosdoshme që ai që kanoset të mendojë seriozisht ta realizojë kanosjen. Madje nuk kërkohet që të ekzistojnë as mundësitë reale për realizimin e kanosjes. Kështu, fjala vjen, mundet që ndokush t'i kanoset tjetrit edhe me pushkë apo me revole të zbrazët apo me armë imituese. Është e mjaftueshme dhe kanosja do të konsiderohet se ekziston, po qe se personi ndaj të cilit është e drejtuar kanosja, në bazë të rrethanave të situatës konkrete, të formojë bindje se vërtet do të realizohet kanosja.

Në të drejtën penale, për t'u konsideruar se kanosja e përjashton fajësinë, së këndejmi edhe veprën penale, ajo duhet të jetë **serioze, aktuale** dhe e **paevitueshme**, po siç thuhet në Kodin Penal e **pabërballueshme**.

Efekti i dhunës kompulsive dhe i kanosjes. Nga nocioni, intensiteti dhe rrethanat e tjera në të cilat shprehet dhuna dhe kanosja, varet edhe efekti i tyre në të drejtën penale. Kjo konstatohet sipas rastit konkret. Mirëpo, lidhur me këtë teoria dhe praktika gjyqësore ka sajuar disa kritere të përgjithshme në bazë të të cilave mund të zgjidhet kjo çështje. çdo dhunë dhe kanosje nuk është shkak i mjaftueshëm për përjashtimin e ekzistimit të veprës penale.

Dhuna apo kanosja duhet të jenë të intensitetit të atillë dhe duhet të kryhen në kushtet e caktuara, të cilat janë identike me kushtet që kërkohen për mbrojtjen e nevojshme apo të nevojës ekstreme. Po qe se nuk i plotësojnë në tërësi këto kushte, por ka ekzistuar dhuna apo kanosja në një intensitet më të vogël, në këso raste konsiderohet se është kryer vepra penale. Mirëpo fakti që vepra është kryer nën ndikimin e dhunës apo kanosjes, merret parasysh vetëm si rrethanë lehtësuese dhe kryerësi mund të dënohet më butë.

Mund të ndodhë që vepra e cila është kryer nën presionin (ndikimin) e dhunës apo kanosjes të jetë e rëndësisë së vogël ose që të mos jetë shkaktuar fare pasoja e dëmshme. Në rastet e këtilla gjykata do të konkludojë se nuk ekziston vepra penale për shkak të rëndësisë së vogël të veprës apo për shkak të mungesës së pasojave dhe ndaj kryerësit të këtillë do të aplikohet neni 11 i Kodit Penal.

Urdhrat nga lartë

Çështja e përgjegjësisë penale e personave të cilët kryejnë vepra penale në bazë të urdhrat të eprorëve të tyre është rregulluar në mënyrë parimore në nenin 16 të Kodit Penal, ndërsa më detajisht rregullohet me ligje të posaçme - me ligjin mbi shërbimin ushtarak, me ligjin mbi shërbimin policor dhe me ligjin mbi shërbimin e detyrave të caktuara zyrtare. Kosova akoma nuk e ka nxjerrë Ligjin për ushtrinë, ngase Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK-ëja) nuk është avansuar në ushtri. Me Ligjin për Policinë (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28, të datës 4 qershor 2008), në nenin 13, paragrafi 1 thuhet shprehimisht se zyrtari policor ka për detyrë t'i ushtroj autorizimet policore në përputhje me urdhrat e dhëna në mënyrë të drejtë nga mbikqyrësi. Ndërsa

në paragrafin 2 të këtij nenin, është paraparë se zyrtari policor ka për detyrë t'i refuzoj urdhrat të cilët janë qartësisht të paligjshëm dhe të raportojë për ta, pa u friksuar nga dënimi.

Sipas Kodit Penal, edhe në rastet kur vartësi kryen një veprim në bazë të urdhrat të eprorit, veprim ky i cili është i paraparë si vepër penale, personi i këtillë do të konsiderohet penalisht përgjegjës dhe do të dënohet. Personi i cili e ekzekuton urdhërin e këtillë të eprorit, së bashku me eprorin konsiderohen kryerës të veprës penale. Kështu është paraparë në paragrafin 1 të nenit 10 të Kodit Penal, në të cilin thuhet: “Fakti që një vepër penale është kryer nga një person në bazë të një urdhri qeveritar ose të një eprori, qoftë ushtarak ose civil, nuk e lehtëson kryerësin nga përgjegjësia penale”. Mirëpo, në tri nënparagrafe të këtij neni, janë paraparë raste kur vartësi, i cili edhe pse ka kryer vepër penale në bazë të urdhrat të eprorit, nuk konsiderohet penalisht përgjegjës, nuk dënohet. Këto tri situata apo raste janë nëse: *Personi ka qenë i detyruar ligjërisht (sipas ligjit) ti bindet urdhrat të tillë; Personi nuk e dinte që urdhri i tillë ka qenë i kundërligjshëm dhe Urdhri nuk ishte në mënyrë të dukshme i paligjshëm, i kundërligjshëm.*

Këto situata apo raste janë alternative. Thënë ndryshe, përgjegjësia penale e vartësit do të përjashtohet vetëm nëse është shprehë njëra nga këto tri situata.

Shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë sipas pjesës së posaçme të legjislacionit penal

Në pjesën e posaçme të Kodit penal janë të parapara disa shkaqe që e përjashtojnë kundërligjshmërinë e ca veprave penale.

Në Kodin penal të Kosovës shkaqet e posaçme që e përjashtojnë kundërligjshmërinë janë të parapara në nenin 152, 169 par 2., 187 par 4 dhe 189 paragrafi 5.

Ndërprerja e palejuar e shtatzënisë, zbulimi i paautorizuar i fshehtësisë, fyerja dhe zbulimi i rrethanave personale dhe familjare.

Shkaqet e përjashtimit të kundërligjshmërisë që nuk janë të parapara në kodin penal

Veprat e kryera gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, Rreziku i lejuar,

Veprat apo masat që ndërmerren në bazë të se drejtës prindërore dhe të drejtës së edukimit,

Intervenimet mjekësore, Pëlqimi i të dëmtuarit,

Të vepruarit në interes të dëmtuarit dhe pëlqimi i supozuar, Vetëlëndimi.

PËRGJEGJËSIA PENALE

Përgjegjësia penale si element subjektiv i veprës penale. Në të drejtën penale bashkëkohore është përvetësuar parimi i përgjithshëm se për të mund me u dënuar kryerësi, përveç që vepra duhet të jetë e paraparë me ligj si vepër penale, duhet që kryerësi të jetë penalisht i përgjegjshëm. Përgjegjësia penale, përkatësisht fajësia është një ndër elementet e përgjithshme e cila duhet të shprehet te çdo vepër penale. Kjo njëherit është garancë e të drejtave të njeriut dhe kufizim i të drejtës së shtetit që t'i ndëshkoj qytetarët (*ius puniendi*). Pra, përgjegjësia penale, përkatësisht fajësia është kusht që medoemos duhet të plotësohet për të mundur kryesit të veprës penale t'i shqiptohet dënimi, parim ky i cili është formësuar me maksimumin “*nulla poena sine culpa*” (nuk ka dënim pa fajsi). Fajësia është digë mbrojtëse nga arbitrariteti i mundshëm i gjykatës, ngase gjykata nuk mund ta dënoj asnjë person nëse nuk e konstaton fajsinë e tij.

Në të drejtën penale, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka poseduar cilësi të caktuara psikike dhe nëse te ai ka ekzistuar një marrëdhënie e caktuar psikike ndaj veprës të cilën e ka kryer. Me fjalë të tjera, një person konsiderohet penalisht i përgjegjshëm nëse në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.

Elementet e përgjegjësisë penale. Duke u mbështetur në atë që thamë më sipër, del se përgjegjësia penale përbëhet nga këto dy elemente:

- a) ***Nga vetitë e caktuara psikike të kryerësit (nga përgjegjësia) dhe***
- b) ***Nga qëndrimi apo marrëdhënia e kryerësit ndaj veprës që e ka kryer (nga fajësia).***

Së këndejmi, përgjegjësia penale në të drejtën penale përbëhet prej përgjegjësisë dhe fajësisë. Një person konsiderohet i përgjegjshëm atëherë kur posedon aso veti (cilësi) psikike që i bëjnë të mundshme të kuptojë rëndësinë e veprës dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Ndërsa kryerësi i veprës penale konsiderohet i fajshëm atëherë kur ndaj veprës së kryer ka pasur asi qëndrimi apo raporti i cili bën të mundshme që t'i ngarkohet vepra, përkatësisht kur veprën e konsideron si të veten. Nga kjo rezulton se për të ekzistuar përgjegjësia penale, kryerësi duhet të jetë i përgjegjshëm dhe i fajshëm.

Në paragrafin e parë të nenit 17 të Kodit Penal është përcaktuar nocioni i përgjegjësisë penale. Në të thuhet: “Kryerësi i veprës është penalisht përgjegjës nëse është mendërisht i aftë dhe veprën penale e ka kryer me dashje apo nga pakujdesia”. Siç shihet, për përgjegjësinë penale Kodi Penal nuk përdor termin fajësi, por përdor dy format e fajësisë - dashjen dhe pakujdesinë, me të cilat njëherit përcakton edhe shkallën e intensitetit të fajësisë së kryesit të veprës penale.

Nocioni dhe elementet e përgjegjshmërisë

Nocioni i përgjegjshmërisë. Për t'u konsideruar një person penalisht i përgjegjshëm dhe për të mundur të ndëshkohet për veprën e kryer, ai duhet të jetë i përgjegjshëm. Pa përgjegjshmëri nuk ka fajsi. Përgjegjshmëria është element i fajësisë, ngase për t'u konsideruar një person i fajshëm ai duhet të jetë i aftë që ta kuptojë rëndësinë sociale të veprës. Të mund të dalloj të mirën nga e keqja, dhe lirshëm të vendosë.

Në shkencën e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore një person konsiderohet i përgjegjshëm atëherë kur posedon aso veti apo aftësi intelektuale (mendore) dhe volitive që i bëjnë të mundshme të mendojë, të gjykojë, të vendosë dhe t'i kontrollojë sjelljet dhe veprimet e veta. Me fjalë të tjera, një person konsiderohet i përgjegjshëm kur është në gjendje psikike që të kuptojë, është i vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojën e veprës që e kryen dhe është në gjendje që t'i kontrollojë sjelljet e tij. Pra njeriu konsiderohet i përgjegjshëm kur është në gjendje psikike normale, gjendje kjo që i mundëson që veprën ta kryejë me vetëdije dhe vullnet të vetin.

Prej këtij përkufizimi del se përgjegjshmëria përbëhet prej dy elementesh: *elementit intelektual apo të vetëdijes dhe elementit volitiv apo të dëshirës - vullnetit.*

Elementi intelektual apo vetëdija (aftësia mendore), në të drejtën penale ekziston atëherë kur kryerësi i veprës penale është i aftë që të kuptojë rëndësinë e veprës së vet, që të ketë pasqyrë, përfytyrim të qartë se është duke kryer një vepër të rrezikshme, të dëmshme dhe të kundërligjshme. Me fjalë të tjera, një person posedon aftësi intelektuale atëherë kur është i vetëdijshëm se veprimi apo mosveprimi i tij do të shkaktojë një pasojë të dëmshme ndaj personit tjetër apo ndaj shoqërisë

Elementi volitiv apo elementi i dëshirës, përkatësisht **vullnetit,** ekziston atëherë kur personi është në aso gjendje apo ka aftësi psikike që të vendosë dhe t'i kontrollojë sjelljet e veta. Pra aftësia psikike e personit që i bën të mundshme vullnetarisht të vendosë për të kryer një vepër dhe aftësia për t'i kontrolluar sjelljet e veta, është element volitiv apo element i vullnetit - dëshirës.

Papërgjegjshmëria (paaftësia mendore). Sipas përkufizimit të Kodit Penal (par. 1), i papërgjegjshëm, përkatësisht me paaftësi mendore konsiderohet personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale lëngon nga një smundje mendore e përkohshme ose e përhershme, çrregullim mendor apo ngecje në zhvillimin mendor që ka prekur funksionimin e tij mendor dhe për pasojë nuk ka qenë në gjendje të kuptojë apo të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen vepër penale.

Nga dispozita e paragrafit 1 rezulton se Kodi Penal parasheh tri lloje apo grupe të sëmundjeve apo çrregullimeve mendore që mund ta bëjnë një person të papërgjegjshëm. Me këtë rast duhet të theksohet veçmas se çdo lloj i këtyre sëmundjeve apo çrregullimeve mendore nuk e bën kryerësin e veprës penale të papërgjegjshëm, të paaftë mendërisht, por vetëm nëse njëra prej këtyre sëmundjeve ka pasur asi efekti në psikën e njeriut, në jetën shpirtërore të tij, saqë e ka bërë të paaftë që ta kuptojë apo të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tij apo të kuptojë se kryen vepër penale.

Përgjegjshmëria esencialisht e zvogëluar

Gjendja psikike e njeriut, përkatësisht sëmundjet mendore, çrregullimet mendore apo ngecja në zhvillimin mendor mund të jenë edhe të intensitetit të tillë, të cilat personin nuk e bëjnë në tërësi të papërgjegjshëm, mirëpo personi i tillë, megjithatë, të mos jetë edhe në tërësi i përgjegjshëm. Këto janë në fakt raste kur sëmundja mendore, çrregullimi apo ngecja në zhvillimin mendor vetëm në një masë, pjesërisht ua ka privuar personave aftësinë që të kuptojnë rëndësinë e veprës dhe që t'i kontrollojnë sjelljet e tyre.

Midis papërgjegjshmërisë dhe përgjegjshmërisë, në shkencën e psikiatrisë janë konstatuar gjendje të ndryshme psikike, të cilat në masë të konsiderueshme mund ta privojnë personin nga aftësia intelektuale dhe volitive, apo njërën prej tyre. Këta persona, në të drejtën penale quhen persona me përgjegjshmëri esencialisht të zvogëluar.

Në paragrafin 2, Kodi Penal njih përgjegjshmërinë e zvogëluar, si gjendje mendore midis përgjegjshmërisë dhe papërgjegjshmërisë. Sipas kësaj dispozite, personi, i cili ka kryer vepër penale, konsiderohet se ka aftësi të zvogëluar mendore nëse në kohën e kryerjes së veprës penale aftësia e tij për të kuptuar apo kontrolluar veprimet apo mosveprimet e tij ka qenë dukshëm e zvogëluar për shkaqet e cekura në paragrafin 1 të këtij neni.

Nga kjo dispozitë del se për t'u konsideruar se ekziston përgjegjshmëria e zvogëluar, kërkohen gjendjet e njëjta të sëmundjes mendore, çrregullimit mendor apo ngecjes në zhvillimin mendor, të cilat janë supozim për papërgjegjshmërinë.

Përgjegjshmëria esenciale e zvogëluar dhe ndikimi i saj në ndëshkimin

Sipas fjalisë së fundit të paragrafit 2, personi, i cili veprën penale e kryen në gjendje të përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar, konsiderohet penalisht përgjegjës. Me fjalë të tjera, përgjegjshmëria e zvogëluar nuk e përjashton përgjegjësinë penale. Nga kjo rezulton se në rastet e përgjegjshmërisë së zvogëluar kryerësit e këtyllë mund të kryejnë veprën penale me dashje apo nga pakujdesia.

Përgjegjësia esenciale e zvogëluar duhet të konstatohet lidhur me veprën penale konkrete. Kjo nga fakti se ekziston mundësia që një person, varësisht prej natyrës së gjendjes psikike të tij, përkitazi me një vepër penale të caktuar, të ketë vepruar në gjendje të përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar, kurse për veprën tjetër të jetë plotësisht i përgjegjshëm.

Kryerja e veprës penale në gjendje të dehur

Nëse personi ka qenë i papërgjegjshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, ai nuk mund të konsiderohet penalisht i përgjegjshëm për atë vepër. Ky është parim bazë. Mirëpo nga ky parim fundamental ekziston një përjashtim. Ky përjashtim shprehet në rastet kur vetë personi e shpien, e sjell veten në gjendje të papërgjegjshme duke konsumuar alkool, drog apo në ndonjë mënyrë tjetër e bënë veten të paafte mendërisht

dhe në atë gjendje kryen veprën penale. Në rastet e këtilla personi konsiderohet penalisht i përgjegjshëm për veprën penale që e ka kryer në gjendjen e papërgjegjshme, të cilën e ka shkaktuar vetë. Së këndejmi, ekziston mundësia që në të drejtën penale kryerësi të konsiderohet penalisht i përgjegjshëm për veprën penale që e ka kryer në gjendje të papërgjegjshme, me kusht që ai me dashje apo nga pakujdesia ta ketë sjellë veten në këtë gjendje. Rastet e këtilla në shkencën e së drejtës penale janë të njohura në gjuhën latine me shprehjen *actiones liberae in causa* (veprimet që janë të lira në vendim, e jo edhe në kryerje).

Raste të institucionit *actiones liberae in causa*, janë p.sh. personi A. para se të niset në rrugë me veturë, konsumon alkool apo drogë dhe duke vozitur, meqë aftësia për të kontrolluar automobilin i është dobësuar shumë, shkakton aksident në komunikacion me ç'rast humb jetën njëri prej udhëtarëve të veturës me të cilën është ndeshur.

Në Kodin Penal ky institucion është paraparë në nenin 19. Kuptimi dhe qëllimi i kësaj dispozite është që të bëhet e mundshme të konsiderohen penalisht të përgjegjshëm personat që kanë kryer veprën penale në gjendje të papërgjegjshme, të cilën gjendje ia kanë shkaktuar vetes duke përdorur alkool, drogë ose në ndonjë mënyrë tjetër dhe kështu nuk kanë mundur ta kuptojnë rëndësinë e veprës së vet ose nuk kanë mundur t'i kontrollojnë sjelljet e veta, edhe pse para se ta kenë sjellë veten në këtë gjendje, e kanë ditur apo kanë mundur të dinë se mund të kryejnë veprën penale.

Pra qëllimi i institucionit *actiones liberae in causa* është që të pengojë keqpërdorimin e parimit se mund të konsiderohet penalisht i përgjegjshëm vetëm personi i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm. Përndryshe, po mos të njihej institucioni *actiones liberae in causa*, nuk do të ishte e mundur të dënohen personat që me vetëdije, me qëllim apo nga pakujdesia e sjellin veten në gjendje të papërgjegjshme dhe në këtë gjendje kryejnë vepra penale.

Sipas nenit 19, kryerësi i veprës penale mund ta sjellë veten në gjendje të papërgjegjshme me dashje apo nga pakujdesia. Së këndejmi në praktikë mund të shprehet a) *actione liberae in causa me dashje* dhe b) *actione liberae in causa nga pakujdesia*.

2. *Actiones liberae in causa me dashje* do të shkaktohet në rastet kur personi me vetëdije dhe me qëllim sjell veten në gjendje në të cilën nuk ka qenë i vetëdijshëm për rëndësinë e veprës së tij dhe nuk ka mundur t'i kontrollojë sjelljet e veta me qëllim që në këtë gjendje (në gjendje të papërgjegjshme) të kryejë veprën penale të caktuar. Dashja në këso raste mund të jetë direkte apo eventuale.

3. *Actiones liberae in causa nga pakujdesia* do të ekziston në rastet kur personi para se ta ketë sjellë veten në gjendje të papërgjegjshme ka qenë i vetëdijshëm apo ka qenë i obliguar apo ka mundësi me qenë i vetëdijshëm se në gjendje të tillë mund të kryej veprën penale të caktuar.

4. *Actiones liberae in causa në relacion me përgjegjshmërinë e zvogëluar*. Me konsumimin e alkoolit apo të ndonjë mjeti tjetër joshës, personi mund ta sjell veten në gjendje plotësisht të papërgjegjshme apo në gjendje të përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar. Tani shtrohet pyetja se a mund të konsiderohet se personi ka vepruar në

gjendje të *actiones liberae in cause* nëse e ka sjellë veten në gjendje të përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar. Meqë siç u cekë, gjendja plotësisht e papërgjegjshme e shkaktuar nga vetë kryerësi nuk përjashton përgjegjshmërinë penale dhe ndëshkimin për veprën penale, është e logjikshme të konkludohet se personi i cili me rastin e konsumimit të alkoolit apo ndonjë mjeti tjetër joshës sjell veten në gjendje të përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar, ai person do të dënohet për veprën penale të kryer. Madje, gjendja e përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar, me rastin e matjes së dënimit, nuk mund t'i merret as si rrethanë lehtësuese. Ndërkaq, vështruar thjesht në aspektin penalo-juridik, dispozita e nenit 19 të Kodit Penal, në të cilin është përkufizuar institucioni i *actiones liberae in causa*, aplikohet vetëm kur vepra është kryer në gjendje të papërgjegjshme.

Institucioni *actiones liberae in causa* në brendinë e vet do të thotë

“veprim që është i lirë në vendim por jo dhe në kryerje”. Që të aplikohet ky institucion, duhet të përmbushen këto kushte: **a).** që personi të jetë i vetëdijshëm në kohën kur e sjellë vetën në gjendje të papërgjegjshme,

b). që personi me fajin e tij (me dashje apo nga pakujdesia) vihet në aso gjendje (konsumon alkool apo drogë),

c). që para se ta sjellë vetën në atë gjendje të papërgjegjshme, vepra penale e kryer të jetë e përfshirë me dashjen apo pakujdesinë e tij, dhe

d). që të ketë kryer veprën penale e cila në esencë i përgjigjet veprës penale e cila ka qenë e përfshirë me dashjen apo pakujdesinë e kryesit gjersa ai ka qenë në gjendje të vetëdijshme.

Lidhja shkakore

Nocioni dhe rëndësia e lidhjes shkakësore në të drejtën penale. Lidhja shkakësore apo kauzaliteti në shkencën e së drejtës penale përkufizohet si lidhje objektive midis veprimit apo mosveprimit dhe pasojës së shkaktuar. Meqë kauzaliteti është thjeshtë lidhje midis veprimit apo mosveprimit dhe pasojës së shkaktuar, ky institucion duhet shqyrtuar ndaras nga fajësia e kryerësit.

Kauzaliteti në të drejtën penale ka rëndësi të madhe, ngase për t'u konsideruar një vepër e njeriut si vepër penale dhe për të mundur t'i ngarkohet atij, duhet të konstatohet se ajo vepër ka shkaktuar pasojën e ndaluar e cila në ligj është e paraparë si vepër penale. Andaj midis veprimit të njeriut dhe pasojës së shkaktuar duhet të ekzistojë një lidhje apo raport i caktuar në bazë të të cilit konstatohet se pasoja është shkak i veprimit të caktuar të njeriut. Kjo lidhje apo ky raport quhet lidhje shkakore apo kauzale, kurse veprimi i cili ka shkaktuar pasojën quhet shkak

Në shkencën e së drejtës penale janë paraqitur disa teori të cilat ofrojnë kritere dhe pikëpamje me qëllim që t'i ndihmojnë praktikës gjyqësore në zgjidhjen e kësaj çështjeje të ndërlikuar. Prej këtyre teorive, më të rëndësishmet janë: a) *teoria ekuivalente*; b) *teoria e dallimit apo diferencimit kualitativ të shkakut dhe kushtit* dhe c) *teoria e kauzalitetit adekuat*.

- a) *Teoria ekuivalente* ndryshe quhet dhe teoria mbi rëndësinë e njëjtë të të gjitha shkaqeve dhe kushteve, apo teoria *conditio sine qua non*. Sipas kësaj teorie si shkak i pasojës konsiderohet çdo veprim apo mosveprim i cili në ndonjë mënyrë ka kontribuar që të shkaktohet pasoja e ndaluar. Përkatësisht, sipas kësaj teorie, rëndësi të njëjtë kanë të gjitha shkaqet apo kushtet që kanë kontribuar në shkaktuarjen e pasojës. Lidhur me këtë, kjo teori mbështetet në pohimin se pasoja nuk do të shkaktohej po të mungonte ndonjë shkak apo kusht (*conditio sine qua non*).
- b) *Teoria e dallimit apo diferencimit kualitativ të shkakut dhe kushtit*. Kjo teori paraqitet si kritikë e teorisë ekuivalente. Sipas kësaj teorie ekziston dallimi kualitativ apo esencial midis shkaqeve dhe kushteve që kanë kontribuar në shkaktuarjen e pasojës. Ky dallim konsiston në faktin se vetëm shkaqet mund të shkaktajnë pasojën, kurse kushtet vetëm ndikojnë që pasoja të shkaktohet. Në kuadrin e shkaqeve, sipas kësaj teorie, duhet dalluar ato të cilat sipas kualitetit dhe efektit të tyre kanë mundur të shkaktajnë pasoja.
- c) *Teoria e kauzitetit adekuat*. Sikundër dy teoritë e mëparshme, edhe teoria e kauzalitetit adekuat, në mënyrë të posaçme mundohet t'i ndajë shkaqet nga kushtet. Sipas kësaj teorie, shkak i pasojës është ai veprim i cili sipas përvojës së përgjithshme, pra në mënyrë gjenerale, pavarësisht nga rasti konkret në zinxhirin e ngjarjes, është i përshtatshëm që të shkaktojë pasojën e ndaluar. Me fjalë të tjera, sipas kësaj teorie, shkak i pasojës është ai veprim i cili marrë në përgjithësi mundet, është i përshtatshëm apo adekuat që në bashkëndodhje me disa kushte të tjera të shkaktojë pasojën e dëmshme. P.sh., nëse personi A. e qëllon personin B. në kokë me një send të fortë dhe të rëndë, ky veprim në rastin konkret është i përshtatshëm, adekuat që të shkaktojë vdekjen e personit. Pasoja e këtyre shkaktohet edhe në shumë raste të tjera të ngjashme. Andaj, sipas teorisë së kauzalitetit adekuat në rastin e përmendur, veprimi i personit A. konsiderohet shkak i vdekjes së personit B.

Në rastet e kundërta, nëse veprimi nuk është i përshtatshëm (adekuat) që në rrethanat normale të shkaktojë pasojën e ndaluar, atëherë sipas teorisë së kauzalitetit adekuat ai veprim nuk është tipik dhe si i tillë nuk mund të konsiderohet si shkak i pasojës. Për shembull, nëse personi A. e qëllon lehtë personin B. në kokë, i cili për shkak të lëndimit të mëparmë ka pasur komça, dhe kështu nga kjo e rreme shkaktohet keqësimi i gjendjes shëndetësore dhe ky vdes, atëherë sipas kësaj teorie veprimi i personit A. nuk mund të konsiderohet shkak i vdekjes së personit B.

Prej këtyre tri teorive, në praktikën gjyqësore më së shpeshti aplikohet teoria *ekuivalente apo teoria conditio sine qua non*. Madje disa shkencëtarë, këtë e konsiderojnë si teori më adekuate. Kjo teori konsiderohet më adekuate, ngase rekomandon rregulla të përgjithshme në bazë të të cilave mund të zgjidhet çështja e kauzalitetit, ndërprerjen e lidhjes kauzale dhe më së miri e bën diferencimin e kauzalitetit nga fajësia.

Disa prej rregullave të përgjithshme të cilat janë përvetësuar në teori dhe më për së afërmi ofrojnë zgjidhje për përcaktimin e kauzalitetit janë:

a) Kushtet e drejtpërdrejta, të cilat shkaktojnë pasojën e veprës penale gjithëherë konsiderohen shkak i saj.

b) Kushtet indirekte mund të konsiderohen shkak i pasojës vetëm në rastet kur shkaktojnë aso kushte apo rrethana të drejtpërdrejta të cilat shkaktojnë pasojën e veprës penale. Pohimi i këtyre arsyetohet më së miri nga shembulli vijues: nëse personi A. i shkakton lëndim trupor personit B., lëndim ky i cili e keqëson sëmundjen ekzistuese të personit B. dhe kështu ky vdes, në këtë rast lëndimi trupor si kusht indirekt mund të konsiderohet si shkak i vdekjes së personit B., ngase lëndimi trupor shfaqet si kusht indirekt i cili ka shkakuar vdekjen e personit B.

c) Kusht apo shkak i pasojës së veprës penale konsiderohet edhe rasti kur vetëm shpejtohet shkaktimi i pasojës, e cila edhe ashtu do të shkaktohej. Për shembull, nëse në spital infermierja gabimisht ia jep injeksionin apo ndonjë terapi tjetër pacientit që lëngon nga ndonjë sëmundje e pashërueshme dhe po qe se pacienti menjëherë vdes, edhe në këso raste veprimi i këtyre konsiderohet shkak i vdekjes si pasojë e veprës penale të mjekimit të pandërgjegjshëm, edhe pse pasoja e këtyre do të shkaktohej po mos të ndërmerrej ky veprim.

ç) Lidhjen kauzale e ndërpreu ndonjë veprim apo rrethanë tjetër e cila ndërkohë ndërlihet në zinxhirin e ngjarjes dhe kështu shkakton pasojë krejtësisht tjetër nga ajo që zakonisht shkaktohet. Për shembull, nëse personi A. i shkakton lëndim të lehtë trupor personit B. dhe po qe se personi B. vdes në spital për shkak të infeksionit, ngase plagën ia mbështjellin me fashë të papastër, apo në përgjithësi për shkak të mjekimit të pandërgjegjshëm, atëherë në këtë rast veprimi i personit A. nuk do të konsiderohet shkak i vdekjes së personit B., ngase infektimi apo mjekimi i pandërgjegjshëm e ndërpreu lidhjen kauzale midis veprimit të personit A. dhe pasojës së vdekjes së personit B.

2. *Lidhja shkakësore te veprat penale me mosveprim.* Në të drejtën penale, rëndësi të posaçme ka çështja e përcaktimit të kauzalitetit të veprat penale të kryera me mosveprim. Kjo nga fakti se në kushtet e tanishme të jetës bashkëkohore gjithnjë më tepër çdo individ ka një varg detyrash dhe obligimesh, kështu që moskryerja e këtyre detyrave dhe obligimeve, apo qëndrimi pasiv ose indiferent ndaj tyre, mund të shkaktojë pasoja të dëmshme për shoqërinë. Konsiderohet se mosndërmarrja e veprimit të caktuar apo mosveprimi mund të jetë shkak i pasojës nëse janë përmbushur këto kushte: 1) nëse ka ekzistuar obligimi që të veprohet në mënyrë të caktuar për t'u parandaluar pasoja, 2) nëse personi ka pasur mundësi, ka qenë në gjendje të parandalojë shkakuarjen e pasojës dhe 3) nëse konstatohet se me siguri pasoja nuk do të shkaktohej, ose do të shkaktohej pasojë shumë më e vogël, po të ndërmerrej veprimi që është dashur të ndërmerrej. Vetëm nëse përmbushen këto tri kushte në mënyrë kumulative, mosveprimi mund të konsiderohet shkak i pasojës.

DASHJA

Në strukturën e elementeve të përgjithshme të veprës penale, faji është element subjektiv i veprës penale. Për të mundur të ndëshkohet një person për veprën e tij, nuk mjafton që të ketë kryer vetëm vepër të kundërligjshme që parashihet si vepër penale, por ai atë vepër duhet ta ketë kryer me fajin e tij. Në të drejtat penale bashkëkohore, për t'u konsideruar personi penalisht i përgjegjshëm dhe për të mundur të dënohet, duhet që veprën ta ketë kryer me fajin e tij.

Në të drejtën penale shtrohet pyetja se a ka qenë personi i caktuar i fajshëm apo jo vetëm në rastet kur ai kryen vepër penale. Pra, vepra penale është supozim, parakusht në procedurën penale për t'u shqyrtuar se a është fajtor personi i caktuar për veprën e kryer. Pasi që të konstatohet se personi i caktuar ka kryer vepër penale, shqyrtohet çështja se a ka qenë i fajshëm për veprën e kryer.

Një person konsiderohet se veprën penale e ka kryer me faj në rastet kur ka ditur se me veprimin apo mosveprimin e tij do të shkaktojë pasojë të ndaluar në botën e jashtme, pasojë kjo që në ligj është e paraparë si vepër penale, dhe nëse ndaj pasojës - ndaj veprës, ka pasur aso marrëdhënie, relacioni, e cila i bën të mundshme gjykatës që t'ia ngarkojë, t'ia vëjë në barrë atë vepër. Marrëdhënia apo relacioni psikik i kryesit ndaj veprës në të drejtën penale quhet fajësi.

Nga ky përkufizim i fajit del se fajësia përfshin veprimin dhe pasojën e veprës penale. Për këtë shkak në të drejtën penale flitet për fajin lidhur me veprimin dhe për fajin lidhur me pasojën e veprës penale.

Lidhur me veprimin e veprës penale, faji ekziston atëherë kur personi është i vetëdijshëm dhe dëshiron ndërmarrjen e veprimit, apo kur është i vetëdijshëm dhe dëshiron që të mos e ndërmarrë veprimin e caktuar, kur me mosveprim kryhet vepra e caktuar.

Lidhur me pasojën, konsiderohet se një person është i fajshëm në rastet kur është i vetëdijshëm dhe dëshiron që të shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme.

Dashja. Dashja (*dolus*) konsiderohet forma më e rëndë, më tipike dhe forma më e shpeshtë e fajit me të cilën kryhen veprat penale. Sipas nenit 21 të Kodit Penal, vepra penale është kryer me dashje kur kryerësi ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet dhe ka dashur që ta kryejë, apo kur ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit të tij mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, por e ka pranuar, është dakorduar që të shkaktohet ajo pasojë.

Prej këtij përkufizimi që është dhënë në këtë dispozitë penale del qartë se Kodi ynë Penal njih dy lloje të dashjes: *dashjen direkte* dhe *dashjen eventuale*.

Dashja direkte (*dolus direktus*) ekziston atëherë kur kryerësi është i vetëdijshëm se me veprimin apo mosveprimin e vet do të kryejë vepër të dëmshme, vepër penale dhe dëshiron kryerjen e asaj vepre, dëshiron që të shkaktohet pasoja e ndaluar në botën e jashtme (neni 21, par.2).

Te dashja direkte, kryerësi është i vetëdijshëm për veprimet e veta, është i vetëdijshëm për rrezikshmërinë shoqërore abstrakte të sjelljes së vet, e parasheh

mundësinë e shkaktuarjes së pasojës së dëmshme, përkatësisht është i vetëdijshëm për rrezikun konkret, me vullnet i drejton (qeveris) sjelljet e veta dhe dëshiron shkaktuarjen e pasojës së rrezikshme. Së këndejmi, te kjo formë e dashjes shprehet *elementi i vetëdijes (elementi intelektual) dhe elementi i vullnetit (elementi i dëshirës)*.

Elementi *volitiv* apo *i dëshirës (i vullnetit)* është komponentë e dytë e dashjes direkte. Ky element shprehet atëherë kur kryerësi ka dashur, ka dëshiruar që me veprimin apo mosveprimin e vet të shkaktojë pasojën e caktuar. Konsiderohet se personi e ka dëshiruar kryerjen e veprës kur ndërmerr veprimin me qëllim që të shkaktojë pasojën, e cila është tipare e veprës penale të caktuar.

Dashja eventuale (dolus eventualis) ekziston atëherë kur kryerësi ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit mund të shkaktohet pasoja e ndaluar, mirëpo me vetëdije është pajtuar, është dakorduar që ajo të shkaktohet (neni 21, par. 3 i Kodit Penal). Dashja eventuale ka ngjashmëri me dashjen direkte, mirëpo ka edhe dallime kualitative në sferën e vetëdijes, e edhe më tepër në sferën e vullnetit, dëshirës lidhur me shkaktuarjen e pasojës së ndaluar. Rrjedhimisht, te dashja eventuale, ndryshe nga dashja direkte, kryerësi me veprimet e veta nuk ka për qëllim që të shkaktojë pasojën e caktuar që është tipare e veprës së ndaluar, madje shkaktuarjen e asaj pasoje nuk e parashih as si të sigurt, mirëpo është i vetëdijshëm se me ndërmarrjen e veprimit krijohet një mundësi e madhe, një rrezik i madh se do të kryhet edhe ajo vepër dhe do të shkaktohet edhe ajo pasojë, të cilën vetëm e parashih si të mundshme, por të cilën nuk e dëshiron. Këtu edhe qëndron thelbi i dashjes eventuale, dhe themeli i sajimit të përgjegjësisë penale, ngase kryesi, edhe pse është i vetëdijshëm se me veprimin apo me mosveprimin e vet krijon një rrezik të madh që të shkaktohet pasoja e ndaluar (të kryhet vepra penale) dhe përkundër saj nuk abstenon nga ajo vepër.

Dijenja, dashja, pakujdesia ose qëllimi

Dispozita e nenit 22 është tërësisht risi në Kodin Penal të Kosovës. Këso dispozite nuk haset në asnjë kod penal të shteteve të formuara nga territori i ish Jugosllavisë dhe as në Kodin Penal të Shqipërisë. Për këtë arsye mungon edhe literatura si dhe praktika lidhur me zbatimin e kësaj norme shumë të rëndësishme për të drejtën penale. Prandaj edhe për autorin është shumë vështirë që ta komentoj këtë nen. Por përkundër kësaj do të bëjmë përpjekje që ta shpjegojmë këtë nen.

Sipas të gjitha gjasave, dispozita e nenit 22 është inkorporuar në Kodin Penal sipas zgjidhjeve dhe rekomandimeve që dalin nga Modeli i Kodit Penal Evropian. Meqë është koncept dhe trend i përafrimit dhe unifikimit të legjislacioneve penale të shteteve të Evropës, me siguri edhe kodet penale të regjionit dhe të shteteve të tjera do ta parashohin këtë dispozitë.

Paraparaja e dispozitës në nenin 22 është bërë me qëllim që t'i ndihmojë gjyqësisë penale që të konstatoj se kur vepra penale konsiderohet se është kryer me dashje dhe kur nga pakujdesia. Lidhur me këtë, tani veç është pranuar koncepti se në rastet e caktuara, konstatimi nëse është kryer vepra penale me dashje apo nga pakujdesia mund të nxirret edhe sipas rrethanave faktike në të cilat është kryer vepra e caktuar. Pikrisht,

dipsozita e nenit 22 sajón bazën juridike që gjykatat të mund të konstatojnë edhe në bazë të rrethanave faktike, nëse vepra është kryer me dashje apo nga pakujdesia, përkatësisht nëse kryerësi i ka ditë elementet relevenate të veprës penale dhe me çfarë qëllimi veprën e ka kryer.

Dijenja, dashja, pakujdesia dhe qëllimi janë elemente subjektive të veprës penale. Për shkak të natyrës së tyre, këto elemente subjektive të veprës penale në disa raste është jashtëzakonisht vështirë të vërtetohen ngase duhet të depërtohet në psikën, në mendjen e personit. Pikërisht për këtë arsye, po e përsërisim edhe një herë, është paraparë dispozita e nenit 22 për t'u krijuar bazë juridike gjykatave që në rastet e caktuara këto elemente subjektive, e sidomos dashja dhe pakujdesia të konstatohen në bazë të rrethanave faktike.

PAKUJDESIA

Pakujdesia (culpa) është formë e dytë e fajit dhe për nga intensiteti i përgjegjësisë penale formë më e lehtë e fajësisë. Pakujdesia ekziston atëherë kur kryesi nuk e dëshiron pasojën e shkaktuar, përkatësisht kur pasoja shkaktohet kundër vullnetit të tij.

Kodi penal i Kosovës (neni 23 par. 1) i njeh dy lloje të pakujdesisë: dhe atë pakujdesi me vetëdije apo mendjehetësinë dhe pakujdesia pa vetëdije apo neglizhencën.

Këto dy lloje të pakujdesisë dallohen mes veti vetëm sipas elementit të vetëdijes apo elementit intelektual, kurse në asnjërën variantë kryesi nuk e dëshiron pasojën (nuk dëshiron që të shkaktohet pasoja në botën e jashtme). ngase në asnjë formë nuk shprehet dëshira apo vullneti për të shkaktuar pasojën e ndaluar në botën e jashtme.

Pakujdesia me vetëdije

Pakujdesia me vetëdije apo mendjehetësia (luxuria), sipas paragrafit 2 të nenit 16 të KPPK, ekziston atëherë kur personi është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit apo mosveprimit të tij, por me mendjehetësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai do të mund të parandalojë shkaktimin e saj.

Pakujdesia pa vetëdije

Pakujdesia pa vetëdije apo neglizhenca ekziston kur personi nuk është i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet si rezultat i veprimit ose mosveprimit të tij, edhe pse në rrethanat dhe sipas vetive të tija personale ka mundur të ishte apo duhej të ishte i vetëdijshëm për këtë mundësi (neni 23 par. 3 të KPPK).

Për veprat penale të kryera me dashje, kryesi gjithherë përgjigjet penalisht, kurse të veprat penale të kryera nga pakujdesia, kryesi do të përgjigjet penalisht vetëm për veprat penal ku me ligj shprehimisht është paraparë përgjegjësia penale dhe për veprat penale të kryera nga pakujdesia.

Përgjegjësia për veprat penale të kryera nga pakujdesia.

Në rastet kur vepra penale kryhet nga pakujdesia, kryerësi zakonisht nuk dënohet, por dënohet vetëm përjashtimisht dhe atë vetëm atëherë kur me ligj shprehimisht është paraparë se kryerësi do të dënohet edhe për rastet kur veprën e kryen nga pakujdesia. Në rastet kur me ligj është paraparë që kryesi do të dënohet edhe për veprat penale të kryera nga pakujdesia, dënimi i paraparë është më i butë sesa për veprat e kryera me dashje.

Se për cilat vepra të kryera nga pakujdesia kryerësi do të dënohet, kjo është çështje e politikës kriminale. Mirëpo, lidhur me këtë vendimtare është rëndësia individuale dhe shoqërore e objektit i cili mbrohet edhe me të drejtën penale. Shikuar në përgjithësi, sipas Kodit tonë Penal, për pakujdesi dënohen kryerësit e veprave penale kundër shëndetit të njeriut, kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe të pasurisë në trafikun publik, mandej për veprat penale nga pakujdesia të personave që ushtrojnë detyra (funksione) të rëndësishme si dhe për veprat penale kundër jetës dhe trupit.

LAJTHIMI FAKTIK

Lajthimi në fakt (*lat. error facti*), konsiderohet se ekziston në rastet kur kryerësi në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë i vetëdijshëm për ndonjë nga tiparet e saj të caktuara me ligj, apo kur gabimisht mendon se ekzistojnë rrethanat relevante sipas të cilave, po të ekzistonin ato faktikisht, ajo vepër do lejohej.

Lajthimi në fakt mund të shprehet lidhur me veprimin, pasojën, kauzalitetin, objektin- të miren ndaj të cilës kryhet vepra dhe në përgjithësi ndaj çdo rrethane e cila është tipare e veprës penale.

Nga përkufizim i lajthimit në fakt që është përcaktuar në Kodin Penal, rezulton se e drejta jonë penale njih dy lloje të këtij lajthimi: *lajthimin në fakt lidhur me tiparet e veprës penale* dhe *lajthimin në fakt lidhur me rrethanat të cilat e përjashtojnë veprën penale*.

2.Lajthimi në fakt lidhur me tiparet (elementet) e veprës penale. Ky lloj lajthimi ekziston atëherë kur kryerësi ka përfytyrim të gabuar apo kur nuk di për ndonjë rrethanë reale, e cila në ligj është përcaktuar si element përbërës i veprës penale.

Me fjalë të tjera ky lloj lajthimi shprehet në rastet kur kryerësi ka një pasqyrë të gabuar apo nuk e di ndonjë rrethanë reale e cila bën pjesë në figurën e veprës penale dhe për këtë shkak e kryen veprën penale, edhe pse nuk e di dhe as që dëshiron ta kryejë atë vepër. Meqë në rastet e lajthimit në fakt në kuptimin e ngushtë kryerësi nuk di apo ka përfytyrim të gabuar për rrethanat relevante të veprës penale dhe as që e dëshiron kryerjen e saj, ky lloj lajthimi gjithherë përjashton ekzistimin e dashjes.

Lajthimi në fakt në kuptimin e ngushtë mund t'i përket veprimit të kryerjes, pasojës, objektit të veprimit, kauzalitetit të veprës penale, kohës, vendit apo mënyrës së kryerjes së veprës dhe të gjitha rrethanave të tjera, të cilat me ligj janë të parapara si elemente të figurës së caktuar të veprës penale. Gjithashtu këto rrethana mund t'i përkasin veprës penale themelore apo formës së kualifikuar apo të privilegjuar të saj.

Ja disa shembuj më karakteristikë ku mund të konsiderohet se vepra penale është kryer në lajthimin në fakt në kuptimin e ngushtë, përkatësisht lidhur me elementet përbërëse (konstitutive) të veprës penale: personi merr sendin e huaj duke menduar gabimisht se është i tij; ndokush ka marrëdhënie seksuale me femrën e cila është nën moshën 16-vjeçare duke menduar se ajo është mbi 16 vjeçe; mjekut i përzihen rezultatet e analizave të dy të sëmurëve, kështu që terapinë që duhet caktuar njërit, ia cakton tjetrit dhe me këtë ia keqëson gjendjen shëndetësore të sëmurit; ndokush gabimisht ia jep tjetrit helm duke menduar se ia jep barin; ndokush lidh martesë të re duke menduar gabimisht se martesa e mëparshme i ka pushuar.

Shmangia(devijim) e veprimit (aberatio ictus sive impetus) është një lloj i ngjashëm me lajthimin përkitazi me lidhjen kauzale. Ky lloj lajthimi ekziston kur kryerësi ndërmerr veprimin ndaj subjektit apo objektit të caktuar, kurse pasoja shkaktohet ndaj subjektit apo objektit tjetër. Rastet e tilla në të drejtën penale quhen sulm i gabuar, apo devijim i veprimit. Për shembull, gjuetari shkrepe me armë në drejtim të egërsirës, por e godet personin që ka qenë duke prerë dru në pyll; bashkëshortja ka patur për qëllim që ta helmojë burrin e vet, por venën e helmuar të cilën e ka vuar në tavolinë e ka pirë personi tjetër. Apo rasti tjetër - personi A. shkrepe me armë në drejtim të personit B. me qëllim që ta privojë nga jeta, mirëpo me atë rast godet personin C. që është gjendur rastësisht afër.

Lajthimi lidhur me rrethanat të cilat e përjashtojnë kundërligjshmërinë.

Ky lloj lajthimi ekziston kur ndokush në kohën e kryerjes së veprës penale, gabimisht mendon se ekzistojnë rrethana sipas të cilave, po të ekzistonin ato faktikisht, ajo vepër do të ishte e lejuar. Me fjalë të tjera, lajthimi në fakt në kuptimin e gjerë ekziston në rastet kur ndonjë person ka qenë i vetëdijshëm për të gjitha tiparet e veprës penale, mirëpo ka pasur përfytyrim të gabuar mbi ndonjë rrethanë reale, e cila nëse në të vërtetë do të ekzistonte ashtu çfarë e paramendon, sipas ligjit do të përjashtohej kundërligjshmëria dhe rrezikshmëria shoqërore e veprës së kryer, kështu që ajo vepër do të ishte e lejueshme. Për shembull, polici e privon nga liria një person duke menduar se ai është personi për të cilin është shpallur urdhërarrestimi; personi A. mendon gabimisht se është i sulmuar nga personi B. dhe shti në të me armë me ç'rast i shkakton plagë të rëndë apo e privon nga jeta (*mbrojtja e nevojshme putative*); personi A. gabimisht mendon se ai apo dikush tjetër është i rrezikuar dhe duke qenë në këtë lajthim ndërmerr ndonjë veprim me ç'rast lëndon ndonjë person apo asgjëson pasurinë e tjetrit (*nevoja ekstreme putative*).

Lajthimi në fakt i mënjanuar dhe i pa mënjanuar.

Lajthimi në fakt lidhur me elementet e veprës penale dhe lajthimi në fakt lidhur me rrethanat të cilat e përjashtojnë ekzistimin e veprës penale, mund të jetë *i mënjanuar* dhe *i pamënjanuar*.

Lajthimi në fakt i mënjanuar ekziston në rastet kur kryerësi për shkak të pakujdesisë së tij ka qenë në lajthim. Me fjalë të tjera, nëse konstatohet se lajthimi është rezultat i moskujdesit të paarsyeshëm të kryerësit, apo kur konstatohet se është vetë fajtor për përfytyrimin e gabuar mbi tiparet e veprës, përkatësisht kur kryerësi nuk i ka ndërmarrë të gjitha masat që të ketë përfytyrim të drejtë mbi veprën, atëherë në të drejtën penale konsiderohet se personi ka vepruar në lajthimin e mënjanuar.

Lajthimi në fakt i pamënjanuar ekziston atëherë kur kryerësi nuk ka mundur dhe as që ka qenë i detyruar të ketë përfytyrim të drejtë për ato rrethana, për të cilat ka qenë në lajthim.

Efkti i lajthimit në fakt në përgjegjësi.

Lajthimi në fakt i mënjanuar dhe i pamënjanuar gjithherë përjashton dashjen. Së këndejmi, personi që veprën penale e ka kryer në lajthim nuk mund të konsiderohet se veprën penale e ka kryer me dashje. Gjithashtu lajthimi i pamënjanuar e përjashton jo vetëm dashjen, por edhe pakujdesinë. Kryerësi i cili veprën e kryen në lajthimin e pamënjanuar nuk është penalisht i përgjegjshëm dhe nuk dënohet.

Mirëpo, në rastet kur është fjala për lajthimin e mënjanuar, kryerësi mund të jetë penalisht i përgjegjshëm dhe penalisht i papërgjegjshëm. Meqë, siç pamë, te lajthimi i mënjanuar personi veprën e kryen nga pakujdesia, atëherë a do të përgjigjet kryerësi penalisht apo jo, kjo varet se a parasheh ligji përgjegjësi penale edhe për veprën e kryer nga pakujdesia. Përkatësisht, në nenin 25, paragrafin 2 të Kodit Penal është paraparë sa vijon: “Personi që për shkak të pakujdesisë ka qenë në lajthim, është penalisht përgjegjës për veprën penale të kryer nga pakujdesia nëse ligji në mënyrë specifike parashikon përgjegjësi penale për kryerjen e veprës së tillë nga pakujdesia

LAJTHIMI JURIDIK

Lajthimi juridik (*lat. error iuris*) përkufizohet si lajthim mbi ndalueshmërinë e veprës. Kryerësi i veprës konsiderohet se gjendet në lajthimin juridik në rastet kur nuk di se vepra e tij është e ndaluar, është e paraparë si vepër penale. Në lajthimin juridik kryerësi është i vetëdijshëm për veprën e tij, mirëpo gabimisht mendon se vepra e tij është e lejuar.

Lajthimi apo përfytyrimi i gabuar i kryerësit mbi kundërligjshmërinë e veprës mund të shprehet në dy forma.

1.Forma e parë shprehet në rastet kur kryesi nuk e di se se vepra e tij është e kundërligjshme, është e paraparë si vepër penale. Psh. polici i cili privon ndonjë person

nga liria, nuk e din se vendimi mbi ekzekutimin e privimit të lirisë është nxjerrë në mënyrë të kundërligjshme.

2. Forma e dytë e lajthimit juridik ekziston në rastet kur kryesi gabimisht mendon se ekziston ndonjë rrethanë e cila përjashton kundërligjshmërinë dhe veprën e bënë të lejueshme. p.sh. ushtari gjatë kohës së luftës, në bazë të urdhërit të eprorit të tij, kryen krime të gjenocidit apo krime kundër njerëzimit.

Efekti i lajthimit juridik në përgjegjësinë sipas Kodit Penal.

Sipas nenit 26.par.1. të KPK: “Perssoni I cili për shkaqe të arsyeshme nuk e ka ditur ose nuk ka mundur ta dijë se vepra është e ndaluar nuk është penalisht përgjegjës”.

Nga kjo zgjidhje, që është përvetësuar në këtë dispozitë, rezulton përfundimi se Kodi ynë Penal në fuqi e ka braktisur konceptcionin tradicional dhe të ngurtë se mosnjohja e ligjit dëmton (*ignoratio legis nocet*).

Gjithashtu nga analiza juridike e nenit 26 të Kodit Penal, ku është përcaktuar efekti i lajthimit juridik në përgjegjësinë penale, mund të konstatojmë edhe një varg zgjidhjesh që janë aprovuar lidhur me këtë çështje.

Para së gjithash, sipas kësaj dispozite, lajthimi juridik nuk përjashton dashjen, që do të thotë se edhe në rastet kur personi kryen veprën në lajthimin juridik, ai mund të konsiderohet se ka vepruar me dashje.

Më tutje, siç pamë, lajthimi juridik është bazë për përjashtimin e përgjegjësisë penale, në rastet kur kryerësi i veprës penale ka qenë në lajthimin juridik për shkaqe të arsyeshme. Shtrohet pyetja se në cilat raste konsiderohet se personi ka qenë në lajthimin juridik për shkaqe të arsyeshme.

Në të drejtën penale konsiderohet se kryerësi ka qenë në lajthim për shkaqe të arsyeshme në rastet kur ka vepruar në lajthimin e pamënjanuar, të paevitueshëm. Ndërsa nëse në lajthim ka qenë për shkaqe të paarsyeshme, atëherë konsiderohet se ka qenë në lajthimin e mënjanuar, të evitueshëm. Së këndejmi, për të mundur të konstatohet nëse kryerësi ka qenë në lajthimin juridik për shkaqe të arsyeshme apo të paarsyeshme, duhet përcaktuar se çka nënkuptojmë me lajthim të pamënjanuar e çka me lajthim të mënjanuar.

Lajthimi juridik i pamënjanuar, i paevitueshëm, apo për shkaqe të arsyeshme ekziston kur kryerësi nuk ka mundur të evitojë lajthimin në të cilin është gjendur. Përkatësisht, ky lloj lajthimi shprehet në rastet kur kryerësi ka vepruar në aso rrethanash në të cilat vërtet nuk ka mundur të dijë se ndonjë normë juridike atë vepër e parasheh si vepër penale. Me rastin e përcaktimit nëse kryerësi ka qenë në lajthimin juridik të pamënjanuar, rëndësi të posaçme ka lloji i veprës penale për të cilën kryerësi ka qenë në lajthim. Kështu, p.sh. nëse është fjala për ndonjë vepër e cila nga ana e shoqërisë dhe moralit të saj në masë të theksuar nuk dënohet, mirëpo përkundrazi kësaj për shkak të interesit individual dhe të përgjithshëm me normat juridike është e përcaktuar si vepër penale, atëherë mund të bëhet fjalë se kryerësi ka qenë në lajthimin juridik të pamënjanuar. Vepër e tillë do të ishte p.sh. vepra penale e ushtrimit të kundërligjshëm të veprimtarisë mjekësore (neni 262).

Krahas llojit të veprës penale të kryer si rrethana në bazë të të cilave duhet konstatuar nëse ka qenë kryerësi në lajthimin juridik të pamënjanuar, duhet të merret parasysh aftësia psikike e kryerësit, lloji i profesionit të cilin ai e ushtron, rrethanat objektive në të cilat e ka kryer veprën etj. Me këtë rast duhet theksuar se, marrë në tërësi, konstatimi i lajthimit juridik të pamënjanuar është çështje faktike për të cilën gjykata në çdo rast konkret duhet të administrojë prova të duhura.

Lajthimi juridik i mënjanuar (apo për shkaqe të paarsyeshme).

Ekziston në rastet kur kryerësi ka qenë në lajthimin juridik mirëpo, në rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e kryerjes së veprës penale dhe sipas aftësive të tij personale, ai ka mundur të dijë se veprën që është duke e kryer është vepër e ndaluar, është e paraparë si vepër penale.

Sipas këtij koncepti të shkencës së të drejtës penale, në paragrafin 3 të nenit 26, është përkufizuar nocioni i lajthimit juridik të evitueshëm. Në këtë dispozitë është paraparë me sa vijon: “Lajthimi juridik është i evitueshëm nëse çdo person, pra edhe kryerësi, ka mundur lehtë të dijë se vepra është e kundërligjshme, apo nëse është fjala për kryesin, i cili, duke marrë parasysh thirrjen, profesionin apo detyrën e tij, ka qenë i obliguar të dijë se vepra është e kundërligjshme.” Në këso raste lajthimi i këtillë juridik nuk mund të konsiderohet si lajthim për shkaqet e arsyeshme, andaj lajthimi i këtillë vetëm mund të merret si bazë për zbutjen e dënimit sipas paragrafit 2 të nenit 26.

TENTATIVA

Në kuptimin e përgjithshëm, tentativa konsiderohet në rastet kur është filluar kryerja e veprës penale por e cila nuk përfundohet, nuk kryhet vepra. Tentativa është një situatë në tërë zingjirin e ngjarjes kriminale e cila shprehet midis veprimeve përgatitore dhe veprës penale të përfunduar. Shikuar në aspektin e katër fazave nëpër të cilat zakonisht kalon kryerja e veprës penale, tentative është më afër veprimeve përgatitore dhe më larg nga përfundimi i veprës.

Sipas nenit 28, par. 1, tentativa ekziston kur ndokush me dashje ndërmer veprime të drejtpërdrejta për kryerjen e veprës penale dhe vepra nuk është kryer ose elementet e veprës së qëllimshme penale nuk janë realizuar. Sipas këtij përkufizimi ligjor, për t’u konsideruar se është kryer tentativa e veprës penale, medoemos duhet të përmbushen këto tri kushte: **a) që të ndërmerret veprimi i kryerjes së veprës penale; b) që veprimi të ndërmerret me dashje dhe c) që vepra të mos përfundohet, përkatësisht që të mos shkaktohet pasoja e veprës penale.**

Tentativa e plotë dhe e metë

Meqë tentativa konsiderohet se është kryer si në rastin kur veprimi i kryerjes ka përfunduar ashtu edhe në rastin kur vetëm ka filluar, por gjithherë me kusht që pasoja e veprës penale të mos jetë shkaktuar, në të drejtën penale njihen dy lloje të tentativës: tentativa e plotë dhe tentativa e metë.

Tentativa e plotë konsiderohet se ekziston në rastet kur veprimi i kryerjes ka filluar dhe ka përfunduar, mirëpo pasoja nuk është shkaktuar. Për shembull, personi A. shkrep nga revolja në personin B. mirëpo nuk e godet.

Tentativa e metë konsiderohet se ekziston atëherë kur personi e fillon veprimin e kryerjes por nuk e përfundon. Për shembull, personi A. merr në shenjë me pushkë personin B. mirëpo nuk shkrep.

Dallimi midis tentativës së plotë dhe të metë është i rëndësishëm lidhur me çështjen e heqjes dorë vullnetare nga kryerja e veprës penale dhe matjes së dënimit. Rrjedhimisht për tentativën e metë në praktikën gjyqësore shqiptohet dënimi më i butë në krahasim me tentativën e plotë.

Tentativa e cilësuar

Në të drejtën penale konsiderohet se ekziston tentativa e cilësuar në rastet kur me veprimin e ndërmarrë është tentuar të kryhet vepra penale, mirëpo në fakt është kryer figura e një vepre penale tjetër, e cila është e përcaktuar me ligj si vepër penale e posaçme. Raste të tilla më së shpeshti ndodhin lidhur me veprat penale të tentativës së vrasjes. Për shembull, personi A. shkrep me armë në personin B. me qëllim që ta privojë nga jeta, mirëpo i shkaktonte vetëm lëndim të rëndë trupor. Në këtë rast personi A. në fakt e ka kryer veprën penale të plagosjes së rëndë, mirëpo meqë dashja e tij ka qenë e orientuar që të kryejë veprën penale të vrasjes, në të drejtën penale ky person do të konsiderohet se e ka kryer veprën penale të tentativës së vrasjes, e jo veprën penale të plagosjes. Pra, në këso raste, për kualifikimin e veprës penale është vendimtare dashja e kryerësit. Fakti që personi me këtë tentativë ka shkaktuar plagosjen do t'i merret parasysh si rrethanë rënduese me rastin e matjes së dënimit me ç'rast gjyqi do ta ketë parasysh edhe dënimin e paraparë për veprën e cila është kryer me tentativë.

Veprat penale te të cilat nuk është e mundur tentativa

Në teorinë e së drejtës penale dhe në praktikën gjyqësore konsiderohet se te disa vepra penale nuk është e mundur tentativa. Lidhur me këtë kryesisht njihen dy grupe të veprave penale te të cilat nuk është e mundur tentativa. Në grupin e parë bëjnë pjesë ato vepra penale të cilat në të drejtën penale konsiderohen se janë kryer nëse janë ndërmarrë veprimet përgatitore apo tentativa. Vepra penale të këtilla janë p.sh. organizimi i grupit për të kryer krimin e gjenocidit, krime kundër njerëzimit, krime të luftës, pastaj trafikimin me njerëz etj.

Në grupin e dytë të veprave penale te të cilat nuk është e mundur tentativa, bëjnë pjesë ato vepra penale te të cilat për shkak të natyrës së tyre tentativa nuk është e mundur. Për shembull, nuk është e mundur tentativa e veprës penale pjesëmarrjes në rrahje, te vepra penale e shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, mandej te veprat penale nga pakujdesia (tek të cilat edhe pse është e mundur tentativa, ajo nuk është e ndëshkuar)etj.

Ndëshkimi i tentativës sipas të drejtës sonë penale

Duke marrë parasysh natyrën dhe peshën e veprës penale si dhe duke përvetësuar teorinë objektivo-subjektive, e drejta e jonë penale e zgjidhë çështjen e ndëshkimit për rastet e tentativës. Rrjedhimisht, sipas paragrafit 1 të nenit 28 të Kodit penal, për tentativë personi dënohet kur është fjala për veprat penale për të cilat mund të shqiptohet dënimi me burgim më së paku tre vjet, ndërsa për tentativën e veprave të tjera penale më të lehta, vetëm atëherë kur me ligj shprehimisht parashihet se edhe për tentativë dënohet. Pra, këtu pesha e veprës penale apo intensiteti i rrezikshmërisë është përcaktuar me llojin dhe masën e dënimit të paraparë.

BASHKËPUNIMI

Vepra penale mund të kryhet me veprimin e një personi apo të shumë personave. Në rastet kur në kryerjen e veprës penale marrin pjesë dy apo më shumë persona, kjo në të drejtën penale quhet bashkëpunim, ndërsa personat me veprimin e të cilëve është kryer vepra penale quhen bashkëpunëtor.

Për tu konsideruar se ekziston bashkëpunimi nuk mjafton që në kryerjen e veprës penale të marrin pjesë shumë persona, ngase është e mundur që në kryerjen e veprës penale të marrin pjesë dy apo më shumë persona, mirëpo me gjithë atë mos të ekziston bashkëpunimi, p.sh. një person e thyen marketin dhe nga ai i merr disa sende, pas tij vjen tjetri edhe ai po ashtu i merr disa sende, pas tij personi tjetër e me radhë hynë dhe marrin sende, por ne rastin konkret nuk ekziston bashkëpunimi.

Për të konsideruar se ekziston bashkëpunimi me drejtën penale midis pjesëmarrësve duhet të shprehet lidhja e caktuar objektive dhe subjektive.

Lidhje objektive qëndron në atë se secili bashkëpunëtor duhet të ndërmarr ndonjë veprim me të cilin i kontribuon kryerjes së veprës penale. Me fjalë të tjera pasoja e veprës penale duhet të jetë rezultat i përbashkët i veprimeve të gjithë bashkëpunëtorëve.

Lidhje subjektive qëndron në atë se të gjithë bashkëpunëtorët duhet të jenë të vetëdijshëm se në kryerjen e veprës penale të caktuar do të marrin pjesë, do të veprojnë së bashku në mënyra të ndryshme.

Format e bashkëpunimit

Nocioni, format e bashkëpunimit si dhe llojet e bashkëpunëtorëve janë përcaktuar në nenet 31, 32, 33, 34, dhe 35 të KP të Kosovës dhe ato janë, bashkëkryerja, shtytja, ndihma dhe bashkimi kriminal, ndërsa me nenin 38 janë paraparë kufijtë e përgjegjësisë penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim.

BASHKËKRYERJA

Sipas dispozitës së nenit 31 të KP të Kosovës, bashkëkryerja ekziston nëse dy apo më shumë persona duke marr pjesë në veprimin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër së bashku kryejnë veprën penale. Nga ky përkufizim del se për tu konsideruar se është shprehur bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit duhet që dy apo më shumë persona të marrin pjesë në veprimin e kryerjes së veprës penale. P.sh. nëse dy apo më shumë persona me thikë e sulmojnë personin dhe i shkaktojnë vdekjen apo lëndime të rënda trupore,

Bashkëkryerja si formë e bashkëpunimit mund të kryhet si me dashje ashtu edhe nga pakujdesia.

Përgjegjësia dhe ndëshkimi i bashkëkryesit

Sipas nenit 31 të KP të Kosovës, secili bashkë kryes ndëshkohet me dënimin e parashikuar për veprën penale të kryer. Në këtë rast bashkëkryerësi përgjigjet penalisht brenda kufijve të dashjes apo pa kujdesisë. Me fjalë të tjera KP ka përvetësuar parimin e përgjegjësisë individuale të bashkëkryerësve.

Parimi që çdo bashkëkryerës përgjigjet brenda kufijve të dashjes së tij nënkupton edhe këtë se bashkëkryerësi nuk përgjigjet për aksesin e bashkë kryesit tjetër. P.sh. nëse bashkëkryerësit janë marr vesh që të hyjnë në një shtëpi dhe të vjedhin, dhe se në atë rast njeri prej bashkëkryerësve dhe e dhunon femrën e cila ka qenë në shtëpi, me këtë rast bashkëkryerësi tjetër nuk do të përgjigjet për aksesin e bashkëkryerësit tjetër, sepse marrëveshja e tyre ka qenë vjedhja e jo dhe dhunimi.

SHTYTJA

Sipas dispozitës së nenit 32 të KP, shtytja është njëra ndër format e bashkëpunimit në kuptimin e ngushtë. Kjo formë është paraparë me nenin 32, por në këtë nen nuk është përcaktuar nocioni i bashkëpunimit por në këtë dispozitë thuhet: kush do që me dashje e shtytë tjetrin të kryejë veprën penale dënohet sikurse ai ta kishte kryer atë veprën penale, nëse vepra penale është kryer nën ndikimin e tij.

Por edhe pse ligdhënësi nuk e ka përcaktuar nocionin e shtytjes, këtë e ka bërë teoria e drejtës penale dhe praktika gjyqësore, ashtu që në teori dhe praktikë shtytja përkufizohet si ndërmarrje e veprimeve të atilla me të cilat të personi tjetër me dashje shkaktohet ose forcohet vendimi për të kryer një veprën penale.

KP nuk përcakton mënyrat dhe mjetet me të cilat kryhet shtytja, por në praktikë është përvetësuar koncepti se shtytja mund të kryhet me çdo lloj veprimi me të cilin të tjetri mund të formohet apo të forcohet vendimi për të kryer veprën penale, si veprime të tilla praktika i merr p.sh. dhënien apo premtimin e dhuratës, lutja, dhënia e këshillave, përqeshja për shkak mos vendosmërisë. Kryesore është që nga veprimet e këtylla të personi tjetër të formohet apo të forcohet vendimi për të kryer veprën penale. Shtytja mund të ndërmirët nga një apo më shumë persona.

Shtytja duhet të jetë e drejtuar ndaj personi të caktuar si kryes i ardhshëm dhe me qëllim që të kryhet vepra penale e caktuar. Shtytja duhet të jetë e drejtuar me qëllim që të kryhet vepra penale e caktuar, vepra konkretë.

Shtytja është e mundshme të kryhet, vetëm deri sa personi nuk ka vendos ta kryej veprën penale, p.sh. fare nuk ka menduar të kryej vepër penale e shtytësi me veprimet e veta e bindë që të kryej vepër, ose ka vendos të kryej vepër por është labil nuk është i sigurt kështu që shtytësi paraqitet si person që ia forcon bindjen që të kryej veprën për të cilën kryesi nuk ka qenë i sigurt a ta kryej apo jo.

Sipas nenit 32 të KP shtytja mund të kryhet vetëm me dashje, dhe dënohet sikurse ai ta kishte kryer atë vepër penale, me kusht që vepra penale është kryer nën ndikimin e tij.

Në nenin 32 të KP është përcaktuar ndëshkimi i shtytësit dhe sipas kësaj dispozitë shtytësi dënohet për çdo lloj vepre penale si në rastet po ta kishte kryer vet veprën penale pa marr parasysh peshën e saj, me kusht që vepra penale të jetë kryer me ndikimin e tij. Pra si pre supozim që të mund të ndëshkohet shtytësi duhet që kryesi të ketë kryer veprën penale.

Përndryshe edhe pse parashihet se shtytësi dënohet sikurse edhe kryesi, nuk përjashtohet mundësia që shtytësi të dënohet më rëndë se kryesi i veprës penale.

Me KP shtytja është e paraparë edhe si vepër e posaçme penale.psh. nenin 147 nxitja, e urrejtjes, përçarjes, ose mosdurimit kombëtar, racor, fetar ose etnik, neni 162 shtytja për luftë agresive ose konfliktit të armatosur, neni 183 shtytja në vetëvrasje, neni 247.par.2,bashksia jashtëmartesore me personin nën moshën gjashtëmbdhjetë vjet e mitur nën 16 vjet.

Këtë ligjdhënësi e ka paraparë për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe të këtyre veprave penale dhe natyrës specifike të tyre.

Shtytja e pa suksesshme

Shtytja e pasuksesshme ekziston në rastet kur personi i shtytur nuk e ka kryer e as nuk ka tentuar të kryejë veprën penale. Meqë shtytja dënohet vetëm nëse është kryer vepra penale, së këndejmi rezulton se edhe për shtytjen e pasuksesshme shtytësi nuk dënohet.

Shkaqet që mund të shpiejnë në shtytjen e pasuksesshme mund të jenë të shumta dhe të natyrës së ndryshme. Për shembull, shtytja e pasuksesshme ekziston kur shtytësi nuk ka pasur sukses të bindë tjetrin për të kryer vepër penale ose kur shtytësi ka sukses që të bindë, mirëpo i shtyturi ndërron mendimin (vendimin) para se të ketë filluar kryerjen e veprimeve që hyjnë në zonën kriminale, që konsiderohen vepër penale. Gjithashtu, shtytja e pasuksesshme shprehet edhe atëherë kur për shkaqe objektive i shtyturi nuk ka mundur të kryejë veprën penale. Do të bëhet fjalë për shtytjen e pasuksesshme edhe atëherë kur i shtyturi i ka ndërmarrë vetëm veprimet përgatitore, të cilat sipas Kodit Penal nuk ndëshkohen. Shtytja e pasuksesshme do të ekzistojë edhe

në rastet kur “shtytësi” e ka shtytur personin i cili më parë ka vendosur të kryejë veprë penale, ose kur i shtyturi fare nuk e ka kuptuar shtytësin.

Duhet theksuar se si shtytje e pasuksesshme konsiderohet edhe rasti kur i shtyturi kryen krejtësisht tjetër veprë penale nga ajo për të cilën ka qenë i shtytur. Në këso rastesh konsiderohet se është shprehur i ashtuquajtur *eksces kualitativ i shtytjes*, i cili sipas teorisë aksesore të limituar nuk ka bazë për prëgjegjësinë e bashkëpunëtorit, përkatësisht të shtytësit. Rast i tillë është p.sh. nëse personi A e shtytë personin B që të kryej veprën penale të marrëdhënies seksuale me dhunë, ndërsa personi B. e kryen lëndimin e rëndë trupor apo vjedhjen grabitqare.

NDIHMA

Si formë e bashkëpunimit, është e paraparë me dispozitën e nenit 33 të KP të Kosovës. Ndhimja është ndërmarrja e veprimeve me të cilat një person me dashje ndihmon tjetrin të kryejë veprë penale. Këto janë veprimet me të cilat ndihmohet kryerja e veprës penale, apo veprime që ndërmerren gjatë kohës së kryerjes së veprës penale me të cilat lehtësohet kryerja e saj. Nga nocioni dhe natyra juridike e ndihmës del se veprimet e kësaj forme të bashkëpunimit konsistojnë në ndërmarrjen e veprimeve të tilla me të cilat nuk kryhet vepra penale por vetëm ndihmohet kryerja e saj. Përndryshe veprimet e ndihmës duhet të paraqesin kontribut në realizimin e veprës penale. Ndhimja si formë e bashkëpunimit mund të kryhet vetëm pasi që personi tjetër ka vendosur të kryej veprë penale, ashtu që në rastet kur veprimet ndërmerren para se të ketë vendosur personi tjetër të kryej veprë penale, mund të konsiderohet vetëm si shtytje e jo si ndihmë.

Në nenin 33 par. 2 të KP të Kosovës, në mënyrë ekzemplare janë cekur disa mënyra apo forma me të cilat mund të kryhet ndihma. Në këtë dispozitë është paraparë se ndihma, kryesit mund ti jepet në dy mënyra, ndihma fizike dhe ndihma psikike. Si ndihmë fizike konsiderohet vënia apo dhënia në disponim e mjetet kryesit, për kryerjen e veprës, mënjanimi i pengesave, bërja rroje gjatë kohës së kryerjes së veprës penale, kontrollimi i mjeteve me të cilat duhet të kryhet vepra penale e kështu me radhë. Si ndihmë psikike konsiderohet dhënia e këshillave, udhëzimeve, premtimit për fshehje të veprës, kryesit dhe gjurmëve të veprës penale.

Ndryshe nga shtytja e cila për shkak të natyrës së saj mund të kryhet vetëm me veprim, ndihma mund të kryhet me veprim dhe mos veprim.

Lidhur me kohën, ndihma jepet zakonisht para se të filloj kryerja e veprës penale, mirëpo ndihma mund të kryhet edhe gjatë kohës së kryerjes së veprës penale, deri sa nuk ka përfunduar vepra penale në kuptimin material. Veprimet që ndërmerren pasi të jetë kryer vepra penale nuk mund të konsiderohen si ndihmë, me kusht që të mos jetë premtuar më parë, para se të ketë filluar kryerja e veprës penale. Nëse jepet pasi të ketë përfunduar vepra penale, kemi të bëjmë për veprën e veçantë të fshehjes së kryesit pas kryerjes së veprës penale apo ndihmës pas kryerjes së veprës penale.

Ndihma e pasuksesshme

Do të ekzistojë atëherë nëse personit që i është dhënë ndihma nuk e ka kryer veprën penale ose nuk ka tentuar ta kryejë, apo nuk ka ndërmarrë veprimet përgatitore të cilat ndëshkohen. Ndihmë e pasuksesshme konsiderohet edhe rasti kur kryerësi e refuzon ndihmën. Gjithashtu do të konsiderohet se ekziston ndihma e pasuksesshme edhe atëherë kur me rastin e kryerjes së veprës penale, kryerësi i veprës fare nuk i ka shfrytëzuar veprimet e ndihmësit. Për shembull, personi A. veprën penale të vrasjes e kryen me pushkë, e jo me helmin që ia ka dhënë ndihmësi. Ose rasti tjetër, personi A. veprën penale të vjedhjes e kryen duke e thyer dritaren, e jo me çelësin fals që ia ka dhënë ndihmësi.

Kodi ynë Penal nuk përmban ndonjë normë me të cilën do të rregullonte çështjen e ndëshkimit për ndihmën e pasuksesshme. Andaj mund të konkludojmë se ndihma e pasuksesshme nuk ndëshkohet. Zgjidhja e këtillë është edhe e arsyeshme. Përkatësisht, sipas përkufizimit që është dhënë në Kodin Penal, ndihma e pasuksesshme nuk konsiderohet bashkëpunim, ngase nuk paraqet kontribut kauzal në kryerjen e veprës penale. Me fjalë të tjera, në rastin e ndihmës së pasuksesshme, veprimet e ndihmësit nuk inkorporohen në rezultatit kriminal, ngase është bërë ndërprerja e rrjedhës së kauzalitetit, sipas vullnetit të kryerësit apo nën ndikimin e rrethanave të tjera (për shembull, nëse revolja të cilën ia ka dhënë kryerësit të vrasjes ka dështuar, nuk ka funksionuar dhe për këtë arsye nuk është përdorur për kryerjen e veprës). Mirëpo, ndihma e pasuksesshme mund të inkriminohet si vepër penale e posaçme. Rasti i tillë është me veprën penale, furnizimi me pajisje ose materiale që janë të destinuara për prodhimin apo trafikimin e substancave narkotike ose psikotropike ose analog, (neni 274 par. 4). vepra penale për të cilin ligji parasheh dënim edhe për tentativë. Gjithashtu ndihmësi dënohet edhe në rastet kur kryesi ka ndërmarr veprime përgatitore po që se edhe për të është paraparë ndëshkimi me ligj.

Ndihma si vepër e posaçme penale. Për shkak të natyrës së disa veprave penale, për të cilat jepet ndihma dhe për disa shkaqe kriminalo-politike, ndihma mund të konsiderohet si vepër e posaçme dhe e pavarur penale nga vepra penale e kryerësit. Rastet e tilla janë p.sh. ndihma në vetëvrasje (neni 183), ndihma gruas shtatzënanë që ta ndërpresë shtatzëninë (neni 184), dhënia ndihmë kryerësit pas kryerjes së veprës penale (neni 388), mundësimi i arratisjes së personit të privuar nga liria (neni 406).

Ndihma si vepër penale e posaçme në disa raste mund të inkriminohet për vepra për të cilat kryerësi nuk dënohet, përkatësisht kur vepra e kryerësit nuk konsiderohet si vepër penale. Rast i tillë është p.sh. dhënia ndihmë personit tjetër që të kryejë vetëvrasje ose dhënia ndihmë gruas me barrë që ajo vetë të bëjë ndërprerjen e shtatzënisë. Në këto dy raste, personi që tenton të bëjë vtëvrasje, apo gruaja që në trupin e vet bën ndërprerjen e shtatzënisë, nuk konsiderohet se kanë kryer vepër penale, kurse personi që u ndihmon konsiderohet se ka kryer vepër penale dhe dënohet.

BASHKIMI RIMINAL

Bashkimi kriminal është forma më e rëndë e bashkëpunimit edhe për nga natyra e tij juridike dhe kriminalo-politike dallohet nga format e tjera të bashkëpunimit. Specifikat e bashkimit kriminal kanë kontribuar që ky lloj bashkëpunimit me arsye të trajtohet si bashkëpunim “sui generis”.

Bashkimi kriminal sipas Kodit Penal. Kodi Penal i kushton rëndësi të posaçme krimet të organizuar, i cili kryehet në forma të ndryshme të bashkimit kriminal. Kjo nga fakti se sikundër në shtet e tjera, edhe në Kosovë nga bashkimi kriminal kryhen llojet më të rënda të veprave penale, siç janë vrasjet, kidnapimet, tregtia me drogë, trafikimi i njerëzve, terrorizmi etj. Krahas kësaj, rregullimin e bashkimit kriminal me norma të posaçme penale, ndryshe nga format e tjera të bashkëpunimit, e ka determinuar edhe fakti se në legjislacionet bashkëkohore dhe në shkencën e së drejtës penale, siç cekëm më sipër, rregullat e përgjithshme të cilat i dedikohen pjesëmarrjes së shumë personave në kryerjen e veprave penale, nuk janë të mjaftueshme, ngase krimi i organizuar është fenomen i posaçëm për të cilin duhet të përcaktohen rregulla të posaçme. Suazat juridike penale për rregullat e këtilla duhet të sigurojnë inkriminimin e formave të ndryshme të kryerjes së veprave penale në mënyrë të organizuar. Në frymën e këtij koncepti, tani një numër i konsiderueshëm i legjislacioneve penale të Evropës i kanë braktisur rregullat restriktive të ndëshkimit të bashkimit kriminal. Në këtë drejtim në dekadën e fundit janë bërë ndryshme në Kodin penal të Gjermanisë, Zvicrës, Italisë, Francës etj.

Në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, në paragrafin 1 të nenit 34, është përcaktuar nocioni i bashkimit kriminal. Në Kodin tonë Penal përkufizimi i bashkimit kriminal është bërë sipas modelit anglo-amerikan të institutit “*conspiracy*”. Duhet theksuar se tani këtë model janë duke e përvetësuar gjithnjë më tepër edhe kodet penale të shteteve të tjera të Evropës.

Nocioni bashkim kriminal është nocion gjenerik, nocion i përgjithshëm, me të cilin nënkuptohet kryerja e veprës penale në bashkëpunim nga dy apo më shumë persona. Kodi i ynë Penal, si dhe kodet penale të shteteve të tjera, nuk i cekë format e bashkimit kriminal nëpërmjet të cilit kryhen së bashku veprat penale, mirëpo këtë e bën teoria dhe praktika gjyqësore. Përkatësisht, sipas shkencës së të drejtës penale dhe praktikës gjyqësore, me nocionin gjenerik të bashkimit kriminal duhet nënkuptuar: *marrëveshjen, grupin, organizatën, bandën, rrjetin apo ndonjë lloj bashkimi tjetër me qëllim të kryerjes së veprave penale*. Këta terma si forma të bashkimit kriminal, nëpërmjet të cilit kryhet krimi i organizuar i ndeshim edhe në pjesën e posaçme të Kodit Penal dhe atë si forma të kualifikuara të veprave penale.

Përgjegjësia penale dhe ndëshkimi i anëtarëve të bashkimit kriminal. Bashkimi kriminal si institut i përgjithshëm i së drejtës penale, është paraparë me qëllim të inkriminimit të fazës më të hershme të kryerjes së veprës penale, në fazën e përgatitjes së veprës penale. Me këtë institut në faktë ndëshkohen veprimet përgatitore, vepra këto të cilat ndryshe quhen *delicta preparata*. Në frymën e këtij koncepti, sipas dispozitës së paragrafit 1 të nenit 34, personat hyjnë në zonën kriminale, ndëshkohen vetëm nëse

merren vesh, arrijnë marrëveshje që të kryejnë apo shtytin të tjerët për të kryer veprë penale për të cilën me ligj është paraparë dënimi me burgim së paku pesë vjet dhe nëse ndërmarrin edhe veprimet përgatitore për realizimin e marrëveshjes.

Sipas kësaj dispozite, rezulton se në rastin e bashkimit kriminal, personi konsiderohet penalisht përgjegjës dhe dënohet nëse janë plotësuar këto kushte:

- nëse ka arritur marrëveshje në mënyrë shprehimore apo të heshtur me një apo me shumë persona që të kryejë veprë penale;
- nëse ka arritur marrëveshje me një apo me shumë persona që të shtytin të tjerët që të kryejnë vepra penale;
- kjo marrëveshje në të drejtën penale konsiderohet relevante vetëm nëse është kryer me dashje;
- vepra penale për të cilën është arritur marrëveshja për t'u kryer duhet të jetë e dënuar së paku me pesë vjet burgim dhe
- nëse me qëllim të kryerjes së veprës penale, për të cilën është arritur marrëveshja, janë ndërmarrë edhe veprimet përgatitore për realizimin e marrëveshjes, për shembull, është bërë furnizimi me armë me qëllim të kryerjes së vrasjes, apo janë blerë automjete me qëllim të trafikimit të drogës.

Të gjitha këto kushte duhet të përmbushen në mënyrë kumulative për t'u konsideruar se ekziston bashkimi kriminal dhe që të mund të ndëshkohen personat për këtë formë të bashkëpunimit. Lidhur me këtë duhet veçmas të theksohet se sipas Kodit Penal kjo formë e bashkëpunimit do të konsiderohet se ekziston dhe pjesëmarrësit e tij do të dënohen, edhe pse nuk është kryer apo nuk është tentuar të kryhet vepra penale për të cilën janë marrë vesh. *Mjafton që të jetë arritur marrëveshja dhe që të jenë ndërmarrë veprimet përgatitore me qëllim të realizimit të marrëveshjes.*

Meqë krimi i organizuar, i cili kryhet nga forma të ndryshme të bashkimit kriminal, vështirë zbulohet nga organet e ndjekjes, ngase organizohet në mënyrë shumë sekrete, konspirative, në paragrafin 2 të nenit 34 është paraparë një dispozitë e karakterit kriminal politik me qëllim të lehtësimit të zbulimit dhe të luftës më efektive kundër krimit të organizuar, përkatësisht të bashkimit kriminal. Në këtë dispozitë është paraparë shprehimisht se gjykata mund t'ia zvogëlojë dënimin apo ta lirojë tërësisht nga dënimi anëtarin e bashkimit kriminal i cili është penalisht përgjegjës në këto raste:

- nëse vullnetarisht heq dorë nga marrëveshja;
- nëse vullnetarisht ndërmerr veprime për parandalimin e ekzistimit të vazhdueshëm të bashkimit kriminal ose të kryerjes së veprës penale në pajtim me qëllimet e saj, ose
- nëse vullnetarisht ia zbulon policisë njohuritë e marrëveshjes në kohën e duhur kur veprat penale të planifikuara ende mund të parandalohen.

Bashkimi kriminal si veprë penale e posaçme në Kodin penal. Në disa raste për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe dhe për shkaqe të caktuara kriminalo-politike, në pjesën e posaçme të Kodit Penal, format e ndryshme të bashkimit kriminal janë paraparë si vepra penale të veçanta. Numri i inkriminimeve të bashkimit kriminal,

të cilat janë të parapara si vepra penale të posaçme apo si forma të rënda të këtyre veprave penale, në Kodin Penal është relativisht i madh. Sa për ilustrim po i cekim vetëm disa prej tyre: organizimi, përkrahja dhe pjesëmarrja në grupet terroriste (neni 143); organizimi i grupit për kryerjen e krimit të gjenocidit, krimeve kundër njerëzimit dhe krimeve të luftës (neni 160); organizimi i personave apo pjesëmarrja në trafikimin e njerëzve (neni 171, par.3); prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve të rrezikshëm dhe i substancave psikotropike nga anëtarë i një grupi (neni 274, par.4, pika 1); organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të ndaluar (neni 300); pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar (neni 283) etj.

Kufijtë e përgjegjësive penale dhe ndëshkimi për bashkëpunim

Bashkëkryesi është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes apo të pakujdesisë së vet.

Personi i cili shtytë ose ndihmon në kryerjen e veprës penale është penalisht përgjegjës brenda kufijve të dashjes së tij. Rrethanat personale, përfshirë marrëdhëniet dhe cilësitë të cilat mund të rezultojnë në përjashtimin nga përgjegjësia penale, lirim nga dënimi, ekzistimin e formave të rënda apo të lehta të veprës penale ose që ndikojnë në përcaktimin e dënimit, mund të merren parasysh vetëm ndaj personit për të cilin vlej. Nëse rrethanat personale të cilat ndërlidhen me kryesin kanë ndikim në zbutjen ose ashpërsimin e dënimit dhe këto rrethana konstituojnë element të veprës penale, bashkëkryesi, shtytësi ose ndihmësi është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale kur ai ka ditur për këtë rrethanë, edhe nëse nuk ka pasur lidhshmëri me të.

Për format e bashkëpunimit, sipas teorisë së aksesoritetit të limituar, teori kjo e cila është përvetësuar në Kodin Penal, vlen rregulla parimore se bashkëpunëtorët përgjigjen brenda kufijve të dashjes së tyre, pavarësisht nga përgjegjësia e kryerësit kryesor. Brenda këtyre kufijve për përgjegjësinë është me rëndësi shkalla e realizimit të veprës. Nga kjo rezulton se nëse vepra është përfunduar nga kryerësi, shtytësi dhe ndihmësi përgjigjen për veprën e kryer sipas dispozitave të nenit 32 dhe 33. Nëse vepra penale ka ngelë në tentative edhe bashkëpunëtorët do të përgjigjen sipas shkallës së realizimit, përkatësisht për tentative.

PËRGJEGJËSIA PENALE E PERSONAVE JURIDIK

Legjislacioni penal i mëparshëm i Kosovës nuk e ka njohur personin juridik si kryerës i veprës penale, duke u mbështetur në parimin se personi juridike nuk mund të përgjigjet për veprën penale (*societas delinquere non potest*). Këso koncepti ka qenë i pranishëm edhe në legjislacionet e shteteve të Evropës. Mirëpo ky koncept ndryshoi në dekadat e fundit, ngase u lajmëruan forma të atilla të kriminalitetit që u kushtëzuan nga korporatat e ndryshme biznesore. Lajmërimin e formave të reja të veprave penale, madje edhe shumë të rrezikshme me pasoja dhe përmasave të mëdha e kushtëzoi

edhe fuqizimi i rolit të këtyre korporatave jo vetëm në sferën ekonomike por edhe në sektorin publik, në ndërmarrjet publike dhe ente, në paranë publike, tendere etj. Këto dhe rrethanat tjera e shtruan domosdon që edhe personat juridik të konsiderohen subjekt të veprës penale.

Obligimi që shtetet në legjislacionet e tyre ta akceptojnë konceptim që edhe personat juridik të konsiderohen subjekt i veprës penale, ka rrjedhë edhe nga konventat ndërkombëtare në të cilat janë të inkriminuara format e reja të kriminalitetit siç janë; krimi i organizuar, korupsioni, larja e parasë, ndotja e mjedisit etj. Konventa të tilla me të cilat shtetet obligohen që në legjislacionet e tyre ta akceptojnë konceptin se edhe personat juridik të konsiderohen kryerës të veprave penale të caktuara, janë p.sh. Konventa e Këshillit të Evropës për larjen e paras si dhe zbulimin, ngrirjen dhe konfiskimin e fitimit nga vepra penale (1990) si dhe Konventa më e re - Konventa për larjen e parasë, ngrirjen dhe konfiskimin e fitimit pasuror të realizuar nga kriminaliteti dhe finansimin e terrorizmit (2005); Konventa e këshillit të Evropës për parandalimin e korupsionit (1999) dhe Konventa e Organizatës së Kombeve të Bashkuar për parandalimin e korupsionit (2003).

Tani një numër i madh i shteteve të Evropës, në legjislacionet e tyre e kanë përvetësuar konceptin se edhe personat juridik duhet të konsiderohen kryerës të veprave të caktuara penale dhe gjithashtu parashihen edhe llojet të atilla dënimeve të cilat ndryshojnë nga dënimet e parapara për personat fizik. Konceptin e këtillë p.sh. e kanë përvetësuar Anglija, Irlanda, Norvegjia, Çipro, Franca, Belgjika, Finlanda, Sllovenia, Kroacia etj. Sipas ecurive të gjerëtanishme mund të thuhet se po vrehet një trend ndërkombëtar për akceptimin e konceptit jo vetëm në shtetet e Evropës por edhe më gjerë se edhe personi juridik duhet të konsiderohet subjekt i veprës penale.

Edhe në të drejtën penale të Kosovës është pranuar koncepti se edhe personi juridik mund të konsiderohet subjekt, kryerës i veprës penale. Kështu Kodi Penal i Kosovës i cili hyri në fuqi me 6 prill të vitit 2004, në nenin 106 parashikonte se çështja e përgjegjësisë penale e personave juridik do të rregullohet me ligj të veçant. Tani me ndryshimet dhe plotësimet e Kodit Penal të cilat hynë në fuqi me 1 janar të vitit 2013, është paraparë neni 40 me katër paragrafe me të cilin është paraparë edhe përgjegësia penale e personave juridik. Krahas kësaj dispozite, Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar Ligjin për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale i cili hyri në fuqi me 1, janar 2013. Në këtë Ligj, sipas modeleve të avansuara të shteteve të Bashkimit Evropian, në 34 nene në mënyrë gjithëpërfshirëse është rregulluar çështja e përgjegjësisë së personave juridik për veprat penale.

Dispozita e nenit 40 të Kodit Penal, për nga natyra dhe përbajtja e saj është e karakterit parimor dhe bazik. E njehta dispozitë e paraparë në këtë nen, është e paraparë edhe në nenin 5 të Ligjit për përgjegjësinë e personave juridik për vepra penale.

Për shkak të specifikave të veprave të kundërligjshme të cilat i kryejnë personat juridik, vepra këto të cilat konsiderohen vepra penale, çështja e përgjegjësisë së tyre është rregulluar në mënyrë specifike dhe ndryshe nga përgjegësia e personave juridik. Marrë në përgjithësi, ndryshe nga përgjegësia e personit fizik, përgjegësia e personit juridik supozohet. Lidhur me këtë, përgjegësia e personit juridik bazohet në

teorinë e identifikimit (*alter ego*), teori kjo e cila e pranon konceptin se vepra e personit përgjegjës është vepër edhe e personit juridik.. Këtë teori e ka përvetësuar nëni 40 i Kodi Penal Kosovës dhe Ligji për përgjegjësin e personave juridik për veprat penale.

DËNIMET

Dënimet janë në epiqendër të vëmendjes të së drejtës penale dhe të politikës kriminale. Çështjet e tjera, të cilat i rregullon legjislacioni penal, sado të rëndësishme që të jenë, i referohen parakushteve për zbatimin e dënimeve dhe sanksioneve tjera apo çështjeve të tjera lidhur me zbatimin e tyre.

Dënimet janë masa që i ndërmerr shteti me qëllim të mbrojtjes nga kriminaliteti. Këto janë një lloj i reagimit i shtetit ndaj kryerësve të veprave penale dhe ndërmerren me qëllim të mbrojtjes së qytetarëve dhe shoqërisë nga veprat e dëmshme. Dënimet kanë për qëllim që të sigurojnë kushtet elementare të jetës së përbashkët në shoqërinë e organizuar. Në të kundërtën, nëse zbatimi i dënimeve nuk është në funksion të luftimit të kriminalitetit, por i shërben interesave të ngushta burokratike apo partive politike, gjykatat bëhen vegël e tyre.

Dënimi është i arsyeshëm vetëm në atë masë e cila është e nevojshme për funksionimin e jetës së përbashkët. Dënimi është mjet i fundit i shoqërisë për luftimin e kriminalitetit. Ndëshkimi është i arsyeshëm vetëm atëher kur nuk ka mënyrë më të mirë për mbrojtjen e qytetarit dhe të shoqërisë (*klauzozla ultima ratio*). Por kjo domosdoshmëri e aplikimit të dënimit kërkon që ndëshkimi të realizohet vetëm në mënyrën dhe në formën e cila i përgjigjet konceptit të shoqërisë së kohës sonë, të jet në pajtim me perceptimin e tërësishëm të kulturës së sotme dhe postulateve demokratike. Këto postulate njëherit i ndalojnë dënimet e vrazhda, nënçmuese dhe tretmanin johuman të kryerësit të veprës penale.

Dënimet janë masa shtrënguese që zbatohen me dhunë dhe paraqesin represion ndaj kryerësit të veprës penale. Me anë të dënimeve kryerësit të veprës penale i kufizohen apo i merren të drejtat, liritë dhe vlerat e tjera shumë të rëndësishme, siç është liria e lëvizjes, pasuria, ndalimi i ushtrimit të profesionit etj. Dënimet, madje edhe ato ndër më të lehtat, në një masë janë një e keqe që godasin personin që ka kryer vepër penale. Gjithashtu, dënimet, për shkak të natyrës, peshës dhe implikimeve të tyre ndaj qytetarëve dhe shoqërisë në përgjithësi, janë çështje edhe të interesit të opinionit të gjerë.

Qëllimi i dënimit

Qëllimi i dënimit sipas Kodit Penal. Kodi i ynë Penal penal i përvetëson teorinë e përziera lidhur me qëllimin e dënimit. Përfundimi i këtille del nga dispozitat e nenit 41 të Kodit Penal. Në këtë dispozita është paraparë se qëllimet e dënimit janë: 1) Të parandalojë kryesin që në të ardhmen të mos kryej vepra penale dhe të bëjë rehabilitimin e tij; 2) Të parandalojë personat e tjerë të mos kryejnë vepra penale; 3) Të bëjë komensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara

nga vepra penale; dhe 4) Të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Nga dispozitat e sipërpërmendura të Kodit Penal, del qartë se e drejta jonë e përvetëson preventivën e posaçme (speciale) dhe të përgjithshme (gjenerale) si qëllim të dënimit.

Preventiva e posaçme shprehet në **pikën 1** të nenit 41, në të cilën si qëllim i dënimit parashihet “parandalimi i kryerësit të veprës të kryejë vepra penale dhe rehabilitimi i tij”.

Preventiva e përgjithshme është përcaktuar në **pikën 2** të nenit të njëjtë, ku thuhet se qëllimi i dënimit është të parandalojë personat e tjerë që të mos kryejnë vepra penale, përkatësisht ndikimi preventiv ndaj të tjerëve që të mos kryejnë vepra penale.

Në **pikën 3** të kësaj dispozite është paraparë shprehimisht se qëllim i dënimit është edhe kompensimi i viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale. Qëllimi edhe i këtillë i dënimit është paraparë ngase çdo vepër penale shkakton një të keqe, i shkakton dëmë individit ose komunitetit. Kompenzimi i viktimës së veprës penale është në harmoni me konceptin bashkëkohor të drejtësisë restorative. Drejtësia restorative nisët nga koncepti se çdo vepër penale është në kundërshtim me ligjin dhe shkakton pasoja të dëmshme, andaj dënimi duhet të ketë edhe qëllim që ta restauroj, riparoj, ta ndreqë dëmin e shkaktuar me vepër penale, duke e bërë kompenzimin e viktimës.

Në **pikën 4** thuhet se qëllim i dënimit është edhe që të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Në kohën e fundit këtij aspekti të qëllimit të dënimit i kushtohet rëndësi e madhe. Ky qëllim ndryshe emërtohet si preventiv pozitive gjenerale. Synimi i këtillë i dënimit ka për qëllim që t’i përforcoj nomat e moralit dhe të shoqërisë. Përforcimi i këtyre normave është diga më e fortë në parandalimin e kriminalitetit. Koncepti i ngritjes së moralit dhe të ndiesisë për respektimin e ligjit është koncept modern i preventivës gjenerale përforcimit të moralit.

Qëllimi i preventivës së përgjithshme apo gjenerale të dënimit, i cili është sublimuar në Kodin Penal me postulatit që të ushtrojë ndikim edukativ ndaj të tjerëve, që të ndikoj në ndërgjegjësimin e qytetarëve për pasojat e dëmshme të veprës penale. Kjo arrihet edhe me një atribut të dënimit, i cili shprehimisht nuk është theksuar në Kodin Penal, mirëpo ai është imanent në të. Ky është në fakt efekti frikësues i dënimit ndaj kryerësve të mundshëm të veprave penale. Rrjedhimisht, me faktin se për çdo vepër penale është paraparë dënimi që do t’i shqiptohet kryerësit të veprës penale, kjo është një lloj kanosje, një lloj vrejthe dhe si e tillë ushtron edhe efekte frikësuese. Ushtron aso efekte që njerëzit të mos kryejnë vepra penale. I zmbrajs ata nga kryerja e veprës penale. Lidhur me këtë, disa autorë me të drejtë theksojnë se nuk mund të ushtrohet preventiva gjenerale pa frikësim. Kjo në brendinë e saj do të thotë se ata, të cilët nuk kanë kryer vepra penale, duhet të frikësohen duke i ndëshkuar fajtorët. Krahas kësaj, shumë persona nuk kryejnë vepra penale ngase e dinë se do të ndëshkohen dhe kështu krahas privimeve të tjera, do ta humbasin edhe autoritetin që gëzojnë në shoqëri.

Koncepti i këtillë i efektit frikësues të dënimeve me vetëm faktin që janë paraparë në legjislacionin penal është i pranishëm edhe në literaturën juridike të Francës.

Ndërsa në kuadër të preventivës gjenerale, edhe pse nuk është thënë shprehimisht, e drejta penale aspirojnë që të ushtrojë funksionin etik dhe përgjegjësive në shoqëri. Përkatësisht, me faktin se dënimi u shqiptohet atyre personave që cenojnë moralin e shoqërisë, i cili është shkelur me kryerjen e veprës penale, del se qëllimi i dënimit është edhe mbrojtja e moralit në shoqëri.

Krahas preventivës speciale dhe gjenerale si qëllim i dënimit, në shkencën e së drejtës penale shtrohet pyetja se a është edhe hakmarrja, retribucioni qëllim i dënimit. Disa autorë në mënyrë kategorike ia mohojnë dënimit këtë qëllim, disa nuk flasin fare për këtë, ndërsa grupi i tretë i autorëve pohojnë se dënimi ka edhe qëllim hakmarrës.

LLOJET E DËNIMEVE

Llojet e dënimeve janë:

1. dënimet kryesore;
2. dënimet alternative; dhe
3. dënimet plotësuese.

Dënimet kryesore janë lloje të cilat mund të shqiptohen si të vetme dënime, pavarësisht prej llojit tjetër të dënimeve dhe me zbatimin e tyre në tërësi mund të realizohet qëllimi i ndëshkimit. Këto dënime mund t'u shqiptohen vetëm kryerësve madhor të veprave penale dhe të cilët janë penalisht të përgjegjshëm.

Dënimet alternative në brendinë e tyre janë substitute, zëvendësim i dënimit me burgim. Spektri i tyre është mjaftë i gjërë dhe i llojllojshëm. Këto lloje të dënimeve në fakt janë lloj i posaçëm i masave parapenale, me të cilat në të gjitha rastet e mundhsme, kryerësi i veprës penale në vend që të dënohet me burgim, atij i tërhiqet vërejtja dhe njëherit i caktohen obligime të cilat duhet t'i përmbushë Brenda afatit të caktuar. Nëse nuk i përmbushë obligimet e caktuara nga gjykata, siç do të shohim në vazhdim, dënimet alternative mund të revokohen dhe të shëndrrohen në dënim me burgim.

Dënime plotësuese janë ato lloje të dënimeve të cilat mund të shqiptohen vetëm së bashku me dënimin kryesor apo alternativ. Dënimet plotësuese në fakt janë dënime komplementare dhe duhet ta sforcojnë efektin e dënimit kryesor. Rrjedhimisht, në rastet kur gjykata konstaton se vetëm me shqiptimin e dënimit kryesor nuk mund të ushtrohet funksioni i luftës kundër kriminalitetit dhe nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit, do ta shqiptojë edhe njërin nga dënimet plotësuese. Gjer me hyrjen në fuqi të Kodit Penal, shumica dërrmuese e nëntë llojeve të dënimeve plotësuese të parapara në nenin 62, janë konsideruar si masa sigurorese.

DËNIMET KRYESORE

Llojet e dënimeve kryesore janë:

- 1. dënimi me burgim të përjetshëm;**
- 2. dënimi me burgim dhe**
- 3. dënimi me gjobë.**

Rendradhitja e dënimeve në Kodin Penal e përcakton relacionin e tyre me rastin e shqiptimit. Ky sistem është përcaktuar sipas peshës së dënimeve dhe njëherit ka rëndësi praktike në rastet kur shtrohet çështja e zbutjes së dënimit.

Dënimet kryesore janë ato të cilat ligji i parasheh se mund të shqiptohen si masë kryesore e ndëshkimit. Këto janë ato lloje të dënimeve që mund të shqiptohen si të vetme ndaj kryerësit të veprës penale, pavarësisht prej llojit tjetër të dënimit. Kryesisht këto janë dënime të tilla me të cilat gjykata vlerëson se me zbatimin e tyre si të vetme mund ta realizojnë funksionin e ndëshkimit.

Në të gjitha sistemet ndëshkimore të legjislacioneve penale të shteteve bashkëkohore, dënimi me burgim zë vend qendror, ngase për numrin më të madh të veprave penale është paraparë ky lloj dënimi. Edhe në Kodin Penal të Kosovës, përkundër parashikimit të një numri të konsiderueshëm të dënimeve alternative si supstitute të dënimit me burgim, për numrin më të madh të veprave penale është paraparë dënimi me burgim.

Dënimi me burgim të përjetshëm apo me burgim është gjithëherë dënim kryesor. Ndërsa dënimi me gjobë, përkatësisht me të holla, mund të jetë edhe kryesor edhe plotësues. Dënimi me gjobë në asnjë dispozitë të Kodit Penal nuk është paraparë si i vetmi dënim kryesor, por gjithëherë është paraparë në mënyrë alternative me dënimin me burgim. Në rastet kur dënimi me gjobë me ligj është paraparë në mënyrë alternative me dënimin me burgim, do të jetë kryesor nëse gjykata e shqipton si të vetmin dënim, ndërsa do të jetë plotësues nëse gjykata, krahas dënimit me burgim, shqipton edhe dënimin me gjobë. Kurse dënimi me gjobë është plotësues në rastet kur për një vepër është paraparë në mënyrë kumulative me dënimin me burgim. Gjithashtu dënimi me gjobë mund të shqiptohet si dënim plotësues krahas dënimit me burgim me kusht (neni 52, par. 5). Në rastet kur gjykata krahas dënimit me burgim me kusht e shqipton edhe dënimin me gjobë pa kusht, atëherë dënim kryesor konsiderohet dënimi me kusht, ndërsa dënimi me gjobë është e karakterit plotësues.

Dënimi me burgim të përjetshëm

Paraparja e dënimit me burgim të përjetshëm në Kodin Penal është rrjedhojë e abrogimit të dënimit me vdekje në Kosovë. Të gjitha shtetet të cilat e kanë hequr dënimin me vdekje, në vend të tij, në legjislacionet e tyre penale, e kanë paraparë dënimin me burgim afatgjatë deri në 30 apo 40 vjet, kurse disa shtete të tjera e kanë paraparë dënimin me burgim të përjetshëm. Siç shihet, kështu është vepruar edhe në Kodin penal të Kosovës.

Në Kodin Penal që pushoj së vepruari me 31 dhjetor 2012, dënimi më i rëndë ka qenë dënimi me burgim afatgjatë në kohëzgjatje prej 21 deri në 40 vjet. Përkundër

faktik se ky dënim ishte mjaftë i rëndë, në këto dhjetë vjetë e fundit u kryen edhe vepra penale jashtëzakonisht të rënda për kryerësit e të cilave as ky dënim nuk ishte adekuat. Gjithashtu arsyeshmëria e ashpërsimit të politikës ndëshkimore e cila u manifestuar me paraparjen e burgimit të përjetshëm në vend të burgimit afatgjatë konsiston në faktin se akoma edhe sot e kësaj dite mund të gjenden aso kryerës të veprave penale jashtëzakonisht të rënda, kështu që paraparja e burgimit të përjetshëm është edhe një lloj vrejje dhe kërcnimi për këso kryerës potencial. Për paraoarjen e burgimit të përjetshëm, duke I marrë parasysh të gjitha këto që u thanë dhe arsyet tjera, në rradhën e ekspertve kosovar si dhe të atyre ndërkombëtar, pa kurfar hezitimi u morrë qëndrim që në Kodin Penal që hyri në fuqi me 1. janar 2013 të parashihet burgimi i përjetshëm për veprat penale shumë të rënda.

Në Kodin Penal dënimi me burgim të përjetshëm është paraparë për format më të rënda të veprave penale ose të kryera në rrethana veçanërisht të rënda ose që kanë shkaktuar pasoja shumë të rënda (neni 44, par. 1).

Kufizimet për paraparjen dhe shqiptimin e burgimit të përjetshëm, janë të ngjashme me ato të cilat kanë qenë të parapara në legjisllacionin penal të mëparshëm për dënimin me vdekje. Këto kufizime janë të ngjashme edhe për veprat penale, ngase ky dënim kryesisht është paraparë për llojet dhe format më të rënda të veprave penale për të cilat më pare ka mundë të shqiptohet dënimi me vdekje. Meqë dënimi me burgim të përjetshëm është lloji më i rëndë i dënimit në Kodin Penal, është e kuptueshme që ligjdhënësi ka caktuar një vargë kufizime për paraparjen dhe shqiptimin e tij.

Në paragrafin 2 është përcaktuar një kusht i karakterit parimor, në të cilin thuhet se dënimi me burgim të përjetshëm në asnjë rast nuk mund të parashihet si lloji i vetëm i dënimit për një vepër penale të veçantë, madje as për llojet më të rënda të veprave penale, siç janë veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare, për vrasjet e rënda etj. Nga ky kusht rezulton se dënimi me burgim të përjetshëm në të gjitha rastet mund të parashihet vetëm në mënyrë alternative me dënimin me burgim, kështu që i lehet mundësia gjykatës të zgjedhë në mes të këtyre dy llojeve të dënimit për çdo rast konkret të veprës penale.

Lidhur me personalitetin e kryerësit të veprës penale, në paragrafin 3 janë paraparë edhe dy kufizime për shqiptimin e burgimit të përjetshëm. Këto janë: burgimi i përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale nuk i ka mbushë njëzetënjë vjet dhe burgimi i përjetshëm nuk mund t'i shqiptohet personit i cili në kohën e kryerjes së veprës penale ka pasur aftësi esenciale të zvogëluar mendore.

Meqë dënimi me burgim të përjetshëm është paraparë dhe mund të shqiptohet vetëm për veprat penale jashtëzakonisht të rënda, në mënyrë që ky dënim ta ruajë ashpërsinë, rrepresionin e domosdoshëm, në Kodin Penal kriteret për mundësinë e lirimit me kusht janë shumë të ashpra. Përkatësisht, sipas nenit 94, par. 2. personi i dënuar me burgim të përjetshëm mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dyzet (40) vjet.

Dënimi me burgim

Sikundër në legjislacionet e shteteve tjera, edhe në Kodin Penal të Kosovës, në krahasim me dënimet të tjera, dënimi me burgim është paraparë për të gjitha veprat penale. Në shumicën e rasteve është paraparë si i vetmi dënim, ndërsa në disa raste është paraparë në mënyrë alternative apo kumulative me dënimin me gjobë. Ndërsa, në raport me dënimet plotësuese, dënimi me burgim gjithherë është paraparë në mënyrë kumulative. Në paragrafin 1 është përcaktuar minimumi i përgjithshëm dhe maksimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim. Minimumi i përgjithshëm i dënimit me burgim është *tridhjetë ditë*, ndërsa maksimumi i përgjithshëm është *njëzetepesë vjet*.

Për veprat penale veç e veç, në legjislacionin penal më së shpeshti caktohet në mënyrë decitive minimumi dhe maksimumi i posaçëm i këtij lloji dënimi. Nëse minimumi i posaçëm nuk është caktuar, atëherë si kohëzgjatje më e shkurtër e dënimit me burgim konsiderohet minimumi i përgjithshëm (tridhjetë ditë). Ndërsa, nëse nuk është caktuar maksimumi i posaçëm, atëherë si kufi më i lartë i kohëzgjatjes së dënimit me burgim konsiderohet maksimumi i përgjithshëm i këtij dënimi (njëzetepesë vjet).

Sipas paragrafit 2, dënimi me burgim shqiptohet në vite dhe muaj të plotë. Ndërsa, nëse këtë lloji dënimi gjykata e shqipton në kohëzgjatje deri në gjashtë muaj, atëherë mund ta shqiptojë edhe në ditë të plota.

Në pajtim me trendet bashkëkohore të shkencës së të drejtës penale dhe të legjislacionit penal, në Kodin Penal është përvetësuar koncepti që në të gjitha rastet e mundshme për veprat penale të lehta apo jo shumë të rënda, në vend të dënimit me burgim, sidomos të burgimit afatshkurtër, të shqiptohen dënimet alternative apo dënimi me gjobë, me të cilat kryerësi nuk privohet nga liria.

Dënimi me gjobë

Dënimi me gjobë bën pjesë në llojet e dënimeve pasurore. Me anë të këtij dënimi, kryerësi i veprës penale detyrohet që brenda afatit të caktuar të paguajë një shumë të hollash në dobi të shtetit.

Dënimin me gjobë apo me të holla e njohin të gjitha legjislacionet penale të shteteve bashkëkohore. Dënimi me gjobë është një ndër dënimet më të vjetra. Në mesin e dënimeve kryesore, për nga pesha, dënimi me gjobë në sistemin tonë ndëshkëimor është lloji më i lehtë i dënimit. Pas Luftës së dytë botërore ky lloji dënimi ka filluar të shqiptohet në përmasa më të gjëra. Për shkak të tipareve dhe përparësive, në legjislacionet penale bashkëkohore, dënimi me gjobë gjithnjë e më tepër është duke u afirmuar dhe duke u masovizuar. Si rrjedhojë e këtij trendi, dënimin me gjobë disa autorë me të drejtë e konsiderojnë sanksion penal të së ardhmes.

Dënimi me gjobë është veçanërisht i përshtatshëm për rastet e veprave penale të lehta, mirëpo në mënyrë restriktive mund të zbatohet edhe në lëmin e kriminalitetit të mesëm. Në shkencën e së drejtës penale si *përparësi* të dënimit me gjobë veçmas cekën këto arsye: është më human në krahasim me dënimin me burgim; është mjet adekuat për të mos u zbatuar dënimi me burgim afatshkurtër; i dënuari nuk e mbanë vulën e të burgosurit, nuk stigmatizohet pa nevojë; është i ndarë dhe lehtë mund t'i

përmbushë postulatet e individualizimit të dënimit; për ekzekutimin e tij shteti nuk ka nevojë të shpenzoj mjete materiale siç është rasti me dënimin me burgim; i dënuari nuk i ekspozohet ndikimit të delikuentve të rrezikshëm; të dënuarin nuk e ndanë nga familja; i dënuari nuk e humbë vendin e punës.

Me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve më të mira në mënyrë që dënimi me gjobë të jetë sa më i drejtë dhe më efektiv, t'i godas njësoj si kryesëit e varfur ashtu dhe të pasurit, në legjislacionet penale janë të njohura sisteme të ndryshme për paraparjen dhe shqiptimin e këtij dënimi. Këto sisteme kryesisht janë tri lloje: **a) sistemi fiks; b) sistemi sipas mëditjes dhe c) sistemi sipas të ardhurave mujore mesatare dhe ç) sistemi i përzier.**

Kodi ynë Penal e përvetëson sistemin fiks të dënimit me gjobë. Gjatë punës në përgatitjen e këtij kodi, ka patur mendime që të parashihet sistemi sipas mëditjes, por meqë në Kosovë shkalla e papunësisë është e madhe (rreth 45%), u vendos për sistemin fiks. Sipas paragrafit 1, minimumi i përgjithshëm i dënimit me gjobë është 100 euro, ndërsa maksimumi i përgjithshëm është 25.000 euro. Ndërsa, në rastet veprave penale të kryera lidhur me terrorizmin, trafikimin me njerëz, krim të organizuar ose me qëllim fitimi të dobisë pasurore, maksimumi i gjobës është 500.000 EUR.

Në paragrafin 2 të nenit 46 është përcaktuar afati i pagimit të dënimit me gjobë, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë e as më i gjatë se 3 muaj. Mirëpo, në raste të arsyeshme, gjykata mund të vendosë që dënimi me gjobë të paguhet edhe me këste, me kusht që afati i pagesës të mos jetë më i gjatë se dy vjet. Në rastet kur gjykata vendosë që dënimi me gjobë të paguhet me këste, atëher cekë edhe se kur duhet të paguhet këstet dhe njëherit në aktgjykim cekë në mënyrë shprehimore se mundësia e lejuar që dënimi me gjobë të paguhet me këste do të revokohet nëse personi i dënuar nuk e paguan këstin me kohë.

Sipas paragrafit 3, nëse i dënuari refuzon të paguajë gjobën ose nuk është në gjendje ta paguajë atë, gjykata mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim. Kur dënimi me gjobë zëvendësohet me burgim, një ditë burgim gjykata e llogaritë 20 euro gjobë. Por në këso raste dënimi me burgim nuk mund të tejkalojë tre vjet.

Edhe në paragrafin 4 është rregulluar çështja kur kryerësi i veprës penale nuk dëshiron ose nuk mundet me e paguar jo në tërësi por një pjesë të gjobës. Në këso raste gjykata do ta zëvendësoj pjesën e mbetur të gjobës me dënim me burgim, sipas kushteve të parapara në par. 3. Por nëse i dënuari e paguan pjesën e mbetur të gjobës, ekzekutimi i dënimit ndërpritet.

Në paragrafin 5 është rregulluar situata kur personi i dënuar me gjobë, këtë lloj dënimi nuk dëshiron apo nuk mund ta pagua, Në këso raste, edhe pse gjykata mundet gjobën me e shëndrruar me burgim, gjykata përkundër kësaj, nëse pajtohet i dënuari, mund të vendosë, që dënimin me gjobë ta zëvendësoj me dënim me urdhër për punë në dobi të përgjithshme. Në këso raste urdhëri për punë të përgjithshme llogaritet ashtu që 8 orë punë në dobi të përgjithshme llogariten me 20 euro gjobë. Por në pajtim me nenin 60, par. 2, urdhëri për punë në dobi të përgjithshme nuk mund të zgjatë më tepër se 240 orë.

Kur gjykata vendosë ta zëvendësojë gjobën me një urdhër për punë në dobi të përgjithshme, duhet të merrë parasysh që kryerja e punës në interes të përgjithshëm, sa të jetë e mundur të mos paraqesë pengesë në aktivitetet e tij të rregullta të punës. Ndërsa, nëse i dënuari nuk pajtohet me zëvendësimin e dënimit me gjobë me punë në dobi të përgjithshme, apo nuk e zbaton dënimin e shqiptuar me punë në dobi të përgjithshme, edhe pse është dakorduar më parë, gjoba i zëvendësohet me dënim me burgim. Në këso raste, gjykata cakton një ditë burgim për çdo 20 euro të gjobës, me kusht që afati i burgimit nuk tejkalon gjashtë muaj (par. 4).

Dënimi me gjobë nuk do të ekzekutohet pas vdekjes së të dënuarit (par. 6).

Dënimet alternative

Dënimet alternative janë:

- 1. dënimi me kusht;**
- 2. gjysmëliria; dhe**
- 3. urdhri për punë në dobi të përgjithshme.**
- 4. Kur shqipton dënimin me kusht, gjykata po ashtu mund të shqiptojë:**
- 5. urdhrin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues; dhe**
- 6. urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.**

Duke u mbështetur në dispozitat e Rregullave të Tokios, si dhe Rekomandimet e Këshillit të Evropës për aplikimin e tyre, dhe në bazë të modeleve të kodit penal të Italisë, Francës, Zvicrës, Gjermanisë dhe të disa shteteve të tjera të Evropës Perëndimore, në Kodin penal të Kosovës janë bërë përpjekje që të anticipohet shumica e korpusit të këtyre dënimeve dhe masave alternative.

Duke e përfillur këtë koncept dhe filozofi të re në të drejtën penale dhe duke marrë parasysh edhe rrethanat konkret në Kosovë, në Kodin Penal janë paraparë tri lloje të dënimeve alternative, të cilat mund të shqiptohen në vend të dënimit me burgim.

Në nenin 49 të Kodit Penal, janë paraparë këto tri lloje të dënimeve alternative:

- dënimi me kusht;
- gjysmëliria; dhe
- urdhëri për punë në dobi të përgjithshme

Në dispozitat e posaçme të Kodit Penal, këto lloje të dënimeve alternative mund të shqiptohen ndaj një numri relativisht të madh të kryerësve të veprave penale. Natyrisht, në këto dispozita janë paraparë edhe kushtet të cilat duhet të përmbushen për të mundur të shqiptohen këto dënime alternative. Veçmas duhet theksuar se me hyrjen në fuqi të këtij Kodi Penal, në Kosovë për herë të parë parashihen si lloje të dënimeve alternative, urdhëri për punë në dobi të përgjithshme dhe gjysmëliria.

Në nenin 49, ku janë paraparë dënimet alternative, në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë se në rastet kur gjykata shqipton dënimin me kusht, së bashku me këtë dënim alternativ, mund të shqipton edhe urdhrin për trajtim të detyrueshëm apo urdhrin për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues.

Dënimi me kusht

Dënimi me kusht është lloji i parë i dënimeve alternative, i cili është paraparë në nenin 51 të Kodit Penal. Sipas natyrës, përmbajtjes, kushteve dhe detyrimeve që mund t'i caktohen kryerësit të veprës penale, është i njëjtë me dënimin me kusht, i cili parashihej me legjislacionin penal të mëparshëm, që veproi në Kosovë gjër me hyrjen në fuqi të Kodit Penal.

Në pajtim me trendin bashkëkohor të akceptimit të dënimeve alternative, krahas sistemit kontinental të dënimin me kusht të paraparë në nenin 49 dhe 51, Kodi ynë Penal i ka paraparë mundësinë që së bashku me dënimin me kusht, gjykata ta shqiptoj edhe:

- urdhërin për trajtim të detyrueshëm rehabilitues (neni 57) dhe
- urdhërinë për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues (neni 58).

Me parashikimin e dënimin me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues, të dënimin me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, Kodi Penal e ka përvetësuar sistemin anglo-amerikan të dënimin me kusht me disa specifika të cilat janë rezultat i të mbrimeve në shkencën e së drejtës penale dhe praktikën gjyqësore.

Sipas Kodit penal, dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryerësit penalisht të përgjegjshëm të veprës penale. Kur gjykata konstaton se kryerësit është oportune t'i shqiptohet dënimi me kusht si lloj i dënimin alternativ, ia shqipton dënimin, mirëpo ekzekutimin e tij e pezullon për një kohë të caktuar, e cila mund të jetë prej një deri pesë vjet, dhe me atë rast ia cakton edhe një apo disa kushte apo obligime të cilat duhet t'i përmbushë gjatë kohëzgjatjes së dënimin me kusht. Njëherit, personit të këtillë gjykata ia bën me dije se nëse nuk i përmbushë kushtet apo obligimet e caktuara, dënimi me kusht do të revokohet dhe dënimi do të bëhet efektiv, përktësisht kryerësi i veprës penale do të detyrohet ta mbajë dënimin me burgim apo të paguajë gjobën. Kësisoj, dënimi me kusht i përmbanë elementet e vërejtjes dhe të kërcënimit, ngase gjykata ia bën me dije në mënyrë serioze kryerësit të veprës penale se nëse nuk i përmbushë obligimet gjatë kohëzgjatjes së dënimin me kusht, posaçërisht që të mos kryejë vepër tjetër penale si dhe t'i përmbushë obligimet apo kushtet e tjera të cilat gjykata ia cakton me dënimin me kusht.

Sipas nenit 7, par.5 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, dënimi me kusht mund t'u shqiptohet edhe të miturve në rastet kur u është shqiptuar dënimi me burgim për të mitur apo masa e dërgimit në institucionin edukativ apo edukativo-korrektues deri në dy vjet.

Së bashku me këtë lloj të dënimin me kusht, si dhe dy llojet tjera të dënimeve alternative të parapara në Kodin Penal, mund të shqiptohet edhe masa e marrjes së fitimit pasuror (neni 96).

Së bashku me dënimin me kusht mund të shqiptohet edhe çdo lloj i dënimin plotësues (neni 62, par. 1).

Dënimi me kusht shënohet në evidencën e ndëshkimeve, ndërsa shlyhet nga kjo evidence sipas kushteve të parapara në nenin 103, par. 2, pika 2.2.

Kushtet për shqiptimin e dënimit me kusht

Në paragrafin 1 përcaktohet se për cilat vepra penale, duke marrë parasyshë lartësinë e dënimit, mund të shqiptohet dënimi me kusht. Në këtë dispozitë thuhet shprehimisht se kryerësit mund t'i shqiptohet dënimi me kusht për veprën penale, për të cilën është paraparë dënimi me burgim deri në pesë vjet. Sipas kësaj dispozite është e mundur shqiptimi i dënimit me kusht edhe për veprën penale më të rëndë, për të cilën është paraparë dënimi deri në dhjetë vjet burgim, nëse zbatohen dispozitat për zbutjen e dënimit. Nga kjo dispozitë shihet se dënimi me kusht mund të shqiptohet edhe për vepra penale të rënda. Madje edhe për veprën penale të vrasjes së kryer nga pakujdesia. Andaj në rastet e veprave penale të rënda, gjykatat duhet të ken kujdes dhe këtë lloj dënimi ta shqiptojë vetëm në rastet shumë të arsyeshme, posaçërisht duhet marrë parasyshë pasojën e shkaktuar dhe ndiesinë e viktimeve dhe të mjedisit në mënyrë që të mos shkaktoj paknaqësi, përkatësisht që edhe për viktimën të paraqet satisfaksion.

Mundësia shumë e gjerë e shqiptimit të dënimit me kusht e paraparë në paragrafin e mësipër, është kufizuar me dispozitën e paragrafit 3. Në këtë dispozitë është paraparë se dënimi me kusht mund t'i shqiptohet kryerësit vetëm nëse gjykata e cakton dënimin me gjobë ose me burgim më së tepërmi deri në dy vjet, qoftë për një vepër penale, qoftë për bashkim të veprave penale.

Në rastet e bashkimit të veprave penale, nuk është e mundur që për një vepër penale të shqiptohet dënimi, ndërsa për veprën tjetër penale të shqiptohet dënimi me kusht, ngase siç dihet, sipas dispozitave penale, për matjen e dënimit për veprat penale në bashkim, gjykata duhet të caktojë dënimin unik i cili mund të jetë efektiv, të zbatohet apo të shqiptojë dënim me kusht.

Në dispozitën e paragrafit 3 të nenit 52 **janë paraprë kushtet të cilat i referohen personalitetit të kryerësit të veprës penale** dhe qëllimit të dënimit me kusht.

Në dispozitën e paragrafit 5 është paraparë situata kur gjykata kryerësit të veprës penale ia cakton në mënyrë kumulative dënimin me burgim dhe dënimin me gjobë, dënimin me kusht mund t'i shqiptojë për të dy dënimet apo vetëm për dënimin me burgim. Në këso raste dënimi me gjobë ekzekutohet sipas dispozitave në fuqi, mirëpo ligji nuk e thot si të veprohet nëse i dënuari nuk e paguan gjobën.

Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprave të reja penale

Dënimi me kusht do të dëshmohet sanksion i arsyeshëm dhe me vend, i qëlluar, nëse personi, ndaj të cilit është shqiptuar, e përmbushë kushtin e përgjithshëm – të mos kryej vepër tjetër penale dhe nëse i përmbushë detyrimet (kushtet) e posaçme të cilat i janë caktuar. Mirëpo, ka raste që i dënuari me kusht nuk i respekton kushtet dhe nuk i përmbushë detyrimet e caktuara nga ana e gjykatës. Në rastet e tilla nuk është realizuar qëllimi i dënimit me kusht. Në kësi raste, ligjvënësi ka paraparë mundësinë e revokimit të dënimit me kusht. Revokimi i dënimit me kusht konsiston në ekzekutimin e dënimit të shqiptuar me kusht.

Në nenet 53, 54 dhe 55 Kodi Penal i parasheh tri kushte, për shkak të cilave dënimi me kusht mund të revokohet: nëse i dënuari gjatë periodës së verifikimit kryen vepër të

re penale; nëse pas shqiptimit të dënimit me kusht vërtetohet se i dënuari ka kryer veprë penale, para se të jetë dënuar me kusht; nëse i dënuari nuk i ka përmbushur detyrimet, të cilat i janë caktuar me dënimin me kusht.

Në rastet e kryerjes së veprës penale gjatë kohëzgjatjes së dënimit me kusht, sipas nenit 53, revokimi i dënimit me kusht mund të jetë *obligator dhe fakultativ*.

Në dispozitën e paragrafit 1 të nenit 53. është paraparë *revokimi i dënimi me kusht në mënyrë të obliguar* nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo shumë vepra penale për të cilat i është shqiptuar dënimi me burgim prej dy apo më shumë vjetësh.

Gjykata duhet medeomos ta revokoj dënimin me kusht nëse është kryer një veprë penale apo më shumë vepra penale për të cilat kryerësit i është shqiptuar dënimi me burgim prej së paku dy vjet apo më tepër. Nuk është me rëndësi se për çfarë vepra penale është fjala dhe çfarë dënimi është i paraparë për atë veprë. Vendimtare është lartësia e dënimit të caktuar me burgim. Kjo don të thotë se vendimi për revokimin e dënimit me kusht është në duar të gjykatësist, sepse ai mund ta përshatë dënimin në aso mase e cila nuk do të shpie në revokim të obliguar, të shqiptoj dënim nën dy vjet burgim. Dënimin me kusht e revokon gjykata e cila vendosë për veprën e re penale. Vendimi për revokim duhet të shënohet në dispozitivin e aktgjykimit për veprën e re.

Nëse vepra e re penale është kryer pas caktimit të dënimit me kusht, por para aktgjykimit të plotëfuqishëm, sipas profesorit Baqiç, rastet e këtilla duhet vendosë në të njëjtën mënyrë sikur të ishte kryer vepra e re penale pasi që aktgjykimit për dënimin me kusht ta ket marrë formën e plotëfuqishme. Mirëpo situata e këtillë sipas profesorit Baqiç duhet të rregullohet me ligj.

Në dispozitën e paragrafit 2 është paraparë *revokimi i dënimi me kusht në mënyrë fakultative*. Kjo situatë do të shprehet nëse i dënuari gjatë kohës së verifikimit kryen një apo më shumë vepra penale për të cilat është shqiptuar dënimi me burgim më pak se dy vjet apo dënimi me gjobë. Në raste të tilla, gjykata do të vendosë nëse do ta revokojë dënimin me kusht, pasi t'i vlerësoj të gjitha rrethanat të cilat i përkasin veprës penale të kryer dhe kryerësit, e sidomos ngjashmërinë e veprës penale të kryer, peshën e veprës së kryer, rëndësinë e sajë, motivet nga të cilat është kryer, a është kryer vepra me dashje apo nga pakujdesia, sa kohë ka kaluar nga vepra e kryer më parë etj.

Par.3.Nëse gjykata e revokon dënimin me kusht, për të gjitha veprat penale e shqipton një dënim unik, duke i zbatuar dispozitat e matjes së dënimit për veprat penale në bashkim (neni 80). Me atë rast dënimi i shqiptuar më parë me kusht merret si i caktuar, ndërsa për veprën penale të kryer gjatë kohës së verifikimit, shqiptohet dënimi tejtër, dhe në bazë të tyre shqiptohet dënimi unik.

Në paragrafin 4 është rregulluar çështja kur gjykata nuk e revokon dënimin me kusht. Në këso situata mund të shprehen dy situata:

Situata e parë është rasti nëse për veprën penale të kryer gjatë kohës së verifikimit (kohëzgjatjes së dënimit me kusht), është shqiptuar dënimi me burgim apo me gjobë, atëherë në mënyrë paralele ekzistojnë dy dënime – dënimi me kusht dhe dënimi. Në

kësi raste, nëse është shqiptuar dënimi me burgim, koha e kaluar në burg nuk i llogaritet në kohën e verifikimit të caktuar me dënimin me kusht.

Situata e dytë është rasti kur gjykata edhe për veprën penale të re shqipton dënimin me kusht. Në kësi raste nuk do të ishte e arsyeshme që paralelisht të ekzistojnë dy dënime me kusht, të cilat do të ekzekutoheshin në mënyrë succesive. Për këtë arsye ligji parasheh që gjykata në kësi raste do të shqiptojë një dënim me kusht, duke i zbatuar dispozitat për matjen e dënimit për veprat penale në bashkim (duke e zbatuar nenin 80), dhe e shqipton një dënim unik edhe për veprën penale të mëparshme edhe për veprën penale të re. Në këso raste dënimin me kusht të shqiptuar më parë e merr si të caktuar. Në situata të tilla, gjykata e cakton edhe kohën e re të verifikimit, e cila gjithashtu nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit dhe as më e gjatë se pesë vjet. Kjo kohë llogaritet prej ditës së plotfuqishmërisë së aktgjyqimit me të cilin është shqiptuar dënimi i ri me kusht.

Revokimi i dënimit me kusht për shkak të veprave penale të kryera më parë

Pas shqiptimit të dënimit me kusht, mund të ndodhë që gjykata ndërkohë të zbulojë se personi ka kryer edhe ndonjë vepër penale, për të cilën nuk ka ditur në kohën e shqiptimit të dënimit me kusht. Këtë situatë ligjëvënësi e zgjidhë me dispozitën e nenit 54. Sipas kësaj dispozite, në raste të tilla, gjykata mund të revokojë dënimin me kusht nëse vlerëson se nuk do të kishte bazë për shqiptimin e dënimit me kusht po të dihej për atë vepër.

Me rastin e vendosjes nëse do ta revokojë dënimin me kusht, gjykata do të marrë parasysh kriteret, të cilat janë paraparë për revokimin e dënimit me kusht për shkak të veprës penale të re (neni 53, par.2). Nëse gjykata e revokon dënimin me kusht, e shqipton dënimin unik për të gjitha veprat penale duke i zbatuar dispozitat mbi matjen e dënimit për veprat penale së bashku (neni 80), ndërsa nëse nuk e revokon, atëherë për veprën e kryer më parë e shqipton dënimin, apo dënimin me kusht. Në kësi raste zbatohen dispozitat lidhur me revokimin e dënimit me kusht për shkak të veprës penale të kryer gjatë kohës së verifikimit.

Gjykata medoemos duhet ta revokoj dënimin me kusht nëse dënimet e caktuara së bashku tejkalojnë dy vite burgim.

Revokimi i dënimit me kusht për shkak të mos përbushjes së kushteve

Sipas kësaj dispozite, mos përbushja e detyrimeve të caktuara mund të jetë shkak për revokimin e dënimit me kusht. Detyrimet e veçanta, të cilat gjykata ia cakton të dënuarit me kusht, duhet t'i përbushë në afatin e caktuar me aktgjykim.

Detyrimet që duhet t'i përbushë personi i dënuar me kusht janë ta kthejë përfitimin pasuror të fituar me veprën penale, ta kompensojë dëmin që e ka shkaktuar

me veprën penale, apo t'i përmbushë obligimet e tjera të parashikuara me dispozitat penalo-juridike (shih komentet lidhur me neni 59).

Procedurën për revokimin e dënimit me kusht e zhvillon gjykata e shkallës së parë, e cila e ka shqiptuar këtë dënim sipas propozimit të paditësit ose të dëmtuarit ose sipas detyrës zyrtare (lidhur me procedurën e mëtejshme shi më gjerësisht nenet përkatëse të Kodit të Procedurës Penale).

Nëse gjykata konstaton se i dënuari me kusht nuk i ka përmbushë detyrimet e caktuara brenda afatit të caktuar me aktgjykim, gjykata, sipas nenit 55, mund të vendosë me sa vijon: **a)** që personit të dënuar t'ia vazhdojë afatin e përmbushjes së detyrimit brenda afatit të detyrimit; **b)** personin e dënuar mund ta lirojë nga përmbushja e atij obligimi, nëse bindet se i dënuari, për shkaqe të arsyeshme, nuk mund ta përmbushë obligimin; **c)** detyrimin e caktuar më parë ta zëvendësojë me obligim tjetër të paraparë me ligj, apo **ç)** mund ta revokojë dënimin me kusht.

Para se të vendosë për njërën nga këto zgjidhje, gjykata duhet të vlerësoj se për çfar shkaqe i dënuari nuk i ka përmbushë detyrimet e caktuara, përkatësisht se a ka mundë me i përmbushë.

Në rast se gjykata vendos që ta revokojë dënimin me kusht, atëherë dënimi i shqiptuar me kusht bëhet i pakusht, ekzekutohet. Përkatësisht, nëse gjykata e revokon dënimin me kusht për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve të caktuara, do ta ekzekutojë dënimin, i cili ka qenë i caktuar me dënimin me kusht.

Revokimi i dënimit me kusht bëhet me aktgjykim të gjykatës së shkallës së parë dhe e cila e ka shqiptuar këtë dënim.

Afatet për revokimin e dënimit me kusht

Në par.1 të nenit 56, ligji parasheh një zgjidhje parimore sipas së cilës, pa marrë parasysh nëse është fjala për revokimin obligativ apo fakultativ, dënimi me kusht mund të revokohet gjatë kohës së verifikimit. Mirëpo, pas fjalisë së parë të pragarfit 1, është caktuar edhe një afat plotësues në kohëzgjatje prej një viti pas skadimit të kohës së verifikimit, brenda të cilit gjykata mund ta revokoj dënimin me kusht. Kjo zgjidhje shprehet në rastet kur i dënuari me kusht, gjatë kohës së verifikimit kryen veprën penale për shkak të së cilës duhet të revokohet dënimi me kusht, ndërsa kjo është konstatuar pas skadimit të kohës së verifikimit.

Nga kjo rezulton se për revokimin e dënimit me kusht për shkak të veprës penale të kryer më parë (neni 54) ekziston vetëm një afat – koha e verifikimit. Mirëpo në rastet kur vepra penale është kryer gjatë kohës së verifikimit, mirëpo kjo është zbuluar pas skadimit të kohës së verifikimit, dënimi me kusht mund të revokohet edhe gjatë afatit prej një viti, nga dita kur ka skaduar koha e verifikimit. Ky afat prej një viti është afat prekluziv dhe brenda këtij afati duhet të nxirret aktgjykimi i plotëfuqishëm me të cilin konstatohet vepra e re penale dhe me të cilin revokohet dënimi me kusht sipas nenit 53.

Në paragrafin 2 gjithashtu është paraparë afati plotësues për revokimin e dënimit me kusht në kohëzgjatje prej një viti edhe në rastet e mos përmbushjes së njërës prej detyrimeve të parapara në nenin 59. Edhe ky afat është prekluziv dhe brenda afatit prej

një viti duhet të nxirret aktgjykimi i plotfuqishëm me të cilin duhet të konstatohet mos përbushja e detyrimit të caktuar dhe revokimi i dënimit me kusht.

Në të gjitha rastet kur të skadojë një vit, nga koha e verifikimit, e cila ka qenë e caktuar me vendimin e gjykatës, dënimi i shqiptuar me kusht nuk mund të revokohet, pa marrë parasysh nëse është fjala për revokimin obligator apo fakultativ.

Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues

Dënimi me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues është lloji dënimit me kusht dhe në brendinë e tij është një formë e modifikuar e dënimit me kusht klasik. Njëkohësisht dënimit është denim alternativ, i cili ndaj kryerësve të veprave penale mund të shqiptohet në vend të dënimit me burgim. Në legjislacionin e mëparshëm është konsideruar si lloj i masës siguruese.

Me këtë variant të dënimit, si dhe të dënimit me kusht nën mbikëqyrjen e shërbimit sprovues, që gjithashtu parashihet me Kodin Penal, krahas sistemit kontinental – belgo-francez, e drejta jonë penale përvetëson në masë të konsiderueshme edhe sistemin anglo-amerikan, i cili është i njohur si sistem i sprovimit (probation).

Ky dënim me kusht shqiptohet në rastet kur gjykata konstaton se kryerësi nuk mundet vet, pa ndihmën mjekësore në mënyrë të organizuar dhe institucionale të lirohet nga vartësia nga droga apo alkooli.

Krahas kushteve të parapara në nenin 52, gjykata mund ta shqiptojë dënimin me kusht me urdhër për trajtim të detyrueshëm rehabilitues në këto raste: **a)** nëse personi i dënuar ka kryer vepër penale për herë të parë dhe është i varur nga droga ose alkooli; **b)** nëse gjykata konstaton se faktori kryesor që ka ndikuar në kryerjen e veprës penale është varësia nga alkooli ose nga droga dhe **c)** nëse konstaton se trajtimi i suksesshëm do ta zvogëlonte rrezikun për kryerjen e veprës tjetër penale. Për shqiptimin e këtij dënimi duhet të përbushen në mënyrë kumulative të gjitha këto kushte. Personit të dënuar me këtë dënim, gjykata ia cakton obligimin që ai të mjekohet. Ky mjekim nënkupton realizimin e një programi të posaçëm mjekësor me të cilin kihet për qëllim që personi do të lirohet nga vartësia e alkoolit apo drogës.

Si kusht për shqiptimin e këtij dënimi ligjvënësi nuk parasheh se duhet të merret pëlqimin i kryerësit se do t'i nënshtrohet këtij lloj trajtimi. Mirëpo ky dënim nuk mund të zbatohet me dhunë. Andaj nëse i dënuari refuzon ti nënshtrohet trajtimit rehabilitues gjatë kohës së verifikimit, do të veprohet sipas zgjidhjeve të parapara në paragrafin 4 të këtij neni.

Programin e trajtimit e përpilon dhe e mbikëqyrë organi i shërbimit sprovues. Ky lloj mjekimi bëhet në liri në mënyrë ambulatorë (par 2).

Në dispozitën e par.3 është paraparë se ky dënim me kusht do të konsiderohet se është mbajtur nëse kryhet me sukses programi i trajtimit. Lidhur me këtë, shërbimi sprovues duhet ta informojë gjykatën se programi i trajtimit është kryer me sukses. Në kësi raste gjykata nxjerrë vendim me të cilin konstatohet se dënimi është mbajtur.

Sipas kësaj dispozite, periudha e trajtimit të detyrueshëm nuk mund të jetë më pak se tre muaj dhe as më gjatë se dymbëdhjetë muaj.

Në dispozitën e par.4. janë paraparë situatat kur i dënuari me kusht me urdhër për trajtim largohet nga programi i trajtimit rehabilitues pa i përmbushur detyrimet lidhur me urdhrin për trajtim. Në rastet e tilla gjykata i ka tri mundësi: a) ta zëvendësojë detyrimin e mëparshëm me një tjetër; b) të shtyjë kohëzgjatjen e urdhrin për trajtim ose c) ta revokojë dënimin me kusht dhe të urdhërojë ekzekutimin e dënimin të caktuar në dënimin me kusht. Për secilën prej këtyre zgjidhjeve, gjykata duhet të nxjerrë vendim të posaçëm.

Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues

Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues, është tërësisht i tipit të dënimin me kusht si sistemit anglo amerikan, ngase edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me rastin e shqiptimit të dënimin me kusht caktohet personi zyrtar i cili do ta mbikëqyrë dhe do t'i ndihmoj personit të dënuar me kusht gjatë periudhës së kohëzgjatjes së këtij dënimi alternativ.

Ky model i dënimin me kusht, si dhe detyrimet dhe urdhrat të cilat ia cakton gjykata të parapara në nenin 59, dhe ndihma profesionale që i epet nga shërbimi sprovues, në fakt është një lloj tretmani i të dënuarit në liri. Me këtë dënim kihet për qëllim që të parandalohet recidivizmi dhe që kryerësi i veprës penale të vetëdijesohet, të kuptoj se ka kryer një veprë të sanksionuar me ligj.

Dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues shqiptohet në rastet kur gjykata formon bindje se kryerësin e veprës penale nuk duhet me e ndëshkua, mirëpo duke marrë parasysh rrethanat në të cilat jeton dhe duke marrë parasysh personalitetin e tij, dënimi me kusht nuk është adekuat, nuk është i mjaftueshëm, ngase janë të nevojshme edhe masa shtesë të ndihmës dhe mbikëqyrjes. Nga kjo rezulton se për shqiptimin e këtij dënimi, krahas kushteve të parapara për shqiptimin e dënimin me kusht klasik të paraparë në nenin 52, gjykata duhet të konstatoj se për parandalimin e recidivizmit dhe vetëdijesimit dhe përmirësimin, kryerësi duhet të mbikëqyret dhe t'i ofrohet ndihmë profesionale nga shërbimi sprovues dhe t'i caktohen detyrime të cilat duhet me i përmbushë gjatë kohës së verifikimit.

Për shqiptimin e këtij dënimi, së pari duhet të përmbushen kushtet për shqiptimin e dënimin me kusht klasik të parapara në nenin 51 dhe 52. Sipas dispozitave të këtij paragrafi, krahas këtyre kushteve, gjykata do ta shqiptoj këtë lloj dënimi nëse konstaton se, për shkak të rrethanave sociale dhe familjare në të cilat kryerësi jeton, si dhe personaliteti i tij, për përmirësimin dhe integrimi në shoqëri arrihet më me sukses nëse i ofrohet ndihmë, mbrojtje dhe mbikëqyrje gjatë kohës së verifikimit.

Sipas dispozitës së paragrafit 2, në rastet kur gjykata e shqipton këtë dënim alternative, gjykata e urdhëron personin e dënuar që të mbajë kontakt me shërbimin sprovues. Gjithashtu gjykata mund t'i caktoj të përmbushë një ose më shumë detyrime të parapara me nenin 51, par. 3 ose nenin 59. Shërbimi sprovues e mbikëqyrë përmbushjen e detyrimit. Kohëzgjatja e përmbushjes së një detyrimi të paraparë me nenin 59 nuk

mund të jetë më pak se gjashtë muaj dhe jo më tepër se tri vjet. Mirëpo, meqë edhe dënimi me kusht me urdhër për mbikëqyrje nga shërbimi sprovues në brendinë e tij është dënimit me kusht, koha e verifikimit mund të jetë prej një deri në pesë vite.

Nëse gjykata vendosë të ia caktoj një apo më tepër detyrime të parapara në nenin 59, do të merr parasysh moshën e personit të dënuar, gjendjen e tij të përgjithshme shëndetësore, mënyrën e jetesës dhe nevojat e tij, veçanrisht nevojat në lidhje me familjen, shkollën dhe punën, motivet e kryerjes së veprës penale, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, sjelljen e mëparshme dhe rrethanat tjera personale dhe familjare, që janë të rëndësishme për zgjedhjen e llojit të mbikëqyrjes dhe të kohëzgjatjes së saj.

Në rastet kur i dënuari me kusht nën mbikëqyrjen e shërbimit sprovues nuk e mban kontaktin me shërbimin sprovues ose nuk i përmbushë detyrimet të cilat ia ka caktuar gjykata, shërbimi sprovues e njofton gjykatën pas verifikimit të fakteve dhe arsyeve. Në këso raste gjykata mund t'ia zëvendësojë me një detyrim tjetër apo t'ia vazhdojë afatin brenda kohës së verifikimit apo ta revokojë këtë lloj të dënimit me kusht. Siç shihet nga kjo dispozitë, revokimi i dënimit me kusht nën mbikëqyrjen e shërbimit sprovues për shkak të mos përmbushjes së detyrimeve, është zgjidhja e fundit e mundshme, të cilën gjykata mund ta zbatojë në mënyrë fakultative.

Llojet e detyrimeve të caktuara në dënimin me kusht

Dënimi me kusht mund të përfshijë edhe urdhrin për të përmbushur një apo më shumë nga detyrimet e mëposhtme: mjekimi ose rehabilitimi në entin e kujdesit shëndetësor; nënshtrimi në programin e trajtimit mjekësor ose të rehabilitimit; vizita te psikologu ose te këshilluesit e tjerë dhe veprimi në pajtim me rekomandimet e tyre; aftësimi profesional në një profesion të caktuar; kryerja e aktiviteteve punuese; shfrytëzimi i pagës dhe i të ardhurave apo pasurisë tjetër për përmbushjen e detyrimeve familjare; mos ndërrimi i vendbanimit pa informuar shërbimin sprovues; heqja dorë nga përdorimi i alkoolit apo i drogës; heqja dorë nga frekuentimi i vendeve apo lokaleve të caktuara; heqja dorë nga shoqërimi ose kontaktimi me persona të caktuar; heqja dorë nga mbajtja e çfarëdo lloji të armëve; të kompensojë ose dëmshpërblejë viktimën e veprës penale; të kthejë dobinë pasurore të fituar me kryerjen e veprës penale; të mos posedojë apo përdor kompjuterin ose të mos qaset në internet siç kërkohet nga gjykata ose të ofrojë raporte financiare siç kërkohet nga gjykata.

Dënimi me urdhër për punë në dobi të përgjithshme

Gjykata mund t'ia shqiptojë personit të dënuar dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse kryesit i shqipton dënim me gjobë deri në dymijepesëqind (2.500) Euro ose me burgim deri në një (1) vit. Puna në dobi të përgjithshme mund të caktohet vetëm me pëlqimin e personit të dënuar. Nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata e urdhëron personin e dënuar të kryejë pa pagesë, punë në dobi të përgjithshme për një periudhë të caktuar prej tridhjetë (30) deri në dyqind e katërdhjetë (240) orë pune. Shërbimi sprovues vendos për llojin e punës në dobi të përgjithshme që duhet të kryhet nga personi i dënuar, cakton organizatën e veçantë për

të cilën personi i dënuar do të kryejë punën në dobi të përgjithshme, vendos për ditët e javës gjatë të cilave puna në dobi të përgjithshme duhet të kryhet dhe mbikëqyrë kryerjen e punës në dobi të përgjithshme. Puna në dobi të përgjithshme kryhet brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga gjykata, e cila nuk e tejkalon një (1) vit. Nëse e shqipton dënimin me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, gjykata, po ashtu, mund t'i urdhërojë personit të dënuar të mbajë kontaktin me shërbimin sprovues ose kryerjen e një apo më shumë prej detyrimeve të parapara me paragrafin 3. të nenit 51 ose me nenin 59 të këtij Kodi.

Kohëzgjatja e detyrimit të paraparë me nenin 59 nuk duhet të jetë më e shkurtë se gjashtë (6) muaj ose më e gjatë se sa tri (3) vjet. Nëse personi i dënuar nuk e kryen punën në dobi të përgjithshme, ose e kryen pjesërisht gjykata mund ta shtyjë kohëzgjatjen e mbikëqyrjes brenda kohës së verifikimit ose ta revokojë dënimin. Nëse pas kalimit të kohës së caktuar personi i dënuar nuk e ka kryer punën në dobi të përgjithshme ose e ka kryer vetëm pjesërisht punën e tillë në dobi të përgjithshme, gjykata urdhëron dënimin me burgim. Një (1) ditë burgim do të urdhërohet për çdo tetë (8) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

Në Kodin e Drejtësisë për të Mitue të Kosovës, puna në dobi të përgjithshme është paraparë si lloj i masës së diversitetit (neni 18) dhe si lloj i dënimit për të miturit (neni 31).

Gjysmëliria

Gjysmë liria, apo siç quhet në gjuhën frënge *semi liberte*, është lloji i dënimit alternativ i paraparë në Kodin Penal. Ky lloj dënimi alternativ është paraparë në pajtim me Rregullat e Tokios dhe si i tillë është paraparë dhe është duke u aplikuar me sukses në Angli, Poloni dhe në disa vende të tjera të Evropës Perëndimore.

Gjysmë liria, si lloj i dënimit alternativ, konsiston në atë që personit të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim, i mundësohet që në ditët e caktuara, brenda orëve të caktuara (katër, gjashtë apo tetë orë), të mund të qëndrojë në liri. Ky qëndrim në liri mund t'i lejohet për të vazhduar punën profesionale të cilën e ka kryer edhe para kryerjes së veprës penale, apo që të kryejë punët familjare të rëndësishme (p.sh. nëse është fjala për një femër e cila është nënë e fëmijëve, të përkujdeset për fëmijët dhe punët e tjera të shtëpisë), të vijojë shkollimin, të vazhdojë mjekimin etj. Pasi që t'i kryejë punët brenda orëve të lejuara për të qëndruar në liri, i dënuari është i detyruar të kthehet në entin penal, në burg. Përkatesisht, kohën tjetër i dënuari me gjysmëliri, duhet ta kalojë në burg.

Në paragrafin 2 është paraparë shprehimisht se nëse i dënuari nuk i përmbushë detyrimet lidhur me punën, arsimimin apo aftësimin profesional, për të cilat është shqiptuar gjysmëliria, gjykata do ta revokoj këtë lloj të dënimit dhe do të urdhërojë që ky dënim, apo pjesa e mbetur e këtij dënimi, të ekzekutohet në burg. Në rastet kur gjykata vendos për revokimin e këtij lloj dënimi për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të punës apo aktiviteteve të tjera, do të kërkojë raport nga shërbimi sprovues. Natyrisht, edhe pse nuk thuhet shprehimisht në Kodin Penal, gjysmëliria do të revokohet edhe në rastet kur i dënuari nuk kthehet në burg pas skadimit të orëve të lejuara që të qëndroj në

liri apo ka sjellje të këqija, devijante apo kryen veprë penale të re gjatë kohës së qëndrimit në liri apo në burg.

Dënimet plotësuese

Dënimet plotësuese janë llojet e posaçme të dënimeve të cilat po paraqiten si rezultat i njohurive se dënimet kryesore nuk mund të jenë të vetmet mjete efikase ndaj të gjithë kryesve të veprave penale. Për këtë arsye në të drejtën penale u formësua mendimi se krahas dënimit kryesor duhet paraparë edhe sanksionet tjera penale të karakterit komplementar, plotësues me të cilat do të bëhej i mundshëm parandalimi më efektiv i kriminalitetit dhe risocializimi i personave të dënuar.

Kryesit të veprës penale i shqiptohet dënimi plotësues me qëllim që t'i merren apo t'i kufizohen disa të drejta të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk mund të merren apo të kufizohen me dënime kryesore.

Arsyeja e parë qëndron në atë që funksionimi dhe autoriteti i disa detyrave dhe profesioneve shtetërore e publike kërkon që t'i ushtrojnë personat të cilët kanë një të kaluar të pastër. Dhe arsyeja e dytë e marrjes apo kufizimit të disa të drejtave personit të dënuar është i natyrës kriminale politike, është paraparë me qëllim të parandalimit të kushteve të cilat ia kanë mundësua kryerjen e veprës penale, respektivisht parandalimit të recidivit. Dënimet plotësuese janë sanksione të posaçme, me të cilat personit edhe pasi ta mbajë dënimin i merren apo i kufizohen disa të drejta për një kohë të caktuar. Në pajtim me parimin e legalitetit, nulla poene sine lege, sikundër edhe dënimet kryesore edhe dënimet plotësuese mund të shqiptohen vetëm nëse janë paraparë me ligj dhe vetëm ndaj kryesve të veprave penale. Siç rezulton nga kjo dënimet plotësuese shqiptohen krahas dënimit kryesor, kurse në disa raste krahas dënimit alternativ (dënimit me kusht), ngase me kryerjen e veprës penale personi i ka keqpërdorë këto liri dhe të drejta.

Dënimi plotësues mund të shqiptohet së bashku me dënimin kryesor ose alternativ.

Dënimet plotësuese janë:

- 1) heqja e të drejtës për t'u zgjedhur;
- 2) urdhri për kompensimin e humbjes apo dëmit;
- 3) ndalimi i ushtrimit të funksioneve në administratën publike ose në shërbimin publik;
- 4) ndalimi i ushtrimit të profesionit, i veprimtarisë ose detyrës;
- 5) ndalimi i drejtimit të automjetit;
- 6) marrja e lejes së vozitjes;
- 7) konfiskimi;
- 8) urdhri për publikimin e aktgjykimit dhe
- 9) dëbimi i të huajit nga territori i Republikës së Kosovës.

3. Dënimi plotësues me ndalimin e drejtimit të automjetit ose marrjen e sendit mund të shqiptohet së bashku me dënimin me kusht, me vërejtjen gjyqësore ose me lirim nga dënimi.

Matja e dënimit

Me matje të dënimit, nënkuptojmë caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit kryesit të veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit duhet të merren parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese që janë shprehur në momentin e kryerjes së veprës penale, në mënyrë që të caktohet ai lloj dhe masë e dënimit i cili do t'i përgjigjet peshës së veprës penale dhe rrezikshmërisë shoqërore të kryesit dhe me të cilën më së miri do të arrihej qëllimi i dënimit.

Duke pasur parasysh se cili organ e bën- matjen e dënimit, në të drejtën penale njihen tri lloje të matjes së dënimit:

- matja ligjore,
- matja gjyqësore,
- matja administrative.

Matja ligjore e dënimit siç tregon dhe vetë titulli bëhet nga organi që e nxjerr ligjin, me ç'rast ligjdhënësi cakton llojin dhe lartësinë e dënimit me rastin e parashikimit të veprave penale. Matja e dënimit nga ana e ligjdhënësit bëhet sipas rrezikshmërisë abstrakte të veprave penale.

Matja gjyqësore e dënimit, këtë lloj të matjes së dënimit e bën- gjykata kur në procedurën penale konstatohet se kryesi i veprës penale është penalisht përgjegjës për veprën e kryer. Sipas rregullave, gjykata matë dënimin brenda kufijve të minimumit të posaçëm dhe maksimumit të posaçëm i cili është përcaktuar me ligj për veprën e caktuar penale.

Matja administrative e dënimit. Sipas këtij sistemi, dënimin e matin organet kompetente për ekzekutimin e dënimit. Kjo matje e dënimit mund të aplikohet vetëm te dënimi me heqje të lirisë, me ç'rast gjykata cakton vetëm llojin e dënimit kurse kohëzgjatjen e dënimit e cakton organi administrativ-. Këtë lloj matje të dënimit KP i Kosovës nuk e njeh.

Individualizimi i dënimit

Me individualizimin e dënimit e nënkuptojmë përshtatjen e dënimit, veprës penale dhe të kryesit të saj. Qëllimi i individualizimit është që të shqiptohet ai dënimi i cili në mënyrë më efikase do të ndikojë në riedukimin e kryesit të veprës penale.

Matja e dënimit nga ana e gjyqit bëhet brenda minimumit dhe maksimumit të dënimit të paraparë me ligj për ato vepra penale dhe duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese. KP me nenin 73 parasheh në mënyrë të përgjithësuar se cilat rrethana gjykata do t'i merr parasysh gjatë matjes së dënimit dhe me atë rast i cekë rrethanat me tipare lehtësuese dhe rënduese, duke i lënë mundësi gjykatës që në çdo rast konkret të merr parasysh edhe rrethana- të tjera të cilat ndikojnë që të shqiptohet dënim më të ashpër apo më të butë. Në mesin e rrethanave që i parasheh KP, gjenden rrethanat objektive që i referohen veprës penale dhe rrethanat subjektive që i referohen kryesit.

KP (neni 73) si rrethana lehtësuese dhe rënduese i parasheh këto rrethana: shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer vepra penale, sjellja e mëparshme dhe rrethanat personale, pranimi i fajit nga kryesi i veprës penale, sjellja e kryesit pas kryerjes së veprës penale, intensiteti i rrezikimit apo i dëmtimit të së mirës së mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, gjendja pasurore e kryesit dhe të gjitha rrethanat tjera të cilat gjykata i vërteton në procedurë e që mund të ndikojnë gjatë matjes së dënimit.

Zbutja e dënimit

Sipas nenit 75 të KP të Kosovës njihen dy lloje të zbutjes së dënimit:

- a) *Zbutja e dënimit në rastet kur shprehimisht e parasheh ligji (zbutja ligjore).*
- b) *Zbutja e dënimit sipas bindjes së gjykatës (zbutja gjyqësore).*

Mënyra dhe kufijtë e zbutjes së dënimit janë të përcaktuara në mënyrë shprehimore në paragrafin 1 të nenit 76 të KP.

Lirimi nga dënimi

Në KP të Kosovës, neni 77 është paraparë mundësia e lirimit nga dënimi nga ana e gjykatës. Mirëpo, duhet theksuar faktin se gjykata mund të lirojë kryesin e veprës penale nga dënimi vetëm në rastet kur ligji shprehimisht e parasheh këtë mundësi (neni 77 par. 1). Sipas KP njihen dy grupe të rasteve kur kryesi mund të lirohet nga dënimi. Grupi i parë i rasteve është i paraparë me dispozitat e pjesës së përgjithshme të KP, ndërsa grupi i dytë me dispozitat e pjesës së posaçme.

Bazat e posaçme të lirimit nga dënimi për veprat penale të kryera nga pakujdesia.

Në nenin 78 të KP është paraparë në mënyrë shprehimore mundësia e lirimit nga dënimi për rastet e posaçme të veprave penale të kryera nga pakujdesia. Sipas kësaj dispozite gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryesin e veprës penale të kryera nga pakujdesia në këto situata:

- kur pasojat e veprës penale e godasin aq rëndë kryesin e veprës penale sa që ndëshkimi do të ishte i panevojshëm për realizimin e qëllimit të dënimit, ose
- kur kryesi menjëherë pas kryerjes së veprës penale ka bërë përpjekje për evitimin apo zvogëlimin e pasojave të asaj vepre dhe nëse në tërësi apo në masë të madhe e ka kompensuar dëmin i cili është shkaktuar në atë vepër.

Recidivi

Me recidiv apo fajtor përsëritës, nënkuptojmë rastet kur personi që ka qenë më parë i dënuar kryen vepër penale.

Matja e dënimit për veprat penale në bashkim

Me bashkim të veprave penale nënkuptojmë rastet kur një person kryen dy apo më shumë vepra penale, për të cilat i shqiptohet një dënim unik.

Në pjesën e përgjithshme të Kodit Penal, instituti i bashkimit të veprave penale nuk është paraparë si institut i veçantë, por janë paraparë sistemet për matjen e dënimit për veprat penale të kryera në bashkim (neni 80 të KPPK).

Në teorinë e së drejtës penale dhe praktikën gjyqësore njihen dy lloje të bashkimit të veprave penale, bashkimi ideal dhe bashkimi real. Bashkimi ideal ekziston në rastet kur një person me një veprim kryen dy apo më shumë vepra penale për të cilat i shqiptohet një dënim i përbashkët, ndërsa bashkimi real ekziston në rastet kur një person me dy apo më shumë veprime veç e veç kryen dy apo më shumë vepra penale për të cilat i shqiptohet një dënim i përbashkët.

Sistemet e matjes së dënimit për veprat penale të kryera në bashkim.

Legjislacionet penale e njohin 3 sisteme të matjes së dënimit unik për veprat penale në bashkim. Këto janë:

- sistemi i absorbicionit,
- sistemi i asperacionit,
- sistemi i komulacionit

Sistemi i absorbicionit i matjes së dënimit ekziston kur për veprat penale në bashkim, matja e dënimit unik bëhet në atë mënyrë që për secilën vepër penale matet një dënim, dhe dënimi më i rëndë i absorbon dënimet më të buta (p.sh. për një vepër penale jepet dënimi 5 vite, për tjetrën 4 vite dhe për të tretën 2 vite, sipas këtij sistemi do të shqiptohet dënimi prej 5 viteve sepse ky dënim i absorbon dënimet më të buta).

Sipas sistemit të asperacionit së pari matet dënimi veç e veç për çdo vepër penale në bashkim, mandej dënimi më i rëndë merret për bazë, kurse dënimet e tjera i shtohen këtij dënimi, por me kusht që dënimi unik të mos arrijë shumën e dënimeve e as mos të tejkalojë maksimumin e përgjithshëm të atij lloji të dënimit të përcaktuar me ligj (p.sh. në rastin e cituar më parë dënimit prej 5 vite do t'i shtohen dënimet prej 4 vite dhe 2 vite dhe dënimi unik duhet të jetë më i madh se 5 vite, por më i vogël se 11 vjet sa është shuma e këtyre dënimeve, p.sh. 8 vite).

Sipas sistemit të akumulacionit, gjithashtu së pari matet dënimi veç e veç për çdo vepër penale në bashkim e më pas mbledhen të gjitha dënimet dhe shuma e tyre paraqet dënimin unik të përbashkët (në rastin e cekur më parë dënimi- unik do të jetë 11 vjet).

KP i Kosovës i njeh të tri sistemet e matjes së dënimit për veprat penale në bashkim (neni 80).

Mirëpo, prej tri sistemeve që njihen, sipas KP të Kosovës sistemi i asperacionit është themelor ngase më së shpeshti aplikohet në praktikë, ndërsa sistemet e kumulacionit dhe absorbicionit janë sisteme plotësuese, komplementare.

Sipas sistemit të absorcionit, nëse gjykata për ndonjë veprë penale të kryer në bashkim ka shqiptuar dënimin me burgim të përjetshëm atëherë e shqipton vetëm këtë dënim (neni 80 par. 2 pika 2.1 KP).

Sistemi i asperacionit më së shpeshti aplikohet, parashikohet për shqiptimin e dënimit unik për veprat penale në bashkim në rastet kur gjykata vendos të shqiptojë dënime me burgim. Ky sistem është paraparë shprehimisht në paragrafin 2 pika 2.2 të nenit 80, sipas të cilit, nëse gjykata për secilën veprë penale ka shqiptuar dënimin me burgim, dënimi unik duhet të jetë më i madh se çdo dënim i veçantë, por dënimi unik nuk mund të arrijë shumën e të gjitha dënimeve të përcaktuara dhe as të tejkalojë periudhën prej 25 vjet.

Gjithashtu, sistemi i asperacionit të matjes së dënimit për veprat penale relativisht të lehta në bashkim, është paraparë edhe në pikën 2.3 të paragrafit 2 të nenit 80. sipas kësaj dispozite nëse gjykata ka shqiptuar dënimin me burgim deri në 3 vjet për të cilën prej veprave penale, dënimi unik nuk mund të jetë më i madh se 8 vjet.

Sistemi i akumulacionit me limitet e përcaktuara, aplikohet në rastet kur gjykata për veprat penale në bashkim shqipton dënime me gjobë. Sipas nenit 80 par. 2 pika 2.4, nëse gjykata ka caktuar dënime me gjobë për secilën nga veprat penale dënimi unik me gjobë nuk mund të tejkalojë shumën prej 25.000 euro, ose 500.00 euro, kur një apo më shumë vepra penale janë kryer me qëllim të përfitimit material. Nëse gjykata për disa vepra penale pashqiptuar dënime me burgim, ndërsa për vepra të tjera ka shqiptuar dënim me gjobë, ajo shqipton një dënim unik me burgim dhe një dënim unik me gjobë, në pajtim me nenin 80 par. 2 pika 2.5 të KP.

Dënimin plotësues gjykata e shqipton nëse është paraparë së paku për një veprë penale, ose nëse gjykata ka shqiptuar dënime me gjobë për shumë vepra penale, atëherë ajo e shqipton një dënim unik me gjobë, sipas par.3 të nenit 80.

Matja e dënimit personit të dënuar.

Sipas dispozitës së nenit 82 të KPPK, matja e dënimit personit të dënuar bëhet sipas rregullave të parapara për veprat penale në bashkim. Sipas këtyre dispozitave, në rastin e shqiptimit të dënimit unik për të gjitha veprat penale, dënimin e shqiptuar më parë gjykata e trajton si të përcaktuar, kurse dënimin e matë vetëm për veprat penale që nuk kanë qenë të përfshira me aktgjykimin e mëparshëm. Më pas duke i aplikuar dispozitat e kodit penal që i referohen matjes së dënimit për veprat penale në bashkim, e shqipton dënimin unik për të gjitha veprat penale, zakonisht duke aplikuar sistemin e asperacionit. Në rastet e këtilla dënimin apo pjesën e dënimit të cilin e ka vuajtur i llogaritet në dënimin e shqiptuar.

Dënimi për veprat penale në vazhdim

Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjashme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes, dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim:

- 1.1. viktimës së njëjtë të veprës penale;
- 1.2. objekti i njëjtë i veprës;
- 1.3. shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënies së njëjtë kohore;
- 1.4. vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; dhe
- 1.5. dashja e njëjtë e kryesit.

2. Veprat penale të kryera kundër personit mund të konsiderohen si vepër penale në vazhdim vetëm nëse janë kryer kundër të njëjtit person.

3. Veprat penale në vazhdim, të cilat për shkak të natyrës së tyre nuk mund të bashkohen në një vepër, nuk konsiderohen vepra penale në vazhdim.

4. Nëse vepra penale në vazhdim përfshin forma të rënda dhe të lehta të të njëjtës vepër, konsiderohet se vepra penale në vazhdim është kryer në formën e rëndë.

5. Nëse vepra penale në vazhdim përfshin veprat penale element i të cilave është shuma në para, vepra penale në vazhdim do të përcaktohet nga shuma e tërësishme e realizuar me të gjitha veprat e veçanta.

6. Vepra penale e cila nuk është përfshirë në veprën penale në vazhdim në aktgjykimin e plotfuqishëm të gjykatës, por është zbuluar më vonë, paraqet vepër penale të veçantë.

Llogaritja e paraburgimit dhe e dënimit të mëparshëm

Paraburgimi është masë penalo juridike e paraparë me Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale. Sipas Kodit Penal, koha që i pandehuri ka kaluar në paraburgim, si dhe çdo lloj tjetër të privimit nga liria lidhur me veprën penale, detyrimisht llogaritet në dënimin e shqiptuar me dënim me burgim, burgim afatgjatë, dhe në dënimin me gjobë (neni 82 par. 1 të KPPK). Nga kjo rezulton se gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit duhet medoemos t'ia llogarisë të pandehurit tërë atë kohë të cilën e ka kaluar në paraburgim, kështu që ai do ta mban vetëm pjesën e mbetur. Sipas dispozitës së nenit 82 par. 2 të KPPK, dënimi ose dënimi me gjobë të cilin i pandehuri e ka mbajtur përkatësisht e ka paguar për kundërvajtje apo për delikt ekonomik, përfshihen në dënimin e shqiptuar për vepër penale, tiparet e së cilës përfshijnë edhe tiparet e kundërvajtjes apo deliktit ekonomik.

Masa mbrojtëse e cila është shqiptuar për kundërvajtje ose për delikt ekonomik përfshihet në dënimin plotësues për vepër penale tiparet e së cilës i përfshijnë edhe tiparet e kundërvajtjes apo deliktit ekonomik.

Një ditë paraburgim, një ditë të heqjes së lirisë, një ditë burgim, një ditë burgim afatgjatë dhe 20 € të dënimit me gjobë, barazohen për qëllime të llogaritjes sipas këtij neni.

Vërejtja e gjykatës

Vërejtja e gjykatës është sanksion penal i paraparë me dispozitën e nenit 85 dhe 86 të KPPK.

Sipas dispozitës së nenit 85 të KPPK, qëllimi i vërejtjes së gjykatës është që t'i jepet kryesit qortimi kur duke pasur parasysh të gjitha rrethanat në lidhje me veprën penale dhe kryesin, vërejtja gjyqësore është e mjaftueshme për të arritur qëllimin e dënimit.

Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi me burgim deri në një vit ose dënimi me gjobë, në rast kur veprat e tilla janë kryer në rrethana lehtësuese të cilat i bëjnë veprat veçanërisht të lehta.

Përfundimisht sipas dispozitës së nenit 86 par. 3 vërejtja e gjykatës mund të shqiptohet dhe për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me burg deri në tre vjet.

Pra, vërejtja gjyqësore paraqet qortim serioz dhe publik që i bëhet kryesit të veprës penale nga gjykata dhe njëherit i tërhiqet vërejtja që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale.

Baza e konfiskimit të dobisë pasurore

Gjykata është e obliguar që t'ia konfiskojë çdokujt dobinë pasurore që është rezultat i veprës penale. Kjo dispozitë është ndërtuar në bazë të parimit të përgjithshëm juridik se kryerësit të veprës penale si dhe çdo pjesëmarrësi në veprën penale të mos i lejohet shfrytëzimi i fitimit të realizuar me veprën penale. Në mënyrë sublimë dhe përmbajtësore, profesori Baqiq e cekë kësioji dhe e mbështetë arsyeshmërinë dhe bazën juridike, morale dhe etike të marrjes së dobisë pasurore të fituar me veprën penale: "Në aspektin juridik është e palejueshme, e padrejtë si dhe është e pamoralshme që dikush ta mbajë fitimin pasuror të realizuar me veprën penale.

Marrja e dobisë pasurore e realizuar me veprën penale bazohet në parimin e drejtësisë. Kjo si e tillë e ka edhe efektin juridik, ngase e thekson në mënyrë decisive faktin se kryerësit detyrimisht do t'i merret dobia pasurore. Zbatimi i kësaj mase ka edhe karakter të preventivës gjenerale.

Në rastet kur gjykata konstaton se me veprën penale është realizuar dobia pasurore, ajo është e obliguar edhe pa propozimin e paditësit, eksoficio ta shqiptoj masën e konfiskimit të dobisë pasurore (neni 6 par. 7 i Ligjit për Kompetencat e Zgjeruara për Konfiskimin e Pasurisë së Përfitur me vepër Penale). Këtë masë gjykata është e obliguar ta shqiptoj: pa marrë parasysh çfarë është fitimi pasuror; pa marrë parasysh se a është dëmtuar apo jo ndokush; pa marrë parasysh se çka ka bërë kryerësi me pasurinë (p.sh. nëse e ka asgjësuar, ia ka falë ndokujt dhe kështu nuk ka realizuar fitim pasuror). Pasi që është konstatuar fitimi pasuror i realizuar nga vepra penale, nuk është e lejuar që gjykata ta vlerësoj oportunitetin e shqiptimit të kësaj mase.

Nëse gjykata nuk e shqipton këtë masë kur janë plotësuar kushtet, atëherë sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale kjo konsiderohet shkelje e Kodit Penal.

Marrja e fitimit pasuror mund të bëhet vetëm me aktgjykimin e plotfuqishëm me të cilën është konstatuar kryerja e veprës penale. Kjo masë shqiptohet në rastet kur kryerësit të veprës penale i shqiptohet dënimi kryesor, dënimi alternativ, vërejtja e gjykatës dhe lirimi nga dënimi. Kjo masë u shqiptohet edhe të miturve kur u shqiptohen masa e diversitetit, masat edukuese apo dënimet. Gjithashtu kjo masë u shqiptohet edhe personave të papërgjegjshëm apo me përgjegjshmëri të zvogëluar kur u shqiptohet trajtimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në entin shëndetësor si dhe trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri dhe kryerësve në varësi të drogës apo alkoolit.

Për procedurën e shqiptimit të kësaj mase më detajisht shih dispozitat e neni 267 – 284 të KPPK. Ndërsa për ekzekutimin dhe administrimin e pasurisë së konfiskuar shih nenin 10 të Ligjit për r Konfiskimin e Pasurisë të Fituar me vepër Penale.

Kushtet dhe mënyra e konfiskimit të dobisë pasurore

Para së gjithash dobia pasurore merret nga kryerësi i veprës penale. Mirëpo dobia pasurore konfiskohet edhe nga çdo person i cili në ndonjë formë ka bashkëpunuar në kryerjen e veprës penale dhe që ka pasur dobi pasurore nga vepra penale. Rrjedhimisht kjo masë shqiptohet edhe ndaj organizatorit të bashkimit kriminal apo anëtarit, nga shtytësi, ndihmësi apo ai i cili e ka fshehur veprën penale apo kryerësin. Kjo masë shqiptohet gjithashtu edhe ndaj personit të cilit i është dhënë që ta ruajë pasurinë e fituar me veprën penale. Andaj nuk është formulim adekuat në dispozitën e paragrafit 1, ku thuhet se dobia pasurore merret nga kryerësi, ngase siç shihet kjo masë shqiptohet edhe ndaj secilit që në ndonjë mënyrë ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale dhe nga ajo ka pas përfitim pasuror.

Në praktikën gjyqësore me të drejtë janë konsideruar si fitim pasuror edhe nëse kryerësit të veprës penale p.sh. i janë paguar shpenzimet e rrugës, pagesa e qëndrimi në shtetin e huaj, pagesa e pushimit veror në det apo pushimi dimëror në skijim, apo nëse i është dhënë kredi e beneficuar-me kamatë më të ultë dhe shërbime të ngjashme. Në këso raste i caktohet shuma e parasë e cila do të ishte adekuate me vlerën e shërbimeve. Në rastet e dëmtimit të sendeve apo të zvogëlimit të vlerës së tyre në ndonjë mënyrë tjetër, kryerësi obligohet që t'i kompensojë.

Vendimtare për shqiptimin e kësaj mase është çfarëdo fitimi pasuror i realizuar nga kryerja e veprës penale.

Në rastet kur fitimi pasuror është realizuar nga kryerja e veprës penale në bashkëpunim, atëherë duke e respektuar parimin e përgjegjësisë subjektive dhe individuale, këtë masë gjykata ia shqipton secilit pjesëmarrës dhe për secilin e cakton lartësinë e fitimit të realizuar. Mirëpo në disa raste kjo nuk është e mundur të konstatohet, kështu që sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale gjykata është e autorizuar që sipas bindjes së lirë të ia caktoj secilit lartësinë e fitimit të realizuar e cila i merret. Lidhur me këtë, mbisundon mendimi në praktikën gjyqësore se në rastet e veprës penale të kryer në bashkëpunim me të cilën është realizuar fitim pasuror, bashkëpunëtorët nuk mundën të obligohen që në mënyrë solidare t'u merret fitmi pasuror.

Kryerësit të veprës penale i konfiskohen të gjitha të hollat, sendet me vlerë dhe çdo dobi tjetër pasurore që është fituar me kryerjen e veprës penale. Ndërsa në rastet kur konfiskimi i të njëjtës dobi pasurore nuk është i mundshëm, p.sh. nuk mund të konfiskohet automobili ngase kryerësi e ka shitë, atëherë kryerësi detyrohet të paguajë shumën e të hollave e cila i përgjigjet dobisë së fituar pasurore.

Gjykata sipas detyrës zyrtare në procedurën penale është e obliguar ta përcaktoj saktësisht vlerën e realizuar të dobisë pasurore.

Në fjalinë e fundit të paragrafit 1, është paraparë mundësia që gjykata të lejoj që kryerësi të hollat t'i paguaj në këste gjatë periudhës e cila nuk i tejkalon dy vite. Sipas mendimit tone, kjo mundësi duhet të lejohet në raste të rralla, përjashtimisht dhe vetëm atëherë kur nga kryerësi kurrsesi nuk mund të konfiskohet menjëherë dobia pasurore. Në të kundërtën nëse lejohet në mënyrë ekstenzive kjo mundësi, atëherë kjo masë e humbë efektin e saj.

Lidhur me përmbajtjen e kësaj mase, në teori dhe praktikë ekzistojnë dilema se çka i merret nëse kryerësi me paratë të cilat i ka fituar me kryerjen e veprës penale ka blerë sende tjera apo nëse sendet që i ka fituar me veprën penale i ka ndërrua (këmbye) me sende tjera, p.sh. me parat e vjedhura ka blerë automobil apo kompjuterin –lapë top e ka ndërrua me ndonjë makinë. Në këso raste shtrohet pyetja se a do t'i merren këto sende (automobili apo makina), apo do të obligohet të paguaj para në vlerën e sendeve që i ka prokuruar me veprën penale. Lidhur me këtë, mbisundon mendimi se mund t'i merren vetëm sendet të cilat janë prokuruar me veprën penale, ndërsa nëse kjo nuk është e mundur, kryerësi obligohet që të paguaj shumën e parasë në vlerën e sendeve të prokuruar.

Nuk janë raste të rralla që kryesi, dobinë pasurore të cilën e ka fituar me veprën penale, ta bartë në persona të tjerë në formë dhurate apo në ndonjë formë tjetër. Sipas paragrafit 2, në rastet e tilla mund të ndodhin dy situata. Situata e parë është kur pasuria e fituar me veprën penale të bartet në persona të tjerë. Ndërsa situata e dytë është kur pasuria bartet në të afërmit e kryerësit.

- 1) Nëse dobia pasurore është bartur në persona të tjerë, që të mund të shqiptohet konfiskimi i dobisë pasurore, duhet që të përmbushen dy kushte, kushti objektiv dhe subjektiv. Kushti objektiv përmbushet në rastet kur pasuria është bartur pa kompensim apo me kompensim që nuk i përgjigjet vlerës reale. Ndërsa kushti subjektiv përmbushet në rastet kur personi në të cilin është bartur pasuria, e ka ditur apo ka mundur të dijë se pasuria është fituar me veprën penale. Që të mundet gjykata të shqiptojë këtë masë, duhet të përmbushen të dy kushtet në mënyrë kumulative. Rasti i tillë është p.sh. nëse personi i cili e ka vjedhur një orë të arit, që kushton 1000 euro, këtë orë të vjedhur ia falë ndokujt apo ia shet shumë lirë – për 100 euro. Kjo orë mund t'i merret personit të cilit i është falur apo shitur me këtë çmim shumë të lirë.
- 2) Nëse dobia pasurore e fituar me veprën penale është bartur në të afërmit e ngushtë, kjo dobi do të konfiskohet nëse nuk administrojnë prova se si kompensim kanë dhënë vlerën e plotë. Nga kjo rezulton se në rastet kur të afërmit e kryerësit të veprës

penale kanë dhënë kompensimin e plotë, nuk ka arsye që nga këta të konfiskohet dobia pasurore. Në kësi raste dobia pasurore merret nga kryerësi i veprës penale. Siç cekëm më sipër, qëllimi i masës së konfiskimit të dobisë pasurore është që personave t'u bëhet e pamundshme të pasurohen me anë të kryerjes së veprës penale. Mirëpo, me anë të kësaj mase nuk guxohet të merret pasuria e cila nuk është rezultat i veprës penale, ngase kjo masë as pjesërisht nuk guxon të shndërrohet në dënim pasuror. Për kushtet të cilat duhet të plotësohen për të mund me u konfiskuar dobia pasurore e fituar me veprën penale dhe mënyrën e ekzekutimit të kësaj mase, më për së afërmi shif nenin 4 – 11 të Ligjit për Konfiskimin e Pasurisë së Fituar me Vepër Penale.

Mbrojtja e të dëmtuarit

Sipas dispozitës ligjore që i referohet kësaj çështje (neni 98) personi i dëmtuar me veprën penale ka përparësi në realizimin e kërkesës pronëso- juridike. Lidhur me kërkesën e personit të dëmtuar me veprën penale, mund të paraqiten dy situata:

- ku i dëmtuari ka paraqitur kërkesën pronëso- juridike,
- situata kur kërkesën pronëso- juridike nuk e ka paraqitur.

Në rastin kur i dëmtuari në procedurën penale e paraqet kërkesën pronëso- juridike, gjykata mund të vendosë për tërë kërkesën. Nëse fitimi pasuror të cilin i akuzuari e ka realizuar me veprën penale është në lartësi të vlerës së kompensimit të dëmit, të cilin ia ka caktuar gjykata, atëherë nuk ka arsye që gjykata të shqiptojë edhe masën e konfiskimit të pasurisë, ngase kjo dobi është marrë. Mirëpo nëse fitimi pasuror, të cilin e ka realizuar me veprën penale i akuzuari, është më i madh se vlera të cilën gjykata ka vendosur lidhur me kërkesën pronëso- juridike, gjykata do të shqiptojë masën e marrjes së dobisë pasurore.

Mund të ndodhë që i dëmtuari i cili e ka paraqitur kërkesën pasurore juridike në procedurën penale, lidhur me kërkesë të udhëzohet në kontest civil. Në raste të tilla i dëmtuari mund të kërkojë që të kompensohet nga shuma e vlerës e cila është konfiskuar, nëse e fillon procedurën kontestimore brenda afatit prej 6 (gjashtë) muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është udhëzuar në procedurën kontestimore dhe nëse brenda afatit 3 (tre) muaj, nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit me të cilin është zgjidhur pozitivisht kërkesa e tij, e kërkon kompensimin nga vlera e cila është konfiskuar. Dhe situata e dytë shprehet në rastin kur i dëmtuari nuk e paraqet kërkesën pronëso- juridike në procedurën penale. Në rastin e tillë i dëmtuari mund të kërkojë kompensimin e dëmit nga vlera e konfiskuar nëse e fillon procedurën e kontestit civil në afat prej 3 (tre) muaj nga dita kur ka marrë vesh për aktgjykimin me të cilin është konfiskuar dobia pasurore dhe më së voni në afatin prej 2 (dy) vitesh nga plotfuqishmëria e vendimit mbi konfiskimin e dobisë pasurore dhe nëse në afatin prej 3 (tre) muaj nga dita e vendimit të plotfuqishëm me të cilin është vërtetuar kërkesa e tij, kërkon kompensimin nga vlera e dobisë pasurore e cila është konfiskuar (neni 98 par. 3 të KP).

Konfiskimi i dobisë pasurore nga personat juridikë

Sipas dispozitës së nenit 99, nëse me anë të kryerjes së veprës penale të kryer nga ana e kryerësit, përfiton dobi pasurore një organizatë biznesi ose ndonjë person tjetër juridik, kjo dobi pasurore e organizatës së biznesit ose personit juridik konfiskohet.

Rehabilitimi

Rehabilitimi nënkupton kthimin e të drejtave personit të dënuar pasi ta ketë mbajtur dënimin. Gjithashtu, me rehabilitimin nënkuptojmë edhe shlyerjen e pasojave juridike në ato legjislacionit të cilat i njohin këto pasoja, si dhe shlyerjen e dënimeve nga evidenca e të ndëshkuarve.

Instituti i rehabilitimit e njeh edhe KP i Kosovës, neni 102. në këtë dispozitë është paraparë shprehimisht se pas dënimit të mbajtur, amnistisë, ose faljes, parashkrimit, personat e dënuar i gëzojnë të gjitha të drejtat e përcaktuara me ligj dhe me dispozita të tjera dhe mund t'i fitojnë të gjitha të drejtat përveç rasteve kur ndryshe është përcaktuar me kod. Rehabilitimi është në funksion të risocializimit dhe reintegrimit të personit të dënuar në shoqëri.

KP i njeh dy lloje të rehabilitimit, rehabilitimi ligjor që paraqitet në mënyrë automatike me kalimin e kohës së caktuar me ligj pas dënimit të mbajtur dhe me kusht që personi i dënuar gjatë kësaj periudhe të mos kryejë veprë të re penale, dhe rehabilitimi gjyqësor i cili për nga efekti është i njëjtë me rehabilitimin ligjor, mirëpo ky realizohet ndryshe. Sipas KP të Kosovës neni 102, pasi që i dënuari e mban dënimin, i fiton të gjitha të drejtat që i ka pasur para se të ketë kryer veprën penale për të cilën është dënuar.

Në KP të Kosovës janë paraparë dy kufizime dhe ato i referohen dënimit me burgim mbi 15 vjet dhe dënimit me burgim të përjetshëm, ku sipas dispozitës së nenit 103 parashihet se këto dy dënime nuk mund të shlyhen, dhe kufizimi i dytë sipas nenit 103 par. 4 ekziston se dënimi nuk mund të shlyhet gjatë kohës së dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm.

PARASHKRIMI

Parashkrimi i ndjekjes penale konsiston në atë se për shkak të kalimit të afatit i cili është paraparë me ligj nuk mund të ndërmerret ndjekja penale dhe personit nuk mund t'i shqiptohet dënimi për veprë penale që e ka kryer. Nëse ndjekja penale është në vazhdim e sipër dhe nëse në ndërkohë ka ardhë gjër te parashkrimi, ndjekja penale nuk mund të vazhdohet.

Në çdo fazë të procedurës penale, gjykata dhe organet e tjera të ndjekjes penale si dhe organet e ekzekutimit të sanksioneve penale, janë të detyruara sipas detyrës zyrtare të kujdesen, ta marrin parasysh dhe ta zbatojnë parashkrimin. Së këndejmi parashkrimi shprehet sipas fuqisë së ligjit (*ex lege*), në të gjitha rastet kur skadojnë afatet e parashkrimit.

Koha që duhet të kalojë për t'u bërë parashkrimi, quhet afati i parashkrimit. Kohëzgjatja e afatit të parashkrimit është paraparë në paragrafin 1 dhe është përcaktuar varësisht prej lartësisë së dënimit të paraparë për veprën penale. Rrjedhimisht për parashkrimin e ndjekjes penale për vepra penale të rënda është e nevojshme të kaloj periudhë më e gjatë kohore, ndërsa për vepra më të lehta afat më i shkurtër. Kështu sipas paragrafit 1, afati maksimal i parashkrimit është 30 vjet, ndërsa afati më i shkurtër dy vjet. Për afatin e parashkrimit vendimtare është kufiri i epërm i dënimit të paraparë.

Nëse për veprën penale janë paraparë shumë dënime, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë (neni 106, par.2). Gjithashtu, nëse për një vepër janë paraparë dënime alternative, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit më të rëndë. Nëse për një vepër penale janë paraparë në mënyrë alternative dënimi me burgim apo me burgim të përjetshëm, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit me burgim të përjetshëm. Nëse për një vepër penale janë paraparë shumë dënime në mënyrë kumulative, p.sh. dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë, afati i parashkrimit caktohet sipas dënimit me burgim si dënim kryesor.

Parashkrimi fillon të ecë nga dita kur është kryer vepra penale. Afatet e parashkrimit janë të caktuara sipas viteve, ndërsa vitet llogariten sipas kohës kalendarike. Në rastet kur afati i parashkrimit skadon të dielën apo në ditën e ndonjë feste shtetërore apo të ndonjë feste tjetër zyrtare që nuk punohet, kjo nuk ndikon në afatin e parashkrimit, përkatësisht afati i parashkrimit nuk vazhdohet deri në ditën që punohet.

Nëse ekzistojnë dilema se në cilën ditë është kryer vepra penale, sipas parimit *ind dubio pro reo* merret parasysh varianti e cila është më e favorshme për kryerësin.

Në rastet kur me ligj është paraparë mundësia e zbutjes së dënimit, lirimit nga dënimi apo mundësia e shqiptimit të vërejtjes së gjykatës (si psh. për tentativën e veprës penale, për tejkalimin e mbrojtjes së nevojshme etj), si dhe mundësia e shqiptimit të dënimit më të rëndë (p.sh. për recidivin e shumfishtë), këto rrethana apo mundësi nuk kanë ndikim në përcaktimin e afatit të parashkrimit. Në të gjitha këto raste afati i parashkrimit përcaktohet sipas dënimit të paraparë për veprën penale të kryer.

Për veprat penale të parapara në formë të kualifikuar apo të privilegjuar, afati i parashkrimit përcaktohet sipas dënimit të paraparë të formës përkatëse të veprës penale të kryer. Përkatësisht nëse është kryer forma e rëndë e veprës penale, afati i parashkrimit përcaktohet sipas dënimit të paraparë për formën e rëndë. Në të kundërtën, nëse është kryer forma e lehtë, afati i parashkrimit përcaktohet sipas kësaj forme.

Nëse vepra penale ka ngelur në tentativë, vlen afati i parashkrimit që është paraparë për vepër penale të përfunduar.

Në rastet e bashkimit ideal apo real të veprave penale, afati i parashkrimit përcaktohet për çdo vepër penale në bashkim.

Nëse pas kryerjes së veprës penale me ligj është ndryshuar dënimi dhe nëse ai dënim ka ndikim në kohëzgjatjen e afatit të parashkrimit të ndjekjes penale, sipas dënimit të ri do të përcaktohet afati i parashkrimit vetëm nëse ai afat është më i shkurtër. Zgjidhja e këtillë bazohet në paragrafin 2 të nenit 3, dispozitë kjo e cila parasheh mundësin e

veprimit retroaktiv të ligjit në rastet kur është më i favorshëm për kryerësin e veprës penale.

Fillimi dhe ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale

Sipas paragrafit 1 të nenit 107 afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të ecë nga dita kur është kryer vepra penale apo kur është tentuar. Në rastin e parë është fjala për veprën penale të përfunduar. Nëse është fjala për tentativën e metë, parashkrimi fillon të ecë prej momentit kur është ndërprerë fillimi i veprimit të kryerjes, ndërsa te tentativa e plotë parashkrimi fillon të ecë në momentin e përfundimit të veprimit.

Te veprat penale me mosveprim, afati i parashkrimit i ndjekjes penale fillon të ecë prej momentit kur ka pushuar obligimi i kryerësit që të ndërmarrë veprimin e caktuar.

Në rastet kur vepra penale është kryer në bashkëpunim, afati i parashkrimit fillon të ecë prej ditës kur fillon të ecë për kryerësin e veprës penale, përkatësisht prej ditës kur është ndërmarrë veprimi i kryerjes. Ndërsa në rastet kur në bashkëpunim janë kryer dy apo më shumë vepra penale, afati i parashkrimit fillon të ecë prej momentit të kryerjes së veprës penale më të rëndë.

Afati i parashkrimit është çështje specifike në rastet e veprës penale të vazhduar, të veprës penal kolektive dhe të veprës penale permanente.

Në rastet e veprës penale të vazhduar e cila është një lloj konstruksioni juridik ku shumë vepra penale mund të jenë kryera p.sh brenda një dite apo brenda një viti, në raste të tilla parashkrimi fillon të ecë nga momenti (dita) prej kur është ndërmarrë veprimi i veprës penale të fundit e cila bënë pjesë në veprën penale të vazhduar.

Në rastet e *veprës penale kolektive* afati i parashkrimit fillon të ecë prej ditës kur është ndërmarrë veprimi i fundit i cili hynë në përbërje të veprës penale kolektive, përkatësisht sipas kritereve të cilat vlejné për veprën penale të vazhduar.

Në rastet e *veprave penale permanente*, siç është p.sh. vepra penale e privimit të kundërligjshëm nga liria apo vepra penale e rrëmbimit, si veprim i kryerjes konsiderohet e tërë koha deri sa zgjatë gjendja e kundërligjshme. Së këndejmi afati i parashkrimit fillon të ecë nga momenti, nga dita kur pushon gjendja e tillë, kur lirohet personi i privuar apo i rrëmbyer.

Në rastet kur vepra penale është kryer ndaj personit nën moshën 18 vjet, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita kur viktima të ketë mbushur tetëmbëdhjetë vjet.

Gjatë afatit të parashkrimit mund të paraqiten rrethana të caktuara të cilat e pengojné ecjen e parashkrimit të ndjekjes penale dhe shpijnë në **ndalje** dhe **ndërprerje**. Në rastet e ndaljes dhe të ndërprerjes, në fakt vazhdohen afatet e parashkrimit relativ.

Ndalja e parashkrimit. Ndalja e parashkrimit të ndjekjes penale paraqitet atëherë kur për shkak të disa rrethanave të parapara me ligj, ndjekja penale nuk mund të fillohet apo nëse është filluar nuk mund të vazhdohet sipas ligjit (par. 3). Gjatë asaj kohe derisa janë të pranishme ato rrethana, të cilat e pengojné fillimin apo vazhdimin e ndjekjes penale, parashkrimi nuk rrjedhë. Kjo ngecje e afatit të parashkrimit, për shkak të efektit të rrethanave të caktuara, quhet ndalja e parashkrimit. Kur pushojné (evitohen) pengesat

që e kanë shkaktuar ndaljen e parashkrimit, afati i parashkrimit vazhdon të ecë. Në asi raste aq kohë sa ka zgjatur ndalja, për aq kohë vazhdohet edhe afati i parashkrimit.

Në shkencën e së drejtës penale njihen dy lloje të pengesave të cilat mund të shkaktojnë ndaljen e afatit të parashkrimit: **pengesat faktike dhe pengesat juridike**.

Pengesat faktike janë ato rrethana dhe situata reale të cilat e bëjnë të pamundshëm fillimin apo vazhdimin e ndjekjes penale. Si rrethana apo situata faktike për shkak të të cilave nuk mund të filloj apo të vazhdoj ndjekja, në par. 3 janë cekë në mënyrë ekzemplare këto rrethana: kur kryerësi është jashtë Republikës së Kosovës dhe kjo shkakton vonesa në procedurë; kur kryerësi kërkohet me urdhër arrest; kur kryeprokurori i shtetit, në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, përpiket të sigurojë dëshmi jashtë Republikës së Kosovës; ose gjatë kohës sa zgjatë procedura për pranimin e fajësisë. Përveç këtyre rrethanave të cilat ceken në Kodin Penal, si rrethana apo situata të tjera për shkak të të cilave nuk mund të fillohet apo të vazhdohet ndjekja penale janë p.sh. edhe arratisja e kryerësit të veprës penale; kur nuk dihet vendbanimi i kryerësit; okupimi i territorit nga ana e armikut; tërmeti; vërshimet; zjarri; epidemitë; kur kryerësi është i panjohur apo kur është i paarritshëm për organet e ndjekjes dhe rrethanat e tjera të ngjashme të cilat e bëjnë të pamundshme punën e gjykatave.

Pengesat juridike ose ligjore konsiderohen ato të cilat në ligj janë cekë në mënyrë shprehimore si shkak që kundër kryerësit të caktuar nuk mund të fillohet procedura penale, ndërsa nëse është filluar ajo duhet të ndalet. Së këndejmi për parashkrimin për shkak të pengesave relevante janë dispozitat e Kodit të Procedurës Penale me të cilat janë paraparë rrethanat apo situatat për shkak të të cilave nuk mund të fillohet apo të vazhdohet ndjekja penale. Rrethana apo situata të tilla janë p.sh. imuniteti i deputetit të parlamentit apo i ndonjë zyrtari të lartë; nevoja e zgjidhjes së ndonjë çështjes procedurale, koha deri sa nuk vendoset lidhur me kërkesën për ekstradim, sëmundja psikike e të pandehurit gjatë procedurës penale etj.

Paragrafi 5 dhe 6 e rregullon çështjen e *ndërprerja e parashkrimit*. Ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale qëndron në faktin se gjatë kohës sa zgjasin rrethanat, të cilat ligji veçmas i parasheh, afati i parashkrimit ndërprehet. Në këto raste, koha e cila ka kaluar para ndërprerjes nuk llogaritet, por parashkrimi fillon të ecë rishtas.

Kodi Penal njeh dy shkaqe të cilat shpijnë ndërprerjen e parashkrimit.

- 1) Së pari, parashkrimi i ndjekjes penale ndërprehet me çdo veprim të organit shtetëror kompetent, i cili ndërmerret me qëllim të ndjekjes së kryerësit për shkak të veprës penale të kryer (par. 5). Nga kjo rezulton se për t'u ndërprerë parashkrimi, veprimi duhet të ndërmerret nga organet kompetente për luftimin e kriminalitetit, e këto janë: prokuroria, gjykata apo policia. Veprimet e organeve kompetente që e ndërprejnë parashkrimin mund të jenë p.sh. marrja në pyetje e dëshmitarit, nxjerrja e vendimit për paraburgim, hetimi në vendin e ngjarjes, ekspertiza, veprimet procedurale të paditësit privat dhe të të dëmtuarit si paditës, veprimet e policisë të cilat ndërmerren me kërkesën e prokurorit të shtetit apo të gjykatës etj.
- 2) *Kryerja e veprës penale të re gjatë afatit* të parashkrimit është shkak i dytë që shpie ndërprerjen e afatit të parashkrimit (paragrafi. 6). Vepra penale e re për nga pesha

duhet të jetë e njëjtë apo më e rëndë se ajo që është kryer më parë. Me rastin e vlerësimit nëse vepra penale është e njëjtë apo më e rëndë se ajo që është kryer më parë, vendimtar është dënimi i paraparë në ligj për atë vepër. Në këso raste parashkrimi nuk shprehet deri sa edhe për atë vepër penale të re nuk skadon afati i parashkrimit.

Nëse në kryerjen e veprës penale kanë marrë pjesë shumë persona, ndërprerja e parashkrimit do të ekzistojë vetëm ndaj atij personi kundër të cilit është ndërmarrë veprimi i ligjshëm i organit kompetent, përkatësisht vetëm ndaj atij i cili gjatë afatit të parashkrimit kryen vepër penale me peshë të njëjtë apo më të rëndë.

Efekti i ndërprerjes në afatin e parashkrimit konsiston në atë që me çdo ndërprerje fillon të rrjedhë afati i ri i parashkrimit. Thënë ndryshe, në rastin e ndërprerjes periudha kohore e mëparshme e parashkrimit nuk llogaritet.

Paragrafi 8 e rregullon çështjen e *parashkrimi absolut*. Ndalja dhe ndërprerja e parashkrimit mund të shprijnë praktikisht që kurrë njëherë të mos shkaktohet parashkrimi. Sidomos me ndërprerje gjithherë mund të pengohet parashkrimi ngase organet kompetente shtetërore mund të ndërmarrin veprime me të cilat do të bënin të pamundshme kuptimin dhe qëllimin e parashkrimit. Për t'iu shmangur kësaj mundësie, e drejta penale bashkëkohore parashih parashkrimin absolut.

Në dispozitën e par. 4 është thuhet se afati i parashkrimit nuk ndërpritet nëse vepra nuk ndiqet për shkak të mungesës së kërkesës apo autorizimit për të bërë ndjekjen ose për shkak të mungesës së kërkesës nga ana e shtetit të huaj për të bërë ndjekjen.

Parashkrimi absolut i ndjekjes penale paraqitet kur kalon dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin, pa marrë parasysh në ndërprerjet apo ndaljet eventuale të mëparshme. Në këtë sens në paragrafin 8 është paraparë se parashkrimi shprehet në çdo rast kur të ket kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit. Kështu, p.sh. nëse për ndonjë vepër është paraparë se parashkrimi shkaktohet pas pesë vjetëve, atëherë parashkrimi absolut paraqitet pas skadimit të dhjetë vjetëve.

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit konsiston në atë se pas kalimit të kohës së paraparë me ligj, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet. Kjo situatë mund të ndodhë nëse dënimi nuk ka filluar të ekzekutohet, apo nëse ekzekutimi i tij është ndërprerë.

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi është bërë i plotfuqishëm, ndërsa nëse është revokuar dënimi alternativ, nga dita kur vendimi mbi revokimin është bërë i plotfuqishëm (paragrafi 1).

Nëse parashkrimi është shprehë para se aktgjykimi të ketë marrë formën e plotfuqishme, atëherë duhet konsideruar se është fjala për parashkrimin e ndjekjes penale.

Parashkrimi i ekzekutimit shprehet si për dënimet kryesore, ashtu dhe për dënimet alternative dhe plotësuese. Mirëpo, siç do të shohim me komentet lidhur me nenin

109, parashkrimi i dënimeve plotësuese nuk shprehet në të njëjtën kohë si për dënimet kryesore dhe alternative.

Dënimi i cili për shkak të parashkrimit nuk mund të ekzekutohet, nuk shlyhet nga evidenca e të ndëshkuarve. Gjithashtu me këtë lloj parashkrimi nuk preken interesat e palëve tjera. Kohëzgjatja e afatit të parashkrimit varet prej lartësisë së dënimit të shqiptuar. Nuk është me rëndësi dënimi i paraparë me ligj për veprën penale. Kohëzgjatja e afateve të parashkrimit është përcaktuar sipas dënimit kryesor.

Afati maksimal i parashkrimit është 30 vjet nga dita e aktgjykimit të plotfuqishëm të dënimit me burgim të përjetshëm, ndërsa afati minimal është dy vjet nga dita e aktgjykimit të plotfuqishëm me të cilin është shqiptuar dënimi me burgim deri në një vit apo dënimi me gjobë.

Paragrafi 2 i këtij neni ku thuhet se afati i parashkrimit të dënimeve ndërpritet kur personi i dënuar nuk paraqitet ose nuk dorëzohet për të mbajtur dënimin me burgim.

Për parashkrimin e burgimit për të mitur vlejné dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur (neni 36).

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm

Dënimet plotësuese, sikundër edhe dënimet kryesore, janë lloje të sanksioneve penale, andaj edhe ndaj tyre vlen instituti i parashkrimit. Instituti i parashkrimit gjithashtu vlen edhe për masat e trajtimit të detyrueshëm.

Për shkak të specifikave të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet me to, afatet e parashkrimit të ekzekutimit nuk kanë mundur të caktohen njësoj si për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve kryesore. Për këtë arsye afatet e parashkrimit të ekzekutimit midis llojeve të caktuara të dënimeve plotësuese, si dhe të masave të trajtimit të detyrueshëm dallojnë dukshëm.

Për shkak të specifikave të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm dhe qëllimit që dëshirohet të arrihet me to, afatet e parashkrimit të ekzekutimit nuk kanë mundur të caktohen njësoj si për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve kryesore. Për këtë arsye afatet e parashkrimit të ekzekutimit midis llojeve të caktuara të dënimeve plotësuese, si dhe të masave të trajtimit të detyrueshëm dallojnë dukshëm.

Shkaqet e përgjithshme të cilat shpijnë parashkrimin e dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm janë të njëjta si për parashkrimin e ekzekutimit të dënimeve kryesore. Gjithashtu në të njëjtat kushte vlejné dispozitat mbi ndaljen dhe ndërprerjen e parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve plotësuese si dhe për parashkrimin absolut.

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese shprehet në rastet kur të kenë kaluar pesë vjet nga dita e aktgjykimit me të cilin këto dënime bëhen të plotfuqishme (par. 1).

Parashkrimi i ekzekutimit të masës, trajtimit të detyrueshëm, paraqitet kur të kalojnë tre vjet nga plotfuqishmëria e aktgjykimit me të cilin është shqiptuar kjo masë (paragrafi 2).

Në par. 3 është paraparë se parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm ndërpritet, kur personi nuk u përmbahet urdhrave të gjykatës lidhur me dënimet plotësuese dhe masat e trajtimit të detyrueshëm.

Fillimi dhe ndërprerja e afateve të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit

Parashkrimi i i ekzekutimit të dënimit fillon të rrjedhë prej ditës kur aktgjykimi me të cilin është shqiptuar dënimi është bërë i plotfuqishëm. Në sensin e Kodit të Procedurës Penale, i plotfuqishëm konsiderohet ai aktgjykim i cili nuk mund të atakohet me ankesë apo kur ankesa nuk është e lejuar.

Krahas kësaj rregulle, fillimi i rrjedhës së afatit të parashkrimit është përcaktuar në mënyrë specifike për situatat vijuese: në rastin e revokimit të dënimit me kusht, afati i parashkrimit fillon të rrjedhë prej ditës kur vendimi për revokim është bërë i plotfuqishëm;

në rastet e revokimit të lirimit me kusht parashkrimi fillon të rrjedhë prej ditës së plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin është revokuar lirimi me kusht dhe është shqiptuar dënimi unik; në rastin kur i dënuari ikë nga burgu ku ka qenë duke mbajtur dënimin, parashkrimi fillon të ecë prej ditës kur i dënuari është arratisur; në rastet kur i dënuari nuk kthehet pas skadimit të ditëve të pushimit apo të pushimit vjetor i cili i është lejuar që ta shfrytëzoj jashtë institucionit edukues korrektues (jashtë burgut), parashkrimi fillon të ecë nga dita kur i dënuari ka qenë i obliguar që të kthehet në entin ku ka qenë duke e mbajtur dënimin. Sipas këtij parimi do të zgjidhet edhe çështja e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit në rastet e ekzekutimit të dënimit alternativ të gjysmë lirisë, nëse i dënuari nuk kthehet në burg (neni 61).

Ngjashëm si te parashkrimi i ndjekjes penale, edhe te parashkrimi i ekzekutimit të dënimit mund të paraqiten rrethana të cilat shkaktojnë ndaljen dhe ndërprerjen e afatit të parashkrimit

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit ndalet, nuk rrjedhë, gjatë kohës kur sipas kushteve të parapara me ligj, dënimi i shqiptuar nuk mund të ekzekutohet. Periudha kohore sa ka zgjatë ndalja nuk llogariteti në afatin e parashkrimit dhe afati i parashkrimit vazhdon të ecë aty ku ka mbetë. Rrethana të cilat shpiejnë ndaljen e afatit të parashkrimit janë vetëm ato të cilat parashihen me Ligjin mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Thënë ndryshe, rrethana për shkak të të cilave dënimi nuk mund të ekzekutohet (prolongohet ekzekutimi i tij), mund të jenë vetëm ato të cilat janë të parapara me dispozita juridike. Rrethana të tilla janë p.sh. kur i dënuari sëmuhet rëndë, apo i vdes ndonjë anëtar i familjes së ngushtë, kur organet e ndjekjes penale nuk mund ta gjejnë personin e dënuar, kur i dënuari është duke e mbajtur ndonjë dënim tjetër apo është në lirim me kusht etj.

Afati i parashkrimit të ekzekutimit të dënimit ndërpritet me çdo veprim të organit kompetent që ka për qëllim ekzekutimin e dënimit (paragrafi 4).

Sikundër parashkrimi i ndjekjes penale, edhe parashkrimi i ekzekutimit të dënimit mund të ndërpritet vetëm nëse veprimi është ndërmarrë nga organet kompetente, nëse veprimi është i ligjshëm dhe nëse është ndërmarrë në mënyrën e paraparë me ligj. Gjithashtu veprimi i organit kompetent duhet të jetë i drejtuar me qëllim të ekzekutimit të dënimit të caktuar dhe ndaj pesonit të caktuar.

Veprimet apo rrethanat të cilat e shkaktajnë ndërprerjen e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit në shumicën e rasteve janë të parapara me ligjin mbi ekzekutimin e sanksioneve penale. Veprime të tilla janë p.sh. thirrja nga ana e gjykatës e personit të dënuar që gjendet në liri që të paraqitet për ta mbajtur dënimin; urdhëresa që i dënuari të sillet me dhunë për ta mbajtur dënimin; masa e gjykatës që të gjendet i dënuari i cili fshihet apo nuk dihet vendbanimi i tij; lëshimi i fletëarrestit, dhënia e urdhrin për arrestimin e të dënuarit që ka ikur etj.

Si dhe te ndërprerja e parashkrimit të ndjekjes penale, edhe te ndërprerja e parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, koha që ka kaluar gjer në momentin e ndërprerjes së parashkrimit nuk llogaritet. Pra edhe këtu afati i parashkrimit fillon të ecë rishtas (paragrafi 5).

Parashkrimi i ekzekutimit të dënimit paraqitet në çdo rast kur të kalojë dyfishi i kohës që kërkohet sipas ligjit për parashkrimin e ekzekutimit të dënimit, pa marrë parasysh sa ndalje dhe ndërprerje kanë qenë dhe pa marrë parasysh kohëzgjatjen e tyre. Në teorinë e së drejtës penale kalimi i dyfishtë i afatit të parashkrimit quhet parashkrim absolut. Së këndejmi, në rastet kur shkaktohet parashkrimi absolut i ekzekutimit të dënimit, dënimi i shqiptuar kurrsesi nuk mund të ekzekutohet.

Mos zbatueshmëria e parashkrimit për veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare dhe vrasjes së rëndë

Instituti i parashkrimit të ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të dënimit parimisht është përvetësuar për të gjitha veprat penale. i vetmi përjashtim nga ky parim janë veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare, siç janë krimi i gjenocidit, krimet të luftës etj. Rrjedhimisht, sipas nenit 111 të Kodit Penal, pa marrë parasysh sa kohë ka kaluar prej momentit të kryerjes së veprës penale, nuk mund të bëhet parashkrimi i ndjekjes penale dhe të ekzekutimit të dënimit për veprat penale të gjenocidit, krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit, si dhe për veprat e tjera penale për të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk mund të zbatohet parashkrimi.

Për kryerësit e këtyre veprave penale është përjashtuar mundësia e parashkrimit për shkaqe kriminale-politike, humane dhe etike. Kjo nga fakti se të gjitha këto vepra penale janë jashtëzakonisht të rrezikshme, gjithashtu dhe pasojat e tyre janë shumë të rënda. Në të shumtën e rasteve këto vepra penale kryhen ndaj numrit të madh të njerëzve, ndërsa disa prej tyre, siç është gjenocidi, kanë për qëllim që ta shfarosin një pjesë apo tërë grupin e njerëzve të përkatësisë së caktuar nacionale, fetare racore apo etnike.

E DREJTA PENALE

Paragarfi 2 i këtij neni është i ri dhe për herë të parë është paraparë në legjislacionin penal të Kosovës. Kështu, përveç veprave penale kundër të së drejtës ndërkombëtare, edhe për llojet e vrasjeve të rënda nuk mund të shprehet parashkrimi i ndjekjes penale dhe ekzekutimit të dënimit. Këso dispozite për mos parashkrimin e vrasjeve të rënda nuk parashohin legjislacionet penale të shteteve të regjionit.

■ PJESA E POSAÇME E KODIT PENAL

VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT KUSHTETUES DHE SIGURISË REPUBLIKËS SË KOSOVËS (146)

Vështrime të përgjithshme

Veprat penale me të cilat rrezikohen apo dëmtohen të mirat juridike të një vendi, përkatësisht të një shteti, siç janë rregullimi kushtetues, siguria dhe pavarësia, integriteti territorial etj., zënë vend të rëndësishëm në strukturën e pjesës së posaçme të Kodit Penal të çdo shteti. Për shkak të rrezikshmërisë së madhe dhe pasojave të cilat mund t'i shkaktojnë, në kodet penale të mëparshme dhe të tanishme të të gjitha shteteve, për këto lloje të veprave penale, parashihen dënime të rënda.

Për shkak të funksionit specifik që mëtojnë të realizojnë veprat penale të këtij kapitulli, si dhe për shkak të motiveve nga të cilat më së shpeshti kryhen, në teorinë e së drejtës penale, këto vepra shpesh emërtohen vepra penale politike (**crimes politique**).

Në shumicën e kodeve penale të shteteve bashkëkohore, këto vepra penale emërtohen “vepra kundër shtetit”, “kundër sigurisë së shtetit”, “kundër rregullimit kushtetues dhe sigurisë së vendit”, “kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues” (Shqipëria), kundër sigurisë dhe rregullimit kushtetues” (Sllovenia) etj. Në Kodin Penal të Kosovës ky kapitull është emërtuar: **Veprat penale kundër rednit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës**.

Kalimi i paautorizuar i vendkalimeve kufitare ose vijës kufitare

Vështrime të përgjithshme. Në shtetet aktuale të regjionit por edhe më gjerë, kalimi i paautorizuar i kufirit shtetëror konsiderohet si kundërvajtje. Si vepër kundërvajtëse është konsideruar edhe në legjislacionin e mëparshëm i cili ishte në fuqi në Kosovë deri në hyrjen në fuqi të Kodit Penal me 6 prill 2004. Mirëpo, meqë Kodi Penal u aprovua në kohën kur Kosova akoma nuk e kishte arrit pavarësinë dhe sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit gjendej nën protektoratin e Kombeve të Bashkuara dhe të juridiksionit të saj, sipas faktorit ndërkombëtar çdo kalimi i paautorizuar i kufirit të Kosovës konsiderohej rrezik për sigurinë e Kosovës dhe qytetarët e saj.

Forma themelore e paraparë në paragrafin 1 konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush kalon kufirin apo vijën kufitare të Republikës së Kosovës.

Veprime të kryerjes së kësaj vepre penale konsiderohen kalimi i kufirit dhe hyrja në territorin e Kosovës, madje në hapësirën tokësore, ujore dhe ajrore. Si kalim i kufirit dhe hyrje në territorin e Kosovës konsiderohen edhe fluturimi me aeroplan, lundrimi në ujërat territoriale etj. Lidhur me këtë, çështja e kalimit të kufijve të shteteve është e

rregulluar edhe me konventa të shumta ndërkombëtare dhe me zakone ndërkombëtare. Por gjithashtu kjo vepër penale duhet të konsiderohet se është kryer edhe në rastet kur një person hynë në vendkalimet e autorizuara kufitare shtetërore në territorin e Kosovës në mënyrë ilegale, p.sh. duke u fshehtë ndonjë hapësirë të kamionit apo të ndonjë mjeti tjetër transportues, apo duke e shfrytëzuar neglizhencën e personit zyrtarë etj.

Në paragrafin 2 është paraparë formë e cilësuar e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur kryerësi e kalon kufirin shtetëror të Kosovës së bashku me ndonjë fëmijë apo person tjetër. Ndërsa në paragrafin 3 janë paraparë katër forma edhe më të rënda të kësaj vepre penale.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Për ekzistimin e kësaj vepre penale nuk kërkohet ndonjë motiv i posaçëm. Mjafton që personi i caktuar ta ketë kaluar kufirin në mënyrë ilegale.

Kryerësi i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Sipas paragrafit 5 thuhet se kjo vepër penale nuk konsiderohet se kryhet nëse kalimi i kufirit është bërë në një vendkalim i cili është hap përkohësisht nga KFOR dhe kalimi i refugjatëve të cilëve nga vendi që vijnë është e rrezikuar jeta, trupi dhe liritë elementare.

Nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mos durimit kombëtar, racor, fetar ose etnik (Neni 147)

Kusht për ndërtimin dhe funksionimin e një sistemi juridik demokratik dhe të qëndrueshëm është njohja dhe respektimi i diversiteteve të grupeve kombëtare, racore, fetare apo etnike. Ky postulat nënkupton njohjen dhe respektimin e të gjitha dallimeve lidhur me gjuhën, zakonet, veçoritë historike, përkatësisë fetare etj. Njohja dhe respektimi i këtyre veçorive, sipas konventave ndërkombëtare dhe të të drejtave nacionale, bënë pjesë në liritë dhe të drejtat themelore individuale dhe kolektive. Për këtë arsye nxitja e urrejtjes, e përçarjes ose e mosdurimit në baza të veçorive kombëtare, racore, fetare ose etnike është vlerësuar se duhet të konsiderohet vepër penale. Këtë koncept e ka akceptuar edhe e drejta penale e Kosovës.

Forma themelore e kësaj vepre penale është përcaktuar në mënyrë alternative dhe konsiderohet se kryhet kur ndokush publikisht nxit ose përhap urrejtje, përçarje ose mostolerancë kombëtare, racore, fetare ose etnike. Konsiderohet se personi e ka kryer këtë vepër penale nëse e ndërmer vetëm njëri nga këto veprime. Por, gjithashtu, do të konsiderohet se një person e kryen këtë vepër penale edhe në rastet kur i ndërmer të gjitha këto veprime.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit.

Shprehja **nxit** si formë e kryerjes së kësaj vepre penale ka kuptimin e krijimit ose shkaktimit të urrejtjes, përçarjes ose mos durimit. Ndërsa shprehja **përhapje** presupozon që njëra nga këto ndjenja ka ekzistuar si gjendje latente apo si gjendje e intensitetit më

të vogël, por që me veprime të këtitilla (nxitjes ose përhapjes) urrejtja, përçarja apo mos toleranca zhvillohet, sforcohet ose thellohet.

Nxitja dhe përhapja e urrejtjes, përçarjes ose mos tolerancës duhet të kryhet publikisht, me gojë ose me shkrim, siç janë p.sh. shkrimet në gazeta dhe fjalimet në tubime publike, ku nënçmohen ose përqeshen vlerat e caktuara të kombit apo të pakicave kombëtare, fyerja ose tallja e ndonjë personaliteti historik të kombit ose të pakicës kombëtare ose grupit etnik, përqeshja e flamurit apo simboleve të tjera dhe veprime të ngjashme.

Me **urrejtje** nënkuptohet ndjenjë armiqësore ndaj pjesëtarit të kombit, racës fesë apo etnisë tjetër, intensitetit i së cilës është i tillë i cili nuk e përjashton mundësinë që t'i shkaktohet ndonjë e keqe. Urrejtja është bazë psikologjike për krijimin e situatave konflikte midis kombeve, racave, feve ose grupeve etnike, gjendje këto të cilat mund të shkaktjnë pasoja të rënda. **Përçarja** është situatë edhe më e rëndë dhe nënkupton krijimin e antagonizmit ose kundërshtimit dhe të krijimit të raporteve armiqësore deri te konflikti midis pjesëtarëve të kombeve, racave, feve ose të grupeve etnike. Situata e këtitillë e krijuar e përjashton gatishmërinë për dialog dhe krijon rrezik latent që të shpërthejnë konflikte të hapura.

Mos durimi, përkatësisht mos toleranca është gjendje e mosbesimit në raport me pjesëtarët e kombit, racës, fesë ose grupit tjetër etnik. Kjo është gjendje e refuzimit dhe mos tolerancës ndaj pjesëtarëve të kombit, racës, fesë ose grupit etnik. Mos durimi për nga potenciali negativ është i intensitetit më të ulët në krahasim me urrejtjen.

Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit duhet të kryhet ndaj kombeve dhe pakicave që jetojnë në Kosovë. Si komb në Kosovë konsiderohet populli shumicë shqiptarë, ndërsa si pakica kombëtare janë serbët, boshnjakët, turqit. Ndërsa bashkësi etnike janë romët, ashkalinjtë, egjiptianët dhe goranët.

Pasojë e kësaj vepre penale është shkaktimi, përhapja ose thellimi i urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit midis pjesëtarëve të kombit shqiptarë dhe pjesëtarëve të pakicave kombëtare dhe grupeve etnike të cilët jetojnë në Kosovë.

Subjekt pasiv të kësaj vepre penale është kombi dhe bashkësitë etnike të cilat jetojnë në Kosovë. Nëse kjo vepër është e drejtuar ndaj kombeve apo grupeve etnike, racave apo feve të cilat nuk jetojnë në Kosovës, kjo vepër nuk konsiderohet se është kryer.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person, shtetasi i Kosovës apo shtetasi i huaj.

Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje, direkte apo eventuale.

Vepra konsiderohet se është kryer me ndërmarrjen e çdo lloj veprimi me të cilin nxitet apo përhapet urrejtja, përçarja apo mos durimi midis grupeve kombëtare, racore, fetare etnike apo çfarëdo grupi tjetër.

Pasoja e kësaj vepre penale është cenimi i bashkëjetesës së kombeve, feve, racave apo grupeve etnike që jetojnë në Kosovë.

Sipas paragrafit 2, si formë e rëndë e kësaj vepre penale konsiderohet nëse ndokush në mënyrë **a)** sistematike e kryen këtë vepër penale ose **b)** e keqpërdor pozitën apo

autorizimet, apo kur si pasojë e kryerjes së kësaj vepre c) shkaktohen trazira, dhunë apo pasoja të tjera të rënda.

a) Kryerja sistematike e kësaj vepre konsiderohet se ekziston nëse kryerësi vepron sipas planit të përgatitur, përkatësisht kur vepra është pjesë përbërëse e planit. Në rastet e këtilla, kryerësi zakonisht e përsëritë kryerjen e veprës. Lidhur me këtë konsiderohet se kjo vepër kryhet në mënyrë sistematike edhe në rastin kur është kryer vetëm një vepër, nëse ajo vepër është vetëm fillim i kryerjes së shumë veprave të nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mosdurimit nacional, fetar, racor ose etnik.

b) Kjo vepër konsiderohet se është kryer duke e keqpërdorur pozitën ose autoritetin, në rastet kur kryerësi e keqpërdor pozitën ose autorizimet e tij, përkatësisht kur pozitën ose autorizimin e shfrytëzon në mënyrë që më lehtë ta kryejë këtë vepër penale. Lidhur me këtë, duhet të theksohet se për kryerjen e kësaj vepre penale mund të shfrytëzohen pozita dhe autorizime të ndryshme, prej të cilave disa prej tyre veçanërisht mund të keqpërdoren për këtë qëllim, siç janë p.sh. pozita dhe autorizimet në organet shtetërore dhe publike, në arsim, në bashkësitë fetare etj.

c) Shkaktimi i trazirave, dhunës apo pasojave të tjera të rënda si formë e kualifikuar e kësaj vepre penale nënkupton cenimin e rëndë të rendit publik dhe paqes, rrezikimin e trafikut publik, pengimin e funksionimit të shërbimeve publike etj. Dhuna mund të jetë e drejtuar ndaj njerëzve dhe pasurisë dhe mund të shprehet me rrahje, rrënim, shkatërrime, ndezje etj. Mirëpo nëse me këto veprime ndokush është privuar nga jeta apo i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor, do të konsiderohet se ekziston bashkimi i kësaj vepre penale dhe vrasjes, përkatësisht lëndimit të rëndë trupor, e kryer me dashje apo nga pakujdesia, varësisht nga fakti se me çfarë forme të fajit është kryer vrasja apo lëndimi trupor.

Në dispozitën e paragrafit 3 gjithashtu është paraparë formë e rëndë e kësaj vepre penale, e cila konsiderohet se ekziston nëse vepra kryhet përmes detyrimit, rrezikimit të sigurisë duke i përqeshur simbolet kombëtare, racore etnike apo fetare, duke dëmtuar pasurinë e personit tjetër ose duke përdhosur monumentet apo varrezat.

Në dispozitën e paragrafit 3 është fjala për mënyra të veçanta të kryerjes së kësaj vepre penale të cilat për nga përmbajtja dhe natyra e tyre mund të shprehin shumë rëndësi me i cenuar ndjenjat nacionale, fetare apo racore të njerëzve.

Në sensin e kësaj forme të rëndë të veprës penale, me dhunë duhet nënkuptuar përdorimin e dhunës apo kanosjes serioze. Me rrezikim të sigurisë duhet nënkuptuar shkaktimin e ndjenjës së rrezikut për jetë apo për integritetin trupor. Ndërsa me përqeshje të simboleve kombëtare, racore, etnike apo fetare duhet nënkuptuar çdo veprim me të cilin manifestohet fyerja apo nënçmimi i tyre. Me dëmtim të pasurisë së personave të tjerë nënkuptohet shkatërrim, dëmtimi apo bërja e papërdorshme e sajë. Nga natyra e kësaj vepre penale rezulton se këtu është fjala për pasuri apo sende, dëmtimi i të cilave mund të nxitë apo të shkaktoj urrejtja, përçarje apo mosdurim midis kombeve, feve, grupeve etnike apo racave. Përdhosja e monumenteve apo varrezave gjithashtu mund të kryhet duke i shkatërruar, duke i dëmtuar, duke i rrënuar, duke shkruajtur në to fjalë apo vizatime fyese apo provokative, duke i dëmtuar apo shlye mbishkrimet në to etj.

Forma edhe më e rëndë e kësaj vepre penale është paraparë në paragrafin 4, dhe konsiderohet se kryhet në rastet kur vepra nga paragrafi 3 e këtij neni kryhet në **mënyrë sistematike** ose duke **keqpërdorur pozitën**, autoritetin e tij apo nëse vepra e këtillë shkakton trazira, dhunë ose pasoja të tjera të rënda. Pasojat e veprës penale të parapara në këtë paragraf janë të njëjta me paragrafin 3. I vetmi dallim konsiston në faktin se kjo formë edhe më e rëndë konsiderohet se ekziston nëse kryhet në mënyrë sistematike ose nga personi zyrtarë.

VEPRAT PENALE KUNDËR NJERËZIMIT DHE VLERAVE TË MBROJTURA ME TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE

1. Vështrime të përgjithshme

Me kapitullin e veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare është synuar që maksimalisht të inkriminohen të gjitha veprat e mundshme me të cilat dëmtohen apo rrezikohen vlerat ndërkombëtare, mbarë njerëzore.

Katalogu i inkriminimeve të këtij kapitulli është përgatitur sipas “**Modelit të kodeksit të së drejtës penale ndërkombëtare**” i cili para njëzet vitesh është përgatitur nga ekspertët e së drejtës penale ndërkombëtare. Ky katalog parasheh inkriminime të cilat rezultojnë nga konventat dhe aktet e tjera relevante ndërkombëtare si burime të së drejtës penale ndërkombëtare.

Objekt i përbashkët mbrojtës i këtyre veprave penale janë vlerat e mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare. Rrjedhimisht, me këtë grup të veprave penale mbrohen vlerat të cilat bashkësisht ndërkombëtare i konsideron si vlera mbarë njerëzore siç janë: ekzistenca e grupeve të caktuara - nacionale, etnike, racore apo fetare; paqja si vlerë sublimë e bashkësisë ndërkombëtare, njerëzimi, jeta, trupi dhe shëndeti i njerëzve, liritë e njeriut dhe dinjiteti. Gjithashtu mbrohen edhe personat që gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare, autoritetin e shteteve të huaja dhe simbolet e tyre, sigurinë e qarkullimit ajror dhe detar etj.

Përcaktimi i veprës penale dhe dënimit me ligj, është postulat themelor i së drejtës penale bashkëkohore, postulat ky i cili është formësuar **me parimin nullum crimen, nulla poena sine lege**. Mirëpo, në krahasim me të drejtat nacionale të shteteve bashkëkohore, ku veprat penale dhe sanksionet penale janë të parapara me ligj, në të drejtën penale ndërkombëtare, veprat penale ndërkombëtare janë të parapara me konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare. Korpusi i konventave ndërkombëtare si dhe i akteve dhe zakoneve ndërkombëtare, me të cilat parashihen ose janë të derivuara veprat penale ndërkombëtare është i madh dhe i induardurshëm. Lidhur me këtë sipas një analize, llogaritet se në periudhën 1815 deri 1988, janë aprovuar rreth 315 akte ndërkombëtare në disa prej të cilave janë të parapara edhe veprat penale ndërkombëtare, siç janë agresioni, krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidi, aparteidi etj.

Të gjitha veprat penale kundër të drejtës ndërkombëtare në Kodin Penal të Kosovës janë paraparë në 30 nene me tituj përkatës. Të gjitha këto inkriminime bazohen në shkeljen e rregullave të caktuara të së drejtës ndërkombëtare. Për këtë arsye, edhe pse këto inkriminime janë mjaft voluminoze me shumë paragrafë dhe nënparagrafë, shumë dispozita janë të *karakterit blanket, ngase udhëzojnë që të aplikohen rregullat e së drejtës ndërkombëtare, përkatësisht të dispozitave të konventave dhe akteve të caktuara ndërkombëtare.*

Kontrabandimi me emigrantë (Neni 170)

Baza ndërkombëtare e inkriminimit të kësaj vepre është Protokoli kundër kontrabandimit të migrantëve përmes rrugëve, ujërave apo ajrit. Me këtë Protokol është plotësuar Konventa e OKB-ës kundër krimit të organizuar transnacional.

Objekt i mbrojtjes së kësaj vepre penale është i dyfishtë. Së pari me këtë vepër mbrohen liritë dhe të drejtat themelore të migrantëve dhe së dyti, me këtë vepër mbrohet rezhimi i kalimit të ligjshëm të migrantëve prej një shteti në shtetin tjetër.

Trafikimi i emigrantëve është një formë e trafikimit me njerëz, mirëpo për shkak të specifikave të tij, e veçmas për shkak se viktima të kësaj vepre janë vetëm emigrantët dhe se trafikimi bëhet duke kaluar kufirin prej një shteti në shtetin tjetër, në Kodin Penal të Kosovës është paraparë si vepër penale e veçantë.

Për shkak të natyrës së kësaj vepre penale, veprimet me të cilat kryhet janë të ndryshme dhe komplekse dhe janë përcaktuar në shumë paragrafe të këtij neni.

Në këtë paragraf 1 është paraparë forma themelore e kësaj vepre penale e cila në një mënyrë e inkriminon llojin e veprimit i cili është më i theksuar dhe më i drejtpërdrejtë. Përkatësisht meqë në këtë paragraf përdoret shprehja “kush merret me trafikim” duhet nënkuptuar veprimin i cili konsiston në transportimin e migrantëve, kuptohet në mënyrë ilegale, prej një shteti në shtetin tjetër. Transportimi apo kalimi ilegal i imigrantëve nënkupton hyrjen apo daljen e migrantëve në apo nga shteti duke mos i respektuar formalitetet për kalimin e kufirit shtetëror apo hyrjen apo daljen nga shteti në ato vija kufitare ku nuk është e lejuar (duke kaluar male, lumenj, dete etj).

Subjekt pasiv i kësaj vepre penale është një apo më shumë migrantë, të cilët kalojnë në territorin e shtetit tjetër me qëllim që të mbesin në atë shtet për të punuar, për të lypin lëmshë, që të kryejnë vepra penale etj.

Për shkak të rrezikshmërisë shumë të madhe dhe për shkaqe kriminalo-politike, me qëllim që të intervenohet me të drejtën penale në një fazë më të hershme të kryerjes së kësaj vepre penale, në paragrafin 2 të këtij neni janë inkriminuar edhe veprimet përgatitore të cilat ndërmerren me qëllim të kryerjes së veprës së kontrabandimit të emigrantëve. Kësisoj si forma të veçanta të kryerjes së kësaj vepre penale konsiderohen edhe këto veprime: prodhimi, prokurimi, sigurimi ose posedimi i dokumentit të rrejshëm të udhëtimit ose të identifikimit me qëllim të mundësimit të marrjes me trafikim me emigrantë. Sipas këtij paragrafi të gjitha këto lloje të veprimit ndërmerren me qëllim për të fituar drejtpërdrejt ose tërthorazi dobi pasurore apo financiare.

Krahas kontrabandimit të emigrantëve, në paragrafin 3 është inkriminuar edhe veprimi i personave të cilët mundësojnë qëndrimin e emigrantëve në shtetet e caktuara.

Si veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale konsiderohet rasti kur ndokush i mundëson me dokumente të rrejshme të qëndroj në Kosovë ndonjë personi i cili nuk është shtetas i Kosovës apo banorë i përkohshëm apo i përhershëm.

Në këtë paragraf është paraparë forma më e rëndë e kësaj vepre penale dhe konsiderohet se kryhet në rastet kur ndokush organizon ose urdhëron personat tjerë për të kryer kontrabandimin e emigrantëve të paraparë në paragrafin 1,2 dhe 3 të këtij neni.

Si formë tjetër e rëndë e kësaj vepre penale është paraparë në paragrafin 6 të këtij neni dhe konsiderohet ekziston nëse kryerësi është anëtar i grupit ose në rastet kur kjo vepër kryhet në aso mënyre që i rrezikon jetët e emigrantëve ose ka gjasë që t'i rrezikojë jetët e tyre ose nëse kryhet duke i trajtuar në mënyrë çnjerëzore apo degraduese apo duke i eksploatuar emigrantët. Ndërsa në paragrafin 7 është paraparë formë edhe më e rëndë e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se ekziston nëse me rastin e kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1, 2 ose 3 është shkaktuar vdekja e një apo më shumë personave.

Sipas këtij paragrafi, emigrantët të cilët me rastin e kryerjes së kësaj vepre penale janë viktima, nuk konsiderohen penalisht përgjegjës, nuk dënohen.

Trafikimi i njerëzve (Neni 171)

Trafikimi me njerëz është paraparë si vepër penale me një numër relativisht të madh të konventave ndërkombëtare. Konventat më të rëndësishme ndërkombëtare me të cilat ndalohet dhe ndëshkohet trafikimi me njerëz janë: Konventa mbi ndalimin e tregtisë me robër të bardhë të vitit 1910; Konventa për ndëshkimin e tregtisë me gra dhe fëmijë të vitit 1921; Konventa për ndëshkimin e tregtisë me gra të rritura, të moshës madhore të vitit 1933 dhe Konventa për ndëshkimin dhe parandalimin e tregtisë me njerëz dhe eksploatimin e tyre për qëllime prostitucioni të vitit 1949 dhe Konventa për parandalimin e tregtisë me njerëz dhe eksploatimi i të tjerëve të vitit 1950.

Vetë emërtimi “trafikimi me njerëz” mjaftë qartë e tregon se me këtë vepër penale bëhet tregëti me njerëz, bëhet shitblerja e njerëzve dhe se qëllimi kryesor është realizimi i dobisë pasurore.

Sipas këtij paragrafi, llojet e veprimit me të cilat kryhet kjo vepër penale janë përcaktuar në mënyrë alternative dhe si të tilla janë të shumta dhe komplekse. Rrjedhimisht si forma të veprimit të kryerjes së kësaj vepre penale konsiderohet: rekrutimi, transferim, strehim ose pranim i personave të trafikuar (viktimave) me qëllim të shfrytëzimit, përkatësisht me qëllim të eksploatimit të tyre në mënyra të ndryshme siç janë: shfrytëzimi seksual ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, shërbimeve ose punës së detyruar, skllavërisë ose veprimeve të ngjashme me skllavërinë, robërisë ose heqjes së organeve (transplantimin e organeve në mënyrë të kundërligjshme).

Ndërlíkueshmëria e natyrës së figurës së kësaj vepre penale inkludon në vete edhe mënyrat e ndryshme me të cilat kryhet kjo vepër penale dhe ato: me anë të kërcënimit ose të përdorimit të forcës apo me forma të tjera të detyrimit, rrëmbimit, falsifikimit,

mashttrimit, apo keqpërdorimit të pushtetit apo të pozitës ose të një pozite të ndjeshme ose me anë të dhënies apo marrjes së pagesave apo përfitimeve për të arritur pëlqimin e personit, që ka kontroll mbi personin tjetër me qëllim të shfrytëzimit.

Në par.2. si formë e rëndë e veprës penale të trafikimit me njerëz konsiderohet rasti nëse vepra penale nga paragrafi 1 të këtij neni kryhet në një perimetër prej 350 metra nga shkolla apo mjedisi tjetër i cili përdoret për fëmijë, ose kur vepra kryhet ndaj personit nën moshën tetëmbëdhjetë vjet.

Në paragrafin 3 është paraparë një formë e posaçme e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se është kryer me faktin që ndokush e ka organizuar një grup, përkatësisht kur e ka the meluar një grup personash, me qëllim të kryerjes së veprës penale të trafikimit me njerëz e paraparë në paragrafin 1 të këtij neni.

Në këtë paragrafin 4 është paraparë gjithashtu formë e rëndë e trafikimit me njerëz nëse kjo vepër e paraparë në tri paragrafët e mësipërme kryhet nga personi zyrtar duke e keqpërdorë pozitën zyrtare. Ndërsa në paragrafin 5 si formë e rëndë konsiderohet nëse vepra e trafikimit me njerëz ka shkaktuar vdekjen e një apo të ma shumë personave. Rast i tillë i formës shumë të rëndë të trafikimit të njerëzve me q' rast u shkaktua edhe vdekja e personave ishte trafikimi i shtetasve të Shqipërisë për në Itali nëpërmjet detit Adriatik me gomone (anije) gome me 9 janar të vitit 2004, ku u mbytën 28 persona. Gjithashtu rast shumë i rëndë i kësaj vepre penale ishte trafikimi i kosovarëve, ku në tetor të vitit 2009, në kufirin Serbi Hungari, në lumin Tisa u mbytën 17 njerëz, në mesin e tyre edhe gra dhe fëmijë.

Kjo vepër penale konsiderohet se është kryer edhe në rastet kur subjekti pasiv (personi i trafikuar) e ka dhënë pëlqimin që të trafikohet (paragrafi 6, pika 3).

Lidhur me fajësinë, të gjitha format e kësaj vepre penale mund të kryhen vetëm me dashje.

VEPRAT PENALE KUNDËR JETËS DHE TRUPIT

Vështrime të përgjithshme

Jeta e njeriut është e drejtë absolute, e drejtë natyrore. E drejta për jetë është para të gjitha të drejtave të tjera, është e drejta më e rëndësishme. Me humbjen e jetës humbin të gjitha të drejtat e tjera, humb ekzistenca e njeriut. Krahas jetës edhe integriteti trupor konsiderohet një ndër vlerat themelore të njeriut. Andaj, është e kuptueshme përse e drejta penale i kushton rëndësi të madhe mbrojtjes së këtyre të mirave juridike.

E drejta e jetës është e garantuar me aktet më të rëndësishme ndërkombëtare, siç janë p.sh. Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara (1948), Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore e Këshillit të Evropës (1950), Pakti Ndërkombëtar i të Drejtave Civile dhe Politike (1966). Kjo e drejtë themelore garantohet dhe mbrohet edhe me kushtetutat dhe ligjet themelore të shteteve aktuale. Në paragrafin 1 të nenit 25 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës

është paraparë shprehimisht se secili individ gëzon të drejtën për jetë. Ndërsa në paragrafin 2 thuhet se dënimi me vdekje është i ndaluar.

E drejta penale e mbron jetën e njeriut që nga fillimi i saj deri në fund, deri në vdekje. Përkatësisht, e drejta penale e mbron jetën e njeriut që nga nisma e saj, ngase jetën e ardhshme (fetusin) e mbron nga ndërprerja e kundërligjshme e shtatzënisë. Mirëpo, njeriu si qenie e gjallë konsiderohet prej momentit kur jeta është autonome, auto-rregullative dhe auto-reproduktive. Si e këtillë jeta konsiderohet prej momentit të lindjes.

Pëlqimi i ndonjë personi që të privohet nga jeta nga personi tjetër nuk e përjashton veprën penale. Kjo nga fakti se jeta e njeriut është vlerë e patjetërsueshme e cila posedohet si vlerat e tjera. Andaj, fakti se privimi nga jeta është bërë me kërkesën apo pëlqimin e viktimës (rasti i eutanazisë) nuk e përjashton nga përgjegjësia penale kryerësin e veprës, por kjo mund të merret parasysh vetëm si rrethanë lehtësuese me rastin e matjes së dënimit.

Nga kjo që u tha më sipër rezulton se e drejta në jetë është e drejtë absolute, është e drejtë natyrore pa marrë parasysh interesin jetësor të individit dhe pa marrë parasysh se a është i aftë për jetë. Mirëpo ekzistojnë edhe disa përjashtime nga kërkesa absolute e mbrojtjes së jetës së njeriut, siç janë: ndërprerja e lejuar e shtatzënisë, luftra, dënimi me vdekje (në disa shtete e caktuara), apo vrasja në mbrojtje të nevojshme.

Mbrojtja e integritetit trupor është e paraparë në mënyrë të ngjashme, si edhe mbrojtja e jetës. Lëndimet trupore konsiderohen vepra penale, vetëm kur ato kryhen ndaj personit tjetër. Vetëlëndimi, përkatësisht në rastet kur personi i shkakton lëndime vetes, nuk konsiderohet vepër penale. Vetëlëndimi përjashtimisht konsiderohet vepër penale, nëse kryhet me qëllim të shmangies së ndonjë obligimi, siç është p.sh. obligimi i shërbimit ushtarak, ose me qëllim që të realizohet ndonjë e drejtë në mënyrë kundërligjore, siç është p.sh. e drejta për pension invalidor, ose e drejta nga sigurimi. Kështu p.sh. në paragrafin 3 të nenit 338 është paraparë si vepër penale rasti kur kushdo që me qëllim që nga sigurosi të arkëtojë paratë e sigurimit për rastet e lëndimit trupor apo të dëmtimit shëndetësor i shkakton vetes lëndim trupor apo dëmtim të shëndetit dhe pastaj e paraqet lëndimin apo dëmtimin, dënohet me gjobë dhe me burgim prej gjashtë muaj deri në tre vjet.

Veprat penale kundër jetës dhe trupit zakonisht kryhen me dashje. Në shumicën e rasteve këto vepra kryhen me dashje direkte apo eventuale. Për veprat penale të vrasjeve dhe të lëndimeve të rënda trupore, Kodi Penal parasheh dënime edhe në rastet kur kryhen nga pakujdesia.

Vrasja (Neni 178)

Çdo vrasje është vepër penale shumë e rëndë, ngase privohet personi nga jeta. Mirëpo në aspektin e së drejtës penale njihet tri lloje të vrasjeve dhe atë *vrasje të rëndomta* apo forma themelore e vrasjes, *vrasjet e cilësuar (të kualifikuara)* dhe *vrasjet e privileguara*.

Forma themelore e vrasjes e paraparë në nenin 178 në literaturën juridiko-penale emërtohet kushtimisht edhe si *vrasje e rëndomtë*. Për këtë formë të vrasjes, Kodi Penal nuk cek tipare të posaçme, andaj edhe në mungesë rrethane, mënyre të kryerjes apo motivi të posaçëm, vrasja e rëndomtë dallohet nga vrasjet e rënda dhe vrasjet e privileguara. Së këndejmi, si vrasje të rëndomta konsiderohen të gjitha ato vrasje të cilat mungojnë tiparet e posaçme që i karakterizojnë vrasjet e rënda dhe të lehta, përkatësisht vrasjet e privileguara.

Formën themelore të vrasjes Kodi Penal e përkufizon me dispozitë të thjeshtë - “Kushdo që e privon personin tjetër nga jeta.”

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale konsiston në privimin e personit tjetër nga jeta. Vrasja zakonisht kryhet me veprim, me ndërmarrje aktive të ndonjë veprimi. Mirëpo, kjo vrasje mund të kryhet edhe me mosveprim. Me mosveprim konsiderohet se kryhet vrasja në ato raste kur ka ekzistuar obligimi juridik që të veprohet.

Lidhur me mënyrën e veprimit të kryerjes, vrasja mund të kryhet me veprim të drejtpërdrejtë apo indirekt. Mënyrë e drejtpërdrejtë apo direkte e kryerjes ekziston në rastet kur kryerësi vetë, me veprimin e vet drejtpërdrejt e privon nga jeta personin tjetër, p.sh. duke shkrepur nga armë zjarri, duke e goditur me thikë, duke ia zënë frymën, duke i hedhur helm në ushqim etj. Në mënyrë indirekte, vrasja kryhet, jo vetëm me veprimin e kryerësit (dorasit), por edhe me ndërmjetësimin e ndonjë personi tjetër, madje edhe të vetë viktimës. Raste të këtilla do të ekzistonin p.sh. kur kryerësi me postë ia dërgon paketën personit A. në të cilën gjendet eksplozivi i cili aktivizohet me rastin e hapjes së dërgesës dhe e shkakton vdekjen e tij; apo kur kryerësi ia prish frenat e veturës personit A. dhe për shkak të kësaj ndodh aksidenti në trafik, në të cilin humb jetën personi A.

Krahas kësaj, vrasja mund të kryhet në mënyrë fizike dhe psikike. Në mënyrë fizike vrasja kryhet me mjete mekanike, kimike, me zjarr dhe me veprime të ngjashme ndaj trupit të viktimës. Ndërkaq, vrasja mund të kryhet në mënyrë psikike p.sh. duke shkaktuar frikë të madhe dhe të papritur te viktima, që mund të shkaktojë ngushtimin e shpejtë të enëve të gjakut dhe për pasojë mund të sjellë atakun kardiak dhe vdekjen, ose duke lëshuar në trupin e viktimës insekte, minj etj. të cilët tek viktima mund të shkaktojnë tronditje dhe ndërprerje të funksionimit të zemrës.

Objekt i mbrojtjes juridiko-penale të kësaj vepre penale është jeta e njeriut. Thënë ndryshe, objekt i kësaj vepre penale është vetëm njeriu i gjallë. Jeta e njeriut mbrohet prej momentit të lindjes deri në vdekje.

Pasojë e veprës penale të vrasjes është shkaktimi i vdekjes së personit tjetër. Midis ndërmarrjes së veprimit dhe shkakimit të vdekjes duhet të ekzistojë lidhja kauzale. Kauzaliteti midis veprimit dhe shkakimit të vdekjes zakonisht konstatohet pa vështirësi. Lidhur me kauzalitetin problemet lajmërohen në këto situata: a) kur pasoja nuk shkaktohet menjëherë pas ndërmarrjes së veprimit; b) në rastet kur në shkaktimin e pasojës kontribuojnë edhe veprimet e personave të tjerë; c) kur në shkaktimin e pasojës kontribuojnë disa rrethana të tjera objektive dhe subjektive.

Kryerës i veprës penale. Këtë lloj të vrasjes mund ta kryejë çdo person (delictum communium).

Forma e fajit. Ky lloj i vrasjes mund të kryhet me dashje, direkte apo eventuale. Konsiderohet se personi këtë lloj të vrasjes e ka kryer me dashje, nëse veprimin e kryerjes e ka ndërmarrë me qëllim që tjetrin ta privojë nga jeta (dashja direkte), apo nëse ka qenë i vetëdijshëm se për shkak të veprimit apo mosveprimit të tij mund të shkaktohet pasoja e vdekjes dhe nëse është dakorduar që kjo pasojë të shkaktohet (dashja eventuale).

Tentativa e kësaj vepre penale ndëshkohet.

Vrasja e rëndë (Neni 179).

1. Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili:

- 1.1. privon nga jeta fëmijën;
- 1.2. privon nga jeta femrën shtatzënë;
- 1.3. privon nga jeta anëtarin e familjes;
- 1.4. privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake;
- 1.5. privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë;
- 1.6. privon nga jeta personin tjetër me qëllim të fitimit të dobisë pasurore;
- 1.7. privon nga jeta personin tjetër me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale, ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;
- 1.8. privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurë penale;
- 1.9. privon nga jeta personin tjetër zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare;
- 1.10. privon nga jeta personin tjetër për motive racore, kombëtare ose fetare.
- 1.11. me dashje kryen dy apo më shumë vrasje, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi; ose
- 1.12. privon nga jeta personin tjetër dhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 180 dhe 182 të këtij Kodi.

Nocioni dhe llojet. Vrasje të rënda, apo siç emërtohen ndryshe edhe vrasje të kualifikuara, konsiderohen ato vrasje të cilat kryhen në rrethana posaçërisht të rënda. Në rastet e vrasjeve të rënda shprehet një shkallë më e lartë e kundërligjshmërisë dhe e fajësisë së kryerësit. Për këtë arsye, edhe Kodi Penal për rastet e vrasjeve të rënda parasheh dënime më të rënda, së paku dhjetë vjet burgim apo burgim të përjetshëm.

Llojet e vrasjeve të rënda janë të parapara në nenin 179 të Kodit Penal dhe mund të sistemohen sipas kritereve të ndryshme: sipas **mënyrës së kryerjes**: vrasja në mënyrë mizore apo dinake (pika 1.4), vrasja kur me dashje vihet në rrezik jeta e një ose e më shumë personave (pika 1.5). Sipas **motiveve**: vrasja nga motive racore, nacionale

apo fetare (pika 1.10), vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore (pika 1.6), vrasja me qëllim të fshehjes së ndonjë veprë tjetër penale (pika 1.7), vrasja nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta (pika 1.8). Sipas **objektit mbrojtës (viktimës)**: vrasja e fëmijës (pika 1), vrasja e femrës për të cilën dorasi e di se ajo është shtatzënë (pika 2), vrasja e anëtarit të familjes (pika 1.4.), vrasja e personit zyrtar gjatë kohës së ushtrimit të detyrës në mbrojtje të rendit ligjor, sigurimit të njerëzve apo të pasurisë, zbulimit të veprave penale, arrestimit të kryerësit të veprës penale, ruajtjes së personave të privuar nga liria ose ruajtjes së rendit dhe paqes publike (pika 1.9). Sipas **pasojave**: vrasja me dashje e dy apo më shumë personave, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenet 180 dhe 182). Sipas **sjelljes (të kaluarës) së mëparshme të dorasit**: vrasja nga personi i cili më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenet 180 dhe 182.

Ekzistimi i më shumë rrethanave kualifikuese është e rëndësishme për matjen e dënimit.

Vrasja e fëmijës

Sipas konventave ndërkombëtare, fëmijë konsiderohet personi prej moshës zero deri në moshën tetëmbëdhjetë vjeçare. Kualifikimi i vrasjes së fëmijës si lloj i vrasjes së rëndë është shprehje e mbrojtjes më të madhe penalo-juridike të fëmijës. Mbrojtja më e madhe juridike-penale e fëmijës është e pranishme edhe në shumë dispozita të tjera të Kodit Penal. Duke u mbështetur në konceptin e këtillë të ligjdhënësisë, por edhe në aspektin moral dhe shoqëror, vrasja e fëmijës konsiderohet më e rëndë se vrasja e personit madhor.

Për t’u konsideruar se është kryer kjo vrasje, kryerësi duhet të dijë, të jetë i vetëdijshëm se viktima është fëmijë. Në rastet kur kryerësi nuk është i vetëdijshëm se personi të cilin e vret është fëmijë, atëherë lajthitja e këtillë nuk e përjashton nga përgjegjësia penale për vrasje dhe në këso rastesh të lajthitjes lidhur me viktimën kryerësi do të përgjigjet për vrasjen e rëndomtë apo të rëndë, varësisht nga motivi, rrethanat dhe mënyra e kryerjes, të paraparë në nenet 178 dhe 179 të Kodit Penal.

Vrasja e gruas shtatzënë

Kualifikimi i kësaj vrasjeje si vrasje e rëndë është tregues se Kodi Penal i kushton mbrojtje më të madhe gruas shtatzënë. Kjo është e arsyeshme, ngase edhe me të drejtën zakonore, si dhe në aspektin human, moral dhe religjioz, vrasja e gruas shtatzënë konsiderohet si vrasje më e rëndë, në krahasim me vrasjen e rëndomtë.

Në rastet e vrasjes së gruas shtatzënë, në fakt, fjala është për të ashtuquajturën “vrasje të dyfishtë”, ngase me këtë veprë penale nuk vritet vetëm gruaja shtatzënë, por edhe fëmija e saj që ende nuk ka lindur. Kjo veprë ekziston pa marrë parasyshë stadin e shtatzënësisë.

Si në rastet e vrasjes së fëmijës, edhe ky lloj i vrasjes do të konsiderohet se ekziston vetëm nëse kryerësi e ka ditur, ka qenë i vetëdijshëm se objekt i kësaj veprë penale

është gruaja shtatzënë. Rrjedhimisht, në këso raste fjala është për të ashtuquajturin “qëllim të dyfishtë”. Qëllimi i dyfishtë të kjo veprë penale konsiston në faktin se dorasi i realizon dy qëllime: vrasjen e gruas shtatzënë, si dhe asgjësimin e frytit (fëmijës) që është dashur të lindë.

Në rastet kur dorasi nuk e ka ditur se gruaja të cilën e privon nga jeta është shtatzënë, atëherë bëhet fjalë për lajthitjen në objekt dhe personi i këtitllë do të përgjigjet për vrasje të rëndomtë, apo për ndonjë lloj tjetër të vrasjes së rëndë, varësisht nga motivi, rrethanat apo mënyra e kryerjes së vrasjes.

Vrasja e anëtarit të familjes

Në legjislacionin penal të Kosovës, kjo formë e vrasjes së rëndë për herë të parë është paraparë me amandamentet e Kodit Penal që kanë hyrë në fuqi me 1 janar të vitit 2013. Për t’u konsideruar se ekziston ky lloj i vrasjes, duhet të plotësohet kushti objektiv i cili konsiston në faktin se ky lloj i vrasjes kryhet ndaj anëtarit të familjes.

Vrasja në mënyrë mizore

Vrasje në mënyrë mizore apo barbare, në literaturën juridike-penale dhe në praktikën gjyqësore konsiderohen rastet kur kryerësi, me qëllim, ose me vetëdije, ndërmerr aso veprimesh të cilat i shkaktojnë dhembje të mëdha fizike dhe psikike viktimës. Dhembjet fizike dhe psikike duhet t’i tejkalojnë ato dhembje dhe mundime që zakonisht shkaktohen me rastin e çdo vrasjeje. Me fjalë të tjera, dhuna duhet të jetë posaçërisht e rëndë, në mënyrë ekstreme e rëndë.

Vrasjet në mënyrë mizore në veçanti shprehen me rastin e privimit gradual nga jeta, prerja e gjymtyrëve të trupit viktimës para se të shkaktohet vdekja, duke e hedhur viktimën në zjarr apo në ujë, duke mos i dhënë ushqim apo ujë, duke ia zgjatur mundimet vdekjeprurëse dhe veprime të ngjashme.

Nga kjo që u tha më sipër, rezulton se për ekzistimin e vrasjes në mënyrë mizore janë të nevojshme *dy elemente të natyrës objektive dhe subjektive*.

Vrasja në mënyrë dinake

Ky lloj i vrasjes së kualifikuar karakterizohet me një intensitet të madh të sjelljes mashtruese apo të fshehtë me qëllim që viktimë të privohet nga jeta pa rezistencë apo me rezistencë sa më të vogël, me ç’rast dorasi e shfrytëzon besimin apo sinqeritetin apo padjallëzinë e viktimës. Thënë ndryshe, vrasje në mënyrë dinake konsiderohet rasti kur kryhet në mënyrë mashtruese (himbene) apo të fshehtë. Zaten, dinakëria është veti negative e njeriut. Si vrasje në mënyrë dinake rëndom konsiderohen vrasjet në gjumë dhe vrasjet me anë të helmit. Shembull më tipik i vrasjes në mënyrë dinake do të ishte rasti nëse kryerësi e thërret shokun e vet (viktimën) në darkë dhe i hedh helm në ushqim. Ose, rasti kur kryerësi e thërret viktimën për të shëtitur në parkun e qytetit dhe duke shëtitur prapa shpinës shkrepë me armë dhe e vret.

Vrasja kur me dashje rrezikohet jeta e një apo më shumë personave tjerë

Vrasje e këtillë konsiderohet kur kryerësi për të kryer veprën përdor aso mjetesh ose vepron në aso rrethanash dhe vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave, përveç atij ndaj të cilit është i drejtuar veprimi i kryerjes. Për t'u konsideruar se është kryer vepra e këtillë, është e nevojshme të krijohet rrezikshmëri konkrete.

Kjo veprë rëndom kryhet kur kryerësi përdor aso mjetesh, veprimin e të cilave nuk mund ta kontrollojë, si eksplozivin, zjarrin, armën automatike etj. Gjithashtu, do të konsiderohet se është kryer ky lloj vrasjeje kur kryerësi, për shembull, shkrep me armë në drejtim të viktimës e cila gjendet në shoqëri me persona të tjerë, ose nëse shkrep kur viktima gjendet në rrugë ku ka kalimtarë, ose në ndonjë lokal me plot njerëz.

Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore

Fakti që ndokush e vret tjetrin me qëllim të fitimit të dobisë pasurore është tregues se bëhet fjalë për egoizëm ekstrem dhe motiv të paskrupullt që me çdo kusht të fitohet pasuri. Vrasja me qëllim të fitimit të dobisë pasurore konsiderohet në rastet kur privimi nga jeta i personit tjetër kryhet me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjellë ndonjë dobi pasurore, dobi materiale.

Kjo veprë konsiderohet se është kryer si në rastin kur pretendohet të realizohet ndonjë dobi materiale, përkatësisht të zmadhohet pasuria, ashtu edhe në rastet kur pretendohet pengimi i zvogëlimit të pasurisë që do të ndodhte.

Për ekzistimin e kësaj vepre nuk është e domosdoshme që dobia edhe të realizohet. Madje, për ekzistimin e kësaj vepre nuk kërkohet që dobia të jetë e kundërligjshme. Së këndejmi, edhe ai që e vret borxhliun e vet me qëllim që t'i marrë të holla dhe kështu të arkëtojë borxhin e vet, konsiderohet se e ka kryer këtë veprë. Krahas vrasjes së borxhliut, si vrasje e këtillë konsiderohet, p.sh., edhe vrasja me qëllim të trashëgimisë, vrasja e kreditorit me qëllim që të mos paguhet borxhi, vrasja e paguar, vrasja me qëllim të eliminimit të konkurrentit etj.

Vrasja me qëllim të kryerjes apo të fshehjes së ndonjë vepre tjetër penale ose për të ndaluar personin nga dhënia e dëshmisë ose sigurimi në ndonjë mënyrë tjetër të informatave për policinë apo në procedurën penale

Si edhe te lloji i mëparshëm i vrasjes, rrethanë kualifikuese te kjo formë e rëndë e vrasjes është gjithashtu qëllimi i kryerjes. Këtu, privimi nga jeta i personit tjetër është mjet për realizimin e ndonjë qëllimi tjetër – me qëllim të kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale apo të fshehjes së veprës penale të kryer më parë. Nga kjo rezulton se **kjo vrasje e rëndë i ka tri forma.**

Forma e parë shprehet në rastet kur kryerësi e privon nga jeta personin tjetër, me qëllim që të bëjë të mundur ose të lehtësojë kryerjen e ndonjë vepre tjetër penale. Këtu vrasja i paraprin kryerjes së ndonjë vepre tjetër penale. **Forma e dytë** e kësaj vrasjeje ekziston në rastet kur kryerësi e privon nga jeta personin tjetër me qëllim që të pengojë zbulimin e veprës penale, e cila është kryer më parë ose e cila është duke u kryer. Për

shembull, vrasja e viktimës së dhunimit apo vrasja e dëshmitarit I cili duhet të jep dëshmi në procedurën penale. Edhe te kjo formë e vrasjes nuk është e rëndësishme se vepra e kujt fshihet, vepra e tij penale, apo vepra e personit tjetër.

Formë e tretë e kësaj vrasjeje të rëndë konsiderohet se kryhet në rastet kur në ndonjë mënyrë tjetër pamundësohet dhënia e informatave organeve të ndjekjes, përkatësisht organeve të policisë, prokurorisë apo gjykatave në procedurën penale.

Për ekzistimin e forms së dytë dhe të tretë të kësaj vrasjeje të rëndë nuk është e rëndësishme se a është zbuluar apo jo vepra e kryer më parë.

Vrasjet nga hakmarrja e paskrupullt

Një vrasje nga hakmarrja mund të konsiderohet si vrasje nga hakmarrja e paskrupullt nëse me atë rast plotësohet njëri prej këtyre kushteve: **a)** nëse hakmarrja është e drejtuar ndaj anëtarit të pafajshëm të familjes, psh. ndaj vllahut, motrës etj; **b)** nëse ajo haptas nuk është në përpjesëtim në krahasim me të keqen e pësuar më parë; **c)** nëse privohen nga jeta shumë persona; **ç)** nëse edhe vetë është kryer nga hakmarrja (hakmarrja ndaj hakmarrjes); **d)** nëse është kryer ndaj personit i cili për veprën e mëparshme penale me aktgjykim të plotfuqishëm është dënuar ose liruar nga dënimi; **e)** nëse me rastin e kryerjes së hakmarrjes cenohen disa rregulla ekzistuese pozitive të së drejtës zakonore, p.sh. hakmarrja gjatë kohëzgjatjes së besës ose pas arritjes së pajtimit dhe **f)** nëse hakmarrja është drejtuar ndaj personit, i cili në bazë të ligjit e ka kryer ndonjë veprim ose ka qenë i detyruar të veprojë ashtu, p.sh.vrasja e gjykatësit, prokurorit, policit, dëshmitarit, vrasja e personit për shkak se ka dhënë ndonjë informatë në polici apo në procedurën penale etj.

Vrasja nga motive të ulëta

Motive të ulëta në kuptimin e kësaj forme të vrasjes së rëndë konsiderohen motivet që janë në kundërshtim të rreptë me rregullat ekzistuese sociale-etike dhe për to kryerësi qortohet ashpër në aspektin moral. Këto janë motive veçanërisht të ulëta, motive veçanërisht negative të cilat shkaktojnë indinjatë dhe revoltë të thellë edhe në opinionin e gjerë. Lidhur me këtë, në dispozitën e Kodit Penal të Kroacisë (neni 34) ku parashihet ky lloj i vrasjes së rëndë, shprehimisht parashihet se motivet duhet të jenë veçanërisht rënduese. Mendoj se edhe në Kodin tonë Penal është dashur të figurojë fjala ‘veçanërisht’, ngase më për së afërmi e përkufizon këtë lloj të vrasjes së rëndë.

Në praktikën e deritashme gjyqësore të Kosovës dhe të vendeve të tjera, si vrasje nga motivet e ulëta janë konsideruar vrasja për shkak të shovinizmit nacional, vrasja e bashkëshortit ose bashkëshortes me qëllim të evitimit të pengesave për të vazhduar dashurinë dhe të ngjashme. Si shembull i vrasjes nga motive të ulëta në literaturë ceket edhe vrasja me qëllim të realizimit të ndonjë avantazhi apo dobie që nuk është e nocionit të vrasjes me qëllim të realizimit të përfitimit pasuror, p.sh. vrasja me qëllim të avancimit në detyrë, vrasja e konkurentit (kundërshtarit) politik, vrasja me qëllim të eliminimit të konkurentit në ndonjë garë sportive etj.

Me amandamentet e Kodit Penal, si vrasje nga motivet e ulëta konsiderohet edhe rasti i vrasjes së dëshmitarit për shkak të dhënies së dëshmisë në procedurën penale ose për shkak se ka dhënë informate organeve të policisë.

Vrasja e personit zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose në lidhje me detyrën zyrtare

Nocioni i personit zyrtar është përcaktuar në nenin 120, paragrafin 2 të Kodit Penal.

Në Kodin Penal të pa amandamentuar i cili ishte në fuqi deri me 31 dhjetor të vitit 2012 thuhej shprehimisht se si person zyrtar në sensin e këtij inkriminimi nuk konsiderohej çdo person zyrtar por përcaktoheshin vetëm këta persona zyrtar të cilët kryejnë këto autorizime apo detyra: **a)** mbrojtjen e rendit ligjor; **b)** sigurimin e njerëzve apo të pasurisë; **c)** zbulimin e veprave penale; **ç)** arrestimin e kryerësit të veprës penale; **d)** ruajtjen e personave të privuar nga liria dhe **e)** ruajtjen e rendit dhe të paqes publike. Kategoria e personave zyrtarë të cilët kanë qenë të cekur në këtë dispozitë janë p.sh. policët, gjyqtarët, prokurorët, gardianët të cilët i ruajnë dhe përkujdesen për të burgosurit etj.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person (delictum communium).

Kjo veprë mund të kryhet vetëm me dashje. Dashja duhet të përfshijë në vete vetëdijen për statusin (tiparet) e viktimës dhe detyrën të cilën ai e kryen. Me fjalë të tjera, kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm se e privon nga jeta jo vetëm personin zyrtar, por duhet të jetë i vetëdijshëm se personin e tillë zyrtar e privon nga jeta gjatë ushtrimit apo lidhur me ushtrimin e detyrave të sipërpërmendura.

Vrasja për motive racore, kombëtare ose fetare

Për t'u konsideruar se është kryer kjo formë e vrasjes, privimi nga jeta e personit tjetër duhet të jetë kryer nga motive racore, nacionale apo fetare. Së këndejmi, motivi është vendimtar për kualifikimin e kësaj veprë. Rrjedhimisht, fakti se vrasja është kryer nga ky motiv, është tregues se motivi është i ulët, shovinist dhe i cili jo vetëm nga e drejta penale, por edhe sipas perceptimit të opinionit konsiderohet si vrasje e rëndë në krahasim me vrasjet e rëndomta.

Kjo vrasje mund të kryhet vetëm me dashje.

Kryerës i kësaj vrasjeje mund të jetë çdo person.

Vrasja me dashje e dy apo më shumë personave, përveç veprave të cilat janë paraparë në nenin 180 dhe 182

Ky lloj i vrasjes së rëndë konsiderohet se është kryer në rastet kur kryerësi me dashje ka privuar nga jeta dy apo më shumë persona, përveç atyre që janë të parapara në nenin 180 dhe 182 të Kodit Penal (vrasja në gjendje të afektit mendor dhe vrasja e foshnjës gjatë lindjes). Meqë ky lloj i vrasjes së rëndë mund të kryhet vetëm me dashje, edhe vrasjet nga pakujdesia nuk mund të kualifikohen sipas kësaj dispozite. Sipas kësaj

dispozite, vrasja e këtyllë konsiderohet se është kryer nëse kryerësi dy apo më shumë vrasje i kryen në bashkimin ideal apo real, por me kusht që procedura penale të jetë e njëjtë dhe fajtori të ndëshkohet me dënim unik, të përbashkët. Pra këtu nuk është fjala për recidiv të vrasjes.

Si vrasje e këtyllë duhet kualifikuar jo vetëm vrasja e rëndomtë dhe e rëndë nga Kapitulli i veprave penale kundër jetës dhe trupit, por edhe vrasjet që janë paraparë në kapitujt e tjerë, si për shembull vrasjet nga Kapitulli i veprave penale kundër Kosovës dhe qytetarëve të saj, ose vrasjet nga Kapitulli i veprave penale kundër të drejtës ndërkombëtare.

Vrasja nga personi i cili edhe më parë ka qenë i dënuar për vrasje, përveç veprave të cilat janë të parapara në nenin 180 dhe 182

Ky lloj i vrasjes së rëndë konsiderohet se ekziston në rastet kur personi i njëjtë më parë ka qenë i dënuar për vrasje dhe sërish kryen një apo më shumë vrasje, përveç atyre të parapara në nenin 180 dhe 182 (vrasjen e kryer në gjendje të afektit mendor dhe vrasjen e foshnjës gjatë lindjes). Së këndejmi, këtu është fjala për recidiv.

Ndërprerja e palejuar e shtatzënisë (Neni 184)

Kjo veprë penale është e karakterit blanket dhe konsiderohet se ekziston në rastet kur kryhet në kundërshtim me Ligjin për Ndërprerjen e Shtatzënisë. Përndryshe ndërprerja e shtatzënisë në pajtim me dispozitat ligjore nuk është e inkriminuar. Thënë ndryshe, me këtë veprë penale kriminalizohet ndërprerja ilegale e shtatzënisë.

Ndërprerja e shtatzënisë është asgjësimi i frytit të njeriut dhe nxjerrja e tij nga barku i gruas. Disa e bëjnë dallimin midis abortusit dhe ndërprerjes së shtatzënisë. Abortusin e konsiderojnë ndërprerjen e shtatzënisë e cila kryhet para se të mbushen 30 javë shtatzënie. Në aspektin penalo-juridik ky dallim nuk është **relevant** ngase pa marrë parasysh dallimet në emërtim është i inkriminuar.

Me këtë paragraf dhe dy paragrafëve të tjerë të nenit 184 janë të kriminalizuara këto veprime: 1) ndërprerja e shtatzënisë me pëlqimin e gruas shtatzënë por në kundërshtim me dispozitat mbi ndërprerjen e shtatzënisë, 2) ndërprerja e shtatzënisë pa pëlqimin e gruas shtatzënë, dhe 3) rastet e kualifikuara me pasojë të rëndë.

Objekt mbrojtës në radhë të parë është shëndeti i gruas. Gjithashtu, Objekt mbrojtës është edhe integriteti trupor si dhe jeta e gruas shtatzënë. Por objekt mbrojtës është gjithashtu edhe fryti i njeriut, përkatësisht jeta e ardhshme e njeriut. Meqë në rastet e parapara me ligj është e lejuar ndërprerja e shtatzënisë, mbrojtja penalo-juridike e gruas shtatzënë është e paraparë nëse ndërprerja bëhet në mënyrë të kundërligjshme.

Vepra penale e ndërprerjes së palejuar të shtatzënisë i ka disa forma. Forma e themelore e kësaj vepre është paraparë në paragrafin 1.e cila konsiderohet se kryhet nëse ndërprerja e palejuar e shtatzënisë bëhet me **pëlqimin e gruas** shtatzënë. Pëlqimi i gruas shtatzënë për të ndërprerë shtatzënisin duhet të jetë serioz, i qartë dhe i vullnetshëm, pa u përdorur dhuna apo kanosja. Gruaja shpatzënë e papërgjegjshme

nuk ka mundësi të japë pëlqimin valid. Pëlqimi mund të supozohet në rastet kur ndërprerja e shtatzënesisë është në interes të gruas, ndërsa ajo, po të kishte mundësi, do të vendoste vetë për këtë.

Kryerës i veprës penale mund të jetë çdo person: mjeku, mamia, ndonjë punëtor tjetër shëndetësor, apo çdo person tjetër. Këtë vepër penale nuk mund ta kryejë vetëm gruaja shtatzënë, Kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me veprim.

Kjo vepër mund të kryhet vetëm me dashje. Dashja, përveç të tjerash përfshin në vete edhe vetëdijen për kundërligjshmërinë e cila është tipar i posaçëm i kësaj vepre penale.

Forma e dytë e kryerjes së kësaj vepre penale ekziston në rastet kur ndokush e fillon ose e ndërpret shtatzënesinë **pa pëlqimin e gruas shtatzënë** (paragrafi 2). Meqë fillimi apo ndërprerja e shtatzënesisë pa pëlqimin e gruas shtatzënë në vete përmban dozë më të madhe kriminale, kjo konsiderohet edhe formë e kualifikuar e kësaj vepre penale. Ndërprerja e shtatzënesisë pa pëlqimin e gruas shtatzënë zakonisht shprehet në rastet kur kjo vepër kryhet me dhunë ose me kanosje. Por kjo vepër duhet të konsiderohet se është kryer pa pëlqimin e gruas shtatzënë kur ndërprerja e shtatzënesisë është bërë me mashtrim. Nuk konsiderohet pëlqim relevant edhe në rastet kur pëlqimi është dhënë nga personi i papërgjegjshëm apo fëmija, përkatësisht personi i cili nuk i ka mbushur 14 vjet.

Në par.3.është paraparë forma edhe më e rëndë e ndërprerjes së palejuar të shtatzënesisë dhe konsiderohet se është kryer në rastet kur nga kryerja e kësaj vepre është shkaktuar **lëndimi i rëndë trupor, dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e gruas shtatzënë**. Lidhur me këto pasoja të rënda, kryerësi duhet të ketë vepruar nga pakujdesia. Përkatësisht, personi veprat penale të parapara në paragrafin 1 dhe 2 të këtij neni i kryen me dashje (dollus), ndërsa lidhur me pasojat e shkaktuara të parapara në paragrafin 3 (dëmtim i rëndë i shëndetit apo vdekja e gruas shpatzënë) vepron nga pakujdesia. Këto pasoja më të rënda shkaktohen nga pakujdesia ngase kryerësi i kësaj vepre penale fare nuk ka supozuar, nuk i ka shkuar ndërmend se mund të shkaktohen këto pasoja (pakujdesi pa vetëdije), nëse e ka paraparë këtë mundësi ka shpresuar se ato nuk do të shkaktohen apo se ato do të parandalohen.

Lëndimi i lehtë trupor(Neni 188)

Nocioni dhe klasifikimi i lëndimeve trupore. Marrë në përgjithësi, lëndimet trupore konsistojnë në dëmtimin e integritetit fizik apo të shëndetit të ndonjë personi.

Objekt mbrojtës nga këto vepra penale është integriteti trupor, mendor dhe shëndetësor i njeriut, prej momentit të lindjes deri në vdekje. Lëndimi trupor mund të kryhet edhe ndaj personit i cili lëngon nga ndonjë sëmundje e pashërueshme. Integriteti trupor mbrohet jo vetëm nga lëndimet por edhe nga rrezikimi, siç është vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme. Siguria e frytit dhe e integritetit të tij gjithashtu mbrohet, por vetëm nga veprimet e kundërligjshme të ndërprerjes së shtatzënesisë.

Pasojat e lëndimeve trupore konsistojnë në dëmtimin e integritetit trupor apo në shkaktimin e sëmundjes fizike apo mendore. Integriteti trupor mund të dëmtohet në

mënyra të ndryshme, siç janë p.sh. shkaktimi i plagës në trup, shkaktimi i djegies, fraktura (thyerja) e dorës apo këmbës, asgjësimi i ndonjë pjese të trupit apo dëmtimi i tyre i pjesërishëm dhe pasoja të ngjashme.

Kodi Penal i Kosovës i njuh disa lloje të lëndimeve trupore, që janë: **1)** lëndimi i lehtë trupor, **2)** lëndimi i rëndë trupor, **3)** lëndimi i rëndë trupor që ka shkakuar vdekjen e personit, dhe **5)** lëndimi i rëndë trupor në afekt.

Në sensin e paragrafit 1, si vepër penale e lëndimit të lehtë trupor konsiderohet aso lëndimi trupor që kërkon një minimum të mjekimit apo të përkujudesjes. Kjo vlenë edhe për dëmtimin e shëndetit. Thënë ndryshe si lëndim i lehtë trupor konsiderohet rasti kur shkaktohen shenja në integritetit trupor apo dhembje fizike të kohëzgjatjes së shkurtër. Nga kjo rezulton se me nocionin lëndim trupor nuk mund të konsiderohet çdo veprim mbi trupin, nëse me atë veprim nuk është dëmtuar integriteti trupor apo shëndeti i njeriut.

Ndryshe nga kodet penale të shteteve të regjionit të cilat nuk përcaktojnë kurfar kritere, në Kodin Penal të Kosovës në mënyrë të përgjithësuar janë përcaktuar disa kritere sipas të cilave një lëndim trupor duhet të kualifikohet si lëndim i lehtë. Rrjedhimisht sipas paragrafit 1 si lëndim trupor i lehtë duhet të konsiderohet nëse me atë lëndim kryerësi ka shkakuar: **a)** dëmtimin e përkohshëm ose dobësimin e një organi apo pjese të trupit të personit tjetër; **b)** zvogëlimin e përkohshëm të aftësisë së personit tjetër për të punuar; **c)** shëmtimin e përkohshëm të personit tjetër, ose **ç)** dëmtimin e përkohshëm të shëndetit të personit tjetër.

Dëmtimi i shëndetit do të thotë shkaktimi i sëmundjes trupore (somatike) apo sëmundjes mendore (psikike). Me dëmtim të shëndetit duhet nënkuptuar edhe shkaktimin e keqësimit të gjendjes ekzistuese të sëmundjes fizike apo psikike, si dhe pengimin e shërimit të sëmundjes.

Kryerësi i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person (delictum communium).

Kjo vepër penale mund të kryhet me veprim dhe me mosveprim.

Forma e fajit. Kjo formë e veprës penale mund të kryhet vetëm me dashje. Lëndimi i lehtë trupor mund të kryhet edhe nga pakujdesia, por kjo nuk është relevante për të drejtën penale, përkatësisht nuk konsiderohet si vepër penale.

Në paragrafin 2 është paraparë forma e rëndë e kësaj vepre penale dhe konsiderohet se ekziston nëse vepra është kryer me armë, me ndonjë mjet të rrezikshëm, me ndonjë send (mjet) tjetër të përshtatshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit. Sikundër te lëndimi i rëndë trupor, edhe te kjo formë e veprës kihet për qëllim që të sigurohet mbrojtja e tërësishme e integritetit trupor dhe e shëndetit të njeriut. Ky lloj i lëndimit të lehtë trupor, sikundër forma themelore, mund të kryhet vetëm me dashje.

Në dispozitën e paragrafit 3 është paraparë formë e cilësuar e veprës penale të lëndimit të lehtë trupor, e cila konsiderohet se ekziston nës kryhet ndaj viktimës së ndjeshme. Në sensin e kësaj dispozite, si viktimë e ndjeshme konsiderohet rast kur kjo vepër kryhet ndaj fëmijës, ndaj të moshuarit, ndaj gruas shtatëzënë, ndaj personit me aftësi të kufizuara etj.

Në paragrafin 4 është paraparë mundësia e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore për veprën e paraparë në paragrafët 1 dhe 2, nëse kryerësi ka qenë i provokuar nga sjellja çnjerëzore ose e vrazhdë e palës së dëmtuar.

Shtrëngimi (Neni 195)

Shtrëngim do të thotë përdorimi i forcës apo kanosjes ndaj tjetrit për ta detyruar që të veproj apo mos veproj diç ose të pajtohet, respektivisht ta detyroj në sjellje të caktuar. Shtrëngimi sipas kuptimit penalo-juridik na paraqitet si mënyrë e kryerjes së disa veprave penale. P.sh., te vepra penale e rrëmbimit (neni 194), marrja e deklaratës me anë të shtrëngimit (neni 197), cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve (neni 213), dhunimi (neni 230 etj. Tek disa vepra penale shtrëngimi na paraqitet si rrethanë kualifikues, ashtu që vepra bëhet shoqërisht më e rrezikshme për shkak të përdorimit të forcës dhe kanosjes. Në bashkim me ndonjë vepër tjetër penale formon vepër penale të posaçme si p.sh., grabitja (neni 329) dhe vjedhja grabitqare (neni 328).

Shtrëngimi na paraqitet si vepër penale e veçantë e cila me përdorimin e forcës dhe kanosjes përjashtohet apo kufizohet tjetri që të vendos lirshëm.

Qëllimi i këtij inkriminimi është, ngase është e pa mundshme që të parashikohen dhe të përcaktohen të gjitha format e posaçme të shtrëngimit, ashtu që me anë të kësaj vepre penale përshihen ato raste kur me shtrëngim nuk përmbushet figura e ndonjë vepre tjetër penale. Sjelljet për të cilat tjetri shtrëngohet janë të përgjithësuara dhe të pa konkretizuara.

Shtrëngimi sipas Kodin tonë penal është vepër penale e drejtuar kundër lirisë personale të njeriut, respektivisht kundër vendosjes dhe veprimit të lirë. Sipas paragrafit të parë, shtrëngimi manifestohet me dhunë dhe kanosje serioze ndaj një personi me qëllim që ai të veproj ose mos veproj apo të përmbahet nga diç. Për të ekzistuar kjo vepër penale, kryerësi duhet me forcë ose me kanosje serioze të ndikoj në personin tjetër ashtu që ai në kundërshtim me vullnetin e vet të ndërmarri ndonjë veprim, të përmbahet nga ndonjë detyrim apo të duroj diç.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale është shtrëngimi duke e përdorë forcën apo kanosjen serioze. Me përdorimin e forcës dhe kanosjen ndaj personit tjetër fillon kryerja e kësaj vepre penale, ndërsa kryhet atëherë kur realizohet qëllimi i kryerësit.

Sipas përkufizimit të paragrafit 1 të kësaj vepre penale rrjedhë se mjet me të cilin kryhet kjo vepër penale është dhuna dhe kanosja serioze. Dhuna mund të jetë fizike kur përdoret forca dhe psikike kur përdoret kërcënimi. Me forcë do nënkuptojmë, përdorimin e çdo force mekanike apo ndonjë fuçie tjetër e edhe përdorimin e hipnozës apo mjete dehëse me qëllim që dikush pa vullnetin e vet të vihet në gjendje të pa vetëdijshme apo të pa aftë për rezistencë.

Forca mund të jetë absolute e cila e përjashton mundësin e vendosjes. P.sh., personi cili është nën hipnozë nuk mund të vendosi mbi bazën e vullnetit të vetë. Përjashtohet mundësia e vendosjes në mënyrë absolute. Ose p.sh., kur subjekti pasiv është i lidhur këmbë e duar ai përjashtohet në mënyrë absolute të marri vendime sipas vullnetit të vet.

Forca mund të jetë kompulsive e cila nuk e përjashton mundësin e vendosjes, por nën ndikimin e saj mund të merret vendimi në kundërshtim me vullnetin. Forca kompulsive duhet të jetë e atillë sa ta nënshtroj vullnetit e të dhunuarit.

Edhe kanosja mund të jetë e ushtruar në mënyrë direkte kur drejt për së drejti kanoset i kanosuni apo kur kanoset personi në marrëdhënie familjare me të kanosnin. Ka mendime se kanosja mund të jetë edhe ndaj sendeve të kanosnit nëse pritet se edhe në atë mënyrë mund të arrihet synimi i kanositë (p.sh., personi detyrohet ta lëshoj banesën për shkak se kryesi rregullisht ia thyen dritaret). Kanosja si mjet i shtrëngimit mund të ushtrohet me shkrim, me gojë, me veprim konkludent, me telefon, me SMS apo kompjuter e forma tjera.

Kanosja sipas përkufizimit të kësaj vepre penale ekziston edhe atëherë kur të kanosnit i bëhet me dije nga ushtruesi i kanosjes se e keqja që do ta pësoj do ushtrohet nga një person tjetër.

Kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje, dashje direkte apo eventuale. Kryerësi i veprës penale duhet të jetë i vetëdijshëm se me përdorimin e forcës dhe kanosjes e detyron personin tjetër të vepro, të mos vepro apo të përmbahet, respektivisht se me forcë dhe kanosje e detyron tjetrin në sjellje të cilat e realizojnë qëllimin e kryesit.

Në paragrafin e 2 të këtij neni janë paraparë format kualifikuese të kësaj vepre penale për shkak të rrethanave nën të cilat mund të kryhet vepra. Këtë vepër, sipas paragrafit 2 të këtij neni e bënë të kualifikuar apo të rëndë:

Par. 2.1, nëse i kanosuni është kanos me vdekje apo me dëmtim të rëndë të shëndetit;

Par. 2.2, kur kryerësi e kryen veprën penale si anëtar i grupit;

Në par. 2.3, është përkufizuar se vepra themelore e merr karakterin e veprës penale të kualifikuar, për shkak të mjetit me të cilin kryhet vepra penale. Më konkret, nëse gjatë kryerjes së veprës penale përdoret arma apo sendi me të cilin mund të shkaktohet lëndim i rëndë trupor apo mund të dëmtohet rënë shëndeti i subjektit pasiv.

Në par. 2.4, parashihet forma e kualifikuar të kësaj vepre penale dhe konsiderohet se kryhet në rastet kur dhuna dhe kanosja serioze është ushtruar ndaj personit të ndjeshëm. Si person i ndjeshëm konsiderohet: fëmija, invalidi, i moshuari, personi me çrregullime mendore, gruaja shtatzënë dhe çdo person tjetër i cili për kah zhvillimi psikik dhe fizik lenë përshtypjen e personit të pa fuqishëm në aspektin psikik apo fizik.

Sipas par. 3.1 të këtij neni, veprën e bënë të kualifikuar kur kryerësi vepron si anëtarë i një grupi të organizuar. Kur kryerësi vepron si anëtar i një grupi të organizuar, vepra penale merr karakter të rrezikshmërisë shoqërore më të rëndë.

Në par. 3.2 parashihet formë e rëndë të kësaj vepre penale kur tek subjekti pasiv gjatë kryerjes së veprës penale shkaktohet lëndim i rëndë trupor apo vdekja. Vdekja e subjektit pasiv mund të ndodhë edhe pas që të kryhet vepra penale, por për ekzistimin e kësaj vepre penale, duhet të ekzistoj lidhja shkakësore në mes të pasojës dhe veprimeve të kryerjes së kësaj vepre penale.

Cenimi i paprekshmërisë së banesave dhe objekteve (Neni 200)

E drejta e pacenueshmërisë së banesës parqet një nga të drejtat themelore të njeriut kuptimi i së cilës është mbrojtja më e rëndësishme e sferës private, në bazë të së cilës as kush nuk mund të shqetësohet në të drejtën e banimit. Sipas nenit 12 të Deklaratës Universale për të drejtat e njeriut dhe Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, as kush nuk mund të hyjë në banesë dhe hapësira të huaja në kundërshtim me vullnetin e mbajtësit, përveç në bazë të vendimit të gjykatës. Përfundimisht, pa vendimin e gjykatës, hyrja dhe kontrolli i banesës është i lejuar vetëm kur është e nevojshme që të arrestohet kryerësi i veprës penale apo mënjanimi i rrezikut të at qasshëm për njerëz ose pasurisë. Me fjalë tjera hyrja në banesë të huaj është i lejuar vetëm në rastet kur e lejon ligji ose atë e kërkon banuesi.

Edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 36, qytetarëve dhe individëve që jetojnë në Kosovë u garanton pacenueshmërinë e banesës. Në bazë të kësaj edhe e drejta penale e Republikës së Kosovës, me normë penale e mbron këtë drejtë të njeriut që pa pengesë ta shfrytëzojë të drejtën e banimit në banesë dhe objekte tjera të dedikuara për shfrytëzimin e të drejtës së banimit. E drejta e shfrytëzimit të të drejtës së banimit si e drejtë themelore e njeriut bënë pjesë në këtë kapitull të Kodit Penal.

1. Kjo vepër penale përbëhet në hyrjen e kundërligjshme në banesë ose në objektin e mbyllur të personit tjetër apo nuk largohet nga objektet e tilla sipas kërkesës së personit të autorizuar (par. 1).

Objekti mbrojtës tek kjo vepër penale është banesa dhe objektet tjera të mbyllura me të cilat disponon personi fizik apo juridik.

Nuk është e rëndësishme se banesa apo hapësira e mbyllur është e ndonjë organi shtetërorë, organi publik, ndonjë personi juridik ose ndonjë qytetari. Po ashtu nuk është e rëndësishme dedikimi i objektit të mbyllur.

Po ashtu, për të ekzistuar kjo vepër penale nuk është e rëndësishme se a ekziston dikush në banesë apo jo, kryesore është se banesa i takon dikujt, të dihet se kujt i takon.

Tek forma themelore e kësaj vepre penale, janë paraqitur dy forma të kryerjes: a) hyrja në banesë ose në objektin e mbyllur pa ndonjë autorizim dhe b) mos largimi nga objektet e tilla me kërkesën e personit të autorizuar (personit i cili banon në banesë apo objekt).

Sipas rregullit, hyrja duhet të jetë me përdorimin e forcës fizike për të mënjeluar pengesat për të hyrë në banesë. Hyrja mund të jetë nëpërmes dritares, hapjes së derës me ndonjë qelës, apo duke e mposht rezistencën e banorit të autorizuar.

Me mos largim nga banesa apo objekti i mbyllur nënkuptojmë qëndrimin e kryerësit aty pa vullnetin e personit të autorizuar. Më së shumti manifestohet me qëndrimin pasiv e në kundërshtim të thirrjes së personit të autorizuar që ta liroj banesën apo objektin e mbyllur. Mirëpo qëndrimi aty mund të manifestohet edhe me veprim aktiv duke i rezistuar veprimin të personit të autorizuar. E rëndësishme është që të ekzistoj thirrja apo kërkesa e personit të autorizuar që ta liroj banesën apo objektin e mbyllur dhe kryerësi nuk vepron sipas kërkesës. Person i autorizuar është ai person që ka të drejtën e shfrytëzimit të banesës apo të objektit.

Sa i përket fajësisë, kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje. Tek kryerësi duhet të ekzistoj vetëdija se hynë ose qëndron në banesë apo në objektin e mbyllur pa autorizim, në mënyrë kundërligjore.

Forma kualifikuese e kësaj veprë penale është përkufizuar në paragrafin e 3 të këtij neni. Kjo veprë penale bëhet e kualifikuar nëse kryhet nga personi zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Pra vepra themelore bëhet e rëndë në bazë të vetive të kryerësit. Sa i përket shpjegimit të kuptimit të shprehjes “person zyrtar” shihni kuptimin e shprehjeve në nenin 120 të këtij Kodi.

Në paragrafin 4 të këtij neni, ligdhënësi ka përkufizuar formën edhe më të rëndë të kësaj veprë penale, nëse kryesi gjatë kryerjes së veprës penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni përdor armë ose mjet apo send tjetër të përshtatshëm për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor apo për ta dëmtuar rëndë shëndetin. Pra, për shkak të përdorimit të armës apo mjetit ose sendit tjetër të përshtatshëm për ta lënduar rëndë shëndetin apo për ta lënduar rëndë trupin e subjektit pasiv, vepra themelore e paraparë në paragrafin 1 ose 2 të këtij neni merr karakter të rëndë ose kualifikues.

VEPRAT PENALE KUNDER TE DREJTAVE TE VOTIMIT

Vështrime të Përgjithshme.

Veprat penale që kanë të bëjnë me të drejtën e votimit dhe të drejtës zgjedhore, legjislacionet penale të disa shteteve e tani edhe shteti ynë i ka sistemuar në kapitull të veçantë, për shkak të rëndësisë së objektit mbrojtës të këtyre veprave penale, dhe mënyrave të shumta të mundshme të cenimit të këtyre të drejtave.

Kushtetuta e Republikës së Kosovë parimisht, këto të drejta i ka garantuar për shtetasit e vet sipas nenin 45, të cilat i përkufizon në tre paragraf ku thuhet:

“çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendimin gjyqësor.

Vota është personale, e lirë, e barabartë dhe e fshehtë.

Institucionet shtetërore mbështesin mundësin për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e organeve publike.”-

Këto të drejta kushtetuese, mbrohen edhe me normat penale të këtij kapitulli.

Cenimi i përcaktimit të lirë të votuesve (Neni 213).

E drejta e shtetasit që të votoj, përfshin lirinë e shfrytëzimit të kësaj të drejte për tu përcaktuar lirish me rastin e votimit për kandidatin ose partinë. E Drejta e votës së lirë do të thotë se as kush nuk ka të drejtë të ndikoj në vullnetin e votuesit, fshehtësinë e votimit dhe të jetë i barabartë me të tjerët për votim. Pra, me këtë dispozitë penale juridike mbrohet e drejta e lirisë së votimit.

Objekti mbrojtës i kësaj vepre penale është liria e votuesit që pa ndikim dhe pa ushtrim të forcës apo të kanosjes me rastin e votimit që vullnetarisht të përcaktohet lirshëm për kandidatin apo partinë.

Këtë vepër penale mund ta kryej çdo person i cili me përdorimin e dhunës, kanosjes serioze, ryshfetit, duke përdorë varësin ekonomike apo profesionale ndikon ose e detyron votuesin që të votoj në mënyrë të caktuar ose të mos votoj.

Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë paraparë në formë alternative, andaj edhe kemi këto forma të kësaj vepre penale.

Forma e parë është kur kryerësi me përdorimin e dhunës ose kanosjes serioze ndikon në vullnetin e lirë të votuesit që të votoj për kandidatin e caktuar apo partinë e caktuar ose të mos votoj në zgjedhje.

Veprimi i kryerjes së kësaj forme të veprës penale është përdorimi i dhunës apo kanosjes serioze. Dhuna ose kanosja duhet të jenë të intensitetit të përshtatshëm sa të ndikojnë në vullnetin e lirë të subjektit pasiv të kësaj vepre penale e që është votuesi me të drejtë vote.

Vepra do të konsiderohet e kryer me ndikimin në vullnetin e lirë të votuesit me përdorimin e dhunës dhe kanosjes serioze.

Forma e dytë e kësaj vepre penale kryhet me keqpërdorimin e varësisë ekonomike ose profesionale të votuesit. *Veprimi i kryerjes* së kësaj vepre penale ka të bëjë me keqpërdorimin e varësisë ekonomike. P.sh., punëdhënësi ia bënë me dije votuesit se për kënd duhet votuar apo të mos votohet, ose ndikimi i mbajtësit të familjes në vullnetin e anëtarëve tjerë të familjes. Me fjalë tjera me keqpërdorimin e varësisë ekonomike, profesionale ndikon në vullnetin e personit tjetër që të votoj apo të mos votojë. Varësia profesionale do të ishte p. sh., profesori tek nxënësit, mjeku tek personeli tjetër mjekësor, zeytari tek shegerti, gjyqtari tek bashkëpunëtori profesional etj.

Konsideroj se kjo vepër penale mund të kryhet edhe me anë të mashtrimit, ngase edhe mashtrimi mund të konsiderohet si një formë e detyrimit.

Sa i përket fajësisë, kjo vepër penale kryhet vetëm me dashje.

Pasoja e veprës penale realizohet atëherë kur votuesi ka votuar nën ndikimin e kryerësit ose nuk ka votuar në zgjedhje.

VEPRAT PENALE KUNDER TE DREJTAVE NE MARREDHENIET E PUNES

Vështrime të Përgjithshme.

Veprat penale të këtij kapitulli paraqesin cenimin e të drejtave individuale të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet në mes punëdhënësit dhe punëtorit. Këto të drejta të cilat i takojnë grupit të të drejtave ekonomike dhe sociale të njeriut, janë rregulluar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjin mbi marrëdhëniet e punës, ligjin mbi punën e shërbyesve civil, kontrata kolektive etj.

Po ashtu këto të drejta janë të parapara edhe me aktet ndërkombëtare, p.sh., me Deklaratën e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut -1948, me Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe protokollat e saja.

Të drejtat të cilat i takojnë sferës së të drejtave që rrjedhin nga raportet e punëdhënësit dhe punëtorit, si një e drejtë individuale janë rregulluar në mënyra të ndryshme, varësisht nga sistemet shoqëro-politike të shteteve.

Të drejtat nga marrëdhënia e punës janë garantuar me Kushtetutën e vendit tonë, më për së afërmi me nenin 49 ku thuhet"- E drejta e punës garantohet. Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës". Ndërsa, në nenin 28 e ndalon skllavërinë dhe punën e detyruar.

Përveç Kushtetutës, të drejtat nga marrëdhënia e punës dhe në punësim janë rregulluar me ligj dhe akte tjera nënligjore dhe kontrata. Pritet të nxirren edhe ligjet për të drejtat nga marrëdhënia e punës në përputhje me të drejtën bashkëkohore Evropiane. Përveç të drejtës nga marrëdhënia e punës priten të nxirren edhe ligji për sigurimin shëndetësor, invalidor dhe pensional.

Tani në sistemin tonë demokratik, shumë të drejta që i takojnë sferës nga marrëdhënia e punës rregullohen, përveç me ligj dhe akte nënligjore edhe me kontrata kolektive dhe individuale të cilat lidhen në mes të punëdhënësit dhe punëmarrësit. Garantë për zbatimin e këtyre kontratave është shteti me mekanizmat e vet.

Për shkak të rëndësisë që kanë këto të drejta, ligjdhënësi duke i zbatuar normat e kushtetutës ka caktuar edhe veprat penale me të cilat i mbron këto të drejta të cilat burojnë nga marrëdhënia e punës.

Duhet cekur se të drejtat e shumta të kësaj natyre realizohen edhe në të drejtën civile, nga se janë marrëdhënie kontraktuese dhe për to vlejnë edhe dispozitat nga Ligji mbi Marrëdhëniet Detyrimore. Mirëpo veprat penale të cilat përfshijnë cenimin e të drejtave apo kufizimin e tyre që sipas ligjit u takojnë, sa i përket punësimit, pushimit nga puna, për pagën, për kohëzgjatjen e orarit të punës, për pushim apo mungesë në punë, mbrojtjen e grave, fëmijëve apo personave me paaftësi, për punë jashtë orarit etj, janë paraparë në këtë kapitull të Kodit Penal. Po ashtu në këtë kapitull janë paraparë edhe veprat penale që i referohen sigurimit social, rrezikimit të e sigurisë në punë dhe të drejtën në pjesëmarrje në qeverisje.

Veprat penale të këtij grupi karakterizohen me disa karakteristika të përbashkëta, përveç veprës penale që ka të bëjë me të drejtën e sigurimit social. *Ato karakteristika*, para se gjithash kanë dispozitiv blanket (udhëzues). Kryhen me shkelje të ligjit dhe akteve tjera nënligjore si dhe të drejtat që rrjedhin nga kontratat kolektive, të cilat parashohin ndonjë të drejtë të punëtorit.

Pasoja e këtyre e këtyre veprave të këtij Kapitulli është mohimi apo kufizimi i të drejtave të punëtorëve. Për të ekzistuar vepra penale duhet të shkaktohet pasoja e jo vetëm të cenohet ndonjë dispozitë ligjore.

Lidhur me fajësinë, këto vepra kryhen me dashje Nëse kryhen nga pakujdesia atëherë është fjala për përgjegjësi disiplinore apo administrative.

Kryerës të këtyre veprave penale, zakonisht janë personat të cilët janë të ngarkuar me zbatimin e ligjit, akteve nënligjore dhe kontratave. Zakonisht janë persona përgjegjës ose zyrtarë të cilët kanë autorizime të caktuara. Numri i këtyre veprave penale nuk është i madh.

Objekt mbrojtës janë të drejta e punëtorit. Më së shpeshti këto vepra penale kryhen me cenimin e ndonjë ligji, akti ligjor ose kontratë kolektive me çka pushohet, ndalohehet apo i kufizohet një e drejt e cila i takon punëtorit.

Cenimi i të drejtave në marrëdhëniet e punës (Neni 221)

Qëllimi kriminalo-politik i kësaj norme penale është që të sigurohen dhe të realizohen të drejtat e punëtorit. E drejta e punëtorit është themelimi dhe pushimi i marrëdhënies së punës, e drejta për pagën apo të ardhurat tjera (shtesat), të cilat i takojnë në bazë të ligjit apo të ndonjë akti tjetër juridik, apo kontrate mbi punën, e drejta për kohëzgjatjen e orarit të punës, për pushim apo mungesë në punë, mbrojtjen e grave, fëmijëve, invalidëve, e drejta jashtë orarit të punës apo të natës. Kështu, objekt i mbrojtjes së kësaj vepre penale janë të drejtat themelore të punëtorit të cilat rrjedhin nga puna apo marrëdhënia e punës sikurse janë cekur në dispozitën e kësaj norme penalo-juridike.

Kjo normë penale ka karakter blanket, sepse udhëzon gjithnjë në një dispozitë të një ligji të caktuar, akti juridik apo kontrate kolektive e cila është cenuar apo nuk është respektuar. Në realitet të gjitha këto të drejta të cilat mbrohen me këtë normë penalo-juridike janë të rregulluar me ligj, akte tjera nënligjore siç janë rregulloret, urdhëresat administrative dhe kontrata kolektive.

Veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale shprehet në rastet kur kryerësi me veprim ose me mos veprim ia mohon (cenon) apo ia kufizon ndonjë të drejtë që i takon punëtorit në bazë të ligjit, ndonjë akti tjetër juridik. Në realitet veprimi i kryerjes do të ishte në shkeljen e ndonjë dispozite ligjore me të cilën parashihet ndonjë e drejtë e punëtorit.

Për të ekzistuar kjo vepër penale, kryerësi duhet të veproj vetëm me dashje, ndërsa kryerës i kësaj vepre penale nuk mund të jetë çdo person, por vetëm personi i cili ka për detyrë që të kujdeset për zbatimin e ligjit dhe i cili ka mundësi të vendosi mbi të drejtat e punëtorit të cilat rrjedhin nga marrëdhënia e punës ose punës. Zakonisht këta janë personat përgjegjës apo zyrtarë, edhe pse në përkufizimin e kësaj vepre penale si

subjekt aktiv është përcaktuar “kush.” Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë edhe punëdhënësi privat.

Nëse cenimi i ndonjë të drejte nga marrëdhënia e punës bëhet për shkak të dallimit të përkatësisë së nacionale, racës, fesë, gjinisë, të një grupi tjetër etnik, gjuhës, arsimit dhe pozitës, atëherë nuk do të kemi këtë vepër penale por veprën penale, shkelje statusit të barabartë të qytetarëve të Kosovës nga neni 193. Këto vepra penale nuk mund të jenë në bashkim ideal.

VEPRAT PENALE KUNDER INTEGRITETIT SEKSUAL

Vështrime të përgjithshme.

E drejta penale bashkëkohore në deceniet e fundit ka pësuar ndryshme të mëdha lidhur me botëkuptimin se që është normale dhe që është e ndaluar në sferën e jetës seksuale. Legjislacionet penale të më hershme kanë inkriminuar dhe sanksionuar një numër të sjelljeve të kësaj sfere, pa marrë parasysh se i ka kryer individi me pëlqimin e personit tjetër apo jo. Kështu, kohë pas kohe kanë ndryshuar qëndrimet dhe sanksionet lidhur me sjelljet e caktuara të kësaj sfere të jetës intime.

Rregullativa bashkëkohore penalo-juridike më shumë kufizohet në ato sjellje të integritetit seksual të cilat ndërmerren në kundërshtim me vullnetin e tjetrit, respektivisht në ato sjellje të cilat cenojnë integritetin seksual të njeriut si pjesë përbërëse e integritetit të përgjithshëm personal dhe të lirive të njeriut e edhe të drejtës për ta zgjedh partnerin. Kjo, vetëm kur janë në pyetje personat e rritur, ndërsa kur janë në pyetje fëmijët, mbrojtja penalo-juridike është më e zgjeruar dhe më e fuqishme për mbrojtjen e integritetit seksual. Mbrojtja penalo-juridike më e theksuar është atëherë kur sjelljet e tilla kanë të bëjnë me fëmijët për arsye të pasojave që shkaktohen në zhvillimin normal, jo vetëm seksual, por edhe në zhvillimin psiko-fizik.

Dhuna seksuale është e pranishme në të gjitha shtetet e shoqërive bashkëkohore, madje edhe në ato vende me zhvillim ekonomik dhe liberalizëm demokratik. Sipas disa studimeve të cilat janë zhvilluar në Kanada, Zelandë të re, Britani të madhe, SHBA dhe në Koren Jugore është konstatuar se 8- 15% të grave janë dhunuar në moshë të re. Nëse kësaj i shtohen edhe tentim dhunimet, numri rritet deri 20-27 %. Për këtë arsye frika nga dhunimi është pjesë përbërëse e përditshmërisë së një gruaje në shumicën e vendeve të këtij rruzullit tokësor.

Në nenin 23, Kushtetuta e Republikës së Kosovës proklamon respektimin e dinjitetit të njeriut si bazë themelore i të gjitha të drejtave dhe lirive të njeriut, në nenin 26 përcakton të drejtat e integritetit personal, ku bënë pjesë edhe integriteti seksual.

Në Kodin tonë penal janë përfshirë konceptet bashkëkohore lidhur me të drejtën e njeriut që të vendosi lirisht për jetën e tij seksuale, respektivisht për dinjitetin dhe integritetin seksual. Koncepti i këtillë shprehet me emërtimin e këtij kapitulli. Kështu

objekti i përgjithshëm mbrojtës i këtyre veprave penale të parapara në këtë kapitull, është e drejta në dinjitetin dhe integritetin seksual të njeriut.

Dhunimi (Neni 230)

Vetë emërtimi i kësaj vepre penale nënkupton vepër tipike të detyrimit ndaj personit tjetër me qëllim të kryerjes së aktit seksual. Dhunimi është një ndër veprat më të rënda kundër integritetit seksual.

Forma themelore e kësaj vepre penale konsiston në detyrimin e personit tjetër për të kryer akt seksual pa pëlqimin e tij. Nga përkufizimi i kësaj vepre penale themelore, bazike, shihet se është vepër penale e përbërë(e zhdrejtë-jo e drejtë) dhe përbëhet nga detyrimi dhe akti seksual.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person pa marrë parasysh përkatësin gjinore i cili mund të jetë si kryerës i aktit seksual, ose si shtytës, ose si shtytës i personit(subjektit pasiv-viktimës) që ta kryej aktin seksual me kryerësin a me personin e tretë.

Kjo formë e kryerjes së kësaj vepre penale do të ishte kur shtytësi në një formë apo tjetër e shtytë

Vepra penale nga paragrafi 1 është vepër e përbërë e cila përbëhet nga akti seksual dhe nga ndonjë formë e detyrimit për ta kryer aktin seksual pa pëlqimin e subjektit pasiv-viktimës.

Kryerësi kësaj vepre penale është çdo person pa marrë parasysh përkatësin gjinore, në marrëdhënien martesore, në bashkëjetesë ose në ndonjë marrëdhënie tjetër e që nuk paraqet ndonjë vepër tjetër speciale.

Objekti, respektivisht subjekti pasiv i kësaj vepre penale është çdo person pa marrë parasysh përkatësin gjinore.

Vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni konsiderohet si e kryer në momentin e bashkimit të organeve seksuale apo penetrim (depertim) në cilëndo pjesë të trupit apo me hapjen anale a gjentiale me ndonjë objekt ose me cilëndo pjesë të trupit, me qëllim të shfryrjes së epsheve seksuale.

Vepra penale do të ekzistoj edhe nëse nuk shkaktohet deflorimi i femrës, sepse nuk është e rëndësishë se sa depërton organi seksual i mashkullit në rast të virginitetit të viktimës.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Dhunimi mund të kryhet edhe nga shumë persona ndaj të njejtës viktimë. Në këso raste kjo vepër penale konsiderohet formë e kualifikuar. Personat tjerë të cilët nuk e kanë kryer aktin seksual siq është përkufizuar në nenin 228 par. 3 konsiderohen shtytës, ose ndihmës.

Duke pas parasysh peshën e kësaj vepre penale dhe sanksionin e paraparë, është i dënueshëm edhe tentativa e kësaj vepre penale. Tentativa ekziston atëherë kur nuk ka ardhur deri tek akti seksual për çfarëdo arsyeje objektive përkundër faktit që kryerësi i ka ndërmarrë veprimet për ta kryer veprën e dhunimit.

Format e kualifikuara të kësaj vepre penale janë paraparë në paragrafin 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni.

Për të ekzistuar vepra penale, nga paragrafi 2 i këtij neni, kërkohet që kryesi i vë viktimës në pah se do e gjej një e keqe atë ose personin e afërt të saj, nëse ajo nuk pranon të ket mardhënie seksuale.

Format kualifikuese sipas rrethanave të kryerjes së kësaj vepre penale është paraparë në paragrafin e 3 të këtij neni.

Par. 3.1

Kush do që detyron personin tjetër për ta kryer aktin seksual *me kanosje serioze ose me kanosje për përdorim të dhunës*.

Par. 3.2

Forma kualifikuese e kësaj vepre penale parashihet në paragrafin 3 nënparagrafin 2 të këtij neni e cila përbëhet nga kërcënimi (kanosja) se do ta rrezikoj aty për aty jetën apo trupin e viktimës a të personit tjetër.

Par. 3.3

Kjo formë e kualifikuar e kësaj vepre penale, kryhet duke e shfrytëzuar një situatë në të cilinë personi është i pa mbrojtur dhe siguria e tij është në rrezik. Situatat në të cilat personi, viktima është e pa mbrojtur janë të shumta, zakonisht në rastet kur viktima gjendet në hapësira të vetmuara,(në fushë, mal, rrugica të errëta, etj).

Par. 4.

Forma tjetër e kualifikuar është parashikuar në paragrafin 4 të këtij neni i cili ka sanksionuar disa alternativa si në vujim;

Par. 4.1

Kur viktima është torturuar apo është trajtuar çnjerëzisht.

Çdo dhunim në një farë mënyre kryhet duke përdorë torturë apo trajtim çnjerëzor. Mirëpo kjo formë e kualifikuar e veprës penale duhet t'i kaloj kufijtë e zakonshëm të një torture apo sjellje çnjerëzore ndaj subjektit pasiv, kur vuajtjet fizike, psikike dhe maltretimet rëndë cenojnë dinjitetin e viktimës.

Kjo formë e veprës penale konsiderohet e kualifikuar për shkak të mënyrës së kryerjes së saj.

Par. 4. 2.

Në këtë nënparagraf parashihet forma vijuese kualifikuese e kësaj vepre penale, kur viktima në akt seksual është detyruar me forcë. Edhe kjo formë është vepër penale e përbërë, nga se përbëhet me përdorimin e forcës dhe aktit seksual. Përdorimi i forcës është veprim i ndëshkueshëm, ndërsa akti seksual si i tillë nuk është i ndëshkueshëm, për veç nëse kryhet pa vullnetin e personit tjetër.

Forca duhet të përdoret në personin ndaj të cilit kryhet akti seksual, e që mund të mposhti rezistencën e subjektit pasivë-viktimës. Kështu, forca e cila përdoret duhet të jetë e atij intensiteti sa që ta mposhti rezistencën e viktimës. Nuk do të ekzistoj kjo

vepër penale nëse viktimë pajtohet për ta kryer aktin seksual apo për ta vazhduar atë. Rezistenca duhet të jetë serioze, e vërtetë dhe e vazhdueshme.

Par. 4.3

Në nënparagrafin 4.3 është parashikuar forma e rëndë e kësaj vepre penale për shkak të pasojës që ka përjetuar viktimë- lëndime trupore ose çrregullime të rënda mendore. Nëse lëndimi i rëndë trupor ose çrregullimi i rëndë mendor është shkaktuar me dashje atëherë do të kemi bashkimin e këtyre dy veprave penale. Mirëpo, kur kemi të bëjmë me veprën penale të dhunimit dhe lëndimit të lehtë trupor sipas përkufizimit në nenin 188 të KP, atëherë në bazë të parimit të konsumimit, vepra penale e lëndimit të lehtë trupor konsumohet në veprën penale të dhunimit nga neni 230 i këtij Kodi.

Par. 4.4

Veprën penale nga ky nënparagraf e bënë të kualifikuar, përdorimii armës ose mjetit tjetër të rrezikshëm. Kjo formë e kualifikuar konsiderohet se konsumohet nëse kryerësi me qëllim të kryerje së aktit seksual, përdorë armën, kanoset se do ta përdor me armën ose ndonjë mjeti tjetër të rrezikshëm.

Par. 4.5

Kjo formë e cilësuar konsumohet kur kryesi dhunimin e kryen duke shkaktuar dehjen e personit(viktimës) me anë të alkoolit, drogës apo substancave të tjera dehëse. Në këtë rast kryerësi duhet të udhëhiqet me vetëdije se me alkool, drogë apo substanca tjera dehëse do ta vejë viktimën në aso gjendje e cila nuk do të mund t'i kontrolloj veprimet apo nuk është në gjendje që ta shprehi vullnetin për akt seksual dhe e shfrytëzon një gjendje të tillë për ta kryer aktin seksual.

Par. 4.6.

Veprën penale nga ky nënparagraf e bën cilësuese fakti se dhunimi kryhet nga më shumë persona. Nëse ndonjë nga këta nuk e kryen aktin seksual, ai mund të përgjigjet për ndonjë formë tjetër të bashkëpunimit(ndihmës shtytës ose bashkim kriminal).

Par. 4. 7.

Vepra penale nga ky nënparagraf konsumohet kur dhunimi kryhet ndaj viktimës posaçërisht të ndjeshëme, për arsye të moshës së vjetër, çrregullimit fizik a mendor, paaftësisë a shtatzënisë. Këtu na paraqitet një gjendje e posaçme e subjektit pasiv tek të cilët rezistenca për mos dhënien e pëlqimit për akt seksual është më e kufizuar, më lehtë mund të mposhtet rezistenca për mos dhënien e pëlqimit për arsye të moshës së vjetër, çrregullimeve fizike a mendore, paaftësisë a shtatzënisë(p.sh., personi invalid, personi me çrregullime mendore të kufizuara a të plot, personi i palëvizshëm, i sëmurë ashtu që i zvogëlohet aftësia dhe grat shtatzënë).

Par. 4.8.

Vepra penela nga ky nënparagraf merr primesa kualifikuse ngase kryhet ndaj viktimës me të cilën kryesi ndodhet në marrëdhënie të afërta familjare, (prindi, prindi adoptues, prindi birësues, njerku, gjyshi ose gjyshja, daja, axha, tezza, halla, vëllai ose motra më e vjetër e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet.)

Akti seksual i kryer me pëlqimin e subjektit pasiv të këtij nën paragrafi nuk paraqet këtë veprë penale por veprën penale, marrëdhëniet seksuale brenda familjes nga neni 243 të këtij Kodi.

Par. 4.9

Forma tjetër kualifikuese e veprës penale konsumohet nëse kryhet ndaj viktimës midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjeçare, me të cilën kryesi është në raporte familjare.

Par. 4. 10

Veprat penale nga paragrafi 1 ose 2 të këtij neni e marrin formën kualifikuese për shkak të cilësive që ka kryesi në raport me subjektin pasiv. Përkatësisht kjo veprë konsiderohet se ekziston nëse kryhet nga mësimdhënësi i viktimës, udhëheqësi fetar i viktimës, profesionisti i kujdesit shëndetësor, personi të cilit iu është besuar rritja apo kujdesi i viktimës, apo në ndonjë mënyrë tjetër kryesi ka autoritet ndaj viktimës.

Par. 5.

Ndërsa në paragrafin 5 të këtij neni forma kualifikuese konsiderohet se kryhet nëse nga vepra e dhunimit është shkaktuar vdekja e viktimës.

Për të ekzistuar kjo veprë penale, kryerësi ndaj pasojës më të rëndë duhet të ketë vepruar me pakujdesi, ndërsa në raport me veprën themelore (dhunimi) me dashja. Në të kundërtën, po qese kryerësi e dëshiron edhe pasojën e vdekjes së viktimës, atëherë do të kemi dy vepra penale në bashkim, veprën penale të dhunimit dhe veprën penale të vrasjes.

Degradimi i integritetit seksual (Neni 233)

Me këtë normë penalo juridike janë inkriminuar veprimet që i merr shtytësi lidhur me degradimin e integritetit seksual.

Me një inkriminim të tillë sigurohet ndjekja penale e shtytësit, pa marrë parasysh se cilës gjini i takon, i cili shtytë tjetrin t'i ekspozoj pjesët intime të trupit, të masturbojë ose të kryej një akt tjetër seksual pa pëlqimin e vetë me ç' rast degradohet integriteti seksual i tij, me qëllim që t'i kënaqi epshet e veta seksuale apo të tjetrit ose për përfitime tjera materiale. Kjo veprë penale ka karakter supsidiar, do të thotë se nuk do të ekzistoj nëse veprimet e kryerësit do të mund të inkorporohen si ndihmë të një veprë tjetër penale më të rëndë.

Karakteristikë e kësaj veprë penale është se kryerësi nuk merr pjesë vetë në kryerjen e aktit seksual apo të ndonjë veprimi tjetër seksual që kishte për ta degraduar integritetin seksual të personit tjetër. Veprimi i kryerësit të kësaj veprë penale është shtytja e cila për kah natyra mund të ushtrohet në mënyra të ndryshme, duke filluar nga përdorimi i forcës, me kanosje të drejtpërdrejt të rrezikimit të jetës dhe trupit të subjektit pasiv ose të personit tjetër, duke shfrytëzuar një situatë në të cilën personi i shtytur është i pa mbrojtur dhe siguria e tij është në rrezik, me torturë ose me trajtim çnjerëzorë, me shkaktimin lëndimeve të rënda ose çrregullime të rënda të shëndetit mendor dhe fizik, me përdorimin e armëve ose të ndonjë mjeti të rrezikshëm, duke shkaktuar dehjen e

personit me anë të alkoolit, drogës ose substancave tjera, me ushtrimin e shtytje ndaj personave që din se janë të ndjeshëm për shkak të moshës së vjetër, çrregullimit mendor ose fizik, paaftësisë ose shtatzënisë, kur vepra është kryer nga më shumë se një person, kur është prind, prind adoptues, prindi birësues, njerku, gjyshi ose gjyshja, daja, tezza, vëllai ose motra e personit dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetëvjeçare, kur kryesi është në marrëdhënie familjare me personin dhe personi i tillë është midis moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjet ose kryesi është mësimdhënës, udhëheqës fetar, profesionist i kujdesit shëndetësor, person të cilit i është besuar rritja apo kujdesi për personin e tillë ose në ndonjë mënyrë tjetër ka autoritet ndaj personit. Pra, me të gjitha mënyrat të cilat e nënshtrojnë apo e mposhtin vullnetin e personit për t'i ndërmarrë veprimet apo të kryej ndonjë akt seksual me të cilin do të degradohet integriteti seksual. ky nen ka katër paragafe me disa nënparagafe.

Mundësimi ose detyrimi në prostitucion (Neni 241)

Në bazë të një studimi të qendrës studentore” Sud- Etudiant” që është bërë në Francë, 2% e studenteve të universitetit mes moshës 19-25 vjet shesin trupin e tyre për të paguar studimet. Në Itali 3-5% italianëve janë në kërkim të bërit seks me meshkujt e vendeve në zhvillim (si psh. Senegal, Marok, dhe Kuba). Prostitucioni është paraqit në forma të ndryshme por në esencë, ka qenë i njëjtë, ka qenë i pranishëm në të gjitha fazat e historisë së njerëzimit. Andaj shumë shtete iu janë qasë legalizimit të prostitucioni për dy arsyeja : Për ta vënë nën kontroll prostitucionin si fenomen negativ shoqëror dhe e dyta për t'i evituar të gjitha dukurit tjera kriminale të cilat e përcjellin prostitucionin si të tillë.

Me konventa dhe akte të tjera ndërkombëtare janë paraparë masa për luftimin e kësaj dukurie. Një ndër të tillat është: Marrëveshja ndërkombëtare për mbrojtjen efikase nga tregtia kriminale e njohur si “Tregtia me robër të bardhë”(1910); Konventa ndërkombëtare për luftimin e tregtisë me gra dhe fëmijë(1921); Konventa për luftimin e tregtisë me gra madhore(1933) dhe Konventa për luftimin dhe ndalimin e trafikimit me njerëz dhe shfrytëzimin e prostitucionit(1950).

E drejta jonë penale nuk e inkriminon si vepër penale kur personi vet e ushtron prostitucionin. Veprimi i këtillë konsiderohet si kundërvajtje. Kodi ynë penal e inkriminon ndërmjetësimin dhe shtytjen në ushtrimin e kësaj dukurie shoqërisht të rrezikshme.

Në nenin 228 paragrafi është dhënë kuptimi i kësaj shprehje që do të thotë: ofrim ose dhënia e shërbimeve seksuale në këmbim me të holla, me mallra ose me shërbime, përfshirë, por pa u kufizuar në kryerjen e një obligimi për të paguar ose ofrimin e mallrave apo shërbimeve, përfshirë shërbimet seksuale falas apo me zbritje. Nuk është me rëndësi nëse pagesa, mallrat apo të shërbimet i janë dhënë apo premtuar personit të përfshirë në shërbime seksuale apo personit të tretë. Këtu, nuk duhet kuptuar vetëm aktin seksual por edhe prekjen me qëllime seksuale apo forma tjera të kënaqjes së epsheve seksuale.

Me prostitucion mund të nënkuptohen edhe marrëdhëniet seksuale në mesë të gjinive të njëjta.

Për të ekzistuar kjo veprë penale është i relevante se a përfiton edhe personi i cili ofron shërbime seksuale(viktima). E rëndësishë është që personi i cili ndihmon apo shtytë për prostitucion të ketë përfitime material apo ndonjë përfitim tjetër. Është e zakonshme që një pjesë të përfitimit e merr personi i cili ofron shërbimet. Prostitucionin duhet kuptuar si veprimtari i cili sjellë përfitime materiale ose përfitime tjera jo materiale. Zakonisht fitimi paguhet nga personi i cili i shfrytëzon shërbimet por mund të paguhet edhe nga personi i tretë. Fitimi zakonisht realizohet në para, por fitimi mund të realizohet edhe në forma tjera.

Në paragrafi 1 është paraparë forma themelore e kësaj vepre penale. Veprimet e kryerjes së kësaj vepre penale janë paraparë në mënyrë alternative dhe përfshin forma të ndryshme të ndihmës në ushtrimin e prostitucionit, si rekrutimi, organizimi, ndihma të ndryshme që i open personit i cili merret me prostitucion, lëshuarja e lokalit për ushtrimin e prostitucionit dhe kontrollit të personit tjetër për qëllime të prostitucionit etj.

Në paragrafin 2 është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale nëse ushtrohet brenda një rrethi prej 350 metrave nga shkolla ose mjedisi tjetër i cili përdoret nga fëmijët.

Në paragrafin 3 parashihet forma e kualifikuar për shkak të përdorimit të forcës apo kanosjes serioze ose duke mbajtur personin(viktimën) në situatë të varësisë personale a ekonomike me qëllim që ta detyroj që të merret me prostitucion. Andaj, përdorimi i forcës, kanosjes dhe shfrytëzimi i varësisë personale a ekonomike bëjnë që vepra themelore të merr atributet e veprës penale të kualifikuar.

Në paragrafin 4, është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, për shkak të moshës së viktimës -në mes të moshës gjashtëmbëdhjetë dhe tetëmbëdhjetë vjetë.

Në paragrafin 5, është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, për shkak të moshës së viktimës –nën moshëngjashtëmbëdhjetë vjetë,ndërsa në paragrafin 6.nëse viktima është nën moshën 14 vjeçare.

VEPRAT PENALE KUNDËR MARTESËS DHE FAMILJES

Vështrime të përgjithshme

Martesa dhe familja janë celulat e para të shoqërisë brenda së cilës krijohen kushtet për zhvillimin dhe edukimin normal të individit. Andaj, interesi i përgjithshëm shoqëror është që të krijohen, sigurohen dhe të zhvillohen kushtet për këtë institucion. Për këtë të drejtat nacionale penale dhe ato ndërkombëtare merren me mbrojtjen e këtij institucioni nga veprimet apo mos veprimet të cilat mund ta rrezikojnë dhe dëmtojnë këtë institucion.

E drejta ndërkombëtare me një numër aktesh e mbron këtë institucionin. Kështu në nenin 16 të Deklaratës Universale mbi të Drejtat e Njeriut, proklamohet se të gjithë madhorët kanë të drejtë të lidhin martesë dhe të themelojnë familje pa kufizimesh të përkatësisë nacionale, racore, ngjyre, dhe fetare. Në nenin 23 të Paktit Ndërkombëtarë për të Drejtat Politike dhe Qytetare thuhet:” familja është qelizë natyrore dhe themelore e secilës shoqëri dhe ka të drejtë të gëzojë mbrojtje nga shtetet dhe shteti, dhe secili ka të drejtë të lidhë martesë në pajtim me vullnetin e vet. Ngjashëm, marrëdhëniet familjare dhe martesore janë rregulluar edhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ashtu që në nenin 8 përkufizohet e drejta në respektimin e privatësisë dhe jetës familjare. Në nenin 12 rregullohet e drejta për lidhjen e martesës, ose lindjen dhe adoptimin e fëmijëve por jo edhe jetesën e përbashkët. Në pajtim me këtë Komisioni Evropian për të drejtat e njeriut ka konstatuar se shtet nuk mund tu ndalojnë të burgosurve lidhjen e martesës, por mund tu ndalojnë të martuarve apo të fejuarve të jetojnë bashku me bashkëshortët në institucionet e burgut.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 37 parasheh të drejtën në martesë dhe të drejtën që të krijoj familje në bazë të pëlqimit të lirë dhe në pajtim me ligjin. Martesa dhe zgjidhja e saj rregullohet me ligj dhe bazohet në barazinë e bashkëshortëve. Po ashtu në paragrafin 3 të këtij neni, parashihet mbrojtja e veçantë e familjes nga ana e shtetit në mënyrën e rregulluar me ligj.

Objekti mbrojtës i veprave penale të këtij kapitulli është martesa dhe familja, andaj edhe veprat penale mund të ndahen në vepra penale kundër martesës dhe vepra penale kundër familjes.

Marrja apo mbajtja e kundërligjshme e fëmijës (Neni 249)

Kujdesi, edukimi, arsimimi dhe mbajtja e fëmijës është obligim natyror, moral e posaçërisht detyrim ligjorë i prindit, prindit adoptues, kujdestarit dhe të gjithë atyre që kanë detyrim ligjor për kujdesin e fëmijëve. Andaj ligjvënësi me këtë normë penalo-juridike ka për qëllim të mbroj statusin familjar të fëmijës dhe interesin e prindërve për arsimim, edukim dhe zhvillim normal dhe të krijoj kushte të caktuar për një edukim dhe zhvillim normal nga prindërit, personave të autorizuar për at qëllim dhe institucioneve të caktuara të cilave iu besohet fëmija.

Marrja, rrëmbimi apo mbajtja e fëmijës në mënyrë kundërligjore nuk i cenon vetëm ndjenjat prindërore të personave të cilët kujdesen për te, por cenohen edhe të drejtat e fëmijës për edukim, arsimim, jetë dhe zhvillim normal.

Veprimet me të cilat kryhet kjo veprë penale janë paraparë në mënyrë alternative. Mënyra, apo forma e parë e kryerjes së kësaj veprë penale është marrja, mbajtja e kundërligjshme apo rrëmbimi i kundërligjshëm i fëmijës nga prindi, prindit adoptues, kujdestarit, institucionit ose nga personat tjerë të cilëve iu është besuar fëmija.

Shprehjet mbajtje, marrje dhe rrëmbim duhet nënkuptuar të gjitha ato veprime me të cilat shkëputet, ndërpritet ose pamundësohet ushtrimi i të drejtave të personave të autorizuar për përkujdesë ndaj fëmijës.

Marrja e fëmijës do të thotë shkëputje, ndërprerje ose pamundësimi i kundërligjshëm i personit i cili është i autorizuar të kujdeset për fëmijën, ashtu që nuk ka më mundësi faktike t'i ushtroj të drejtat që i ka me autorizim. Marrja mund të realizohet në mënyra të ndryshme, p.sh me mashtrim, me forcë, etj, por është e mundur që fëmija të merret edhe me pëlqimin e tij.

Mbajtja apo marrja e fëmijës duhet të bëhet në mënyrë kundërligjore. Mbjtja apo marrja është e kundërligjshme atëherë kur atë e bënë personi i cili nuk ka autorizim për tu kujdes për fëmijën ose ajo e drejt iu është marrë me vendimin organit të kujdestarisë ose gjykatës. P.sh., një e drejt e tillë mund t'i merret prindit i cili për shkaqe të ndryshme nuk është i përshtatshëm të kujdeset, edukoj dhe ti risi fëmijët.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë çdo person.

Edhe tek kjo formë e veprës penale kryerësi duhet të jetë i vetëdijshëm se veprimet e ndërmarra janë të kundërligjshme.

Në paragrafin 2 është paraparë një formë më e lehtë e kësaj vepre penale, kur vepra penale nga prindi, prindi adoptues, kujdestari apo personi tjetër i cili ushtron të drejtën prindërore, të cilit me vendim iu janë marrë të drejtat dhe detyrimet prindërore ndërsa fëmija iu është besuar prindit tjetër, për edukim dhe mbikëqyrje apo personit tjetër. Arsyet që ligjvënësi e ka përkufizuar si formë të lehtë janë ndjenjat natyrore të prindit ndaj fëmijës.

Formë e kualifikuar e kësaj vepre penale e paraparë në paragrafin 3 konsiderohet se ekziston nëse marrja, rrëmbimi, mbajtjen ose pengimi i ekzekutimit të vendimit kryhet për interes material apo për motive të ulëta.

Në paragrafin 4 është parashikuar forma e privilegjuar e kësaj vepre penale, kur kryerësi vullnetarisht e dorëzon fëmijën personit ose institucionit të cilit iu është besuar apo e lejon zbatimin e vendimit të detyrueshëm. Në këso raste kryerësi i këtillë mund të lirohet nga dënimi.

Keqpërdorimi apo braktisja e fëmijës(Neni 250)

Rritja, kujdesi, edukimi, shkollimi dhe krijimi i kushteve për një zhvillim normal të fëmijës është, para se gjithash, ndjenë natyrore dhe morale e prindit. Mirëpo, është edhe interes shoqëror, sepse ka raste kur prindërit ose personat tjerë me autoritet prindëror, t'i anashkalojnë, braktisin, keqtrajtojnë dhe të mos i përmbushin detyrimet veta ndaj fëmijëve. Mos përmbushja e këtyre detyrimeve nga prindi ose nga personat që kanë autoritet prindëror shkaktojnë çrregullime në edukimin, rritjen dhe zhvillimin normat të fëmijës.

Në nenin 250 janë paraparë pesë forma të kësaj vepre penale.

Forma e parë është përkufizuar në paragrafin 1 të kësaj norme. Veprimet me të cilat kryhet kjo formë e veprës penale janë paraqitë në mënyrë alternative.

Forma e veprimit të parë me të cilin kryhet kjo vepër është keqtrajtimi i fëmijës duke përdorë masa fizike a psikike.Me keqtrajtim duhet kuptuar përdorimin e masave fizike dhe mendore, p.sh., izolimi i fëmijës në një hapsin të kufizuar, mbyllja në një

dhomë, përdorimi i forcës dhe kanosjes në mënyrë sistematike ose kohë pas kohe duke i shkaktuar dhembje fizike a psikike të një intensiteti më të lartë e që nuk do të ishin lëndime trupore ose dëmtim i shëndetit. Do të ishte një sjellje e ashpër ndaj fëmijës e cila do t'i kalonte kufijtë e masave disiplinore lidhur me edukimin e tij. Keqtrajtim do të ishte një keqpërdorim i të drejtave të prindërve apo të drejtave të personave tjerë që kanë autoritet prindëror ndaj fëmijës sipas dispozitave të Ligjit mbi familjen që manifestohen në imponimin e kërkesave jo reale, të pa nevojshme dhe të pa kuptueshme me shkaktimin e dhimbjeve fizike dhe psikike.

Veprimi tjetër me të cilin kryhet kjo veprë penale nga paragrafi 1 është shkelja e detyrimit për kujdes dhe edukim nga mos përfillja e tepruar (e madhe) e fëmijës. Detyrimet për kujdes dhe edukim të prindit, prindit adoptues, kujdestarit apo personit tjetër që ushtron autoritet prindëror burojnë nga dispozitat e Ligjit mbi familjen e që kanë të bëjnë me sigurimin e ushqimit, veshmbathjes, banimit, kujdesit shëndetësor dhe të gjitha masat tjera të nevojshme për zhvillimin dhe edukimin normal e të socializmit pozitiv të fëmijës.

Subjekti pasiv i kësaj veprë penale është fëmija i moshës deri tetëmbëdhjetë vjet. Nëse me ligjin mbi familjen subjektit pasiv i caktohet kujdesi prindëror edhe pas moshës tetëmbëdhjetë vjet ai mund të jetë subjekt pasiv i kësaj veprë penale.

Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Në paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar forma e veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni e cila kryhet me pakujdesi të vetëdijshme.

Në paragrafin 3 të këtij neni është parapa forma tjetër e kësaj veprë penale e cila kryhet në rastet e braktisjes së fëmiut në at mënyrë që i rrezikohet jeta apo i dëmtohet rënd shëndeti i tij. Me braktisje duhet nënkuptuar situatën kur prindi apo personit tjetër i cili ka autoritet prindëror heçë dorë nga detyrimet e veta ndaj fëmijës, me që rast i rrezikohet jeta apo i dëmtohet rënd shëndeti fëmijës, psh., nëna e lenë foshnjën në rrugicë, pyll, arë, varreza, podrum e vende tjera me ç' rast i rrezikohet jeta apo i dëmtohet shëndeti foshnjës së tillë, ose, në rastet kur prind largohet nga shtëpia e nuk dërgon mjete financiar e bashkëshorti tjetër ka vështirësi materiale dhe për këtë fëmijës i rrezikohet jeta apo i dëmtohet shëndeti rënd.

Në paragrafin 4 është inkriminuar rasti kur fëmiu detyrohet të punojë në mënyrë të tepruar ose të bëjë punë që nuk është e përshtatshme për moshën e fëmijës, e detyron fëmijën e tillë të lypë për para ose për dobi tjetër materiale ose detyron fëmijën e tillë të bëjë veprime që e dëmtojnë zhvillimin e fëmijës.

Me paragrafin 5 është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj veprë penale e cila konsiderohet se ekziston nëse është shkaktuar lëndim i rëndë i shëndetit mendor apo fizik të fëmijës. Kryerësi i kësaj veprë penale në raport me lëndimin e rëndë të shëndetit mendor dhe fizik duhet të veproi me pakujdesia.

VEPRAT PENALE KUNDER SHENDETIT PUBLIKE

Vështrime të përgjithshme

Në këtë kapitull janë sistemuar veprat penale të cilat për objekt të përbashkët mbrojtës e kanë shëndetin e njerëzve dhe të personit veç e veç. Disa nga këto vepra penale janë vepra penale të posaçme dhe si kryes mund të jetë vetëm mjeku, mjeku i stomatologjisë, veterinari, apo personat e autorizuar të veprimtarisë veterinare dhe personat tjerë shëndetësor.

Trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor (Neni 260)

Shëndeti publik mbrohet edhe nga trajtimi i pa ndërgjegjshëm mjekësor. Ligdhënësi, nën kushtet e caktuar ka paraparë përgjegjësin penale për mjekimin e pandërgjegjshëm, respektivisht për përdorimin e mjetit apo metodës së pa përshtatshme të mjekimit, për mos përdorimin e masave përkatëse higjienike.

Veprimet me të cilat mund të kryhet kjo vepër penale nga paragrafi 1. janë paraparë në mënyrë alternative edhe atë si: përdorim haptas të mjetit apo metodës së pa përshtatshme të mjekimit; apo mos përdorimin e masave përkatëse higjienike.

Veprimet apo mos veprimet e cekura duhet të jenë në kundërshtim me mjetet, metodat, masat përkatëse higjienike të parapara me rregullat dhe standardet e përvetësuara të mjekësisë apo të përcaktuara me dispozitat shëndetësore. Andaj, edhe kjo normë ka karakter blanket sepse udhëzon në ndonjë dispozitë shëndetësore ose rregull apo standard të përvetësuar në mjekësi me rastin e dhënies së ndihmës ose trajtimit shëndetësor.

Vepra penale nga paragrafi 1. kryhet në rastet kur përdoren haptas mjete apo metoda të papërshtatshme të mjekimit ose mos përdorimi i masave përkatëse higjienike nga ana e mjekut ose mjekut stomatolog gjatë aktivitetit të tyre dhe me këtë rast shkakton keqësimin e gjendjes shëndetësore të personit.

Mospërdorimi i masave përkatëse higjienike nga ana e mjekut gjatë diagnostifikimit ose me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore do të ishte kur në rastin konkret mjeku nuk i përdor masat përkatëse higjienike të cilat sipas rregullave mjekësore dhe praktikës do të duhej t'i përdorte dhe për këtë shkak është keqësuar gjendja shëndetësore e personit. Masat e tillë do të ishin p.sh., dezinfektimi i hapësirës ku intervenohet, duarve, rrabeve, sterilizimi i instrumenteve dhe materialit tjetër mjekësor, dezinfektimin e pjesës së trupit të pacientit ku intervenohet etj.

Vepra penale në fjalë zakonisht kryhet me mosveprim, por mund të kryhet edhe me veprim në rastet kur masat përkatëse për kah cilësia dhe mënyra, përdoren në kundërshtim me rregullat mjekësore ose praktikën mjekësore.

Pasoja e kësaj vepre penale konsiston në keqësimin e gjendjes shëndetësore e cila nënkuptohet si keqësim i sëmundjes ose si dëmtim i shëndetit të personit.

Subjekt pasiv i kësaj vepre penale është çdo person.

Për të ekzistuar vepra penale gjithnjë duhet të ekzistoj lidhja shkakësore në mes të veprimit me të cilin kryhet vepra penale dhe shkaktimit të pasojës, keqësimit të gjendjes shëndetësore, nëse lidhja shkakësore mungon, atëherë nuk ekziston kjo vepër penale.

Kryerës i veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni mund të jetë vetëm mjeku ose stomatologu.

Vepra penale mund të kryhet me dashje.

Vepra kryhet me dashje atëherë kur mjekut me vetë dije përdorë mjete ose metoda të mjekimit haptas në kundërshtim me dispozitat e mjekësisë me standardet dhe rregullat e mjekësisë të përvetësuara nga praktika mjekësore apo nuk përdorë masa adekuate higjienike, ndërsa ndaj pasojës (shkaktimi i keqësimit shëndetësor) vepron nga pakujdesia.

Në paragrafin 2 të këtij neni është paraparë forma tjetër e kryerjes së kësaj vepre penale e cila kryhet me të njëjtat veprimet si vepra penale nga paragrafi 1 i këtij neni, vetëm me dallimin se këtu kryes na paraqitet punonjësi shëndetësor.

Kryerës i kësaj vepre penale (par. 2) është secili punonjës shëndetësor i cili ka përgatitje shkollore të lëmisë së mjekësisë (fakulteti, shkolla e lart ose e mesme).

Lidhur me fajësinë, kjo vepër penale mund të kryhet me dashje dhe nga pakujdesia. Dashja duhet të përfshijë vetëdijen se me rastin e dhënies së ndihmës mjekësore ose trajtimit shëndetësor veprohet në mënyrë të pandërgjegjshme dhe se për këtë arsye mund të keqësohet gjendja shëndetësore e personit. E njëjta vlen edhe në rast të përdorimit të mjetit të pa përshtatshëm, apo metodës së pa përshtatshme.

Vepra penale mund të kryhet me dashje apo nga pakujdesia. Lidhur me dashjen, veçmas duhet të theksohet se kjo vepër mund të kryhet vetëm me dashje eventuale. Në të kundërtën, nëse konsiderohet se kjo vepër penale është kryer me dashje direkte, atëherë nuk do të konsiderohet se ekziston kjo vepër penale, por vepra e caktuar penale kundër jetës dhe trupit.

Format e kualifikuara të kësaj vepre penale janë paraparë në par. 4 dhe 5 të këtij neni.

Format kualifikuese të kësaj vepre penale ekzistojnë nëse për shkak të veprave penale nga par 1, 2 shkaktohet lëndim i rënd trupor ose çfarëdo dëmtimi të rënd trupor apo vdekja e një ose më shumë personave.

Kjo vepër penale do të ekzistoj edhe në rastet kur mjeku vepron në mënyrë të pandërgjegjshme me rastin e trajtimit të personit të sëmurë rënd pa shans të shërimit. Kjo është edhe në kundërshtim me dispozitat e etikës së mjekut ngase nuk është e lejuar të eksperimentohet ose për shkaqe humane ti mohohet trajtimi mjekësor në mënyrë që t'i shkurtohen vuajtjet.

MOSDHËNIA E NDIHMËS MJEKËSORE (NENI 261)

Sipas Ligjit për Shëndetësinë çdo qytetar ka të drejtë në ndihmën e nevojshme mjekësore në kohën kur ajo është e nevojshme. Detyra e mjekut është që ta ofrojë at ndihmë, ngase një detyrë e tillë, jo vetëm se është obligim ligjor por buron edhe nga vetë natyra e profesionit të tillë dhe të drejtës kushtetuese e ligjore të qytetarit.

Veprimi me të cilin kryhet kjo vepra penale nga par.1janë; *mos dhënie e ndihmës së nevojshme mjekësore personit të cilit i nevojitet*. Mos dhënia e ndihmës mjekësore manifestohet me *refuzimin e një kërkesë të tillë* si dhe me *mos marrjen në konsideratë të një kërkesë të tillë*, duke u shtirë se nuk dëgjon ose nuk sheh dhe nuk vepron me vetë iniciativë.

Vepra penale do të ekzistoj edhe në rastin kur mjeku refuzon të ofroj ndihmën mjekësore për shkak të jo kompetencës territoriale ose të organizimit të brendshëm të sistemit shëndetësor duke e udhëzuar që ai të paraqitet në një ambulancë ose spital tjetër shëndetësor. Mirëpo, mos dhënia e ndihmës mjekësore do të paraqes veprim inkriminues, vetëm nëse mjeku ka pas mundësi për ta afruar at ndihmë mjekësore. A ka mund mjeku ta ofroj ndihmën e duhur është çështje faktike.(p.sh., me çfarë mjetesh ose pajisje medicinale ka disponuar mjeku në kohën e duhur, a ka qenë mjeku i aftë në pikëpamje shëndetësore ta afroje at ndihmë etj).

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm mjeku. Sipas kuptimit të këtij inkriminimi kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë secili mjek, do të thotë personi i cili ka mbaruar fakultetin e mjekësisë ose të stomatologjisë, pa marrë përsyshë a e ushtron aktivitetin e mjekut apo jo.

Me paragrafin 2 të këtij neni është paraparë forma e kualifikuar e veprës penale, e cila konsiderohet se kryhet nëse rezulton me lëndim të rëndë të trupor ose dëmtim të rëndë të shëndetit.

Paragrafi 3 parasheh, po ashtu formë të kualifikuar të veprës penale nga paragrafi 1 i këtij neni, nëse kjo vepër rezulton me vdekjen e personit të cilit nuk iu është ofruar ndihma mjekësore.

VEPRAT PENALE KUNDER EKONOMISË

Vështrime të përgjithshme

Marrëdhëniet e ndërlikuara në kushtet bashkëkohor të zhvillimit ekonomik e posaçërisht të vendeve në tranëzicion dhe synimi i kyçjes në ekonomin e lirë globale me vendet e zhvilluara, bëjnë që rregullativa juridike të kësaj fushe dhe mbrojtja ligjore të jenë sa ma efikase dhe e justifikueshme. Inkriminimet e parapara në këtë kapitull duhet të jenë në harmoni me trendet dhe zhvillimet ekonomike e teknologjike të vendeve të Bashkimit Evropian dhe më gjerë. Kjo, jo vetëm për shkak të rëndësisë së veçantë që

ka ekonomia për një shtet, por edhe për shkak të synimit të Republikës së Kosovës që të jetë anëtare e Bashkimit Evropian.

Secili shtet krijon politika zhvillimore ekonomike dhe synon që t'i realizoj ato synime në mënyrën më të mirë të mundshme me qëllim të përmbushjes së nevojave materiale dhe nevojave të tjera të qytetarëve e mbarë shoqërisë, andaj këto rregulla ligjore janë shumë të ndryshme, varësisht nga politikat zhvillimore të një vendi. Prandaj, është e kuptueshme se edhe format e cenimit apo të dëmtimit të interesit ekonomik të një vendi janë të ndryshme dhe marrin karakter të veprimeve kriminale të cilat sanksionohen me dispozitat e Kodit Penal, të delikteve ekonomike dhe kundërvajtjes, ngase disa veprime të kundërligjshme në lëmin e ekonomisë konsiderohen si delikte ekonomike apo kundërvajtje.

Për shkak të ndërlikshmërisë së ekonomisë, kushtëzohen edhe nevojat për zgjedhjet e përshtatshme juridike në lëmin e mbrojtjes penale nga këto delikte e që si pasoj kanë karakteristika të posaçme në të drejtën pozitive penale të kësaj materie. Për këtë arsye në masë të konsiderueshme quhen edhe si e drejta ekonomike penale. Në shkencën e së drejtës penale e drejta ekonomike penale fiton një interesim të veçantë në të drejtën penale bashkëkohore, prandaj në sistemimin e të drejtës penale zënë kapitull të veçantë.

Tregtia e ndaluar (Neni 305)

Tregtia është një ndër degët e ekonomisë dhe paraqet veprimtari ekonomike e cila është e rëndësishme për ekonomin e secilit vend. Me këtë inkriminim mbrohet tregtia e ligjshme, andaj nëse tregtia e mallrave të caktuara me ligj bëhet në mënyrë të kundërligjshme konsiderohet tregti e palejuar, përkatësisht konsiderohet vepër penale.

Dispozita nga paragrafi 1 i këtij neni ka karakter blanket(udhëzues) ngase udhëzon tek dispozitat e caktuara ligjore, se cilat mallra apo sende janë të lejuara për tregti ose lejohen me leje të posaçme.

Forma themelore e kësaj vepre penale kryhet me disa mënyra. Veprimet e kryerjes janë paraparë në formë alternative dhe atë: a) *shitja*, b) *blerja* dhe c) *shkëmbimi i mallrave,pa autorizim*.

Kjo formë e veprës penale konsiderohet se është kryer nëse është ndërmarrë njëra nga këto veprime. Andaj, nuk kërkohet që kryerësi të jetë marrë me tregtinë e këtyre mallrave apo sendeve. Kjo vepër penale konsiderohet e kryer edhe në rastin kur bëhet vetëm një blerje, shitje apo shkëmbimi i mallit. Në rastet kur për një periudhë të caktuar kryerësi është marrë me shitblerjen apo me shkëmbimin e mallrave apo sendeve të këtilla, do të konsiderohet se është kryer një vepër penale e vazhduar.

Lidhur me fajësinë, kjo vepër penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Objekti i kësaj vepre penale janë mallrat, sendet dhe shërbimet.

Në paragrafin 2 është paraparë forma e kualifikuar e kësaj vepre penale e cila konsiderohet se kryhet në rastet kur organizohet rrjeti i stërshitësve ose ndërmjetësuesve apo me vepër është realizuar përfitim pasuror mbi 15.000 euro. Kjo formë e veprës së kualifikuar penale kryhet vetëm me dashje.

Sipas paragrafi 3, malli dhe sendet e tregtisë së ndaluar duhet të konfiskohen.

Prodhimi i ndaluar (Neni 306)

Me këtë veprë penale shtrihet mbrojtja juridiko penale prodhimit të ligjshëm të mallit, ndërsa ndëshkohet prodhimi ose përpunimi i prodhimit të ndaluar. Edhe kjo normë penale është e karakterit blanket- udhëzues sikurse edhe vepra penale e tregtisë së pa lejuar.

Veprimi me të cilin kryhet kjo veprë penale është *prodhimi* i pa autorizuar ose *përpunimi* i mallit të ndaluar. Me prodhim në kuptim të kësaj veprë nënkuptojmë, *krijimin, prodhimin* e ndonjë malli nga lëndët natyrore apo sintetike. Ndërsa *përpunimi*, gjithashtu është një formë prodhimi, ashtu që nga një mall duke shtuar ose zbrit disa përmbajtës ai mall ndryshon, fitohet mall i ri me kualitet tjetër. Malli prodhohet për tu vënë në qarkullim, mirëpo vepra penale ekziston me vetë faktin e prodhimit apo përpunimit pa marrë parasysh a është vënë në qarkullim.

Ndalimi i prodhimit të tillë është i bazuar në dispozita ligjore përkatëse. P.sh., ndalimi i prodhimit të helmeve, armëve, drogave etj.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person. Kjo veprë penale mund të kryhet vetëm me dashje, ku përfshihet edhe vetëdija për prodhimin e ndaluar apo përpunimit të mallit.

Në paragrafin 2. parashihet se mallrat dhe sendet nga tregëtia e ndaluar konfiskohen.

Kontrabandimi i mallrave(317)

Në shumicën e shteteve aktuale kjo veprë është paraparë në Ligjin e Doganor, sepse eksporti dhe importi i mallrave i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore, kontrollit dhe me këtë veprë penale sanksionohen veprimet e kalimit ilegal të mallrave brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës, respektivisht fshehjen e mallit i cili i nënshtrohet doganimit.

Në paragrafin 1 janë paraparë dy mënyra alternative të kryerjes së kësaj veprë penale: a) duke kaluar vijën kufitare bart mallra dhe shmang kontrollin doganor; b) duke shmangur kontrollin doganor, kryen bartjen e mallit dhe kalon vijën kufitare.

- a) *Mënyra e parë e kësaj veprë penale kryhet me bartjen e mallit përtej vijës kufitare dhe shmang kontrollin doganor. Siç shihet, kjo mënyrë e kryerjes së kësaj veprë penale kryhet me veprime kumulative dhe nëse mungon njëri veprim nuk do të ekzistoj vepra penale. Kjo mënyrë e kësaj veprë penale kryhet me bartje të mallit përtej kufirit të Republikës së Kosovës dhe njëheri i shmangët kontrollit doganor.*
- b) *Mënyra e dytë e kësaj veprë penale është e kundërta e mënyrë së parë, gjegjësisht duke iu shmangur kontrollit doganor e bartë mallin përtej vijës kufitare. Edhe tek kjo mënyrë vepra kryhet me dy veprime kumulative ashtu që duke iu shmangë kontrollit doganor e kalon vijën kufitare. Veprimet e kryerjes janë shmangia nga kontrolli doganor dhe kalimi i vijës kufitare. Nëse nuk ekziston njeri veprim kjo formë e veprës penale nuk do të ekzistoj.*

Shmangia e kontrollit doganor do të thotë fshehja apo mos lajmërimi i mallit për kontroll –doganim (“shferc”, kontraband). Me Kodin Doganor është paraparë detyrimi i personit që kontrollit doganor t’ia paraqes të gjithë dokumentacionin, shënimet dhe të tjerat të dhëna që janë të nevojshme për shërbimin doganor.

Ndërsa me bartje nënkuptojmë kalimin e çfarëdo malli përtej vijës kufitare e cila është një vijë e menduar e cila e ndanë territorin e Republikës së Kosovës me vendet tjera të cilat e rrethojnë pa mbikëqyrjen doganore. Mbikëqyrja doganore përfshinë masat e përgjithshme të cilat i ndërmerr shërbimi doganor për ti zbatuar dispozitat e ligjit doganor dhe ligjet tjera të cilat aplikohen lidhur me mallin i cili është objekt i mbikëqyrjes doganore.

Mallrat të cilat i nënshtrohen doganës konsiderohen të gjitha sendet të cilat e kalojnë zonën doganore, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Kosovës. Mallra doganore konsiderohen: Kafshët, energjia elektrike, gazi, tubacionet e naftës, nafta, sendet të cilat kanë mbërrirë në doganë me cilën do mënyrë dhe të cilat sipas ligjit i nënshtrohen doganimit. Si sende të cilat sipas ligjit nuk konsiderohen mallra doganore janë: Dokumentet personale, dërgesat postare deri në një vlerë të caktuar apo nuk përmbajnë mallra të cilat i nënshtrohen doganimit, korrespondenca tregtare, librat afariste, dokumentet financiare, çeqet, kambialet etj.

Vepra penale konsiderohet e kryer me ndërmarrjen veprimit për ta bartë mallin përtej kufirit duke iu shmang kontrollit doganor ose i shmanget kontrollit doganor dhe bart mallin duke kaluar vijën kufitare për eksport. Bartja e mallit të kontrabanduar në mënyrë ilegale brenda apo jashtë vijës doganore, do të thotë kur në mënyra të ndryshme futet malli ilegalisht përmes vendkalimeve zyrtare doganore me ç’rast malli nuk lajmërohet ose kur malli futet në territorin e Republikës së Kosovës jashtë vendkalimeve zyrtare në mënyrë ilegale, me qëllim që t’i shmanget kontrollit të procedurave doganore.

Malli si objekt me të cilin kryhet kjo vepër penale mund të jetë me prejardhje vendore apo të huaj.

Këtë vepër penale mund ta kryej çdo person i cili me rastin e kalimit të kufirit nuk e lajmëron punëtorin e doganës për mallin i cili duhet të doganohet, pa marr parasysh se e ka kaluar vijën doganore në vendin e caktuar apo jo, e fsheh apo nuk e ka fsheh mallin, a e ka pyetur paraprakisht personeli doganor apo jo se a ka mall për doganim dhe a e ka shikuar mallin.

Vepra penale kryhet me dashje direkte. Dashja përfshin vetëdijen e kryerësit për bartjen e mallit pa mbikëqyrjen doganore.

Vjedhja(Neni 325)

Objekti mbrojtës i kësaj vepre penale është pasuria e luajtshme. Legjislacionet tjera penale tek përkufizimi i kësaj vepre penale e përdorin shprehjen send e jo pasuri. Edhe legjislacioni ynë në nenin 325 e përdorë shprehjen pasuri.

Sipas inkriminimit të paraparë në këtë nen, si vepër penale e vjedhjes duhet kuptuar pasurinë e cila vlerësohet prej 50 e më shumë Euro. Si pasuri mund të konsiderohet sendi i luajtshëm i cili mund ta ndërroj pozitën në hapësirë dhe me atë rast nuk e ndryshon gjendjen e as strukturën e brendshme.

Me send nënkuptojmë edhe çdo energji të prodhuar apo akumuluar e cila përdoret për dritë, nxehtësi dhe lëvizje. Po ashtu me send duhet nënkuptuar edhe impulset telefonike. Përveç që sendi duhet të jetë i luajtshëm ai duhet të jetë i natyrës materiale(përfshirë edhe shtazët) dhe të ketë vlerën përdoruese, vlerën se është i huaj dhe gjendet në mbajtje(detencion) të huaj dhe mund të jetë objekt i të drejtës pronësore në kuptim të së drejtës pasurore. Sendi mund të jetë në gjendje të ngurtë, të lëngët dhe gjendje të gazit. Nuk mund të konsiderohen si sende ato pjesë të materies të cilat nuk mund të kontrollohen nga njeriu, si p.sh., ajri atmosferik, nxehtësia e diellit, elektriciteti i lirë natyror, shtresat atmosferike, shiu, bora etj.

Gjithashtu objekt i vjedhjes mund të jenë pjesët e sendeve të cilat sipas së drejtës civile konsiderohen si të paluajtshme. P.sh., një pjesë e një makine e cila mund të ndahet, sendet që gjenden në tokë (thëngjilli, gurët etj.) dhe mbi tokë(frytet), pjesët përbërëse të shtëpive, ndërtesave (dritaret, dyert etj.).

Për ekzistimin e veprës penale nuk është e rëndësishme se sendi i luajtshëm është mënjeluar nga sendi i paluajtshëm apo është mënjeluar nga sendi i luajtshëm para kryerjes së veprës penale ose sendi është mënjeluar me rastin marrjes. Së këndejmi send nuk mund të konsiderohet ai send i cili nuk është në pushtetin e njeriut dhe as që mund të jenë në pronësi të as kujt. Por, nëse ndonjë send, material mund të vihet nën kontrollin e njeriut dhe me atë të pronësohet, atëherë mund të konsiderohet si send, dhe të jetë objekt i vjedhjes. P.sh., ajri nën shtypje, uji i detit, uji i shiut në cisterna, akulli i mbledhur në ftohës e edhe gjithë energjia e prodhuar apo e mbledhur që shërben për ndriçim, nxehtësi dhe lëvizje.

Njeriu nuk mund të konsiderohet si send për deri sa është i gjallë, por pjesët e trupit(gjymtyrët) nëse ndahen nga trupi konsiderohen si send i luajtshëm dhe kanë ndonjë vlerë, atëherë mund të jenë objekt i vjedhjes. P.sh., flokët për prodhimin e perikave të cilat shiten në treg për përdorim, ndonjë gjymtyrë tjetër e cila ka ndonjë vlerë qarkulluese.

Kufoma e njeriu nuk mund të konsiderohet si send po qe se nuk kanë ndonjë vlerë anatomike, shkencore, dhe çfarë do vlere tjetër lidhur me transplantimin ose të ndonjë vlere tjetër pronësore. P.sh., marrja e veshkave, zemrës, dhëmbëve të veshur me ari, argjend, proteza të syrit e sende tjera të vendosura në organizmin e njeriut mund të jenë sende të vjedhjes. Posaçërisht, sendet e vjedhjes mund të jenë rrobet dhe sendet tjera me vlerë të cilat gjenden në dhe me kufomën ngase ato janë pronë e trashëgimtarëve e nëse nuk ka trashëgimtar janë pronë shoqërore- komunale komform me dispozitat e

ligjit mbi trashëgimin. Është qëndrim juridik se sendet e kufomës në varrë janë sendet e vjedhjes ngase nuk janë të hedhura të lëna pas dore, por janë sende të trashëgimtarit dhe janë në detencionin e tij, e nëse trashëgimtari vdes sendet kalojnë në pronë shoqërore. Me shprehjen detencion nënkuptojmë mbajtjen e sendit me dashje.

Objekt i vjedhjes mund të jenë edhe dokumentet e ndryshme në bazë të cilave mund të fitohen të drejta pronësore (vërtetimi për dhënien e sendit në ruajtje në gardëroba, për pastrim kimik, për transport-lista përcjellëse, listë-ngarkesa etj). Pastaj edhe letrat me vlerë mund të jenë objekt i kësaj veprë penale, p.sh., çeku, libreza e kursimit, fletë-obligimi mbi huan, kambiali, biletat e ndryshme sportive apo të artit që kanë vlerë etj. Nga gjithë kjo që thuhet rrjedhë se shprehja “pasuri e luajtshme” ndoshta është shprehja ma adekuate e përdorur në figurën e kësaj veprë penale.

Mashtrimi (336)

Kodi i ri penal për dallim nga kodi i vjetër (neni 261) që kishte vetëm dy (2) paragrafe, parasheh gjashtë (6) paragrafë dhe përveç paragrafit gjashtë (6), për të gjitha format tjera të veprës penale, parasheh shqiptimin e dënimit kumulativ ; me gjobë dhe me burgim.

Legjislacion ynë penal parashikon një numër të madh inkriminimesh që kanë për bazë veprime mashtruese, të cilat, sipas disa elementeve të veçanta, klasifikohen në grupe të ndryshme të veprave penale. Përpos kësaj forme të mashtrimit, në këtë kapitull ekziston edhe mashtrimi lidhur me subvencionet, neni 336 (262) dhe mashtrimi lidhur me pranimin e fondeve nga Komuniteti Evropian, neni 337, ndërsa në grupet tjera të veprave gjenden, p.sh., të ashtuquajturat skema piramidale, paraqitja e llogarisë së rrejshme te veprat penale mashtrimi në detyrë, përdorimi i dokumentit të rrejshëm në komunikimin juridik, (falsifikimi i dokumentit); dhënia e të dhënave të rrejshme për të ardhurat e realizuara ligjore te vepra penale fshehja e tatimit etj.

Kjo vepër penale e mashtrimit ka të bëjë me mashtrimin pasuror dhe është e orientuar kundër pasurisë në përgjithësi, përkatësisht kundër të drejtave dhe interesave pasurore dhe paraqet veprën e përgjithshme të mashtrimit, e cila është subsidiare në raport me format e tjera të përmendura të mashtrimit.

Shfrytëzimi i mashtrimit për realizimin e dobisë pasurore është një dukuri e shpeshtë në sjelljen e njerëzve, e cila nganjëherë prodhon vetëm pasoja civile – juridike, por fatkeqësisht jo rrallë paraqitet edhe si vepër penale. Të gjitha veprat penale të mashtrimit sot janë në ekspansion me modalitete të sofistikuara të kryerjes dhe në forma të reja të paraqitjes së tyre. Veprat penale të mashtrimit që lidhen me pasurinë nuk paraqesin vetëm sulm mbi pasurinë, por edhe mbi aftësinë psikike dhe intelektuale, si vlerë e veçantë personale dhe si atak i sigurisë në komunikimin juridik. Kështu, viktimat e mashtrimit shpesh thonë se nuk u vjen keq që janë dëmtuar, por që janë mashtruar dhe kjo lë të kuptohet se te mashtrimi pasuria nuk duhet të ketë çdoherë rëndësi primare. Një veti specifike e këtyre veprave penale qëndron në karakterin e raporteve mes kryerësit të veprës penale dhe viktimës. Viktima nuk është e vetëdijshme

se ai është vetëm instrument në duart e kryerësit, i cili zbaton lojën e tij mashtruese për realizimin e qëllimit përfitues.

Mashtrimi është një veprë penale e orientuar kundër pasurisë (së luajtshme dhe të paluajtshme), duke përfshirë edhe të drejtat dhe interesat pasurore.

Veprimi i kryerjes së kësaj veprë penale qëndron në paraqitjen e rrejtshme të fakteve a duke i fshehur faktet.

Me paraqitjen e rrejtshme të fakteve nënkuptohet pohimi për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, përkatësisht paraqitja e fakteve ndryshe nga ajo që vërtet ekziston, (ajo që ekziston tregohet jo saktësisht). Fshehja e fakteve ekziston kur kryerësi ndonjë person e mashtron për mosekzistimin e fakteve ekzistuese apo e hesht ekzistimin e tyre, përkatësisht përmbajtjen e tyre, nëse ka ekzistuar detyrimi i tij që ato fakte t'i tregonte. Nga kjo rezulton se mashtrimi mund të kryhet edhe me mosveprim. Ndërkaq, te tregimi i rrejtshëm, kryerësi e bind ndonjë person për ekzistimin e ndonjë fakti që nuk ekziston, d.m.th., te fshehja ai pengon personin që t'i mësojë faktet që vërtet ekzistojnë e të cilat janë relevante për pasjen në dispozicion të pasurisë së tij dhe pasurisë së huaj dhe të cilat do ta zmbropsin nga pasojat e dëmshme në raport me këtë pasuri.

Veprimi me të cilin personi i mashtruar shtyhet dhe me të cilin ai e dëmton pasurinë e tij apo pasurinë e tjetrit, mund të jetë veprim apo mosveprim. Personi i mashtruar me mosveprim e dëmton pasurinë me humbje të mundësisë për të ndërmarrë diçka me cilën do ta kishte shmangur dëmin që i kërcënohej pasurisë, (personi i mashtruar humb mundësinë që ndaj debitorit të parashtrrojë me kohë padi). Ndërkaq ndërmerr veprim me të cilin e dëmton pasurinë, por duke u ndodhur në lajthim, pa qenë i vetëdijshëm se çfarë pasojash për pasurinë mund të rezultojnë nga veprimi i ndërmarrë.

Mashtrimi mund të kryhet si ndaj personave fizikë, ashtu edhe ndaj personave juridikë, organeve shtetërore në procedura administrative dhe procedura të tjera.

Me një veprim të tillë, personit të mashtruar mund t'i dëmtohen të drejtat pasurore ose interesat pasurore, ndërsa te interesat që nuk kanë karakter pasuror kjo nuk ndodh, (p.sh., interesat personale familjare etj), sepse vepra penale e mashtrimit është veprë penale kundër pasurisë. Veprimi të cilin e ndërmerr personi i mashtruar duhet të shkaktojnë dëmtimin - zvogëlimin e pasurisë së personit të mashtruar apo pasurisë së dikujt tjetër.

Pasoja e kësaj veprë penale qëndron në dëmtimin e pasurisë që kushtëzohet drejtpërsëdrejti nga veprimi i personit të mashtruar, ndërsa indirekt nga veprimi i mashtruesit. Pasoja e tillë mund të qëndrojë në çdo zvogëlim të pasurisë, si në zvogëlimin e aktivitetit apo në rritjen e pasivitetit; pasoja mund të shkaktohet edhe si humbje e fitimit vetëm kur ekziston një kërkesë e bazuar juridike që fitimi të realizohet, por jo edhe kur një fitim i tillë vetëm është i mundshëm.

Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale (345)

Kemi të bëjmë me fshehjen e cila, sipas natyrës së saj, është aksesore, ngase prezumon një veprë tjetër, e cila kryhet dhe vazhdon pas të parës (auxilium post delictum). Me veprën e fshehjes përkrahet dhe vazhdohet gjendja e kundërligjshme, e cila është krijuar me veprën e mëparshme. Ajo lidhet objektivisht me veprën e mëparshme, por, në kuptimin penalo-juridik, nuk paraqet bashkëpjesëmarrje, ngase ndërmerret pas përfundimit të veprës së mëparshme. Mirëpo, nëse fshehja ka qenë paraprakisht e premtuar, kryerësi i fshehjes do të jetë ndihmës, (rastet e ndihmës psikologjike), në veprën e mëparshme, (p.sh., të vjedhjes), dhe do të përgjigjet për bashkëpjesëmarrje për atë veprë (nuk ka bashkim me veprën penale të fshehjes).

Esenca e veprës është pranimi apo fshehja e sendit, i cili është vënë në dorë me kryerjen e veprës penale. Ajo mund të paraqitet në dy forma: a) pranimi i mallrave të vjedhura (fshehja e sendit) për të cilin dihet se është fituar me veprë penale dhe b) pranimi i mallrave të vjedhura (fshehja e sendit) prejardhja e të cilit nuk është e njohur për kryerësin.

Forma themelore e veprës (par. 1) ekziston kur dikush sendin, për të cilin e di se është përfituar me veprë penale ose atë që është fituar me një send të tillë të shitur apo të këmbyer, e blen, e pranon si hipotekë apo në ndonjë mënyrë tjetër e siguron ose e fsheh.

Objekt i veprës penale janë sendet që janë fituar me veprë penale ose ajo që është fituar me shitjen apo këmbimin e sendeve të tilla. Fjalën send këtu duhet kuptuar në një formë më të gjerë sesa të vepra penale e vjedhjes, ngase këtu, përpos sendeve të luajtshme, përfshihen edhe sendet e paluajtshme të fituara me veprë penale (p.sh., shtëpia apo toka e fituar me veprën penale të fajdesë), si dhe sendi që është vënë në dorë me shitjen, këmbimin apo përpunimin e sendit të fituar me veprë penale, (ari, argjendi, valuta e huaj apo ndonjë send tjetër i blerë me para të vjedhura). Është e domosdoshme që sendi të jetë fituar me veprë penale e jo me ndonjë veprim tjetër të ndëshkueshëm, siç është delikti ekonomik apo kundërvajtja. Kontestuese është se a mund të jetë çdo veprë penale me të cilën kryerësi mund të përfitojë ndonjë send, apo vetëm veprat kundër pasurisë. Natyra e veprës penale të fshehjes më tepër i përgjigjet qëndrimit se atë e përbëjnë edhe veprat e tjera me të cilat përfitohet një send i caktuar, përkatësisht të gjitha veprat e tilla, siç janë, p.sh., fshehja e parasë së fituar me veprë penale të shpërdorimit, mashtrimit në detyrë etj.

Për të ekzistuar vepra penale e mashtrimit është relevante, nëse personi që ka fituar sendin me veprë penale është penalisht përgjegjës, është dënuar, është liruar nga dënimi, se si ndiqet për atë veprë penale apo është arritur afati i parashkrimit etj.

Nga esenca e veprës rezulton se veprimi i kryerjes përfshin çdo veprim që ka për synim që sendi i përfituar me veprë penale të mbetet i pazbuluar, përkatësisht që të mundësohet qarkullimi i tij. Në ligj janë të përcaktuara në mënyrë alternative veprimet e kryerjes, si: blerja, pranimi në hipotekë, përfitimi në një mënyrë tjetër, fshehja dhe shpërndarja. Me përfitim në një mënyrë tjetër nënkuptohet çdo mënyrë tjetër, përpos

mënyrave të përmendura, (p.sh., marrja si dhuratë etj.), pastaj stërshitja, kërkimi blerësve, ndërrimi me sende të tjera etj.

Kjo veprë penale kryhet vetëm me dashje të drejtpërdrejtë, që nënkupton dijeninë e kryerësit se sendi është vënë në dorë me veprë penale.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person, përpos kryerësit dhe bashkë kryesit të veprës penale me të cilin është përfituar sendi.

Vjedhja e pyllit(358)

Këtë veprë penale e kryen personi i cili, me qëllim të vjedhjes, pret trungje në pyll, ndërsa sasia e drurëve të prerë tejkalon dy metra kub.

Kjo veprë penale paraqet një formë të posaçme të veprës penale të vjedhjes. Veprimi i kryerjes i kësaj veprë penale është prerja e një apo më shumë trungjeve.

Vendi i kryerjes është element ligjor i kësaj veprë penale. Për ekzistimin e veprës është e nevojshme që vepra penale të jetë kryer në pyll. Se çka nënkuptojmë me nocionin pyll, shih komentin te neni 357.

Për ekzistimin e kësaj veprë penale kërkohet që, përpos që të jetë kryer prerja, ajo të jetë bërë me qëllim të vjedhjes. Ky element ligjor i veprës penale të vjedhjes së pyllit do të konsumohej nëse prerja e drunjtëve është bërë me qëllim që kryerësi t'i sjellë vetes ose tjetrit përfitim material të kundërligjshme.

Meqë për ekzistimin e veprës penale është e nevojshme që prerja të jetë kryer me qëllim të vjedhjes, rezulton se kjo veprë penale mund të kryhet vetëm në pyllin e tjetrit-në pyll të huaj.

Prerja në pyll e një apo më shumë trungjeve paraqet veprë penale vetëm nëse sasia e drunjtëve të prerë është më tepër se dy metra kub. Ky element i përshkrimit ligjor të kësaj veprë penale të vjedhjes së pyllit paraqet kusht objektiv të inkriminimit dhe për këtë nuk duhet të përfshihet në dashjen e kryerësit.

Vepra penale është kryer me prerjen në pyll të një apo më shumë trungjeve me qëllim të vjedhjes. Për ta konsideruar veprën të kryer, nuk kërkohet edhe përvetësimi i drunjtëve të prerë.

Kryerës i kësaj veprë penale mund të jetë çdo person.

Vepra mund të kryhet vetëm me dashje. Për këtë arsye, nëse kryerësi në kohën e prerjes të trungjeve nuk ka qenë i vetëdijshëm se pylli në të cilin ka kryer prerjen e trungjeve është i huaj, d.m.th., ka qenë në lajthim faktik në raport me këtë rrethanë dhe gabimisht ka menduar se prerjen e trungjeve po e bën në pyllin e vet, atëherë do të përjashtohej dashja e tij.

VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË NJERËZVE DHE PASURISË

Vështrime të përgjithshme

Kryerja e punëve të caktuara dhe përdorimi i mjeteve të caktuara mund të paraqesë rrezik për jetën, integritetin trupor dhe shëndetin e njerëzve, përkatësisht për pasurinë. Numri dhe rëndësia e veprimeve të këtilla si dhe i mjeteve të përdorura, me përparimin e shkencës, po shënojnë rritje të vazhdueshme. Shfrytëzimi i burimeve të fuqishme dhe sasive të mëdha të energjisë dhe përdorimi i arritjeve teknike në të gjitha segmentet e ekonomisë, veçanërisht në procesin e prodhimit, por edhe në jetën e përditshme të qytetarëve. Është jokontestuese nevoja e shoqërisë bashkëkohore për një eksploitim sa ma të madh të zbulimeve shkencore, të cilat çojnë drejt progresit të njerëzimit, por është e domosdoshme edhe kërkesa që mjetet e tilla të shfrytëzohen me përdorimin e masave të sigurisë, në mënyrën që nuk do të sillte në rrezik sigurinë e njerëzve dhe të pasurisë. Mbrojtja e njerëzve dhe e pasurisë nga veprimet përgjithësisht të rrezikshme realizohet para së gjithash përmes një sistemi adekuat të masave preventive, por janë të domosdoshme edhe normat e caktuara penalo-juridike, të cilat, sipas kushteve ligjore, zbatohen në rastet e shkakimit të rrezikut të përgjithshëm për njerëzit dhe pasurinë.

Për shkak të aktualitetit gjithnjë më të madh në jetën bashkëkohore, veprat penale me të cilat vihet në rrezik jeta dhe integriteti trupor i njerëzve dhe të mirat materiale kanë qen objekt trajtimi i shumë kongreseve ndërkombëtare, siç ishte ai i Romës, i mbajtur në vitin 1969. Në këtë Kongres, ndër të tjera, qe konstatuar se veprimet e tilla, që vënë në rrezik jetën, integritetin trupor dhe pasurinë janë në rritje permanente dhe imponojnë nevojën për zhvillimin e një mekanizmi në drejtim të mbrojtjes së jetës, integritetit trupor dhe sigurimit të të mirave materiale, duke i urdhëruar çdokujt që sjelljet e veta t'ua përshtatë këtyre qëllimeve; që situatat e tilla të shprehen edhe në planin penalo- juridik, nëpërmjet zhvillimit të rregullave juridike, të cilat kanë për qëllim mbrojtjen e individit - kolektiviteteve të tij dhe sanksionimit të veprimeve dhe lëshimeve që prodhojnë rrezik; që në procesin e konstituimit të veprave penale të sjelljes në rrezik, të respektohet me rreptësi edhe principi i legalitetit, duke i përkufizuar konkretisht format e rrezikut dhe duke identifikuar juridikisht rrethin e personave që u nënshtrohen detyrimeve të posaçme profesionale.

Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm(365)

Vepra penale konsumohet kur shkaktohet rreziku për jetën a për pasurinë në vëllim të madh me veprim përgjithësisht të rrezikshëm ose me mjete të rrezikshme a me veprime të palejueshme, në raport me pajimet që shërbejnë për mbrojtje nga rreziqet e tilla. Sipas elementeve të saj, ajo është vepër penale e përgjithshme e këtij grupi; në të janë të përfshira të gjitha karakteristika e përbashkëta të veprës penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë, ndërsa të gjitha veprat e tjera penale paraqesin një formë të posaçme të shkakimit të rrezikut të përgjithshëm. Prandaj, kjo

vepër penale ekziston vetëm po qe se me kryerjen e saj nuk është realizuar ndonjë vepër penale e posaçme kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pasurisë.

Vepra penale e parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni qëndron në shkaktimin e rrezikut për jetën e njerëzve a pasurinë në vëllim të madh dhe atë: me zjarr, vërshim, armë, helm, eksploziv, gaz helmues, rrezatim jonizues, forcë mekanike, energji elektrike ose ndonjë energji tjetër dhe çfarëdo veprimi tjetër përgjithësisht i rrezikshëm a mjet përgjithësisht i rrezikshëm.

Vepra penale e parashikuar në paragrafin 1 paraqet vepër penale të përgjithshme, në raport me veprat e tjera penale të këtij kapitulli, të cilat paraqiten si formë e veçantë e kësaj vepre penale të përgjithshme. Nga karakteri i përgjithshëm i kësaj vepre penale rezulton edhe karakteri i saj subsidiar, ngase ajo do të ekzistojë vetëm po qe se në një rast konkret nuk janë realizuar elementet ligjore të ndonjë vepre tjetër penale të këtij kapitulli.

Kjo formë e veprës penale duhet dalluar nga rrezikimi i jetës dhe pasurisë me përdorim të mjetit motorik jo të rregullt, përkatësisht me ngasje jo të rregullt të mjetit motorik.

Nuk do të bëhet fjalë për këtë vepër penale, por për veprën penale kundër sigurisë së trafikut publik, nëse sjellja në rrezik e jetës dhe trupit të njerëzve a të pasurisë në vëllim të madh është shkaktuar me mjet motorik në trafik publik.

Vepra penale e parashikuar nga paragrafi 1 konsiderohet e kryer kur, për shkak të ndërmarrjes së një veprimi të rrezikshëm në fjalë, përkatësisht me përdorimin e mjeteve përgjithësisht të rrezikshme, me vërshim, helmim etj.) është shkaktuar rreziku konkret për jetën e njerëzve apo rrezik për të shkaktuar dëm të konsiderueshëm të pasurisë.

Për të ekzistuar kjo vepër penale është e domosdoshme që ndërmjet veprimit të kryerjes dhe pasojës së shkaktuar të ekzistojë një raport shkakësor.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë mund të jetë çdo person.

Vepra mund të kryhet me dashje, e cila përfshin vetëdijen për karakterin e veprimeve të ndërmarra dhe për pasojën dhe nga pakujdesia.

VEPRAT PENALE KUNDËR SIGURISË SË TRAFIKUT PUBLIK

Zhvillimi normal dhe i sigurt i trafikut është me rëndësi të shumëfishtë shoqërore. Trafiku publik është, para së gjithash, veprimtari e rëndësishme ekonomike. Transportimi i shumicës së njerëzve, e një sasive të madhe mallrash dhe të mirash të tjera sot bëhet me mjete të trafikut publik. Zhvillimi tij ka arritur një nivel të tillë që bën të mundur që, brenda një kohe relativisht të shkurtër, të përfshijë territore të tëra, gjë që kontribuon në ushtrimin efikas dhe ekonomik të shumë veprimtarive të tjera. Në trafikun publik, pa marrë parasysh llojin e tij, inkuadrohet një numër gjithnjë e më i madh mjeteve motorike shpejtësia e të cilave rritet në mënyrë konstante. Në këtë mënyrë stimulohet zhvillimi i mëtejshëm i prodhimit industrial të mjeteve të trafikut. Zhvillimi i trafikut ndikon pozitivisht edhe në përsosjen dhe ndërtimin e mëtejshëm të sipërfaqeve në të

cilat zhvillohet ndërtimi dhe modernizimi i rrugëve, hekurudhave, hapja e vijave të reja ajrore dhe tokësore etj. Në kryerjen e shërbimeve publike angazhohet një numër gjithnjë e më i madh i njerëzve, ndërsa numri i pjesëmarrësve në trafikun publik rritet çdo ditë. Sot është realitet që çdo person është pjesëmarrës në trafik – si drejtues mjeti, udhëtar a këmbësor. Të gjitha këto tregojnë rëndësinë e jashtëzakonshme ekonomike dhe shoqërore të trafikut publik.

Trafiku publik i përket asaj veprimtarie të cilën, për nga vetë natyra e saj, e shoqërojnë edhe rreziqe permanente, domethënë në trafik kurdoherë mund të jetë e pranishme mundësia që të silltet në rrezik jeta dhe integriteti trupor i njerëzve, përkatësisht e pasurisë ose të shkaktohen pasoja edhe më të rënda ndaj këtyre të mirave të njeriut. Me zhvillimin e trafikut, me shtimin gjithnjë e më të madh të numrit të mjeteve në trafik, rritjen e shpejtësisë, përfshirjen në trafik të mjeteve të reja të trafikut etj., (gjë që pa dyshim kontribuon në zhvillimin e përgjithshëm dhe teknologjik të shoqërisë), rreziqet e tilla vijnë gjithnjë duke u shtuar. Përdorimi i mjeteve në gjendje jo të rregullt, cilësia e dobët e rrugëve dhe pajisjet teknike të dobëta, sidomos mungesa e sinjalistikës, sikurse edhe shumë rrethana të tjera objektive dhe subjektive, rrisin shkallën e rrezikshmërisë për njerëzit dhe pasurinë gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie. Të gjitha këto ndikojnë që në trafik të ndodhin shpesh aksidente me viktima jo të pakta në njerëz dhe me dëme materiale të pallogaritshme. Karakteristikë e trafikut bashkëkohor është rritja e aksidenteve të trafikut, numri gjithnjë e më i madh i njerëzve që humbin jetën në aksidente të tilla apo pësojnë lëndime të rënda trupore dhe shkaktimi i dëmeve të mëdha materiale. Fjala është për një dukuri që ka rëndësi të posaçme shoqërore dhe kriminalo-politike. Shoqëria duhet të mbrohet nga delikuenca në trafik, ndonëse kjo nuk bën të paraqesë pengesë për zhvillimin e mëtejshëm teknologjik të kësaj veprimtarie ekonomike. Për këtë arsye, masat parandaluese, (zhvillimi i kulturës së trafikut dhe ndjenjës së përgjegjësisë të pjesëmarrësit në trafik, mbikëqyrja e efikase në ushtrimin e kësaj veprimtarie, mirëmbajtja e mjeteve të trafikut dhe rrugëve, ndërtimi dhe modernizimi i rrugëve, vendosja e pajisjeve teknike adekuate, rregullimi i plotë normativ i trafikut etj.), kanë rëndësi të posaçme në pengimin e aksidenteve dhe mënjanimin e delikuençës në trafik.

Rrezikimi i trafikut publik(378)

Vërejtje kritike: Paragrafi 1. dhe 2. i këtij neni, ka sanksionuar si vepër penale kur kryesi i veprës penale duke vepruar në kundërshtim me ligjin mbi trafikun publik, tjetrit i shkakton dëm material pa e limituar lartësinë e dëmit, që shpie në përfundim që për çdo dëm material në raste të tilla, do trajtohet si çështje penale. Kjo do sjell probleme në praktikë dhe do i ngarkoj gjykatat me çështje të tilla edhe kur dëmi është fare i papërfillshëm, për këtë arsye është e domosdoshme që ky paragraf të plotësohet dhe deliktet e tilla të trajtohen si penale vetëm po që se vlera e dëmit të shkaktuar kalon një vlerë të caktuar.

Te këto vepra penale janë përfshirë format e ndryshme të rrezikimit të trafikut publik. E përbashkëta e këtyre veprave penale është ajo se ato kryhen me sjellje të paligjshme të pjesëmarrësve në trafik, përkatësisht me shkelje të dispozitave përkatëse

të trafikut publik, duke vënë në rrezik jetën ose integritetin trupor të njerëzve a pasurinë. Varësisht nga lloji i trafikut që rrezikohet, mund të dallojmë dy forma të kësaj vepre penale: rrezikimin e trafikut publik rrugor dhe rrezikimin e trafikut hekurudhor, ujqor dhe formave të tjera të trafikut publik.

Kemi të bëjmë me rrezikim të sigurisë në rrugë (par. 1) kur pjesëmarrësi në trafik nuk u përmbahet dispozitave të trafikut dhe në atë mënyrë rrezikon trafikun publik, duke vënë në rrezik jetën a trupin e njerëzve ose pasurinë dhe, për pasojë, tjetrit i shkaktohet lëndimi i lehtë trupor a dëm pasuror material u tha më sipër nuk është limituar lartësia e dëmit të shkaktuar (sipas nenit 297.par.të kodit të vjetër konsiderohej vepër penale vetëm po qe se lartësia e dëmit të shkaktuar tejkalon vlerën prej 15.000 €, kështu do duhej të ishte edhe tani).

Veprimi i kryerjes së veprës penale është mospërfillja e dispozitave të trafikut, gjë që nënkupton sjellje (veprime) të tilla të pjesëmarrësit në trafik me të cilat ai cenon dispozitat që rregullojnë trafikun rrugor. Kjo i jep karakter blanket kësaj vepre penale, ashtu që veprimi i kryerjes duhet përcaktuar duke marrë parasysh udhëzimet dhe ndalesat që rezultojnë nga dispozitat përkatëse për pjesëmarrësit në trafik. Trafiku rrugor është rregulluar me dispozita ligjore, urdhëresa dhe udhëzime. Ndër këto dispozita, rëndësi të posaçme kanë Ligji për Transportin Rrugor nr.2004/1, datë 24.03.2005 dhe Ligji për Sigurinë e Trafikut Rrugor nr.02/ L-70 datë 11.01.2007.

Mënyrat e mospërfilljes së dispozitave në trafik, me të cilat kryhet kjo vepër penale, janë të shumta dhe të llojllojshme. Në praktikë rrezikimi i trafikut rrugor më së shpeshti kryhet në këto mënyra: me anë të drejtimit të mjetit me shpejtësi më të madhe sesa që është e lejuar, me parakalim jo të rregullt, me lëvizje jo të rregullt, me drejtim të mjetit në gjendje jo të rregullt teknike, me drejtim në gjendje të dehur apo kur është i lodhur, me ndalim dhe parkim të gabuar, me mosrespektim të shenjave të trafikut që kanë të bëjnë me përparësitë e pjesëmarrësve në trafik, me mosrespektim të së drejtës së përparësisë së kalimit të këmbësorëve në vendkalim këmbësorësh, me shkujdesje ndaj këmbësorëve që gjenden në rrugë apo ndaj atyre që i qasen rrugës, me drejtim të parregullt të mjetit prapa etj.

Në këtë formë të veprës penale janë përfshirë rrezikimi i trafikut rrugor, ashtu që vepra ekziston vetëm po qe se dispozitat e trafikut janë shkelur në trafikun rrugor. Me fjalën rrugë, në kuptim të dispozitave të Ligjit për Sigurinë e Trafikut Rrugor, nënkuptohet çdo rrugë publike dhe rrugë e pa kategorizuar, në të cilën zhvillohet trafiku. Rrugë publike është sipërfaqja me interes të përgjithshëm për trafikun, të cilën mund ta shfrytëzojë lirisht çdokush në kushtet e përcaktuara me ligj dhe të cilën sipërfaqe organi kompetent e ka shpallur rrugë publike; rrugicat në lagje gjithashtu konsiderohen rrugë publike. Si kategori të rrugëve publike ligji përcakton: autostradën, rrugën e rezervuar për qarkullimin e mjeteve motorike, rrugët ndërkombëtare, rrugët magjistrale dhe rrugët rajonale. Rrugë e pakategorizuar është sipërfaqja që shfrytëzohet për trafik në çfarëdo baze dhe e cila është e qasshme për numrin më të madh të shfrytëzuesve, (rrugët e fshatit, të fushës, të pyllit, rrugët e krijuara mbi argjinaturat për mbrojtje nga vërshimet etj.). Pra, termi rrugë është përcaktuar në mënyrë të gjerë dhe përfshin të gjitha ato sipërfaqe që janë destinuar për trafikun ose që shfrytëzohen për qëllime të

tilla, ashtu që pjesëmarrësit në trafik që i shfrytëzojnë këto sipërfaqe janë të detyruar t'u përmbahen dispozitave mbi trafikun.

Te çdo aksident trafiku, në kuptim të kësaj dispozite ligjore, është e domosdoshme të vërtetohet që ai të jetë shkaktuar në sipërfaqen që konsiderohet rrugë, por në praktikën gjyqësore kjo shpeshherë ka krijuar probleme dhe divergjenca në interpretim, kështu që si rrugë konsiderohen edhe ato sipërfaqe në të cilat qarkullojnë vetëm kategori të kufizuara mjetesh, siç janë, p.sh., hapësirat e brendshme të fabrikave, spitaleve a organizatave të tjera punuese, në të cilat kanë qasje vetëm mjetet e tyre; rruga që i përket një prone bujqësore, po ashtu, mund jetë vend i kryerjes së kësaj vepre penale; hapësirat brenda garnizoneve në të cilat qarkullojnë vetëm mjetet ushtarake; aeroportet etj. Në vendimin e saj Ap.nr.123/66 datë 22.2.1966, Gjykata Supreme e Jugosllavisë ka konstatuar se vepra penale e rrezikimit të trafikut publik mund të kryhet edhe në rrugën që ndodhet në një mjedis spitalor. Pjesa e hekurudhës mbi të cilën kalojnë mjetet motorike gjithashtu konsiderohet rrugë, ashtu që mosveprimi sipas shenjës së trafikut me rastin e kalimit mbi binarë nuk paraqet rrezikim të trafikut hekurudhor, por të trafikut rrugor. Nuk konsiderohen rrugë, në kuptim të kësaj dispozite, oborret private dhe as ofiçinat për riparimin e mjeteve, pra kur në vende të këtylla është vënë në rrezik jeta dhe trupi i njerëzve me mjet trafiku, nuk do të bëhej fjalë për këtë vepër penale, por për vepër penale të shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm.

Kryerës i kësaj vepre penale mund të jetë vetëm pjesëmarrësi në trafikun rrugor, (ndonëse dispozita ligjore nuk është formuluar kështu, sepse në vend të shprehjes pjesëmarrës në trafik, është përdorur krejtësisht gabim shprehja kushdo, sepse këtë vepër penale nuk mund ta kryejë kushdo, por vetëm pjesëmarrësi në trafik). Sipas dispozitave ligjore pjesëmarrës në trafik është personi që drejton në rrugë mjetin, (mjet trafiku. sipas kësaj dispozite, konsiderohet çdo mjet transportues i destinuar për qarkullim në rrugë, me përjashtim të karrocave pa motor për personat me aftësi të kufizuara dhe mjeteve për mbartjen e fëmijëve); personat e tjerë që ndodhen në mjet, por që nuk e drejtojnë atë; personat që ngasin apo kalërojnë kafshë në rrugë; personat që vendin e tyre të punës e kanë në rrugë, (punëtorët që ndërtojnë, mirëmbajnë rrugët etj) dhe këmbësorët. Në një vendim gjyqësor është marrë qëndrim se pjesëmarrës në trafik konsiderohet jo vetëm punëtori që ushtron punët e vendit të tij të punës në rrugë, por edhe ai që punët e vendit të punës i kryen përbri rrugës, në zonën ku mjetet, duke lëvizur anës së rrugës, mund të sjellin në rrezik jetën a trupin e njerëzve. Shprehja këmbësor gjithashtu përfshin mjaft kategori të pjesëmarrësve në trafik, siç janë: pjesëmarrësit në trafik që nuk drejtojnë mjete trafiku e as transportohen me to; personat që shtynë ose tërheqin me fuqinë e vet mjete transportuese për fëmijë, biçikleta me motor a karroca për personat me aftësi të kufizuara; personat handikapatë që lëvizin me karrige personash të paafte, të cilat lëvizin me fuqinë personale të një personi të tillë ose me motor, nëse ato lëvizin me shpejtësinë e ecjes së njeriut. Kur rrezikimi i trafikut publik është shkaktuar nga ana e disa pjesëmarrësve në trafik, çdonjëri prej tyre konsiderohet kryerës i kësaj vepre penale; në raste të tilla nuk ekziston bashkëkryerja, pasi që midis tyre nuk ka ekzistuar lidhja subjektive – vetëdija për veprim të përbashkët. Përkitazi me fajësinë, (anën subjektive), ligji parashikon që te kjo vepër penale është e mundur edhe dashja(vetëm eventuale), edhe pakujdesia.

VEPRAT PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE

Për qëllime të këtij Kapitulli, shprehja “procedurë zyrtare” nënkupton çfarëdo procedure penale siç përkufizohet në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës; procedurat pranë cilësdo gjykatë dhe Gjykatës Kushtetuese; procedurën pranë Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe kuvendeve komunale; ose ndonjë procedurë e autorizuar me ligj pranë ndonjë ministrie, agjencie apo institucioni të pavarur të Republikës së Kosovës, përfshirë procedurat disiplinore dhe procedurat e noterisë.

Rëndësia dhe roli i drejtësisë në çdo shoqëri janë të shumëfishta. Si pjesë e sistemit shtetëror, drejtësia është një nga mekanizmat për realizimin e qëllimeve e klasës në pushtet në një shoqëri. Funkionimi i saj normal, veçanërisht sigurimi i ekzekutimit të vendimeve të organeve të drejtësisë, kontribuon në sigurimin e sistemit ekzistues shoqëror- ekonomik dhe politik. Kjo rëndësi e drejtësisë nuk është atribut vetëm i atyre shteteve që kanë pranuar sistemin e pushtetit unik, por edhe shteteve të cilat kanë pranuar sistemin e ndarjes së pushteteve. Në shoqërinë tonë funksioni i organeve të drejtësisë është i orientuar para se gjithash në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të qytetarëve dhe sigurimin e rendit kushtetues të Kosovës.

Ne realizimin e funksionimit të vet, organet e drejtësisë ushtrojnë veprimtari të ndryshme, të cilat janë me rëndësi të posaçme shoqërore. Kështu, ato vendosin për të drejta e ndryshme personale, pasurore, çështje nga e drejta e punës, për të drejtat dhe obligimet e qytetarëve etj. “Gjykatat mbrojnë të drejtat dhe liritë e qytetarëve dhe sigurojnë kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë. Në realizimin e këtij funksioni mbrojtës një rëndësi të posaçme ka roli i organeve të drejtësisë në zbulimin e veprave penale dhe delikteve ekonomike, kapja dhe gjykimi e kryerësve të tyre, shqiptimi dhe ekzekutimi i sanksioneve të shqiptuara për vepra penale dhe delikte ekonomike. Në funksion të drejtësisë bie edhe vlerësimi i ligjshmërisë së dispozitave dhe akteve të caktuara të nxjerra nga organet shtetërore, organizatat punuese, kompanitë publike. Të gjitha këto flasin për rëndësinë e madhe shoqërore të organeve të drejtësisë dhe nevojën që ato të punojnë normalisht, gjë që realizohet edhe me masa të mbrojtjes penalo –juridike.

Deklarimet e rreme(392)

Qëllimi i inkriminimit të parashikuar nga ky nen nisat nga interesat që ka shoqëria që individët lirisht të marrin pjesë në procedurat zyrtare, pranë organeve gjyqësore, shtetërore dhe organeve të tjera, në mënyrë që këto organe të mund t’i mbështesin vendimet e veta mbi gjendjen e vërtetë faktike. Cenimi i detyrimeve procedurale që të flitet e vërteta bën që organet e drejtësisë dhe organet tjera të sillen në lajthim me rastin e vërtetimit të fakteve esenciale, si bazë e vendimeve të ligjshme. Me këtë vepër dënohet kryerja e pandershme dhe e pandërgjegjshme e një detyrimi human dhe qytetar që, duke marrë pjesë në procedurë, të kontribuohet në zgjidhjen e drejtë të çdo rasti konkret.

Vërtetimi i drejtë dhe i plotë i gjendjes faktike paraqet bazë për vendime të drejta dhe të ligjshme të gjykatës dhe të organeve administrative e disiplinore. Në numrin

më të madhe të rasteve këto organe vërtetojnë gjendjen faktike në bazë të dëshmisë së dëshmitarëve e shpesh edhe në bazë të mendimit dhe konstatimit të ekspertit. Në procedurën kontestimore dhe atë administrative faktet kontestuese mund të vërtetohen edhe me dëgjimin e palëve. Në raste të caktuar në procedurë shfrytëzohen edhe përkthyesit dhe interpretët. Detyrim ligjor i të gjithë këtyre pjesëmarrësve në procedurë është që të kontribuojnë në zgjidhjen e drejt të rastit. Është detyrë e dëshmitarit dhe e palëve në procedurën kontestimore që, me rastin e deklarimeve të tyre, ta thonë të vërtetën, ndërsa është detyrë e ekspertit, përkthyesit dhe interpretit që funksionin e vet në procedurë ta kryejnë me ndërgjegjeje dhe sipas dijes më të mirë të tyre. Shkelja e këtyre detyrimeve pengon dhe vështirëson funksionimin e organeve të drejtësisë dhe organeve të tjera përkatësi me vërtetimin e fakteve themelore dhe mund të ketë për pasojë marrjen e vendimeve të padrejta dhe të paligjshme. Me këtë inkriminim mbrohet penalo-juridikisht funksionimi i rregullt i organeve të drejtësisë dhe organeve të tjera shtetërore dhe shoqërore, të cilat, në bazë të autorizimeve ligjore, zhvillojnë procedura të caktuara ligjore dhe, në bazë të rezultatit të procedurës, marrin vendime me rëndësi për interesin individual dhe interesin e përgjithshëm shoqëror.

Në këtë nen janë parashikuar tri forma të veprës penale të deklarimit të rrejshëm:

- a) *forma themelore e deklarimit të rrejshëm nga ana e palëve, dëshmitarit, ekspertit, përkthyesit dhe interpretit,*
- b) *marrja e deklarimit të rrejshëm si bazë për dhënie të vendimit në procedurë,*
- c) *dhënia e deklarimit të rrejshëm që ka prodhuar pasojë të rënda për të akuzuarin.*

Në paragrafin 4 është parashikuar mundësia e lirimit nga dënimi, nëse kryerësi e tërheq vullnetarisht deklaratën e rreme.

Vepra penale konsiderohet e kryer me dhënien e deklaratës. Çdo dëgjim i dëshmitarit konsiderohet një tërësi. Vepra penale nuk do të ekzistojë, po qe se dëshmitari, në kuadër të dëgjimit të njëjtë, së pari deklaron rrejshëm e pastaj atë dëshmi e revokon dhe deklaron drejt.

Pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare(394)

Me këtë veprë penale rrezikohet puna normale e organeve gjyqësore dhe organeve të tjera, përkatësisht pengohet dhe vështirësohet puna e këtyre organeve lidhur me zbatimin e procedurës së provave dhe nxjerrjes së vendimit të drejtë dhe të ligjshëm.

Vepra penale e parashikuar nga ky nen ka pesë forma.

Në paragrafin 1 si veprë penale është parashikuar nxitja e dëshmitarit apo ekspertit për dhënien e dëshmisë së rreme; në paragrafin 2 është parashikuar forma e posaçme e pengimit ose vështirësimit të të provuarit që qëndron në pamundësimin e shfrytëzimit të dokumenteve të caktuara që shërbejnë për të provuar, ndërsa sipas paragrafit 3, objekt i kësaj veprë penale mund të jetë guri kufitar, shenjat e tokës dhe shenjat e tjera për pronësinë mbi paluajtshmërinë ose për të drejtën e përdorimit të ujit- d.m.th., fjala është për kufijtë (mezhdat) që përkufizojnë pronësinë - për vijën kufitare mes pronave.

Te forma e veprës penale të parashikuar nga paragrafi 1, veprimi i nxitjes është parashikuar si vepër penale e pavarur; dënimi i kryerësit nuk mbështetet mbi parimin e aksesoritetit, baza e inkriminimit nuk është e mbështetur në dispozitat e nxitjes, si bashkëpunim.

Veprimi kryerjes së veprës penale është shtytja e dëshmitarit apo e ekspertit për të dëshmuar rrejtshëm apo personave të tjerë që nuk kanë statusin e dëshmitarit. Shprehja shtytje nënkupton situatën kur te personi i caktuar (dëshmitari ose eksperti) nuk ekziston vendimi për të dhënë dëshmi të rreme, përkatësisht kur një vendimi i tillë nuk është mjaft i fortë, definitiv.

Çdo shtytje për dhënien e dëshmisë së rreme nuk paraqet veprim kryerës të kësaj vepre penale. Shtytja nga aspekti penalo-juridik është relevante vetëm nëse është kryer me detyrim (forma të ndryshme të presioneve shantazheve etj), por pa efekte trupore dhe detyrime e tilla nuk duhet të marrin primesh të dhunës dhe kanosjes.

Forma të tjera të detyrimit, premtimin e dhuratave ose çfarëdo përfitimi tjetër.

Shprehja forma të tjera të detyrimit përfshin në vete edhe forma të tjera të ndikimit detyruës në lirinë e vendosjes, përkatësisht vullnetin e dëshmitarit apo të ekspertit përkitazi me dhënien e dëshmisë, të cilat përmbajtësisht nuk janë të përfshira në shprehjet dhunë dhe kanosje të sqaruar më sipër.

Mënyra vijuese e detyrimit për dhënien e dëshmisë së rreme është premtimi i dhuratave apo çfarëdo përfitimi tjetër. Premtimi i dhuratës a çfarëdo përfitimi tjetër qëndron në shprehjen e vullnetit të kryerësit që dëshmitarit apo ekspertit t'i bëjë dhuratë a çfarëdo përfitimi tjetër, nëse dëshmitari ose eksperti japin dëshmi të rreme.

Dhurata paraqet përfitim të caktuar pasurore që jepet pa kompensim; mund të bëhet fjalë për valutë vendore apo të huaj, për ar, metale të tjera fisnike, letra me vlerë, përkatësisht çfarëdo sendi që ke vlerë pasurore. Objekt premtimi i dhuratave mund të jetë edhe paluajtshmëria, (p.sh., toka, banesat, lokal afarist etj.). Me shprehjen përfitim tjetër nënkuptojmë para se gjithash një përfitim jopasuror, por mund të bëhet fjalë edhe për përfitimin që nuk paraqet dhuratë në kuptimin e drejtë të fjalës, p.sh., për dhënien e koncesioneve për kryerjen e punëve të caktuara pa procedurë të parashikuar ligjore, për punësim pa i plotësuar kushtet e konkursit etj. Sipas rregullit, vlera e dhuratës, përkatësisht vlera e çfarëdo përfitimi tjetër nuk është relevante për ekzistimin e veprës penale. Detyrimi për të dhënë dëshmi të rreme duhet të kryhet ndaj dëshmitarit ose ekspertit, dhe dëshmia e rreme e dëshmitarit dhe ekspertit duhet të jetë dhënë: në procedurën gjyqësore, kundërvajtëse, administrative, në procedurën para noterit publik apo në procedurën disiplinore.

Veprën penale mund të kryejë çdo person, (*delicta communia*).

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Falsifikimi i dokumenteve(398)

Me kodin e mëparshëm, kjo veprë penale ishte e radhitur në kapitullin e veprave penale kundër rendit publik dhe veprimit juridik (neni 332) tani është radhitur në grupin e veprave penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike.

Falsifikimi i dokumentit është një veprë penale me të cilën sanksionohen format e ndryshme të rrezikimit të qarkullimit juridik, përkatësisht të sigurisë së qarkullimit juridik. Ky lloj inkriminimi paraqitet në dy forma: forma themelore dhe forma e rëndë.

Karakteristikë e veprës penale falsifikimi i dokumentit është ajo se dokumenti nuk rrjedh nga personi i cili është shënuar në të si lëshues (dhënës) i tij. Atë e bën të rremë fakti se ai i atribuohet personit i cili nuk e ka lëshuar atë dhe tentohet që të krijohet përshtypja se pikërisht një person i caktuar është lëshues (dhënës) i tij (dokumentit), edhe pse në fakt ai nuk e ka lëshuar. Dokumenti i rremë ekziston edhe atëherë kur përmbajtja e tij është e saktë, por atë nuk e ka lëshuar personi i cili në dokument është shënuar si lëshues (dhënës) i tij.

Veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe mund të qëndron në përpilimin e dokumentit të rremë apo në ndryshimin e dokumentit të vërtetë, me qëllim që një dokument i tillë të përdoret si i vërtetë. Bëhet fjalë për delikte komiseve, ngase vepra penale mund të kryhet vetëm me veprim.

Formën themelore të veprës penale e kryen ai që përpilon një dokument të rremë apo që ndryshon dokumentin origjinal, me qëllim që atë ta përdorë si të vërtetë ose kushdo që një dokument të tillë e përdor si të vërtetë. Nga kjo del se kjo veprë penale paraqitet si: përpilim i dokumentit të falsifikuar apo si ndryshim i dokumentit origjinal.

Objekt i mbrojtjes penalo-juridike i kësaj vepre penale është dokumenti.

Forma e dytë e kësaj vepre penale është përdorimi i dokumentit të falsifikuar përkatësisht përdorimi i dokumentit të rremë apo të ndryshuar si të vërtetë, (d.m.th., me këtë dispozitë është kriminalizuar edhe përdorimi i këtij dokumenti).

Ana subjektive e veprës penale është dashja, d.m.th., kryerësi konsiderohet penalisht përgjegjës nëse ka vepruar me qëllim që dokumentin e rremë, përkatësisht të ndryshuar ta përdorë si të vërtetë dhe nëse ka vepruar me dashje, e cila qëndron në vetëdijen e kryerësit se po përpilon një dokument të rremë, përkatësisht se po e ndryshon dokumentin origjinal.

Kryerësi që përdor dokumentin e rremë apo të ndryshuar është penalisht përgjegjës nëse ka vepruar me dashje, e cila qëndron në vetëdijen e kryerësit që ta përdorë dokumentin i cili është i rremë, përkatësisht i ndryshuar (dashja direkte), përkatësisht se po e përdor dokumentin për të cilin supozon se është i falsifikuar, përkatësisht i ndryshuar, por megjithatë e përdor atë (dashja eventuale).

Tentativa e falsifikimit të dokumentit me përpilimin e dokumentit të rremë përkatësisht ndryshimit të dokumentit origjinal ekziston, nëse është ndërmarrë veprimi i përpilimit, përkatësisht i ndryshimit të dokumentit origjinal me qëllim që dokumenti i rremë, përkatësisht dokumenti i ndryshuar të përdoret si i vërtetë, por veprimi (i filluar) i ndërmarrë nuk ka përfunduar, pa marrë parasysh arsyet.

Tentativa e përdorimit të dokumentit të falsifikuar, përkatësisht dokumentit të ndryshuar ekziston, nëse dorëzimi i dokumentit (të falsifikuar apo të ndryshuar) personit të cilit i është dedikuar ka filluar, por dokumenti nuk ka mbërritur, përkatësisht nuk i është dorëzuar personit të cilit i është adresuar ose dorëzimi i dokumentit është kryer, por dokumenti nuk është parë (vërejtur) nga ai të cilit i ka mbërritur, përkatësisht i është dorëzuar.

Në paragrafin 2 është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, bazuar në llojin e dokumentit që është objekt falsifikimi. Për këtë kualifikim (përpilimi i dokumentit të rremë, ndryshimi i dokumentit origjinal dhe përdorimi i një dokumentit të tillë) kërkohet që të jetë falsifikuar dokumenti publik, testamenti, kambiali, regjistri publik a zyrtar ose ndonjë regjistër tjetër që ruhet në bazë të ligjit.

VEPRAT PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK

Për të gjitha veprat penale të sistemuara në një grup, e përbashkëta e tyre është objekti grupor unik i mbrojtur. Kjo paraqet lidhjen kohezive mes veprave të ndryshme penale në kuadër të grupit të njëjtë. Ndërkaq, kur bëhet fjalë për veprat penale kundër rendit publik, e vetmja “karakteristikë e përbashkët” e tyre është mungesa e këtij objekti të përbashkët të mbrojtur. Në këtë grup janë radhitur veprat penale me objekte të mbrojtura më se të ndryshme, (p.sh., pengimi i personit zyrtar në ushtrimin e detyrës zyrtare, falsifikimi i dokumentit, thirrja për rezistencë, pengimi i ceremonive fetare, dëmtimi i varreve apo kufomave etj.), ashtu që nuk është e mundur të nxirret asnjë unifikimin minimal për të gjitha këto vepra penale përkitazi me objektin grupor të mbrojtur. Heterogjeniteti i veprave penale të këtij grupi ka për pasojë atë që kuptimi dhe përmbajtja e disa veprave penale në këtë rast nuk mund të caktohet edhe në pikëpamje të sistematikës së tyre në ligjin penal, gjë që te veprat e tjera jo vetëm që është e mundur, por shpesh është edhe shumë e rëndësishme. Përpos kësaj, është e vështirë edhe sistematika e brendshme e këtyre veprave.

Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare(409)

Në ushtrimin e autorizimeve të tyre, personat zyrtarë ndërmarrin veprime të caktuara, përkatësisht janë të detyruar t’i ndërmarrin ato veprime. Përmbajtja dhe qëllimi i veprimeve të tilla është mjaft i ndryshëm, siç është, p.sh., ekzekutimi i vendimeve të organeve shtetërore ose organeve të tjera, mbrojtja e interesave shoqërore ose interesave e individit, ruajtja e rendit dhe qetësisë publike, zbulimi dhe kapja e kryerësve të veprave penale, rregullimi dhe sigurimi i trafikut etj. Ndërmarrja e veprimeve zyrtare në mënyrë të plotë, efikase dhe të ligjshme është e rëndësishme si për shoqërinë në përgjithësi, ashtu edhe për individin, veçanërisht në ato raste kur me veprime të tilla realizohet mbrojtja e lirive dhe të drejtave të tyre. Prandaj kryerja normale dhe e ligjshme e këtyre obligimeve sigurohet me masa të ndryshme, pra edhe me masa penalo juridike. Mbrohet para së gjithash jeta dhe integriteti trupor i personave zyrtarë

në kryerjen e detyrës, ashtu që lëndimi trupor a vrasja e personave zyrtarë konsiderohet formë e cilësuar, (e rëndë), e veprës penale. Veprimet e paligjshme të personave zyrtarë në kryerjen e detyrës janë të përfshira në numrin një të madh të veprave penale kundër detyrës zyrtare. Së fundi kryerja e ligjshme e detyrave zyrtare është e mbrojtur edhe nga sulmet e personave të tjerë; një mbrojtje e tillë është e siguar me këtë vepër penale dhe me disa vepra penale të këtij grupi.

Me veprën penale të parashikuar nga neni 409 sigurohet mbrojtja penale e personit zyrtar në kryerjen e detyrës së tij, d.m.th., ushtrimi i papenguar i detyrave zyrtare. Prandaj objekt primar i mbrojtur është detyra, përkatësisht ushtrimi i papenguar i veprimeve zyrtare nga ana e personit zyrtar, ndërsa tërthorazi sigurohet edhe mbrojtja e vetë personit zyrtar. Ligdhënësi ka parashikuar disa forma të veprës penale: formën themelore, cilësuese dhe privilegjuese.

Pengimi i personit zyrtar në ushtrimin e detyrës zyrtare ekziston kur, me përdorim të dhunës a kanosjes për përdorim aty për aty të dhunës, pengohet personi zyrtar në ushtrimin e detyrës zyrtare, të cilën e ka ndërmarr në kuadër të autorizimeve të veta.

Veprimi kryerës i kësaj vepre penale është përcaktuar si pengim i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare. Me pengim, në kuptim të kësaj vepre penale, duhet kuptuar çdo veprim aktiv i kryerësit që është drejtuar në pamundësimin e kryerjes së detyrës zyrtare. Prandaj veprimi i kryerjes mund të manifestohet vetëm si veprim, pra format e ndryshme të qëndrimit pasiv të kryerësit, d.m.th., mosveprimi, të cilat janë drejtuar në pamundësimin e kryerjes së detyrës zyrtare nuk paraqesin veprim kryerës të kësaj vepre penale. Ato janë, p.sh., rastet kur personi nuk do ta tregojë letërnjoftimin apo një dokument tjetër me qëllim të verifikimit të identitetit të tij, nuk dëshiron ta hapë lokalin e mbyllur për ta kontrolluar, nuk do të largohet nga vendi i caktuar me kërkesë të personit zyrtar etj. Sipas formulimit ligjor, vepra e pengimit të personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare kryhet me dhunë a me kanosje se aty për aty ka për t'u përdorur dhuna.

Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare(410)

Sulmi mbi personin zyrtar gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare nuk është e nevojshme që çdo herë të jetë i motivuar për të penguar në kryerjen e detyrës zyrtare. Është e mundur që ky të bëhet për ndonjë motiv tjetër, (urrejtja ndaj personit zyrtar a ndaj detyrës të cilën ai e ushtron, dëshira që në këtë mënyrë të komprometohet personi zyrtar etj.) ose që kryerësi në këto raste të mos jetë i udhëhequr nga asnjë motiv. Rastet e tilla nuk do të mund të cilësoheshin si vepra e mëparshme – pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrës zyrtare. Po të mos ekzistonte inkriminimi i posaçëm, vepra eventualisht do të mund të cilësohej si ndonjë formë e sulmit mbi integritetin trupor, (lëndimi i lehtë apo lëndimi i rëndë trupor) ose si detyrim. Mirëpo, në raste të tilla ekziston nevoja jo vetëm që të mbrohet jeta dhe trupi i personit zyrtar, por edhe autoriteti dhe rëndësia e detyrës të cilën e ushtron ai. Mbrojtja e shtuar penalo-juridike është veçanërisht e nevojshme dhe e arsyeshme të punët dhe detyrat që kanë të bëjnë me sigurinë publike

dhe shtetërore, ruajtjen e rendit publik. Një mbrojtje e tillë është realizuar me këtë vepër penale.

Forma themelore e veprës penale, (par. 1), ekziston kur kryerësi i veprës e sulmon apo kanoset seriozisht se do të sulmojë personin zyrtar, gjyqtarin, prokurorin a personin për të cilin e di se e ndihmon atë në kryerjen e detyrës zyrtare. Veprimi kryerjes është përcaktuar si sulm a si kanosje serioze se do të sulmohet subjekti pasiv. Me sulm, në kuptim të këtij inkriminimi, duhet kuptuar çdo veprim që krijon rrezik konkret dhe real për subjektin pasiv. I tillë është, p.sh., veprimi i shtyrjes së personit zyrtar, tërheqja për krahësh a rrobash, lëvizjet me dorë a këmbë për ta goditur, hedhja e ndonjë objekti që mund t'i shkaktojë lëndime trupore etj. Kemi të bëjmë me veprime të tilla që paraqesin sulm të një intensitetit më të ulët, sepse sulmi që shkakton lëndim trupor çon në një formë më të rëndë të veprës.

Një formë tjetër e veprimit të kryerjes është kanosja serioze se do të sulmohet personi zyrtar apo personi që e ndihmon atë në kryerjen e detyrës zyrtare.

Kryerës i veprës penale mund të jetë çdo person, ndërsa vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Në paragrafin 2 është parashikuar forma e kualifikuar e kësaj vepre penale, e cila do të ekzistonte kur me rastin e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, personit zyrtar ose personit që e ndihmon atë i është shkaktuar lëndim i lehtë trupor ose kur kryerësi i është kanosur me përdorim të armës.

Në paragrafin 3 është parashikuar forma e cilësuar e veprës penale, e cila ekziston në ato situata kur, me rastin e kryerjes së veprës penale të parashikuar nga paragrafi 1, personit zyrtar a personit që ndihmon atë i është shkaktuar lëndim i rëndë trupor.

Ligjdhënësi ka parashikuar edhe formën privilegjuese të kësaj vepre penale, e cila do të ekzistonte po qe se kryerësi ndonjërin nga format e përshkruara të veprave penale i ka kryer për shkak se ka qenë i provokuar nga veprimi i kundërligjshëm a brutal i personit zyrtar.

KORRUPSIONI ZYRTAR DHE VEPRAT PENALE KUNDËR DETYRËS ZYRTARE

Dukuria e keqpërdorimit të pozitës dhe autorizimeve zyrtare dhe, në përgjithësi, veprimi i kundërligjshëm i personave zyrtar, veçanërisht korrupsioni, ka herë janë të njohura dhe të inkriminuara në të drejtën penale. Mirëpo sistematizimi në të ashtuquajturat vepra penale zyrtare dhe radhitja e tyre në grupe të posaçme ndodh mjaft vonë, më saktë në legjislacionin penal të shekullit XIX. Prej atëherë fillon edhe përpunimi i rëndësishëm teorik i këtyre veprave penale.

Veprat penale kundër detyrës zyrtare paraqesin sjellje të kundërligjshme të drejtuara kundër funksionimit të rregullt të shërbimeve publike, të cilat i kryejnë personat e autorizuar apo personat zyrtarë gjatë ushtrimit të detyrës së tyre zyrtare apo lidhur me kryerjen e detyrës zyrtare. Kjo formë e kryerjes së veprës penale sot bie në kategorinë e kriminalitetit me shkallë të lartë të rrezikut për shoqërinë. Gjë që shprehet jo vetëm në

pasojat materiale që rezultojnë nga kryerja e këtyre veprave penale, por veçanërisht në rrënimin dhe çrregullimin e rrjedhave themelore të jetës shoqërore, duke atakuar vlerat morale të shoqërisë.

Marrja e ryshfetit(428)

Kjo vepër penale, së bashku me veprat penale të parashikuara nga neni 428 dhe neni 429 të KP, është pjesë e masave anti korrupsion në fushën e së drejtës penale, e domosdoshme kjo për mbrojtjen e pastërtisë, ligjshmërisë, objektivitetit, paanshmërisë dhe mos korrupsionit të organeve shtetërore dhe organeve të tjera, sepse të gjitha këto do të vireshin në dyshim, nëse personi zyrtar është i korruptuar, nëse mund të “blihet” veprimi zyrtar; autoriteti i aparatit shtetërore me këtë komprometohet; të gjitha veprimet dhe procedurat e atij organi vihen në dyshim. Qoftë edhe të izoluar, rastet e tilla shkaktojnë pakënaqësi tek opinioni i gjerë, bëjnë që të lindin dyshime ndaj paanshmërisë së aparatit shtetëror. Nëse kjo merr përmasa të një dukurie të gjerë, ajo mund t’i paralizojë tërësisht aparatit shtetëror dhe shërbimet e tjera, gjë që prodhon pasoja të mëdha negative dhe hap rrugën e mosndëshkimit të veprave penale të ndryshme, por edhe të veprave më të rënda penale. Në një situatë të tillë, më nuk mund të bëhet fjalë për një shoqëri të shëndoshë.

Vepra penale e marrjes së ryshfetit apo përfitimeve të tjera paraqet një vepër themelore dhe më të rëndësishmen nga kategoria e veprave penale me objekt korrupsionin. Fenomeni i korrupsionit në botën moderne nxit interesim ndërkombëtar dhe kombëtar. Kjo është e qartë, nëse kihet parasysh se kjo formë e kriminalitetit, pas terrorizmit, pastrimit të parasë, formave të ndryshme të trafikimit të njerëzve, kontrabandës së drogës dhe formave të tjera të kriminimit të organizuar transnacional, paraqet kërcënimin më të madh për shoqërinë dhe funksionimin e saj normal. Korrupsioni është një nga temat dominuese të shumë debateve ndërkombëtare; në planin e luftimit të kësaj të keqeje të së sotmes janë angazhuar aktivisht organizata të mëdha qeveritare dhe joqeveritare. Në mesin e organizatave joqeveritare, më e njohura është Transparency internacional, e cila në planin ndërkombëtar lufton kundër korrupsionit dhe publikon rezultatet e kërkimeve ndërkombëtare të korrupsionit, duke regjistruar shkallën e korrupsionit në shtete të caktuara.

Nga ajo që u tha rezultojnë kjo vepër penale, e cila te ne quhet korrupsioni pasiv dhe ka tri forma:

Paragrafi 1 përfshin veprën penale të korrupsionit të drejtë pasiv që paraqet formën më të rëndë të veprës penale të mitmarrjes;

Paragrafi 2 përfshin të ashtuquajturin korrupsionim jo të drejt pasiv (të rëndomtë) dhe

Paragrafi 3 përfshin të ashtuquajturin korrupsionim të mëvonshëm.

- 1) Korrupsioni jo i drejtë pasiv (par. 1) ekziston kur personi zyrtar kërkon apo merr ryshfet apo premtimin për ryshfet për të kryer veprimin zyrtar të cilin duhet ta kryente, përkatësisht të mos e kryejë veprimin zyrtar të cilin nuk do të duhej ta kryente.

- 2) Korruptimi pasiv i drejtë (par. 2) ekziston kur personi zyrtar apo ai përgjegjës kërkon apo merr dhuratë a ndonjë përfitim tjetër ose pranon premtimin për dhuratë a ndonjë përfitim tjetër për vete "apo për personin tjetër" në mënyrë që, në kuadër të autorizimeve të tij të kryejë një veprim zyrtar apo një veprim tjetër të cilin ai nuk do të duhej ta kryente ose të mos e kryejë një veprim zyrtar a një veprim tjetër të cilin ai duhet apo ka mundur ta kryente.

Vepra penale nga paragrafi 3.merr prima cilësuese, kur kryesi veprës penale nga paragrafi 1.ka realizuar përfitim në vlerë që tejkalon pesmbdhjetëmijë(15.000) Euro.

Kryerës i veprës penale të të gjitha formave mund të jetë vetëm personi zyrtar apo personi përgjegjës. Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje direkte. te kjo vepër penale tentativa nuk është e mundur.

Dhënia e ryshfetit(429)

Nga përshkrimi ligjor i veprës penale rezulton se bëhet fjalë për formën e dytë të korrupsionit, e cila është e lidhur funksionalisht me veprën penale të parashikuar nga neni 428 i KPK. Me këtë vepër penale personi zyrtar shtyhet në shkeljen e kryerjes ligjore të detyrës. Për dallim nga veprat e tjera penale të këtij grupi, të cila mund t'i kryejë vetëm personi zyrtar, veprën penale të dhënies së dhuratës apo një përfitimi tjetër, e kryen personi i cili nuk e ka cilësinë e personit zyrtar dhe kur atë e kryen personi zyrtar, ai atë nuk e kryen gjatë kryerjes së detyrës. Prandaj me këtë vepër zyrtare detyra rrezikohet nga jashtë e jo nga brenda, sikundër ngjan me veprat tjera të këtij grupi. Edhe pse bëhet fjalë për vepër penale jozyrtare, ajo me të drejtë është radhitur në këtë grup të veprave penale, ngase është e lidhur me kryerjen apo moskryerjen e detyrës zyrtare, përkatësisht me pranimin e dhuratave apo formave të tjera të përfitimeve.

Sikurse edhe te pranimi i dhuratave, ashtu edhe te këto vepra penale ligji dallon rastet kur dhurata jepet për kryerjen e detyrës së kundërligjshme apo mosndërmarrjen e detyruar të veprimeve nga rastet kur dhurata jepet për kryerjen e detyrës së ligjshme apo që të mos kryhet një veprim i tillë, i cili edhe pa dhuratë nuk do të lejohej të kryhej. Përpos kësaj, ligji posaçërisht parashikon edhe ndërmjetësimin në njëerën apo tjetrën formë të korrupsionit të personave zyrtarë apo përgjegjës. Edhe këtu ligji nuk e inkriminon këtë vepër penale edhe si korrupsion të mëvonshëm. Mirëpo, nëse dhurata e dhënë është kontraktuar më parë, atëherë ajo është e ndëshkueshme, por në rrethana të tilla nuk bëhet fjalë për korrupsion të mëvonshëm.

Në paragrafin 1. parashikohet i ashtuquajtimi korrupsion jo i drejtë aktiv dhe ai qëndron në dhënien apo premtimin e dhuratës personit zyrtar a personit përgjegjës që ai, në kuadër të autorizimeve të veta, të kryejë detyrën zyrtare të cilën ka qenë i detyruar ta kryejë apo të mos e kryejë detyrën zyrtare të cilën nuk do t'i lejohej ta kryente apo kush ndërmjetëson në rastin e korrupsionit të këtillë të personit zyrtar ose personit përgjegjës.

Sipas paragrafit 2, vepra penale e dhënies së dhuratës apo formave të tjera të përfitimit, e njohur si dhënie e ryshfetit, (i ashtuquajtimi ryshfet aktiv), ekziston kur dikush personit zyrtar apo personit përgjegjës i jep ose i premtim dhuratë a ndonjë

E DREJTA PENALE

përfitim tjetër që ai, në kufijtë e autorizimeve të tij, të kryejë një veprim zyrtar i cili nuk lejohet të kryhet apo të mos e kryejë veprimin të cilën do të duhej ta kryente (i ashtuquajtimi korrupsion i drejtë aktiv).

Kryerës i veprës penale mund të jetë çdo person.

Vepra penale mund të kryhet vetëm me dashje.

Vepra penale nga paragrafi 3.merr primesa cilësuese, kur vlera e përfituar me vepër penale nga paragrafi 1. tejkalon pesmbdhjetëmijë(15.000) Euro. Kjo dispozitë ligjore është identike me dispozitën e paragrafit 3.të nenit 428 edhe pse këtu kemi një situatë ndryshe kemi të bëjmë me dhënien e ryshfetit. Do duhej të ishte “nëse shuma e ryshfetit të dhënë” tejkalon pesmbdhjetëmijë (15.000) Euro.

Në paragrafin 4 është parashikuar një bazë e posaçme për lirimin nga dënimi për këtë vepër penale, me kusht që ryshfeti të jetë dhënë me kërkesë të personit zyrtar apo të personit përgjegjës dhe që kryerësi ta ketë paraqitur atë para se vepra penale të zbulohet apo para se të mësojë që vepra penale është zbuluar, (i ashtuquajtimi pendim i vërtetë).

■ E DREJTA E PROCEDURES PENALE (PJESA E PARË)

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Çdo procedurë që udhëheq një organ i autorizuar për të zbatuar ligjin ka parimet e veta themelore. Edhe procedura penale i ka parimet e veta dhe ato përmbahen në dispozitat e Kapitullit të parë të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, në tekstin vijues KPPK. Shumica nga këto parime në të njëjtën kohë janë edhe parime të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të parapara në Kapitullin e dytë të drejtat dhe liritë themelore.

Në krahasim me legjislacionin e më parëm në këtë lëmi risitë kryesore janë parimet mbi paanshmërinë e gjykatave, parimi akuzator dhe ai mbi barabarësinë e armëve të palëve në procedurë.

Parimi akuzator dhe ai i ndjekjes penale sipas detyrës zyrtare i ndjekjes penale parashihen në dispozitat e nenit 6 të KPPK.

Paditës të autorizuar për të ndërmarrë ndjekjen penale është prokurori publik.

Për veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare prokurori publik detyrohet të fillojë procedurën penale përveç në rastet nga dispozitat e neneve 230 dhe 231 të KPPK.

Për veprat penale që ndiqen në bazë të propozimit të të dëmtuarit, prokurori publik me rastin e fillimit të procedurës penale duhet të dëshmojë në gjykatë se ka siguruar propozimin të tillë.

Bazë për të filluar ndjekjen penale është ekzistimi i dyshimit të arsyeshëm së një person ka kryer veprë penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare.

Prokurori Publik ndërmerr ndjekjen penale sipas detyrës zyrtare për të gjitha veprat penale të parapara në Kodin Penal të Kosovës, në tekstin vijues KPK.

Barazia e palëve (parimi i barabarësisë së armëve).

Parimi i barazisë para ligjit është parim themelor që buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Ky akt juridik këtë parim e adreson në nenin 24. Sipas zgjidhjes së dhënë në këtë nen të gjithë qytetarët janë të barabartë para ligjit

Ky parim gjen shprehje edhe te një numër i madh i dispozitave ligjore të përfshira në Kodin e Procedurës Penale. Megjithatë dispozita më përmbajtjesore janë ato të dizajnuara në nenin 9 të këtij Kodi. Sipas zgjidhjes së dhënë në paragrafin 1 të këtij neni në procedurë penale, përveç nëse me këtë Kod parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit kanë pozitë të barabartë. Si rrjedhojë, i pandehuri ka të drejtë të deklarohet dhe atij duhet t'i lejohet deklarimi për të gjitha faktet dhe provat që e ngarkojnë dhe t'i paraqes të gjitha faktet dhe provat që janë në favor të tij. Ai ka të drejtë t'i marrë në pyetje ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët kundër tij dhe të kërkojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte

të njëjta që vlejnë për dëshmitarët kundër tij (paragrafi 2 i nenit 9 i KPP). Po kështu, edhe prokurorit të shtetit i mundësohet t'i paraqes të gjitha faktet mbi të cilat mbështetë aktakuzën si dhe të propozoj prova për vërtetësinë e tyre. Në mbështetje të këtij parimi është edhe paragrafi 3 i këtij neni. Sipas zgjidhjes së dhënë në këtë dispozitë ligjore i dëmtuari ka të drejtë dhe i lejohet të bëj deklaratë për të gjitha faktet dhe provat që ndikojnë në të drejtat e tij. Rrjedhimisht, ai ka të drejtë të marrë në pyetje dëshmitarët, t'u parashtrij pyetje të tërthorta dëshmitarëve të palës tjetër dhe të kërkoj nga prokurori i shtetit që të thirren dëshmitarët.

KOMPETENCAT E GJYKATAVE

Gjykata para se të filloj me gjykimin e rastit konkret duhet t'i sqaroj dy çështje. Së pari duhet të sigurohet se çështja e shtruar për gjykim a është apo jo vepër penale, dhe së dyti duhet të verifikoj nëse çështja penale është në kompetencë të saj apo të ndonjë gjykate tjetër. Vetëm duke vepruar kështu mundësohet një fillim dhe zhvillim i procedurës penale në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi. Një çështje e caktuar që i takon juridiksionit gjyqësor penal nuk mund të shqyrtohet nga çdo gjykatë. Kjo është çështje të cilën e zgjidhë ligji përmes përcaktimit të kompetencës. Së këndejmi, kompetenca paraqet të drejtë dhe detyrë të një gjykate që të zgjidhë një çështje penale konkrete. Marrë në përgjithësi ekzistojnë këto lloje të kompetencës: kompetenca lëndore, territoriale, personale dhe funksionale.

KOMPETENCA LËNDORE

Kompetenca lëndore është e drejtë dhe detyrë e përcaktuar me ligj e gjykatës konkrete që në procedurë penale të ndërmarrë veprime procedurale dhe të gjykoj veprat penale, varësisht nga natyra dhe rëndësia e tyre. Kjo kompetencë në vështrim të zgjidhjeve të adresuara me Ligjin për Gjykatat, ka të bëjë me përgjegjësitë e departamenteve përkatëse të gjykatave të cilave u është dhënë autorizimi për gjykimin e çështjeve penale si dhe niveleve (shkallë e parë apo e dytë) në të cilat ndodhet gjykimi i rastit konkret. Së këndejmi, fillimisht do të bëhet fjalë për kompetencën lëndore të gjykatës themelore, pastaj të Gjykatës së Apelit dhe në fund të Gjykatës Supreme të Kosovës.

Kompetenca dhe përbërja e gjykatës themelore

Sipas nenit 11 të Ligjit për Gjykatat gjykata themelore ka kompetencë:

1. Të gjykoj në shkallë të parë gjitha çështjet penale, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe;
2. Të ofroj ndihmën juridike ndërkombëtare dhe të vendosë për pranimin e vendimeve të gjykatave të huaja.

Gjykimi i çështjeve penale në nivel të gjykatës themelore i është lënë në kompetencë Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit për të Mitur, Departamentit të Përgjithshëm apo ndonjë departamenti dhe divizioni tjetër të themeluar brenda gjykatës përkatëse sipas paragrafit 3 të nenit 8 të Ligjit për Gjykatat (psh divizioni për çështje

kundërvajtëse). Së këndejmi, Departamenti për Krime të Rënda gjykon veprat penale nga neni 22 të KPP, çfarëdo krimi tjetër që nuk gjendet i listuar në këtë nen i cili bie nën kompetencën ekskluzive apo vartëse të Zyrës së Prokurorisë Speciale të Kosovës siç përcaktohet në Ligjin mbi Prokurorinë Speciale Nr. 03/L-52 (13.03.2008), dhe çfarëdo krimi tjetër të dënueshëm me 10 ose më shumë vjet burgim siç parashihet me ligj.

Departamenti për të Mitur ka kompetencë të gjykoj të gjitha çështjet penale në të cilat si të pandehur paraqiten të miturit si dhe kur gjykohej personat madhor për veprat penale të kryera ndaj fëmijëve, siç parashihet me Kodin e Drejtësisë për të Mitur (paragrafi 2 i nenit 21 i KPP).

Ndërkaq, në kontekst të zgjidhjeve të adresuara në nenin 16 të Ligjit për Gjykatat, Departamentit të Përgjithshëm i është lënë në kompetencë që në shkallë të parë të vendosë për të gjitha veprat penale, përjashtuar veprat penale të lartpërmendura për të cilat, siç u theksua më lart, kompetenca i takon Departamentit për Krime të Rënda, Departamentit për të Mitur apo ndonjë departamenti apo divizioni të themeluar sipas paragrafit 3 të nenit 8 të Ligjit për Gjykatat (paragrafi 3 i nenit 21 i KPP).

Në kuadër të Gjykatës themelore në Prishtinë përpos tri departamenteve që i kanë të gjitha gjykatat ekzistojnë edhe departamenti për Çështje Ekonomike dhe departamenti për Çështje administrative për gjithë territorin e Republikës së Kosovës(neni 12 par.1.1.dhe 1.2. të Ligjit për Gjykatat.

Në realizimin e funksionit të gjykimit të çështjeve penale gjykata themelore vepron në përbërje individuale dhe kolegjiale. Në këtë aspekt, në përbërje individuale vepron gjyqtari i vetëm i gjykatës themelore të cilit i është lënë në kompetencë t'i gjykoj, të gjitha veprat penale të cilat përndryshe nuk janë kompetencë e Departamentit për Krime të Rënda apo të trupit gjykues për të mitur që vepron në kuadër të Departamentit për të Mitur.

Në këtë përbërje gjykata themelore vendosë edhe në procedurën paraprake dhe në procedurën për shqyrtimin e aktakuzës. Më në fund, në përbërje individuale vepron edhe kryetari i gjykatës themelore dhe kryetari i trupit gjykues, kur vendosin për çështje tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Në përputhje me atë që u theksua, rezulton se në raste të tjera gjykata themelore vepron në përbërje kolegjiale. Së këndejmi, në trup gjykues prej tre gjyqtarësh gjykata themelore duhet të vendosë për të gjitha veprat penale për të cilat kompetenca i është dhënë Departamentit për Krime të Rënda si dhe rasteve kur vepron trupi gjykues në Departamentin për të Mitur, dmth. për të gjitha veprat penale për të cilat me ligj mund të shqiptohet dënim me burgim më pak se dhjetë vjet burgim i gjykon gjyqtari i vetëm, ndërsa për veprat penale për të cilat ligji parasheh dënim me dhjetë e më tepër burgim i gjykon trupi gjykues prej tre gjyqtarëve profesional, nga kjo rezulton se trupi gjykues i përzier me gjyqtar laik, do ekzistoj vetëm në procedurën ndaj të miturve.

Kompetenca dhe përbërja e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, konform nenit 18 të Ligjit për Gjykatat, ka kompetencë:

1. Të vendosë në shkallë të dytë për ankesat e ushtruara kundër vendimeve të gjykatave themelore;

3. Të zgjidhë konfliktin për kompetencë të lindur ndërmjet gjykatave themelore;

4. Të vendosë për çështjet tjera të parapara me ligj.

Edhe në kuadër të kësaj gjykate çështjet penale gjykohen në Departamentin e Përgjithshëm, Departamentin për Krime të Rënda dhe në Departamentin për të Mitur.

Përndryshe edhe Gjykata e Apelit vepron në përbërje individuale dhe kolegjiale. Në këtë aspekt, në përbërje individuale vepron Kryetari i Gjykatës së Apelit dhe kryetari i kolegjit kur vendosin për çështje tjera të përcaktuara me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Në përbërje kolegjiale Gjykata e Apelit vepron në të gjitha rastet tjera. Rrjedhimisht, sipas nenit 19 paragrafit 2 të Ligjit për Gjykatat, Gjykata e Apelit shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegji prej tre gjyqtarësh profesionistë, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

Kompetenca dhe përbërja e Gjykatës Supreme

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me nenin 22 të Ligjit për Gjykatat, kur janë në pyetje çështjet penale, ka këto kompetenca:

-të vendosë në shkallë të tretë, sipas ankesës që është lejuar me ligj;

-të vendosë për mjetet e jashtëzakonshme juridike të ushtruara kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës, siç është paraparë me ligj,

-të vendosë për çështje të tjera të parapara me ligj.

Përveç kompetencave të lartpërmendura, Gjykata Supreme ka kompetencë që të përcaktoj qëndrime parimore dhe mendime juridike për çështjet që kanë rëndësi për zbatimin unik të ligjeve.

Për zgjidhjen e çështjeve për të cilat është e autorizuar Gjykata Supreme vendosë në kolegji prej tre gjyqtarësh profesional.

Kompetenca territoriale

Kompetenca territoriale është e drejtë dhe detyrë e gjykatës që ta ndriçoj dhe ta zgjidhë një çështje penale në territorin e vet. Secila gjykatë vepron brenda një territori të njohur, pra ka një kompetencë territoriale të caktuar, që nënkupton se çdo vepër penale e kryer brenda atij territori është në kompetencë të saj. Megjithatë, mund të ndodhë që një vepër penale të filloj të kryhet në një territor dhe të përfundoj në territorin tjetër ose të jetë kryer në disa vende që nuk bëjnë pjesë në territorin ku shtrihet kompetenca e një gjykate, ose të mos dihet fillimisht se në cilin vend është kryer ajo vepër.

Kriteret parësore të përcaktimit të kompetencës territoriale

Kriteret parësore janë kritere bazë, themelore të cilat duhet të merren në konsideratë me rastin e përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës. Kriter i tillë para së gjithash është vendi i kryerjes së veprës penale, por këtu bëjnë pjesë edhe disa kritere të tjera të cilat në një mënyrë ose tjetër, janë të ndërlidhura me këtë kriter. Trajtimi i tyre vështruar në kontekst të radhës, do të bëhet duke marrë për bazë peshën që kanë ato në përcaktimin e këtij lloji të kompetencës.

Kriteret e përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës që ndërlidhen me vendin e kryerjes së veprës penale janë:

- c) *Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës sipas vendit të kryerjes së veprës penale. Ky është kriteri parësor i cili duhet të merret në konsideratë me rastin e përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës. Të këtillë e përcakton këtë kriter paragrafi 1 i nenit 29 i Kodit të Procedurës Penale. Konform kësaj dispozite ligjore e kompetencës territoriale, në radhë të parë është gjykata brenda territorit të së cilës është kryer ose është tentuar të kryhet vepra penale, ose brenda vendit ku është shkaktuar pasoja.*
- d) *Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës kur një vepër penale është kryer ose është tentuar të kryhet apo pasojat e saj janë shkaktuar në territorin e më shumë se të një gjykate ose në kufijtë e atyre territoreve (koneksiteti objektiv apo subjektiv).*

Në rastet kur një vepër penale është kryer ose është tentuar të kryhet apo pasojat e saj janë shkaktuar në territorin e më shumë se të një gjykate ose në kufijtë e atyre territoreve, gjykatë kompetente është ajo e cila e para e ka filluar procedurën gjyqësore si përgjigje në kërkesën e prokurorit të autorizuar, e nëse procedura nuk është filluar, kompetente është gjykata në të cilën së pari është dorëzuar kërkesa për fillimin e procedurës. Këtë kriter e përcakton paragrafi 2 i nenit 29 i Kodit të Procedurës Penale..

- e) *Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës për rastet e kryerjes së veprave penale në aeroplan.*

Këtë kriter e përcakton neni 30 i Kodit të Procedurës Penale. Konform zgjidhjes së dhënë në këtë nen, nëse vepra penale kryhet në aeroplan, kompetente është Gjykata Themelore e Prishtinës. Një zgjidhje e tillë vlerësohet, përveç si zgjidhje qartësuese, pa dyshim edhe pragmatike dhe atë, përveç tjerash, mbështetur edhe në faktin që ndërlidhet me kapacitetin profesional të cilin, si rregull e disponojnë gjykatat e kryeqytetit të çdo vendi krahasuar me gjykatat tjera.

- f) *Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës për rastet e kryerjes së veprave penale përmes mediave.*

Ky është kriteri i katërt (i fundit) parësor që duhet të merret në konsideratë me rastin e përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës. Ky kriter është përcaktuar me dy paragrafë të veçantë të nenit 31 të Kodit të Procedurës Penale. Sipas paragrafit 1 të këtij neni në rastet kur vepra penale është kryer nëpërmjet gazetës kompetente është

grykata në territorin e së cilës është shtypur gazeta. Megjithatë, kur ky vend nuk dihet ose gazeta është shtypur në botën e jashtme, kompetente është grykata në territorin e së cilës shpërndahet informacioni i shtypur.

Në rastet e veprave penale të kryera nëpërmjet shtypit, atëherë kur sipas ligjit për veprën penale të kryer përgjigjet autori i materialit të publikuar, ligjdhënësi me paragrafin 2 të nenit 31 të KPP ka përcaktuar se kompetente është grykata e vendit në të cilën autori e ka vendbanimin ose grykata në territorin e së cilës është zhvilluar ngjarja që ndërlidhet me materialin e publikuar. Rrjedhimisht, sa i përket kompetencës territoriale të grykatës, kur janë në pyetje këto lloje të veprave penale, ky paragraf ka paraparë aplikimin e përshtatshëm të zgjidhjeve të përmendura edhe në rastin kur materiali është shpallur nëpërmjet të radios, televizionit ose ndonjë lloji tjetër të publikimit.

Kriteret dytësore të përcaktimit të kompetencës territoriale

Përveç kriterëve të lartpërmendura të ashtuquajtura parësore, Kodi i Procedurës Penale me synimin që të ofroj zgjidhjet e duhura sa i përket përcaktimit të kompetencës territoriale të grykatës, për çdo situatë që mund të paraqitet, parasheh edhe disa kriterë plotësuese, të ashtuquajtura dytësore të përcaktimit të kompetencës territoriale të grykatës. Në këtë aspekt këto janë kriterë të cilat mund të merren në konsideratë vetëm në rastet kur përcaktimi i kompetencës territoriale mbështetur në kriteret parësore paraqitet si i pamundur. Kriterë të tilla janë tri: vendbanimi ose vendqëndrimi i të pandehurit, vendi i arrestimit të të pandehurit dhe kriteri i caktimit të kompetencës nga Grykata Supreme e Kosovës. Në vazhdim do të bëhet fjalë për secilin nga këto kriterë.

a) Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale sipas vendbanimit ose vendqëndrimit të të pandehurit.

Ky është kriteri i parë dytësor përmes të cilit përcaktohet kompetenca territoriale e grykatës. Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale të grykatës sipas vendbanimit ose vendqëndrimit të të pandehurit do të zbatohet në situatën kur kriteret parësore nuk dihen, gjegjësisht kur rrethanat e rastit imponojnë një zgjidhje të tillë. Së këndejmi, sipas paragrafit 1 të nenit 32 të Kodit të Procedurës Penale në rastet kur nuk dihet vendi i kryerjes ose vendi ku është tentuar të kryhet vepra penale e as vendi ku është shkaktuar pasoja e asaj veprë ose ai vend nuk është në territorin e Kosovës kompetente është grykata në territorin e së cilës i pandehuri ka vendbanimin ose vendqëndrimin. Natyrisht, ky kriter nuk vlen as në rastet tjera kur kompetenca territoriale e grykatës caktohet në mbështetje të kriterëve parësore p.sh., te rastet e kryerjes së veprës penale në aeroplan.

b) Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale sipas vendit të arrestimit ose të dorëzimit të të pandehurit.

Ky është kriteri i dytë dytësor i përcaktimit të kompetencës territoriale të grykatës. Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale të grykatës sipas vendit të arrestimit ose të dorëzimit të të pandehurit vjen në shprehje vetëm nëse nuk dihet vendi i kryerjes së veprës penale e as vendbanimi apo vendqëndrimi i të pandehurit ose të dyja këto

janë jashtë territorit të Kosovës. Në këto raste sipas paragrafit 3 të nenit 32 të Kodit të Procedurës Penale e kompetencës territoriale është gjykata në territorin e së cilës i pandehuri arrestohet ose vet u dorëzohet organeve të autorizuara.

- c) *Kriteri i përcaktimit të kompetencës territoriale përmes caktimit të saj nga Gjykata Supreme e Kosovës.*

Ky është kriteri i tretë dytësor i përcaktimit të kompetencës territoriale të gjykatës. Konform nenit 34 të Kodit të Procedurës Penale, Gjykata Supreme e Kosovës do të caktoj njëjërën nga gjykatat me kompetencë lëndore në të cilën do të zbatohet procedura që të gjykoj çështjen penale konkrete, në çdo rast kur sipas dispozitave të këtij Kodi, bazuar në kriteret e lartpërmendura, nuk mund të vërtetohet se cila gjykatë ka kompetencë territoriale për ta gjykuar një çështje të tillë. “Deri te një situatë e tillë mund të vij p.sh., kur dikush që nuk ka vendbanim ose vendqëndrim në Kosovë kryen vepër penale në botën e jashtme e pastaj në bazë të procedurës për transferim i dorëzohet vendit tonë.”

KALIMI I KOMPETENCËS TERRITORIALE

Kompetenca territoriale mund të kalohet nga një gjykatë në gjykatën tjetër me kompetencë lëndore në rastet kur gjykata kompetente është e penguar për shkaqe juridike ose reale të zbatojë procedurën. Kompetenca territoriale mund të kalohet vetëm për vendosjen e një lënde individualisht të caktuar e jo edhe për të gjitha lëndët që i ka në punë një gjykatë.

- a) *Kalimi i kompetencës për shkaqe reale dhe juridike.*

Nëse krijohet gjendje e tillë që ajo gjykatë fare s’mund ta ushtroj funksionin e saj(shkaqet reale) psh. gjykata nuk mund të formoj trupin gjykues pasi të gjithë gjyqtarët janë ftuar në mobilizim, për shkak të sëmundjes së gjyqtarëve, gjykata nuk mund të punoj për shkak të vërshimeve, tërmeteve, zjarreve, epidemive etj), atëherë problemi duhet zgjidhur në mënyrë tjetër (psh.dërgimi i përkohshëm i gjyqtarëve nga gjykata tjetër, zhvendosja e përkohshme e selisë së gjykatës, ndërrimi i objektit të gjykatës etj) e jo duke e bartë në tersi kompetenca territoriale nga një gjykatë në një gjykatë tjetër. Në situatën e tillë, kalimi i kompetencës në gjykatën tjetër, mund të bëhet vetëm në raport me lëndët që nuk mund të shtyhen.

- b) *Kalimi i kompetencës për shkaqe procedurale.*

Këtu kemi të bëjmë me kalimin (delegimin) e kompetencës për shkaqe të arsyeshme procedurale-oportuniteti procedural, (nëse është e qartë se procedura do zhvillohet më lehtë) ose për shkaqe tjera të rëndësishme(që s’kanë të bëjnë me oportunitetin procedural).

-arsyet e oportunitetit procedural janë të shumta(psh.në një ekskursion ka ardh deri te konflikti në mes të ekskursionistëve ku janë shkaktuar lëndimeve trupore të rënda në territorin e një gjykate tjetër të Republikës së Kosovës, dhe në kompetencën e kësaj gjykate nuk e ka vendbanimin i pandehuri, i dëmtuari e as dëshmitarët, përdorimi i dokumentit të falsifikuar në vendkalimin kufitar etj.).Në situatën e tillë do ishte më

oportune që procedura do zhvillohet në gjykatën ku i pandehuri, të dëmtuarit dhe dëshmitarët kanë vendbanimin.

-shkaqet tjera të rëndësishme, nuk janë përcaktuar me ligj dhe ndodhen jashtë oportunitetit procedural, e ato mund të jenë nga më të ndryshmet psh. ekziston mundësia që të vij deri te protestat nëse procesi mbahet pran gjykatës kompetente, shqetësimet e popullsi vendore lidhur me procesin, mundësitë e ndikimit në rrjedhën e procesit nëse i pandehuri apo i dëmtuari janë gjyqtarët e po asaj gjykate etj.

Kompetenca territoriale një herë e kaluar mbetet tek ajo gjykatë gjer në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë.

Kush e bënë kalimin e kompetencës

Deri sa me kodin e mëhershme, kalimin e kompetencës nga territori i një gjykate të qarkut në territorin e një gjykate tjetër të qarkut të Republikës së Kosovës e bënte Gjykata Supreme, tani me fillimin e aplikimit të Ligjit të Ri për Gjykatat dhe Kodit të ri të procedurës penale, kalimin e kompetencës nga territori i një gjykate themelore në territorin e një gjykate tjetër themelore e bënë Gjykata e apelit, vetëm po qe se nuk ka marrëveshje për kalim kompetence në mes të gjykatave.

Në rastet kur gjykata themelore kompetente për shkaqe juridike ose faktike është penguar të zbatojë procedurën, pas dëgjimit të palëve, kryetari i asaj gjykate mund të kaloj procedurën te një degë tjetër brenda gjykatës themelore kompetente. Në qoftë se kalimi i tillë i kompetencës, për arsye të caktuara nuk është i mundshëm, atëherë kryetari i gjykatës themelore kompetente duhet të konsultohet me një tjetër gjykatë themelore që ka kompetencë lëndore në mënyrë që të arrijnë të pajtohen për transferimin e procedurës. Në qoftë se dy gjykatat themelore brenda dhjetë ditëve nuk arrijnë pajtueshmëri lidhur me transferimin e procedurës, cilado prej tyre e njofton menjëherë për këtë Gjykatën e Apelit, e cila do të caktoj njërën nga gjykatat për të zbatuar procedurën (paragrafët 2-4 të nenit 37 të KPP).

MUNGESA DHE KONFLIKTI I KOMPETENCËS

Gjatë ushtrimit të kompetencave mund të lindin konflikte midis gjykatave. Në të vërtetë konflikti i kompetencës ekziston atëherë kur dy ose më shumë gjykata konsiderojnë se kanë kompetencë territoriale apo konsiderojnë se u mungon kompetenca e tillë për të vendosur lidhur me një çështje penale. Siç shihet konflikti i kompetencës mund të jetë pozitiv dhe negativ. Konflikti është pozitiv kur dy ose më shumë gjykata konsiderojnë se janë kompetente të vendosin lidhur me një çështje penale, kurse negativ kur konsiderojnë se asnjëra prej tyre nuk është kompetente.

Zgjidhjet e reja ligjore vejnë në dukje faktin se në lidhje me çështjet penale konflikti për kompetencë mund të lindë vetëm midis gjykatave themelore. Kjo për faktin se nga 1 janari i vitit 2013 Kosova do të ketë vetëm një gjykatë të shkallës së dytë, Gjykatën e Apelit, dhe kjo është e vetmja gjykatë e cila konform paragrafit 3 të nenit 18 të Ligjit për Gjykatat, ka kompetencën për të zgjidhur konfliktin e lindur ndërmjet gjykatave themelore.

Për kompetencën e vet lëndore dhe territoriale gjykatat janë të detyruara të kujdesen sipas detyrës zyrtare. Gjykata që vlerëson se nuk ka kompetencë lëndore apo territoriale për të vendosur një çështje penale do të shpallet jo kompetente dhe gjykatës kompetente do t'ia dërgoj lëndën pasi aktvendimi mbi shpalljen e jo kompetencës të merr formën e prerë.

Kompetenca territoriale mund të kontestohet nga palët dhe gjykata mund të shpallet inkompetente në pikëpamje të territorit vetëm derisa aktakuza të marr formën e prerë.

Ndërsa sa i përket kompetencës reale-lëndore gjykata janë të detyruar të mbajnë llogari gjatë gjithë procedurës dhe në momentin kur konstatojnë se nuk kanë kompetencë lëndore ndërprejnë çdo procedim të mëtutjeshëm, me përjashtim të veprimeve procedurale për të cilat ekziston rreziku nga vonesa (psh. skadimi i afatit të paraburgimit ndaj të pandehurit). Nëse departamenti për krime të rënda gjatë shqyrtimit konstaton se kompetencë lëndore ka departamenti i përgjithshëm nuk e ndërpretë procedurën për t'ia dërguar çështjen departamentit të përgjithshëm por vet i vendosë çështjen. Kodi i ri i Procedurës Penale, ka lëshuar të rregulloj çështjen kur kemi të bëjmë me konflikt kompetence lëndore dhe ka rregulluar vetëm konfliktin e kompetencës territoriale.

Kujdesi për kompetencën lëndore dhe territoriale ka bazën në nenin 2 të KPPK, sipas së cilit vetëm gjykata kompetente e pavarur dhe e paanshme mund t'i shqiptojë kryesit të veprës penale sanksionin penal në procedurë të filluar dhe zbatuar në bazë të KPPK.

Kompetenca personale

Në raste të caktuara edhe cilësia e kryerësit të veprës penale ka rëndësi në përcaktimin e kompetencës. Në situata të tilla është fjala për kompetencë personale. Në sistemin tonë juridik kur është në pyetje çështja penale, kjo kompetencë vjen në shprehje vetëm në rastet kur i mituri kryen vepër penale. Në raste të tilla për gjykimin e të miturit është kompetent gjyqtari për të mitur, gjegjësisht trupi gjykues për të mitur

i gjykatës kompetente, të cilët në përputhje me Ligjin për Gjykatat, do të veprojnë në Departamentin për të Mitur.

Çështjet që kanë të bëjnë me kompetencën personale, në disa shtete vijnë në shprehje edhe në rastet kur i pandehuri është person ushtarak. Së këndejmi, në një numër të caktuar shtetesh për gjykimin e këtyre personave janë kompetente gjykatat ushtarake.

Kompetenca funksionale

Kjo kompetencë caktohet në bazë të llojit të veprimeve dhe punëve që ushtrohen në një gjykatë. Pra, kjo kompetencë përcakton se kush dhe në çfarë përbërje duhet të veproj brenda një gjykate. Në këtë rrjedhë, kompetenca funksionale përcaktohet si e drejtë dhe detyrë e gjykatës që në përbërje individuale ose kolegjiale të zhvilloj ndonjë veprim ose disa veprime procedurale penale në një fazë të caktuar të procedurës. Siç është theksuar më lart, në përbërje individuale vepron gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues dhe kryetari i gjykatës. Kurse në përbërje kolegjiale vepron trupi gjykues dhe kolegji gjyqësor.

Bashkimi dhe veçimi i procedurës

Siç është theksuar më lart, në procedurë penale në disa raste mund të vij deri te bashkimi apo veçimi i procedurës. Situatat e tilla vijnë në shprehje te rastet e lidhshmërisë apo koneksitetit të veprave penale, gjegjësisht kryerësve të tyre. Koneksiteti (lidhshmëria) e veprave penale apo e kryerësve të tyre ekziston atëherë kur një person ka kryer disa vepra penale në bashkim, kur disa persona kanë kryer një vepër penale dhe kur disa persona kanë kryer disa vepra penale. Pra, koneksiteti mund të jetë subjektiv (lidhja në mes të veprave penale është realizuar përmes personalitetit të kryerësit të veprës penale), objektiv (lidhja në mes lëndëve penale të secilit të pandehur bëhet nëpërmjet veprës penale) dhe objektiv-subjektiv (kur vijnë në shprehje të dy format e këtyre lidhjeve).

PËRJASHTIMI ARSYET E PËRJASHTIMIT

Përjashtimi i gjyqtarëve

Me emërimin gjyqtar personi i tillë fiton aftësinë absolute që të ushtroj funksionin e gjykimit. Mirëpo, posedimi i aftësisë absolute për gjykim nuk do të thotë se gjyqtari me rastin e gjykimit të një çështje konkrete do të jetë objektiv. Në të vërtetë mund të ekzistojnë raste kur ndonjë raport ekzistues (personal, pasuror, familjar, procedural etj.) ndërmjet gjyqtarit dhe çështjes penale konkrete apo kryerësit të saj të shkaktojnë dyshim të arsyeshem në objektivitetin e gjyqtarit nëse atij i lihet zgjidhja e asaj çështje penale. Në të vërtetë është vështirë që gjyqtari ose të mbetet krejtësisht objektiv në çështjen për të cilën materialisht ose moralisht është i interesuar. Sidoqoftë, edhe sikur të ishte plotësisht objektiv, nuk është e arsyeshme që në atë rast konkret atij t'i lejohet ndarja e drejtësisë, sepse opinionin publik dhe palët mund të dyshojnë me arsye në objektivitetin dhe paanësinë e tij. Kjo me siguri do t'i sillte dëm prestigjit dhe autoritetit të gjykatës. Për këtë arsye e drejta e procedurës penale e njeh institutin e përjashtimit të gjyqtarit në çështjen konkrete.

Në procedurë penale ekzistojnë shkaqe të ndryshme të cilat mund të sjellin deri te përjashtimi i gjyqtarit, nga gjykimi. Pësia e këtyre shkaqeve është e natyrave të ndryshme.

Sidoqoftë, konform nenit 39 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari duhet të përjashtohet nga ushtrimi i funksionit gjyqësor në rastin kur ai është:

1. I dëmtuar me vepër penale. Dëmi mund të jetë i karakterit material ose moral dhe ai zakonisht lindë nga marrëdhëniet e gjyqtarit me personin konkret i cili paraqitet në cilësi të personit të akuzuar. I tillë p.sh., mund të jetë rasti kur gjyqtari është viktimë e veprës penale të lëndimit trupor;

2. Bashkëshort, bashkëshort jashtëmartesor, person në afri gjinie në vijë të drejtë në çfarëdo shkalle ose në vijë anësore deri në shkallën e katërt, person në afri krushqie deri në shkallën e dytë me të pandehurin, mbrojtësin e tij, prokurorin e shtetit, të dëmtuarin, përfaqësuesin e tij ligjor ose përfaqësuesin e autorizuar;

3. Kujdestar ligjor, nën kujdestari ligjore, fëmijë i adoptuar ose prind adoptues, prind birësues ose fëmijë i birësuar i të pandehurit, mbrojtësit të tij, prokurorit të shtetit ose të dëmtuarit;

4. Në çështjen e njëjtë penale ka marrë pjesë në procedurë si prokuror, mbrojtës, përfaqësues ligjor, përfaqësues i autorizuar i të dëmtuarit ose është pyetur si dëshmitar apo ekspert.

5. Ekziston konflikti i interesit siç përcaktohet në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik. Në këtë rast, fjala është për ekzistimin e çfarëdo rrethane që e lidh gjyqtarin me ndonjë interes konkret që ndërlidhet me çështjen penale konkrete apo edhe më gjerë.

Rrjedhimisht, gjyqtari përjashtohet nga gjykimi i rasti konkret nëse duke qenë gjyqtar i vetëm gjykues, kryetar i trupit gjykues, anëtar i trupit gjykues, anëtar i Kolegjit

të Apelit apo Kolegjit të Gjykatës Supreme ka marrë pjesë në procedura të mëhershme në të njëjtin rast penal. Pavarësisht kësaj, nuk do të mund të përjashtohet nga gjykimi i rastit konkret gjyqtari që ka shërbyer në kolegjin e mundësisë hetuese të veçantë, si dhe gjyqtari që ka qenë vetëm i përfshirë në procedurat e mëparshme në të njëjtën çështje penale, si një anëtar i një paneli shqyrtues (paragrafi 2 i nenit 39 i KPP).

Përveç rasteve të lartcekura gjyqtari mund të përjashtohet nga gjykimi edhe në situatat kur prezantohen dhe vërtetohen rrethana që e venë në dyshim paanshmërinë e tij, ose që duken të papërshtatshme. Një mundësi e tillë e parashikuar me nenin 39.3 të Kodit të Procedurës Penale.

Procedura për përjashtim mund të iniciohet sipas detyrës zyrtare nga vet gjyqtari ose me iniciativën e palës procedurale penale. Në këtë aspekt, gjyqtari posa të mësoj se ekziston ndonjëra prej arsyeve për përjashtim ai duhet të ndërpres çdo aktivitet lidhur me çështjen dhe për këtë e njofton kryetarin e gjykatës, i cili sipas rregullave e procedurave të brendshme të gjykatës cakton zëvendësimin e tij. Kur është fjala për përjashtimin e kryetarit të gjykatës themelore zëvendësimin e tij do ta caktoj kryetari i Gjykatës së Apelit (paragrafi 1 i nenit 40 i KPP).

Në qoftë se gjyqtari konstaton se ekzistojnë rrethana të cilat arsyetojnë përjashtimin e tij nga neni 39, paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale (rrethana që venë në dyshim paanshmërinë e tij, të ashtuquajtura rrethana fakultative), ai për këtë duhet ta njoftoj kryetarin e gjykatës. Në këtë rast gjyqtarit të tillë i lejohej mundësia që të ndërmerri veprime të cilat janë domosdo të nevojshme për të penguar shtyrjen ose vonesën e palejueshme të çështjes. Një mundësi e tillë gjyqtari mund ta realizojë vetëm deri sa të merret vendimi për përjashtim (paragrafi 2 i nenit 40 i KPP). Në të kundërtën, gjyqtari është i obliguar që të ndërpres menjëherë çdo veprim në lidhje me atë çështje (neni 43 i KPP).

Përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi mund ta kërkojnë edhe palët. Pala mund të kërkoj përjashtimin e gjyqtarit sapo të ketë mësuar për ekzistimin e arsyeve për përjashtim, e më së largu deri para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa te rastet e përjashtimit të ashtuquajtur fakultativ përjashtimi duhet kërkuar para fillimit të shqyrtimit gjyqësor. Kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit të Gjykatës së Apelit apo Gjykatës Supreme pala mund ta bëjë në ankesë ose në përgjigje të ankesës. Përndryshe pala mund të kërkoj vetëm përjashtimin e gjyqtarit konkret duke e identifikuar atë me emër. Kërkesa për përjashtim parashtrohet me akt të shkruar i cili duhet të përmbaj shkaqet (rrethanat) që mbështesin pretendimin për ekzistimin e bazës ligjore për përjashtim. Shkaqet e paraqitura në kërkesën e mëparshme për përjashtim e cila është refuzuar nuk mund të paraqiten përsëri në kërkesë (neni 41 i KPP).

Për kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit vendosë kryetari i gjykatës. Po qe se kërkohet përjashtimi i kryetarit të gjykatës themelore ose i kryetarit të gjykatës themelore dhe gjyqtarit tjetër të së njëjtës gjykatë si dhe të një gjyqtari të Gjykatës së Apelit vendimin për përjashtim e merr kryetari i Gjykatës së Apelit. Në rast se kërkohet përjashtimi i kryetarit të Gjykatës së Apelit, kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe gjyqtarit tjetër të së njëjtës gjykatë ose i gjyqtarit të Gjykatës Supreme të Kosovës vendimin për këtë e merr kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, ndërsa për kërkesën

për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës ose të kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës dhe gjyqtarëve tjerë të së njëjtës gjykatë vendosë kolegji i kryesuar nga zëvendëskryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës (nënparagrafët 1.1-1.4 të paragrafit 1 të nenit 42 të KPP).

Para marrjes së vendimit për përjashtim të gjyqtarit, sipas rregullit, bëhen hetime të nevojshme (paragrafi 2 i nenit 42 i KPP). Kundër aktvendimit me të cilin lejohet kërkesa për përjashtim nuk është e lejuar ankesa. Ndërsa kur kërkesa e tillë është refuzuar kundër aktvendimit të marrë mbi këtë çështje mund të ushtrohet ankesë e posaçme. Megjithatë, kur aktvendimi është marrë pas ngritjes së aktakuzës, aktvendimi i tillë mund të goditet vetëm me ankesë kundër aktgjykimit (paragrafi 3 i nenit 42 i KPP).

Në qoftë se kërkesa për përjashtim është bërë pa e përcaktuar identitetin e gjyqtarit dhe pa i shënuar rrethanat në të cilat mbështetet pretendimi për ekzistimin e bazës për përjashtim ose kërkesa për përjashtim fakultativ është parashtruar pas fillimit të shqyrtimit gjyqësor, kërkesa hedhet poshtë në tërësi ose pjesërisht. Kundër aktvendimit me të cilin është refuzuar një kërkesë e tillë nuk është e lejuar ankesa.

Aktvendimin e tillë e merr kryetari i gjykatës, kurse në shqyrtim gjyqësor trupi gjykues. Në rast se vendimin e merr trupi gjykues gjyqtari përjashtimi i të cilit kërkohet mund të marrë pjesë në marrjen e atij vendimi (paragrafi 4 i nenit 42 i KPP).

Në nenin 44 të Kodit të Procedurës Penale janë adresuar shkaqet për përjashtimin e prokurorëve të shtetit. Shkaqet e tilla janë plotësisht identike me shkaqet e përjashtimit të gjyqtarëve. Rrjedhimisht, sipas paragrafit 2 të këtij neni prokurori i shtetit është përherë i detyruar që të përjashtoj veten sapo të ketë mësuar për ekzistimin e arsyeve për përjashtimin e tij. Në këtë aspekt, nëse prokurori i shtetit kundërshton përjashtimin e tij, ai detyrohet të kërkoj vendim lidhur me këtë nga prokurori i shtetit që është më i lartë se ai. Së këndejmi, kryeprokurori i zyrës vendosë mbi përjashtimin e prokurorit të shtetit të zyrës së tij, ndërsa Kryeprokurori i Shtetit jep vendimin përfundimtar mbi përjashtimin e një prokurori të shtetit të zyrës së tij. Për përjashtimin e Kryeprokurorit të Shtetit vendosë “Këshilli Prokurorial i Kosovës” në seancë plenare. Çdo vendim i marrë lidhur me përjashtimin e prokurorëve kërkohet të jetë i bërë me shkrim dhe t’i dorëzohet prokurorit të shtetit të cilit i referohet dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës (paragrafi 3 i nenit 44 i KPP).

Për përjashtimin e procesmbajtësit, përkthyesit, specialistit dhe ekspertit vendosë kryetari i trupit gjykues, gjyqtari i vetëm gjykues, gjyqtari i procedurës paraprake ose kryetari i kolegjit shqyrtues apo kolegjit ankimor, në vartësi të rrjedhës së procedurës dhe çështjes penale (paragrafi 1 i nenit 45 i KPP).

Për përjashtimin e zyrtarit policor që zbaton veprime hetimore vendosë prokurori i shtetit, kurse për përjashtimin e procesmbajtësit që merr pjesë në zbatimin e hetimeve vendosë personi zyrtar që i ndërmerr veprimet e tilla (paragrafi 2 i nenit 45 i KPP). Krite të ngjashme si në raste të përjashtimit të gjyqtarëve janë vendosur edhe lidhur me përjashtimin e mbrojtësit të viktimave. (paragrafi 3 i nenit 45 i KPP).

PROKURORI SHтетIT

Palët procedurale penale

Sipas legjislacionit procedural penal në fuqi cilësinë e palës procedurale penale në procedurë penale e ka prokurori i shtetit i pandehuri dhe i dëmtuari (neni 19.pika 1.15.). Ky legjislacion ka vendosur korniza të qarta të cilat garantojnë, pothuajse pozicion të barabartë të palëve gjatë zhvillimit të procedurës penale.

Prokurori i shtetit

Prokurori i shtetit është organ kushtetues që organizohet dhe funksionon në përputhje me dispozitat që rregullojnë veprimtarinë e tij. Themi se është organ kushtetues sepse autoriteti i tij, në rend të parë buron nga dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, me paragrafin 1 të nenit 109 të këtij akti juridik është përcaktuar se “Prokurori i shtetit është institucion i pavarur me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë veprë penale ose për ndonjë veprë tjetër, sikurse është rregulluar me ligj.” Kosova, konform legjislacionit në fuqi ka Kryeprokurorin e Shtetit, gjegjësisht Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit, Prokurorinë e Apelit, Prokurorinë Speciale dhe Prokuroritë Themelore. Sipas paragrafit 1 të nenit 3 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit “Prokurori i shtetit është institucion i pavarur që ushtron funksionet e veta në mënyrë të paanshme.” Ai dhe secili prokuror tjetër para ligjit siguron trajtim të barabartë, objektiv dhe pa paragjytime për të gjithë personat pavarësisht gjinisë, racës, prejardhjes kombëtare apo sociale, shoqatave apo lidhjeve politike, besimeve fetare, gjendjes apo të metave shëndetësore apo pozitës shoqërore (paragrafi 2 i nenit 3 i LPSH).

Pavarësia e prokurorëve shtetëror konsiston në faktin se ligjdhënësi përmes paragrafit 3 të nenit 3 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit decidivisht ka ndaluar mundësinë që personat fizikë e juridikë kushdo qofshin ata të mund të ndërhyjnë, pengojnë, ndikojnë apo të përpiqen të ndërhyjnë, pengojnë apo ndikojnë te prokurori i shtetit gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale lidhur me cilindo hetim, procedurë apo lëndë individuale. Në këtë aspekt, prokurori i shtetit detyrohet që me rastin e hetimit të veprës penale të analizoj të gjitha provat dhe faktet fajësuese dhe shfajësuese si dhe të sigurojë që hetimi do të kryhet duke respektuar në tërësi të drejtat e të pandehurit dhe që mbledhja e provave të mos bëhet duke shkelur dispozitat e procedurës penale (neni 48 i KPP).

Sipas nenit 7 të Ligjit për Prokurorin e Shtetit prokurori i shtetit ka këto kompetenca dhe detyra:

1. Ushtrimin e funksioneve prokuroriale në mënyrë të pavarur, të drejtë, objektive dhe të paanshme dhe të sigurohet që të gjithë personat trajtohen në mënyrë të barabartë para ligjit;
2. Zbatimin e standardeve më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare;

3. Sjellje të ndershme dhe profesionale si në jetën personale ashtu edhe profesionale dhe bazuar në ligjin e zbatueshëm dhe Kodin e Etikës Profesionale;

4. Ruajtjen e nderit dhe dinjitetit të prokurorit të shtetit;

5. Mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve dhe personave të dënuar;

6. Ndërmarrjen e veprimeve të nevojshme juridike për zbulimin e veprave penale dhe të autorëve të krimit si dhe hetimin dhe ndjekjen me kohë të veprave penale;

7. Marrjen e vendimeve mbi inicimin, vazhdimin apo ndërprerjen e procedurës penale ndaj personave të dyshuar apo të akuzuar për kryerjen e veprave penale;

8. Ngritjen e aktakuzave dhe përfaqësimin e tyre para gjykatës;

9. Ushtrimin e mjeteve të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve gjyqësore;

10. Bashkëpunimin me policinë, gjykatat dhe institucionet e tjera;

11. Ndërmarrjen e të gjitha veprimeve të tjera të përcaktuara me ligj.

Përveç kësaj, konform paragrafit 1 të nenit 49 të Kodit të Procedurës Penale prokurori i shtetit ka edhe këto detyra dhe kompetenca:

1. Është i autorizuar për të përfaqësuar interesat publike para gjykatave të Republikës së Kosovës dhe të kërkoj nga ato që të urdhëroj masa në pajtim me Kodin e Procedurës Penale, dhe

2. Ka kompetencë që të negocioj dhe të pranoj marrëveshje vullnetare për bashkëpunim apo pranim të fajësisë me të pandehurin në lidhje me veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare apo me propozimin e të dëmtuarit.

Në fakt, prokurori i shtetit ka të drejtë dhe detyrë t'i përcjell dhe t'i studioj edhe marrëdhëniet dhe dukuritë shoqërore të rëndësishme për realizimin e detyrave prokuroriale dhe për vrojtimit e realizuara, të njoftoj institucionet përkatëse (Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Kuvendin e Kosovës) si dhe të paraqes propozime për parandalimin e dukurive të rrezikshme dhe të dëmshme për shoqërinë si dhe për përforcimin e sundimit të ligjit. Prokurori i shtetit, po ashtu ka të drejtë dhe detyrë që ta informoj opinionin lidhur me gjendjen e kriminalitetit në vend dhe për problemet e dukuritë tjera me rëndësi të përgjithshme, të cilat i ka vërejtur gjatë punës së tij.

I PANDEHURI

I pandehuri është subjekt qendror në procedurë penale ndaj të cilit është drejtuar kërkesa procedurale, gjegjësisht ndaj të cilit fillohet dhe zhvillohet procedura penale. Në Kodin e Procedurës Penale nuk është sajuar ndonjë kapitull i veçantë i cili normon pozitën e të pandehurit në procedurë penale. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se këtë çështje ky Kod nuk e ka trajtuar fare. Në të vërtetë, janë të shumta dispozitat ligjore që Kodi

i Procedurës Penale i përmban, në formë shpërndarëse për të pandehurin në shumë kapituj të tij.

Si subjekt procedural ka disa të drejta dhe obligime, ndërsa ndaj tij nën kushtet e përcaktuara me ligj mund të zbatohen edhe disa masa shtrënguese. I pandehuri në procedurë penale ushtron funksionin e mbrojtjes. Në këtë rrjedhë, ai është palë e barabartë me prokurorin e shtetit. Barabarësia e tij me prokurorin shihet nga fakti se për të pandehurin ekziston prezumimi i pafajësisë.

Cilësinë e të pandehurit e fiton personi në momentin kur ndaj tij është ngritur ndonjë akt akuzues, dhe këtë cilësi por me terma të cilët i adoptohen stadeve të zhvillimit të procedurës, ai e ruan deri në përfundim të procedurës penale, d.m.th., deri në momentin që vendimi i pushimit të procedurës, i pafajësisë ose dënimit të ketë marrë formën e prerë.

Vlen të theksohet fakti se varësisht nga rrjedha e procedurës penale, Kodi i Procedurës Penale përdorë terma të ndryshëm për personin ndaj të cilit pritet të fillohet, është filluar ose zhvillohet procedurë penale.

Kështu, **“I dyshuar”** konsiderohet personi për të cilin policia ose prokurori i shtetit kanë dyshim të arsyeshëm se ka kryer vepër penale, por kundër tij nuk ka filluar hetimi.

“I pandehur” konsiderohet personi kundër të cilit zbatohet procedura penale, gjegjësisht ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Kjo shprehje përdoret edhe si emërtim i përgjithshëm për të pandehurin, të akuzuarin dhe të dënuarin.

“I akuzuar” konsiderohet personi ndaj të cilit është paraqitur aktakuza dhe është caktuar shqyrtimi gjyqësor, dhe

“I dënuar” konsiderohet personi i cili me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës është shpallur fajtor për kryerjen e veprës penale.

të se ai ka të drejtë të heshtë.

Konform paragrafit 3 të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, para çdo marrje në pyetje, i pandehuri duhet të informohet për:

1. Veprën penale për të cilën akuzohet;
2. Të drejtën se mund të kërkoj marrjen e provave për mbrojtjen e tij;
3. Të drejtën për të heshtur dhe për të mos u përgjigjur në asnjë pyetje, përveç informacionit mbi identitetin e tij;
4. Të drejtën që të merret në pyetje me ndihmën e përkthyesit (paragrafi 1 i nenit 153 i KPP);
5. Të drejtën në ndihmë të mbrojtësit dhe konsultimit me të para dhe gjatë marrjes në pyetje (paragrafi 4 i nenit 152 i KPP) etj.

I pandehuri merret në pyetje gojarisht. Gjatë marrjes në pyetje duhet të respektohet plotësisht dinjiteti i tij. Në këtë aspekt, sipas paragrafit 4 të nenit 257 të Kodit të Procedurës Penale, gjatë çdo marrje në pyetje të të pandehurit ndalohet që:

1. Liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;

2. I pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;

3. Të premtohet ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj, dhe

4. Të dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kujtuar.

Në lidhje me marrjen në pyetje të të pandehurit ligjdhënësi ka vendosur edhe këto rregulla:

1. Të pandehurit pyetjet duhet t'i parashtrohen në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të përpiktë. Kështu, të pandehurit pyetjet nuk duhet parashtuar në bazë të supozimit që ai ka pranuar diçka që në fakt nuk ka pranuar. Rrjedhimisht, të pandehurit mund t'i kërkohej që të pohoj ose të mohoj fakte të caktuara. Këto ndalesa zbatohen pavarësisht nga pëlqimi i të pandehurit.

2. Të pandehurit i parashtrohen pyetje bazuar në provat dhe shkresat që janë relevante për procedurën penale. Gjatë pyetjeve që kanë të bëjnë me prova apo dokumente, të pandehurit i paraqitet çdo provë ose shkresë relevante. Provat ose dokumentet identifikohen qartë në procesverbal.

3. Sendet të cilat janë të lidhura me veprën penale ose të cilat shërbejnë si provë, pas përshkrimit të pandehurit i prezantohen për njohje. Nëse këto sende nuk mund të sillen, i pandehuri dërgohet në vendin ku ato ndodhen.

4. Marrja në pyetje e të pandehurit duhet t'i ofroj mundësinë për t'i kundërshtuar arsyet e dyshimit kundër tij dhe për të nxjerrë në pah faktet që janë në favor të tij.

Si subjekt themelor i procedurës penale i pandehuri i ka këto të drejta:

1. Të deklarohet për veprën penale;

2. Të marrë në pyetje dhe të propozoj marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe ekspertëve, dhe

3. Të atakoj vendimin gjyqësor me ankesë dhe me mjetin e jashtëzakonshëm juridik.

Në dobi të të pandehurit është paraparë edhe ndalesa *reformatio in peius*, e cila i mundëson atij që lirisht ta përdorë mjetin juridik kundër vendimit gjyqësor, pa frikë se me ankesë do të keqësoj pozitën e vet, dhe *beneficium cohaesionis* si lehtësi që favoret që i kanë nxjerrë të bashkakuvarit të vlejnjë edhe për të, pa marrë parasysh se ai ka lëshuar afatin e marrjes së veprimit nga i cili janë nxjerrë ato favore.

Më në fund, Kodi i Procedurës Penale ka paraparë institutin e kompensimit të dëmit nëse do të vinte deri te situata që me vendim gjyqësor të dënohet personi i pafajshëm.

MBROJTËSI

Mbrojtësi është ndihmës i të pandehurit i cili me njohuritë e tij juridike e ndihmon atë në mbrojtje. Themeli i detyrave të mbrojtësit është dhënia e ndihmës të pandehurit në parashtrimin e fakteve të cilat shkojnë në favor të tij dhe të së vërtetës. Në përputhje me këtë, mbrojtja është çështje kyçe si në rastet kur i pandehuri nuk është fajtor, ashtu edhe në rastin kur ai është fajtor.

Sigurimi i mbrojtjes ligjore për të pandehurin ka qenë një arritje e rëndësishme në përpjekjet e gjata dhe të vështira të forcave përparimtare për të demokratizuar procedurën penale. Ajo u arrit fillimisht në vendet e zhvilluara që shpallen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe mbi këtë bazë miratuan ligjet themelore të veprimtarisë së organeve të drejtësisë.

Roli i mbrojtësit në procedurë penale erdhi duke u avancuar ashtu që ai u bë faktor i rëndësishëm në luftën kundër shkeljeve të ligjit dhe padrejtësive. Mbrojtësi u bë një figurë e procedurës penale e respektuar, duke qëndruar përballë akuzës si palë kundërshtare e aftë për të zhvilluar një debat konstruktiv dhe për të ndikuar në zgjidhjen e drejtë të çështjes.

E drejta e mbrojtjes përmes mbrojtësit është parashikuar edhe në të drejtën tonë. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 53 të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri (dyshuari) ka të drejtë në mbrojtës gjatë të gjitha fazave të procedurës penale. Në këtë rrjedhë, “Policia, prokurori i shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose organi tjetër kompetent, para çdo marrje në pyetje të të pandehurit, e udhëzon atë për të drejtën e tij në angazhimin e mbrojtësit dhe se mbrojtësi mund të marrë pjesë gjatë gjithë kohës së marrjes së tij në pyetje (paragrafi 2 i nenit 53 i KPP)”.

Për mbrojtës mund të angazhohet vetëm avokati i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës. Mbrojtja me avokat arsyetohet me faktin se i pandehuri, në të shumtën e rasteve është person laik të cilit i mungon përgatitja juridike. Në anën tjetër, për shkak se ndaj tij zhvillohet procedurë penale, ai gjendet në një gjendje të posaçme shpirtërore. Për këtë arsye edhe veprimet e tij lidhur me mbrojtjen nuk janë gjithëherë të menduara dhe të koordinuara mirë, kështu që nga mosdija ose për shkak të gjendjes tronditëse në të cilën gjendet, shpesh mund t’i shpëtoj paraqitja e të dhënave të cilat shkojnë në favor të tij. Andaj, për ta ushtruar me sukses funksionin e mbrojtjes si dhe për t’u barazuar me prokurorin e shtetit, i cili është person profesional me përgatitje juridike, i pandehuri gjatë gjithë zhvillimit të procedurës penale mund të ketë, përkatësisht duhet të ketë mbrojtës.

Mbrojtësin nën kushte të caktuara mund ta zëvendësoj praktikanti i avokatisë. Mirëpo, që praktikanti i avokatisë ta zëvendësoj avokatin kur procedura zbatohet për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi prej të paktën pesë vjetësh burgim, kërkohet që ai të ketë të kryer provimin e jurisprudencës. Kurse, në rast se procedura zhvillohet në Gjykatën e Apelit dhe Gjykatën Supreme të Kosovës të pandehurin mund ta përfaqësoj vetëm avokati që është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës (paragrafi 1 i nenit 54 i KPP).

Zgjedhja dhe caktimi i mbrojtësit është e drejtë e të pandehurit. Zgjedhjen e mbrojtësit ai e bën vet, kurse caktimi i mbrojtësit nga organi i procedurës bëhet në rastet kur i pandehuri tek mbrojtja e detyruar nuk angazhon mbrojtës, e këtë nuk e kanë bërë as personat tjerë të autorizuar (paragrafi 2 i nenit 57 i KPP). Mbrojtësin të pandehurit mund t'ia caktoj edhe përfaqësuesi ligjor i tij, bashkëshorti ose bashkëshorti jashtëmartesor, personi i gjinisë së gjakut në vijë të drejtë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra dhe prindi birësues, por jo edhe kundër vullnetit të tij (paragrafi 8 i nenit 53 i KPP). I pandehuri, përveç në rastet e mbrojtjes së detyruar, mund të heqë dorë nga e drejta e mbrojtjes nëse atë e bën qartë, në mënyrë të informuar dhe vullnetarisht. Heqja dorë duhet bërë me shkrim dhe duhet nënshkruar nga i pandehuri dhe nga organi kompetent që e zbaton procedurën, ose gojarisht në audio apo videokasetë, autenticiteti i të cilës vërtetohet nga gjykata (paragrafi 3 i nenit 53 i KPP). Kur i pandehuri heq dorë nga e drejta në mbrojtës dhe e kërkon sërish këtë të drejtë, ai mund ta realizojë atë menjëherë (paragrafi 7 i nenit 53 i KPP).

Personat nën moshën 18 vjet mund të heqin dorë nga e drejta për të angazhuar mbrojtës me pëlqimin e prindit, kujdestarit ose përfaqësuesit nga qendra për punë sociale, përveç rasteve të dhunës në familje në të cilat është përfshirë prindi ose kujdestari, raste këto tek të cilat prindi ose kujdestari i tillë nuk mund të jep pëlqim për heqjen dorë nga kjo e drejtë. Ndërsa, personat të cilët tregojnë shenja të çrregullimeve ose të paaftësisë mendore nuk mund të heqin dorë nga e drejta në angazhimin e mbrojtësit (paragrafët 5 dhe 6 të nenit 53 të KPP). Mirëpo, kur është në pyetje mbrojtja e detyruar, nëse i pandehuri dhe personat tjerë të autorizuar nuk kanë caktuar mbrojtës, atëherë sipas detyrës zyrtare në shpenzime publike mbrojtësin e cakton gjykata ose organi tjetër kompetent i cili e zbaton procedurën (paragrafët 2 i nenit 57 i KPP).

Një i pandehur mund të ketë deri në tre mbrojtës dhe e drejta në mbrojtje konsiderohet se është e mjaftueshme kur në procedurë merr pjesë vetëm njëri nga mbrojtësit (paragrafi 2 i nenit 55 i KPP). Në rast se i pandehuri ka caktuar më shumë se një mbrojtës, njëri nga ta caktohet si mbrojtës kryesor nga i pandehuri, e nëse i pandehuri nuk e bën një gjë të tillë, mbrojtësin kryesor e cakton gjyqtari kompetent (paragrafi 3 i nenit 55 i KPP). Në këto raste secili mbrojtës, sidomos në fjalën përfundimtare të palëve, trajton një aspekt të mbrojtjes së të pandehurit p.sh., njëri për rrethanat lehtësuese, tjetri për personalitetin e të pandehurit etj. Megjithatë, në një procedurë penale mbrojtësi nuk mund të mbrojtë dy ose më tepër të pandehur në të njëjtën çështje (paragrafi 1 i nenit 55 i KPP).

PËRJASHTIMI I MBROJTËSIT

Mbrojtës nuk mund të jetë i dëmtuari, bashkëshorti apo bashkëshorti jashtëmartesor i të dëmtuarit, e as personi që është në gjini gjaku në vijë të drejtë në cilëndo shkallë, në vijë anësore deri në shkallën e katërt ose të krushqisë deri në shkallën e dytë me të dëmtuarin ose prokurorin; personi i cili është thirrur si dëshmitar në shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse sipas Kodit të Procedurës Penale është liruar nga detyra e dëshmitarit dhe ka deklaruar se nuk do të dëshmojë ose nëse mbrojtësi pyetet si dëshmitar për atë që i

pandehuri i ka besuar atij në cilësinë e mbrojtësit të vet, si dhe personi i cili në të njëjtën lëndë ka vepruar si gjyqtar ose prokuror i shtetit (paragrafët 1-3 të nenit 56 të KPP).

Marrë në përgjithësi, në procedurën tonë penale njihen tri lloje të mbrojtjes: mbrojtja e detyruar, mbrojtja për të varfër dhe mbrojtja fakultative.

MBROJTJA E DETYRUAR

Mbrojtja është e detyruar në situatën kur procedura penale nuk mund të zhvillohet pa mbrojtës. Në këtë rrjedhë, sipas paragrafit 1 të nenit 57 të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri duhet të ketë mbrojtës:

1. Nga marrja në pyetje për herë të parë kur i pandehuri është memec, i shurdhër ose shprehë shenja të çrregullimeve ose paaftësisë mendore dhe kështu është i paaftë që të mbrohet vet me sukses;

2. Gjatë marrjes në pyetje në seancën për caktimin e paraburgimit dhe gjatë kohës deri sa ai gjendet në paraburgim;

3. Nga ngritja e aktakuzës kur aktakuza është ngritur kundër tij për vepër penale për të cilën mund të shqiptohet dënimi me të paktën dhjetë vjet burgim;

4. Në procedurë sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike kur i pandehuri është memec, i shurdhër ose shprehë shenja të çrregullimeve ose paaftësisë mendore ose i është shqiptuar dënimi me burgim të përjetshëm, dhe

5. Në të gjitha rastet kur i pandehuri kërkon të hyj në marrëveshje për pranimin e fajësisë për vepër penale për të cilën parashihet dënimi më së paku një vit burgim.

Më tutje, mbrojtja është e detyruar edhe:

1. Në procedurën për të mitur;

2. Në procedurën e veçantë të shqiptimit të masës së sigurimit për mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje që nga momenti kur prokurori i shtetit të paraqes propozimin për shqiptimin e kësaj mase (paragrafi 2 i nenit 508 i KPP).

3. Kur të akuzuarit i cili nuk ka mbrojtës duhet t'i dorëzohet aktgjykimi me të cilin i është shqiptuar dënimi me burgim efektiv, kurse dorëzimi nuk mund të bëhet në adresën e mëparshme të tij (paragrafi 3 i nenit 478 i KPP).

Duhet theksuar faktin se me përjashtim të rasteve të sipërpërmendura, në të gjitha situatat tjera për të cilat zhvillohet procedurë penale mbrojtja është fakultative.

MBROJTJA PËR TË VARFËR

Mbrojtja për të varfër ekziston atëherë kur i pandehuri nuk ka mundësi që vet t'i paguaj shpenzimet e mbrojtjes.

Rrjedhimisht, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 58 të Kodit të Procedurës Penale shpenzimet e mbrojtjes do të paguhën nga buxheti i shtetit, edhe kur nuk janë përmbushur konditat për mbrojtje të detyrueshme, nëse:

1. Procedura zbatohet për vepër penale të dënueshme me të paktën tetë vjet burgim, dhe

2. Kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë pavarësisht nga dënimi i parashikuar, në qoftë se sipas gjendjes pasurore të tij nuk mund t'i përballoj shpenzimet e mbrojtjes së tij.

Vlen të theksohet fakti se i pandehuri duhet të njoftohet për të drejtën e tij në mbrojtës me shpenzime publike para se të merret në pyetje për herë të parë, ndërsa kërkesa për caktimin e një mbrojtësi të tillë mund të bëhet gjatë gjithë procedurës penale (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 58 të KPP). Kryetari i gjykatës ose organi kompetent që zhvillon procedurën vendos për kërkesën dhe cakton mbrojtësin në bazë të kërkesës së të pandehurit i cili duhet të plotësoj një formular dhe të deklarohet se nuk mund t'i përballoj shpenzimet e mbrojtësit. Nëse policia dhe prokurori i shtetit refuzojnë kërkesën për caktimin mbrojtësit në shpenzime publike, i pandehuri mund t'i ankohet gjyqtarit të procedurës paraprake.

SHKARKIMI I MBROJTËSIT

Ligdhënësi ka paraparë se i pandehuri ka të drejtë që në vend të mbrojtësit të caktuar nga gjykata të caktoj vet një mbrojtës tjetër. Në raste të tilla mbrojtësi i caktuar nga gjykata duhet të shkarkohet. Shkarkimin mund ta kërkoj edhe vet mbrojtësi por vetëm kur për këtë ekzistojnë shkaqet e arsyeshme. Aktvendimi për shkarkimin e mbrojtësit para shqyrtimit gjyqësor merret nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjatë shqyrtimit gjyqësor gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, kurse në procedurën e apelit nga kryetari i kolegjit të apelit të Gjykatës së Apelit apo të Gjykatës Supreme. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë. Po ashtu, me kërkesë të të pandehurit kryetari i gjykatës mund ta shkarkoj mbrojtësin e caktuar i cili nuk e ushtron si duhet detyrën, ashtu që në vend të mbrojtësit të shkarkuar ai cakton një mbrojtës të pavarur me përvojë e kompetent dhe në pajtim me natyrën e veprës penale. Në këto raste Oda e Avokatëve duhet të njoftohet për shkarkimin e mbrojtësit (neni 59 i KPP).

TË DREJTAT DHE OBLIGIMET E MBROJTËSIT

Mbrojtësi si ndihmës i palës procedurale penale në procedurë penale ka të drejtë t'i ndërmarrë të gjitha veprimet të cilat mund t'i ndërmarrë i pandehuri, kuptohet përveç atyre të cilat ligji ia rezervon vetëm të pandehurit. Në këtë aspekt ai, konform nenit 61 të Kodit të Procedurës Penale ka këto autorizime:

1. Të komunikoj lirshëm me të pandehurin. Pra ai ka të drejtë të komunikoj me të pandehurin gojarisht ose me shkrim sipas kushteve që garantojnë fshehtësinë;

2. Të propozoj prova për vërtetimin e fakteve të rëndësishme dhe t'i shikoj shkresat e lëndës;

3. Të njoftohet me kohë për vendin dhe kohën e zbatimit të veprimeve hetimore dhe të marrdyshkallësh pjesë në to;

4. Të shikoj, të kopjoj ose të fotografoj shkresa, libra, dokumente, fotografi dhe objekte të tjera materiale që janë në posedim, ruajtje ose kontroll të prokurorit të shtetit, materiale të cilat shërbejnë për përgatitjen e mbrojtjes ose të cilat kanë për qëllim që të shfrytëzohen nga prokurori i shtetit si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose që janë marrë nga i pandehuri apo kanë qenë pronë e tij, varësisht nga rasti (paragrafi 6 i nenit 213 i KPP);

5. Të shikoj, kopjoj ose t'i fotografoj të gjitha shkresat dhe provat materiale me të cilat disponon gjykata. Këto të drejta mbrojtësit i takojnë pas përfundimit të hetimit (paragrafi 4 i nenit 213 i KPP)

Kufizimi i disa të drejtave mbrojtësit nga ana e prokurorit të shtetit

Prokurori i shtetit mund t'i refuzoj mbrojtjes shikimin, kopjimin ose fotografimin e shkresave të caktuara, të librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve të tjera materiale që i ka në posedim, ruajtje ose nën kontroll të tij, nëse ka gjasa reale se shikimi, kopjimi ose fotografimi mund të rrezikoj qëllimin e hetimit, jetën ose shëndetin e njerëzve.

Ankesat në rastet e kufizimeve të të drejtave të mbrojtësit

Në rast të tillë, mbrojtja mund të kërkoj nga gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues që të lejoj shikimin, kopjimin ose fotokopjimin, me ç'rast vendimi i marrë nga ai konsiderohet përfundimtar. Por, duhet pasur parasysh faktin se nën kushte të caktuara ligjore, me qëllim të mbrojtës së të dëmtuarve dhe dëshmitarëve, shikimi i informacioneve të caktuara mund të reduktohet. Në këtë aspekt, “prokurorit të shtetit i lejohet që informacionet e caktuara t'i redaktoj ose shënjoj me vijë të trashë të zezë për të fshehur të dhëna të caktuara në kopjet e shkresave të cilat përmbajnë të dhëna të ndjeshme. I pandehuri mund të kundërshtoj redaktimin e tillë te gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues brenda 3 ditëve nga pranimi i kopjes së redaktuar. Në këto raste, prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të shpjegoj bazën ligjore të redaktimit pa zbuluar informacionin e ndjeshëm. Gjyqtari shqyrton informacionin e ndjeshëm dhe merr vendim brenda 3 ditëve nëse redaktimi është ligjërisht i arsyetuar apo jo (paragrafi 7 i nenit 213 i KPP)”.

PËRFAQËSUESIT PROCEDURALË

Në procedurë penale në anën e të dëmtuarit, nën kushtet e përcaktuara ligjore siç u theksua më lart, mund të paraqitet përfaqësuesi procedural, i cili me efekt të plotë ushtron veprimet procedurale në emër dhe në llogari të tij. Përfaqësuesit angazhohen në procedurë penale kur i dëmtuari ka aftësinë për të figuruar si palë, por i mungon aftësia procedurale ose i ka të dy këto cilësi. Në rastin e parë, i dëmtuari është i paaftë (nuk ka

zotësi) që vet t'i kryej veprimet procedurale, kurse në rastin e dytë ai e ka këtë zotësi por dëshiron që dikush tjetër, në mënyrë më profesionale, t'i kryej veprimet të cilat ka mundësi t'i kryej vet.

Përfaqësues procedural, siç u theksua më lart mund të jetë përfaqësuesi i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe mbrojtësi i viktimave.

Rrjedhimisht, si përfaqësues procedural mund të paraqitet edhe prindi i fëmijës ose kujdestari i personit të cilit i është hequr zotësia për të vepruar, të cilët legjislacioni në fuqi i njeh si përfaqësues ligjor.

I DËMTUARI

Një pjesë e madhe e veprave penale kanë për pasojë dëmtimin e personit, gjegjësisht të personave ndaj të cilëve janë kryer ato. Ky dëm mund të jetë material, shëndetësor dhe moral.

Personi i dëmtuar me vepër penale, konform nenit 62 të Kodit të Procedurës Penale, ka këto të drejta:

1. Të trajtohet me respekt nga policia, prokurorët, gjyqtarët ose organi tjetër që e zbaton procedurën penale;

2. Nëse i dëmtuari nga vepra penale mund të identifikohet, policia dhe prokurori ose organi tjetër që zbaton procedurën penale duhet të kontaktojnë atë në mënyrë të arsyeshme dhe ta informojnë se është palë e dëmtuar;

3. I dëmtuari ka cilësinë e palës në procedurë penale;

4. I dëmtuari ka të drejtë të paraqes propozimin për ndjekje penale për veprën penale nga e cila ka pësuar ndonjë dëm;

5. Në kompensimin e arsyeshëm të urdhëruar nga gjykata prej të pandehurit ose të pandehurve që kanë pranuar ose janë shpallur fajtor për dëmin material, fizik dhe emocional të shkaktuar nga kryerja e veprës penale për të cilën i pandehuri ose të pandehurit janë shpallur fajtorë;

6. Nëse gjykata nuk mund të urdhëroj kompensimin nga i pandehuri apo të pandehurit për shkak të pamundësisë së tyre për të paguar, mungesës së kompetencës së gjykatës ose vdekjes, i dëmtuari ka të drejtë që të kërkoj nga gjykata që të dërgoj urdhrin për kompensim te koordinatori i fondit për kompensimin e viktimave.

Me qëllim që të mundësohet një realizim më efikas i këtyre të drejtave, të dëmtuarit i është dhënë mundësia e përfaqësimit të interesave të tij në procedurë penale. Rrjedhimisht, sipas nenit 63 të Kodit të Procedurës Penale i dëmtuari në procedurë penale mund të përfaqësohet nga:

1. Përfaqësuesi i cili është anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës dhe

2. Mbrojtësi i viktimave.

Konform zgjidhjes së dhënë në këtë nen (paragrafi 3 i nenit 63 i KPP) të dëmtuarit i është dhënë mundësia që në procedurë penale të mund të përfaqësoj veten e tij. Kjo

situatë zakonisht vjen në shprehje në rastet kur i dëmtuari e konsideron veten të aftë për të mbrojtur interesat e tij (personale, pasurore apo morale), të cilat mendon se i janë dëmtuar me rastin e kryerjes së veprës penale konkrete.

AFATET

Për përgatitjen e parashtresave ligjdhënësi ka paraparë afate të caktuara. Afatet tregojnë kohën e caktuar për përpilimin dhe dorëzimin e parashtresës së caktuar nga ana e subjektit të procedurës penale dhe nga personat tjerë të interesuar për zhvillimin e procedurës. Po që se pjesëmarrësi në procedurë nuk e përpilon dhe dorëzon parashtresën brenda afatit të caktuar, sipas rregullit ai e humb të drejtën që këtë ta bëj sërish.

Duhet pasur parasysh faktin se disa afate tregojnë kohën që duhet respektuar për të realizuar ndonjë të drejtë. Të tilla janë afatet për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimeve, aktvendimeve e urdhrave të ndryshëm. Të tjerat afate tregojnë kohëzgjatjen e një gjendje të caktuar në procedurë. Të tilla janë afatet e arrestimit apo ndalimit të personit, paraburgimit etj Afatet mund të ndahen në:

1. Afate ligjore dhe gjyqësore. Afate ligjore janë ato afate kohëzgjatja e të cilave caktohet me ligj. Afat i tillë është afati për paraqitjen e ankesës kundër aktgjykimit të gjykatës themelore. Afatet gjyqësore konsiderohen ato afate të cilat i përcakton gjykata duke u bazuar në autorizimin që asaj ia njeh ligji. Afat i tillë është p.sh., afati i përmirësimit të ankesës ose për paraqitjen e aktakuzës së re.

2. Afate prekluzive dhe joprekluzive. Afat prekluziv konsiderohet ai afat lëshimi i të cilit për subjektin përkatës do të thotë humbje e të drejtës për ripërtëritje të parashtresës së tillë. I tillë është afati për paraqitje të ankesës. Afat joprekluziv konsiderohet afati lëshimi i të cilit nuk ka për pasojë humbjen e mundësisë së paraqitjes së parashtresës, sepse varësisht nga rrethanat e pranishme që kanë penguar paraqitjen e saj në kohë, nëse ato vlerësohen të arsyeshme, subjekti i autorizuar mund të vazhdoj atë afat. I tillë është afati për përmirësimin e aktakuzës së prokurorit të shtetit

3. Afate të rrepta dhe të thjeshta. Afatet e rrepta njëherit janë edhe afate ligjore të cilat, sipas rregullit nuk mund të zgjaten, përveç kur me ligj është paraparë një mundësi e tillë. I tillë është afati për përmirësimin e aktakuzës. Afatet e thjeshta kanë të bëjnë me afatet gjyqësore të cilat si të tilla mund të zgjaten.

Afatet llogariten me orë, ditë muaj dhe vite. Llogaritja e afateve bëhet sipas kalendarit të zakonshëm. Kështu, nuk llogaritet në afat ora ose dita kur është bërë dorëzimi ose njoftimi apo kur ka ndodhur ngjarja që konsiderohet si fillim i afatit. Në këtë rrjedhë, afati fillon të ecë nga ora ose dita e parë vijuese (pasardhëse). Në një ditë llogariten 24 orë kurse muaji llogaritet sipas kalendarit. Afatet e caktuara me muaj apo vite kalojnë me kalimin e ditës së fundit të muajit apo të vitit i cili sipas numrit të vet i përgjigjet ditës kur ka filluar afati. Nëse një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, afati kalon në ditën e fundit të atij muaji. Kur dita e fundit bie në ditë feste zyrtare, të shtunën ose të dielën ose në ndonjë ditë tjetër kur organi kompetent nuk punon, afati kalon në fund të ditës pasuese të punës (neni 446 i KPP).

Pala në favor të së cilës është caktuar një afat, mund të kërkoj shkurtrimin e tij me deklaratë të dorëzuar në gjykatë. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 445 të Kodit të Procedurës Penale nëse afati është paraparë me ligj për realizimin e të drejtës së mbrojtjes dhe të drejtave tjera procedurale të të pandehurit, me kërkesën e tij me shkrim ose përmes kërkesës gojore të përfshirë në procesverbalin e gjykatës afati mund të shkurtohet. “Deklarata konsiderohet se është dhënë me afat kur ajo i paraqitet marrësit të autorizuar para kalimit të afatit (paragrafi 2 i nenit 445 i KPP)”.

Kur deklarata dërgohet përmes postës, postës rekomande ose telegramit ose me mjet tjetër (telefaks ose mjete të ngjashme), dita e postimit ose dërgimit konsiderohet si ditë e dorëzimit personit që i është dërguar. Në këtë rrjedhë, dërguesi i deklaratës konsiderohet se nuk e ka lëshuar afatin kur personi të cilit tentohet t’i dërgohet deklarata nuk e ka marrë me kohë për shkak të gabimeve në mjetet e dërgimit, për të cilat dërguesi nuk ka qenë në dijeni (paragrafi 3 i nenit 445 i KPP).

Deklaratë të lidhur me afat mund të japë edhe i pandehuri i cili gjendet në paraburgim. Në raste të tilla deklarata konsiderohet e dorëzuar ditën kur ajo është përfshirë në procesverbalin e gjykatës që e zbaton procedurën, gjegjësisht ditën kur ajo është dërguar në drejtorinë e burgut. Në mënyrë të ngjashme veprohet edhe në rastet e dërgimit të deklaratave të personit i cili gjendet në vuajtje të dënimit ose ndodhet në ndonjë institucion tjetër me urdhër për trajtim të detyrueshëm për rehabilitimin e kryerësve të veprave penale të varur nga droga ose alkooli. Kështu, dita kur është përpiluar procesverbali i tillë apo kur deklarata i është dërguar drejtorisë së institucionit konsiderohet ditë e dorëzimit të marrësit të autorizuar (paragrafi 4 i nenit 445 i KPP).

Kur parashtrë dorëzimi i së cilës është i lidhur me afat, për arsye të mosdijes ose të gabimit të qartë të dërguesit i është dërguar gjykatës jo kompetente para kalimit të afatit, do të konsiderohet se është dorëzuar me kohë, përkundër faktit se në gjykatën kompetente arrin pas kalimit të afatit të paraparë (paragrafi 5 i nenit 445 i KPP).

KËRKESA PËR KTHIM NË GJENDJE TË MËPARSHME

Lëshimi i afatit mund të ketë efekte negative për të pandehurin në procedurë penale. Në të vërtetë, pasojat negative të lëshimit të afatit më së tepërmi vërehen te lëshimi i afatit për paraqitjen e mjetit juridik, pasi gjykata e hedh atë pa e marrë fare në shqyrtim. Por, meqenëse shkaqet të cilat imponojnë lëshimin e afatit mund të jenë të arsyeshme ligjdhënësi parashih mundësinë e rivendosjes së afatit në mënyrë që të eliminohen pasojat e pakëndshme të lëshimit të afatit. Kjo mundësi është parashikuar me qëllim që t’i kontribuohet gjetjes së të vërtetës në procedurë penale me çka realizohet drejtësia rreth zgjidhjes së çështjes penale.

Për të pasur rivendosje të afatit subjekti konkret duhet të paraqes kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme. Kërkesa duhet të paraqitet brenda 8 ditësh nga dita e kalimit të shkaqeve për arsye të të cilave nuk është respektuar afati (paragrafi 1 i nenit 447 i KPP).

Siç u theksua më lart, kërkesë për kthim në gjendje të mëparshme mund të paraqes i pandehuri i cili për shkak të arsyeshme nuk paralajmëron ose nuk paraqet ankesë

kundër aktgjykimit ose aktvendimit për sekuestrimin e dobisë pasurore brenda afatit të parashikuar ligjor (paragrafi 1 i nenit 447 i KPP). Si shkaqe të arsyeshme konsiderohen fuqia madhore (tërmeti, përmbytja, shkatërrimi i rrugëve etj.), fatkeqësia personale ose familjare e paparashikuar (vdekja e anëtarit të ngushtë të familjes) etj. Për kërkesën e paraqitur brenda afatit vendosë kryetari i trupit gjykues i cili e ka shqiptuar aktgjykimin ose aktvendimin që goditet me ankesë. Kundër aktvendimit me të cilin lejohet kthimi në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankesë. Mirëpo, kur i pandehuri ka paraqitur ankesë kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kthimi në gjendjen e mëparshme, gjykata detyrohet që këtë ankesë, së bashku me paralajmërimin e ankesës apo ankesën kundër aktgjykimit ose aktvendimit për sekuestrimin e dobisë pasurore me përgjigjen në ankesë dhe të gjitha procesverbalet, t'ia dërgoj gjykatës më të lartë për marrjen e vendimit (neni 448 i KPP). Kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme, në parim, nuk e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit apo ekzekutimin e aktvendimit për sekuestrimin e dobisë pasurore, mirëpo me rastin e marrjes së vendimit lidhur me kërkesën gjykata mund të vendosë që të ndërpres ekzekutimin e atij vendimi deri sa të merret vendimi lidhur me kërkesën (neni 449 i KPP). Në fakt, kërkesa për kthim në gjendje të mëparshme nuk mund të paraqitet nëse kanë kaluar 3 muaj nga dita e kalimit të afatit (paragrafi 2 i nenit 447 i KPP).

SHPENZIMET E PROCEDURËS PENALE

Gjatë ndërmarrjes së veprimeve procedurale në procedurë penale shkaktohen shpenzime të caktuara, për të cilat gjykata duhet të kujdeset dhe të vendosë.

Autorët e të drejtës së procedurës penale flasin për lloje të ndryshme të shpenzimeve procedurale. Kështu, disa autorë në trajtimet e tyre bëjnë fjalë për të ashtuquajturat shpenzime në kuptim të gjerë, shpenzime të cilat përfshijnë të gjitha harxhimet e jurisprudencës penale dhe shpenzime në kuptim të ngushtë, të cilat i referohen shpenzimeve të shkaktuara gjatë zhvillimit të procedurës penale konkrete, ose gjatë ndërmarrjes së ndonjë veprimi të veçantë në kuadër të kësaj procedure. Grupi tjetër i autorëve bën fjalë për: shpenzime të përgjithshme ku përfshihen shpenzimet të cilat i bën shteti lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe shpenzimet e posaçme, ku përfshihen shpenzimet të cilat shkaktohen gjatë zhvillimit të procedurës penale në të cilën duhet të ndriçohet dhe të zgjidhet çështja penale konkrete. Përkundër ndarjeve ekzistuese, duhet potencuar se në procedurë penale objekt shqyrtimi janë vetëm shpenzimet e ashtuquajtura të posaçme.

Së këndejmi, si shpenzime të procedurës penale (shpenzime të posaçme) konsiderohen ato shpenzime të cilat shkaktohen gjatë zhvillimit të procedurës penale si dhe ato të cilat shkaktohen duke qenë të lidhura me këtë procedurë (paragrafi 1 i nenit 450 i KPP). Sipas paragrafit 2 të nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale shpenzimet e procedurës penale përfshijnë:

1. Shpenzimet për dëshmitarë, ekspertë, përkthyes, specialistë, stenografim, regjistrime teknike dhe për këqyrjen e vendit të ngjarjes;
2. Shpenzimet e transportit të të pandehurit;

3. Shpenzimet për shoqërimin e të pandehurit apo të personit të paraburgosur;
4. Shpenzimet e transportit dhe të udhëtimit të personave zyrtarë;
5. Shpenzimet e mjekimit të të pandehurit gjatë kohës sa gjendet në paraburgim ose në institucionin shëndetësor në bazë të vendimit të gjykatës, si dhe shpenzimet e lindjes së fëmijës;
6. Shpenzimet paushalle;
7. Kompensimet dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit, dhe
8. Kompensimet dhe shpenzimet e nevojshme për të dëmtuarin dhe përfaqësuesin e tij ligjor, si dhe kompensimet dhe shpenzimet e nevojshme të përfaqësuesit të autorizuar;

Çështja e shpenzimeve paushalle rregullohet me akt të veçantë, përkatësisht me urdhëresë administrative të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Në këtë rast, shpenzimet nga pika 1-5 dhe kompensimi apo shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit të caktuar dhe të përfaqësuesit të autorizuar të të dëmtuarit në procedurë për veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare, parapaguhet nga fondet e policisë, prokurorisë së shtetit ose të gjykatës që e zbaton procedurën penale, kurse arkëtohen më vonë nga personat që detyrohen t'i paguajnë ato sipas dispozitave të këtij Kodi. Natyrisht, me qëllim të evitimit të paqartësive të mundshme organi që e zbaton procedurën penale detyrohet që kronologjikisht t'i shënoj të gjitha shpenzimet e parapaguara në listën e posaçme e cila kërkohet t'i bashkëngjitet shkresave të lëndës (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 450 të KPP).

Është e rëndësishme të theksohet se në procedurë penale shkaktohen edhe shpenzime të përkthimit. Këtu veçanërisht mendohet në shpenzimet e përkthimit në gjuhën e të pandehurit, të dëshmitarit dhe të personit tjetër që merr pjesë në procedurë penale të cilat shkaktohen si rezultat i zbatimit të dispozitave të KPPK Penale lidhur me përdorimin e gjuhës, e të cilat nuk arkëtohen nga personat të cilët sipas dispozitave ligjore detyrohen t'i paguajnë shpenzimet e procedurës. Së këndejmi, shpenzimet e përkthimit nuk mund t'i ngarkohen të pandehurit që nuk e di ose nuk e flet gjuhën në të cilën zbatohet procedura penale (paragrafët 5 dhe 6 të nenit 450 të KPP).

Ligjdhënësi në paragrafin 7 të nenit 450 të Kodit të Procedurës Penale ka përcaktuar se shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare paguhet nga mjetet buxhetore e jo nga i pandehuri.

Është parim i përgjithshëm se shpenzimet e procedurës i paguan pala ose personi i cili ato i ka shkaktuar me fajin e vet. Andaj, edhe përcaktimi nëse i pandehuri do të ngarkohet me shpenzime të procedurës bëhet varësisht nga ajo se ai a është shpallur fajtor apo është liruar nga akuza. Natyrisht, në çdo aktgjykim ose aktvendim me të cilin përfundohet procedura penale duhet përfshirë edhe vendimin për mbulimin e shpenzimeve të procedurës dhe shumën e tyre. Ndërkaq në rastet kur mungojnë të dhënat për shumën e shpenzimeve, është procesmbajtësi ai i cili mban të drejtën e marrjes së aktvendimit të posaçëm për caktimin e shumës së shpenzimeve i cili pastaj do të aprovohet nga ana e kryetarit të trupit gjykues pasi të jenë siguruar të dhënat (paragrafi 2 i nenit 451 i KPPK).

E DREJTA E PROCEDURES PENALE

Sipas paragrafit 2 të nenit 451 të Kodit të Procedurës Penale personi i cili ka të drejtë të paraqes kërkesën për kompensim të shpenzimeve të procedurës, këtë të drejtë mund ta shfrytëzoj në afat prej tre muajsh nga dita kur atij i është dorëzuar aktgjykimi, gjegjësisht aktvendimi i formës së prerë. Pala e pakënaqur me aktvendimin mbi caktimin e shpenzimeve të procedurës, sidomos në rastet kur për to është vendosur me aktvendim të posaçëm ka të drejtë ankese, mbi të cilën do të vendosë kolegji (paragrafi 3 i nenit 451 i KPPK).

Në kontekst të asaj që u theksua më lart rezulton se i pandehuri, i dëmtuari, mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar, dëshmitari, eksperti, përkthyesi dhe specialisti, pavarësisht nga rezultati i procedurës penale, paguajnë shpenzimet e shoqërimit të tyre forcërisht, të shtyrjes së veprimit hetimor, shpenzimet tjera të procedurës të shkaktuara me fajin e tyre, si dhe pagesën përkatëse të shumës paushalle. Për lartësinë e shpenzimeve të tilla vendoset me aktvendim të posaçëm, përveç kur për shpenzimet që i paguan paditësi privat ose i pandehuri vendoset me vendim me të cilin zgjidhet çështja kryesore (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 452 të KPP).

Kur gjykata e shpall të pandehurin fajtor ajo me aktgjykim vendos detyrimin e tij për t'i kompensuar shpenzimet e procedurës penale. I pandehuri i shpallur fajtor detyrohet t'i kompensoj shpenzimet e procedurës penale edhe në rastet kur ai dënohet për disa vepra penale. Mirëpo, personi i tillë i fajësuar për disa vepra penale nuk mund të ngarkohet edhe me kompensimin e shpenzimeve lidhur me veprat për të cilat është liruar nga akuza, po që se këto shpenzime mund të veçohen nga shpenzimet e përgjithshme. Ndërsa, në rastin kur disa të pandehur shpallen fajtorë, gjykata obligohet të caktoj pjesën e shpenzimeve që duhet paguar secili prej tyre, e kur kjo nuk është e mundur vendosë që të gjithë të pandehurit të ngarkohen me shpenzime në mënyrë solidarë. Në raste të tilla edhe shuma paushalle duhet të caktohet veçmas për secilin të pandehur (paragrafët 1-3 të nenit 453 të KPPK).

Konform paragrafit 4 të nenit 453 të Kodit të Procedurës Penale gjykata mund ta liroj të pandehurin nga detyrimi i kompensimit në tërësi ose pjesërisht të shpenzimeve të procedurës penale për dëshmitarë, ekspertë, përkthyes, specialistë, stenografim, regjistrime teknike, këqyrje të vendit dhe shpenzimet paushalle nëse vjen në përfundim se pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështes materialisht. Në rastet kur rrethanat e tilla mbi gjendjen materiale të të pandehurit konstatohen pas marrjes së vendimit lidhur me shpenzimet, i lejohet mundësia kryetarit të trupit gjykues që me aktvendim të posaçëm të liroj të pandehurin nga detyrimi i kompensimit të shpenzimeve të procedurës penale ose që ato t'i paguaj me këste.

Në rastet kur procedura penale pushohet ose kur merret aktgjykimi me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin refuzohet akuza gjykata në aktvendim apo në aktgjykim shënon se shpenzimet e procedurës penale nga neni 450 paragrafi 2 nën paragrafët 1-5 të Kodit të Procedurës Penale, shpenzimet e nevojshme të të pandehurit dhe kompensimin e shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit do të paguhet nga mjetet buxhetore, përveç kur:

1. Personi me vetëdije ka paraqitur kallëzim penal të rrejtshëm (në raste të tilla ai i paguan shpenzimet e procedurës penale), dhe

2. I dëmtuari i cili është tërhequr nga propozimi për ndjekje penale dhe si rrjedhojë procedura pushon, detyrohet t'i paguaj shpenzimet e procedurës penale nëse i pandehuri nuk ka paralajmëruar se ai do t'i paguaj ato (neni 454 i KPPK).

Kompensimi dhe shpenzimet e nevojshme të mbrojtësit ose të dëmtuarit detyrohet t'i paguaj personi i përfaqësuar, pavarësisht se kush sipas urdhrit të gjykatës detyrohet t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale, përveç kur mbrojtësi është caktuar sipas detyrës zyrtare. Rrjedhimisht, mbrojtësi ose përfaqësuesi i autorizuar, të cilët nuk janë anëtarë të Odës së Avokatëve, nuk kanë të drejtë në kompensim. Ata kanë të drejtë në shpenzimet e nevojshme, kurse anëtarët e Odës së Avokatëve kanë të drejtë edhe në fitimin e humbur (neni 455 i KPPK).

Vendimin përfundimtar lidhur me detyrimin për pagesën e shpenzimeve që shkaktohen në gjykatën themelore e merr gjyqtari apo kolegji kompetent i gjykatës themelore. Ndërkaq, një vendim të tillë në Gjykatën e Apelit e merr kryetari i kolegjit të Gjykatës së Apelit e në Gjykatën Supreme e merr kryetari i kolegjit të Gjykatës Supreme (paragrafët 1-3 të nenit 456 të KPPK).

Konform paragrafit 4 të nenit 456 të Kodit të Procedurës Penale caktimi i shpenzimeve të shkaktuara me rastin e procedimit të çështjes penale sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike duhet të bëhet duke zbatuar përshtatshmërisht zgjidhjet e prezantuara gjatë shqyrtimit të mësipërm të kësaj çështje.

KËRKESA PASURORE JURIDIKE

Me rastin e kryerjes së veprës penale nga ana e kryerësit të veprës penale personave të tretë mund t'u shkaktohet ndonjë dëm material dhe moral. Së këndejmi, për shkak të lidhjes që ekziston ndërmjet dëmit të shkaktuar dhe veprës penale, i dëmtuari ka mundësi që në procedurë penale të paraqes propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike, edhe pse dihet se shqyrtimi i kësaj çështje është objekt i procedurës civile dhe zgjidhja e saj do të duhej shtruar në procedurën kontestimore.

Procedura për zgjidhjen e kërkesës pasurore juridike quhet procedurë e bashkangjitur, nga se ajo si e tillë i bashkëngjitet procedurës penale. Por, gjykata do ta zgjidhë atë në kuadër të procedurës penale vetëm nëse zgjidhja e saj, zhvillimin e kësaj procedure nuk e zvarritë në mënyrë të konsiderueshme (paragrafi 1 i nenit 458 i KPP).

Propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale mund ta paraqes personi i cili është i autorizuar për ta ushtruar këtë kërkesë në kontest civil (paragrafi 1 i nenit 459 i KPP). Këtë të drejtë, në rend të parë e ka i dëmtuari, trashëgimtarët e tij ligjor ose personat të cilëve sipas rregullave të së drejtës civile u ka kaluar kërkesa. Megjithatë, nëse me vepër penale është dëmtuar pasuria në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore autorizimi për të marrë pjesë në procedurë penale në të cilën krahas çështjes penale vendoset edhe për kërkesën pasurore juridike, i takon organit ose personit kompetent i cili është i autorizuar me ligj të veçantë për t'u kujdesur për mbrojtjen e kësaj pasurie (paragrafi 2 i nenit 459 i KPP).

E DREJTA E PROCEDURES PENALE

Sipas paragrafit 2 të nenit 458 të Kodit të Procedurës Penale kërkesa pasurore juridike mund të përfshijë: kompensimin e dëmit, kthimin e sendit ose anulimin e veprimit të caktuar juridik.

a) Në emër të kompensimit të dëmit personi i autorizuar mund të kërkoj kompensimin për dëmin material, fitimin e humbur si dhe kompensimin e dëmit moral i cili ka të bëjë me cenimin e ndonjë të drejte personale si nderit, autoritetit, përjetimit të dhembjes fizike ose shpirtërore etj.

b) I dëmtuari me kërkesë pasurore juridike mund të kërkoj kthimin e sendit në qoftë se sendi i marrë është në gjendje të rregullt. I dëmtuari, konform legjislacionit në fuqi, edhe në këtë rast mund të kërkoj kompensimin e dëmit, mirëpo duke marrë parasysh faktin se sendi i marrë me rastin e kryerjes së veprës penale mund të ketë vlerë të posaçme për të (p.sh., orën e vjedhur e ka kujtim prej dikujt) ai mund të mos jetë i kënaqur me kompensimin e dëmit.

c) Në procedurë penale i dëmtuari me kërkesë pasurore juridike mund të kërkoj prishjen e veprimit juridik me karakter pasuror, p.sh., të kontratës së lidhur me forcë ose duke e vënë palën e dëmtuar në lajthim. Në rast të një kërkesë të tillë, gjykata, kur çmon se ajo kërkesë është e bazuar, me aktgjykim urdhëron anulimin e atij veprimi juridik. Anulimi mund të jetë i plotë ose i pjesshëm dhe ai do të përfshijë edhe pasojat që kanë rrjedhur nga një veprim i tillë, natyrisht duke u kujdesur që në këto raste të mos cenohen të drejtat e personave të tretë (neni 465 i KPPK).

Propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale i paraqitet organit kompetent të cilit i është parashtruar kallëzimi penal ose gjykatës para së cilës zhvillohet procedura. Propozimi mund të paraqitet deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor në gjykatën themelore. Propozimi duhet të përfshijë kërkesën e definuar në mënyrë të qartë dhe të argumentuar me prova. Nëse personi i autorizuar nuk e ka paraqitur propozimin për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale para ngritjes së aktakuzës, ai duhet të njoftohet se propozimin mund ta paraqes deri në përfundim të shqyrtimi gjyqësor.

Në rast se me vepër penale është shkaktuar dëm në pasurinë në pronësi publike, shtetërore ose shoqërore dhe nuk është paraqitur propozim, gjykata për këtë duhet ta njoftoj organin, gjegjësisht personin i cili është i autorizuar me ligj të kujdeset për mbrojtjen e pasurisë së tillë (neni 460 i KPPK).

Personat e autorizuar mund të tërhiqen nga propozimi për realizimin e kërkesës pasurore juridike në procedurë penale deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, dhe atë ta realizojnë në kontest civil. Në rast se propozimi është tërhequr ai nuk mund të përsëritet, përveç nëse me Kodin e Procedurës Penale është paraparë ndryshe. Në qoftë se pas paraqitjes së propozimit dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor e drejta në kërkesë pasurore juridike, sipas rregullave të së drejtës pasurore i ka kaluar personit tjetër, ai person duhet të thirret në mënyrë që të deklarohet se a mbetet pranë propozimit. Në rast se personi i thirrur nuk i përgjigjet thirrjes, gjykata do të konsideroj se ai e ka tërhequr propozimin (neni 461 i KPP).

Për kërkesën pasurore juridike vendosë gjykata kompetente. Ajo, konform paragrafit 2 të nenit 463 të Kodit të Procedurës Penale, mund të vendosë për kërkesën e tillë në tërësi ose pjesërisht. Kur ajo ka vendosur vetëm për një pjesë të kërkesës pasurore juridike, për pjesën tjetër palën e dëmtuar e udhëzon në kontest civil. Gjykata do ta udhëzojë të dëmtuarin në kontest civil në çdo rast kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për gjykim të plotë ose të pjesshëm të saj. E njëjta gjë do të përsëritet edhe në rastet kur gjykata me aktgjykim e liron të pandehurin nga akuza, pastaj kur refuzohet akuza si dhe kur me aktvendim pushohet procedura penale. Kur gjykata shpallet jo kompetente për procedurën penale, ajo e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta ushtroj në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente (paragrafi 3 i nenit 463 i KPP).

Për sigurimin e kërkesës pasurore juridike e cila është rrjedhojë e kryerjes së veprës penale në procedurë penale mund të urdhërohen masat e përkohshme. Masat e tilla propozohen nga i dëmtuari dhe personat tjerë të autorizuar dhe ato urdhërohen konform dispozitave të cilat vlejné në procedurën e përmbarimit. Aktvendimin për këto masa në procedurën paraprake merret nga gjyqtari i procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës aktvendimin e merr gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues për rastet jashtë shqyrtimit gjyqësor, kurse në shqyrtim gjyqësor aktvendimin e merr trupi gjykues. Kundër aktvendimit të marrë të trupit gjykues për masë të përkohshme nuk lejohet ankesë, kurse për rastet tjera vendosë kolegji prej tre gjyqtarësh. Ankesa e parashtruar nuk e pezullon ekzekutimin e aktvendimit (neni 467 i KPP).

Marrja dhe komunikimi i vendimeve

Vendimet gjyqësore janë ; aktgjykimi, aktvendimi dhe urdhri (urdhëresa). Aktgjykimin e merr vetëm gjykata, ndërsa aktvendimin dhe urdhrin mund të marrin edhe organet tjera që marrin pjesë në procedurën penale.

Vendimet gjyqësore merren në mënyrë individuale dhe kolegjiale. Në mënyrë individuale vendosë gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues dhe kryetari i gjykatës, ndërsa në mënyrë kolegjiale trupi gjykues dhe kolegji gjyqësor.

Marrja e vendimit nga trupi gjykues në seancë për këshillim dhe votim.

Vendimi në trup gjykues merret pas këshillimit gojor dhe votimit dhe ai miratohet kur për të voton shumica e anëtarëve të atij trupi. Këshillimi dhe votimi drejtohet nga ana e kryetarit të trupit gjykues i cili voton i fundit. Njëra ndër detyrat e kryetarit të trupit gjykues është që të kujdeset për shqyrtimin e të gjitha çështjeve në tërësi dhe nga këndvështrime të ndryshme (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 471 të KPP).

Kur votat për ndonjë çështje individuale për të cilën duhet votuar ndahen në disa mendime të ndryshme, ashtu që asnjëri prej tyre nuk e ka shumicën, çështjet ndahen dhe votimi përsëritet deri sa të arrihet shumica e votave. Nëse në këtë mënyrë nuk arrihet shumica, merret vendimi sipas të cilit votat të cilat janë më të favorshme për të

pandehurin u shtohen votave që janë më pak të favorshme se këto, dhe kështu vazhdohet deri sa të arrihet shumica e nevojshme (paragrafi 3 i nenit 471 i KPP).

Është e rëndësishme të theksohet se anëtarët e trupit gjykues nuk mund të refuzojnë votimin për çështjet që i parashtron kryetari i trupit gjykues, por anëtari i trupit gjykues i cili ka votuar për lirimin e të akuzuarit ose për revokimin e vendimit dhe ka mbetur në pakicë, nuk detyrohet të votoj për dënimin. Në qoftë se ai nuk voton, konsiderohet se pajtohet me votën që është më e favorshme për të pandehurin (paragrafi 4 i nenit 471 i KPP).

Radha e shqyrtimit të çështjeve për të cilat votohet.

Kur me rastin e votimit shtrohen disa çështje, është rregull që fillimisht të votohet për çështjet bazike e pastaj për ato që janë më pak të rëndësishme. Kështu, nëse shtrohet për votim çështja e kompetencës dhe ajo e plotësimit të procedurës, së pari votohet për kompetencën e gjykatës e pastaj për nevojën e plotësimit të procedurës e çështje tjera paraprake. Por nëse shtrohet për votim çështja kryesore, në tërësinë e elementeve që atë e përbëjnë, së pari votohet nëse i akuzuari ka kryer veprë penale dhe nëse ai është penalisht përgjegjës, pastaj votohet për dënimin, për sanksionet tjera penale ose masat për trajtim të detyruar, pastaj për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike dhe pastaj për çështjet tjera për të cilat duhet marrë vendim. Por kur ndodhë që një person të akuzohet për shumë vepra penale, është rregull që së pari të votohet për përgjegjësinë e tij penale dhe dënimet për secilën veprë penale, e pastaj të votohet për një dënim unik për të gjitha veprat penale (neni 472 i KPP).

Këshillimi dhe votimi mbahen në seancë të mbyllur dhe në të marrin pjesë vetëm anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 473 të KPP).

Komunikimi i vendimeve

Vendimi i marrë në seancën për këshillim dhe votim, nëse nuk parashihet ndryshe me Kodin e Procedurës Penale, u komunikohet palëve gojarisht nëse ato janë të pranishme, e kur mungojnë atyre u dërgohet kopja e vërtetuar e vendimit. Fakti se vendimi komunikohet gojarisht shënohet në procesverbal ose në shkresë, kurse personit të cilit i është dërguar komunikimi, marrjen e vërteton me nënshkrimin e tij. Kur personi i interesuar deklaron se nuk do të ankohet, kopja e vërtetuar e vendimit të komunikuar gojarisht parimisht nuk i dërgohet (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 474 të KPP).

Më në fund, ligjdhënësi ka paraparë obligimin që kopjet e vendimeve kundër të cilave është e lejuar ankesa, personave që e kanë këtë të drejtë, duhet t'u dërgohen se bashku me udhëzimin për të drejtën e ankesës (paragrafi 3 i nenit 474 i KPP)

Forma e prerë e vendimeve

Me vendosjen e një çështje penale në procedurë penale në formë të prerë konsiderohet se ajo është çështje e gjykuar për të cilën nuk mund të zhvillohet sërish procedurë penale. Në këtë rrjedhë, mund të thuhet se vendimi gjyqësor i formës së prerë,

nuk mund të atakohet me ankesë ose ankesa kundër tij nuk është e lejuar. Sidoqoftë, vendimi gjyqësor e merr formën e prerë nën këto rrethana:

1. Kur palët heqin dorë nga e drejta e paraqitjes së ankesës;
2. Kur ka kaluar afati ligjor për ankesë e ai nuk është shfrytëzuar;
3. Kur pasi që është paraqitur ankesa ankuesi është tërhequr nga ajo para se të merret vendimi gjyqësor lidhur me të, ose
4. Kur ankesa e paraqitur është hedhur si e pa afatshme ose e palejuar, apo kur ajo është refuzuar si e pabazë.

Ekzekutimi i vendimeve

Ekzekutimi i aktgjykimit. Aktgjykimi para se të ekzekutohet duhet ta marrë formën e prerë. Ai bëhet i ekzekutueshëm pasi të bëhet dorëzimi palës dhe kur për zbatimin e tij nuk ka pengesa ligjore.

Ekzekutimi i aktvendimit. Si rregull, edhe aktvendimet ekzekutohen pasi të kenë marrë formën e prerë. Aktvendimi, sikur dhe aktgjykimi merr formën e prerë kur ai nuk mund të ankimohet me ankesë ose kur kundër tij nuk është e lejuar ankesa (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 488 të KPP). Aktvendimi, në parim ekzekutohet nga ana e organit që e ka marrë atë.

Ekzekutimi i urdhrimit. Urdhri ekzekutohet menjëherë, përpos kur organi që e lëshon atë vendosë ndryshe (paragrafi 1 i nenit 488 i KPP).

Dërgimi i parashtresave

Dërgimi i parashtresave në parim bëhet me postë. Përveç përmes postës parashtresat mund të dërgohen edhe nëpërmjet organit kompetent komunal.

Thirrja për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor ose thirrjet tjera gjykata mund t'ia komunikoj edhe gojarisht personit i cili gjendet në gjykatë së bashku me udhëzimin për pasojat e mosparaqitjes së tij. Thirrja e bërë në këtë mënyrë shënohet në procesverbal të cilin personi i thirrur e nënshkruan, përveç kur kjo thirrje është shënuar në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Kjo mënyrë dërgimi konsiderohet dërgim i rregullt (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 475 të KPP).

Dërgimi i shkresave nëpërmjet policisë

Konform paragrafit 3 të nenit 475 të Kodit të Procedurës Penale gjykata apo prokurori i shtetit mund të urdhëroj Policinë e Kosovës që të bëjë dërgimin e shkresave, nëse dorëzimi i tyre përmes postës ose njoftimit gojor ka rezultuar të jetë i pasuksesshëm. Pavarësisht kësaj, ligjdhënësi e ka autorizuar gjykatën që të mund të urdhëroj Policinë e Kosovës për të dërguar thirrjen edhe pa i shfrytëzuar mundësitë e lartcekura nëse çmon se personi i tillë me gjasë nuk do të veprojnë në pajtim me thirrjen.

Dorëzimi personal i shkresave

Në këtë rrjedhë, shkresa e cila duhet të dërgohet personalisht, duhet t'i jepet direkt personit të cilit i është adresuar. Nëse personi, të cilit shkresa duhet dorëzuar personalisht, nuk gjendet në vendin ku duhet bërë dorëzimi, dërguesi mëson se ku dhe kur mund të gjendet ai person dhe lë njoftimin me shkrim tek ndonjëri nga të afërmit e atij personi, që marrësi i shkresës të gjendet në banesën e tij ose në vendin e punës në ditën dhe orën e caktuar për të pranuar shkresën. Kur edhe pas kësaj dërguesi nuk e gjen personin të cilit duhet dorëzuar shkresën atëherë ajo i dorëzohet kujdestarit të tij ose fqinjit nëse ai pajtohet që ta pranoj atë (neni 476 i KPP).

Dorëzimi i shkresave për të cilat ligji nuk ka parashikuar se duhet të dorëzohen personalisht

Ligjdhënësi e ka rregulluar edhe çështjen e dërgimit të shkresave tjera dërgimi i të cilave nuk është paraparë se duhet të dorëzohen personalisht. Edhe në këto raste ligjdhënësi kërkon që shkresa t'i dërgohet marrësit personalisht. Megjithatë, te këto raste kur marrësi nuk gjendet në banesë ose në vendin e punës shkresa e tillë mund t'i dërgohet ndonjërit nga anëtarët e rritur të familjes së tij i cili detyrohet të pranoj shkresën. Por, kur ata nuk gjenden në shtëpi, shkresa i dorëzohet kujdestarit ose fqinjit nëse pajtohet ta pranoj atë. Kur dërgimi i shkresës bëhet në vendin e punës së personit i cili duhet të pranoj shkresën ndërsa ai nuk gjendet aty, mund t'i dorëzohet personit të autorizuar për marrjen e postës i cili detyrohet të pranoj shkresën, ose personit i cili është i punësuar në të njëjtin vend pune në qoftë se ai pajtohet ta pranoj shkresën (paragrafi 1 i nenit 477 i KPP).

Kur vërtetohet se personit të cilit duhet dërguar shkresa mungon dhe se personat të cilëve shkresa u është lënë nuk kanë mundur t'ia dërgojnë atij me kohë, shkresa kthehet me shënimin se ku gjendet personi që mungon (paragrafi 3 i nenit 477 i KPP).

Nëse ndodhë që të dështojnë mundësitë e lartcekura për dërgimin e shkresës atëherë marrësit i lihet njoftimi për postën ku mund të merret shkresa dhe afati deri kur mund ta marrë atë shkresë. Në rast se shkresa nuk merret brenda afatit të paraparë atëherë ajo i kthehet dërguesit (paragrafi 2 i nenit 477 i KPP).

Shkresat që duhet dorëzuar personalisht

Ligjdhënësi ka paraparë disa situata kur parashitësit duhet të dërgohen personalisht. Kështu të pandehurit personalisht i dërgohet thirrja për marrje në pyetje në procedurë paraprake dhe në shqyrtim gjyqësor. Të pandehurit që nuk ka mbrojtës personalisht i dërgohet aktakuza, aktgjykimi dhe vendimet tjera për të cilat afati i ankesës fillon nga dita e dorëzimit, duke përfshirë edhe ankesën e palës kundërshtare të dorëzuar për përgjigje (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 478 të KPP). Ndërkaq, për dorëzimin e parashitësve disa kategorive të personave ligjdhënësi ka parapara rregulla të tjera të cilat janë vendosur konform zgjidhjeve që vlejnjë për ato institucione.

Dorëzimi i shkresave personave të caktuar (të punësuar në institucione të caktuara)

Policëve rojeve të institucionit ku ruhen personat e privuar lirie, të punësuarve në transportin tokësor, ujqor dhe ajror parashtresat u dorëzohen përmes komandës së tyre apo eprorit të drejtpërdrejtë, personave të burgosur parashtresat u dërgohen përmes gjykatës ose nëpërmjet institucionit ku ata mbahen të burgosur, kurse personave që gëzojnë imunitet në Kosovë shkresat u dërgohen përmes organizatës përkatëse ndërkombëtare (neni 481 i KPPK). Prokurorit të shtetit shkresat i dërgohen përmes zyrës së regjistrimit të prokurorit të shtetit (paragrafi 1 i nenit 482 i KPPK).

Procedura e dorëzimit

Ligjdhënësi ka paraparë se marrësi dhe dërguesi duhet të bëjnë nënshkrimin në fletëdërgesë si garanci që vërteton dorëzimin e shkresës. Në këtë rast në fletëdërgesë domosdoshmërisht shënohet dita e dërgimit. Kur marrësi nuk ka njohuri në të shkruar ose nuk është në gjendje të nënshkruaj emrin e tij, për të nënshkruhet dërguesi duke shënuar ditën e dorëzimit dhe arsyen përse është nënshkruar në vend të marrësit. Ndërkaq, kur marrësi refuzon të nënshkruaj fletëdërgesën, dërguesi këtë e shënon në fletëdërgesë si dhe ditën e përmbushjes së dorëzimit të dërgesës (neni 479 i KPPK).

Më në fund, kur marrësi ose anëtari i rritur i familjes refuzon marrjen e shkresës, dërguesi shënon në fletëdërgesë ditën, orën dhe shkaku e refuzimit të marrjes dhe shkresën e lë në banesën e marrësit ose në vendin e tij të punës. Në këto raste dorëzimi konsiderohet valid (neni 480 i KPPK).

Shikimi i parashtresave (shkresave)

Që subjekti i autorizuar të ketë një pasqyrë të qartë lidhur me çështjen penale për të cilën zhvillohet procedurë penale është e nevojshme që atij t'i mundësohet qasje në shkresat që përbëjnë dosjen penale konkrete. Natyrisht, kjo është një çështje shumë e rëndësishme e cila, në instancë të fundit i kontribuon fuqishëm zbardhjes së të vërtetës së rastit. Duke parë këtë rëndësi ligjdhënësi përmes zgjidhjeve të përfshira në Kodin e Procedurës Penale ka paraparë një sërë dispozitash me të cilat e rregullon këtë çështje.

Kur prokurori i shtetit duhet t'u mundësoj palëve qasje në shkresat e lëndës

Si rregull, prokurori i shtetit para fillimit të hetimit nuk është i detyruar për t'i siguruar të dyshuarit qasje në informatat e mbledhura. Kjo do të thotë se me fillimin e hetimit, prokurori i shtetit është i detyruar që t'i sigurojë cilitdo të pandehur apo mbrojtësve të tyre qasje në shkresat e lëndës, përveç përjashtimeve të parapara me ligj.

Në cilat shkresa mbrojtësi duhet të ketë qasje pa kufizime

Në asnjë fazë të hetimit mbrojtësit nuk mund t'i mohohet shikimi i shkresave lidhur me procesin e marrjes në pyetje të të pandehurit, materialit të marrë nga i pandehuri apo materialit që i përket atij, materialit lidhur me veprimet hetimore në të cilat është lejuar ose është dashur të lejohet pjesëmarrja e mbrojtësit, ose i analizave të ekspertëve. Në këtë aspekt, mbrojtësi ka të drejtë që pas përfundimit të hetimit jo vetëm t'i shikoj, por edhe t'i kopjoj e fotografoj shkresat e provat materiale me të cilat disponon gjykata. Në fakt, pas ngritjes së aktakuzës, të pandehurit mund t'i sigurohet kopja ose kopjet e shkresave të lëndës (paragrafët 1-5 të nenit 213 të KPP).

Mbrojtësi gëzon të drejtën e shikimit edhe të shkresave, kopjimit e fotografimit të tyre të librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve tjera materiale të cilat janë në zotërim, ruajtje ose kontroll të prokurorit të shtetit. Natyrisht, varësisht nga rasti atij i njihet e drejta që krahas kësaj të shikoj, kopjoj e fotografoj të gjitha materialet të cilat i shërbejnë atij për përgatitjen e mbrojtjes ose të cilat i shfrytëzon prokurori i shtetit si prova gjatë shqyrtimit gjyqësor, ose të cilat janë marrë nga i pandehuri apo kanë qenë pronë e tij.

Mundësia e kufizimet që mbrojtësi të ketë qasje për shkresat e caktuara

Ligjdhënësi, megjithatë ka paraparë mundësinë që prokurori i shtetit t'ia refuzoj mbrojtësit shikimin, kopjimin ose fotografimin e shkresave të caktuara, librave, dokumenteve, fotografive dhe objekteve tjera materiale të cilat i ka në zotërim, ruajtje ose nën kontroll, nëse ka gjasa reale se shikimi, kopjimi ose fotografimi i tyre mund të rrezikoj qëllimin e hetimit apo jetën dhe shëndetin e njerëzve.

Në raste të tilla prokurori i shtetit e kërkon mendimin e gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues ashtu që nëse një gjë e tillë lejohet nga të njëjtit atëherë mbrojtësit i mundësohet shikimi, kopjimi dhe fotografimi i shkresave të kërkuara (paragrafi 6 i nenit 213 i KPPK).

Fshehja e të dhënave të caktuara(redaktimi) nga prokurori i shtetit

Prokurori i shtetit (prokurori i çështjes) konform paragrafit 7 të nenit 213 të KPPK, mund t'i redakttoj ose të shënjoj informacionet me vijë të trashë të zezë, për të fshehur të dhëna të caktuara në kopjet e shkresave të cilat përmbajnë të dhëna të ndjeshme.

I pandehuri ka të drejtë që redaktimet e tilla t'i kundërshtoj mund të kundërshtoj redaktimin te gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues brenda 3 ditëve nga pranimi i kopjes së redaktuar. Prokurorit të shtetit i jepet mundësia që të shpjegoj bazën ligjore të redaktimit pa zbuluar informacionin e ndjeshëm. Gjyqtari shqyrton informacionin e ndjeshëm dhe merr vendim brenda 3 ditëve nëse redaktimi është ligjërish i arsyetuar.

Por, duhet pasur parasysh faktin se gjyqtari dhe prokurori i shtetit i autorizuar, me rastin e lejimit të mbrojtësit që të shikoj, kopjoj e fotoografoj shkresat e provat materiale gjithnjë duhet t'i ketë në konsideratë rrethanat që kanë të bëjnë me zbatimin e masave për mbrojtjen e të dëmtuarve, dëshmitarëve dhe privatësisë së tyre, si dhe mbrojtjen e informacioneve konfidenciale (paragrafi 8 i nenit 213 i KPPK).

Qasja në shkresat e lëndës nga i dëmtuari

Të dëmtuarit, përfaqësuesit procedural apo ligjor të tij dhe mbrojtësit të viktimave konform nenit 214 të KPPK, u lejonet shikimi, kopjimi e fotografimi i shkresave dhe provave materiale që i disponon gjykata ose prokurori i shtetit. Megjithatë, para se kjo mundësi të bëhet e realizueshme kërkohet nga autoriteti kompetent që fillimisht të konstatohet ekzistimi i padyshimtë i interesit të të dëmtuarit që t'i lejonet kontakti i kërkuar në relacion me shkresën, gjegjësisht provën materiale konkrete (paragrafi 1 i nenit 214 i KPPK).

Kur kjo e drejt mund t'i kufizohet të dëmtuarit

Përkundër faktit që organi kompetent mund të ketë legjitimuar interesin e të dëmtuarit për shikimin, kopjimin dhe fotografimin e shkresave të caktuara, gjegjësisht të provave materiale konkrete, gjykata dhe prokurori i shtetit mund të refuzoj kërkesën që i dëmtuari e ka mbështetur mbi këto baza në rast se interesi legjitim i të pandehurit ose i personave të tjerë kalon interesin e të dëmtuarit, ose nëse ka gjasa reale që shikimi ose mundësitë tjera mund të rrezikojnë qëllimin e hetimit ose jetën dhe shëndetin e njerëzve apo mund të zvarriste në mënyrë të konsiderueshme procedurën, ose nëse i dëmtuari ende nuk është pyetur si dëshmitar (paragrafi 2 i nenit 214 i KPPK).

Më në fund, të dëmtuarit i njihet e drejta që të parashtrij ankesë në çdo rast kur prokurori i shtetit apo gjyqtari i procedurës paraprake i refuzojnë atij shikimin e shkresave. Ankesa, në rastin kur prokurori i shtetit ka bërë refuzimin i paraqitet gjyqtarit të procedurës paraprake, kurse në rastin kur ky i fundit refuzon kërkesën e të dëmtuarit ankesa i paraqitet kolegjit shqyrtues (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 214 të KPPK).

PROVAT

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre të përcaktuara me legjislacionin në fuqi, në veçanti me dispozitat e KPPK, subjektet e procedurës penale duhet të vërtetojnë kryerjen e veprës penale, të zbulojnë fajtorin që ka kryer veprën penale dhe të sqarojnë të gjitha rrethanat tjera që kanë rëndësi për përcaktimin e drejtë të shkallës së fajit dhe të rrezikshmërisë shoqërore të fajtorit për mjedisin në të cilin ai jeton.

Vepra penale është ngjarje që ka ndodhur në të kaluarën e cila ngjarje tentohet që të improvizohet në proces gjyqësor. Rrethanat e kryerjes së veprës penale (me të gjitha detajet e saja) dhe fajësia e të pandehurit, mund të përcaktohen vetëm me anë të provave. Në këtë rrjedhë, me provë në procedurën penale duhet kuptuar njoftimet mbi faktet dhe rrethanat që lidhen me veprën penale që merren prej burimeve të parapara

me KPPK dhe në përputhje me rregullat e përcaktuara prej tij dhe që shërbejnë për të vërtetuar kryerjen ose jo të veprës penale, pasojat që ajo i ka shkaktuar, fajësinë ose pafajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë së tij.

Në aspektin e përgjithshëm me nocionin fakt duhet nënkuptuar çështjet të cilat ngrihen në procedurë penale që kanë lidhje me veprën penale dhe kryerësin e saj dhe të cilat duhet provuar nga gjykata kompetente. Në të vërtetë, fakti pasqyron ekzistimin objektiv-real të ndonjë sendi, dukurie, procesi, ndodhie, cilësie ose raporti të vërtetuar në mënyrë mendore perceptuese.

MJETET E PROVËS

Mjetet e provës në procedurën penale, në të vërtetë paraqiten si burim i provës. Ato janë instrumente përmes të cilave transmetohet përmbajtja e provës nga burimi i saj deri te gjykata. Si mjete të provës në procedurë penale paraqiten personat, sendet dhe veprimet e caktuara. E përbashkët e të gjitha mjeteve të provës është se ato duhet të përcaktohen shprehimisht me ligj.

Në lidhje me mjetet e provës, ndër të njëra duhet pasur parasysh edhe këto rregulla:

1. Çdo burim i të dhënave nuk mund të jetë mjet i provës, meqë një gjë e tillë do të thoshte pranim i maksimës sipas së cilës “qëllimi arsyeton mjetin”, çka në procedurën penale parqet rrezik potencial për arbitraritet në procedim të provave;

2. Gjatë trajtimit të mjeteve të provës gjithsesi duhet pasur parasysh edhe disa kufizime ligjore që vijnë në shprehje me rastin e përdorimit të tyre, sidomos kur janë në pyetje mjetet e reja të provës të cilat kanë të bëjnë me marrjen e deklaramit, thënies nga i pandehuri ose dëshmitari, siç do të ishte rasti i marrjes së deklaratës së të pandehurit me mashtrim apo dredhi, duhet respektuar edhe ndalimet, tashmë tradicionale të përdorimit të dhunës, kërcënimit dhe mjeteve tjera me qëllim që nga i pandehuri të merret deklarimi ose pohimi.

Provat e papranueshme dhe pasojat juridike të përdorimit të tyre

Gjykata mund të pranojë dhe të marrë parasysh çdo provë të pranueshme që ajo konsideron se i kontribuon sqarimit të çështjes penale konkrete. Ajo ka autoritetin të vlerësojë lirisht të gjitha provat e parashtruara me qëllim të vlerësimit të pranueshmërisë (rëndësisë) ose papranueshmërisë së tyre. Mbi këtë bazë, gjykatës ka të drejtën që sipas bindjes së lirë të vlerësojë rëndësinë e provave të parashtruara, gjegjësisht që të vendosë se mbi cilat prova do ta mbështes vendimin e saj.

Provat e papranueshme

Gjykata nuk mund ta mbështes vendimin e saj në prova të papranueshme, nisur nga kjo gjykata në mbështetje të paragrafit 2 të nenit 258 të KPPK, mund të ndaloj marrjen e provës nëse:

1. Marrja e provave të tilla për të plotësuar provat tjera është e panevojshme dhe e tepërt, sepse çështja është e njohur në vija të përgjithshme;

2. Fakti që do të provohet është i parëndësishëm për vendimin apo se ai është provuar;

3. Prova është tërësisht e papërshtatshme, e pamundshme ose e paarritshme;

4. Kërkesa bëhet për të zvarritur procedurën penale.

Provë e papranueshme konsiderohet çdo informatë që është në thelb nuk ka mbështetje, kur origjina e saj është e panjohur, bazohet në thashetheme si dhe prova apo informata e cila që në dukje të parë konsiderohet e pamundshme ose e pabesueshme.

Sipas ligjit të papranueshme konsiderohen këto prova:

1. Deklarimi i të pandehurit në rastet kur atij i janë shkelur të drejtat e garantuara (përdorimi i gjuhës, e drejta që të heshtë, përkthimi falas, e drejta e mbrojtjes përmes mbrojtësit, e drejta në trajtim mjekësor etj.) dhe kur deklarimi i tij është rrjedhojë e keqtrajtimit, kanosjes, e premtimit të ndonjë përfitimi të paparaparë me ligj, e dobësisht të kujtesës ose aftësisë për të kuptuar etj.;

2. Për dëshmitar pyetet personi i cili nuk mund të pyetet për dëshmitar;

3. Për dëshmitar pyetet personi që është liruar nga dëshmimi, por nuk është vënë në dijeni për këtë ose shprehimisht nuk ka hequr dorë nga kjo e drejtë, apo kur udhëzimi dhe heqja dorë nuk është shënuar në procesverbal;

4. Për dëshmitar pyetet personi që është fëmijë i cili nuk kupton të drejtën e tij për të refuzuar dëshmimin ose

5. Dëshmia e dëshmitarit është marrë me forcë, me kanosje ose me ndonjë mjet tjetër të ngjashëm të ndaluar.

6. Deklarimi i ekspertit në rastet kur ai sipas ligjit nuk mund të caktohet si ekspert;

7. Këqyrja ose rikonstruksioni i vendit të ngjarjes të ushtruar nga prokurori i shtetit ose policia kur i pandehuri ose mbrojtësi i tij nuk janë njoftuar për ndërmarrjen e veprimit të tillë;

8. Kontrolli i personit, shtëpisë ose lokaleve tjera i zbatuar në kundërshtim me dispozitat e procedurës penale (pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake, zbatimi i kontrollit në kundërshtim me urdhrin e zbatuar etj.) dhe

9. Prova është marrë nëpërmjet masës së fshehtë dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit e mbështetur në urdhër të paligjshëm.

Ndërsa, në mbështetje të nenit 257.par.4.të KPPK, ligjdhënësi ka ndaluar çdo marrje në pyetje përmes të cilës:

1. Liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të drogës, torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit;

2. I pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj;

3. Premtohet ndonjë përfitim që nuk parashihet me ligj dhe

4. Dobësohet kujtesa e të pandehurit ose aftësia e tij për të kuptuar.

Këto veprime të palejuara nuk mund të legalizohen edhe nëse i pandehuri eventualisht ka dhënë pëlqimin (nenit 257. para 5 dhe 6 të KPPK).

Ligji gjithashtu ndalon edhe pyetjet të cilat i bëhen të pandehurit të mbështetura në supozimin se ai ka pranuar diçka që në të vërtetë nuk e ka pranuar (pyetjet kapricioze).

Dëshmia e dëshmitarit

Dëshmia është provë e rëndësishme që ndeshet pothuaj në të gjitha çështjet penale për të cilat zhvillohet procedurë penale. Si e tillë ajo shërben për vërtetimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale, për zbulimin e motivit të saj dhe vërtetimin e fajësisë së të pandehurit. Me fjalë tjera, dëshmia është deklaram i personit fizik lidhur me perceptimet shqisore të tij për faktet e rëndësishme nga e kaluara të dhëna në formë procedurale para organit kompetent.

Sipas paragrafit 1 të nenit 124 të Kodit të Procedurës Penale, dëshmitar thirret personi për të cilin besohet se mund të jep informata për veprën penale, për kryerësin dhe për rrethanat që konsiderohen të rëndësishme për procedurën penale. Rrethi i personave të cilët mund të paraqiten si dëshmitar është mjaft i gjerë. Rrjedhimisht, për t'u thirrur një person në cilësi të dëshmitarit, nuk ka kufizime sa i përket moshës, gjinisë, cilësive të tij fizike e psikike. Megjithatë, gjyqtari dhe prokurori i shtetit për shkak të inkompatibilitetit të funksionit të tyre dhe të dëshmisë në një çështje penale nuk mund të jenë edhe dëshmitar edhe gjyqtar apo prokuror i shtetit. Në rast të tillë, dëshmia ka prioritet ndaj gjykimit apo ndjekjes në atë çështje penale, ashtu që personi i tillë duhet të paraqitet në cilësinë e dëshmitarit.

Në anën tjetër, si dëshmitar mund të merret në pyetje edhe i dëmtuari. “Për sa i përket të pandehurit, ai merret në pyetje, si i pandehur dhe nuk mund të dëgjohet si dëshmitar në çështjen e vet”.

Obligimi për të dëshmuar

Çdo person i thirrur për dëshmitar detyrohet t'i përgjigjet thirrjes, e kur me dispozitat e këtij Kodi nuk është paraparë ndryshe, detyrohet edhe të dëshmojë (Neni 124. par. 3 të KPPK). Por ky detyrim ligjor për të dëshmuar nuk është absolut, ngase nuk i përfshinë personat të cilën nuk mund të dëgjohen si dëshmitarë (neni 126) dhe kategorinë e caktuar të dëshmitarëve të cilët për shkak të raporteve farefisnore apo raporteve të tjera me të pandehurin janë të liruar nga obligimi për të dëshmuar-dëshmitarët e privilegjuar (neni 127). Dëshmitarit i dërgohet thirrja me shkrim.

Nëse, dëshmitari i cili për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose të metave të rënda trupore, nuk mund t'i përgjigjet thirrjes, mund të pyetet jashtë gjykatës. Sipas paragrafit 1 të nenit 135 të Kodit të Procedurës Penale në qoftë se dëshmitari i thirrur me rregull nuk paraqitet e mungesën nuk e arsyeton, ose pa leje ose pa shkak të arsyeshëm largohet nga vendi ku duhet të pyetet, mund të detyrohet të paraqitet, por edhe mund të gjyketet deri në 250 Euro për çdo herë që nuk paraqitet.

Në qoftë se dëshmitari, pasi është paralajmëruar për pasojat, pa shkak ligjor nuk dëshiron të dëshmojë, ndaj tij mund të zbatohet dënimi me gjobë deri në 250 Euro. Kur edhe pas kësaj refuzon të dëshmojë, atëherë mund të burgoset. Burgimi zgjatë derisa dëshmitari nuk pranon të dëshmojë apo derisa dëshmimi i tij bëhet i panevojshëm, ose derisa procedura të përfundojë, por më së shumti një muaj (paragrafi 2 i nenit 135 i KPP). Me dënim me burgim nuk mund të dënohet pjesëtari i forcave të armatosura dhe pjesëtari i policisë, i cili ka refuzuar dhënien e dëshmisë. Sidoqoftë, për këtë çështje duhet të njoftohet komanda e tyre përkatëse (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 135 të KPP).

Zbatimi i marrjes në pyetje të dëshmitarit

Pasi dëshmitari të jetë bërë i disponueshëm për t'u pyetur, është rregull që ai të pyetet ndaras, pa praninë e dëshmitarëve të tjerë. Gjatë marrjes në pyetje dëshmitari detyrohet që përgjigjet t'i jep gojarisht (paragrafi 1 i nenit 130 i KPP). Mirëpo, para se të fillohet me pyetjen e dëshmitarit, atij i tërhiqet vërejtja se është i detyruar të flasë të vërtetën dhe se nuk guxon të heshtë asgjë dhe njoftohet se dhënia e dëshmisë së rreme është vepër penale. "Dëshmitari, gjithashtu paralajmërohet se nuk mund të detyrohet të përgjigjet në pyetjet të cilat atë ose të afërmit e tij i ekspozon para turpfit ose dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale, me ç'rast një paralajmërim i tillë shënohet në procesverbal (neni 129 i KPP).

Me rastin e marrjes në pyetje të personit i cili nuk e ka mbushur moshën 18 vjet, sidomos kur ai është i dëmtuar me veprën penale duhet të veprohet me kujdes në mënyrë që pyetja të mos ndikojë dëmshëm në gjendjen e tij shpirtërore. Në këtë rrjedhë, kur është e nevojshme ai pyetet me ndihmën e psikologut për fëmijë ose pedagogut për fëmijë ose personit tjetër profesional (paragrafi 5 i nenit 130 i KPP).

Në procedurë penale, krahas dëshmitarëve tjerë, mund të vihet në situatë që të paraqiten edhe dëshmitarët me nevoja të veçanta. Cilësinë e dëshmitarëve të tillë e kanë personat marrja në pyetje e të cilëve, për shkak të specifikave që ata i karakterizojnë (të qenit persona me nevoja të veçanta, të shurdhët ose memec) bëhet përmes përkthyesit të specializuar.

Sipas nenit 133.par.2 dhe 3. të KPPK, prokurori i shtetit gjatë marrjes në pyetje, së pari fillon me pyetjen e dëshmitarëve që i ka caktuar vetë e pastaj edhe të dëshmitarëve të tjerë, kurse mbrojtja së pari merr në pyetje ata që ajo i ka caktuar. Nevoja për sqarim të detajuar të çështjes penale ka kushtëzuar zgjidhjen që mundëson që secilës palë t'i jepet mundësia që t'i shtrojë pyetje dëshmitarit. Në këtë aspekt, dëshmitarit mund t'i parashtrijë pyetje edhe viktimia apo mbrojtësi i viktimave (paragrafët 4 dhe 5 të nenit 133 të KPP).

Duke pasur parasysh këtë të dhënë si dhe faktin se në disa raste dëshmitë e dëshmitarëve mund të jenë shumë kontradiktore, përkatësisht të mos pajtohen në pikëpamje të fakteve të rëndësishme ligdhënësi ka paraparë mundësinë e ballafaqimit të tyre. Në rast se organi i procedurës penale organizon ballafaqimin e dëshmitarëve, ligji ka paraparë rregullën sipas të cilës të ballafaquarit duhet të pyeten veç e veç dhe

për secilën rrethanë për të cilën dëshmitë e tyre reciprokisht nuk pajtohen dhe përgjigja e tyre shënohet në procesverbal (nenit 133.par.8. i KPPK)

Gjykata mund të kërkojë nga dëshmitari të japë betimin ndërsa nëse dëshmitari betimin e ka dhënë në procedurën paraprake gjykata i njofton të pranishmit se dëshmitari është nën betim.

Mbrojtja e dëshmitarëve dhe të dëmtuarve

Meqenëse nga dëshmitari e shpeshherë edhe nga i dëmtuari nën kanosjen e gjobitjes ose të burgimit kërkohet që të dëshmojë drejtë, shteti duhet t'i ofrojë atij mbrojtje të nevojshme në mënyrë që të mos pësojë konsekuenca të pakëndshme për shkak të dëshmimit. Për këtë qëllim, KPPK në mënyrë shprehimore përmban një mori dispozitash lidhur me mbrojtjen e dëshmitarit dhe të dëmtuarit në procedurë penale. Këto dispozita janë të rëndësishme jo vetëm për mbrojtjen e këtyre personave dhe të familjeve të tyre, por edhe për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale në tërësi. Këto dispozita në fund të fundit, i kontribuojnë ndriçimit sa më të plotë të gjendjes faktike të çështjes penale konkrete, sidomos në ato raste kur deklaratat e tilla paraqesin mjet të rrallë prove në çështjen penale në fjalë.

Me qëllim që kjo mbrojtje të mundësohet në mënyrë sa më funksionale ligjdhënësi ka paraparë mundësinë që ndaj dëshmitarit dhe të dëmtuarit të zbatohen masat mbrojtëse. Sipas paragrafit 2, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 221 të Kodit të Procedurës Penale masën mbrojtëse ndaj dëshmitarit dhe të dëmtuarit mund ta urdhërojë gjyqtari i çështjes, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit, dëshmitarit apo dëshmitarit bashkëpunues. Mbi kërkesën e tillë prokurori i shtetit duhet të njoftohet menjëherë pas pranimit të saj nga ana e gjyqtarit përkatës. Kërkesa e parashtruar lidhur me mbrojtjen e dëshmitarit ose të dëmtuarit shqyrtohet në seancë dëgjimore të mbyllur.

Pas vlerësimit se janë përmbushur kushtet nga neni 221.par.4.1 dhe 4.2 të KPPK, gjyqtari i çështjes ka mundësi ligjore që varësisht nga rrethanat, të jep urdhër për ndërmarrjen e njëres apo të më shumë masave mbrojtëse të parashikuara nga neni 222. par.1 të KPPK.

Dëshmitarët bashkëpunues

Cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues mund ta ketë i dyshuari ose i pandehuri. Sipas nenit 235 të KPPK është paraparë mundësia që i pandehuri për të cilin ende nuk është lexuar aktakuza në shqyrtimin gjyqësor të dëshmojë në gjykatë kur:

1. Ka gjasa që të parandalojë vepra të tjera penale nga personi tjetër;
2. Ka gjasa të shpie drejt zbardhjes së të vërtetës në procedurë penale;
3. Është bërë vullnetarisht dhe me marrëveshje të plotë për të dëshmuar të vërtetën në gjykatë;
4. Është vlerësuar nga gjykata si e vërtetë dhe e plotë ose
5. Mund të shpie drejt ndjekjes së suksesshme të kryerësve tjerë të veprës penale.

Shpalljen e një personi dëshmitar bashkëpunues, kur vlerësohet të jenë plotësuar kushtet e lartcekura e bën gjykata, përkatësisht gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me urdhër të cilin e merr në seancë, në bazë të kërkesës së parashtruar me shkrim nga prokurori i shtetit (paragrafi 1 i nenit 236 i KPP). Kërkesa e prokurorit të shtetit duhet të jetë e arsyetuar dhe me te mund të kërkohej që pretendimet faktike të përfshira në deklaram të mbahen të fshehta nga palët dhe mbrojtësit e tyre, gjë të cilën gjykata mund ta aprovojë (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 236 të KPP). Në seancën e mbyllur dëgjimore, në të cilin mund të marrin pjesë, përveç gjyqtarit të autorizuar edhe prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i dëshmitarit bashkëpunues.

Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk do të lëshojë urdhër për shpalljen e dëshmitarit bashkëpunues nëse prokurori i shtetit ka ndonjë dozë dyshimi ndaj dëshmitarit të tillë si dhe kur ai me aktakuzë akuzohet si organizator ose udhëheqës i grupit prej dy ose më shumë personave të cilët kanë kryer veprë penale (nenit 237.par.5. i KPP).

Urdhri për dëshmitar bashkëpunues është i pa efekt për vepra penale të kryera nga dëshmitari bashkëpunues, pas lëshuarjes së urdhrin dhe kur i pandehuri (dëshmitari bashkëpunues) shpallet fajtor për veprë penale të dënueshme me të paktën 10 vjet burgim. (neni 237 par.6 të KPPK).

KALLËZIMI PENAL

Kallëzimi penal është akt akuzues të cilin e përpilon policia e i cili është manifestim i veprimtarisë së saj në procesin e zbulimit të veprës penale, gjetjes së kryerësit të asaj veprë dhe sigurimit të provave të cilat i referohen rastit penal konkret. Ai si kurorëzim i veprimtarisë së policisë në çështjen penale konkrete i paraqitet prokurorit kompetent të shtetit. Sipas paragrafit 2 të nenit 81 të KPPK, së bashku me kallëzimin penal prokurorit të shtetit i dorëzohen edhe sendet, skicat, fotografitë, raportet e marra, procesverbalet mbi masat dhe veprimet e kryera, shënimet zyrtare, deklaramet e marra dhe materialet tjera të cilat mund të kontribuojnë në zbatimin efektiv të procedurës.

Kur policia pas paraqitjes së kallëzimit penal mëson fakte të reja, prova dhe gjurmë të veprës penale, ajo mbetet e detyruar që në vazhdimësi t'i mbledh ato dhe që për të njëjtat menjëherë t'i dorëzoj prokurorit të shtetit raport plotësues të kallëzimit penal të paraqitur paraprakisht. Po ashtu, ligjdhënësi ka paraparë si të nevojshme që policia t'i paraqesë raport të veçantë prokurorit të shtetit edhe në rastet kur lidhur me çështjen e ngritur, vjen në përfundim se masat dhe veprimet e kryera dhe të dhënat e mbledhura nuk sigurojnë asnjë bazë për kallëzim penal dhe kur kjo nuk justifikon ekzistimin e dyshimit të arsyeshëm se është kryer veprë penale, (neni 81 i KPP).

Përveç policisë, konform nenit 78 të KPPK, kallëzim penal mund të parashtrrojnë edhe organet tjera publike. Në këtë rrjedhë, është paraparë detyrimi i të gjitha organeve publike që t'i paraqesin veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare për të cilat janë informuar nga nëpunësit e tyre gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të funksioneve apo të shërbimit të tyre ose për të cilat kanë marrë dijeni në ndonjë mënyrë tjetër.

Këto organe, krahas kallëzimit penal, prokurorit të shtetit duhet t'ia paraqesin edhe provat që i disponojnë. “Detyrimi për të kallëzuar veprat penale që ndiqen sipas detyrës zyrtare ka të bëjë edhe me punëtorët socialë, ata shëndetësor, arsimtarët, edukatorët dhe personat tjerë që kryejnë punë me cilësi të ngjashme, të cilët mësojnë ose zbulojnë se ekziston dyshim i arsyeshëm se fëmija është viktimë e veprës penale, sidomos në rastet e veprave penale të drejtuara kundër integritetit seksual, për të cilat kallëzimi penal duhet të paraqitet menjëherë.

Po ashtu, ligji ka parashikuar obligimin e çdo qytetari që t'i kallëzojë veprat penale të cilat ndiqen sipas detyrës zyrtare dhe ata detyrohen të bëjnë këtë dhe nëse nuk përmbushet një detyrim i tillë ata konsumojnë veprën penale nga neni 386 të KPK, me disa përjashtime (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 79 KPPK)”. Kallëzimi nga qytetarët është një reagim i tyre ndaj kriminalitetit, përkatësisht akt i ndërgjegjshëm që synon të ndihmohet lufta kundër dukurive negative në shoqëri.

Kur ndjekja për vepër të caktuar penale varet nga propozimi për ndjekje i të dëmtuarit apo nga leja paraprake e organit kompetent, prokurori i shtetit nuk mund të zbatojë hetimin, të ngritë aktakuzën pa dorëzimin e provave që dëshmojnë se është dhënë propozimi apo leja. Pavarësisht kësaj, megjithatë në raste të ngutshme, prokurori i shtetit mund të veprojë në bazë të propozimit gojor për ndjekje i cili duhet konfirmuar me shkrim brenda 48 orëve, (paragrafi 3 i nenit 79 i KPP).

Kallëzimi penal në vështrim të paragrafëve 1 dhe 2 të nenit 80 të KPPK, i paraqitet prokurorit të shtetit kompetent me shkrim, me mjete teknike të komunikimit ose gojarisht. Ai siç është theksuar më lart, përmban shënimet mbi të dhënat personale të të dyshuarit, të dhënat e subjektit që ka përpiluar kallëzimin dhe emërtimin ligjor të veprës penale. Është me rëndësi të theksohet se nëse kallëzimi penal paraqitet gojarisht, kallëzuesi duhet të paralajmërohet për pasojat e kallëzimit të rremë dhe për të hartohet procesverbal. Kurse, në rastet kur kallëzimi penal bëhet përmes telefonit organi i autorizuar duhet të përpilojë shënim zyrtar.

Më në fund, kur kallëzimi penal i paraqitet gjykatës, policisë ose prokurorit të shtetit jo kompetent ai duhet të pranohet dhe pa vonesë t'i dërgohet prokurorit të shtetit kompetent, (paragrafi 3 i nenit 80 i KPPK).

Detyrat e përgjithshme dhe autorizimet e prokurorit të shtetit lidhur me kallëzimin penal

Siç është theksuar më lart, kallëzimi penal i paraqitet prokurorit kompetent të shtetit i cili duke çmuar bazueshmërinë e tij, varësisht nga situata konkrete mund të vendosë:

a). Ta hedh kallëzimin penal. Këtë vendim prokurori i shtetit, konform paragrafit 1 të nenit 82 të Kodit të Procedurës Penale, do ta ndërmarrë atëherë kur prej kallëzimit penal të pranuar nga policia ose burime tjera, brenda 30 ditëve, përkatësisht nga raporti rezulton qartë se: Nuk ekziston asnjë dyshim i arsyeshëm se është kryer vepër penale;

2. Ka kaluar afati i parashkrimit për ndjekje penale; Vepra penale është përfshirë në amnisti ose falje; I dyshuari gëzon imunitet dhe heqja e tij nuk është e mundur ose

nuk është miratuar nga autoriteti kompetent ose 5. Ekzistojnë rrethana tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen.

Në të gjitha këto raste, prokurori i shtetit një kopje të aktvendimit menjëherë i dërgon policisë, ndërsa brenda 8 ditësh, nga dita e hedhjes së kallëzimit duhet ta njoftojë të dëmtuarin për ndërmarrjen e këtij veprimi dhe arsyet që e kanë shtyrë atë ta bëjë një gjë të tillë (neni 82.par.2 dhe 3 i KPPK).

b). Kërkon informata plotësuese. Nëse prokurori i shtetit mbështetur në kallëzimin penal të ushtruar nuk mund të përcaktohet se pretendimet e përfshira në të janë të mundshme, ose të dhënat në kallëzim penal nuk sigurojnë bazë të mjaftueshme për fillimin e hetimit dhe nëse prokurori vetëm ka dëgjuar se është kryer vepër penale, ai nëse nuk është në gjendje vetë të sigurojë informacionet e duhura, kërkon nga policia që të mbledhë të dhënat e tilla, e cila është e detyruar që të veprojë në çdo rast të paraqitjes së kërkesave të ligjshme të prokurorit. Prokurori i shtetit gjithashtu mund të mbledhë vet të dhëna të tilla ose nëpërmjet organeve tjera publike, duke përfshirë bisedën me dëshmitarë, të dëmtuarin dhe përfaqësuesit e tyre ligjor.

c). Fillon zbatimin e hetimeve. Kur prokurori i shtetit pas pranimit të kallëzimit penal apo pas mbledhjes së të dhënave plotësuese, formon bindjen se ekziston dyshimi i arsyeshëm se personi i caktuar ka kryer veprën penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, dhe se në rast të tillë duhet të hetohet çështja, ai merr aktvendim për fillimin e hetimeve dhe i zbaton ato.

d). Kur kemi të bëjmë me kallëzimin penale, për vepra penale për të cilat nuk janë të dënueshme më shumë se tre(3) vjet, ndërsa prokurori vlerëson se ekziston dyshimi i bazuar mirë për të mbështetur akuzën, ai mund të ngrisë aktakuzë sipas nenit 241 të KPPK, pa i zhvilluar hetimet (neni 101.par.2. të KPPK).

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit

Në kushtet bashkëkohore, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit konsiderohen masa me peshë të veçantë përmes të cilave arrihet të konstatohen fakte të rëndësishme si dhe të sigurohen prova materiale të vlefshme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale. Këto masa, konform paragrafit 1 të nenit 84 të Kodit të Procedurës Penale, zbatohen apo kërkohet të zbatohen nga prokurori kompetent dhe gjyqtari i procedurës paraprake. Rrjedhimisht, për autorizimin e zbatimit të këtyre masave prokurori i shtetit ose gjyqtari i procedurës paraprake nuk është e domosdoshme të ketë dyshim të arsyeshëm për identitetin e të dyshuarit apo të dyshuarve të cilët kanë kryer, janë duke kryer ose së shpejti do të kryejnë vepër penale. Në rast të autorizimit të zbatimit të këtyre masave prokurori i shtetit mund të marrë në pyetje informatorë, dëshmitarë apo dëshmitarë bashkëpunues. Në këto raste, ai duhet t'i ndërmarrë masat konkrete për të ruajtur privatësinë e personave të cilët nuk janë përfshirë në vepër penale (paragrafët 1, 2, 3 dhe 5 të nenit 84 të KPPK).

Si masa të fshehta të vëzhgimit dhe hetimit konsiderohen:

Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave, kontrolli i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, përgjimi i komunikimeve

nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerja e simuluar e ndonjë sendi, simulimi i veprës së korrupsionit, hetimi i fshehtë, regjistrimi i thirrjeve telefonike dhe zbulimi i të dhënave financiare. Vëzhgimi i fshehtë fotografik ose me video, monitorimi i fshehtë i bisedave në vende publike, regjistrimi i thirrjeve telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare, konform paragrafit 1 të nenit 88 të Kodit të Procedurës Penale, mund të urdhërohet kundër një personi apo vendi të caktuar, nëse:

1. Ekziston dyshimi i bazuar se vendi është përdorur ose personi i tillë ka kryer veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose në rastet kur tentativa është e ndëshkueshme, ka tentuar të kryejë veprë penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe

2. Informacioni i cili mund të merret nga masat e urdhëruara ka gjasë të ndihmoj në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me masa të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Regjistrimi i bisedave telefonike ose zbulimi i të dhënave financiare po ashtu, konform paragrafit 2 të nenit 88 të Kodit të Procedurës Penale, mund të urdhërohet kundër personave tjerë, përpos të dyshuarit, nëse ekziston dyshim i bazuar se:

1. Personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit apo që merr pjesë në transaksionet financiare të të dyshuarit ose

2. I dyshuari përdor telefonin e personit të tillë.

Monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, ndërprerja e telekomunikimeve, ndërprerja e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzimi i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, blerja e simuluar e ndonjë sendi, simulimi i një veprë të korrupsionit apo hetimi i fshehtë, konform paragrafit 3 të nenit 88 të Kodit të Procedurës Penale, mund të urdhërohen kundër një personi, vendi apo sendi konkret, nëse: Ekziston dyshim i bazuar se vendi apo sendi i tillë përdoret për kryerje të veprës penale ose personi i tillë ka kryer, apo në rastin kur tentimi ndëshkohet, ka tentuar të kryej veprë penale nga neni 90 i këtij Kodi; Informacioni i cili mund të merrej nga masat e urdhëruara me gjasë do të ndihmonte në hetimin e veprës penale dhe nuk do të kishte mundësi të merrej me veprime të tjera hetimore pa shkaktuar vështirësi të paarsyeshme ose rrezik potencial për të tjerët.

Kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve ose përgjimi i komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik po ashtu mund të urdhërohen kundër personit, përpos të dyshuarit, kur plotësohen kushtet e përcaktuara me dispozitat gjegjëse të Kodit të Procedurës Penale (paragrafi 3, nënparagrafi 1 dhe paragrafi 3, nënparagrafi 2 të nenit 88 të KPP) dhe kur ekziston dyshim i bazuar se: Personi i tillë pranon ose transmeton komunikime që burojnë prej të dyshuarit ose që i dedikohen të dyshuarit ose i dyshuari përdor telefonin e personit të tillë ose ka qasje në sistemin kompjuterik.

Duhet theksuar faktin se provat e siguruara në pajtim me masën e urdhëruar në përputhje me ligjin janë të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, pa marrë parasysh nëse

janë apo jo të përfshira në aktakuzë për veprat penale të adresuara në paragrafin 1 të nenit 90 të Kodit të Procedurës Penale (paragrafi 2 i nenit 90 i KPP).

Konform paragrafit 1 të nenit 91 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesë të prokurorit të shtetit mund të urdhëroj secilën nga masat e mëposhtme:

1. Fotografimin e fshehtë ose vëzhgimin me video në vende publike; Monitorimin e fshehtë të bisedave në vende publike; Hetimin e fshehtë; Regjistrimin e bisedave telefonike;

5. Fotografimin e fshehtë ose vëzhgimin me video në vende private; Monitorimin e fshehtë të bisedave në vende private; Kontrollimin e dërgesave postale; Përgjimin e telekomunikimeve, përfshirë tekstet e mesazheve ose mesazhet e tjera elektronike; Përgjimin e komunikimeve me anë të rrjetit kompjuterik; Dërgimin e kontrolluar të dërgesave postale;

11. Shfrytëzimin e mjeteve për përcjellje të vendndodhjes; Blerjen e simuluar të ndonjë sendi; Simulim të një vepre të korrupsionit ose Zbulimin e të dhënave financiare.

Prokurori i shtetit mund të urdhëroj përkohësisht njërën nga masat e përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni vetëm në procedura penale urgjente, ose në procedura penale të cilat janë duke u hetuare nën Kapitullin XXIV ose Kapitullin XXXIV të Kodit Penal, ose rasteve të shpëlarjes së parasë në raste të nevojshme, nëse pritja e lëshimit të urdhrit prej gjyqtarit të procedurës paraprake do të rrezikonte sigurinë e hetimeve ose jetën dhe sigurinë e palës së dëmtuar, dëshmitarit, informatorit ose anëtarëve të familjes së tyre. Urdhri i tillë i përkohshëm pushon të ketë efekt nëse nuk konfirmohet me shkrim nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda tri ditëve nga lëshimi i tij. Me rastin e vërtetimit të urdhrit të përkohshëm të prokurorit të shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake, sipas detyrës zyrtare, do të bëjë vlerësim me shkrim të ligjshmërisë së tij (paragrafi 1 i nenit 91 i KPP).

Sipas paragrafit 3 të nenit 91 të Kodit të Procedurës Penale kërkesa për lëshim të urdhrit për masat e sipërpërmendura duhet të përfshijë këto të dhëna: Identitetin e zyrtarit të autorizuar policor, zyrtarit të organit të autorizuar për të zbatuar ligjin penal apo prokurorit të shtetit që bën kërkesën; Arsyet dhe faktet që mbështesin kërkesën mbi plotësimin e kushteve për zbatimin e këtyre masave dhe Të dhënat lidhur me çfarëdo kërkesë paraprake të njohur për paraqitësin e kërkesës që ka të bëjë me personin e njëjtë dhe veprimet e ndërmarra nga zyrtari i autorizuar gjyqësor lidhur me kërkesën e tillë.

Konform paragrafit 1 të nenit 92 të Kodit të Procedurës Penale, urdhri për zbatimin e ndonjëres prej masave të fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit duhet të përmbaj: Emrin dhe adresën e personit ose të personave që u nënshtrohen urdhrit; Llojin e masës dhe bazën ligjore; Arsyet e zbatimit të masës mbështetur në gjetjet që kanë të bëjnë me rastin dhe Personin e autorizuar për zbatimin e masës dhe zyrtarin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të masës.

Urdhri për vëzhgim të fshehtë fotografik ose me video në vende private, monitorim të bisedave në vende private, përgjim të telekomunikimeve, përgjim të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik ose shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes

mund ta autorizoj zyrtarin e autorizuar të policisë të hyj në lokale private, nëse gjyqtari i procedurës paraprake vlerëson se hyrja e tillë është e domosdoshme për të aktivizuar ose pamundësuar mjetet teknike për zbatimin e masave të tilla. Kur zyrtarët e autorizuar të policisë hyjnë në lokale private në pajtim me urdhrin nga ky paragraf, veprimet e tyre në lokalet private duhet të kufizohen në veprimet e nevojshme për të aktivizuar apo çaktivizuar pajisjet teknike (paragrafi 3 i nenit 92 i KPPK).

Urdhri për regjistrimin e bisedave telefonike ose përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik duhet të përfshijë të gjitha elementet për identifikimin e secilit telefon ose secilës pikë të qasjes në rrjetin kompjuterik që duhet të përgjohet. Përpos përjashtimeve të definuara me ligj, urdhri për përgjim të telekomunikimeve duhet të përmbajë të gjitha elementet për identifikimin e secilit telefon që duhet të përgjohet (paragrafi 4 i nenit 92 i KPP).

Me kërkesën e prokurorit të shtetit, urdhri për përgjimin e telekomunikimeve mund të përfshijë vetëm një përshkrim të përgjithshëm të telefonave që mund të përgjohen, kur gjyqtari i procedurës paraprake të gjykatës themelore kompetente çmon se ekziston dyshim i bazuar që: I dyshuari shfrytëzon telefona të ndryshëm me qëllim të shmangies nga vëzhgimi i zyrtarit të autorizuar të policisë dhe një telefon apo telefonat e paraqitur në urdhër shfrytëzohen ose do të shfrytëzohen nga i dyshuari.

Rrjedhimisht, kur urdhri për përgjimin e telekomunikimeve është lëshuar nga gjyqtari i procedurës paraprake të gjykatës themelore kërkohet që: Zyrtarët e autorizuar të policisë, pas zbatimit të urdhrin për një telefon të caktuar, menjëherë informojnë me shkrim gjyqtarin e procedurës paraprake mbi faktet e rëndësishme, duke përfshirë edhe numrin e telefonit; urdhri nuk mund të shfrytëzohet për të përgjuar telekomunikimet e personit i cili nuk është i dyshuar dhe kohëzgjatja e urdhrin duhet të jetë e kufizuar deri në 15 ditë dhe mund të ripërtërihet deri në 90 ditë nga dita e lëshimit të urdhrin.

Urdhri për kontrollin e dërgesave postare ose dërgesave postare me dërgim të kontrolluar duhet të përfshijë adresën në dërgesat postare që duhet të kontrollohen ose dërgohen. Në këtë rast adresa e tillë duhet të përputhet me adresat e personave të përfshirë në urdhër (paragrafi 7 i nenit 92 i KPP).

Masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit i zbaton zyrtari i autorizuar i policisë. Ai fillon zbatimin e urdhrin për masën konkrete, jo më vonë se 15 ditë nga dita e lëshimit të urdhrin për zbatim të masës. Për zbatimin me sukses të disa masave (përgjimit të telekomunikimeve, përgjimit të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, kontrollit të dërgesave postare, dërgimit të kontrolluar të dërgesave postare dhe regjistrimit të thirrjeve telefonike) personat përgjegjës të institucioneve përkatëse (të telekomunikimeve, rrjeteve kompjuterike e shërbimet postare) duhet të lehtësojnë zbatimin e urdhrin i cili mund të bëhet nën mbikëqyrjen e drejtorit ose zyrtarit tjetër përgjegjës të institucionit. Të njëjtën gjë lidhur me urdhrin për zbatimin e masës së zbulimit të të dhënave financiare duhet ta bëjë edhe punonjësi i institucionit financiar. Kur ndonjëri prej kushteve për urdhërimin e masave pushon të vlejë, zyrtari i autorizuar i policisë duhet të ndërpres zbatimin e urdhrin dhe ta njoftoj me shkrim zyrtarin e autorizuar gjyqësor. Nëse urdhri është lëshuar nga gjyqtari i procedurës

paraprake, zyrtari i policisë duhet ta informoj prokurorin e shtetit (paragrafët 1, 2, 3, 5 dhe 6 të nenit 93 të KPP).

Sipas paragrafit 8 të nenit 93 të Kodit të Procedurës Penale me rastin e zbatimit të urdhrin për hetime të fshehta, simulim të blerjes së një sendi ose stimulim të një veprë të korrupsionit: Personi i cili zbaton urdhrin nuk mund të nxis personin tjetër të kryej veprë penale të cilën personi nuk do ta kryente sikur të mos ishte intervenimi i personit i cili zbaton urdhrin dhe personi i cili në pajtim me dispozitat e këtij kapitulli zbaton urdhrin e tillë, nuk kryen veprë penale.

Me rastin e zbatimit të urdhrin për përgjimin e telekomunikimeve, përgjimin e komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik ose kontrollimin e dërgesave postare, urdhri i tillë nuk mund të zbatohet për komunikimet ndërmjet të dyshuarit dhe mbrojtësit të tij, përveç nëse ekziston dyshim i bazuar se i dyshuari dhe mbrojtësi i tij janë angazhuar së bashku në veprimtari kriminale që përbën bazën e urdhrin (paragrafi 10 i nenit 93 i KPPK).

Urdhri për vëzhgim të fshehte fotografik ose me video në vende publike, monitorim të fshehtë të bisedave, kontroll të dërgesave postare, përgjim të komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgim i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, hetim të fshehtë, regjistrim të thirrjeve telefonike ose zbulim të të dhënave financiare mund të zgjas më së shumti deri në gjashtëdhjetë ditë. Urdhri i tillë mund të ripërtërihet vetëm pasi të kenë kaluar 360 ditë nga dita e lëshimit të urdhrin paraprak. Së këndejmi, urdhri për vëzhgim të fshehte fotografik ose me video në vende private apo përgjimi i telekomunikimeve mund të zgjatet deri në gjashtëdhjetë ditë, por mund të ripërtërihet edhe për gjashtëdhjetë ditë të tjera (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 94 të KPPK) Sidoqoftë gjyqtari i procedurës paraprake mund të ndryshoj e pushoj në çdo kohë urdhrin e lëshuar kur parakushtet për urdhërimin e masës kanë ndryshuar, gjegjësisht pushuar së vlefturi. Vazhdimi i urdhrin për masën e urdhëruar nga gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhërohet vetëm kur ekziston propozimi përkatës i prokurorit të shtetit (paragrafët 5, 6 dhe 7 të nenit 94 të KPPK).

Pasi të pushoj zbatimi i masës konkrete, zyrtari i autorizuar i policisë duhet t'ia dërgoj prokurorit të shtetit të gjitha shkresat, shiritat dhe sendet tjera që kanë të bëjnë me urdhrin dhe zbatimin e tij. Materialet e tilla duhet të ruhen në vende të sigurta. Në rast se dërgesat postare nuk përmbajnë të dhëna që do të ndihmonin hetimin e veprës penale ato menjëherë duhet dërguar marrësit (neni 95 i KPPK).

Me paragrafin 4 të nenit 96 të Kodit të Procedurës Penale janë përcaktuar personat të cilët duhet të njoftohen për masat e vendosura. Të tillë në varësi të masës së urdhëruar, mund të jenë: personi i akuzuar, personat tjerë nën vëzhgim, personat që kanë poseduar ose jetuar në lokale private nën vëzhgim në kohën kur masa ka hyrë në fuqi, dërguesi dhe i adresuari i dërgesave postare etj.

Njoftimi duhet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur, por duke pasur kujdes që të mos rrezikohet qëllimi i hetimit, jeta, integriteti fizik dhe liria personale e tjetrit, ose pasuria e rëndësishme, përfshirë edhe mundësinë e shfrytëzimit të vazhdueshëm të hetuesit të fshehtë. Në rast se njoftimi vonohet, arsyet duhet të dokumentohen në dosje. Ndërkaq, nëse njoftimi nuk është bërë brenda dymbëdhjetë muajve pas pushimit

të masës, ai patjetër duhet t'i nënshtrohet miratimit të gjykatës (paragrafët 5 dhe 6 të nenit 96 të KPPK).

Prova e marrë nëpërmjet ndonjëres nga masat e fshehta dhe teknike është e papranueshme nëse urdhri për masën dhe zbatimin e saj është i kundërligjshëm. Së këndejmi, prova e cila është marrë nga monitorimi i fshehtë i bisedave në vende private, kontrollimi i dërgesave postare, përgjimi i telekomunikimeve, përgjimi i komunikimeve nëpërmjet rrjetit kompjuterik, dërgimi i kontrolluar i dërgesave postare, shfrytëzim i mjeteve për përcjellje të vendndodhjes, simulimi i blerjes së ndonjë sendi, simulimi i një veprë të korrupsionit ose hetimi i fshehtë lejohen vetëm në procedurë penale lidhur me veprën penale të përcaktuar në nenin 88, paragrafi 3. të Kodit të Procedurës Penale. Në fakt, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, në çdo kohë para se aktgjykimi të merr formën e prerë sipas detyrës zyrtare mund të shqyrtoj pranueshmërinë e materialeve të mbledhura për këto vepra penale (neni 88 i KPP) për shkelje të të drejtave kushtetuese të të pandehurit nëse ka indikacione se materialet janë mbledhur në mënyrë të kundërligjshme. Kur aktvendimi për paligjshmërinë e urdhrit ose të zbatimit të tij merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues i cili drejton procedurën heq tërë materialin e mbledhur nga procesverbali dhe materialet e tilla ia dërgon Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit nëpërmjet kryetarit të Gjykatës Themelore për vendim mbi kompensim (neni 97 i KPPK).

Në rast të ushtrimit të ankesës lidhur me vendimin e gjykatës për pranueshmërinë e provës, ajo si rregull i paraqitet Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit, i cili pasi të konstatoj kundërligjshmërinë e masës gjegjëse të zbatuar, mund të vendosë që: Të pushoj urdhrin nëse ende është në fuqi; të urdhëroj asgjësimin e materialeve të mbledhura dhe të kompensoj personin ose personat që i janë nënshtuar urdhrit.

Pavarësisht kësaj, në çdo rast pasi aktvendimi për paligjshmërinë e urdhrit ose të zbatimit të tij merr formën e prerë, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues i cili drejton procedurën heq tërë materialin e mbledhur nga procesverbali dhe materialet e tilla ia dërgon Panelit për Shqyrtimin e Vëzhgimit dhe Hetimit nëpërmjet kryetarit të Gjykatës Themelore për vendim mbi kompensimin (paragrafi 5 i nenit 97 i KPPK).

Më në fund, duhet theksuar se dispozitat lidhur me masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, pa paragjykuar kompetencat e personave zyrtarë sipas ligjit në fuqi, vlejnjë për zbatim të vëzhgimit dhe hetimit edhe me rastin e ofrimit të shërbimeve doganore dhe shërbimeve të tjera të ngjashme (neni 100 i KPPK).

KUPTIMI I HETIMIT ZBATIMI, QËLLIMI DHE KOHËZGJATJA E HETIMIT

Hetimi është faza e parë e procedurës penale që shërben si premisë për zhvillimin e mëtejshëm të saj. Në këtë fazë zgjidhen një sërë çështjesh të procedimit penal, si: fillimi i procedimit, caktimi i masave të sigurimit të të pandehurit në procedurë ose të provave materiale, njoftimi i aktakuzës, merren provat që nuk mund të përsëriten, kryhen kontrollime, sekuestre, ekspertime dhe eksperimente, grumbullohen të dhënat e nevojshme për përcaktimin e veprës penale dhe individualizimin e atij që e ka kryer veprën etj.

Hetimi, paraqet fazën e parë të procedurës penale të cilën e zhvillon prokurori i shtetit kundër personit të caktuar për të cilin ekziston dyshimi i arsyeshëm se ka kryer veprën penale, (paragrafi 1 i nenit 101 i KPPK).

Hetimin në të drejtën tonë të procedurës penale e zbaton dhe e mbikëqyrë prokurori kompetent i shtetit. Pra, prokurori i shtetit mund të ndërmarrë veprime hetimore, ose të autorizojë policinë që të ndërmarrë veprime hetimore lidhur me marrjen e provave, (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 104 të KPPK).

Prokurori i shtetit e fillon hetimin kundër personit të caktuar atëherë kur është informuar nëpërmjet kallëzimit penal ose burimeve tjera, dhe nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se ai person ka kryer vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare, (paragrafi 1 i nenit 102 i KPP).

Për zbatimin e hetimit prokurori nxjerr aktvendim, me të cilin përcakton personin kundër të cilit kryhet hetimi, kohën e fillimit të hetimit, përshkrimin e veprës e cila tregon elementet e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale, rrethanat dhe faktet që arsyetojnë dyshimin e arsyeshëm për veprën penale, shënimin lidhur me masën e fshehtë dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, nëse është urdhëruar dhe provat e informacionin e mbledhur deri në atë moment, me ç`rast një kopje të tij pa vonesë ia dërgon gjyqtarit të procedurës paraprake, (paragrafi 1 i nenit 104 i KPPK).

Qëllimi i hetimit është mbledhja e provave dhe e të dhënave të nevojshme për të vendosur për ngritjen e aktakuzës apo për pushimin e procedurës, dhe të tubojë prova mbledhja e të cilave në shqyrtimin gjyqësor do të ishte e pamundur ose e vështirësuar, (paragrafi 2 i nenit 103 i KPPK).

Hetimi, duhet të përfundojë brenda 2 vjetëve (nenit 159. par.1 të KPPK). Nëse hetimi nuk përfundon brenda 2 vjetëve nga fillimi i hetimit paraprak dhe nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi, hetimi duhet të pushohet menjëherë.

Pavarësisht kësaj, ligdhënësi megjithatë i ka dhënë të drejtë gjyqtarit të procedurës paraprake që të mund të autorizojë një vazhdim deri në 6 muaj të hetimit, në rastet kur kjo arsyetohet me ndërlikueshmërinë e çështjes, me përfshirjen në hetim të 4 apo më shumë të pandehurve (natyrisht me përjashtime), në rastet kur çështja penale ka të bëjë me disa të dëmtuar, te situatat kur është bërë kërkesa për ndihmë juridike ndërkombëtare, si dhe kur ekzistojnë rrethana tjera të jashtëzakonshme.

Pezullimi, pushimi dhe përfundimi i hetimit

Hetimi i filluar duhet të ketë edhe ecurinë përmbyllëse të tij. Në këtë aspekt, prokurori i shtetit dhe kryeprokurori i zyrës së prokurorisë përkatëse, çdo 3 muaj detyrohen të shqyrtojnë lëndën dhe konstatojnë nëse hetimi duhet të mbetet i hapur, të pezullohet, të pushohet apo të ngritet aktakuza. Së këndejmi, marrë në përgjithësi, hetimet mund të pezullohen, të pushohen ose të përfundohen.

Hetimet mund të *pezullohen*, atëherë kur për zhvillimin e mëtejshëm të procedurës penale paraqiten pengesa procedurale (neni 157). Kështu, prokurori i shtetit mund të pezullojë hetimin me aktvendim atëherë kur:

1. I pandehuri pas kryerjes së veprës penale vuan nga një çrregullim ose paaftësi e përkohshme mendore ose sëmundje tjetër e rëndë;

2. I pandehuri është arratisur jashtë vendit dhe

3. Kur ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen me sukses të të pandehurit. Këtu është menduar në rrethana të jashtëzakonshme, siç mund të jenë gjendja e luftës, tërmetit etj.

Para se të pezullohet hetimi mblidhen të gjitha provat e mundshme të cilat i referohen veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të pandehurit. Fakti i pezullimit të hetimit duhet të shënohet në procesverbal të veçantë. Në atë procesverbal shënohet koha dhe arsyet e pezullimit të hetimit si dhe koha e rifillimit të hetimit. Koha e pezullimit të hetimit nuk llogaritet në afatin e hetimit e as në kohën e parashkrimit të veprës penale. Është e qartë se hetimi i pezulluar mund të rifillohet, por kjo mund të ndodhë vetëm atëherë kur të pushojnë pengesat që kanë shkaktuar atë pezullim, (paragrafët 2-5 të nenit 157 të KPP).

Hetimi *pushohet* me aktvendim të prokurorit të shtetit, (me ç`rast faktikisht pushon procedura penale në përgjithësi) kurdo që është provuar nga provat e mbledhura se:

1. Nuk ekziston dyshim i arsyeshëm që personi konkret ka kryer veprën penale për të cilën dyshohet;

2. Vepra e kryer nuk është vepër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare;

3. Ka kaluar afati i parashkrimit;

4. Vepra penale është përfshirë me amnisti ose falje ose

5. Ekzistojnë rrethana tjera të cilat përjashtojnë ndjekjen.

Kur prokurori i shtetit pushon hetimin, ai duhet që brenda 8 ditësh ta lajmërojë të dëmtuarin lidhur me këtë fakt dhe arsyet mbi bazën e të cilave ka marrë një vendim të tillë. Lidhur me vendimmarrjen e tillë prokurori i shtetit duhet ta njoftojë edhe gjyqtarin e procedurës paraprake, (paragrafi 2 i nenit 158 i KPPK).

Hetimin prokurori i shtetit e pushon edhe nëse gjatë rrjedhës së procedurës penale vërtetohet se i pandehuri ka vdekur, (neni 160 i KPPK).

Më në fund, duhet theksuar faktin se hetimi pushon edhe me kalimin e afateve kohore për të cilat është folur më lart. Në këto raste hetimi pushon automatikisht, pavarësisht mungesës së ndonjë vendimi përkatës, (paragrafi 3 i nenit 158 i KPP).

Prokurori i shtetit e përfundon hetimin kur çmon se çështja është sqaruar mjaft, gjegjësisht se janë kryer të gjitha veprimet e mundshme dhe janë grumbulluar të dhënat e nevojshme në mënyrë që të ngritet aktakuza. Për përfundimin e hetimeve prokurori i shtetit, si rregull, duhet ta njoftojë të pandehurin dhe mbrojtësin e tij.

Mundësia hetuese e veçantë

Me zgjidhjet ligjore në fuqi ligjdhënësi ka lënë mundësinë që përjashtimisht, prokurori i shtetit, viktimata, mbrojtësi i viktimave, i pandehuri ose mbrojtësi i tij të mund të kërkojnë nga gjyqtari i procedurës paraprake që të merr dëshmi nga dëshmitari ose të kërkojë ekspertizë me qëllim të ruajtjes së provës, kur ekziston një mundësi e veçantë për marrjen e provës së rëndësishme ose kur ka rrezik të konsiderueshëm se kjo provë nuk do të mund të merrej gjatë shqyrtimit gjyqësor. Si rregull, gjyqtari i procedurës paraprake do të miratojë një kërkesë të tillë vetëm atëherë kur procedura penale zbatohet për hetimin e veprës penale për të cilën është paraparë dënimi prej 5 ose më shumë vjet burgim. Por, nëse gjyqtari i procedurës paraprake nuk e aprovon kërkesën për marrjen e dëshmisë së tillë vendimin definitiv lidhur me këtë do ta marrë kolegji shqyrtues, (paragrafët 1, 2 dhe 5 të nenit 149 të KPP).

Sidoqoftë në rastet e mundësisë hetuese të veçantë gjyqtari i procedurës paraprake merr masat e nevojshme për të siguruar efikasitetin dhe tërësinë e procedurës, dhe në veçanti për të mbrojtur të drejtat e të pandehurit. Në seancën e dëgjimit që zhvillohet lidhur me këtë çështje duhet të marrin pjesë i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe prokurori i shtetit, kurse viktimata dhe mbrojtësi i viktimave njoftohen për seancën, por ajo mund të mbahet edhe pa praninë e tyre.

Në këto raste deklarata e marrë në panelin e mundësisë hetuese të veçantë incizohet audio apo audio dhe video incizohet dhe ajo i bashkëngjitet shkresave të lëndës, *dëshmia e tillë mund* të merret edhe me anë të teknologjisë që mundësojnë video-konferencat nëse dëshmitari nuk gjendet në Kosovë dhe ka gjasë që mos të kthehet në Kosovë, apo në pajtim me masën për mbrojtjen e dëshmitarëve, (paragrafët 6-8 të nenit neni 149 të KPPK).

VEPRIMET HETIMORE

Deklarimi i të pandehurit

Deklarimi i të pandehurit, marrë në përgjithësi parqet një rën nga provat më të rëndësishme e cila mund të shfrytëzohet si bazë për marrjen e vendimit gjyqësor. Ajo, në shumë raste përfaqëson një burim shumë të vlefshëm për ndriçimin e të dhënave të rëndësishme në procedurë penale. Marrja në pyetje e të pandehurit bëhet për shkak të rëndësisë që ka deklarimi, eventualisht pohimi i tij si provë për ndriçimin dhe zgjidhjen e çështjes penale. Për arsye se i pandehuri më së miri e ka të njohur faktin se a është kryerës i veprës penale apo jo. Në anën tjetër, organet e procedurës penale

nuk disponojnë gjithëherë me prova të mjaftueshme me të cilat do të ndriçohet çështja penale, sepse sa më e rëndë të jetë vepra penale, aq më tepër i pandehuri kujdeset që t'i eliminojë provat, prandaj organet e procedurës penale janë të obliguara edhe në marrjen e deklaratës së të pandehurit

Marrja në pyetje e të pandehurit

Marrja në pyetje e të pandehurit rregullohet me shumë dispozita të Kodit të Procedurës Penale, të cilat dispozita parashohin mundësinë që organet procedurale ta thërrasin të pandehurin e nën kushte të caktuara ligjore, ta shoqërojnë për ta marrë në pyetje edhe pse pasi të arrijë në gjykatë dhe të njoftohet mbi të drejtat e tij, i pandehuri mund të heshtë (paragrafi 3 i nenit 125 i KPPK). Në bazë të nenit 257 par.4 të KPPK, pavarësisht se i pandehuri heshtë apo deklaron, rreptësisht është e ndaluar që gjatë marrjes në pyetje liria e të pandehurit për të formuluar dhe shprehur mendimin e tij të ndikohet nëpërmjet keqtrajtimit, lodhjes së shkaktuar, ndërhyrjes fizike, përdorimit të torturës, shtrëngimit ose hipnotizimit; që i pandehuri të kanoset me masa të ndaluara me ligj, që atij t'i premtohet ndonjë përfitim i paparaparë me ligj, që t'i dobësohet kujtesa ose aftësia për të kuptuar, pavarësisht nga fakti se i pandehuri për këtë paraprakisht mund të ketë dhënë pëlqimin (paragrafi 5 i nenit 257 i KPPK). Po ashtu, gjatë marrjes së deklaratës së të pandehurit ligji ndalon në mënyrë shprehimore përdorimin e drogave dehëse të cilat kanë refleksione në mendimin e tij (neni 257.par.4.1). Dispozitat ligjore në fuqi ndalojnë edhe përdorimin e hipnozës për arsye se personi në gjendje hipnotizuese nuk është në gjendje të disponojë mendjen e vet, gjegjësisht se ai nuk është në gjendje të ketë kontroll mbi fjalët dhe mendimet e veta.

Me qëllim të vërtetimit të fakteve të rëndësishme në procedurë penale, edhe pa pëlqimin e të pandehurit, mund të bëhet kontrolli mjekësor i tij. Në këtë drejtim, kur konsiderohet e nevojshme mund të merret mostra e flokut dhe e folikulës, pështymës, urinës, sekretit të hundës, pjesës sipërfaqësore të lëkurës, duke përfshirë edhe zonën e ijeve, thonjtë e mostra të pjesës së poshtme të thoit si dhe mostra tjera të ngjashme të cilat nuk përbëjnë ndërhyrje trupore. Mirëpo, ekzaminimi fizik që ndërlikohet me ndërhyrje trupore siç është marrja e mostrave të gjakut mund të bëhet vetëm me urdhër të gjykatës ose me pëlqimin e personit në fjalë (nenit 144 parag. 4, 5 dhe 6 të KPPK). I pandehuri merret në pyetje më së voni para përfundimit të hetimit si dhe në shqyrtim gjyqësor.

Gjatë fazës së hetimit të pandehurin e merr në pyetje prokurori i shtetit ose policia. Deklarimi i të pandehurit dhënë policisë dhe prokurorit të shtetit mund të jetë provë e pranueshme në gjykatë nëse deklarimi i tij është marrë duke respektuar të drejtat e tij dhe në përputhje me obligimet që i parasheh KPPK. por ajo assesi nuk mund ta shpallë të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë të tillë dhe duke i dhënë rëndësi vendimtare asaj (neni 162.par.2. të KPPK).

Para çdo marrje në pyetje, pavarësisht se a është i ndaluar ose në liri, i pandehuri duhet të informohet për: Veprën penale për të cilën akuzohet; Faktin se ai mund të kërkojë marrjen e provave për mbrojtjen e tij; të drejtën në ndihmë të mbrojtësit dhe

konsultim me të para dhe gjatë marrjes në pyetje; të drejtën për të heshtur dhe për të mos u përgjigjur në asnjë pyetje, përveç informacionit mbi identitetin e tij; të drejtën në përkthim falas nëse ai nuk e kupton ose flet gjuhën e personit që pyetjen; faktin se deklarimi i tij mund të merret si provë në gjykatë dhe para por edhe gjatë marrjes në pyetje i pandehuri duhet të njoftohet edhe për të drejtën që i takon për t' u këshilluar me mbrojtësin e tij (neni 151.par.1. neni 152.par.3.të KPPK).

Është rregull që të gjitha njoftimet të cilat i bëhen të pandehurit duhet të regjistrohen në procesverbal. Megjithatë, kur të pandehurin e merr në pyetje policia dhe prokurori i shtetit, njoftimet e tilla si dhe veprimet tjera që ndërmerren ndaj tij (p.sh., kontrollimet), mund të regjistrohen edhe në mënyrë audio ose vizuale, natyrisht duke i respektuar të gjitha zgjidhjet ligjore në fuqi, për të cilat është folur më lart. Nëse regjistrimet auditive dhe vizuale praktikisht janë të pamundura atëherë gjithsesi duhet të hartohet procesverbali, me ç'rast në të gjithsesi duhet të shënohen arsyet pse marrja në pyetje nuk ka mundur të regjistrohet në mënyrë audio dhe vizuale (neni 152 par.5.i KPPK).

Gjatë marrjes në pyetje nga ai, konform paragrafit 1 të nenit 154 të Kodit të Procedurës Penale, kërkohet të tregoj emrin dhe mbiemrin e tij dhe nofkën nëse ka, emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij, mbiemrin e vajzërisë së nënës, vendlindjen dhe vendbanimin e tij, ditën, muajin dhe vitin e lindjes, numrin e tij personal të identifikimit, kombësinë dhe shtetësinë, profesionin e tij dhe rrethanat familjare, a di shkrim e lexim, shkollimin e tij, a ka të ardhura personale edhe pozitën e tij materiale, a është ndonjë procedurë penale kundër tij për ndonjë veprë tjetër penale në zbatim e sipër, dhe nëse është i mitur, identitetin e përfaqësuesit të tij ligjor, pastaj pyetet edhe për veprën penale. Megjithatë, pa marrë parasysh mënyrën në të cilën është marrë në pyetje i pandehuri, deklarata e tij e dhënë gjatë hetimeve mund të përdoret si mundësi për ta kundërshtuar deklarinimin e tij para gjykatës.

Në shqyrtim gjyqësor i pandehuri gjithashtu pyetet duke respektuar zgjidhjet ligjore në fuqi. Edhe në këtë fazë të procedurës penale i pandehuri, fillimisht pyetet për të dhënat personale ku nuk mund të përfshihet pyetja lidhur me dënimet e mëparshme të tij, si dhe pas leximit të aktakuzës kryetari i trupit gjykues kërkon nga ai që të deklarohet rreth fajësisë. Kur në shqyrtim gjyqësor i akuzuari merret në pyetje për veprën me të cilën është akuzuar, prokurori i shtetit i pari i bën pyetje të pandehurit pastaj mbrojtësi i tij. I dëmtuari, përfaqësuesi procedural i tij, i bashkakuzuari dhe eksperti mund t'i bëjnë pyetje të drejtpërdrejta të akuzuarit vetëm me lejen e gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues. Më në fund, të akuzuarit mund t'i shtrojë pyetje edhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues dhe anëtarët e trupit gjykues.

I pandehuri merret në pyetje gojarisht, mirëpo në procedurën paraprake nëse ai dyshohet për veprë penale për të cilën nuk mund të shqiptohet dënim me tepër se tri(3) vjet burgim, mjafton që atij ti jepet mundësia që mbrojtjen ta paraqes me shkrim (neni 151.par.1.të KPPK). Gjatë marrjes në pyetje atij mund t'i lejohet të mbajë shënime. Marrja në pyetje duhet t'i ofrojë mundësinë të pandehurit për të kundërshtuar arsyet e dyshimit kundër tij dhe të nxjerrë në pah faktet në favor të tij (paragrafët 2 dhe 8 të nenit 154 të KPP). Në këtë rrjedhë, atij duhet t'i bëhet e mundur që pa asnjë pengesë

ta parashtrojë mbrojtjen e vet duke i kundërshtuar faktet të cilat e ngarkojnë dhe duke i paraqitur të gjitha rrethanat që atij i shërbejnë për mbrojtje.

Kur i pandehuri nuk e di gjuhën në të cilën zhvillohet procedura marrja në pyetje e tij bëhet me ndihmën e përkthyesit. Kur është i shurdhër ose memec, ai merret në pyetje me ndihmën e një përkthyesi të kualifikuar për gjuhën e shenjave ose me shkrim, e kur marrja në pyetje në mënyrë të tillë nuk mund të zbatohet atëherë personi i cili di të komunikojë me të pandehurin ftohet në rolin e përkthyesit, përveç nëse ka konflikt interesash. Duhet theksuar se kur marrja në pyetje bëhet me ndihmën e përkthyesit, si rregull nga ai kërkohet që të betohet. Ky veprim ndërmerret në atë mënyrë që përkthyesi betohet se me besnikëri do t'i përkthejë pyetjet të cilat i bëhen të pandehurit dhe deklaratimet e dhëna të tij (paragrafët 1-3 të nenit 153 të KPP).

Gjatë marrjes në pyetje duhet të respektohet plotësisht dinjiteti i të pandehurit. Në këtë rrjedhë, atij pyetjet duhet t'i bëhen në mënyrë të qartë, të kuptueshme dhe të përpiktë. Me këtë rast është e ndaluar që të pandehurit t'i bëhen pyetje të cilat nisen nga supozimi se i pandehuri ka pranuar diçka që ai, në të vërtetë nuk e ka pranuar. Për më tepër, pyetjet e tilla nuk lejohet të bëhen as në rastet kur për këtë është siguruar pëlqimi i të pandehurit. Në fakt, të pandehurit mund t'i kërkohet të pohojë ose mohojë fakte të caktuara (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 154 të KPP).

Ligdhënësi ka paraparë pasoja radikale në rast se nuk respektohen dispozitat rreth marrjes në pyetje të të pandehurit. Rrjedhimisht, prova e marrë me shkelje të dispozitave procedurale është provë e papranueshme dhe gjykata nuk mund ta mbështes vendimin gjyqësor në prova të tilla (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 257 të KPP). Andaj, gjykata siç është theksuar më lart, detyrohet që gjatë procedurës të sigurojë që asnjë provë e papranueshme të mos përfshihet në shkresë të lëndës dhe të mos paraqitet në shqyrtim gjyqësor.

Më në fund, ligdhënësi ka paraparë mundësinë që për sqarimin e ndonjë çështje teknike ose profesionale e cila mund të shtrohet lidhur me provat e mbledhura ose gjatë marrjes në pyetje të të pandehurit ose gjatë ndërmarrjes së veprimeve tjera hetimore, prokurori i shtetit të kërkojë nga ndonjë specialist ose institut i specializuar që të jep sqarime të nevojshme për çështjet e tilla. Në raste të tilla, i pandehuri ose mbrojtësi i tij, nëse janë të pranishëm gjatë dhënies së sqarimeve, mund të kërkojnë që specialisti të jap sqarime më të hollësishme dhe ato të shënohen në procesverbal (nenet 136-142 të KPP).

Pohimi i të pandehurit

Siç dihet, me rastin e marrjes në pyetje gjatë zhvillimit të procedurës penale i pandehuri mund të pranojë se e ka kryer veprën penale ose mund ta pranojë si të vërtetë ndonjë fakt i cili i ngarkohet. Nuk ka dyshim se meqë i pandehuri më së miri e di të vërtetën lidhur me veprën për të cilën është akuzuar, deklarimi e posaçërisht pohimi i tij i dhënë në mënyrë të sinqertë, ka rëndësi të madhe për ndriçimin e çështjes penale. Sipas nenit 155 lidhur me parag. 2 të nenit 261 të KPPK, gjykata mund ta konsiderojë provë të pranueshme deklarin e të pandehurit dhënë policisë ose prokurorit të shtetit,

por ajo assesi nuk mund ta shpallë të akuzuarin fajtor duke u mbështetur vetëm në një deklaratë të tillë dhe duke i dhënë rëndësi vendimtare asaj (neni 162.par.2. të KPPK). Në të vërtetë, me gjithë rolin që mund të ketë pohimi i të pandehurit si provë në procedurë penale, është e qartë se organi që e zhvillon procedurën penale mbetet i detyruar që të mbledhë, pa hezitim, edhe prova të tjera. Në çdo rast, pohimi i të pandehurit duhet të jetë i qartë, detal dhe konkret. Ai duhet të përshkruaj rrjedhën e tërë ngjarjes, duke përfshirë motivin, vendin, kohën, mënyrën e kryerjes së veprës etj.

Më në fund, duhet theksuar faktin se deklarimi i të pandehurit si provë dhe pohimi i tij çmohen së bashku me provat tjera procedurale sipas bindjes së lirë të gjykatës.

MASAT PËR SIGURIMIN E PROVAVE MATERIALE DHE TË INTERESAVE PASURORE

Gjatë zhvillimit të procedurës penale shtrohet e nevojshme të tubohen sende të cilat kanë atributin e provave materiale e të cilat gjenden në posedim të të pandehurit ose të personave të tjerë. Për sigurimin e tyre Kodi i Procedurës Penale parasheh mundësinë e ndërmarrjes së masave të caktuara. Masat e tilla duhet të zbatohen sipas formës së caktuar, duke pasur kujdes që në atë rast, sa u përket të drejtave të qytetarëve të bëhen kufizime vetëm aq sa është e domosdoshme për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale. Masa për sigurimin e provave materiale konsiderohen: kontrolli i banesës dhe i personit, masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit, sekuestrimi i përkohshëm i sendeve dhe këqyrja e rikonstruksioni. Të këtij karakteri mund të jenë edhe: identifikimi i personave dhe sendeve, ngrirja e asetëve dhe urdhrat ndalues dhe masat e përkohshme për sigurimin e pasurisë.

Kontrollimi

Kontrollimi, marrë në përgjithësi paraqet njëërën nga masat më të rëndësishme të cilat janë në funksion të sigurimit të provave materiale dhe të interesave pasurore për mbarëvajtje të procedurës penale. Kjo masë, në shoqërinë bashkëkohore shënon një aplikueshmëri tejet të madhe. Ky aplikim i shpeshtë i kontrollimit është determinuar nga fakti se objektet që trajtohen si prova materiale, të shumtën e rasteve, arrihen të sigurohen vetëm përmes zbatimit të kësaj mase.

Kontrollimi, meqenëse prek vlerat elementare të personave, kërkohet që të zbatohet vetëm atëherë kur ka arsye të bazuara për të besuar se personi fshehë prova materiale ose se janë fshehur ato në shtëpinë apo lokalet tjera të tij.

Më në fund, duhet theksuar se në aspektin procedural penal njihen dy lloje të kontrollimeve: kontrollimi i shtëpisë dhe kontrollimi i personit. Për të dy këto dy lloje të kontrollimit, për shumë arsye do të flitet bashkërisht.

Kontrollimi i shtëpisë dhe i personit

Kontrollimi i shtëpisë si masë për sigurimin e provave materiale, siç u theksua më lart, gjen një aplikim mjaft të avancuar në procedurë penale. Ky lloj kontrollimi përfaqëson një masë të ndërlikuar, sepse në shtëpi ka shumë hapësira për t'u fshehur sendet. Në çdo rast, shprehjen "kontrollim i shtëpisë" duhet kuptuar, në aspekt të zgjeruar. Themi kështu ngase në kuadër të kësaj shprehje përfshihen edhe kontrollet që zbatohen në banesa, lokale të tjera dhe të pronës tjetër. Së këndejmi, shprehja "kontrollim i shtëpisë" përdoret si një shprehje gjenerale për të gjitha situatat kur zbatohet kontrollimi i objekteve të ndryshme.

Sipas paragrafit 3 të nenit 105 të KPPK gjyqtari i procedurës paraprake mund të urdhëroj kontrollin e një shtëpie, lokaleve të tjera dhe pasurisë së një personi të caktuar, kur:

1. Ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë ka kryer veprë penale dhe

2. Ka gjasa reale që kontrolli të rezultojë me arrestimin e atij personi ose me zbulimin dhe sekuestrimin e provave të rëndësishme për procedurë penale.

Rrjedhimisht, gjyqtari i procedurës paraprake, konform paragrafit 4 të nenit 105 të KPPK mund të urdhëroj edhe zbatimin e kontrollit të shtëpisë apo lokaleve tjera dhe të pasurisë të një personi që nuk dyshohet për veprë penale. Mirëpo, ky kontroll mund të autorizohet vetëm në rastet kur

1. Ka gjasa reale se kontrolli do të rezultojë me arrestimin e të pandehurit ose

2. Është e nevojshme të ruhen provat e veprës penale ose të konfiskohen sendet përkatëse të cilat nuk mund të sigurohen pa zbatim të kontrollit dhe ka gjasa reale se provat e sendet e tilla ndodhen në lokalet ose pasurinë që i nënshtrohet kontrollit.

Gjyqtari i procedurës paraprake gjithashtu mund të urdhëroj kontrollin personal të një personi konkret kur ka gjasa reale se ky kontroll do të rezultojë në zbulimin e gjurmëve ose sekuestrimin e provave të një veprë penale (paragrafi 5 i nenit 105 i KPPK).

Kontrolli i shtëpisë, i lokaleve tjera dhe i pronës si dhe i personit bëhet në bazë të urdhërkontrollit me shkrim të cilin e lëshon gjyqtari i procedurës paraprake sipas kërkesës së prokurorit të shtetit, ndërsa në raste të ngutshme edhe sipas kërkesës me shkrim të zyrtarit të autorizuar të policisë. Urdhërkontrolli përfshin: identifikimin e vendit apo personit kundër të cilit lëshohet urdhri, përshkrimin e veprës penale për të cilën lëshohet urdhri, shpjegimin e arsyeve për dyshim, përshkrimin e sendeve të kërkuara gjatë kontrollit, përshkrimin e veçantë të personit, të lokaleve apo pasurisë ku zbatohet kontrolli dhe informacionin tjetër të nevojshëm për zbatimin e kontrollit (paragrafët 6 dhe 7 të nenit 105 të KPPK).

Në rastet kur ka arsye të bazuar për të kontrolluar pajisjet elektronike, përfshirë por pa u kufizuar në kompjuterë, kamera, telefona celular, pajisje elektronike mobile ose pajisje elektronike mobile për ruajtje, urdhërkontrolli duhet të autorizoj sekuestrimin e përkohshëm të pajisjes apo pajisjeve të tilla dhe duhet të përshkruaj llojin e të dhënave elektronike për të cilat zyrtari i autorizuar i policisë mund të kontrolloj dhe t'i

kopjoj (paragrafi 8 i nenit 105 i KPPK). Konform paragrafit 9 të nenit 105 të KPPK, dispozitat të cilat i referohen kontrollit të shtëpisë, lokaleve të tjera dhe pronës zbatohen përshtatshmërisht edhe gjatë kontrollit të vendeve të fshehta në vetura ose në mjete të tjera të transportit.

Urdhërkontrollin e ekzekutojnë zyrtarët e autorizuar policor me ndihmën e nevojshme të zyrtarëve të tjerë të policisë. Kontrolli duhet të zbatohet brenda 48 orësh nga momenti i lëshimit të urdhrit. Si rregull, zyrtarët e autorizuar të policisë e ekzekutojnë urdhrin e kontrollit brenda intervalit kohor që përfshinë kohën prej orës 06.00 deri në 22.00. Megjithatë, ligjdhënësi ka lënë mundësinë që kontrolli përjashtimisht të zbatohet edhe jashtë kësaj kohe, dhe kjo mund të ndodhë atëherë kur kontrolli ka filluar brenda kësaj kohe e nuk ka arritur të përfundoj deri në orën 22.00, pastaj kur për këtë ekziston pëlqimi i personit të cilin kryhet kontrolli ose ekzistojnë arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë etj., si dhe kur gjyqtari i procedurës paraprake çmon që vonesa mund të ndikonte në arratisjen e personit të kërkuar ose asgjësimin e gjurmëve ose provave të veprës penale ashtu që ai lejon një kontroll të tillë të zgjatur (neni 106 i KPPK).

Para fillimit të kontrollit zyrtari i autorizuar policor ia prezanton urdhrin personit të cilit i drejtohet urdhri i tillë, me ç'rast atë e njofton se ka të drejtë të kontaktoj me avokatin e tij i cili mund të jetë i pranishëm gjatë kontrollit. Kur personi kërkon praninë e avokatit gjatë kontrollit, zyrtari i autorizuar i policisë e shtyn kontrollin derisa të arrij avokati, por jo më shumë se 2 orë nga njoftimi i avokatit për kontroll. Në ndërkohë, deri sa pritet ardhja e avokatit, zyrtari i autorizuar policor mund të kufizoj lëvizjen e personit përkatës dhe personave të tjerë në lokalet të cilat do të kontrollohen. Megjithatë, ligjdhënësi lejon që në raste të ngutshme zyrtarët e autorizuar të policisë të fillojnë kontrollin edhe para mbarimit të afatit kohor të ardhjes së avokatit (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 107 të KPPK).

Është rregull që para fillimit të kontrollit, zyrtari i autorizuar policor të kërkoj nga personi që vullnetarisht të dorëzoj personin ose sendet që kërkohen, ashtu që kontrolli mund të mos zhvillohet nëse veç ka ardhur deri te plotësimi i kërkesave të tilla të parashtruara (paragrafi 3 i nenit 107 i KPPK).

Përjashtimisht, kontrolli mund të filloj edhe pa prezantimin e urdhrit ose pa kërkesë të mëparshme për dorëzim të personit ose sendeve të kërkuara. Një mundësi e tillë do duhej shfrytëzuar vetëm në rastet kur pritet rezistencë e armatosur ose ka mundësi të dështoj efekti i kontrollit nëse ai nuk zbatohet menjëherë dhe pa paralajmërim ose kur kontrolli zbatohet në lokalet publike (paragrafi 4 i nenit 107 i KPPK).

Gjatë kontrollimit të shtëpisë ose lokaleve tjera personi, shtëpia, lokalet ose pasuria e të cilit kontrollohen ose përfaqësuesi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm. Gjatë kontrollimit kërkohet të jenë të pranishëm edhe dy dëshmitar madhor, të cilët paralajmërohen që me kujdes të vëzhgojnë zbatimin e kontrollit dhe njoftohen mbi të drejtën e tyre për të bërë vërejtje kur ata mund të kenë në procesverbalin mbi kontrollimin të cilin do ta nënshkruajnë pas përfundimit të kontrollit (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 108 të KPPK).

Sipas paragrafit 3 të nenit 108 të KPPK gjatë kontrollit të personit duhet zbatohet rregulla sipas së cilës kontrolli i femrave të kryhet nga femrat. Në këtë rast kërkohet që edhe dëshmitarët të jenë femra.

Me rastin e zbatimit të kontrollit të shtëpive e lokaleve të tjera kërkohet që të veprohet me kujdes në mënyrë që të mos priset qetësia. Pavarësisht kësaj, ligjdhënësi lejon hapjen e lokaleve të mbyllura, mobilieve dhe sendeve tjera edhe përmes zbatimit të forcës. Në fakt, kjo mundësi lejohet vetëm atëherë kur pronari i tyre nuk është i pranishëm ose refuzon hapjen në mënyrë vullnetare. Rrjedhimisht, gjatë hapjes së këtyre objekteve kërkohet që të shmangen me kujdesin më të madh dëmtimet e panevojshme (paragrafi 4 i nenit 108 i KPPK).

Kontrolli i personit mund të përfshijë kontrollin intim, i cili zbatohet nga mjeku ose infermieri i kualifikuar në pajtim me rregullat e shkencës së mjekësisë dhe me respektim të plotë të dinjitetit të personit (paragrafi 5 i nenit 108 i KPPK).

Përveç shtëpisë e lokaleve në pronësi private ligjdhënësi ka rregulluar edhe çështjen e kontrollit të lokaleve të organeve publike. Konform paragrafit 6 të nenit 108 të KPPK te ky lloj kontrolli duhet gjithsesi të jetë i pranishëm kryesuesi i organit të tillë publik.

Për çdo kontroll të personit, shtëpisë ose lokaleve përpilohet procesverbal. Procesverbalin e tillë e nënshkruan personi i kontrolluar ose personi lokalet ose pasuria e të cilit është kontrolluar, avokati i tij nëse është i pranishëm gjatë kontrollit dhe personat tjerë prania e të cilëve është e detyruar. Gjatë zbatimit të kontrollit mund të konfiskohen vetëm sendet dhe shkresat që kanë lidhje me qëllimin e kontrollit të caktuar. Sendet dhe shkresat e konfiskuara përfshihen dhe përshkruhen qartë në procesverbal, dhe e njëjta gjë shënohet edhe në vërtetimin që i jepet menjëherë personit sendet dhe shkresat e të cilit janë konfiskuar (paragrafi 7 i nenit 108 i KPPK).

Konfiskimi i sendeve të gjetura gjatë kontrollit që nuk kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është urdhëruar kontrolli

Nëse ndodhë që gjatë kontrollit të personit, shtëpisë ose lokaleve të gjenden sende të cilat nuk kanë të bëjnë me veprën penale për të cilën është zbatuar kontrolli, por që tregojnë një vepër tjetër penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, këto sende gjithashtu përshkruhen në procesverbal, konfiskohen dhe menjëherë lëshohet vërtetimi që tregon për sekuestrimin e tyre. Në këtë rast prokurorit të shtetit menjëherë i dërgohet informata që ai të mund të filloj procedurën penale apo të ndryshoj procedurën penale ekzistuese. Sendet e tilla do të kthehen menjëherë kur prokurori i shtetit konstaton se nuk ka bazë për ndjekje penale e as ndonjë bazë tjetër ligjore për konfiskim të atyre sendeve (neni 109 i KPPK).

Kontrollimi pa urdhër të gjyqtarit

Në përputhje me paragrafin 1 të nenit 110 të KPPK, kur është e domosdoshme dhe në masë e nevojshme, zyrtarët policor mund të hyjnë në shtëpinë dhe lokalet tjera të personit dhe të zbatojë kontrollin pa urdhër të gjyqtarit të procedurës paraprake,

nëse: Personi përkatës me dije dhe vullnet pajtohet me kontrollin; Personi thërret për ndihmë; Kryerësi i kapur në flagrancë gjatë kryerjes së veprës penale duhet arrestuar pas ndjekjes; Arsyet për mbrojtjen e njerëzve dhe pasurisë kërkojnë një veprim të tillë ose⁵. Personi kundër të cilit lëshohet urdhërarresti nga gjykata gjendet në shtëpi apo në lokale të tjera.

Në kontrollimet e këtij lloji zyrtari policor nuk shkruan procesverbal por personit të tillë i jepet një shënim zyrtar në të cilin theksohen arsyet e hyrjes në shtëpi dhe lokale të tjera (paragrafi 2 i nenit 110 i KPPK).

Kontrollimi në bazë të urdhrit me gojë të gjyqtarit të procedurës paraprake

Përfundimisht, kur këtë e kërkojnë rrethanat e ngutshme, kur urdhri me shkrim për kontroll nuk mund të merret me kohë dhe nëse ekziston rrezik real për vonesë, që mund të rezultojë me humbjen e provave ose rrezik ndaj jetës dhe shëndetit të njerëzve, zyrtari i autorizuar i policisë mund të fillojë kontrollin në bazë të lejes gojore të gjyqtarit kompetent.

Kontrollimi pa praninë e dëshmitarëve

Përfundimisht kontrolli mund të zbatohet edhe pa praninë e dëshmitarëve kur prania e tyre nuk mund të sigurohet menjëherë dhe vonesa e fillimit të kontrollit do të ishte e rrezikshme. Arsyet e zbatimit të kontrollit pa praninë e dëshmitarëve duhet të shënohen në procesverbal.

Kontrollimi pa urdhër dhe pa praninë të dëshmitarëve

Policia do të mund të zbatojë kontrollin e personit pa urdhër ose pa praninë e dëshmitarëve kur ekziston aktvendimi mbi sjelljen forcërisht të personit ose kur e bën arrestimin e tij nëse ekziston dyshimi i bazuar se personi i tillë mban armë ose mjet për sulm ose se mund të mënjanojë, fshehtë, apo asgjësojë sendet të cilat duhet nga ai të merren si provë në procedurë penale (paragrafët 3-5 të nenit 110 të KPPK).

Kur policia bën kontroll pa urdhër gjyqësor, ajo lidhur me këtë brenda afatit prej 12 orësh i dërgon raport prokurorit të shtetit dhe gjyqtarit kompetent nëse për çështjen është caktuar ndonjë gjyqtar i tillë (paragrafi 6 i nenit 110 i KPPK).

Çështja e papranueshmërisë së provave që janë siguruar gjatë procesit të kontrollimit është rregulluar me dispozitat e nenit 111 të KPPK.

Këqyrja dhe rikonstruksioni

Sipas paragrafit 1 të nenit 150 të KPPK prokurori i shtetit mund të urdhërojë këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes për të shqyrtuar provat e mbledhura ose për të qartësuar faktet e rëndësishme për procedurën penale.

Këqyrjen ose rikonstruksionin e vendit të ngjarjes e kryen prokurori i shtetit dhe policia. Prokurori i shtetit dhe policia mund të realizojnë këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë për t'u njohur personalisht me gjendjen e cila do të ju ndihmonte në përcaktimin e besueshmërisë ose gjetjen e fakteve por, në rastin e tillë rezultatet për gjykatën janë të pranueshme. Prokurori i shtetit mund të përsëris këqyrjen ose rikonstruksionin e tillë me njoftimin e të pandehurit dhe mbrojtësit, me ç'rast rezultatet e tilla janë të pranueshme (paragrafi 2 i nenit 150 i KPPK).

Sipas paragrafit 3 të nenit 150 të Kodit të Procedurës Penale i pandehuri dhe mbrojtësi i tij kanë të drejtë të jenë të pranishëm në këqyrje ose rikonstruksion të vendit të ngjarjes, nëse identiteti i tyre është i njohur. “Por, nëse i dyshuari, përkatësisht i pandehuri apo mbrojtësi i tij janë të panjohur për prokurorin e shtetit, gjyqtari i procedurës paraprake merr pjesë dhe vëzhgon këqyrjen dhe rikonstruksionin (paragrafi 4 i nenit 150 i KPPK)”.

Rikonstruksioni kryhet me rikrijimin e fakteve ose të situatave nën rrethanat e të cilave është zhvilluar ngjarja, bazuar në provat e mbledhura. Nëse faktet ose situatat paraqiten ndryshe në dëshmitë e dëshmitarëve konkret, në parim rikonstruksioni i ngjarjes zbatohet veçmas me secilin dëshmitar. Gjatë rikonstruksionit të ngjarjes duhet pasur kujdes që të mos shkelet ligji dhe rendi, të mos fyhet morali publik apo të vihet në rrezik jeta ose shëndeti i njerëzve (paragrafët 4 dhe 5 të nenit 150 të KPPK).

Këqyrja dhe rikonstruksioni i vendit të ngjarjes mund të ndihmohet nga specialistët e mjekësisë ligjore, trafikut dhe lëmenjve tjera që mund të angazhohen për të mbrojtur ose përshkruar provat, për të bërë matjet ose incizimet e nevojshme, për të bërë skicat apo për të mbledhur informata të tjera. Eksperti, gjithashtu, mund të thirret të jetë i pranishëm në këqyrje apo në rikonstruksion të vendit të ngjarjes kur prania e tij konsiderohet e nevojshme nga prokurori i shtetit

Më në fund, duhet theksuar faktin se pas ngritjes së aktakuzës, kryetari i trupit gjykues mund të urdhëroj rikonstruksionin e vendit të ngjarjes nga ky nen vetëm nëse fajësia apo pafajësia e të pandehurit kërkon që trupi gjykues të ketë njohuri të drejtpërdrejtë nga rikonstruksioni i vendit të ngjarjes apo nga vizita në vendin e kryerjes së veprës penale (paragrafi 10 i nenit 150 i KPP).

MASAT TJERA QË JANË NË FUNKSION TË SIGURIMIT TË PROVAVE MATERIALE

Identifikimi i personave dhe sendeve

Kur është e nevojshme të vendoset nëse një dëshmitar e njeh personin ose sendin, nga dëshmitari i tillë së pari kërkohet të përshkruaj dhe tregoj tiparet dalluese të personit ose sendit të tillë. Kështu, kur bëhet përshkrimi i personit, përshkrimi duhet të përqendrohet në pasqyrimin e pamjes së jashtme të personi, siç janë: shtati, gjinia, tiparet e fytyrës, veshja etj., sidomos veçoritë që në këto aspekte e karakterizojnë atë

person. Procedurë e ngjashme zbatohet edhe gjatë përshkrimit të sendit, pra në mënyrë të veçantë duhet të përshkruhen veçoritë të cilat e dallojnë atë send nga sendet tjera të ngjashme. Pas zbatimit të kësaj ecurie dëshmitarit i tregohet personi me persona të tjerë të panjohur për dëshmitarin ose fotografitë e tyre, ose sendi me sende të tjera të llojit të njëjtë ose fotografitë e tyre. Me këtë rast ai duhet të tregoj shenjat në bazë të të cilave ka arritur ta identifikoj atë send (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 120 të KPPK).

Gjatë zbatimit të këtij procesi dëshmitarit i bëhet me dije se nuk detyrohet të zgjedh personin ose sendin ose ndonjë fotografi, dhe se është po aq e rëndësishme për të treguar se nuk e njeh personin, sendin ose fotografinë sikurse të thoshte se e njeh (paragrafi 3 i nenit 120 i KPP).

Gjatë zbatimit të veprimit të identifikimit të personave apo sendeve mbahet procesverbal. Procesverbali i tillë duhet të përfshijë kohën dhe datën e realizimit të identifikimit si dhe emrat e personave të pranishëm, dhe ai u bashkëngjitet shkresave tjera të lëndës (paragrafi 4 i nenit 120 i KPPK).

Më në fund, ligjdhënësi ka parashikuar se procedura e identifikimit të personave apo sendeve mund të mbikëqyret nga ana e policisë apo prokurori i shtetit (paragrafi 5 i nenit 120 i KPPK).

MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT NË PROCEDURË PENALE

Në procesin e zbatimit të veprimeve procedurale në procedurë penale vjen në shprehje angazhimi i shumë subjekteve procedurale. Që zhvillimi i procedurës penale të ketë rrjedhë normale dhe që aq sa është e mundur, të procedohet në përputhje me afatet e përcaktuara, gjegjësisht të synuara me Kodin e Procedurës Penale është paraparë mundësia e ndërmarrjes së një sërë masash. Masat e tilla në fakt, sjellin deri te heqja ose kufizimi i lirive dhe të drejtave të personit ndaj të cilit zhvillohet procedura penale. Ato kanë si qëllim të mundësojnë zhvillimin normal të procedurës penale, por edhe të parandalojnë veprimtarinë e mëtejshme kriminale të atij që ka kryer vepër penale, të pengoj shmangien e tij nga procedura, përpjekjet që ai mund të bëjë për të vënë në rrezik marrjen e provës ose vërtetësinë e saj, si dhe të garantojnë shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale.

Ligjdhënësi ka paraparë se gjykata me rastin e vendosjes se cilën nga masat do ta zbatojë për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë penale, duhet t'i marrë parasysh kushtet e përcaktuara për zbatim të masës konkrete si dhe të siguroj që të mos zbatojë masë më të rëndë kur për arritjen e qëllimit mjafton zbatimi i masës më të butë (paragrafi 2 i nenit 173 i KPP). Në këtë rrjedhë, me paragrafin 3 të të njëjtit nen është përcaktuar detyrimi për organin e procedurës që të ndërpres aplikimin e masës në momentin kur pushojnë shkaqet që kanë kushtëzuar zbatimin e saj, gjegjësisht që ta zëvendësoj masën e shqiptuar me masë më të butë, në çdo rast kur vlerëson se edhe përmes saj do ta arrihet qëllimi i paraparë.

Si masa për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale konsiderohen: thirrja, urdhërarresti, premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktisë vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, paraqitja në stacionin policor, dorëzania, arresti shtëpiak, diversioni dhe paraburgimi si masa më e rëndë e cila mund të aplikohet vetëm atëherë kur vërtetohet se masat tjera më të buta nuk mund të arrihet ndonjë nga këto tri qëllime(nenit 173 i KPP)..

Këto masa kanë tri qëllime. Sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë, pengimin e përsëritjes së veprës penale dhe sigurimin e zhvillimit të suksesshëm i procedurës penale.

Thirrja gjyqësore

Thirrja është masa themelore dhe më e butë nëpërmjet të cilës synohet të sigurohet prania e të pandehurit në procedurë penale. Thirrjen të pandehurit ia dërgon gjykata. Ajo dërgohet në letër të mbyllur e cila si rregull përmban (përfshin): emrin dhe adresën e gjykatës e cila dërgon thirrjen, emrin dhe mbiemrin e të pandehurit, përcaktimin e veprës penale për të cilën akuzohet, vendin, ditën dhe orën kur i pandehuri duhet të paraqitet, njoftimin se thirret në cilësi të të pandehurit, paralajmërimin që në rast të mosparaqitjes kundër tij do të lëshohet urdhërarresti ose do të silllet në gjykatë forcërisht, vulën zyrtare dhe emrin e gjyqtarit që ka lëshuar thirrjen(paragrafët 1 dhe 2 të nenit 174 të KPPK).. Kur i pandehuri thirret për herë të parë, ai në thirrje duhet të udhëzohet për të drejtën e tij për të angazhuar mbrojtës dhe se mbrojtësi mund të jetë i pranishëm gjatë marrjes së tij në pyetje (paragrafi 3 i nenit 174 i KPP).

Urdhërarresti

Urdhërarresti është masë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale të cilën me kërkesë të prokurorit të shtetit, ose sipas detyrës zyrtare e lëshon gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetrari i trupit gjykues. Urdhërarresti mund të lëshohet edhe me kërkesë të policisë kur ekziston dyshimi i bazuar se i pandehuri që ka kryer veprën penale mund të fshihet ose ikë, asgjësoj, fshehë ose falsifikoj provat e veprës penale, pengoj rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarin ose bashkëpjesëmarrës, dhe kur pesha e veprës penale, mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer ajo, karakteristikat personale të kryerësit, jeta e tij e mëparshme etj., tregojnë rrezikun se ai mund të përsërisë veprën penale, ta përfundoj veprën e tentuar penale, ose të kryej veprën penale të cilën është kanosur ta kryej, ose kur i pandehuri i cili pasi është thirrur me rregull nuk paraqitet dhe nuk e arsyeton mungesën e tij, ose kur sipas rrethanave që e karakterizojnë rastin (thirrja nuk ka mundur t'iu dërgohet) është e qartë se ai do të përpiqet t'iu shmangët pranimit të thirrjes (paragrafi 1 i nenit 175 i KPP).

Premtimi i të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin

Përmes dhënies së premtimit të të pandehurit se nuk do të braktisë vendqëndrimin bëhet kufizimi i lirisë së qarkullimit të të pandehurit pa heqje të lirisë. Këtë masë konform paragrafit 1 të nenit 176 të KPPK. Me anë gjykata kërkon nga i pandehuri premtimin se nuk do të fshihet ose largohet nga vendqëndrimi pa leje të dhënë, me ç'rast premtimi i dhënë shënohet në procesverbal.

Me rastin e dhënies së premtimit, i pandehuri paralajmërohet se kundër tij mund të caktohet paraburgimi po që se nuk e respekton premtimin (paragrafi 3 i nenit 176 i KPPK).

Ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar

Me anë të kësaj mase personit të caktuar i ndalohet vajtja në një vend të caktuar, i cili mund të jetë një ose më shumë fshatra apo komuna si dhe shoqërimi me personin e caktuar, që po ashtu mund të jetë një apo shumë persona të tillë. Kjo masë është e përshtatshme të shqiptohet ndaj personave që dyshohet se kryejnë vepra penale në më shumë vende dhe që ato i kryejnë në bashkëpunim. Kjo masë, si rregull nuk e ndalon personin që të lëvizë në tërësi dhe që të komunikoj me personat në tërësi, por i ndalon që të shkoj, përkatësisht t'ia afrohet vendit (vendeve) apo personit (personave) të caktuar.

Ndalimin e të pandehurit për t'iu afruar vendit apo personit të caktuar gjykata e çështjes e ndërmerr me qëllim të pengimit të kryerjes së serishme të veprës penale, ose me qëllim që të sigurohet zhvillim i suksesshëm i procedurës penale. Gjykata,.

Me rastin e caktimit të kësaj mase gjykata gjithsesi duhet të përcaktoj edhe largësinë përkatëse nga vendi i specifikuar ose nga personi të cilin i pandehuri qëllimisht nuk duhet ta kaloj (paragrafi 3 i nenit 177 i KPPK).

Nëse i pandehuri vepron në kundërshtim me kushtet e vëna të kësaj mase, gjykata kundër tij do të caktoj paraburgimin. Natyrisht, gjykata duhet ta informoj me kohë të pandehurin për pasojat të cilat mund ta godasin atë nëse nuk i respekton kushtet e vendosura (paragrafi 5 i nenit 177 i KPPK).

Konform paragrafit 6 të nenit 177 të KPPK edhe personi i mbrojtur me këtë masë mund të dënohet, në këtë rast me gjobë, nëse qëllimisht cenon distancën e tillë të vendosur për të pandehurin.

Paraqitja në stacionin policor

Paraqitja në stacionin policor është gjithashtu masë e cila është në funksion të sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurë penale. Përmes zbatimit të kësaj mase gjykata vendosë që i pandehuri të paraqitet herë pas here në kohë të caktuar në stacionin policor, në regjionin ku i pandehuri ka vendbanimin apo vendqëndrimin, ose vendin ku i pandehuri është ndodhur në momentin e dhënies së urdhrin. Qëllimi këtu është që përmes paraqitjes i pandehuri të argumentoj faktin e prezencës së vazhdueshme në vendbanimin ose vendqëndrimin e tij.

Gjykata mbi zbatimin e kësaj mase vendosë me aktvendim, i cili përveç tjerash, duhet të përfshijë edhe informatat që përcaktojnë përmbushjen e kushteve të lartcekura dhe nevojën për zbatimin e një mase të tillë. Kopja e aktvendimit të tillë duhet t'i dorëzohet të pandehurit dhe stacionit policor përkatës në territorin e së cilës masa duhet të zbatohet (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 178 të KPP).

Në rastet e shkeljes së kushteve të vendosura me aktvendim gjykata ndaj të pandehurit mund të caktoj paraburgimin. Për këtë dhe pasojat tjera gjykata duhet ta njoftoj me kohë të pandehurin (paragrafi 4 i nenit 178 i KPP).

Gjykata krahas masës së paraqitjes në stacionin policor mund të marrë aktvendim edhe për konfiskim të përkohshëm të pasaportës së të pandehurit. Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa por ajo nuk e pezullon ekzekutimin e tij (paragrafi 7 i nenit 178 i KPP).

Dorëzania

Dorëzania gjithashtu është masë për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale. Kjo masë konsiston në deponimin e shumës së caktuar të parave nga i pandehuri, apo dikush tjetër në emër të tij, për të zëvendësuar paraburgimin.

Dorëzania caktohet me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, kurse pas ngritjes së aktakuzës atë e cakton gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues. Para se të merret një aktvendim i tillë duhet të dëgjohet prokurori i shtetit, kur vepra penale ndiqet sipas detyrës zyrtare, si dhe duhet të dëgjohet edhe mendimi i të pandehurit ose mbrojtësit të tij. Në çdo rast aktvendimi duhet t'i dorëzohet të pandehurit dhe ai duhet të përmbaj arsyetimin mbi plotësimin e kushteve të caktimit të dorëzanisë dhe nevojës së zbatimit të saj dhe i njëjti duhet t'i dorëzohet të pandehurit (paragrafët 1-4 të nenit 180 të KPP).

Shuma e parave të cilat deponohen në emër të dorëzanisë caktohet në bazë të peshës së veprës penale, rrethanave personale e familjare të të pandehurit dhe gjendjes materiale të personit që jep dorëzanimin. Dorëzania mund të jepet me para të gatshme, me letra me vlerë, sende të vlefshme dhe me pasuri të tjera të luajtshme me vlerë të konsiderueshme të cilat lehtë mund të shndërrohen në para dhe të ruhen (ari, pajisje të amvisërisë etj.), me vënien e hipotekës për shumën e dorëzanisë mbi vlerat e paluajtshme të personit që jep dorëzanimin, ose me detyrim personal të një ose më shumë personave që në rast të ikjes së të pandehurit zotohen të paguajnë shumën e caktuar të dorëzanisë (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 181 të KPP).

Nëse i pandehuri, përkundër pretimit të dhënë, largohet atëherë gjykata do të marrë aktvendim të posaçëm me të cilin caktohet që vlera e dhënë si dorëzani të derdhet në fondin për kompensimin e viktimave (paragrafi 3 i nenit 181 i KPPK).

Arresti shtëpiak

Arresti shtëpiak është masë për sigurimin e të pandehurit në procedurë penale e cila konsiston në vendosjen e detyrimit ndaj të pandehurit që ai të mos largohet nga lokalet

ku e ka vendbanimin ose vendqëndrimin apo nga institucioni publik ku ndodhet për trajtim ose përkujdesje. Caktimin e kësaj mase bëhet me aktvendim të posaçëm përmes të cilit ajo përcakton plotësimin e kushteve ligjore dhe nevojën për zbatimin e masës. Krahas kësaj, gjykata me aktvendim vendos se i pandehuri nuk guxon të largohet nga lokalet ku ai e ka vendbanimin ose vendqëndrimin apo nga institucioni publik ku ai ndodhet për trajtim dhe përkujdesje, si dhe mund të kufizoj ose ndaloj kontaktin e të pandehurit me persona të tjerë me të cilët ai nuk jeton apo të cilët nuk janë të varur nga i pandehuri. Me këtë rast i pandehuri nuk izolohet plotësisht nga shoqëria. Ai ruan të drejtën e komunikimit me personat me të cilët bashkëjetojnë, por atij mund t'i kufizohet ose ndalohet kontakti me personat tjerë.

Përkundër ndalesave që i vihen të pandehurit ligjdhënësi megjithatë ka ofruar zgjidhjen sipas së cilës të pandehurit mund t'i lejojnë disa favore. Në të vërtetë, gjykatës i është lënë mundësia që përjashtimisht t'i lejoj të pandehurit që për kohë të caktuar të largohet nga lokalet ku mbahet arresti shtëpiak (paragrafi 3 i nenit 183 i KPPK). Kjo zgjidhje është në funksion të mundësisë së të pandehurit që t'i përmbushë disa nevoja jetësore ose të kryej disa punë që janë të domosdoshme për mbijetesë të tij dhe familjes së tij.

Me mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj mase është ngarkuar gjykata e çështjes drejtpërdrejt ose nëpërmjet policisë. Rrjedhimisht, policia edhe pa kërkesë të gjykatës, në çdo kohë mund të verifikoj zbatimin e masës së arrestit shtëpiak, si dhe llogaritjen e arrestit shtëpiak dhe pa vonesë e njofton gjykatën për çdo cenim të mundshëm të masës (paragrafi 6 i nenit 183 i KPPK).

Diversioni

Diversioni si masë e re në KPPK (neni 184) është një përzierje e masës për sigurimin e pranisë së të pandehurit (pika 1.2.), dënim alternativë (1.3.) dhe masë për pezullimin procedurës.

Paraburgimi

Paraburgimi është masa më e rëndë për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale. Është kështu, meqenëse zbatimi i kësaj mase shpie në kufizimin e lirisë së lëvizjes të personit të tillë. Në këtë aspekt, të pandehurit i kufizohet mundësia e realizimit të njërës prej të drejtave themelore të njeriut e garantuar me të drejtën e brendshme dhe atë ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh peshën e madhe që ka liria e lëvizjes, me paragrafin 1 të nenit 185 të Kodit të Procedurës Penale është paraparë se paraburgimi si masë që e kufizon atë (lirinë e lëvizjes), të mund të caktohet vetëm nën kushtet dhe në pajtim me procedurat e parapara ligjore. Në këtë rrjedhë, kërkohet që paraburgimi të reduktohet në kohën më të shkurtër të mundshme e në situatën kur i pandehuri mbahet në paraburgim kërkohet nga të gjitha organet të cilat marrin pjesë në procedurë penale dhe organet që ofrojnë ndihmë juridike të veprojnë me urgjencë të posaçme. Në këtë drejtim përfshihet edhe zgjidhja me të cilën është përcaktuar se paraburgimi duhet të hiqet, në çdo fazë

të procedurës, posa të pushojnë shkaqet për caktimin e tij (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 185 të KPP).

Paraburgimin e detyrueshëm KPPK, ka parashikuar vetëm në situatën kur kryesi i veprës penale është shpallë fajtorë dhe i është shqiptuar dënim me pesë(5) apo më tepër burgim (neni 367 par.3 KPPK). Në të gjitha rastet tjera paraburgimi nuk është i detyrueshëm mirëpo gjykata mund ta caktoj nëse kumulativisht përmbushen dy kushte edhe atë: kur ekziston dyshimi i bazuar se personi i caktuar ka kryer vepër penale dhe nëse ekzistojnë të dhëna të cilat tregojnë se ekzistojnë ndonjëra nga bazat ligjore për caktimin e paraburgimit nga neni 187. të KPPK.

Çështja e dyshimit të bazuar si njëra nga kushtet për caktimin paraburgimit, nuk mund të veheet në dilemë pasi marrjes së aktvendimit për fillimin e hetimit dhe pas ngritjes së aktakuzës së drejtpërdrejt. Dyshimi i bazuar se i pandehuri ka krye vepër penale vërtetohet në bazë të informacioneve apo provave që ka siguruar prokuroi prokurori publik në procedurën paraprake apo gjatë hetimit. Ato mund të jenë rezultatet nga këqyrja e vendit të ngjarjes, sendet e konfiskuar me rastin e kontrollit, deklaratat e dëshmitarëve dhe të pandehurit dhënë në polici, etj

Kush e cakton paraburgimin

Paraburgimin në fazën e hetimeve e cakton, vazhdon dhe e heq gjyqtari i procedurës paraprake, me kërkesën e prokurorit publik, ndërsa pas ngritjes së aktakuzës paraburgimin e cakton e vazhdon dhe e heq: kryetari i trupit gjykues ; trupi gjykues apo gjyqtari i vetëm me kërkesë apo pa kërkesë të prokurorit publik.

Bazat për paraburgim alternativ janë:

1. Ekziston rreziku se ai do të fshihet, kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet ose kur ekzistojnë rrethana të tjera që tregojnë se ekziston rrezik i ikjes së tij(neni 187. par.1pika 1.2. të.KPPK;

Rrethana që vërtetojnë se i pandehuri fshihet janë; mos mundësia e dorëzimit të thirrjes në adresën e vendqëndrimit apo vendbanimit, nëse është i punësuar e nuk paraqitet në vendin e punës, etj.

Nuk mund të vërtetohet identiteti i të pandehurit kur ai nuk tregon identitetin e vet, kur policia identitetin e tij nuk mund ta vërtetojë me bazën e të dhënave që ajo posedon apo kur identiteti i tij nuk mund të vërtetohet me ndihmën e personave tjerë.

Ndër rrethanat që tregojnë rrezikun e ikjes mund të jenë: i pandehuri nuk banon në adresën që i ka dhënë gjykatës; furnizimi me dokument të udhëtimit apo vazhdimi afatit të vlefshmërisë së dokumentit të udhëtimit; shitja e pasurisë së luajtshme apo të paluajtshme; largimi i anëtarëve të familjes jashtë shtetit; transferimi i parave nga llogaria në vend në llogaritë në banka në shtetet tjera, etj.

2. Ka arsye për të besuar se ai do të asgjësoj, fshehë, ndryshoj ose falsifikoj provat e veprës penale ose kur rrethanat e posaçme tregojnë se do të pengoj rrjedhën e procedurës penale duke ndikuar në dëshmitarë, në të dëmtuarit ose bashkëpjesëmarrësit;

Caktimi përkatësisht vazhdimi i paraburgimit, nga baza e ekzistimit të frikës së bazuar se i pandehuri nëse ndodhet në liri mund të asgjësoj, fshehë, ndryshoj ose falsifikoj provat relevante është i mundur vetëm po qe se provat e tilla nuk janë siguruar, ndërsa nëse provat e tilla janë të siguruar dhe nuk ka mundësi as abstrakte që provat e tilla ti nënshtrohen asgjësimit, ndryshimit apo falsifikimit nuk mund të caktohet paraburgimi nga këto arsye.

Gjykata më së shpeshti përcaktojnë këtë rrethanë si bazë për caktimin e paraburgimit, ndërsa në të shumtën e arsyeve me atë se i pandehuri ka tentuar që të vë lidhje me dëshmitarë të caktuar, nëse nuk ka dëshmi se i pandehuri ka tentuar që të ndikoj te personi i caktuar për të dëshmuar rrejshëm.

Përfundimi për ekzistimin e frikës së bazuar se i pandehuri do pengoj hetimet duke ndikuar në dëshmitar apo bashkë kryes duhet të jetë e konkretizuar qartë me faktet të cilat tregojnë se i pandehuri personalisht ka tentuar të ndikoj te ndonjë dëshmitar apo bashkë kryes, përkatësisht se ndikimin e tillë e ka tentuar nëpërmjet personave tjerë. Prandaj caktimi përkatësisht vazhdimi i paraburgimit në kuptim të kësaj dispozite është i arsyeshëm vetëm po qe se me fakte është verifikuar tentimi i drejtpërsëdrejti apo i tërthortë i të pandehurit për të ndikuar te ndonjë dëshmitar apo bashkë kryes, e jo vetëm të supozohet se ndërmarrja e veprimit të tillë është i mundshëm.

3.kur pesha e veprës penale, mënyra ose rrethanat në të cilat është kryer vepra penale, karakteristikat e tij personale, sjellja e mëparshme, ambienti dhe kushtet nën të cilat ai jeton ose ndonjë rrethanë tjetër personale tregojnë rrezikun se ai mund ta përsërisë veprën penale, ta përfundojë veprën e tentuar penale ose ta kryejë veprën penale për të cilën është kanosur ta kryej.

Caktimi i paraburgimit sipas kësaj baze, ka të bëjë me situatë e ekzistimit të rrezikut të serishëm kriminal në anën e të pandehurit. Rrethanat konkretet me rastin e caktimit të paraburgimit nga kjo bazë mund të radhiten në tri grupe :rrethanat që kanë të bëjnë me veprën (recidivist, special, mënyra e kryerjes, intervali i shkurtër kohor në të cilën i pandehuri ka kryer shumë vepra penale, karakteri i raporteve në mes të pandehurit dhe viktimës) ; vetit personale të pandehurit (patologjia e personalitetit, gjendja shëndetësore) dhe faktorët social (i pandehuri nuk ka vendbanim të caktuar, është i papunë, është i prirë për bredhje, mjetet për jetesë të siguruar me vepër penale etj.).

Paraburgimi obligativ

Kur gjykata të akuzuarin e ka deklaruar fajtor dhe i ka shqiptuar dënim me pesë (5) vjet apo më tepër burgim, të akuzuarit i cakton paraburgimin nëse ai nuk ndodhet në paraburgim ose i vazhdon paraburgimin pavarësisht kushteve nga neni 187 të KPPK(neni 367.par.2.i KPPK).

Kohëzgjatja e paraburgimit

Sipas aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake i paraburgosuri mund të mbahet në paraburgim më së shumti 1 muaj duke filluar nga dita e arrestimit të tij. Pas kësaj kohe ai mund të mbahet në paraburgim vetëm me aktvendim të gjyqtarit të procedurës paraprake, gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues me të cilin urdhërohet vazhdimi i paraburgimit (paragrafi 1 i nenit 190 i KPPK). Konform paragrafit 2 të nenit 19 të KPPK, para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi nuk mund të zgjas më shumë se: katër (4) muaj kur procedura zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me më pak se pesë vjet burgim dhe tetë (8) muaj kur procedura zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi mbi pesë vjet burgim.

Megjithatë, duke pasur parasysh rrethanat e jashtëzakonshme të cilat ndërliken me ndërlikueshmërinë e rastit ose faktorë të tjerë të cilët mund t'i atribuohen prokurorit të shtetit, përjashtuar afatet e sipërpërmendura të para ngritjes së aktakuzës, paraburgimi mund të vazhdohet më së shumti edhe deri në 4 muaj për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej 12 muaj (paragrafi 3 i nenit 190 i KPPK).

Kur ekziston ndonjë shkak i bazuar dhe bindës për të besuar se ekziston rrezik i përgjithshëm apo rrezik i dhunës nëse lirohet i pandehuri në procedurë paraprake, paraburgimi mund të vazhdohet edhe për 6 muaj tjerë për një maksimum të përgjithshëm të paraburgimit prej 18 muaj. Rrjedhimisht, nëse aktakuza nuk ngritet para kalimit të këtyre afateve (maksimalisht brenda 18 muajve) i paraburgosuri lirohet (paragrafët 4 dhe 5 të nenit 190 të KPP).

Ligdhënësi ka përcaktuar se paraburgimi, sipas bazave dhe kohëzgjatjes së përcaktuar më lart, në fazën e hetimeve mund të zgjatet vetëm me propozim të prokurorit të shtetit. Në propozimin e tillë përpos arsyeve për zgjatje ai duhet të ofroj edhe informacionin se e ka filluar hetimin dhe se janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të përshpejtuar zbatimin e tij. I dëmtuari apo mbrojtësi i viktimave mund të kërkoj formalisht apo joformalisht nga prokurori i shtetit që të kërkoj vazhdimin e paraburgimit. Mbi propozimin e tillë të prokurorit të shtetit duhet të informohen me kohë i pandehuri dhe mbrojtësi në afat jo më vonë se 3 ditë para skadimit të paraburgimit të caktuar me aktvendimin e fundit (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 191 të KPPK).

Ndërprerje e paraburgimit

Gjyqtari i procedurës paraprake, në çdo kohë derisa hetimi është duke u zbatuar, mund të ndërpres paraburgimin sipas detyrës zyrtare, pasi të ketë paralajmëruar prokurorin e shtetit 3 ditë më parë. Prokurori i shtetit mund të paraqes ankesë te kolegji shqyrtues kundër aktvendimit të gjyqtarit të procedurës paraprake për të ndërprerë paraburgimin, kurse kolegji shqyrtues do të nxjerr aktvendimin e tij lidhur me këtë brenda 48 orësh nga pranimi i ankesës së prokurorit të shtetit (paragrafi 1 i nenit 192 i KPPK).

Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve

Meqenëse nga dëshmitari e shpeshherë edhe nga i dëmtuari nën kanosjen e gjobitjes ose të burgimit kërkohet që të dëshmojë drejtë, shteti duhet t'i ofrojë atij mbrojtje të nevojshme në mënyrë që të mos pësojë konsekuenca të pakëndshme për shkak të dëshimit. Për këtë qëllim KPPK në mënyrë shprehimore përmban një mori dispozitash lidhur me mbrojtjen e dëshmitarit dhe të dëmtuarit në procedurë penale. Këto dispozita janë të rëndësishme jo vetëm për mbrojtjen e këtyre personave dhe të familjeve të tyre, por edhe për zhvillimin e suksesshëm të procedurës penale në tërësi. Këto dispozita në fund të fundit, i kontribuojnë ndriçimit sa më të plotë të gjendjes faktike të çështjes penale konkrete, sidomos në ato raste kur deklaratat e tilla paraqesin mjet të rrallë prove në çështjen penale në fjalë.

Me qëllim që kjo mbrojtje të mundësohet në mënyrë sa më funksionale ligjdhënësi ka paraparë mundësinë që ndaj dëshmitarit dhe të dëmtuarit të zbatohen masat mbrojtëse. Sipas paragrafit 2, në lidhje me paragrafin 1 të nenit 221 të KPPK masën mbrojtëse ndaj dëshmitarit dhe të dëmtuarit mund ta urdhërojë gjyqtari i çështjes, duke u bazuar në kërkesën me shkrim të paraqitur nga ana e prokurorit të shtetit, të pandehurit, mbrojtësit, të dëmtuarit, dëshmitarit apo dëshmitarit bashkëpunues. Mbi kërkesën e tillë prokurori i shtetit duhet të njoftohet menjëherë pas pranimit të saj nga ana e gjyqtarit përkatës. Kërkesa e parashtruar lidhur me mbrojtjen e dëshmitarit ose të dëmtuarit shqyrtohet në seancë dëgjimore të mbyllur. Në seancën e tillë gjyqtari i çështjes mund të urdhërojë masën mbrojtëse për të dëmtuarin apo dëshmitarin, kur konstaton se: Ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose për anëtarin e familjes së tij dhe masa mbrojtëse është e domosdoshme për të parandaluar rrezikun serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues, dëshmitarin ose anëtarin e familjes së tij.

Pas vlerësimit se janë përmbushur këto dy kushte, paragrafit 1 i nenit 222 i KPPK i ofron mundësi gjyqtarit kompetent që varësisht nga rasti, të jep urdhër për ndërmarrjen e njërës apo të më shumë masave mbrojtëse vijuese: Lënien bosh ose shlyerjen e emrave, adresave, vendit të punës, profesionit ose ndonjë informate ose të dhëne tjetër që mund të përdoret për të identifikuar të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin; moszbulimin e ndonjë shkrese që identifikon të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin; përpjekjen për të fshehur veçoritë ose përshkrimin fizik të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues apo dëshmitarit që jep dëshminë, duke përfshirë dhënien e dëshmisë prapa një mburoje jo të tejdukshme, përmes pajisjeve për ndryshimin e fotografisë ose të zërit, ose marrjen në pyetje të njëkohshme nga një vend tjetër që komunikon me gjykatoren me anë e qarkut të mbyllur televiziv, ose videoregjistrim para seancës së dëgjimit në praninë e mbrojtësit; caktimin e pseudonimit; seancën e mbyllur për publikun; urdhrat ndaj mbrojtësit për të moszbuluar identitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit apo të ndonjë materiali që do të shpie në zbulimin e identitetit të tij; largimin e përkohshëm të të pandehurit nga gjykatëria nëse dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari refuzon të dëshmojë në prani të të pandehurit ose nëse rrethanat ia bëjnë të ditur gjykatës se dëshmitari nuk do të flasë të vërtetën në prani të të pandehurit ose cilindo nga

kombinimet e masave të përmendura më lart për të parandaluar zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit, ndërsa sipas paragrafit 2 të nenit 5 të Ligjit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve, për mbrojtjen e kësaj kategorie personash mund të aplikohen masat mbrojtëse si në vijim: Mbrojtja fizike;zhvendosja e përkohshme;procedurat e veçanta për qasje në të dhëna dhe dokumente nga zyrat e lëshimit të dokumenteve dhe bazës së të dhënave tjera formale;ndërrimi i vendbanimit, punës apo shkollimit;ndërrimi i identitetit;ndryshimi i pamjes fizike, duke përfshirë edhe operacionin plastik;mbështetja financiare;mbështetja sociale, ligjore dhe çfarëdo mbështetje tjetër e nevojshme;regjimi i veçantë në institucione korrektuese.

Urdhri për masë mbrojtëse jepet me shkrim, por ai nuk duhet të përfshijë informata të cilat mund të qojnë në zbulimin e identitetit të të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues, dëshmitarit ose anëtarit të familjes së tij, ose e cila mund të rrezikojë seriozisht sigurinë e veprimeve hetimore dhe fshehtësinë e tyre.

Vendosja e dëshmitarit nën anonimitet

Kur masat mbrojtëse të sipërpërmendura nuk janë të mjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e dëshmitarit, i cili është propozuar nga mbrojtja, zgjidhjet në fuqi ofrojnë mundësi që në rrethana të jashtëzakonshme gjyqtari të mund të urdhërojë anonimitet për publikun, por edhe për të dëmtuarin dhe për përfaqësuesit e tij ligjorë ose përfaqësuesit e autorizuar (paragrafi 1 i nenit 223 i KPP).

Rrjedhimisht, gjyqtari pas mbajtjes së seancës së dëgjimit me dyer të mbyllura, në të cilën merret në pyetje dëshmitari përkatës ose personeli tjetër i nevojshëm siç janë policia dhe personeli ushtarak që kujdeset për sigurinë e në të cilën mund të asistojë vetëm prokurori i shtetit, personeli kryesor i gjykatës, i prokurorisë dhe mbrojtësi, merr urdhër për anonimitet kur çmon se: Ekziston rrezik serioz për dëshmitarin dhe anëtarin e familjes së tij dhe anonimiteti i plotë i dëshmitarit është i nevojshëm për të parandaluar rrezikun e tillë serioz;dëshmia e dëshmitarit është e rëndësishme për çështjen sa që e bën të pamundshëm realizimin e mbrojtjes pa të;besueshmëria e dëshmitarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin në seancë të mbyllur dhe nevoja për anonimitetin e dëshmitarit është më e rëndësishme se sa efekti i interesit të të dëmtuarit për ta ditur identitetin e dëshmitarëve në zbatimin e procedurës (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 223 të KPPK).

Kur masat mbrojtëse të lartpërmendura konsiderohen të pamjaftueshme për të garantuar mbrojtjen e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëshmitarit i cili nuk është propozuar nga mbrojtja, gjyqtari kompetent në rrethana të jashtëzakonshme mund të marrë urdhër për anonimitet me të cilin i dëmtuari, dëshmitari bashkëpunues ose dëshmitari mbetet anonim edhe për të pandehurin dhe mbrojtësin e tij (paragrafi 1 i nenit 224 i KPPK).

Sipas paragrafit 5 të nenit 224 të KPPK, gjyqtari kompetent mbi bazën e kërkesës së prokurorit të shtetit, merr urdhër për anonimitet kur pas mbajtjes së seancës së mbyllur në të cilën merret në pyetje i dëmtuari ose dëshmitari në fjalë dhe personeli policor ose ai ushtarak, me ç`rast të pranishëm mund të jenë prokurori i shtetit, personat

tjerë të nevojshëm, siç është personeli i gjykatës dhe ai i prokurorisë që kujdesen për rendin (paragrafët 2-4 të nenit 224 të KPP), çmon se: Ekziston rrezik serioz për të dëmtuarin, dëshmitarin bashkëpunues ose dëshmitarin apo anëtarin e familjes së tij nëse nuk ruhet anonimiteti i plote i të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose dëshmitarit dhe është e nevojshme të parandalohet rreziku i tillë; dëshmia e dëshmitarit, dëshmitarit bashkëpunues ose e të dëmtuarit është aq e rëndësishme për çështjen sa që e bën të padrejtë realizimin e ndjekjes pa të; besueshmëria e dëshmitarit, dëshmitarit bashkëpunues ose e të dëmtuarit është hetuar dhe zbuluar plotësisht për gjyqtarin kompetent në seancë të mbyllur dhe nevoja për anonimitetin e të dëmtuarit, dëshmitarit bashkëpunues ose e dëshmitarit në vënien e drejtësisë vlen më shumë se interesi i të pandehurit për të mësuar identitetin e dëshmitarit, dëshmitarit bashkëpunues ose të dëmtuarit gjatë zbatimit të mbrojtjes.

PROCEDURAT ALTERNATIVE

Me qëllim të evitimit të procedurave gjyqësore, përsheptimit të vendosjes së çështjeve penale, shmangies së shpenzimeve procedurale dhe me qëllim të shkarkimit të gjykatave nga çështjet e caktuara penale, në Kodin e Procedurës Penale janë ndërtuar procedura alternative, ku në rrethanat të caktuara i lejon prokurorit publik që të shmangë parimin e ligjshmërisë dhe të aplikoj parimin e oportunitetit (me ligjet e mëhershme parimi i oportunitetit vlen vetëm në procedurën ndaj të miturve).

Prokurori i shtetit shqyrton dhe shfrytëzon procedurat alternative nga ky kapitull ose diversionin nga neni 184 i këtij Kodi kur procedura e tillë apo diversioni është në pajtim me detyrat dhe kompetencat e prokurorit të shtetit nga neni 49 i këtij Kodi.

Pezullimi i përkohshëm i procedurës

Prokurori i shtetit, me pëlqimin e të dëmtuarit mund të pezullojë ndjekjen për veprë penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, duke pasur parasysh natyrën, rrethanat dhe karakterin e veprës penale dhe të kryerësit, nëse i pandehuri zotohet se do të sillet siç është udhëzuar nga prokurori i shtetit dhe se do t'i përmbushë detyrimet e caktuara që pakësojnë ose mënjanojnë pasojat e dëmshme të veprës penale, duke përfshirë: eliminimin ose kompensimin e dëmit; pagesën e një kontributi ndaj një institucioni publik ose humanitar apo të fondeve për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale; ose kryerjen e punës në interes të përgjithshëm. Nëse brenda një afati prej jo më shumë se gjashtë (6) muajsh i pandehuri i përmbush detyrimet, kallëzimi penal hudhet ose pushohet hetimi. Kur i pandehuri nuk i ndërmerr veprimet në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni, prokurori i shtetit mund të rifillojë ndjekjen e veprës penale. Në rastet e dhunës në familje ose dhunës seksuale ky nen nuk zbatohet (neni 230.par.4 KPPK).

Kushtet kur ndjekja nuk është e detyrueshme Prokurori i shtetit nuk detyrohet të fillojë ndjekjen penale ose mund të heqë dorë nga ndjekja: kur ligji penal parasheh që gjykata mund ta lirojë nga dënimi kryerësin e veprës penale dhe prokurori i shtetit çmon se nga aspekti i rrethanave aktuale të çështjes vetëm gjykimi pa sanksion nuk është i nevojshëm; ose kur kryerësi i veprës penale të dënueshme me gjobë ose burgim deri në një (1) vit sinqerisht pendohet për veprën penale dhe ndalon pasojat e dëmshme ose bën kompensimin e dëmit, kurse prokurori i shtetit çmon se nga aspekti i rrethanave të çështjes sanksioni penal nuk do të ishte i arsyeshëm(neni 231.KPPK).

Procedura e ndërmjetësimit

Prokurori i shtetit mund ta dërgojë kallëzimin penal për një vepër penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet për ndërmjetësim. Para se të veprojë kështu, prokurori i shtetit merr parasysh llojin dhe natyrën e veprës, rrethanat në të cilat ajo është kryer, personalitetin e kryerësit dhe dënimet e mëparshme të tij për të njëjtën vepër penale apo për vepra penale të ndryshme, si dhe nivelin e përgjegjësisë penale të tij. Ndërmjetësimi bëhet nga ndërmjetësi i pavarur. Ndërmjetësi detyrohet ta pranojë çështjen e dërguar nga prokurori i shtetit dhe të ndërmarrë masa për të siguruar se përmbajtja e marrëveshjes është në proporcion me seriozitetin dhe pasojat e veprës. Marrëveshja mund të arrihet përmes ndërmjetësimit vetëm me pëlqimin e të pandehurit dhe të dëmtuarit, me marrjen e njoftimit për arritjen e marrëveshjes, prokurori i shtetit e hudh kallëzimin penal. Ndërmjetësi detyrohet të informojë prokurorin e shtetit për dështim në arritjen marrëveshjes dhe për arsyet e dështimit të tillë. Kohëzgjatja për arritje të marrëveshjes nuk mund të kalojë tre (3) muaj. Procedura mbi zbatimin e ndërmjetësimit zbatohet përshtatshëmrisht sipas dispozitave të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, dhe Ligjin për ndërmjetësim (neni 232 KPPK)..

Negocimi i marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë përfaqëson një institucion të rëndësishëm nëpërmjet të cilit mundësohet që i akuzuari ta pranojë fajin dhe në këmbim të kësaj të përfitojë lehtësira të caktuara që lidhen me dënimet, përkatësisht sanksionet penale. Kështu, konform paragrafit 1 të nenit 233 të Kodit të Procedurës Penale, në çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës prokurori i çështjes dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i akuzuari pranon fajësinë në shkëmbim për: pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e paraparë me ligj ose minimumin e përcaktuar në paragrafin të këtij neni; ose konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi sipas nenit 234 të këtij Kodi.

Në çdo kohë pas ngritjes së aktakuzës dhe para përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit dhe mbrojtësi mund të negociojnë kushtet e marrëveshjes së shkruar për pranimin e fajësisë, në bazë të së cilës i pandehuri pranon fajësinë në shkëmbim për: pajtimin e prokurorit të shtetit që t'i rekomandojë gjykatës dënim më të butë, por jo nën minimumin e parashikuar me ligj ose minimumin e përcaktuar në paragrafin 7.

të këtij nenin; ose konsiderime tjera në interes të drejtësisë, siç është lirimi nga dënimi sipas nenit 234 të këtij Kodi.

Në rastet kur i pandehuri dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, mbrojtësi i të pandehurit, ose i pandehuri nëse nuk përfaqësohet nga mbrojtësi, kërkon nga prokurori i shtetit një takim paraprak për të filluar negociimin për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Në të gjitha negociatat e tilla, i pandehuri duhet të përfaqësohet nga mbrojtësi, në pajtim me paragrafin 1. të këtij neni.

Pas pranimit të kërkesës për takim paraprak, prokurori i shtetit informon kryeprokurorin e zyrës së tij përkatëse, i cili jep autorizim me shkrim për mbajtjen e takimit për diskutimet mbi pranimin e fajësisë, në të cilin deklaratave të të pandehurit do t'i jepet imunitet i kufizuar, siç parashihet me paragrafin 11. të këtij neni. Të gjitha marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë duhet të jenë në formë të shkruar dhe të pranuar nga kryeprokurori i zyrës përkatëse të prokurorisë para se formalisht t'i ofrohen të pandehurit.

Në rastet kur prokurori i shtetit dëshiron të arrijë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit merr miratimin e kryeprokurorit të zyrës së tij përkatëse për të filluar negociatat për marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Pas miratimit nga kryeprokurori i zyrës së tij përkatëse, prokurori i shtetit: i dërgon letër mbrojtësit të të pandehurit në të cilën përshkruhet marrëveshja e ofruar, përfshirë kushtet e përcaktuara në paragrafin 12. të këtij neni; ose takohet me mbrojtësin dhe të pandehurin për të negociuar mundësinë dhe kushtet e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Paragrafi 4. i këtij neni zbatohet përshtatshmërisht.

Marrëveshja me shkrim mbi pranimin e fajësisë mund të përfshijë dispozitën që prokurori i shtetit, në pajtim me nenin 236 të këtij Kodi, do të kërkojë nga gjykata dhënie e urdhrorit që të shpall të pandehurin si “dëshmitar bashkëpunues”, siç përkufizohet në nenin 235 të këtij Kodi. Nëse i pandehuri i ndihmon si dëshmitar bashkëpunues, prokurori i shtetit do t'i rekomandojë gjykatës një dënim më të butë në pajtim me paragrafin 7. të këtij neni që reflekton nivelin e ndihmës dhe bashkëpunimit të dhënë nga i pandehuri, duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale.

Në pajtim me marrëveshjen me shkrim mbi pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit mund të rekomandojë dënim më të butë nga paragrafi 1. nën-paragrafi 1.1., paragrafi 2. nënparagrafi 2.1. dhe paragrafi 6. të këtij neni por vetëm deri në atë shkallë që lejohet sipas formulimit të mëposhtëm: për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura në shqyrtim gjyqësor, i pandehuri mund të dënohet së paku 90% të minimumit të dënimit të përcaktuar me dispozitat përkatëse të KPPK. Për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura para shqyrtimit gjyqësor, i pandehuri mund të dënohet së paku 80% të minimumit të dënimit të përcaktuar me dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura para shqyrtimit gjyqësor, në rastet kur i pandehuri merr pjesë si dëshmitarë bashkëpunues dhe siguron prova në procedurë penale, i pandehuri mund të dënohet së paku 60% të minimumit të dënimit të përcaktuar me dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Për marrëveshjet mbi pranimin e fajësisë të arritura para shqyrtimit gjyqësor, në rastet kur i pandehuri merr pjesë si dëshmitarë bashkëpunues në hetim të fshehtë dhe siguron prova në procedurë penale, i pandehuri

mund të dënohet së paku 40% të minimumit të dënimit të përcaktuar me dispozitat përkatëse të Kodit Penal.

I pandehuri dhe mbrojtësi i tij duhet të jenë të pranishëm gjatë takimeve mbi negociimin e pranimit të fajësisë dhe duhet të pajtohen me kushtet e marrëveshjes me shkrim mbi pranimin e fajësisë para se ajo ti paraqitet gjykatës.

Në çdo kohë para se gjykata të pranojë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, prokurori i shtetit ose i pandehuri mund të refuzojnë marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues do të caktoj shqyrtimin gjyqësor siç parashihet me Kapitullin XIX të këtij Kodi. Në qoftë se prokurori i shtetit dhe mbrojtësi apo i pandehuri nuk arrijnë marrëveshje mbi pranimin e fajësisë, ose nëse marrëveshja nuk pranohet nga gjykata, deklaratat e të pandehurit të dhëna gjatë negociimit të pranimit të fajësisë, siç parashihet në paragrafët 3., 4. dhe 5. të këtij neni janë provë e papranueshme në shqyrtim gjyqësor ose në procedurë tjetër të ndërlidhur.

Nëse gjykata bindet se janë përmbushur të gjitha kushtet e parapara në paragrafin 18. të këtij neni, gjykata pranon marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe urdhëron që marrëveshja të vendoset në shkresat e lëndës në gjykatë. Gjykata cakton datën kur palët do të japin deklaratat e tyre në lidhje me dënimin, pas së cilës gjykata shqipton dënimin.

Dëshmitarët bashkëpunues

Cilësinë e dëshmitarit bashkëpunues mund ta ketë i dyshuari ose i pandehuri. Në të vërtetë sipas nenit 235 të Kodit të Procedurës Penale është paraparë mundësia që i pandehuri për të cilin ende nuk është lexuar aktakuza në shqyrtimin gjyqësor të dëshmojë në gjykatë kur: Ka gjasa që të parandalojë vepra të tjera penale nga personi tjetër; ka gjasa të shpie drejt zbardhjes së të vërtetës në procedurë penale; është bërë vullnetarisht dhe me marrëveshje të plotë për të dëshmuar të vërtetën në gjykatë; është vlerësuar nga gjykata si e vërtetë dhe e plotë ose mund të shpie drejt ndjekjes së suksesshme të kryerësve tjerë të veprës penale.

Shpalljen e një personi dëshmitar bashkëpunues, kur vlerësohet të jenë plotësuar kushtet e lartcekura e bën gjykata, përkatësisht gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues me urdhër të cilin e merr në seancë, në bazë të kërkesës së parashtruar me shkrim nga prokurori i shtetit (paragrafi 1 i nenit 236 i KPPK). Kërkesa e prokurorit të shtetit duhet të jetë e arsyetuar dhe me të mund të kërkohet që pretendimet faktike të përfshira në deklaram të mbahen të fshehta nga palët dhe mbrojtësit e tyre, gjë të cilën gjykata mund ta aprovojë (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 236 të KPPK). Përndryshe, seanca e dëgjimit është e tipit të mbyllur dhe në të mund të marrin pjesë, përveç gjyqtarit të autorizuar edhe prokurori i shtetit dhe mbrojtësi i dëshmitarit bashkëpunues. Në seancë vlerësohet fakti i besueshmërisë së dëshmitarit bashkëpunues dhe për faktin se a janë plotësuar kushtet e lartcekura. Me këtë rast, duhet theksuar se deklaramet e dëshmitarit bashkëpunues nuk mund të përdoren në procedurë penale kundër dëshmitarit të tillë ose kundër ndonjë personi tjetër si prova që mbështesin zbulimin e fajësisë (paragrafi 1 i nenit 237 i KPPK). Me rastin e marrjes në pyetje të dëshmitarit bashkëpunues, në mënyrë të përshtatshme duhet të zbatohen

dispozitat që vlejné për marrjen në pyetje të dëshmitarëve përgjithësisht (paragrafi 2 i nenit 237 i KPPK).

Për cilat vepra penale urdhri është irelevant

Urdhri nuk e ndalon fillimin apo vazhdimin e procedurës penale kundër dëshmitarit bashkëpunues për vepra penale të kryera pas lëshimit të urdhrit ose për vepra penale që dënohen me të paktën 10 vjet burgim (paragrafi 6 i nenit 237 i KPPK).

Në cilat situatat nuk mund të lëshohet urdhëresa

Gjyqtari i procedurës paraprake, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk do të lëshojë urdhër për shpalljen e dëshmitarit bashkëpunues nëse prokurori i shtetit ka ndonjë dozë dyshimi ndaj dëshmitarit të tillë si dhe kur ai me aktakuzë akuzohet si organizator ose udhëheqës i grupit prej dy ose më shumë personave të cilët kanë kryer vepër penale (paragrafi 5 i nenit 237 i KPPK).

Dëshmitari bashkëpunues paralajmërohet për pasojat e dhënies së dëshmisë së rreme në ndonjë pjesë të rëndësishme të saj ose kur qëllimisht nuk e tregon të vërtetën e plotë para se të merret në pyetje nga gjyqtari i procedurës paraprake dhe para se të dëshmojë nën mbrojtjen e urdhrit. Çdo dëshmim i tillë duhet të jetë qoftë në formë të shkruar në gjuhën e dëshmitarit bashkëpunues dhe e nënshkruar nga ai për të vërtetuar saktësinë e saj ose e incizuar në audio ose video trakë e cila për gjykatën është autentike (paragrafi 2 i nenit 238 i KPPK).

Në mbështetje të kërkesës së prokurorit të shtetit kolegji shqyrtues do ta revokojë urdhrin për shpalljen e dëshmitarit bashkëpunues kur vërtetohet se ai ka paraqitur dëshmi të rreme në ndonjë pjesë të rëndësishme të saj, ose kur dëshmitari i tillë nuk prezanton të vërtetën e plotë (paragrafi 1 i nenit 238 i KPPK).

Lirimi nga dënimi dhe zbutja e dënimit të pandehurit i cili nuk e ka statusin e Dëshmitarit bashkëpunues

Ligjdhënësi ka paraparë mundësinë që gjykata në bazë të kërkesës së prokurorit të shtetit, ta lirojë nga dënimi kryerësin i cili është dëshmitar bashkëpunues ose këtë dënim ta ulë në pajtim me nenin 75 të KPK, kur kryerësi bashkëpunon vullnetarisht ose kur bashkëpunimi i tij ka parandaluar veprat penale tjera nga të tjerët ose ka rezultuar me ndjekje të suksesshme ndaj kryerësve tjerë të veprave penale. Megjithatë, kur kryerësi shpallet fajtor për vepër penale të dënueshme me të paktën 10 vjet burgim, gjykatës nuk i njihet autorizimi që dënimin e dhënë ta pezullojë ose ta heqë (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 234 të KPP).

AKTAKUZA DHE SHQYRTIMI I SAJ

Ngritja dhe shqyrtimi i aktakuzës përfaqëson fazën e dytë të procedurës penale e cila, si rregull, pason pas përfundimit të hetimit. Në këtë aspekt, pas përfundimit të hetimit, kur prokurori i shtetit gjykon se ka prova të mjaftueshme për fajësinë e të pandehurit, ai vendosë për dërgimin e çështjes në gjykatë. Për këtë qëllim ai përpilon kërkesën për gjykim, gjegjësisht aktakuzën në të cilën tregohen të dhënat personale të të pandehurit dhe të dëmtuarit nga vepra penale, rrethanat e faktit dhe çështjet tjera për të cilat do të bëhet fjalë në vazhdim të këtij kapitulli.

AKTAKUZA

Aktakuza është akt akuzues i prokurorit të shtetit që paraqitet pas përfundimit të hetimit ose kur ai konsideron se informacionet me të cilat disponon për veprën penale dhe kryerësin e saj paraqesin bazë të mjaftueshme për ngritjen e këtij akti, (paragrafi 1 i nenit 240 i KPP). Me paraqitjen e aktakuzës në këtë fazë të procedurës penale realizohet parimi akuzator *nemo iudex sine actore*.

Aktakuzën e përpilon prokurori i çështjes. Aktakuza është akt formal procedural që i paraqitet gjykatës në formë të shkruar, ose përjashtimisht duke shënuar në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor kur është në pyetje ndryshimi ose zgjerimi i saj. Aktakuza si akti më i rëndësishëm akuzues i prokurorit të shtetit, konform paragrafit 1 të nenit 241 të KPPK, duhet të përmbajë: Përcaktimin e gjykatës ku do të mbahet shqyrtimi gjyqësor; emrin dhe mbiemrin e të pandehurit dhe të dhënat e tij personale; të dhënat nëse është shqiptuar paraburgimi dhe sa kohë ka zgjatur ose masat e urdhëruara kundër të pandehurit për sigurimin e pranisë së tij, nëse ai ndodhet në liri dhe nëse ai është liruar para ngritjes së aktakuzës, sa është mbajtur në paraburgim; kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, objektin në të cilin është kryer dhe mjetin me të cilin është kryer vepra penale, si dhe rrethanat tjera të nevojshme për të përcaktuar me saktësi veprën penale; emërtimin ligjor të veprës penale duke iu referuar dispozitave të Kodit Penal; rekomandimin për provat që duhet prezantuar në shqyrtimin gjyqësor së bashku me emrat e dëshmitarëve dhe ekspertëve, shkresat që duhet lexuar dhe sendet që duhet marrë si provë, shpjegimin e arsyeve për ngritjen e aktakuzës bazuar në rezultatet e hetimit dhe provat që vërtetojnë faktet kryesore; nëse është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, në aktakuzë duhet të cekin emrat e gjyqtarëve të kolegjit që kanë drejtuar mundësinë hetuese të veçantë dhe përcaktimin me saktësi të çdo ndërtese, pasurie të paluajtshme, pasurie të luajtshme, fondeve apo pasurie tjetër që mund t'i nënshtrohen konfiskimit. Aktakuza po ashtu përshkruan provat e nevojshme që kërkohen për të arsyetuar konfiskimin e sendeve apo pasurisë së përkufizuar me dispozitat e KPPK.

Nëse i pandehuri gjendet në liri, prokurori i shtetit në aktakuzë mund të propozojë që të jepet urdhri për paraburgim, e kur i pandehuri gjendet në paraburgim, ai mund të propozojë që i njëjti të lirohet. Rrjedhimisht, një aktakuzë mund të ngritet për një apo më shumë vepra penale të cilat mund të jenë të llojeve të ndryshme si dhe ndaj disa të pandehurve, kur konform zgjidhjeve përkatëse të Kodit të Procedurës Penale mund të zhvillohet procedurë penale e përbashkët, (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 241 të KPPK).

Aktakuza i paraqitet gjykatës kompetente në aq kopje sa ka të pandehur dhe mbrojtës të tyre dhe një kopje shtesë për gjykatën. Së bashku me aktakuzën në gjykatë dërgohet edhe lënda complete e hetimit, (paragrafi 1 i nenit 242 i KPPK). Së bashku me aktakuzën, prokurori i shtetit, konform paragrafit 1 të nenit 243 të KPPK, ia dorëzon gjykatës së çështjes edhe këto dokumente: Vërtetimin e pohimit që përfshinë përshkrimin e dëshmive, deklaratën ose provën tjetër në të cilën mendon të mbështetet së bashku me deklaratat e dëshmitarëve, dëshmitarëve bashkëpunues, viktimave, dëshmitarëve të mbrojtur dhe ekspertëve apo provat e siguruara përmes rrugëve joformale të qeverive të huaja, organeve për zbatim të ligjit, prokurorive, gjykatave etj., të cilat synon t'i paraqesë si prova të drejtpërdrejta pa praninë e dëshmitarëve. Në vërtetim duhet të përshkruhen provat e pavarura që vërtetojnë deklaratat të cilat prokurori i shtetit synon t'i paraqesë si prova të drejtpërdrejta. I njëjti mund të plotësohet ose të paraqitet në një kohë më të vonshme nëse dëshmitari për të cilin zbatohet kjo dispozitë nuk është më në dispozicion për të dëshmuar në shqyrtim gjyqësor. Kërkesën për të vazhduar apo për të zbatuar ndonjë nga masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit në procedurë penale;

Prjedhimisht, prokurori i shtetit mund t'i paraqesë vërtetimet apo kërkesat e lartcekura edhe më pas, kuptohet nëse nuk ka mundur ta dijë bazën për paraqitjen e njoftimit apo kërkesës në kohën kur është ngritur aktakuza.

Sipas paragrafit 1 të nenit 244 të KPPK, prokurori i çështjes, jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, duhet t'i sigurojë mbrojtësit materialet e mëposhtme ose kopjet e tyre të cilat janë në procedim, kontroll ose mbrojtje, nëse këto materiale nuk i janë dhënë mbrojtësit gjatë hetimit: Procesverbalet mbi deklaratimet ose pohimet, të nënshkruara apo të panënshkruara nga i pandehuri; emrat e dëshmitarëve të cilët prokurori i shtetit ka ndërmend t'i thërret për dëshmim dhe çdo deklaratim të mëhershëm të dhënë nga dëshmitarët e tillë; të dhënat mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit ka njohuri se posedojnë prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklaratimeve, të nënshkruar apo të pa nënshkruar nga personat e tillë për atë çështje; rezultatet e ekzaminimit fizik dhe mental, testet shkencore ose eksperimentet e bëra lidhur me çështjen; kallëzimet penale dhe raportet e policisë dhe përmbledhjet ose referencat për provat materiale të mbledhura gjatë hetimit.

Prokurori i çështjes brenda dhjetë ditëve pas ngritjes së aktakuzës, duhet t'i sigurojë mbrojtësit çfarëdo materiali të ri të pranuar që korrespondon me materialet e specifikuar më lart. Deklarimet e dëshmitarëve i vihen në dispozicion të pandehurit në gjuhën që ai e kupton dhe e flet. Është evident fakti se në raport me këto materiale duhet pasur gjithnjë në konsideratë dispozitat lidhur me mbrojtjen e të dëmtuarve dhe të dëshmitarëve, (paragrafët 2-4 të nenit 244 të KPPK).

Shqyrtimi i aktakuzës

Ngritja e aktakuzës kundër të pandehurit dhe procedimi penal sipas saj është jo e këndshme për të pandehurin, bile edhe atëherë kur procedura përfundon me lirimin e tij. Prandaj, ligdhënësi ka paraparë kontrollin e aktakuzës në seancë për shqyrtimin

e aktakuzës, në mënyrë që të pengohet nxjerrja e tij në shqyrtim gjyqësor pa bazë të mjaftueshme. Ana tjetër pozitive e seancës për shqyrtim të aktakuzës manifestohet gjithashtu në ruajtjen e autoritetit të organeve shtetërore i cili cenohet nëse në gjykatë arrijnë numër i madh i aktakuzave të pabazuara. Parimisht, shqyrtimi i aktakuzës, para se i pandehuri të nxirret në shqyrtim gjyqësor, zhvillohet në dy nivele dhe atë në shqyrtim fillestar dhe në shqyrtim të dytë.

Shqyrtimi fillestar i aktakuzës

Në seancën e shqyrtimit fillestar si rregull i bëhet një vlerësim paraprak ligjshmërisë së aktakuzës, por edhe i rrethanave tjera që i kanë paraprirë ngritjes së saj. Për seancë të shqyrtimit fillestar të aktakuzës thirren prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, pa të cilët edhe nuk mund të mbahet ajo. Rrjedhimisht, para se të fillohet me zhvillimin e seancës në fjalë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet t'ia dorëzoj të pandehurit kopjen e aktakuzës, nëse ai këtë nuk e ka pranuar më parë, kurse më pas ai do të vendosë për të gjitha propozimet që mund të jenë parashtruar lidhur me zbatimin apo vazhdimin e masave për sigurinë e të pandehurit në procedurë penale, (paragrafët 1-3 të nenit 245 të KPPK).

Me të filluar të shqyrtimit fillestar të aktakuzës gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues e udhëzon të pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vet ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë. Krahas kësaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues çmon edhe faktin nëse e drejta e të pandehurit në mbrojtës është respektuar dhe nëse prokurori i shtetit ka përmbushur detyrimet që kanë të bëjnë me zbulimin e provave (p.sh., njoftimin mbi emrat e dëshmitarëve që do t'ia thërrasë në shqyrtim gjyqësor, njoftimin mbi qëllimin e pranimit të alibisë etj.). Më në fund, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij informohen për mundësinë e paraqitjes së kundërshtimit në lidhje me provat e përfshira në aktakuzë dhe të paraqitjes së kërkesës për hedhje të aktakuzës. Pastaj i jepet fjala prokurorit të shtetit, i cili ia lexon aktakuzën të pandehurit. Pas leximit të aktakuzës kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues bindet se i pandehuri e kupton atë, të njëjtit i ofrohet mundësia që të pranojë fajësinë ose të deklarohet i pafajshëm. Nëse ndodhë që i pandehuri të mos e ketë kuptuar aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues thërret prokurorin e shtetit që t'ia shpjegojë aktakuzën të pandehurit në mënyrë që ai ta kuptojë pa vështirësi. Në të kundërtën, nëse i pandehuri nuk dëshiron të bëjë ndonjë deklaram lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se ai nuk e pranon fajësinë, (neni 246 i KPP).

Në vazhdim të seancës prezantohet marrëveshja për pranimin e fajësisë (nëse ekziston një marrëveshje e tillë), me c' rast gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pasi ta ketë vlerësuar atë, vendosë mbi pranimin apo refuzimin eventual të saj, ose në lidhje me të cakton shqyrtim të veçantë në pajtim me dispozitat ligjore përkatëse. Rrjedhimisht, nëse i pandehuri deklarohet i pafajshëm, gjykata nuk mund ta dënojë

atë, përveç nëse i pandehuri e ndryshon deklaratën e tij dhe pranon fajësinë, ose nëse gjykata e shpallë fajtor atë pas shqyrtimit gjyqësor, pavarësisht nga marrëveshja mbi pranimin e fajësisë, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 247 të KPP).

Megjithatë, kur i pandehuri, konform paragrafit 1 të nenit 248 të Kodit të Procedurës Penale, pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të bindet nëse: I pandehuri kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; pranimi bëhet vullnetarisht nga i pandehuri pas këshillimeve të mjaftueshme me mbrojtësin, nëse i pandehuri ka mbrojtës; pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit për plotësimin e aktakuzës të pranuar nga i pandehuri dhe çdo provë tjetër, siç është dëshmia e dëshmitarëve e paraqitur nga prokurori i shtetit ose i pandehuri; dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Me rastin e vlerësimit të çështjes së pranimin të fajësisë së të pandehurit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit. Kur autoriteti në fjalë nuk bindet se janë vërtetuar faktet e lartpërmendura, ai merr aktvendim me të cilin refuzon pranimin e fajësisë dhe procedon shqyrtimin fillestar sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë. Megjithatë, kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues bindet se janë vërtetuar faktet e tilla, ai merr aktvendim me të cilin pranon pranimin e fajësisë nga i pandehuri dhe vazhdon me shqiptimin e dënimit, caktimin e seancës për vërtetimin e ndonjë fakti relevant për dënimin ose pezullon dënimin deri në përfundimin e bashkëpunimit të të pandehurit me prokurorin e shtetit. Sidoqoftë, i pandehuri i cili nuk pranon fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar ai megjithatë mund të ndryshojë deklaratën e tij dhe të pranojë fajësinë në çdo kohë, (paragrafët 2-5 të nenit 248 të KPPK). Rrjedhimisht, marrëveshja mbi pranimin e fajësisë ose pranimi i fajësisë mund të shqyrtohen nga gjykata në çdo kohë para se të ketë përfunduar shqyrtimi gjyqësor, (paragrafi 4 i nenit 247 i KPPK).

Konform paragrafit 1 të nenit 249 të KPPK, para shqyrtimit të dytë, të pandehurit i lejohet mundësia që të paraqesë kundërshtim ndaj provave të caktuara në aktakuzë, bazuar në këto arsye: Provat nuk janë marrë në mënyrë të ligjshme nga policia, prokurori i shtetit ose organi tjetër qeveritar; provat janë në kundërshtim me rregullat e vendosura në dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale; ose ka bazë të artikulueshme që gjykata të çmojë provën si thelbësisht të pambështetshme.

Në lidhje me kundërshtimet e paraqitura të të pandehurit prokurorit të shtetit duhet t`i jepet mundësia për të dhënë përgjigje qoftë gojore ose me shkrim. Mbi kundërshtimet e parashtruara gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendosë me aktvendim, pjesë e të cilit duhet të jetë arsyetimi mbi lejimin ose përjashtimin e provës. Natyrisht, kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë brenda 5 ditësh nga dita e pranimin të tij. Rrjedhimisht, të gjitha provat kundër të cilave nuk është paraqitur kundërshtim konsiderohen prova të pranueshme në shqyrtim gjyqësor, përveç nëse gjykata sipas detyrës zyrtare përcakton se pranueshmëria e provës së caktuar do të cenonte të drejtat e të pandehurit të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ndërkaq, në rast se ka prova të papranueshme, të njëjtat ndahen nga shkresat tjera të lëndës dhe mbylleen në zarf të veçantë, si dhe ato nuk mund të shqyrtohen apo të

shfrytëzohen në procedurë penale, përveç në rastin e ankesës kundër aktvendimit mbi pranueshmërinë e tyre, (paragrafët 2-6 të nenit 249 të KPPK).

Të pandehurit ligdhënësi i ka dhënë të drejtë që para fillimit të shqyrtimit të dytë të mund të paraqesë kërkesë për hedhjen e aktakuzës. Një mundësi të tillë, konform paragrafit 1 të nenit 250 të KPPK, i pandehuri mund ta shfrytëzojë nëse konsideron se: Vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale; ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale; ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra penale është e përfshirë në amnisti apo falje ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

Lidhur me kërkesën e të pandehurit për hedhje të aktakuzës prokurorit të shtetit duhet t'i mundësohet që të paraqesë mendimin e tij, qoftë në mënyrë gojore apo me shkrim. Në raste të tilla aktvendimin me shkrim të arsyetuar me të cilin refuzohet kërkesa ose hedhet aktakuza e merr gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues. Kundër këtij aktvendimi, ankesë mund të paraqesin palët brenda 5 ditëve nga dita e pranimit të tij, (paragrafët 2-4 të nenit 250 të KPPK).

Pavarësisht asaj që u theksua më lart, konform paragrafit 1 të nenit 251 të KPPK, prokurorit të shtetit duhet dhënë mundësia që të përgjigjet, qoftë me gojë ose me shkrim, në kundërshtimet dhe kërkesat e paraqitura nga i pandehuri, për të cilat është folur më lart. Për këtë qëllim atij duhet lënë në dispozicion një kohë prej 1 jave, përkatësisht 7 ditë, ndonëse ai (prokurori) në vend të përgjigjes ndaj kërkesës për hedhje të aktakuzës, mund të paraqesë aktakuzë të ndryshuar, (paragrafët 2-4 të nenit 251 të KPPK).

Rrjedhimisht, nëse kërkesa e paraqitur nga i pandehuri për hedhjen e aktakuzës mund të rregullohet me ndryshim të saj, prokurori i shtetit brenda 1 jave, përkatësisht 7 ditëve nga dita e mbajtjes së shqyrtimit të dytë mund të paraqesë aktakuzë të ndryshuar. Në raste të tilla, pavarësisht faktit se aktakuza e ndryshuar a ka të bëjë me një apo më shumë të pandehur, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtim fillestar, sikur të ishte fjala për aktakuzë të re. Të pandehurit edhe në këto raste duhet t'i ofrohet mundësia që të paraqesë kundërshtime të reja ose kërkesa përkatëse, por vetëm për ato pjesë të aktakuzës të cilat janë ndryshuar. Në këtë rrjedhë, nëse i pandehuri nuk i përsëritë kundërshtimet apo kërkesat e mëparshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues do të konsiderojë se të njëjtat nuk janë relevante për aktakuzën e ndryshuar dhe nuk i shqyrtojnë më tej. Në fakt, prokurorit të shtetit i është dhënë mundësia që në këtë fazë të procedurës të ndryshojë aktakuzën vetëm njëherë, kuptohet përveç në rastet kur ai siguron të dhëna të reja që bëjnë të nevojshme ndryshimin e saj, (neni 252 i KPPK).

Hedhja e aktakuzë gjatë shqyrtimit të parë fillestarë

Konform paragrafit 1 të nenit 253 të KPPK, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me rastin e vendosjes mbi kërkesën e të pandehurit për hedhje të aktakuzës, do ta hedh atë kur e vlerëson të bazuar, dhe kështu shkakton pushimin e procedurës penale kur çmon se: vepra për të cilën akuzohet nuk përbën vepër penale;

Ekzistojnë rrethana të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale; ka kaluar afati i parashkrimit të veprës penale, vepra është përfshirë me amnisti apo falje, ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen; ose nuk ka prova të mjaftueshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet në aktakuzë.

Duhet theksuar faktin se me rastin e marrjes së aktvendimit mbi hedhjen e aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë, (paragrafi 2 i nenit 253 i KPPK).

Po ashtu ligjdhënësi e ka bërë të qartë faktin se në seancën e shqyrtimit fillestar të aktakuzës nuk lejohet marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe ekspertëve, e as paraqitja e provave, përveç nëse deklarimi i dëshmitarit është i nevojshëm për marrjen e vendimit mbi vazhdimin ose zbatimin e masave për të siguruar praninë e të pandehurit në procedurë penale.

Rrjedhimisht, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të ndërmarret të gjitha masat që vlerësojnë të nevojshme për përgatitjen e shqyrtimit të dytë, të cilin si rregull obligohen ta caktojnë jo më herët se 30 ditë dhe jo më vonë se 40 ditë pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, si dhe kërkon paraqitjen e propozimeve eventuale të palëve duke caktuar një datë, deri kur kjo mund të bëhet, por gjithsesi brenda periudhës e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 30 ditë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit fillestar, (paragrafët 4 dhe 5 të nenit 245 të KPPK).

Shqyrtimi i dytë i aktakuzës

Shqyrtimi i dytë është vazhdimësi logjike e shqyrtimit të parë të aktakuzës. Si rregull, edhe në seancën e shqyrtimit të dytë duhet të marrin pjesë prokurori i shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij, kuptohet përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ka kërkuar vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e shqyrtimit të dytë, (paragrafi 1 i nenit 254 i KPPK).

Gjatë shqyrtimit të dytë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të verifikojë nëse mbrojtësi i ka përmbushur të gjitha detyrimet lidhur me zbulimin e provave, të shqyrtojnë kundërshtimet dhe kërkesat e parashtruara nga i pandehuri dhe të kërkojë nga prokurori i shtetit që të përgjigjet gojarisht gjatë shqyrtimit ose me shkrim në lidhje me kërkesat e kundërshtimet e tilla. Këto çështje gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, nëse e vlerëson të nevojshme, i adreson në seanca dëgjimore. Megjithatë, kur në lidhje me këto çështje ende nuk është vendosur, ata do të vendosin mbi to me aktvendim të posaçëm pas shqyrtimit të dytë, (paragrafët 2, 3, 4 dhe 6 të nenit 354 të KPPK).

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues do të vendosë mbi kërkesat dhe kundërshtimet e paraqitura nga palët me aktvendim, sa më parë që të jetë e mundur, por jo më vonë se tre javë nga dita e mbajtjes së shqyrtimit të dytë, (paragrafi 2 i nenit 255 i KPPK).

Rrjedhimisht, në shqyrtim të dytë, konform paragrafit 1 të nenit 256 të KPPK, mbrojtja i paraqet prokurorit të shtetit: Njoftimin për qëllimin e prezantimit të alibisë, duke precizuar vendin ose vendet ku i pandehuri pohon të ketë qenë në kohën e kryerjes së veprës penale dhe emrat e dëshmitarëve dhe çdo provë tjetër që e mbështet alibinë; njoftimin për qëllimin e prezantimit të arsyeve për përjashtim të përgjegjësisë penale, duke precizuar emrat e dëshmitarëve dhe çdo prove tjetër që e mbështet arsyen e tillë; dhe njoftimin për emrat e dëshmitarëve të cilët mbrojtja synon t'i thërret për të dëshmuar.

Sidoqoftë, mbrojtësit, në çdo kohë para shqyrtimit gjyqësor, i lejohet mundësia që të plotësojë me shkrim informatat e lartpërmendura sipas kërkesës së prokurorit të shtetit. Kur mbrojtësi nuk kryen detyrimet në fjalë dhe gjykata nuk gjen shkaqe të arsyeshme për një gjë të tillë, ajo mund ta gjobitë mbrojtësin deri në 250 Euro dhe për këtë e njofton Odën e Avokatëve të Kosovës, (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 256 të KPPK).

Pas përfundimit të shqyrtimit të dytë të aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin gjyqësor, përveç nëse ende nuk ka marrë aktvendim mbi kundërshtimet e dhe kërkesat e paraqitura nga palët. Ai cakton shqyrtimin gjyqësor me urdhër me shkrim, të cilin e nxjerr në të njëjtën kohë me aktvendimin apo aktvendimet me shkrim për propozimet e lartpërmendura, (paragrafi 6 i nenit 254 i KPPK).

SHQYRTIMI GJYQËSOR DHE AKTGJYKIMI

Shqyrtimi gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor përfaqëson fazën më e rëndësishme të procedurës penale. Ai përfshinë tërësinë e veprimeve procedurale që duhet të kryhen për paraqitjen e palëve në gjykatë dhe dëgjimin e pretendimeve të tyre, për marrjen e provave dhe vlerësimin e tyre, për zgjidhjen e drejtë të çështjes dhe dhënien e vendimit gjyqësor të bazuar në ligj dhe në prova. Ai zhvillohet në seancë gjyqësore në përputhje me rregullat e caktuara me Kodin e Procedurës Penale, siç janë publiciteti i seancës dhe mënyra e drejtimit të saj, prania e të akuzuarit në seancë, gjykimi i pandërprerë, mbajtja e procesverbalit etj. Shqyrtimi gjyqësor është i hapur dhe në të mund të marrin pjesë personat madhorë, por të cilët nuk mund të mbajnë armë dhe mjete tjera të rrezikshme, me përjashtim të zyrtarëve të policisë që ruajnë të akuzuarin.

Përgatitjet për shqyrtim gjyqësor

Veprimet procedurale të fazës së shqyrtimit gjyqësor kryhen sipas radhës dhe mënyrës së caktuar me KPPK. të cilat, si rregull duhet respektuar në mënyrë të përpiktë. Ato fillojnë me veprimet përgatitore dhe vazhdojnë radhën me hapjen e seancës, me njoftimin e përbërjes së trupit gjykues dhe me shqyrtimin e mundshëm të kërkesave

për përjashtimin e gjyqtarëve dhe zëvendësimitin e prokurorit, me dëgjimin e aktakuzës dhe të pretendimeve të palëve, me marrjen e provave, e në fund me dhënien e vendimit.

Si rregull, shqyrtimi gjyqësor mbahet në selinë e gjykatës dhe në ndërtesën e gjykatës. Megjithatë, kur lokalet në ndërtesën e gjykatës nuk janë të përshtatshme për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor për shkak të mungesës së hapësirës ose për shkaqe të tjera të arsyeshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues mund të vendosë që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në ndonjë ndërtesë tjetër, (neni 286 i KPPK).

Në kuadër të përgatitjeve për shqyrtim gjyqësor thirret i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit i dëmtuari dhe përfaqësuesit e tyre ligjor, përfaqësuesit e autorizuar dhe përkthyesi. Për shqyrtim gjyqësor thirren edhe dëshmitarët e ekspertët e propozuar qoftë nga prokurori i shtetit apo i akuzuari. Në thirrjen e dërguar të akuzuarit dhe dëshmitarëve, përveç të dhënave që adresojnë personalitetin e tyre, duhet të përfshihen edhe të dhënat që kanë të bëjnë me veprën penale, kohën dhe vendin e mbajtjes së shqyrtimit, cilësinë në të cilën thirren, shënohen edhe paralajmërimet për pasojat e mosparaqitjes në gjykatë dhe njoftimet tjera të rëndësishme. Në thirrje, të akuzuarit i bëhet me dije se do të konsiderohet se ka hequr dorë nga ankesa nëse nuk e paralajmëron ankesën brenda 8 ditëve nga dita e shpalljes së aktgjykimit. Kur mbrojtja nuk është e detyrueshme, i akuzuari në thirrje udhëzohet për të drejtën e tij në mbrojtës, por që shqyrtimi gjyqësor nuk mund të shtyhet nëse mbrojtësi nuk vjen në të ose për shkak se i akuzuari ka angazhuar mbrojtës në shqyrtimin gjyqësor. Me qëllim që t'i lihet kohë e mjaftueshme për t'u përgatitur për mbrojtje, të akuzuarit thirrja duhet t'i dorëzohet jo më vonë se 8 ditë para shqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, ky afat mund të shkurtrohet nëse ekziston kërkesa e të akuzuarit, gjegjësisht e prokurorit të shtetit dhe kur për këtë është siguruar pëlqimi i të akuzuarit, (paragrafët 1-3 të nenit 287 të KPPK).

Krahas njoftimeve të lartcekura, gjykata bën edhe njoftime për subjekte e persona të tjerë. Kështu, të dëmtuarin i cili nuk thirret si dëshmitar, gjykata në thirrje e njofton se shqyrtimi gjyqësor do të mbahet edhe pa praninë e tij dhe se deklarata e tij për kërkesën pasurore juridike do të lexohet. Për pasojat e mosparaqitjes në shqyrtim gjyqësor përmes thirrjes njoftohen edhe i akuzuari, dëshmitari dhe eksperti. Po ashtu, me kërkesë të Avokatit të Popullit, gjykata duhet ta njoftoj atë për shqyrtimin gjyqësor me qëllim të monitorimit të procedurës penale në çështjet që kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe të veprimeve që përbëjnë shpërdorim të pushtetit, (paragrafët 4-6 të nenit 287 të KPPK).

Propozimet për prova pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor

Palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor, mund të kërkojnë që në shqyrtim gjyqësor të thirren dëshmitarë dhe ekspertë të rinj ose të mblidhen prova të reja. Kërkesa e tyre në raste të tilla duhet të jetë e arsyetuar si dhe të përmbajë shënime se cilat fakte duhet provuar dhe me cilat prova do të argumentohet kjo.

Aprovimi i propozimeve për prova të reja

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e aprovon kërkesën për thirrjen e dëshmitarëve apo ekspertëve të rinj ose marrjen e provave të reja nëse dëshmitari i ri, eksperti i ri apo prova e re ka qenë e panjohur në kohën e shqyrtimit të dytë të aktakuzës, ose kur kjo nuk sjell deri te përsëritja në mënyrë të konsiderueshme e thënieve të dëshmitarit, ekspertit apo provës tjetër dhe kur e drejta e të pandehurit në gjykim të drejtë mund të dëmtohet nëse refuzohet një kërkesë e tillë.

Refuzimi i propozimeve për prova të reja

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka mundësi që ta refuzojë një propozim të tillë, megjithëse refuzimi i tillë mund të ankimohet brenda 48 orëve nga pranimi i urdhrimit për refuzimin e kërkesës. Në rast të aprovimit të kërkesës për marrje të provave të reja palët dhe mbrojtësi duhet të njoftohen me vendimin që adreson këtë çështje para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, (neni 288 i KPPK).

Caktimi i gjyqtarëve shtesë

Nëse parashihet se shqyrtimi gjyqësor do të zgjasë më shumë se zakonisht, kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës të caktojë një gjyqtarë për të marrë pjesë në shqyrtim gjyqësor për të zëvendësuar anëtarët e trupit gjykues, në rast se ata janë të penguar të marrin pjesë në shqyrtimin gjyqësor. Në rastet kur gjatë procedurës penale është zbatuar mundësia hetuese e veçantë, një nga dy gjyqtarët që kanë shërbyer në atë kolegji, por që nuk kanë qenë gjyqtarë në procedurë paraprake, shërben si anëtar i trupit gjykues ndërsa tjetri si gjyqtar zëvendësues, (neni 289 i KPPK).

Marrja në pyetje e dëshmitarëve-ekspertëve në vendin ku ai banon

Kur dëshmitari ose eksperti i thirrur në shqyrtim gjyqësor nuk mund të paraqitet për shkak të sëmundjes kronike ose për shkak të pengesave të tjera, dëshmitari i tillë ose eksperti mund të merret në pyetje në vendin ku ai banon, përveç nëse dëshmitari apo eksperti i tillë është marrë në pyetje gjatë mundësisë hetuese të veçantë. Palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari informohen për kohën dhe vendin e marrjes në pyetje nëse kjo është e mundshme duke pasur parasysh ngutësinë e procedurës. Nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të vendosë nëse prania e tij gjatë marrjes në pyetje është e nevojshme, duke siguruar që në mungesë të të akzuarit, mbrojtësi i tij të jetë i pranishëm. Kur palët, mbrojtësi dhe i dëmtuari janë të pranishëm, ata i gëzojnë të gjitha të drejtat të cilat u takojnë në procedurë penale, (neni 290 i KPPK).

Parakushtet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor

Në ditën dhe orën kur është caktuar mbajtja e shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e hapë seancën si dhe shpallë çështjen penale që është lëndë gjykimi dhe përbërjen e trupit gjykues. Pastaj konstaton nëse kanë ardhur të gjithë personat e thirrur dhe kur vëren se ndonjëri prej tyre mungon, atëherë ai verifikon nëse të njëjtit i është dorëzuar thirrja me rregull dhe nëse e ka arsyetuar mungesën e tij, (neni 305 i KPPK).

Mos ardhja e palëve dhe të ftuarve tjerë në shqyrtim

Si parakusht për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor paraqitet prania e subjekteve themelore të procedurës penale dhe parimisht edhe e mbrojtësit.

Kur në shqyrtim gjyqësor i cili është caktuar në bazë të aktakuzës së prokurorit të shtetit nuk paraqitet ky i fundit (prokurori), shqyrtimi gjyqësor shtyhet dhe për këtë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues njofton mbikëqyrësin e prokurorit të shtetit; kur në shqyrtim gjyqësor, përkundër dërgimit të rregullt të thirrjes, nuk paraqitet i akuzuari dhe mungesën nuk e arsyeton, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për të lëshon urdhërarrest. Kur i akuzuari nuk mund të sillet menjëherë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e shtyn shqyrtimin gjyqësor dhe urdhëron që i akuzuari në seancën e ardhshme të sillet me forcë. Së këndejmi, në rast se i akuzuari e arsyeton mungesën e tij para se të jetë arrestuar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues revokon urdhër arrestin.

Paraburgimi ndaj të akuzuarit për mospërfillje të gjykatës

Ndaj të akuzuarit të padisiplinuar mund të caktohet edhe paraburgimi. Në të vërtetë, kur shihet qartazi se i akuzuari i thirrur me rregull i shmanget paraqitjes së tij në shqyrtim gjyqësor, edhe pse nuk ekzistojnë shkaqet për paraburgimin e tij, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të caktojë paraburgimin në mënyrë që të sigurojë praninë e tij në shqyrtim gjyqësor. Paraburgimi i tillë mund të zgjasë më së shumti 1 muaj

Mos prezenca në shqyrtim e mbrojtësit

Kur në shqyrtim gjyqësor nuk paraqitet mbrojtësi i thirrur me rregull dhe për arsytet e mosardhjes nuk e njofton gjykatën posa të ketë mësuar për to, ose nëse mbrojtësi lëshon shqyrtimin gjyqësor pa lejen e gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues, gjykata kërkon nga i akuzuari që menjëherë të angazhojë mbrojtës tjetër. Nëse i akuzuari nuk e bën këtë, kurse mbajta e shqyrtimit do të ndikojë në dëmtimin e mbrojtjes, shqyrtimi gjyqësor shtyhet.

Mungesa e dëshmitarëve dhe e ekspertëve

Kur në shqyrtim gjyqësor mungon pa arsye dëshmitari ose eksperti i thirrur me rregull, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë sjelljen e tij të menjëhershme me forcë. Sjellja me dhunë e tyre në shqyrtim gjyqësor çmohet varësisht nga rasti dhe rëndësia e deklarimeve të tyre. Kjo do të thotë së shqyrtimi gjyqësor mund të filloj edhe pa praninë e dëshmitarit ose ekspertit të thirrur, duke i lënë ligjdhënësi mundësi gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues që gjatë shqyrtimit gjyqësor të vendosë nëse për shkak të mungesës së dëshmitarit ose të ekspertit, shqyrtimi gjyqësor duhet ndërprerë ose shtyrë.

Drejtimi i shqyrtimit gjyqësor

Në shqyrtimin gjyqësor për shkak të peshës së madhe që ka duhet të jenë vazhdimisht të pranishëm gjyqtari i vetëm gjykues, përkatësisht kryetari i trupit gjykues, anëtarët e trupit gjykues, procesmbajtësi dhe gjyqtari zëvendësues, (paragrafët 1 të neneve 297 dhe 298 të KPPK). Për prezencën e tyre dhe për nevojën që trupi gjykues të jetë i përbërë në përputhje me ligjin, duhet të kujdeset gjyqtari i vetëm, përkatësisht kryetari i trupit gjykues. Në këtë aspekt, konform paragrafit 2 të nenit 297 dhe paragrafit 2 të nenit 298 të KPPK, ata duhet të shikojnë nëse ka arsye ligjore për përjashtim të ndonjërit prej anëtarëve të trupit gjykues (kjo është përgjegjësi e kryetarit të trupit gjykues) dhe të procesmbajtësit.

Gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues drejton shqyrtimin gjyqësor dhe fton palët, të dëmtuarin, përfaqësuesit ligjorë, përfaqësuesit e autorizuar, mbrojtësin dhe ekspertët për t'i prezantuar dëshmitë e tyre dhe për të parashtruar pyetje. Po ashtu, anëtarët e trupit gjykues mund t'i parashtrojnë pyetje cilitdo dëshmitar apo ekspert. Në këtë rrjedhë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues detyrohet të kujdeset për shqyrtimin e gjithanshëm dhe të drejtë të çështjes penale në pajtim me administrimin e provave, për marrjen e tyre në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, si dhe vendosë për propozimet e palëve. Në të gjitha këto raste vendimmarrja e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues konkretizohet me nxjerrje të aktvendimit të veçantë, por të njëjtat evidencohen edhe në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, (neni 299 i KPPK)

Shqyrtimi gjyqësor zhvillohet sipas rregullave të cilat i ka vënë KPPK. Megjithatë, për shkaqe të arsyeshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndryshojë procedurën e zakonshme të shqyrtimit të provave sidomos, për shkak të numrit të akuzuarve, numrit të veprave penale dhe të vëllimit të materialit provues, (neni 300 i KPPK).

Prishja e rendit në shqyrtimin gjyqësor

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues detyrohet të kujdeset për mbajtjen e rendit në gjykatore dhe ruajtjen e dinjitetit të gjykatës. Kështu, ai menjëherë pas hapjes së seancës paralajmëron personat e pranishëm në shqyrtimin gjyqësor që të

sillen si duhet dhe të mos e pengojnë zhvillimin e procedurës. Për qëllime të tilla, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë kontrollin personal të personave në shqyrtim gjyqësor. Kur masat për mbajtjen e rendit në shqyrtim gjyqësor nuk janë treguar efikase, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë largimin e publikut nga shqyrtimi gjyqësor.

Masat e lartcekura, dhe jo vetëm ato, zbatohen ndaj disa pjesëmarrësve në procedurë. Kështu, kur i akuzuari, mbrojtësi, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor ose përfaqësuesi i autorizuar, dëshmitari, eksperti, përkthyesi ose personi tjetër që merr pjesë në shqyrtim gjyqësor prishë rendin ose nuk u nënshtrohet urdhrave të gjyqtarit të vetëm ose kryetarit të trupit gjykues për mbajtjen e rendit, ai atyre ua tërheqë vërejtjen. Kur vërejtja është e pasuksesshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që i akuzuari të nxirret jashtë gjykatores, kurse personat tjerë jo vetëm që mund t'i nxjerr jashtë, por mund t'i dënojnë edhe me gjobë deri në 1.000 Euro, (paragrafi 1 i nenit 302 i KPPK).

Me urdhër të gjyqtarit të vetëm ose kryetarit të trupit gjykues, i akuzuari mund të nxirret përkohësisht nga gjykatorja, e kur ai është marrë në pyetje në shqyrtim gjyqësor, atëherë ai mund të nxirret gjatë tërë kohës së shqyrtimit të provave. Para përfundimit të procedurës së provave gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e thërret të akuzuarin dhe e njofton atë për rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor. Kur i akuzuari me veprimet e tij vazhdon ta prishë rendin dhe të ofendojë dinjitetin e gjykatës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues përsëri mund ta nxjerrë atë nga seanca. Në këtë rast, seanca përfundon pa praninë e të akuzuarit, kurse aktgjykimin ia komunikon gjyqtari i vetëm ose kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari tjetër që është anëtar i trupit gjykues, në praninë e procesmbajtësit, (paragrafi 2 i nenit 302 i KPPK).

Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, mbrojtësit ose përfaqësuesit të autorizuar mund t'ia mohojnë të drejtën për të mbrojtur ose përfaqësuar klientët e tyre në shqyrtim gjyqësor kur pas dëgjimit ata vazhdojnë ta prishin rendin, dhe me këtë rast, nga pala kërkon që të angazhohë një mbrojtës tjetër apo përfaqësues të autorizuar. Kur i akuzuari nuk mund të angazhohë mbrojtës tjetër menjëherë, apo atë gjykata nuk mund ta caktojë më vonë pa e dëmtuar mbrojtjen, shqyrtimi gjyqësor ndërpritet ose shtyhet. Aktvendimi për këtë çështje së bashku me arsyetimin, shënohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor dhe kundër tij nuk lejohet ankesë e veçantë, (paragrafi 3 i nenit 302 i KPP).

Kur prokurori i shtetit prishë rendin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për këtë e njofton mbikëqyrësin e prokurorit të shtetit dhe gjithashtu mund të pezullojë shqyrtimin gjyqësor dhe të kërkojë nga mbikëqyrësi i prokurorit të shtetit, që për këtë çështje të caktojë prokuror tjetër të shtetit, (paragrafi 4 i nenit 302 i KPPK).

Kur nga gjykatorja largohet avokati ose avokati praktikant ose kur gjykata e gjobitë atë për prishje të rendit, njoftohet Oda e Avokatëve, (paragrafi 5 i nenit 302 i KPPK).

Të gjitha aktvendimet lidhur me aplikimin e këtyre masave, dënimet me të holla dhe dënimet tjera përkritazi me drejtimin e shqyrtimit gjyqësor shënohen në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor. Ankesa është e lejuar vetëm kundër vendimit mbi dënimin, ndërsa

kundër vendimeve tjera lidhur me mbajtjen e rendit dhe me drejtimin e shqyrtimit gjyqësor, nuk lejohet ankesë, (neni 303 i KPPK).

Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor

Për të gjitha veprimet e ushtruara gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor mbahet procesverbal. Procesverbali i tillë emërtohet si procesverbali i shqyrtimit gjyqësor. Ai përpilohet me shkrim dhe në të duhet shënuar esencën e rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor. Përveç në procesverbal, shqyrtimi gjyqësor mund të regjistrohet edhe në mënyrë auditive dhe vizuale ose në mënyrë stenografike. Me atë rast procesverbali i shqyrtimit gjyqësor përfshinë kopjen e shkruar të regjistrimit auditiv të shqyrtimit gjyqësor dhe shënimin mbi rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor, pjesët kryesore të tij dhe vendimet e marra. Kur i akuzuari dënohet me burgim pas paraqitjes së ankesës në një shkallë më të lartë, regjistrimet audio dhe vizuale të shqyrtimit gjyqësor përshkruhen tërësisht brenda 3 ditëve të punës nga përfundimi i shqyrtimit gjyqësor. Ky afat mund të zgjatet nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues për një afat prej 15 ditësh kur ekzistojnë rrethana të arsyeshme për një gjë të tillë. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues rishikon dhe konfirmon përshkrimin dhe atë e vendosë në procesverbal si pjesë përbërëse të procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor. Për mënyrën e regjistrimit të shqyrtimit gjyqësor vendosë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupi gjykues, (neni 315 i KPP).

Kur shqyrtimi gjyqësor regjistrohet vetëm me shkrim, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me propozim të palës ose sipas detyrës zyrtare, mund të urdhërojë që deklaratimet që i konsideron të një rëndësie të veçantë të përshkruhen në procesverbal tekstualisht. Në këto situata dhe në çdo rast kur kjo konsiderohet e nevojshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të urdhërojë që pjesë të caktuara të procesverbalit të lexohen menjëherë kur këtë e kërkon pala, mbrojtësi ose personi deklarimi i të cilit është përfshirë në procesverbal, (neni 316 i KPP).

Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor ka rëndësi për gjykatën e shkallës së parë për të kontrolluar në kohën që jep aktgjykimin, saktësinë e përshtypjeve lidhur me faktet e caktuara, veçanërisht në rastin kur shqyrtimi gjyqësor nuk ka përfunduar përgjatë një seance gjyqësore. Mirëpo, procesverbali i shqyrtimit gjyqësor ka rëndësi të veçantë për gjykatën e shkallës së dytë e cila verifikon saktësinë e përfundimeve të gjykatës së shkallës së parë nëpërmjet shqyrtimit të shkresave. “Procesverbali i shqyrtimit gjyqësor, shqyrtimit fillestar dhe shqyrtimit të dytë të aktakuzës përfundohet me mbarimin e seancës. Ai nënshkruhet nga gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi”, (paragrafi 1 i nenit 317 i KPP). Rrjedhimisht, procesverbali përbëhet nga pjesa hyrëse, pjesa qendrore dhe pjesa përmbyllëse (përfundimtare).

Pjesa hyrëse e procesverbalit duhet të përfshijë: gjykatën ku mbahet shqyrtimi gjyqësor, numrin e lëndës, vendin dhe kohën e seancës, emrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues, të anëtarëve të trupit gjykues, të procesmbajtësit, prokurorit të shtetit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, të dëmtuarit dhe përfaqësuesit të

tij ligjor ose përfaqësuesit të autorizuar, mbrojtësit të viktimës dhe emrin e përkthyesit, veprën penale që shqyrtohet dhe nëse dëgjimi zbatohet në shqyrtim gjyqësor të hapur apo të mbyllur, (paragrafi 1 i nenit 318 i KPP).

Pjesa qendrore e procesverbalit, si rregull ndër të tjera përfshinë: identifikimin e aktakuzës, nëse prokurori i shtetit e ka ndryshuar apo e ka zgjeruar aktakuzën, cilat propozime janë bërë nga palët dhe çka është vendosur për to nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues, cilat prova janë paraqitur, nëse provat ose shkrimet e tjera janë lexuar ose nëse regjistrimi audio dhe regjistrimet tjera janë riprodhuar, si dhe komentet e palëve për këtë. Nëse publiku përjashtohet nga shqyrtimi gjyqësor, në procesverbal shënohet se gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ka paralajmëruar të pranishmit për pasojat e zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë që e kanë mësuar në shqyrtimin gjyqësor, (paragrafi 2 i nenit 318 i KPP). Në këtë pjesë të procesverbalit shënohet edhe dispozitivi i aktgjykimit dhe fakti se aktgjykimi është shpallur publikisht si dhe vendimi për paraburgim, (neni 319 i KPP).

Pjesa përfundimtare e procesverbalit, si rregull duhet të përmbajë shënimet mbi atë se ka apo jo vërejtje në lidhje me të dhënat e lartshënuara për të cilat është mbajtur shënim apo ka nevojë për korrigjime ose shtesa tjera në procesverbal si dhe nënshkrimi i kryetarit të trupit gjykues dhe procesmbajtësit.

Si rregull në procesverbal përfshihet vetëm përmbajtja kryesore e deklaramit të të akuzuarit, dëshmitarëve dhe ekspertëve. Me kërkesë të palës, në procesverbal shënohet edhe pyetja ose përgjigjja e refuzuar si e palejueshme nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 318 të KPP).

Procesverballi i shqyrtimit gjyqësor mbahet në mënyrë të rregullt dhe pedante. Siç është theksuar më lart, palët kanë të drejtë që të shikojnë procesverbalin ose ndonjë pjesë të tij, të paraqesin vërejtjet e komentet e tyre dhe të kërkojnë korrigjimin e tij. Korrigjimet zakonisht kufizohen në emrat e shënuar gabimisht, numra të shkruar pasaktë dhe në gabime të tjera të qarta në shkrim. Komentet mund të bëhen në deklaramet e palëve ose provat tjera dhe ato së bashku me vërejtjet e bëra përfshihen si shtojcë e veçantë e procesverbalit. Rrjedhimisht, në shtojcë shënohen arsyet e mospranimin të sugjerimeve dhe komenteve të caktuara dhe ajo ngjashëm me procesverbalin, nënshkruhet nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi, (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 317 të KPPK).

Më në fund, duhet theksuar se mbi seancën për këshillim dhe votim kur edhe merret aktgjykimi (e cila mbahet pas fjalës përfundimtare të palëve) mbahet procesverbal i veçantë, i ashtuquajtur procesverbal për vendimmarrje dhe votim. Në këtë procesverbal duhet të përfshihet rrjedha e votimit dhe vendimi i marrë. Atë e nënshkruajnë të gjithë anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi. Nëse ka mendime të ndara dhe kur ato nuk janë përfshirë në procesverbal të njëjtat i bashkëngjiten atij. Procesverballi për vendimmarrje dhe votim i gjyqtarëve mbyllet në zarf të posaçëm dhe qasje në të mund të ketë vetëm gjykata më e lartë kur vendosë lidhur me mjetin juridik, me ç'rast detyrohet që atë ta mbyllë përsëri në zarf të posaçëm në të cilin shënon informatën se ai është shqyrtuar, (neni 320 i KPPK).

Rrjedha e shqyrtimit gjyqësor

Natyra e ndërlikuar e shqyrtimit gjyqësor kërkon përgatitje të gjatë, studim të thellë të çështjes dhe plan të përpunuar mirë nga ana e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues. Gjatë këtij aktiviteti gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet të respektojë në mënyrën më të përpiktë të mundshme, radhën e veprimeve procedurale të përcaktuara në mënyrë decidive në dispozitat e KPPK. Gjithë veprimtaria e shqyrtimit gjyqësor përmbledhet në: fillimin e shqyrtimit gjyqësor deklarimin e të akuzuarit, prezantimin e provave dhe fjalën përfundimtare të palëve.”

Hapja e shqyrtimit gjyqësor dhe deklarimi i të akuzuarit

Siç dihet, është nën autoritetin e gjyqtarit të vetëm gjykues, përkatësisht kryetarit të trupit gjykues, që të bëj hapjen e seancës dhe të shpallë lëndën e gjykimit si dhe përbërjen e trupit gjykues. Pas kësaj ai shikon se a janë plotësuar supozimet për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor. Kur konstaton se në shqyrtim gjyqësor janë të pranishëm të gjithë personat e thirrur, ose kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues vendosë që shqyrtimi gjyqësor të mbahet në mungesë të ndonjë personi të thirrur apo vendimin për këto çështje e ka lënë për më vonë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e thërret të akuzuarin dhe nga ai i merr të dhënat personale për të vërtetuar identitetin e tij, (paragrafi 1 i nenit 321 i KPPK). Pas kësaj gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e udhëzon të akuzuarin që me vëmendje ta përcjellë zhvillimin e shqyrtimit, se mund të paraqesë fakte dhe të propozojë prova për mbrojtjen e vet, t'u shtrojë pyetje të bashkakuzuarve, dëshmitarëve dhe ekspertëve si dhe të bëj pyetje dhe të jep shpjegime rreth deklarimeve të tyre, (paragrafi 1 i nenit 323 i KPP). Pastaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, konform paragrafit 2 të nenit 323 të KPPK, e udhëzon të akuzuarin se: Ka të drejtë të deklarohet lidhur me çështjen e tij ose të mos përgjigjet në asnjë pyetje; nëse deklarohet lidhur me çështjen, ai nuk detyrohet të inkriminojë vetveten ose të afërmit e tij as të pranojë fajësinë dhe ai mund të mbrohet personalisht ose nëpërmjet ndihmës ligjore të mbrojtësit sipas zgjedhjes së tij.

Më tutje gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, i dërgon dëshmitarët dhe ekspertët në vendin e caktuar për ta, ku presin deri sa të ftohen për të dëshmuar. Nëse ka nevojë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund t'i ndalë ekspertët në gjykatore që ta përcjellin zbatimin e shqyrtimit gjyqësor. Kur i dëmtuari është i pranishëm dhe ende nuk ka paraqitur kërkesën pasurore juridike, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e udhëzon se mund të paraqesë propozim për realizim të kësaj kërkesë në procedurën penale dhe e udhëzon atë edhe për të drejtat tjera që i ka në procedurë penale. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të ndërmarrë masat e nevojshme për të penguar marrëveshjen e fshehtë midis dëshmitarëve, ekspertëve dhe palëve, (neni 322 i KPPK).

Fillimi i shqyrtimit gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor fillon me leximin e aktakuzës nga prokurori i shtetit, megjithëse të pandehurit i njihet e drejtas që të heqë dorë nga leximi i saj, (neni 324 i KPPK).

Pas leximit të aktakuzës, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e pyet të akuzuarin se a e ka kuptuar aktakuzën, dhe pasi ai të bindet se e ka kuptuar atë i jep mundësinë atij që ta pranojë ose të mos e pranojë fajësinë. Kur i akuzuari nuk e kupton aktakuzën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kërkon nga prokurori që ta shpjegojë atë në mënyrën që i akuzuari të mund ta kuptojë pa vështirësi. Kur i akuzuari nuk dëshiron të bëjë deklaratë lidhur me fajësinë e tij, konsiderohet se nuk e pranon fajësinë, (neni 325 i KPPK).

Pranimi i fajësisë nga i akuzuari

Kur i akuzuari ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës në shqyrtim gjyqësor, trupi gjykues vendosë nëse janë plotësuar kushtet për plotësimin e procedurës, përkatësisht vendosë nëse do të thërrasë dëshmitarët dhe ekspertët.

Gjatë shqyrtimit të pranimit të fajësisë së të akuzuarit, kryetari i trupit gjykues mund të dëgjojë mendimin e prokurorit të shtetit të mbrojtësit dhe të dëmtuarit. Nëse gjatë pranimit të fajësisë ekzistojnë supozime se i akuzuari nuk i kupton pasojat e pranimit të fajit, ose se faji është pranuar jo me vullnetin e lirë të tij etj., procedohet sikur pranimi i fajësisë të mos ishte bërë. Në të kundërtën, trupi gjykues vazhdon shqyrtimin gjyqësor me paraqitjen e fjalës përfundimtare të palëve (paragrafët 2-4 të nenit 326 të KPPK).

Kur ka disa të pandehur dhe një apo më shumë prej tyre pranojnë fajësinë, shqyrtimi gjyqësor vazhdon vetëm për të pandehurit të cilët janë deklaruar të pafajshëm. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shtyn shqiptimin e dënimit për të pandehurit të cilët pranojnë fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor. Nëse provat të cilat janë paraqitur në shqyrtimin gjyqësor e inkriminojnë të pandehurin i cili ka pranuar fajësinë, por nuk janë prova relevante kundër të pandehurve të tjerë të cilët nuk e kanë pranuar fajësinë, provat e tilla nuk mund të merren parasysh kundër të pandehurve tjerë, (paragrafi 5 i nenit 326 i KPPK).

Më në fund, kur i pandehuri pranon fajësinë sipas marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, si rregull, vazhdon me marrjen në pyetje të të bashkakuzuarve të tjerë, (paragrafi 6 i nenit 326 i KPPK).

Prezantimi i provave

Prezantimi i provave përfshinë tërësinë e të gjitha fakteve të cilat gjykata i konsideron të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë. Prezantimi i provave, konform nenit 327 të KPPK, sipas kësaj radhe: fillohet me fjalën hyrëse, vazhdohet me provat e propozuara nga prokurori i shtetit, provat e propozuara nga i dëmtuari (nëse ka të dëmtuar), provat e paraqitura nga mbrojtësi (nëse ka mbrojtës) dhe përfundohet me fjalën përfundimtare të palëve.

Në parim, së pari prezantohen provat e propozuara nga prokurori i shtetit, pastaj provat e propozuara nga i dëmtuari dhe në fund provat e propozuara nga mbrojtësi. Nëse i pandehuri nuk e pranon fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues thërret prokurorin e shtetit, të dëmtuarin dhe mbrojtësin për të përmbledhur provat që mbështesin rastin apo kërkesën e tyre. Rrjedhimisht, personat në fjalën hyrëse mund t'u referohen provave të pranueshme, ligjit në fuqi dhe mund të përdorin tabela, diagrame, transkripte të kasetave të lejuara nga gjykata, përmbledhje dhe krahasime të provave nëse ato bazohen në prova të pranueshme, si dhe zmadhim të ekzemplarëve të tyre për t'i demonstruar ose për t'i paraqitur si ilustrim në gjykatë. Fjala hyrëse e palëve mund të kufizohet në kohë nga gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues, (neni 328 i KPPK).

Prezantimi i provave ka të bëjë me të gjitha faktet që gjykata i konsideron të rëndësishme për një gjykim të saktë dhe të drejtë. Përndryshe, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, palët dhe i dëmtuari mund të propozojnë shqyrtimin e fakteve të reja, mbledhjen e provave të reja dhe të përsërisin propozimet të cilat gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose trupi gjykues më herët i ka refuzuar. Përveç provave të propozuara nga palët dhe i dëmtuari, trupi gjykues ka të drejtë të shqyrtojë edhe çdo provë që e konsideron të nevojshme për verifikimin e drejtë dhe të plotë të çështjes penale, (neni 329 i KPPK).

Procedura e prezantimit të provave, sipas rregullit vazhdon duke i pyetur dëshmitarët, ekspertët, duke i lexuar procesverbalet e ndryshme të cilat janë përpiluar mbi veprimet e ndërmarra jashtë shqyrtimit gjyqësor, dokumentet, librat, dosjet dhe shkresat tjera, si dhe duke i dëgjuar e shikuar incizimet teknike që shërbejnë si provë. Dokumentet që kanë rëndësinë e provës, sipas mundësisë, duhet t'i paraqiten gjykatës në original. Po ashtu, gjatë procedurës provuese mund të shikohen sendet të cilat mund të shërbejnë për sqarimin e çështjes dhe të shikohet fotodokumentacioni i vendit të ngjarjes.

Marrja në pyetje e dëshmitarit

Me rastin e verifikimit të të dhënave personale të dëshmitarit, kryetari i trupit gjykues duhet të shikojë nëse është fjala për dëshmitar të privilegjuar, i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, (neni 126 i KPPK), ose i cili mund të përjashtohet nga dëshmimi, (neni 127 i KPPK), dhe kur konstaton se ka të bëjë me person të tillë, duhet ta njoftojë atë për mundësitë që atij ia njeh ligji. Po që se dëshmitari i privilegjuar e shfrytëzon mundësinë e refuzimit të dhënies së dëshmisë, gjykatës i mbetet që të orientohet në shfrytëzimin e provave tjera. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues duhet t'ia tërheqë vërejtjen dëshmitarit se duhet të flasë të vërtetën dhe se nuk guxon të heshtë asgjë dhe ia bën me dije se dëshmia e rreme është vepër penale. Dëshmitari gjithashtu paralajmërohet se nuk detyrohet të përgjigjet në ndonjë pyetje nëse përgjigja në të ka gjasa që ta vë atë ose ndonjë të afërm të tij para turpit të rëndë, dëmit të konsiderueshëm material ose ndjekjes penale dhe paralajmërimi i tillë shënohet në procesverbal.

Në parim, dëshmitari i cili ende nuk është marrë në pyetje, nuk duhet të jetë prezent gjatë shqyrtimit të provave. Po ashtu, edhe eksperti i cili nuk ka dhënë konstatimin dhe mendimin e tij, nuk mund të jetë i pranishëm në seancë derisa eksperti tjetër jep deklarin e tij mbi çështjen e njëjtë, (neni 330 i KPPK). Në shqyrtimin gjyqësor, si rregull nuk lejohet marrja në pyetje e personit nën moshën 16 vjeç, i cili është viktimë e veprës penale kundër jetës dhe trupit, integritetit seksual dhe shmangies së alimentacionit, nëse dëshmia e tij është marrë në procedurën paraprake dhe nëse trupi gjykues çmon se marrja sërish në pyetje e tij nuk është e nevojshme. Megjithatë, në rast se vendoset të merret në pyetje dëshmitari i tillë trupi gjykues mund ta përjashtojë publikun. Nëse si dëshmitar merret në pyetje fëmija, atëherë ai do të largohet nga gjykatorja posa prania e tij më nuk është e nevojshme, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 239 të KPPK).

Dhënia e betimit nga dëshmitarit

Para marrjes në pyetje gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari i procedurës paraprake mund të kërkojë nga dëshmitari dhënien e betimit e nëse ai është betuar në procedurën paraprake, i bëhet me dije se është nën betim. Fëmija dhe personi për të cilin është vërtetuar të ketë kryer vepër penale ose me arsye dyshohet se ka kryer vepër penale ose ka marrë pjesë në kryerjen e veprës penale për të cilën merret në pyetje, nuk i nënshtrohet betimit. Dëshmitari memec që ka njohuri në shkrim dhe lexim e bën betimin me nënshkrimin e librit të betimit, ndërsa dëshmitari që është i shurdhët e lexon librin e betimit. Kur dëshmitari shurdh-memec është analfabet, betimin e bën para përkthyesit, (paragrafët 1 dhe 5 të nenit 340 të KPPK).

Si rregull pala e cila e ka propozuar dëshmitarin fillon e para me marrjen në pyetje të tij, ndërsa palëve tjera duhet t'u jepet mundësia për marrjen e tërthortë në pyetje ose kundërshtimin e besueshmërisë së dëshmitarit, (neni 332 i KPPK). Natyrisht, palës që e ka propozuar dëshmitarin duhet dhënë mundësia që edhe në fund të sqarojë përgjigjet me dëshmitarin ose të rehabilitojë besueshmërinë e dëshmitarit. Në këtë aspekt, pala e cila e ka propozuar dëshmitarin mund t'i parashtojë pyetje konkrete për të sqaruar dëshminë e paqartë, të shpjegojë mospërputhjet në dëshmi, dyshimet lidhur me besueshmërinë e dëshmisë si dhe t'ia paraqesë provën materiale atij. Po ashtu, edhe pala e cila e bën marrjen e tërthortë në pyetje të dëshmitarit, të konfirmojë ose mohoj një fakt, kur ai jep përgjigje në kundërshtim me provën e pranueshme ia paraqet ose ia lexon atij provën që është në kundërshtim me të, me ç'rast mund të kërkojë nga dëshmitari që t'u shpjegojë mospërputhjet e tilla, (nenet 333, 334 dhe 335 të KPPK).

Marrja në pyetje e ekspertit

Eksperti ia komunikon gjykatës konstatimin dhe mendimin e tij përmes raportit që i dërgohet asaj gojarisht. Rrjedhimisht, eksperti në raport përshkruan konstatimet dhe shpjegon analizat e tij. Në këtë aspekt, ai mund të përdorë provat materiale në mbështetje të dëshmisë së tij. Sidoqoftë, në shqyrtim gjyqësor, raporti duhet të futet në procesverbal, (neni 341 i KPPK). Në fakt, edhe para marrjes në pyetje të ekspertit,

gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga ai dhënien e betimit. Para shqyrtimit gjyqësor, eksperti mund të betohet vetëm para gjykatës dhe vetëm kur ekziston rreziku se ai nuk do të jetë i pranishëm në shqyrtim gjyqësor. Arsyeja e dhënies së betimit shënohet në procesverbal. Ekspertit të përhershëm i cili ka dhënë betim të përgjithshëm për ekzaminime përkatëse, në shqyrtimin gjyqësor vetëm i përkujtohet betimi i dhënë. Eksperti memec që dinë shkrim dhe lexim e bën betimin me nënshkrim të tekstit të betimit, ndërsa eksperti shurdh e lexon tekstin e betimit. Nëse eksperti shurdh ose memec është analfabet, betimi bëhet përmes përkthyesit, (paragrafët 3 dhe 5 të nenit 340 të KPPK).

Leximi i deklarimeve-procesverbaleve të mëhershme në shqyrtimin gjyqësor

Përveç rasteve të parapara me dispozitat përkatëse të KPPK, procesverbalet mbi deklaratimet e dëshmitarëve, të bashkakuarve ose pjesëmarrësve të dënuar për vepër penale, si dhe procesverbalet dhe shkresat tjera mbi konstatimin dhe mendimin e ekspertit, konform paragrafit 1 të nenit 338 të KPPK, sipas vendimit të trupit gjykues mund të lexohen vetëm në këto raste: Kur personat e marrë në pyetje kanë vdekur, kanë çrregullime ose paaftësi mendore, nuk mund të gjenden ose ardhja e tyre në gjykatë është e pamundur apo dukshëm e vështirësuar për shkak të pleqërisë, sëmundjes ose shkaqeve të tjera të rëndësishme; kur dëshmitarët ose ekspertët, pa arsye ligjore, nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtim gjyqësor; ose kur palët pajtohen që në vend të marrjes së drejtpërdrejtë në pyetje të dëshmitarit apo ekspertit i cili nuk është i pranishëm, pavarësisht se ka qenë i thirrur, të lexohet procesverbali mbi dëshminë e tij të mëparshme.

Kufizimet e leximit të deklarimeve –procesverbaleve

Procesverbalet mbi marrjen e mëparshme në pyetje të personave të cilët janë liruar nga detyra e dëshmimit nuk lexohen nëse këta persona nuk janë thirrur në shqyrtim gjyqësor ose nëse kanë deklaruar se nuk dëshirojnë të dëshmojnë në shqyrtimin gjyqësor. Kur personat e tillë, pasi të kenë dëshmuar më parë, e përdorin të drejtën e tyre për të mos dëshmuar në shqyrtim gjyqësor, ose nëse nuk kanë ardhur në shqyrtim kur janë thirrur, procesverbali mbi dëshminë e mëparshme është provë e papranueshme.

Arsyet e leximit të procesverbalit shënohen në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor, e me rastin e leximit tregohet nëse dëshmitari ose eksperti është betuar, (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 338 të KPPK).

Si rregull, dëshmitarët dhe ekspertët e marrë në pyetje mbeten në gjykatore, përpos nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pas marrjes në pyetje të palëve, i lejon të shkojnë ose përkohësisht të largohen nga gjykatorja. Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, me propozim të palëve ose sipas detyrës zyrtare, mund të urdhërojë që dëshmitarët dhe ekspertët e marrë në pyetje të largohen nga gjykatorja dhe më vonë të thirren përsëri dhe të merren në pyetje edhe një herë në prani ose në mungesë të dëshmitarëve dhe ekspertëve të tjerë, (neni 342 i KPPK).

Kur në shqyrtim gjyqësor mësohet se dëshmitari ose eksperti i thirrur nuk mund të vijë në gjykatë ose kur paraqitja e tij do të shkaktonte vështirësi të konsiderueshme, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues, kur çmon se deklarimi i tij është i rëndësishëm, urdhëron që ai të merret në pyetje jashtë shqyrtimit gjyqësor, ose marrja në pyetje të bëhet nga gjyqtari i procedurës paraprake brenda kompetencës territoriale ku banon dëshmitari apo eksperti. Po ashtu, gjyqtari i vetëm gjykues, kryetari i trupit gjykues ose gjyqtari anëtar i trupit gjykues, kur e sheh të nevojshme e zbaton këqyrjen ose rikonstrukcionin jashtë shqyrtimit gjyqësor. Rrjedhimisht, palët dhe i dëmtuari gjithmonë njoftohen kur dhe në cilin vend do të merret në pyetje dëshmitari apo do të zbatohet këqyrja ose rikonstrukcioni dhe njoftohen se kanë të drejtë të jenë të pranishëm në këto veprime. Kur palët dhe i dëmtuari janë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve, atyre u takojnë të gjitha të drejtat e parapara me legjislacionin në fuqi, (neni 343 i KPPK).

Leximi dhe riprodhimi i provave materiale

Në vazhdim bëhet prezantimi i përmbledhur i procesverbaleve të këqyrjes së vendit jashtë shqyrtimit gjyqësor, të kontrollimit të lokaleve dhe të personit, marrjes së sendeve, dokumenteve, librave, dosjeve dhe shkresave të tjera si dhe i incizimeve teknike me vlerë provuese, të cilat lexohen ose riprodhohen për vërtetimin e përmbajtjes së tyre. Trupi gjykues gëzon të drejtë diskrecioni të lejojë prezantim të përmbledhur gojor të këtyre të dhënave, si dhe riprodhim të regjistrimit audio ose video të rrjedhës së këtyre veprimeve hetimore. Në këto raste, sendet që gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të shërbejnë për sqarimin e çështjes, mund t'i tregohen të akuzuarit, e në rast nevojë edhe dëshmitarëve dhe ekspertëve, (neni 344 i KPPK).

Marrja në pyetje e të akuzuarit

Pas marrjes në pyetje të dëshmitarëve e ekspertëve dhe pas prezantimit të provave materiale vazhdohet me marrjen në pyetje të të akuzuarit i cili nuk ka pranuar fajësinë. Natyrisht, ai merret në pyetje pa qenë të pranishëm të bashkakuazarit të cilët ende nuk janë marrë në pyetje, (paragrafët 1 dhe 3 të nenit 345 të KPP). Rrjedhimisht, i akuzuari ka të drejtë që të mos dëshmojë. Ai merret në pyetje nga mbrojtësi kryesor i tij, prokurori i shtetit, i bashkëpandehuri dhe i dëmtuari. Pas përfundimit të marrjes në pyetje nga këta persona, kur gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues sigurohet se të njëjtit nuk kanë pyetje të tjera, ai mund të vazhdojë t'i shtrojë pyetje të akuzuarit nëse në deklarinim ose në përgjigjet e tij ka zbrazëti, paqartësi apo kundërthënie. Pas kësaj, edhe anëtarët e trupit gjykues mund t'i bëjnë pyetje të drejtpërdrejta të akuzuarit. Rrjedhimisht, pas përfundimit të marrjes në pyetje, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e pyet të akuzuarin nëse ka diçka për të shtuar për mbrojtjen e tij. Kur i akuzuari shtjellon më tej mbrojtjen e tij, atij mund t'i shtrohen pyetje përsëri, (neni 346 i KPP).

Pas përfundimit të marrjes në pyetje të të akuzuarit të parë, vazhdohet me marrjen në pyetje të të bashkakuazarve të tjerë. Në këtë drejtim, çdo i akuzuar ka të drejtë

t'u bëj pyetje të bashkakuzuarve të tjerë të pyetur më parë. Sidoqoftë, deklarimet e mëparshme të të bashkakuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor mund të përdoren nga palët për të parashtruar pyetje dhe kërkuar sqarime të nevojshme prej tij. Kur deklarimet e të bashkakuzuarve për rrethana të njëjta ndryshojnë, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues mund të bëj ballafaqimin e të bashkakuzuarve, (neni 347 i KPP).

Ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës

Kur prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar, ai në shqyrtim gjyqësor mund ta ndryshojë aktakuzën gojarisht dhe mund të propozojë që shqyrtimi gjyqësor të ndërpritet për përgatitjen e aktakuzës së re. Natyrisht, kur vjen deri të ndryshimi i aktakuzës, edhe i akuzuari ose mbrojtësi tij mund të propozojnë ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e mbrojtjes, dhe trupi gjykues mund ta ndërpres atë në rast se është ndryshuar ose zgjeruar thelbi i aktakuzës. Nëse trupi gjykues lejon ndërprerjen e shqyrtimit gjyqësor për përgatitjen e aktakuzës së re, atëherë cakton afatin kur prokurori i shtetit detyrohet të paraqesë aktakuzën e re. Të akuzuarit i dërgohet kopja e aktakuzës së re. Nëse prokurori i shtetit në afatin e caktuar nuk paraqet aktakuzë të re, gjykata vazhdon shqyrtimin gjyqësor në bazë të aktakuzës së mëparshme, (neni 350 i KPP).

Kur i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor kryen veprën penale

Nëse i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor kryen veprën penale ose nëse vepra penale e mëparshme e të akuzuarit zbulohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues në shqyrtimin gjyqësor mund të përfshijë edhe këtë veprë në bazë të akuzës së prokurorit të autorizuar, e cila mund të paraqitet edhe gojarisht. Në rastin e tillë, gjykata mund të ndërpres shqyrtimin gjyqësor për t'i dhënë kohë mbrojtjes për t'u përgatitur, e pas dëgjimit të palëve, mund të vendosë që për veprën e tillë ta gjykojë veçmas të akuzuarin. Por, kur për gjykimin e të akuzuarit për veprën penale të kryer gjatë shqyrtimit gjyqësor konstatohet se kompetenca i takon një departamenti tjetër në kuadër të gjykatës themelore, atëherë trupi gjykues pas dëgjimit të palëve, vendosë nëse do t'ia dërgojë çështjen për të cilën është duke e drejtuar shqyrtimin gjyqësor gjykatës drejtpërdrejt më të lartë kompetente për të marrë vendim, (neni 351 i KPPK).

Pas përfundimit të procedurës së provave, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i pyet palët dhe të dëmtuarin nëse kanë propozim për plotësimin e procedurës së provave. Së këndejmi, nëse askush nuk ka propozim për plotësim të procedurës së provave ose propozimi refuzohet dhe gjykata çmon se çështja është sqaruar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues shpallë të përfunduar procedurën e provave, (neni 348 i KPP).

Më në fund, vlen të theksohet fakti se të dhënat penale nga evidenca e të dënuarve, si dhe të dhënat tjera për dënimet për vepra penale mund të lexohen pas përfundimit të procedurës së provave. Kur i akuzuari pranon fajësinë, të gjitha informatat lidhur

me dënimet e mëparshme të të akuzuarit lexohen para se palët të paraqesin fjalën përfundimtare, (neni 349 i KPP).

Fjala përfundimtare e palëve

Në fjalën përfundimtare palët gojarisht i paraqesin dhe arsyetojnë argumentet dhe përfundimet në të cilat ato kanë arritur lidhur me të gjitha çështjet për të cilat duhet të vendosë gjykata. Fjala përfundimtare zhvillohet sipas kësaj radhe: së pari i jepet fjala prokurorit të shtetit, pastaj të dëmtuarit, mbrojtësit dhe në fund të akuzuarit. “Personat në fjalën përfundimtare mund t’u referohen provave të pranueshme dhe procedurës, ligjit në fuqi dhe karakterit dhe sjelljes së dëshmitarëve gjatë procedurës gjyqësore. Me atë rast ata mund të përdorin tabela, diagrame, përshkrime incizime, si dhe zbatim të ekzemplarëve të tyre për t’i demonstruar ose për t’i paraqitur si ilustrim në gjykatë, (neni 352 i KPPK)”.

Prokurori i shtetit në fjalën e tij përfundimtare paraqet vlerësimin e tij për provat e shqyrtuara në shqyrtim gjyqësor, shpjegon konkluzionet e tij mbi faktet e rëndësishme për marrjen e vendimit, paraqet dhe arsyeton propozimin e tij për përgjegjësinë penale të të akuzuarit, për dispozitat e Kodit Penal të cilat duhet zbatuar si dhe për rrethanat lehtësuese dhe rënduese që duhet të merren parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Prokurori i shtetit nuk mund të propozojë lartësinë e dënimit, por mund të propozojë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore ose ndonjë dënim alternativ nga neni 49 i Kodit Penal, (neni 353 i KPP). Prokurori i çështjes në fjalën e tij përfundimtare bënë analizën dhe çmuarjen e provave në mënyrë të hollësishme, përcakton qëndrimin e tij lidhur me besueshmërinë dhe fuqinë provuese të provave të caktuara lidhur me faktet konkrete. Pasi prokurori t’i ketë analizuar provat në bazë të të cilave gjen se është provuar fajësia e të akuzuarit, kalon në cilësimin juridik të veprës penale. Në këtë rast ai duhet të justifikojë se veprimtaria e të akuzuarit përmban elementet e një figure të caktuar të veprës penale. Në këtë aspekt, qëndrimi i prokurorit të shtetit duhet të jetë i qartë. Në këto raste nuk lejohet kurrfarë alternative, pra nuk lejohen variante të ndryshme për kualifikimin e veprës penale. Rrjedhimisht, prokurori i shtetit duhet të përcaktohet për kualifikim konkret.

Kur kalon te kërkesa për masën e dënimit e cila sipas mendimit të tij duhet t’i shqiptohet të akuzuarit, prokurori i shtetit duhet të ndalet në disa tregues të cilët janë bazë për individualizimin e dënimit. Kështu, ai duhet të përcaktojë shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer nga i akuzuari, rolin që ai ka luajtur në kryerjen e veprës penale, motivet nga të cilat është udhëhequr me rastin e kryerjes së saj etj. Varësisht nga rezultati i procedurës provuese prokurori i shtetit mund të *tërhiqet nga aktakuzat, të ndryshojë ose të zgjerojë aktakuzën, ose të qëndrojë pranë aktakuzës së vet dhe të kërkojë që i akuzuari të dënohet sipas ligjit.*

Prokurori i shtetit tërhiqet nga ndjekja penale në fjalën përfundimtare të tij kur rezultatet e procedurës provuese nuk argumentojnë bazën e akuzës.

Ndryshimi dhe zgjerimi i aktakuzës, siç është theksuar më lart mund të bëhet kur prokurori i shtetit gjatë shqyrtimit gjyqësor konstaton se provat e shqyrtuara tregojnë

se gjendja faktike e paraqitur në aktakuzë është ndryshuar. Ndërsa, zgjerimi i aktakuzës bëhet kur gjatë shqyrtimit gjyqësor konstatohet se i akuzuari ka kryer edhe veprë penale tjetër ose kur vepra penale e mëparshme e të akuzuarit zbulohet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Prokurori i shtetit në fjalën e vet përfundimtare mbetet pranë aktakuzës së paraqitur kur çmon se me provat e proceduara në gjykatë është vërtetuar baza e tij se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar dhe se për të mbanë përgjegjësi penale. Në rast të tillë kërkon nga gjykata që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit. I dëmtuari ose përfaqësuesi i autorizuar i tij, në fjalën përfundimtare mund të shpjegojë kërkesën e tij pasurore juridike dhe potencon provat që ndërlidhen me përgjegjësinë penale të të akuzuarit, (neni 354 i KPP).

Mbrojtësi në fjalën përfundimtare personalisht paraqet argumentet të cilat shkojnë në favor të mbrojtjes së të akuzuarit dhe mund të komentojë pretendimet e prokurorit dhe të dëmtuarit. Pasi mbrojtësi të ketë prezantuar argumentet për mbrojtjen, i akuzuari ka të drejtë të deklarohej personalisht nëse pajtohet me mbrojtjen e prezantuar nga mbrojtësi i tij dhe mbrojtjen e tillë ta plotësojë. Prokurori i shtetit dhe i dëmtuari kanë të drejtë të përgjigjen në mbrojtje, kurse mbrojtësi apo i akuzuari kanë të drejtë që këto përgjigje t'i komentojnë. Fjalën e fundit gjithmonë e merr i akuzuari, (neni 355 i KPP). Pas mbrojtësit fjala i jepet të akuzuarit, i cili deklarohej se e aprovon apo jo mbrojtjen e mbrojtësit, apo sipas nevojës e plotëson atë. Kështu, duke folur i fundit i akuzuari ka mundësi të vlerësojë nga pikëpamja e mbrojtjes së interesave të tij rezultatet e procedurës provuese, ndërsa gjykata gjithashtu është e interesuar të dëgjojë mendimin e të akuzuarit dhe qëndrimin e tij përfundimtar pikërisht para se të tërhiqet për të marrë vendim. Përndryshe, në fjalën përfundimtare i akuzuari mund të merret me çdo problem i cili sipas tij meriton vëmendje nga ana e gjykatës, mjafton që këto të kenë lidhje me veprën penale.

Me rastin e zhvillimit të fjalës përfundimtare të palëve mund të vijë deri te replika. Në të vërtetë prokurori apo ndonjëri prej subjekteve tjerë sërish mund të marrin fjalën, me ç'rast duhet t'u mundësohet edhe subjekteve tjerë që ta thonë fjalën e tyre. Fjala e fundit, edhe në këto raste i takon të akuzuarit. Paraqitja e fjalës përfundimtare nga palët mund të kufizohet në kohë. Së këndejmi, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pasi të ketë bërë vërejtje paraprake, mund të ndërpres personin i cili në fjalën e tij përfundimtare fyen rendin publik dhe moralin, fyen personin tjetër, përsëritë ose jep shpjegime të gjata të cilat qartazi nuk ndërlidhen me çështjen. Kur aktakuzën e përfaqësojnë disa persona ose mbrojtjen disa mbrojtës, vetëm prokurori apo mbrojtësi kryesor ose mbrojtësi i caktuar nga mbrojtësi kryesor mund të paraqet fjalën përfundimtare në emër të palës që përfaqësojnë. Më tutje, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, pas prezantimit të fjalës përfundimtare, pyet nëse ka ndokush ndonjë deklaratë tjetër, (neni 356 i KPP).

Nëse palët nuk kanë propozime të reja dhe kur pas fjalës përfundimtare të palëve, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues nuk çmon se duhet marrë prova të reja, ai e shpallë shqyrtimin gjyqësor të përfunduar. Pas kësaj, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi

gjykues tërhiqet në seancën për këshillim dhe votim për marrjen e aktgjykimit, (neni 357 i KPP).

Më në fund, konform paragrafit 1 të nenit 358 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtarit të vetëm gjykues ose trupit gjykues i është dhënë autorizimi që gjatë shqyrtimit gjyqësor, pa kaluar në seancën për këshillim dhe votim ose edhe gjatë kësaj seance, me aktvendim e hedh aktakuzën kur: Procedura është zbatuar pa kërkesën e prokurorit të autorizuar; ka munguar propozimi i kërkuar i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht pengojnë ndjekjen.

Shtyrja dhe ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor

Pesha e madhe që ka shqyrtimi gjyqësor për procedurën penale në tërësi kërkon që ai të zhvillohet në mënyrë koherente dhe pa zvarritje në mënyrë që pas përfundimit të tij të shpallet aktgjykimi. Një mënyrë të tillë të zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor e kërkojnë rregulla të shumta procedurale. Mirëpo, për shkaqe të caktuara shqyrtimi gjyqësor megjithatë mund të shtyhet dhe ndërpritet. Shkaqet të cilat imponojnë shtyrjen e shqyrtimit gjyqësor janë të shumta dhe të llojllojshme. Së këndejmi, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 310 të KPPK, përveç rasteve të ashtuquajtura të përgjithshme, si shkaqe të cilat imponojnë nevojën për shtyrje të shqyrtimit gjyqësor, ndër të tjera konsiderohen: Nevoja për të mbledhur prova të reja; paraqitja e çrregullimit ose paaftësisë mendore të përkohshme të akuzuarit, pas kryerjes së veprës penale dhe ekzistimi i pengesave tjera për zbatim të suksesshëm të shqyrtimit gjyqësor.

Për shtyrje të shqyrtimit gjyqësor vendosë gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me aktvendim, me të cilin caktohet dita dhe ora e vazhdimit të tij si dhe mund të urdhërohet edhe mbledhja e provave të cilat me kalimin e kohës mund të humbin. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë, (neni 310 i KPPK).

Vazhdimi i shqyrtimit të shtyrë gjyqësor

Çështja e vazhdimit të shqyrtimit gjyqësor të shtyrë është rregulluar varësisht nga përbërja e trupit gjykues që e vazhdon atë dhe nga kohëzgjatja për të cilën është shtyrë seanca. Kështu, kur përbërja e trupit gjykues është ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë fillon rishtas. Por, në rastin e tillë, trupi gjykues pas dëgjimit të palëve mund të vendosë që dëshmitarët dhe ekspertët të mos merren sërish në pyetje dhe të mos bëhet këqyrja e re e vendit, por të lexohen deklaratimet e dëshmitarëve dhe ekspertëve të dhëna në shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor dhe procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes. Kur përbërja e trupit gjykues nuk ka ndryshuar, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë vazhdohet para të njëjtit trup gjykues dhe kryetari i trupit gjykues shkurtimisht paraqet rrjedhën e shqyrtimit gjyqësor të mëparshëm. Por, edhe në këtë rast trupi gjykues mund të caktojë që shqyrtimi gjyqësor të filloj rishtas. Kur shtyrja e shqyrtimit gjyqësor ka zgjatur më shumë se 3 muaj ose kur shqyrtimi gjyqësor mbahet para një kryetari tjetër të trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të filloj rishtas dhe përsëri të shqyrtohen të gjitha provat, (neni 311 i KPP).

Ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor

Ndërprerja e shqyrtimit gjyqësor, si rregull bëhet për një kohë të shkurtër. Në këtë aspekt, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, konform paragrafit 1 të nenit 312 të KPPK, mund ta ndërpres shqyrtimin gjyqësor: Për një pushim të shkurtër; për shkak të kalimit të orarit të punës; për të lejuar një kohë të shkurtër që të sigurohet provë konkrete ose, për përgatitje të akuzës ose mbrojtjes.

Vazhdimi i shqyrtimit të ndërprerë

Si rregull, shqyrtimi gjyqësor i shtyrë gjithmonë fillon para të njëjtit gjyqtar gjykues, përkatësisht të njëjtit trup gjykues. Por, kur shqyrtimi gjyqësor nuk mund të vazhdojë para të njëjtit gjyqtar gjykues, përkatësisht të njëjtit trup gjykues ose kur ndërprerja ka zgjatur më shumë se 8 ditë duhet vepruar si në rastin e shtyrjes së shqyrtimit gjyqësor, (neni 312 i KPPK).

Më në fund, kur shqyrtimi gjyqësor është drejtuar nga gjyqtari i vetëm gjykues, ndërsa faktet në të cilat bazohet aktakuza tregojnë se për shqyrtimin e veprës penale është kompetent trupi gjykues prej tre gjyqtarëve, atëherë gjykimi i kalohet trupit përkatës gjykues në kuadër të gjykatës themelore dhe shqyrtimi gjyqësor fillon rishtas, (neni 313 i KPP).

Koha e përfundimit të shqyrtimit gjyqësor

Për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor dispozitat ligjore në fuqi kanë paraparë afate të caktuara. Së këndejmi, konform paragrafit 1 të nenit 314 të KPPK, përveç në rastet kur gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues shtyn shqyrtimin gjyqësor mbi bazën e arsyeve të theksuara më lart, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundojë brenda këtyre afateve kohore: nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para gjyqtarit të vetëm gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda 90 ditësh, përveç nëse gjyqtari i vetëm gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve që determinojnë shtyrjen e tillë dhe nëse shqyrtimit gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda 120 ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjërës prej arsyeve që determinojnë një shtyrje të tillë.

Sipas paragrafëve 2 dhe 3 të nenit 314 të KPPK, shqyrtimi gjyqësor mund të vazhdohet deri në 30 ditë me aktvendim të arsyetuar kur ekzistojnë rrethana të cilat kërkojnë më shumë kohë për sqarim të çështjes penale, përfshirë por pa u kufizuar në: Numër të shumtë të dëshmitarëve; dëshmia e një apo më shumë dëshmitarëve është shumë e gjatë; numri i provave është jashtëzakonisht i madh ose siguria e shqyrtimit gjyqësor bën të nevojshme vazhdimin.

Hedhja e aktakuzës

Kjo dispozitë ligjore në aspektin strukturor nuk e ka vendin në këtë pjesë, nga se është sistemuar pas dispozitës që bënë fjalë për këshillimin dhe votimin (nuk është e mundur që të mos hetohen këto pengesa procedurale deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor) dhe këto arsye të theksuari tanimë në këtë dispozitë, do duhej të ishin arsye për marrjen e aktgjykimit refuzues në kuptim të nenit 363 të KPPK.

Po iu referuam paragrafit 2.të nenit 358 të KPPK, rezulton se kjo dispozitë është menduar të jetë funksionale para se shqyrtimi gjyqësor të filloj, dmth. gjatë përgatitjes së shqyrtimit gjyqësor, edhe nëse është caktuar shqyrtimi por akoma nuk ka filluar.

Si do që të jetë sipas nenit 358 të KPPK, trupi gjykues me aktvendim e hedh aktakuzën kur: procedura është zbatuar pa kërkesën e prokurorit të shtetit; ka munguar propozimi i kërkuar i të dëmtuarit ose leja e organit publik kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen; ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e pengojnë ndjekjen.

Aktvendimin mbi hedhjen e aktakuzës mund ta merr gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues edhe pas caktimit të shqyrtimit gjyqësor (neni 358.par.2.).

AKTGJYKIMI

Aktgjykimi është vendim gjyqësor me të cilin zgjidhet çështja penale konkrete. Ai mbështetet mbi bazën e provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Aktgjykimi shprehë bindjen e gjyqtarëve për ekzistimin ose jo të veprës penale, për fajësinë e të pandehurit dhe shkallën e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së tij shoqërore.

Marrja e aktgjykimit

Aktgjykimi si lloji kryesor i vendimit gjyqësor merret dhe shpallet në emër të popullit. Atë e nxjerr gjykata nëse gjatë këshillimit çmon se nuk nevojitet që përsëri duhet hapur shqyrtimin gjyqësor për plotësimin e procedurës ose për sqarimin e ndonjë çështje konkrete, (neni 359 i KPPK). Nëpërmjet aktgjykimit zbatohen masat e shtrëngimit shtetëror kundër atyre që vërtetohet se kanë kryer ndonjë veprë penale. Dhënia e aktgjykimit është e drejtë ekskluzive e gjykatës. Ai jepet pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, dhe kur ai merr formën e prerë e ka fuqinë e ligjit për çështjen penale konkrete që është zgjidhur, dhe si i tillë është i detyrueshëm për të gjithë. Rrjedhimisht, pas mbylljes së shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues së bashku me procesmbajtësin tërhiqen në seancën për këshillim dhe votim në të cilën merr aktgjykimin. Seanca për këshillim dhe votim, siç është theksuar më lart, zhvillohet nën udhëheqjen e kryetarit të trupit gjykues dhe në të trajtohen të gjitha çështjet paraprake të cilat janë të rëndësishme për zgjidhjen e lëndës së procedurës si dhe çështja kryesore.

Aktgjykimi i marrë mund t'i referohet vetëm personit të akuzuar dhe vetëm veprës që është objekt i akuzës të përfshirë në aktakuzën e paraqitur fillimisht, të ndryshuar ose të zgjeruar në shqyrtimin gjyqësor. Është me rëndësi të theksohet se gjykata

aktgjykimin e marrë e bazon vetëm në faktet dhe provat e proceduara në shqyrtimin gjyqësor. Gjykata detyrohet që me ndërgjegje të vlerësojë çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera, dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerr përfundim nëse fakti konkret është provuar, (neni 361 i KPPK).

Llojet e aktgjykimit

Në seancën për këshillim dhe votim, në varësi të fakteve dhe provave të shqyrtuara, gjykata mund të marr aktgjykim merititor dhe jomeritor. Me aktgjykimin merititor gjykata e zgjidhë çështjen penale konkrete tërësisht. I tillë është aktgjykimi dënues dhe aktgjykimi lirues. Përkundrazi, me aktgjykim jomeritor gjykata fare nuk lëshohet në zgjidhjen dhe vendosjen e çështjes kryesore për të cilën është filluar procedura. Rrjedhimisht, deri te një situatë e tillë vihet në ato raste kur në lidhje me rastin konkret paraqitet ndonjë pengesë procedurale, ashtu që gjykata duhet të orientohet në marrjen e aktgjykimit me të cilin refuzohet akuza.

Vlen të theksohet fakti se një aktgjykim njëkohësisht nuk mund të jetë edhe aktgjykim merititor edhe aktgjykim jomeritor, sikurse nuk mundet që gjykata njëkohësisht për të njëjtën vepër ndaj të njëjtit kryerës të shqiptojë edhe aktgjykim lirues edhe aktgjykim dënues. “Megjithatë, te rasti i koneksitetit të veprave penale, ekziston mundësia që për një vepër penale me aktgjykim të refuzohet akuza e për tjetrën të lirohet apo të shpallet fajtor personi, gjegjësisht personat e akuzuar.

Në seancën për këshillim dhe votim gjykata mund të merr këto lloje të aktgjykimeve: aktgjykimin refuzues, aktgjykimin lirues dhe aktgjykimin dënues.

Aktgjykimi refuzues

Aktgjykimi refuzues është aktgjykim me të cilin çështja kryesore mbetet e pazgjidhur. Këtë aktgjykim, siç u theksua më lart, gjykata e shqipton atëherë kur në rrugë për zgjidhjen e çështjes kryesore paraqitet ndonjë pengesë procedurale. Kështu, konform paragrafit 1 të nenit 363 të KPPK, gjykata merr aktgjykimin me të cilin aktakuza refuzohet kur: Prokurori i shtetit është tërhequr nga aktakuza nga hapja deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor; i akuzuari për të njëjtën vepër është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë ose procedura kundër tij është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ka kaluar afati i parashkrimit dhe vepra përfshihet në amnisti ose falje ose kur ekzistojnë rrethana tjera që përjashtojnë ndjekjen penale.

Për të gjitha shkaqet për të cilat refuzohet aktakuza gjykata duhet të mbajë llogari sipas detyrës zyrtare. Përndryshe, kur gjykata jep aktgjykim refuzues, në dispozitiv duhet të përfshihet përshkrimi i veprës për të cilën i pandehuri është akuzuar, vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe vendimi mbi kërkesën pasurore juridike nëse ajo ka qenë e paraqitur. Më në fund, gjykata me aktgjykim refuzues duhet të urdhërojë lirimin e menjëhershëm të të akuzuarit të paraburgosur dhe të deklarojë heqjen e masave tjera të sigurisë të cilat mund të jenë shqiptuar ndaj tij.

Aktgjykimi lirues

Aktgjykimi lirues është aktgjykim meritor me të cilin gjykata e zgjidhë tërësisht çështjen penale. Në këtë rast, zgjidhja e çështjes penale bëhet përmes lirimit të personit të akuzuar nga akuzat me të cilat ka qenë i ngarkuar. Sipas paragrafit 1 të nenit 364 të KPPK, gjykata merr aktgjykim me të cilin i akuzuari lirohet nga akuza atëherë kur:

- 1) *Vepra për të cilën i akuzuari akuzohet nuk përbën veprë penale.* Në situatën e tillë bëhet fjalë për rastet kur vepra e përshkruar në aktin akuzues nuk i përmban ato elemente të cilat çdoherë duhet të ekzistojnë për të mundur që sjelljet e caktuara të ndëshkohen (kuptimi i përgjithshëm i veprës penale) apo elementet e posaçme të veprës së caktuar penale të përmbajtur në përshkrimin ligjor të veprës. Në KP të Republikës së Kosovës si elementet të përgjithshme të veprës penale parashihen : kundërligjshmëria, vepra në ligj duhet të jetë e paraparë si veprë penale, dënueshmëria e veprës (dmth përpos që vepra duhet të jetë e parashikuar me ligj si veprë penale, duhet me ligj të parashihet edhe sanksioni penal), veprimi i kryerjes dhe pasojat e veprës penale, kauzaliteti (pasoja është rezultat i veprimit të ndërmarr).

Aktgjykimi lirues sipas pikës 1.1. të nenit 364 të KPPK, mund të shqiptohet vetëm atëherë kur vepra e përshkruar në aktakuzë nuk është veprë penale dmth. kur vërtetohet se nuk janë realizuar elementet e përgjithshme dhe të posaçme të përshkrimit ligjor të veprës penale apo ka rrethana që i përjashton ato. Në KPK si bazë për përjashtimin e kundërligjshmërisë janë paraparë: mbrojtja e nevojshme (neni 12) dhe nevoja ekstreme (neni 13). Gjithashtu si bazë për përjashtimin e kundërligjshmërisë nën kushtet e caktuara merren ushtrimi i të drejtave qytetare dhe zyrtare apo ushtrimi i veprimeve të caktuara në bazë të autorizimeve ligjore (psh.privimi nga liria i personit të caktuar (arrestimi dhe mbajtja), përdorimi i forcës nga ana e personave të autorizuar në përputhje me ligjin etj), nën konditat e caktuara edhe pëlqimi i të dëmtuarit dhe vetëlëndimi nuk konsiderohen veprë penale.Me KPK, është parashikuar se për mosparaqitje të përgatitjes së veprës penale (neni 385.par.3.), moslajmërimi i veprës penale apo kryesit (neni 386.par.3), mos lajmërimi i personit të akuzuar nga TNP -tribunali ndërkombëtar penal, (neni 387. par..2.) dhënia e ndihmës kryesit pas kryerjes së veprës penale (neni 388 par.5), dhe ndihma personit të akuzuar nga tribunali ndërkombëtar penal(neni 389.par. 2), nuk janë penalisht përgjegjës përkatësisht nuk dënohen: Prindi, fëmija,bashkëshorti apo bashkëshortja, vëllai ose motra, prindi adoptues apo fëmija i adoptuar apo personi me të cilin kryesit jeton në bashkësi jashtëmartesore ;

- 2) *Ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale.* Lirimi nga akuza sipas kësaj baze nënkupton se gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, mirëpo ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale siç janë : kryerja e veprës penale në gjendje të paaftësisë mendore(neni 18),mos ekzistimi i formës së caktuar të fajësisë që kërkohet për vepra penale të caktuara (psh disa vepra penale mund të kryhen vetëm me dashje dmth.nuk është e ndëshkueshme pakujdesia) dhe lajthimi faktik dhe juridik(neni 25 dhe 26 të KPK) dhe,

- 3) *Nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Në këtë rast vepra penale ekziston dhe ekzistenca e saj vërtetohet pa asnjë mëdyshje, por nuk ka prova që vërtetojnë në mënyrë të padyshimtë se atë e ka kryer i akuzuari. Sipas kësaj baze gjykata është obliguar që të merr aktgjykim lirues si atëherë kur saktë ka vërtetuar se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet gjithashtu edhe atëherë kur gjykata ngelë në mëdyshje ka dileme përkitazi me atë se është apo nuk është i akuzuari kryes i veprës penale. Gjithashtu të gjitha faktet të cilat shkojnë në dëm të akuzuarit (in peius) duhet në mënyrë të sigurt të vërtetohen-dëshmohen e nëse kjo nuk arrihet atëherë merret sikur ato nuk ekzistojnë, ndërsa të gjitha faktet të cilat i shkojnë në favor të akuzuarit (in favorem) merren sikur ato ekzistojnë kur janë vërtetuar me besueshmëri po jo në mënyrë të sigurt(kur saktësia e këtyre rrethanave ka ngelë në mëdyshje).*

Për dallim nga pika 1.1. sipas të cilës aktgjykimi lirues merret atëherë kur përshkrimi faktik nga aktakuza nuk përmban elementet qenësore të veprës penale apo ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ekzistimin e elementeve ligjore të veprës penale, sipas pikës 1.3. gjykata merr aktgjykim me të cilin të akuzuarin e liron nga akuza, kur provat që janë proceduar në shqyrtim gjyqësor nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për të përfunduar se ekzistojnë të gjitha fatet relevante juridike nga përshkrimi i veprës penale nga e cila rezulton përshkrim ligjor i veprës penale dhe me të cilat vërtetohet përgjegjësia penale.

Aktgjykimi dënues

Kur gjykata pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe të seancës për këshillim dhe votim vjen në përfundim se ekzistojnë prova të mjaftuara në bazë të të cilave konstatohet lidhja e rrethanave të veprës penale me veprimet apo mosveprimet e të akuzuarit, gjegjësisht në mbështetje të të cilave provohet fajësia e të akuzuarit për kryerjen e veprës penale për të cilën është akuzuar, ajo merr aktgjykim me të cilin të akuzuarin e shpallë fajtor.

Duhet theksuar faktin se me rastin e shqiptimit të aktgjykimit dënues gjykata duhet të merr parasysh të gjitha rrethanat rënduese dhe lehtësuese për të akuzuarin. Si rregull, gjykata para se ta shqiptojë aktgjykimin e tillë duhet me kujdes të vlerësojë të gjitha rrethanat të cilat eventualisht do të ndikojnë në shqiptimin e aktgjykimit refuzues apo lirues, dhe vetëm atëherë kur nuk gjen arsye për të shqiptuar ndonjërin nga këto dënime e shqipton aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e shpallë fajtor.

Gjykata në aktgjykimin me të cilin të akuzuarin e deklaron fajtor, konform paragrafit 1 të nenit 365 të Kodit të Procedurës Penale, shënon:

- 1) Veprën penale për të cilën shpallet fajtor së bashku me faktet dhe rrethanat që përbëjnë figurën e veprës penale, si dhe faktet dhe rrethanat nga të cilat varet zbatimi i dispozitës përkatëse të Kodit Penal;
- 2) Emërtimin ligjor të veprës penale dhe dispozitat e Kodit Penal të zbatuara gjatë marrjes së dënimit. Këtu është fjala për kualifikimin ligjor të veprës i cili bëhet duke u thirrur në dispozitën përkatëse të Kodit Penal;
- 3) Dënimin e shqiptuar të akuzuarit, duke përfshirë edhe dënimin alternativ ose lirimin nga dënimi. Gjykata në aktgjykimin dënues duhet të precizojë, në mënyrë të qartë

llojin e dënimit të cilin ia ka shqiptuar të akuzuarit dhe kohëzgjatjen e tij. Ky përshtkrim ka të bëjë me rastet kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim. Ndërsa, në rastet kur gjykata shqipton dënimin me gjobë, ose dhe lirimin nga dënimi në raste të tilla, në dispozitivin e aktgjykimit shënohen lartësia e dënimit, afati i përmbushjes dhe mënyra e ekzekutimit të tij, gjegjësisht fakti i lirimit të të akuzuarit.

- 4) Urdhrin për shqiptimin e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin e kryerësve të veprave penale të varur nga droga ose alkooli, apo për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale. Këtu është fjala për definim të qartë të llojit të masës së shqiptuar, pra a është shqiptuar masa e mjekimit të detyruar psikiatrik të kryerësit të papërgjegjshëm, kryerësit me përgjegjësi të zvogëluar apo masa e mjekimit të detyruar të narkomanëve dhe alkoolistëve dhe detyrimet të cilat mund ta shoqërojnë kohën e zbatimit të masës së shqiptuar;
- 5) Vendimin për llogaritjen e paraburgimit ose dënimit të mëparshëm të vuajtur në lartësinë e dënimit. Sipas Kodit Penal koha e kaluar në paraburgim si dhe çdo privim lirie lidhur me veprën penale llogaritet në dënimin e shqiptuar me burgim (cilido qoftë ai) dhe dënimin me gjobë. Në këtë rrjedhë, në çdo llogaritje barazohet 1 ditë paraburgim ose 1 ditë privim lirie me 1 ditë burgim, përkatësisht 1 ditë burgim afatgjatë dhe 15 Euro të dënimit me gjobë me 1 ditë burgim, përkatësisht 1 ditë burgim afatgjatë;
- 6) Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike si dhe përcaktimin se a duhet shpallur aktgjykimin e formës së prerë në shtyp, radio ose televizion. Këtu zakonisht është fjala për caktimin e lartësisë së shpenzimeve gjyqësore me të cilat ngarkohet i akuzuari që t'i paguaj në llogari të buxhetit të shtetit, caktimin e lartësisë e cila do duhej paguar në emër të realizimit të kërkesës pasurore juridike të personit të dëmtuar me vepër penale si dhe definimin e qartë të ekzistimit apo jo të mundësisë së shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar në mjetet e informimit publik.

Shpallja e aktgjykimit

Pasi gjykata të marrë aktgjykimin, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues, si rregull e shpallë atë menjëherë. Kur gjykata nuk ka mundësi që në të njëjtën ditë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të merr aktgjykimin, shpalljen e aktgjykimit e shtyn më së shumti për 3 ditë, duke caktuar kohën dhe vendin e shpalljes së aktgjykimit, (paragrafi 1 i nenit 366 i KPP).

Shpallja e aktgjykimit siç është theksuar më lart, bëhet në emër të popullit dhe në seancë të hapur. Shpalljen e bën gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues në prani të palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor, të përfaqësuesve të autorizuar dhe të mbrojtësve, me ç'rast lexon dispozitivin dhe prezanton në pika të shkurtra arsyet e aktgjykimit, kuptohet përveç rasteve kur ka arsye të jashtëzakonshme për të shtyrë leximin e dispozitivit deri në nxjerrjen e aktgjykimit me shkrim. Shpallja e aktgjykimit bëhet edhe kur pala, përfaqësuesi ligjor, përfaqësuesi i autorizuar ose mbrojtësi nuk janë të pranishëm. Në këtë rrjedhë, kur i akuzuari nuk është i pranishëm, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues ia komunikon atij aktgjykimin gojarisht ose

kopja e aktgjykimit i dërgohet me shkrim. Shpallja e aktgjykimit, përkatësisht leximi i dispozitivit të aktgjykimit bëhet gjithmonë publikisht, pavarësisht asaj se shqyrtimi gjyqësor mund të jetë zhvilluar pa të ashtuquajturin publicitet të përgjithshëm. Ndërsa sa i përket leximit të arsytimit çështja është rregulluar paksa më ndryshe. Në fakt, trupi gjykues është autoriteti që vendosë se a do ta përjashtojë publikun me rastin e prezantimit të arsyeve të aktgjykimit dhe në ç'masë do ta përjashtojë atë. Është e rëndësishme të theksohet se me rastin e leximit të dispozitivit të pranishmit e dëgjojnë atë duke qëndruar në këmbë, (neni 366 i KPP). Shpallja e aktgjykimit publikisht shërben për njohjen e palëve dhe publikut solemnisht me përmbajtjen e aktgjykimit ashtu që në masën aq sa është e mundur, shprehë transparencën e punës së gjykatës karshi qytetarëve.

Shpallja e aktgjykimit dhe paraburgimi

Çështje me rëndësi që shtohet me rastin e shpalljes së aktgjykimit është çështja e paraburgimit. Në të vërtetë me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari dënohet me burgim, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues cakton paraburgimin kur ekzistojnë kushtet për caktimin e tij, ose e heq paraburgimin nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim në rastet kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat është paraburgosur. Rrjedhimisht, me rastin e marrjes së aktgjykimit me të cilin i akuzuari dënohet me burgim, konform paragrafit 1 të nenit 367 të Kodit të Procedurës Penale, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues:

- 1) Cakton, përkatësisht vazhdon paraburgimin kur ekzistojnë kushtet për caktimin apo vazhdimin e tij; ose
- 2) Ndërprenë paraburgimin nëse i akuzuari ndodhet në paraburgim kur pushojnë së ekzistuari shkaqet për të cilat është paraburgosur.

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues ka shpallur aktgjykimin me të cilin shqipton dënim prej 5 apo më shumë vjet burgim, ai ia cakton ose ia vazhdon paraburgimin të akuzuarit, (paragrafi 2 i nenit 367 i KPP).

Nëse gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues ka shpallur aktgjykimin me të cilin shqipton dënim me burgim që është më pak se 5 vjet burgim, ai urdhëron caktimin ose zgjatjen e paraburgimit vetëm nëse konsideron se janë plotësuar kushtet e përcaktuara ligjore për caktimin e paraburgimit, (paragrafi 3 i nenit 367 i KPP).

Së këndejmi, trupi gjykues gjithmonë ndërpre në paraburgimin dhe urdhëron lirin e të akuzuarit nëse:

- 1) Është liruar nga akuza;
- 2) Është deklaruar fajtor, por është liruar nga dënimi;
- 3) Është dënuar vetëm më gjatë ose i është shqiptuar vërejtja gjyqësore;
- 4) Është shqiptuar një nga dënimet alternative, përveç dënimit me gjysmëliri;
- 5) Për shkak të llogaritjes së paraburgimit në lartësinë e dënimit, ai veç e ka mbajtur dënimin ose
- 6) Akuza është refuzuar, përveç në rastin kur është refuzuar për shkak të moskompetencës së gjykatës.

Para caktimit ose heqjes së paraburgimit, vështruar kjo në kontekst të dy situatave të fundit, përkatësisht rasteve të parashikuara me paragrafët 3 ose 4 të nenit 367 të KPPK, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues së pari dëgjon mendimin e prokurorit të shtetit, nëse procedura është filluar me kërkesën e tij dhe pastaj dëgjon të akuzuarin apo mbrojtësin e tij, (paragrafi 5 i nenit 367 i KPPK).

Kur i akuzuari gjendet në paraburgim dhe gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues çmon se ende ekzistojnë shkaqet për të cilat ishte caktuar paraburgimi, paraburgimin e vazhdon me aktvendim të posaçëm. Po ashtu, gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues me aktvendim të posaçëm e cakton ose e heq paraburgimin. Në këto raste, paraburgimi i caktuar ose i vazhduar mund të zgjasë derisa aktgjykimi të merr formë të prerë, por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykimin e gjykatës themelore. Megjithatë, ligjdhënësi ka parashikuar se i akuzuari i dënuar me burgim, i cili gjendet në paraburgim, me kërkesën e tij të mund të transferohet me aktvendim të gjyqtarit të vetëm gjykues ose të kryetarit të trupit gjykues në institucionin për mbajtjen e dënimit para se aktgjykimi të merr formë të prerë.

Çka i udhëzon gjykata palët pas shpalljes së aktgjykimit

Pas shpalljes së aktgjykimit gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i udhëzon palët për të drejtën në ankesë. Udhëzimi i dhënë shënohet në procesverbalin e shqyrtimit gjyqësor. Krahas kësaj, kur shqiptohet dënimi alternativ gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues paralajmëron të akuzuarin për rëndësinë e dënimit dhe kushtet të cilat duhet respektuar ai në lidhje me atë. Më në fund, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues i njofton palët për detyrimin e tyre që deri në përfundim të procedurës, të njoftojnë gjykatën për çdo ndryshim të adresës, (neni 368 i KPP).

Përpilimi dhe dorëzimi i aktgjykimit

Pas shpalljes, aktgjykimi duhet të përpilohet në formë të shkruar. Përpilimi me shkrim i aktgjykimit, si rregull duhet të bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tij kur i akuzuari është dërguar në mbajtje të burgimit, përkatësisht brenda 15 ditëve kur i akuzuari gjendet në paraburgim dhe brenda 30 ditëve në rastet tjera. Megjithatë, kur rasti është i ndërlikuar, gjyqtari i vetëm gjykues apo kryetari i trupit gjykues mund të kërkojë nga kryetari i gjykatës që të zgjasë afatin për përpilimin me shkrim të aktgjykimit deri në 60 ditë, (paragrafi 1 i nenit 369 i KPPK).

Aktgjykimin e nënshkruajnë gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues dhe procesmbajtësi. Kopja e vërtetuar e aktgjykimit e cila përmban udhëzimin për të drejtën në ankesë u dërgohet palëve. Ajo së bashku me udhëzimin për të drejtën në ankesë i dërgohet edhe të dëmtuarit, personit të cilit i është konfiskuar sendi me aktgjykim, si dhe personit juridik të cilit i është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale. Në fakt, kopje të vërtetuar të aktgjykimit gjykata e çështjes u dorëzon edhe gjykatave tjera të cilat kanë shqiptuar aktgjykime ndaj të akuzuarit, kur ajo është

gjendur në situatë që të shqiptojë dënimin unik për rastet e veprave penale të kryera në bashkim, (paragrafët 2-5 të nenit 369 të KPPK).

Përmbajtja e aktgjykimit

Aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të jetë identik me aktgjykimin e shpallur. Si i tillë, aktgjykimi i përpiluar përbëhet prej tri pjesëve: *hyrjes, dispozitivit dhe arsyetimit*, (paragrafi 1 i nenit 370 i KPPK).

Hyrja e aktgjykimit përfshinë: shënimin se aktgjykimi merret në emër të popullit, emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit dhe të anëtarëve të trupit gjykues dhe të procesmbajtësit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, veprën penale për të cilën i akuzuari është dënuar dhe nëse ka qenë i pranishëm në shqyrtimin gjyqësor, ditën e shqyrtimit gjyqësor, nëse shqyrtimi gjyqësor ka qenë i hapur, emrin dhe mbiemrin e prokurorit të shtetit, mbrojtësit, përfaqësuesit ligjor dhe të përfaqësuesit të autorizuar të cilët kanë qenë të pranishëm në shqyrtim gjyqësor, datën e shpalljes së aktgjykimit të shqiptuar dhe datën e përpilimit të aktgjykimit, (paragrafi 2 i nenit 370 i KPP).

Dispozitivi i aktgjykimit përfshinë të dhënat personale të të akuzuarit dhe vendimin me të cilin i akuzuari shpallet fajtor për vepër penale për të cilën akuzohet, ose me të cilin lirohet nga akuza për atë vepër apo me të cilin refuzohet aktakuza. Kur i akuzuari është dënuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshinë të gjitha të dhënat e nevojshme të parapara në nenin 365 të këtij Kodi, ndërsa kur ai është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, dispozitivi i aktgjykimit përfshinë përshkrimin e veprës për të cilën është akuzuar dhe vendimin për shpenzimet e procedurës penale dhe kërkesën pasurore juridike, nëse një kërkesë e tillë është paraqitur. Në rastin e gjykimit të veprave penale në bashkim, gjykata në dispozitivin e aktgjykimit shënon dënimet e shqiptuara për secilën vepër penale, e pastaj dënimin për të gjitha veprat në bashkim, (paragrafët 3-5 të nenit 370 të KPP).

Gjykata në arsyetimin e aktgjykimit paraqet arsyet për çdo pikë të aktgjykimit. Në këtë aspekt, gjykata paraqet qartë dhe në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara apo të pavërtetuara. Gjykata gjithashtu, në mënyrë të veçantë vlerëson saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimit konkret të palëve, si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve juridike, veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale dhe përgjegjësisë penale të të akuzuarit, si dhe me rastin e zbatimit të dispozitave të caktuara të Kodit Penal ndaj të akuzuarit dhe veprës së tij, (paragrafët 6 dhe 7 të nenit 370 të KPP).

Kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimin. Gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim më të rëndë se dënimi i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo të heqë dënimin, të shqiptojë dënim alternativ ose masën për trajtim të detyruar rehabilitimi ose të konfiskohet dobia pasurore e fituar me vepër penale, (paragrafi 8 i nenit 370 i KPP).

Kur në aktakuzë përcaktohet pasuria që i nënshtrohet konfiskimit, aktgjykimi përcakton nëse pasuria konfiskohet apo jo. Aktgjykimi përmban arsyetimin për konfiskimin e secilës pasuri për të cilën urdhërohet konfiskimi dhe arsyetimin për secilën pasuri për të cilën nuk urdhërohet konfiskimi, (paragrafi 9 i nenit 370 i KPP).

Kur i akuzuari lirohet nga akuza, varësisht nga rasti, në arsyetim veçanërisht shënohen arsytet pse vepra me të cilën është akuzuar i akuzuari nuk paraqet vepër penale, cilat janë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit dhe si erdhi në përfundim se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale me të cilën është akuzuar (paragrafi 10 i nenit 370 i KPP).

Kur të akuzuarit i është shqiptuar aktgjykimi me të cilin është refuzuar akuza, në arsyetim gjykata nuk do të ndalet në vlerësimin e çështjes kryesore, por ajo do të kufizohet vetëm në arsytet e refuzimit të akuzës, (paragrafi 11 i nenit 370 i KPP).

Përmirësimi i aktgjykimit

Gabimet në emra dhe numra, gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, parregullsitë në mënyrën e përpilimit të aktgjykimit me shkrim dhe mospërputhja e aktgjykimit origjinal me kopjet, me kërkesë të palëve, të mbrojtësit ose sipas detyrës zyrtare, me aktvendim të posaçëm përmirësohen nga gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues. Në rast se gabimet e tilla janë objekt i ankesës, ato si rregull i përmirëson Gjykata e Apelit, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 371 të KPPK).

Kur ekziston papajtueshmëri midis aktgjykimit të hartuar me shkrim dhe origjinalitetit të tij përkitazi me të dhënat kryesore të tij, aktvendimi për përmirësim u dërgohet personave të cilët kanë të drejtë ankesë kundër aktgjykimit. Në rastin e tillë, afati i ankesës kundër aktgjykimit llogaritet nga dita e dorëzimit të aktvendimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e posaçme, (paragrafi 3 i nenit 371 i KPP).

Kur gjykata vendosë për vazhdimin ose caktimin e paraburgimit pas shpalljes së aktgjykimit dhe i akuzuari pajtohet me këtë, ose kur gjykata e shqipton dënimin me burgim (më i gjatë apo më i shkurtër se 5 vjet), ose kur me aktgjykim të formës së prerë me shkrim shqiptohet dënimi unik për rastet e veprave penale të kryera në bashkim, konsiderohet se i akuzuari është në vuajtje të dënimit dhe ai do të ekzekutohet sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Ndërsa, kur me aktgjykim shqiptohet dënimi me burgim (më i gjatë apo më i shkurtër se 5 vjet), ose kur me aktgjykim të formës së prerë me shkrim shqiptohet dënimi unik për rastet e veprave penale të kryera në bashkim, ndërsa i akuzuari ka ikur jashtë Kosovës apo i shmanget mbajtjes së dënimit, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues lëshon urdhërarrest për të akuzuarin, (neni 372 i KPP).

Më në fund, duhet theksuar faktin se investitorët, aksionarët apo kreditorët e personit juridik nuk mund të kundërshtojnë aktgjykimet dhe ekzekutimin e tyre kundër personit juridik, përveç nëse personi i tillë është përfaqësues i personit juridik të pandehur nga neni 20 i Ligjit për Përgjegjësinë e Personave Juridik për Vepra Penale, (neni 373 i KPP).

PROCEDURA SIPAS MJETEVE JURIDIKE

Ankesa kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë

Siç dihet procedura penale para gjykatës së shkallës së dytë, përkatësisht Gjykatës së Apelit mund të zhvillohet vetëm pasi të ketë përfunduar gjykimi në shkallë të parë dhe pasi të jetë adresuar iniciativa e personit të autorizuar për paraqitjen e ankesës. “Gjykimi në gjykatën e shkallës të dytë është stad i veçantë i procedurës penale që ka kërkesa e detyra të posaçme. Për plotësimin e tyre, si rregull, përdoren mjete e metoda të ndryshme, por të cilat, në esencë, janë të ngjashme me ato që zbatohen në procedurën para gjykatës së shkallës së parë, përkatësisht gjykatës themelore. Pavarësisht nga kjo edhe gjykimi në gjykatën e shkallës së dytë konsiderohet pjesë përbërëse e procedurës dhe si i tillë i shërben qëllimit përfundimtar të saj. Gjykimi në gjykatën e shkallës së dytë inicohet me ankesë. Këtë mjet juridik e paraqesin personat e autorizuar atëherë kur konsiderojnë se me aktgjykimin e dhënë është bërë ndonjë gabim i natyrës faktike ose juridike. Gabimi i natyrës faktike ekziston nëse me aktgjykim është vërtetuar gjendja faktike gabimisht ose në mënyrë jo të plotë, ndërsa gabimi i natyrës juridike ekziston po që se me aktgjykim është shkelur ndonjë dispozitë e legjislacionit penal ose procedural penal. Në parim, procedura e jonë penale është procedurë dyshkallëshe. Megjithatë, në rastet shprehimisht të përcaktuara me nenin 407 të KPPK, me ankesë mund të ankimohet edhe aktgjykimi i gjykatës të shkallës së dytë, përkatësisht Gjykatës së Apelit.

E drejta në ankesë

Kundër aktgjykimit të marrë nga gjyqtari i vetëm gjykues ose trupi gjykues i gjykatës themelore, ankesë mund të paraqesin personat e autorizuar, në radhë të parë palët (prokurori i shtetit dhe i akuzuari), mbrojtësi, përfaqësuesi ligjor i të akuzuarit dhe i dëmtuari, personi, pasuria e të cilit është konfiskuar ose nga i cili është konfiskuar dobia pasurore e fituar me vepër penale si dhe personi juridik, pasuria e të cilit është konfiskuar nën përshtypjen se ajo është fituar nga vepra penale, (paragrafët 2-4 të nenit 381 të KPPK).

Prokurori i shtetit mund të paraqesë ankesë në dëm dhe në dobi të të akuzuarit. I dëmtuari mund të ankimojë aktgjykimin vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionet penale për veprat penale kundër jetës dhe trupit, kundër integritetit seksual, kundër sigurisë së trafikut publik dhe për shpenzimet e procedurës penale.

Afati për paraqitjen e ankesës

Ankesa paraqitet brenda 15 ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit. Në rastet kur ankesa paraqitet brenda afit ligjor ajo e pezullon ekzekutimin e aktgjykimit, (neni 380 i KPPK).

Palët disponojnë lirshëm me të drejtën e tyre në ankesë. Kështu, derisa gjykata e shkallës së dytë nuk merr vendim, ankuesi mund të tërheqë ankesën. Megjithatë, duhet pasur parasysh faktin se tërheqja e ankesës nuk mund të revokohet.

Përmbajtja e ankesës

Ligjdhënësi me qëllim që të krijojë rregullsi dhe mundësi sa më të gjera në aspektin që procesi ankimor të zhvillohet pa pengesat me të cilat ai vazhdimisht mund të përballet, ka përcaktuar se çfarë duhet të përmbajë ankesa me të cilën subjekti i autorizuar për paraqitjen e saj e atakon vendimin e gjykatës themelore. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 382 të Kodit të Procedurës Penale, ankesa duhet të përmbajë:

1. Të dhënë mbi aktgjykimin i cili ankimohet (p.sh., numrin dhe datën);

2. Arsyet e kundërshtimit të aktgjykimit. Këtu subjekti i ankesës duhet të prezantojë arsyet mbi bazën e të cilave e mbështetë ankesën e tij. Ato mund të bëjnë me shkeljet e dispozitave ligjore apo gjendjen faktike;

3. Propozimin për anulimin e tërësisht apo të pjesshëm të aktgjykimit ose për ndryshimin e tij. Në fakt ankuesi në ankesën e tij duhet të precizojë faktin se a kërkon ndryshimin e aktgjykimit apo anulimin e tij. Në rast se kërkon anulimin e aktgjykimit ai duhet të evidencojë përmasat e kërkesës për anulim të aktgjykimit dhe

5. Nënshkrimin e ankuesit.

Kur ankesën e paraqet i akuzuari ose i dëmtuari i cili nuk përfaqësohet nga mbrojtësi dhe ankesa nuk është përpiluar në pajtim me kërkesat e lartcekura, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues kërkon nga ankuesi që në afat të caktuar të ndryshojë ankesën me parashtresë të veçantë. Nëse ankuesi nuk e përmbushë kërkesën e tillë, ndërsa ankesa nuk përfshinë të dhënat mbi numrin e aktgjykimit, emrin dhe mbiemrin e të akuzuarit, përshkrimin e bazës ligjore të atakimit të aktgjykimit, nënshkrimin e ankuesit etj., gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues e hedh ankesën nëse të dhënat nuk mund të zbulohen lehtë, (paragrafi 3 i nenit 382 i KPPK).

Në ankesë mund të paraqiten fakte dhe prova të reja, por ankuesi detyrohet të arsyetojë përse ato nuk i ka paraqitur më parë. Kur ankuesi thirret në fakte të reja, detyrohet të paraqesë prova me të cilat ato fakte mund të provohen, e kur u referohet provave të reja detyrohet t'i paraqesë faktet që ai synon t'i vërtetojë me to. Kur ankuesi pretendon në ankesë arsye të cilat nuk i ka ngritur në gjykatën themelore gjatë shqyrtimit fillestar ose shqyrtimit të dytë të aktakuzës, apo gjatë shqyrtimit gjyqësor, ankuesi nuk mund të ankohet mbi këto baza, përveç nëse vërteton se ka pasur shkaqe të jashtëzakonshme pse ato prova ose fakte të reja nuk i ka prezantuar më parë, (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 382 të KPPK).

Arsyet e ushtrimit të ankesës kundër aktgjykimit

Arsyet e ushtrimit të ankesës kundër aktgjykimit qëndrojnë në të metat të cilat figurojnë ose të paktën supozohet se i përmban aktgjykimi. Të metat e tilla, siç është theksuar më lart, mund të jenë reale ose juridike dhe ato vijnë si pasojë e lëshimeve dhe

gabimeve të subjekteve procedurale. Në këtë rrjedhë, ankesa mund të paraqitet kundër aktgjykimit në tërësi ose edhe kundër pjesëve të veçanta të tij.

Sipas paragrafit 1 të nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale aktgjykimi mund të ankimohet për shkak të:

1. Shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale;
2. Shkeljes së Kodit Penal;
3. Vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike ose
4. Vendimit lidhur me sanksionet penale, konfiskimit të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, shpenzimeve të procedurës penale, kërkesave pasurore juridike, si dhe për shkak të vendimit mbi publikimin e aktgjykimit.

Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale

Si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale konsiderohen të gjitha ato shkelje të cilat i ka bërë gjykata themelore, të cilat drejtpërdrejt kanë ndikuar në vendim. Shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale mund të jenë të karakterit absolut dhe relativ.

Shkeljet esenciale absolut janë parashikuar në nenin 384.par.1.të KPPK, ndërsa shkelje esenciale relative janë të parashikuar në paragrafin 2. të këtij neni.

Shkeljet esenciale absolute nga neni 384.par.1.të KPPK, kushtëzojnë anulimin e aktgjykimit të ankimuar, nëse nuk është fjala për shkelje të tilla të cilat gjykata e shkallës së dytë mund t'i evitohet me vendimin e saj, ndërsa shkeljet esenciale relative mund të kushtëzojnë anulimin e aktgjykimit, dmth. aktgjykimi anulohet për shkak të shkeljeve esenciale të karakterit relativ vetëm po që se shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligshmërinë e vendimit (është e mundur që të ekzistojë shkelje tillë por që nuk imponon anulimin e aktgjykimit siç është rasti me shkeljet esenciale me natyrë absolute).

Shkeljet e Kodit Penal

Shkeljet e Ligjit Penal kanë të bëjnë me moszbatimimin ose zbatimin e gabuar të ndonjë dispozite e cila referon çështje që kanë të bëjnë me ekzistimin e veprës penale, përgjegjësinë penale dhe sanksionin penal. Secila nga këto shkelje trajtohen si shkelje absolute për të cilat gjykata duhet të kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Sipas nenit 385 të KPPK, shkelja e Ligjit Penal ekziston atëherë kur ai është shkelur në çështjet:

1. Nëse vepra për të cilën i akuzuari ndiqet nuk është vepër penale;
2. Nëse ekzistojnë rrethana që përjashtojnë përgjegjësinë penale;
3. Nëse ekzistojnë rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale e sidomos nëse ndjekja penale është parashikuar ose është përjashtuar për shkak të amnistisë ose faljes, ose më parë është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë;
4. Nëse lidhur me veprën penale të gjykuar është zbatuar ligji i cili nuk mund të zbatohet;

5. Nëse në marrjen e vendimit për dënimin, dënimin alternativ, vërejtjen gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim ose për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, gjykata ka tejkuluar kompetencat ligjore ose

6. Nëse janë shkelur dispozitat mbi llogaritjen e paraburgimit dhe të dënimit të mbajtur.

Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Çështja më problematike në një proces gjyqësor është vërtetimi i fakteve, ngase të metat në gjendjen e fakteve kushtëzojnë, shkeljet procedurale edhe gabimet në aplikimin e ligjit penal. Shkeljet në këtë segment mund të jenë dy llojesh : vërtetimin i gabuar i gjendjes faktike dhe vërtetimin jo i plotë i gjendjes faktike.

Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike ekziston atëherë kur gjykata ka vërtetuar gabimisht ndonjë fakt të rëndësishëm apo kur përmbajtja e dokumentit, procesverbalit mbi provat e shqyrtuara ose incizimit teknik e vejnë në pikëpyetje saktësinë ose besnikërinë e vërtetimit të fakteve të rëndësishme, (paragrafi 2 i nenit 386 i KPP).

Vërtetimi jo i plotë i gjendjes faktike ekziston atëherë kur gjykata nuk ka vërtetuar ndonjë fakt të rëndësishëm, gjegjësisht kur ajo ka lëshuar t'i vërtetojë të gjitha faktet relevante dhe provat konkrete për marrjen e vendimit të duhur, (paragrafi 3 i nenit 386 i KPPK).

Procedura e ankimit

Sipas dispozitat përkatëse të KPPK veprimtaria gjyqësore lidhur me ankesën e parashtruar kundër aktgjykimit të gjykatës themelore zhvillohet në dy nivele: në gjykatën themelore dhe në Gjykatën e Apelit.

Procedura lidhur me ankesë në gjykatën e shkallës së parë

Ankesa kundër aktgjykimit paraqitet në gjykatën e cila e ka marrë aktgjykimin për gjykatën që është kompetente që të vendosë në lidhje me të. Ankesa paraqitet në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare. Në këtë rast, palës kundërshtare i njihet e drejta që në afat prej 8 ditësh të paraqesë përgjigje në ankesë, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 388 të KPPK).

Ankesën së bashku me përgjigjen në ankesë dhe me të gjitha shkresat tjera të lëndës, gjykata vendimi i të cilës goditet me ankesë ia dërgon gjykatës që është kompetente për shqyrtimin e ankesës dhe vendimmarrjen në lidhje me të, (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 388 të KPPK).

Kufijtë e shqyrtimit të aktgjykimit të gjykatës themelore të goditur me ankesë

Gjykata e Apelit, konform paragrafit 1 të nenit 394 të Kodit të Procedurës Penale, e shqyrton aktgjykimin e gjykatës themelore vetëm në pjesën në të cilën është atakuar me ankesë, ndërsa pjesët tjera të aktgjykimit konsiderohen çështje të gjykuara. Përkundër kësaj, ligjdhënësi në këtë dispozitë ligjore ka paraparë se megjithatë Gjykata e Apelit, gjatë vendosjes mbi ankesën e parashtruar, çdoherë sipas detyrës zyrtare duhet të shqyrtojë:

1. Nëse ekziston shkelje e dispozitave të procedurës penale në çështjet që kanë të bëjnë me përbërjen e trupit gjykues (përbërja e gjykatës a ka qenë në pajtim me ligjin), me faktin se mos në shqyrtim gjyqësor ka marrë pjesë gjyqtari i cili është dashur të përjashtohet, me faktin se mos aktgjykimi i atakuar është bazuar në provë të papranueshme si dhe me faktin se mos aktgjykimi i përpiluar me shkrim nuk është në përputhje me aktgjykimin e shpallur;

2. Nëse shqyrtimi gjyqësor, në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, është mbajtur në mungesë të të akuzuarit;

3. Nëse në çështjen e mbrojtjes së detyrueshme, shqyrtimi gjyqësor është mbajtur pa praninë e mbrojtësit dhe

4. Nëse në dëm të të akuzuarit është shkelur Kodi Penal.

Nëse ankesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit nuk përfshinë të dhënat e aktgjykimit që ankimohet, arsyet e kundërshtimit të aktgjykimit dhe propozimin për anulimin e tërësishtëm ose të pjesshëm, përkatësisht për ndryshimin e tij, Gjykata e Apelit do të kufizohet vetëm në shqyrtimin e shkeljeve të cilat cilësohen si shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe në shqyrtimin e vendimit mbi dënimin, caktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim dhe konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, (paragrafi 2 i nenit 394 i KPP).

Në lidhje me çështjen e përcaktimit të kufijve të shqyrtimit të ankesës, në Kodin e Procedurës Penale janë vënë edhe tri rregulla bazë, për njërën nga të cilat do të bëhet fjalë tani, kurse për dy të tjerat (beneficium cohaesionis dhe reformatio in peius) do të flitet më vonë në kuadër të këtij kapitulli. Në këtë rrjedhë, sipas nenit 396 të Kodit të Procedurës Penale ankesa e paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ose për shkak të shkeljes së Kodit Penal në dobi të të akuzuarit, përfshinë edhe ankesën kundër vendimit lidhur me dënimin, trajtimin e detyrueshëm për rehabilitim dhe marrjen e dobisë pasurore të fituar me vepër penale.

Vendimet e Gjykatës së Apelit lidhur me ankesën dhe aktgjykimin e gjykatës themelore

Me rastin e shqyrtimit të aktgjykimit të gjykatës themelore të goditur me ankesë, Gjykata e Apelit, konform paragrafit 1 të nenit 398 të Kodit të Procedurës Penale, në seancë të kolegjit ose në shqyrtim gjyqësor ka këto mundësi:

1. Të hedh ankesën si të paafatshme ose të palejuar;

2. Të refuzojë ankesën si të pabazë dhe të vërtetojë aktgjykimin e gjykatës themelore;

3. Të anulojë aktgjykimin dhe çështjen t'ia kthejë gjykatës themelore për rigjykim dhe vendim ose

4. Të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës themelore.

Është rregull parimor se Gjykata e Apelit është e detyruar që të vendosë për të gjitha ankesat e drejtuara kundër të njëjtit aktgjykim ose aktvendim me një vendim gjyqësor të vetëm.

Rrjedhimisht, Gjykata e Apelit sipas nenit 399 dhe 400 të Kodit të Procedurës Penale me aktvendim e hedh ankesën si të paafshme ose të palejuar kur:

- a) *Konstaton se ajo është paraqitur pas kalimit të afatit ligjor dhe*
- b) *Konstaton se ajo është paraqitur nga personi pa të drejtë ankese ose nga personi që ka hequr dorë nga ankesa, apo kur ankesa është tërhequr ose kur ankesa e tërhequr paraqitet sërish, ose ankesa sipas ligjit nuk është e lejuar.*

Në anën tjetër, Gjykata e Apelit, konform nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale, me aktgjykim refuzon ankesën si të pabazë dhe vërteton aktgjykimin e gjykatës themelore kur:

- a) *Vërteton se nuk ekzistojnë shkaqet për të cilat ankimohet aktgjykimi dhe*
- b) *Kur vërteton se:*

1. Nuk ekzistojnë shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale;
2. Nuk ekzistojnë shkeljet e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale mbi mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor në mungesë të të akuzuarit;
3. Nuk ekzistojnë shkeljet e dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të cilat rregullojnë çështjen e mbrojtjes së detyrueshme dhe
4. Nuk ekzistojnë shkeljet e Kodit Penal në dëm të të akuzuarit.

Gjykata e Apelit, sipas paragrafit 1 të nenit 402 të Kodit të Procedurës Penale, e anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe çështjen e kthen në rigjykim vetëm në raste të jashtëzakonshme kur vlerëson se:

- a) *Ekziston shkelje esenciale e dispozitave të procedurës penale, dhe ajo nuk mund të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës themelore dhe*
- b) *Duhet urdhëruar shqyrtim të ri gjyqësor në gjykatën themelore për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për rastet kur ajo nuk mund të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës themelore.*

Gjykata e Apelit me aktvendim e anulon aktgjykimin e gjykatës themelore dhe e refuzon aktakuzën edhe atëherë kur konstaton se procedura është zbatuar pa kërkesën e prokurorit të autorizuar, ka munguar propozimi i kërkuar i të dëmtuarit ose leja e organit kompetent, apo nëse organi publik kompetent e ka tërhequr lejen, ose ekzistojnë rrethana tjera që pengojnë ndjekjen. Në fakt, Gjykata e Apelit do të veprojë në këtë mënyrë edhe kur gjen se gjykata themelore nuk ka pasur kompetencë lëndore për

gjykimin e rastit, përveç kur ankesa është paraqitur në favor të të akuzuarit, (paragrafi 2 i nenit 402 i KPP).

Në anën tjetër, ligdhënësi i ka dhënë autorizim Gjykatës së Apelit që të anulojë edhe pjesërisht aktgjykimin e gjykatës themelore, kur ka mundësi që pjesë të veçanta të aktgjykimit mund të veçohen pa pasojë për gjykim të drejtë, (paragrafi 3 i nenit 402 i KPP).

Në këto raste, nëse, kur i akuzuari gjendet në paraburgim, Gjykata e Apelit shqyrton nëse ende ekzistojnë shkaqet për paraburgim dhe vendosë me aktvendim për vazhdimin ose heqjen e paraburgimit. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë, (paragrafi 4 i nenit 402 i KPP).

Gjykata e Apelit, konform paragrafit 1 të nenit 403 të Kodit të Procedurës Penale, duke aprovuar ankesën e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore me aktgjykim kur vërteton se gjykata themelore ka bërë vërtetim të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, dhe për këtë qëllim:

1. Në bazë të kërkesës së palëve ose sipas detyrës zyrtare zbaton shqyrtim për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave në mënyrë që të vlerësojë drejt dhe të çmojë provat materiale ose

2. Mund të vërtetojë dhe të çmojë provat materiale pa mbajtur shqyrtim, nëse nuk ka nevojë për të marrë prova të reja apo për të përsëritur shqyrtimin e provave.

Gjykata e Apelit me aktvendim e ndryshon aktgjykimin e gjykatës themelore edhe në rastet kur çmon se ekzistojnë kushtet ligjore për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore, (paragrafi 2 i nenit 403 i KPP).

Kur për shkak të ndryshimit të aktgjykimit të gjykatës themelore ka arsye për caktimin ose heqjen e paraburgimit, (kur është deklaruar fajtor por është liruar nga dënimi ose është liruar nga akuza), Gjykata e Apelit merr aktvendim të posaçëm kundër të cilit nuk lejohet ankesë, (paragrafi 3 i nenit 403 i KPP).

Të gjitha vendimet e saj Gjykata e Apelit duhet t'i arsyetojë. Rrjedhimisht, në rastet e aktgjykimit apo të aktvendimit, Gjykata e Apelit bën vlerësimin e pretendimeve të ankesës dhe tregon shkeljet e ligjit të cilat i ka shqyrtuar sipas detyrës zyrtare. Kur aktgjykimi i gjykatës themelore anulohet për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në arsyetim shënohen dispozitat e shkelura dhe në çka kanë konsistuar shkeljet e tilla. Ndërkaq, kur aktgjykimi i gjykatës themelore anulohet për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, në arsyetim shënohen të metat në vërtetimin e gjendjes faktike apo arsyet përse provat dhe faktet e reja janë të rëndësishme dhe me ndikim në marrjen e vendimit të drejtë, (neni 404 i KPP).

Gjykata e Apelit mund të urdhërojë gjykatën themelore që të caktojë një tjetër gjyqtar të vetëm gjyqësor, kryetar të trupit gjyqësor ose trup gjyqësor sipas një sistemi të caktimit të lëndëve që të jetë objektiv dhe transparent, nëse Gjykata e Apelit vlerëson se gjyqtari i vetëm gjyqësor, kryetari i trupit gjyqësor ose trupi gjyqësor që e ka gjykuar rastin në mënyrë të vazhdueshme nuk e ka zbatuar ligjin siç duhet, ka vlerësuar shumë gabimisht provat ose moscaktimi i gjyqtarit apo trupit gjyqësor tjetër do të rezultonte në keqpërdorim të drejtësisë ose konflikt të interesit, (paragrafi 2 i nenit 398 i KPP).

Vendimi i Gjykatës së Apelit nënshkruhet nga të gjithë gjyqtarët e kolegjit, përveç aktvendimit të marrë me të cilin hedhet ankesa si e paafatshme ose e paraqitur nga personi i paautorizuar. Natyrisht, një anëtar i kolegjit mund të japë mendim të ndarë, mos pajtues ose pajtues për çështjet juridike ose faktike lidhur me ankesën dhe mendimi i tillë i bashkëngjitet vendimit kryesor, (paragrafi 4 i nenit 398 i KPP).

Pas zhvillimit të procedurës dhe marrjes së vendimit gjyqësor, Gjykata e Apelit ia kthen lëndën me të gjitha shkresat gjykatës themelore në numër të mjaftueshëm kopjesh të vërtetuara të vendimit të saj për t'ua dërguar palëve dhe personave të tjerë të interesuar. Në qoftë se i akuzuari është në paraburgim, Gjykata e Apelit ia dërgon vendimin dhe shkresat gjykatës themelore jo më vonë se 3 muaj nga dita e marrjes së shkresave nga kjo gjykatë, (neni 405 i KPP).

Procedura lidhur me ankesë në Gjykatën e Apelit

Kur Gjykata e Apelit pranon lëndën së bashku me ankesë, ajo si rregull i dorëzohet kryetarit të kolegjit të caktuar sipas orarit të saj. Kryetari i kolegjit, fillimisht ia procedon lëndën gjyqtarit raportues, i cili ka për detyrë ta studiojë lëndën, sidomos pretendimet e ankuesit, por ai është i detyruar që të zhvillojë edhe aktivitete tjera të cilat ndihmojnë në procedim të mëtutjeshëm të çështjes. Në këtë aspekt, gjyqtari raportues sipas nevojës mund të kërkojë nga gjykata e shkallës së parë raport për shkeljen e dispozitave të procedurës penale, e nëpërmjet kësaj gjykate ose në ndonjë mënyrë tjetër, të vërtetojë pohimet e ankuesit lidhur me provat dhe faktet e reja, ose i siguron raportet dhe dokumentet e nevojshme nga organet ose nga personat tjerë juridikë. Po ashtu, nëse i akuzuari është në paraburgim, gjyqtari raportues brenda 5 ditësh pas pranimit të shkresave të lëndës shqyrton sipas detyrës zyrtare nëse ende ekzistojnë arsyet për mbajtje në paraburgim të tij, (neni 389 i KPP). Pas kryerjes së detyrave të përcaktuara gjyqtari raportues e informon kryetarin e kolegjit, i cili sipas rregullit i ndërmer të gjitha masat e nevojshme për mbajtjen sa më parë të seancës së kolegjit. Në funksion të realizimit të këtij qëllimi, ai cakton datën e mbajtjes së seancës dhe ndërmer veprime të tjera të nevojshme.

Në të vërtetë Gjykata e Apelit merr vendim në seancë të kolegjit ose në shqyrtim gjyqësor. Se a do të vendosë në seancë të kolegjit apo në shqyrtim vendoset në seancën e kolegjit. Kur vepra penale ndiqet sipas detyrës zyrtare për seancë të kolegjit ftohen: prokurori kompetent i shtetit, i dëmtuari, i akuzuari dhe mbrojtësi i tij. Kur i akuzuari gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit dhe dëshiron të merr pjesë në seancë, kjo duhet mundësuar atij, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 390 të KPP). Përndryshe, mospjesëmarrja e palëve të thirrura me rregull nuk pengon mbajtjen e seancës së kolegjit. Rrjedhimisht, kur i akuzuari nuk e ka njoftuar gjykatën për ndërrimin e adresës ose të vendqëndrimit, seanca e kolegjit mund të mbahet edhe pa njoftimin e të akuzuarit, (paragrafi 4 i nenit 390 i KPP).

Seanca e kolegjit fillon me raportimin e gjyqtarit raportues përkitazi me faktet. Parimisht, kolegj i mund të kërkojë nga palët dhe mbrojtësi që të prezantojnë në seancë sqarime të nevojshme lidhur me pretendimet e tyre në ankesë. Palët dhe mbrojtësi

mund të propozojnë që për plotësim të raportit të lexohet ndonjë shkresë dhe mund të japin shpjegime të nevojshme për qëndrimet e tyre në ankesë apo përgjigje në ankesë pa përsëritur përmbajtjen e raportit, (paragrafi 3 i nenit 390 i KPP). Përndryshe, edhe në seancën e kolegjit vlen parimi i publicitetit, përveç rasteve të përcaktuara me Kodin e Procedurës Penale, si dhe hartohet procesverbal i cili i bashkëngjitet shkresave të lëndës.

Pas dëgjimit të raportit dhe propozimeve eventuale të palëve, kolegji ankimor e mbyll seancën dhe tërhiqet në seancë jopublike në të cilën merr vendim lidhur me ankesën dhe aktgjykimin e ankimuar.

Siç u theksua më lart, në seancën e kolegjit vendoset që Gjykata e Apelit të zhvillojë shqyrtim gjyqësor ose që çështjen e tillë ta vendosë në kolegji. Si rregull, Gjykata e Apelit vendosë të mbaj shqyrtim gjyqësor vetëm atëherë kur është e nevojshme që për shkak të vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike, duhet të merren prova të reja ose të përsëriten provat e marra më parë, dhe kur ekzistojnë shkaqe të arsyeshme që lënda të mos i kthehet gjykatës themelore në rigjykim, (paragrafi 1 i nenit 392 i KPP).

Në shqyrtim të Gjykatës së Apelit thirren i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, prokurori i shtetit, i dëmtuari, përfaqësuesi ligjor dhe përfaqësuesi i autorizuar i të dëmtuarit si dhe dëshmitarët dhe ekspertët të cilët gjykata me propozim të palëve apo sipas detyrës zyrtare vendos t'i pyes. Në qoftë se i akuzuari gjendet në paraburgim ose në mbajtje të dënimit, kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Apelit ndërmerr masat e nevojshme për të siguruar praninë e të akuzuarit në shqyrtim, (paragrafi 2 dhe 3 i nenit 392 i KPP). Shqyrtimi në shkallë të dytë nuk është përsëritje e thjeshtë e shqyrtimit gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë. Si konkludim, gjykata e tillë duhet të orientohet në administrimin e atyre provave në saktësinë e të cilave dyshon.

Edhe shqyrtimi gjyqësor para Gjykatës së Apelit fillon me raportimin e gjyqtarit raportues i cili në fjalën e tij prezanton gjendjen faktike, por pa dhënë mendimin e tij për bazueshmërinë e ankesës. Pas kësaj, me propozim të palëve ose sipas detyrës zyrtare, lexohet aktgjyrimi ose pjesa e tij që është atakuar me ankesë, dhe sipas nevojës edhe procesverbali i shqyrtimit gjyqësor. Me të përfunduar kryerja e këtyre veprimeve procedurale, thirret ankuesi që ta arsyetojë ankesën e pastaj thirret pala kundërshtarë që t'i prezantojë përgjigjet asaj. Të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij në shqyrtimin gjyqësor të Gjykatës së Apelit, kuptohet për arsye të njëjta me ato që vlejnjë në gjykatën themelore, gjithmonë fjala i jepet në fund. Përndryshe palët gjatë shqyrtimit mund të paraqesin prova dhe fakte të reja, përfshirë provat dhe faktet të cilat nuk i kanë prezantuar më parë gjatë zhvillimit të procedurës penale në gjykatën themelore ose me rastin e paraqitjes së ankesës. Varësisht nga rezultati i shqyrtimit gjyqësor, prokurori i shtetit mund të tërhiqet plotësisht apo pjesërisht nga akuza ose atë ta ndryshojë në dobi të të akuzuarit, (neni 393 i KPP).

Duke i përfshirë rastet e lartcekura, dispozitat për shqyrtimin gjyqësor në gjykatën e shkallës së parë, përshtatshëmërisht zbatohen në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë, (neni 414 i KPP).

Rigjykimi i çështjes penale nga gjykata themelore

Gjykata themelore, pas pranimit të vendimit të Gjykatës së Apelit me të cilin është prishur aktgjykimi i kësaj të parës, dhe pranimit edhe të shkresave tjera të lëndës, hap shqyrtimin gjyqësor dhe procedon sipas aktakuzës së mëparshme. Megjithatë, kur aktgjykimi i gjykatës themelore është anuluar vetëm pjesërisht, gjykata themelore do të procedojë sipas pjesës së aktakuzës e cila ka të bëjë me pjesën e anuluar të aktgjykimit. Në shqyrtimin e ri gjyqësor, palët kanë të drejtë të prezantojnë fakte dhe prova të reja, pavarësisht nga ajo se sipas kërkesës së cilës palë është prishur aktgjykimi i mëparshëm. Po ashtu, gjykata themelore në rigjykim i ndërmerr të gjitha veprimet procedurale dhe shqyrton të gjitha çështjet kontestuese të theksuara në vendimin e Gjykatës së Apelit, (paragrafët 1-3 të nenit 406 të KPP). Mirëpo, është me rëndësi të theksohet se pas zbatimit të veprimeve procedurale të sugjeruara nga Gjykata e Apelit, gjykata themelore merr aktgjykim në mënyrë të pavarur. Pra, Gjykata e Apelit nuk mund t'i urdhërojë gjykatës themelore çfarë vendimi duhet të merr në rastin konkret. Për këtë kjo gjykatë nuk ka nevojë t'ia kthej lëndën gjykatës themelore ngase ajo për këtë mund të vendosë vet. Deri te rigjykimi mund të vijë edhe në rastet kur aktgjykimi priset sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik.

Duhet theksuar faktin se me rastin e marrjes së aktgjykimit të ri, gjykata themelore është e lidhur me ndalesën reformatio in peius, (paragrafi 4 i nenit 406 i KPP).

Më në fund, nëse i akuzuari është në paraburgim, kolegji i gjykatës themelore pasi të kalojnë 2 muaj nga aktvendimi i fundit për paraburgim, edhe pa propozimin e palëve shqyrton nëse ekzistojnë apo jo arsyet për këtë masë të sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurë penale, dhe në varësi të këtij vlerësimi, merr aktvendim për zgjatjen apo heqjen e tij, gjithnjë duke respektuar dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale, (paragrafi 5 i nenit 406 i KPP).

Beneficium cohaesionis dhe reformatio in peius

Beneficium cohaesionis dhe reformatio in peius përfaqësojnë institute juridike të cilat janë paraparë në interes të të akuzuarit. Ato janë ngushtësisht të lidhura me mjetet juridike dhe ofrojnë garanci të caktuara të mbrojtjes së interesave të të akuzuarit në një fazë të ndjeshme të procedurës penale.

Beneficium cohaesionis, përkatësisht beneficioni i bashkëngjitjes konsiston në detyrimin e gjykatës që përshtatshmëritë për të cilat ka konstatuar se ekzistojnë për të akuzuarin i cili ka përdorur mjetin juridik, t'i zbatojë edhe ndaj të akuzuarve të tjerë edhe pse ata nuk kanë paraqitur mjet juridik ose jo në atë aspekt. Zgjidhja e tillë është përfshirë në mënyrë shumë të kompletuar edhe në Kodin e Procedurës Penale. Kështu, sipas nenit 397 të këtij Kodi, kur me rastin e paraqitjes së ankesës të cilitdo të akuzuar, Gjykata e Apelit çmon se arsyet për të cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit, e që nuk janë të natyrës personale, shkojnë në dobi edhe të ndonjërit nga të bashkakuzuarit i cili nuk ka paraqitur ankesë ose atë nuk e ka paraqitur në atë aspekt, vepron sipas detyrës zyrtare sikurse ankesa e tillë të ishte paraqitur nga i bashkakuzuari.

Siç shihet beneficium cohaesionis vjen në shprehje te koneksiteti i veprave penale. Kështu, nëse shumë persona janë përfshirë me një procedurë penale unike dhe ndaj tyre është dhënë një aktgjykim, instituti i bashkëngjitjes vjen në shprehje po që se ndonjëri nga të akuzuarit me sukses ushtron ankesë kundër atij aktgjykimi. Vlen të theksohet fakti se ky institut është në funksion të sigurimit të barazisë së qytetarëve para ligjit.

Ndalesa reformatio in peius, përkatësisht moskeqësimi i pozitës së të pandehurit është institut i cili gjithashtu është instaluar në favor të të akuzuarit. Ky institut mundëson që në rastet kur ankesa paraqitet vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimin nuk guxon të ndryshohet në dëm të tij. Në të vërtetë, sipas nenit 395 të Kodit të Procedurës Penale, në qoftë se ankesa është paraqitur vetëm në dobi të të akuzuarit, aktgjykimin për sa i përket cilësimit juridik të veprës penale dhe sanksionit penal, nuk mund të ndryshohet në dëm të tij. Një zgjidhje e tillë nuk e pengon gjykatën që të merret me vërtetimin e fakteve që janë më të favorshme për të akuzuarin, por vetëm ndalon çdo ndryshim i cili ka të bëjë me cilësimin juridik të veprës ose dhe të dënimit me të cilin do të keqësohej pozita e të akuzuarit në krahasim me aktgjykimin që atakohet me ankesë.

Ky institut është vendosur me synimin që t' i sigurojë të akuzuarit liri në përcaktimin e tij për paraqitje të ankesës kundër vendimeve që ai i çmon të padrejta dhe të paligjshme. Kjo ndalesë ka karakter absolut, ngase kur njëherë krijohen kushtet për zbatimin e saj, ajo vlen deri në përfundim të procedurës penale në atë çështje penale.

Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit

Si rregull, me marrjen e aktgjykimit nga Gjykata e Apelit, konsiderohet se çështja penale është çështje e gjykuar, sepse aktgjykimin në parim e fiton formën e prerë. Megjithatë, ligdhënësi ka lejuar mundësinë që në disa raste të caktuara, procedura penale të zhvillohet edhe në shkallë të tretë. Në këtë aspekt, sipas paragrafi 1 të nenit 407 të Kodit të Procedurës Penale, ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet vetëm në rastet kur Gjykata e Apelit e ndryshon aktgjykimin lirues të gjykatës themelore dhe e zëvendëson me aktgjykim dënues për të akuzuarin ose kur me aktgjykimin e Gjykatës Themelore ose Gjykatës së Apelit, të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burg të përjetshëm.

Ankesa kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit mund të paraqitet sipas të gjitha bazave për të cilat mund të ushtrohet ankesë. Mbi ankesën e tillë vendosë Gjykata Supreme e Kosovës. Ajo vendosë në seancë të kolegjit të gjyqtarëve sipas dispozitave që vlejnjë për procedurë të apelit në Gjykatën e Apelit, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 407 të KPP).

Aktgjykimet e Gjykatës Supreme të Kosovës nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e kolegjit. Një anëtar i kolegjit edhe këtu mund të paraqesë mendim të ndarë, mospajtues ose pajtues mbi ndonjë çështje ligjore ose faktike që lidhet me ankesën, i cili i bashkëngjitet aktgjykimit, (paragrafi 3 i nenit 407 i KPP).

Ankesa kundër aktvendimit

Ngjashëm si te aktgjykimi edhe ankesa kundër aktvendimit përfaqëson mjet të rregullt juridik i cili është në funksion të pengimit të mundësisë që aktvendimi kundër të cilit ushtrohet, në përmbajtjen e dhënë të fitojë formën e prerë.

Në lidhje me ankesën kundër aktvendimeve ligjdhënësi ka paraparë zgjidhjet sipas të cilave, për një grup aktvendimesh lejon mundësinë e atakimit me ankesë, kurse për grupin tjetër këtë mundësi e përjashton. Sa i përket kësaj çështje, me nenin 408 të Kodit të Procedurës Penale, janë parashikuar këto zgjidhje:

1. Kundër aktvendimeve të gjyqarit të procedurës paraprake si dhe kundër aktvendimeve tjera të gjykatës themelore, palët dhe personat tjerë të drejtat e të cilëve janë shkelur, mund të paraqesin ankesë, përveç kur me dispozitat e këtij Kodi shprehimisht nuk lejohet ankesë e tillë;

2. Kundër aktvendimit të marrë në procedurë paraprake nga kolegji shqyrtues i përbërë prej tre gjyqtarëve, nuk lejohet ankesë, me përjashtim të rasteve kur ky Kod parasheh zgjidhje tjetër;

3. Aktvendimet që merren për përgatitjen e shqyrtimit gjyqësor dhe të aktgjykimit mund të ankimohen vetëm me ankesë kundër aktgjykimit, përveç kur me këtë Kod është paraparë ndryshe dhe

4. Kundër aktvendimeve të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk lejohet ankesë.

Rrethi i subjekteve që mund të paraqesin ankesë kundër aktvendimit është shumë më i gjerë se sa te ankesa kundër aktgjykimit. Deri te ky konkludim vihet për shkak se përveç personave që kanë të drejtë të paraqesin ankesë kundër aktgjykimit, në lidhje me aktvendimin ankesë mund të paraqesin edhe personat tjerë të drejtat e të cilëve preken me rastin e shqiptimit të tij. Kështu, kundër aktvendimeve të caktuara ankesë mund të paraqesë edhe dëshmitari, eksperti, përkthyesi apo edhe personi tjetër.

Ankesa kundër aktvendimit mund të paraqitet sipas po të njëjtave baza për të cilat paraqitet ankesë edhe kundër aktgjykimit. Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka marrë aktvendimin dhe ajo, me përjashtim të rasteve kur me Kodin e Procedurës Penale parashihet ndryshe, paraqitet në afatin prej 3 ditësh nga dita e dorëzimit të aktvendimit, (neni 409 i KPP). Mirëpo te disa aktvendime afati është më i shkurtër ose më i gjatë. I tillë është aktvendimi mbi caktimin e paraburgimit, kundër të cilit ankesa duhet të paraqitet brenda 24 orëve nga momenti i pranimit të aktvendimit.

Ankesa kundër aktvendimit, me përjashtim të rasteve kur Kodi i Procedurës Penale parasheh ndryshe, ka karakter suspenziv, (neni 410 i KPP) dhe devolutiv. Së këndejmi, ka rastet kur ankesa e tillë nuk i ka këto karakteristika. Rrjedhimisht, ankesa kundër aktvendimit të gjyqarit të procedurës paraprake mbi caktimin e paraburgimit nuk e pezullon ekzekutimin e tij,

Konform paragrafit 1 të nenit 415 të Kodit të Procedurës Penale aktvendimi i gjyqarit të procedurës paraprake, gjyqarit të vetëm gjykues, kryetarit të trupit gjykues ose trupit gjykues mund të ankimohet kur ai shkel:

1. Të drejtën e cila i njihet palës me Kushtetutën e Republikës së Kosovës;

2. Të drejtën thelbësore të palës të paraparë me këtë Kod;
3. Të drejtën thelbësore të palës të paraparë me ndonjë ligj tjetër të Kosovës dhe
4. Të drejtën procedurale që ka për qëllim garantimin e të drejtës së palës të garantuar me Kushtetutë, me këtë Kod ose me ndonjë ligj tjetër.

Mbi ankesën e ushtruar kundër aktvendimeve të gjykatës themelore dhe të Gjykatës së Apelit, përveç nëse me Kodin e Procedurës Penale është paraparë ndryshe, vendosin kolegjet përkatëse shqyrtuese dhe të njëjtat duhet të arsyetohen.

Që ankesa e parashtruar kundër aktvendimit të mund të shqyrtohet duhet që pala e cila kundërshton atë të demonstrojë se shkelja e së drejtës së pretenduar i shkakton asaj dëm të parevokueshëm, (paragrafi 2 i nenit 415 i KPP).

Kur vendoset mbi ankesën gjykata me aktvendim mund ta hedh ankesën si të paafatshme ose të papranueshme, ta refuzojë si të pabazë, ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktvendimin ose ta anulojë dhe sipas nevojës çështjen ta kthejë për rivendosje. Kur vendosë mbi ankesën kundër aktvendimit me të cilin hedhet aktakuza, gjykata mund të marrë aktgjykim refuzues nëse mëson se për aktgjykim të tillë ka arsye. Gjatë shqyrtimit të ankesës së ushtruar kundër aktvendimit, gjykata sipas detyrës zyrtare vlerëson nëse gjykata themelore ka pasur kompetencë lëndore për marrje të aktvendimit të tillë dhe nëse ai është marrë nga ana e organit të autorizuar, (neni 416 i KPP).

Mjetet e jashtëzakonshme juridike

Me marrjen e vendimit në Gjykatën e Apelit, gjegjësisht në Gjykatën Supreme të Kosovës për rastet shprehimisht të parashikuara me Kodin e Procedurës Penale, vendimi gjyqësor fiton formën e prerë. Si rregull, vendimi gjyqësor i formës së prerë është definitiv dhe i pandryshueshëm. Mirëpo, meqenëse ekziston mundësia që një çështje juridike e gjykuar në formë të prerë të mos jetë e gjykuar drejt, për shkak se gabimisht janë vërtetuar faktet dhe provat, apo janë paraqitur fakte dhe prova të reja nga të cilat shihet qartë se gjendja faktike nuk është vërtetuar drejt, ose për arsye se gjykata në gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht ka aplikuar Kodin Penal, ose për arsye se rrethanat e reja, për ekzistimin e të cilave gjykata ka mësuar me vonesë, ose ato janë paraqitur më vonë, tregojnë se gjykata, duke vepruar në kufijtë e ligjit, ka shqiptuar dënim tepër të ashpër. Në këtë aspekt, përkundër faktit se çështja e gjykuar konsiderohet si gjendje faktike e vërtetuar drejtë dhe e gjykuar sipas ligjit, e me qëllim që të pengohet zbatimi i vendimeve me të meta të caktuara, Kodi i Procedurës Penale përjashtimisht lejon mundësinë e atakimit të aktgjykimit të formës së prerë me mjete të jashtëzakonshme juridike. Atakimi i aktgjykimit me mjet juridik të jashtëzakonshëm mund të bëhet për shkak të lajthimeve të natyrës faktike dhe të gabimeve juridike.

Mjete të jashtëzakonshme juridike janë: rishikimi i procedurës penale, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Rishikimi i procedurës penale

Rishikimi i procedurës penale është mjet i jashtëzakonshëm juridik përmes të cilit mund të goditen vendimet gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë.

Në kuptim të gjerë, me rishikim të procedurës penale kuptohet shqyrtimi edhe një herë i çështjes penale të përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë me qëllim modifikimi ose shfuqizimi. Si rregull, ai bëhet për shkaqe të caktuara, të lidhura me bazueshmërinë e aktgjykimit, në ligj e në fakte. Rishikimi i procedurës penale mund të paraqitet:

1. Kundër aktvendimit me të cilin është pushuar procedura penale ose

2. Kundër aktgjykimit në rastet kur vlerësohet se me të gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë plotë dhe të drejtë.

Si rregull, për të ardhur deri te rishikimi i procedurës penale duhet të paraqiten fakte dhe prova të reja. Këto prova e fakte duhet të kenë të bëjnë me esencën e çështjes penale dhe për to gjykata nuk duhet të ketë ditur se ekzistojnë ose që ato të jenë shfaqur më vonë. Rishikimi i procedurës penale mund të rezultojë në tri forma:

Si vazhdim i procedurës penale;

Si rishikim jo i drejtë i procedurës penale dhe

Si rishikim i drejtë i procedurës penale.

Vazhdimi i procedurës penale. Konform nenit 421, në lidhje me nenin 253 dhe paragrafin 1 nënparagrafin 2 të nenit 358 të Kodit të Procedurës Penale, procedura penale e pushuar me aktvendim për shkak të ekzistimit të pengesave të caktuara të cilat sjellin deri te hedhja e akuzës në seancë për shqyrtimin e aktakuzës ose në shqyrtim gjyqësor mund të vazhdohet posa të eliminohen ato pengesa. Në fakt, kur në mungesë të kompetencës lëndore aktakuza hedhet me aktvendim të formës së prerë, me kërkesë të prokurorit të autorizuar procedura për çështjen e tillë vazhdohet në gjykatën kompetente, (neni 421 i KPP).

Rishikimi jo i drejtë i procedurës penale. Kjo formë e rishikimit të procedurës penale mundëson që aktgjykimi i formës së prerë të ndryshohet pa u zhvilluar veprimet procedurale të cilat në të vërtetë e karakterizojnë rishikimin e rregullt apo standard të procedurës penale. Sipas paragrafit 1 të nenit 420 të Kodit të Procedurës Penale, aktgjykimi i formës së prerë mund të ndryshohet edhe pa përsëritje të procedurës penale, në rastet kur:

1. Në dy ose më shumë aktgjykime të të njëjtit person të dënuar janë shqiptuar në formë të prerë disa dënime pa i zbatuar dispozitat për shqiptimin e dënimit unik për vepra penale në bashkim;

2. Me rastin e shqiptimit të dënimit unik sipas dispozitave për vepra penale në bashkim, dënimi i përfshirë në dënimin unik sipas një aktgjykimi të mëparshëm për vepra penale në bashkim, gjithashtu është marrë parasyshe ose

3. Aktgjykimi i formës së prerë me të cilin për disa vepra penale është shqiptuar dënimi unik, pjesërisht nuk mund të ekzekutohet për shkak të amnistisë, faljes ose për shkaqe të tjera.

Në situatat kur vlerësohet se ekziston ndonjëri nga rastet e lartcekura, me propozim të prokurorit të shtetit, kur procedura është filluar me kërkesën e tij ose të të akuzuarit, por pas dëgjimit të palës kundërshtare, gjykata në seancë të kolegjit me aktgjykim të ri ndryshon aktgjykimin e mëparshëm për dënimet e shqiptuara dhe shqipton dënim unik, (paragrafi 5 i nenit 420 i KPP).

Marrja e aktgjykimit të ri në rastet kur dy ose më shumë aktgjykime ndaj të njëjtit person të dënuar janë shqiptuar në formë të prerë pa i zbatuar dispozitat mbi shqiptimin e dënimit unik për vepra penale në bashkim, është kompetencë e gjykatës themelore që e ka gjykuar çështjen në të cilën ka shqiptuar llojin më të rëndë të dënimit. Kur janë shqiptuar dënime të llojit të njëjtë, aktgjykimin e ri e merr gjykata e cila ka shqiptuar dënimin e fundit, (paragrafi 2 i nenit 420 i KPP).

Në rastet kur gjatë shqiptimit të dënimit unik sipas veprave penale në bashkim, dënimi i përfshirë në dënimin unik sipas një aktgjykimi të mëparshëm për vepra penale në bashkim, gjithashtu është marrë parasysh, aktgjykimin e ndryshon gjykata e cila me rastin e shqiptimit të dënimit unik gabimisht ka përfshirë dënimin i cili është përfshirë në ndonjë aktgjykim të mëparshëm, (paragrafi 3 i nenit 420 i KPP).

Kurse, në rastet kur aktgjykimi i formës së prerë me të cilin për disa vepra penale është shqiptuar dënim unik, pjesërisht nuk mund të ekzekutohet për shkak të amnistisë, faljes ose për shkaqe të tjera, gjykata themelore që ka gjykuar çështjen e ndryshon aktgjykimin e mëparshëm sa i përket dënimit dhe shqipton dënim të ri, ose vendosë cila pjesë e dënimit të shqiptuar me aktgjykim të mëparshëm duhet ekzekutuar, (paragrafi 4 i nenit 420 i KPP).

Gjatë shqiptimit të dënimit unik në rastet kur janë marrë parasysh aktgjykimet e më shumë gjykatave, kopja e vërtetuar e aktgjykimit të ri të formës së prerë duhet gjithsesi t' u dërgohet gjykatave të tilla, (paragrafi 6 i nenit 420 i KPP).

Rishikimi i drejtë i procedurës penale. Ky lloj rishikimi vjen në shprehje në rastet kur procedura penale ka përfunduar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Rrjedhimisht, procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, konform paragrafit 1 të nenit 423 të Kodit të Procedurës Penale, mund të rishikohet vetëm në rastet kur:

1. Provohet se aktgjykimi është mbështetur në dokument të falsifikuar ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose të përkthyesit;

2. Provohet se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore;

3. Zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja të cilat vet ose së bashku me provat e mëparshme ka të ngjarë të arsyetojë fajësinë e personit të dënuar ose dënimin e tij sipas një dispozite më të butë penale;

4. Personi për të njëjtën veprë është gjykuar disa herë ose kur disa persona janë dënuar për veprë të njëjtë të cilën ka mundur ta kryejë vetëm një person ose disa prej tyre;

5. Në rastin e dënimit të veprës penale të vazhduar ose veprave penale tjera të cilat sipas ligjit përfshijnë disa veprime të njëjta ose të ndryshme, zbulohen fakte të reja ose paraqiten prova të reja që tregojnë se i dënuari nuk ka kryer veprimin që është përfshirë në veprën penale për të cilën ai është dënuar dhe ekzistimi i fakteve të tilla do të ishte me ndikim vendimtar në caktimin e dënimit.

Procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet vetëm në favor të të pandehurit, përveç nëse vërtetohet se rrethanat e lartcekura janë pasojë e veprës penale të kryer nga i pandehuri ose agjenti i tij kundër një dëshmitari, eksperti, përkthyesi, prokurorit të shtetit apo gjyqtarit ose të afërmit të tyre, me ç`rast procedura penale e përfunduar me aktgjykim të formës së prerë mund të rishikohet kundër të pandehurit. Mirëpo, rishikimi i procedurës penale në dëm të të pandehurit lejohet vetëm brenda 5 vjetëve nga koha e shpalljes së aktgjykimit të formës së prerë, (paragrafi 2 i nenit 423 i KPP).

Në rastet kur provohet se aktgjykimi është bazuar në dokument të falsifikuar, ose në deklaram të rremë të dëshmitarit, ekspertit ose të përkthyesit ose se aktgjykimi është pasojë e veprës penale të kryer nga gjyqtari ose personi që ka ndërmarrë veprimet hetimore ose se rrethanat e lartcekura janë pasojë e veprës penale të kryer nga i pandehuri ose agjenti i tij kundër dëshmitarit, ekspertit, përkthyesit, prokurorit, gjyqtarit, gjyqtarit laik ose të afërmit të tyre, me aktgjykimin e formës së prerë duhet vërtetuar se personat e tillë janë shpallur fajtorë për veprat penale përkatëse. Në rastet kur procedura kundër këtyre personave nuk mund të zbatohet për shkak se ata kanë vdekur ose ekzistojnë rrethana të cilat përjashtojnë ndjekje penale, faktet e lartcekura mund të vërtetohen edhe me prova të tjera, (paragrafi 3 i nenit 423 i KPP).

Rrjedhimisht, procedura penale e pushuar në formë të prerë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor mund të rishikohet kur prokurori i shtetit tërhiqet nga aktakuza dhe vërtetohet se tërheqja është pasojë e veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare nga ana e tij. Po ashtu, kur aktakuza hedhet bazuar në mungesë provash të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprën penale të përshkruar në aktakuzë dhe nëse zbulohen dhe mblidhen fakte dhe prova të reja, mund të ngritet aktakuzë e re kur kolegji shqyrtues vendosë se provat dhe faktet e reja e arsyetojnë këtë, (neni 422 i KPP).

Rishikimin e procedurës penale mund ta kërkojnë palët dhe mbrojtësi. Pas vdekjes së personit të dënuar, rishikimin mund ta kërkojë prokurori i shtetit, bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor, farefisi në vijë të drejtë deri në shkallë të parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit. Rishikimi mund të kërkohej edhe pasi i dënuari ta ketë mbajtur dënimin, pavarësisht nga afati i parashkrimit, amnistisë ose faljes. Rrjedhimisht, kur gjykata e cila është kompetente për të vendosur për rishikimin e procedurës penale mëson se ekzistojnë shkaqe për rishikim të procedurës, për këtë pa vonesë duhet të njoftojë të dënuarin apo personin tjetër të autorizuar për paraqitje të kërkesës, (neni 424 i KPP).

E DREJTA E PROCEDURES PENALE

Kërkesa për rishikimin e procedurës penale mund të paraqitet brenda 2 vjetëve nga aktgjykimi i formës së prerë ose aktvendimi i formës së prerë për pushimin e procedurës penale, (paragrafi 1 i nenit 418 i KPP) dhe për të vendoset nga kolegji shqyrtues i gjykatës themelore i cili ka gjykuar çështjen në procedurën e mëparshme. Në këto raste, në përbërje të kolegjit nuk lejohet të merr pjesë gjyqtari i cili ka marrë pjesë në marrjen e aktgjykimit në procedurën e mëparshme, (paragrafët 1 dhe 3 të nenit 425 të KPP).

Në kërkesë duhet shënuar bazën ligjore sipas së cilës kërkohet rishikimi si dhe provat me të cilat argumentohen faktet në të cilat mbështet kërkesa. Nëse kërkesa nuk i përmban këto të dhëna, gjykata e thërret parashtruesin që brenda afatit të caktuar, të plotësojë kërkesën, (paragrafi 2 i nenit 425 i KPP).

Sipas paragrafit 1 të nenit 426 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata me aktvendim e hedh kërkesën kur në bazë të saj dhe shkresave të lëndës nga procedura e mëparshme e zhvilluar, vërteton se:

1. Kërkesën e ka parashtruar personi i paautorizuar;
2. Nuk ka bazë ligjore për rishikim të procedurës;
3. Faktet dhe provat në të cilat mbështetet kërkesa janë paraqitur në kërkesën e mëparshme për rishikim të procedurës e cila është refuzuar me aktvendim të formës së prerë;
4. Faktet dhe provat nuk ofrojnë arsye për lejim të rishikimit të procedurës ose
5. Parashtruesi i kërkesës në kërkesën e tij nuk ka shënuar bazën sipas së cilës kërkohet rishikimi dhe provat me të cilat argumentohen faktet në të cilat e mbështet kërkesën.

Kur gjykata nuk e hedh kërkesën, kopja e saj i dërgohet palës kundërshtare e cila ka të drejtë që brenda 8 ditëve të përgjigjet në kërkesë. Pasi gjykata të merr përgjigje në kërkesë ose kur kalon afati për paraqitjen e përgjigjes, kryetari i kolegjit shqyrtues urdhëron gjurmimin dhe shqyrtimin e fakteve dhe provave të paraqitura në kërkesë dhe në përgjigje të saj, (paragrafi 2 i nenit 426 i KPP).

Pas marrjes së shkresave nga prokurori i shtetit si dhe të mendimit të tij në lidhje me çështjen, gjykata bazuar në rezultatet e hetimit e aprovon kërkesën dhe lejon rishikimin e procedurës penale ose e refuzon atë. Në aktvendim me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale, gjykata urdhëron caktimin e menjëhershëm të shqyrtimit të ri ose kthimin e çështjes në fazën e hetimit, apo fillimin e hetimit kur ai nuk është zbatuar më parë. Kur gjykata çmon se shkaqet për të cilat ka lejuar rishikimin e procedurës janë edhe në dobi të ndonjërit nga të bashkakuzuarit i cili nuk ka paraqitur kërkesë për rishikim të procedurës, vepron sipas detyrës zyrtare sikur kërkesa e tillë të ishte paraqitur, (paragrafët 1-3 të nenit 427 të KPP).

Konform paragrafit 4 të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, gjykata urdhëron që ekzekutimi i aktgjykimit të shtyhet ose të ndërpritet nëse, bazuar në provat e paraqitura çmon se:

1. I dënuari në procedurë të përsëritur mund të dënohet me dënim të tillë që pas llogaritjes së dënimit të mbajtur do të duhej të lirohet;

2. I dënuari mund të lirohet nga akuza ose

3. Akuza e ngritur kundër personit të tillë mund të refuzohet.

Kur aktvendimi me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale merr formë të prerë, pushohet ekzekutimi i vendimit, megjithatë nëse ekzistojnë kushtet për caktimin e paraburgimit, gjykata mund ta ndërmarrë aktvendimin përkatës që adreson këtë çështje, (paragrafi 5 i nenit 427 i KPP).

Në procedurën e re që zbatohet në bazë të aktvendimit me të cilin lejohet rishikimi i procedurës penale vlejnë dispozitat e njëjta si ato të procedurës penale të ashtuquajtur të rregullt, me përjashtim se në procedurën e re gjykata nuk detyrohet me aktvendimet e marra në procedurën e mëparshme, (paragrafi 1 i nenit 428 i KPP).

Në qoftë se procedura e re pushohet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, aktgjykimi i mëparshëm anulohet me aktvendim mbi pushimin e procedurës, (paragrafi 2 i nenit 428 i KPP).

Duhet theksuar faktin se me rastin e marrjes së aktgjykimit të ri, gjykata anulon aktgjykimin e mëparshëm apo vetëm një pjesë të tij, ose e lë në fuqi aktgjykimin e mëparshëm. Në dënimin e shqiptuar me aktgjykim të ri gjykata të akuzuarit ia llogaritë dënimin e mbajtur, e kur lejohet rishikimi vetëm për ndonjë vepër për të cilën i akuzuari ka qenë dënuar ose liruar, gjykata shqipton dënim të ri unik sipas dispozitave përkatëse të Kodit Penal, (paragrafi 3 i nenit 428 i KPP).

Më në fund, duhet theksuar se gjykata edhe në procedurën e re detyrohet me ndalesën reformatio in peius, (paragrafi 4 i nenit 428 i KPP).

Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit

Me kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit kërkohet që aktgjykimi i formës së prerë të ndryshohet për sa i përket vendimit mbi dënim. Së këndejmi, ky mjet juridik mund të paraqitet nëse pas formës së prerë të aktgjykimit paraqiten rrethana të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në shqiptimin e dënimit më të butë. Megjithëse rrethanat që mund të sjellin deri te zbutja e dënimit janë të shumta, është e evidente se çdo rrethanë megjithatë nuk sjell favore të kësaj natyre. Si rrethana që mund të sjellin deri te zbutja e dënimit të formës së prerë mund të jenë: sëmundja e rëndë e të dënuarit, gjendja e vështirë familjare etj. Në fakt, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund të ushtrohet vetëm në dobi të të dënuarit.

Kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund ta paraqesë prokurori i shtetit kur procedura penale është zhvilluar me kërkesë të tij, i dënuari dhe mbrojtësi i tij. Kjo kërkesë si rregull nuk sjell deri te pezullimi i ekzekutimit të dënimit, (neni 430 i KPP).

Kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit personat e autorizuar mund ta paraqesin në çdo kohë gjatë periudhës së mbajtjes së dënimit, por jo në rastet kur kanë

mbetur 6 muaj e më pak deri në përfundimin e dënimit me burgim, (paragrafi 2 i nenit 418 i KPP).

Kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit i paraqitet gjykatës themelore e cila fillimisht e ka marrë aktgjykimin. Në këtë gjykatë, së pari kërkesa i dërgohet gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues i cili e ka gjykuar lëndën në shkallë të parë, me ç'rast ai do të merret me konstatimin e faktit nëse kërkesa i përmban të dhënat e nevojshme, përfshirë përshkrimin e bazës ligjore dhe të fakteve të rëndësishme. Në këtë drejtim, kur ai konstaton se kërkesa nuk i përmban të dhënat e tilla atëherë ai e hedh poshtë atë. Nëse kërkesa nuk i përmban këto mangësi, në vazhdim nga gjykata themelore do të verifikohet fakti nëse ekzistojnë shkaqet për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe pas dëgjimit të prokurorit të shtetit nëse procedura është zbatuar sipas detyrës zyrtare, dhe personit të dënuar ose mbrojtësit të tij, shkresat me propozimin e arsyetuar i dërgohen Gjykatës Supreme të Kosovës e cila do të marrë vendimin definitiv lidhur me kërkesën e tillë, (paragrafët 1-4 të nenit 431 të KPP).

Rrjedhimisht, Gjykata Supreme e Kosovës refuzon kërkesën kur çmon se nuk ka bazë ligjore për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit. Në të kundërtën ajo e aprovon kërkesën, me ç'rast me aktvendim e ndryshon aktgjykimin e formës së prerë lidhur me vendimin mbi dënimin, (paragrafi 6 i nenit 431 i KPP).

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet kundër vendimit të formës së prerë ose kundër procedurës gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë. Së këndejmi, konform paragrafit 1 të nenit 432 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet në rastet vijuese:

1. Në rast të shkeljes së Kodit Penal;
2. Në rast të shkeljes esenciale absolute të dispozitave të procedurës penale ose
3. Në rast të shkeljeve të tjera (relative) esenciale të dispozitave të procedurës penale kur shkeljet e tilla kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Me gjithë faktin e numërimit taksativ të shkaqeve për të cilat mund të paraqitet kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, ligdhënësi ia njeh të drejtën Kryeprokurorit të Shtetit që këtë kërkesë ta paraqesë edhe për shkelje të tjera të ligjit. Përjashtimisht, kjo kërkesë mund të paraqitet edhe gjatë procedurës penale e cila nuk ka përfunduar në formë të prerë, por vetëm kundër vendimeve të formës së prerë lidhur me caktimin ose vazhdimin e paraburgimit, (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 432 të KPP).

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të paraqitet për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, e as kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës me të cilin është vendosur për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, (paragrafi 2 i nenit 432 i KPP).

Kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqesë Kryeprokurori i Shtetit, i pandehuri dhe mbrojtësi i tij. Pas vdekjes së të pandehurit, kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në emër të tij, mund të paraqesin bashkëshorti, bashkëshorti jashtëmartesor,

farefisi në vijë të drejtë deri në shkallën e parë, prindi adoptues, fëmija i adoptuar, vëllai, motra ose prindi birësues i të dënuarit.

Kryeprokurori i shtetit, i pandehuri, mbrojtësi i tij dhe personat tjerë të autorizuar mund të paraqesin kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë brenda 3 muajve nga dita kur të pandehurit i është dorëzuar vendimi gjyqësor i formës së prerë. Nëse kundër vendimit të gjykatës themelore nuk paraqitet ankesë, afati rrjedh nga dita kur vendimi merr formë të prerë, (paragrafi 2 i nenit 433 i KPP).

Kur me vendimin e Gjykatës Europiane mbi të drejtat e njeriut është vërtetuar se me vendim përfundimtar janë shkelur të drejtat e njeriut në dëm të të pandehurit, afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë rrjedh nga dita kur vendimi i Gjykatës Europiane mbi të drejtat e njeriut i dorëzohet të pandehurit, (paragrafi 3 i KPP).

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë i paraqitet gjykatës themelore e cila e ka marrë vendimin në shkallë të parë, (paragrafi 1 i nenit 434 i KPP). Në këtë gjykatë, konform paragrafit 2 të nenit 434 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesa i procedohet gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues i cili ka vendosur mbi rastin, me ç'rast ai ka mundësi që me aktvendim ta hedh poshtë kërkesën për këtë mjet juridik. Një aktvendim të tillë ai do të mund ta marr atëherë kur:

1. Kërkesa është paraqitur kundër vendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për shkeljet për të cilat, si rregull, nuk autorizohet paraqitja e një kërkesë të tillë (autorizimi i takon vetëm Kryeprokurorit të Shtetit), me përjashtim të rasteve kur këtë shprehimisht e lejon Kodi i Procedurës Penale;

2. Është paraqitur nga personi i paautorizuar ose

3. Kërkesa është paraqitur jashtë afatit.

Vlen të theksohet fakti se kundër aktvendimit të gjyqtarit të vetëm gjykues ose kryetarit të trupit gjykues të gjykatës themelore mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit, (paragrafi 3 i nenit 434 i KPP).

Gjykata themelore me rastin e vendosjes mbi këtë kërkesë, varësisht nga përmbajtja e saj, mund të vendosë që ekzekutimi i vendimit gjyqësor i formës së prerë të shtyhet apo ndërpritet, (paragrafi 4 i nenit 434 i KPP).

Për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë vendosë Gjykata Supreme e Kosovës. Kjo gjykatë me aktvendim e hedh kërkesën nëse gjen se ajo është e papranueshme ose është paraqitur jashtë afatit. Në të kundërtën, kopjen e kërkesës ia dërgon palës kundërshtare e cila në afat prej 15 ditëve nga dita e dorëzimit të kërkesës mund të paraqesë përgjigje në kërkesë. Pas kësaj dhe para marrjes së vendimit mbi kërkesën, gjyqtari raportues sipas nevojës mund të kërkojë raport mbi shkeljet e pretenduara ligjore. Në fakt, Gjykata Supreme e Kosovës varësisht nga përmbajtja e kërkesës, mund të caktojë shtyrjen ose ndërprerjen e ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, (neni 435 i KPP).

Me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, Gjykata Supreme e Kosovës kufizohet vetëm në verifikimin e shkeljeve ligjore në të cilat paraqitësi i kërkesës pretendon. Në këtë rrjedhë, kur gjykata në fjalë vërteton se shkaqet për të

cilat ka marrë vendim në dobi të të akuzuarit ekzistojnë edhe për ndonjërin nga të bashkakuzuarit që nuk ka paraqitur kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, vepron sipas detyrës zyrtare sikurse kërkesa e tillë të ishte paraqitur nga personi i tillë. Kur kërkesa është paraqitur në dobi të të akuzuarit, Gjykata Supreme e Kosovës me rastin e vendosjes detyrohet me ndalesën reformatio in peius, (neni 436 i KPP).

Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim e refuzon si të pabazë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, kur vërteton se nuk ekziston shkelje e ligjit për të cilën pretendon paraqitësi i kërkesës, ose kur kërkesa është paraqitur për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, (neni 437 i KPP).

Kur Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar ajo, konform paragrafit 1 të nenit 438 të Kodit të Procedurës Penale, merr aktgjykim me të cilin duke pasur parasysh llojin e shkeljes:

1. Ndryshon vendimin e formës së prerë;

2. Në tërësi ose pjesërisht anulon vendimin e gjykatës themelore dhe të gjykatës më të lartë dhe lëndën e kthen për vendim të ri ose për rigjykim në gjykatën themelore ose gjykatën më të lartë ose

3. Kufizohet vetëm në vërtetimin e shkeljes së ligjit.

Kur Gjykata Supreme e Kosovës çmon se kërkesa e paraqitur për mbrojtjen e ligjshmërisë në dëm të të pandehurit është e pabazuar, vetëm konstaton shkeljen e ligjit pa ndikuar në vendimin e formës së prerë. Po ashtu, kur Gjykata e Apelit sipas Kodit të Procedurës Penale nuk ka pasur të drejtë ta mënjanojë shkeljen e ligjit e cila është bërë me vendimin e gjykatës së shkallës së parë ose në procedurë gjyqësore që i ka prirë atij vendimi dhe Gjykata Supreme e Kosovës vërteton se kërkesa e paraqitur në dobi të të akuzuarit është e bazuar, dhe se për mënjanimin e asaj shkelje duhet anuluar ose ndryshuar vendimin e shkallës së parë, Gjykata Supreme e Kosovës e anulon ose e ndryshon edhe vendimin e Gjykatës së Apelit edhe pse me të nuk është shkelur ligji, (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 438 të KPP).

Kur me rastin e vendosjes mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë ka dyshim të konsiderueshëm lidhur me saktësinë e fakteve vendimtare të vërtetuara në vendimin kundër të cilit është paraqitur kërkesë, Gjykata Supreme e Kosovës me aktgjykim me të cilin vendosë mbi kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë anulon vendimin dhe urdhëron mbajtjen e shqyrtimit të ri në gjykatën e njëjtë ose në gjykatën tjetër themelore kompetente, (neni 439 i KPP).

Në qoftë se aktgjykimi i formës së prerë anulohet dhe lënda kthehet për gjykim të ri, gjykata merr për bazë aktakuzën e mëparshme ose atë pjesë të saj që ka të bëjë më pjesën e anuluar të aktgjykimit. Në këto raste gjykata e tillë duhet t'i ndërmerret të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet për të cilat e ka paralajmëruar Gjykata Supreme e Kosovës. Gjatë rigjykimit, qoftë në gjykatën themelore apo në Gjykatën e Apelit palët kanë të drejtë të paraqesin fakte e prova të reja. Vlen të theksohet fakti se edhe në këtë rast, gjatë marrjes së vendimit të ri gjykata detyrohet me ndalesën reformatio in peius. Kur krahas vendimit të Gjykatës së Apelit anulohet edhe vendimi i gjykatës themelore, lënda i dërgohet gjykatës themelore nëpërmjet Gjykatës së Apelit, (neni 440 i KPP).

PROCEDURAT E VEÇANTA

Përveç llojeve të procedurave penale të trajtuara më lart, të cilat kanë për objekt shqyrtimi çështjen penale konkrete në tërë dimensionet e saj deri në marrjen e vendimit definitiv, me Kodin e Procedurës Penale janë paraparë edhe të ashtuquajturat procedurat e veçanta në të cilat shtrohen për zgjidhje çështje dhe lëndë procedurale të posaçme dhe plotësuese. Lëndët e tilla me qëllim të zgjidhjes mund të shtrohen ose pas përfundimit të veprimtarisë mbi çështjen themelore, por edhe krahas zgjidhjes së kësaj çështjeje. Për këto procedura do të flitet në trajtimet në vazhdim.

Procedura për dhënien e urdhrin ndëshkimor

Procedura për dhënien e urdhrin ndëshkimor përfaqëson institut procedural përmes të cilit ofrohet mundësia e përfundimit të çështjes penale pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor. Së këndejmi, me paragrafin 1 të nenit 493 të Kodit të Procedurës Penale është parashikuar mundësia që për veprat penale për të cilat është paraparë dënimi me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet, për të cilat prokurori i shtetit është informuar në bazë të provave të besueshme nga kallëzimi penal, ai mund të kërkojë në aktakuzë që gjykata të jep urdhër ndëshkimor në të cilin të akuzuarit do t'i shqiptohet dënimi përkatës pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor.

Në kërkesën e tij për dhënie të urdhrin ndëshkimor, prokurori i shtetit mund të kërkojë shqiptimin e një ose më shumë masave vijuese: dënim me gjobë, ndalim të drejtimit të automjetit, urdhër për publikim të aktgjyqimit, konfiskim të sendit, vërejtje gjyqësore ose konfiskim të dobisë pasurore të fituar me vepër penale, (paragrafi 2 i nenit 493 i KPP).

Gjyqtari i vetëm konform paragrafit 1 të nenit 494 të Kodit të Procedurës Penale, do ta hedh kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor atëherë kur:

1. Konstaton se për veprën e tillë penale nuk mund të paraqitet kërkesë e tillë dhe
2. Prokurori i shtetit kërkon shqiptimin e dënimit i cili sipas ligjit nuk është i lejueshëm.

Në këto raste, nëse ka ankesë të adresuar nga prokurori i shtetit, për te vendos kolegjii shqyrtues në afat prej 48 orëve nga momenti i pranimit të aktvendimit mbi hedhjen e kërkesës (paragrafi 1 i nenit 494 i KPPK).

Kur gjyqtari i vetëm çmon se të dhënat në aktakuzë nuk ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor, ose nga të dhënat e tilla mund të pritët shqiptim i ndonjë dënimi tjetër nga ai që ka propozuar prokurori i shtetit, pasi ta pranojë aktakuzën, cakton shqyrtim gjyqësor dhe thërret personat që duhet të marrin pjesë në shqyrtim, (paragrafi 2 i nenit 494 i KPPK).

Kur gjyqtari i vetëm gjykues pajtohet me kërkesën e prokurorit të shtetit, ai jep urdhër ndëshkimor me aktgjykim. Me këtë rast në urdhër ndëshkimor shënohet se pranohet kërkesa e prokurorit të shtetit dhe se shqiptohet dënimi nga kërkesa ndaj të pandehurit, të dhënat personale të të cilit duhet shënuar qartë.

Urdhri ndëshkimi i dorëzohet të pandehurit dhe mbrojtësit të tij, nëse ka mbrojtës si dhe prokurorit të shtetit. I pandehuri dhe mbrojtësi i tij në afat prej 8 ditëve pas pranimit mund të paraqesin kundërshtim kundër urdhrin ndëshkimi me shkrim ose me gojë në procesverbal të gjykatës. Kundërshtimi nuk duhet domosdo të arsyetohet.

Kur gjyqtari nuk e hedh kundërshtimin si të paafatshëm ose të paraqitur nga personi i paautorizuar, cakton shqyrtim gjyqësor lidhur me aktakuzën e prokurorit të shtetit dhe me këtë rast e thërret të akuzuarin dhe mbrojtësin e tij, prokurorin e shtetit, të dëmtuarin dhe përfaqësuesit ligjor e të autorizuar, dëshmitarët, ekspertët dhe përkthyesin, dhe i jep të pandehurit udhëzimet dhe paralajmërimet e nevojshme si dhe vazhdohet me leximin e aktakuzës dhe ndërmarrje të veprimeve tjera procedurale deri në marrjen e vendimit gjyqësor.

Procedura për shqiptimin e vërejtjes gjyqësore

Vërejtja gjyqësore është sanksion penal i posaçëm që mund të shqiptohet për vepra penale për të cilat është parashikuar dënimi me burgim deri në 1 vit apo dënimi me gjobë, të cilat janë kryer në rrethana lehtësuese, të cilat i bëjnë ato vepra veçanërisht të lehta. Me anë të këtij sanksioni penal kryerësit i bëhet me dije se ka kryer një vepër të dëmshme dhe të rrezikshme e cila me ligj është paraparë si vepër penale dhe njëkohësisht i tërhiqet vërejtja nga gjykata se nëse kryen përsëri vepër penale të tillë do t'i shqiptohet dënim më i rëndë. Vërejtja gjyqësore mund të shqiptohet edhe për vepra penale për të cilat është paraparë dënimi deri në 3 vjet burgim në qoftë se për ato vepra penale shprehimisht është paraparë mundësia e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore. Gjykata mund të shqiptojë vërejtjen gjyqësore për më shumë se një vepër penale të kryer në bashkim, nëse për çdonjërin nga këto vepra penale ekzistojnë kushtet për shqiptimin e saj. Me rastin e vendosjes nëse do të shqiptojë vërejtjen gjyqësore, gjykata duke marrë parasysh qëllimin e vërejtjes gjyqësore, veçanërisht do të marrë parasysh të kaluarën e personit të pandehur, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale, pjesëmarrjen vullnetare në trajtimin mjekësor dhe programin e rehabilitimit dhe rrethanat tjera në të cilat është kryer vepra.

Vërejtja gjyqësore shqiptohet me aktgjykim, me ç'rast gjykata do t'i zbatojë përshtatshmërisht dispozitat e Kodit të Procedurës Penale lidhur e aktgjykimit me të cilin i pandehuri shpallet fajtor, (neni 498 i KPP). Aktgjykimi për vërejtjen gjyqësore shpallet menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor me arsyet esenciale, (paragrafi 1 i nenit 499 i KPP).

Në dispozitiv të aktgjykimit për vërejtje gjyqësore shënohen të dhënat personale të të akuzuarit, shënohet se është shqiptuar vërejtje gjyqësore për veprën që është objekt i aktakuzës dhe emërtimi ligjor i veprës penale. Dispozitivi i aktgjykimit përfshinë edhe të dhënat mbi urdhrin për shqiptimin e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin e kryerësve të varur nga droga ose alkooli, ose për konfiskimin e dobisë pasurore të fituar me vepër penale, si dhe vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, për kërkesën pasurore juridike si dhe përcaktimin se a duhet shpallur aktgjykimit e formës së prerë në shtyp, radio ose televizion, (paragrafi 2 i nenit 499 i KPP).

Gjykata në arsyetim të aktgjykimit paraqet arsyet në të cilat është bazuar me rastin e shqiptimit të vërejtjes gjyqësore, (paragrafi 3 i nenit 499 i KPP).

Kundër aktgjykimit mbi shqiptimin e vërejtjes gjyqësore mund të paraqitet ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave esenciale të Kodit të Procedurës Penale, shkeljes së Kodit Penal, vërtetimit të gabueshëm ose jo të plotë të gjendjes faktike si dhe për shkak të mosekzistimit të rrethanave që e arsyetojnë shqiptimin e vërejtjes gjyqësore.

Procedura për shqiptimin e masave të trajtimit të detyrueshëm

Siç dihet si kryerës të veprave penale paraqiten edhe personat të cilët lëngojnë nga sëmundje e çrregullime mendore. Së këndejmi, konform paragrafit 1 të nenit 508 të Kodit të Procedurës Penale, në çdo kohë gjatë procedurës, duke përfshirë kohën gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor, gjykata sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e prokurorit të shtetit apo të mbrojtësit, mund të caktojë ekspert për të kryer ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit për të konstatuar nëse:

1. Në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore ose

2. I pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin.

Në urdhër për caktimin e ekspertit shënohet koha kur duhet kryer ekzaminimin psikiatrik e cila nuk mund të jetë më gjatë se 2 javë nga dita e lëshimit të urdhrin si dhe emërohet mbrojtësi me shpenzime të shtetit, nëse i pandehuri nuk ka angazhuar vet mbrojtës. Në çdo rast të tillë mbrojtësit duhet dhënë mundësia për të marr pjesë në ekzaminimin psikiatrik për të konstatuar aftësinë e të pandehurit për të përballuar gjykimin, përveç nëse eksperti konstaton se prania e tij do të pengonte vlerësimin e drejtë të të pandehurit, (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 508 të KPP).

Propozimin për shqiptimin e masës së trajtimit të detyruar psikiatrik e paraqet prokurori i shtetit. Ai këtë propozim si rregull e paraqet para hapjes së shqyrtimit gjyqësor, kur mendon se i pandehuri ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore dhe nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë siç parashihet në nenet 88 dhe 89 të Kodit Penal. Pavarësisht kësaj, prokurori i shtetit mundet që edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor ta ndryshojë aktakuzën dhe të paraqesë propozim për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, nëse provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor dëshmojnë se i pandehuri ka kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore dhe nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e masës së tillë. Mbrojtja për të pandehurin është e obliguar që nga momenti i dorëzimit të propozimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, (neni 512 i KPP).

Procedura për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm rehabilitues ndaj personave të cilët kanë kryer veprë penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës

Trajtimi i detyrueshëm për rehabilitim të personave të cilët kanë kryer veprë penale nën ndikimin e alkoolit ose drogës është masë relativisht e re, që shqiptohet së bashku me sanksionet e caktuara penale dhe ka për qëllim që t' i evitohet rrethanat dhe shkaqet që ndër lidhen me alkoolin apo drogën si faktorë kriminogjen. Hulumtimet shkencore kanë treguar se vetëm dënimi ndaj kryerësve të cilët veprat penale i kanë kryer si alkoolistë apo narkomanë nuk mund të ushtrojë efekte të duhura në luftën kundër kriminalitetit. Në raste të këtilla, trajtimi mjekësor psikiatrik ka efekt më të madh preventiv se dënimi. Gjykata mund të urdhërojë zbatimin e kësaj mase me qëllim që të mbrojtë shoqërinë prej personave që janë të prirur që nën ndikimin e alkoolit ose drogës të kryejnë vepra penale, por në të njëjtën kohë personave të tillë nëpërmjet mjekimit u jepet ndihmë që t' i çrrënjosin shprehitë, përkatësisht të lirohen nga varësia e alkoolit dhe drogës.

Këtë masë gjykata mund t' ia shqiptojë kryerësit në rastet kur atij ia ka shqiptuar dënimin, vërejtjen gjyqësore ose kryerësin e ka liruar nga dënimi, kur ai e ka kryer veprën penale për shkak të varshmërisë nga alkooli apo droga, kur ekziston lidhja kauzale në mes të veprës penale të kryer dhe varshmërisë së kryerësit nga droga ose alkooli dhe kur çmon se ka gjasa për mjekimin e tij të suksesshëm. Natyrisht, me rastin e caktimit të kësaj mase gjykata do të dëgjojë vlerësimin e ekspertit, si dhe mendimin e prokurorit të shtetit dhe të mbrojtësit.

Gjykata pushon zbatimin e masës së trajtimit të detyrueshëm rehabilitues kur trajtimi ose rehabilitimi më nuk janë të nevojshëm ose kur ka kaluar koha e përcaktuar, (3 vjet sipas nenit 90 të Kodit Penal).

Kjo masë nuk mund të shqiptohet ndaj personit i cili veprën penale e ka kryer nën ndikimin e drogës apo alkoolit, por i cili përndryshe nuk është i varur nga droga ose alkooli.

Procedura për marrjen e vendimit për shlyerjen e dënimit nga evidenca e të ndëshkuarve

Sipas nenit 103 të Kodit Penal, dënimi do të shlyhet nga evidenca e të ndëshkuarve nëse ai është parashkuar apo është falur ose i dënuari nuk kryen veprë penale të re. Për të gjitha këto raste ligjdhënësi kërkon kalimin e një periudhe të caktuar kohore. Lidhur me këtë Kodi i ka paraparë edhe afatet brenda të cilave mund të vjen deri te shlyerja e dënimit nga evidenca. Kështu: për personin, të cilit i është shqiptuar vërejtja gjyqësore, dënimi me kusht dhe dënimi me gjysmëliri, 1 vit nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, përkatësisht 1 vit prej ditës kur ka kaluar periudha e verifikimit, për personin të cilit i është shqiptuar dënimi me gjobë, dënimi plotësues ose dënimi me burg deri në 1 vit, tri vjet, për personin të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim prej 1-3 vjet, pesë vjet; për personin të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim prej 3-5 vjet, tetë vjet; për personin të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim prej 5-10 vjet, dhjetë vjet, për personin të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim prej 10-15 vjet,

15 vjet. Ndërkaq për personin të cilit i është shqiptuar dënimi me burgim mbi 15 vjet burgim apo dënimi me burgim afatgjatë dhe dënimi me burgim të përjetshëm, dënimi nuk shlyhet. Më në fund duhet theksuar faktin se nuk mund të shlyhen as dënimet plotësuese e as masat e trajtimit të detyrueshëm gjatë kohëzgjatjes së tyre.

Aktvendimin për shlyerjen e dënimit nga evidenca e merr organi publik kompetent për çështje gjyqësore. Para marrjes së aktvendimin të tillë kërkohet të bëhen gjurmime të nevojshme, veçanërisht në mbledhjen e të dhënave të cilat tregojnë nëse kundër të dënuarit zbatohet procedurë penale për ndonjë vepër penale të re të kryer para kalimit të afatit të paraparë për shlyerjen e dënimit, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 520 të KPP).

Shlyerja e dënimit mund të bëhet në dy mënyra: *në rrugë administrative nga ana e organit publik dhe në procedurë gjyqësore.*

Në të vërtetë kur konstatohet se janë plotësuar kushtet për shlyerjen e dënimit, organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore si rregull merr aktvendim për shlyerjen e dënimit, (paragrafi 1 i nenit 521 i KPP).

Nëse organi publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore nuk merr aktvendim mbi shlyerjen e dënimit, personi i dënuar mund të kërkojë të konstatohet se shlyerja e dënimit është bërë në bazë të ligjit. Kur organi i tillë nuk merr aktvendim sipas kërkesës së të dënuarit brenda 30 ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës, i dënuari mund të kërkojë që gjykata themelore e cila në shkallë të parë ka marrë aktgjykim, të merr aktvendim për shlyerje të dënimit. Gjykata do të vendosë mbi këtë kërkesë pasi ta dëgjojë mendimin e prokurorit të shtetit kur procedura është filluar sipas kërkesës së tij, (neni 521 i KPP).

Kur dënimi alternativ nuk revokohet pas 1 viti nga dita e pushimit të kohës së verifikimit, gjykata themelore e cila ka gjykuar në shkallë të parë, merr aktvendim me të cilin shlyen dënimin. Ky aktvendim i dërgohet të dënuarit, prokurorit të shtetit, kur procedura është filluar me kërkesë të tij si dhe organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, (neni 522 i KPP).

Kërkesa për shlyerjen e dënimit në rrugë gjyqësore i adresohet gjykatës themelore e cila ka vendosur mbi çështjen në shkallë të parë. Ajo iniciohet me kërkesën e të dënuarit. Me këtë rast, gjyqtari të cilit i caktohet çështja, së pari konstaton nëse ka kaluar afati i paraparë ligjor i nevojshëm, pastaj bën gjurmime të nevojshme, vërteton faktet të cilat i pohon kërkuesi dhe mbledhë prova mbi të gjitha rrethanat e rëndësishme për vendim. Për sjelljet e kërkuesit gjykata mund të kërkojë raport nga policia në territorin e të cilit ai ka banuar pas mbajtjes së dënimit, ndërsa raport të tillë mund të kërkojë edhe administrata e institucionit ku i dënuari ka mbajtur dënimin, (paragrafët 1-4 të nenit 523 të KPP).

Më në fund dënimi i shlyer nuk shënohet në certifikatën e lëshuar bazuar në evidencën e dënimeve për realizimin e të drejtave të individëve, (neni 524 i KPP).

Procedura për kompensim dëmi, rehabilitim dhe për ushtrimin e të drejtave të tjera të personave të dënuar pa arsye ose të arrestuar pa bazë

Nga titulli i specifikuar rezulton se në rastin konkret, është fjala për tri lloje të procedurave të veçanta: procedura për kompensimin e dëmit personave të dënuar ose të arrestuar pa bazë, procedura për rehabilitimin e personave të dënuar apo të arrestuar pa bazë dhe procedura për realizimin e të drejtave tjera të personave të dënuar ose të arrestuar pa bazë.

Procedura për kompensimin e dëmit personave të dënuar ose të arrestuar pa bazë

Përkundër intencës që të mos zhvillohet procedurë penale kundër personit i cili nuk ka kryer vepër penale, dhe të mos shqiptohet dënim i paarsyeshëm ose të mos kufizohet liria e të pandehurit pa bazë, megjithatë nuk përjashtohet mundësia që diçka e tillë të ndodhë në punën praktike të organeve që zhvillojnë procedurë penale. Duke pasur parasysh këtë fakt, Kodi i Procedurës Penale parashikon që personi i dënuar pa arsye ose i privuar lirie pabazë, ka të drejtë kompensimi të dëmit të shkaktuar nga mjetet shoqërore.

Kështu, konform paragrafit 1 të nenit 525 të Kodit të Procedurës Penale, të drejtë në kompensim dëmi për dënim të paarsyeshëm ka personi kundër të cilit është shqiptuar sanksioni penal në formë të prerë ose që është shpallur fajtor dhe është liruar nga dënimi por që më vonë, sipas mjetit të jashtëzakonshëm juridik, procedura e re është pushuar në formë të prerë ose me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar, përveç në këto raste:

1. Kur deri te pushimi i procedurës ose aktgjykimi me të cilin akuza është refuzuar ka ardhur për arsye se në procedurën e re i dëmtuari është tërhequr nga propozimi për ndjekje si rezultat i marrëveshjes së arritur me të pandehurin dhe

2. Kur në procedurën e rishikimit me aktgjykim është refuzuar akuza për shkak të mos kompetencës së gjykatës, e prokuroi i shtetit e ka ndërmarrë ndjekjen në gjykatën kompetente.

Në rast të dënimit për vepra penale në bashkim, e drejta në kompensim dëmi ekziston vetëm për veprën penale për të cilën plotësohen kushtet për njohjen e kompensimit, (paragrafi 3 i nenit 525 i KPP).

Sipas paragrafit 1 të nenit 529 të Kodit të Procedurës Penale e drejta e kompensimit të dëmit i takon edhe personit i cili:

1. Ka qenë në paraburgim e kundër tij nuk është filluar procedura penale ose procedura është pushuar me aktvendim të formës së prerë ose ai me aktgjykim të formës së prerë është liruar nga akuza ose akuza është refuzuar;

2. Ka mbajtur dënimin me heqje të lirisë dhe me rastin e rishikimit të procedurës penale ose kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje më të shkurtër se dënimi të cilin e ka mbajtur ose është deklaruar fajtor dhe është liruar nga dënimi;

3. I cili për shkak të gabimit ose veprimit të paligjshëm të një organi, pa arsye është arrestuar ose është mbajtur një kohë në paraburgim ose në një institucion korrektues për mbajtjen e dënimit ose masës së shqiptuar dhe

4. I cili në paraburgim ka kaluar kohë më të gjatë se sa dënimi me burgim me të cilin është gjykuar.

Kompensimi i dëmit i takon gjithashtu edhe personit i cili është arrestuar pa bazë ligjore nëse kundër tij nuk është caktuar paraburgimi ose koha e arrestimit nuk i është llogaritur në dënimin e shqiptuar për veprë penale ose kundërvajtje, (paragrafi 2 i nenit 529 i KPP).

Mirëpo nga këto rregulla ekzistojnë edhe disa përjashtime. Kjo do të thotë se përkundër ekzistimit të kushteve të lartpërmendura, në disa raste deri te kompensimi i dëmit nuk mund të bëhet. Rrjedhimisht, kompensimi i dëmit nuk i takon personit i cili me pohimin e tij të rremë ose në ndonjë mënyrë tjetër ka shkaktuar me qëllim arrestimin e tij, (paragrafi 3 i nenit 529 i KPP).

Kërkesën për kompensim dëmi ka të drejtë ta paraqesë personi i dëmtuar, kurse trashëgimtarët e tij mund ta vazhdojnë kërkesën për kompensim të dëmit material apo ta fillojnë një procedurë të tillë në qoftë se i dëmtuari ka vdekur para kalimit të parashkrimit dhe nëse nuk ka hequr dorë nga kërkesa për kompensim, (neni 528 i KPP).

Kërkesa mund të orientohet në kompensimin e dëmit të shkaktuar për shkak të humbjes ose zvogëlimit të të ardhurave personale, për shkak të mosshfrytëzimit të të drejtave të cilat i kanë takuar atij nga marrëdhënia e punës, për shkak të dëmtimit ose keqësimit të gjendjes shëndetësore, për shkak të mbajtjes së dënimit, për shkak të pagimit të dënimit me të holla, pagimit të shpenzimeve të procedurës penale, përmbushjes së kërkesës pasurore juridike etj.

Kërkesa për kompensim dëmi parashkruhet 3 vjet pas formës së prerë të aktgjykimit të shkallës së parë me të cilin i akuzuari është liruar nga akuza ose me të cilin është refuzuar akuza, apo nga forma e prerë e aktvendimit me të cilin procedura është pushuar. Kur për ankesë vendosë gjykata më e lartë, e drejta për kompensim parashkruhet pas 3 vjetësh nga dita e marrjes së vendimit nga gjykata e tillë, (paragrafi 1 i nenit 526 i KPP).

Kërkesa për kompensimin e dëmit, me qëllim miratimi, së pari i paraqitet organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore. Në këtë aspekt, synohet arritja e marrëveshjes për ekzistimin e dëmit, llojin dhe lartësinë e kompensimit, (paragrafi 2 i nenit 526 i KPP).

Në rast se kërkesa e parashtruar nuk miratohet nga ana e organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore dhe i dëmtuari nuk arrin marrëveshje brenda 3 muajsh nga dita e paraqitjes së kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padinë për kompensim dëmi në gjykatën kompetente. Nëse është arritur marrëveshje vetëm për një pjesë të kërkesës, i dëmtuari mund të paraqesë padi për pjesën tjetër të kërkesës. Duhet theksuar se deri sa zgjatë procedura e arritjes së marrëveshjes për kompensim dëmi afati i parashkrimit të kërkesës nuk rrjedh. Padia paraqitet kundër organit kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, (neni 527 i KPP).

Rehabilitimi i personave të dënuar apo të arrestuar pa bazë

Në kuptimin e përgjithshëm me rehabilitim nënkuptohet kthimi i të drejtave personit të dënuar pasi ta ketë mbajtur dënimin si dhe shlyerja e pasojave juridike të dënimit dhe shlyerja e dënimeve nga evidenca e të ndëshkuarve. Kur rehabilitimi ka të bëjë me arrestime e dënime të pabazuara atëherë Kodi i Procedurës Penale, për realizimin e mundësive që ofron ky institucion, parasheh zhvillimin e procedurës së veçantë.

Në këtë aspekt, kur rasti i dënimit të paarsyeshëm ose arrestimit të pabazë të ndonjë personi është paraqitur nëpërmjet mjeteve publike të informimit dhe me këtë rast është cenuar prestigji i personit, gjykata, me kërkesën e tij, shpallë në gazetë ose në mjetin tjetër të informimit publik njoftimin mbi vendimin nga i cili shihet qartë se dënimi ishte i paarsyeshëm ose arrestimi i pabazë. Kur rasti nuk është paraqitur në mjetet e informimit publik, me kërkesën e personit, njoftimi i tillë i dërgohet punëdhënësit të tij. Pas vdekjes së të dënuarit, e drejta për paraqitjen e kësaj kërkesë i takon bashkëshortit të tij apo bashkëshortit jashtëmartesor, fëmijëve, prindërve, vëllezërve dhe motrave të tij. Duhet theksuar faktin se kërkesa për rehabilitim mund të paraqitet edhe në rastet kur nuk është paraqitur kërkesa për kompensim dëmi. Po ashtu, kjo kërkesë mund të parapritet edhe në rastin kur me paraqitjen e mjetit të jashtëzakonshëm juridik ndryshohet cilësimi juridik i veprës, kur për shkak të cilësimit juridik me aktgjykimin e mëparshëm është cenuar rëndë reputacioni i personit të dënuar, (paragrafët 1-3 të nenit 530 të KPP).

Kërkesa për rehabilitim sipas kësaj baze, mund të paraqitet brenda 6 muajsh në gjykatën themelore e cila në procedurën penale ka gjykuar në shkallë të parë. Për kërkesën vendosë kolegji shqyrtues i Gjykatës së Apelit. Me rastin e vendosjes mbi këtë kërkesë zbatohen përshtatshmërisht dispozitat që adresojnë çështjen e kompensimit të dëmit, dhe atë paragrafët 2 dhe 3 të nenit 525 dhe paragrafi 3 i nenit 529 të Kodit të Procedurës Penale, (paragrafi 4 i nenit 530 i KPP).

Gjykata themelore e cila ka gjykuar në procedurë penale në shkallë të parë, sipas detyrës zyrtare merr aktvendim me të cilin e anulon regjistrimin e dënimit të paarsyeshëm në evidencën e dënimeve. Aktvendimi i dërgohet organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, kurse të dhënat nga vendimi i anuluar nuk i komunikohen askujt, (neni 531 i KPP).

Duhet theksuar faktin se personi i autorizuar për shikim dhe kopjim të shkresave që kanë të bëjnë me dënimin e paarsyeshëm ose me heqjen e lirisë pabazë të personit nuk mund t'i përdorë këto shënime në mënyrë të dëmshme për rehabilitimin e personit kundër të cilit është zbatuar procedura penale. Kryetari i gjykatës detyrohet që për këtë të paralajmërojë personin të cilit i lejohet shikimi dhe kjo shënohet në shkresë me nënshkrimin e atij personi, (neni 532 i KPP).

Procedura për realizimin e të drejtave të tjera të personave të dënuar ose arrestuar pa bazë

Personit të cilit për shkak të dënimit të paarsyeshëm ose heqjes së lirisë pabazë i ka pushuar marrëdhënia e punës ose sigurimi social sipas sistemit të mirëqenies sociale, ka të drejtë të përfitojë kohën e humbur të papunësisë dhe sigurimit duke ia llogaritur kohën e humbur të papunësisë sikur të ishte i punësuar gjatë dënimit dhe arrestimit të pabazë. Në stazh llogaritet edhe koha që ka qenë papunë për shkak të dënimit të paarsyeshëm ose heqjes së lirisë pabazë, nëse humbja e vendit të punës nuk është shkaktuar me fajin e atij personi. Në fakt, me rastin e çdo vendimmarrje për të drejtën në të cilën ndikon gjatësia e stazhit të punës apo stazhit të sigurimit social, organi kompetent duhet të merr parasysh stazhin e njohur si më lart, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 533 të KPP).

Kur organi kompetent me rastin e vendosjes mbi të drejtën në të cilën ndikon gjatësia e stazhit nuk merr në konsideratë këtë stazh, i dëmtuari mund të kërkojë që gjykata të konfirmojë njohjen e asaj kohe sipas ligjit. Padia paraqitet kundër organit kompetent i cili refuzon të pranojë stazhin e pranuar dhe kundër organit publik kompetent në lëmin e çështjeve gjyqësore, (paragrafi 3 i nenit 533 i KPP).

Rrjedhimisht, me kërkesë të organit në të cilin realizohet ndonjëra nga të drejtat e lartpërmendura (p.sh., e drejta lidhur më stazhin e punës), kontributi i caktuar për kohën e pranuar duhet të paguhet nga mjetet buxhetore. Së këndejmi, stazhi social i pranuar në tërësi llogaritet në stazhin pensional si dhe duhet të sigurohet realizimi i kompensimit të të ardhurave personale të perealizuara gjatë kohës së papunësisë së përkohshme së personit dhe i të ardhurave tjera të cilat atij i takojnë sipas ligjit në fuqi, (paragrafët 4 dhe 5 të nenit 533 të KPP).

Procedura për dhënien e letër-rreshtimit dhe shpalljeve publike

Siç është theksuar më lart për zhvillimin e procedurës penale, posaçërisht të shqyrtimit gjyqësor, nevojitet prania e të pandehurit. Kur nuk dihet vendbanimi ose vendqëndrimi i të pandehurit, kurse sipas legjislacionit në fuqi kjo është e nevojshme, gjykata kërkon nga policia që ai të kërkohet dhe që ajo të njoftohet për adresën e tij, (neni 534 i KPP). Mirëpo, kur nuk mund të mësohet adresa e të pandehurit, mund të urdhërohet dhënia e letër-rreshtimit me qëllim që i pandehuri të sillet para organit që e zhvillon procedurën.

Në këtë aspekt, konform paragrafit 1 të nenit 535 të Kodit të Procedurës Penale, lëshimi i letër-rreshtimit mund të urdhërohet kur i pandehuri, kundër të cilit është filluar procedura penale për vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare dhe për të cilën sipas ligjit mund të shqiptohet dënimi me të paktën 2 vjet burgim gjendet në arrati dhe kur është lëshuar urdhërarrest ose aktvendim për caktimin e paraburgimit.

Lëshimi i letër-rreshtimit urdhërohet nga gjykata e cila e zbaton procedurën penale. Kështu, në procedurën paraprake lëshimi i letër-rreshtimit, me propozim të prokurorit të shtetit, urdhërohet nga gjyqtari i procedurës paraprake. Letër-rreshtimin mund ta urdhërojë edhe drejtori i institucionit në rastet kur i pandehuri është arratisur

nga institucioni ku mban dënimin, ose nga institucioni ku mban masën e trajtimit të detyrueshëm që konsiston me heqje lirie, (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 535 të KPP).

Nëse janë të nevojshme të dhënat për sendet e caktuara lidhur me veprën penale ose këto sende duhet të gjenden, sidomos nëse janë të nevojshme për identifikimin e kufomës së paidentifikuar, organi kompetent i cili e zbaton procedurën, urdhëron shpalljen me të cilën kërkon që të dhënat dhe njoftimet t'i dërgohen organit i cili zbaton procedurën, (paragrafi 1 i nenit 536 i KPPK).

Urdhri i gjykatës ose i drejtorit të institucionit për lëshimin e letër-rreshtimit i dërgohet policisë për ekzekutim, (paragrafi 4 i nenit 535 i KPP). Përndryshe, për njoftimin e publikut me letër-rreshtim ose shpallje mund të shfrytëzohen edhe mjetet e informimit publik, (paragrafi 2 i nenit 538 i KPPK).

Nëse është e besueshme se personi për të cilin është urdhëruar letër-rreshtimi gjendet jashtë shtetit, organi kompetent mund të lëshojë edhe letër-rreshtim ndërkombëtar, (paragrafi 3 i nenit 538 i KPP).

Me lutjen e organit të jashtëm, organi publik kompetent për punë të brendshme mund të lëshojë letër-rreshtim për personin për të cilin dyshohet se gjendet në Kosovë, me kusht që në lutje të shënohet se në rast se gjendet ky person do të kërkohet transferimi i tij, (paragrafi 4 i nenit 538 i KPPK).

Policia është e detyruar që të mbajë evidencë mbi letër-rreshtimet e lëshuara. Të dhënat për personat ndaj të cilëve është lëshuar letër-rreshtim fshihen nga evidenca posa organi kompetent e revokon letër-rreshtimin, (paragrafi 7 i nenit 535 i KPPK).

Përveç kësaj, duhet theksuar faktin se ligjdhënësi ia ka mundësuar policisë që të publikojë fotografitë e kufomave dhe të personave të zhdukur kur ekzistojnë arsye për dyshim se vdekja apo zhdukja e personave të tillë është rrjedhojë e veprës penale, (paragrafi 2 i nenit 536 i KPPK).

Procedura ndaj të miturve kriminaliteti i të miturve dhe reagimi i shoqërisë ndaj kësaj dukurie negative

Kriminaliteti si dukuri negative nuk është vetëm karakteristikë e të rriturve. Shpeshherë si kryerës të veprave penale paraqiten edhe të miturit. Në këtë rrjedhë, të dhënat empirike dëshmojnë se kriminaliteti i të miturve, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, është në rritje e sipër. Nga të dhënat e forumeve të specializuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe të asociacioneve të cilat merren me përcjelljen e kriminalitetit vërehet se gjatë dekadave të fundit, është rritur dukshëm pjesëmarrja e të miturve në kriminalitetin e përgjithshëm. Kjo rritje vërehet sidomos te vendet me zhvillim të lartë ekonomik. Përqindja e pjesëmarrjes së të miturve, varësisht nga vendi, në numrin e përgjithshëm të kryerësve të veprave penale, shikuar sipas evidencave të policisë, prokurorisë së shtetit dhe gjykatave sillet prej 5-15%. Madje në disa vende kjo pjesëmarrje e të miturve në kriminalitetin e përgjithshëm shkon mbi 30%. Kështu qëndron çështja në Francë, Gjermani, ShBA etj. Sipas disa të dhënave në Kroaci, në periudhën dhjetëvjeçare (1978-1987) pjesëmarrja e të miturve në numrin e përgjithshëm të personave të paraqitur për vepra penale sillet rreth 11%. Në ShBA

pjesëmarrja e të miturve në kriminalitetin e përgjithshëm, gjatë periudhës 1996-2000, sillet rreth 30%. Në Kosovë sipas të dhënave të fundit, kjo pjesëmarrje sillet rreth 10%.

Disa nga karakteristikat themelore të procedurës penale ndaj të miturve

Duke u bazuar në dispozitat penale me të cilat rregullohen çështjet penale që kanë të bëjnë me të miturit, mund të konkludohet se si veçori të procedurës penale e cila zhvillohet ndaj kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale janë:

Procedura penale ndaj të miturve zbatohet ndaj personave që kanë kryer veprë penale si të mitur (moshat 14-18 vjeç) dhe të cilët në kohën e fillimit të procedurës, apo të gjykimit nuk kanë mbushur moshën 21 vjeçare. Në këtë rrjedhë, duhet sqaruar se disa nga dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur aplikohen edhe në procedurën ndaj madhorit i cili në kohën e gjykimit nuk ka mbushur moshën 21 vjeçare, me ç'rast gjykata duke marrë parasysh personalitetin e tij dhe rrethanat nën të cilat e ka kryer veprën penale, mund të caktojë masë edukative. Po ashtu, është e nevojshme të theksohet fakti se në qoftë se gjatë zhvillimit të procedurës penale personi i caktuar nuk i ka pasur 14 vjet, procedura penale pushohet me aktvendim ngase personat e tillë, sipas Kodit Penal nuk konsiderohen penalisht përgjegjës;

I mituri nuk mund të gjykohet në mungesë, në procedurë penale kundër të miturit karakteristikë është paraqitja e prindit dhe organit të kujdestarisë. Prindi, prindi adoptues dhe kujdestari i të miturit kanë të drejtë ta shoqërojnë të miturin në të gjitha procedurat gjyqësore. Ata mund të detyrohen të marrin pjesë në procedurë nëse çmohet të jetë në interes të të miturit. Sa i përket organit të kujdestarisë, ligjdhënësi ka paraparë që prokurori i shtetit ta njoftojë atë kurdoherë që fillon procedurën penale ndaj të miturit, kurse gjyqtari për të mitur varësisht nga situata konkrete, mund të lejojë pjesëmarrjen e përfaqësuesit të autorizuar të organit të kujdestarisë gjatë ndërmarrjes së veprimeve në procedurën përgatitore si dhe e thërret atë në shqyrtim gjyqësor. Në çdo rast, organi i kujdestarisë merr pjesë në procedurë me qëllim që të njoftohet me rrjedhën e procedurës, por ai ka të drejtë të bëjë edhe propozime dhe të paraqesë fakte e prova të rëndësishme për marrjen e vendimit gjyqësor; mbrojtja në procedurë penale për të mitur është e obligueshme, në procedurë penale për të mitur askush nuk mund të lirohet nga detyra për të dëshmuar mbi rrethanat që vlerësohen të nevojshme për konstatimin e zhvillimit psikologjik të të miturit, për njohjen e personalitetit të tij dhe kushteve në të cilat ai jeton; në procedurë penale për të mitur nuk ka publicitet, procedura penale për të mitur zhvillohet me urgjencë.

Përbërja e trupit gjykues për të mitur dhe emërimi i gjyqtarëve

Trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së parë (gjykatës themelore) dhe trupi gjykues për të mitur në gjykatën e shkallës së dytë (Gjykatës së Apelit), me përjashtim të kolegeve në Gjykatën Supreme të Kosovës, përbëhet nga një gjyqtar

për të mitur dhe dy gjyqtarë porotë. Gjyqtari për të mitur gjithnjë është kryetar i trupit gjykues, (paragrafi 1 i nenit 51 i KDM).

Kompetenca e gjykatës në procedurën penale për të mitur

Kompetenca lëndore e gjykatës në procedurë penale për të mitur rregullohet me dispozita të përgjithshme të Kodit të Procedurës Penale dhe të Ligjit për Gjykatat. Në procedurën penale për të mitur, konform paragrafit 1 të nenit 52 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, prokurori mund të pezullojë ndjekjen penale dhe të shqiptojë masën e diversitetit nëse i mituri pranon përgjegjësinë për veprën penale, nëse shprehë gatishmëri që të pajtohet me palën e dëmtuar si dhe kur ka pajtueshmëri nga ana e të miturit, prindit, prindit adoptues apo kujdestarit për t'u zbatuar një masë e tillë. Që kjo të mund të ndodhë kërkohet që i mituri të jetë i akuzuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi me gjobë ose dënimi me burgim deri në 3 vjet, ose 5 vjet në rast se ai atë vepër e ka kryer nga pakujdesia.

Konform paragrafit 1 të nenit 53 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) është kompetente:

1. Të vendosë mbi ankesën kundër vendimit të trupit gjykues për të mitur të shqiptuar në shkallë të parë, përkatësisht nga gjykata themelore;
2. Të vendosë mbi ankesën kundër vendimit të prokurorit;
3. Të vendosë mbi ankesën kundër vendimit të gjyqtarit për të mitur; dhe
4. Të vendosë mbi rastet tjera të parashikuara me ligj.

Kompetenca territoriale është rregulluar ndryshe në krahasim me procedurën penale për të rritur. Në të vërtetë për zhvillimin e procedurës penale për të mitur përparësi i jepet vendbanimit të të miturit. Kështu, sipas paragrafit 1 të nenit 54 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur për zhvillimin e procedurës penale për të mitur sipas rregullit kompetente është gjykata në territorin e të cilës është adresa e përhershme e vendbanimit të të miturit. Pavarësisht kësaj, në rastet kur i mituri nuk ka vendbanim të përhershëm, ose kur adresa e tij është e panjohur kompetente për gjykimin e të miturit mbetet gjykata e vendqëndrimit të tij, (paragrafi 2 i nenit 54 i KDM).

Arrestimi i përkohshëm, ndalimi në polici dhe paraburgimi

Arrestimi i përkohshëm, ndalimi në polici dhe paraburgimi si masa të sigurimit të prezencës së të miturit në procedurë penale urdhërohen si masa të fundit dhe atë për një kohë sa më të shkurtër të mundshme, (neni 64 i KDM). Arrestimi i përkohshëm dhe ndalimi në polici, si rregull zbatohen nga policia në mbështetje të urdhrit të lëshuar nga gjyqtari për të mitur, në përputhje me kushtet e parapara me Kodin e Procedurës Penale. Këto masa nuk mund të zgjasin më shumë se 24 orë, ashtu që pas kalimit të kësaj periudhe, policia ose duhet ta lirojë të miturin ose duhet që rastin t'ia procedojë gjyqtarit për të mitur të gjykatës kompetente, i cili konform Kodit të Procedurës Penale, mund të marrë aktvendim mbi caktimin e paraburgimit, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 65 të KDM).

Paraburgimi mund të caktohet atëherë kur plotësohen kushtet e parapara për caktimin e paraburgimit në procedurën penale e cila zbatohet ndaj të rriturve, dhe nëse masat tjera për sigurimin e prezencës së të miturit në procedurë vlerësohen të pamjaftueshme për të siguruar prezencën e të miturit të tillë në gjykatore, për të parandaluar kryerjen e serishme të veprës penale dhe për të siguruar zbatimin e suksesshëm të procedurës. Paraburgimin e cakton gjyqtari për të mitur, mirëpo para se të marrë një vendim të tillë ai duhet të shqyrtojë se masat tjera të parapara për sigurimin e prezencës së të miturit të pandehur në procedurë (p.sh., thirrja) apo masat tjera të cilat kanë të bëjnë me vendosjen e të miturit në strehimore, ose në institucionin edukativ apo të ngjashme, me vendosjen e të miturit nën mbikëqyrje të organit të kujdestarisë ose transferimin e të miturit në familje tjetër, kur është e nevojshme ndarja e të miturit nga ambienti i tij jetësor ose për t'i ofruar ndihmë, mbrojtje apo strehim mund të urdhërohet si alternativë paraburgimi. Në çdo rast aktvendimi mbi caktimin e paraburgimit duhet të përfshijë një shpjegim të arsyetuar për pamjaftueshmërinë e alternativave të tilla kundrejt paraburgimit, (paragrafi 1 i nenit 66 i KDM).

Në bazë të aktvendimit të gjyqtarit për të mitur, i mituri i pandehur mund të mbahet në paraburgim për një periudhë kohore maksimale prej 1 muaji, duke llogaritur nga dita kur ai është arrestuar. Pas këtij afati i mituri mund të mbahet në paraburgim në bazë të aktvendimit të kolegjit për të mitur mbi vazhdimin e paraburgimit. Ky vazhdim i paraburgimit mund të bëhet për një periudhë shtesë prej 2 muajsh, pas paraqitjes së propozimit për dënim të miturit mund t'i vazhdohet paraburgimi, në raste të tilla kërkohet që kolegj i në prani të të miturit, mbrojtësit të tij dhe prokurorit ta rishikojë aktvendimin në fjalë brenda 1 muaji nga dita e marrjes së tij, (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 66 të KDM), mirëpo përkundër këtyre mundësive ta vazhdimin të paraburgimit ndaj të miturit, ai nuk mund të mbahet në paraburgim më tepër se 12 muaj nga dita e arrestit (neni 68.par.2).

Zbatimi i paraburgimit ndaj të miturit

Të miturit mbahen në paraburgim në qendrën e paraburgimit të ndarë nga të paraburgosurit madhorë, (paragrafi 1 i nenit 67 i KDM). Megjithatë, në rastet kur konsiderohet të jetë në interes të të miturit ai mund të mbahet në paraburgim edhe në institucionin edukativo korrektues, (paragrafi 2 i nenit 67 i KDM). Me lejen e gjyqtarit për të mitur, të miturin e paraburgosur mund ta vizitojnë të afërmit e tij e me kërkesën e mjekut edhe persona tjerë. Po ashtu, i mituri i paraburgosur mund të mbajë korrespondencë dhe kontakte tjera me personat jashtë institucionit të paraburgimit me lejen dhe nën mbikëqyrjen e gjyqtarit për të mitur. Nën kushte të caktuara ligjore, kur kjo konsiderohet e dëmshme për zhvillimin e procedurës, të miturit mund t'i ndalohej përkohësisht dorëzimi ose pranimi i dërgesave si dhe kontakti me personat tjerë, por kjo duhet të jetë përjashtim. Sidoqoftë, nuk mund të ndalohej dërgimi i kërkesave, ankesave dhe komunikimi i të miturit me mbrojtësin e tij.

Masat disiplinore ndaj të miturit

Ndaj të miturit të padisiplinuar mund të shqiptohet dënimi disiplinor i cili konsiston në ndalimin e pranimit të dërgesave apo të korrespondencës. I mituri mbahet në paraburgim i ndarë nga personat e rritur. Mirëpo nëse është në interes të të miturit, gjyqtari për të mitur mund të vendosë që ai të qëndrojë në institucion edukativo korrektues. Derisa mbahet në paraburgim i mituri, konform paragrafit 3 të nenit 67 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, kur kjo vlerësohet e nevojshme dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin e tij, duhet t'i ofrohet ndihma e nevojshme sociale, edukative, profesionale, psikologjike, mjekësore dhe fizike. I mituri, përveç përjashtimeve të përcaktuara me ligj, nuk mund të mbahet në paraburgim më shumë se 12 muaj, (paragrafi 2 i nenit 68 i KDM). Organet procedurale kanë obligim që të veprojnë me urgjencën më të madhe të mundshme, në rastet kur është në pyetje gjykimi i të miturit të paraburgosur.

Rrjedha e procedurës penale për të mitur

Procedura penale për të mitur vihet në lëvizje posa të paraqitet supozimi se është kryer vepra penale, qëllimi i të cilës është konstatimi i faktit se a është kryer vepra penale dhe kush është i mituri që e ka kryer atë vepër. Ajo inicohet nga prokurori i shtetit në bazë të kallëzimit penal të policisë apo të personave tjerë të autorizuar ose kur kjo mësohet nga burime tjera.

Procedura penale për të mitur përbëhet prej: procedurës përgatitore, shqyrtimit gjyqësor, procedurës lidhur me mjetin juridik dhe ekzekutimit të sanksionit penal.

Fillimi dhe zbatimi i procedurës përgatitore

Siç është theksuar më lart, procedura penale ndaj të miturit vihet në lëvizje nga ana e prokurorit të shtetit. Ai e bën këtë në bazë të kallëzimit penal të policisë, kallëzimit penal të personave të tjerë si dhe kur për kryerjen e veprës penale nga i mituri, informacionet prezantohen nga burime të tjera, por të cilat besueshëm dëshmojnë këtë fakt, (paragrafi 1 i nenit 55 i KDM). Në fakt, inicimin e procedurës penale ndaj të miturit mund ta kërkojë edhe i dëmtuari. Ai në këto raste paraqet propozim për fillimin e procedurës penale. Këtë propozim ia paraqet prokurorit të shtetit brenda afatit prej 3 muajsh nga dita kur kanë mësuar se është kryer vepra penale, (paragrafi 2 i nenit 55 i KDM).

Parimi i legalitetit dhe oportunitetit në procedurën penale ndaj të miturve

Si rregull, prokurori i shtetit është i obliguar që ta filloj ndjekjen penale, në çdo rast, kur merr informacion se i mituri ka kryer vepër penale. Megjithatë, konform paragrafit 1 të nenit 56 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, prokurorit të shtetit, kur janë në pyetje veprat penale të dënueshme me burgim prej më pak se 3 vjet ose me gjobë, i është lënë mundësia që të vendosë të mos e filloj procedurën përgatitore edhe pse ekziston dyshimi i bazuar se i mituri ka kryer veprën penale. Këtë mundësi do ta shfrytëzojë

prokurori i shtetit, kur vlerëson se, në rastin konkret, nuk do të ishte e përshtatshme të zbatohet procedura ndaj të miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të madh ose të pasojave për viktimën si dhe të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale.

Gjithashtu, sipas paragrafit 2 të nenit 56 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, prokurorit të shtetit i është lënë mundësia që të vendosë të mos e filloj procedurën penale ndaj të miturit edhe në rastet kur i mituri kryen veprë penale të re, derisa ndaj tij është duke u ekzekutuar dënimi ose masa edukative për veprën penale të kryer më parë.

Fillimi i procedurës përgatitore

Prokurori i shtetit e fillon procedurën përgatitore me aktvendim. Në aktvendim shënohen të dhënat personale të të miturit, koha e fillimit të procedurës përgatitore, përshkrimi i veprës penale, emërtimi ligjor i saj, rrethanat dhe faktet që arsyetojnë dyshimin e bazuar për veprën penale, provat dhe informatat e mbledhura si dhe të dhënat për ndonjë dënim ose masë të shqiptuar më parë ndaj të miturit. Prokurori i shtetit, pa vonesë një kopje të aktvendimit për fillimin e procedurës ia dërgon gjyqtarit për të mitur, (paragrafi 1 i nenit 58 i KDM). Prokurori i shtetit, duke pasur parasysh natyrën, rrethanat dhe rëndësinë e veprës penale si dhe arsyet që lidhen me të miturin, me pëlqimin e të dëmtuarit mund të pezullojë ndjekjen për veprë penale të dënueshme me gjobë ose me burgim deri në 3 vjet, nëse i mituri zotohet se do të sillet siç është urdhëruar nga prokurori i shtetit dhe se do të përmbushë detyrimet e caktuara që pakësojnë ose mënjanojnë pasojat e dëmshme të veprës penale.

Gjatë rrjedhës së procedurës përgatitore gjyqtari për të mitur duhet t'i garantojë të drejtat e të miturit. Ai me qëllim të mbrojtjes më të mirë të interesave të të miturit, në procedurën përgatitore mund të lejoj pjesëmarrjen e mbrojtësit, prindit, prindit adoptues dhe të kujdestarit të të miturit. Personat në fjalë mund të bëjnë propozime dhe t'i parashtrojnë pyetje personit që është duke u marrë në pyetje, qoftë si dëshmitar apo ekspert. Gjyqtari për të mitur mund të lejoj që në këtë procedurë, gjatë marrjes në pyetje të të miturit, të marrë pjesë edhe përfaqësuesi i organit të kujdestarisë, i cili gjithashtu mund të bëjë pyetje dhe propozime të caktuara. Në rastet kur shtrohet e nevojshme i mituri mund të merret në pyetje me ndihmën e këshilltarit, i cili merret me mbikëqyrjen e fëmijëve ose të ndonjë profesionisti tjetër të kualifikuar, pedagogut, psikologut, defektologut etj. (paragrafët 1-3 të nenit 59 të KDM).

Pushimi i procedurës përgatitore

Procedura përgatitore e filluar duhet të ketë rrjedhën e vet përfundimtare. Në këtë rrjedhë, konform paragrafit 1 të nenit 60 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, prokurori i shtetit e pushon procedurën përgatitore kurdo që nga provat e mbledhura konstaton se: Nuk ka dyshim të bazuar se i mituri ka kryer veprën penale të caktuar; ka kaluar afati i parashkrimit të ndjekjes penale; vepra penale është përfshirë me amnisti dhe falje; kur për vepra penale të dënueshme me burgim prej më pak se 3 vjet ose me gjobë prokurori i shtetit mendon se nuk është e përshtatshme që të zbatohet procedura ndaj të

miturit për shkak të natyrës së veprës penale, të rrethanave në të cilat është kryer ajo, mungesës së dëmit të rëndë ose të pasojës për viktimën, si dhe të kaluarës së të miturit dhe të karakteristikave të tij personale dhe kur ekzistojnë rrethana tjera që e pengojnë ndjekjen.

Për pushimin e procedurës përgatitore prokurori i shtetit duhet ta njoftojë menjëherë gjyqtarin për të mitur. Për ndërmarrjen e një veprimi të tillë, prokurori i shtetit pa vonesë e informon edhe të miturin, përveç në rastet kur nuk janë ndërmarrë akoma veprime në procedurë përgatitore, (paragrafi 2 i nenit 60 i KDM).

Pezullimi i procedurës përgatitor

Ligjdhënësi ka paraparë mundësinë që në raste të caktuara të mund të vijë deri te pezullimi i procedurës përgatitore. Deri te kjo situatë mund të vijë në rrethanat kur: I mituri pas kryerjes së veprës penale vuan nga ndonjë çrregullim ose paaftësi e përkohshme mendore ose nga ndonjë sëmundje tjetër ose kur ekzistojnë rrethana tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen me sukses të të miturit të pandehur (është fshehur).

Me rastin e pezullimit të procedurës përgatitore, prokurori i shtetit mban shënime në procesverbal mbi kohën dhe arsyet e pezullimit.

Prokurori i shtetit 15 ditë para se ta përfundojë procedurën përgatitore, e njofton mbrojtësin e të miturit për qëllimin e tillë. Gjatë kësaj periudhe mbrojtësi mund të parashtrijë kërkesë për marrjen parasysh të fakteve dhe provave të reja. Kur prokurori i shtetit miraton kërkesën e tillë, procedura përgatitore po ashtu mund të përfundohet.

Kohëzgjatja e procedurës përgatitore

Procedura përgatitore duhet të përfundoj brenda gjashtë (6) muajve Prokurori i shtetit, në rastet kur procedura përgatitore nuk përfundon brenda periudhës prej 6 muajve, pasi të vlerësojë të nevojshme mund t'i dorëzojë gjyqtarit për të mitur lutje të arsyetuar me shkrim për vazhdimin e procedurës përgatitore, (neni 61 i KDM).

Siç mund të rezultojë, prokurori i shtetit e përfundon procedurën përgatitore kur çmon se çështja është sqaruar mjaft në mënyrë që të paraqesë propozimin e arsyetuar të trupi gjyqësor për të mitur ose gjyqtari për të mitur për shqiptimin e masës edukative ose të dënimit.

Propozimi i arsyetuar i prokurorit të shtetit

Pas përfundimit të procedurës përgatitore prokurori i shtetit paraqet propozimin e arsyetuar në mënyrë që çështja penale të kalojë në gjykatë. Prokurori i çështjes përmes propozimit të arsyetuar, si rregull kërkon shqiptimin e masës edukative ose të dënimit kundër të miturit të akuzuar, (paragrafi 1 i nenit 63 i KDM). Propozimi i arsyetuar si akt akuzues është rezultat i zhvillimit të procedurës përgatitore ose rezultat i faktit se prokurori i shtetit konsideron se informacionet me të cilat disponon për veprën

penale dhe për të miturin e pandehur paraqesin bazë të mjaftueshme për paraqitjen e propozimit.

Propozimi i arsyetuar është akt formal procedural i cili i paraqitet gjykatës nga ana e prokurorit të shtetit në formë të shkruar, ose përjashtimisht duke e shënuar në procesverbal të shqyrtimit gjyqësor, kur vjen deri te zgjerimi ose ndryshimi i propozimit gjatë kësaj faze të procedurës.

Propozimi i arsyetuar duhet të përfshijë: të dhënat personale të të miturit (emrin dhe mbiemrin, moshën, klasën në të cilën vijon mësimin etj.), përshkrimin e veprës penale, emërtimin ligjor të veprës penale me përcaktimin e dispozitave të Kodit Penal, provat të cilat tregojnë se i mituri ka kryer veprën penale, rezultatet e ndonjë ankete sociale të zbatuar nga Shërbimi Sprovues dhe propozimin për shqiptimin e masës edukative ose dënimit ndaj të miturit, (paragrafi 2 i nenit 63 i KDM).

Propozimi i arsyetuar i dërgohet gjykatës kompetente (gjyqtarit për të mitur) në kopje të mjaftueshme. Së bashku me propozimin, gjykatës së çështjes i dërgohet edhe lënda e kompletuar, përfshirë të dhënat e grumbulluara gjatë zhvillimit të procedurës përgatitore.

Shqyrtimi gjyqësor

Shqyrtimi gjyqësor përfaqëson fazë të veçantë të procedurës penale për të mitur në të cilën gjykata pas shqyrtimit të gjithanshëm të provave, duhet të vendosë për arsyeshmërinë e propozimit të arsyetuar të prokurorit të shtetit. Së këndejmi, sipas paragrafit 1 të nenit 69 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, gjyqtari për të mitur pas pranimit të propozimit të arsyetuar, mund të merr aktvendim për hedhjen e propozimit të parashtruar apo për transferin e çështjes në ndonjë gjykatë tjetër. Një aktvendim të tillë gjyqtari për të mitur mund ta marrë atëherë kur çmon se vepra me të cilën është ngarkuar i mituri, nuk paraqet vepër penale, kur ekzistojnë rrethanat të cilat përjashtojnë përgjegjësinë penale, kur ka kaluar afati i parashkrimit apo kur vepra është përfshirë me amnisti ose falje apo ekzistojnë rrethana tjera të cilat e pengojnë ndjekjen, kur nuk ka prova të mjaftuara që mbështesin dyshimin e bazuar se i mituri ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet, kur propozimi nuk është ngritur nga prokurori i shtetit kompetent dhe kur çmon se gjykimi i veprës penale është në kompetencë të gjykatës tjetër. Nëse gjyqtari për të mitur nuk merr aktvendim për hedhjen e propozimit ose transferin e çështjes në gjykatë tjetër, ai do të caktojë shqyrtimin gjyqësor brenda 8 ditëve nga dita e pranimit të propozimit, (paragrafi 2 i nenit 69 i KDM).

Rrjedhimisht, trupi gjykues për të mitur mund të pushojë procedurën e shqyrtimit gjyqësor dhe të shqiptojë masën e diversitetit, nëse i mituri pranon përgjegjësinë penale për veprën e kryer dhe kur shpreh gatishmëri që të pajtohet me palën e dëmtuar. Para se të marrë një masë të tillë trupi gjykues për të mitur dëgjon të miturin, prindin e tij, prindin adoptues, kujdestarin dhe mbrojtësin, (paragrafi 3 i nenit 69 i KDM).

Shqyrtimi gjyqësor si rregull mbahet në selinë dhe lokalet e gjykatës. Megjithatë, në raste të caktuara seanca mund të mbahet edhe në lokale të tjera.

Publiciteti

Sipas paragrafit 1 të nenit 71 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, kur gjykohet i mituri, publiku përjashtohet nga shqyrtimi gjyqësor. Pavarësisht kësaj, trupit gjykues për të mitur megjithatë i është ofruar mundësia që të lejoj që në shqyrtim gjyqësor të marrin pjesë ekspertë dhe persona të tjerë, të cilët profesionalisht trajtojnë mirëqenien dhe edukimin e të miturve ose luftimin e sjelljeve kriminale të të miturve, (paragrafi 2 i nenit 71 i KPP). Gjatë seancës gjyqësore trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë që të gjithë personat ose personat e caktuar të largohen nga seanca me përjashtim të të miturit, prokurorit, mbrojtësit, përfaqësuesit të organit të kujdestarisë dhe përfaqësuesit të Shërbimit Sprovues. Në fakt, trupi gjykues për të mitur mund të urdhërojë që prindi, prindi adoptues ose kujdestari të largohen nga shqyrtimi gjyqësor vetëm në rrethana të jashtëzakonshme, nëse ka arsye për të besuar se kjo është në interesin më të mirë të të miturit, (paragrafi 3 i nenit 71 i KDM).

Shtyrja e shqyrtimit gjyqësor

Gjyqtari për të mitur, me propozimin e palëve, por vetëm në situata shumë specifike mund të vendosë që shqyrtimi gjyqësor i caktuar të shtyhet për një ditë tjetër. Për çdo shtyrje apo ndërprerje të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari për të mitur duhet ta njoftojë kryetarin e gjykatës, duke ia paraqitur arsyet për këtë, (neni 72 i KDM). Më tutje, nëse prokurori i shtetit tërhiqet nga ndjekja para fillimit të shqyrtimit gjyqësor, gjyqtari për të mitur njofton personat e thirrur në shqyrtim gjyqësor për ndërmarrjen e veprimit të tillë nga ana e prokurorit.

Palët dhe i dëmtuari në thirrjen për shqyrtim gjyqësor njoftohen për pranimin e fajësisë së të miturit, nëse ka ardhur deri te një situatë e tillë, ndonëse në procedurën penale për të mitur “fakti i pranimit të veprës penale” duhet të merret me shumë kujdes dhe rezervë.

Aplikimi i dispozitave të KPPK, në procedurën ndaj të miturve

Në procedurën penale për të mitur aplikohen përshtatshëmrisht dispozitat e Kodit të Procedurës Penale lidhur me drejtimin e shqyrtimit gjyqësor, procesverbalin dhe zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor (neni 76 i KDM).

Është e rëndësishme të theksohet se trupi gjykues për të mitur nuk është i lidhur me propozimin e prokurorit të shtetit me rastin e marrjes së vendimit të tij lidhur me llojin e masës ose dënimit që do të shqiptohet, (paragrafi 1 i nenit 73 i KDM).

Ndryshimi dhe zgjerimi i propozimit

Në procedurë për të mitur, po ashtu aplikohet ndryshimi dhe zgjerimi propozimit. Megjithatë, trupi gjykues për të mitur është i autorizuar të marrë vendim madje edhe nëse prokurori i shtetit nuk ka ndryshuar propozimin e tij ose nëse nuk ka përgatitur propozim të ri, në bazë të gjendjes faktike e cila ka ndryshuar në shqyrtim gjyqësor, (paragrafi 3 i nenit 70 i KDM).

Procedura lidhur me bashkim veprash penale

Në rast se i mituri përgjigjet për vepra penale në bashkim, pa marrë parasysh se kur konstatohet se janë kryer ato, para ose pas shqiptimit të masës edukative apo dënimit me burgim për të mitur, gjykata i shqipton të miturit vetëm një masë edukative ose vetëm dënimin me burgim për të mitur.

Format e vendimeve në procedurën ndaj të miturve

Vendimet në procedurë penale për të mitur jepen në formë të aktvendimit dhe aktgjykimit. Me aktvendim në procedurë penale për të mitur zgjidhen si çështjet procedurale ashtu edhe çështja kryesore. Me aktvendim vendoset kur: *Pushohet procedura penale, (paragrafi 2 i nenit 73 i KDM).. Kur trupi gjykues shqipton masën edukative, masën e trajtimit të detyrueshëm ose dënimin plotësues.*

Çka përmban dispozitivi i aktvendimit te procedura ndaj të miturit

Në dispozitivin e aktvendimit shënohet vetëm masa që shqiptohet, por i mituri nuk shpallet fajtor për veprën penale të përshkruar në propozimin e prokurorit të shtetit. Në këto raste, në arsyetimin e aktvendimit bëhet përshkrimi i veprës penale dhe i rrethanave që e arsyetojnë aplikimin e masës së shqiptuar, (paragrafi 3 i nenit 73 i KDM).

Gjykata vendosë me aktgjykim kur të miturit ia shqipton dënimin, (paragrafi 4 i nenit 73 i KDM). Aktgjykimi merret konform dispozitave të KPPK, me të cilat rregullohet aktgjykimi dënues. Në aktgjykim, përveç të dhënave të cilat i përmban aktgjykimi dënues në procedurën penale të rregullt përfshihet edhe urdhri për shqiptimin e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitimin e kryerësve të mitur të varur nga droga ose alkooli, kur janë në pyetje persona me këto varësi si dhe dënimi alternativ kur gjykata ka shqiptuar dënimin e tillë.

Kur i mituri mund të obligohet t'i paguaj shpenzimet e procedurës dhe kërkesën pasurore-juridike

Gjykata mund të urdhërojë të miturin që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe të plotësojë kërkesën pasurore juridike vetëm kur të miturit i shqipton dënimin. Ndërsa, në rastet kur të miturit i shqiptohet masa edukative, shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, kurse për realizimin e kërkesës pasurore juridike i dëmtuari udhëzohet në kontest civil. Mirëpo, nëse vlerësohet se i mituri ka të ardhura të veta financiare ose pronë, gjykata mund të urdhërojë që i mituri t'i paguaj shpenzimet e procedurës si dhe të përmbushë kërkesën pasurore juridike edhe në rastin kur atij i është shqiptuar masa edukative, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 75 të KDM).

Shpallja e vendimit gjyqësor në procedurën ndaj të miturve

Mungesa e publicitetit në procedurën penale kundër të miturit përfshinë edhe momentin e shpalljes së vendimit gjyqësor. Në të vërtetë, në kuadër të kësaj procedure,

publikisht mund të shpallet vetëm ajo pjesë e vendimit për të cilin ekziston leja, por duke pasur kujdes që të mos përmendet emri i të miturit dhe të dhënat tjera në bazë të të cilave mund të konkludohet se për cilin të mitur është fjala. Këto ndalesa janë paraparë në interes të të miturit dhe kjo me qëllim që aq sa është e mundur, të mos dëmtohet e ardhmja e tij.

Afati për hartimin e aktgjykimit në procedurën ndaj të miturve

Më në fund, duhet theksuar se në procedurën penale kundër të miturve aktvendimi, përkatësisht aktgjykimi duhet të përpilohet me shkrim brenda 8 ditëve nga dita e shpalljes së tij, kurse në raste që vlerësohen të ndërlikuara brenda 15 ditësh nga dita e shpalljes së tij, (neni 74 i KDM).

Mjetet juridike

Edhe në procedurën penale për të mitur, ngjashëm si dhe në procedurën penale të përgjithshme hasen mjetet juridike. Ato edhe në këtë procedurë janë të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Mjet i rregullt juridik është ankesa. Sipas paragrafit 1 të nenit 77 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur personat e autorizuar për paraqitjen e ankesës mund të paraqesin atë kundër aktvendimit mbi shqiptimin e masës së diversitetit, aktvendimit për pushim të procedurës në shqyrtim gjyqësor, aktvendimit për shqiptimin e masës edukative, aktgjykimit mbi shqiptimin e dënimit dhe aktgjykimit apo aktvendimit për shqiptimin e masës së trajtimit të detyrueshëm, brenda afatit prej 8 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit ose aktgjykimit.

Duke pasur parasysh interesat e të miturit dhe për dallim nga procedura penale që zhvillohet për persona të rritur, me paragrafin 2 të nenit 77 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur është paraparë mundësia që mbrojtësi, prokurori i shtetit, bashkëshorti, prindi, prindi adoptues ose kujdestari, i afërmi i gjakut në vijë të drejtë në çfarëdo shkalle, vëllai dhe motra të mund të ushtrojnë ankesë edhe kundër dëshirës së të miturit. Karakteristikë e veçantë e procedurës penale për të mitur është se i mituri nuk mund të heqë dorë nga e drejta e tij në ankesë. Rrjedhimisht, ankesa e paraqitur kundër aktvendimit me të cilën është shqiptuar masa edukative e mbajtjes në institucion e pezullon ekzekutimin e masës së tillë. Sidoqoftë gjykata mund të vendosë të ekzekutojë masën edukative pavarësisht nga ankesa, nëse vjen në përfundim se kjo është në interesin më të mirë të të miturit, por këtë ajo mund ta bëjë vetëm pasi ta ketë dëgjuar të miturin, prindin e tij, prindin adoptues apo kujdestarin, (paragrafët 3 dhe 4 të nenit 77 të KDM).

Veçoritë e procedurës ndaj të miturve në gjykatën e shkallës së dytë (Apelit)

Sidoqoftë Gjykata e Apelit edhe në procedurën penale për të mitur ka autoritetin që në varësi të gjendjes që e karakterizon rastin konkret, vendimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetojë, ndryshojë apo anulojë. Parimisht, vendimet e tilla Gjykata e Apelit i merr në përputhje me rregullat e përgjithshme që vlejnë lidhur me këto çështje në procedurën që zhvillohet për persona të rritur. Veçoria e kësaj procedure këtu qëndron në faktin se Gjykata e Apelit mund të ndryshojë vendimin kundër të cilit është ushtruar ankesa dhe të shqiptojë masë më të rëndë vetëm nëse një gjë të tillë e ka kërkuar prokurori i shtetit me ankesën e tij. Po ashtu, Gjykata e Apelit mund të shqiptojë burgimin për të mitur përkundër asaj që këtë nuk e ka bërë gjykata themelore, por vetëm nëse ajo mban shqyrtim. E njëjta mundësi është paraparë edhe në rastin kur Gjykata e Apelit shqipton ndonjë masë edukative institucionale, (paragrafët 1 dhe 2 të nenit 78 të KDM). Pra, edhe në këto raste, për të ardhur deri te kjo situatë, Gjykata e Apelit duhet të mbaj shqyrtim gjyqësor.

Përmbajtja e ankesës dhe bazat për paraqitjen e saj janë të njëjta si në procedurë penale që zbatohet për persona të rritur.

Mjetet e jashtëzakonshme juridike në procedurën ndaj të miturve

Si mjete të jashtëzakonshme juridike edhe në procedurën penale për të mitur janë: rishikimi i procedurës penale, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit dhe kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë. Në këtë rrjedhë, ngase kemi të bëjmë me çështje thujse identike, dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të cilat rregullojnë çështjen e rishikimit të procedurës penale të përfunduar me aktvendim të formës së prerë dhe ato mbi kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, zbatohen përshtatshëm për rishikim të procedurës penale ndaj të miturit, e cila është pushuar në shqyrtim gjyqësor, me aktvendim të formës së prerë me të cilin është shqiptuar masa edukative ose aktgjykim të formës së prerë me të cilin është shqiptuar dënimi dhe për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë. Në anën tjetër, kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është paraparë si mundësi për t'u ushtruar vetëm kundër aktgjykimit të formës së prerë me të cilin është shqiptuar dënimi, përkatësisht aktvendimit të formës së prerë me të cilin është shqiptuar masa edukative.

PROCEDURAT GJYQËSORE QË PËRFSHIJNË VEPRAT PENALE TË KRYERA NDAJ FËMIJËVE

Me Kodin e Drejtësisë për të Mitur, krahas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, janë paraparë një mori garancish të cilat kanë për qëllim mbrojtjen adekuate të fëmijëve dhe të miturve, të cilët janë atakuar me veprën penale dhe atë jo vetëm gjatë zhvillimit të procedurës penale por edhe gjatë ushtrimit të aktiviteteve të Shërbimit Sprovues dhe organit të kujdestarisë. Veçmas kjo përkujdesje në mbrojtjen e fëmijës së atakuar me veprën penale të kryer nga personi madhor është shprehur duke siguruar mënyrë të veçantë të marrjes së deklaratave nga fëmijët, pastaj në statusin e dëshmitarit dhe në përgjithësi duke pasur kujdes që gjatë veprimeve procedurale të mos shkaktohen pasoja të dëmshme në edukimin dhe zhvillimin e personit të ri.

Si rregull procedura penale ndaj kryerësve madhorë të veprave penale zhvillohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale. Mirëpo, në rastet kur procedura zhvillohet për disa vepra penale të cilat i kanë kryer personat madhorë ndaj fëmijëve, me të cilat është cenuar rëndë dinjiteti, morali dhe zhvillimi i drejtë i fëmijës, Kodi i Drejtësisë për të Mitur ka paraparë shprehimisht se në raste të tilla, gjykimi i personave madhorë do të bëhet nga trupi gjykues për të mitur apo nga gjyqtari për të mitur.

Trupi gjykues për të mitur ose gjyqtari për të mitur, krahas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale, në rastet kur personat madhorë kryejnë disa vepra penale ndaj fëmijëve të cilat do të pasqyrohen në vazhdim, do t'i zbatojë edhe dispozitat e posaçme të Kodit të Drejtësisë për të Mitur. Këto dispozita të posaçme janë paraparë me qëllim që gjatë zbatimit të procedurës penale, maksimalisht të kursehet personaliteti i fëmijës, dhe atë jo vetëm nga traumat dhe të këqijat që ka pësuar si viktimë e veprës penale por edhe në kontekst të shmangies të pasojave të mundshme të dëmshme që mund ta përcjellin edukimin dhe zhvillimin e tij të mëvonshëm.

Lloji i veprave penale të cilat është i autorizuar t'i gjykojë trupi gjykues për të mitur ose gjyqtari për të mitur, kur gjykohen personat madhorë për veprat penale të kryera ndaj fëmijëve

Sipas paragrafit 1 të nenit 145 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur trupi gjykues për të mitur dhe gjyqtari për të mitur, janë kompetentë t'i gjykojnë personat madhorë për këto vepra penale të parapara me Kodin Penal të Kosovës të cilat kryhen ndaj fëmijëve:

Dhunimin;kryerjen e akteve seksuale me kërcënim të nderit dhe autoritetit;sulmin seksual;degradimin e integritetit seksual;keqpërdorimin seksual të personave me çrregullime mendore ose emocionale ose me paaftësi mendore;keqpërdorimin seksual të personave nën moshën 16 vjeçare;nxitjen e akteve seksuale ose të prekjes seksuale nga personat nën moshën 16 vjeçare;shpërdorimin seksual duke keqpërdorë pozitën, autoritetin ose profesionin;mundësimin e prostitucionit;keqpërdorimin e fëmijëve në pornografi;tregtimin e materialit pornografik personave nën moshën 16 vjeçare;marrëdhëniet seksuale brenda familjes;bashkëjetesën me persona nën moshën 16 vjeçare;ndryshimin e statusit familjar të fëmijës;rrëmbimin e kundërligjshëm të fëmijës;keqtrajtimit ose braktisjen e fëmijës;shkeljen e detyrimeve familjare;shmangien

nga ndihma për mjete jetese; pengimin dhe mosekzekutimin e masave për mbrojtjen e fëmijëve; rekrutimin dhe regjistrimin e personave ndërmjet moshës 15 e 16 vjeçare në konflikt të armatosur; vendosjen e skllavërisë, kushteve të ngjashme me skllavërinë dhe punës së detyruar; trafikimin me njerëz dhe fshehjen e dokumenteve të identifikimit të viktimave të skllavërisë dhe trafikimit me njerëz.

Kur merret në pyetje si dëshmitar, fëmija ndaj të cilit është kryer ndonjëra nga veprat penale të lartcekura, ai mund të merret në pyetje më së shumti dy herë. Kjo marrje në pyetje, për arsytet që u theksuan më lart, duhet të zbatohet me ndihmën e pedagogut, psikologut apo ekspertit tjetër. Fëmija ndaj të cilit është kryer ndonjëra nga veprat penale të lartcekura mund të merret në pyetje si dëshmitar jashtë gjykatores përmes televizionit në qark të mbyllur. Madje, për t'iu shmangur gjykatës dhe procedurave të cilat zhvillohen në gjykatë, e cila për shkak të natyrës dhe atmosferës e cila zakonisht është e pranishme dhe e cila mund të shkaktojë pasoja të dëmshme ndaj fëmijës, trupi gjykues mund të vendosë që fëmija të merret në pyetje në shtëpinë e tij ose në ndonjë lokacion tjetër ku ndodhet ai ose në qendrën për punë sociale. Edhe në këtë rast marrja në pyetje zbatohet me ndihmën e personave profesionist. Incizimi teknik i marrjes në pyetje përmes televizionit me qark të mbyllur, duhet të asgjësohet brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e vendimit, (paragrafët 2, 3 dhe 4 të nenit 174 të KDM). Procedura e tillë duhet të jetë konfidenciale, ashtu që incizimet e tilla është e ndaluar që të bëhen publike pa autorizim të gjykatës. Në rast se incizimi i tillë bëhet publik, është e ndaluar që të zbulohen të dhënat personale të cilat do të mundësonin identifikimin e fëmijës.

KOMPETENCA TERRITORIALE E GJYKATËS KUR GJYKOHEN PERSONAT MADHORË PËR VEPRAT PENALE TË KRYERA NDAJ FËMIJËVE

Sipas nenit 150 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, për zhvillimin e procedurës penale për personat madhorë kur ata kryejnë vepra penale ndaj fëmijëve, kompetente është gjykata në territorin e të cilës është adresa e përhershme e vendbanimit të palës së dëmtuar, në këtë rast e fëmijës. Edhe në lidhje me çështjen e definimit të kësaj kompetence, ligjdhënësi ka pasur parasysh interesat e fëmijës.

Përkundër faktit se kur është në pyetje kompetenca territoriale, përparësi i është dhënë gjykatës së vendbanimit të palës së dëmtuar, ligjdhënësi ka paraparë mundësinë që në rastet kur vlerësohet se procedura do të zbatohet më lehtë në gjykatën në territorin e të cilës është kryer vepra penale, që procedura të zhvillohet para asaj gjykate, (neni 150 i KDM).

PËRBËRJA E TRUPIT GJYKUES PËR TË MITUR ME RASTIN E GJYKIMIT TË PERSONAVE MADHORË PËR VEPRAT PENALE TË KRYERA NDAJ FËMIJËVE

Sipas paragrafit 1 të nenit 152 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, personat madhorë për veprat penale të kryera ndaj fëmijëve, gjykohen nga trupi gjykues për të mitur. Megjithatë, në çdo situatë kërkohet që aplikimi i këtyre dispozitave t'i përshtatet rastit konkret.

Përbërja e trupit gjykues

Trupi gjykues për të mitur i gjykatës themelore do të përbëhet nga gjyqtari për të mitur dhe dy gjyqtarë porotë. Megjithatë, në rastet kur është në pyetje vepra penale e dënueshme prej së paku 15 vjet burgim, trupi gjykues i gjykatës themelore do të përbëhet nga pesë gjyqtarë, prej të cilëve dy profesionalë dhe tre porotë. Në këtë rast është parashikuar obligimi që njëri prej gjyqtarëve profesional të jetë gjyqtarë për të mitur, (paragrafi 1 i nenit 152 i KDM).

Në Gjykatën Supreme të Kosovës trupi gjykues kur gjykohen personat madhorë për veprat penale të kryera ndaj fëmijëve, përbëhet prej tre gjyqtarëve në rastet kur gjykon në shkallë të dytë. Ndërkaq kur procedura zhvillohet për vepër penale për të cilën është paraparë dënimi prej të paktën 15 vjet burgim, trupi gjykues përbëhet nga pesë gjyqtarë, prej të cilëve tre duhet të jenë gjyqtarë për të mitur. Kur gjykon në shkallë të dytë (Gjykatën e Apelit), në seancë shqyrtimi, trupi gjykues për të mitur përbëhet nga dy gjyqtarë për të mitur dhe tre porotë. Ndërkaq, kur gjykon në shkallë të tretë dhe vendosë për mjetet e jashtëzakonshme juridike, trupi gjykues përbëhet në përputhje me zgjidhet të cilat Kodi i Procedurës Penale i parasheh për rastet kur zhvillohet procedurë penale ndaj të rriturve. Trupi gjykues do të ketë përbërje në përputhje me zgjidhjen e lartcekur edhe kur çështja gjykohet në seancë në të cilën nuk ka shqyrtim. Në këtë rast së paku një anëtar i trupit gjykues duhet të jetë gjyqtar që gjykon çështjet e të miturve, (paragrafët 2 dhe 3 të nenit 152 të KDM).

Më në fund duhet theksuar se në rastet e përcaktuara me ligj personat madhorë për veprat penale të kryera ndaj fëmijëve mund të gjykohen edhe nga gjyqtari i vetëm gjykues.

KARAKTERISTIKAT TJERA TË PROCEDURËS PENALE QË PËRFSHIJNË VEPRAT PENALE TË KRYERA NGA PERSONAT MADHORË NDAJ FËMIJËVE

Përveç karakteristikave të theksuara më lart, procedura penale e cila zhvillohet ndaj personave madhorë që kryejnë vepra penale ndaj fëmijëve, i përmban edhe disa karakteristika tjera të cilat e bëjnë atë të veçantë në krahasim me procedurën penale që zhvillohet në situatat e rëndomta, ndaj personave madhorë.

Karakteristikë e veçantë e kësaj procedure është se gjyqtari për të mitur është i obliguar që në mënyrë të rregullt ta informojë organin e kujdestarisë për të gjitha faktet dhe provat e vërtetuara në procedurë penale, të cilat kanë kontribuar ose mundësuar kryerjen e veprës penale. Ky aktivitet është parashikuar me qëllim që organi i tillë t'i ndërmarrë përballë obligimeve që ka, masat e duhura për mbrojtjen e të drejtave dhe mirëqenien e fëmijës.

Karakteristikë e veçantë e kësaj procedure është edhe fakti se nëse gjatë kësaj procedure vërtetohet se prindi po i keqpërdorë ose së tepërmi po i lë pas dore detyrat prindërore, përkatësisht të drejtat ose po i shkelë të drejtat e fëmijës, prokurori i shtetit do ta fillojë procedurën jokontestimore për heqjen e të drejtave për përkujdesje prindërore nga ana e prindit të tillë.

Më në fund njëra prej karakteristikave thelbësore të procedurës penale e cila zhvillohet ndaj personave madhorë për veprat penale të kryera ndaj fëmijëve, është urgjenca. Pra, ngjashëm dhe për arsye identike si në rastin kur gjykohen të miturit, edhe në këto situata ligjdhënësi kërkon që procedura në fjalë të zbatohet shpejt dhe pa vonesa të paarsyeshme.

■ **LIGJI MBI EKZEKUTIMIN E SANKCIONEVE PENALE**

PJESA E PARË

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

DISPOZITAT THEMELORE

Sipas dispozitave të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), ekzekutohen dënimet kryesore, dënimet alternative, dënimet plotësuese, masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik të kryesit të veprës penale me paaftësi mendore ose aftësi të zvogëluar mendore, masa e trajtimit me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga dhe alkooli si dhe vërejtja gjyqësore.

Sipas dispozitave të këtij ligji ekzekutohen edhe sanksionet penale që gjykatat e huaja u kanë shqiptuar shtetasve të Republikës së Kosovës. Ekzekutimi i këtyre sanksioneve, kryhet vetëm në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare ose me zbatimin e parimit të reciprocitetit. Aktgjykimin për ekzekutimin e sanksionit penal të shqiptuar nga gjykata e huaj, e merr kolegji prej tre gjyqtarëve i gjykatës kompetente të qarkut.

Ekzekutimi i dënimit me burgim, dhe i dënimit me gjobë

Për ekzekutimin e sanksioneve penale kompetente, është gjykata themelore Që ka shqiptuar dënimin në shkallë të parë, gjithashtu edhe në situatat kur Gjykata e Apelit ka shqiptuar dënimin, kompetente për ekzekutimin e dënimit është gjykata themelore, që e ka proceduar çështjen në shkallë të parë.

Ekzekutimi i dënimit me burgim, me burgim të përjetshëm, kryhet nëpërmjet dërgimit të të dënuarit për mbajtjen e dënimit në institucionin korrektues për vuajtje të dënimit.

Ditën e fillimi të dënimit me burgim-me burgim të përjetshëm, të personit të dënuar që është në liri, gjykata e urdhëron me shkrim dhe urdhri i dërgohet personit të gjykuar. Në urdhër, përcaktohet dita kur i dënuari, duhet të paraqitet në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit.

I dënuari i urdhëruar për t'u paraqitur ditën e caktuar në institucionin për mbajtjen e dënimit me burgim, me burgim të përjetshëm mund të paraqesë kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit. Kërkesën e tillë mund ta paraqes vetëm i dënuari. Kërkesa duhet të mbështetet në prova që vërtetojnë se ekzistojnë arsyet e pretenduara për shtyrje të ekzekutimit të dënimit. Në kërkesë, duhet treguar kohën për të cilën kërkohet, shtyrja e ekzekutimit të dënimit.

Sëmundja, si arsye për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, duhet të jetë në të njëjtën kohë akute dhe e rëndë. Ekzistimi i sëmundjes së rëndë dhe akute, provohet me raport mjekësor të lëshuar nga institucioni mjekësor, në të cilin trajtohet i dënuar. Raportet mjekësore, janë raporte tremujore, mirëpo në kërkesë të gjykatës ato mund, të jenë edhe raporte për periudha kohore më të shkurtra. Kohëzgjatja e shtyrjes së ekzekutimit të dënimit për këtë arsye, nuk është e kufizuar dhe ajo mund të zgjatë gjer në shërimin e të dënuarit.

Arsye për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit personit të dënuar të gjinisë femërore, është shtatzënia e saj dhe mosha e fëmijërisë. Shtatzënia duhet të ketë përfunduar muajin e gjashtë, ndërsa mosha e fëmijës, duhet të jetë më e re se një vit. Për këto arsye ekzekutimi i dënimit me burgim, mund të shtyhet gjer sa fëmija i lindur nga shtatzënia ekzistuese apo fëmija i lindur me parë, i moshës nën një(1) vjeç, të mbushë moshën tre(3) vjeç. Shtatzënia, vërtetohet me dokumentacionin mjekësor ndërsa mosha e fëmijut me certifikatën nga libri amzë i të lindurve.

Vdekja e bashkëshortit, fëmijës, fëmijës së adoptuar, prindit ose prindit adoptues të të dënuarit, është arsye për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit në kohëzgjatje gjer në tre muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së dënimit. Vdekja, provohet me certifikatën nga libri i amzës për të vdekur.

Shtatzënia e bashkëshortes së të dënuarit, është arsye për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit për gjashtë muaj, nëse koha e lindjes së bashkëshortes shtatzëne, është më e shkurtër se tre muaj nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit të dënimit. Për këtë dhe për arsyen se bashkëshortja e të dënuarit ka lindur gjatë muaj më parë nga dita e fillimit të shtyrjes së ekzekutimit të dënimit dhe nuk ka anëtarë tjerë të familjes që mund t'i ndihmonin asaj fillimi i ekzekutimit të dënimit, mund të shtyhet për më së largu gjashtë muaj.

Më së largu gjashtë muaj ditë nga dita e fillimit të shtytjes së ekzekutimit të dënimit personit të dënuar, mund t'i shtyhet ekzekutimi i dënimit, nëse bashkëshorti i të dënuarit apo anëtari i bashkësisë së përbashkët, është në mbajtje të dënimit, apo ata për ta, është urdhëruar fillimi i vuajtjes së dënimit në të njëjtën kohë me të dënuarin. Fakti se bashkëshorti apo i afërmi i familjes, është në mbajtje të dënimit, provohet me vërtetim nga institucioni korrektues, ndërsa fakti se ndonjëri prej tyre, është ftuar në mbajtje të dënimit. Vërtetohet me urdhrin e dërguar atyre për fillimin e ekzekutimit të dënimit.

Punët sezonale në bujqësi, janë të atilla që ato duhet kryer në kohën e caktuar. Moskryerja e tyre në sezonin e caktuar, mund të ketë pasoja të rënda për të dënuarin.

I dënuari, mund të ketë pësuar ndonjë fatkeqësi që i ka shkaktuar dëm material dhe fillimi i ekzekutimit të dënimit, mund të ketë pasoja për të dënuarin, nëse fillon ta mbajë dënimin, pa eliminuar pasojat e fatkeqësisë. Nevoja për kryerjen e punëve sezonale dhe nevoja për eliminimin e pasojave të fatkeqësisë, mund të jenë arsye për shtyrjen e dënimit, vetëm nëse ato punë familja e të dënuarit, nuk to të mund t'i kryente pa të dënuarin në mungesë të fuqisë punëtore. Për këto arsye fillimi i ekzekutimit të dënimit, mund të shtyhet për më së largu tre(3) muaj.

Punë e filluar para ditës së fillimit të ekzekutimit të dënimit, është arsye për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit më së largu tre muaj. Puna e filluar, duhet të jetë e natyrës së tillë që moskryerja e saj, do të mund t'i shkaktonte të dënuarit dëm të konsiderueshëm. Si punë të tilla, mund të jenë fillimi i ndërtimit të shtëpisë, fillimi i një procesi prodhues që zgjatë një kohë të caktuar etj.

Ekzekutimi i sanksioneve penale, në mes tjerash, ka qëllim edhe përgatitjen e të dënuarit për jetë dhe sjellje të ndërgjegjshme. Shkollimi është një ndër veprimtaritë që e përgatitë njeriun për jetë, prandaj nevoja për të përfunduar shkollimin ose për t'iu nënshtruar një provimi të përgatitur, është arsye për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit më së largu për një kohë prej gjashtë muajsh.

Ekzistimit të arsyeve për të cilat, kërkohet shtyrja e fillimit të ekzekutimit të dënimit, gjykata mund ta hetojë gjithnjë sipas detyrës zyrtare.

I dënuari Lutjen për shtyrjen e fillimit të mbajtjes së dënimit, duhet ta paraqesë më së voni shtatë (7) ditë, nga dita e pranimit të urdhrit me të cilin është urdhëruar të paraqitet ditën e caktuar në institucionin korrektues për mbajtjen e dënimit. I dënuari, mund ta paraqesë kërkesën e tillë më së voni deri në ditën kur në bazë të urdhrit për fillimin e mbajtjes së dënimit, do të duhej të paraqitet në institucionin korrektues, vetëm nëse në kohën në mes të kalimit të afatit prej shtatë (7) ditësh dhe kohës kur do të duhej të paraqitej në institucion për mbajtje të dënimit, është sëmurë rëndë nga ndonjë sëmundje akute ose i ka vdekur bashkëshorti, fëmiju, fëmija i adoptuar, prindi ose prindi adoptues.

Nëse Lutje për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit, nuk përmban prova me të cilat, vërtetohen pretendimet që arsyetojnë shtyrjen, kryetari i gjykatës kompetente komunale kërkon nga personi i dënuar t'ia bashkëngjis kërkesës provat, në afat prej tetë (8) ditësh. Kërkesa e kryetarit të gjykatës, dërguar të dënuarit për bashkëngjitjen e provave, që vërtetojnë pretendimet nga Lutja, duhet të përmbajë edhe paralajmërimin se kërkesa, do të refuzohet nëse në afatin e lënë asaj nuk i bashkëngjiten provat e kërkuara.

Procedura për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit, është urgjente dhe kryetari i gjykatës themelore, duhet vendosur lidhur me lutjen për shtyrjen e dënimit brenda tri (3) ditësh nga dita e pranimit të kërkesës, përveç për nëse nga i dënuari është kërkuar që kërkesës t'i bashkëngjis provat e kërkuara.

Kompetencat e kryetarit të gjykatës themelore, janë të aprovojë lutjen dhe ta shtyj fillimin e mbajtjes së dënimit, të refuzoj lutjen, të hedhë të pa lejuar lutjen, nëse ajo është paraqitur jashtë afatit prej tri ditësh, kur lutja është paraqitur nga personi i paautorizuar ose kur i dënuari nuk i bashkëngjit provat, që mbështesin kërkesën në afatin e caktuar (neni 23 paragrafi 2).

Në rastin e hedhjes së kërkesës dhe kur ajo refuzohet e pabazuar, zbatohet parimi i dy shkallëshmërisë. Për hedhjen dhe refuzimin e kërkesës, kryetari i gjykatës themelore merr aktvendim, kundër të cilit i dënuari ka të drejtë ankese në afat prej tri ditëve, kryetarit të Gjykatës së Apelit.

Kërkesa për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit, pengon ekzekutimin gjersa lidhur me të, vendoset me vendim të formës së prerë.

Shtyrja e ekzekutimit të dënimit, mund të urdhërohet edhe në procedurën sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike, kërkesës për rishikimin e procedurës penale dhe kërkesës për mbrojtjen ligjshmërisë. Me dispozitën e nenit 29 paragrafi 2 i LESP, gabimisht është theksuar se mbajtja e dënimit mund të shtyhet edhe me rastin e ushtrimit të kërkesës për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, sepse sipas nenit 418. par.2 të KPPK, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit mund të paraqitet gjatë mbajtjes së dënimit, ndërsa sipas nenit 430.par.2. të KPPK, kërkesa për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, nuk pezullon ekzekutimin e dënimit.

Për shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit në procedurën për rishikimin e procedurës penale, kompetente është gjykata që ka marrë aktgjykimin në shkallë të parë, që është edhe gjykatë kompetente, për të vendosur lejimin e rishikimit të procedurës penale.

Kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë mund të paraqesin : i pandehuri, mbrojtësi dhe Prokurori Publik i Kosovës. I pandehuri dhe mbrojtësi në kërkesë mund të propozojnë shtyrjen e fillimit të ekzekutimit të dënimit dhe kompetencë për të shtyrë ekzekutimin e dënimit, kanë gjykata e shkallës së parë dhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Kur kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të dënimit e paraqet Prokurori Publik i Kosovës, shtyrja e ekzekutimit të dënimit, është e domosdoshme.

Ekzekutimi i dënimit me gjobë

Dënimin me gjobë, e ekzekuton gjykata që ka shqiptuar dënimin e tillë. Dënimin e tillë mund ta shqiptojnë të gjitha gjykatat, ato themelore, E Apelit dhe Gjykata Supreme e Kosovës. Kur personi i dënuar, nuk dëshiron apo nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë, gjykata mundet që dënimin me gjobë t'ia zëvendësoj me dënim me burgim, duke llogaritur një ditë burgimi njëzet euro(20), ndërsa pa marrë parasysh lartësinë e dënimit me gjobë, dënimi i zëvendësuar me burgim, nuk mund të jetë më i gjatë se tre (3) vjet, ose t'ia zëvendësoj dënimin me gjobë me dënim me Urdhër për punë në dobi të përgjithshme nëse për një punë të tillë pajtohet i gjykuari (neni 46 i KPK).

E DREJTA CIVILE

3

■ PJESA E PËRGJITHSHME

E drejta civile është dega më e vjetër e së drejtës. Njëherësh, ajo është edhe një ndër degët më me rëndësi të sistemit juridik të një shteti. E drejta civile pozitive nënkupton tërësinë e normave juridike të cilat rregullojnë marrëdhëniet shoqërore me karakter pasuror, përkatësisht të atyre marrëdhënieve shoqërore qëllimi i fundit i të cilave është karakteri pasuror.

I. PARIMET E SË DREJTËS CIVILE

Marrëdhëniet juridike civile karakterizohen me parimet e përbashkëta që kanë, andaj edhe këto parime i përcaktojnë marrëdhëniet ndërmjet subjekteve. Të gjitha marrëdhëniet shoqërore të cilat kanë karakter pasuror e që janë të rregulluara me norma të cilat i përkasin të drejtës civile bazohen në këto parime:

- 1) Barazia e palëve dhe e vullneteve të tyre,
- 2) Iniciativa e lirë e palëve,
- 3) Qarkullueshmëria e të drejtave subjektive civile dhe
- 4) Sanksioni pasuror.

1. Barazia e palëve dhe e vullneteve të tyre në marrëdhëniet juridike civile.

Në marrëdhëniet juridike civile subjektet janë të barabarta, pavarësisht nga statuset e veta që kanë në shoqëri, të barabarta janë edhe vullnetet e tyre. Në këtë mënyrë vullneti i njëjës palë nuk i nënshtrohet vullnetit të palës tjetër, siç është në të drejtën dhe në marrëdhëniet administrative. Barazia e palëve dhe e vullneteve të tyre është

paraparë edhe në dispozitat ligjore me të cilat rregullohen marrëdhëniet juridike civile konkrete. Ky parim është parashikuar edhe me nenin 3 të Ligjit Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), sipas së cilës dispozitë pjesëmarrësit në marrëdhënien detyimore janë të barabartë.

2. Iniciativa e lirë e palëve (liria e vullnetit).

Ky parim nënkupton iniciativën e lirë të palëve në themelimin e marrëdhënieve juridike civile. Shumë marrëdhënie juridike civile themelohen dhe varen nga dispozitat ligjore të cilat janë me karakter detyrimor, apo të atilla që, pavarësisht nga vullneti i subjekteve, janë të pranishme në marrëdhëniet civile juridike. Mirëpo, subjektet juridiko civile lirisht vendosin nëse do të hyjnë në ndonjë marrëdhënie juridike civile, me këndë dhe kur do të hyjnë, se çfarë do të jetë ajo, çka është kryesore e çka e dorës së dytë, etj. Autonomia e vullnetit në të drejtën sendore vjen në shprehje nëpërmjet lirisë së shfrytëzimit dhe disponimit të pronës, në të drejtën e detyrimeve nëpërmjet të lirisë së kontraktimit (neni 2 i LMD) dhe përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit mbi bazën e fajësisë, ndërsa në të drejtën e trashëgimisë nëpërmjet të shprehjes së vullnetit të fundit me anë të testamentit.

3. Qarkullueshmëria e të drejtave subjektive civile.

Të drejtat subjektive civile, bartësit e tyre, sipas marrëveshjes së lirë, mund t'i bartin nga njëri në tjetrin. Pronari i një sendi, nëpërmjet një pune juridike, pronësinë e bartë në personin tjetër, ky në të tretin e kështu me radhë. Autori mundet të drejtën e botimit të veprës së vetë ta bartë në botuesin. Në këtë aspekt, qarkullimi i së drejtës ekziston vetëm në të drejtën civile. Ky qarkullim nuk ekziston në të drejtën administrative, ku të drejtat dhe detyrimet e organit administrativ, sipas ligjit, janë të lidhura për atë organ.

4. Sanksioni pasuror.

Nëse nuk realizohet marrëveshja e lidhur në bazë të vullnetit të lirë të subjekteve juridiko civile, apo nëse ndonjëri subjekt nuk sillet në pajtim me atë që është përcaktuar sipas asaj marrëveshje, do to vije në shprehje sanksioni ndaj atij subjekti, si shprehje e domosdoshme e ndonjë norme të caktuar ligjore. Me këtë sanksion goditet masa pasurore e subjektit. Kësisoj, në marrëdhëniet juridike civile sanksioni është gjithnjë pasuror dhe i përket pasurisë së palës pjesëmarrëse në marrëdhënien juridike civile. Ky sanksion nuk ka asgjë të përbashkët me atë penal apo administrativ.

II. SUBJEKTET E SË DREJTËS CIVILE

Me marrëdhënie juridike civile nënkuptojmë marrëdhënien juridike e cila bazohet në rregullat e së drejtës civile nga edhe krijohet, ndryshohet apo shuhet ndonjë e drejtë subjektive, e bazuar në të drejtën objektive. Marrëdhëniet juridike civile janë të llojllojshme, qoftë sipas llojit, sipas mënyrës si krijohen, varësisht nga afati i zgjatjes, apo nga veprimi etj. Mirëpo pavarësisht nga lloji, mënyra e krijimit, zgjatjes dhe efektit, të gjitha ato kanë elementet e përbashkëta e këto janë:

- 1) Subjekti në marrëdhëniet juridike civile,
- 2) Objekti i marrëdhënies juridike civile dhe
- 3) Të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia juridike civile.

Të drejtat dhe detyrimet në marrëdhëniet juridike civile ndryshojnë varësisht nga vetë marrëdhënia juridike civile, prandaj varësisht nga marrëdhënia e caktuar juridiko civile mund të bëhet fjalë edhe për të drejtat dhe detyrimet e subjekteve nga kjo marrëdhënie.

5. Llojet e subjekteve të së drejtës civile

Subjektet në marrëdhëniet juridike civile janë bartësit e të drejtave dhe të detyrimeve, që nënkupton subjektin të cilit i përket ndonjë e drejtë apo ndonjë detyrim nga një marrëdhënie juridike civile. Subjekte të së drejtës civile mund të jenë:

- a) *personat fizik dhe*
- b) *personat juridik.*

6. Personi fizik, si subjekt i së drejtës-fitimi i subjektivitetit, zotësia juridike

Çdo qenie njerëzore që lind e gjallë, përpos ndonjë monstrumi, në të drejtën civile tek ne trajtohet si person fizik me cilësi të subjektivitetit në marrëdhëniet juridike civile. Nga kjo rrjedh se personi fizik fiton subjektivitetin e së drejtës nga momenti i lindjes. Përrjashtim nga kjo rregull paraqet fëmija i zënë i cili akoma nuk ka lindur, me kusht që të lind i gjallë. Sipas Ligjit të trashëgimisë (neni 7.1 i LTK)¹ edhe fëmija i cili ka qenë i zënë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, ka të drejtë në trashëgimi, me kusht që të lind i gjallë brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit (neni 7.2 i LTK).

¹ Ligji për Trashëgiminë i Kosovës (më tutje LT) nr. 2004/26 i datës 28 korrik 2004 i shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (më tutje PSSP) me dt. 04 shkurt 2005.

Kjo do të nënkuptonte se çdo person fizik si dhe fëmija i porsazënë ka zotësi juridike dhe mund të jetë subjekt i së drejtës civile, që nënkupton se mund të jetë bartës i të drejtave dhe detyrimeve në tërë vëllimin e përcaktuar me dispozitat konkrete ligjore. Përndryshe, personi fizik, përpos zotësisë juridike, mund të ketë edhe zotësinë e veprimit dhe zotësinë e deliktit.

7. Shuarja e subjektivitetit

Zotësia juridike do të zgjas gjatë gjithë kohës sa është gjallë personi fizik, përkatësisht ajo do të shuhet me vdekjen e personit fizik, apo me shpalljen e personit fizik për të vdekur.

Vdekja e njeriut është çështje faktike, nga edhe nuk ka problem për caktimin e kohës së vdekjes. Vdekja regjistrohet në librin amzë për të vdekurit, ku shënohet edhe koha e vdekjes. Mirëpo, mund të ndodhë që, për shkak të mungesës së ndonjë personi për një kohë më të gjatë, vështirë është të konkludohet nëse është i gjallë apo i vdekur. Me qëllim të sigurimit të ekzistimit të të drejtave, ekziston instituti i shpalljes për të vdekur.

Për të iniciuar procedurën për shpalljen e personit për të vdekur nevojitet që ai person të mungoj nga vendqëndrimi i tij një kohë të caktuar dhe të mos dihet ku ndodhet dhe nëse është gjallë apo jo. Ky institut veçmas është bë aktual në Kosovë pas luftës së fundit të viteve 1998 dhe 1999, nga se shumë persona janë të zhdukur dhe nuk dihet ku ndodhen dhe nëse janë gjallë apo jo.

Kushtet dhe procedura për të shpallur një person për të vdekur janë rregulluar me Ligjin e Procedurës Jokontestimore². Për të vendosur lidhur me propozimin për shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur kompetente është gjykata themelore sipas vendbanimit të përhershëm të fundit, e nëse nuk ka pasur vendbanim të përhershëm, sipas vendbanimit të përkohshëm të personit i cili duhet shpallur për të vdekur (neni 63 lidhur me nenin 50 të LPJ). Procedurën e zhvillon dhe aktvendimin e merr gjyqtari individual (neni 63 lidhur me nenin 50.2 të LPJ).

Procedurën mund ta inicioj çdo person i cili ka interes juridik të drejtpërdrejtë si dhe Organi i Kujdestarisë 61 i LPJ). Me aktvendimin me të cilin një person do të shpallet për të vdekur, nëse mund të vërtetohet, do të caktohet edhe dita, nëse është e mundur edhe ora, për të cilën konsiderohet se ka vdekur. Nëse ora dhe dita e vdekjes nuk mund të vërtetohen, atëherë konsiderohet se vdekja ka ndodhur ditën e parë pas kalimit të afateve të parapara ligjore nga neni 59 i LPJ (neni 65.3 i LPJ) për shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur. Në të drejtën trashëgimore, në rastet kur nuk ka mund të vërtetohet dita e vdekjes, si ditë e vdekjes e personit të zhdukur konsiderohet dita kur aktvendimi me të cilin personi është shpallur për të vdekur, është bë i plotfuqishëm (neni 125.1 i LTK). Nëse pas plotfuqishmërisë së aktvendimit për shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur kuptohet se personi ka vdekur tjetër ditë nga ajo që është

2 Ligji për Procedurën Jokontestimore (më tutje LPJ) 2008/03-L-007 i datës 20.11.2008 i shpallur me Dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës DL-068-2008 i datës 13.12.2008 dhe i publikuar në Gazetën Zyrtare të RK nr. 45 të dt. 12.01.2009.

konstatuar në aktvendim, me propozimin e çdo personi i cili ka interes juridik, gjykata, pas zhvillimit të procedurës, sa i përket datës së vdekjes, do të ndryshoj aktvendimi e mëparshëm.

Aktvendimi me të cilin personi i zhdukur shpallet për të vdekur vetëm supozon vdekjen e personit dhe ky supozim do të qëndroj dhe ekzistoj deri sa nuk provohet e kundërta. Personi i cili është shpallur për të vdekur, nëse është gjallë, duhet të paraqitet personalisht në gjykatë. Gjykata, pasi të vërtetohej identitetin e tij, pa procedurë tjetër do ta abrogoj aktvendimin me të cilin ai person është shpallur për të vdekur. Nëse pas plotfuqishmërisë së aktvendimit për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur gjykata, në çfarëdo mënyre informohet se ai person është i gjallë, në bazë të propozimit të personit i cili ka interes juridik ose sipas detyrës zyrtare, do të zhvilloj procedurën për abrogimin e aktvendimit me të cilin ai person është shpallur si i vdekur.

Sa u përket efekteve juridike të shpalljes së personit të zhdukur për të vdekur, ato janë të njëjta si të vdekja natyrore, nga se hapet trashëgimia, nëse ka pasur martesë ajo shuhet, si edhe me rastin e vdekjes. Nëse është zhvilluar dhe është përfunduar procedura e trashëgimisë, në rast të kthimit të personit i cili është shpallur për të vdekur, ai mund të kërkoj t'i kthehet pasuria e tij, e nëse ndonjëri trashëgimtar i shpallur ka qenë me keqbesim, e ka ditur se nuk ka vdekur, do ta kthej edhe atë pasuri që e ka shpenzuar, e trashëgimtarët me mirëbesim, të cilët nuk e kanë ditur se është gjallë, do ta kthejnë vetëm pasurinë të cilën e kanë në momentin e kthimit të saj.

8. Zotësia e veprimit e personave fizik

Zotësia e veprimit e personit fizik nënkupton zotësinë e një personi për të ndërmarr personalisht veprime juridike me qëllim të përfitimit të drejtave dhe marrjes së detyrimeve.

Sipas ligjit në fuqi zotësia e plotë e veprimit në rregull fitohet me arritjen e moshës madhore (neni 15.2 dhe 3 i LFK)³ ose me lidhjen e martesës, në bazë të lejimit nga ana gjykatës, pasi që personi t'i ketë mbushur 16 vjet. Personat fizik të cilit nuk i kanë mbushur 18 vjet janë persona të mitur, andaj edhe nuk e kanë zotësinë e plotë të veprimit. Mirëpo, te personat nën moshën 18 vjeçare zotësia e veprimit nuk është e njëjtë.

Personat nga mosha 15 vjeçare deri në moshën madhore e kanë zotësinë e veprimit të kufizuar nga se kanë mundësi të lidhin kontratë të punës, dhe të disponojnë vet të ardhurat e tyre personale dhe pasurinë që e kanë fituar me punën e tyre (neni 217.2 i LFK). Ata kanë detyrim që sipas mundësive të kontribuojnë në ushqimin, edukimin dhe arsimimin e tyre si dhe për ushqimin e familjes në nivel të arsyeshëm (neni 217.2 i LFK). Personi i cili i ka mbushur 16 vjeç mund të përpiloj edhe testament (neni 70.2 i LTK). Personat fizik të mitur, para se t'i mbushin 14 vjeç, nuk kanë zotësi veprimi, si dhe personat e moshës madhore të cilëve u është marr zotësia e veprimit. Në të drejtën tonë personi madhor mund të shpallet i paaftë për të vepruar nëse nuk është

³ Ligji për Familjen i Kosovës (më tutje LFK) 2004/32, Gazeta Zyrtare e IPVQ-ve, nr. 4/2006 e datës 1 shtator 2006,

në gjendje të kujdeset për të drejtat dhe interesat e veta (neni 31 i LPJ). Arsye për këtë, në rregull, mund të jetë sëmundja mendore dhe shpirtërore e në raste të veçanta edhe të metat fizike. Procedura për heqjen e zotësisë për të vepruar fillohet dhe zhvillohet sipas detyrës zyrtare, sipas propozimit të personave të interesuar për këtë ose sipas propozimit të vetë personit të cilit duhet ti hiqet zotësia, nëse ai është në gjendje të kuptoj rëndësinë dhe pasojat e propozimit. Procedura zhvillohet sipas rregullave të procedurës jokontestimore në gjykatën themelore sipas vendbanimit, përkatësisht vend - qëndrimit të fundit të personit të cilit duhet t'i hiqet zotësia e veprimit. Vendos gjyqtari individual. Me aktvendim mund t'i hiqet vetëm pjesërisht apo në tërësi zotësia e veprimit (neni 31 i LPJ).

9. Zotësia deliktore e personit fizik

Marrëdhënia juridike mund të rrjedhë edhe nga veprimi i ndaluar – delikti. Delikti juridiko civil dallon nga ai penal. Pasoja e deliktit civil (ai i cili në të drejtën civile përfaqëson veprimin e ndaluar) është lindja e detyrimit për dëmshpërblim. Në këtë aspekt zotësia deliktore nënkupton zotësinë e personit fizik të përgjigjet për veprimet e veta nga masa e vetë pasurore.

Sipas një rregulle të përgjithshme, edhe në të drejtën civile, për veprimin e ndaluar shkaktuesi i dëmit përgjigjet vetëm nëse ka qenë i vetëdijshëm për veprimin e vetë, që nënkupton se edhe zotësinë e deliktit nuk e ka çdo person fizik. Në këtë aspekt personi i mitur nën moshën 14 vjeç dhe personi madhor të cilit i është hequr në tërësi zotësia e veprimit nuk e kanë zotësinë deliktore. Për veprimet e tyre përgjigjen personat të cilët kanë pasur detyrim të kujdesen për ata, që përfaqëson edhe përgjegjësinë e personave të tretë.

10. Personi juridik, si subjekt i së drejtës - fitimi dhe shuarja e subjektivitetit

Subjekt i së drejtës civile, përpos personit fizik, mund të jetë edhe personi juridik. Cilësia e personit juridik të një subjekti duhet ta pranohet edhe nga rendi juridik i shtetit, nga se personi juridik, përkundër personit fizik i cili është krijesë natyrore, ai është krijesë shoqërore, e cila përbëhet nga një grup njerëzish apo disa njerëz të organizuar në bazë të ligjit.

Kjo krijesë shoqërore duhet të ketë edhe pasuri të angazhuar për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën është formuar.

Nga kjo rrjedhë se personi juridik duhet:

- Të ketë organizimin formal (organet dhe aktet normative),
- Të ketë pasuri të vetën për tu përgjigjur për detyrimet që rezultojnë nga marrëdhëniet juridike civile,
- Të ushtron veprimtari të caktuar dhe
- Të jetë e regjistruar si subjekt juridik sipas ligjit.

Duke pasur parasysh faktin se personat juridik me cilësi të subjektit juridik në të drejtën civile janë disa llojesh, edhe fitimi i subjektivitetit të personave juridik dallon varësisht se për cilat persona juridik është fjala. Në rregull, personi juridik e fiton cilësinë e subjektit juridik në momentin e regjistrimit në regjistrin zyrtar të parashikuar me ligj. Në këtë mënyrë e fitojnë cilësinë e personit juridik shoqëritë tregtare, ndërmarrjet e ndryshme punuese, shoqatat e ndryshme, partitë politike etj. Në dallim nga këto vetë shteti dhe njësitë tjera shtetërore e fitojnë këtë cilësi në bazë të Kushtetutës dhe ligjit.

Personi juridik shuhet me çregjistrimin nga regjistri zyrtar, me të cilin regjistrim edhe e ka fituar këtë cilësi.

11. Dallimet përkitazi me zotësinë juridike dhe të veprimit mes personave fizik dhe juridik

Zotësia juridike dhe ajo e veprimit e personit juridik ndryshon nga zotësia juridike dhe ajo e veprimit e personit fizik. Personat juridik e kanë të ashtuquajturën zotësi juridike dhe të veprimit të specializuar, të cilat janë më të ngushta dhe të kufizuara në krahasim me ato të personit fizik. Personi juridik mund të jetë bartës i të drejtave, detyrimeve dhe përgjegjësive vetëm në kuadër të veprimitarisë për të cilën është themeluar. Përndryshe kufijtë e zotësisë juridike dhe të veprimit të personit juridik janë të përcaktuara me ligj ose statut të atij personi juridik.

III.OBJEKTET E MARRËDHËNIEVE JURIDIKE CIVILE

Përkitazi me objektin marrëdhënia juridike civile krijohet, ndryshohet dhe shuhet. Nga kjo objekti është parakusht për krijimin e marrëdhënies juridike civile. Objekt i të drejtës civile mund të jetë gjithë ajo që, në një mënyrë apo në tjetrën, mund të shprehet në vlerë ekonomike - monetare. Andaj edhe objekte të së drejtës civile në marrëdhënie juridike civile janë.

- 1) Sendet,
- 2) Veprimet e njeriut,
- 3) Vlerat personale dhe
- 4) Pasuria si objekt i së drejtës civile.

1. Sendet

Sendet janë objekti më me rëndësi i të drejtës civile. Gjatë zhvillimit historik të njerëzimit ka ndryshuar edhe kuptimi i sendeve. Pavarësisht nga kjo, sendet janë pjesë materiale e natyrës. Pjesa e natyrës për të qenë send në aspektin e të drejtës civile duhet të plotësoj dy kushte:

- a) *Kushti fizik – ajo pjesë e natyrës të mund të jetë në pushtetin e njeriut,*
- b) *Kushti juridik – sistemi juridik duhet t'ia pranoj cilësinë e sendit.*

Në këtë aspekt në kuptimin fizik si sende mund të konsiderohen të gjitha pjesët e natyrës të cilat mund të jenë në pushtetin e njeriut dhe që i shërbejnë ndonjë nevojë të njeriut. Mirëpo vetëm kjo nuk mjafton. Ka shumë sende që, edhe pse e plotësojnë këtë kusht, nuk janë sende në të drejtën civile, ato janë jashtë qarkullimit dhe si të tilla ndaj tyre nuk mund të fitohen të drejtat civile, siç konsiderohen sot të mirat publike, si rrugët, publike, parqet, tregjet, ujërat etj. Në këtë aspekt, sipas të drejtës tonë, ato janë sende, të mira publike nën rezhimin administrativ, jashtë qarkullimit, nuk mund të jen objekt i marrëdhënieve juridike civile.

2. Veprimet e njeriut

Çdo veprim i njeriut nuk e ka cilësinë e objektit të marrëdhënieve civile juridike. Këtë cilësi e ka vetëm ai veprim i njeriut i cili në ndonjë mënyrë është shprehur në vlerë monetare. Në bazë të një pune konkrete juridike njëra pala mund të merr për detyrim të kryen veprime të caktuara, ndërsa pala tjetër ta shpërblen atë. Në këtë marrëdhënie juridike veprimi i njeriut është objekt. Është i shprehur në vlerë monetare.

Edhe përmbajtja nga një veprim i caktuar i cili në rregull është i lejuar, mosveprimi, nëse ajo përmbajtje përfaqëson ndonjë interes për palën tjetër, mund të jetë objekt i së drejtës civile, p.sh. moskultivimi i kulturave të larta në arë të vetën për të mos penguar dritën në paluajtshmërinë e fqinjit.

3. Vlerat personale

Vlerat personale, në kuptimin më të gjerë e jo vetëm në atë ekonomik, janë vlerat më të mëdha në jetën e njeriut. Këto janë të mbrojtura nga të gjitha degët e së drejtës. Mirëpo në të drejtën civile ato përfaqësojnë objekte të së drejtës dhe gëzojnë mbrojtjen juridike civile vetëm në ato raste nëse mund të shprehen në vlerë ekonomike.

Vlerat personale shërbejnë si objekt i të drejtave personale, andaj edhe ato janë të lidhura për personin dhe i takojnë atij. Ato nuk mund të barten në tjetrin e as të trashëgohen dhe shuhet me vdekjen e tij.

4. Pasuria si objekt i së drejtës civile

Pasuria është grup të drejtash të cilat i takojnë një personi. Këtu bëjnë pjesë vetëm të drejtat subjektive civile, që nënkupton ato të drejta të cilat në mënyrë të drejtpërdrejt apo të tërthortë për objekt kanë sendet, përkatësisht paratë, si lloj të veçantë të sendeve. Subjektet e ndryshme juridike hynë ndërmjet veti në marrëdhënie juridike civile me qëllim të krijimit të vlerave pasurore, nga edhe rrjedhë se edhe pasuria është e krijuar në qarkullimin ekonomik, nga edhe paraqitet objekt i së drejtës civile. Në këtë aspekt pasuria si objekt i së drejtës civile nënkupton tersin e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të një subjekti juridik.

Të gjitha të drejtat nga të cilat përbëhet pasuria si tërësi, përkatësisht të drejtat në pasuri quhet masa pasurore. Masa pasurore gjithmonë përbëhet nga sendet e caktuara, mirëpo që ato gjithmonë të mund të shprehen në vlerë monetare. Nga kjo rrjedhë se masa pasurore mund të jetë në qarkullim juridik, që nënkupton bartjen e të drejtave në sendet nga masa pasurore. Pasuria ndahet në aktivë dhe pasivë. Aktiven e përbëjnë të gjitha të drejtat, ndërsa pasiven të gjitha detyrimet.

IV. TË DREJTAT SUBJEKTIVE CIVILE

5. Nga rrjedhin dhe çka përmbajnë

E drejta e subjektit, qoftë person fizik apo juridik, në një marrëdhënie juridike civile e cila rrjedhë nga e drejta objektive (e zbatueshme) nënkupton të drejtën subjektive. E drejta subjektive mund të rrjedh nga vetë ligji (e drejta e fëmijës për ushqim nga prindërit dhe e kundërta) apo nga ndonjë punë juridike (kontrata).

E drejta subjektive përmban një apo më shumë autorizime, p.sh. e drejta e pronësisë për pronarin nënkupton tri autorizime kryesore: 1. që sendin, pronar i të cilit është, ta mbaj në posedim, 2. ta sigurojë dhe ta shfrytëzoj dhe 3. të disponoj me atë send (neni 1 i LPDTS)⁴.

Çdo të drejte subjektive i përgjigjet detyrimi i një apo më shumë personave. Ajo që paraqet të drejtë për një subjekt, për subjektin tjetër paraqet detyrim, p.sh. e drejta për ushqim e fëmijës nga ana e prindit, si e drejtë subjektive civile ligjore, ushqimi për fëmijën paraqet një të drejtë e kjo njëherësh për prindërit paraqet detyrim të kontribuojnë për ushqimin e fëmijës dhe anasjelltas.

Subjekti në një marrëdhënie juridike i cili disponon me një të drejtë quhet edhe titullar apo person i autorizuar. Përkundër kësaj, subjekti i cili në atë marrëdhënie juridike civile ka detyrime thirret person përgjegjës.

Përpos autorizimit, element tjetër i së drejtës subjektive civile është kërkesa, apo padia në aspektin material. Kërkesa definohet si mundësi e realizimit të dhunshëm të

⁴ Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (më tutje LPDTS) Ligji nr. 03/L-154, GZ nr. 57 datë 04.08.2009,

autorizimit nga e drejta subjektive, zakonisht nëpërmjet të gjykatës. Për nga përmbajtja e drejta subjektive është pushtet i cili sigurohet me të drejtën objektive. Ky pushtet është i orientuar gjithmonë ndaj personave tjerë.

6. Ndarja e të drejtave subjektive civile

Varësisht nga elementet e përbashkëta që kanë dhe varësisht nga raporti që ekziston ndërmjet të drejtave dhe detyrimeve, të drejtat subjektive civile ndahen në:

- 1) Të drejtat subjektive civile absolute,
- 2) Të drejtat subjektive civile relative.

7. Llojet e të drejtave subjektive civile absolute varësisht nga objekti

Varësisht nga objekti i së drejtës të drejtat subjektive civile absolute ndahen

- 1) Të drejtat sendore,
- 2) Të drejtat personale.

Të drejtat sendore për objekt i kanë sendet. Më kryesorja nga këto është e drejta e pronës e nga kjo rrjedhin të drejtat tjera sendore si e drejta e servitutit dhe e pengut.

Të drejtat personale janë të drejta të karakterit personal dhe për objekt kanë të mirat personale ashtu që nuk hynë në kuadër të pasurisë së personit dhe në rregull nuk trashëgohen. Ato ndahen në:

- 1) Të drejtat personale nga marrëdhëniet familjare dhe statutet personale, të cilat kanë të bëjnë me statusin juridiko civil të personit, të cilat ndryshe quhen edhe të drejta personale jo pronësore, siç janë: mosha madhore, zotësia juridike, zotësia e veprimt, e drejta për të qenë trashëgimtar ligjor etj.
- 2) Të drejtat e personalitetit të cilat për objekt i kanë vlerat e personalitetit, të parashikuara edhe me kushtetutë, siç janë: e drejta në integritetin personal, moral dhe shpirtëror, në lirinë e lëvizjes, lirin e mendimit dhe të shprehurit, në punë, zgjedhjen e profesionit, etj.
- 3) Të drejtat e autorit e që janë ato të drejta të cilat për objekt kanë produktin e mendjes dhe shpirtit të njeriut, siç janë: puna shkencore, vepra letrare, piktura skulptura etj.

8. Dallimi mes të drejtave absolute dhe relative varësisht nga raporti ekzistues mes të drejtave dhe detyrimeve

Absolute janë ato të drejta subjektive a. Të cilat veprojnë ndaj të gjithëve – erga omnes, pra të drejtës së titullarit i përgjigjet detyrimi i të gjithë personave tjerë; b. Paraprakisht nuk është i përcaktuar dhe nuk dihet numri i personave përgjegjës; c. Detyrimi i personave përgjegjës është gjithmonë negativ, që nënkupton se qëndron në

përmbajtje nga ndonjë veprim i caktuar me të cilin do të pengohej titullari në autorizimet që ka; ç. Raporti i titullarit ndaj personave tjerë nuk është i konkretizuar paraprakisht, andaj edhe paraprakisht nuk është i shprehur në para; d. Detyrimi i të gjithë personave ndaj titullarit të së drejtës është i plotë dhe dh. Nuk vjetërsohen me kalimin e kohës.

Në dallim nga të drejtat absolute, te të drejtat relative: a. Detyrimi i përket vetëm personave të caktuar; b. Zakonisht detyrimi është pozitiv që nënkupton se personi përgjegjës duhet të ndërmerret një veprim ose të jep diçka; c. Raporti ndërmjet titullarit të së drejtës me personat tjerë është paraprakisht i ditur dhe i konkretizuar; ç. Autorizimi i titullarit të së drejtës është detyrim për subjektin tjetër; d. Detyrimi gjithmonë është i konkretizuar dhe i njohur dhe dh. Me kalimin e kohës së parashikuar me ligj vjetërsohen.

Në këtë mënyrë te të drejtat absolute është i caktuar vetëm titullari, p.sh. te e drejta e pronësisë paraprakisht dihet vetëm pronari i një sendit të caktuar, ndërsa personat përgjegjës paraprakisht nuk dihen, pasi që kjo e drejtë vepron ndaj të gjithë personave tjerë, andaj edhe çdo person mund të jetë përgjegjës. Te të drejtat relative janë të caktuar edhe titullari i së drejtës edhe ai i detyrimit, si p.sh. në marrëdhënien juridike nga shitblerja.

9. Krijimi, ndryshimi dhe shuarja e të drejtave subjektive civile

- Faktet juridike

Paraqitja e fakteve të caktuara juridike mundëson krijimin, ndryshimin apo shuarjen e të drejtave subjektive civile. Vetëm ekzistimi i normës objektive nuk nënkupton edhe krijimin e ndonjë të drejte subjektive. Për krijimin e një të drejte subjektive konkrete të paraparë me të drejtën objektive, përkatësisht të një marrëdhënie juridike, është e nevojshme të ekzistoj një rrethanë shoqërore konkrete e jetës e cila edhe mundëson zbatimin e dispozitës së caktuar nga e drejta objektive. Në këtë aspekt faktet juridike janë ato rrethana të jetës për shkak të ekzistimit, ndryshimit apo shuarjes së të cilave, në bazë të drejtës objektive, krijohet, ndryshohet apo shuhet një marrëdhënie juridike. Këto konsiderohen fakte vendimtare për të cilat është e lidhur ndonjë e drejtë subjektive. Në të drejtën civile vendimtare janë ato fakte për të cilat është i lidhur krijimi, ndryshimi apo pushimi i marrëdhënies juridike civile.

Faktet juridike ndahen në **ndodhi** apo **ngjarje natyrore** (si lindja, vdekja, sëmundja shpirtërore, kalimi i kohës, fatkeqësitë elementare etj.) dhe në **veprime të njeriut** (punët juridike, deliktet etj.). Ndodhitë natyrore nuk varen nga vullneti i njeriut.

Veprimet e njeriut ndahen në veprime të lejuara dhe të palejuara (deliktet). Ato të lejuara ndahen në veprime në pajtim me të drejtën, që nënkupton se nuk janë të ndaluara me ligj por nuk janë ndërmarr me qëllim të krijimit, ndryshimit apo të shuarjes së ndonjë marrëdhënie juridike civile si p.sh. gjetja e sendit dhe veprimet e dëshirueshme të cilat nënkuptojnë shprehjen e vullnetit me qëllim të krijimit, ndryshimit apo të shuarjes të ndonjë marrëdhënie juridike civile, siç janë punët juridike.

10. Supozimet dhe fiksionet juridike

Procedura lidhur me vërtetimin e ekzistimit apo mos ekzistimit të një apo disa fakteve juridike, në të shumtën e rasteve, është e mundimshme, kërkon kohë dhe shkakton shpenzime. Për këtë arsye, si në teori poashtu edhe në praktikë, shumë fakte juridike nënkuptohen, qoftë si fakt i supozuar (prezumcion) qoftë si fiksion juridik.

Supozimet juridike janë mjete juridike teknike me ndihmën e të cilave, nga faktet e njohura nxirret konstatimi për ekzistimin e fakteve të panjohura. Fakt juridik i supozuar konsiderohet ai fakt juridik për të cilin mund të kuptohet nga vetë rrethanat konkrete, për të cilën arsye edhe nuk provohet nëse diç e tillë nuk kërkohet posaçërisht. Me Ligjin për Procedurën Kontestimore (neni 321 par. 4)⁵ janë paraparë pasojat procedurale juridike të supozimeve, ashtu që është parashikuar se faktet e supozuara nuk argumentohen nëse posaçërisht ajo nuk kërkohet.

Përkritazi me mundësinë e kundërshtimit, supozimet ndahen në ato të rrëzueshme dhe të parrëzueshme. Kjo ndarje është me rëndësi nga se ligji lejon mundësinë e argumentimit vetëm të supozimeve të rrëzueshme, ndërsa te ato të parrëzueshme përjashtohet mundësia e argumentimit të së kundërtës.

Edhe fiksionet janë mjete të teknikës juridike. Si fiksion juridik konsiderohet ai fakt juridik për të cilin dihet se nuk ekziston por merret se ekziston, ose e kundërta, dihet se ekziston por merret se nuk ekziston p.sh. “ Fëmija i zënë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit merret si i lindur, me kusht që të lind i gjallë” edhe pse dihet se nuk ekziston (neni 7.1 i LTK). Në kohën e sotme fiksionet janë shumë të rralla.

11. Mënyra e fitimit të drejtave subjektive civile

Të drejtat subjektive civile fitohen në bazë të ligjit apo me punë juridike. Mbi këtë bazë ligjore shkenca juridike dallon dy mënyra të fitimit të të drejtave subjektive civile dhe atë: 1. Derivative apo rrjedhëse dhe 2. Origjinere apo burimore.

Fitimi i së drejtës subjektive civile nga shkakut se ashtu është parashikuar me ligj nënkupton fitimin origjinar ose burimor. Kjo nënkupton se ajo e drejtë nuk bazohet në të drejtën e paraardhësit të saj, në ndonjë punë juridike e as që ndodhet në ndonjë varshmëri me ndonjë subjekt tjetër. Në këtë mënyrë të fitimit bëjnë pjesë fitimi i së drejtës nga jopronari, në bazë të posedimit etj.

Mënyra derivateve e fitimit nënkupton fitimin e një të drejte subjektive civile në bazë të punës juridike, që nënkupton kalimin e një të drejte nga titullari i mëparshëm i saj. Kjo mënyrë e fitimit është me rëndësi nga se vëllimi i të drejtave të paraardhësit është me ndikim vendimtar në vëllimin e të drejtave të pasardhësit – suksesorit. Në të drejtën vlen parimi i përgjithshëm se askush nuk mund të bartë në tjetrin më tepër të drejta se që ka ai vetë.

5 Ligji për Procedurën Kontestimore (më tutje LPK), Ligji nr. 03/L-006 i datës 30.06.2008 i shpallur me Dekretin e Presidentit të RK nr. DL-04502008 i datës 29.07.2008 i cili zbatohet prej 06 tetor 2008 dhe Ligji nr. 04/L-118 i dt. 13.09.2012 Për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i shpallur me Dekretin e Presidentit të RK DL-045-2012 i datës 28.09.2012.

Qarkullimi juridik në të drejtën civile nënkupton kalimin e të drejtave nga një subjekt në tjetrin, nga një titullar në tjetrin. Ngjashëm me qarkullimin e mallit ku bartet malli nga një subjekt në tjetrin, te qarkullimi juridik barten të drejtat nga një titullar në tjetrin.

Të drejtat subjektive civile të cilat barten me qarkullim juridike janë të drejtat absolute, siç janë: prona, servituti, pengu etj. Në rastet e kalimit të këtyre të drejtave, të drejtat absolute janë objekt i qarkullimit juridik ndërsa punët juridike me të cilat bëhet ky kalim i së drejtës është mjete me të cilin bëhet qarkullimit juridik. Nëpërmjet të punës juridike palët dëshirojnë të arrijnë qëllimin – kauzën si efekt ekonomik të cilin e dëshirojnë.

Për të fituar një të drejtë subjektive civile duhet patjetër të ekzistoj baza juridike e përcaktuar me ligj. Nëse është në pyetje puna juridike si bazë juridike për fitimin e një të drejte subjektive, ajo medoemos duhet të jetë e vlefshme sipas ligjit dhe vetëm si e tillë mund të shërbej si bazë juridike për fitimin e një të drejte subjektive civile. Nëse puna juridike është me të meta në bazë të saj nuk mund të fitohet e drejta edhe pse bartet objekti, ekonomikisht kalon nga njëri subjekt në tjetrin, por në këtë rast nuk do të kalon edhe e drejta subjektive civile.

Sipas të drejtës tonë për fitimin e të drejtave absolute në bazë të qarkullimit juridik është e nevojshme baza juridike (titulus) dhe mënyra e fitimit (modus acquirendi). Nga kjo rrjedh se kusht dhe kërkesë edhe sipas ligjit edhe sipas punës juridike, për fitimin e së drejtës subjektive civile, është baza juridike. Mënyra e fitimit është ajo që duhet bë sipas ligjit, si veprim me qëllim të realizimit të bartjes, përkatësisht për tu realizuar e drejta e fitimit të një të drejte subjektive civile.

12. Sukcesioni universal dhe suksesioni singular

Shikuar nga këndvështrimi i vëllimit të kalimit të të drejtave subjektive civile në mënyrë derivateve dallojmë:

- 1) Sukcesionin universal dhe
- 2) Sukcesionin singular.

Sukcesioni universal nënkupton bartjen, qoftë të pasurisë së përgjithshme apo vetëm të ndonjë pjese të saj, si grumbull të drejtash dhe detyrimesh. Në suksesorin kalojnë edhe të drejtat edhe detyrimet. Sukcesionin universal e kemi te trashëgimia, konfiskimi etj.

Sukcesioni singular nënkupton bartjen e ndonjë të drejte subjektive civile apo të disa të drejtave subjektive të caktuara. Sukcesori universal e fiton të drejtën ashtu si e ka pasur paraardhësi i saj, në të njëjtën përmbajtje dhe vëllim. Kësisoj në suksesorin kalojnë vetëm të drejtat e jo edhe detyrimet.

V. PUNËT JURIDIKE

1. Kuptimi dhe kushtet për krijimin e punës së vlefshme juridike

Me punë juridike në kuptim të gjerë nënkuptojmë çdo shprehje të vullnetit me të cilën krijohet, ndryshohet ose shuhet ndonjë marrëdhënie juridike civile. Shprehjet e vullnetit përfaqësojnë fakte juridike me të cilat krijohen marrëdhënie të llojllojshme juridike. Një lloj i shprehjeve të vullnetit dallohet për nga efekti, e këto janë shprehjet e vullnetit me të cilën jo vetëm që ndryshohet ndonjë marrëdhënie juridike por me të cilat bartet ndonjë send apo ndonjë vlerë tjetër pasurore nga një pasuri në tjetrën. Nga kjo mund të konstatohet se me punë juridike, si mjet të qarkullimit juridik, nënkuptojmë shprehjen e vullnetit e cila krijon të drejta relative (detyrime).

Për të qenë e vlefshme një punë juridike duhet në mënyrë kumulative të plotësohen këto kushte:

- të ekzistoj shprehja e vullnetit,
- të ekzistoj qëllimi (kauza),
- të ekzistoj objekti,
- të ekzistoj lejueshmëria ligjore dhe
- të mos ketë të meta formale.

Vullneti duhet të jetë i lirë dhe serioz. Ai mund të shprehet shprehimisht ose drejtpërdrejt dhe me të nënkuptuar ose tërthorazi. Drejtpërdrejt mund të shprehet me gojë ose me shkrim, apo edhe në mënyrë të heshtur, ndërsa me të nënkuptuar ose tërthorazi mund të rrjedhë nga veprimet apo mos veprimet konkludente.

Qëllimi definohet si efekt ekonomik të cilin palët duan ta arrijnë me punën juridike, p.sh. të shitblerja qëllimi i blerësit është marrja e sendit ndërsa i shitësit pagesa e çmimit. Shikuar nga praktika gjyqësore tek ne, kauza është qëllimi i kontraktimit të cilin kontraktuesit e kanë parasysh, i cili edhe është pjesë përbërëse e kontratës.

Objekti duhet patjetër të jetë i mundshëm i lejuar dhe i caktuar, në të kundërtën puna juridike është nule.

Pjesëmarrësit në qarkullimin juridik duhet të sillën brenda kufijve të asaj që është e lejuar me ligj. Në këtë aspekt për të qenë e vlefshme puna juridike duhet medoemos të jetë e lejuar me ligj, në të kundërtën nëse ligji e ndalon ajo është nule.

Për punët e caktuara juridike është e paraparë forma e caktuar ligjore, andaj edhe puna juridike duhet të lidhet në formën e parashikuar me ligj, Në mungesë të formës së parashikuar me ligj puna juridike është nule.

2. Llojet e punëve juridike

Sipas numrit të vullneteve të shprehura punët juridike ndahen në punë juridike të njëanshme, në të cilat kemi shprehjen e vullnetit vetëm të njëjës palë, siç janë premtimi i shpërblimit, dhënia e letrave me vlerë, etj.

Punët e dyanshme juridike janë ato punë juridike vlefshmëria e të cilave varet nga deklarimi i të dy palëve, dy vullneteve. Këto punë juridike në të drejtën civile njihen si kontrata.

Kontratat mund të jenë:

- me efekt detyrimor vetëm për njëjën palë (kontrata e dhurimit), apo për të dy palët (kontrata e shitblerjes),
- reale, kur ekzistimi i kontratës varet nga dorëzimi i sendit dhe konsensuale, kur dorëzimi i sendit nuk është element qenësor,
- komutative, kur me rastin e kontraktimit dihet objekti, dihet vëllimi i të drejtave dhe detyrimeve apo së paku janë të përcaktueshme dhe
- aleatore, kur me rastin e kontraktimit nuk dihet vëllimi i të drejtave dhe detyrimeve por varet nga e ardhmja,
- me barrë, në rastet kur nga kontrata rrjedhin detyrime dhe bamirëse, në rastet kur sipas kontratës pala nuk ka detyrim,
- formale, atëherë kur me ligj është parashikuar forma e kontratës,
- joformale kur sipas ligjit nuk parashihet forma e caktuar,
- abstrakte, kur nga kontrata nuk shihet qëllimi dhe
- kauzale, shihet qëllimi i lidhjes së asaj kontrate,
- punë juridike mes të gjallëve, (**inter vivos**) dhe
- punë juridike për rast të vdekjes, (**mortus causa**).

3. Punët juridike të pavlefshme, llojet

Nëse mungon ndonjëri nga pesë kushtet e sipërshënuara për themelimin e një pune juridike, atëherë edhe puna juridike ende nuk ekziston. Mirëpo në rastet kur njëri nga ato kushte nuk është i vlefshëm atëherë edhe puna juridike është e pavlefshme. Sipas ligjit në fuqi punët juridike të pavlefshme janë dy llojesh: 1. Punët juridike nule dhe 2. Punët juridike të rrëzueshme (nenet 89 – 102 të LMD)⁶.

⁶ Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (më tutje LMD) Ligji nr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012 i shpallur me Dekretin e Presidentit të RK DL-024-2012 i datës 30 maj 2012 dhe i shpallur në GZ nr. 16 të dt. 19 qershor 2012.

4. Punët juridike nule (nulitetit absolut), shkaqet e nulitetit

Një nga kushtet për vlefshmërinë e një pune juridike ishte që të jetë i lejuar me ligj. Mbi këtë bazë juridike, nule janë punët juridike të cilat janë në kundërshtim me normat e detyrueshme ligjore ose që janë në kundërshtim me normat morale të shoqërisë. Nga kjo, varësisht nga shkakun e nulitetit ato mund të grupohen në dy grupe: punët juridike në kundërshtim me ligjin dhe në punët juridike amorale. Kjo nënkupton se nule janë të gjitha punët juridike të cilat janë në kundërshtim me ligjin. Nule do të jenë edhe ato punë juridike të cilat shprehimisht me ligj nuk janë të ndaluara, mirëpo janë në kundërshtim me moralin shoqëror.

Këto punë juridike nuk prodhojnë efekte juridike që nga fillimi dhe janë nule sipas fuqisë ligjore. Anulimin e tyre mund ta kërkojë çdo person i interesuar e lidhur me këtë gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Punë juridike nule janë edhe punët juridike me fajde, punët juridike fiktive (me qëllim të shpëlarjes së parave lidhet kontrata e shitblerjes), punët juridike simulative (fshehët shitblerja me kontratën e dhurimit). Punë juridike nule mund të jetë edhe ajo e cila është lidhur me detyrim, nëse detyrimi ka qenë i tillë sa që nuk ekziston fare vullneti i personit të detyruar, ashtu që nuk ka as punë juridike (neni 97 i LMD).

Karakteristikë e përbashkët e punëve juridike nule është se e drejta në padë nuk vjetërsohet e as që mund të bëhet konvalidimi i tyre me kalimin e kohës, që nënkupton se kalimi i kohës nuk mund të ketë ndikim në vlefshmërinë e tyre (neni 96 i LMD).

5. Punët juridike të rrëzueshme (nuliteti relativ), shkaqet e anulimit

Punë juridike të rrëzueshme janë ato punë juridike të cilat prodhojnë efekte juridike të caktuara mirëpo, për shkak të të metave që kanë, mund të anulohen nën kushtet e parashikuara ligjore. Këto janë punët juridike të cilat në momentin e krijimit kanë të meta përkitazi me deklarinimin e lirë të vullnetit, kur e ka lidhur pala me aftësi të kufizuar për të vepruar, apo në ndonjë element tjetër i cili është qenësor, mirëpo e cili mund të konvalidohet. Anulimin e tyre mund të kërkojnë vetëm ata persona të cilët kanë interes juridik për konstatimin e nulitetit respektivisht pala kontraktuese, në interesin e së cilës është vërtetuar rrëzueshmëria, mund të kërkojë që kontrata të shpallet e pavlefshme (neni 98.1 i LMD).

Përkitazi me deklarinimin e lirë të vullnetit ka të meta nëse puna juridike është lidhur në ndikim: të kërcënimit, duke e frikësuar lidhur me jetën ose ndonjë të mirë tjetër me rëndësi të palës kontraktuese apo personit tjetër (neni 45 i LMD); lajthimit, përkitazi me objektin, subjektin apo natyrën e punës juridike (neni 46 i LMD); dhe mashtrimit, duke e sjell me vetëdije në lajthim palën tjetër kontraktuese, pavarësisht nëse është apo jo lajthimi esencial (neni 49 i LMD).

Punë juridike të rrëzueshme janë edhe ato të cilat i lidhin të miturit, personat të cilët nuk kanë zotësi të plotë veprimi, të cilëve u është hequr zotësia e veprimit si dhe për shkak të dëmtimit përtej mase (neni 97 i LMD).

Për anulimin e kontratave të rrëzueshme për shkak të të metave në deklarinimin e lirë janë parashikuar me ligj afatet brenda të cilëve mund të kërkohet anulimi i tyre, ashtë që pas kalimit të këtij afati nuk mund të paraqitet kërkesa për anulim (neni 102 i LMD).

6. Kundërshtimi i punëve juridike (Actio Pauliana)

Me padinë Actio Pauliana i mundësohet kreditorit mbrojtja nga debitori i pandërgjegjshëm. Kreditori mund të dëmtohet në mënyrë që nuk mund të realizon kërkesën e vetë nga se debitori ka tjetërsuar me këtë qëllim vlerat nga masa pasurore e tij. Nëse debitori ka ndërmarr një punë juridike me një person të tretë me qëllim që t'i pamundësoj kreditorit realizimin e kërkesës, kreditori ka të drejtë ta konteston me padi atë punë juridike. Në këtë rast palë paditëse është kreditori, ndërsa palë të paditura janë debitori dhe personi i tretë me të cilin debitori ka lidhur punën juridike. Për të pas të drejtë në këtë padi duhet plotësuar këto kushte: a. që për shkak të ndërmarrjes së punës juridike kontestuese kreditori nuk ka mundësi të realizon kërkesën nga pjesa tjetër e pasurisë së debitorit, b. që debitori të ketë qenë i pandërgjegjshëm, përkatësisht të ketë ditur se me ndërmarrjen e kësaj pune juridike i pamundëson kreditorit realizimin e kërkesës dhe c. që personi i tretë të është i pandërgjegjshëm, të ketë ditur për qëllimin e pandërgjegjshëm të debitorit.

Me këtë padi nuk mund të kërkohet që puna juridike e cila kontestohet të shpallet pa efekt juridik në tërësi, nga se ajo nuk është as nule e as e rrëzueshme. Ajo punë juridike nuk është në kundërshtim me normat imperative e as nuk ka të meta përkitazi me shprehjen e vullneteve të palëve. Me këtë padi do të kërkohet që puna juridike të shpallet juridikisht e pavlefshme vetëm përkitazi me paditësin, kreditorin dhe deri në lartësi të kërkesës së kreditorit. Ma aprovimin e kërkesës debitorit i kthehet pasuria e tjetërsuar vetëm në lartësi të kërkesës së kreditorit, me qëllim të realizimit të saj.

7. Pasojat juridike të punëve të pavlefshme juridike

Në rastet kur një punë juridike shpallet e pavlefshme, atëherë nuk kemi më as bazën juridike për të drejtat dhe detyrimet që do të rrjedhin nga ajo, ashtu që në rregull secila palë duhet t'i kthen palës tjetër atë që e ka marr në bazë të kësaj pune juridike (neni 90 i LMD), që nënkupton se duhet kthyer gjendja para kësaj pune juridike e nëse kjo nuk është e mundur duhet të bëhet kompensimi përkatës në të holla sipas çmimeve në kohën e nxjerrjes së vendimit gjyqësor, përveç nëse përcaktohet ndryshe me ligj (neni 90.1 i LMD).

Nga kjo rregull e përgjithshme ligji në fuqi parasheh përjashtime, varësisht nga mirëbesimi apo keqbesimi i palëve. Në këtë mënyrë, nëse puna juridike për nga përmbajtja është në kundërshtim me parimet themelore kushtetuese dhe dispozitat ligjore imperative, gjykata mundet palës me keqbesim t'ia refuzoj pjesërisht apo në

tërësi kërkesëpadinë për kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër (neni 90.2 i LMD). Në keqbesim është pala nëse ka ditur apo ka mund të dijë për pavlefshmërinë e punës juridike.

Pala e cila është fajtoare për lidhjen e kontratës së pavlefshme, me anulimin e punës juridike, ka përgjegjësi për dëmin e shkaktuar ndaj palës tjetër kontraktuese, nëse ai nuk ka ditur dhe nuk ka mund të dijë për shkaqet e anulimit (neni 100 i LMD).

8. Mundësia e konvalidimit të punëve juridike të pavlefshme

Konvalidimi nënkupton përmirësimin e punës juridike të rrëzueshme nga pala e cila ka të drejtë të kërkon anulimin e saj. Për të qenë konvalidimi i vlefshëm duhet që: 1. iniciativa për konvalidim të rrjedhë nga pala e cila ka të drejtë të kërkojë anulimin e kontratës dhe 2. në momentin e konvalidimit të ketë pushuar së ekzistuari shkaku i rrëzueshmërisë së punës juridike. Në këtë mënyrë kontrata të cilën e ka lidhur pala me zotësi veprimi të kufizuar mund të konvalidohet pasi ajo palë të ketë fituar zotësinë e plotë të veprimit. Në anën tjetër nëse një person e ka lidhur kontratën në lajthim, nën ndikimin e mashtrimit apo detyrimit, konvalidimi mund të bëhet pas evitimit të shkaqeve që e bëjnë kontratën të pavlefshme.

Përndryshe, konvalidimi mund të bëhet në dy mënyra: a.. shprehimisht dhe b. në mënyrë të heshtur. Shprehimisht bëhet atëherë kur personi i cili ka pasur të drejtë të kërkon anulimin e punës juridike shprehimisht deklaron se heq dorë nga kjo e drejtë dhe punën juridike e konsideron juridikisht të vlefshme. Ndërsa, në mënyrë të heshtur bëhet kur personi i cili ka të drejtë të kërkon anulimin, duke kuptuar paraprakisht për shkaqet e anulimit, e përmbush detyrimin që rrjedh nga puna juridike dhe kështu heshtazi e fuqizon punën juridike.

Nga mënyrat e paraqitura të konvalidimit rrjedh se ai është akt juridik i njëanshëm dhe për vlefshmërinë e këtij akti nuk kërkohet pëlqimi i palës tjetër. Ky akt ka veprim retroaktiv ashtu që konsiderohet se puna juridike ka qenë e vlefshme që nga momenti i lidhjes së saj.

9. Modifikimi i punëve juridike (kushti, afati dhe urdhri).

Modifikimet (kufizimet) e punëve juridike mund të parashihen nga palët të cilat veprimet e veta i kushtëzojnë:

- me kusht,
- me afat dhe
- me urdhër.

Kushti është një rrethanë e ardhshme jo evidente, nga paraqitja e të cilës varet paraqitja apo pushimi i ndonjë të drejte. Kushti duhet të jetë i ligjshëm, i moralshëm dhe i mundshëm, në të kundërtën punët juridike janë nule.

Varësisht nga pasojat e shkaktuara me kusht në punën juridike, kushti mund të paraqitet në dy forma: Shtyes apo suspensiv dhe shkëputës apo rezolutiv.

Shtyes ose suspensiv është ai kusht nga paraqitja, përkatësisht mosparaqitja e të cilit varet veprimi i punës juridike. Nëse kushti plotësohet, dmth. paraqitet rrethana e ardhshme jo evidente, puna juridike do të prodhon efekte juridike. Nëse nuk paraqitet rrethana e ardhshme jo evidente puna juridike nuk do të prodhon efekte juridike.

Shkëputës ose rezolutiv është ai kusht paraqitja e të cilit shkakton ndërprerjen e veprimit të punës juridike e cila është paraqitur dhe ka filluar të veproj më para, vjen deri te shkëputja e punës juridike e cila ka vepruar deri atëherë.

Varësisht nga kush varet paraqitja e rrethanës së ardhshme jo evidente kushtet ndahen në: **potestative, kauzale dhe të përziera.**

Potestativ është kushti paraqitja e të cilit varet nga subjekti i asaj pune juridike.

Kauzal është ai kusht paraqitja e të cilit nuk varet nga vullneti i subjekteve.

I përzier është ai kusht paraqitja e të cilit varet edhe nga vullneti i subjekteve edhe nga paraqitja e ndonjë fakti pavarësisht nga vullneti i tyre.

Kushtet ndahen edhe në **pozitive dhe negative.**

Pozitiv është kur me paraqitjen e kushtit fillon, përkatësisht pushon veprimi juridik i një pune juridike.

Negativ është atëherë kur veprimi juridik i punës juridike fillon ose pushon me mosparaqitjen e kushtit (neni 59-64 i LMD).

Çdo punë juridike nuk mund të kushtëzohet. Zakonisht kushtëzohen punët juridike nga e drejta detyrimore dhe ajo trashëgimore. Punët juridike nga e drejta familjare në rregull nuk mund të kushtëzohen si p.sh. lidhja e martesës, pranimi i atësisë, birësimi etj.

Afati nënkupton një periudhë të caktuar kohore apo momentin e caktuar në kohë, me të cilin lidhet fillimi i veprimit ose pushimi i veprimit të një pune juridike. Në dallim nga kushti afati është rrethanë e sigurt e ardhshme e cila sigurisht do të ndodh në të ardhmen.

Edhe afatet ndahen në shtyese dhe shkëputëse. Shtyese është afati nga paraqitja e të cilit varet fillimi i veprimit të punës juridike. Shkëputës është afati nga paraqitja e të cilit varet pushimi i veprimit të punës juridike.

Urdhëri është përkufizim i punëve juridike bamirëse (dhurimi), me të cilin përfituesit i urdhërohet të kryen atë që i është urdhëruar.

PËRFAQËSIMI

Përfaqësimi nënkupton ndërmarrjen e punëve juridike në emër dhe në llogari të huaj. Personi i cili ndërmerr punët juridike në emër dhe në llogari të tjetrit quhet përfaqësues, ndërsa personi në emër të të cilit ndërmerr ato punë juridike quhet i përfaqësuar.

Varësisht nga personi i cili duhet përfaqësuar kemi përfaqësimin e personave fizik dhe përfaqësimin e personave juridik. Varësisht nga rrjedh e drejta për përfaqësim dallojmë:

- 1) Përfaqësimin kontraktues (me autorizim),
- 2) Përfaqësimin ligjor,
- 3) Përfaqësimin gjyqësor,
- 4) Përfaqësimin statutar (të personave juridik).

Si personat fizik ashtu edhe personat juridik mund të autorizojnë personin tjetër të ndërmerr punët e caktuara juridike në emër dhe në llogari të tij. Ky lloj përfaqësimi zakonisht bëhet me shpërblim, nga edhe quhet përfaqësim kontraktues. Përfaqësuesi është i kufizuar në ndërmarrjen e punëve juridike ashtu si është përcaktuar me autorizim. Përfaqësues mund të jenë personat e moshës madhore me zotësi të plotë veprimi.

Përfaqësimi ligjor rrjedh nga vetë ligji. Të përfaqësuar janë personat e mitur, pa zotësi veprimi, me zotësi veprimi të kufizuar për punë juridike të caktuara, personat madhor të cilëve u është vazhduar e drejta prindore dhe personat madhor të cilëve u është marr zotësia e veprimit.

Sipas Ligjit të Familjes personat e mitur pa zotësi veprimi, të miturit me zotësi veprimi të kufizuar si dhe personat e rritur të cilëve u është vazhduar e drejta prindore i përfaqësojnë prindërit e tyre. Personat të cilëve u është marr zotësia e veprimit i përfaqëson kujdestari i tyre.

Përfaqësuesi gjyqësor caktohet me vendim të gjykatës gjatë zhvillimit të një procedure gjyqësore nën kushtet e parashikuara me ligj (neni 79 i LPK). Përfaqësuesi i caktuar nga ana e gjykatës i ka në procedurë të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesi ligjor.

Personi juridik nuk ka zotësi veprimi, nga e cila arsye edhe punët juridike i ndërmerr nëpërmjet të përfaqësuesit. Përfaqësuesi i personit juridik është i caktuar me ligj ose me akte normative të personit juridik, ku është i caktuar edhe vëllimi i autorizimeve.

VI. PARASHKRIMI

1. Kuptimi, afatet e përgjithshme dhe të veçanta

Parashkrimi është institut juridik sipas të cilit titullari, pas kalimit të afatit të parashikuar me ligj, nuk mund ta realizon një të drejtë në mënyrë të dhunshme, nëpërmjet të gjykatës, nëse deri atëherë nuk e ka ushtruar atë të drejtë. Me kalimin e afatit të parashikuar ligjor e drejta subjektive nuk shuhet por humbet e drejta në padi, kjo nënkupton se titullari i së drejtës nuk ka mundësi nëpërmjet të gjykatës ta realizon atë, pra gjykata në rastin kur titullari i së drejtës i drejtohet gjykatës me padi në situatën kur pala kundërshtarë thirret në institutin e parashkrimit (pra gjykata nuk vepron sipas detyrës zyrtare) nuk mund ti ofroj mbrojtje gjyqësore titullarit të së drejtës. Kjo dmth. se gjykata nuk kujdeset për parashkrimin sipas detyrës zyrtare, kështu që do të vendos lidhur me parashkrimin vetëm nëse pala thirret në parashkrimin e kërkesës. Këtë kërkesë pala mund ta bëjë vetëm pranë gjykatës së shkallës së parë por jo edhe në procedurën ankimore (neni 180.3 i LPK).

Nuk parashkruhen të gjitha të drejtat por vetëm ato detyrimore e të cilat nuk rrjedhin nga e drejta familjare. Nuk parashkruhen të drejtat absolute, qofshin ato reale apo personale si dhe të drejtat detyrimore që rrjedhin nga e drejta familjare si ushqimi ndërmjet anëtarëve të familjes, por jo edhe shuma e gjykuar mbi këtë bazë.

Me ligj është parashikuar afati i përgjithshëm për parashkrim (neni 352 i LMD), ndërsa afatet e veçanta ndryshojnë varësisht nga e drejta subjektive civile. Ato janë afate prekluzive dhe nuk mund të ndryshohen me punë juridike nga ana e palëve. Përndryshe deri te vjetërsimi vjen me kalimin e afatit të parashikuar me ligj gjatë së cilit kreditori ka pasur të drejtë të kërkon përmbushjen e detyrimit. Në qoftë se debitori e përmbush detyrimin e parashkruar, ai nuk ka të drejtë të kërkojë që t'i kthehet ajo që ka dhënë edhe atëherë kur nuk e ka ditur, se detyrimi është parashkruar (neni 348 i LMD).

Kur parashkruhet kërkesa kryesore, atëherë parashkruhen edhe kërkesat aksesore, sikurse janë: kërkesat e kamatës, frutave, shpenzimeve dhe dënimeve kontraktuese (neni 350 i LMD).

Kërkesat e vërtetuara me aktgjykim të plotfuqishëm të gjykatës ose me ujdj gjyqësore apo të ndonjë organi tjetër kompetent parashkruhen brenda 10 viteve, edhe për ato ku me ligj është parashikuar afati më i shkurtër (neni 361 i LMD).

2. Rrjedha, ndërprerja dhe ndalja e rrjedhës së afatit

Afati i parashkrimit fillon të rrjedhë nga dita e parë kur kreditori ka pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit. Deri te parashkrimi vjen me kalimin e ditës së fundit të afatit të parashikuar me ligj për parashkrim.

Afati ligjor për parashkrim mund të ndërprehet. Ndërprerja e afatit të parashkrimit nënkupton mos llogaritjen e afatit deri në ndërprerje dhe fillimin e llogaritjes rishtas të afatit të parashkrimit. Deri te ndërprerja vjen: a. me pranimin e detyrimit dhe b. me

paraqitjen e padisë. Pranimi mund të bëhet me deklaram ose me pagesën e ndonjë pjese të detyrimit, të kamatës ose me dhënien e sigurimit për pagesë të kërkesës.

Ndalja e parashkrimit nënkupton kur për shkaqe të ndryshme një pjesë e kohës së kaluar nuk llogaritet në afatin e parashkrimit, dmth. për një kohë ndalet rrjedha e afatit. Shkaqet e ndaljes së afatit mund të jen objektive dhe subjektive.

3. Afatet prekluzive

Nga parashkrimi duhet dalluar afatet prekluzive. Afatet prekluzive nënkuptojnë ushtrimin e ndonjë të drejte brenda afatit të parashikuar me ligj. Në dallim nga parashkrimi me kalimin e afatit prekluziv humbet jo vetëm e drejta në padi por edhe vetë e drejta. Në anën tjetër të afatet prekluzive nuk kemi as ndërprerje e as ndalje të afatit. Afati prekluziv si edhe afati në përgjithësi mund të jetë subjektiv dhe objektiv (p.sh. afati për paraqitjen e padisë për pengim posedimi).

VII. CENIMI DHE MBROJTJA E TË DREJTAVE SUBJEKTIVE CIVILE

1. Cenimi i të drejtës subjektive civile

Të drejtat subjektive civile janë të shumëllojshme, andaj edhe varësisht nga lloji dhe përmbajtja e të drejtave subjektive civile shprehet edhe ushtrimi i tyre. Nga dëshira e titullarit të së drejtës subjektive civile varet nëse do ta ushtron ai atë apo jo dhe në çfarë mase dhe vëllimi. Mirëpo, ekziston parim i përgjithshëm në të drejtën se duke ushtruar të drejtën tënde tjetrit nuk guxon t'i shkakton dëm. Pavarësisht nëse titullari e ushtron apo jo një të drejtë, me ligj nuk lejohet që ajo e drejtë të cenohet nga të tjerët. Në të drejtën tonë ekzistojnë dy forma të mbrojtjes subjektive civile: 1. Vetëmbrojtja dhe 2. Mbrojtja gjyqësor.

VETËMBROJTJA

Në rregull të drejtat mbrohen nga ana e organeve shtetërore. Parimisht vetëgjyqësia në realizimin e të drejtave, e edhe të drejtave civile është e ndaluar. Përjashtimisht nga kjo, sipas ligjit lejohet vetëmbrojtja e të drejtave civile, që nënkupton zbrapsjen e sulmit me të cilin është cenuar e drejta dhe nevoja ekstreme që nënkupton flijimin e sendit të huaj me qëllim të evitimit të rrezikut personal apo të tjetrit. Vetëmbrojtja e së drejtës është e lejuar me kusht që rreziku të jetë i drejtpërdrejtë, që vetëmbrojtja të jetë e domosdoshme dhe në pajtueshmëri me rrethanat e imponuara. Te nevoja ekstreme duhet shpërblyer dëmin personit sendi i të cilit është flijuar me qëllim të evitimit të rrezikut.

MBROJTJA GJYQËSORE

Çdo sistem juridik organizon mbrojtjen e të drejtave civile. Organet shtetërore të cilat mbrojnë të drejtat civile janë gjykatat. Në dallim nga e drejta penale dhe e drejta administrative, të drejtat civile nuk mbrohen nga gjykata sipas detyrës zyrtare, por vetëm me iniciativën e palëve, titullarëve të këtyre të drejtave (neni 3.1 i LPK). Mbrojtja e të drejtave civile inicohet me padi. Padia në kuptimin material nënkupton kërkesën si element të së drejtës subjektive civile. Në rregull, ka edhe përjashtime, padinë e paraqet titullari i së drejtës, duke e paraqitur me padi kërkesën e caktuar, kundër personit detyrimor i cili është i paditur. I padituri mund të paraqet kundërshtim të natyrës materialo juridike duke e theksuar ndonjë të drejtë të vetën e cila e bënë joefikase kërkesën nga padia, apo edhe duke parashtruar kundërpadi.

Pas zhvillimit të procedurës, administrimit të provave të nevojshme, gjykata do të vendos me aktgjykim apo aktvendim lidhur me mbrojtjen gjyqësore të së drejtës civile të kërkuar me padi, përkatësisht kundërpadi.

■ E DREJTA SENDORE

E drejta sendore është degë e së drejtës civile e cila rregullon marrëdhëniet shoqërore të cilat i kanë për objekt sendet. Në këtë aspekt marrëdhënia juridike sendore mund të paraqitet vetëm ndërmjet titullarit të së drejtës sendore dhe të gjithë personave tjerë të cilat mund të vijnë në kontakt me sendin. Në të drejtat sendore klasike numërohen pronësia, servituti dhe pengu. Varësisht nga sistemet juridike ekzistuese ndryshojnë edhe të drejtat sendore që rregullohen me të drejtën objektive. Kjo nga arsyeja se e drejta objektive parasheh dhe rregullon një për një të drejtat sendore. Në bazë të drejtës objektive subjektet realizojnë të drejtat subjektive lidhur me sendet. Në të drejtën tonë, përveç pronësisë si më kryesorja, si të drejta sendore konsiderohen edhe e drejta e servitutit, e drejta e pengut, e drejta e ndërtimit e drejta e përparësisë së blerjes dhe ngarkesat sendore.

E drejta sendore në kuptimin subjektiv nënkupton autorizimin konkret të titullarit të së drejtës sendore të cilin ai e ka ndaj të gjithë personave tjerë përkitazi me sendin e caktuar.

I. PARIMET THEMELORE ME TË CILAT KARAKTERIZOHEN TË DREJTAT SENDORE

Të drejtat sendore karakterizohet me këto parime të përbashkëta:

- 1) Parimi i absolutitetit,
- 2) Parimi i numrit të përkufizuar të drejtave sendore,
- 3) Parimi i publicitetit dhe
- 4) Parimi i (specialitetit) përcaktueshmërisë së të drejtave sendore.

1. Parimi i absolutitetit

Të drejtat sendore bëjnë pjesë në grupin e të drejtave absolute, andaj edhe parimi i absolutitetit është karakteristika themelore e tyre, që nënkupton veprimin e këtyre të drejtave ndaj të gjithëve, *erga omnes*. Nga vetia e këtillë e këtyre të drejtave rrjedhë se mbrojtja juridike e tyre është gjithëpërfshirëse, vepron ndaj të gjithëve. Titullari i të drejtës sendore e ka pushtetin juridik ndaj sendit, dhe ky pushtet shprehet ndaj gjithë të tjerëve.

Deri sa këto të drejta veprojnë ndaj të gjithëve, e jo vetëm ndaj një personi apo numrit të caktuar të personave, si edhe te të drejtat tjera absolute, detyrimi i personave tjerë paraprakisht nuk dihet, përpos që veprimi i të gjithë personave tjerë ndaj titullarit të kësaj të drejte është negativ, që nënkupton se të gjithë personat tjerë duhet të përmbahen nga çfarëdo veprimi me të cilin do të cenohej e drejta sendore.

Në rast të cenimit të drejtës subjektive sendore, qoftë me marrjen e sendit apo me shqetësim të ushtrimit të drejtës sendore mbi atë send, titullari ka të drejtë mbrojtje me padi, me kërkesë në aspektin material. Të drejtat sendore si edhe e drejta në padi ndaj personave nga të cilët cenohen këto të drejta nuk vjetërsohet.

2. Parimi i numrit të kufizuar i të drejtave sendore

Ky parim nënkupton se të drejtat sendore janë të caktuara një për një me të drejtën objektive. Kjo nuk do të thotë se numri i të drejtave sendore është i njëjtë në të gjitha sistemet juridike. Mirëpo, duke pasur parasysh faktin se ato janë të drejta absolute, me të drejtën objektive duhet përcaktuar se cilat janë ato të drejta dhe kujt i përkasin. Në këtë mënyrë me legjislacionin e çdo sistemi juridik janë shprehimisht të parashikuara të drejtat sendore. Varësisht nga sistemi juridik ndryshon edhe numri i të drejtave sendore të cilat janë të parashikuara me legjislacion. Nga të gjitha të drejtat sendore, më kryesorja është e drejta e pronësisë, nga e cila arsyë edhe, mund të themi, se ekziston në të gjitha sistemet juridike. Të drejtat tjera sendore të cilat edhe rrjedhin nga e drejta e pronësisë ndryshojnë, varësisht nga sistemet juridike, përkatësisht legjislacionet ekzistuese.

Në të drejtën klasike, nga të drejtat sendore, kanë qenë të njohura e drejta e pronësisë, e drejta e servitutit dhe e drejta e pengut. Në të drejtën e sotme, përpos tyre, janë të parashikuara edhe të drejta tjera sendore si e drejta e ndërtimit, superficies, e drejta e pronës në kate, e drejta e përparësisë së blerjes, ngarkesat sendore etj. Me legjislacionin e një vendi mund të parashikohen edhe të drejta tjera sendore me të cilin legjislacion, medoemos duhet rregulluar si përmbajtjen ashtu edhe mënyrën e fitimit, ndryshimit dhe shuarjes të çdo të drejtës sendore të parashikuara me ligj.

Parimi i numrit të kufizuar të të drejtave sendore nënkupton jo vetëm se numri i këtyre të drejtave është i kufizuar dhe i përcaktuar me legjislacionin e një vendi por edhe se është e rregulluar saktësisht edhe përmbajtja e këtyre të drejtave sendore, ashtu që edhe nuk është e lejuar që palët, sipas dëshirës së tyre, ta ndryshojnë përmbajtjen e këtyre të drejtave nga ajo si është parashikuara me ligj.

3. Parimi i publicitetit

Nga vetë fakti se të drejtat sendore janë të drejta absolute dhe veprojnë ndaj të gjithëve, jep të kuptohet se ato janë publike, të gjithë të tjerët duhet të dinë se kush është titullar i të drejtës sendore. Ky parim nënkupton se të drejtat sendore janë publike, janë të njohura për të gjithë.

Te të drejtat sendore në paluajtshmëri funksionin e publicitetit e luan regjistri i paluajtshmërive. Të gjitha të drejtat apo ngarkesat në paluajtshmëri janë të regjistruara në këta regjistër. Çdo person ka të drejtë të marr informata përkitazi me shënimet në regjistër të paluajtshmërive. Askush nuk mund t'i referohet mos informimit përkitazi me të drejtat sendore në paluajtshmëri nga fakti se nuk ka marr informata sipas regjistrimit të paluajtshmërive, nga edhe i heq të gjitha pasojat juridike të sendit të paluajtshëm i cili është na qarkullimin juridik.

Publiciteti i të drejtave sendore në sende të luajtshme sigurohet nëpërmjet të ushtrimit të pushtetit faktit - të posedimit ndaj një sendi. Nga vetë fakti se dikush e ka një send të luajtshëm në posedim nënkupton se e ka të drejtën sendore mbi atë send dhe ajo e drejtë është e njohur për të tjerët.

Manifestimi i publicitetit të të drejtave sendore në sendet e paluajtshme nga ai në sendet e luajtshme dallon nga vetë fakti se pasojat juridike në rast gabimi nuk janë të njëjta.

Nga parimi i publicitetit rrjedhë edhe parimi i mbrojtjes së përfituesit të së drejtës në mirëbesim, nga se përfitimi bazohet në regjistrin e paluajtshmërive për sendet e paluajtshme dhe posedimin për sendet e luajtshme.

4. Parimi i (specialitetit) caktueshmërisë së të drejtave sendore

Ky parim i të drejtës sendore nënkupton se të drejtat sendore mund të konstituohen vetëm në sendet saktësisht të caktuara, në çdo send individualisht veçmas të caktuar. Një subjekt i caktuar ka të drejta sendore aq sa ka edhe sende individualisht të caktuar. Kjo dmth. se nuk ekziston e drejta e pronësisë në grup sendesh, por në çdo send individualisht të caktuar nga ai grup sendesh. Në rregull, objekti i të drejtës sendore gjithmonë është individualisht dhe saktësisht i caktuar. Ky parim ka përjashtime nga se disa të drejta sendore mund të konstituohen edhe në të drejta, p.sh. e drejta e pengut në kërkesa.

II. SENDET

1. Kushtet që diç të ketë kuptimin e sendit

Kuptimi më adekuat për sendet do të mund të konsiderohej se sendet janë pjesë materiale të natyrës të cilat ndodhen në pushtetin e njeriut dhe në të cilat ekziston e drejta e pronësisë ose ndonjë e drejtë tjetër subjektive civile. Nga një definim i këtillë rrjedhë se me sende nënkuptojmë pjesët materiale të natyrës të cilat i plotësojnë dy kushte.

Kushti i parë që duhet plotësuar është kushti fizik që nënkupton se sendi duhet të jetë pjesë e botës materiale, me mundësi nënshtimi pushtetit të njeriut, të jetë nën kontrollin e njeriut. Nga kjo do të rrjedhë se energjia e lirë dhe elektriciteti i lirë në natyrë nuk janë sende në kuptimin juridiko civil. Mirëpo, për të pas diç kuptimin e sendit nuk është medoemos e nevojshme që ai send të ketë ndonjë formë dhe të mund të preket. Kësisoj, sende janë edhe forcat natyrore dhe energjia në formën e elektricitetit, nxehtësisë, gazit etj. nëse ato mund ti nënshtrohen pushtetit të njeriut dhe të vihen në shërbim të njeriut.

Kushti i dytë që duhet plotësuar është kushti juridik, që nënkupton se ajo pjesë e botës materiale e cila është në pushtetin e njeriut njëherësh duhet të jetë edhe objekt i të drejtës së pronësisë ose ndonjë të drejte tjetër subjektive civile.

Në këtë aspekt, duke u bazuar në këto dy kushte, sipas nenit 141 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë “Send është çdo gjë që mund të përbëjë objekt pronësie ose i të drejtës tjetër reale”.

2. Ndarja e sendeve me rëndësi për të drejtën civile

Ndarja e sendeve si objekte të së drejtës civile dallon varësisht nga sistemi juridik dhe legjislativi i një vendi. Duke u nisur nga fakti se e drejta sendore rregullon marrëdhëniet ndërmjet subjekteve lidhur me sendet, ndarja e sendeve është me rëndësi të veçantë për këtë degë të së drejtës. Sipas ligjit, lloji i sendeve është me ndikim përkitazi me mënyrën e fitimit dhe shuarjes së të drejtave sendore, përmbajtjen e të drejtës sendore, mbrojtjen e tyre, kompetencën dhe përbërjen e gjykatës në rastet e vendosjes lidhur me ato etj.

Varësisht nga qëllimi ekonomik i sendit dhe duke pasur parasysh objektin e llojeve të caktuara të marrëdhënieve juridike dallojmë këto lloje të sendeve:

- a) ***Të luajtshme dhe të paluajtshme.*** *Kjo është ndarja më kryesore e sendeve. Në të drejtën tonë pozitive nuk jepet kuptimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme. Këtë e ka bërë teoria juridike dhe praktika gjyqësore, sipas së cilës të luajtshme janë ato sende të cilat mund të barten nga një vend në tjetrin pa dëmtimin e substancës së tyre. Sende të paluajtshme nuk mund të barten nga një vend në tjetrin, e të mos ndryshojnë nga forma apo nga substanca. Send i paluajtshëm është toka dhe gjithë ajo (sendet e luajtshme) që është, në mënyrë organike apo mekanike, e lidhur për tokën. Të gjitha sendet tjera që nuk bëjnë pjesë këtu janë sende të luajtshme. Rëndësia juridike e kësaj ndarjeje të sendeve është e shumëfishtë. Sipas ligjit tretmani juridik i sendeve të paluajtshme është më i rreptë nga ai i sendeve të luajtshme. Edhe fitimi edhe humbja e të drejtave sendore në sendet e paluajtshme regjistrohet në regjistrin e paluajtshmërive, ndërsa për sendet e luajtshme nuk bëhet kjo. Përndryshe, sipas të drejtës tonë, ky regjistrim i të drejtës në paluajtshmëri përfaqëson mënyrën e fitimit të së drejtës (**modus acquirendi**) (neni 36 i LPDTS). Përkundër kësaj mënyre e fitimit e sendeve të luajtshme është më e thjeshtë, nevojitet vetëm dorëzimi i thjesht i sendit (neni 32.1 i LPDTS). Afatet për fitimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri mbi bazën e posedimit janë më të gjata se ato për sendet e luajtshme. Fitimi i të drejtës së pronësisë nga jopronari është e mundur vetëm te sendet e luajtshme. Procedura trashëgimore zhvillohet medoemos nëse trashëgimlënësi ka lënë pasuri të paluajtshme e nëse ka lënë vetëm pasuri të luajtshme nuk është e thënë të zhvillohet. Për kontratën për bartjen e të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri ligji kërkon formën e shkruar dhe vërtetimin e nënshkrimeve të palëve te noteri, gjë që nuk kërkohet për sendet e luajtshme.*

Për të vendosur në kontestet gjyqësore përkitazi me kërkesat në sendet e paluajtmshme kompetencën tokësore e ka gjykata në territorin e së cilës ndodhet paluajtmshëria e cila është objekt i asaj kërkesë, ndërsa vendndodhja e sendit të luajtmshëm nuk është me ndikim në kompetencën vendore të gjykatës. Tretmani juridik ndryshon nëse është objekt i pengut sendi i luajtmshëm nga ai i paluajtmshëm (hipoteka). Ndryshon edhe procedura e shitjes publike të sendit të paluajtmshëm nga ajo e sendit të luajtmshëm.

- b) **Sendet në qarkullim dhe jashtë qarkullimit.** Kjo ndarje e sendeve bëhet varësisht nga mundësia e qarkullimit juridik të sendeve. Në rregull sendet janë në qarkullim juridik. Edhe sipas të drejtës tonë pozitive disa sende janë jashtë qarkullimit. Këto janë sendet të cilat shërbejnë për përdorim të përgjithshëm, për shkak të vetive natyrale që kanë, shërbejnë për plotësimin e nevojave të përgjithshme të njerëzve. Në këtë grup të sendeve bëjnë pjesë të mirat me interes të përgjithshëm, andaj edhe, për shkak të rëndësisë ekonomike shoqërore që kanë, gëzojnë mbrojtje të veçantë dhe shfrytëzohen në kushte dhe në mënyrë si është rregulluar me ligj. Në grupin e sendeve jashtë qarkullimit bëjnë pjesë: rrugët publike, pavarësisht nëse janë të kategorizuara apo jo, rrjedhat natyrale të lumenjve, liqejt natyral, urat, ujërat, tregjet, parqet, xehet dhe pasuritë xehtare etj. Kjo ndarje e sendeve është me rëndësi për të drejtën civile nga se në sendet jashtë qarkullimit nuk mund të konstituohet as e drejta pronësore e as ndonjë e drejtë tjetër sendore, në këtë aspekt as e drejta e posedimit, ashtu që subjektet nuk mund të kenë të drejta sendore mbi këto sende, andaj edhe as që mund të kërkohet mbrojtja gjyqësore e ndonjë të drejte sendore mbi sendet jashtë qarkullimit.
- c) **Sendet e konsumueshme dhe të pakonsumueshme.** Të konsumueshme janë ato sende qëllimi ekonomik i të cilave është të shpenzohen me një përdorim, siç janë gjërat ushqimore, pijet, paraaja etj. Sendet e pakonsumueshme mund të përdoren më shumë herë, siç janë: libri, ora, objekti banesor, etj. Kuptimi juridik i kësaj ndarje ndryshon nga ai fizik. Varësisht nga destinimi i njëjti send mund të jetë në një rast i konsumueshëm e në tjetrin i pakonsumueshëm. Druri me destinim për nxehje është send i konsumueshëm, e ai me destinim për ndërtimtari është i pakonsumueshëm. Kjo ndarje e sendeve është me rëndësi për të drejtën civile nga se disa marrëdhënie shoqërore mund të themelohen vetëm në sendet e konsumueshme, ndërsa të tjerat vetëm në ato të pakonsumueshme. Shfrytëzimi i frutave mund të ekzistoj vetëm në sendet e pakonsumueshme, e nëse ka të bëjë me sendet e konsumueshme atëherë shëndrohet në marrëdhënie detyrimore. Objekt i kontratës së huas mund të jenë vetëm sendet e konsumueshme, ndërsa objekt i kontratës së qirasë mund të jenë vetëm sendet e pakonsumueshme.
- d) **Sendet e zëvendësueshme dhe të pazëvendësueshme.** I zëvendësueshëm është ai send nëse në vend të tij mund të vije sendi tjetër i ngjashëm për nga tiparet, ngjashmëria, destinimi dhe vlëra. Nëse kjo nuk është e mundur atëherë kemi të bëjë me sende të pazëvendësueshme. Sendet e zëvendësueshme janë automobili nga prodhimi serik deri sa është në fabrikë, libri i caktuar në librari, sasia e

caktuar e llojit të caktuar të drithit, etj. Sende të pazëvendësueshme janë piktura e caktuar e një piktori, shtëpia e caktuar në udhëkryqin e rrugës së caktuar. Sendi mund të jetë i pazëvendësueshëm nga aspekti subjektiv si p.sh. sendi i zëvendësueshëm i dhënë për kujtim, libri me nënshkrimin të autorit etj. Rëndësia juridike e këtij kategorizimi të sendeve është me rëndësi në rastet e shpërblimit të dëmit. Nëse janë dëmtuar sendet e zëvendësueshme ato kompensohen në natyrë. Te sendet e pazëvendësueshme shpërblimi i dëmit gjithmonë bëhet në të holla.

- e) **Sendet e pjesëtueshme dhe të papjesëtueshme.** Sende të pjesëtueshme konsiderohen ato sende të cilat mund të ndahen fizikisht dhe secila pjesë e fituar me ndarje ka vlerën e vetë në përpjesëtim me vlerën e tërësishme të ati sendi para ndarjes. Sende të ndashme janë shuma e caktuar e të hollave, toka, kaca e djathit etj. Sende i papjesëtueshëm konsiderohet sendi i cili fizikisht nuk mund të ndahet në mënyrë që secila pjesë e fituar me ndarje të ketë cilësinë dhe vlerën e vet qarkulluese në përpjesëtim me vlerën qarkulluese të tërësisë. Kriteriumi i ndarjes së këtillë është juridik, përkatësisht ekonomik e jo fizik, pasi që në aspektin fizik nuk ka sende të pandashme, dhe se varësisht nga destinimi i njëjti send në një rast mund të jetë i ndashëm e në tjetrin i pandashëm. Rëndësia juridike e kësaj ndarje të sendeve është te bashkëpronësia dhe te detyrimet me më shumë debitor.
- f) **Sendet kryesore dhe aksesore.** Send kryesor konsiderohet ajo pjesë e sendit që përmban në vetvete karakteristikat e tërë sendit, i cili mund të jetë objekt i ndonjë të drejte sendore, ndërsa aksesore konsiderohen pjesët përbërëse pa të cilat sendi kryesor do të pushonte të ishte me të vërtetë ai që ka qenë. LPDTS në nenin 14 në paragrafin 1 parasheh se: “Sendet aksesore janë sende të luajtshme që nuk janë pjesë përbërëse, por që kanë për qëllim të shërbejnë vijueshëm qëllimeve ekonomike të një sendi kryesor të luajtshëm ose paluajtshmërie dhe për këtë arsye janë vendosen në afërsi përkatëse të sendit kryesor”. Kjo ndarje është me rëndësi juridike nga se në qarkullimin juridik, në rastet kur i njëjti person është pronar edhe i sendit kryesor edhe i ati të dorës së dytë, sendi kryesor e përcakton fatin e ati të dorës së dytë dhe, nëse nuk ka marrëveshje tjetër, punët juridike përkitazi me sendin kryesor vlejné edhe për ato të dorës së dytë.
- g) **Frutat.** Janë lloji i veçantë i sendeve të dorës së dytë të cilat i jep periodikisht sendi kryesor dhe të cilat janë të destinuara të ndahen nga ai. Frutat mund të jen natyrale, si frutat nga bimët dhe shtazët dhe artificiale, si prodhimet periodike nga puna e njeriut. Përpos këtyre kemi edhe frutat civile, e këto janë të ardhurat periodike në të holla nga ndonjë send apo nga ndonjë e drejtë, siç janë kamata, qiraja, etj. Deri sa nuk ndahen frutat natyrale janë pjesë përbërëse të sendit kryesor dhe e ndajnë fatin e tij juridik. Me rastin e ndarjes bëhen sende në vete dhe si të tilla mund të jen objekt i punëve juridike të veçanta. Në parim, frutat i takojnë pronarit të sendit kryesor, mirëpo ka edhe të drejta subjektive të tilla në bazë të së cilave frutat u takojnë ndonjë personi tjetër (shfrytëzimi i frutave, qiraja). Rëndësia juridike e frutave është te kthimi i sendeve, rei vindikacio, varësisht nëse poseduesi jo pronar ka qenë në mirëbesim apo keqbesim.

III. POSEDIMI (Possesio).

1. *Kuptimi dhe rëndësia e posedimit*

Juridikisht posedimi ka dallim të madh nga pronësia. Kësisoj, posedimi nënkupton **pushtetin faktik** të një personi ndaj një sendi apo një të drejte, në dallim nga pronësia e cila nënkupton **pushtetin juridik** të një personi ndaj një sendi. Nga kjo rrjedhë se te posedimi është i nevojshëm të ekzistoj pushteti faktik, ndërsa te pronësia pushteti juridik.

Posedimi ekziston pavarësisht nga ajo nëse poseduesi ka apo jo edhe të drejtë në posedim, përkatësisht nëse pushtetin faktik e ushtron mbi bazën e ndonjë të drejte. Pronari i një sendi, sipas rregullit, njëherësh është edhe posedues, nga se këtë autorizim e ka nga e drejta e pronësisë, mirëpo gjithmonë nuk ndodh kështu. Një person mund ta ketë të drejtën e pronësisë në një send e mos ta ketë pushtetin faktik ndaj atij sendi dhe e kundërta, ta ketë pushtetin faktik e mos ta ketë të drejtën e pronësisë, pasi që posedimi është një fakt e jo e drejtë.

Instituti i posedimit është me rëndësi të shumëfishtë:

- Posedimi përfaqëson mjetin dhe formën për bartjen e pronësisë në sendet e luajtshme (neni 21.1 i LPDTS),
- Nëpërmjet të posedimit te sendet e luajtshme vjen në shprehje parimi i publicitetit i të drejtave sendore,
- Poseduesi gëzon prezumimin e pronarit të një sendi apo bartësit të një të drejte reale, deri sa mos të vërtetohet e kundërta,
- Posedimi si fakt juridik, në rrethana të parashikuara me ligj, prodhon efekte juridike të dobishme për poseduesin - posedimi i ligjshëm dhe me mirëbesim, apo së paku ai me mirëbesim, pas kalimit të afateve të caktuara ligjore, shëndrohet në pronësi – (neni 28 i LPDTS),
- Nëse sendi i luajtshëm ka dal nga pushteti faktik i poseduesit pa vullnetin e tij, mbi atë send nuk mund ta fiton pronësinë as personi i cili ka qenë me mirëbesim me rastin e marrjes së atij sendi në pushtetin faktik të tij,
- Poseduesi i një sendi apo një të drejte gëzon të drejtën në mbrojtje juridike deri sa e ka pushtetin faktik ndaj atij sendi apo të drejte,
- Poseduesi ka përgjegjësi të prezumuar për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm (pavarësisht nga fakti kush është pronar i sendit të rrezikshëm, për dëmin eventual të shkaktuar nga ai, përgjegjës është poseduesi i atij sendi).

2. Objekti i posedimit

Objekt i posedimit mund të jetë çdo send në qarkullim. Nëse në një send është e mundur pronësia, ose ndonjë e drejtë tjetër sendore ose detyrimore që ka të bëjë me shfrytëzimin e sendit, në atë send është i mundur edhe posedimi.

Ligji i zbatueshëm dallon posedimin e sendit dhe posedimin e së drejtës. Në këtë aspekt posedimi i sendit nënkupton pushtetin e plotë faktik ndaj një sendi. Mirëpo, nëse personi i caktuar nuk e ka pushtetin e plotë faktik mbi sendin, por vetëm ndonjë pushtet tjetër të kufizuar i cili përfaqëson përmbajtjen e ndonjë të drejte sendore përkitazi me atë send, kjo përfaqëson posedimin e së drejtës. Sipas ligjit në fuqi, nga posedimi i së drejtës kemi vetëm posedimin e të drejtës të servituteve reale (neni 252 i LPDTS). Posedimin e të drejtës e ka edhe trashëgimtari pasi që konsiderohet posedues nga momenti i vdekjes së trashëgimlënësit, pavarësisht nga fakti që nuk e ka pushtetin faktik (neni 106 i LPDTS).

3. Ndarjet e posedimit varësisht nga llojet - Posedimi i ligjshëm dhe jo i ligjshëm

Sipas ligjit duhet plotësuar dy kushte për të qenë posedimi i ligjshëm. Kushti i parë për të qenë i ligjshëm posedimi është që të ketë mbështetje në një punë të vlefshme juridike të nevojshme për fitimin e të drejtës së pronësisë (është posedues i ligjshëm personi i cili sendin e luajtshëm e ka marr me kompensim nga jopronari i cili merret me tregtinë e atij sendi).

Kushti tjetër është që mos të jetë fituar me dhunë, mashtrim apo me keqpërdorim të mirëbesimit. Për të qenë posedues i ligjshëm i një sendi të luajtshëm nuk mjafton vetëm baza juridike – kontrata e blerjes, nga se vetëm me kontratën nuk fitohet pronësia por vetëm e drejta në posedim. Për të qenë i ligjshëm duhet të bëjë edhe dorëzimin në mënyrën e lejuar ligjore, e jo të jetë marr me dhunë, mashtrim apo keqpërdorim të mirëbesimit (neni 22 i LPDTS).

E kundërta e të më lartës përfaqëson posedim të kundërligjshëm.

Kjo ndarje është me rëndësi te fitimi i të drejtës në bazë të posedimit.

- Posedimi i drejtë dhe me të meta

Posedimi me të meta është ai i cili është fituar me forcë, me mashtrim apo me keqpërdorim të besimit, që nënkupton se fjala është edhe për posedim të paligjshëm. Nëse posedimi nuk është fituar në këtë mënyrë atëherë fjala është për posedimin e drejtë.

Edhe kjo ndarje është me rëndësi te fitimi i të drejtës së pronësisë (neni 28 i LPDTS).

- **Posedimi i pavarur (autonom) dhe bashkëposedimi**

Në kuptim të nenit 108 të LPDTS rrjedhë se edhe disa persona mund të jenë posedues të një sendi apo një të drejte, që nënkupton se, përpos mundësisë që një person të jetë posedues i një sendi apo një të drejte, ekziston mundësia që disa persona të jenë bashkëposedues i një sendi apo një të drejte.

Te posedimi autonom, poseduesi i përjashton të gjithë personat tjerë nga pushteti faktik ndaj ati sendi. Te bashkëposedimi disa persona e ushtrojnë pushtetin faktik mbi sendin, në mënyrë që çdonjëri bashkëposedues është i kufizuar me pushtetin faktik të bashkëposeduesve tjerë.

Kjo ndarje e posedimit është me rëndësi përkitazi me vëllimin e të drejtave dhe marrëdhënieve mes bashkëposeduesve.

- **Posedimi i drejtpërdrejt dhe i tërthortë**

Varësisht nga raporti hapësinor me sendin, ligji dallon posedimin e drejtpërdrejt dhe të tërthortë. Posedues i drejtpërdrejt është ai i cili personalisht dhe drejtpërdrejt e ushtron pushtetin faktik ndaj një sendi. Përkundër kësaj, poseduesi i tërthortë e ushtron pushtetin faktik mbi sendin nëpërmjet të tjetrit (neni 109 i LPDTS).

Poseduesi i tërthortë gëzon mbrojtjen gjyqësore të posedimit edhe në raport me poseduesin e drejtpërdrejtë, edhe në raport me personat e tretë, sipas gjendjes së fundit të posedimit të krijuar me punë juridike, në të cilin rast nuk ka ndikim vlefshmëria e punës juridike për krijimin e posedimit, si dhe rrethana se personi i tretë e ka penguar poseduesin e tërthortë me pëlqimin e poseduesit të drejtpërdrejt.

Kjo ndarje është me rëndësi juridike përkitazi me marrëdhëniet mes poseduesit të drejtpërdrejt dhe atij të tërthortë.

- **Posedimi me mirëbesim dhe keqbesim**

Posedimi është me mirëbesim nëse poseduesi mendon se nuk është vetëm posedues por edhe titullar i ndonjë të drejte sendore, pra duhet vërtetuar se, në bazë të të gjitha rrethanave të rastit konkret, poseduesi nuk ka mund të dyshon se nuk është titullar i së drejtës.

Posedimi është me keqbesim atëherë kur poseduesi din ose, në bazë të të gjithave rrethanave të rastit, patjetër është dashtë të din se nuk ka të drejtë të posedon sendin. Poseduesi me mirëbesim bëhet posedues me keqbesim nga momenti kur i dorëzohet padia për kthimin e sendit, me kusht që ta humb kontestin.

Kjo ndarje është me rëndësi te fitimi i të drejtës në bazë të posedimit dhe përkitazi me të drejtat dhe detyrimet me rastin e kthimit të sendit pronarit.

Mirëbesimi supozohet deri sa nuk vërtetohet e ndryshe.

4. Pozita juridike e poseduesit me mirëbesim dhe atij me keqbesim

Pozita juridike e poseduesit me mirëbesim ndryshon në disa aspekte nga ajo e poseduesit me keqbesim.

Si në sendet e luajtshme (neni 28 i LPDTS), ashtu edhe në ato të paluajtshme (neni 40 i LPDTS), mbi bazën e posedimit, pas kalimit të afatit të parashikuar ligjor, mund ta fitoj të drejtën pronësore vetëm poseduesi me mirëbesim. Pavarësisht nga kalimi i kohës poseduesi me keqbesim nuk mund asnjëherë, nga shkak se për një kohë ka qenë posedues, ta fitoj të drejtën e pronësisë.

Pozita mes tyre veçmas ndryshon përkitazi me të drejtat dhe detyrimet që kanë me rastin e kthimit të sendit pronarit.

Në këtë mënyrë, poseduesi me mirëbesim ka detyrim t'ia kthen pronarit sendin bashkë me frutat që ndodhen në atë send në momentin e paraqitjes së padisë për kthimin e atij sendi. Për frutat të cilat i ka marr nga ai send, ndaj pronarit të atij sendi nuk ka kurrfarë detyrimi. Poseduesi me mirëbesim nuk ka detyrim ndaj pronarit në emër të kompensimit për shfrytëzimin e sendit, e as nuk ka përgjegjësi për dëmtimin apo shkatërrimin e sendit gjatë kohës së posedimit të tij me mirëbesim, nga se ndaj sendit është sjellë si pronar, e pronari ka të drejtë edhe ta shkatërroj sendin pronar i të cilit është, p.sh. poseduesi me mirëbesim nuk ka detyrim ta kthen apo kompenzon automobilin të cilin e ka shkatërruar plotësisht në aksident.

Sa i përket të drejtave, poseduesi me mirëbesim ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të domosdoshme që ka pasur për mirëmbajtjen e sendit si dhe në kompensimin e shpenzimeve përfituese të bëra me qëllim të rritjes së vlerës, deri në lartësi të vlerës së rritur. Kompensimi i shpenzimeve të domosdoshme dhe të atyre përfituese do të paguhet për aq sa ato tejkalojnë lartësinë e përfitimeve që ka pasur poseduesi nga ai send. Për kompensimin e shpenzimeve të bëra për kënaqësi të vetën dhe me qëllim të zbulurimit të sendit ka vetëm nëse është rritur vlera e sendit dhe në lartësi të rritjes së vlerës. Poseduesi me mirëbesim ka të drejtë ta mbaj sendin deri sa nuk i paguhet shpenzimet e domosdoshme dhe përfituese që ka pasur në lidhje me mirëmbajtjen e sendit (neni 96 i LPDTS).

Përkundër kësaj, poseduesi i pandërgjegjshëm jo vetëm që ka detyrim t'ia kthej pronarit sendin bashkë me frutat që ndodhen në atë (kërkesë kjo e natyrës juridike sendore), por ka detyrim t'ia kompensoj vlerën e të gjitha frutave të marra dhe të shpenzuara gjatë kohës sa ka qenë posedues me keqbesim (kërkesë juridiko detyrimore – fitimi i humbur). Ai është përgjegjës ndaj pronarit për çfarëdo dëmtimi apo shkatërrimi të sendit, përpos nëse vërtetohet se ky dëm do të shkaktohej edhe sikur sendi të ndodhej te pronari.

Sipas ligjit edhe poseduesi i pandërgjegjshëm ka të drejtë në disa shpenzime që i ka pasur lidhur me sendin. Ai ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të domosdoshme, pasi që ato shpenzime do të shkaktoheshin edhe sikur sendi të ishte te pronari. Sa i përket shpenzimeve në të mirë të sendit me të cilat është rritur vlera e sendit, poseduesi i pandërgjegjshëm mund t'i kërkoj ato vetëm nëse janë me interes

personalisht për pronarin, përndryshe nuk ka të drejtë në kompensimin e tyre. Poseduesi i pandërgjegjshëm nuk ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të bëra për kënaqësi të vetën apo për zbulimin e sendit por, nëse mund të ndahen pa dëmtimin e sendit, mund t'i ndaj nga sendi dhe t'i merr.

5. Fitimi dhe shuarja e posedimit

Posedimi fitohet me marrjen në pushtetin faktik të një sendi apo një të drejte. I vetmi përjashtim nga kjo rregull është te trashëgimia. Trashëgimtari konsiderohet posedues i një sendi apo një të drejte nga momenti i vdekjes së trashëgimlënësit, pavarësisht nga koha kur do ta ketë edhe pushtetin faktik (neni 106 i LPDTS). Sipas kësaj dispozite ligjore trashëgimtari, nga momenti i vdekjes së trashëgimlënësit, fiton të njëjtin lloj të posedimit të cilin e ka pasur trashëgimlënësi.

Përndryshe deri te marrja në pushtetin faktik të një sendi apo një të drejte mund të vijë me punë juridike, me trashëgim ose me pushtim.

Posedimi shuhet kur poseduesi pushon të ushtron pushtetin faktik ndaj një sendi (neni 107 i LPDTS). Posedimi nuk shuhet në rastet kur poseduesi, përkundër dëshirës së tij, përkohësisht i është bërë e pamundur të ushtron pushtetin faktik ndaj atij sendi. Shuarja e posedimit mund të bëhet sipas dëshirës dhe kundër dëshirës së poseduesit të deriatëhershëm. Sipas dëshirës është nëse poseduesi e braktis sendin. Kundër dëshirës posedimi shuhet nëse personi i tretë ia merr sendin nga posedimi (vjedhja) ose nëse e humb sendin që e ka pasur në posedim.

6. Mbrojtja gjyqësore e posedimit

Çdo posedim është i mbrojtur nga marrja e sendit kundër dëshirës së poseduesit apo nga trazimi (shqetësimi) i poseduesit i cili kryhet pa marrjen e sendit, nëse marrja apo trazimi juridikisht nuk janë të lejuara (neni 113 i LPDTS). Nga kjo rrjedhë se poseduesi i sendit apo të drejtës ka të drejtë në mbrojtje nga trazimi ose marrja e posedimit. Marrja e sendit ka për rrjedhim shuarjen e posedimit të sendit, p.sh. marrja e kundërligjshme e sendit me përdorim të forcës, me kërcënim, me vjedhje, etj. Trazimi nënkupton çdo pengim të posedimit i cili nuk rezulton me marrjen e sendit, p.sh. kalimi nëpër tokë të huaj, lëshimi i ujërave të zeza në tokë të huaj, pengimi në shfrytëzimin e dritës, etj.

Si me rastin e marrjes së posedimit ashtu edhe me rastin e trazimit themi se fjala është për pengim posedimi.

Mbrojtja e posedimit mund të bëhet në dy mënyra: a. me vetëndihëm ose b. në mënyrë institucionale.

Mbrojtja institucionale mundësohet përmes gjykatës. Qëllimi i mbrojtjes gjyqësore nga pengim posedimi është moslejimi, përkatësisht evitimi i vetëgjyqësisë.

Mbrojtja gjyqësore mundëson kthimin e gjendjes së fundit cila ka ekzistuar para cenimit të posedimit.

Varësisht nga fakti se poseduesi mund të pengohet me marrjen e posedimit apo me pengim (trazim) të posedimit, edhe mundësia e mbrojtjes me padi është e dylojshme:

- 1) Padia për shkak të marrjes së posedimit (sendit).
 - a) *Posedues është poseduesi i mëparshëm,*
 - b) *I paditur është poseduesi i tanishëm, c, Kërkesa: Kthimi i sendit,*
 - c) *Provat: Se posedues është i padituri i cili ia ka marr posedimin paditësit (se paditësi e ka pasur posedimin),*
 - d) *Kundërshtimet: Kundërshtimet e përgjithshme për padi poseduese,*
 - e) *fatet prekluzive: subjektiv 30 ditë, objektiv 1 vit,*
 - f) *Afati për paraqitjen e propozimit për përmbarrim: 30 ditë pas kalimit të afatit për përmbushje vullnetare.*

- 2) Padia për mbrojtjen e posedimit, me rastin e trazimit, pengimit në posedim.
 - a) *Paditësi: Poseduesi,*
 - b) *I padituri: Personi i cili pengon apo ai sipas urdhrorit të cili bëhet pengimi,*
 - c) *Kërkesa: (1). Ndërprerja e pengimit, (2). Kthimi në gjendjen e mëparshme (3). Ndalesa e pengimit në të ardhmen nën kërcënimin e shqiptimit të dënimit me gjobë,*
 - d) *Provat: Posedimi, pengimi i shkaktuar,*
 - e) *Kundërshtimet: (1). Mungesa e legjitimitetit aktiv apo pasiv, (2). Mungesa e moslejueshmërisë,*
 - f) *Afatet: Si te padia paraprake.*

7. Specifikat e procedurës për pengim posedimi

Rregullat e procedurë në kontestet për pengim posedimi janë paraparë në pjesën e III-të, kreu i XVII të Ligjit të Procedurës Kontestimore ku parashihen rregullat për procedurat e posaçme kontestimore, dhe atë nga neni 478 përfundimisht me nenin 483 të LPK. Nëse në këtë pjesë të ligjit nuk ekzistojnë dispozita të veçanta për kontestet e pengimit në posedim, atëherë përshtatshmërisht zbatohen dispozitat tjera të LPK.

Padia për pengim posedimi mund të paraqitet nga dy arsye:

- a) *Për shkak të marrjes së sendit, përkatësisht privimit në tersi nga ushtrimi i të drejtës së mëparshme të poseduesit dhe*
- b) *Kufizimit të posedimit të sendit apo ushtrimit të ndonjë të drejte të shkaktuar me trazim ose pengim të posedimit të qetë të mëparshëm nga i padituri (neni 113 i LPDTS).*

Paraqitja e padisë për pengim posedimi është me afat të kufizuar, ashtu që kjo padi mund të paraqitet brenda 30 ditësh nga dita kur paditësi ka kuptuar për pengimin e shkaktuar dhe kryesin (afati subjektiv), përkatësisht brenda një viti nga dita e pengim posedimit (afati objektiv). Padia e paraqitur pas afateve të mësipërme duhet hedhë poshtë si e pasafatshme (neni 114 i LPDTS).

Në kontestet për pengim posedimi gjykata shqyrton gjendjen e fundit faktike, me qëllim të mbrojtjes së saj si dhe aktin e pengim posedimit të ndërmarr nga i padituri, përkatësisht nëse veprimi apo mosveprimi (përmbajtja) i të paditurit përfaqëson aktin e pengim posedimit. Gjykata nuk shqyrton të drejtën në posedim, bazën juridike të posedimit, ndërgjeshmërinë apo jo ndërgjeshmërinë e posedimi si dhe kërkesat eventuale për dëmshpërblim (neni 480 i LPK). Nëse i padituri bën kundërshtim se paditësi ia ka marr posedimin me forcë, me mashtrim apo fshehtazi, gjykata përjashtimisht do të shqyrton lidhur me këtë kundërshtim nëse nuk kanë kaluar 30 ditë nga dita kur ai e ka kthye sendin në posedim (neni 112 i LPDTS).

Procedura në kontestet për pengim posedimi është e natyrës urgjente, ka qëllim që sa më shpejtë të rivendoset gjendja ekzistuese para shkaktimit të pengim posedimi, gjë që edhe është parashikuar afati subjektiv për paraqitjen e padisë, 30 ditë, përkatësisht objektiv prej një viti. Afatet për përmbushjen e detyrimit, varësisht nga rasti, janë më të shkurta se zakonisht. Afati për paraqitjen e ankesës është 7 ditë (neni 481.2 i LPK). Propozimi për përbarim me të cilin do të kërkohej ekzekutim i aktvendimit nga kontesti për pengim posedimi, me të cilin i është urdhërua të paditurit të ndërmerr veprimin e caktuar duhet të paraqitet brenda 30 ditësh pas kalimit të caktuar për kryerjen e atij veprimi.

Vetëm në kontestet për pengim posedimi forma e vendimit të gjykatës është aktvendimi (neni 142.3 i LPK), në të gjitha kontestet tjera vendoset me aktgjykim.

Kundër aktvendimeve të marra në kontestet për pengim posedimi nuk është i lejuar revizioni (neni 481.4 i LPK). Në këto konteste lejohet përsëritja e procedurës vetë nga shkaqet e përcaktuara në nenin 323 pika a. dhe b. të këtij ligji, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita në të cilën është bërë i formës së prerë aktvendimi përfundimtar (neni 483 i LPK).

8. Masat e përkohshme

Ligji i Procedurës Kontestimore në fuqi, në pjesën ku janë paraparë rregulla të posaçme për kontestet për pengim posedimi, e as në ndonjë pjesë tjetër, nuk ka parashikuar mundësinë e caktimit të masave të përkohshme. Nga kjo arsye këtë mundësi duhet shfrytëzuar në bazë të dispozitave të Ligjit të Procedurës së Përbarimore (LPP), ku është paraparë mundësia e caktimit të masës së përkohshme me qëllim të sigurimit të kërkesës.

9. Vetëndihma

Poseduesi mund të përdorë forcën e arsyeshme për mbrojtje nga veprimet e paligjshme në pengimin e posedimit të tij, në qoftë se ndërhyrja është atëçastshme dhe janë ndërmarrë masat adekuate (proporcionale) për mbrojtje, menjëherë me paraqitjen e ndërhyrjes (rrezikut). Nëse një send i luajtshtëm i merret poseduesit me pengim të kundërligjshëm, poseduesi mundet të përdorë forcë të arsyeshme që ta heq sendin nga penguesi i cili është zënë në vepër ose ndiqet. Po ashtu të drejtën për vetëndihëm e ka edhe detentori (neni 112 i LPDTS)⁷.

Vetëndihma nënkupton të drejtën e poseduesit, në rastin kur i është marr sendi, që atë send ta kthen në posedim të vetin. Kjo mund të bëhet vetëm brenda një kohe të caktuar. Kthimi si i sendit të luajtshtëm edhe të paluajtshtëm mund të bëhet brenda afatit për padi për pengim posedimi - 30 ditësh.

PRONËSIA

1. Kuptimi dhe përmbajtja e të drejtës së pronësisë

E drejta e pronësisë nënkupton pushtetin e plotë juridik të një personi ndaj një sendi. E drejta e pronësisë është e drejtë absolute pronësore. Personi i cili e ka pushtetin juridik ndaj një sendi, në rregull, ai e ka edhe pushtetin faktik, mirëpo kjo nuk ndodh gjithmonë, nga se edhe pse e ka pushtetin juridik, mund mos ta ketë atë faktik.

Aktualisht e drejta e pronësisë tek ne është e rregulluar me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore (LPDTS).

E drejta e pronësisë ndaj një sendi nuk përfaqëson vetëm të drejtën mbi atë send por, si marrëdhënie juridike, përfaqëson edhe marrëdhënien themelore, më të rëndësishme juridike pronësore. Përmbajtja e të drejtës së pronësisë është parashikuar në nenin 18 të LPDTS, sipas të cilit nen edhe është përcaktuar se ajo është e drejtë nga e cila për pronarin rrjedhin autorizimet: a. që ai sendin pronar i të cilit është **1. ta mbaj, 2. ta shfrytëzoj dhe 3. të disponoj me atë**. Këto të drejta dhe këto autorizime në një mënyrë i kufizohen pronarit brenda kufijve të përcaktuar me ligj, siç është parashikuar në nenin 5 të këtij ligji.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës përkitazi me të drejtën e shfrytëzimit të pronës ka përcaktuar se shfrytëzimi i pronës do të rregullohet me ligj, në pajtim me interesin publik (neni 46.2 i Kushtetutës)⁸.

Duke përcaktuar tri autorizimet e pronarit si më lartë, ligji ka paraparë edhe mbrojtjen gjenerale të së drejtës së pronësisë, përkatësisht detyrimin e çdonjërit të përmbahet nga cenimi i kësaj të drejte, pasi që ajo vepron ndaj të gjithëve.

7 Detentori është personi i cili e ushtron pushtetin faktik mbi një send për ndonjë person tjetër ose për biznesin e ndonjë personi tjetër apo në ndonjë raport të ngjashëm (neni 105 i LPDTS).

8 Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar me 9 prill 2008,

2. Subjektet e të drejtës së pronësisë

Subjekt i të drejtës së pronësisë, në radhë të parë, mund të jetë qytetari si person fizik (neni 2 i LPDTS) i cili përcakton se titullar i të drejtave sendore janë 1. Çdo person mund të fitojë të drejta sendore, përveç nëse është paraparë ndryshe me ligj dhe 2. Titullari i një të drejte sendore mund të paraqesë këtë të drejtë kundrejt cilitdo person, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.

Bartës të drejtës së pronësisë mund të jenë edhe personat juridik, të regjistruar si të tillë në regjistrin përkatës siç është rregulluar me ligj. Sipas këtij ligji, bartës të drejtës së pronësisë mund të jenë edhe shoqatat e qytetarëve. Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës edhe personat fizik të huaj mund të sigurojnë të drejtën e pronësisë, në pajtim me ligj ose marrëveshje ndërkombëtare (neni 121 i Kushtetutës).

Varësisht nga forma e pronës Kushtetuta e Republikës së Kosovës përcakton edhe bartësin e të drejtës së pronës. Në këtë aspekt sipas nenit 159.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës të gjitha ndërmarrjet që kanë qenë në pronësi shoqërore para hyrjes në fuqi të Kushtetutës, do të privatizohen. Ndërsa sipas par. 2 të këtij neni, të gjitha interesat në pronësi shoqërore në prona dhe ndërmarrje në Kosovë, do të jenë në Pronësi të Republikës së Kosovës. Republika e Kosovës i ka në pronësi të vetën edhe të gjitha ndërmarrjet publike (neni 160 par. 1 i Kushtetutës). Sipas par. 2 të këtij neni edhe komuna mund të jetë bartës i të drejtës së pronës.

3. Të drejtat e tjera të pronarit të objektit banesor të ndërtuar në bazë të ligjit në pronësi shoqërore

LPDTS, përpos të drejtës së pronësisë, parasheh dhe rregullon për raste të caktuara edhe të drejtën e shfrytëzimit. Ky ligj në nenin 1.2 të tij rregullon pronësinë si dhe të drejtat sendore të kufizuara si posedimin, të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit. Këto të drejta sendore të kufizuara mund të krijohen në pronësi apo në të drejta sendore të tjera që mund të jenë të përshtatshme për këtë qëllim.

Paragrafi 3 i nenit 1 të këtij ligji parasheh se të drejtat tjera sendore mund të krijohen vetëm përmes ligjit. Dispozitat e përgjithshme dhe parimet themelore të këtij ligji gjithashtu vlejnë për të drejtat sendore të cilat nuk parashihen në paragrafin 2 të këtij neni, përveç nëse ligjet e veçanta parashohin ndryshe.

Për të fituar të drejtën e shfrytëzimit të tokës në pronësi shoqërore si më sipër duhet plotësuar disa kushte. Në radhë të parë, personi që e ka ndërtuar objektin është dashtë të ketë të drejtë ndërtimi të atij objekti, qoftë mbi bazën se në kohën e ndërtimit ajo tokë ka qenë në pronësi të tij e më vonë ka kaluar në pronësi shoqërore, apo në kohën e ndërtimit ka qenë pronë shoqërore e ndërtuesit i është ndarë në shfrytëzim me vendim të organit shtetëror, me qëllim të ndërtimit të objektit. Kjo nënkupton se objekti është ndërtuar në bazë të lejes për ndërtim. Kusht tjetër është që ndërtuesi i objektit ta ketë të drejtën e pronësisë mbi atë objekt.

Ma plotësimin e këtyre dy kushteve pronari i ndërtesës ka të drejtë të shfrytëzon tokën ndërtimore nën objekt dhe të pjesës tjetër e cila shërben për shfrytëzimin e

rregullt të këtij objekti (oborrit). Këtë të drejtë e ka deri sa të jetë objekti ndërtimor. E drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore në pronësi shoqërore, në të cilën është ndërtuar objekti ndërtimor në bazë të ligjit, mund të bartet, mirëpo jo ndaras nga e drejta e pronësisë në objekt, nga se me kalimin e të drejtës së pronësisë në objekt në personin tjetër, automatikisht kalon edhe e drejta e shfrytëzimit të tokës ndërtimore në pronësi shoqërore.

4. Bashkëpronësia, prona e përbashkët dhe prona në etazhe

Përpos rasteve kur një person e ka të drejtën e pronësisë në një send, ndodhë që disa persona të kanë të drejtën e pronësisë në të njëjtin send. Në këtë aspekt sipas LPDTS dallojmë:

- Bashkëpronësinë,
- Pronën e përbashkët dhe
- Pronësinë në njësinë e ndërtesës

Bashkëpronësia është institut juridik i cili nënkupton se më shumë veta e kanë të drejtën e bashkëpronësisë në një send të pandarë e pjesa e secilit nga ata është e përcaktuar në pjesë ideale, pasi që sendi nuk është realisht i ndarë. Të drejtën e pronësisë e kanë të gjithë bashkëpronarët dhe asnjëri nga bashkëpronarët nuk është pronar i gjithë sendit (neni 51 i LPDTS). Nëse pjesët e bashkëpronarëve nuk janë të caktuara as në pjesë ideale, vetëm thuhet se janë bashkëpronar pa u përmend pjesët ideale të tyre, supozohet se janë bashkëpronar në pjesë të barabarta, deri sa nuk vërtetohet ndryshe (neni 56.4 i LPDTS). Ka mjaftë konteste gjyqësore kur njëri nga bashkëpronarët, pjesa e të cilit nuk është e caktuar në mënyrë ideale, paditë bashkëpronarët tjerë dhe kërkon të vërtetohet pjesa ideale e tij në krahasim me pjesët e bashkëpronarëve tjerë.

Të drejtat e bashkëpronarëve janë të drejta pronësore, me një përkufizim që të drejtat e bashkëpronarëve janë në një bashkësi juridike të interesave të bashkëpronarëve tjerë. Çdonjëri bashkëpronar e ka të drejtën individuale në sendin, në mënyrë që ajo duhet patjetër harmonizuar me të drejtat e bashkëpronarëve tjerë. Në këtë mënyrë bashkëpronari ka të drejtë që sendin ta mbaj dhe ta shfrytëzoj bashkë me bashkëpronarët tjerë, në proporcion me pjesën e vetë që e ka, duke mos cenuar të drejtën e bashkëpronarëve tjerë. Asnjë nga bashkëpronarët nuk mund të jetë posedues i vetëm, përpos nëse nuk merren vesh ndërmjet veti për këtë. Ai mund të disponoj me pjesën e vetë pa pëlqimin e të tjerëve mirëpo, në rast të shitjes së pjesës së vetë, tjerët e kanë të drejtën e përparësisë së blerjes, vetëm nëse ashtu është paraparë me ligj. Nëse bashkëpronari disponon me gjithë sendin pa marrëveshje me bashkëpronarët tjerë, disponimi i këtillë përfaqëson disponimin e paautorizuar të personit me sendin e huaj.

Të drejtën e shfrytëzimit e ka bashkë me bashkëpronarët tjerë, varësisht nga pjesa në të cilën e ka të drejtën e bashkëpronësisë. Bashkëpronarët bashkërisht administrojnë me sendin të cilin e kanë në bashkëpronësi.. Për ndërmarrjen e veprimeve me qëllim të administrimit të rregullt me sendin kërkohet pëlqimi i atyre që kanë mbi 50%.. Nëse

nuk ka marrëveshje, vendos gjykata në procedurën jokontestimore. Për veprimet tjera jashtë administrimit të rregullt si shitja, dhënie me qira, etj. kërkohet pëlqimi i të gjithë bashkëpronarëve, pavarësisht nga madhësia e pjesëve që kanë.

Bashkëpronari ka të drejtë në çdo kohë, pa pëlqimin e të tjerëve, të kërkon ndarjen e sendit, përpos në kohën e cila do të ishte në dëm të bashkëpronarëve tjerë. Kjo e drejtë nuk vjetërsohet. Ndarja bëhet sipas marrëveshjes e nëse nuk arrihet ajo, bëhet në procedurë jokontestimore nëpërmjet të gjykatës. Nëse ndarja fizike nuk është e mundur, bëhet ndarja civile, sendi shitet në ankand publik e të hollat e marra i ndajnë bashkëpronarët varësisht nga pjesët që kanë.

E drejta e bashkëpronësisë mund të fitohet me përzjerjen e sendeve të disa vetave, me punë juridike (blerje të përbashkët), me trashëgim, etj.

Prona e përbashkët nënkupton të drejtën e pronësisë të disa personave në një send të pandarë, pjesët e të cilëve paraprakisht nuk janë të caktuara por mund të përcaktohen (neni 51 i LPDTS). Prona e përbashkët vetëm përmendet dhe jepet kuptimi i saj në dispozitën e sipërsëhënuar. Normat të cilat e rregullojnë këtë në detale ndodhen në ligje tjera⁹. Kjo formë e pronës ekziston vetëm në rastet shprehimisht të përcaktuara me ligj dhe rregullohen me ato ligje, varësisht nga materia të cilën e rregullojnë.

Te prona e përbashkët, në rastet e përcaktuara me ligj, më shumë persona e kanë të drejtën e pronësisë në një send, ashtu që e drejta e pronësisë u takon të gjithëve atyre së bashku. Pronarët e përbashkët administrojnë dhe disponojnë me sendin bashkërisht, me vendim unanim, nëse me ligj nuk është parashikuar ndryshe për rastet konkrete. Pronari i përbashkët nuk e ka pjesën e vetë të veçantë. Ai është pronarë i tërë sendit i përkufizuar me të drejtën e pronësisë të pronarëve tjerë të përbashkët, nga kjo arsye edhe nuk mundet të disponoj me asnjë pjesë të pronës së përbashkët pa pëlqimin e pronarëve tjerë të përbashkët. Për detyrimet eventuale të sendit të përbashkët pronarët e përbashkët përgjigjen solidarisht. Sikur të bashkëpronësia, pronari i përbashkët ka të drejtë të kërkoj ndarjen e pronës së përbashkët, e cila edhe bëhet në të njëjtën mënyrë.

Sipas të drejtës tonë, prona e përbashkët paraqitet në bazë të ligjit dhe ekziston në këto forma: **a.** Prona e përbashkët e anëtarëve të familjes; **b.** Prona e përbashkët e bashkëshortëve dhe **c.** Prona e përbashkët e bashkëtrashëgimtarëve para ndarjes së trashëgimisë.

E drejta e pronës në njësinë e ndërtesës - Në rastet dhe nën kushtet e përcaktuara me ligj, ekziston edhe e drejta e pronës në një pjesë të një ndërtese (njësi ndërtese) është pronësi e veçantë në një banesë, një hapësirë (lokal) afariste ose një vend parkim garazhi së bashku me pjesën e bashkëpronësisë në paluajtshmëri në të cilën ndodhet pjesa e ndërtesës (neni 57 i LPDTS). Pronësia në njësinë e ndërtesës nënkupton të drejtën e pronësisë në pjesën fizike të ndërtesës, qoftë asaj banesore apo afariste.

Objekt i kësaj forme të pronës është banesa apo lokali afarist si pjesë e veçantë e ndërtesës, pjesët e përbashkëta të ndërtesës (korridoret, shkallët, etj) dhe toka në të cilën ndodhet ndërtesa. Nga kjo arsye edhe e drejta e pronës në njësinë e ndërtesës është

9 Shih Komentarin e Ligjit për Familjen i Kosovës botimi i parë Prishtinë 2012 i autorëve Aliu Abdulla, Gashi Haxhi & Vokshi Adem – faqet 550 – 573,

komplekse dhe në vete përmban: **1.** Të drejtat dhe detyrimet nga pronësia në banesë, apo lokal afarist; **2.** Të drejtat dhe detyrimet përkitazi me shfrytëzimin e pjesëve të përbashkëta të ndërtesës dhe **3.** Të drejtat dhe detyrimet përkitazi me sipërfaqen e tokës ku ndodhet ndërtesa.

Titullarët e të drejtës së pronësisë në njësinë e ndërtesës kanë të drejtën e pronës së përbashkët në pjesët e përbashkëta të ndërtesës, që shërbejnë për plotësimin e nevojave të përbashkëta të tyre, siç janë: muret, pullazi, korridoret, shkallët, kthinat për terjen e teshave, etj.

Kryesorja këtu është e drejta e pronës në banesë apo lokal afarist, si pjesë e veçantë e ndërtesës, ashtu që të drejtat tjera sekondare përcjellin fatin e të drejtës kryesore. Nga kjo rrjedh se e drejta e pronës në banesë apo lokal afarist dhe të drejtat në pjesët e pandashme të ndërtesës nuk mund të ndahen.

5. Fitimi i të drejtës së pronësisë (sipas ligjit, me punë juridike, me trashëgim dhe me vendim të organit shtetëror)

Në bazë të mundësive të parashikuara ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë, teoria juridike njih dy forma të fitimit të drejtës së pronësisë: **origjinare** apo burimore dhe **derivative** apo rrjedhëse. Forma origjinare nënkupton rastet kur e drejta e pronësisë nuk rrjedhë nga e drejta e titullarit paraprak të saj por nga faktet tjera juridike. Në rastet e këtilla nuk ka suksesim të së drejtës. Fitimi derivativ i të drejtës së pronësisë nënkupton rastet kur e drejta e pronësisë rrjedhë nga titullari paraprak i saj.

Këto dy forma të fitimit të së drejtës së pronësisë janë të parapara edhe me LPDTS, ashtu që shikuar në mundësitë e parashikuara ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë, ajo fitohet: **a.** sipas ligjit; **b.** në bazë të punës juridike; **c.** me trashëgim dhe ç. në bazë të vendimit të organit shtetëror, në mënyrë dhe në kushte të parapara ligjore.

6. Mënyra origjinare e fitimit të drejtës së pronësisë.

Kjo mënyrë e fitimit është paraparë në nenin 31 të LPDTS, sipas të cilës dispozitë, e drejta e pronësisë në bazë të ligjit fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkimin e sendeve, me përzierjen e sendeve, me ndërtim në tokë të huaj, me ndarjen e frutave nga sendi që jep fruta, mbi bazën e posedimit, nga jopronari, me okupim dhe në rastet tjera të parashikuara me ligj.

- Krijimi i sendit të ri

LPDTS i cili edhe aktualisht rregullon mënyrën e fitimit të drejtës së pronësisë, përcakton tri raste të ndryshme të fitimit të drejtës së pronësisë mbi bazën e krijimit të sendit të ri.

Se kush do të jetë pronar i një sendit të ri të krijuar varet se i kujt është materiale nga i cili është krijuar ai send, kush ka punuar në krijimin e tij dhe nga ndërgjegjshmëria e krijuesit ë sendit të ri (neni 31 i LPDTS).

Në rastin e parë ligji përcakton se personi i cili me material të vetin dhe punë të vetën ka krijuar një send të ri, ai është edhe pronar i atij sendi. Në rastin tjetër, nëse sendi i ri i luajtshëm krijohet përmes përpunimit apo ndryshimit me materialin e personave tjerë, e fiton pronësinë në sendin e ri të krijuar, përveç në rast se vlera e përpunimit është qenësish më e vogël se vlera e materialit me të cilin është krijuar sendi i ri (neni 31.2 i LPDTS). Së fundi, nëse një person nga materiali i huaj e me punë të vetën krijon sendin e ri, fitimi i të drejtës së pronësisë mbi atë send varet nëse ai person ka qenë i ndërgjegjshëm apo i pandërgjegjshëm, e nëse ka qenë i ndërgjegjshëm pronësia mbi atë send të ri varet edhe nga vlera e punës dhe e materialit me të cilin është krijuar ai send. Nëse vlera e tyre është përafërsisht e barabartë do të kemi bashkëpronësinë.

- **Fitimi i të drejtës së pronësisë nga jopronari**

Sipas këtij instituti juridik fitohet e drejta e pronësisë në një send të luajtshëm me bartjen e të drejtës së pronësisë nga personi i cili as nuk është pronar i atij sendi e as që është i autorizuar të disponoj me atë. Në bazë të kësaj dispozite ligjore personi me mirëbesim e fiton të drejtën e pronësisë mbi sendin e luajtshëm të cilin e ka marr me kompensim nga jopronari i cili merret me tregtinë e atij sendi, nga jopronari të cilit atë send ia ka dhënë pronari me punë juridike të pavlefshme për fitimin e të drejtës së pronësisë apo e ka marr në ankand publik.

Për të fituar të drejtën e pronësisë mbi këtë bazë është e nevojshme ndërgjegjshmëria e fituesit ë drejtës së pronësisë, sendi të është marr me kompensim nga personi i cili merret me tregtinë e atij sendi ose në ankand publik. Me rastin e fitimit të drejtës së pronësisë nga jopronari marrin pjesë tre persona: titullari i mëhershëm i të drejtës (pronari i mëhershëm), tjetërsuesi i sendit dhe personi i tretë i cili e fiton të drejtën. Në këtë rast pronari i vërtetë e humb të drejtën e pronësisë edhe pse ai nuk ka marr pjesë në punën juridike të arritur mes personit që e tjetëron sendin dhe personit të tretë të ndërgjegjshëm.

- **Fitimi i të drejtës së pronësisë në bazë të posedimit (parashkrimit fitues)**

Fitimi i të drejtës mbi këtë bazë nënkupton fitimin e të drejtës së pronësisë në bazë të posedimit të ligjshëm dhe me mirëbesim, me kalimin e afatit të caktuar kohor. Te posedimi vjen në shprehje parimi se mosqëndrueshmëria e mospajtimit (konfliktit) të përhershëm ndërmjet pushtetit faktik dhe juridik mbi një send përfundon në favor të pushtetit faktik.

Të drejtën e pronësisë mbi bazën juridike të posedimit mund ta fitoj vetëm poseduesi i ligjshëm dhe në mirëbesim (neni 4 i LPDTS). Nëse është apo jo posedimi i ligjshëm duhet argumentuar, ndërsa mirëbesimi (ndërgjegjshmëria) supozohet, ai që e kundërshton duhet argumentuar të kundërtën. Pavarësisht nga kalimi i afatit kohor, poseduesi me keqbesim nuk mund ta fitoj të drejtën e pronësisë mbi këtë bazë juridike.

Me ligj dallojnë afatet kohore të nevojshme për fitimin e të drejtës së pronësisë me posedim, varësisht nëse poseduesi është edhe i ligjshëm edhe në mirëbesim (afati i rregullt) apo nuk është i ligjshëm por vetëm me mirëbesim (afati absolut), si dhe në rastet kur janë në pyetje sendet e luajtshme nga ato të paluajtshme (neni 40 i LPDTS).

- Posedimi i rregulltë

- poseduesi i ligjshëm dhe në mirëbesim i sendit të luajtshëm, afati kohor 10 vite,
- poseduesi i ligjshëm dhe në mirëbesim i sendit të paluajtshëm, afati kohor 10 vite.

- Posedimi absolut

- poseduesi në mirëbesim i sendit të luajtshëm, afati kohor 10 vite,
- poseduesi në mirëbesim i sendit të paluajtshëm, afati kohor 20 vite.

Afati fillon të rrjedhë nga momenti kur poseduesi e ka marr sendin në posedim e përfundon me kalimin e ditës së fundit të afatit të parashikuar ligjor për vjetërsim.

Në rastet kur poseduesi paraprak i pandërgjegjshëm vdes, trashëgimtari i tij bëhet posedues në mirëbesim nga momenti i vdekjes së trashëgimlënësit, nëse nuk ka ditur dhe nuk ka mundur të dijë për se paraardhësi ka qenë i pandërgjegjshëm, ndërsa afati i posedimit fillon të rrjedhë nga momenti i hapjes së trashëgimisë. Në kohën e nevojshme për posedim llogaritet edhe koha gjatë së cilës paraardhësit e poseduesit të tanishëm kanë qenë posedues të ligjshëm dhe në mirëbesim, përkatësisht vetëm në mirëbesim (neni 344 i LMD).

Mirëbesimi në posedim duhet të ekzistoj gjatë gjithë kohës së parashikuar me ligj për fitimin e të drejtës së pronësisë mbi këtë bazë juridike. Përkritazi me ndërprerjen dhe ndaljen e posedimit zbatohen dispozitat ligjore të zbatueshme për ndërprerjen dhe ndaljen e vjetërsimit të kërkesave sipas LMD.

- Fitimi i të drejtës së pronësisë me ndërtim

Ndërtimi në tokë të huaj paraqet rast specifik, nga edhe paraqiten situata të ndryshme, për të cilën arsye edhe kërkojnë tretman të posaçëm. Personi i cili mund të jetë bartës i të drejtës së pronësisë, i cili ndërton objektin ndërtimor në tokë në të cilën tjetri e ka të drejtën e pronësisë, e fiton të drejtën e pronësisë edhe në sipërfaqen tokësore nën objekt dhe të asaj e cila shërben për shfrytëzimin e rregullt të objektit, nëse nuk ka ditur dhe nuk ka mundur të di se po ndërton në tokë të huaj e pronari i tokës ka ditur për ndërtimin dhe nuk ka kundërshtuar menjëherë. Në rastet e këtilla kur personi që ndërton është i ndërgjegjshëm, ndërsa pronari i tokës i pandërgjegjshëm, nga se nuk ka kundërshtuar ndërtimin, pronari i tokës nuk mund të kërkon rrënimin e objektit. Në këtë rast personi që ndërton e fiton të drejtën e pronësisë jo vetëm në objektin ndërtimor të cilin po e ndërton, por edhe në sipërfaqen tokësore nën objekt dhe sipërfaqen tjetër e cila është e nevojshme për shfrytëzimin e rregullt të objektit (neni 90 i LPDTS).

Pronari i tokës ka të drejtë në vlerën e tokës në lartësi të çmimit të tregut në kohën e marrjes së vendimit gjyqësor. Kërkesa e këtillë duhet paraqitur brenda afatit subjektiv prej 1 viteve dhe atij objektiv prej 5 viteve nga dita e përfundimit të ndërtimit.

Nëse pronari i tokës ka kundërshtuar menjëherë, pavarësisht nëse ndërtuesi ka ditur apo jo se po ndërton në tokë të huaj, pronari i tokës ka të drejtë të zgjedhë dhe mund të kërkon: t'i takon atij e drejta e pronësisë në objektin e ndërtuar; personi që ka ndërtuar ta rrënon objektin, ta heq materialin ndërtimor dhe t'ia dorëzoj tokën si ka qenë më parë; ose personi që ka ndërtuar t'ia paguaj vlerën e tregut të tokës.

Nëse personi që ndërton është i ndërgjegjshëm e pronari i tokës nuk ka ditur për ndërtimin, në rastet kur objekti ka vlerë shumë më të madhe se toka, objekti bashkë me tokën i takon në pronësi personit i cili e ka ndërtuar objektin, e pronari i tokës ka të drejtë në vlerën e tregut të tokës. Nëse toka ka vlerë shumë më të madhe, sipas kërkesës së pronarit të saj, gjykata do t'ia jep atij në pronësi objektin, duke e detyruar t'ia kompensoj ndërtuesit vlerën ndërtimore të tij. Nëse vlera e objektit dhe e tokës janë përafërsisht të njëjta, gjykata vendos cilit do t'i jepet në pronësi, varësisht nga rrethanat tjera.

- Okupimi

Okupimi nënkupton marrjen e sendit të luajtshëm në posedim, të cilin pronari e ka braktisur, me qëllim që mbi atë të fitohet e drejta e pronësisë (neni 32 i LPDTS). Në sendet e paluajtshme nuk mund të fitohet e drejta e pronësisë mbi këtë bazë juridike, pasi që paluajtshmëria e braktisur kalon në pronësi shoqërore nga momenti i braktisjes (neni 42.2 i LPDTS).

Për tu konsideruar se një send është i braktisur është e nevojshme që pronari i tij e heq nga posedimi atë me qëllim të heqjes dorë edhe nga e drejta e pronësisë. Këtë veprim juridik mund ta bëj vetëm personi i cili ka zotësi për të vepruar. Përkundër braktisjes së sendit, marrjen në posedim të sendit të braktisur me qëllim të fitimit të drejtës së pronësisë mund ta bëjnë edhe personat të cilët nuk e kanë zotësinë e veprimit (fëmijët).

7. Mënyra derivateve e fitimit të drejtës së pronësisë

- baza juridike (titulus) dhe mënyra e fitimit (modus acquirendi).

Mënyra derivateve e fitimit të drejtës së pronësisë nënkupton kalimin e të drejtës së pronësisë nga titullari i mëparshëm, në bazë të punës juridike. Në dallim nga ajo origjinere, te mënyra derivateve e drejta fitohet në bazë të vullnetit të pronarit të mëparshëm.

Për fitimin derivativ të drejtës së pronësisë është e nevojshme që: në sendin e caktuar dikush të jetë bartës i të drejtës së pronësisë; që ajo e drejtë e pronësisë të bartet nga titullari i mëparshëm në tjetrin; gjer te kjo bartje të vjen me dëshirën e paraardhësit të

kësaj të drejte. Përpos këtyre tri kushteve paraprahe, për fitimin e të drejtës së pronësisë në mënyrë derivative, të cilat edhe përfaqësojnë bazën juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë, duhet plotësuar edhe kushti i katërt e ai është mënyra e fitimit. Mënyra e fitimit e të drejtës së pronësisë dallon varësisht nga ajo nëse bartet e drejta e pronësisë në sendin e paluajtshëm apo të luajtshëm.

E drejta e pronësisë në sende të paluajtshme, në bazë të punës juridike, fitohet me regjistrimin e kësaj të drejte në regjistrin e paluajtshmërive (neni 36 i LPDTS). Për fitimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmëri nuk mjafton vetëm baza juridike e vlefshme për fitimin e kësaj të drejte (p.sh. lidhja e kontratës së shitblerjes në formën e parashikuar ligjore) nga se sipas ligjit nevojitet edhe mënyra e fitimit e kjo është regjistrimi i kësaj të drejte në regjistër të paluajtshmërive.

Për sendet e luajtshme, mënyra e fitimit të drejtës së pronësisë e parashikuar me ligj, dallon nga ajo që është parashikuar për sendet e paluajtshme (neni 21 i LPDTS). E drejta e pronësisë mbi sendet e luajtshme, në bazë të punës juridike, fitohet me dorëzimin e sendit në posedim. Nëse ndodhë që disa persona kanë lidhur punë juridike për fitimin e të drejtës së pronësisë në të njëjtin send të paluajtshëm, të drejtën e pronësisë e fiton personi të cilit i dorëzohet sendi më parë.

8. Llojet e padisë për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë

Si mbrojtje gjenerale, jocenueshmëria e të drejtës së pronës është parim kushtetues. Kushtetuta e Republikës së Kosovës të drejtën e pronës e garanton dhe askush nuk mund të privohet në mënyrë arbitrare nga prona (neni 46 i Kushtetutës). Kjo e drejtë është e mbrojtur edhe me konventa ndërkombëtare.

Actio Reivindicatio (Padia e reivindikimit)

Të gjitha format e pronës me ligj gëzojnë mbrojtje edhe si të drejta individuale. Duke u nisur nga autorizimet që ka titullari i të drejtës së pronës edhe për ta mbajtur sendin pronar i të cilit është, pronari mund me padi të kërkon nga poseduesi kthimin e sendit individualisht të caktuar (neni 93 i LPDTS). Kjo padi pronësore për kthimin e sendit është e njohur që nga e drejta romake me emrin **Actio Reivindicatio**.

Ajo paraqitet nga pronari jo posedues kundër poseduesit jo pronar, përkatësisht paditës është pronari i sendit e i paditur poseduesi i ati sendit. Paditësi duhet të paraqet prova dhe të argumenton se është pronar i sendit kthimin e të cilit e kërkon. Kërkesat që mund të paraqiten janë: kthimi i sendit individualisht të caktuar, dëmshpërblimi eventual në emër të dëmtimit të sendit dhe kthimi i frutave (sasia e frutave varësisht nga rrethana nëse poseduesi është në mirëbesim apo jo). I padituri mund të paraqet këto kundërshtime: se ka ndonjë të drejtë sendore sipas së cilës ka autorizim për një kohë të caktuar ta mbaj sendin në posedim apo ka ndonjë të drejtë detyrimore ndaj paditësit e cila e autorizon ta mbaj sendin për një kohë të caktuar p.sh. ka paguar qiranë për një kohë më të gjatë.

Actio publiciana (Padia nga e drejta e supozuar e pronësisë)

Edhe kjo padi rrjedhë që nga e drejta romake. Padia Publiciana është mjet kontesti mes dy pjesëmarrësve rreth posedimit të sendit, në të cilin kontest asnjëri nuk mund të argumentojnë se ka të drejtën në sendin, mirëpo sendi i jepet poseduesit me bazë më të mirë për posedim. Padiësi në këtë kontest duhet të argumentoj ligjshmërinë e posedimi, bazën juridike të posedimit – titulus, se posedimin e ka fituar në bazë të punës së vlefshme juridike në bazë të së cilës edhe fitohet e drejta e pronësisë. Pse nuk e ka fituar të drejtën e pronësisë, në të shumtën e rasteve personi që e ka tjetërsuar atë send nuk ka pas të drejtë të disponoj me atë, e për këtë fakt poseduesi nuk ka ditur, është në mirëbesim (neni 94 i LPDTS).

Nëse dy persona konsiderohen pronar të supozuar bazën juridike me të fortë e ka ai i cili sendin e ka fituar në bazë të punës juridike me barrë, në krahasim me atë pa barrë. Nëse bazat juridike janë të njëjta përparësi ka personi te i cili ndodhet sendi.

Padiës është poseduesi i mëparshëm i cili edhe sendin individualisht të caktuar e ka fituar në mënyrë të ligjshme dhe sipas bazës juridike të vlefshme, ndërsa i paditur është poseduesi i tanishëm. Kërkesa sipas kësaj padie është dorëzimi i sendit individualisht i caktuar, kthimi i frutave si dhe dëmshpërblimi eventual nëse sendi është dëmtuar. Sa u përket kundërshtimeve, në radhë të parë i padituri mund të bënë kundërshtim se ai është pronar i sendit, ashtu që kjo padi mund të ndikoj ndaj të gjithëve por jo edhe ndaj pronarit të sendit. I padituri mund të bënë kundërshtim edhe se ka bazë më të fortë për posedim, apo së paku njësoj si padiësi.

Actio negatoria (Padia negatore – për shkak të pengimit të pronësisë)

Në dallim nga dy rastet e më sipërme kur me padi pronari mbrohej për shkak të marrjes së sendit individualisht të caktuar nga posedimi, kjo padi paraqitet kur deri te marrja e sendit nuk ka ardhur por pronari ose pronari i supozuar, pa bazë, në ndonjë mënyrë, nga personi i tretë, është shqetësuar, trazuar në të drejtën e pronësisë (neni 113 i LPDTS).

Numri më i madh i trazimeve të pronësisë së paluajtshme rrjedhë nga imisionet siç janë: përcjellja e tymit, aromave jo të këndshme, lëshuarja e nxehtësisë, ujërave të zeza, pastaj hedhja e gurëve, dheut, lëshuarja e kafshëve, etj.

Padiës është pronari apo pronari i supozuar i sendit të paluajtshëm apo të luajtshëm. I paditur është personi i cili kryen shqetësimin e pronësisë personalisht apo e urdhëron tjetrin për këtë.

Kërkesa është ndërprerja e shqetësimeve të mëtejshme pronësore, pengimit të pronësisë

9. Humbja e të drejtës së pronësisë

Nëse e drejta e pronësisë humbet vetëm për pronarin e deriatëhershëm kemi humbjen apo shuarjen relative të drejtës së pronësisë. Nëse ajo shuhet nga ekzistenca juridike, atëherë kemi humbjen apo shuarjen absolute të saj.

Përndryshe e drejta e pronësisë humbet: 1. me kalimin e sendit në pronësi shoqërore (nacionalizimi, konfiskimi, eksproprijimi, braktisja e paluajtshmërisë, me ngeljen e pasurisë pa trashëgimtar, me punë juridike etj.); 2. me kalimin e të drejtës së pronësisë në personin tjetër (në bazë të punës juridike); 3. me braktisjen e sendit (paluajtshmëria e braktisur kalon në pronësi shoqërore); 4. me shkatërrimin e sendit si dhe eventualisht në rastet tjera, nëse është përcaktuar me ligj.

IV. E DREJTA E PËRPARËSISË SË BLERJES – KUPTIMI DHE RASTET

E drejta e përparësisë së blerjes paraqet kufizim të së drejtës së pronësisë, pasi që titullari i saj, në rastet e përcaktuara me ligj apo në bazë të kontratës, në rast të shitjes të sendit pronar i të cilit është, paraprakisht duhet ofruar ta blejnë, nën kushte të njëjta, personat siç është parashikuar me ligj apo me kontratë.

E drejta e përparësisë së blerjes nënkupton të drejtën e titullarit të saj që sendi duhet më parë, në rast të shitjes, t'i ofrohet atij që ai ta blej para të tjerëve nën kushte të njëjta (**e drejta e përparësisë së blerjes**), e nëse kjo nuk respektohet, titullari i saj ka të drejtë të kërkojë nga blerësi t'i dorëzohet sendi nën të njëjtat kushte siç e ka blerë ai si dhe kontrata e shitblerjes të shpallet pa efekt juridik përkitazi me atë (**e drejta e parablerjes**).

Sipas këtij instituti të së drejtës mbrohet interesi i personave të caktuar me qëllim të marrjes dhe fitimit të sendeve të caktuara. Këta persona, qoftë në bazë të kontratës apo ligjit, kanë përparësi në krahasim me blerësit tjerë dhe në këtë mënyrë u mundësohet ta marrin (blejnë) sendin para se të hyjnë blerësit tjerë në bisedime për blerjen e tij.

E drejta e përparësisë së blerjes përbëhet prej dy pjesëve, në bazë të së cilës edhe në gjykatë mund të paraqiten dy lloj kërkesash.

Së pari ajo mund të paraqitet si e drejtë e përparësisë së blerjes. Kështu, kur pronari vendos ta shet sendin, ka detyrim paraprakisht t'ia ofroj atë për blerje personit i cili, sipas kontratës apo ligjit, ka të drejtën e përparësisë së blerjes, e pasi që ai ta refuzon këtë ose mos të përgjigjet në ofertë në afatin e paraparë, pronari mund të ia shet sendin, nën të njëjtat kushte, çfarëdo personi tjetër.

Nëse ndodh që pronari i sendit mos ta përfill këtë detyrim dhe mos t'ia ofron sendin për blerje personit i cili e ka të drejtën e përparësisë së blerjes, duke e lidhur kontratën e shitblerjes me personin tjetër, e drejta e përparësisë së blerjes merr karakter tjetër dhe paraqitet si e drejtë e parablerjes të sendit nga dora e blerësit. Në këtë rast personi i cili e ka të drejtën e parablerjes nëpërmjet gjykatës do të kërkon që kontrata e shitblerjes të shpallet pa efekt juridik dhe sendi i shitur t'i dorëzohet atij me çmim dhe sipas kushteve nga kontrata e shpallur pa efekt juridik.

E DREJTA SENDORE

Nga të paraqiturat e mësipërme rrjedh se kushtet për të mos cenuar, për të realizuar këtë të drejtë, janë:

- Pronari i sendit që shitet, duhet tu dërgon ofertën me shkrim të gjithë personave të cilët kanë të drejtën e përparësisë së blerjes, me të cilën ata njoftohen lidhur me qëllimin e shitjes së sendit;
- Në ofertë duhet të paraqitjen të gjitha kushtet e shitjes (çmimi, afatet dhe kushtet e pagesës).
- Personat të cilët e kanë këtë të drejtë duhet të përgjigjen në ofertë brenda afatit të caktuar;
- Nëse nuk përgjigjem brenda këtij afati konsiderohet se nuk janë të interesuar për blerjen e atij sendi, ashtu që pronari, nën të njëjtat kushte nga oferta, mund t'ia shet sendin personit të tretë, sikur të lajmërohej se nuk e pranon ofertën;
- Nëse e lajmëron shitësin se pranon kushtet nga oferta, nën të njëjtat kushte duhet të kryhet shitblerja në formën ligjore;
- Nëse shitblerja është kryer në kundërshtim me rregullat e parashikuara ligjore, pa respektuar të drejtën e përparësisë së blerjes, ose me kushte më të volitshme nga ato të paraqitura në ofertë, personi i cili e ka të drejtën e përparësisë së blerjes, brenda afatit për paraqitjen e padisë duhet të deponoj në gjykatë shumën e të hollave në lartësi të çmimit të shitblerjes dhe të paraqet padi me kërkesë që kontrata e shitblerjes me të cilën është cenuar e drejta e tij për përparësi në blerje, të bartet në emër të tij si blerës.

E drejta e përparësisë së blerjes mund të rrjedhë në bazë të kontratës apo në bazë të ligjit. Këto dy lloje të së drejtës së përparësisë së blerjes, pavarësisht nga disa ndryshime që kanë, ato kanë edhe mjaftë ngjashmëri, andaj edhe rregullat që vlejné për të drejtën e përparësisë së blerje në bazë të kontratës, vlejné edhe për atë në bazë të ligjit (neni 516.3 i LMD).

Më së shpeshti e drejta e përparësisë së blerjes në bazë të kontratës paraqitet si element sekondar te kontrata e shitblerjes në favor të shitësit, te kontrata e dhurimit në favor të dhuratëdhënësit, te kontrata e këmbimit në favor të njëres apo të dy palëve apo te kontrata e pengut në favor të pengmarrësit.

Ekzistojnë forma të shumta të drejtës së përparësisë së blerjes në bazë të ligjit siç janë: me rastin e shitjes të tokës bujqësore, të pyllit apo të tokës pyjore, të tokës ndërtimore, të ndërtesës apo banesës familjare, të lokalit afarist, sipas Ligjit për Qarkullimin e paluajtshmërive, të pjesës së pasurisë së bashkëshortit nga pasuria e përbashkët (neni 94 i LFK), etj.

V. E DREJTA E SERVITUTIT

E drejta e servitutit është një e drejtë reale që nënkupton të drejtën e një personi që, në përmasë dhe në mënyrë të caktuar, të shfrytëzon sendin pronar i të cilit është personi tjetër.

Tri janë karakteristikat themelore të drejtës së servitutit. Së pari, kjo e drejtë ekziston mbi sendin e huaj. E dyta është se, nga ajo rrjedh autorizimi për bartësin e saj që nga pronari i të mirës shërbyese të kërkon të duron (p.sh. të kalohet nëpër pronën e tij). Karakteristika e tretë është që duke e shfrytëzuar këtë të drejtë, duhet sa është e mundur më pak të ngarkohet e mira shërbyese.

Servitutet ndahen: në servitute reale dhe servitute personale.

1. Servitutet reale – kuptimi dhe ndarja e tyre varësisht nga përmbajtja dhe vëllimi

Servituti real është e drejtë e pronarit të një paluajtshmërie (e mira e privilegjuar) që për nevoja të asaj paluajtshmërie të ndërmerr veprime të caktuara në paluajtshmërinë e pronarit tjetër (e mira shërbyese), apo të kërkon nga pronari i të mirës shërbyese që ai të përmbahet nga ndërmarrja e ndonjë veprimi për të cilin ka të drejtë (neni 252 i LPDTS). Nga kuptimi i këtillë i dhënë ligjor i të drejtës së servitutit real, duke pasur parasysh edhe kufizimin e dhënë të kësaj të drejte, rrjedhin edhe tri karakteristikat dhe parimet e sipërshënuara të drejtës së servitutit. Servitutet reale si marrëdhënie juridike sendore ndahen në: servitute të fushës dhe servitute urbane. Servitutet e fushës mundësojnë shfrytëzimin e shumë të drejtave si p.sh. e drejta e rrugëkalimit të njerëzve nëpër të mirën shërbyese; e drejta e kalimit të kafshëve; e drejta e marrjes së ujit nga e mira shërbyese; e drejta e kullotjes së kafshëve etj. Nga servitutet urbane mund të rrjedhin të drejtat si p.sh. e drejta e mbështetjes së murit në murin e huaj; mbështetja e traut në murin e huaj; hapja e dritares në murin e huaj etj.

Sipas përmbajtjes servitutet ndahen në pozitive dhe negative. Te servitutet pozitive autorizohet titullari i të drejtës së servitutit të shfrytëzon të mirën shërbyese në vëllim dhe mënyrë të caktuar. Negative janë ato servitute të cilat titullari i së drejtës ka autorizim të kërkojë që pronari i të mirës shërbyese të përmbahet nga shfrytëzimi i të mirës shërbyese në mënyrë dhe vëllim të caktuar (të mbjell kultura të larta afër të mirës së privilegjuar).

2. Mënyra e fitimit e të drejtës së servituteve reale

E drejta e servitutit real mund të fitohet:

- në bazë të punës juridike,
- me vendim të organit shtetëror dhe
- mbi bazën e një ligji (neni 253 i LPDTS).

Për të fituar të drejtën e servitutit me punë juridike, sikur edhe te e drejta e pronësisë, nevojiten baza juridike dhe mënyra e fitimit. Baza juridike në bazë të së cilës fitohet e drejta e posedimit zakonisht është kontrata. Mënyra ligjore e fitimit është regjistrimi në regjistër të paluajtshmërive.

Në bazë të vendimit të organit shtetëror e drejta e servitutit real fitohet nga dita e plotfuqishmërisë së atij vendimi. Kjo ndodh nga gjykata në rast të konstituimit të kësaj të drejte apo me rastin e ndarjes fizike të paluajtshmërisë atëherë kur nuk ekziston mundësia që të gjitha pjesët e ndara të paluajtshmërisë të kenë dalje në rrugë.

3. Shuarja e të drejtës së servitutit sendor

Për shuarjen e servitutit sendor janë të nevojshme deklarata e pronarit të paluajtshmërisë dominuese për heqjen dorë nga servituti sendor dhe regjistrimi në Regjistrin e të drejtave në paluajtshmëritë.

Gjithashtu edhe pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar mund të kërkojë shlyerjen e servitutit sendor, nëse servituti sendor nuk është më i nevojshëm për shfrytëzimin e paluajtshmërisë dominuese ose nëse në mënyrë substanciale kanë ndryshuar rrethanat. Shlyerja e servitutit duhet të regjistrohet në regjistrin e të drejtave në paluajtshmëri.

4. Llojet e padisë ngas praktika gjyqësore përkitazi me fitimin, humbjen dhe vërtetimin e ekzistimit të së drejtë së servitutit

Duke u nisur nga mundësitë ligjore për të fituar apo mbrojtur të drejtën e servitutit real, përkatësisht kundërshtuar ekzistimin e kësaj të drejte, mund të paraqiten këto padi:

- padia për konstituimin e të drejtës së servitutit real. Padiës është pronari i paluajtshmërisë në favor të së cilës duhet konstituuar kjo e drejtë. I paditur është pronari i paluajtshmërisë në të cilën duhet të konstituohet kjo e drejtë. Kërkesa do të jetë konstituimi i të drejtës së servitutit real. Kundërshtimet mund të jenë veçmas se padiësi nuk ka nevojë për këtë ose ka mundësi tjera, me më pak ngarkesë të të mirës shërbyese. Edhe pronari i të mirës shërbyese si i paditur mund të paraqet kërkesë me kundërpadi me të cilën kërkon shpërblimin nga pronari i të mirës së privilegjuar.
- Padia për vërtetimin e ekzistimit të drejtës së servitutit real. Padiës është pronari i paluajtshmërisë së privilegjuar i cili konsideron se e ka këtë të drejtë mbi ndonjë

bazë ligjore. I paditur është pronari i të mirës shërbyese. Fjala është për padi për vërtetim të një të drejte. Kërkesa është vërtetimi i ekzistimit të së drejtës së servitutit real. I padituri mund të bënë kundërshtim se kjo e drejtë nuk është fituar mbi ndonjë bazë ligjore e në këtë mënyrë edhe nuk ekziston. Në gjykatën ngel të vërteton nëse ekziston apo jo e drejta e servitutit e fituar në ndonjë bazë ligjore për fitimin e saj.

- Padia për vërtetimin e mosekzistimit të drejtës së servitutit real. – Padiës është pronari i paluajtshmërisë e cila konsiderohet si e mirë shërbyese i cili konsideron se i padituri nuk e ka këtë të drejtë. I paditur është pronari i paluajtshmërisë e cila konsiderohet si e mirë privilegjuese e i cili konsideron se këtë të drejtë e ka fituar mbi ndonjë bazë të parashikuar ligjore. Edhe këtu fjala është për padi për vërtetim. Kërkesa të vërtetohet mosekzistimi i të drejtës së servitutit real në favor të të mirës së privilegjuar e në dëm të mirës shërbyese. I padituri mund të kundërshton se padiësi nuk e ka fituar këtë të drejtë mbi ndonjë bazë ligjore, ose atë e ka humbur në ndonjë mënyrë të parashikuar me ligj.
- Padia për ndërprerjen e të drejtës së servitutit real. – Padiës është pronari i të mirës shërbyese. I paditur është pronari i të mirës së privilegjuar. Kërkesa është ndërprerja e të drejtës ekzistuese të servitutit real. Nuk është kontestuese se kjo e drejtë ekziston andaj edhe kërkohet ndërprerja e saj për shkak se është e panevojshme për shfrytëzimin e të mirës së privilegjuar (është krijuar mundësia të kalohet drejtpërdrejt në rrugë publike) ose pushon së ekzistuari arsyeja tjetër në të cilën është bazuar kjo e drejtë. Varësisht nga arsyeja për të cilën kërkohet ndërprerja, i padituri mund të bënë kundërshtim duke paraqitur fakte se nuk janë paraqitur rrethana të reja për shkak të të cilave kjo e drejtë do të ishte e panevojshme ose se në ndërkohë nuk ka pushuar të ekzistoj arsyeja në të cilën është bazuar ajo.

5. Servitutet personale (kuptimi, llojet dhe përkufizimi në kohë)

Me servitutin personal nënkuptojmë të drejtën reale në send të huaj. Kjo e drejtë mundëson përdorimin, përkatësisht shfrytëzimin e sendit të huaj dhe i përket vetëm personit të caktuar. Servitutet personale nuk mund të barten në tjetrin e as të trashëgohen dhe janë të kufizuara në kohë (neni 261 i LPDTS).

Servitutet personale ju takojnë personave të caktuar të cilët kanë autorizime që, ekonomikisht në tërësi ose vetëm pjesërisht të shfrytëzojnë sendin e luajshëm apo të paluajshëm të huaj. Në këtë mënyrë servitutet personale janë të përkufizuara në kohë (nëse eventualisht nuk është kontraktuar ndryshe) nga se janë të lidhura me personin dhe pushojnë me vdekjen e titullarit e të drejtës së servitutit personal, në dallim nga servitutet reale të cilat janë të lidhur me paluajtshmërinë dhe nuk janë të kufizuara në kohë.

E DREJTA SENDORE

Numri i servituteve personale me ligj është i përcaktuar një për një e ato janë:

- Shfrytëzimi i frutave (usufruktus)
- Përdorimi i sendit (usus) dhe
- E drejta e banimit apo bujtjes (habitatio).

Shfrytëzuesi i frutave ka të drejtë në të gjitha të mirat dhe frutat të cilat i sjell sendi për kohën sa e shfrytëzon sendin. Frutat i merr me rastin e ndarjes së tyre nga sendi i cili jep fruta. Shfrytëzuesi i frutave ka detyrim që sendin ta mirëmbaj dhe mos ta ndryshoj substancën ekonomike të tij. Ai njëherësh mban shpenzimet rreth prodhimit të frutave dhe ngarkesat publike (tatimi etj). Shpenzimet e jashtëzakonshme i mban pronari i sendit, nga se ai i merr edhe të ardhurat e jashtëzakonshme nga sendi. Përndryshe, shfrytëzuesi i frutave përgjigjet për çdo lloj dëmi ndaj sendit, përpos asaj të rastësishme. Nuk përgjigjet për zvogëlimin e vlerës së sendit të shkaktuar nga përdorimi i rregullt.

Përdorimi i sendit (usus) ka të bëjë me përdorimin e sendit të huaj dhe marrjen e frutave nga ai send vetëm për nevoja personale të veta dhe të anëtarëve të familjes së tij. Për shkak të vëllimit të përdorimit edhe dallohet nga usufruktusi. Shpenzimet rreth mirëmbajtjes së sendit i mban pronari.

E drejta e banimit apo bujtjes (Habitatio) është një lloj servituti i përdorimit të lokaleve për banim për nevoja personale të titullarit të kësaj të drejte dhe anëtarëve të familjes së tij. Shpenzimet lidhur me mirëmbajtjen e banesës i mban pronari. Titullari i kësaj të drejte ka autorizim ta shfrytëzon ndërtesën për nevoja personale dhe të anëtarëve të familjes së tij, pa cenuar substancën e banesës.

VI. E DREJTA E PENGUT

E drejta e pengut (pengu) do të thotë krijimi i ndonjë interesi mbi pasurinë e luajtshme ose mbi ndonjë të drejtë me anë të marrëveshjes ose me anë të ligjit, i cili i jep pengmarrësit të drejtën për të marrë në posedim atë pasuri ose për ta shfrytëzuar atë të drejtë me qëllim të përmbushjes së ndonjë obligimi ekzistues dhe të identifikueshëm që është siguruar me anë të pengut. Pra, pengu është e drejtë sendoren bazë të së cilës kreditori fiton të drejtën që të realizon kërkesën nga sendi apo e drejta e lënë peng para të gjithë kreditorëve tjerë, pavarësisht kush është pronar i ati sendi në momentin e kompensimit. E drejta e pengut është e rregulluar në kapitullin e II, konkretisht me dispozitat e neneve 133 – 171 të Ligjit mbi pronësinë dhe të drejtat tjera sendore. Më parë pengu ishte trajtuar me Rregulloren e UNMIK-ut për Pengun nr. 2001/5 datë 07.02.2001, e cila kishte të bënte vetëm me pengun kontraktues.

1. Objekti i pengut

Objekt i pengut – Peng mund të lihet çfarëdo vlere pasurore e luajtshme ose ndonjë e drejtë e cila mund të bartet në mënyrë të ligjshme.

Pasuritë nëntokësore dhe hidrokarburet si dhe të drejtat në to mund të lihen peng në përputhje me dispozitat ligjore për bartjen dhe për të të drejtën në ngarkim për pasuritë nëntokësore dhe hidrokarburet apo të drejtat e tilla (neni 138 i LPDTS).

Në këtë aspekt, sipas ligjit, kusht për të qenë objekt i pengut është të jetë e lejuar mundësia e qarkullimit juridik të së drejtës mbi atë send. Objekti i pengut duhet të jetë individualisht i përcaktuar dhe i pakonsumueshëm. Po të ishte objekti i pengut send i konsumueshëm atëherë te pengmarrësi do të kalon e drejta e pronësisë mbi atë send dhe për kthimin e sendit të marr peng do të kishte detyrim ta kthen sendin tjetër në sasi të njëjtë nga edhe në atë rast do të kishim të bëjmë me një marrëdhënie detyrimore.

Edhe pasuria e cila është pronë e përbashkët (pasuria e përbashkët e bashkëshortëve apo ajo e anëtarëve të familjes) mund të jetë

objekt i pengut, me kusht që për këtë të japin pëlqimin pronarët tjerë të përbashkët të kësaj pasurie. Përkundër kësaj pasuria e cila është në bashkëpronësi të disa personave mund të jetë objekt (bashkëpronarët në bazë të trashëgimisë) i pengut edhe pa pëlqimin bashkëpronarëve tjerë.

Përpos sendeve, objekt pengu mund të jetë edhe çdo e drejtë e pengdhënësit që rrjedhë nga sendi i lënë peng, e që ka ndonjë vlerë pasurore, e parashikuar sipas ndonjë kontrate apo marrëveshje, si dhe çdo pasuri apo e drejtë që në ndërkohë më vonë bëhet pjesë apo i bashkëngjitet kolateralit, nëse me marrëveshjen e pengut nuk është parashikuar ndryshe.

Së fundi, objekt i pengut mund të jetë edhe e drejta nga e cila do të mund të përmbushej kërkesa e kreditorit. Këto të drejta duhet të jenë në qarkullim juridik, të kenë vlerë ekonomike dhe mos të jenë të lidhura me personalitetin e debitorit pengdhënës, si p.sh. e drejta e autorit dhe zbulimit si dhe të drejtat tjera nga pronësia industriale.

2. Llojet e të drejtës së pengut

Pengu mund të jetë standard dhe posedimor ose peng i blerjes (neni 134 i LPDTS).

Pengu standard nënkupton sigurimin e detyrimit me kolateralin e lënë peng i cili ngel në posedim të pengdhënësit.

Pengu posedimor ose peng i blerjes ekziston atëherë kur pengdhënësi, sipas marrëveshjes për pengun, e bartë të drejtën e posedimit të kolateralit në pengmarrësin dhe për gjithë kohën ai ngel në posedim të tij. Ky lloj pengu mund të krijohet edhe atëherë kur në kohën e nënshkrimit të marrëveshjes kolaterali ndodhet, mbi ndonjë bazë tjetër, në posedim të pengmarrësit apo të ndonjë depozitëmarrësi i autorizuar nga ai.

3. Krijimi i të drejtës së pengut

Varësisht nga mënyra e krijimit të drejtës së pengut dallojmë:

- a) *Pengun kontraktues,*
- b) *Pengun ligjor dhe*
- c) *Pengun gjyqësor.*

Te pengu kontraktues kontrata është titulli juridik në bazë të së cilës edhe themelohet e drejta e pengut. Në këtë rast vetë kontrata është e karakterit detyrimor, ndërsa të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ajo janë të karakterit sendor. Sipas nenit 136 të LPDTS ajo ka formën e marrëveshjes së përpiluar me shkrim.

E drejta e pengut ligjor krijohet në momentin e plotësimit të kushteve të parashikuara ligjore për këtë. Kësisoj këtu nuk kemi vullnetin e shprehur të palëve e as që nevojitet ai. Nga vetë fakti se ligji parasheh kushtet për themelimin e pengut, me përmbushjen e këtyre kushteve dhe me paraqitjen e rrethanave të caktuara siç është p.sh. transportuesi ka të drejtën e pengut në mallin e transportuar me kompensim, deri sa nuk e merr kompensimin për shërbimin e transportit të mallit.

E drejta e pengut mund të themelohet edhe me vendim të gjykatës, në të cilin rast edhe fjala është për pengun gjyqësor. Titull juridik për themelimin e pengut është vendimi i gjykatës, andaj edhe kjo ndodh në kundërshtim me vullnetin e debitorit. Kjo ndodh në procedurën e përmbartimit, me rastin e regjistrimit dhe marrjes peng të sendeve të luajtshme të debitorit me qëllim të shitjes së tyre.

4. Marrëveshja e pengut

Marrëveshja e pengut mund të lidhet për një ose më shumë detyrime. Për të qenë ajo e vlefshme duhet të jetë e formës së shkruar dhe duhet të përmban, identifikimin e pengdhënësit, personit tjetër përgjegjës dhe të pengmarrësit, përcaktimin e detyrimit të siguruar me pengun: përshkrimin e sendit të lënë peng, konstatimin se me marrëveshje themelohet peng në favor të pengmarrësit, datën e përpilimit të marrëveshjes dhe nënshkrimet e palëve (neni 136 ILPDTS).

Sipas ligjit nuk kërkohet që marrëveshja e pengut të noterizohet, përveç nëse palët merren vesh ndryshe.

Lejohet mundësia që marrëveshja e pengut të ndryshohet më vonë nga palët, ashtu që në atë të përfshihen edhe çështje tjera për të cilat palët merren vesh.

5. Të drejtat dhe detyrimet e palëve në lidhje me sendin e lënë peng

Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjellta të pengdhënësit dhe pengmarrësit përcaktohen me marrëveshje që e lidhin mes veti, ashtu që edhe ato janë të lira në rregullimin e tyre përpos nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ligj. Zakonisht me marrëveshje për pengun themelohet pengu standard, në mënyrë që sendi i lënë peng ngel në posedim të pengdhënësit, ai vazhdon ta përdor atë dhe në çdo mënyrë tjetër t'i gëzoj të gjitha të drejta mbi atë send. Vetëm në rastet e parashikuara me ligj ose nëse pengdhënësi dhe pengmarrësi kanë pranuar shprehimisht me marrëveshjen e pengut, ai mund të jetë posedimor, ashtu që pengmarrësi ta merr kolateralin në posedim.

Nëse me marrëveshje të pengut nuk parashikohet ndryshe, pengdhënësi mund ta përdor sendin e lënë peng në proces prodhimi ose veprimtari tjetër dhe t'i merr të gjitha të ardhurat nga ai, duke u kujdesur mos të dëmtohet dhe që ta mirëmbaj normalisht. Mirëpo, pengdhënësi nuk ka të drejt ta huazoj sendin e lënë peng, ta jep me qira ose ta tjetërsoj në ndonjë mënyrë tjetër. Ai ka përgjegjësi ndaj pengmarrësit për dëmet e shkaktuara për shkak të mosrespektimit të detyrimeve të mësipërme. Frutat e sendit të lënë peng mbesin pjesë e tij deri sa nuk ndahen e me rastin e ndarjes u takojnë pengdhënësit, përveç nëse nuk është parashikuar ndryshe me marrëveshje.

6. Shuarja e të drejtës së pengut

E drejta e pengut sipas dispozitës së nenit 161 të LPDTS shuhet nëse:

- 1.1 pengdhënësi dhe pengmarrësi merren vesh për këtë;
- 1.2 kërkesa e siguruar përmbushet ose shuhet për ndonjë arsye tjetër;
- 1.3 sendi ose e drejta e pengut apo ndonjë zëvendësim i tyre shuhet;
- 1.4 sendi ose e drejta e pengut ndryshohet ose inkorporohet me ndonjë send ose të drejtë tjetër e cila uk ekziston në një formë të identifikueshme apo të ndashme;
- 1.5 pengmarrësi bëhet pronar i sendit ose i të drejtës të pengut;
- 1.6 në rastin e pengut posedimor, përfundon pronësia e pengmarrësit mbi sendin e lënë peng;
- 1.7 bartet kërkesa e siguruar me anë të së drejtës së pengut, por kjo bartje nuk e përfshin të drejtën e pengut;
- 1.8 një palë e tretë në mënyrë të vlefshme e fiton sendin ose të drejtën e pengut në pajtim me dispozitat e këtij ligji .

Sipas paragrafit 2 të nenit 161 të LPDTS është paraparë që pas përfundimit të një pengu posedimor, pengmarrësi ia kthen pengdhënësit sendin e lënë peng.

7. Marrja e sendit të lënë peng nga ana e pengmarrësi në rast mospërbushjeje nëpërmjet të gjykatës

Mospërbushja e detyrimit sipas marrëveshjes për pengun ndodh nëse nuk shlyhet detyrimi i siguar ose kur në ndonjë mënyrë tjetër shkelen kushtet e marrëveshjes së pengut nga pengdhënësi ose personi i cili është përgjegjës për pengun e siguar. Në rast të mospërbushjes së këtillë, pengmarrësi ka të drejtë ta marr në posedim sendin e lënë peng e këtë mund ta bëjë (neni 166 të LPDTS):

- në procedurë gjyqësore,
- duke e marr sendin e lënë peng nga vetë pengmarrësi, nëse kjo ndodh pa prishjen e qetësisë publike dhe
- nëpërmjet të administratës, duke e caktuar një person, në marrëveshje me zyrën e regjistrimit, që ai ta merr në posedim sendin e lënë peng, në rastet kur pengmarrësi nuk mund ta merr vetë sendin e lënë peng.

Nga tri mundësitë e parashikuara ligjore të sipërshënuara ngel në pengdhënësin të zgjedh. Në rast se zgjedh procedurën gjyqësore, që zakonisht ndodh tek ne, pengmarrësi duhet të paraqes në gjykatën kompetente një kërkesë me të cilën kërkohet që gjykata brenda 5 ditë pune nga dita e dorëzimit të kërkesës, të lëshon urdhrin sipas të cilit, edhe pa njoftimin e pengdhënësit, personit tjetër që është përgjegjës për detyrimin e siguar ose garantuesit apo borxhliut tjetër, do t'i sekuestrohet sendi i lënë peng dhe do t'i dorëzohet në posedim pengmarrësit.

Pas pranimit të një urdhri të tillë nga gjykata kompetente, pengdhënësi ose personi tjetër përgjegjës për detyrimin e siguar mund të bëjnë kundërshtim përkitazi me vlefshmërinë e tërësishme apo vetëm të pjesshme të pengut. Në bazë të një kundërshtimi të paraqitur gjykata duhet të vendos përkitazi me arsyeshmërinë e tij. Nëse gjen se kundërshtimi është i bazuar, urdhri i dhënë mund të ndryshohet apo të revokohet në tërësi, në të cilin rast pengmarrësi ka detyrim për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga urdhri i sekuestrimit dhe dorëzimit të sendit të lënë peng.

Shitja e sendit të lënë peng mund të bëhet në ankand publik ose në shitje private, me kusht që metoda, mënyra, koha, vendi dhe kushtet e shitjes duhet të jen sipas kushteve të arsyeshme tregtare.

VII. HIPOTEKA

1. Objekti i hipotekës

Hipoteka në Kosovë po ashtu është e rregulluar me Ligjin për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore dhe atë në Kapitullin e III me dispozitat e neneve 172 – 217 të LPDTS. Hipoteka më parë ishte trajtuar me Ligjin nr. 2002/4 për Hipotekat, i cili ligj rregullonte vetëm një lloj të hipotekave dhe atë hipotekat e kontraktuara.

Ligji për Hipotekat përcakton kuptimin e hipotekës ashtu që sipas këtij ligji: “Hipoteka” do të thotë krijimi i interesit në pasurinë e paluajtshme me anë të marrëveshjes apo ligjit, që kreditorit të hipotekës (pengmbajtësit) i jep të drejtën të iniciojë procedurën për heqjen e të drejtës mbi pronën e vënë në hipotekë për pasurinë e tillë të paluajtshme, me qëllim të përmbushjes së një detyrimi që është siguruar me hipotekë dhe që duhet të paguhet.

Nga kuptimi i këtyllë i dhënë i hipotekës rrjedhë se objekt i hipotekës mund të jetë pasuria e paluajtshme, me të cilën pronari posedon brenda kufijve të përcaktuar me ligj. Për të qenë objekt i hipotekës, sendi i paluajtshëm duhet të jetë në qarkullim juridik dhe të ketë vlerë pasurore. Njëherësh, sendi i paluajtshëm duhet të jetë i individualizuar, pasi vetëm si i tillë edhe mund të jetë objekt i ndonjë të drejte sendor, pra të jetë në qarkullim juridik dhe të ketë vlerë pasurore. Në këtë mënyrë sendi i ardhshëm nuk mund të jetë objekt i hipotekës. Hipoteka shtrihet mbi të gjitha pjesët e paluajtshmërisë së ngarkuar, duke përfshirë edhe ndërtesat që aty qëndrojnë apo janë të lidhura në mënyrë të pandashme me tokën. Përfshirë mund të krijohet një hipotekë e pavarur, e cila nuk shtrihet mbi pjesët e tjera të paluajtshmërisë në një ndërtesë, në një banesë ose në një ndërtesë pra sendi i paluajtshëm është objekt i hipotekës bashkë me frutat të cilat nuk janë të ndara dhe me të gjitha pjesët tjera përbërëse si dhe ato aksesore. Objekt i hipotekës mund të jen edhe disa paluajtshmëri.

Të gjitha ato duhet të jenë individualisht të përcaktuara. E drejta e hipotekës regjistrohet në çdonjërin nga këto paluajtshmëri të cilat janë objekt i hipotekës mirëpo, të gjitha ato paraqiten si një send i përbashkët, nga edhe me rastin e regjistrimit evidencohet si hipotekë e përbashkët.

Objekt i hipotekës mund të jetë edhe vetëm pjesa e caktuar ideale e një sendi të paluajtshëm.

Në një pjesë të bashkëpronësisë ose të pronësisë së përbashkët nuk mund të vihet hipoteka pa pëlqimin e bashkëpronarëve të tjerë ose të pronarëve të përbashkët.

Njëherësh një paluajtshmëri mund të jetë objekt i hipotekës të disa kreditorëve të ndryshëm, në të cilin rast rangimi i tyre me rastin e realizimit bëhet sipas kohës së regjistrimit të hipotekës në librat publike.

Objekti i cili shërben si lëndë e hipotekës nuk duhet të pëson ndryshime përkitazi me vlerën që ka. Në qoftë se për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të pronarit të paluajtshmërisë së siguruar ose të një personi të tretë është paraqitur apo rrezikon të paraqitet zvogëlimi i vlerës së paluajtshmërisë, kreditori hipotekues mund të paditë

për përmbajtjet nga sjelljet e tilla. Në rast të veprimeve ose mosveprimeve të pronarit të paluajtshmërisë së ngarkuar, të cilat sjellin në të ardhmen një zvogëlim të vlerës së paluajtshmërisë, me kërkesë të kreditorit hipotekues, gjykata mund të urdhërojë masa për evitimin e rrezikimit (neni 185 i LPDTS).

2. Kërkesat e siguruara me hipotekë

Përpos nëse nuk është parashikuar ndryshe me dokumentin e hipotekës, me hipotekë sigurohet pagesa e detyrimit kryesor, kamata e papaguar, dënimet kontraktuese, shpenzimet e zbatimit, të mirëmbajtjes dhe shitjes së objektit të pengut (neni 181 lidhur me nenet 143 dhe 144 të LPDTS).

3. Shuarja e hipotekës

Sipas nenit 193 të LPDTS Hipoteka shuhet përmes shlyerjes së regjistrimit në Regjistrin për të drejtat në paluajtshmëritë.

Paragrafi 2 i këtij neni e rregullon shuarja e hipotekës sipas kërkesës duke dhënë përcaktuar se kur mund të kërkohe shuarja dhe atë:

- a) *Nëse debitori i kërkesës së siguruar ka përmbushur kërkesën përmes pagesës ose në ndonjë mënyrë tjetër;*
- b) *Nëse kërkesa e siguruar shuhet për arsye të tjera;*
- c) *Nëse kreditori hipotekues heq dorë nga hipoteka në formën me shkrim dhe duke vërtetuar nënshkrimin e tij;*
- d) *Nëse kreditori hipotekues dhe pronari i paluajtshmërisë së ngarkuar janë ose bëhen i njëjti person dhe*
- e) *Nëse paluajtshmëria e ngarkuar shitet për të përmbushur kërkesën e siguruar.*

4. Përmbartimi i paluajtshmërisë së lënë në hipotekë.

Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore ka paraparë rregullat për shitjen e paluajtshmërisë së hipotekuar edhe me marrëveshjen e palëve e edhe përmes procedurës gjyqësore dhe në mungesë të dispozitave përkatëse për zhvillimin e kësaj procedure atëherë përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Përmbartimore¹⁰.

Në ndërkohë në Kosovë është në shqyrtim e sipër Ligji i ri për Procedurën Përmbartimore ku parashihet veprimtaria e përmbartuesve privat të cilët edhe do të kenë kompetencën e zbatimit të procedurës së përmbartimit të paluajtshmërive të lëna nën hipotekë.

¹⁰ Ligji për Procedurën Përmbartimore 2012/04-L-139 i datës 20.12.2012 i dekretuar nga ana e Presidentes së Republikës së Kosovës me dekretin DI-01-2013 të dt. 03.01.2013.

■ E DREJTA FAMILJARE

VIII. MARTESA DHE MARRËDHËNIET JURIDIKE NË MARTESË

Kuptimi dhe rëndësia shoqërore e familjes, fejesës dhe martesës

Martesa dhe marrëdhëniet familjare në Kosovë janë të rregulluara me Ligjin për Familjen i Kosovës (më tutje LFK) nr. 2004/32, i shpallur në Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ-ve), nr. 4/2006 të datës 1 shtator 2006. Me këtë ligj rregullohen familja, fejesa, martesa, marrëdhëniet martesore, marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve, mbrojtja e fëmijëve pa kujdesin prindëror, adoptimi (birësimi), kujdestaria, ushqimi, marrëdhëniet pasurore në familje dhe procedurat e veçanta gjyqësore në kontestet nga marrëdhëniet familjare.

Sipas ligjit në fuqi familja është bashkësia e jetës e prindërve dhe fëmijëve të tyre si dhe personave tjerë në gjini. Nga kjo rrjedhë se ligji, përpos prindërve dhe fëmijëve të tyre, nuk përcakton shprehimisht edhe kush konsiderohet anëtar i familjes, që nënkupton se mund të jetë edhe çdo person tjetër që është në gjini dhe jeton në atë bashkësi. Lloji i gjinisë i anëtarëve të familjes me ligj nuk përcaktohet andaj edhe ata mund të jenë nga cili do lloj i gjinisë.

AFËRSIA GJINORE

1. Llojet e gjinisë

Gjinia nënkupton lidhjen biologjike - shoqërore ndërmjet dy apo më shumë personave e pranuar me ligj. Lidhjet gjinore mund të bazohen në fakte të ndryshme. Varësisht nga fakti në të cilin bazohet këto lidhje dallojmë: 1. Gjininë e gjakut, 2. Gjininë e krushqisë dhe 3. Gjininë civile.

Gjinia e gjakut është lidhja mes personave të cilët rrjedhin njëri nga tjetri apo mes personave të cilët rrjedhin nga paraardhësi i përbashkët. Kjo bazohet në lidhjen natyrore të gjakut mes personave. Mund të jetë martesore dhe jashtëmartesore. Është me rëndësi me rastin e lidhjes së martesës, në të drejtën trashëgimore, te përcaktimi i veprave të caktuara penale, në procedurat gjyqësore etj.

Gjinia e krushqisë ose martesore përfaqëson lidhjen e njërit bashkëshort me të afërmit e bashkëshortit tjetër. Sipas të drejtës tonë, të afërmit e njërit bashkëshort nuk konsiderohen se janë në gjini me të afërmit e bashkëshortit tjetër. Kjo gjini për bazë e ka martesën. Marrëdhëniet jashtëmartesore nuk krijojnë lidhje gjinore të krushqisë. Kjo gjini është me karakter të përhershëm, ashtu që vazhdon të ekzistoj edhe pas pushimit të martesës. Edhe kjo është me rëndësi te lidhja e martesës, në të drejtën penale dhe procedurat gjyqësore.

Gjinia civile është lidhje gjinore e cila themelohet në mënyrë artificiale, sipas procedurës së përcaktuar me ligj, ndërmjet adoptuesit dhe të afërmit të tij, në një anë dhe të adoptuarit dhe të afërmeve të tij, në anën tjetër. Kjo gjini është me rëndësi të veçantë nga se me këtë mundësohet që fëmijët pa prind dhe kujdes prindëror bëhen me prind të ri. Është me rëndësi të lidhja e martesës, në të drejtën në trashëgimi, në procedura gjyqësore etj.

2. Llogaritja e gjinisë

Afërsia gjinore llogaritet sipas shkallës së gjinisë ndërmjet personave të cilët janë në gjini. Gjinia e gjakut, për nga afërsia, është dy llojesh: 1. në vijën e drejtpërdrejt apo vertikale dhe 2. të tërthortë apo horizontale. Në gjini të gjakut në vijën vertikale janë të gjithë paraardhësit dhe pasardhësit ndërsa në atë horizontale janë vëlla dhe motra prej një ati dhe një nëne dhe pasardhësit e tyre, xhaxhai dhe halla dhe pasardhësit e tyre, daja dhe tezja dhe pasardhësit e tyre.

FEJESA

Ligji i Familjes në fuqi për herë të parë në Kosovë e rregullon fejesën. Kësisoj sipas këtij ligji akti i fejesës konsiderohet premtim reciprok i dy personave me gjini të kundërta për tu martuar ndërmjet veti (neni 9 i LFK). Nga fakti se është dhënë premtimi për martesë, është lidhur fejesa, nuk mund të paraqitet padi në gjykatë dhe të kërkohet që ajo martesë edhe të lidhet. Njëherësh nga kjo edhe është e pavlefshme çfarëdo marrëveshje me të cilën do të parashihej çfarëdo shpërblimi nëse nuk vjen deri te martesë ndërmjet të fejuarve.

1. E drejta dhe përgjegjësia për dëmshpërblim për heqje dorë nga fejesa

I fejuari i cili pa ndonjë arsye heq dorë nga fejesa ka detyrim të paguaj gjithë dëmin e shkaktuar të fejuarit tjetër, prindërve të të fejuarit apo personave tjerë të cilët kanë vepruar në emër të tyre. Ai është përgjegjës për çdo shpenzim apo investim të bërë gjatë pritjes së martesës, si dhe për fitimin e humbur eventual nga punësimi apo në pasuri. Padia për dëmshpërblim mund të paraqitet brenda dy viteve nga dita e heqjes dorë nga fejesa. Nëse për heqjen dorë nga fejesa është fajtor i fejuari tjetër ai është njëherësh edhe përgjegjës për çdo lloj dëmi të përcaktuar më sipër nga bashkëshorti i cili heq dorë nga fejesa.

2. Fati i dhuratave të këmbyerë në rast të heqjes dorë nga fejesa

Zakonisht, në bazë të adeteve të vendit, bashkëshortët e ardhshëm, me rastin e fejesës, shkëmbejnë dhurata ndërmjet veti. Në rast se fejesa nuk përfundon me martesë secili nga të fejuarit ka të drejtë të kërkojë nga tjetri kthimin e dhuratave të cilat ia ka

dhuruar atij me rastin e fejesës. Kërkesa e këtillë duhet mbështetur në rregullat për begatim të pabazë nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

E DREJTA MARTESORE

Sa i përket martesës, sipas ligjit në fuqi ajo definohet si bashkësi mes dy personave të gjinive të ndryshme e rregulluar me ligj, e lidhur në bazë të vullnetit të lirë me qëllim të jetës së përbashkët dhe krijimit të familjes (neni 14 i LFK). Nga vetë fakti se martesë si bashkësi e jetës është e rregulluar me ligj nënkupton se ajo ka rëndësi të posaçme shoqërore, pasi që edhe konsiderohet se martesë është bazë e familjes, ndërsa familja bazë e shoqërisë. Nga kjo arsye edhe, sipas dispozitave të këtij ligji, rol i veçantë i kushtohet mbrojtjes shoqërore dhe juridike të familjes dhe anëtarëve të saj, veçmas nënës dhe fëmijës.

1. Kushtet për lidhjen dhe vlefshmërinë e martesës

Me LFK janë të përcaktuara edhe marrëdhëniet juridike martesore. Në këtë mënyrë janë të përcaktuara edhe kushtet për ekzistimin e martesës. Këto janë kushtet të cilat patjetër duhet plotësuar për themelimin e martesës. Nga vetë kuptimi ligjor i martesës rrjedhë se për të lidhur martesë është e domosdoshme që dy persona të gjinive të ndryshme, para organit kompetent, në mënyrën e përcaktuar me ligj, të japin pëlqimin për lidhjen e martesës, me qëllim të jetës së përbashkët dhe krijimit të familjes. Sipas kësaj kushtet esenciale për themelimin e martesës janë:

- 1) Martesë mund të lidhet vetëm ndërmjet dy personave të sekseve të ndryshme (neni 14 i LFK),
- 2) Të ekzistoj pajtimi i vullneteve të tyre për lidhjen e martesës, i shprehur personalisht (neni 34 i LFK),
- 3) Forma e caktuar me ligj për lidhjen e martesës, e kjo është që martesë të lidhet para organit kompetent në mënyrë të përcaktuar me ligj (neni 28 i LFK).
- 4) Për të qenë e vlefshme një martesë, në momentin e lidhjes së saj nuk duhet të ekzistoj ndonjë pengesë apo ndalesë martesore e paraparë me ligj. Me LFK janë të parapara njëpërmjës pengesat martesore ekzistimi i të cilave martesën e bëjnë të pavlefshme..

2. Ndalesat dhe pengesat martesore-Pengesat martesore – kuptimi dhe llojet

Pengesat martesore janë ato rrethana të parashikuara me ligj të cilat pengojnë lidhjen e martesës së vlefshme.

Në bazë të kriterëve të ndryshëm pengesat martesore mundë të ndahen në disa lloje:

- 1) Varësisht nga fakti se kush ka të drejtë në paraqitjen e padisë dhe rëndësisë shoqërore të pengesave martesore ato ndahen në pengesa martesore të cilat kanë për pasoj

nulitetin absolut dhe ato të cilat kanë për pasojë nulitetin relativ të martesës. Pengesat martesore të cilat kanë për pasojë nulitetin absolut të martesës janë: ekzistimi i martesës tjetër të ndonjërit nga bashkëshortët (neni 19 i LFK), sëmundja shpirtërore dhe pamundësia për të gjykuar e ndonjërit nga bashkëshortët nga e cila arsye edhe me vendim të gjykatës i është hequr zotësia e veprimit (neni 20) dhe shkalla e caktuar e gjinisë ndërmjet bashkëshortëve (neni 21, 22 dhe 23 i LFK). Pengesat martesore të cilat kanë për pasojë nulitetin relativ të martesës janë: mosekzistimi i vullnetit të lirë (neni 18 i LFK) dhe mosha jomadhore (neni 16 i LFK).

- 2) Varësisht nga fakti nëse mundet apo jo një pengesë martesore të evitohet me lejimin paraprak ose të mëvonshëm të gjykatës, apo nuk mund të evitohet në asnjë mënyrë, ato ndahen: në pengesa martesore të evitueshme dhe në të paevitueshme. Pengesat martesore të paevitueshme janë: ekzistimi i martesës tjetër të ndonjërit nga bashkëshortët, sëmundja shpirtërore dhe paaftësia për të gjykuar dhe gjinia e gjakut në vijën vertikale pavarësisht nga shkalla, ndërsa në atë horizontale deri në shkallën e katërt të gjinisë. Pengesat martesore të evitueshme janë: gjinia e krushqisë dhe mosha e mitur.
- 3) Varësisht nga fakti nëse janë apo jo në kohë të kufizuara, pengesat martesore ndahen: në pengesa martesore të përhershme dhe të përkohshme.

Ndalesat martesore

Ndalesat martesore janë rrethanat e caktuara me ligj ekzistimi i të cilave e pengon lidhjen e martesës, mirëpo mosrespektimi i tyre nuk ka për pasojë nulitetin e martesës. Martesa e lidhur në praninë e ndalesës martesore mbetet në fuqi, por pasojnë sanksionet tjera. Ndalesë martesore përfaqëson raportin e kujdestarisë mirëpo, “nga shkaqet e arsyeshme”(paragrafi 2 i nenit 24 i LFK), ligji u lejon lidhjen e martesës personave në këto raporte. Në rastet e këtilla, me lidhjen e martesës ndërmjet kujdestarit dhe të kujdesurit ndërpritet raportin e kujdestarisë (neni 24 i LFK).

3. Vendi dhe procedura e lidhjes së martesës zyrtare

Për të qenë martesa e vlefshme ajo duhet të lidhet në formën e paraparë ligjore. Ligji parasheh të ashtuquajturën formën solemne për lidhjen e martesës. Fletëparaqitja për lidhjen e martesës, bashkë me dokumentet tjera të nevojshme, i paraqitet ofiqarit. Me ligj nuk është përcaktuar kompetenca tokësore e organit për lidhjen e martesës, ashtu që bashkëshortët kanë të drejtë të pakufizuar të zgjedhjes së vendit ku do të lidhin martesën (neni 25 i LFK). Akti solemn i lidhjes së martesës mbahet në lokal të caktuar, por sipas kërkesës së bashkëshortëve e për shkaqe të arsyeshme mund të mbahet edhe në ndonjë vend tjetër (neni 27 i LFK).

Pjesëmarrës në lidhjen e martesës janë: Bashkëshortët, dy dëshmitar dhe ofiqari. Lidhja e martesës fillon me raportimin e ofiqarit përkitazi me praninë e bashkëshortëve të ardhshëm dhe se, në bazë të dokumentacionit dhe deklaratave të tyre dhe të dëshmitarëve, është vërtetuar se nuk ekzistojnë pengesa dhe ndalesa për lidhjen e martesës. Pas kësaj bashkëshortëve të ardhshëm ofiqari u lexon pjesët e ligjit përkitazi

me të drejtat dhe detyrimet e bashkëshortëve. Pas kësaj ai i pyet nëse janë të pajtimit të lidhin martesë ndërmjet veti. Pas dhënies së deklaratave se pajtohen të lidhin martesë me njëri tjetrin, ofiqari e shpall martesën e lidhur. Ofiqari e regjistron faktin e lidhjes së martesës në regjistrin amzë për të martuarit, në të cilën nënshkruajnë bashkëshortët, dëshmitarët dhe ofiqari. Pas kësaj bashkëshortëve u lëshohet certifikata e kurorëzimit e cila shërben si prove për lidhjen e martesës.

4. Kushtet për lidhjen e martesës religjioze dhe regjistrimi i saj

Bashkëshortët të cilët paraprakisht e kanë lidhur martesën zyrtare, mund të lidhin martesë edhe sipas rregullave religjioze. Nga kjo rrjedhë se bashkëshortët të cilët paraqiten për lidhjen e martesës fetare duhet të dëshmojnë se paraprakisht e kanë lidhur atë zyrtare (neni 36 i LFK). Kjo martesë lidhet para zyrtarit të bashkësisë religjioze, i cili ka për detyrë që dokumentin për lidhjen e martesës religjioze, brenda 5 ditësh nga dita e lidhjes së kësaj martese, t'ia dërgoj ofiqarit ku është lidhur martesa zyrtare. Në bazë të këtij dokumenti, brenda pesë ditësh nga dita e pranimit të këtij dokumenti, ofiqari e regjistron martesën religjioze në librin amzë për të kurorëzuarit dhe e lëshon certifikatën e martesës fetare.

5. Kushtet për lidhjen e martesës së shtetasve të huaj dhe shtetasve tanë në botën e jashtme

Kosovarët mund të lidhin martesë në botën e jashtme sipas ligjit të shtetit ku ndodhen. Kjo martesë e lidhur në botën e jashtme është e vlefshme nëse janë plotësuar kushtet ligjore sipas ligjit të shtetit ku lidhet martesa dhe kushtet materiale ligjore për lidhjen e martesës sipas LFK. Sa i përket formës, për të qenë ajo martesë e vlefshme, me rastin e lidhjes së martesës duhet patjetër plotësuar forma sipas ligjit të vendit ku lidhet martesa.

Sipas ligjit në fuqi edhe shtetasit e huaj mund të lidhin martesë në Kosovë sipas dispozitave të këtij ligji. Me rastin e paraqitjes së kërkesës për lidhjen e martesës, përpos dokumenteve nga neni 25 i LFK, duhet të paraqet edhe certifikatën nga shteti i tij me të cilën dëshmon se ka të drejtë të lidh martesë sipas ligjit të vendit të tij (neni 17 i LFK).

6. Shuarja e martesës -Mënyrat e shuarjes

Sipas ligjit, gjykata kompetente në kontestet martesore duhet të kujdeset dhe angazhohet sa është e mundur që martesa të ruhet, e nëse kjo nuk është e mundur, atëherë që shuarja e martesës të krijoj sa më pak shqetësime për bashkëshortët dhe fëmijët e tyre, të promovohen marrëdhënie sa më të mira mes fëmijëve dhe prindit të cilit nuk i janë besuar ata, procedura të përfundoj me sa më pak shpenzime dhe të shmanget çdo rrezik për dhunë ndaj bashkëshortëve dhe fëmijëve.

Deri sa martesa konsiderohet bashkësi e jetës mes dy personave të gjinive të ndryshme, me rastin e vdekjes së njërit nga bashkëshortët, përkatësisht me shpalljen e bashkëshortit të zhdukur për të vdekur martesa do të shuhet. Në rast të vdekjes martesa

shuhet nga momenti i vdekjes, ndërsa në rast të shpalljes së personit të zhdukur për të vdekur, martesë shuhet nga data e konstatuar si datë e vdekjes në aktvendimin me të cilin është shpallur për të vdekur. Në rastet kur kjo nuk ka mund të vërtetohet dhe nuk është konstatuar, data e plotfuqishmërisë së aktvendimit me të cilin është shpallur për të vdekur merret si datë e vdekjes.

Deri sa ligji parasheh lidhjen e martesës, me këtë ligj është paraparë edhe mundësia e zgjidhjes së martesës. Kësisoj, sipas ligjit në fuqi martesë mund të zgjidhet në dy mënyra: 1. me **anulim** dhe 2. me **shkurorëzim**.

Martesat e pavlefshme, kuptimi dhe llojet

Të pavlefshme janë martesat me rastin e lidhjes së të cilave nuk janë plotësuar kushtet për ekzistimin, përkatësisht për plotfuqishmërinë e tyre, gjë që edhe sipas LFK kjo është arsye për zgjidhjen e martesës me anulimin e saj. Sipas ligjit dallojmë dy lloje të martesave të pavlefshme: martesat absolutisht nule dhe ato relativisht nule.

7. Martesat absolutisht nule, shkaqet e nulitetit

Sipas LFK shkaqet e nulitetit absolut të martesës janë:

- a) *Nëse me rastin e lidhjes së martesës, në mënyrë kumulative, nuk janë plotësuar kushtet esenciale për vlefshmërinë e martesës, e ato janë që dy persona të gjinive të ndryshme, në formën e paraparë ligjore, të kenë shprehur vullnetin e lirë për lidhjen e martesës (neni 64 par. 1 lidhur me nenin 14 të LFK).*
- b) *Nëse martesë është lidhur gjatë kohës së ekzistimit të martesës së mëparshme të ndonjërit nga bashkëshortët, pasi që askush nuk mund të lidhë martesë deri sa nuk pushon ose nuk zgjidhet martesë e lidhur më para (neni 62 i LFK).*

Në rast se në një procedurë të filluar për anulimin e martesës për këtë arsye ligjore bashkëshortët theksojnë se martesë e mëparshme është e pavlefshme, atëherë gjykata do t'i udhëzojë ata të iniciojnë procedurën kontestimore për anulimin e martesës së mëparshme, me të cilin rast edhe do ta ndërpresë procedurën e cila rrjedhë, deri sa mos të vendoset me aktgjykim të plotfuqishëm ajo procedurë.

- c) *Nëse ka lidhur martesë personi i cili për shkak të sëmundjes shpirtërore ose nga arsyt tjera nuk është i aftë për të gjykuar (neni 64 par. 1 nënpar. 1 i LFK).*

Paaftësia për të gjykuar mund të jetë e përhershme dhe e përkohshme. Për anulimin e martesës nga kjo arsye ligjore me rëndësi është gjendja e përhershme shpirtërore e jo ajo momentale, ashtu që e pavlefshme është edhe martesë e lidhur gjatë kohës së momenteve të ndritshme “lucida intervala” në të cilën kohë bashkëshorti ka qenë plotësisht i aftë për të gjykuar ¹¹.

11 Shih Komentarin e Ligjit për Familjen i Kosovës botimi i parë Prishtinë 2012 i autorëve Aliu Abdulla, Gashi Haxhi & Vokshi Adem – faqet 179 – 181,

- d) Nëse kanë lidhur martesë ndërmjet veti personat në gjini të gjakut, sipas adoptimit ose sipas krushqisë ndërmjet të cilëve ligji e ndalon martesën (neni 64 par. 2 i LFK)¹².
- e) Nëse martesa nuk është lidhur me qëllim të jetës së përbashkët, por me lidhjen e saj fshehin ndonjë punë tjetër juridike ose dëshirojnë realizimin e ndonjë qëllimi tjetër. Nëse vetëm njëri bashkëshort ka lidhur martesën për qëllime tjera, martesa nuk do të anulohet sipas kësaj baze ligjore. Mosekzistimi i qëllimit të jetës së përbashkët duhet të ekzistojë si në momentin e lidhjes së martesës ashtu edhe gjatë ekzistimit të asaj martese (neni 66 i LFK)¹³.

8. Martesat relativisht nule, shkaqet e nulitetit

Sipas LFK shkaqet e nulitetit relativ të martesës janë:

- a) Nëse njëri nga bashkëshortët ka pranuar të lidhë martesë nga frika e shkaktuar me dhunë ose me kanosje serioze (neni 63 i LFK). Frika e shkaktuar në këtë mënyrë nënkupton se nuk ka ekzistuar vullneti i lirë i bashkëshortëve të ardhshëm, por pëlqimi është dhënë me detyrim ose në lajthim (neni 18 i LFK). Frika duhet të jetë e intensitetit të madh dhe të ketë zgjatur më shumë kohë. Nuk është me rëndësi kush e ka përdorur dhunën ose kanosjen serioze, pasi që nuk është patjetër që ajo të rrjedhë nga bashkëshorti tjetër, e as që ajo t'i është drejtuar bashkëshortit të dëmtuar ose të afërmve të tij (saj).
- b) Nëse martesë ka lidhur personi para moshës madhore pasi t'i ketë mbushur 16 vjet, pa lejen e gjykatës për lidhjen e martesës para moshës madhore (neni 16 i LFK). Në rastet e këtilla nëse leja e gjykatës për lidhjen e martesës para moshës madhore sigurohet në ndërkohë martesa nuk do të anulohet, ose nëse gjatë zhvillimit të procedurës bashkëshorti i mitur e arrin moshën madhore.
- c) Nëse martesa është lidhur në lajthim përkitazi me personalitetin e bashkëshortit (neni 65 par. 1 i LFK), nga se martesa nuk mund të lidhet nëse nuk ekziston pëlqimi i lirë i bashkëshortëve për lidhjen e martesës, por pëlqimi është dhënë duke genë në lajthim.

Lajthimi është pasqyrimi i gabuar mbi realitetin objektiv, ashtu që në rastin e lajthimit ekziston disharmonia ndërmjet vullnetit të vërtet dhe veprimt juridik, nga se po të ishin të njohura ato fakte reale nuk do të vinte deri te ai veprim juridik.

Sipas ligjit ekzistojnë dy lloje të lajthimit përkitazi me personalitetin: Lajthimi përkitazi me personalitetin fizik dhe përkitazi me personalitetin civil. Lajthimi përkitazi me personalitetin fizik ekziston nëse ka menduar se po lidhë martesë me një person

¹² Po aty faqe 179-181,

¹³ Po aty faqe 184-186,

e martesën e ka lidhur me personin tjetër. Lajthimi përkitazi me personalitetin civil nënkupton prezantimin e rrejshëm, duke fshehur identitetin e vërtet përkitazi me veçoritë esenciale që ka.

- d) *Nëse ka lidhur martesë personi i cili për shkak të sëmundjes shpirtërore ose nga ndonjë arsye tjetër nuk ka qenë i aftë të gjykojë në momentin e lidhjes së martesës, mirëpo gjatë martesës paaftësia për të gjykuar ka pushuar. Personi i këtyllë në këtë kohë më vonë, kur është i aftë për të gjykuar do të jep pëlqimin për lidhjen e martesës, gjë që edhe përfaqëson vullnetin e lirë të tij.*

9. E drejta në padi për anulimin e martesës absolutisht dhe relativisht nule

Për anulimin e martesave absolutisht nule kanë të drejtë të paraqesin padi bashkëshortët, të gjithë personat tjerë që kanë interes juridik të drejtpërdrejtë për këtë dhe prokurori publik. E drejta për paraqitjen e padisë për anulimin e martesës absolutisht nule nuk vjetërsohet. Vetëm në rast se martesë ka lidhur personi me sëmundje shpirtërore, apo për shkaqe tjera ka qenë i paaftë për të gjykuar, pas kalimit të kësaj gjendje, të drejtën në padi e ka vetëm ai, brenda një viti nga dita e kalimit të kësaj gjendje (neni 67 i LFK). Nëse padia nuk paraqitet brenda afatit të mësipërm kjo e drejtë vjetërsohet dhe martesa mbetet në fuqi.

10. Pasojat e anulimit të martesës

Pasojat e nulitetit të martesës paraqiten nga dita e anulimit të saj, e jo edhe për kohën para anulimit të plotfuqishëm. Martesa konsiderohet e anuluar nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit me të cilin është anuluar ajo. Pasojat janë të njëjta si për atë absolutisht ashtu edhe për atë relativisht nule.

Pasojat e nulitetit të martesës kanë të bëjnë me: 1. Mbiemrin e bashkëshortëve pas anulimit të martesës, 2. Pozitën juridike të fëmijëve dhe ushqimin i tyre, 3. Marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve, dhe 4. Trashëgiminë.

- 1) Në kuptim të nenit 96 të LFK, bashkëshorti i cili me rastin e lidhjes së martesës ka ndërruar mbiemrin, pas anulimit të saj, në bazë të një deklarate të paraqitur ofiqarit brenda 6 muajve nga anulimi i martesës, mund të rimarr mbiemrin që e ka mbajtur më para.
- 2) Fëmijët e lindur gjatë martesës së anuluar janë fëmijë martesor. Çështja e besimit në ruajtje, kujdes dhe edukim njihet nga prindërit si dhe ushqimit të tyre vendoset në të njëjtën mënyrë si në rastin e shkurorëzimit të martesës (neni 140 i LFK).
- 3) Përkitazi me marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve vendoset në të njëjtën mënyrë si në rastin e shkurorëzimit të martesës, ashtu që mirëbesimi përkatësisht keqbesimi i bashkëshortit me rastin e lidhjes së martesës së anuluar nuk është me rëndësi në zgjidhjen e marrëdhënieve pasurore ndërmjet tyre (neni 89 i LFK).

- 4) Pas anulimit të martesës pushon e drejta e ndërsjellë në trashëgimi, si në bazë të ligjit ashtu edhe në bazë të testamentit të përpiluar para anulimit të martesës (neni 98 i LFK).

11. Shkaqet e shkurorëzimit

Shkurorëzimi nënkupton zgjidhjen e martesës së plotfuqishme gjatë jetës së bashkëshortëve, në procedurë gjyqësore, për shkaqe të parashikuara me ligj. Martesa mund të zgjidhet me shkurorëzim vetëm në bazë të vendimit të gjykatës. Shkaqet e shkurorëzimit janë rrethanat e parashikuara me ligj për shkak të të cilave mund të zgjidhet martesa me shkurorëzim (neni 69 i LFK).

Shkaqet nga të cilat bashkëshorti mund të kërkoj shkurorëzimin sipas ligjit janë:

- 1) Nëse marrëdhëniet bashkëshortore janë çrregulluar në mënyrë serioze dhe të vazhdueshme,
- 2) Kur për shkaqe tjera nuk mund të arrihet qëllimi i martesës.

Ligji përcakton shprehimisht disa nga shkaqet për shkurorëzim. Shumica e këtyre shkaqeve të parashikuara me ligj janë edhe arsye për çrregullimin serioz dhe të vazhdueshëm të marrëdhënieve mes bashkëshortëve. Përpos tyre si shkak për shkurorëzim ligji parasheh edhe sëmundjen shpirtërore të pashërueshme, paaftësinë e vazhdueshme për të vepruar, ndërprerjen e paarsyeshme të jetës faktike më tepër se 1 vit dhe shkurorëzimin me marrëveshje të dyanshme.

Çrregullimin e marrëdhënieve bashkëshortore mund të shkaktojnë rrethanat e ndryshme, të cilat jetën e përbashkët e bëjnë të pamundur, në të cilin rast shkurorëzimi është zgjidhja më e mirë për të dal nga ajo situatë e krijuar.

Qëllimi i martesës nuk mund të arrihet nëse nuk ekziston bashkësia e jetës e harmonizuar mes bashkëshortëve, si për shkak të mosparaqitjes së bashkëshortit për një kohë të gjatë, sëmundja psikike apo të ngjashme.

Procedura për shkurorëzim inicohet me padi ose me propozim të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje. Padia paraqitet në rastet kur nuk ekziston pajtimi mes bashkëshortëve për shkurorëzim. Në rast se bashkëshortët pajtohen të shkurorëzohen paraqitet propozimi i përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje. Nëse është paraqitur padia për shkurorëzim e bashkëshorti i paditur nuk e konteston kërkesën për shkurorëzim, padia e paraqitur konsiderohet propozim i bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje (neni 68 par. 4 i LFK).

Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët të mitur, bashkë me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje duhet të paraqesin marrëveshjen me shkrim përkitazi me ruajtjen, edukimin dhe ushqimin e fëmijëve dhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me ta (neni 70 par. 2 i LFK). Shkurorëzimi në bazë të marrëveshjes nuk është shkak por mënyrë e shkurorëzimit, andaj edhe sipas ligjit shkurorëzimi me marrëveshje

nuk përfaqëson lirinë e plotë të bashkëshortëve për shkurorëzim, pa kurrfarë kufizimi. Kësisoj, pavarësisht nga marrëveshja për shkurorëzim e bashkëshortëve, gjykata mund ta refuzoj kërkesën për shkurorëzim nëse kjo është në interes të fëmijëve të tyre të mitur.

12. E drejta në padi për shkurorëzim dhe propozim të përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje

Me LFK janë paraparë rregulla të veçanta për shqyrtimin e kontesteve martesore dhe kontesteve tjera familjare. Në mungesë të rregullave të veçanta sipas këtij ligji, zbatohen dispozitat e Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK).

Për shqyrtimin e kontesteve për shkurorëzim kompetenca lëndore i përket gjykatave themelore (neni 11 par. 1i Ligjit për Gjykatat)¹⁴. Sa i përket kompetencës tokësore ajo është e rregulluar me LPK. Kësisoj, në kontestet për shkurorëzim, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme (neni 38 i LPK), kompetente është edhe gjykata në territorin e së cilës bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët (neni 44 i LPK). Nëse bashkëshortët, përkatësisht i padituri, nuk kanë pasur vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë, e për të gjykuar kompetente është gjykata Kosovare, kompetente është gjykata sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin të paditësit. Nëse edhe ky nuk e ka vendbanimin, përkatësisht vendqëndrimin në Kosovë, Gjykata Supreme e Kosovës cakton cila gjykatë territorialisht do të jetë kompetente (neni 65 i LPK). Në kontestet martesore procedurën e zhvillon dhe vendos në shkallë të parë trupi gjykues i përbërë nga një gjyqtar profesionist dhe dy gjyqtar porotë, ndërsa në shkallë të dytë trupi gjykues në përbërje prej tre gjyqtarëve profesionist (neni 73 i LFK).

13. Procedura e shkurorëzimit

Procedura gjyqësore për shkurorëzim mund të iniciohet me padi ose me propozim të përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje. E drejta për të paraqitur padi për shkurorëzim, përkatësisht propozimi i përbashkët është e drejtë personale e bashkëshortëve, ashtu që edhe kjo e drejtë u takon vetëm atyre. Kjo e drejtë nuk mund të bartet në personin tjetër e as të trashëgohet. Mirëpo, nëse procedura për shkurorëzim është iniciuar, trashëgimtarët e paditësit mund të vazhdojnë procedurën e filluar, me të cilin rast gjykata do të vendos nëse ka qenë e bazuar kërkesa për shkurorëzim ose jo (neni 68 par. 3 i LFK). Nëse gjatë procedurës vdes i padituri, gjykata do ta pezullojë procedurën, pasi që trashëgimtarët e të paditurit nuk kanë të drejtë ta vazhdojnë procedurën.

Për bashkëshortin e sëmur shpirtërisht, përkatësisht për personin e paaftë për të gjykuar, të drejtën në padi për shkurorëzim e ka kujdestari i tij me lejen paraprake të Organit të Kujdestarisë (neni 74 i LFK).

¹⁴ Shih Ligjin për Gjykatat ligji nr. 03/L-199 i datës 22.07.2010, dhe ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat,

Gjatë shtatzënisë së gruas dhe deri sa fëmija i përbashkët nuk ka mbushur një vit, bashkëshortët nuk kanë të drejtë të paraqesin padi për shkurorëzim, e kanë të drejtë të kërkojnë shkurorëzimin vetëm me marrëveshje (neni 70 i LFK).

Nëse të dy bashkëshortët paraqesin padi për shkurorëzim, bëhet bashkimi i procedurës, zhvillohet një procedurë unike dhe vendoset me një aktgjykim të përbashkët.

Procedura në kontestet martesore përbëhet nga dy faza:

1. Procedura e pajtimit të bashkëshortëve dhe 2. Procedura e shqyrtimit.

1. Pajtimi i bashkëshortëve

Në kontestet për shkurorëzim më para zhvillohet procedura e pajtimit, të cilën e zhvillon gjykata ose Organi i Kujdestarisë, varësisht nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët të mitur apo jo. Procedura e pajtimit nuk do të zhvillohet: a. kur njëri nga bashkëshortët është i paaftë për të gjykuar, b. kur njëri ose të dy bashkëshortët jetojnë në botën e jashtme dhe c. kur është i panjohur vendqëndrimi i njërit prej bashkëshortëve (neni 76 i LFK).

Palës së paditur padia për shkurorëzim i dorëzohet pas përfundimit të procedurës së pajtimit, nëse pajtimi nuk ka pasur sukses.

Procedurën e pajtimit e zhvillon Organi i Kujdestarisë në rastet kur bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët, e nëse nuk kanë, procedurën e pajtimit e zhvillon gjykata të cilës i është paraqitur padia për shkurorëzim, nëse kryetari i trupit gjykues nuk vlerëson se është e nevojshme që procedura e pajtimit t'i besohet Organit të Kujdestarisë (neni 80 par. 3 i LFK). Nëse është paraqitur padia për shkurorëzim, për zhvillimin e procedurës së pajtimit kompetent janë Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit ndodhet vendbanimi ose vendqëndrimi i të paditurit dhe Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët. Kur procedura është filluar me propozimin për shkurorëzim me marrëveshje, kompetent për procedurën e pajtimit janë Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit e ka vendbanimin ose vendqëndrimin njëri nga bashkëshortët si dhe Organi i Kujdestarisë në territorin e të cilit bashkëshortët e kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

Kur procedurën e pajtimit e zhvillon Organi i Kujdestarisë, ai ka detyrim që sa më para e më së voni brenda tre muajve, nëse bashkëshortët nuk propozojnë që procedura e pajtimit të vazhdohet edhe pas kalimit të këtij afati, t'ia përcjell gjykatës raportin me shkrim me të cilin e njofton gjykatën nëse ka pasur sukses pajtimi apo jo. Nëse pajtimi nuk ka pasur sukses, me të njëjtin raport Organi i Kujdestarisë do ta jep mendimin se cilit prind duhet besuar fëmijët e mitur në ruajtje, kujdes dhe edukim në rast shkurorëzimi të bashkëshortëve.

Atëherë kur procedura për shkurorëzim është iniciuar me padi, në rastet kur procedurën e pajtimit të bashkëshortëve e zhvillon gjykata, ajo cakton seancë të veçantë gjyqësore për tentim pajtimi të bashkëshortëve, e cila mbahet para kryetarit të kolegjit. Në këtë seancë ftohen vetëm të dy bashkëshortët që personalisht të jenë të pranishëm.

Po që se bashkëshortët kanë të autorizuar, të autorizuarit nuk ftohen në këtë seancë e as që mund të jenë të pranishëm. Nëse në seancën e parë pajtimi nuk ka sukses, gjykata mund të caktojë dhe të mbajë edhe një ose më tepër seanca tjera për pajtimin e bashkëshortëve, deri sa nuk bindet se deri te pajtimi nuk mund të vjen. Nëse në seancën për tentim pajtimi mungojnë njëri ose të dy bashkëshortët të cilët kanë qenë të ftuar në rregull, varësisht nga të gjitha rrethanat, gjykata do të vlerësojë nëse duhet të caktohet seanca e re për pajtim apo të konstatohet se pajtimi nuk ka pasur sukses.

Në rastet kur procedura është iniciuar më propozimin e përbashkët të bashkëshortëve për shkurorëzim me marrëveshje, e në seancën për pajtim mungojnë njëri ose të dy bashkëshortët, do të konsiderohet se është tërhequr propozimi (neni 79 par. 2 i LFK).

2. Procedura e shqyrtimit

Nëse procedura për shkurorëzim është iniciuar me propozim të përbashkët, gjykata nuk heton dhe shqyrtton arsyet e paraqitura në propozim, përpos nëse konstatohet se ajo martesë duhet të ruhet për shkak të interesave fundamentale të fëmijëve të përbashkët të tyre. Pavarësisht nga fakti që bashkëshortët kanë paraqitur propozimin për ruajtjen, kujdesin dhe mbajtjen e fëmijëve të mitur, gjykata mund të vendosë të hetojë faktet dhe të administrojë prova, nëse bindet se propozimi nuk është në interes të fëmijëve.

Gjatë gjithë procedurës në kontestet martesore gjykata, sipas detyrës zyrtare (ex officio), me aktvendim mund të caktojë masat e përkohshme përkritazi me mbrojtjen, vendosjen dhe ushqimin e fëmijëve të përbashkët të mitur (neni 327 i LFK), ndërsa përkritazi me dhënien e ushqimit bashkëshortit dhe vendosjen e tij, vetëm sipas propozimit të tij (neni 71 i LFK). Ankesa kundër këtyre aktvendimeve nuk e ndal përmbarimin.

14. Veçoritë e procedurës në kontestet martesore janë:

Në seancat gjyqësore përjashtohet publiku.

Parimi i disponimit të palëve nuk vjen në shprehje, nga se gjatë kësaj procedure gjykata mund të vendosë të vërteton edhe ato fakte në të cilat bazohet kërkesa, edhe nëse ato nuk janë kontestuese mes palëve.

Në kontestet martesore nuk mund të merret aktgjykimi për shkak të mungesës e as aktgjykimi në bazë të pranimit (neni 85 par. 2 i LFK).

Nëse procedura është iniciuar me propozimin e përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje, nuk hetohen faktet në të cilat mbështetet propozimi për shkurorëzim, mirëpo gjykata mund të vendosë të bëhet kjo, duke administruar prova sikur te padia par shkurorëzim, nëse vlerëson se interesat e arsyeshme të fëmijëve të mitur kërkojnë që të ruhet martesja.

Në dallim nga kontestet tjera kur paditësi, pa pëlqimin e të paditurit, mundë të tërheqë padinë deri sa ajo nuk i është dorëzuar të paditurit, në kontestet martesore padia mund të tërhiqet deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, e me pëlqimin e tij

deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Propozimi i përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje mund të tërhiqet deri sa aktgjykimi për shkurorëzim të marrë formën e prerë. Propozimi konsiderohet se është tërhequr edhe nëse vetëm njëri bashkëshort heq dorë nga propozimi (neni 86 i LFK).

Aktgjykimi me të cilin është zgjidhur martesë me shkurorëzim sipas propozimit të përbashkët për shkurorëzim me marrëveshje, në pjesën përkitazi me shkurorëzimin mund të kundërshtohet me ankesë vetëm për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave procedurale apo për shkak se propozimi është dhënë në lajthim ose nën ndikimin e shtrëngimit ose mashtrimit (neni 87 i LFK).

Kundër aktgjykimit me të cilin është zgjidhur martesë me shkurorëzim apo anulim nuk mund të paraqiten mjetet e jashtëzakonshme juridike (neni 88 i LFK).

15. Pasojat e shkurorëzimit

Pas shkurorëzimit paraqiten pasoja të shumta të cilat kanë të bëjnë: **a.** me bashkëshortët dhe **b.** mes bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre të përbashkët.

- a) *Pasojat të cilat kanë të bëjnë me bashkëshortët i përkasin: mbiemrit; trashëgimisë; dhuratave; pasurisë së përbashkët; ushqimit të bashkëshortit dhe kompensimit të dëmit.*

Mbiemri. Bashkëshorti i cili me rastin e lidhjes së martesës e ka ndërruar mbiemrin, duke e marrë mbiemrin e bashkëshortit tjetër ose duke ia shtuar mbiemrit të vetë edhe mbiemrin bashkëshortit, pas zgjidhjes së martesës mund të marrë mbiemrin që e ka mbajtur para lidhjes së martesës. Kjo bëhet me një deklaratë të cilën duhet paraqitur ofiqarisë brenda 6 muajsh pas zgjidhjes së martesës. Deklarata duhet paraqitur ofiqarisë ku është lidhur martesë ose ofiqarisë ku e ka vendqëndrimin paraqitësi i deklaratës.

Trashëgimia. E drejta në trashëgimi mes bashkëshortëve pushon me shkurorëzim. E drejta në trashëgimi pushon edhe nëse bashkëshorti gjatë jetës ka paraqitur padinë për shkurorëzim, gjatë zhvillimit të procedurës vdes, e pas përfundimit të procedurës të vazhduar nga trashëgimtarët e tij vërtetohet se padia për shkurorëzim ka qenë e bazuar. Bashkëshorti nuk ka të drejtë të trashëgojë as në bazë të testamentit në rast të vdekjes së testamentlënësit, nëse testamenti është lënë para shkurorëzimit.

Dhuratat. Përkitazi me dhuratat e ndërsjella mes bashkëshortëve dhe të tjerëve ndaj tyre, LFK në fuqi nuk përmban dispozita me të cilat do të rregullohej kjo çështje. Andaj edhe kjo duhet zgjidhur në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Pasuria e përbashkët. Kjo është pasuria të cilën bashkëshortët e kanë fituar me punë gjatë martesës. Ndarjen e kësaj pasurie bashkëshortët mund ta bëjnë me marrëveshje, e nëse nuk arrihet marrëveshja, ndarja do të bëhet nëpërmjet të gjykatës në procedurën e veçantë kontestimore. Përkitazi me ndarjen e pasurisë së përbashkët nuk shqyrtohet dhe nuk mund të vendoset në kontestin martesor.

Ushqimi. Përkitazi me ushqimin e bashkëshortëve gjatë dhe pas martesës do të bëhet fjalë në pjesën DETYRIMI LIGJOR PËR USHQIM.

Kompensimi i dëmit. Me rastin e shkurorëzimit mund të dëmtohet njëri ose bashkëshorti tjetër. Edhe kjo çështje nuk është rregulluar më LFK, andaj edhe kompensimi i dëmit eventual material apo jomaterial do të shqyrtohen sipas LMD.

- b) *Pasojat e shkurorëzimit në fëmijët e përbashkët kanë të bëjë me ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve të mitur dhe atyre të rritur ndaj të cilëve është vazhduar e drejta prindore.*

Në rastet e shkurorëzimit të martesave me fëmijë të mitur gjykata vendos se cilit nga prindërit do t'i besohen ata në ruajtje dhe edukim. Për këtë bashkëshortët mund të merren vesh. Mirëpo, pavarësisht nga kjo, gjykata sipas detyrës zyrtare e vlerëson atë nëse është në interes të fëmijëve apo jo. Nëse nuk ka marrëveshje mes prindërve përkitazi me besimin e fëmijëve të mitur, ose marrëveshja e tyre nuk është në interes të fëmijëve, me aktgjykimin e shkurorëzimit vendoset edhe për ruajtjen, edukimin dhe mbajtjen e fëmijëve të mitur. Gjukata para se të vendos për këtë merr mendimin dhe propozimin nga Organi i Kujdestarisë dhe heton të gjitha rrethanat me rëndësi për vendosje, si që janë: moshë e fëmijëve, lidhja emocionale e tyre me prindërit, kushtet e jetesës (materiale, të banimit etj), gjendja shëndetësore e fëmijëve dhe prindërve, e nëse fëmija ka mbushur 10 vjet edhe mendimi i tij. Pasi të hetohen të gjitha rrethanat mund të vendoset: të gjithë fëmijët t'i besohen njërit prind, disa fëmijë t'i besohen njërit e disa tjetrit prind ose fëmijët t'i besohen ndonjë personi të tretë a ndonjë organizate të specializuar.

Kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët të mitur, mund të shkurorëzohen me marrëveshje vetëm nëse janë marrë vesh edhe për ruajtjen, edukimin dhe ushqimin dhe mbajtjen e kontakteve personale me ta.

Prindi të cilit i janë besuar fëmijët e ushtron të drejtën prindore efektivisht. Prindi të cilit nuk i janë besuar fëmijët ka të drejtë të mbaj kontakte personale me ta në mënyrë si merren vesh ose si e cakton gjykata.

MARRDHËNIET PASURORE TË BASHKËSHORTËVE

Varësisht nga përkatësia e pasurisë, bashkëshortët mund të kenë:

1. Pasurinë e veçantë dhe
2. Pasurinë e përbashkët (neni 45 i LFK),

1. Pasuria e veçantë e bashkëshortit, e drejta e qeverisjes dhe e disponimit me atë

Pasuri e veçantë e njërit bashkëshort është ajo pasuri të cilën ai e ka pasur para lidhjes së martesës, të cilën ai e ka fituar gjatë martesës, por jo me punë, po me trashëgim, dhurim ose me forma tjera të fitimit pa barrë si dhe pasuria që i takon atij me ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve. Edhe pasuria e fituar në lojën në fat paraqet pasuri të veçantë të njërit bashkëshort, nëse ai e ka deponuar në këtë lojë pasurinë e vetë të veçantë.

Përpos rasteve të mësipërme të fitimit të pasurisë së veçantë, të cilat janë edhe rastet më të shpeshta, në pasurinë e veçantë bëjnë pjesë edhe të gjitha të drejtat sendore dhe ato detyrimore të fituara nga pasuria e veçantë, si frutat, qiraja, kamata nga kursimet, etj. Pasuri të veçantë të bashkëshortit përfaqësojnë edhe sendet që shërbejnë për përdorimin e tij personal si sendet e veshmbathjes, stolitë, etj, me kusht që vlera e tyre nuk është joproportionale në krahasim me vlerën e përgjithshme të pasurisë së përbashkët. Së fundi pasuri të veçantë përfaqëson edhe pasuria të cilën e ka fituar njëri bashkëshort gjatë martesës por gjatë kohës kur bashkëshortët kanë jetuar ndaras, nuk ka ekzistuar jeta faktike e përbashkët mes tyre. Bashkëshorti në mënyrë të pavarur administron dhe disponon me pasurinë e tij të veçantë, e mund të administrojë dhe disponojë me te edhe përkundër dëshirës së bashkëshortit tjetër (neni 46 i LFK).

2. Pasuria e përbashkët e bashkëshortëve, mënyra e disponimit, qeverisjes dhe ndarja

Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është ajo pasuri të cilën ata e kanë fituar me punë të përbashkët gjatë martesës si dhe të hyrat nga ajo pasuri (neni 47 i LFK). Për të qenë pasuri e përbashkët e bashkëshortëve duhet plotësuar dy kushte: a. Të është fituar gjatë martesës, b. Të është fituar me punë.

Pasuria e fituar gjatë martesës është pasuria e fituar nga momenti i lidhjes së martesës deri në momentin e ndërprerjes së saj (nëse është e vlefshme ndërprehet me vdekjen e njërit bashkëshort ose me shkurorëzim, nëse është e pavlefshme me anulim).

Fakti se ekziston martesë nuk do të thotë se ekziston edhe bashkësia faktike e jetës mes bashkëshortëve. Nëse për një kohë gjatë martesës bashkëshortët nuk jetojnë në bashkësi faktike të jetës, por jetojnë ndaras dhe të pavarur njëri nga tjetri, pasuria e fituar me punë e njërit bashkëshort do të përfaqësojë pasuri të veçantë të tij, nëse në fitimin e saj në asnjë mënyrë nuk ka kontribuar bashkëshorti tjetër.

Përndryshe edhe në rastet kur bashkësia faktike e jetës për një kohë me bashkëshortëve nuk ekziston, (për shkak të punës, aftësisimit profesional, etj), ashtu që edhe pse ata jetojnë ndaras, bashkëshorti tjetër kujdeset në mënyra të ndryshme për familje dhe në këtë mënyrë kontribuon në fitimin e kësaj pasurie, ajo paraqet pasuri të përbashkët të bashkëshortëve.

Pasuria është e fituar me punë pavarësisht nga ajo nëse është fituar me punë të përbashkët të bashkëshortëve, me punë direkte ose indirekte të tyre.

Mënyra e qeverisjes dhe disponimit

Pjesët e bashkëshortëve në pasurinë e përbashkët nuk dihen, por mund të caktohen. Nga kjo arsye bashkëshorti, me pjesën e vetë në pasurinë e përbashkët të pandarë, nuk mund të disponojë e as ta ngarkojë me ndonjë punë juridike mes të gjallëve. Me pasurinë e përbashkët bashkëshortët administrojnë dhe disponojnë bashkërisht dhe me marrëveshje (neni 49 i LFK), në rast të mosmarrëveshjes vendos gjykata në procedurën jokontestimore.

Të drejtat e bashkëshortëve në sendet e paluajtshme të cilat janë pasuri e përbashkët, në regjistrat publik për evidencën e pasurive të paluajtshme, regjistrohen në emër të dy bashkëshortëve, si pasuri e përbashkët e tyre, në pjesë të papërcaktuara (neni 50 i LFK). Nëse është regjistruar si pronar i pasurisë së përbashkët vetëm njëri bashkëshort, konsiderohet sikur regjistrimi është bërë në emër të dy bashkëshortëve.

Ndarja e pasurisë së përbashkët

Bashkëshortët mundin në çdo kohë të bëjnë ndarjen e pasurisë së përbashkët me marrëveshje. Marrëveshja duhet të jetë e formës së shkruar (neni 52 i LFK). Në rast se nuk arrihet marrëveshja, në rast kontesti, pjesët e bashkëshortëve në pasurinë e përbashkët caktohen në procedurë gjyqësore, në bazë të kontributit të secilit bashkëshort, duke vlerësuar të gjitha rrethanat me rëndësi për fitimin e saj. Me rastin e ndarjes së pasurisë së përbashkët merren parasysh jo vetëm të ardhurat e secilit bashkëshort, por edhe ndihma e njërit bashkëshort tjetrit, mënyra e udhëheqjes së punëve familjare, kujdesi dhe mirëmbajtja e pasurisë nga ata, eventualisht shpenzimet e tepërta të ndonjërit nga ata si dhe çdo formë tjetër e punës në mirëmbajtjen dhe rritjen e pasurisë së përbashkët. Kompetente për të vendosur është gjykata themelore. Pjesët e bashkëshortëve caktohen në përpjesëtim të njëjtë në të gjitha sendet dhe të drejtat në pasurinë e përbashkët, ashtu si janë në momentin e ndërprerjes së bashkësisë martesore.

Në rregull ndarja e pasurisë së përbashkët kërkohet pas ndërprerjes së martesës, e mund të kërkohet edhe gjatë martesës. Të drejtën të kërkojnë ndarjen e pasurisë së përbashkët e kanë: bashkëshortët, trashëgimtarët e bashkëshortit të vdekur ose të bashkëshortit të shpallur për të vdekur dhe kreditori i njërit bashkëshort, nëse kërkesën e vetë nuk mund ta realizojë nga pasuria e veçantë e atij bashkëshorti (neni 56 i LFK).

Me LFK janë të rregulluara edhe marrëdhëniet pasurore të bashkëshortëve jashtëmartesor, ashtu që pasuria e fituar me punën e burrit dhe të gruas në bashkësinë

jashtëmartesore është pasuri e përbashkët e tyre, e ne marrëdhëniet pasurore të tyre zbatohen në mënyrë analoge dispozitat për ndarjen e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve (neni 58 i LFK).

BASHKËSIA JASHTËMARTESORE (FAKTIKE)

Efektet juridike të bashkësisë jashtëmartesor

Sipas LFK bashkësi jashtëmartesore konsiderohet marrëdhënia faktike ndërmjet burrit dhe gruas të cilët jetojnë në qifte, e karakterizuar nga një jetë e përbashkët që paraqet një karakter stabiliteti dhe vazhdueshmërie (neni 39 i LFK). Pavarësisht nga fakti që ajo bashkësi nuk është e rregulluar me ligj, sipas ligjit në fuqi ajo barazohet me bashkësinë martesore shikuar nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve për përkujdesje të ndërsjellë, mbështetje financiare reciproke dhe përkritazi me të drejtat pasurore të tyre.

Për të pasur efektet juridike të sipërshënuara, në momentin e formimit të bashkësisë jashtëmartesore, nga pengesat martesore të parashikuara me ligj, nuk duhet të kenë ekzistuar: martesa e ndonjërit nga bashkëshortët jashtëmartesor me ndonjë person tjetër, të mos jenë në gjini të gjakut apo atë civile deri në shkallën e cila ndalohej me ligj dhe mos të jenë shpirtërisht të sëmurë dhe të paaftë për të gjykuar. Konsiderohet se një qift jeton në bashkësi jashtëmartesore nëse, sipas ligjit kanë të drejtë të martohen mes veti por nuk kanë lidhur martesë ligjore dhe kanë bashkëjetuar haptazi si një qift bashkëshortor.

Bashkëshortet jashtëmartesor kanë detyrim për respekt të ndërsjellë, mirëkuptim dhe ndihëm ndaj njëri tjetrit, në të njëjtën mënyrë sikur të ishin bashkëshortë martesor (neni 41 i LFK).

Nga jeta faktike e përbashkët bashkëshortët jashtëmartesor, me punën e tyre ata mund edhe të krijojnë pasuri. Kjo pasuri e fituar gjatë bashkësisë faktike konsiderohet pasuri e tyre e përbashkët dhe i nënshtrohet ndarjes apo pjesëtimit si edhe pasuria e përbashkët e bashkëshortëve martesor. Dispozitat ligjore me të cilat rregullohet ndarja e pasurisë së përbashkët e bashkëshortëve martesor, në mënyrë analoge zbatohen edhe përkritazi me marrëdhëniet pronësore të personave në bashkësi jashtëmartesore (neni 58 i LFK).

IX. MARRËDHËNIET NDËRMJET PRINDËRVE DHE FËMIJËVE

Kuptimi dhe burimet e së drejtës prindërore

Me LFK rregullohen të gjitha marrëdhëniet në martesë dhe familje, ashtu që edhe përfaqëson një kodifikim të normave juridike me të cilat rregullohen këto marrëdhënie. Edhe marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve dhe personave tjerë në gjini janë të rregulluara me këtë ligj.

1. Presumimet e atësisë martesore

Fëmijë martesor janë fëmijët e lindur gjatë ekzistimit të martesës, edhe nëse ajo më vonë shpallet e pavlefshme, si dhe fëmijët të cilët kanë lindur brenda 300 ditësh pasi martesë ka pushuar së ekzistuari. Fëmijë martesor konsiderohet edhe fëmija i lindur jashtë martesës nëse prindërit e tij lidhin martesë ndërmjet veti. Nëse fëmija ka lindur gjatë martesës së mëvonshme të nënës së vet pas kalimit të afatit prej 270 ditësh e deri në afatin prej 300 ditësh pas zgjidhjes së martesës së saj të mëparshme, at do të konsiderohet burri i nënës nga martesë e mëparshme, përveç nëse burri i nënës nga martesë e mëvonshme, me pëlqimin e nënës së fëmijës, e pranon fëmijën për të vetin (neni 99 par. 2 i LFK).

2. Kundërshtimi i atësisë martesore

Kundërshtimi i atësisë nënkupton kundërshtimin e prezumimit ligjor se burri i nënës është i ati i fëmijës të cilin ajo e ka lindur në martesë ose 270 –300 ditë pas zgjidhjes së martesës. Kundërshtimi bëhet me padi të ushtruar pran gjykatës themelore e cila e ka kompetencën tokësore, nga këta persona:

Burri mund të kundërshtoj atësinë e fëmijës të cilin e ka lindur gruaja e tij gjatë martesës ose pas kalimit të 300 ditëve pas zgjidhjes së martesës. Afati i padisë është 6 muaj nga marrja në dijeni për faktin i cili e ve në dyshim atësinë e tij, por jo pasi fëmija t’i mbush 10 vite.

Nëna mund të kundërshtoj se është i ati i fëmijës së saj personi i cili sipas ligjit konsiderohet se është i ati i fëmijës.. Afati për paraqitjen e padisë është 6 muaj nga lindja e fëmijës.

Fëmija mund të kundërshtojë atësinë e personit i cili me ligj konsiderohet si at i tij. E drejta e padisë së fëmijës nuk parashkruhet (neni 115 par 3 i LFK).

3. Kundërshtimi i atësisë jashtëmartesore

Personi që e konsideron veten at i fëmijës së lindur jashtë martesë, mund t’ia kundërshtojë atësinë personit i cili e ka pranuar atë fëmijë si të vetin me kusht që të

kërkojë edhe vërtetimin e atësisë së fëmijës. Afati për paraqitjen e padisë është një vit nga regjistrimi i atësisë së kundërshtuar.

Edhe gruaja e cila është regjistruar nënë e fëmijës mund ta kundërshtojë amësinë e vetë brenda 6 muajve nga marrja në dijeni të faktit se nuk është nënë e fëmijës, e më së voni brenda afatit prej 7 vjetësh nga lindja e fëmijës (neni 118 par. 2 i LFK).

Gruaja e cila e konsideron veten nënë të fëmijës, mund t'ia kundërshtojë amësinë gruas tjetër në emër të së cilës është regjistruar fëmija me kusht që të kërkojë edhe vërtetimin e amësisë, brenda 6 muajve nga marrja në dijeni se ajo është nënë e fëmijës, e më së voni brenda afatit prej 7 vjetësh nga lindja e fëmijës (neni 119 i LFK).

E drejta e padisë së fëmijës për kundërshtimin e amësisë nuk parashkruhet. Pas vdekjes së fëmijës nuk është e lejuar padia për kundërshtimin e atësisë dhe amësisë. E drejta në këtë padë nuk kalon në trashëgimtar.

4. Pasojat e atësisë së kundërshtuar

Me plotfuqishmërinë e aktgjykimit me të cilin është aprovuar kërkesa për kundërshtimin e atësisë, fëmija e humb statusin e fëmijës martesor. Në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm, ndryshimet përkritazi me atësinë regjistrohen në librat amzë për të lindurit, me efekt prapaveprues nga se fëmija konsiderohet jashtëmartesor nga momenti i lindjes.

Pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, fëmija i humb të gjitha të drejtat që ka pasur ndaj burrit të nënës e cila e ka lindur, e edhe ta mbaj mbiemrin e tij.

5. Fëmijët jashtëmartesor

Ligji për Familjen i Kosovës nuk përmban dispozita të veçanta se cilët fëmijë konsiderohen jashtëmartesor. Mirëpo, duke u nisur nga dispozitat ligjore sipas së cilave është përcaktuar se cilët fëmijë konsiderohen si fëmijë martesor të gjithë fëmijët nga lindjet tjera konsiderohen jashtëmartesore, si p.sh.: fëmija i lindur nga gruaja e pamartuar; ai i lindur nga gruaja e ve apo e shkurorëzuar pas 300 ditësh nga dita e pushimit të martesës dhe ai i lindur në martesë ose 300 ditë pas ndërprerjes së martesës atësia e të cilit me sukses është kundërshtuar.

6. Konstatimi i atësisë dhe amësisë jashtëmartesore

Atësia e fëmijës jashtëmartesor mund të pranohet ose të vërtetohet me vendim gjyqësor.

Atësinë mund të pranoj mashkulli i aftë për të gjykuar i cili i ka mbushur 16 vjet, në bazë të deklaratës së dhënë para ofiqarit, Organit të Kujdestarisë, gjykatës ose të ndonjë organi tjetër shtetëror të autorizuar për përpilimin e dokumenteve publike. Atësia mund të pranohet edhe me testament. Pranimi i atësisë është i vlefshëm vetëm nëse me atë pajtohet nëna e fëmijës, e nëse fëmija ka mbushur 16 vjet kërkohet edhe pëlqimi i fëmijës.

Të drejtën në padi për vërtetimin e atësisë e kanë: personi i cili veten e konsideron at i fëmijës, fëmija dhe nëna e fëmijës. Nëna mund të paraqet padi deri sa e ushtron të drejtën prindërore, ndërsa vetë fëmija mund të paraqet padi në çdo kohë (neni 110 i LFK).

Për të vendosur lidhur me vërtetimin e atësisë, kompetencën lëndore e ka në shkallë të parë gjykata themelore. Në këto konteste palë në procedurë janë personi atësia e të cilit vërtetohet, fëmija dhe nëna e fëmijës. Nuk mund të shqiptohet aktgjykimi për shkak të mungesës e as aktgjykimi në bazë të pranimit, e as që mund të lidhet ujdj gjyqësore.

Kërkimi i atësisë së fëmijës të zënë me mbarsim artificial të nënës nuk është i lejuar.

Për vërtetimin e amësisë LFK në dispozitën e nenit 112 parasheh zbatimin e dispozitave të këtij ligji lidhur me vërtetimin e atësisë.

7. Pasojat e atësisë dhe amësisë së vërtetuar jashtëmartesore

Në bazë të deklaratës së mashkullit të dhënë para organeve të sipërshënuar përpilohet procesverbali e pas marrjes së deklaratës së nënës, nëse fëmija ka mbushur 16 vjet edhe të fëmijës, bëhet regjistrimi i atësisë në librat amëz për të lindurit dhe nga ai moment është i njohur edhe i ati i fëmijës.

Nëse atësia ose amësia është vërtetuar me vendim të gjykatës, ky vendim ka karakter statusor, andaj edhe vepron ndaj të gjithëve dhe prodhon efekte juridike nga dita e plotfuqishmërisë. Në bazë të aktgjykimit të plotfuqishëm regjistrohet edhe atësia, përkatësisht amësia e fëmijës në librat amëz për të lindurit.

8. Legjitimimi i fëmijëve të lindur jashtë martesë dhe pasojat e legjitimit

Fëmija jashtëmartesor konsiderohet se ka lindur në martesë nëse prindërit e tij më vonë lidhim martesë ndërmjet veti. Në këtë mënyrë fëmijës jashtëmartesor me aktin e lidhjes së martesës ndërmjet prindërve të tij i pranohet statusi i fëmijës martesor.

Nëse prindërit e fëmijës së lindur jashtë martesës kanë pasur qëllimin të lidhin martesën por kanë qenë të penguar me vdekjen e njërit prej tyre, me kërkesën e prindërit të gjallë ose të fëmijës, gjykata në procedurën jokontestimore do të shpall se fëmija ka lindur në martesë. Këtë kërkesë mund ta paraqet edhe Organi i Kujdestarisë nëse prindi i gjallë nuk ka mundësi të bëjë këtë (neni 100 par. 2 i LFK).

Pavarësisht nga mundësitë e mësipërme ligjore të legjitimitit të fëmijës jashtëmartesor, duke pasur parasysh faktin se fëmijët jashtëmartesor janë plotësisht të barabartë në të gjitha të drejtat dhe detyrimet me ata martesor, legjitimimi i fëmijëve jashtëmartesor nuk ka ndonjë rëndësi juridike, pasi që me këtë akt nuk zgjerohen as ngushtohen të drejtat e tyre.

E DREJTA PRINDËRORE

Prindërit kanë të drejtë dhe detyrë që të kujdesen për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur. Ata janë të detyruar t'i rrisin fëmijët duke u kujdesur për jetën dhe shëndetin e tyre, për edukimin e tyre të drejtë, për shkollimin dhe aftësimin profesional varësisht nga prirjet dhe dëshira që kanë, duke i aftësuar për jetë të pavarur. Kanë për detyrë të kontribuojnë në ushqimin e tyre, varësisht nga mundësitë që kanë, të kujdesen për pasurinë e tyre dhe t'i përfaqësojnë ata. Të gjitha detyrimet e mësipërme quhen të drejta prindërore, pasi që nevojat emocionale dhe dëshira e prindërve që të rrisin fëmijët e tyre dhe drejtpërdrejt të kujdesen për ata, atyre u japin karakter të drejtave të cilat i kryejnë prindërit në interes të fëmijëve të tyre.

1. Ushtrimi i të drejtës prindore

Ushtrimi i të drejtës prindore u përket vetëm prindërve. Duke e ushtruar këtë të drejtë ata realizojnë edhe interesat e veta duke përmbushur nevojat e tyre emocionale të cilat rrjedhin nga marrëdhëniet natyrore të prindërve dhe fëmijëve.

Prindërit e ushtrojnë të drejtën prindore bashkërisht dhe me marrëveshje, e në rast të mospajtitimit të tyre vendos Organi i Kujdestarisë. Kjo nënkupton barazinë e plotë të prindërve në ushtrimin e të drejtës prindërore. Në rastet kur është i njohur vetëm njëri prind (te fëmijët jashtëmartesor), kur njëri prind ka vdekur, ose i është hequr e drejta prindërore, kur i është hequr zotësia për të vepruar, ose për shkak të rrethanave tjera nuk është në gjendje të ushtrojë të drejtën prindërore, këtë e ushtron prindi tjetër. Nëse prindërit, qofshin ata martesor ose jashtëmartesor, jetojnë ndaras, ose me rastin e zgjidhjes së martesës, me vendim të gjykatës, fëmija i është besuar në ruajtje, kujdes dhe edukim njërit prind, të drejtën prindërore e ushtron prindi të cilit i është besuar fëmija (neni 140 i LFK). Për ushtrimin e të drejtës prindore të prindërve jashtëmartesor si dhe të atyre martesor gjithmonë vendos gjykata (neni 139 i LFK), në bazë të kërkesës së paraqitur. Gjykata sipas detyrës zyrtare vendos për ushtrimin e të drejtës prindërore nga njëri prind vetëm në kontestet martesore në rastet kur vendos për zgjidhjen e martesës.

Lidhur me çështjet të cilat janë me rëndësi qenësore për zhvillimin e fëmijës, pavarësisht që njëri prind nuk e ushtron të drejtën prindërore, prindërit janë të barabartë dhe vendosin me marrëveshje. Në rast të mosmarrëveshjes, sipas kundërshtimit të prindit i cili nuk e ushtron të drejtën prindërore, do të vendos Organi i Kujdestarisë nëse veprimi i tillë është në interes të fëmijës apo jo (neni 141 i LFK).

Përkitazi me mbajtjen e kontakteve personale me fëmijët, prindërit vendosin me marrëveshje. Në rast se nuk merren vesh do të vendos gjykata. Me aktgjykimin me të cilin zgjidhet martesë gjykata do të vendos edhe lidhur me mbajtjen e marrëdhënieve personale të fëmijës me prindin të cilit nuk i janë besuar fëmijët, nëse prindi tjetër e pengon në këtë, ose nëse gjykata konstaton se kjo është e nevojshme për mbrojtjen e fëmijës. Pavarësisht nga fakti nëse gjykata ka vendosur apo jo për mbajtjen e marrëdhënieve personale të prindërve me fëmijët, gjykata kompetente mundet në çdo kohë të rregullojë mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale të prindërve me fëmijët varësisht nga rrethanat e ndryshuara (neni 145 i LFK).

Ushtrimi i të drejtës prindërore, në mënyrë të gjithanshme dhe të vazhdueshme, mbikëqyrret nga Organi i Kujdestarisë (neni 138 i LFK). Kjo mbikëqyrje bëhet si përkritazi me zhvillimin e personalitetit të fëmijës së mitur ashtu edhe përkritazi me administrimin me pasurinë e tij. Organi i Kujdestarisë ka detyrim të ndërmerë masat e nevojshme me qëllim të mbrojtjes së të drejtave personale dhe pasurore në interes të fëmijës së mitur. Organi i Kujdestarisë mund të caktojë mbikëqyrjen e përhershme të ushtrimit të së drejtës prindërore, përkritazi me të gjithë fëmijët ose të ndonjërit nga ata, nëse këtë e kërkojnë interesat e fëmijëve.

2. Kufizimi dhe heqja e së drejtës prindërore

Sipas kushteve të parapara me ligj ushtrimi i të drejtës prindërore prindërve mund t’iu kufizohet ose t’iu hiqet në tërësi.

Në rast rreziku lidhur me edukimin e drejtë të fëmijës, Organi i Kujdestarisë mund të vendos që fëmija të merret nga prindi dhe t’i besohet personit tjetër ose organizatës për ruajtje dhe edukim. Në këtë rast prindërit nuk lirohen nga të drejtat dhe detyrimet tjera ndaj fëmijës. Sa i përket pasurisë së fëmijës, më qëllim të mbrojtjes së saj, Organi i Kujdestarisë mund të kërkojë që gjykata në procedurën jokontestimore të lejojë masa të sigurisë në pasurinë e prindërve, ose që prindi, përkritazi me administrimin e pasurisë së fëmijës, të ketë pozitën e kujdestarit (neni 148 i LFK).

Ndaj të gjithë fëmijëve ose ndaj fëmijës së caktuar prindërve mund t’u hiqet e drejta prindërore nëse:

- 1) E keqpërdorin ushtrimin e të drejtës prindërore,
- 2) Në mënyrë serioze e neglizhojnë ushtrimin e të drejtës prindërore.

Pasi të ketë hetuar të gjitha rrethanat e rastit dhe marrjes së mendimit nga Organi i Kujdestarisë, vendimin për heqjen e të drejtës prindërore e merr gjykata themelore kompetente në procedurën jokontestimore. Këtë procedurë mund ta iniciojë prindi tjetër ose Organi i Kujdestarisë. Këtë vendim, sipas detyrës zyrtare, mund ta merr gjykata edhe në kontestet martesore dhe në ato nga marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve (vërtetimi ose kundërshtimi i atësisë dhe amësisë), nëse konstaton se për këtë ekzistojnë shkaqet e parapara me ligj. Me heqjen e të drejtës prindërore prindërit humbin të gjitha të drejtat dhe detyrimet ndaj fëmijëve, përpos detyrimit për ushqimi (neni 149 i LFK).

E drejta prindërore mund t’i kthehet prindit me vendim të gjykatë, kur pushojnë arsyet që kanë sjell heqjen e saj. Propozimin për kthimin e të drejtës prindërore mund ta paraqesin prindi dhe Organi i Kujdestarisë. Edhe për kthimin e të drejtës prindërore (si për heqjen e saj), sipas detyrës zyrtare gjykata mund të vendos në kontestet martesore dhe në kontestet nga marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve, nëse konstaton se janë plotësuar kushtet për këtë (neni 151 i LFK).

3. Pushimi i së drejtës prindërore

Marrëdhënia prindërore ekziston nga fakti i ekzistimit të marrëdhënies së afërsisë, e cila themelohet me lindjen e fëmijës, dhe ekziston deri sa prindërit dhe fëmija të jenë gjallë. Ndërsa, e drejta prindërore nuk ka karakter të përhershëm, dhe nuk ekziston deri sa të ekzistojë marrëdhënia prindërore, pasi që ajo ekziston vetëm për interes të fëmijës.

Andaj edhe e drejta prindërore pushon:

- me vdekjen e fëmijës ose të prindit,
- me arritjen e moshës madhore të fëmijës,
- me emancipimin e fëmijës.

4. Zgjatje e të drejtës prindërore

E drejta prindërore ushtrohet deri në moshën madhore të fëmijës, nëse nuk është ndërpre më herët për shkak të emancipimit të tij. Mirëpo, e drejta prindërore mund të zgjatet edhe pas moshës madhore nëse fëmija, për shkak të sëmundjes shpirtërore, zhvillimit shpirtëror të ngecur, të metave fizike, ose për shkaqe të tjera, nuk është në gjendje të kujdeset vetë për personalitetin të drejtat dhe interesat e veta.

Përkitazi me zgjatjen e të drejtës prindërore vendos gjykata kompetente në procedurën jokontestimore, me propozimin e prindërve ose të Organit të Kujdestarisë. Propozimi për zgjatjen e të drejtës prindërore duhet paraqitur para se të mbush fëmija moshën madhore, ose pas mbushjes së moshës madhore me kusht që në kohën e mbushjes së moshës madhore të kanë ekzistuar shkaqet për zgjatjen e të drejtës prindërore. Me vendimin për zgjatjen e të drejtës prindërore gjykata duhet të caktoj nëse personi është i barazuar me personin më të ri ose më të vjetër se 14 vjet (neni 153 i LFK).

Me pushimin e shkaqeve për vazhdimin e të drejtës prindërore gjykata, me propozimin e atij personi, të prindërve të tij ose të Organit të Kujdestarisë, do të vendos për pushimin e të drejtës së vazhduar prindërore.

Vendimet për heqjen, kthimin, zgjatjen dhe pushimin e të drejtës së vazhduar prindërore, regjistrohen në librin amzë për të lindurit.

X. ADOPTIMI (birësimi)

Kuptimi. Me adoptim, ndërmjet adoptuesit dhe të adoptuarit, themelohen të drejtat dhe detyrimet që ekzistojnë ndërmjet prindërve dhe fëmijëve (neni 167 i LFK). Interesimi, kujdesi dhe dashuria e prindërve ndaj fëmijëve mundësojnë kushte të pazëvendësueshme për zhvillimin fizik, mental dhe shoqëror të personalitetit të fëmijës. Fëmijët pa kujdesin e prindërve konsiderohen më të rrezikuarit, andaj edhe gëzojnë mbrojtjen juridiko familjare. Me adoptimin fëmijës i sigurohet zhvillimi në familje me të cilin rast adoptuesi merr rolin e prindit dhe kryen të gjitha të drejtat dhe detyrimet nga e drejta prindërore.

1. Kushtet ligjore për adoptim përkitazi me adoptuesit dhe të adoptuarit

Adoptimi lejohet nëse është i dobishëm për të adoptuarin. Kusht formal për vlefshmërinë e adoptimit është që adoptuesi dhe prindërit, përkatësisht kujdestari i tij, të japin pëlqimin për adoptim. Për adoptimin e të miturit mbi 14 vjet është i nevojshëm edhe pëlqimi i tij. Mund të adoptohet vetëm personi i mitur (neni 174 i LFK) i cili nuk është në gjini në vijën e drejtë me adoptuesin e as vëllai dhe motra e tij (neni 177 i LFK). Ndërsa adoptues mund të jetë vetëm personi që ka zotësinë për të vepruar, që posedon cilësi të nevojshme personale për ushtrimin e të drejtës prindërore dhe që ka arritur moshën 21 vjeçare. Nëse adoptojnë bashkëshort, njëri duhet doemos të ketë arritur moshën 25 vjeç e tjetri 21 vjeç. Ligji shprehimisht përcakton kush nuk mund të jetë adoptues, dhe atë: nëse me vendim gjyqësor i është hequr kujdesi prindëror; nëse me bazë dyshohet se pozitën e adoptuesit do ta përdor në dëm të adoptuarit; nëse e kërkon adoptimin për përfitime materiale apo nuk jap garanci të mjaftueshme për edukimin dhe arsimimin e drejtë të adoptuarit; dhe nëse lëngon nga ndonjë sëmundje shpirtërore ose ndonjë sëmundje tjetër nga e cila do të rrezikohet shëndeti dhe jeta e të adoptuarit.

Përndryshe askush nuk mund të adoptohet nga dy persona, përpos nëse adoptuesit janë bashkëshort.

2. Autoritetet kompetente dhe procedura për adoptim

Adoptimi themelohet sipas procedurës së posaçme të paraparë me ligj. Kompetente për zhvillimin e procedurës dhe për vendosje është gjykata themelore sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimin të adoptuarit. Propozimin e paraqesin bashkërisht prindërit adoptues, të cilit duhet bashkangjitur pëlqimi me shkrim i prindërve natyror të fëmijës, certifikatën e lindjes së fëmijës dhe dokumentet tjera të nevojshme për marrjen e informatave për adoptuesin, të adoptuarin dhe kushtet e adoptimit (neni 182 i LFK). Paraprakisht, këta do të njoftohen nga ana e gjykatës me të drejtat, detyrimet dhe pasojat e adoptimit. Para marrjes së vendimit gjykatë mund të vendosi që i adoptuar të kaloj një kohë në familjen e adoptuesit, më së shumti një 3 muaj (neni 166 i LFK).

Nëse konstatohet se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për adoptim, ose se adoptimi nuk është i dobishëm për të adoptuarin, propozimi për adoptim do të refuzohet (neni 185i LFK).

Pas hetimit të gjithanshëm të çështjes, veçmas pas marrjes edhe të mendimit të sociologut, psikologut, mjekut dhe ekspertëve tjerë, nëse gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore, do të themeloj adoptimin. Me rastin e themelimit të adoptimit duhet të jen të pranishëm adoptuesi, bashkëshorti i tij, prindërit, përkatësisht kujdestari i të adoptuarit si dhe vetë i adoptuari nëse është më i vjetër se 10 vjet.

Me këtë rast mbahet procesverbali ku duhet shënuar të dhënat për të gjitha veprimet e marra, informatat e mbledhura, deklaratat e palëve dhe shpalljen e adoptimit të themeluar. Ai nënshkruhet nga të gjithë personat e pranishëm dhe nga gjyqtari.

Vendimi mbi adoptimin u dorëzohet vetëm palëve të cilat, në pajtim me ligjin, marrin pjesë në procedurë si dhe organit kompetent për regjistrim në librat amzë të lindurve bashkë me procesverbalin për themelimin e adoptimit.

3. Të drejtat dhe detyrimet mes adoptuesit dhe të adoptuarit

Në bazë të nenit 167 të LFK, mes palës adoptuese dhe të adoptuarit themelohen të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve. Në bazë të kësaj dispozite ligjore edhe rrjedhë se gjithë ajo që është parashikuar me këtë ligj lidhur me të drejtat dhe detyrimet mes fëmijëve dhe prindërve vlen edhe për të drejtat dhe detyrimet ndërmjet adoptuesit dhe të adoptuarit. Kësisoj adoptuesi, si prind, përkujdeset dhe administron me pasurinë e të adoptuarit, ndërmerr në emër të të adoptuarit punët juridike, ushtron në tersi kujdesin prindëror me të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuar me ligj. Ndërmjet veti kanë të drejtën dhe detyrimin për ushqim.

Në rastet kur fëmija adoptohet nga bashkëshortet ose nëse bashkëshorti e adopton fëmijën e bashkëshortit tjetër, fëmija i adoptuar fiton statusin ligjor të fëmijës së përbashkët të bashkëshortëve. Në rastet tjera kur nuk adoptohet nga të dy bashkëshortët, i adoptuari e fiton statusin ligjor të fëmijës së prindit adoptues.

4. Shuarja e adoptimit dhe pasojat e shuarjes

Adoptimi shuhet në dy mënyra:

- ex officio,
- me anulim.

Ex officio.- Gjatë kohës sa është i adoptuari i mitur, në bazë të iniciativës së çdo personi, gjykata kompetente do të inicioj, sipas detyrës zyrtare, procedurën për shuarjen e adoptimit të vlefshëm nëse konstaton se këtë e kërkojnë interesat e të adoptuarit të

mitur (neni 198 i LFK). Adoptimi do të shuhet edhe në bazë të kërkesës dhe marrëveshjes së adoptuesit ose të adoptuarit nëse për këtë ekzistojnë shkaqe të arsyeshme.

Në rastet kur kanë adoptuar të dy bashkëshortët, mund të vije deri te shuarja e adoptimit mes fëmijës dhe vetëm njërit nga bashkëshortët, nëse ai pajtohet të merr përsipër kujdesin i cili nuk do të ishte në kundërshtim me mirëqenien e fëmijës.

Anulimi.- Ligji përcakton shprehimisht shkaqet dhe arsyet për të cilat mund të anulohet adoptimi. Edhe për anulimin e adoptimit kompetente është, përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme, edhe ajo sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të adoptuarit. Në bazë të padisë së paraqitur gjykata me aktvendim do të anulohet adoptimin nëse nuk kanë ekzistuar kushtet ligjore për themelimin e tij, para se gjithash nëse nuk ka pasur kërkesë për adoptim nga adoptuesi apo nuk është dhënë pëlqimi për adoptim nga fëmija ose prindi i tij (neni 196 i LFK). Të drejtën në padi e kanë i adoptuari, prindërit e tij, adoptuesi dhe personat tjerë të cilët drejtpërsëdrejti kanë interes juridik për anulimin e adoptimit (nuliteti absolut).

Gjykata mund të anulohet adoptimin nëse ai është themeluar pa pëlqimin e personave i cili është i nevojshëm sipas ligjit, nëse këta persona nuk kanë deklaruar më vonë para organit kompetent se pajtohen me adoptimin, me të cilin rast adoptimi nuk do të anulohet (nuliteti relativ).

Padia për anulimin e adoptimit mundet të paraqitet në afatin subjektiv prej gjashtë muajsh nga dita kur paraqitësi i padisë ka kuptuar për shkaqet e anulimit të adoptimit dhe në afatin objektiv prej një viti nga dita e themelimit të adoptimit. Pas kalimit të afatit prej një viti nuk lejohet paraqitja e padisë.

Pasojat.- Efektet juridike të shuarjes së adoptimit vlejnë nga momenti i shuarjes. Shuarja e adoptimit ka për pasojë ndërprerjen e marrëdhënies së fëmijës dhe pasardhësve të tij me kushërinjtë nga adoptimi bashkë me të drejtat dhe detyrimet e krijuara me adoptim. Me këtë njëherësh përtërihen marrëdhëniet, bashkë me të drejtat dhe detyrimet e të adoptuarit dhe pasardhësve të tij me kushërinjtë natyral. Nëse gjykata e shef të arsyeshme, prindërve biologjik ua kthen kujdesin prindëror ndaj fëmijës.

Sa i përket mbiemrit, me shuarjen e adoptimit, fëmija e humb edhe mbiemrin e adoptuesit, nëse gjykata, me kërkesën e fëmijës, nuk vendos që ai ta mban mbiemrin e fituar me rastin e adoptimit.

XI. KUJDESTARIA

Kuptimi dhe rëndësia e kujdestarisë

Kujdestaria është një nga format e mbrojtjes sociale sipas së cilës bashkësia shoqërore u siguron mbrojtje të veçantë të miturve për të cilët nuk kujdesen prindërit, si dhe personave tjerë të cilët për shkak të paaftësisë ose nga arsyet tjera nuk janë në gjendje të kujdesen vetë dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e veta.

Qëllimi i kujdestarisë është: mbrojtja e plotë e personalitetit; mbrojtja e të drejtave dhe interesave të miturit; dhe mbrojtja e pasurisë së personit të paaftë për punë. Përkitazi me të miturit rëndësia e kujdestarisë është që të miturit t'i mundësojë zhvillimin sa më të mirë të personalitetit të tij, duke e ngritur, edukuar dhe arsimuar si dhe zhvillimin e aftësisë për të bërë jetë të pavarur. Për personat madhor të paaftë qëllimi është mbrojtja e personalitetit të tyre, shërimi dhe aftësimi i tyre për jetë të pavarur. Te të dy kategoritë e më larta sigurohen edhe të drejtat pasurore dhe të drejtat dhe interesat tjera të tyre (neni 215 i LFK).

Kujdestari, kushtet për caktimin, detyrat dhe të drejtat e kujdestarit

Kujdestar caktohet personi i aftë për të kryer detyrat e kujdestarit, pasi që ai paraprakisht të jep pëlqimin për këtë. Kujdestari në radhë të parë caktohet nga mesi i personave në familjen e personit nën kujdestari. Për këtë Organi i Kujdestarisë do të vendosë nëse kjo gjë është në interes të të kujdesurit. Këta persona kanë detyrim të pranojnë këtë detyrë. Nuk janë të detyruar të pranojnë detyrën e kujdestarit personi në gjini gjaku nëse nuk ka mbushur moshën 10 vjeçare; nëse për shkak të sëmundjes ose punës që kryen nuk pritet që drejtë të kryen këtë detyrë: nëse e ushtron detyrën e kujdestarit ndaj dy apo më shumë fëmijëve të huaj; ose nëse ka tre a më shumë formojë të vet të mitur (neni 238 të LFK).

Nuk mund të caktohet për kujdestar personi:

- të cilit i është hequr e drejta prindërore,
- të cilit i është hequr aftësia për të vepruar,
- interesat e të cilit janë në konflikt të dukshëm me interesat e personit që do të vendoset nën kujdestari,
- për të cilin, nga arsyet tjera, nuk pritet të ushtron me sukses këtë detyrë.

Detyrat e kujdestarit në vëllimin e caktuar të autorizimeve mund t'i besohen edhe personit shoqëroro juridik, e këtë detyrë mund ta kryen edhe vetë Organi i Kujdestarisë.

Me aktvendimin me të cilin caktohet kujdestari caktohen edhe detyrat dhe vëllimi i autorizimeve të tij.

Kujdestari posaçërisht ka për detyrë të kujdeset për personalitetin, të drejtat dhe interesat e personit që është vënë nën kujdestari, të administroj me kujdes me pasurinë e tij, ta informoj Organin e Kujdestarisë për kryerjen e këtyre detyrave dhe të kujdeset për sigurimin e mjeteve materiale të nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrave. Përpos kësaj kujdestari e përfaqëson të kujdesurin dhe në emër dhe në llogari të tij ndërmerr veprime në mënyrë të pavarur lidhur me administrimin e pasurisë së tij. Përndryshe vetëm me lejen e Organit të Kujdestarisë mund të ndërmerr veprime me të cilat ngarkohet ose tjetërsohet pasuria e paluajtshme e të kujdesurit siç janë: tjetërsimi i pasurisë së luajtshme me vlerë më të madhe; heqja dorë nga trashëgimia, nga legu ose ta refuzojë dhurimin ose të ndërmerr masa tjera të përcaktuara me ligj.

Në rregull kujdestari i kryen detyrat e veta pa shpërblim, e ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve të arsyeshme të bëra gjatë kryerjes së punëve të kujdestarit.

1. Kujdestaria ndaj të miturve

Kujdestari i caktohet të miturit i cili nuk është nën kujdesin prindëror. Ai ka për detyrë të kujdeset për shëndetin, edukimin, arsimimin dhe për aftësimin e tij për jetë të pavarur (neni 216 i LFK). Nëse i mituri i ka mbushur 14 vjet, mund të ndërmerr vetë veprime juridike, e nëse ato janë me rëndësi më të madhe për vlefshmërinë e tyre nevojitet leja e kujdestarit të tij, ose të Organit të Kujdestarisë. Nëse i mituri nën kujdestari ka krijuar marrëdhënie pune, ai mund të disponoj me të ardhurat personale dhe ka detyrim edhe të kontribuoj për ushqimin, arsimimin dhe aftësimin e vetë.

Kujdestari, pa lejen e Organit të Kujdestarisë, nuk mundet:

- t'ia besojë të miturin për ruajtje, edukim arsimim dhe kujdes shtëpisë së fëmijëve bonjak, ndonjë organizate tjetër ose ndonjë personi tjetër, apo ta vendos të miturin për një kohë më të gjatë për mjekim në ndonjë organizatë shëndetësore,
- t'ia ndërpres shkollimin ose t'ia ndërroj shkollën të miturit,
- të vendos për profesionin e të miturit,
- të marrë masa tjera të rëndësishme përkitazi me personalitetin dhe interesat e të miturit.

Kujdestaria ndaj të miturit pushon: me arritjen e moshës madhore të të miturit; me lidhjen e martesës para moshës madhore; me adoptim dhe me kthimin e kujdesit prindëror prindit të tij.

2. Kujdestaria ndaj personave të cilëve u është hequr zotësia për të vepruar

Me vendim të gjykatës në procedurën jokontestimore personave madhor mund t'iu hiqet në tërësi ose vetëm pjesërisht zotësia për të vepruar. Në tërësi u hiqet zotësia për të vepruar personave të cilët (për shkak të sëmundjes shpirtërore apo ndonjë arsye tjetër)

nuk janë në gjendje të kujdesen plotësisht për të drejtat dhe interesat e veta. Ndërsa personat të cilët, nga arsytet e cekura mësipërm ose nga arsytet tjera, me veprimet e veta rrezikojnë të drejtat dhe interesat e veta apo të tjerëve, zotësia për të vepruar u hiqet pjesërisht.

Personat të cilëve me vendim të gjykatës pjesërisht ose plotësisht u është hequr zotësia për të vepruar, pas marrjes së vendimit nga gjykata, Organi i Kujdestarisë, brenda 30 dite, u cakton kujdestarin.

Ky kujdestar posaçërisht kujdeset që i kujdesuri të aftësohet për jetë të pavarur, duke evituar shkaqet për të cilat i është hequr zotësia për të vepruar.

Kujdestari i personit që i është hequr plotësisht zotësia për të vepruar ka detyrat dhe të drejtat e kujdestarit të personit të mitur që nuk ka mbushur 14 vjet, ndërsa kujdestari i personit që i është hequr pjesërisht zotësia për të vepruar ka detyrat dhe të drejtat e kujdestarit të personit mbi 14 vjet.

Me iniciimin e procedurës për heqjen e zotësisë për të vepruar, gjykata duhet ta njoftoj për këtë Organin e Kujdestarisë. Nëse e shef të arsyeshme ai mundet menjëherë, me masë të përkohshme, ati t'i caktoj kujdestarin e përkohshëm, detyra e të cilit zgjat deri në caktimin e kujdestarit të përhershëm.

3. Kujdestarët për raste të veçanta

Kujdestari për raste të veçanta caktohet nga ana e gjyqit, Organit të Kujdestarisë ose organit tjetër i cili e zhvillon procedurën, me qëllim që të ndërmer veprimet e caktuara në emër të personit vendbanimi, përkatësisht vendqëndrimi i te cilit nuk dihet, në emër të pronarit të panjohur të pasurisë nëse është e nevojshme që dikush të kujdeset për atë pasuri, si dhe në rastet tjera me qëllim të mbrojtjes së të drejtave dhe interesave të personave të caktuar. Organi i cili ka marr këtë vendim duhet pa vonesë ta njoftoj për këtë Organin e Kujdestarisë.

Kujdestari për raste të veçanta i caktohet edhe personit ndaj të cilit prindërit e ushtrojnë të drejtën prindërore, ose i cili është nën kujdestari, për zhvillimin e kontestit, për ndërmarrjen e veprimeve juridike ndërmjet tij dhe prindit përkatësisht kujdestarit, si dhe në rastet tjera nëse interesat ndërmjet tyre janë të kundërta.

4. Shkarkimi i kujdestarit nga detyra

Organi i Kujdestarisë sipas detyrës zyrtare pa vonesë do ta shkarkoj kujdestarin nëse kupton se po i keqpërdor autorizimet, nëse rrezikon interesat e të kujdesurit ose nëse paraqitet ndonjëra nga rrethanat për shkak të së cilës nuk mund të jetë kujdestar. Organi i Kujdestarisë do ta shkarkoj kujdestarin nga detyra brenda afatit prej 30 ditësh nëse kupton se është i pakujdesshëm në kryerjen e autorizimeve, apo nëse konsideron se për të kujdesurin do të ishte e dobishme që t'i caktohet kujdestari tjetër.

Organi i Kujdestarisë do ta shkarkojë kujdestarin nga detyra, kur kujdestari kërkon këtë, më së voni brenda tre muajve nga dita e paraqitjes së kërkesë.

Me rastin e shkarkimit nga detyra të kujdestarit, Organi i Kujdestarisë posaçërisht kujdeset për mbrojtjen e pasurisë së të kujdesurit, duke bërë regjistrimin dhe vlerësimin e saj dhe dorëzimin kujdestarit të ri.

XII. DETYRIMI LIGJOR PËR USHQIM

E drejta, përkatësisht detyrimi në ushqim, është një marrëdhënie juridike sipas së cilës një person ka detyrim t'i paguan tjetrit, në para apo në natyrë, me qëllim të plotësimit të nevojave të tij të domosdoshme për jetë. Kjo nënkupton sigurimin e ekzistencës dhe mundësimin e zhvillimit të drejtë të personalitetit, siç janë shpenzimet për ushqim, veshmbathje, banim, nxehe, mbajtje të higjienës, në rast sëmurje – shërimi, e kur janë në pyetje të miturit edhe shpenzimet për arsimim dhe edukim.

Detyrimi për ushqim rrjedhë në bazë të kontratës (kontrata për ushqimin e përjetshëm), në bazë të legatit, nga delikti në bazë të fajësisë, ose në bazë të ligjit. Edhe për rastet tjera të detyrimit në ushqim, e drejta përkatësisht detyrimi për ushqim është i parashikuar dhe i rregulluar me ligj, mirëpo paraprakisht duhet ndërmarr një veprim tjetër juridik për të ekzistuar kjo e drejtë, përkatësisht detyrim. Ndërsa e drejta, përkatësisht detyrimi për ushqim ligjor rrjedh nga ligji pa ndërmarr ndonjë veprim tjetër juridik paraprakisht. Duke pasur parasysh faktin se në esencë të detyrimit ligjor për ushqim gjithnjë ndodhen marrëdhëniet familjare, kjo e drejtë, përkatësisht detyrim, është rregulluar me Ligjin e Familjes, në pjesën e tetë, nga neni 278 përfundimisht me nenin 336.

1. Detyrimi ligjor për ushqim mes bashkëshortëve

Bashkëshorti ka të drejtë në ushqim nga bashkëshorti tjetër:

- nëse nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim,
- nëse është i paaftë për punë ose nuk mund të punësohet,
- nëse bashkëshorti tjetër është në gjendje të jep ushqimin.

Edhe nëse plotësohen kushtet e mësipërme, gjykata mund të refuzoj kërkesën për ushqim nëse atë e kërkon bashkëshorti i cili me qëllim të keq apo pa ndonjë shkak të arsyeshëm e ka braktisur bashkëshortin dhe jetën e përbashkët (neni 298 i LFK).

Në rregull kërkesa për ushqim duhet paraqitur gjatë kontestit martesor. Përjashtimisht mundë të paraqitet në kontestin e ndarë, pas ndarjes, deri sa bashkëshorti kujdeset dhe e mban fëmijën e përbashkët, për të cilën arsye edhe nuk është në gjendje të punoj, ose këtë nuk është në gjendje ta bëjë për shkak të sëmundjes. Në rregull ushqimi ndërmjet bashkëshortëve caktohet me marrëveshje, e nëse nuk mund të arrihet marrëveshja, me vendim të gjykatës.

Bashkëshorti i cili nuk ka, kërkuar ushqimin në kontestin martesor ai mund ta bën këtë në kontest të ndarë brenda afatit prej 2 vjetësh, pas zgjidhjes së martesës, me kusht që prezumimet për ushqim të jenë krijuar para zgjidhjes së martesës dhe të kenë

vazhduar gjer në mbylljen e seancës gjyqësore të kontestit për ushqimi. Afati fillon të rrjedhë nga dita kur aktgjykimi për zgjidhjen e martesës merr formë të prerë.

Nëse bashkëshortët janë marr vesh për ushqim jashtë procedurës gjyqësore, ose njëri nga bashkëshortët pa marrëveshje të bërë shprehimisht ka marr pjesë në ushqimin e bashkëshortit tjetër në ndonjë mënyrë, për të cilën arsye bashkëshorti i cili ka marrë ushqim nuk ka paraqitur kërkesë për ushqim në kontestin martesor, nëse në ndërkohë pas shkurorëzimit ndërpres të jep ushqimin, afati për paraqitjen e kërkesës për bashkëshortin që ka marr ushqimin në këtë mënyrë llogaritet nga data kur është bërë dhënia e fundit në emër të ushqimit.

Pavarësisht nga fakti që janë plotësuar kushtet e mësipërme për të pasur të drejtë në ushqim, gjykata mund ta refuzoj kërkesën në rast se: a) ushqimin e kërkon bashkëshorti i cili, pa ndonjë shkak serioz nga bashkëshorti tjetër, është sjell në mënyrë të vrazhdë ose të padenjë në bashkësinë martesore, ashtu që kërkesa do të paraqiste padrejtësi të hapët për bashkëshortin tjetër; b) bashkësia faktike e jetës mes bashkëshortëve është ndërpre dhe vite me radhë kanë jetuar në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri dhe kanë siguruar mjete për ushqim për vete deri në shkurorëzim dhe c) paditësi me qëllim shkakton nevojshmërinë për ushqim.

Në rregull ushqimi caktohet në kohë të pacaktuar. Përgjithimisht mund të caktohet për një afat nëse kërkuesi i ushqimit ka mundësi për një kohë të shkurtër, në ndonjë mënyrë tjetër, të sigurojë mjetet për ushqim, ose nëse martesa ka zgjatur një kohë të shkurtër (neni 312 i LFK). Gjykata mund të vendos që ushqimi në kohë të caktuar të vazhdohet edhe për një kohë tjetër të caktuar apo në kohë të pacaktuar. Kërkesa duhet paraqitur para kalimit të afatit për të cilin është caktuar ushqimi.

E drejta në ushqim e bashkëshortit të shkurorëzuar pushon nëse pushojnë kushtet ligjore për ushqim; pas kalimit të afatit për të cilin është caktuar dhe atëherë kur shfrytëzuesi i ushqimit lidhë martesë ose themelon bashkësi jashtëmartesore apo vdes (neni 312 i LFK).

2. Detyrimi ligjor për ushqim mes prindërve dhe fëmijëve

Ajo që është detyrim për prindërit ndaj fëmijëve përfaqëson të drejtë të fëmijëve nga prindërit dhe anasjelltas. Kësisoj fëmijët kanë të drejtë të kërkojnë nga prindërit e tyre që ata t'i ruajnë, ushqejnë, edukojnë, arsimojnë sipas mundësive që kanë, t'i përfaqësojnë përkritazi me të drejtat dhe interesat e tyre dhe të administrojnë me pasurinë e tyre.

Ushqimi i fëmijëve është detyrim i natyrës pasurore. Prindërit janë të detyruar të ushqejnë fëmijët e tyre të mitur, e nëse janë në shkollim deri në moshën 26 vjeçare. Nëse fëmija madhor, për shkak të sëmundjes apo të metave shpirtërore, është i paaftë për punë, nuk ka mjete të mjaftueshme për jetë, apo nuk mund këtë ta realizoj nga pasuria e vetë ekzistuese, prindërit kanë detyrim t'i ushqejnë ata deri sa të zgjas kjo gjendje (neni 291 i LFK). Rrethana se prindi është privuar nga e drejta prindërore nuk e liron atë nga detyrimi që të ushqen fëmijën e vetë.

Ushqimi i fëmijëve është detyrim i përbashkët i prindërve, pavarësisht nëse jetojnë bashkë apo jo. Në ushqimin e fëmijëve prindërit marrin pjesë në përpjesëtim me mundësitë që kanë. Ky problem nuk paraqitet deri sa prindërit jetojnë bashkë. Nëse prindërit jetojnë ndaras detyrimi për ushqim i tyre caktohet sipas nevojave të fëmijëve e në përpjesëtim me mundësitë e çdonjërit prind. Prindërit nuk mund të heqin dorë apo në çfarëdo mënyre të lirohen nga ky detyrim.

Në kontestin martesor, me aktgjykimin me të cilin zgjidhet martesë gjykata, sipas detyrës zyrtare, vendos edhe për ushqimin e fëmijëve të mitur. Vendimi për ushqim i marr në këtë kontest mundet më vonë, në procedurë të zhvilluar në gjykatën themelore, për shkak të ndryshimit të rrethanave, sipas padisë së të miturit, i përfaqësuar nga prindi, të ndryshohet.

Fëmijët kanë detyrim moral që të kujdesen për prindërit e tyre. Përpos aspektit moral, sipas ligjit fëmijët madhor kanë detyrim të marrin pjesë në ushqimin e prindërve të tyre (neni 294 i LFK). Këtë detyrim e ka edhe fëmija i cili ka mbushur 15 vjet nëse realizon të ardhura nga puna. Detyrimi i fëmijëve të ushqejnë prindërit e tyre qëndron pavarësisht nëse kanë kontribuar prindërit në ushqimin e tyre apo jo. Përfundimisht gjykata mund të refuzojë kërkesën e prindit për ushqim nëse këtë e kërkon prindi i cili është privuar nga e drejta prindërore dhe nuk e ka ushqyer fëmijën edhe pse ka pasur mundësi ta bënë këtë. Detyrimi i fëmijëve për ushqimin e prindërve ekziston vetëm nëse prindi është i paaftë për punë dhe nuk ka mjete të mjaftueshme për ushqim, apo nuk mund të realizojë mjete të mjaftueshme nga pasuria që ka, ndërsa fëmija ka mundësi të kontribuojë në ushqimin e tij. Ky detyrim zgjat deri në vdekjen e prindit ose deri sa gjendja ekonomike e tij nuk përmirësohet në atë masë që mos të ketë nevojë për ushqim nga tjetri.

3. Detyrimi ligjor për ushqim mes personave tjerë në gjini

Detyrimi i ushqimit ekziston edhe mes personave tjerë në gjini në vijën e drejtë ngjithëse dhe zbritëse, pavarësisht në cilën shkallë janë. E drejta në ushqim nga personat në gjini të gjakut realizohet sipas asaj radhe që kanë të drejtë në trashëgimi. Në rastet kur disa persona kanë detyrim për ushqim, detyrimi i ushqimit nga ata caktohet sipas mundësive të secilit prej tyre.

Përpos mes prindërve dhe fëmijëve, ligji parasheh detyrimin në ushqim edhe ndërmjet personave tjerë në gjini. Sipas LFK vëllezërit dhe motrat kanë detyrim të ushqejnë vëllezërit dhe motrat e tyre të mitur të cilët nuk kanë mjete për ushqim, nëse prindërit e tyre nuk janë gjallë ose janë gjallë por nuk kanë mundësi ta bëjnë këtë. Kësisoj detyrimi në ushqim ndaj vëllezërve dhe motrave të mitur është kushtëzuar me pamundësinë për ushqim nga ana e prindërve.

LFK parasheh edhe të drejtën dhe detyrimin për ushqim të njerkes dhe njerkut ndaj thjeshtërit të tyre të mitur dhe anasjelltas (neni 295 dhe 296 i LFK).

Njerku dhe njerka kanë detyrim të ushqejnë thjeshtërit e tyre të mitur nëse këta nuk kanë të afërm të cilët sipas ligjit kanë detyrim t'i ushqejnë, ose nëse ata nuk kanë

mundësi ta bëjnë këtë. Njerku dhe njerka kanë këtë detyrim edhe pas vdekjes së prindit të thjeshtërit të mitur me të cilin njerku apo njerka kanë qenë në martesë, nëse deri në vdekjen e saj (tij) ka ekzistuar bashkësia familjare. Kjo e drejtë pushon nëse martesë mes prindit dhe njerkes apo njerkut shkurorezohet apo anulohet.

Njëherësh edhe thjeshtërit kanë detyrim për ushqimin e njerkes dhe njerkut, nëse këta i kanë ushqyer dhe janë kujdesur për ta. Nëse njerku apo njerka kanë fëmijë, ky detyrim është i përbashkët me ata fëmijë.

4. Format e dhënies së ushqimit ligjor

Edhe pse pjesa e ligjit me të cilën rregullohet e drejta, përkatësisht detyrimi, në ushqim është titulluar **MBAJTJA FINANCIARE**, në nenin e parë të kësaj pjese të ligjit (278 i LFK) konstatohet se kjo nënkupton detyrimin **financiar** dhe **material**, nga edhe rrjedh se ushqimi mund të jepet në të holla ose në natyrë. Në këtë mënyrë me kontributin për ushqim nuk nënkuptohet vetëm pagesa e shumës së caktuar e të hollave por edhe të gjitha vlerat tjera pasurore të ushqimdhënësit të cilat i realizon ushqimëmarrësi për ushqim.

Dhënia e ushqimit zakonisht është në para. Nëse në një rast konkret, në një moment të caktuar, duhet zëvendësuar detyrimin për ushqim në të holla me ndonjë formë tjetër, për këtë duhet të vendoset me vendim të gjykatës.

Përkritazi me detyrimin financiar të dhënies së ushqimit nuk ka nevojë për ndonjë sqarim të posaçëm, pasi kjo nënkupton pagesën e shumës së caktuar të parasë për ushqim. Mirëpo, detyrimi material për ushqim si një nga format e ushqimit ligjor, mund të jetë i shumëllojshëm. Kësisoj kjo mund të ndodhë në rastet kur ushqimdhënësi e merr në familje të vetë dhe aty kujdeset për ushqimëmarrsin, nëse ia le në shfrytëzim sipërfaqen e caktuar banesore, ia le në shfrytëzim sipërfaqen e caktuar të tokës bujqësore, lokalit afarist ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Duke u nisur nga dispozita e nenit 278 të LFK, në pjesën lidhur me parimet për ushqim, rrjedh se parimisht ushqimi mund të jepet në para ose në natyrë. Mirëpo, dhënia e detyrimit në natyrë vjen në shprehje zakonisht të ushqimi i bashkëshortit ose ushqimi i prindërve nga fëmijët. Kjo formë e ushqimit nuk është e mundur të detyrimet e prindërve ndaj fëmijëve. Në këtë mënyrë detyrimi i prindit për dhënie e kontributit për ushqimin e fëmijës mund të jetë vetëm në para, nga edhe prindi nuk e ka të drejtën e zgjedhjes të formës tjetër të ushqimit.

Për personat në gjini të gjakut detyrimi për ushqim caktohet sipas radhës me të cilën thirren në trashëgimi. Nëse detyrimi për ushqim ekziston mes disa të afërmeve, këtë detyrim e kanë më para pasardhësit e pastaj të afërmit nga vija e paraardhësve (282 të LFK).

Nga të paraqiturat e mësipërme rrjedh se paditës në procedurën e filluar për ushqim ligjor është personi i cili, sipas ligjit, ka të drejtë në ushqim, ose përfaqësuesi i tij, si dhe Organi i Kujdestarisë (326 i LFK), ndërsa të paditur janë personat të cilët, sipas ligjit, kanë detyrim për ushqim. Si të paditur mund të na paraqiten disa persona të të njëjtës radhë me detyrim për ushqim, apo të radhëve të ndryshme.

5. Caktimi i lartësisë së detyrimit për ushqim ligjor

Në kontestin për ushqim gjykata duhet të caktoj shumën e përgjithshme të mjeteve për ushqim. Caktimi i nevojave të përgjithshme për ushqim është me rëndësi nga se në rastet kur i padituri nuk ka mundësi të përmbush ato nevoja, gjykata e njofton për këtë Organin e Kujdestarisë i cili mund ta zgjeroj padinë duke përfshirë persona të tjerë të cilët sipas radhës në bazë të ligjit e kanë këtë detyrim. Nëse edhe kjo nuk mjafton Organi i Kujdestarisë ndërmer masat tjera të nevojshme (332 i LFK).

Lartësia e ushqimit caktohet në përpjesëtim me mundësitë e personit që duhet të jep ushqimin, e brenda kufijve të nevojave të kërkuarit të ushqimit. Për çdo rast konkret gjykata duhet të vlerësoj nevojat e kërkuarit të ushqimit, gjithmonë duke pasur parasysh gjendjen e tij pasurore dhe financiare, zotësinë për të punuar, mundësin faktike për punësim, gjendjen shëndetësore, nevojat personale dhe rrethanat tjera me ndikim për caktimin e ushqimit. Kësisoj, si bashkëshort i pasiguar konsiderohet edhe bashkëshorti i punësuar të ardhurat personale të të cilit nuk i mjaftojnë për përmbushjen e nevojave për të jetuar, andaj edhe mund të kërkon ushqim plotësues. Në anën tjetër, bashkëshorti i cili, pas shkëputjes së bashkësisë martesore, ka hequr dorë nga pjesa e vetë e trashëgimisë, nga të ardhurat e së cilës ka mundur të jetoj, nuk ka të drejtë në ushqim nga bashkëshorti tjetër. Në të njëjtën mënyrë nuk do të kishte të drejtë në ushqim edhe personi i cili e ndërpre, pa ndonjë arsye, marrëdhënien e punës dhe e sjell veten në situatë pa mjete për ushqim. Në rastet kur kërkohet ushqimi për fëmijën e mitur me ndikim është edhe moshë e fëmijës dhe nevoja për edukim dhe arsimim profesional të tij (330.3 i LFK).

Sa i përket vlerësimit të mundësive të personit nga i cili kërkohet ushqimi, gjykata duhet pasur parasysh të gjitha të ardhurat që realizon ai, si ato të rregullta ashtu edhe ato periodike (p.sh. të ardhurat nga bujqësia, honorari i autorit, të ardhurat nga puna në teren, etj.). Në anën tjetër në mënyrë të njëjtë duhet vlerësuar edhe zvogëlimin eventual të të ardhurave si p.sh. për shkak të sëmurjes së përkohshme, pushimit mjekësor, etj. Për t'i ikur detyrimit ose me qëllim që ai të jetë sa më i ulët, personi nga i cili kërkohet ushqimi mund të shërbehet edhe me keqpërdorime të ndryshme si p.sh. duke zvogëluar të ardhurat e veta në kohën e zhvillimit të procedurës. Nga kjo arsye gjykata duhet vlerësuar mundësitë për ushqim jo vetëm në momentin e vendosjes për ushqimin, por për një kohë më të gjatë, zakonisht brenda një viti.

Ma rastin e vlerësimit të mundësive për të kontribuar në ushqimin e fëmijëve, gjykata do të vlerësoj edhe mundësitë reale për realizimin e fitimit nga personi nga i cili kërkohet ushqimi, nevojat e tij vetanake dhe detyrimet tjera për ushqim që ka. Kjo nënkupton se prindit kanë detyrim të kontribuojnë për ushqimin e fëmijëve edhe nëse rrezikojnë mjetet e tyre financiare, përkatësisht në dëm të vetin (280.2 i LFK).

Me rastin e caktimi të lartësisë së kontributit për mbajtje, nga të ardhurat e përgjithshme të personit i cili ka detyrim të kontribuon për ushqim, zakonisht në praktik llogaritet se 50% të të ardhurave ky person i shpenzon për nevoja personale, nëse duhet të kontribuon për ushqimin e më shumë fëmijëve duhet llogaritur 1/3 e të ardhurave për nevoja personale, ashtu shpenzimet tjera të ndahen për ushqim të personave tjerë,

nëse ka këtë detyrim, dhe pastaj pjesa tjetër caktohet për ushqimin e kërkuar, gjithmonë duke pasur parasysh edhe nevojat e personit i cili kërkon ushqimin. Duke u nisur nga rregulla se lartësia e kontributit për ushqimin e fëmijës varet nga mundësitë ekonomike të prindit në një anë dhe nevojave të fëmijës në anën tjetër, nuk mund të detyrohet prindi të paguan në emër të pjesës së kontributit të tij për ushqimin e fëmijës, më tepër se sa realisht janë nevojat e fëmijës, edhe nëse ai prind ka mundësi të jep ushqimin në atë lartësi. Në kontestet për ushqimin e fëmijëve, si kontribut për prindin që i është besuar fëmija, gjykata e merr edhe punën dhe përkujdesjen e tij të përditshme ndaj fëmijës.

E drejta për ushqim paraqitet dhe pushon me paraqitjen, përkatësisht pushimin e kushteve të parapara ligjore e jo në bazë të vendimit gjyqësor, që nënkupton se vendimi gjyqësor, në kontestet për ushqim, ka karakter deklarativ e jo konstituiv. Në këtë mënyrë qëllimi i kontributit për ushqim është plotësimi i nevojave për jetë të kërkuarit të ushqimit, nga momenti i paraqitjes së kërkesës në të ardhmen. Nga kjo edhe në asnjë mënyrë nuk mund të kërkohej ushqimi për kohën e kaluar por vetëm për të ardhmen.

6. Kompetenca lëndore dhe vendore e gjykatave për vendosje lidhur me ushqim

Sa i përket kompetencës lëndore, lidhur me kërkesat për ushqim ligjor, në shkallë të parë vendoset nga ana e gjykatës themelore. Në rastet kur vendoset përkritazi me anulimin apo shkurorezimin e martesës, e njëjta gjykatë, me të njëjtin aktgjykim, duke vendosur sipas detyrës zyrtare, do të vendos edhe për ushqimin e fëmijëve të mitur, ndërsa për ushqimin e bashkëshortit ajo do të vendos vetëm nëse është paraqitur kërkesa e këtillë në kontestin martesor.

Sa i përket kompetencës vendore, me rastin e vendosje për ushqimin ligjor jashtë kontestit martesor, pos gjykatës e cila e ka kompetencën e përgjithshme, kompetente është edhe gjykata sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të paditësit.

Për ushqimin e fëmijëve gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kësisoj, në kontestin martesor, me rastin e vendosjes për ushqimin e fëmijëve të mitur sipas kërkesës së tyre, detyrimi për ushqim duhet caktuar nga dita e paraqitjes së kërkesës, e nëse vendos zyrtarisht pa kërkesë, nga data e marrjes së aktgjykimit. Për kohën para paraqitjes së kërkesës, pjesa e shpenzimeve në përpjesëtim me mundësit e prindit tjetër, mund të kërkohej me padi në një procedurë tjetër.

Dispozitat ligjore përkritazi me ushqimin ligjor janë të karakterit imperativ, andaj edhe në kontestet e këtilla nuk mund të merret aktgjykimi në bazë të pranimit. Njëherësh, çfarëdo marrëveshje e arritur mes prindërve lidhur me ushqimin e fëmijëve të mitur nuk e obligon gjykatën, ashtu që edhe në rast të marrëveshjes mes prindërve, gjykata mund të heton rrethanat për të vendosur lidhur me ushqimin e fëmijës, dhe atë do ta pranoj vetëm nëse ajo është në harmoni me dispozitat e LFK përkritazi me caktimin e ushqimit.

Vendimi i gjykatës përkritazi me ushqimin është me karakter të përkohshëm nga se, personi me të drejtë ose ai me detyrim ushqimi, mundet të paraqet padi në gjykatën kompetente, me kërkesë që ushqimi i caktuar me vendim të mëparshëm gjyqësor, për shkak të ndryshimit të rrethanave në bazë të cilave është vendosur, të ndryshohet

ashtu që ai të ndërpritet, shtohet ose zvogëlohet, ose të ndryshohet forma dhe mënyra e dhënies së ushqimit (331 i LFK). Ndryshimi i rrethanave hetohet përkitazi me nevojat personale dhe rritjen e shpenzimeve të jetës të ushqimëmarrësit dhe statusit financiar të ushqimëdhënësit. Me qëllim të vërtetimit nëse janë ndryshuar apo jo rrethanat, gjykata do të krahason gjendjen në kohën e paraqitjes së kërkesës së fundit për ndryshimin e vendimit për ushqim me gjendjen në kohën e marrjes së vendimit ndryshimi të cilit kërkohet. Rritja apo zvogëlimi i kontributit për ushqim, për shkak të ndryshimit të rrethanave në bazë të të cilave është vendosur më para, mund të kërkohet vetëm për kohën e ardhshme, e jo edhe për atë të kaluar.

XIII. MARRËDHËNIET PASURORE TË ANËTARËVE TË BASHKËSISË FAMILJARE

Sipas ligjit në fuqi, bashkësinë familjare e përbëjnë bashkëshortët dhe familja e tyre e ngushtë. Anëtarë të familjes së ngushtë janë fëmijët dhe prindërit e bashkëshortëve. Duke pasur parasysh faktin se në mjaftë familje kosovare, përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve dhe prindërve të tyre, në bashkësi familjare jetojnë edhe persona tjerë, të cilët edhe bashkërisht punojnë, krijojnë, administrojnë dhe mundë të disponojnë pasurinë e krijuar në atë bashkësi familjare, me ligj janë rregulluar edhe marrëdhëniet pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare (pjesa e shtatë e LFK - nga neni 271 – 277). Në këtë mënyrë edhe gjithë pasuria e fituar gjatë ekzistimit të bashkësisë familjare konsiderohet pasuri e përbashkët e të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare të cilët kanë kontribuar në fitimin e saj. Me ligj nuk është përcaktuar ndonjë minimum i moshës për tu fituar statusi i pronarit të pasurisë së përbashkët, nga vetë fakti se kjo është një çështje faktike dhe varet nga rasti konkret, ashtu që ekziston mundësia që edhe personat nën moshën 15 vjeçare të kontribuojnë në fitimin e pasurisë së përbashkët.

1. Administrimi i pasurisë së përbashkët

Me pasurinë e përbashkët të bashkësisë familjare administrojnë dhe disponojnë bashkërisht, me marrëveshje, anëtarët e bashkësisë familjare të cilët kanë kontribuar në fitimin e saj, nëse kjo nuk i është besuar me marrëveshje një apo më shumë anëtarëve të bashkësisë familjare. Nëse nuk mundet të arrihet marrëveshja, sipas propozimit të ndonjërit nga pronarët e përbashkët, lidhur me këtë do të vendosë gjykata themelore në procedurën jokontestimore.

E drejta në pronën e paluajtshme të përbashkët e anëtarëve të bashkësisë familjare regjistrohet në librat publike për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në regjistrat e tokës, ku edhe ata do të figuronin si pronar të përbashkët të asaj paluajtshmërie. Në të shumtën e rasteve kjo nuk ndodh, pasi që ajo zakonisht regjistrohet në emër vetëm të njërit nga anëtarët e bashkësisë familjare, zakonisht në emër të kryefamiljarit. Në rastet e këtylla, statusi juridik i pronës së përbashkët mund të ndryshohet me një propozim të

përbashkët të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare të cilët kanë kontribuar në fitimin e saj.

Nëse anëtari i bashkësisë familjare në emër të të cilit evidentohet pasuria e paluajtshme e bashkësisë familjare e tjetëron, apo në ndonjë mënyrë e ngarkon atë, anëtarët tjerë të bashkësisë familjare mundin ta kundërshtojnë kontratën me të cilën është bërë kjo, nëse në regjistër ka pasur fakte për pronësinë e përbashkët, apo nëse pala tjetër kontraktuese ka ditur apo ka mundur të dijë se ajo paluajtshmëri ka qenë pasuri e përbashkët e anëtarëve të bashkësisë familjare. Përndryshe, në rastet e këtylla, anëtarët tjerë të bashkësisë familjare gjithsesi kanë të drejtë në shpërblim në para të pjesës së tyre (neni 274 i LFK).

Përkritazi me administrimin e pasurisë së përbashkët të anëtarëve të familjes, në mënyrë analoge zbatohen rregullat përkritazi me marrëdhëniet pasurore mes bashkëshortëve.

2. Marrëveshjet kontraktuese mes anëtarëve të pasurisë së përbashkët

Anëtarët e bashkësisë familjare mundin me marrëveshje të rregullojnë marrëdhëniet reciproke pasurore. Kontrata me të cilën rregullohen këto marrëdhënie duhet të jetë me shkrim dhe të përfshijë të gjithë anëtarët që kanë kontribuar në fitimin e saj. Ajo duhet vërtetuar në gjykatë nga ana e gjyqtarit, pasi të lexohet nga gjyqtari dhe tu tërhiqet vërejtja palëve përkritazi me pasojat e kontratës. Nëse pronar i pasurisë së përbashkët është personi i mitur, para vërtetimit të kontratës gjykata do të kërkojë mendimin për këtë nga Organi i Kujdestarisë.

Përndryshe, nëse ndryshe nuk është parashikuar me Ligjin e Familjes, në marrëdhëniet pasurore të anëtarëve të bashkësisë familjare zbatohen rregullat e përgjithshme të drejtës pasurore.

MBROJTJA KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE

1. Dhuna në familje sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje¹⁵

Marrëdhëniet shoqërore, ekonomike dhe juridike në martesë dhe familje janë të rregulluara me ligj. Qëllimi i intervenimit shoqëror në marrëdhëniet martesore dhe familjare është mbrojtja e familjes, që nënkupton ndërmarrjen e masave të ndryshme, qëllimi i përbashkët i të cilave është që t'i sigurohet asaj kryerja e funksioneve shoqërore, posaçërisht për ngritjen, kujdesin, arsimimin dhe aftësimin e fëmijëve dhe në dhënien e ndihmës anëtarëve të familjes të cilët nuk janë në gjendje të kujdesen për vetë.

¹⁵ Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Ligji nr. 03/L-182 i dt. 01.07.2010,

Ndodhë që anëtarë i familjes në ndonjë mënyrë të keqtrajtohet nga ndonjëri nga anëtarët tjerë të familjes, andaj edhe me qëllim të mbrojtjes ligjore efektive dhe mundësisë së përdorimit të mekanizmave ndihmës për viktimat e dhunës në familje, është nxjerr Ligji i veçantë – Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. Më parë kjo çështje ishte e rregulluar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2003/12/, të dt. 07.05.2003.

Dhuna në familje sipas ligjit nënkupton një ose më shumë vepra apo lëshime të qëllimshme që i bën një person personit tjetër me të cilin është ose ka qenë në marrëdhënie familjare si këto, por nuk kufizohet në: 1. përdorimin e forcës fizike ose presionin psikik të ushtruar ndaj anëtarit tjetër të familjes; 2. çdo veprim tjetër i një anëtarë të familjes që mund të shkaktojë apo kanos, se do të shkaktojë dhembje fizike dhe vuajtje psikike; 3. shkaktimi i ndjenjës së frikës, rrezikshmërisë personale apo cenimin e dinjitetit; 4. sulmi fizik pa marrë parasysh pasojat; 5. ofendimi, sharja, thirrja me emra ofendues dhe mënyra të tjera të shqetësimit të vrazhdë; 6. përsëritja e vazhdueshme e sjelljeve me qëllim të përluljes së personit tjetër; 7. marrëdhënia seksuale pa pëlqim dhe keqtrajtimi seksual; 8. kufizimi i kundërligjshëm i lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër; 9. dëmtimi apo shkatërrimi i pasurisë dhe kanosja që ta bëjë këtë; 10. vënia e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike; 11. hyrja apo largimi me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër dhe 12. rrëmbimi. Pra Ligji për Dhunën në Familje në mënyrë taksative ka përcaktuar se çka nënkuptohet me dhunën në familje.

Sipas Ligjit pala e mbrojtur është personi ndaj të cilit është ushtruar dhuna në familje dhe vartësit në dobi të të cilit është kërkuar urdhri për mbrojtje, urdhri për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtjen e përkohshme emergjente.

2. Masat mbrojtëse

Me qëllim të mbrojtjes së viktimës dhe evitimit të dhunës në familje, varësisht nga lloji dhe intensiteti i saj, në dispozitat e neneve 4 - 11 të këtij ligji janë parashikuar masat mbrojtëse të cilat mund të shqiptohen nga ana e gjykatës ndaj personit përgjegjës për dhunën në familje.

Përpos masave mbrojtëse të parapara në këto nene, varësisht nga situata e paraqitur, mund të caktohet edhe ndonjë masë tjetër, e cila është e domosdoshme për mbrojtjen e sigurisë, shëndetit ose mirëqenies së palës së mbrojtur. Në këtë aspekt, gjykata ka autorizim të cakton edhe masa tjera, përpos atyre që janë parashikuar me këto nene dhe atë urdhrin për mbrojtje, urdhrin për mbrojtje emergjente ose urdhri për mbrojtje emergjente të përkohshme.

Propozimin për caktimin e një ose më shumë masave mbrojtëse mund ta paraqes: pala e mbrojtur ose përfaqësuesi ligjor apo i autorizuar i saj, anëtarë tjetër i familjes, qendra për punë sociale dhe çdo person tjetër i cili është në dijeni për ushtrimin e dhunës në familje.

3. Llojet e urdhrave për mbrojtje nga dhuna në familje

Me propozimin e paraqitur mund të kërkohej të lëshohet:

- 1) Urdhri për mbrojtje,
- 2) Urdhri për mbrojtje emergjente dhe
- 3) Urdhri për mbrojtje të përkohshme emergjente.

Ditëve të punës dhe gjatë orarit të punës së gjykatës propozimi i paraqitet gjykatës që të lëshojë urdhrin për mbrojtje apo urdhrin për mbrojtje emergjente. Ditëve të pushimit dhe jashtë orarit të punës së gjykatës propozimi i paraqitet Shefit të njësitit rajonal të Policisë së Kosovës kundër dhunës në familje, që ai të lëshojë urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente.

Me një urdhër mund të caktohen një apo më shumë masa mbrojtëse. Me urdhër për mbrojtje mund të caktohen të gjitha masat e parashikuara në nenin 18 të Ligjit.

4. Organet kompetente për lëshuarjen e urdhrave

Për të vendosur lidhur me propozimin për dhënien e urdhrin për mbrojtje dhe urdhrin për mbrojtje emergjente është kompetente gjykata themelore sipas vendbanimit ose vendqëndrimit të palës së mbrojtur. Propozimi mund të paraqitet edhe gjatë procedurës e cila është duke u zhvilluar në gjykatë përkitazi me besimin e fëmijëve apo të ushqimit ligjor. Pas dëgjimit të palëve dhe administrimit të provave në seancë gjyqësore të zhvilluar sipas rregullave të parapara në këtë ligj, e në mungesë të tyre sipas rregullave të Ligjit të Procedurës Kontestimore¹⁶, nëse vërtetohet se ekziston dyshimi i arsyeshëm se kryesi i dhunës është kërcënuar se do të kryej ndonjë veprë të dhunës në familje, me qëllim të mbrojtjes së sigurisë, shëndetit ose mirëqenies së palës së mbrojtur, apo të personit me të cilin pala e mbrojtur ka lidhje familjare, gjykata lëshon urdhrin për mbrojtje ose urdhrin për mbrojtje emergjente. Me njërin apo tjetrin urdhër caktohen një apo më shumë masa mbrojtëse me afat të zgjatjes më së shumti 12 muaj me mundësi vazhdimi gjer në 24 muaj, duke ia tërhequr vërejtjen kryesit të dhunës se urdhri zbatohet nga momenti kur atij i dorëzohet aktvendimi me të cilin është dhënë urdhri dhe se moszbatimi i tij paraqet veprë penale. Përpos kryesit të dhunës urdhri i dorëzohet edhe palës së mbrojtur, stacionit lokal të policisë, dhe qendrës për punë sociale, sipas vendbanimit, përkatësisht vendqëndrimit të viktimës.

Nëse rrethanat në bazë të cilave është dhënë urdhri për mbrojtje ndryshojnë para kalimit të afatit të caktuar për atë urdhër, sipas kërkesës së palës së mbrojtur ose kryesit të dhunës gjykata mund të vendos që ai të ndryshohet ose edhe të ndërpritet.

Gjatë 15 ditëve të fundit para kalimit të afatit të caktuar për zgjatjen e urdhrin për mbrojtje pala e mbrojtur ose përfaqësuesi i autorizuar mund të paraqet kërkesën për vazhdimin e urdhrin për mbrojtje. Pas shqyrtimit të kërkesës në seancë gjyqësore

¹⁶ Shih nenin 15 të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje,

gjykata mundë të vazhdoj urdhrin edhe për një afat tjetër, më së shumti edhe 12 muaj tjerë, ose të vërtetoj ndërprerjen e tij.

5. Pasojat e shkëljes së urdhrave

Nëse kryesi i dhunës në familje nuk e zbaton urdhrin për mbrojtje, përkatësisht urdhrin për mbrojtje emergjente të lëshuar nga gjykata, ose urdhrin për mbrojtje të përkohshme emergjente të lëshuar nga Shefi i Njësitit rajonal të Policisë së Kosovës, ai kryen vepër penale, e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare e për të cilën parashihet dënimi me gjobë ose me burgim deri në gjashtë muaj¹⁷.

17 Po aty neni 25,

■ E DREJTA TRASHËGIMORE

I. Institutet e përgjithshme:

1. Trashëgimia, nocioni dhe prezumimet e trashëgimit;

Vdekja e një personi, në njërën anë, ka për pasojë shuarjen e disa të drejtave dhe detyrimeve, ndërsa në anën tjetër kalimin e këtyre të drejtave dhe detyrimeve tek personat tjerë, konkretisht të trashëgimtarët e tij. Si pasojë e vdekjes do të shuheshin si të drejtat pasurore, po ashtu edhe ato jo pasurore. Nga këtu do të rrjedh edhe nocioni se **trashëgimia është kalimi me ligj apo në bazë të testamentit i pasurisë, disa të drejtave dhe detyrimeve të personit të vdekur tek një apo më shumë persona tjerë.**

Duke u nisur nga kjo, personi i vdekur është ai person pasuria e të cilit trashëgohet që ndryshe Ligji për Trashëgiminë i Kosovë (LTK) e njehë me emrin trashëgimlënës. Pasuri trashëgimore është pasuria të cilën e ka poseduar trashëgimlënësi deri në momentin e vdekjes, ndërsa personat në të cilët pasuria trashëgimore pas vdekjes së trashëgimlënësit do të trashëgohej, quhen trashëgimtar.

2. Objekti i trashëgimit;

Pasuria e një personi e humb titullarin e sajë me rastin e vdekjes së atij personi, Kjo pasuri përbehet nga sendet apo të mirat materiale, të drejtat dhe detyrimet që ka pasur ai person. Pikërisht, këto sende apo të mira materiale janë objekt i trashëgimit, të cilat pas vdekjes së titullarit të tyre duhet të kalojë në trashëgimtarë. Përveç këtyre, si objekt i trashëgimit apo shqyrtimit të trashëgimisë, sipas LTK paraqiten edhe të drejtat dhe detyrimet që ka pasur personi i caktuar para vdekjes së tij.

3. Fitimi i trashëgimit;

Që një trashëgimtar apo më shumë sish të fitojnë cilësinë e trashëgimtarit duhet të ndodhë vdekja. Vdekja provokon thirrjen e trashëgimtarëve si testamentar po ashtu edhe atyre ligjor. Momenti i vdekjes së një personi fizik, është momenti i cili përcakton subjektet të cilët kanë të drejtën në trashëgim. Sipas LTK vetëm personat fizik mund të jenë trashëgimlënës (neni 4.2 i LTK).

4. Koha dhe vendi i hapjes së trashëgimit;

Vdekja e një personi është momenti kur edhe provokohet hapja e trashëgimisë, gjë që për këtë arsye, e drejta në trashëgim fitohet në momentin e vdekjes, të njëjtin efekt e ka edhe shpallja e personit të vdekur. Këtë cilësi e fitojnë të gjithë ata persona të cilët në momentin e vdekjes së personit apo shpalljes së tij të vdekur, kanë fituar të drejtën për të qenë trashëgimtar (neni 5.1 i LTK), po ashtu, këtë të drejtë e kanë të gjithë personat

që janë të aftë për të trashëguar, po që se me ligj nuk parashihet ndryshe (neni 5.2 i LTK).

Ndërsa si vend i hapjes së trashëgimisë konsiderohet vendi ku trashëgimlënësi në kohën e vdekjes ka pasur vendbanimin e përhershëm apo të përkohshëm apo vendi në të cilin gjendet pjesa me e madhe e pasurisë trashëgimore të tij (neni 95 i Ligjit të Procedurës Jokontestimore, (LPJ)).

5. Barazia në trashëgimi;

Sipas LTK të barabartë në trashëgim janë të gjithë ata persona fizik, të cilët kanë qenë gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit (neni 3.1), në kushte të njëjta, janë të aftë për të trashëguar edhe personat e paslindur apo të cilët ende nuk kanë lindur, me kusht që të njëjtit të kenë qenë të zënë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit (neni 7 i LTK). Gjithashtu, janë të barabartë në trashëgim edhe ata fëmijë që kanë lindur jashtë martese por të cilëve me ndonjë vendim të gjykatës apo organi administrativ ju njihet atësia, apo të njëjtit janë adoptuar nga ana e trashëgimlënësit (neni 3.2 i LTK), qoftë edhe nëse të njëjtit janë shtetas të huaj, me kusht reciprociteti nga shteti i huaj, i cili reciprocitet do të prezumohej (neni 3.4 i LTK).

6. Marrëveshjet për trashëgiminë e ardhshme;

Ligji për Trashëgim i Kosovës, nuk lejon kurrfarë marrëveshje mes trashëgimtarëve të ardhshëm, apo trashëgimtarëve të ardhshëm dhe personave të tretë lidhur me trashëgiminë e cila nuk është hapur ende, çfarëdo marrëveshje mbi këtë bazë, do të ishte e pavlefshme.

7. Zotësia për të trashëguar;

Të gjithë personat të cilët kanë qenë gjallë në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit, apo të cilët kanë qenë të zënë para vdekjes së trashëgimlënësit, por të cilët kanë lindur të gjallë, janë të aftë apo kanë zotësi për të trashëguar (neni 7.1 i LTK). Do të konsiderohej se kanë qenë të zënë në kohën e hapjes së trashëgimisë, në rast se ai person ka lindur i gjallë brenda 300 ditëve nga vdekja e trashëgimlënësit. Mirëpo, edhe në rast se këta persona plotësojnë kushtet e lartcekura, jo të gjithë ata të cilët kanë qenë të thirrur për të trashëguar, qofshin ata trashëgimtarë ligjorë apo me testament, mund të trashëgojnë, ngase për të fituar cilësinë e trashëgimtarit duhet që të mos plotësohen kushtet që të njëjtit të jenë të padenjë në trashëgim apo të njëjtit jenë të përjashtuar nga trashëgimia.

8. Bazat e thirrjes në trashëgimi;

Kalimi i pasurisë prej trashëgimlënësit në trashëgimtarë bëhet në dy mënyra:

- a) *Mënyra e për është ajo ligjore, ku vetë ligji është ai i cili përcakton trashëgimtarët dhe radhët e tyre dhe*

- b) *Mënyra tjetër është me testament, pra, dëshira që ka trashëgimtari duke e shpreh vullnetin e tij të fundit me të cilin ai mund të ndikojë në caktimin e rendit të trashëgimtarëve duke u nisur nga interesat e tij. Nga kjo vijmë në përfundim se janë dy baza të thirrjes në trashëgim, testamentare dhe ligjore (neni 8 i LTK).*

9. Nocioni i trashëgimtarit;

Me LTK, nuk përcaktohet nocioni i trashëgimtarit. Mirëpo duke pas parasysh përmbajtjen e dispozitave të LTK, si dhe duke pas parasysh aspektet teorike dhe shkencore arrijmë në përfundim se trashëgimtar janë të gjithë ata persona të cilët do të trashëgonin, pasurinë trashëgimore, pas vdekjes së trashëgimlënësit.

10. Dallimi në mes të trashëgimtarit dhe suksesorit të vetëm;

Sukcesioni i të drejtës nënkupton pasimin e një subjekti në të drejtat dhe detyrimet të cilat i ka pasur subjekti tjetër. Në këtë aspekt suksesori është pasuesi i të drejtave dhe detyrimeve të cilat i ka pasur trashëgimlënësi, pas zhvillimit të procedurës trashëgimore. Nga kjo rrjedh se para se të zhvillohet procedura trashëgimore, akoma nuk dihet nëse do të mundin të trashëgojnë të gjithë personat të cilët sipas ligjit konsiderohen si trashëgimtar. Përkundër kësaj e drejta në trashëgimi e suksesorit është vendosur në bazë të procedurës së zhvilluar trashëgimore, në këtë edhe qëndron dallimi mes trashëgimtarit dhe suksesorit.

11. Trashëgimia ligjore në përgjithësi;

Me trashëgimi ligjore nënkuptojmë fitimin e trashëgimisë sipas rendit trashëgimor dhe në vëllim të përcaktuar me ligj.

12. Disponimet në rast vdekje.

Përpos tjerash, punët juridike ndahen edhe në punë juridike gjatë jetës (inter vivos) dhe në rast vdekje (mortis causa). Është karakteristikë se të dy këto lloje të punëve juridike themelohen gjatë jetës së personave të cilët i ndërmarrin, ashtu që kriteri i dallimit të tyre mes veti nuk është koha e themelimit - paraqitjes së tyre, por është koha e fillimit të efekteve juridike të tyre. Në këtë aspekt efektet të punëve juridike inter vivos paraqiten gjatë jetës së personave të cilët i kanë ndërmarr ato. Ndërsa, tek ato mortis causa efektet juridike fillojnë pas vdekjes së personit që e ka ndërmarr atë punë juridike, ashtu që vdekja e personit është kusht themelorë që ajo punë juridike të ketë efekt juridik.

Sipas LTK punë juridike në rast vdekje janë testamenti dhe kontrata për ushqimin e përjetshëm.

II. Trashëgimia në bazë të ligjit:

Trashëgimia në bazë të ligjit nënkupton trashëgimin në bazë të fakteve të caktuara, të cilat i parasheh ligji, në rastet kur nga këto fakte nuk ka mundur të vijë deri të trashëgimia në bazë të testamentit.

Deri të trashëgimia në bazë të ligjit vjen: a. kur trashëgimlënësi nuk ka lënë asnjë testament apo kur testamenti është revokuar, apo kur trashëgimlënësi me testament nuk ka përfshirë gjithë pasurinë e tij, si dhe b. kur trashëgimtari testamentar ka vdekur para trashëgimlënësit.

1. Rrethi i trashëgimtarëve

Ligji i Trashëgimisë i Kosovës, njeh tri radhë të trashëgimit. Mirëpo, nëse trashëgimlënësi nuk ka trashëgimtar të cilët do të trashëgonin në bazë të ligjit, autoritetet publike, gjegjësisht komuna do të paraqitet si trashëgimtar ligjorë i radhës së fundit.

2. Radhët e trashëgimisë;

Sipas ligjit, radhët e trashëgimisë janë të përcaktuara varësisht nga shkallët e gjinisë të trashëgimtarëve të mundur ligjorë me trashëgimlënësin. Duhet theksuar se, trashëgimtarët e radhës më të afërt i përjashtojnë nga trashëgimia personat e radhës më të largët (neni 11.4 i LTK).

- a) *Radhën e par të trashëgimisë e përbejnë bashkëshorti dhe pasardhësit e trashëgimlënësit. Pra, trashëgimlënësin para të gjithëve e trashëgojnë bashkëshorti dhe fëmijët e tij (neni 12.1 i LTK), këta trashëgojnë në pjesë të barabarta (neni 12.2 i LTK).*




Fig. 1

b 1) Radhën e dytë të trashëgimisë e përbejnë: **prindërit dhe bashkëshorti i trashëgimlënësit**. Në këtë rast, trashëgimlënësin i cili nuk ka lënë pasardhës e trashëgojnë prindërit e tij dhe bashkëshorti pasjetues i cili zbret nga radha e parë në të dytë dhe trashëgon së bashku me trashëgimtarët e radhës së dytë, por jo më pak se $\frac{1}{2}$ e pasurisë trashëgimore (neni 14.1 i LTK). Gjysmën e pasurisë e trashëgojnë prindërit **në pjesë të barabarta**. Në rastet kur trashëgimlënësi nuk lënë pasardhës e as bashkëshortë pasjetues, në pjesë të barabarta me nga $\frac{1}{2}$ e tërë pasurisë së trashëgimlënësit e trashëgojnë prindërit e tij (neni 14.3 i LTK).




Fig. 2




Fig. 3

E DREJTA TRASHËGIMORE

b 2) Gjithashtu në radhën e dytë të trashëgimisë hyjnë edhe vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre se bashku me bashkëshortin e trashëgimlënësit (neni 15 i LTK). Një gjë e tillë ndodhë në rastin kur njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit, pjesën trashëgimore që do t'i takonte atij e trashëgojnë fëmijët e tij, konkretisht (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit), sipas dispozitave të këtij ligji që vlejnjë për rastin kur trashëgimlënësin e trashëgojnë fëmijët dhe pasardhësit e tjerë të tij (neni 15.1 i LTK). Në rastin konkretë duhet pasur parasysh se (vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit dhe pasardhësit e tyre), trashëgojnë në pjesë të barabarta me prindin tjetër (neni 14.2 i LTK).




Fig. 4

- b 3) Pjesët trashëgimore të cilat do tu takonin prindërve të trashëgimlënësit (sikurse të ishin gjallë), të cilët kanë vdekur para trashëgimlënësit dhe atë $\frac{1}{2}$ e trashëgojnë pasardhësit e tyre, në rastin konkret vëllezërit dhe motrat e trashëgimlënësit siç është përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 15 të LTK, ndërsa pjesën tjetër prej $\frac{1}{2}$ e trashëgon bashkëshorti pasjetues, me kusht që trashëgimlënësi të mos ketë lënë pasardhës.




Fig. 5

- b 4) në rast se njëri nga prindërit e trashëgimlënësit ka vdekur para trashëgimlënësit e nuk ka lënë asnjë pasardhës, pjesën e tij do ta trashëgonte prindi tjetër, e në qoftë se edhe ky ka vdekur para trashëgimlënësit, pasardhësit e tij, të cilët ka mundur t'i ketë nga ndonjë martesë tjetër e tij apo jashtëmartesor, do të trashëgonin pjesën e pasurisë trashëgimore që do tu takonin të dy prindërve.
- c) Në radhën e tretë të trashëgimit hyjnë gjyshi dhe gjyshja e trashëgimlënësit. Gjyshi dhe gjyshja e të njëjtit trung trashëgojnë në pjesë të barabarta. Pasurinë trashëgimore të trashëgimlënësit i cili nuk ka lënë pasardhës, bashkëshort, prindër dhe pasardhës të tyre, e trashëgojnë gjyshërit dhe gjyshet e tij. Gjysmën e pasurisë trashëgimore apo $\frac{1}{2}$, në pjesë të barabarta e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e të atit, ndërsa gjysmën tjetër apo $\frac{1}{2}$, të pasurisë trashëgimore, në pjesë të barabarta e trashëgojnë gjyshi dhe gjyshja nga ana e nënës.
- ç) Sipas LTK si trashëgimtar i radhës së fundit paraqitet komuna. Pasuria trashëgimore e trashëgimlënësit i cili nuk ka lënë as trashëgimtar testamentar e as trashëgimtar ligjorë, i takon komunës në të cilin trashëgimlënësi ka pasur vendbanimin ose vendqëndrimin e tij të fundit.

3. Raporti në mes të radhëve të trashëgimisë;

Në çdo rast, sa herë që kemi të bëjmë me trashëgimtarët ligjor, duke përjashtuar trashëgimtarët testamentar, trashëgimtarët e radhës më të afërt, me rastin e ndarjes së pasurisë trashëgimore, i përjashtojnë nga ndarja e pasurisë trashëgimtarët e radhës më të largët.

4. E drejta e përfaqësimit;

Në mungesë të një trashëgimtari i cili ka vdekur para trashëgimlënësit, deklarohet i padenjë për të trashëguar, heq dorë nga trashëgimia apo përjashtohet nga e drejta për të trashëguar, në vend të tij, në shkallë të njëjtë dhe me të drejta të njëjta futet një trashëgimtar tjetër. Shembull. **Trashëgimlënësi Hasani pas vdekjes së tij ka lënë bashkëshorten Yllken, fëmijët Besën, Arbërin ndërsa fëmija i tretë Arbeni ka vdekur para trashëgimlënësit dhe ka lënë djalin Drenin. Në këtë rast bashkëshortja trashëgon $\frac{1}{4}$, Besa $\frac{1}{4}$, Arbëri $\frac{1}{4}$ dhe Dreni me të drejtë të përfaqësimit trashëgon $\frac{1}{4}$ e pasurisë trashëgimore e cila pasuri do t'i takonte të atit të tij.** Kjo e drejtë njihet me emrin e drejta në përfaqësim. Këta persona të cilët zëvendësojnë trashëgimtarin i cili do të duhej të trashëgonte, trashëgojnë në pjesë të barabarta me trashëgimtarët tjerë.

E drejta e rritjes dhe e zvogëlimit të pjesës trashëgimore

1. Pozita trashëgimtare e fëmijëve, trajtimi i barabartë i fëmijëve të trashëgimlënësit;

Kurë bëme fjalë për radhën e trashëgimisë thamë se aty trashëgojnë të gjithë pasardhësit e trashëgimlënësit në pjesë të barta, që do më thënë se në këtë rreth bëjnë pjesë si fëmijët e lindur në martesë po ashtu edhe ata të lindur jashtë martesës. Me fëmijët legjitim barazohen edhe fëmijët e adoptuar si dhe fëmijëve të cilëve u është njohur atësia me vendim të gjykatës nga ana e trashëgimlënësit para vdekjes së tij.

2. Shtimi i pjesës trashëgimore të fëmijëve;

Ligji parasheh, në rastet e veçanta, shtimin e pjesës trashëgimore të fëmijëve, përkatësisht zvogëlimin e asaj të bashkëshortit. Nëse ekzistojnë fëmijët të cilët bashkëshortin e trashëgimlënësit nuk e kanë prind, e pasuria e të cilit është më e madhe nga ajo që do ti takonte me ndarjen e trashëgimisë në pjesë të barabarta, atëherë çdo fëmijë i trashëgimlënësit ka të drejtë të trashëgojë dy herë më shumë nga bashkëshorti, nëse varësisht nga rasti gjykata këtë e shef të arsyeshme.

Nuk është me rëndësi nga cila martesë janë fëmijët, nëse ata janë martesor apo jashtëmartesor. Shembull: Trashëgimlënësi ka pasur dy fëmijë nga martesë e parë dhe dy të tjerë nga martesë e dytë. Fëmijët nga martesë e parë kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për shtimin e pjesës së tyre. Nëse gjykata vlerëson se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore, bashkëshortit do t'i cakton pjesën ideale në lartësi prej $\frac{1}{9}$ të

trashëgimisë, ndërsa të gjithë fëmijët e trashëgimlënësit (fëmijët nga martesë e parë dhe fëmijët nga martesë me bashkëshortin pasjetues) do të marrin nga 2/9 të pjesës së trashëgimisë. Matematikisht do të shprehëj $4 \times 2 + 1 = 9$, që do të thotë se numri i fëmijëve të trashëgimlënësit shumëzohet për 2 dhe shumësi së fituar i shtohet një (neni 23 i LTK).

E drejta e trashëgimit të adoptuarit dhe adoptuesit;

Fëmijët të cilët janë e adoptuar si dhe pasardhësit e tyre, të cilët janë adoptuar me vendim të gjykatës, kanë të drejta të barabarta me fëmijët e adoptuesit (trashëgimlënësit), ata trashëgojnë njëjtë sikurse fëmijët e adoptuesit, pra, konkurrojnë në trashëgim në pjesë të barabarta me fëmijët e adoptuesit.

3. Të drejtat e bashkëshortit;

Bashkëshorti i trashëgimlënësit nënkupton si burrin ashtu edhe gruan të cilët kanë të drejtë të trashëgojnë bashkëshortin e vdekur. Bashkëshorti pasjetues ka të drejtë të trashëgojë në pjesë të barabarta me fëmijët e trashëgimlënësit apo $\frac{1}{2}$ e pasurisë së trashëgimlënësit kur trashëgon në rrethin e dytë trashëgimor. Mirëpo bashkëshorti pasjetues ka të drejtë të kërkojë që nga masa trashëgimore të veçohet pjesa e tij e pasurisë e fituar gjatë jetës së përbashkët me trashëgimlënësin (se cila do të jetë kjo pjesë do të vendos gjykata në procedurë kontestimore nëse palët nuk do të merren vesh në mes veti) dhe pjesa tjetër e pasurisë së trashëgimlënësit do të jetë objekt i shqyrtimit në procedurë trashëgimore (neni 26.1 i LTK).

4. Kur bashkëshorti nuk ka të drejtë për të trashëguar;

LTK parasheh situatën kur bashkëshorti pasjetues të përjashtohet nga trashëgimia. Në dispozitën e nenit 27 taksativisht janë paraparë shkaqet për përjashtim nga e drejta në trashëgim;

- a) *shkaku i parë ka të bëjë me zgjidhjen e martesës me shkurorëzim. Në rastin kur trashëgimlënësi ka paraqitur padinë për shkurorëzim deri sa ka qenë gjallë, mirëpo, pas vdekjes së tij është zgjidhur martesë me shkurorëzim me aktgjykim të formës së prerë.*
- b) *shkaku tjetër ka të bëjë me zgjidhjen e martesës me anulim. Në rastin kur pas vdekjes së trashëgimlënësit anulohet martesë me aktgjykim të formës së prerë për shkaqet që bashkëshorti pasjetues i ka ditur në kohën e lidhjes së martesës dhe*
- c) *shkaku i fundit ka të bëjë me fajin e bashkëshortit pasjetues që si pasojë ka pasur pushimin e bashkëjetesës me trashëgimlënësin.*

5. E drejta e trashëgimit të bashkëshortit jashtëmartesor;

E drejta Trashëgimore në Kosovë i njeh të drejtën në trashëgim bashkëshortit jashtëmartesor vetëm në rast të plotësimit të disa kushteve. Kushtet që duhet plotësuar janë bashkëjetesa e cila ka zgjatur më së paku

10 vite ose nëse bashkëjetesa ka zgjatur më së paku 5 vite, me kusht që nga kjo bashkëjetesë bashkëshortet jashtëmartesor të kenë fëmijë (neni 28.1 a i LTK). Si dhe deri në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit asnjëri nga personat që kanë bashkëjetuar të mos kenë lidhur martesë me ndonjë person tjetër (neni 28.1 b i LTK).

Ndërsa si trashëgimtar i domosdoshëm sipas LTK nuk mund të konsiderohet bashkëshorti jashtëmartesor (neni 28.2 i LTK).

6. Trashëgimia e domosdoshme;

Në nenin 30 të LTK parashihet se kush mund të jenë trashëgimtar të domosdoshëm. Këtë të drejtë e kanë, përpos bashkëshortit të trashëgimlënësit, në vijë të drejtë pasardhësit e trashëgimlënësit dhe prindërit e tij, si dhe të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre. Ndërsa sa i përket vijës tërthorët si trashëgimtar të domosdoshëm mund të thirren: motrat dhe vëllezërit e trashëgimlënësit, me kusht që të njëjtët të jenë plotësisht të paaftë për punë dhe të mos kenë mjete për ekzistencë. Personat në vijë të drejtë dhe ata në vijë tërthore të cekur më lartë thirren në trashëgim sipas radhës ligjore.

7. Pjesa e domosdoshme dhe disponibile e pasurisë trashëgimore;

Pjesa e domosdoshme e pasurisë trashëgimore është ajo pjesë e pasurisë me të cilën trashëgimlënësi nuk mundet të disponojë. Në këtë pjesë, të drejtë ekskluzive në trashëgim kanë trashëgimtarët e domosdoshëm (neni 31 i LTK), për trashëgimtarët e radhës së parë (fëmijëve dhe bashkëshortit) ajo përbën $\frac{1}{2}$ të pasurisë që do t'u takonte secilit si trashëgimtarë ligjorë. Ndërsa, për radhët e tjera, ajo përbenë $\frac{1}{3}$ e pasurisë trashëgimore që do t'u takonte si trashëgimtar ligjor.

8. Llogaritja e pasurisë së domosdoshme;

Për të llogaritur pjesën e domosdoshme së pari duhet përcaktuar vlerën e pasurisë trashëgimore. Kjo bëhet me vlerësimin e të gjitha të mirave me të cilat është disponuar me testament, të mirave tjera të trashëgimlënësit në momentin e vdekjes së tij dhe të gjitha borxhet që ia kanë pasur përkatësisht ia kanë trashëgimlënësit. Nga kjo vlerë zbritet lartësia e borxheve të trashëgimlënësit ndaj të tjerëve, shpenzimet rreth përcaktimit të vlerës si mësipërm si dhe lartësia e shpenzimeve të varrosjes së trashëgimlënësit. Lartësisë të këtij ndryshimi i shtohet vlera e të gjitha dhurimeve eventuale të trashëgimlënësit ndaj trashëgimtarëve ligjor si dhe vlera e dhurimeve të cilat i ka bërë trashëgimlënësi vitin e fundit ndaj personave të tjerë.

9. Pasuria që veçohet nga pasuria trashëgimore;

Pasuria e trashëgimlënësit, e fituar nga pasardhësit të cilët kanë bashkëjetuar me të dhe të cilën e kanë fituar me punën e tyre, fitimin e vetë apo në çfarëdo mënyre që i kanë ndihmuar trashëgimlënësit, kanë të drejtë të kërkojnë që nga pjesa e pasurisë trashëgimore, të veçohet ajo pjesë e cila u përgjigjet kontributeve të tyre. Kjo pjesë nuk i takon pasurisë trashëgimore, e në asnjë mënyrë kjo pjesë nuk mundet të merret për bazë në llogaritjen e pjesës së domosdoshme. E drejta që të kërkohej kjo pjesë e pasurisë, vjetërohet pas kalimit të 5 viteve nga dita kur është hapur trashëgimia (neni 36.3 i LTK).

10. Zvogëlimi i disponimit me testament;

Në rastet kur preket dhe në një mënyrë zvogëlohet pjesa e domosdoshme, atëherë të gjitha dhurimet të cilat janë bërë nga ana e trashëgimlënësit kthehen me qëllim të plotësimit të pjesës së domosdoshme. Gjithashtu edhe disponimet me testament zvogëlohen.

Zvogëlim të pjesës së domosdoshme kemi atëherë kur dhurimet që janë bërë dhe disponimet me testament kalojnë pjesën disponibile, pra, prekin pjesën e domosdoshme të pasurisë trashëgimore.

11. Llogaritja e dhurimeve dhe legeve në pjesën trashëgimore;

Me rastin e llogaritjes së pjesës trashëgimore për secilin trashëgimtar ligjorë, në pjesën trashëgimore për secilin do të llogaritet çdo gjë që ka marr si dhurim në çfarëdo mënyre nga ana e trashëgimlënësit. Frytet apo të mirat nga sendi i dhuruar nuk llogariten, siç nuk llogariten edhe dhurimet të cilat vetë trashëgimlënësi i ka deklaruar si dhurime në testament apo nëse kuptohet se ky ka qenë vetë vullneti i trashëgimlënësit

TRANSAKSIONET JURIDIKO-TRASHËGIMORE:

1. Cedimi dhe ndarja e pasurisë në përgjithësi;

Përveç mënyrës ligjore dhe asaj me testament, me LTK janë parashikuar edhe mundësi tjera të kalimit të pasurisë nga paraardhësi në pasardhës. Neni 58 i LTK parasheh se paraardhësi me anë të veprimit juridik, për së gjalli mund t'ua cedojë dhe pjesëtojë pasurinë e vetë pasardhëseve të vet. Një veprim të tillë mund ta kryen me anë të kontratës për ndarjen e pasurisë gjatë jetës.

2. Kushtet për vlefshmërinë e cedimit;

Që një cedim apo pjesëtim i pasurisë të jetë i vlefshëm LTK-ja parasheh kushte të caktuara, ato janë: a. pajtimi i të gjithë trashëgimtarëve ligjor për kontratën për cedimin e pasurisë. Pra, që cedim apo pjesëtim i pasurisë të jetë i vlefshëm duhet që për këtë kontratë të jenë pajtuar të gjithë pasardhësit e ceduesit, të cilët do të ishin trashëgimtar të tij në kohën kur është bërë cedim, të jenë palë kontraktuese dhe b. kontrata për cedimin e pasurisë duhet të jetë e formës së shkruar dhe të vërtetohet nga gjyqtari, pasi që i njëjti tua lexon dhe tregon kontraktuesve ne pasojat e kësaj kontrate.

3. Objekti i cedimit dhe pjesëtimit;

Objekt i cedimit apo pjesëtimit është vetë pasuria e trashëgimlënësit, çoftë si tërësi apo vetëm si një pjesë e sajë.

4. Përjashtimi i pasurisë së ceduar nga pasuria trashëgimore;

Që cedimi të jetë i vlefshëm për të duhet të jenë pajtuar të gjithë trashëgimtarët ligjor. Mirëpo, në rastet kur për të nuk është pajtuar ndonjëri nga trashëgimtarët ligjorë, pjesët të cilat u janë ceduar me anë të kontratës trashëgimtarëve tjerë, do të veçohen nga pasuria trashëgimore. Kjo pjesë e pasurisë trashëgimore nuk merret parasysh me rastin e përcaktimit të pasurisë trashëgimore të trashëgimlënësit pas hapjes së trashëgimisë.

5. Kur konsiderohet pjesa e ceduar si dhurime;

Pjesët e pasurisë trashëgimore të cila iu janë ceduar trashëgimtarëve ligjor, por, me të cilin cedim nuk është pajtuar ndonjë trashëgimtar, konsiderohen si dhurime. Me të, pas vdekjes së ceduesit do të veprohet njëjtë sikurse me dhurime të cilat iu janë bërë trashëgimtarëve.

6. Ruajtja e së drejtës me rastin e cedimit dhe pjesëtimit;

Ceduesi në rastet kur cedon apo pjesëton pasurin e tij, mundet që nga pasuria e tij të ruan të drejtën e uzufruktit në të gjitha sendet e ceduara si për veten e tij po ashtu edhe për bashkëshortin apo ndonjë person tjetër apo të caktoj rentë për mbajtje të përjetshme. Në rast se uzufrukti apo renta caktohet për ceduesin dhe bashkëshortin e tij dhe ndonjëri nga ta vdesë, pjesa e tij do të takonte tjetrit deri në vdekjen e tij.

7. Të drejtat e bashkëshortit të ceduesit;

Bashkëshorti i ceduesit gëzon të drejtën e dhënies ose mosdhënies së pëlqimit me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për cedim apo pjesëtimit e pasurisë nga ana e ceduesit. Kjo e drejtë është kusht për vlefshmërinë e cedimit apo pjesëtimit të pasurisë (neni 59 i LTK).

8. Borxhet e ceduesit;

Për borxhet e ceduesit, nuk përgjigjen pasardhësit të cilëve vetë ceduesi ju ka ceduar apo pjesëtuar pasurinë, me kusht, që me rastin e cedimit të mos është caktuar ndonjë detyrim tjetër. Mirëpo, përkundër kësaj, kreditorët e ceduesit sipas dispozitave të parapara për kundërshtimin e disponimeve pa shpërblim, mund të kundërshtojnë cedimet apo pjesëtimet e bëra.

9. Shuarja e kontratës;

Ceduesi ruan të drejtën që të kërkoj shkëputjen e kontratës në mënyrë të njëanshme dhe kthimin e sendit të ceduar, në rast se përfituesit e cedimit apo pjesëtimet kanë treguar një mosmirënjohje të vrazhdë ndaj tij. Nëse kthimi i sendit është i pamundur atëherë duhet të kthehet vlera e sendit të ceduar në pajtim me dispozitat për pasurim të pabazë.

Një veprim të tillë ceduesi mund të ndërmerret edhe në rastet kur përfituesi i cedimit nuk i jep atij apo ndonjë personi tjetër ushqimin e caktuar, nuk paguan borxhet e ceduesit apo ndonjë personi tjetër, të cilat detyrime i kanë paraparë në kontratën për cedimin apo pjesëtimin e pasurisë. Gjykata, në këto konteste çdoherë duhet t'i kushton kujdes rëndësishëm së detyrimit, me rastin e vendosjes për kthimin e të mirave apo të vendos për përmbushjen e detyrimit.

10. Të drejtat e trashëgimtarëve pas shuarjes së kontratës;

Trashëgimtari i cili ka qenë i detyruar që t'i kthejë ceduesit atë që ka marr me cedim, pas shkëputjes së kontratës për cedim, ruan të drejtën të kërkojë pjesën e domosdoshme, që do t'i takonte si trashëgimtar ligjor, pas vdekjes së ceduesit, me kusht që të mos ketë hequr dorë nga trashëgimia, të mos jetë i padenjë për trashëgim si dhe të mos jetë përjashtuar nga e drejta në trashëgim.

TRASHËGIMIA NË BAZË TË TESTAMENTIT

1. Nocioni i testamentit;

Për sa i përket testamentit, dispozitat e nenit 69 të LTK, japin këtë nocion apo kuptim të testamentit, “**testamenti është shprehje e vullnetit të fundit e dhënë në formë të paraparë me ligj, me të cilin trashëgimtari urdhëron si të veprohet me pasurin e tij pas vdekjes**”.

2. Kushtet e përgjithshme për vlefshmërinë e testamentit;

Ligji i Trashëgimisë parasheh kushte të caktuara, plotësimi i të cilave do të bënte që një testament të jetë i vlefshëm. Kusht kryesor për vlefshmërinë e testamentit është

zotësia për të bërë testament. Personat e moshës madhore të cilët kanë mbushur moshën 18 vjeçare, si dhe personat 16 vjeç, të cilët kanë fituar zotësinë për të vepruar mbi bazën e lidhjes së martesës gjegjësisht emancipimit, janë ata të cilët e kanë këtë cilësi (neni 70 i LTK).

3. Forma e testamentit;

Dallohen dy forma të testamentit, forma e shkruar dhe ajo gojore. Forma e shkruar detyrimisht duhet të përmbaj nënshkrimin e testatorit, të shkruhet dhe të jetë e datuar nga ai apo i njëjti duhet të vënë shenjën e gishtit në të. Data duhet të tregon patjetër ditën, muajin dhe vitin si dhe të vendoset në fund të testamentit.

4. Llojet e testamentit;

Ligji ynë i Trashëgimisë njih disa lloje të testamentit, të cilat mund të përmbliken në dy grupe.

- a) *Private – është ai testament të cilin e përpilon vet testatori pa pjesëmarrjen e personit zyrtar, të tillë janë:*
- **testamenti i shkruar nga vet testatori**, është ai testament i cili është shkruar, nënshkruar dhe datuar nga vetë testatori apo i shkruar nga dikush tjetër e në të cilin ka vu shenjën e gishtit vetë testatori.
 - **testamenti me shkrim në praninë e dëshmitarëve**, është ai testament të cilin testatori e nënshkruan me dorën e vetë pa marr parasysh se kush e ka shkruar atë testament, duke deklaruar para dëshmitarëve se i njëjti është i tij, me kusht që testatori të dinë shkrim dhe lexim në gjuhën në të cilën është shkruar testamenti.
 - **testamenti në rrethana të jashtëzakonshme**, është testamenti me të cilin testatori me gojë e deklaron vullnetin e tij të fundit, pasi që për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme një gjë të tillë nuk ka mund ta bej me shkrim.
- b) *Publik - është ai testament të cilin e përpilon dhe vërteton vetë gjykata me kërkesën e testatorit, të tillë janë:*
- testamenti gjyqësor, është testamenti të cilin e përpilon gjyqtari i gjykatës themelore, pas vërtetimit të identitetit të tij, me kërkesën e këtij të fundit.

5. Dëshmitarët testamentar;

Dëshmitar testamentar mund të janë të gjithë personat madhor të cilët kanë zotësi për të vepruar dhe të cilët dinë të shkruajnë, lexojnë dhe kuptojnë gjuhën në të cilën është përpiluar testamenti (neni 79.1 i LTK). Nga këta persona, si dëshmitar nuk mund të jenë: gjyqtari, pasardhësit e trashëgimtarit, të adoptuarit dhe pasardhësit e tyre, paraardhësit e testatorit, prindërit e tij adoptues, personat e tij në gjini ne vijë të tërthortë

deri në shkallën e katërt, bashkëshortët e të gjithë këtyre personave dhe bashkëshorti i testatorit” (neni 79.2 i LTK)

6. Përmbajtja e testamentit;

Zakonisht testamenti përmban caktimin e trashëgimtarëve, pasurinë që trashëgohet, dhënien e legeve si dhe caktimin e personave të cilët do të ekzekutojnë testamentin.

7. Legu;

Legu konsiston në lënien e sende të veçanta ose kryerjen e një veprimi të caktuar. Kjo nënkupton se testatori me testament mundet të urdhërojë trashëgimtarin ose ndonjë person tjetër të cilit i ka lënë një pjesë të pasurisë së tij, t’i jap personit të caktuar një shumë të hollash, ta liroj nga ndonjë borxh të përmbahet nga ndonjë veprim ose të fitoj diçka në dobi të tij, apo të bëjë diçka për të (nenin 93 i LTK).

8. Ekzekutimi i testamentit;

Me qëllim që testatori të jetë i sigurt që testamenti i tij do të ekzekutohet, ai me testament mund të caktoj një apo më shumë persona për ekzekutimin e tij. Ekzekutuesi nuk është i detyruar të marr përsipër këtë detyrë. I njëjti duhet të ketë aftësi për të vepruar. Ekzekutuesi ka për detyrë që me rastin e ekzekutimit të testamentit të kujdeset për ruajtjen e pasurisë trashëgimore, ta administroj me atë, të kujdeset për pagimin borxheve dhe legeve dhe për gjithçka që ka dashur testatori. Për të gjitha këto veprime ekzekutuesi është i detyruar të jep llogari para gjykatës, i njëjti ka të drejtë në kompensimin e shpenzimeve dhe shpërblim për punën e vetë.

9. Revokimi i testamentit.

Trashëgimlënësi në çdo kohë mund ta revokoj në tërësi apo pjesërisht testamentin e vetë. Revokimi i testamentit bëhet sipas rregullave që vlejnë për përpilimin e testamentit. I njëjti, testamentin e vetë mund ta revokon me shkrim, sipas procedurës së parashikuar ligjore apo me asgjësim të dokumentit.

Pasi ta revokoj testamentin trashëgimlënësi, revokimi shënohet në testamentin që ruhet në gjykatë (neni 190 i Ligjit për Procedurën Jokontestimore).

III. PADENJËSIA DHE PËRJASHTIMI I TRASHËGIMTARËVE TË DOMOSDOSHËM

Padenjësia trashëgimore është një dënim civil që përjashton nga trashëgimia **ab intestat** trashëgimtarin fajtor për fajet e rënda, të shkaktuara ndaj trashëgimlënësit. Sipas nenit 111 të LTK, të padenjë në trashëgim janë ata trashëgimtar të cilët

- a) *me dashje e ka vrarë apo ka tentuar ta vras trashëgimlënësin, bashkëshortin, fëmijët apo prindërit t trashëgimlënësit;*
- b) *ka bërë kallëzim penal të rremë për trashëgimlënësin;*
- c) *duke përdorur dhunë, mashtrim apo kanosje ndaj trashëgimlënësit, ka ndryshuar apo shfuqizuar testamentin e përpiluar nga vet trashëgimlënësi;*
- ç) *Është sjell në mënyrë poshtëruese ndaj trashëgimlënësit dhe*
- d) *Nuk ka mbushur detyrimin për të mbajtur apo ndihmuar trashëgimlënësin.*

Padenjësia e ndonjërit trashëgimtar, nuk i pengon pasardhësit e tij që të trashëgojnë, e pjesa të cilën ata do ta trashëgonin është e njëjtë sikurse personi i padenjë të kishte vdekur para trashëgimtarit. Gjykata do të kujdeset kryesisht për padenjësi.

Po ashtu trashëgimlënësi, me testament, mundet të përjashton nga trashëgimia trashëgimtarin nga pjesa e domosdoshme. Që një përjashtim të ketë efekt juridik, së pari duhet që këtë përjashtim vetë trashëgimlënësi ta shprehë në mënyrë të qartë dhe të tregojë shkakun e përjashtimit e ky shkak duhet të ekzistoj në kohën e përpilimit të testamentit (neni 116 i LTK) në anën tjetër duhet që të ekzistojnë shkaqet e nevojshme të sipër shënuara për përjashtim (neni 114 i LTK) të cilat mund të grupohen në tri forma: a. shkelja e ndonjë detyrimi ligjorë apo moral që ka pas për pasojë cenimin e rëndë ndaj trashëgimlënësit; b. nëse me dashje ka bërë ndonjë vepër të rëndë penale ndaj trashëgimlënësit, bashkëshortit apo fëmijëve të tij dhe c. nëse është plëngprishës dhe i dhënë pas jetës së pandershme.

Përjashtimi mund të jetë i plotë ose i pjesshëm. Me rastin e përjashtimit të trashëgimtarit, i njëjti i humb të drejtat trashëgimore në vëllimin në të cilin është përjashtuar (neni 117 i LTK).

IV. KREDITORËT E TRASHËGIMLËNËSIT

1. Përgjegjësia e trashëgimtarëve dhe legatarëve për borxhet e trashëgimlënësit.

Trashëgimtarët janë përgjegjës për borxhet e trashëgimlënësit vetëm me atë vëllim të pjesës trashëgimore sa do tu takonte si trashëgimtar ligjor. Në ndryshim nga trashëgimtarët, legatari nuk përgjigjet për borxhet e trashëgimlënësit, me kusht që trashëgimlënësi të mos ketë përcaktuar ndryshe me testament.

V. Kalimi i pasurisë trashëgimore te trashëgimtarët:

1. Hapja e trashëgimisë;

Vdekja e një personi ka për pasojë hapjen e trashëgimisë. Gjithashtu edhe shpallja e personit të vdekur është momenti kur hapet trashëgimia. Dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit me të cilin shpallet personi si i vdekur konsiderohet si ditë e hapjes së trashëgimisë, po që se në aktvendimin për shpalljen e personit të vdekur, nuk është caktuar dita e vdekjes së tij. Nga ky moment caktohet vëllimi i pasurisë që duhet të trashëgohet, radhët e trashëgimisë si dhe zotësia e trashëgimtarëve për të trashëguar. Ky moment është i rëndësishëm edhe për fillimin e llogaritjes së afateve. Në këtë rast, trashëgimtar mundet të jetë vetëm personi që në momentin e vdekjes së trashëgimlënësit ka qenë gjallë ose i zënë me kusht që të lindë i gjallë.

Procedura për hapjen e trashëgimisë fillohet me propozimin për iniciimin e trashëgimisë. Procedura iniciohet sipas detyrës zyrtare nga ofiqari e këtë propozim mundet të paraqet çdo person që për këtë ka interes të drejtpërdrejt juridik. Mund të konstatohet se në praktik rregullisht procedura trashëgimore iniciohet sipas propozimit të ndonjërit nga trashëgimtarët e mundshëm ligjor. Dokumenti i cili është i domosdoshëm për iniciimin e procedurës së trashëgimore është aktvdekja. Ky është një dokument pa të cilin nuk mund të fillojë procedura trashëgimore. Në kuptim të nenit 100 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore, aktvdekjen e përpilon nëpunësi i gjendjes civile në bazë të të dhënave që janë marr nga kushërinjtë e të vdekurit, nga personat me të cilët ka bashkëjetuar i vdekuri ose informatave të mbledhura në mënyrë tjetër. Aktvdekja, përpos tjerash, duhet të përmban emrin dhe mbiemrin e të vdekurit dhe emrin e të atit të tij, profesioni, data e lindjes, shtetësia, ndërsa për femrat edhe mbiemri i vajzërisë, pastaj dita, muaji, viti, vendi dhe sipas mundësisë ora e vdekjes, emri e mbiemri, data e lindjes, profesioni, vendbanimi i përhershëm ose i përkohshëm i bashkëshortit, i fëmijëve të lindur nga martesja, jashtë martesës dhe të fëmijëve të adoptuar. Gjithashtu duhet të shënohet vlera e përafërt e pasurisë së paluajtshme dhe ajo e pasuri së luajtshme, vendi ku gjendet kjo pasuri, letrat me vlerë, gjërat e çmueshme, librezat e kursimit etj. Nëse ka fëmijë të zënë, në aktvdekje do të shënohet se pritet lindja e fëmijës së zënë i cili, nëse lind i gjallë ka të drejtë në trashëgimi, një fakt që është shumë i rëndësishëm për caktimin e radhëve të trashëgimit.

Pas kompletimit të të gjithë dokumentacionit të lartcekur, si në rastin e vdekjes ashtu edhe në atë të shpalljes për të vdekur të personit, trashëgimtarët apo pala e interesuar për hapjen e trashëgimit, parashtrajnë pran gjykatës trashëgimore propozimin për hapjen e trashëgimit së bashku me gjithë dokumentacionin përkatës.

Propozimi për iniciimin e procedurës trashëgimore patjetër duhet të përmbajë: emrin e gjykatës që është kompetente për këtë procedurë, pasuria që duhet të trashëgohet, certifikata e vdekjes e trashëgimlënësit, emrat dhe mbiemrat e trashëgimtarëve të mundur, për të cilët paraqiten certifikatat e lindjes, aktvdekjen dhe në fund lutjen që gjykata trashëgimore pas zhvillimit të procedurës të nxjerr aktvendimin për trashëgim.

Sipas propozimit të paraqitur për iniciimin e procedurës trashëgimore, gjykata cakton seancën e shqyrtimit në të cilën thërret trashëgimtarët e mundur ligjor dhe kërkon nga ata që të japin deklaratën trashëgimore. Ky është një akt pa të cilin trashëgimia nuk realizohet. Trashëgimtarët e mundshëm ligjor, me deklaratën e dhënë, kanë mundësi të pranojnë pjesën e trashëgimisë që u takon sipas ligjit dhe të pjesëve nëse dikush nga trashëgimtarët ligjor heq dorë në favor të atij, mos të pranojnë pjesën trashëgimore që u takon ose të heqin dorë në favor të ndonjërit nga trashëgimtarët apo në favor të gjithë trashëgimtarëve tjerë.

2. Heqja dorë nga trashëgimia;

Heqja dorë nga trashëgimi është shprehje e njëanshme e vullnetit e cila mund të jepet në procedurën e trashëgimit dhe e njëjta shënohet në procesverbalin e shqyrtimit të trashëgimit. Heqja dorë nga trashëgimia, ushtrohet vetëm atëherë kur një person është vënë në dijeni se është trashëgimtar i një pasurie trashëgimore. Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi mund të behet në dy mënyra. E para është kur një deklaratë e tillë bëhet gjatë zhvillimit të procedurës dhe shënohet në procesverbal, ndërsa tjetra bëhet nga distanca, pra atëherë kur personi një deklaratë të tillë e shkruan, e vërteton në gjykatë apo në ndonjë organ tjetër dhe këtë ja parashtron gjykatës kompetente, derisa zhvillohet procedura e trashëgimit.

Shembuj të deklaratave të dhëna trashëgimore në rastet kur trashëgimtari heq dorë në favor të njërit trashëgimtar, në favor të të gjithë trashëgimtarëve dhe në fund, kur heq dorë vetëm në emër të vetin e jo edhe për pasardhësit e tij.

“thirrem në trashëgimi pas vdekjes së babait tim Hasan Hasani, nga Prishtina dhe njëherësh heq dorë nga pjesa trashëgimore që më takon sipas ligjit si dhe nga pjesa nëse eventualisht ndonjëri nga trashëgimtarët heqin dorë në emër timin, në favor të vëllait tim Hysen Hasani, nga Prishtina. Trashëgimtarëve tjerë nuk ua mohoj të drejtën në trashëgimi”

“thirrem në trashëgimi pas vdekjes së babait tim Hasan Hasani, nga Prishtina dhe njëherësh heq dorë nga pjesa trashëgimore që më takon sipas ligjit dhe nga pjesa nëse eventualisht ndonjëri nga trashëgimtarët heqin dorë në emër timin, në favor të trashëgimtarëve tjerë, në pjesë të barabarta. Trashëgimtarëve tjerë nuk ua mohoj të drejtën në trashëgimi”

“thirrem në trashëgim pas vdekjes së babait tim Hasan Hasani, nga Prishtina dhe njëherësh heq dorë nga pjesa trashëgimore që më takon sipas ligjit dhe nga pjesa nëse eventualisht ndonjëri nga trashëgimtarët heqin dorë në emër timin. Kjo heqje dorë nga trashëgimia nuk vlen për pasardhësit e mijë. Trashëgimtarëve tjerë nuk ua mohoj të drejtën në trashëgimi”

Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi, vlen edhe për pasardhësit e atij që ka hequr dorë nga trashëgimi, përveç nëse shprehimisht ka deklaruar se heq dorë vetëm në emër të vet. Në rast se pasardhësit e personit që heq dorë nga trashëgimia janë të mitur, për heqjen dorë nga trashëgimia nuk nevojitet leja e Organit të Kujdestarisë. Trashëgimtarit i cili ka hequr dorë nga trashëgimi në emër të vetin, konsiderohet sikur të mos ketë qenë trashëgimtar.

Heqja dorë nga trashëgimi do të jetë e pavlefshme kur ajo behet me kusht, me afat, ose për një pjesë të trashëgimit. Ndërsa sa i përket të drejtës që të heqin dorë nga trashëgimi, shtrohet pyetja nëse kjo e drejtë u takon të gjithëve trashëgimtarëve. Ligji i Trashëgimisë i Kosovës, këtë të drejtë i'a mohon vetëm trashëgimtarit i cili ka disponuar tërë pasurinë ose një pjesë të sajë, pra ky trashëgimtar nuk mundet të deklarohet për heqjen dorë nga trashëgimi.

Duhet theksuar se heqja dorë nga trashëgimi që nuk është hapur nuk ka kurrfarë efekti juridik, për shkak se vetëm atëherë kur personi është vënë në dijeni të faktit që është trashëgimtar në një pasuri trashëgimore, vetëm atëherë ai mund të heq dorë nga trashëgimia e cila ka kaluar në favor të tij.

Deklarata për heqjen dorë nga trashëgimi apo për pranimin e trashëgimisë nuk mund të revokohet. LTK njeh të drejtën e kërkesës për anulimin e deklaratës për heqjen dorë nga trashëgimia. Në këtë rast trashëgimtarit apo pasardhësit e tij, mund të kërkojnë anulimin e kësaj deklarate në rast se deklarata është dhënë me kanosje, dhunë, për shkak të mashtrimit ose lajthimit. Këto janë bazat të mjaftueshme që të kërkohet anulimi i kësaj deklarate. Pra, këtë të drejtë e kanë titullarët e kësaj deklarate dhe pasardhësit e tij.

3. Ndarja e pasurisë trashëgimore;

Secili trashëgimtar ka të drejtë që të kërkojë ndarjen e trashëgimisë, duke pasur parasysh që kjo ndarje të mos kërkohej në kohën e papërshtatshme. Kjo e drejtë nuk parashkruhet.

Çfarëdo kontrate me të cilën trashëgimtarit heq dorë nga e drejta që të kërkojë ndarjen si dhe çdo testament me të cilin ndalohet e drejta që të kërkojë ndarjen e pasurisë është nule, dhe ashtu që ato nuk prodhojnë kurrfarë efekti juridik.

4. Vjetërsimi i të drejtës për të kërkuar pasurinë trashëgimore

Me ligj janë të parashikuara afatet ligjore pas kalimit të cilëve vjetërsohet e drejta të kërkohej trashëgimia. Në këtë mënyrë, kjo e drejtë ndaj poseduesit me mirëbesim

E DREJTA TRASHËGIMORE

vjetërsohet brenda një viti nga dita që trashëgimtari ka kuptuar për të drejtën e vetë dhe për poseduesit e sendeve nga pasuria trashëgimore, si afat subjektiv përkatësisht brenda 10 vjetësh, si afat objektiv, për trashëgimtarin ligjor nga dita e vdekjes së trashëgimlënësit, ndërsa për atë testamentar nga shpallja e testamentit, kur edhe llogaritet se trashëgimtari ka kuptuar për testamentin. Me kalimin e afateve të sipërshënuara pason vjetërsimi relativ i kësaj të drejte.

Nëse poseduesi i pasurisë trashëgimore ka qenë me keqbesim, kjo e drejtë vjetërsohet pas kalimit të afatit prej 20 vjetësh nga koha si është përshkruar më sipër.

■ E DREJTA E DETYRIMEVE

1. *Nocioni i detyrimeve*

E drejta e detyrimeve është një degë e veçantë e së drejtës dhe bën pjesë në grupin e lëndëve civile. Në kuptimin objektiv, ajo përfshin normat juridike, të cilat rregullojnë marrëdhëniet juridike të detyrimeve. Regullativa juridike pozitive në Kosovë nuk e pëcakton kuptimin e marrëdhënies juridike të detyrimeve, siç nuk e bëjnë këtë edhe shumë kode civile dhe ligje të marrëdhënies të detyrimeve në të drejtën krahasuese.

Më përcaktimin e nocionit të marrëdhënies të detyrimeve merret doktrina e së drejtës së detyrimeve. Në këtë doktrinë ekzistojnë shumë përkufizime përkitazi me kuptimin e marrëdhënies të detyrimeve, ndër të cilët zotëron përkufizimi sipas të cilit marrëdhëniet e detyrimeve janë marrëdhënie juridike mes dy subjekteve, nga të cilat njëri quhet debitor dhe tjetri kreditor, sipas të cilave kreditori ka të drejtë të kërkojë nga debitori një dhënie (dare), bërje ose veprim (facere), mos bërje (non facere) ose pësim (pati), ndërsa debitori është i detyruar që ta përmbushë atë.

Megjithatë në disa kode civile është përcaktuar nocioni i detyrimit. Sipas Kodit Civil të Shqipërisë detyrimi është një marrëdhënie juridike, me anën e së cilës një person (debitori) detyrohet të japë diçka ose të kryejë a të mos kryejë një veprim të caktuar në dobi të një personi tjetër (kreditori), i cili ka, gjithashtu, të drejtë të kërkojë t'i jepet diçka ose të kryhet apo të mos kryhet veprimi (neni 419).

E drejta e detyrimeve, në kuptimin subjektiv, përfshin pushtetin juridik të subjekteve pjesëmarrëse në marrëdhëniet e detyrimeve, të cilin e nxjerrin nga e drejta objektive e që ka të bëjë me autorizimet e kreditorit për të kërkuar nga debitori përmbushjen e detyrimeve të caktuara.

Fjala detyrim rrjedh nga fjala latine obligatio që do të thotë lidhje, ndërsa në të drejtën romake është kuptuar si lidhje mes debitorit dhe kreditorit.

Çdo detyrim përmban kërkesën e caktuar të kreditorit dhe detyrimin e debitorit, përkatësisht borxhin e debitorit.

E drejta e detyrimeve përfshin normat juridike, të cilat rregullojnë marrëdhëniet pasurore mes personave. Pra, ajo merret me kalimin e pasurisë nga pasuria e një subjekti në pasurinë e subjektit tjetër, kalim ky që bëhet me vullnetin e palëve ose kundër vullnetit të tyre dhe me shpërblim ose pa shpërblim. E drejta e detyrimeve, si degë e së drejtës, e cila merret me studimin e marrëdhënies të detyrimeve me anë të cilave bëhet qarkullimi i mallrave dhe i shërbimeve, është superstrukturë në ekonominë e tregut.

Subjektet e detyrimeve

Marrëdhënia e detyrimeve është marrëdhënie juridike mes dy a më shumë subjekteve me cilësi të kreditorit dhe debitorit, me kërkesa dhe detyrime të ndërsjella, të cilët Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD) i cilëson si pjesëmarrës në

marrëdhëniet e detyrimeve. Çdo marrëdhënie e detyrimeve supozon ekzistimin e dy anëve - palëve, prandaj do të ishte më e drejtë të flitet për palët e marrëdhënies të detyrimeve, në cilësinë e të cilave paraqiten subjektet si pjesëmarrës, të cilët, sipas LMD, mund të jenë persona fizikë dhe persona juridikë. Pjesëmarrës në marrëdhëniet e detyrimeve, janë personat juridikë shoqërorë, personat fizikë dhe personat juridikë civilë. Personat juridikë shoqërorë paraqiten në forma të ndryshme të organizimit, si: ndërmarrje, shoqëri tregtare, bashkësi politiko- shoqërore, institucione të tjera, siç janë bashkësitë për sigurimin e pasurisë dhe të personave, kooperativat bujqësore etj. Ndërkaq, personat juridiko-civilë mund të paraqiten në formë të institucioneve të ndryshme, siç janë: bashkësitë fetare, fondacionet e themeluara me mjete të individëve ose anëtarëve të ndonjë asociacioni, të cilat kanë destinim të caktuar për arritjen e ndonjë qëllimi të caktuar humanitar, shkencor, kulturor etj. ose institucione në formë asociacionesh të ndryshme, të cilat ushtrojnë ndonjë veprimtari të caktuar ekonomike, të regjistruar pranë organit kompetent për regjistrimin e biznesit.

Karakteristikat e marrëdhënies të detyrimeve

Është thënë se marrëdhëniet juridike e detyrimeve është ajo marrëdhënie që është e rregulluar me rregulla juridike të së drejtës së detyrimeve. Për dallim nga marrëdhëniet e tjera faktike, materiale ekonomiko-shoqërore, LMD nuk flet për karakteristikat e marrëdhënies të detyrimeve, me të cilat merret teoria juridike. Për dalim nga marrëdhëniet e tjera faktike materiale ekonomiko – shoqërore, në shkencën juridike ekziston mendimi se marrëdhëniet e detyrimeve kanë këto karakteristika:

- 1) Marrëdhëniet e detyrimeve janë marrëdhënie juridike, ngase janë të rregulluara me norma juridike. Në të vërtetë, nga faktet juridike përkatëse e drejta e detyrimeve lidh: krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënies juridike të detyrimeve. Fakti se në marrëdhëniet e detyrimeve subjektet pjesëmarrëse kanë të drejta dhe detyrime të ndërsjella dhe se prestimet nuk përmbushen gjithëherë me vullnet, për realizimin e prestimeve në raste të tilla ekziston sanksioni civilo-juridik dhe mënyra e parashikuar me norma juridike, me të cilën debitori, detyrohet përmes gjykatës të përmbushë detyrimin e vet.
- 2) Marrëdhëniet e detyrimeve janë me karakter relativ. Parimisht, ato kanë efekt juridik ndaj subjekteve pjesëmarrëse në to - ndaj kreditorit dhe debitorit. Për dallim nga e drejta reale, që ka karakter absolut dhe Kalorësi i saj ka pushtet të kërkojë nga çdonjëri sjellje të caktuar, marrëdhënie juridike të detyrimeve kanë efekt inter partes dhe kreditori mund të kërkojë një sjellje të caktuar vetëm ndaj debitorit. Përfundim nga ky parim bëjnë rastet e lidhjes së kontratës në dobi të personit të tretë. Kur dikush kontraktin, në emër të vetin, kërkesë në dobi të personit të tretë, ky i fundit fiton të drejtën e tij të drejtpërdrejtë ndaj debitorit, po qe se nuk është kontraktuar diçka tjetër ose nuk rezulton nga rrethanat e veprimit juridik.

- 3) Marrëdhëniet detyrimore janë marrëdhënie juridike të krijuara mes personave të caktuar të kreditorit, i cili është i autorizuar të kërkojë një dhënie, një bërje, një mos bërje ose një pësim dhe debitorit, i cili është i detyruar ta përmbushë prestimin e caktuar të kreditorit. Në anën e kreditorit ose të debitorit mund të jenë, si pjesëmarrës të detyrimit, një apo më shumë persona. Te detyrimet me shumë persona, siç është rasti me detyrimet e pjesëtueshme ose detyrimet solidare, në anën e kreditorit apo të debitorit mund të ketë dy apo më shumë të tillë.
- 4) Marrëdhëniet detyrimore janë me përmbajtje të caktuar. Secila anë në marrëdhëniet e detyrimeve ka autorizime të kërkojë nga pala tjetër përmbushjen e një prestimi me përmbajtje të caktuar dhe detyrime. Te kontrata e shitblerjes, shitësi është i detyruar t'ia dorëzojë sendin blerësit në pronësi, përkatësisht në disponim, ndërsa blerësi t'ia paguajë shitësit çmimin e shitblerjes. Kreditori, si titullar i së drejtës së servitutës, është i autorizuar ta shfrytëzojë të drejtën e kalimit nëpër pasurinë e paluajtshme të pronarit, ndërsa pronari, si debitor sipas kontratës ose bazës tjetër juridike të fitimit të së drejtës së servitutës, është i detyruar të pësoj ë dhe kreditorit t'i lejojë kalimin nëpër paluajtshmërinë e caktuar, edhe pse sipas ligjit nuk do të pësonte një kalim të tillë, sikur të mos ekzistonte baza juridike, mbi të cilën është fituar e drejta e servitutës.
- 5) Marrëdhëniet e detyrimeve janë me karakter pasuror. Karakteri pasuror i marrëdhënieve të detyrimeve i dallon këto nga marrëdhëniet e tjera juridike. Nga përvoja e përgjithshme mund të thuhet se njerëzit, për t'i plotësuar nevojat e veta materiale, janë të prirur ndaj njëri-tjetrit dhe se, me anë të marrëdhënieve të detyrimeve, i plotësojnë ato nevojat, ngase, në kuadër të tyre, zhvillohet qarkullimi i rregullt ekonomik i të mirave materiale dhe shërbimeve. Marrëdhëniet e detyrimeve janë marrëdhënie pasurore, që shprehen me vlera ekonomike dhe vlerësohen me para. Nga ky rregull bëjnë përjashtim veprimet juridike bamirëse me detyrime të njëanshme, të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në pasurinë e debitorit.

Burimet e marrëdhënieve të detyrimeve

Në teorinë juridike janë të njohura dy lloje të burimeve të së drejtës së detyrimeve: burimet formale dhe burimet materiale të së drejtës. Në teorinë juridike ekziston mendimi sipas të cilit burimet formale janë forma dhe trajta me të cilat paraqiten rregullat juridike, të cilat rregullojnë marrëdhëniet detyrimore. Burimet formale të së drejtës së detyrimeve në Kosovë, aktualisht, janë të shumta dhe të shpërndara, ngaqë nuk ekziston një ligj unik a kod civil. Tani për tani, si burime formale së drejtës së detyrimeve duhen konsideruar: akti më i lartë juridik, Ligji për M marrëdhëniet e Detyrimeve, aktet ligjore dhe aktet e tjera (shtetërore) të përgjithshme nënligjore.

Aktet juridike sipas fuqisë juridike që kanë një hierarki

Shteti, përkatësisht subjekti që ka në dispozicion monopolin e pushtetit shtetëror, cakton se çka është burim i së drejtës dhe përcakton hierarkinë e këtyre burimeve. Neni 16 i Kushtetutës¹⁸ së Kosovës parasheh se Kushtetuta është akti më i lartë juridik i Republikës së Kosovës. Ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me këtë Kushtetutë. Nga kjo rrjedhë se në rast mospajtimi midis Kushtetutës së Kosovës dhe çdo ligji të Kuvendit, përparësi zbatimi ka Kushtetuta. Pastaj kemi Ligjin për Marrëdhëniet e Detyrimeve. Rregullorja e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe 2000/59 të cilat parashohin ligjin në fuqi në Kosovë sipas së cilit ligji në fuqi në Kosovë janë: Rregulloret e shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to (neni 1.par.1.1(a)dhe legjisllacionin në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989, por në qoftë se një çështje nuk mund të mbulohet nga legjisllacionin nën par. 1.1 (a), ajo do të vihet nën një ligji tjetër që ka qenë në fuqi në Kosovë pas 22 marsit 1989, me kusht që të mos jetë diskriminues dhe të jetë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të parashikuara me konventat ndërkombëtare (par 1.2 - 4).

Sistemi juridik në Kosovë është në ndërtim e sipër dhe për këtë arsye hierarkia e burimeve formale juridike të së drejtës së detyrimeve do të ishte jo e plotë. Megjithatë, nga ajo që u tha më sipër mund të thuhet se aktualisht si burime formale juridike të kësaj dege juridike mund të përmendën këto akte të përgjithshme juridike pozitive:

- 1) rregulloret e shpallura nga PSSP dhe instrumentet ndihmëse të nxjerra në përputhje me to;
- 2) ligjet në fuqi në Kosovë më 22 mars 1989;
- 3) në kushtet e caktuara me ligj, edhe ligjet që ishin në fuqi në Kosovë e të nxjerra pas 22 marsit 1989, të cilat nuk janë diskriminuese dhe janë në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare, të parashikuara me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- 4) konventat ndërkombëtare, të cilat sipas kapitullit II neni 22 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës e të cilat mund të zbatohen drejtpërsëdrejti, si pjesë e Kushtetutës dhe në mënyrë të tërthortë.
- 5) Praktika e gjykatave dhe shkenca juridike.

Burimet materiale të së drejtës së detyrimeve

Marrëdhëniet juridike të detyrimeve së pari paraqiten si marrëdhënie faktike, materiale ekonomiko - shoqërore. Marrëdhëniet ekonomiko - shoqërore krijohen, ndryshohen dhe shuhen atëherë kur në jetën reale lindin disa fakte përkatëse. Kjo vlen edhe për marrëdhëniet detyrimore. Pasi që e drejta e detyrimeve, e cila shërben si rregulluese i marrëdhënieve të detyrimeve, medoemos duhet ta respektojë strukturën ekzistuese të marrëdhënieve ekonomike, edhe marrëdhënia juridike e detyrimeve mund të krijohet, të ndryshojë ose të shuhet, po ashtu, kur lindin fakte të caktuara. Faktet e

18 Kushtetuta e Republikës së Kosovës e miratuar me dt. 09.04.2008 e cila ka hyrë në fuqi me dt. 15.06.2008,

tilla quhen fakte juridike. Pra, fakte juridike janë të gjitha ato fakte të nevojshme për të cilat e drejta, në këtë rast e drejta e detyrimeve, e lidh krijimin, ndryshimin ose shuarjen e marrëdhënieve juridike të detyrimeve, e lidhur me të edhe krijimin, ndryshimin ose shuarjen e së drejtës subjektive të detyrimeve.

Burimet juridike materiale të detyrimeve janë fakte juridike nga të cilat krijohen, ndryshohen dhe shuhen marrëdhëniet juridike të detyrimeve. LMD, përmban dispozita të veçanta për burimet materiale të marrëdhënieve të detyrimeve, ashtu që me këtë ligj rregullohen marrëdhëniet e detyrimeve, të cilat krijohen nga kontrata, shkaktimi i dëmit, fitimi pa bazë, gjërimi (kryerja) e punëve pa urdhër, deklarimi i njëanshëm i vullnetit dhe faktet e tjera të caktuara me ligj. Këto burime materiale të marrëdhënieve të detyrimeve janë të rregulluara në pjesën e përgjithshme të këtij Ligji.

Parimet themelore të Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve

LMD në pjesën e parë përmban parimet themelore të marrëdhënieve juridike të detyrimeve, të formuluar në dispozitat e nenit 1 - 14. Nisur nga nevojat për të cilat është destinuar doracak, mjafton të flitet për disa parime, të cilat janë më të rëndësishmet e që mund të shërbejnë si ide udhërrëfyese të zbatimi i dispozitave përkatëse të ligjit.

Parimi i lirisë së rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve

E drejta e detyrimeve është një superstrukturë e marrëdhënieve të mallit dhe të hollave dhe e ekonomisë së tregut. Në çdo shoqëri, në të cilën ekziston prodhimi i mallrave dhe shkëmbimi i tyre, medoemos duhet të ekzistojë edhe e drejta e detyrimeve me institucionet e saja themelore, ndër të cilat bën pjesë liria e kontraktimit. Se në çfarë mase ekziston liria e rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve varet nga sistemi shoqëror i një shteti dhe sistemi i marrëdhënieve ekonomike. Parimi i lirisë së rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve është i pranuar në të gjitha sistemet juridike të shteteve me ekonomi tregu. Kufijtë e këtij parimi varen nga ajo se në ç' masë normat juridike, të cilat i rregullojnë marrëdhëniet e detyrimeve, janë me karakter dispozitiv.

Parimi i lirisë së rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve, sipas LMD, është shprehur në dispozitën e nenit 2, sipas së cilës, pjesëmarrësit në qarkullim i rregullojnë lirisht marrëdhëniet e detyrimeve. Sipas dispozitës së nenit 2 të këtij Ligji, pjesëmarrësit mund t'i rregullojnë ndryshe marrëdhëniet e veta të detyrimeve nga ajo se si është caktuar me këtë Ligj, në qoftë se nga ndonjë dispozitë e këtij Ligji ose nga kuptimi i saj nuk rezultojnë diçka tjetër.

Pra, nga kjo dispozitë rezultojnë qëndrimi i së drejtës së detyrimeve në të drejtën pozitive në Kosovë – autonomia e vullnetit është rregull, kurse kufizimi është përjashtim.

Liria e rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve qëndron në atë se pjesëmarrësit e atyre marrëdhënieve: 1. vendosin vetë se a do të krijojnë marrëdhënie të detyrimeve, 2. e zgjedhin vetë palën tjetër me të cilën do të krijojnë marrëdhënien e detyrimeve, 3. e caktojnë vetë përmbajtjen e marrëdhënieve të veta të detyrimeve, 4. në kuadër të dispozitave juridike të karakterit dispozitiv, 5. e caktojnë vetë të drejtën e aplikueshme,

dhe 6. në rastet e caktuara me ligj, në rast kontesti, vendosin vetë se a do t'ia besojnë zgjidhjen e tij gjykatës apo arbitrazhit.

Kufijtë e lirisë së rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve

Në të gjitha shtetet me ekonomi tregu shteti, me rregullativë juridike, ndërhyjnë në lëmin e lirisë së rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve, duke përcaktuar kufijtë, që i përgjigjen “Rendit publik” të çdo shteti. Është parim juridik se e gjithë ajo që nuk është e ndaluar është e lejuar, mirëpo, me intervenimin e shtetit hapësira e autonomisë së vullnetit është kufizuar, ngase me “Rendin publik” (në të drejtën komparative “Order publik”), me të cilin kuptohen të gjitha ato rregulla të cilat me kontratë nuk mund të preken, caktohet minimumi i ndalesave.

Kufizimi i lirisë së rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve është shprehur në dispozitat e LMD, sipas së cilave është caktuar që pjesëmarrësit nuk mund t'i rregullojnë marrëdhëniet e detyrimeve në kundërshtim me parimet e rregullimit shoqëror të caktuara me Kushtetutë, dispozitat imperative dhe rregullat e moralit shoqëror. Kritere të njëjta janë caktuar për vlerësimin e lejueshmërisë së Objektit të detyrimeve. Objekti e detyrimeve nuk është i lejueshëm, në qoftë se është në kundërshtim me dispozitat imperative, rendin publik dhe doket e mira (neni 4.2 i LMD), kur baza e detyrimeve është e palejueshme (neni 37 dhe 39 i LMD), kur flitet për nulitetin e kontratës lidhur me kushtin e palejuar ose të pamundur (neni 35, 61 e 125 të LMD) dhe vlefshmërinë juridike të kontratës.

Doket e mira, përkatësisht rregullat e moralit, kanë të bëjë me të gjithë atë që nuk është përfshirë në dispozitat imperative dhe rendin publik.

Barazia juridike e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve

Barazia juridike e pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve, përkatësisht kontraktore, nënkupton pozitën e barabartë të pjesëmarrësve në fitimin e të drejtave, kalimin e detyrimeve dhe përgjegjësisë. Sipas LMD, barazia juridike është një ndër parimet themelore të së drejtës kontraktore, ashtu që në dispozitën e nenit 3 të këtij Ligji ky parim është shprehur me maksimumin se “pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të barabartë”. Legjislacioni krahasues tregon se në shoqëritë ekonomike të zhvilluara shteti, me legjislacionin e vet, gjithnjë e më shumë ndikon në rregullimin e marrëdhënieve shoqërore në përgjithësi, pra edhe të atyre kontraktore. Në të drejtën e detyrimeve mund të thuhet në pikëpamje të mbrojtjes së pjesëmarrësve ekonomike më të dobët nga ata që janë më të fortë. Mbrojtja u nevojitet konsumatorëve dhe biznesmenëve të vegjël. Barazia e palëve në marrëdhëniet kontraktore, e cila synohet të arrihet me këtë parim ligjor, shpesh nuk ekziston, ngase sot rrallë mund të ndodhë që palët kontraktuese të gjenden në pozitë të barabartë. Kjo ndodhë jo vetëm te kontratat e ad-hezionit - formulare, por edhe më gjerë, gjë që kërkon mbrojtje të cilën pjesërisht e siguron ligji, i cili i rregullon marrëdhëniet kontraktore.

Parimi i ndërgjegjshmërisë dhe i ndershmërisë

Parimi i ndërgjegjshmërisë dhe i ndershmërisë është një ndër parimet dominante, i cili është i gërshtuar në tërë të drejtën e detyrimeve. Ky parim ka ekzistuar edhe në të drejtën romake, i njohur si bona fides, që do të thotë: besnikëri dhe mbajtja e fjalës së dhënë, sjellje me mirëbesim. Ky parim është i pranuar në të gjitha shtetet e civilizuar. Bona fides është kriter për sjellje në marrëdhëniet e detyrimeve - në qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimeve. Ky parim ka qenë i parashikuar në nenin 3 të uzansave të përgjithshme për qarkullimin e mallrave që nga viti 1954, por LMD, në nenin 4, e ka përmirësuar formulimin e këtij parimi, ashtu që është parashikuar që në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe realizimin e të drejtave dhe detyrimeve nga ato marrëdhënie, pjesëmarrësit janë të detyruar t'i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe të nderit. Funkzioni i këtij parimi është dhënia e formës dhe vërtetimit më të afërt të përmbajtjes së një marrëdhënieje ekzistuese të detyrimeve, si dhe ekzistimit të një marrëdhënieje të tillë. Parimi i ndërgjegjshmërisë dhe i ndershmërisë shërben si themel juridik për situatat e rishkaktuara të institucioneve juridike. Ky parim e detyron si atë që ushtron të drejtën e vet, ashtu edhe atë që e përmbush detyrimin që, me rastin e përmbushjes së detyrimit, të marrë parasysht edhe interesat e palës tjetër. Ky parim u referohet kriterëve më të gjera juridike dhe jo juridike të sjelljes. Detyrë e praktikës së gjykatave dhe e shkencës juridike është që ato kriterë t'i konkretizojnë, duke i mbajtur parasysht marrëdhëniet juridike, për të cilat është fjala, meqë synimi thelbësor i këtij parimi këtu paraqitet mbrojtja e besimit të ndërsjellë në marrëdhëniet e detyrimeve. Edhe pse LMD nuk ka dispozita shprehimore, nga dispozita e nenit 85 del se parimi i ndërgjegjshmërisë dhe i ndershmërisë është kriter themelor i interpretimit të veprimeve juridike dhe akteve juridike. Sipas kësaj dispozite, me rastin e interpretimit të dispozitave kontestuese të kontratave nuk është e thënë t'i përmbahemi shkronjë për shkronjë domethënies së shprehjeve të përdorura në një kontratë, por duhet të hulumtohet qëllimi i kontraktuesve, domethënë kjo dispozitë duhet kuptuar ashtu që ajo t'u përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve të caktuara me këtë ligj.

Parimi i ndërgjegjshmërisë dhe i nderit është një rregull e sjelljes mbi marrëdhëniet e ndërsjella të palëve kontraktuese dhe rregull e moralit në raportet shoqërore në shoqëri. Prandaj, “ndërgjegjshmëria dhe nderi” vlerësohen në pajtim me moralin.

Ndalimi i keqpërdorimit të së drejtës

E drejta objektive ua pranon individëve të drejtat subjektive civile, përkatësisht të drejtat e detyrimeve. Titullarët e së drejtës, duke i ushtruar të drejtat e tyre subjektive, mund të ndodhë t'ua cenojnë subjekteve të tjera të drejtat e tyre. Lidhur me keqpërdorimin e së drejtës, ekzistojnë dy teori: teoria subjektive, sipas së cilës duhet të ekzistoj qëllimi i bartësit të së drejtës që tjetrit t'i shkaktohet dëmi, duke ushtruar një të drejtë të veten dhe teoria objektive, sipas së cilës mjafton që të ekzistojë ushtrimi i padrejtë i së drejtës së bartësit, në kundërshtim me qëllimin për të cilin i është pranuar ajo e drejtë dhe ajo të konsiderohet keqpërdorim i së drejtës.

Institucionin juridik të keqpërdorimit të së drejtës LMD e ka rregulluar, duke ndaluar ushtrimin e së drejtës nga marrëdhëniet e detyrimeve në kundërshtim me qëllimin për të cilin ajo është themeluar ose është pranuar me ligj.

Mirëpo, duhet dalluar keqpërdorimin e së drejtës nga përgjegjësia për rrezikun, në rastin kur edhe me ushtrimin e rregullt të së drejtës tjetrit i shkaktohet dëmi, i cili medoemos duhet t'i shpërblehet në tërësi.

Se a ekziston keqpërdorimi i së drejtës në marrëdhëniet e detyrimeve, gjykatat në çdo rast konkret nisen nga qëllimi i palëve kontraktuese, duke iu përmbajtur edhe parimit bona fides.

Ndalimi i shkakimit të dëmit

Dispozita e LMD, e cila përmban parimin e shkakimit të dëmit, është një dispozitë juridike, me të cilën caktohet detyrimi juridik i të përmbajturit (frenimit) nga shkaktimi i dëmit tjetrit. Çdokush është i detyruar të përmbahet nga veprimet me të cilat mund t'i shkaktohet dëmi tjetrit (neni 9 i LMD). Sanksioni i një detyrimi të tillë është parashikuar me dispozitat e tjera, të cilat kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit (neni 169 i LMD) etj.

Detyrimi për t'u përmbajtur nga shkaktimi i dëmit nuk ka të bëjë vetëm me veprimet aktive (bërja), por edhe me veprimet pasive (mos bërja), kur mund të kontribuohet në shkaktimin e dëmit ose që dëmi të jetë më i madh. Detyrimi juridik i përmbajtjes nga veprimi aktiv është rregull, kurse detyrimi juridik i përmbajtjes nga qëndrimi pasiv duhet të ketë bazë juridike në ligj, në kontratë ose në ndonjë akt tjetër juridik.

Veprimet me të cilat mund t'i shkaktohet dëmi tjetrit, parimisht, janë të kundërligjshme. Mirëpo, kjo rregull nuk mund të jetë absolute. Nga kjo rregull bëjnë përjashtime rastet e shkakimit të dëmit gjatë ushtrimit të veprimtarisë me interes të përgjithshëm dhe në bazë të lejes së lëshuar nga organi shtetëror kompetent, në kushtet e parashikuara me ligj, me rastin e mbrojtjes së nevojshme, nevojës ekstreme, vetë ndihmës së lejuar dhe pranimit të të dëmtuarit me veprimin dëmtues të tjetrit.

Parimi pacta sunt servanda

Pacta sunt servanda është një ndër parimet themelore të së drejtës kontraktore. Ky është parashikuar në dispozitën e nenit 8 par. 1 të LMD. Sipas kësaj dispozite, pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve janë të detyruar t'i përmbushin detyrimet e veta dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre. Detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullnetit të pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve ose në bazë të ligjit. Nga kjo rregull bëhet përjashtim në rast të lindjes së rrethanave të jashtëzakonshme dhe në rast të ndryshimit të rrethanave pas lidhjes së kontratës (neni 565-566 të LMD).

Ky parim është në pajtim me parimin e lirisë së rregullimit të marrëdhënieve të detyrimeve dhe duhet të respektohet me rreptësi.

Parimi i sjelljes në përmbushjen e detyrimeve dhe realizimin e të drejtave

Nga pjesëmarrësit në marrëdhëniet e detyrimeve, LMD kërkon që në përmbushjen e detyrimeve dhe realizimin e të drejtave të veprojnë me kujdesin që kërkohet në qarkullimin juridik në llojin përkatës të marrëdhënies të detyrimeve. Pjesëmarrësi në marrëdhëniet e detyrimeve është i detyruar që, në përmbushjen e detyrimit të vet, të veprojë me kujdesin e “shtëpiakut të mirë” ose të “ekonomistit të mirë”, varësisht prej asaj se a është fjala për marrëdhënie juridiko-civile apo juridiko-ekonomike të marrëdhënies së detyrimit (neni 5 par. 1 i LMD). Derisa nga qytetarët kërkohet kujdesi i shtëpiakut të mirë, nga pjesëmarrësit e veprimtarive profesionale kërkohet kujdesi i shtuar sipas “rregullave të profesionit dhe të zakoneve” (neni 5 par. 2 i LMD).

Kriteri për vlerësimin e kujdesit është objektiv, duke filluar nga kujdesi i tipit abstrakt, duke pasur kujdes për interesat e ndërsjella të kreditorit dhe të debitorit. Në këtë mënyrë arrihet siguria juridike në qarkullimin juridik.

LMD kërkon edhe nga kreditori të përmbahet nga veprimet me të cilat do t’ia vështirësonte përmbushjen e detyrimit të vet palës tjetër - debitorit (neni 6 par. 3 i LMD), ngase në veprimet juridike me detyrime të dyanshme të dy palët kanë pozitën edhe të kreditorit edhe të debitorit, kështu që veprimet me të cilat vështirësohet pozita e debitorit kanë për pasojë uljen e përgjegjësisë së debitorit, por kanë pasojë edhe për vetë kreditorin në rastet e caktuara me ligj.

KRIJIMI I DETYRIMEVE

Pjesa e 1

KONTRATA

1) Kontrata si burim i marrëdhënies të detyrimeve

Kontrata është burimi themelor i marrëdhënies të detyrimeve në të gjitha sistemet juridike. Nocioni i kontratës gjithashtu është i njëjtë në të gjitha sistemet juridike, d.m.th., ajo është marrëveshje, përkatësisht manifestim i ndërsjellë i pajtimit të vullnetit të dy a më shumë personave të caktuar dhe ka për qëllim të krijojë, të ndryshojë a të shuajë një ose më tepër marrëdhënie të detyrimeve.

Kontrata është një veprim i dyanshëm juridik, me të cilin arrihet ndonjë efekt juridik detyrimor. Kontrata është institut i së drejtës civile. Kontratën në të drejtën detyrimore e dallon karakteri i saj pasuror nga kontratat në degët e tjera të së drejtës. Në të drejtën e detyrimeve dhe ekonomike ka hapësirë të gjerë të zbatimit si në qarkullimin e mallrave, ashtu edhe në dhënien e shërbimeve ndërmjet pjesëmarrësve në marrëdhëniet e detyrimeve.

2) Lidhja e kontratës

Kushtet e përgjithshme

Kontrata lind me pajtimin e vullnetit të palëve. Ajo supozon persona të caktuar që shprehin vullnetin, me të cilën dëshirojnë të arrijnë ndonjë efekt juridik. Për të lindur një kontratë dhe për të prodhuar efekt juridik, medoemos duhet të plotësohen këto kushte të përgjithshme: 1. aftësia punuese e palëve; 2. pajtimi i vullnetit të palëve kontraktuese, 3. objekti i kontratës, 4. baza ose kauzës i kontratës dhe, te kontratat formale, edhe forma e kontratës e parashikuar me ligj. Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe janë të nevojshme për lidhjen e çdo kontrate.

Kushtet e veçanta

Në teori, si kushte të veçanta përmenden: 1. forma e kontratës, 2. dhënia e pëlqimit për lidhjen e kontratës dhe 3. te lidhja e kontratës me dorëzimin e sendit, dorëzimi i sendit.

Kushtet e përgjithshme të kontratës dallohen nga elementet thelbësore të kontratës, ngase kushtet e përgjithshme janë të domosdoshme për lindjen e çdo kontrate, ndërsa elementet thelbësore janë të nevojshme për lindjen e kontratës konkrete.

Aftësia punuese e kontraktimit është kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës. Personi i cili lidh kontratën duhet të ketë aso cilësish që, me veprimet e veta, deklarimin e vullnetit të vet, me kontratë të fitojë të drejta dhe të krijojë detyrime.

Sipas LMD, për lidhjen e kontratës juridikisht të vlefshme nevojitet që kontraktuesi të ketë aftësi veprimi, e cila kërkohet për lidhjen e një kontrate të tillë (neni 41 i LMD). Aftësinë kontraktuese personi e fiton me arritjen e moshës madhore. Se kur arrihet moshë madhore është caktuar me dispozitat e së drejtës familjare. Një aftësi të tillë mund ta fitojë edhe personi i mitur me anë të emancipimit në rastin kur, në bazë të vendimit të gjykatës kompetente, i lejohet lidhja e martesës edhe para moshës madhore. I mituri i moshës 15 vjeç, po qe se është i punësuar, mund të lidhë kontratë në mënyrë të pavarur, në kuadër të të ardhurave të tij të fituara nga marrëdhënia e punës. I mituri deri në moshën 14 vjeçe nuk posedon aftësi kontraktuese, Aftësinë e kufizuar kontraktuese e fiton prej moshës 14-18 vjeç. Kontrata e lidhur nga personi deri në moshën 14 vjeç është e nule. Mirëpo, kontrata me të cilën personi i mitur me pa aftësi vepruese fiton vetëm dobi materiale (p.sh. kontrata e faljes dhe kontratat e dyanshme detyrimore që kanë objekt shitjeje sendet me vlerë të vogël - blerja e gazetës ditore, bukës, sendeve ushqimore në shitore, prodhon efekt juridik. Kontratat e lidhura nga personat me aftësi të kufizuar vepruese, pa lejen e përfaqësuesit ligjor, janë relativisht nule, por mund të konvalidohen me dhënien e lejes më vonë.

Kontraktuesi i personit me pazotësi për të vepruar, i cili ka lidhur me të kontratë pa lejen e përfaqësuesit ligjor, mund ta thërrasë këtë të fundit që të deklarohet nëse pranon ose jo atë kontratë. Nëse përfaqësuesi ligjor nuk deklarohet brenda afatit prej 30

ditësh nga dita e një ftese të tillë, konsiderohet se e ka refuzuar pranimin (neni 43 par. 2 i LMD). Pala e aftë për të vepruar mund të kërkojë anulimin e kontratës, të cilën e ka lidhur gjatë kohës së aftësisë së tij të kufizuar vepruese brenda afatit prej tre muajsh, nga dita kur ka fituar aftësinë e plotë vepruese (neni 44 i LMD). Pala tjetër kontraktuese e personit të paaftë, i cili nuk ka ditur për paaftësinë dhe në rastin kur e ka ditur se i mungon paaftësia kontraktuese, por pala e paaftë për të vepruar e ka mashtruar se posedon lejen e përfaqësuesit ligjor, mund të heqë dorë nga kontrata që e ka lidhur me të pa lejen e përfaqësuesit ligjor, përkatësisht me anë të mashtrimit se posedon lejen e përfaqësuesit ligjor. Një e drejtë e tillë mund të shuhet pas skadimit të afatit prej 30 ditësh nga dita kur ka marrë dijeni për mungesën e paaftësisë kontraktuese, përkatësisht për mungesën e lejes së përfaqësuesit ligjor. Të njëjtën të drejtë e ka edhe pala të cilën pala a paaftë për lidhjen e kontratës e ka mashtruar.

Personat juridikë fitojnë aftësinë e veprimit në momentin e regjistrimit në regjistrin përkatës të organit kompetent shtetëror për regjistrimin e biznesit. Në teori ka qenë kontestuese se kur e fiton aftësinë e veprimit personi juridik për t'u paraqitur si i pavarur në qarkullimin juridik – në momentin e miratimit të aktit mbi themelimin e personit juridik apo në momentin e regjistrimit të personit juridik në regjistrin përkatës pranë organit kompetent shtetëror. Sipas një pikëpamje, regjistrimi në regjistrin përkatës nuk është relevant për lindjen (krijimin) e personit juridik, pra kjo ka rëndësi për evidencimin dhe jo rëndësi konstituive. Praktika e gjykatave ka mbështetur qëndrimin se regjistrimi i themelimit ka rëndësi konstitutive në pikëpamje të lidhjes së veprimeve juridike në qarkullimin juridik, ngase, sipas këtij qëndrimi, organi regjistruar me regjistrimin në regjistrin përkatës ka vërtetuar se themelimi i personit juridik është bërë sipas ligjit. Ky qëndrim mund të përkrahët vetëm me kusht që në të vërtetë organi regjistruar, me rastin e regjistrimit në regjistrin përkatës, të ketë dëshmuar ligjshmërinë e themelimit të personit juridik.

Personi juridik mund të lidhë kontratat në qarkullimin juridik në kuadër të aftësisë së tij vepruese. Kontratat të cilat i lidh jashtë kufijve të aftësisë vepruese nuk kanë efekt juridik dhe, si të tilla, ato janë nule. Nuliteti i kontratave të tilla është relativ, ngase me to cenohet interesi individual i subjektit të caktuar, kurse nulitetin e kontratave të tilla mund të kërkojnë personat që kanë interes juridik. Këto kontrata mund të konvalidohen në kushtet e parashikuara për anulimin e kontratave relativisht të pavlershme.

Pajtimi i vullnetit të palëve kontraktuese është një ndër kushtet thelbësore për lindjen e kontratës. Kjo del nga vetë nocioni i kontratës së dyanshme, te e cila paraqiten dy vullnete nga pajtimi i të cilave lindin të drejtat dhe detyrimet. Çdo kontratë supozon ko ekzistencën e dy vullneteve, nga të cilat njëra ka veti të iniciativës dhe kjo quhet ofertë, ndërsa tjetra ka veti të pranimit të asaj iniciative, pranimit të ofertës.

Pajtimi i vullnetit duhet të jetë i dyanshëm, sepse kur vullneti i dy palëve dakordohet, thuhet se është lidhur kontrata. Sipas LMD, kontrata është lidhur kur palët kontraktuese janë marrë vesh për elementet thelbësore të saj (neni 15 i LMD). Ligji nuk flet lidhur me atë se ç' kuptohet me elementet thelbësore të kontratës. Në teori theksohet se ajo që e identifikon çdo tip të kontratës, si tip të veçantë, është objekti i detyrimit të kontratës, prandaj objekti i detyrimit kontraktues në çdo rast paraqitet si

pjesë përbërëse thelbësore e kontratës. Çdo tip kontrate krijon detyrime, të cilat janë specifike, andaj elementet thelbësore të kontratës dallohen sipas tipit të tyre. Elementet thelbësore të kontratës së shitblerjes kanë të bëjnë me dorëzim të sendit – kalim të së drejtës së pronësisë së sendit, si objekt i detyrimit kontraktues, dhe pagesë të çmimit. Në praktikën e gjykatave konsiderohet se elemente thelbësore të kontratës janë ato pa të cilat kontrata nuk mund të ekzistojë.

Objekti i kontratës është një kusht i përgjithshëm për lidhjen e kontratës juridikisht të vlefshme. Objekti i kontratës është ajo për çfarë palët janë marrë vesh. Në shkencën juridike nuk ka një mendim unik lidhur me nocionin e objektit të detyrimit. Megjithatë, mbizotëron mendimi se objekt detyrimi është prestimi, përkatësisht veprimi i përmbushjes. Prestimi është çdo veprim pozitiv ose negativ i njeriut, të cilin debitori, në marrëdhëniet e detyrimeve, është i detyruar t'ia përmbush kreditorit. Prestimi ka përmbytjen e tij, e cila qëndron në dhënie (dare), bërje (facere), mos bërje (non facere) ose pësim (et pati). Ligji e ka identifikuar objektin e kontratës me përmbytjen e detyrimit të kontratës. Sipas LMD, objekti i kontratës ka të bëjë me dhënie, bërje, mos bërje ose pësim (neni 34 i LMD). Mirëpo, kontrata mund të ketë më shumë detyrime, prandaj mund të ketë shumë objekte kontratash, p.sh., te kontrate e shitblerjes objekt i kontratës mund të jetë kalimi i së drejtës së pronësisë së sendit dhe pagesa e çmimit; te kontrata e veprës objekt kontrate është kryerja e një pune të caktuar dhe pagesa e shpërblimit.

Dhënie ose dare, si një ndër format e përmbytjes së prestimit në kuptimin juridik, domethënë që debitori është i detyruar ta kalojë të drejtën e pronësisë ose ndonjë të drejtë tjetër sendore. Me prestimin i cili si përmbytje ka bërjen (facere) kuptohet bërja e punës e cila qëndron në përmbushjen e detyrimit me anë të shpenzimit të fuqisë së punës. Mirëpo, objekt prestimi mund të jetë edhe rezultati i punës, (siç është rasti te kontrata e veprës - sipërmarrjes). Përmbytja e prestimit mund të jetë mosveprimi (non facere), që domethënë mos bërja e disa veprimeve nga ana e debitorit të cilat ai përndryshe do t'i bënte sikur të mos ishte në marrëdhënie detyrimore. Pësimi (pati) është një formë e përmbytjes që nënkupton mos pengimin e veprimit të huaj, të cilin debitori do të ishte i autorizuar ta pengonte sikur të mos ishte në marrëdhënie të detyrimeve.

Sipas LMD, për të pasur efekt juridik, objekti i kontratës medoemos duhet t'i ketë këto karakteristika: ajo medoemos duhet të jetë e mundshme, e lejueshme dhe e përcaktuar, përkatësisht e përcaktueshme (neni 38 dhe 39 i LMD). Në teori shtrohet edhe kërkesa që prestimi të ketë karakter pasuror dhe të jetë veprim i njeriut.

Objekti i kontratës është i mundur nëse prestimin i detyrimit qëndron në atë që mund të kryhet.

Prestimi mund të jetë objektivisht i pamundur, nëse një detyrimi të tillë nuk do të mund ta kryente askush (p.sh. detyrimi që dikush të drejtojë automjetin Prishtinë - Tiranë me shpejtësi prej 200 km/h, gjë që praktikisht është e pamundur). Prestimi mund të jetë subjektivisht i pamundur kur atë nuk mund ta kryejë një debitor konkret, por nëse dikush tjetër do të gjendej në pozitën e tij, me angazhimin e vet normal, do ta kishte kryer një prestim të tillë (p.sh. debitori A, i cili nuk është skulptor, nuk do të mund ta përmbushë prestimin e tij duke punuar një skulpturë, por të njëjtin punim,

me një angazhim normal, do ta bënte personi B, i cili ka kualifikimin e skulptorit). Në një rast të tillë kontrata lind dhe ka efekt juridik, por debitori, në vend të përmbushjes së prestimit, është i përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Kontrata nuk mund të lind në rast të ekzistimit të pamundësisë fillestare (p.sh. në çastin e lidhjes së kontratës nuk ka ekzistuar sendi. Pamundësia juridike ekziston kur prodhimi i sendit, i cili është objekt prestimi, është ndaluar me ligj ose është jashtë qarkullimit. Pamundësia fizike ekziston kur debitori me kontratë merr përsipër një detyrim, i cili është fizikisht fare i pamundur (që ta prekë qiellin me dorë). Te pamundësia e mëvonshme e objektit të kontratës, kontrata ka lindur, por ekzistimi i mëvonshëm i saj varet nga fakti se pamundësia është shkaktuar për fajin e debitorit ose për shkak të forcës madhore; në rastin e parë, debitori është përgjegjës për shpërblimin e dëmit, ndërsa në të dytin detyrimet kontraktuese shuhen. Objekti i kontratës duhet të jetë juridikisht i lejueshëm dhe jo i ndaluar me ligj ose me rregullat e moralit shoqëror.

Objekti i kontratës mund të jetë i përcaktuar individualisht dhe sipas llojit. Objekti i kontratës është individualisht i përcaktuar kur, në momentin e lidhjes së kontratës ose më vonë, deri në momentin e dorëzimit të sendit, bëhet specifikimi i tij, ashtu që caktohen të dhënat në bazë të cilave mund të bëhet identifikimi i sendit konkret, i cili është objekt i përmbushjes së detyrimit. Kjo do të thotë se, kur objekt kontrate është sendi, palët duhet të dinë saktësisht se çka është objekti i kontratës. Në rast të blerjes së sendit të luajtshëm, p.sh., veturës, duhet të shënohen marka e automjetit me të dhënat teknike nga librezja e qarkullimit dhe targa regjistrimit; te sendi i paluajtshëm, p.sh., ngastra e tokës, individualizimi bëhet me anë të të dhënave kadastrale ose të shtëpisë së banimit, me anë të dhënave kadastrale - vendi, rruga, numri, dimensionet etj.

Objekti i kontratës është i përcaktueshëm, nëse kontrata përmban të dhëna me anë të cilave ai mund të përcaktohet ose palët e kanë autorizuar palën e tretë ta bëjë përcaktimin. Por, nëse personi i tretë nuk do ose nuk mund ta përcaktojë objektin e kontratës, kontrata është nule (neni 38 i LMD).

Baza e kontratës (kauza) është një ndër kushtet thelbësore për lidhjen e kontratës. Kauza është shkas, arsyeja, qëllimi i drejtpërdrejtë juridik për marrjen përsipër të detyrimit të kontraktuar. Ligji nuk përcakton kuptimin e kauzës, por as në teori nuk ekziston një mendim unik lidhur me nocionin e bazës. Ekzistojnë: teoria kauzaliste, e cila kauzën e konsideron si kusht thelbësor të kontratës dhe teoria antikauzaliste, e cila mohon që kjo të jetë kusht thelbësor për lidhjen e kontratës. Për kauzalistët kauza shpjgohet ashtu që te kontratat e dyanshme detyrimi i njëjës palë shpjgohet me detyrimin e palës tjetër kontraktuese. Te kontrata e shitblerjes, kauza e detyrimit të blerësit për pagimin e çmimit të shitblerjes është arsyeja që shitësi, me dorëzimin e sendit, i kalon të drejtën e pronësisë atij; bazë e detyrimit të shitësit për dorëzimin dhe kalimin e pronës së sendit është pagimi i çmimit të shitblerjes, me anë të të cilit ky merr në dispozicion një sasi të të hollave. Këto shpjgime mund të vlejnjë edhe për kontratat e tjera të dyanshme, si, p.sh., për kontratat e qirasë, të huas, të sipërmarrjes etj. Te kontratat e njëanshme detyrimore - kontrata e dhurimit, si bazë e kontratës paraqitet qëllimi i bamirësisë së dhuratëdhënësit (animus donandi). Objekti i kontratës shpjgohet me atë se me çka ka të bëjë lënda e kontratës, ndërsa baza e kontratës është ajo për çfarë arsye

debitori merr përsipër detyrimin. Baza, pra, është arsyeja e drejtpërdrejtë juridike, e cila e ka nxitur palën kontraktuese të marrë përsipër detyrimin. Baza mund të ketë shumë arsye, por, për dallim nga arsyeja e drejtpërdrejtë, e cila përfaqëson bazën e kontratës, janë më të largëta. Motivi është arsyeja më e largët shtytëse për lidhjen e kontratës dhe marrjen përsipër të detyrimit. Baza është pjesë përbërëse e çdo kontrate. Nuk ka kontratë pa bazë. Supozohet se ekziston baza edhe në rast se nuk është e shprehur në kontratë (neni 39 par. 3 i LMD). Në qoftë se nuk ekziston baza, kontrata është nule. Çdo bazë e kontratës medoemos duhet të jetë e lejueshme. Baza është e palejueshme, në qoftë se është në kundërshtim me dispozitat juridike imperative, me rendin publik dhe me moralin shoqëror.

Motivi nga i cili është lidhur kontrata nuk ndikon në vlefshmërinë e saj. Por, nëse motivi i palejueshëm ka ndikuar thellbësisht në vendimin e njëres nga palët që ta lidhë kontratën, nëse këtë e ka ditur pala tjetër kontraktuese ose ka qenë e detyruar ta dijë, kontrata do të jetë pa efekt juridik. Kontrata e shpërblimit nuk ka efekt juridik edhe kur pala tjetër nuk ka ditur që motivi i palejueshëm ka ndikuar thellbësisht në vendimin e palës tjetër kontraktuese (neni 40 par. 3 i LMD).

Të metat e vullnetit

Për lidhjen e kontratës së vlefshme kërkohet që vullneti i palëve të shprehet lirisht. Në qoftë se me rastin e lidhjes së kontratës ka pasur të meta në shprehjen e vullnetit, si pasojë e të cilave vullneti i njëres palë kontraktuese nuk ka qenë i lirë, kontrata mund të anulohet.

Kemi të bëjmë me të meta të vullnetit, në qoftë se kontrata është lidhur nën ndikimin e kërcënimit, të lajthimit dhe të mashtrimit.

- 1) Kërcënimi ekziston kur njëra palë kontraktuese ose ndonjë person i tretë, me kërcënim të palejueshëm, ka shkaktuar frikë të arsyeshme te pala tjetër për shkak të së cilës ajo ka lidhur kontratën. Që kërcënimi të ketë ndikim në shprehjen e lirë të vullnetit, frika duhet të jetë e arsyeshme, përndryshe anulimi i kontratës nuk do të mund të kërkohet për çdo lloj kërcënimi. Sipas Ligjit, kemi të bëjmë me frikë të arsyeshme, kur nga rrethanat konkrete del se është rrezikuar seriozisht jeta ose ndonjë vlerë e rëndësishme e palës kontraktuese ose e personit të tretë (neni 45 i LMD). Frika e arsyeshme mund të shkaktohet në mënyra të ndryshme: me kërcënim fizik se do të sulmohet me mjete fizike, siç është arma e zjarrit, dhe me kërcënimin psikik, siç është deklarata e personit të tretë se do të përdorë dhunën fizike kundër palës kontraktuese, se do t'i shkaktojë ndonjë të keqe atij apo të afërmit të tij.
- 2) Lajthimi, në kuptimin e gjerë, përkufizohet si përfytyrim i gabuar për ndonjë rrethanë. Ajo në të vërtetë është mospërputhje mes aktit psikik - vullnetit të brendshëm dhe shprehjes së një akti të tillë - vullnetit lidhur me ndonjë rrethanë. Që të mund të ketë ndikim në vlefshmërinë e kontratës, lajthimi duhet të jetë thelbësor. Lajthimi është thelbësor, nëse ka të bëjë me cilësinë e objektit, me personin me të cilin lidhet kontrata, nëse kjo lidhet duke pasur parasysh personin e caktuar, si dhe me rrethanat të cilat, sipas dokeve në qarkullim ose sipas qëllimit të palëve,

konsiderohen si vendimtare, ndërsa pala që është në lajthim nuk do ta kishte lidhur kontratën me një përmbajtje të tillë (46 i LMD). Lajthim thelbësor te kontrata pa shpërblim përfaqëson edhe lajthimi lidhur me motivin i cila ka qenë vendimtar për marrjen përsipër të detyrimit.

- 3) Mashtrimi ekziston atëherë kur njëra palë e vë ose e mban në lajthim palën tjetër, me qëllim që ashtu ta shtyjë të lidhë kontratën, të cilën ajo nuk do ta kishte lidhur, sikur ta dinte ose ishte dashur ta dinte se është në lajthim. Pala që ka qenë në lajthim mund të kërkojë anulimin e kontratës edhe në rast se lajthimin e ka shkaktuar personi i tretë.

Forma e kontratës

Forma e kontratës është kusht i veçantë thelbësor për lidhjen e disa kontratave, për të cilat me ligj ose me marrëveshje të palëve kontraktuese është parashikuar forma e caktuar me shkrim.

LMD dallon formën e shprehjes së vullnetit (neni 28) nga forma e kontratës. Vullneti mund të shprehet në forma të ndryshme (me fjalë, me shenja të zakonshme ose me ndonjë sjellje tjetër, nga e cila mund të konkludohet me siguri për ekzistimin e tij), përmes së cilave vullneti i brendshëm i subjektit shfaqet jashtë.

Me formë të kontratës kuptohen ato forma të shfaqjes së vullnetit, në të cilat mund të shprehet përmbajtja e plotë e kontratës. Forma është shfaqje e jashtme e përmbajtjes së kontratës.

Çdo kontratë ka një formë të caktuar qoftë me gojë, qoftë me shkrim, ndonëse LMD për lidhjen e kontratës nuk kërkon një formë të caktuar të saj, përveç kur me ligj është caktuar ndryshe. Megjithatë, për lidhjen e disa kontratave të detyrimeve kërkohet forma me shkrim e tyre, si, p.sh., për: kontratën e shitjes së sendeve të paluajtshme, kontratën e kredisë, kontratën e qirasë, kontratën e shkëmbimit etj. Kur për kontratën është parashikuar forma me shkrim, kjo vlen edhe për ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme të saj, përveç ndryshimeve që kanë të bëjnë me klauzolat dytësore, për të cilat në kontratën formale nuk është thënë asgjë, nëse nuk është në kundërshtim me qëllimin për të cilin është caktuar forma (neni 52 i LMD). Përveç formës së parashikuar me ligj, palët mund të merren vesh që forma me shkrim të jetë kusht për vlefshmërinë juridike të kontratës, e cila nuk është formale. Një formë e tillë është formë kontraktore (neni 54 i LMD).

Forma e kontratës ka rëndësi, ngase ajo është një element konstitutiv i kontratës (forma ad solemnitatem), pastaj ka rëndësi për të provuar ekzistimin e kontratës në rast kontesti (forma ad probationem), për të paditur dhe për regjistrimin në regjistrin publik.

Në rast mosrespektimi të formës së parashikuar me shkrim, qoftë ajo e parashikuar me ligj, qoftë me vetë kontratën, parimisht, kontrata nuk ka efekt juridik, po qe se nga qëllimi i dispozitës, me të cilën është parashikuar forma, nuk rezulton diçka tjetër, përkatësisht palët nuk e kanë kushtëzuar vlefshmërinë juridike të kontratës me një formë të veçantë të saj (neni 58 i LMD).

Kontrata që nuk është lidhur në formën me shkrim është e vlefshme, edhe po të mos jetë lidhur në atë formë, në qoftë se palët kontraktuese i kanë përmbushur plotësisht ose në masën më të madhe detyrimet që dalin prej saj, përveç nëse nga qëllimi, për të cilin është parashikuar forma, nuk rezulton qartazi diçka tjetër.

LIDHJA E KONTRATËS

Kontrata lidhet me pajtimin e vullnetit të palëve për elementët thelbësore të saj. Për t'u arritur pajtimi i vullnetit të palëve, njëra palë duhet të marrë nismën dhe t'i propozojë palës tjetër lidhjen e kontratës. Personi që bën i propozim personit tjetër për lidhjen e kontratës quhet propozues ose ofertues dhe një propozim i tillë quhet ofertë. Ndërkaq, personi të cilit i drejtohet propozimi për t'u lidhur kontrata quhet pranues i propozimit ose i ofertuari.

Oferta është propozim për lidhjen e kontratës që i bëhet personit të caktuar dhe e cila përmban të gjitha elementet thelbësore të kontratës, kështu që me pranimin e saj mund të lidhet kontrata. Pra oferta është shprehje e njëanshme e vullnetit, me të cilën thirret personin tjetër për ta lidhur kontratën në kushtet e caktuara në ofertë.

Kushtet.-Çdo propozim që ka kuptimin e ofertës duhet t'i plotësojë këto kushte: ajo të bëhet nga personi që ka për qëllim të lidhë kontratë ose personi që është i autorizuar të përfaqësojë për lidhje të kontratës; të përmbajë elementet thelbësore të kontratës, ashtu që me pranimin saj të mund të lidhet kontrata; të përmbajë vullnetin të shprehur të qartë të ofertuesit se dëshiron të lidhë kontratë sipas kushteve të cekura në ofertë; t'i jetë drejtuar personit të caktuar.

Oferta ekziston edhe kur i drejtohet një rrethi të caktuar të personave. Propozimi për lidhjen e kontratës i bërë ndaj një numri të pacaktuar të personave, i cili përmban elementet thelbësore të kontratës, për lidhjen e së cilës ia është dedikuar, vlen si ofertë, po qe se nga rrethanat e rastit ose doket e mira nuk rezulton diçka tjetër. Në rast se për lidhjen e kontratës përkatëse me ligj është parashikuar që ajo të lidhet në formën me shkrim, oferta duhet të jetë e bërë në atë formë.

Kushtet e cekura medoemos duhet të plotësohen në mënyrë kumulative, sepse pa plotësimin qoftë edhe të njërit prej tyre, kontrata nuk mund të lidhet.

Oferta, parimisht, është një akt joformal me përjashtim kur për lidhjen e ndonjë lloji të kontratës me ligj është parashikuar forma me shkrim. Ajo mund të bëhet me gojë, me shkrim, me shenja të rëndomta, me anë të ekspozimit të e mallit me çmim të caktuar, me veprime konkludente.

Efekti.- Oferta ka efektin e vet juridik, ashtu që, parimisht, propozuesi është i detyruar t'i përmbahet asaj, përveç në rastin kur detyrimin e vet e ka përjashtuar ose një përjashtim i tillë rezulton nga rrethanat e veprimit juridik (neni 25 par. 1 i LMD). Propozuesi është i lidhur për ofertën nga momenti i bërjes së saj derisa të skadojë afati i caktuar në ofertën e bërë me shkrim ose formë tjetër për pranimin e ofertës. Ecja e afatit të ofertës fillon nga data e caktuar në letër, nëse në letër nuk është shënuar data

e pranimit të ofertës, afati për pranimin e saj llogaritet nga data e dorëzimit postës, përkatësisht nga data e dorëzimit të telegramit në postë.

Oferta mund t'i behet personit të pranishëm ose personit jo të pranishëm. Konsiderohet se oferta i iu ka bërë personit të pranishëm jo vetëm kur palët janë ndodhur në të njëjtin lokal, por edhe kur kanë qenë në lidhje të drejtpërdrejtë me anë të mjeteve teknike të informimit - telefonit, teleprinterit, internetit etj. Oferta që i bëhet personit jo të pranishëm konsiderohet ajo që bëhet me anë të letrës ose telegramit.

Kur oferta i bëhet personit të pranishëm ose personit jo të pranishëm dhe është caktuar afati për pranimin e ofertës, i ofertuari është i detyruar të deklarohet nëse e pranon ose jo ofertën brenda afatit të caktuar. Oferta e bërë ndaj personit jo të pranishëm, në të cilën nuk është caktuar afati i pranimit, e obligon propozuesin për kohën që zakonisht është e nevojshme që oferta t'i arrijë të ofertuarit që ai ta shqyrtojë, të vendosë lidhur me të dhe të japë përgjigjen e cila do t'i arrijë ofertuesit (26 par. 3 i LMD).

Ofertuesi është i lidhur për ofertën e bërë të ofertuarit dhe, sipas rregullit, ai nuk mund ta revokojë atë. Megjithatë, nga kjo rregull ka përjashtime. Ofertuesi mund ta revokojë ofertën deri atëherë kur revokimi i ka mbërritur të ofertuarit para se t'i mbërrijë oferta ose njëkohësisht me ofertën (neni 28 par 3 i LMD). Nëse revokimi arrin pasi i ofertuari ta ketë pranuar ofertën, revokimi nuk do të ketë efekt juridik.

Pranimi i ofertës.- Pranimi i ofertës është shprehje e vullnetit të ofertuarit, dërguar ofertuesit, me të cilin e njofton këtë të fundit se e pranon propozimin për lidhjen e kontratës në kushtet e caktuara në ofertë. Oferta quhet e pranuar kur ofertuesi pranon deklaratën e të ofertuarit se pranon ofertën (neni 28 par. 1 i LMD). Pranimi i ofertës, për të krijuar efekt juridik, duhet t'i plotësojë këto kushte: a) që të përmbajë deklaratën e të ofertuarit ose të autorizuarit tij se e pranon ofertën; b) që të përmbajë së paku elementet thelbësore për lidhjen e kontratës dhe ato të jenë në përputhje me ofertën e propozuesit. LMD nuk përmban dispozita me të cilat caktohet se cilat elemente të kontratës janë thelbësore, por në teorinë juridike dhe në praktikën gjyqësore cilësimi i elementeve thelbësore varet nga tipi i kontratës. Prandaj, palët kontraktuese duhet të merren vesh së pari për llojin e kontratës dhe, varësisht prej saj, konsiderohet se elemente thelbësore janë ato pa të cilat kontrata e një lloji përkatës nuk mund të ekzistojë; p.sh., te kontrata e shitblerjes elemente thelbësore të kontratës janë sendi që i kalohet blerësit në pronësi dhe çmimi të cilin blerësi ia paguan shitësit; te kontrata e sipërmarrjes, si elemente thelbësore janë vepra kryerjen e së cilës e ka marrë përsipër kryerësi i i saj dhe shpërblimi të cilin porositësi detyrohet t'ia paguajë atij për veprën e kryer; c) që pranimi i ofertës të përmbajë vullnetin e shprehur në mënyrë të qartë për dëshirën që të lidhet kontrata në përputhje me kushtet e cekura në ofertë. Përndryshe, po qe se pranimin e ofertës e kushtëzon me kushte të cilat i ofertuari i paraqet për pranimin e ofertës, konsiderohet se i ofertuari nuk e ka pranuar ofertën. Deklarata me të cilën pranohet oferta duhet të jetë e qartë dhe e padyshimtë; d) deklarata për pranimin e ofertës duhet t'i arrijë ofertuesit brenda afatit të caktuar në ofertë, por, nëse afati nuk është i caktuar në ofertë, kjo duhet të ndodhë brenda afatit të caktuar në ligj, përkatësisht brenda afatit të arsyeshëm.

Pranimi i ofertës dhe bërja e saj mund të realizohen në mënyra të ndryshme: me shprehjen e vullnetit në mënyrë të drejtpërdrejtë (shprehimisht) dhe në mënyrë të tërthorët (heshtazi). Në mënyrë të drejtpërdrejtë ajo mund të bëhet me shkrim, me gojë, dhe me përdorimin e mjeteve të tjera të komunikimit – me telegram, teleprinter, me veprime konkludente, si, p.sh., me lëvizje të kokës, zgjatje të dorës, dhënie të kaparit etj.

Heshtja e të ofertuarit, parimisht, nuk ka domethënie të pranimit të ofertës (neni 30 par 1 i LMD). Nuk ka efekt juridik as klauzola e ofertës, sipas së cilës heshtja e të ofertuarit ose ndonjë lëshim tjetër (p.sh.. nëse nuk refuzohet oferta brenda afatit të caktuar ose sendi i dërguar, për të cilin ofrohet lidhja e kontratës, nuk kthehet brenda afatit të caktuar) do të konsiderohet si pranim (neni 30 par. 2 i LMD). Megjithatë, nga kjo rregull ka përjashtime. Ekzistojnë raste kur heshtja mund të quhet pranim i ofertës. Një rast i tillë mund të jetë ai kur palët janë marrë vesh që heshtja e njëres palë mund të jetë e mjaftueshme për ta quajtur të lidhur kontratën. Një marrëveshje e tillë mund të arrihet me rastin e negociatave për lidhjen e kontratës ose në ndonjë mënyrë tjetër. Pastaj, në qoftë se palët ndodhen në lidhje të përhershme të afarizmit për sa i përket ndonjë malli të caktuar, heshtja për atë mall të livruar konsiderohet pranim i ofertës për lidhje kontrate. Këtë rregull e përmban dispozita e LMD, sipas së cilës, kur i ofertuari gjendet në lidhje të përhershme afariste me ofertuesin për sa i përket një malli të caktuar, heshtja konsiderohet pranim i ofertës e cila ka të bëjë me atë mall, nëse menjëherë ose brenda afatit të caktuar nuk e ka refuzuar atë (neni 30 par. 3 i LMD). Me raste të tilla kemi të bëjmë edhe kur kontrata është lidhur për një afat të caktuar; mund të vazhdojë afati i kontratës, po qe se pala tjetër sillet si të jetë vazhduar afati i kohëzgjatjes së kontratës, ndërsa pala tjetër hesht dhe nuk reagon ndaj një sjelljeje të tillë të palës tjetër (p.sh., konsiderohet se është vazhduar kontrata e qirasë, e lidhur për një afat të caktuar, po qe se qiramarrësi vazhdon ta shfrytëzojë sendin që është objekt qiraje, ndërsa qiradhënësi hesht dhe në atë mënyrë bie dakord me një sjellje të tillë të qiramarrësit). Gjithashtu, personi që i është ofruar personit tjetër për t'i zbatuar urdhrat e tij për kryerjen e punëve të caktuara, si dhe personi në veprimtarinë e të cilit bën pjesë zbatimi i urdhrave të tilla, është i detyruar ta zbatojë urdhrin e pranuar nëse nuk e ka refuzuar menjëherë atë (neni 30 par. 4 i LMD). Nëse i ofertuari nuk dëshiron ta zbatojë një urdher të tillë, të cilin e kishte pranuar, duhet ta refuzojë shprehimisht atë me deklaratë.

Kushti.- Palët, me rastin e lidhjes së kontratës, efektin juridik mund ta bëjnë të varur nga ndonjë rrethanë e mëvonshme juridike të pasigurt, nga ndodhja ose mos ndodhja e së cilës varet lindja ose shuarja e kontratës. Kushti mund të jetë suspensiv atëherë kur kontrata lind pas ndodhjes ose mos ndodhjes së rrethanës së pasigurt. Kushti është rezolutiv ose shues, kur kontrata shuhet pas ndodhjes së rrethanës së pasigurt. Do të thotë se kushti është një dispozitë plotësuese (sekondare) e shtuar e kontratës, me të cilën palët efektin juridik të kontratës e bëjnë të varur nga ndonjë rrethanë e mëvonshme e pasigurt. Kur kontrata është lidhur me kushtin suspensiv dhe kushti plotësohet, kontrata ka efekt juridik që nga momenti i lidhjes së saj, përveç nëse nga ligji, natyra

e kontratës ose vullneti i palëve nuk rezulton diçka tjetër (59 par. 2 i LMD). Në rast të lidhjes së kontratës me kusht rezolutiv ose shues, kur kushti plotësohet, kontrata pushon të vlejë. Me qëllim të sigurisë juridike të palëve, për të penguar plotësimin ose mosplotësimin e kushtit me veprime të pandërgjegjshme të palëve, ligji ka parashikuar fiksionin e plotësimit ose të frustrimit të kushtit. Konsiderohet se kushti është plotësuar nëse realizimin e tij, në kundërshtim me parimin e ndershmërisë dhe nderit, e ka penguar pala nën ngarkesë të së cilës është caktuar ai, ndërsa konsiderohet se ky nuk është plotësuar, kur realizimin e tij, në kundërshtim me parimin e ndershmërisë dhe nderit, e ka bërë pala në dobi të së cilës është caktuar.

Kushti medoemos duhet të jetë i mundshëm dhe i lejueshëm. Kontrata e cila është lidhur me kusht suspensiv ose rezolutiv në kundërshtim me rendin publik, me dispozitat imperative dhe me moralin shoqëror është nule. Kontrata është nule edhe kur është e lidhur me kusht të pamundshëm suspensiv, ndërsa kushti shues i pamundshëm konsiderohet i paqenë (neni 61 i LMD).

Afati.- Afati është një moment i caktuar i kohës ose në kohë, nga i cila ose në të cilin lind ose pushon kontrata. Edhe afati mund të jetë suspensiv ose rezolutiv a shues. Rregullat të cilat vlejné për kushtin suspensiv apo rezolutiv përshtatshëm mund të zbatohen edhe te afati. Afati i caktuar në njësi kalendarike - me ditë fillon të ecë nga dita e parë pas ngjarjes nga e cila afati llogaritet, ndërsa përfundon me skadimin e ditës së fundit të afatit (p.sh. te kontrata e huas huadhënësi detyrohet që huamarrësit t'i paguajë shumën në emër të huas brenda afatit prej 15 ditësh, nga dita e lidhjes së kontratës). Afati i caktuar në javë, muaj, dhe vite përfundon në datën e cila, për nga emri dhe numrit, përputhet me ditën e shkaktimit të ngjarjes, nga e cila fillon të ecë afati, por nëse një ditë e tillë nuk ekziston në muajin e fundit, fundi i afatit është dita e fundit e atij muaji. Nëse dita e fundit të afatit bie në ditën kur me ligj është caktuar si ditë jo pune, si ditë e fundit e afatit llogaritet dita e ardhshme e parë e punës (p.sh., 1 janar), ditë e fundit e afatit do të jetë dita e parë e punës, pas 1 janarit. Fillimi i muajit konsiderohet dita e parë e muajit, gjysma - i pesëmbëdhjeti, ndërsa fundi - dita e fundit e muajit (neni 65 i LMD).

Rregullat e përmendura më sipër për llogaritjen e afateve të caktuara sipas LMD janë të natyrës dispozitive dhe me pëlqimin e palëve ato mund të ndryshohen.

Kapari.- Kapari është një shumë e caktuar të hollash ose një sasi e caktuar e sendeve të zëvendësueshme, të cilat njëra palë ia paguan palës tjetër kontraktuese, si shenjë se kontrata është lidhur. Konsiderohet se kontrata është lidhur atëherë kur është bërë pagimi i të hollave ose dorëzimi i sendeve (neni 67 i LMD). Domethënë, kapari shërben si provë që kontrata është lidhur.

Kapari është një instrument i sigurimit të përbushjes së detyrimit kontraktues. Nëse për mospërbushjen e kontratës është përgjegjëse pala e cila ka dhënë kaparin, pala tjetër, përveç së drejtës që të kërkojë përbushjen e kontratës, shkëputjen e kontratës dhe shpërblimin e dëmit, sipas zgjedhjes së saj, mund të kënaqet me mbajtjen e kaparit, por në qoftë se për mospërbushjen e kontratës është fajtores pala që ka

pranuar kaparin, pala tjetër, sipas zgjedhjes së saj, mund të kërkojë përmbushjen e kontratës, të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe kthimin e kaparit ose të kënaqet me kthimin e kaparit të dyfishuar (neni 68 par. 2 i LMD).

Në rast të përmbushjes së detyrimeve kontraktuese, kapari mund të llogaritet si përmbushje e pjesshme e kontratës. Kapari është një lloj kontrate aksesore dhe reale, ngase konsiderohet se është lidhur me dorëzimin e shumës së të hollave, përkatësisht shumës së caktuar të sendeve të zëvendësueshme, ndërsa rrjedhimi i saj varet nga ekzistimi i kontratës kryesore.

Masën e kaparit e përcaktojnë palët sipas marrëveshjes, por, me kërkesë të palës së interesuar, gjykata mund të ulë kaparin nëse ky është tepër i lartë.

Pendesa është marrëveshje e palëve kontraktuese, sipas së cilës njëra apo pala tjetër autorizohet që, me dhënien e një shume të caktuar të hollave ose sendit të zëvendësueshëm (pendesës), të heqë dorë nga kontrata. Kjo marrëveshje mund të arrihet me rastin e lidhjes së kontratës në formë klauzole kontraktuese, por mund të arrihet edhe më vonë dhe për këtë të lidhet një kontratë tjetër, e cila është e natyrës aksesore në raport me kontratën kryesore, ngase rrjedhimet e saj varen nga epilogu i kontratës kryesore. Nëse kontrata kryesore është nule, shuhet edhe efekti i marrëveshjes së pendesës.

Pala kontraktuese, në dobi të së cilës është kontraktuar pendesa, nuk mund të detyrohet nga pala tjetër që të heqë dorë nga kontrata. Por, nëse i deklaron palës tjetër se do të japë pendesën, ajo më vonë nuk mund të kërkojë përmbushjen e kontratës.

Detyrimi i pagesës së pendesës arrin në momentin e dhënies së deklaratës sipas së cilës hiqet dorë nga kontrata dhe pala në dobi të së cilës është kontraktuar pendesa është e detyruar ta paguajë shumën e të hollave në emër të pendesës njëkohësisht me dhënien e deklaratës se heqë dorë nga kontrata.

Pala e autorizuar mund të heqë dorë nga kontrata brenda afatit të caktuar me marrëveshje të palëve, por nëse ky nuk është caktuar me kontratë, atë mund ta bëjë derisa nuk ka skaduar afati i caktuar për përmbushjen e detyrimit të saj.

E drejta për të hequr dorë nga kontrata pushon në momentin kur pala, në dobi të së cilës është kontraktuar pendesa, fillon ta përmbushë detyrimin e saj kontraktues ose ta pranojë përmbushjen e detyrimit të palës tjetër, sepse konsiderohet që ka hequr dorë nga pendesa dhe është përcaktuar për të drejtën alternative - përmbushjen e kontratës.

PËRFAQËSIMI

Me fjalën përfaqësim, në kuptimin e gjerë të fjalës, nënkuptohen të gjitha format e përfaqësimit të interesave ekonomike të përfaqësuarit, pa marrë parasysh se përfaqësuesi ka autorizime që në emër dhe për llogari të përfaqësuarit të marrë përsipër të drejta dhe detyrime në qarkullimin juridik.

Përfaqësimi, në kuptimin e ngushtë, nënkupton vetëm ato forma të përfaqësimit të cilat përfaqësuesi merr (përveç urdhëresave) edhe autorizimeve (autorizim) që, me deklarin e vullnetit në emër dhe për llogari të përfaqësuarit, të marrë përsipër të drejta dhe detyrime në qarkullimin e mallrave dhe dhënien e shërbimeve.

Parimisht, personat fizik, në cilësinë e palëve kontraktuese, kontratat i lidhin personalisht, përveç kur si palë kontraktuese është personi të cilit i mungon zotësia për të vepruar, ndërsa në emër të personit juridik kontratën e lidh personi i autorizuar me ligj, me statut ose me aktin e themelimit të personit juridik. Mirëpo, kontrata apo një veprim tjetër juridik mund të lidhet edhe nëpërmjet përfaqësuesit. LMD ka përcaktuar të gjitha format e përfaqësimeve, përveç përfaqësimit nga ana e përfaqësuesit ligjor të personit juridik, i cila është rregulluar me nenin 13.7 dhe nenin 13.8 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare¹⁹ i cili caktohet me statut ose aktin e themelimit të shoqërisë tregtare.

Bazë juridike e autorizimit të përfaqësimit është ligji, Statuti apo akti tjetër i përgjithshëm për themelimin e personit juridik dhe deklarimi i vullnetit të të përfaqësuarit (prokura).

Kontrata, të cilën e lidh përfaqësuesi në emër të palës së përfaqësuar dhe në kuadër të autorizimeve të veta, prodhon efekt juridik drejtpërdrejt për të përfaqësuarin dhe palën tjetër, me supozimin se përfaqësuesi e ka njoftuar palën tjetër të paraqitet në emër të palës së përfaqësuar ose atë pala tjetër ka qenë e detyruar ta dijë nga rrethanat e veprimit juridik, përkatësisht ka mundur të konkludon se ai paraqitet si përfaqësues (neni 73 par. 3 i LMD).

Në qoftë se përfaqësuesi i tejkalon kufijtë e autorizimit, i përfaqësuarit e merr përsipër detyrimin, nëse jep pëlqimin e tejkalimit. Nëse i përfaqësuarit nuk e jep pëlqimin brenda afatit të nevojshëm, në të cilin kontrata e një lloji të tillë mund të shqyrtohet dhe vlerësohet, konsiderohet se pëlqimi është refuzuar. Nëse pala tjetër nuk ka pasur dijeni dhe as nuk ka qenë e detyruar të dijë për tejkalimin e autorizimeve, menjëherë pasi të ketë marrë dijeni për tejkalimin, pa pritur që i përfaqësuarit të deklarohet, mund të deklarojë që nuk konsideron se ka marrë përsipër detyrime nga një kontratë e tillë.

Kontratën të cilën e lidh personi si përfaqësues, në emër të personit tjetër, pa autorizimin e tij, e detyron të përfaqësuarin pa autorizim, po qe se ai më vonë e pranon atë. Pala tjetër, me të cilën është lidhur kontrata, mund të kërkojë nga pala e përfaqësuar pa autorizim që, brenda një afati të arsyeshëm, të deklarohet nëse e pranon ose jo kontratën dhe, nëse e refuzon këtë, konsiderohet se kontrata nuk është lidhur (neni 76 par. 3 i LMD).

Ekzistimi dhe vëllimi i autorizimit janë të pavarura nga marrëdhënia juridike-detyrimore, në bazë të së cilës është dhënë prokura. Prokurën për përfaqësim mund ta japë çdo person fizik dhe person juridik.

Prokura mund të jepet me gojë dhe me shkrim, por nëse me ligj është parashikuar forma e caktuar për një kontratë ose veprim tjetër juridik, kjo vlen edhe për formën e prokurës për lidhjen e së cilës është dhënë prokura (p.sh., për lidhjen e kontratës së shitblerjes së paluajtshmërisë, ndërtimit, sigurimit është parashikuar forma me shkrim), prandaj edhe prokura për lidhjen e këtyre kontratave detyrimisht duhet të jepet me shkrim.

19) Ligji për Shoqëritë Tregtare Ligji nr. 02/L-123 i datës 27.09.2007 dhe Ligji për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare nr. 04/L-006 i datës 23.06.2011.

Përfaqësuesi mund të ndërmarrë vetëm ato punë juridike për ndërmarrjen e të cilave është i autorizuar.

Prokura mund të jetë e përgjithshme dhe e veçantë. I autorizuari, në bazë të autorizimit të përgjithshëm, mund t'i lidhë ato kontrata dhe të ndërmarrë ato veprime juridike të cilat bëjnë pjesë në veprimtarinë e rregullt të pushtet dhënësit. Veprimin që nuk bën pjesë në veprimtarinë e rregullt i autorizuari mund ta ndërmarrë vetëm nëse është ka autorizim të veçantë për ndërmarrjen e atij veprimi. I autorizuari pa autorizim të veçantë nuk mund të marrë përsipër detyrimin e kambialit, të lidhë kontratë të dorëzanisë, ujudi, të kontraktot kompetencën e gjykatës së zgjedhur - arbitrazhit e as të heqë dorë nga ndonjë e drejtë pa shpërblim (neni 79 par. 4 i LMD).

Përveç autorizimit të veçantë, ekziston edhe autorizimi afarist. Autorizimin afarist mund ta japë, në kuadër të ligjit, personi juridik ose pronari i punëtorisë individuale, me të cilin e autorizojnë të autorizuarin të lidhë kontrata dhe të kryejë punë tjera, të cilat janë të zakonshme në ushtrimin e veprimtarisë së tyre afariste.

I autorizuari afarist nuk mund të ndërmarrë veprime juridike, për lidhjen e kontratave për kredi ose për pranimin e të ardhurave të shitjeve, përveç nëse posedojnë autorizim të veçantë për shitje të kredisë ose për pranimin e të ardhurave të shitjeve (neni 84 par. 3 i LMD).

Pushtet dhënësi, sipas dëshirës së tij, mund ta ngushtojë ose të revokojë prokurën. Këtë të drejtë e ka edhe në rast se me kontratë ka hequr dorë nga ajo e drejtë. Reduktimi i autorizimeve të përfaqësuesit ose revokimi i prokurës nuk kanë efekt juridik ndaj personit të tretë, i cili ka lidhur kontratë me përfaqësuesin dhe nuk ka ditur dhe nuk ka qenë i detyruar të dijë që prokura është reduktuar ose revokuar.

Agjenti tregtar është i autorizuar të ndërmarrë vetëm ato veprime të cilat kanë të bëjnë me shitjen e mallit ose të cilat janë të përmendura në prokurën të cilën pushtet dhënësi ia ka dhënë atij. Në rast dyshimi, konsiderohet se agjenti tregtar nuk është i autorizuar të lidhë kontrata, por vetëm të mbledhë porosi; megjithatë, kontrata të cilën e ka lidhur, mund të mbetet në fuqi, në qoftë se pushtet dhënësi më vonë e pranon atë.

Agjenti tregtar, i cili është i autorizuar ta shesë mallin, nuk është i autorizuar të inkasojë çmimin, as ta shesë mallin me kredi, përveç nëse është i autorizuar ta bëjë këtë. Ndërkaq, ai është i autorizuar që për pushtet dhënësin t'i pranojë reklamimet për të metat e mallit dhe deklaratat e tjera lidhur me përmbushjen e kontratës së lidhur me afarizmin e tij dhe në emër të pushtet dhënësit të ndërmarrë masat e duhura për ruajtjen e të drejtave të tija nga ajo kontratë (neni 84 par. 4 i LMD).

Prokura shuhet: sipas ligjit; me shuarjen e personit juridik, si përfaqësues; me vdekjen e personit fizik, si përfaqësues; me shuarjen e personit juridik, përkatësisht të personit juridik, si dhënës i prokurës, përveç nëse veprimi i filluar nuk mund të ndërpritet pa dëmtuar pasardhësit juridikë ose nëse prokura vlen edhe në rast vdekjeje të pushtet dhënësit qoftë sipas dëshirës së tij, qoftë duke marrë parasysh natyrën juridike të veprimit. Mirëpo, ndonëse në ligj nuk janë cekur forma të tjera, prokura, sidoqoftë, shuhet edhe në këto raste: me arritjen e qëllimit të përmendur në prokurë; me revokimin e prokurës; me skadimin e kohës për të cilën prokura është dhënë; me

shkaktimin e kushtit rezolutiv në të cilin prokura është dhënë; me humbje të aftësisë vepruese të personit fizik, të cilit iu ka dhënë prokura dhe me fillimin e falimentimit të personit juridik.

INTERPRETIMI I KONTRATËS

Gjatë realizimit të detyrimeve kontraktuese paraqitet nevoja që disa dispozita kontraktuese ose e tërë përmbajtja e kontratës të interpretohen, ngase palët nuk pajtohen lidhur me domethënien e vërtetë të tyre. Në qoftë se palët kontraktuese nuk mund ta zgjidhin kontestin me marrëveshje, ato mund t'i drejtohen gjykatës, arbitrazhit ose, me pëlqimin e tyre, palës së tretë, me kërkesën që të zgjidhet kontesti i lindur. Interpretim i kontratës do të thotë të vërtetohet domethënia e drejtë (e vërtetë) e ndonjë dispozite kontraktuese apo e përmbajtjes së tërësishme të kontratës. Parimisht, objekt interpretimi është vullneti i shprehur i palëve kontraktuese në rastet kur nuk ekziston përputhja në mes asaj që është manifestuar dhe vullnetit të vërtetë (vullnetit të brendshëm), prandaj edhe shtrohet pyetja se cili është vullneti relevant juridik. Si pikënisje, me rastin e interpretimit të kontratës, merret qëllimi i përbashkët i palëve, në të vërtetë çfarë kanë dashur ato, duke mos lënë anash edhe doket dhe mentalitetin e mjedisit, në të cilin kontrata është lidhur.

Ligji fillon nga siguria juridike, duke iu përmbajtur parimit *pacta sunt servanta*, domethënë, dispozitat e kontratës zbatohen ashtu siç janë theksuar në kontratë. Ndërkaq, me rastin e interpretimit të dispozitave kontestuese, nuk duhet rreptësisht t'i përmbahemi përmbajtjes së shprehjeve të përdorura, por duhet të hetohet qëllimi i përbashkët i palëve dhe dispozitat, duke kuptuar ashtu siç i përgjigjet parimeve të së drejtës së detyrimeve. Kur përmenden parimet e detyrimeve, në radhë të parë, mendohet për parimin e ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë (neni 4 i LMD).

Përveç rregullës së mësipërme, e cila konsiderohet si rregull e përgjithshme, ekzistojnë edhe rregulla plotësuese për interpretimin e kontratës. Te kontratat të cilat i ka hartuar njëra nga palët kontraktuese, siç janë kontratat formularë, në rast të ndonjë dispozite të pakuptueshme, është rregull që një dispozitë e tillë të interpretohet në dëm të asaj pale kontraktuese e cila e ka hartuar kontratën dhe i ka caktuar kushtet e kontratës.

Te kontratat pa shpërblim, dispozitat e pakuptueshme duhen interpretuar në kuptimin i cili është më pak i rëndë për debitorin, ndërsa te kontratat e dyanshme detyruese, ato duhet të interpretohen në kuptimin që të realizohet parimi i drejtë i prestimeve të ndërsjella.

Palët mund të parashikojnë që, në rast mospajtimi lidhur me domethënien e dispozitave kontraktuese, ato t'i interpretojë ndonjë palë e tretë. Me atë rast, nëse me kontratë nuk është parashikuar diçka tjetër, palët nuk mund t'i drejtohen gjykatës me kërkesë për interpretimin e kontratës, përderisa paraprakisht nuk e sigurojnë interpretimin nga pala e tretë, përveç nëse pala e tretë refuzon ta bëjë atë (neni 88 par. 2 i LMD).

PAVLEFSHMËRIA E KONTRATËS

Kontrata të pavlefshme janë ato kontrata të cilat janë lidhur në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat imperative dhe me moralin dhe që cenojnë interesin e përgjithshëm apo individual. Ligji njih dy lloje të pavlefshmërisë: pavlefshmërinë absolute (nuliteti absolut) dhe relative ose (kontratat relativisht të pavlefshme - të rrëzueshme).

Kontratat që lidhen në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat imperative dhe me moralin janë absolutisht nule, nëse qëllimi i rregullës së cenuar nuk i referohet ndonjë sanksioni tjetër ose nëse ligji, në rastin e caktuar, nuk përcakton diçka tjetër (neni 89 i LMD). Një kontratë e tillë është e pavlefshme dhe ajo nuk prodhon efekt juridik që nga fillimi. Të metat e një kontrate të tillë, përveç palëve kontraktuese, mund t'i vërejë edhe çdonjëri që nuk ka qenë palë kontraktuese, ngase është fjala për të meta thelbësore.

Nëse kontrata e pavlefshme i është ndaluar vetëm njërës palë kontraktuese, ligji ka parashikuar se ajo kontratë do të mbetet në fuqi apo, thënë më drejt, do të vlejë nëse në ligj nuk është parashikuar diçka tjetër për raste të tilla, ndërsa pala që ka cenuar ndalesën ligjore do t'i heqë pasojat përkatëse.

Vërtetimin e nulitetit të kontratës absolutisht nule mund ta kërkojë çdo person që ka interes juridik, palët kontraktuese, pasardhësit e tyre universalë apo singular, prokurori publik dhe atë është e detyruar ta bëjë edhe gjykata, sipas detyrës zyrtare - ex officio. Këtë nuk mund ta kërkojë pala e pandërgjegjshme.

Vendimi i gjykatës ka karakter deklarativ - vërtetues, ngase për faktin se kontratat nule nuk prodhojnë efekt juridik, nuk ka nevojë as të anulohen, por vetëm mund të konstatohet nuliteti i tyre.

E drejta e kërkesës për vërtetimin e nulitetit të kontratës nuk parashkruhet.

Në rast nuliteti absolut të kontratës, duhet të bëhet kthimi në gjendjen e mëparshme - restitutio in integrum, ashtu që secila palë kontraktuese është e detyruar t'i kthejë palës tjetër atë që ka marrë sipas bazës së një kontrate të tillë, e nëse kjo nuk është e mundur, ose natyra e asaj që është përmbushur i kundërvihet kthimit, duhet të jepet shpërblimi përkatës në të holla, sipas çmimeve të cilat vlejën në ditën e marrjes së vendimit gjyqësor, nëse ligji nuk ka caktuar diçka tjetër. Kthimi i prestimit të palëve bëhet duke pasur parasysh mirëbesimin e palëve kontraktuese, ashtu që gjykata mund të refuzojë pjesërisht ose në tërësi kërkesën e palës së pandërgjegjshme për kthimin e asaj që i ka dhënë palës tjetër, por mund të vendos që pala tjetër kontraktuese atë që ka marrë sipas një kontrate të tillë, t'ia dorëzojë komunës në territorin e së cilës ajo ka selinë.

Pasoja e vërtetimit të nulitetit absolut ndaj personave të tretë, të cilët nuk kanë qenë palë kontraktuese, varet nga ajo nëse personi i tretë ka fituar ndonjë të drejtë duke qenë me mirëbesim apo pa mirëbesim. Nëse nuk ka ditur, as nuk ka pasur mundësi të dijë për pavlefshmërinë absolute të kontratës, Kalojësi i së drejtës sipas kontratës së pavlefshme nuk mund të kërkojë kthimin e sendit nga personi i tretë i ndërgjegjshëm.

Edhe pse kontrata nule nuk prodhon efekt juridik, në rast se i plotëson kushtet e ndonjë kontrate tjetër, kjo e fundit mund të jetë e juridikisht e vlefshme.

KONTRATAT RELATIVISHT TË PAVLEFSHME (KONTRATAT E RRËZUESHME)

Janë ato kontrata që i ka lidhur personi që nuk ka fare zotësi për të vepruar, personi me zotësi për të vepruar të kufizuar, kur me rastin e lidhjes së kontratës ka pasur të meta në pikëpamje të shprehjes së lirë të vullnetit të njëres palë kontraktuese. Ligji flet për të metat e vullnetit, kur njëra palë lidh kontratë nën ndikimin e kërcënimit, lajthimit, mashtrimit si dhe kur lidhet kontrata fiktive. Me ligj është rregulluar actio Pauliana (neni 45 – 50 i LMD), me të cilën goditen kontratat për shkak të dëmtimit përtej mase neni 122 i LMD etj. Kontrata relativisht e pavlefshme nuk përmban të meta të paevitueshme, por përmban të meta të cilat mund të mënjanohen, ngase një kontratë e tillë mund të konvalidohet.

Kontrata relativisht e pavlefshme prodhon efekt juridik dhe nuliteti relativ nuk shkaktohet ex lege. Veprimi relativisht i pavlefshëm është i vlefshëm aq gjatë sa nuk goditet me padi. Vërtetimin e pavlefshmërisë relative të kontratës mund ta kërkojë pala e dëmtuar, trashëgimtari i saj dhe personi i tretë, i cili ka interes juridik. Mirëpo, kontraktuesi tjetër mund të kërkojë nga pala e interesuar që, brenda afatit të caktuar, por jo më pak se 30 ditë, të deklarohet nëse i qëndron kontratës ose jo, sepse, në të kundërtën, konsiderohet se kontrata është anuluar (neni 98 par. 2 i LMD).

E drejta për anulimin e kontratës relativisht të pavlefshme parashkruhet brenda afatit subjektiv prej një viti, nga dita kur pala e dëmtuar ka marrë dijeni për shkakun e nulitetit, përkatësisht brenda afatit objektiv prej tri vjetësh. Afati fillon të ecë nga dita e lidhjes së kontratës (neni 102 i LMD).

Pala në dobi të së cilës mund të anulohet kontrata mund të mos shfrytëzojë të drejtën e anulimit dhe shprehimisht mund të heqë dorë nga ajo e drejtë ose heshtazi të mos e shfrytëzojë atë të drejtë dhe të përmbushë detyrimet kontraktuese dhe, në atë mënyrë, kontrata relativisht e pavlefshme të konvalidohet dhe të bëhet e vlefshme.

Në rast anulimi të kontratës relativisht të pavlefshme, vendimi i gjykatës ka karakter konstitutiv. Pasojat e anulimit janë kthimi në gjendjen e mëparshme, shpërblimi i dëmit dhe pasojat ndaj personave të tretë.

Kontratat e dyanshme detyruese (kontratat me shpërblim)

Te kontratat me shpërblim, secila palë kontraktuese përgjigjet për të metat e detyrimit të përmbushur (neni 103 i LMD). Ligji njih dy lloje të të metave: të metat materiale dhe të metat juridike të detyrimit.

1. Përgjegjësia për të metat materiale të përmbushjes

Rregullat e përgjegjësisë për të metat materiale të përmbushjes më së tepërmi janë të përpunuara në pjesën e rregullave të përgjegjësisë së shitësit për të metat e

sendit, prandaj ato zbatohen përshtatshmërisht ndaj të gjitha detyrimeve të kalojësit të detyrimeve, përveçse kur me ligj është parashikuar diçka tjetër.

Përgjegjësia për të metat materiale të përmbushjes ka të bëjë me detyrimin e kalojësit që marrësit t'ia kalojë sendin pa të meta për shkak të të cilave ai nuk mund të përdoret. Sendi është me të meta materiale (fizike): nëse sendi nuk ka cilësi të duhura për përdorim të rregullt ose për qarkullim; nëse sendi nuk ka cilësi të duhura për përdorim të veçantë, për të cilin blerësi e ka blerë, e të cilën mungesë shitësi e ka ditur ose ka qenë i detyruar ta dijë; nëse sendi nuk ka cilësi ose veti të cilat shprehimisht ose heshtazi janë kontraktuar ose parashikuar me ligj dhe nëse shitësi ka dorëzuar sendin që nuk është i njëjtë me mostrën ose modelin, përveç nëse mostra ose modeli iu kanë treguar blerësit me qëllim njoftimi (neni 462 par. 1.4 i LMD). Prandaj, sendi ka të meta fizike kur nuk ka cilësi të parashikuara me kontratë, me ligj ose cilësi për të cilat është destinuar përdorimi i rregullt i tij.

Kalojësi nuk i përgjigjet marrësit për të metat e cekura më parë, nëse marrësi në momentin e lidhjes së kontratës ka pasur dijeni ose nuk ka qenë e mundur të mos dijë për të metat e tilla. Konsiderohet se blerësit nuk kanë mundur t'i mbesin të panjohura ato të meta të cilat personi i kujdesshëm, me dijeni dhe përvojë mesatare të personit dhe të degës, sikurse edhe blerësi, do të mund t'i vërente me lehtësi me rastin e kontrollimit të sendit. Mirëpo, edhe në rast se blerësi ka mundur t'i vërejë lehtë të metat e sendit me rastin e kontrollimit të mallit, shitësi është përgjegjës për të metat e sendit, nëse ka deklaruar se sendi nuk ka të meta ose ka cilësi të caktuara.

Të metat e sendit mund të jenë të dukshme dhe të padukshme (të fshehta).

Blerësi është i detyruar që sendin, të cilin e ka pranuar, ta kontrollojë në mënyrë të zakonshme dhe për të metat e vërejtura (të dukshme) ta njoftojë shitësin brenda afatit prej 8 ditësh, ndërsa te kontratat në ekonomi menjëherë, pa zvarritje, përndryshe e humb të drejtën që i takon sipas kësaj baze.

Kemi të bëjmë me të metë të fshehur të sendit atëherë kur, me një kontrollim të zakonshëm të sendit, ajo nuk mund të zbulohet.

Kur, pas pranimit të sendit nga ana e blerësit, zbulohet se sendi ka të meta, të cilat nuk kanë mundur të zbulohen me një kontrollim të zakonshëm me rastin e pranimit të mallit (e meta e fshehur), blerësi është i detyruar ta njoftojë shitësin për të metat e tilla brenda afatit prej tetë ditësh, nga dita e zbulimit të së metës, ndërsa te kontratat në ekonomi - menjëherë, pa zvarritje, përndryshe do ta humbasë të drejtën e cila do t'i takonte mbi këtë bazë. Shitësi nuk përgjigjet për të metat që paraqiten pas skadimit të afatit prej gjashtë muajve, përveç kur me kontratë të jetë caktuar një afat më i gjatë. Këtë të drejtë blerësi nuk e humbet edhe pas skadimit të afatit prej gjashtë muajsh, në qoftë se shitësi ka ditur për të metën e sendit ose nuk ka mundur të mbetet pa e ditur.

Palët kontraktuese mund ta kufizojnë me kontratë ose ta përjashtojnë plotësisht përgjegjësinë e shitësit për të metat materiale të sendit. Mirëpo, dispozita e kontratës, me të cilën kufizohet ose përjashtohet përgjegjësia e shitësit, është nule, në rast se shitësi ka ditur për ekzistimin e së metës së sendit dhe nuk e ka njoftuar blerësin për këtë, si dhe në rastin kur shitësi ka shfrytëzuar pozitën e tij monopoliste.

Kur blerësi ka zbuluar të metën e sendit, për të cilën e ka njoftuar me kohë shitësin, blerësi mund t'i realizoj këto të drejta: të kërkojë mënjanimin e të metës së sendit, zëvendësimin e sendit me të meta me sendin pa të meta, të kërkojë zvogëlimin proporcional të çmimit blerës të sendit, mund të zgjidhë kontratën në kushtet përkatëse të parashikuara me ligj dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit (neni 471 i LMD).

2. Përgjegjësia për të metat juridike të përmbushjes

Te kontrata me shpërblim ekziston edhe përgjegjësia për të metat juridike të përmbushjes. Kjo përgjegjësi ka të bëjë me detyrimin e njëjës palë kontraktuese që ta mbrojë palën tjetër nga të drejtat dhe kërkesat e personave të tretë, me të cilat e drejta e saj të jetë përjashtuar ose ngushtuar (neni 491 i LMD).

Nga kjo rregullativë rezulton se përgjegjësia për të metat juridike të sendit (eviksioni) ekziston në rastet e shqetësimit të blerësit nga persona të tretë, për shkak të pretendimit të tyre se kanë të drejtën e pronësisë mbi sendit ose sendi është i ngarkuar me ndonjë të drejtë, siç është, p.sh., e drejta e servitutës, e pengut, e hipotekës apo ndonjë ngarkesë tjetër, e cila ka ekzistuar para se blerësi ta blinte atë send. Kërkesat e personave të tretë më së shpeshti shfaqen me marrjen e posedimit të sendit. Që të ekzistojë përgjegjësia për të metat juridike, duhet të plotësohen këto kushte: që e meta juridike të ketë ekzistuar në momentin e lidhjes së kontratës, që blerësi të mos ketë ditur për një të metë të tillë dhe shitësi të jetë njoftuar me kohë për shqetësimin juridik nga ana e blerësit.

Blerësi i cili ka hyrë në kontest me personin e tretë, pa e njoftuar shitësin, dhe kontestin e humbet, mund t'i referohet përgjegjësisë së shitësit, përveç nëse shitësi provon se ai ka poseduar prova, në bazë të cilave do të ishte refuzuar kërkesëpadia e personit të tretë.

Në qoftë se shitësi nuk vepron sipas kërkesës së blerësit dhe nuk i ofron mbrojtjen e kërkuar, në rast të marrjes së sendit, kontrata shkëputet sipas vetë ligjit, ndërsa, në rast të kufizimit ose zvogëlimit të së drejtës së blerësit, blerësi mund ta shkëputë kontratën ose të kërkojë zvogëlimin proporcional të çmimit. Nëse shitësi, brenda një afati të arsyeshëm nuk i mënjanon pretendimet e personave të tretë, blerësi mund ta shkëputë kontratën, kur për atë arsye nuk mund të realizohet qëllimi i kontratës dhe të kërkojë shpërblimin e dëmit. Shpërblimin e dëmit nuk mund ta kërkojë, nëse në momentin e lidhjes së kontratës ka pasur dijeni për mundësinë që sendi t'i merret ose e drejta t'i kufizohet ose zvogëlohet, por në atë rast ka të drejtë të kërkojë zvogëlimin, përkatësisht kthimin e çmimit (neni 493 par. 4 i LMD).

Palët me kontratë mund ta kufizojnë ose ta përjashtojnë përgjegjësin për të metat juridike të sendit, përveçse kur shitësi ka ditur për ekzistimin e mungesave të tilla ose e shfrytëzon pozitën monopoliste dhe, në rast të kontraktimit të një klauzole të tillë, ajo nuk do të ketë efekt juridik, përkatësisht do të jetë nule.

E drejta e blerësit për realizimin e të drejtave sipas bazës së të metave juridike të sendit parashkruhet brenda afatit prej një viti, nga dita kur ai ka marrë dijeni për ekzistimin e së drejtës së personit të tretë, kurse në rast se pala e tretë e ka filluar

kontestin para skadimit të atij afati, kurse blerësi e ka thirrur shitësin të ndërhyjë në kontest, e drejta e blerësit shuhet brenda afatit prej gjashtë muajve, pasi aktgjykimi të marrë formën e prerë (neni 498 i LMD).

Kundërshtimi i mospërbushjes së kontratës

Kontratat me shpërblim sajojnë detyrime të ndërsjella të palëve kontraktuese dhe që të dy këto palë janë debitorë. Prandaj, është rregull që, nëse nuk është kontraktuar ndryshe, të dy palët të jenë të detyruara që t'i përbushin njëkohësisht detyrimet e veta. Mirëpo, në qoftë se njëra palë nuk e ka përbushur detyrimin e saj dhe iu ka drejtuar gjykatës me padi, me të cilën kërkon që të detyrohet pala tjetër ta përbushë detyrimin kontraktues, pala tjetër mund të paraqesë prapësimin e mospërbushjes. Në raste të tilla gjykata do t'i urdhërojë asaj që ta përbushë detyrimin e vet atëherë kur edhe pala tjetër ta përbushë detyrimin e saj. Prapësimi i përbushjes njëkohësisht mund të paraqitet në këto kushte: të ekzistojnë detyrimet e ndërsjella, përbushja e të cilave duhet të jetë e njëkohshme; të ekzistojë kërkesa e vlefshme juridike e palës së paditur, që kërkesa e palës së paditur të jetë borxhi kryesor dhe që asnjëra nga palët nuk e ka përbushur detyrimin e vet kontraktues.

Kundërshtimin për mospërbushjen e detyrimit mund ta paraqesë edhe pala e detyruar me kontratë për ta përbushur e para detyrimin, në rast se pas lidhjes së kontratës rrethanat materiale të palës tjetër janë keqësuar deri në atë masë saqë nuk është e sigurt që ajo mund ta përbushë detyrimin e vet ose ajo pasiguri rezulton nga arsye të tjera, ashtu që mund ta shtyjë përbushjen e detyrimit, përderisa pala tjetër nuk e përbush detyrimin e saj apo nuk ofron garanci se do ta përbushë atë (neni 104 par. 1 dhe 2 i LMD).

Në qoftë se pala tjetër, brenda afatit të arsyeshëm, nuk ofron siguri, pala e parë mund ta shkëputë kontratën.

Kundërshtimi i mospërbushjes së kontratës është i natyrës materiale dhe devolutive.

Shkëputja e kontratës për shkak të mospërbushjes

Te kontratat me detyrime të dyanshme, një ndër të drejtat e palës kontraktuese që ka përbushur detyrimin është e drejta e shkëputjes së kontratës. Kushtet për shkëputjen e kontratës dallohen sipas asaj nëse përbushja brenda afatit të caktuar është element thelbësor apo jo.

Që të mund të shkëputet kontrata për shkak të mospërbushjes së kontratës duhet të plotësohen këto kushte: të jetë fjala për kontratë me detyrime të dyanshme - me shpërblim; kontrata të mos jetë përbushur dhe debitori të jetë fajtor për mospërbushjen e kontratës.

Kur përbushja e detyrimit brenda afatit të caktuar paraqet element thelbësor të kontratës, ndërsa debitori nuk e përbush detyrimin brenda këtij afat, kontrata shkëputet sipas vetë ligjit dhe për këtë nuk është e nevojshme kurfar deklarate e kreditorit. Afati i

caktuar i përmbushjes është element thelbësor kur shprehimisht është thënë se detyrimi ka për t'u përmbushur "në afatin e fiksuar", "më së largu deri" ose në ndonjë mënyrë tjetër nga e cila mund të kuptohet qartë afati brenda të cilit debitori është i detyruar ta përmbushë detyrimin (neni 107 par. 1 i LMD). Kur përmbushja e detyrimit brenda afatit të caktuar nuk është element i kontratës, kreditori është i detyruar që debitorit t'i lërë një afat të arsyeshëm plotësues për përmbushjen e detyrimit, pas të cilit, nëse nuk e përmbush detyrimin, lindin të njëjtat pasoja sikurse edhe te kontrata tek e cila afati është element thelbësor (108 i LMD).

Pas skadimit të afatit, brenda të cilit kreditori nuk e ka përmbushur detyrimin e vet, kreditori nuk është i detyruar t'i lërë një afat plotësues, por ta shkëputë kontratën në rast se nga sjellja e debitorit del qartë se ai nuk do ta përmbushë detyrimin e vet brenda afatit të caktuar.

Kreditore mund ta shkëputë kontratën edhe para skadimit të afatit të caktuar për përmbushjen e detyrimit kontraktues, kur del qartë se debitori nuk dëshiron ta përmbushë detyrimin e vet.

Kur kontrata shkëputet, konsiderohet sikur të mos ishte lidhur fare. Palët kontraktuese lirohen nga detyrimet e veta, përveçse nga detyrimi për shpërblimin eventual të dëmit. Shkëputja e kontratës ka efekt prapaveprues dhe secila palë mund të kërkojë kthimin në gjendje të mëparshme (restitutio in integrum), siç ka qenë ajo para lidhjes së kontratës dhe secila prej tyre është e detyruar ta paguajë shpërblimin për dobinë të cilën e ka fituar nga ajo që është e detyruar ta kthejë, përkatësisht nëse është fjala për kthim të detyrimit në të holla, të paguajë kamatën nga dita kur është bërë pagesa (114 i LMD).

Shkëputja ose ndryshimi i kontratës për shkak të rrethanave të ndryshuara (klauzola rebus sic stantibus)

Palët lidhin kontratë për të arritur një qëllim të caktuar. Me rastin e lidhjes së kontratës, ato kanë parasysh rrethanat përkatëse, të cilat ekzistojnë në momentin e lidhjes së kontratës dhe në të cilat detyrimet e veta mund t'i përmbushin pa ndonjë vështirësi të jashtëzakonshme. Mirëpo, në praktikë ndodh që, pas lidhjes së kontratës, të lindin rrethana të cilat njëres palë ia vështirësojnë përmbushjen e detyrimeve në atë masë sa që qartazi kontrata më nuk i përgjigjet asaj që palët kontraktuese kanë pritur dhe, sipas mendimit të përgjithshëm, do të jetë e padrejtë që një kontratë e tillë të mbetet në fuqi ashtu siç është lidhur.

Që të mund të shkëputet ose të ndryshohet kontrata për shkak të ndryshimit të rrethanave, duhet të përmbushen kotë prezumime: që kontrata të jetë me detyrime të dyanshme; që rrethanat të kenë lindur pas lidhjes së kontratës; që rrethanat e shkaktuara njëres palë t'ia vështirësojnë përmbushjen e detyrimeve ose për shkak të tyre të mos mund të realizohet qëllimi i kontratës; që të jetë e qartë se kontrata e lidhur më nuk i përgjigjet asaj që palët kanë pritur dhe, sipas mendimit të përgjithshëm, do të ishte e padrejtë të mbetet në fuqi, si e tillë, dmth. siç ka qenë e lidhur; që rrethanat të kenë lindur pavarësisht nga vullneti i palëve dhe pa fajin e palës së cilës iu ka vështirësuar

përmbushja e detyrimeve kontraktuese dhe që përmbushja e detyrimit për debitorin do të ishte një barrë e rëndë.

Për shkak të rrethanave të ndryshuara, kontrata me prestime të përhershme, mund të shkëputet me kërkesë të njërës palë kontraktuese, por edhe mund të ndryshohet, nëse pala tjetër ofron ose pranon që kushtet të ndryshohen, ashtu që të mundësohet përmbushja e saj.

Në qoftë se gjykata merr vendim me të cilin e shkëput kontratën, me kërkesë të palës tjetër, do të detyrojë palën që ka kërkuar shkëputjen që palës tjetër t'ia caktojë pjesën e kompensimit të drejtë të dëmit, të cilin, për atë arsye, e ka pësuar (neni 116 par. 5 i LMD).

Kontrata nuk mund të shkëputet dhe as të ndryshohet, nëse pala së cilës iu ka vështirësuar përmbushja e detyrimit, menjëherë pasi të ketë marrë dijeni se janë shkaktuar rrethana të jashtëzakonshme, nuk e njofton palën tjetër për qëllimin e vet për të kërkuar shkëputjen e kontratës. Nëse këtë nuk e bënë është përgjegjëse për shpërblimin e dëmit.

Gjykata, me rastin e vendosjes lidhur me shkëputjen ose ndryshimin e kontratës, do të veprojë në përputhje me parimet e qarkullimit të ndershëm, rrezikun e jashtëzakonshëm të kontratës dhe interesin e të dy palëve kontraktuese (neni 118 i LMD).

Palët me kontratë mund të përjashtojnë të drejtën e kërkesës për shkëputjen ose ndryshimin e kontratës, përveçse kur një klauzolë e tillë është në kundërshtim me parimin e ndërgjegjshmërisë dhe të nderit.

Pamundësia e përmbushjes

Në kuptim të LMD, kemi të bëjmë me pamundësi të përmbushjes kur te kontratat e dyanshme përmbushja e detyrimit të njërës palë është bërë e pamundur për shkak të rrethanave të shkaktuara pas lidhjes së kontratës, për të cilat nuk është përgjegjëse asnjëra palë. Kur pamundësia e përmbushjes nga njëra palë është shkaktuar si pasojë e rrethanave, për të cilat nuk është përgjegjëse as pala tjetër, atëherë shuhet edhe detyrimi i palës tjetër.

Në rast se për shkak të rrethanave të shkaktuara, për të cilat nuk është përgjegjëse asnjëra nga palët, njërës palë iu ka bërë pjesërisht e pamundur përmbushja, pala tjetër mund ta shkëputë kontratën, nëse përmbushja e pjesëshme nuk u përgjigjet nevojave të saj; sidoqoftë, kontrata mbetet në fuqi, meqë pala tjetër ka të drejtë të kërkojë uljen proporcionale të detyrimit të vet (neni 120 par. 2 i LMD).

Kur përmbushja e detyrimit të kontratës e dyanshme është bërë e pamundur për rrethanat për të cilat është fajtorë pala tjetër, detyrimi i saj shuhet, ndërsa ajo mund ta mbajë të drejtën e vet ndaj palës tjetër, meqë kërkesa e saj zvogëlohet për aq sa ajo do të kishte mundur të kishte dobi nga lirimi prej detyrimit të saj. Nga kjo rezulton se qëllimi i kësaj rregulle është që debitori, detyrimi i të cilit shuhet, të mos përfitojë nga situata e shkaktuar për fajin e tij. Gjithashtu, ajo është e detyruar që palës tjetër t'ia kalojë edhe të gjitha të drejtat, të cilat i ka ndaj personave të tretë lidhur me objektin e detyrimit të saj.

Dëmtimi përtej mase (laesio in ormis)

Dëmtim i përtej mase ekziston në qoftë se mes detyrimeve të palëve, te kontratat e dyanshme, në kohën e lidhjes së kontratës, ka ekzistuar një shpërpjesëtim i qartë dhe pala e dëmtuar, në momentin e lidhjes së kontratës, nuk ka ditur dhe as nuk ka qenë e detyruar të dinte vleftën e vërtetë të prestimit të saj (neni 122 i LMD).

Që të mund të ekzistojë dëmtimi përtej mase, duhet të plotësohen këto kushte: të jetë fjala për kontratat me detyrime të dyanshme; që mes detyrimeve të ndërsjella të palëve kontraktuese, në kohën e lidhjes së kontratës, të ketë ekzistuar një shpërpjesëtim i qartë; dhe që pala e dëmtuar, në momentin e lidhjes së kontratës, të mos ketë ditur dhe të mos ketë qenë e detyruar të dinte për vleftën e vërtetë të sendit ose shërbimit, i cili është objekt i detyrimit të saj.

Pasojat juridike te kontratat te të cilat ekziston dëmtimi përtej mase qëndrojnë në të drejtën e palës së dëmtuar që të kërkojë anulimin e kontratës, ngase një kontratë e tillë është e rrëzueshme (relativisht e pavlefshme). E drejta për anulimin e kontratës shuhet pas të ketë kaluar një vit nga dita e lidhjes së kontratës.

Kontrata mund të mbetet në fuqi nëse pala tjetër ofron plotësimin e prestimit të saj deri te vlera e vërtetë e prestimit të palës së dëmtuar.

Nuk mund të kërkohet anulimi i kontratës për shkak të shpërpjesëtimit të prestimit të detyrimeve të palëve te kontrata e fatit, te shitja publike, si dhe në rast të dhënies së çmimit më të madh për shkak të prirjeve të veçanta.

Kontratat me fajde

Kontratë për fajdenë është ajo kontratë e dyanshme në bazë të së cilës njëra palë, duke shfrytëzuar gjendjen e mjerë ose gjendjen e vështirë materiale, përvojën e pamjaftueshme, mendjehetësinë a varësinë e palës tjetër, kontrakton për vete ose për një tjetër dobi pasurore e cila është në shpërpjesëtim të qartë me atë që palës tjetër i ka dhënë ose ka bërë për të ose që është i detyruar t'i japë a të bëjë.

Elementet thelbësore të kësaj kontrate, siç është parashikuar me LMD, janë: të jetë e dyanshme detyruese; që prestimet e palëve kontraktuese, në momentin e lidhjes së kontratës, të jenë në shpërpjesëtim të qartë; që njëra palë kontraktuese ta ketë shfrytëzuar pozitën e vështirë, në të cilën është ndodhur pala tjetër (gjendja e mjerë ose gjendja e vështirë materiale, përvoja e pamjaftueshme, mendjehetësia ose vartësia), nga e cila ka rezultuar një shpërpjesëtim i qartë mes prestimeve të ndërsjella të palëve; që pala e cila ka shfrytëzuar një pozitë të tillë të palës tjetër të ketë pasur dijeni ose të ketë qenë e detyruar të dinte që pala tjetër ndodhet në një situatë të tillë.

Kontrata për fajdenë dëmton interesin e individit dhe prandaj mund të thuhet se është fjala për një kontratë relativisht të pavlefshme. Por, kontrata për fajdenë bën pjesë edhe në radhën e kontratave të ndaluara dhe, sikurse tek ato, edhe këtu zbatohen rregullat e nulitetit absolut. Me gjithë faktin se kontratat absolutisht nule nuk mund të konvalidohen, LMD përmban dispozitën sipas së cilës, nëse pala e dëmtuar kërkon që detyrimi i saj të zvogëlohet në shumë të drejtë, gjykata do ta pranojë një kërkesë të tillë,

po qe se është e mundur dhe atëherë kontrata, me ndryshime përkatëse, do të mbetet në fuqi. I dëmtuari kërkesën për zvogëlimin e detyrimit mund ta bëjë brenda afatit prej pesë vjetësh, nga lidhja e kontratës (neni 123 par. 4 i LMD).

Kushtet e përgjithshme (kushtet e përgjithshme të afarizmit)

Kushtet e përgjithshëm (formulare) të kontratës janë një përmbledhje klauzolash, të cilat janë formular paraprakisht me shkrim, të cilat, në formë të tillë ose të ndryshuar, do të jenë bazë e të drejtave dhe detyrimeve të palëve kontraktuese me rastin e lidhjes së një kontratë konkrete në të ardhmen. Ato janë të përmbajtura në kontratën formulare të shtypur më parë nga njëra palë kontraktuese ose shpallen në mënyrë të veçantë. Kushtet e tilla e obligojnë palën tjetër, nëse ka qenë e njohur më to ose ka qenë e detyruar t'i njohë me rastin e lidhjes së kontratës. Në rast të mospajtit të kushteve të përgjithshme dhe klauzolave të veçanta, vlejnë këto të fundit. Me qëllim të mbrojtjes së palës më të dobët nga kushtet që i formulon më parë pala me pozitë më të volitshme ekonomike, ligji konsideron se janë nule ato klauzola të kushteve të përgjithshme të cilat janë në kundërshtim me qëllimin e vetë kontratës së lidhur ose me doket e mira afariste, edhe në rast se kushtet e përgjithshme të afarizmit kanë qenë të lejueshme nga organi kompetent.

Gjykata mund të refuzojë zbatimin e ndonjë dispozite të kushteve të përgjithshme, të cilat palën tjetër e privojnë nga e drejta për të paraqitur prapësime ose janë tepër të rrepta ndaj saj (neni 125 par. 2 i LMD).

Kalimi i kontratës

Kalimi i kontratës është një ndër efektet e veçanta që i karakterizon kontratat e dyanshme detyruese. Kalimi i kontratës ndodh në bazë të marrëveshjes mes njëres palë kontraktuese - cedentit të kontratës dhe personit të tretë - cesionarit, në bazë të së cilës, me pëlqimin e palës tjetër kontraktuese - cesuesit, kalojnë të drejtat dhe detyrimet që përmban ajo kontratë të personi i tretë - cesionari.

Me kalimin e kontratës nënkuptohet ardhja e personit të tretë në marrëdhënien e detyrimeve në pozitën e njëres palë kontraktuese, meqë të drejtat dhe detyrimet e përfshira në atë kontratë kalojnë te pala e tretë dhe shuhen ato të ceduesit. Me anë të kalimit të kontratës bëhet ndërrimi i njëres nga palët kontraktuese, e cila bëhet edhe kreditor edhe debitor në të njëjtën kontratë.

Kalimin e kontratës duhet dalluar nga kalimi i kërkesës (kalimit), ngase me kalimin e kontratës mund të bëhet ndërrimi i njëres apo palës tjetër kontraktuese, sepse te kontratat e dyanshme detyruese, secila nga palët ka pozitën e debitorit dhe kreditorit dhe, në bazë të marrëveshjes së njëres palë kontraktuese dhe me pëlqimin e palës tjetër, kalojnë ta palën e tretë të gjitha të drejtat dhe detyrimet, ndërsa te kalimi i kërkesës mund të ndodh vetëm ndërrimi i kreditorit por jo edhe i debitorit dhe se te pala e tretë - cesionari kalon vetëm kërkesa e cedentit dhe jo edhe detyrimet e tij. Kalimi i kërkesës mund të bëhet jo vetëm te kontratat e dyanshme detyruese, por te të gjitha llojet e kontratave.

Që të mund të jetë kalimi i kontratës i vlefshëm, duhet të plotësohen këto kushte: kalimi i kontratës mund të ndodhë vetëm kur kemi të bëjmë me kontratë të dyanshme detyruese, e cila nuk është ekzekutuar; që në marrëveshjen e kalimit mes njëres palë kontraktuese dhe personit të tretë ta ketë dhënë më parë pëlqimin pala tjetër kontraktuese, njëkohësisht kur është lidhur marrëveshja mes njëres palë kontraktuese dhe palës së tretë ose këtë pëlqim ta ketë dhënë më vonë; pëlqimi i tillë mund të jepet me gojë apo në formën e caktuar me ligj për kontratën e kaluar dhe nëse kontrata nuk është lidhur nisur nga cilësitë personale të palës kontraktuese (intuitu personae). Këto kushte duhet të plotësohen në mënyrë kumulative.

Cedenti i përgjigjet personit të tretë për vlefshmërinë juridike të kontratës së kaluar, por nuk i garanton që pala tjetër do ta përmbushë detyrimin e vet që përmban kontrata e kaluar, përveç nëse shprehimisht ka marrë përsipër një detyrim të tillë.

Mjetet e sigurimit të përmbushjes së kërkesës, të dhëna nga ana e ceduesit, kalojnë te pala e tretë, ndërsa mjetet e dhëna nga personat e tjerë nuk kalojnë me kalimin e kontratës, ngase ato mjete kanë qenë të lidhura me personalitetin e vetë ceduesit.

EFEKTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

Efektet e përgjithshme të kontratave kanë të bëjnë me krijimin, ndryshimin dhe shuarjen e marrëdhënieve detyrimore. Nga kontrata dalin të drejta dhe detyrime të palëve kontraktuese, pa marrë parasysh nëse e kanë lidhur kontratën personalisht apo, në emër dhe për llogari të tyre, e kanë lidhur përfaqësuesit e tyre ligjorë ose të autorizuarit e tyre. Kjo do të thotë se kontrata krijon të drejta dhe detyrime për palët kontraktuese (neni 130 par. 1 i LMD). Kontratat detyrimore krijojnë të drejta relative, të cilat kanë efekt inter partes - ndaj palëve kontraktuese dhe, parimisht, nuk kanë efekt ndaj personave të tretë, sepse për ta kontrata është res inter alios actio. Mirëpo, në të drejtën bashkëkohore, nga rregulla e mëparshme ekziston përjashtimi kur kontrata ka efekt juridik edhe ndaj personave që nuk janë pjesëmarrës në lidhjen e kontratës, por të drejtat dhe detyrimet që dalin nga kontrata janë të kalueshme nga një person te personi tjetër. Në raste të tilla ligji ka parashikuar se kontrata ka efekt juridik edhe për suksesorët juridikë të palëve kontraktuese, përveç nëse është kontraktuar diçka tjetër ose kur nga natyra e vetë kontratës nuk del diçka tjetër (neni 132 par. 2 i LMD).

Efekti i kontratës mund të shtrihet edhe mbi suksesorët singular, nëse ndodh kalimi i një kontrate të dyanshme detyruese, kalimi i kërkesës ose pranimit i borxhit me anë të një kontrate të njëanshme.

Kontrata në dobi të personit të tretë

Përjashtim nga rregulla se kontrata ka efekt juridik vetëm ndaj palëve kontraktues bën edhe kontrata e lidhur në dobi të personit të tretë.

Kontrata në dobi të personit të tretë është marrëveshje mes dy personave - palëve kontraktuese, sipas së cilës njëra palë, e cila quhet premtues (promitent), obligohet ndaj

palës tjetër, që quhet stipulant, që t'ia përmbushë një prestim të caktuar palës së tretë, e cila quhet shfrytëzues ose beneficjar. Te kjo kontratë, pala që quhet stipulant ka pozitën e kreditorit, pala që quhet promitent ka pozitën e debitorit, ndërsa personi i tretë, e cila quhet beneficjar, nuk merr pjesë në lidhjen e kontratës, por ka pozitën e shfrytëzuesit dhe nga kontrata nxjerr përfitime.

Për t'u lidhur një kontratë juridikisht e vlefshme në dobi të palës së tretë, duhet të plotësohen këto kushte: kontrata të lidhet mes premtuesit (promitentit) dhe kontraktuesit (stipulantit); një kontratë e tillë të përmbajë klauzolën se kontrata lidhet në dobi të personit të tretë; kontraktuesi (stipulanti) të ketë ndonjë interes. Këto kushte duhen plotësuar në mënyrë kumulative.

Sipas LMD, kur dikush kontrakton, në emër të vetin, kërkesën në dobi të tretit, i treti fiton të drejtën e vet të drejtpërdrejtë ndaj debitorit, nëse nuk është kontraktuar diçka tjetër ose nuk del nga rrethanat e kontratës (neni 132 i LMD). Nga kjo del se si kontraktuesi, ashtu edhe personi i tretë – beneficjari fiton të drejtën e drejtpërdrejtë që debitori - promitenti t'ia përmbushë prestimin të cilin ia ka premtuar në bazë të kontratës së lidhur me stipulantin.

Stipulanti mund ta revokojë ose ta ndryshojë dobinë e kontraktuar për të tretin - beneficjarin deri atëherë kur beneficjari nuk deklaron se pranon atë që është kontraktuar në dobi të tij.

Kontrata në dobi të personit të tretë lidhet më së shpeshti me qëllim që stipulanti të lirohet në atë mënyrë nga detyrimi i vet, të cilin e ka ndaj beneficjarit, ashtu që do ta udhëzojë promitentin që të përmbushë diçka për beneficjarin dhe jo për të.

Nëse beneficjari refuzon dobinë që është kontraktuar për të ose stipulanti e revokon atë, dobia i takon kontraktuesit - stipulantit, ngase pushon të ekzistojë kontrata në dobi të personit të tretë dhe ajo do të ketë efekt juridik mes palëve kontraktuese.

SHKAKTIMI I DËMIT

Nocionii dëmit.-Dëmi është një ndër burimet materiale të marrëdhënieve të detyrimeve. Marrëdhënia juridike lind ngase i është shkaktuar dëm tjetrit dhe ai duhet t'i shpërblehet atij. Që të mund të bëhet fjalë për shpërblimin e dëmit, është e nevojshme që, së pari, të ekzistojë dëmi, që të jetë shkaktuar një humbje në pasurinë e dikujt ose, përgjithësisht, të jetë cenuar ndonjë e drejtë e tij. Dëmi është njëri nga kushtet themelore për përgjegjësinë juridike-civile. Në bisedat e rëndonmta me fjalën dëm nënkuptohet çdo humbje, pavarësisht nga natyra e saj. Në këtë kuptim, thuhet se është dëm kur dikush sëmuret, kur lëshon një rast të mirë etj. Me fjalën dëm kuptohet çdo përjetim i ndonjë të keqeje. Por, në kuptimin e ngushtë juridik, me fjalën dëm konsiderohet cenimi i vlerave juridikisht të mbrojtura. LMD, si dhe ligjet e detyrimeve në shumë shtete, nuk e përcakton saktësisht kuptimin e dëmit, por jep orientime në bazë të cilave mund të përcaktohet kuptimi i tij. Në kuptimin juridik, dëmi paraqet

zvogëlimin e pasurisë së ndokujt (dëmi i thjesht) dhe pengimin e shtimit të saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimin e dhimbjeve fizike ose psikike ndaj tjetrit ose frikës (dëmi jomaterial - neni 137 i LMD).

Dëmi mund të jetë material (pasuror) dhe jomaterial ose moral.

a) Dëmi material dhe llojet e tij.- Me dëmin material kuptojmë cenimin e vlerave pasurore të ndonjë personi fizik apo juridik. Dëmi material shkaktohet më së shpeshti me asgjësimin, dëmtimin apo marrjen e sendit, bërjen të pamundur ose vështirësimin e shfrytëzimit të sendit, për mënjanimin e të cilave kërkohen shpenzime. Kemi të bëjmë me dëm material edhe në rast të shkaktimit të lëndimeve trupore – cenimi i integritetit fizik, humbja e aftësisë për punë, për të cilin shkak mund të humbasin të ardhurat mbi bazë të punës, si dhe në rast të shkaktimit të vdekjes së ndonjë personi.

Dëmi material mund të ndahet në dëm real ose të thjeshtë (damnum emergens) dhe fitim të humbur (lucrum cesans). Dëm material është zvogëlimi i pasurisë ekzistuese të dëmtuarit. Kështu ndodh kur dikujt i dëmtohet në tërësi automjeti në aksident trafiku, kur dikush ia thyen dorën personit tjetër, kur dikush u ekspozohet shpenzimeve lidhur me fikjen e zjarrit të vënë nga një person tjetër. Fitimi i humbur ekziston në rast të pengimit të shtimit të pasurisë së personit të dëmtuar. Fitimi i humbur është ai që, sipas rrjedhës së rregullt të gjërave ose rrethanave të veçanta, me të drejtë është pritur të realizohet, por kjo është penguar me veprimin ose lëshimin e dëmtuesit (neni 137 i LMD). Kjo ndodh kur shoferit, i cili ushtron profesionin e taksistit, dëmtuesi ia dëmton automjetin, për të cilin shkak ai, për një kohë të caktuar, nuk mund ta ushtrtojë profesionin, apo kur, për pasojë të lëndimeve trupore, tek i dëmtuari është shkaktuar humbja e aftësisë për punë, për të cilin shkak nuk mund të realizojë të ardhura nga marrëdhënia e punës, të cilat do t'i kishte realizuar sikur të mos ndodhte ngjarja dëmtuese.

b) Dëmi moral ose jomaterial.- Me dëm jomaterial kuptojmë cenimin e vlerave jopasurore, përkatësisht cenimin e vlerave personale të ndonjë personi. Dëmi jomaterial ekziston në rast të shkaktimit të dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore, zvogëlimit të aktivitetit jetësor, shëmtimit, cenimit të prestigjit e të nderit, cenimit të lirive dhe të drejtave të personalitetit, shkaktimit të vdekjes së personit të afërm dhe shkaktimit të frikës (neni 182 – 189 të LMD).

Bazat e përgjegjësive.- Në të drejtën pozitive të detyrimeve, në Kosovë ekzistojnë dy baza themelore të përgjegjësive dhe një bazë plotësuese për shpërblimin e dëmit: përgjegjësia sipas fajit dhe përgjegjësia objektive ose pa faj dhe baza plotësuese e përgjegjësive sipas parimit të drejtshmerisë.

Përgjegjësia për dëmin sipas bazës së fajit.- Që të ekzistojë përgjegjësia për shpërblimin e dëmit, duhet të plotësohen këto kushte: të ekzistojë dëmi, që dëmi të jetë shkaktuar me veprim ose lëshim të kundërligjshëm të dëmtuesit, që të ekzistojë

faji i dëmtuesit dhe të ekzistojë lidhja shkakësore mes veprimit dëmtues dhe pasojave - dëmit.

Veprimi është i kundërligjshëm kur është në kundërshtim me normën juridike, moralin shoqëror, me të cilin cenohet ndonjë e drejtë subjektive e të dëmtuarit. Megjithatë, ekzistojnë veprime të njeriut të cilat nuk janë të kundërligjshme, por dëmtuesi është përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Një përgjegjësi e tillë ekziston: kur dëmtuesi e shkakton dëmin, duke ushtruar ndonjë të drejtë që i takon, por me rastin e shfrytëzimit të saj nuk bën t'i kalojë kufijtë e lejuar, kur shfrytëzimi i së drejtës do të shndërrohej në keqpërdorim të së drejtës; kur dëmi shkaktohet me pëlqimin e të dëmtuarit; kur dëmi është shkaktuar nga personi zyrtar gjatë kryerjes së punës zyrtare, në kuadër të autorizimeve të veta; kur dëmi shkaktohet në mbrojtje të nevojshme; kur dëmi është shkaktuar në gjendje të nevojshme ekstreme dhe në rastin kur dëmi është shkaktuar në vetëndihëm të lejuar.

Faji ekziston kur dikush ka bërë diçka që nuk është dashur ta bëjë dhe që nuk do ta kishte bërë njeriu i arsyeshëm ose kur ka lëshuar ndonjë veprim, të cilin nuk do ta kishte lëshuar njeriu i arsyeshëm. Sipas LMD, faji ekziston edhe kur dëmtuesi e shkakton dëmin me dashje ose nga pakujdesia (neni 140 i LMD). Domethënë, kjo dispozitë njeh shkallët e fajësisë - dashjen ose qëllimin dhe pakujdesinë. Qëllimi ekziston kur dëmtuesi ka qenë i vetëdijshëm për veprimet e veta dhe ka dashur të shkaktohet pasoja ose kur ka qenë i vetëdijshëm që, për shkak të veprimeve të tij, mund të shkaktohen pasoja dhe ka pranuar të ndodhin ato. Pakujdesia ekziston kur dëmtuesi nuk ka vepruar me kujdesin e njeriut mesatarisht të kujdesshëm (pakujdesia ekstreme) ose nuk ka vepruar me kujdesin e njeriut shumë të kujdesshëm (pakujdesia e rëndomtë).

Lidhja kauzale (shkakësore).-Lidhja kauzale është një ndër kushtet e përgjithshme për përgjegjësinë për dëmin e shkaktuar. Lidhja kauzale është lidhje mes ngjarjes për të cilën pala është përgjegjëse dhe pasojave të saj, të cilat paraqesin dëmin. Një person përgjigjet për dëmin e shkaktuar vetëm në rast se ekziston lidhja kauzale mes veprimeve të tij dhe pasojës së shkaktuar - dëmit. Veprimi është shkak i dëmit, në qoftë se paraqet kusht të drejtpërdrejtë dhe të pandërprerë dhe nëse, sipas efektit të tij të rregullt, është shkaktuar dëmi.

Përgjegjësia për tjetrin

Në të drejtën e detyrimeve ekziston një rregull e përgjithshme sipas së cilës, çdokush është përgjegjës për veprimet e veta dëmtuese lidhur me shpërblimin e dëmit të shkaktuar ndaj personit tjetër. Sipas LMD, kush tjetrit i shkakton dëm, ai është i detyruar t'ia shpërblejë atë (neni 136 i LMD) Por, me qëllim të sigurisë juridike të personit të dëmtuar që t'i shpërblehet dëmi i shkaktuar, nga kjo rregull ligji ka parashikuar përjashtime, kur për dëmin e shkaktuar nuk përgjigjet shkaktuesi i dëmit, por personi tjetër, siç është rasti me përgjegjësinë e prindit, përkatësisht kujdestarit për dëmin e shkaktuar nga ana e fëmijës së moshës jomadhore ose personit ndaj të cilit iu ka besuar

kujdesi dhe mbikëqyrja si dhe në rast të përgjegjesisë së ndërmarrjes, përkatësisht të personit tjetër juridik për dëmin e shkaktuar nga punëtori i tij.

Përgjegjësia e prindit për dëmin e shkaktuar nga fëmija i mitur dhe përgjegjësia e kujdestarit për dëmin e shkaktuar nga personi i privuar nga zotësia për të vepruar.

Prindërit janë përgjegjës për dëmin e shkaktuar nga fëmija i tyre deri në moshën shtatëvjeçare, pavarësisht nga ajësia. Nga kjo përgjegjësi mund të lirohen vetëm nëse provojnë se ekzistojnë arsye për përjashtimin e përgjegjesisë sipas rregullave për përgjegjësinë, pavarësisht nga fajti.

Për veprimet dëmtuese të fëmijës mbi 7 vjeç, prindi dhe kujdestari përgjigjen sipas parimit të fajit të supozuar. Nga kjo përgjegjësi mund të lirohen kur provojnë se kanë bërë mbikëqyrjen e nevojshme dhe se dëmi është shkaktuar pa fajin e tyre. Për dëmin e shkaktuar nga fëmija i moshës mbi 7 vjeç, përveç prindit, mund të përgjigjet edhe fëmija, në rast se provohet se në momentin e shkakimit të dëmit, ai ka qenë i aftë për të gjykuar, për ta kuptuar rëndësinë e veprimeve të veta, ndërsa i mituri mbi 14 vjeçar konsiderohet se posedon aftësi për të gjykuar dhe është përgjegjës sipas bazës së fajësisë, sikurse edhe personi i moshës madhore dhe ndaj personit të dëmtuar ekziston përgjegjësia solidare e të miturit dhe prindërve.

Për të ekzistuar përgjegjësia e prindërve për dëmin e shkaktuar nga fëmijët e tyre, duhet të përmbushen këto kushte: ekzistimi i dëmit; dëmi të jetë shkaktuar nga fëmija i mitur; në momentin e shkakimit të dëmit fëmija i mitur të ketë jetuar së bashku me prindin, përkatësisht fëmija të mos jetë nën mbikëqyrjen e një personi tjetër.

Përgjegjësia e punëdhënësit dhe e personave të tjerë juridikë për dëmin që i shkaktohet personit tjetër nga punonjësi e tyre apo organet e tyre.

Për dëmin të cilin ia shkakton personit të tretë punëmarrësi në punë ose lidhur me punën, përgjigjet punëdhënësi në të cilën punëmarrësi ka punuar në momentin e shkakimit të dëmit, përveç nëse provon se punëmarrësi ka vepruar ashtu siç është dashur të veprohet. Por, nëse punëmarrësi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia ekstreme, i dëmtuari mund të kërkojë shpërblimin e dëmit drejtpërdrejt edhe nga punëmarrësi. Kjo do të thotë se, në kushte të caktuara, mund të jetë përgjegjësia solidare e punëdhënësit dhe punëmarrësit për shpërblimin e dëmit personit të tretë.

Sipas të njëjtit parim, sikurse punëdhënësi, edhe personat e tjerë juridikë përgjigjen për dëmin të cilin organi i tyre ia shkakton personit të tretë gjatë ushtrimit ose lidhur me ushtrimin e funksioneve të tij (neni 153 i LMD).

Për të ekzistuar përgjegjësia e punëdhënësit ose e personave të tjerë juridikë për dëmin të cilin e shkaktojnë punonjësit, përkatësisht organet e tyre në kushtet e përmendura më sipër duhet të plotësohen këto kushte: të jetë shkaktuar dëmi; dëmi të jetë shkaktuar nga punonjësi në punë ose lidhur me punën, përkatësisht gjatë ushtrimit të funksionit ose lidhur me funksionin dhe dëmi të mos jetë shkaktuar me dashje ose nga pakujdesia ekstreme.

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose veprimtaria e rrezikshme

Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm ose veprimtaria e rrezikshme është një ndër përgjegjësit civile sipas parimit të përgjegjësisë objektive. Si sende të rrezikshme konsiderohen ato që, për shkak të pozitës së tyre, ndikimit, cilësive ose vetë ekzistimit të sendit, si të tillë, përbëjnë rrezik të shtuar për mjedisin. Më së shpeshti përgjegjësia objektive ka të bëjë me lëmenj, në të cilët punohet me energji elektrike, lëndë shpërthyesë, makina me avull ose me gaz, pajisje me energji nukleare, instalime për kalimin e energjisë elektrike. Si rrezik i shtuar konsiderohet edhe ndezja e zjarrit në hapësirë të hapur, përhapja e ndotësve dhe ndotja e mjedisit. Dëmi i shkaktuar lidhur me sendin e rrezikshëm ose nga veprimtaria e rrezikshme konsiderohet se rrjedh nga ai send ose veprimtari, përveçse kur provohet se ato nuk kanë qenë shkak i dëmit (neni 154 i LMD). Për dëmin e shkaktuar nga sendi i rrezikshëm përgjigjet zotëruesi i saj, kurse për dëmin nga veprimtaria e rrezikshme përgjigjet personi që merret me te. Prezumimet për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga sendi i rrezikshëm apo veprimtaria e rrezikshme janë: që të jetë shkaktuar dëmi dhe të ekzistojë lidhja shkakësore mes dëmit dhe përdorimit të sendit, përkatësisht ushtrimit të veprimtarisë së rrezikshme që paraqet rrezik të shtuar për mjedisin. Përgjegjësia e pronarit të sendit të rrezikshëm apo veprimtarisë së rrezikshme për shpërblimin e dëmit përjashtohet nëse dëmi është shkaktuar me ndikimin e forcës madhore, me veprimin e të dëmtuarit apo me veprimet e personave të tretë.

PËRGJEGJËSIA NË RAST FATKEQËSIE TË SHKATUAR ME AUTOMJET NË LËVIZJE

Për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me automjetin në lëvizje ekzistojnë rregulla të veçanta. Përgjegjësia për dëmin e shkaktuar me automjetin në lëvizje bazohet në fajësinë e shfrytëzuesit të automjetit. Në qoftë se dëmi është shkaktuar për fajin ekskluziv të njërit drejtues të automjetit, ai është përgjegjës për shpërblimin e tërë dëmit të shkaktuar me automjetin në lëvizje. Por, në qoftë se ekziston fajësia e dyanshme, secili drejtues i automjetit përgjigjet për shpërblimin e dëmit në përpjesëtim me shkallën e fajësisë për tërë dëmin e shkaktuar. Në rast të mungesës së fajësisë për dëmin e shkaktuar, drejtuesit e automjetit janë përgjegjës për shpërblimin e dëmit në pjesë të barabarta, nëse arsytet e drejtshmërisë nuk kërkojnë diçka tjetër. Për dëmin e shkaktuar ndaj personave të tretë, drejtuesit e automjeteve janë përgjegjës solidarë (neni 159 par. 4 i LMD).

Përgjegjësia për të metat e produkteve

Produkti me të meta që vihet në qarkullim përbën rrezik të shtuar për shkaktimin e dëmit ndaj njerëzve dhe sendeve. Për këtë arsye, me LMD ka rregulluar çështjen e përgjegjësisë së prodhuesit të sendeve të tilla. Prodhuesi i cili e vë në qarkullim sendin

që ka prodhuar, i cili, për shkak të ndonjë të mete për të cilën ai nuk e ka ditur, paraqet rrezik për dëmtimin e njerëzve dhe sendeve, është përgjegjës për shpërblimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e asaj të mete. Prodhuesi përgjigjet edhe për cilësitë e rrezikshme të sendit, në qoftë se nuk ka ndërmarrë të gjithë atë që kërkohet në mënyrë që dëmin, të cilin ka munduar ta parashikojë, ta pengojë me tërheqjen e vërejtjes, me ambalazh të sigurt ose me masa të tjera përkatëse (neni 160 i LMD). Prodhuesi i sendit me të meta, për dëmin e shkaktuar, përgjigjet mbi bazë të përgjegjësisë objektive, sepse sendet me të meta janë sende të rrezikshme si pasojë e cilësive të tilla që kanë. Që prodhuesi i sendit me të meta të mund të jetë përgjegjës për t'ia shpërblyer dëmin personit tjetër, duhet të plotësohen këto kushte: dëmi t'i jetë shkaktuar ndonjë personi; dëmi të jetë shkaktuar si pasojë e të metave të sendit dhe sendi me të meta të jetë vënë në qarkullim.

PËRGJEGJËSIA PËR DËMIN MATERIAL

Qëllimi i shpërblimit të dëmit është rivendosja e gjendjes së mëparshme të pasurisë së të dëmtuarit, domethënë, ashtu siç ka qenë ajo para se të ndodhte ngjarja dëmtuese. Ky qëllim, sipas LMD, mund të arrihet në dy mënyra: në natyrë dhe në të holla. Në qoftë se të dëmtuarit iu ka marrë ose dëmtuar sendi, rikthimi i gjendjes së mëparshme në natyrë arrihet me kthimin e sendit, përkatësisht riparimin e sendit të dëmtuar apo zëvendësimin me një send tjetër të njëjtë lloj dhe me vlerë të njëjtë. Mirëpo, kjo formë nuk është e mundur gjithëherë dhe në këso rastesh ose kur gjykata konsideron se nuk është e nevojshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, ajo do të caktojë që të dëmtuarit t'i paguhet shuma përkatëse e të hollave, në emër të shpërblimit të dëmit. Ligji e lejon shpërblimin e dëmit në të holla edhe në rast se këtë e kërkon i dëmtuari dhe këtë e lejojnë rrethanat e rastit konkret (neni 169 i LMD).

Shpërblimi i dëmit në të holla i bëhet të dëmtuarit edhe kur sendi i është marrë në mënyrë të palejueshme atij dhe është asgjësuar nga forca madhore.

Shpërblimi në formë të rentës

Kur dëmi i është shkaktuar personit fizik dhe ai ka të bëjë me vdekjen, lëndimin trupor ose dëmtimin e shëndetit, shpërblimi i dëmit, sipas rregullit, bëhet në formë të rentës së përjetshme ose rentës në kohë të caktuar. Kreditori mund të kërkojë t'i jepet një garanci për pagesën e rentës, përveç nëse ajo, sipas rrethanave të rastit, nuk do të ishte e arsyeshme. Renta në të holla paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër (neni 172 par. 2 i LM). Nëse nuk i sigurohet një garanci e tillë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë që, në vend të rentës, t'i paguhet një shumë e përgjithshme, lartësia e së cilës caktohet sipas shumës së rentës dhe kohëzgjatjes së jetës së debitorit, duke zbritur kamatat përkatëse (neni 172 par. 4 i LMD).

Shpërblimi i dëmit në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit

Në rast të vdekjes, lëndimit trupor dhe dëmtimit të shëndetit të personit fizik shkaktohet dëmi material në forma të ndryshme. LMD përmban dispozitat, me të cilat është rregulluar shpërblimi i dëmit. Në rastet e lëndimit trupor, dëmtuesi është i detyruar t'ia shpërblejë dëmin të dëmtuarit lidhur me mjekimin nga lëndimet e marra dhe shpenzimet e tjera që kanë të bëjnë me të, si dhe të ardhurat e humbura nga puna si pasojë e humbjes së aftësisë së përkohshme a të përhershme për punë dhe zvogëlimit të kësaj aftësie. Nëse i dëmtuari, për pasojë të paaftësisë së përkohshme ose të përhershme për punë, humb të ardhurat nga puna ose i shtohen nevojat në mënyrë të përhershme ose i zvogëlohen apo i zhduken mundësitë e zhvillimit dhe të avancimit, dëmtuesi është i detyruar t'i paguajë të lënduarit rentën e caktuar në të holla, si shpërblim të një dëmi të tillë (neni 177 – 179 i LMD).

Në rast të vdekjes së personit, anëtarët e familjes së tij kanë të drejtën t'u shpërblehet dëmi material: shpenzimet e varrimit; ushqimi i personave të cilët i vdekuri, sipas ligjit, ka qenë i detyruar t'i ushqejë. Shpërblimi i dëmit për ushqimin e humbur paguhet në formë të rentës, shuma e së cilës caktohet duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, por e cila nuk mund të jetë më e madhe se ajo të cilën i dëmtuari do ta kishte fituar nga i vdekuri, sikur të kishte mbetur gjallë.

Shuma e rentës së caktuar, pas ndryshimit të rrethanave, mund të rritet sipas me kërkesë të dëmtuarit apo të zvogëlohet, përkatësisht të shuhet me kërkesës së dëmtuesit. E drejta e ushqimit të caktuar në formë të rentës për shkak të vdekjes së personit të afërm, lëndimit trupor ose shëmtimit trupor nuk mund t'i kalohet një personi tjetër, përveç shumave të arritura për pagesë, të cilat janë caktuar me marrëveshje me shkrim të palëve ose me aktgjykim të formës së prerë.

Shpërblimi i dëmit material në rast të cenimit të nderit dhe përhapjes së fakteve të pavërteta

Veprimet dëmtuese, të cilat kanë të bëjnë me cenimin e nderit, përhapjen ose kalimin e fakteve të pavërteta për të kaluarën, dijen dhe aftësitë e personit tjetër, për të cilat dëmtuesi ka pasur dijeni ose është i detyruar të dijë që janë të pavërteta, janë bazë e veçantë e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit material, të cilin e pëson i dëmtuari. Me veprime të tilla të dëmtuarit i cenohen vlerat jo materiale, me të cilat i shkaktohet dëmi material. Me veprime të tilla të dëmtuarit mund t'i rrezikohet seriozisht ekzistenca materiale. Kjo është arsyeja për të cilën dëmtuesi detyrohet t'ia shpërblejë dëmin të dëmtuarit, të cilin ky e ka pësuar nga veprimet dëmtuese (neni 185 i LMD). Për vlerësimin e ekzistimit të cenimit të interesave materiale të dëmtuarit, si pasojë e cenimit të integritetit të tij, është relevante që dëmtuesi të përhapë fakte të pavërteta për të kaluarën e të dëmtuarit, për cilësitë e tij personale, duke ditur se faktet e tilla janë të pavërteta, si dhe me përhapjen e tyre pa interes material të personit i cili përhap dhe para të cilit bëhet përhapja, mund t'i rrezikohet ekzistenca materiale e të dëmtuarit.

Shpërblimi i dëmit jomaterial

Përveç dëmit material dhe pavarësisht nga ekzistimi i tij, mund të shkaktohet edhe dëmi jomaterial. Një dëm i tillë mund të shkaktohet me cenim të integritetit të njeriut, i cili ka të bëjë me shkaktimin e dhimbjeve fizike, dhimbjeve shpirtërore, uljen e aktivitetit jetësor, shëmtimin, me cenimin e prestigjit dhe nderit, lirive ose të drejtave të personalitetit, me shkaktimin e vdekjes së personit të afërm dhe shkaktimin e frikës. Qëllimi i shpërblimit të dëmit është që të rivendoset gjendja e mëparshme e pasurisë së të dëmtuarit, ajo para se të shkaktohej dëmi. Te dëmi material, parimisht, kjo mund të realizohet në natyrë. Për dallim nga kjo, te shpërblimi i dëmit moral rivendosja e gjendjes së mëparshme realizohet varësisht nga forma e dëmit të tillë. Në rast të cenimit të së drejtës së personalitetit, kjo mund të arrihet me publikimin e aktgjykimit me shpenzime të dëmtuesit ose me revokimin e deklaratës nga ana e dëmtuesit, me të cilën është shkakuar dëmi ose në një mënyrë tjetër, me të cilën arrihet qëllimi i shpërblimit të dëmit. Në raste të tjera gjykata të dëmtuarit ia cakton shpërblimin e drejtë në të holla, i cili ka karakter të satisfaksionit moral. Shpërblimin e drejtë për dhimbjet shpirtërore të përjetuara gjykata mund t'ia caktojë edhe personit i cili, me anë të mashtrimit, shtrëngimit ose të keqpërdorimit të ndonjë raporti, të nënshtrimit ose vartësisë, është shtrënguar të ketë marrëdhënie seksuale ose është kryer ndonjë vepër tjetër kundër dinjitetit të personalitetit dhe moralit të tij (neni 185 i LMD).

Në rast të vdekjes së personit të afërm, të drejtën e shpërblimit të drejtë në të holla e kanë anëtarët e familjes së ngushtë (bashkëshorti, fëmijët dhe prindërit e të vdekurit), por kjo e drejtë mund t'iu përkasë edhe vëllezërve dhe motrave të vdekurit, në rast se mes tyre dhe të vdekurit ka ekzistuar bashkësia e përhershme jetësore. Për dhimbjet e pësuar shpirtërore, gjykata mund t'iu caktojë shpërblimin e drejtë anëtarëve të familjes së ngushtë edhe në rast të invaliditetit të rëndë të ndonjë personi.

Si kriter për vërtetimin e masës së dëmit merret parasysh shkalla e intensitetit të dhimbjeve fizike, frikës dhe kohëzgjatja e tyre.

PËRGJEGJËSIA E DISA PERSONAVE PËR TË NJËJTIN DËM

Për shpërblimin e dëmit të shkakuar me pjesëmarrjen e shumë personave me veprime të tyre të drejtpërdrejta apo të tërthorta si nxitës, ndihmës si dhe ata që ndihmojnë që personat përgjegjës të mos zbulohen, të gjithë këta janë përgjegjës në mënyrë solidare. Ata të gjithë konsiderohen pjesëmarrës në shkaktimin e dëmit, ngase që të gjithë, në ndonjë mënyrë, kanë pasur dorë në shkaktimin e dëmit. Përgjegjësia solidare për shpërblimin e dëmit ekziston edhe kur dëmin e kanë shkakuar dy a më shumë persona veç e veç, pavarësisht nga njëri- tjetri, në qoftë se nuk mund të vërtetohet shkalla e kontributit të secilit prej tyre në shkaktimin e dëmit. Përgjegjësia solidare për shpërblimin e dëmit ekziston edhe kur është e sigurt se dëmin e kanë shkakuar dy ose më shumë persona të caktuar, të cilët në ndonjë mënyrë janë të lidhur mes tyre, por nuk mund të vërtetohet cili nga ata e ka shkakuar dëmin (neni 190 par. 4 i LMD). Pas pagesës së dëmit nga njëri prej debitorëve solidarë, ky ka të drejtë të kërkojë pjesët përkatëse në procedurën e regresit, shuma e të cilave caktohet sipas shkallës së

pjesëmarrjes në shkaktimin e dëmit, por, po qe se nuk mund të vërtetohet një shkallë e tillë e secilit pjesëmarrës të shkaktimit të dëmit, çdonjëri duhet të paguajë pjesë të barabarta të shpërblimit, përveç nëse arsyet e drejtësisë nuk e lejojnë këtë.

PASURIMI PA BAZË

Pasurimi pa bazë është një ndër burimet materiale të së drejtës së detyrimeve. Pasurimi pa bazë është kalimi pa bazë juridike i pasurisë së një personi, i cili quhet i varfëruar, në pasurinë e personit tjetër, i cili quhet i pasuruar. Pasurim i pabazë do të thotë rritje e pasurisë ose kursimi në pasurinë e një personi, duke u zvogëluar pasurinë e personit tjetër pa bazë të vlefshme juridike. Kjo mund të shkaktohet me veprimet e të varfëruarit (kur dikush dy herë e paguan të njëjtin borxh ose e paguan borxhin që nuk ekziston), me veprimet e të pasuruarit (kur ky shfrytëzon materialin e huaj ndërtimor për ndërtimin e objektit të vet) dhe për shkak të forcës madhore (kur dikujt i rritet pasuria për pasojë të ndikimit të përmytjeve). Për t'u quajtur pasurim i pabazë (*Conditio sine causa*) duhet të plotësohen këto prezumime: rritja e pasurisë së të pasuruarit; zvogëlimi i pasurisë së të varfëruarit; mosekzistimi i bazës së vlefshme juridike; mënyra e lejueshme e kalimit të pasurisë dhe lidhja kauzale. Ekziston një rregull e përgjithshme se kur dikush pasurohet pa bazë juridike, lind detyrimi i kthimit, përkatësisht i shpërblimit të vlerës së saj në të holla të varfëruarit (neni 194 par. 4 i LMD).

Me pasurimin e pabazë krijohet marrëdhënia detyrimore mes personit të pasuruar dhe të varfëruar, ashtu që personi i pasuruar është i detyruar t'ia kthejë personit të varfëruar atë që ka pranuar pa bazë juridike.

Ligji përmban rregulla për kthimin e fitimit pa bazë. Sipas këtyre rregullave, nuk mund të kërkoj kthimin ai që e ka bërë pagesën duke ditur se nuk është i detyruar ta bëjë atë, përveç në rast se e ka rezervuar të drejtën të kërkojë kthimin ose pagesën e ka bërë për t'iu shmangur dhunës. Nuk mund të kërkohej as ajo që është dhënë ose është bërë në emër të përmbushjes së ndonjë detyrimi natyror, moral ose shoqëror, si dhe të asaj që është paguar në emër shpërblimit të dëmit, për shkak të lëndimit trupor, dëmtimit të shëndetit ose vdekjes, nëse pagesa iu ka bërë personit të ndërgjegjshëm.

Në të gjitha format e pasurimit të pabazë ekziston detyrimi i të pasuruarit që përveç asaj që është fituar pa bazë, t'i kthejë edhe frytet dhe kamatën, nga dita e paraqitjes së padisë dhe kur fituesi është i pandërgjegjshëm, nga dita e fitimit pa bazë.

KRYERJA E PUNËVE TË HUAJA PA AUTORIZIM (NEGOTIORUM GESTIO)

Parim i përgjithshëm është që askush nuk bën të ndërhyjë në punët e huaja. Nga ky parim ekziston përjashtimi në rastet kur dikujt i nevojitet ndihma e tjetrit. Ekziston edhe parimi moral për ta ndihmuar njëri-tjetrin jo vetëm kur vërehet ekzistimi e nevojës, por edhe kur dikujt i kanoset rreziku të pësojë humbje personale apo materiale, të cilën nuk mund ta pengojë vetë, më së shpeshti për shkak se për këtë as që ka dijeni. Për këto

arsye, e drejta e detyrimeve bën përjashtime nga rregulla se askush nuk bën të përzihet në punët e huaja, duke lejuar kështu kryerjen e punëve të huaja pa autorizim.

Kryerja e punëve të huaja pa autorizim është një ndër burimet materiale të detyrimeve. Ky institucion juridik është rregulluar me dispozitat e LMD (neni 203 - 211). Kryerja e punëve të huaja pa autorizim ekziston kur dikush kryen pa autorizim punë fizike ose juridike të ngutshme, me qëllim të mbrojtjes së pasurisë nga dëmi ose rritjes së pasurisë së të zotit të punës.

Për të ekzistuar kryerja e punëve të huaja pa autorizim, duhet të ekzistojnë këto prezumime: që kryerësi i punëve pa autorizim vërtet të ketë ndërmarrë kryerjen e punëve të huaja; që puna të jetë e huaj; që puna të jetë kryer me qëllim të mbrojtjes së interesit të huaj dhe që kryerësi i punës të mos jetë i autorizuar sipas ligjit, me kontratë apo në ndonjë mënyrë tjetër për t'i kryet punët e huaja.

Në teorinë juridike përmenden këto lloje të kryerjes së punëve të huaja pa autorizim: kryerja e domosdoshme e punëve të huaja pa autorizim, kryerja e dobishme e punëve të huaja pa autorizim (kur kryerësi i punëve të huaja ndërmerr veprime për të evituar dëmin, i cili i kanoset të zotit të punës ose pasurisë së tij); kryerja e ndaluar e punëve të huaja pa autorizim (kur kryerësi i punës pa autorizim ndërmerr veprimin për të zotin e punës përkundër ekzistimit të ndalesës së të zotit të punës dhe kryerja jo juridike e punëve të huaja pa autorizim (kur kryerësi i punëve ndërmerr veprime me qëllim të sigurimit të dobisë materiale për vete).

Në rast të kryerjes së punëve pa autorizim, krijohet marrëdhënia e detyrimeve mes kryerësit të punëve pa autorizim dhe të zotit të pasurisë.

Detyrimet e kryerësit të punëve pa autorizim janë: ta njoftojë të zotin sa më parë që është e mundur, të vazhdojë punët e filluara deri sa nuk i merr përsipër vetë i zoti, që punët e tilla t'i kryejë me kujdesin e shtëpiakut të mirë ose të ekonomistit të mirë dhe, pas përfundimit të punës, t'i paraqesë llogari dhe t'ia kalojë gjithë atë që ka siguruar me kryerjen e punës pa autorizim atij që i përket kjo punë.

Kryerësi i punës së huaj pa autorizim ka të drejtë të kërkojë nga i zoti i pasurisë: që i zoti ta lirojë nga të gjitha detyrimet të cilat, për ta kryer punën e tij, i ka marrë përsipër dhe detyrimet nga veprimet juridike, të cilat i ka lidhur në emër të tij; që t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e nevojshme dhe të dobishme dhe t'ia shpërblejë dëmin e pësuar si dhe t'ia paguajë shpërblimin për punën e kryer.

Kryerësi i punëve pa autorizim, i cili ka kryer punë të huaja përkundër ekzistimit të ndalimit të zotit të punës, i cili ka pasur dijeni ose ka qenë i detyruar ta dijë, nuk ka të drejta që do t'i takonin sipas rregullave të kryerjes së punëve të huaja pa autorizim. Përkundrazi, ai është i detyruar t'ia shpërblejë dëmin eventual të zotit të punës edhe atëherë kur dëmi të jetë shkaktuar pa fajin e tij, përveç në rast se ndalesa për kryerjen e punëve të tilla iu ka bërë në kundërshtim me ligjin ose moralin, në të cilin rast vlejné rregullat e mëparshme të kryerjes së punës së huaj pa autorizim.

Kur dikush i kryen punët e huaja pa autorizim, me qëllim që dobinë pasurore të arritur ta ndalë për vete, edhe pse ka ditur se puna është e huaja, jo vetëm që nuk i gëzon të drejtat sipas rregullave të kryerjes së punëve të huaja pa autorizim, por është

i detyruar që të zotit të punës t'i paraqes llogari dhe t'ia dorëzojë tërë dobinë e arritur dhe t'ia shpërblej dëmin e shkaktuar, përveç në kur i zoti i punës më vonë e ka pranuar një punë të tillë.

SHPREHJA E NJËANSHME E VULLNETIT

Premtimi publik i dhuratës

Premtimi publik i dhuratës është një ndër burimet juridike materiale të së drejtës së detyrimeve. Ky është një veprim juridik i njëanshëm, sipas të cilit premtuesi - një person fizik a juridik, në bazë të shprehjes së njëanshme të vullnetit, të bërë publikisht një numri të pacaktuar personash ose një rrethi të caktuar personash, obligohet se do t'i bëjë një dhuratë atij personi që kryen një punë, arrin ndonjë sukses, gjendet në ndonjë situatë të caktuar, brenda afatit të caktuar.

Ky institucion juridik është i rregulluar me dispozitat e LMD neni 212 -216.

Që premtimi publik i dhuratës të mund të jetë një veprim juridikisht i vlefshëm, duhet të plotësohen këto prezumime: që një person fizik apo juridik të ketë premtuar dhuratën përkatëse për një punë të kryer; që premtimi të jetë bërë publikisht - nëpërmjet shtypit, radios, televizionit, konkursit apo në mënyra tjera përmes mjeteve publike të komunikimit; që premtimi t'i jetë bërë një numri të pacaktuar të personave ose një rrethi të caktuar, siç janë: rrethi i artistëve, skulptorëve, arkitektëve etj. dhe që dhurata të jetë caktuar në të holla ose sende tjera të caktuara.

Premtimi publik i dhuratës bëhet më së shpeshti nëpërmjet konkursit, në të cilin caktohen kushtet e konkursit dhe dhurata. Kushtet e konkursit kanë të bëjnë me të dhënat në bazë të cilave bëhet përshkrimi i punës, e cila duhet të kryhet, afati në të cilin puna duhet të kryhet, lloji dhe vlera e dhuratës, e cila do t'i paguhet kryerësit më të suksesshëm, mënyra e përmbushjes së pagesës si dhe qëllimi që synohet të arrihet.

Efektet juridike të premtimit publik të dhuratës kanë të bëjnë me detyrimin e premtuesit që t'i përmbushë detyrimet lidhur me dhuratën e premtuar. Një detyrim i tillë krijohet në momentin e deklarimit publikisht të vullnetit dhe duhet t'i përmbushet atij personi që e ka kryer i pari punën dhe ka qenë më i suksesshmi. Në rast se më shumë persona e kanë kryer punën në të njëjtën kohë dhe njësoj kanë qenë të suksesshëm, secilit prej tyre i takon pjesa e njëjtë e dhuratës, nëse sipas parimit të drejtshmërisë nuk kërkohet ndonjë ndarje tjetër.

Me qëllim të sigurimit në qarkullimin juridik dhe për shkak të rëndësisë juridike të premtimit publik të dhuratës, me ligj është parashikuar se revokimi i një premtimi të tillë mund të bëhet në po atë mënyrë, në të cilën është bërë premtimi. Revokimi mund të bëhet deri brenda afatit të caktuar për kryerjen e punës. Revokimi nuk ka efekt juridik pas kryerjes së punës, për të cilën është premtuar dhurata. Pjesëmarrësi i konkursit, i cili e ka kryer punën edhe pas revokimit të premtimit të dhuratës publike, por nuk ka pasur dijeni dhe as nuk ka mundur të dijë për revokimin, ka të drejtë të kërkojë dhuratën

e premtuar, ndërsa person që ka pasur shpenzime lidhur me kryerjen e punës së caktuar në shpalljen publike deri në momentin e revokimit të dhuratës, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin, përveç në rast se premtuesi provon se shpenzimet e bëra kanë qenë të kota, ngase nuk do të kishin dhënë rezultatin e pritur, të përcaktuar në premtimin publik të dhuratës.

Në rast të premtimit publik të dhuratës me konkurs, për dhënien e dhuratës vendos organizuesi i konkursit - një ose më shumë persona të cilët i cakton ai. Nëse me kushtet e konkursit apo me dispozitat ligjore, të cilat vlejnjë për konkursin e caktuar, janë parashikuar rregulla të caktuara sipas të cilave bëhet dhënia e dhuratës, vendimi për dhënien e saj mund të anulohet në qoftë se dhurata nuk është dhënë në pajtim me ato rregulla.

Detyrimi i premtuesit shuhet në qoftë se brenda afatit të caktuar askush nuk e njofton premtuesin e dhuratës se ka kryer punën ose ka arritur sukses të caktuar në konkurs, kurse në rast se në konkurs nuk është caktuar afati i kryerjes së punës, detyrimi shuhet pas kalimit të një viti nga dita e shpalljes publike.

LETRAT ME VLERË

Ligji i Marrëdhënieve të Detyrimeve, në nenin 217, letrën me vlerë e ka përkufizuar si “dokument me shkrim, me të cilin emetuesi (lëshuesi) i saj detyrohet se do ta përmbushë detyrimin e shkruar në këtë dokument poseduesit të saj të ligjshëm”.

Veti themelore juridike e letrave me vlerë është ajo se e drejta e shënuar në atë dokument publik është aq e lidhur me atë dokument saqë realizimi, disponimi dhe kalimi i asaj të drejte mund të bëhet vetëm së bashku me të. Letra pa të drejtën e shënuar në të sikurse edhe e drejta e shënuar jashtë letrës me vlerë, nuk mund të trajtohen si letër me vlerë.

Kush konsiderohet i zoti ligjor i letrës me vlerë është një ndër çështjet kryesore në lëmin e së drejtës se letrave me vlerë, sepse dhënësi i saj nuk detyrohet që detyrimin e shënuar në letër t’ia përmbush secilit person që e ka letrën, por vetëm të zotit të saj ligjor. Se kush është i zoti ligjor i letrës me vlerë, varet nga lloji i saj.

a) Elementet thelbësore të letrave me vlerë

Çdo letër me vlerë medoemos duhet të përmbaj këto elemente: 1) emërtimin e llojit të letrës me vlerë; 2) firmën, përkatësisht emërtimin dhe selinë, përkatësisht emrin dhe vendbanimin e lëshuesit të letrës me vlerë; 3) firmën respektivisht, emërtimin ose emrin e personit me urdhër të së cilit është dhënë letra me vlerë ose emërtimi se letra me vlerë i është e pagueshme prurësit; 4) detyrimin e përshkruar saktë të lëshuesit të letrës me vlerë; 5) vendin dhe datën e lëshimit të letrës me vlerë, kurse tek ato të cilat emetohen në seri, edhe numrin e saj serik; 6) nënshkrimin e dhënësit të letrës me vlerë, përkatësisht faksimilin e nënshkrimit të lëshuesit të letrës me vlerë që emetohet në seri.

Me ligj të veçantë për ndonjë lloj të letrave me vlerë mund të caktohen edhe elemente tjera thelbësore.

Dokumenti që nuk përmban elementet e cekura më sipër nuk mund të konsiderohet letër me vlerë.

Sipas lëshuesit të së drejtës që përmban letra me vlerë, letra me vlerë mund të jetë sipas prurësit, sipas emrit të shënuar në letrën me vlerë dhe sipas urdhërrit. Prandaj, letrat me vlerë ndahen në tri lloje: letrat sipas emrit, sipas urdhrit dhe sipas prurësit.

Letrat me vlerë sipas prurësit janë ato të cilat përmbajnë klauzolën “sipas prurësit” ose fare nuk e përmbajnë këtë, por nga përmbajtja e tyre kuptohet se është fjala për letrën me vlerë sipas prurësi. Si person i cili është i autorizuar të kërkojë realizimin e kërkesës nga kjo letër është personi i cili letrën e mban në dorë - i zoti i saj.

Letrat me vlerë sipas emrit janë ato në të cilat e drejta që përmbajnë ato i takon personit emri i të cilit është shënuar në to.

Letrat me vlerë sipas urdhrit janë ato në të cilat e drejta që përmban letra i takon jo vetëm atij personi emri i të cilit është shënuar i pari në letër, por ajo mund t’u kalohet edhe personave të tjerë.

Detyrimi nga letrat me vlerë, sipas ligjit, krijohet në momentin kur dhënësi i letrës me vlerë ia dorëzon atë shfrytëzuesit të saj.

Realizimi i të së drejtës

Kërkesa që përmban letra me vlerë është e lidhur me vetë letrën dhe i takon të zotit të saj ligjor. I zoti ligjor i letrës me vlerë sipas prurësit konsiderohet prurësi i saj; i zoti i letrës me vlerë sipas emrit ose sipas urdhrit konsiderohet personi emri i të cilit është shënuar në letër ose të cilit i ka kaluar letra.

Prokuruesi i ndërgjegjshëm i letrës me vlerë sipas prurësit bëhet i zoti i saj ligjor dhe fiton të drejtën e kërkesës me regjistrim edhe atëherë kur letra me vlerë ka dalë nga dora e dhënësit të saj përkatësisht të zotit të saj të mëparshëm edhe pa vullnetin e tij.

Kalimi i letrave me vlerë

E drejta që përmban letra me vlerë sipas prurësin kalohet me dorëzimin e saj.

E drejta që përmban letra me vlerë sipas emrit mund të kalohet te tjetri. Me ligj të veçantë mund të jetë caktuar që kjo e drejtë të kalohet edhe me indosament. E drejta që përmban letra me vlerë sipas urdhrit kalohet me anë të indosamentit. Indosamenti është mënyra e kalimit të së drejtës që përmban letra me vlerë, ashtu që në letrën me vlerë shënohet emri i personit tek i cili kalohet e drejta që përmban letra (indosadarit) dhe nënshkrimi i kaluesit (indosatit). Ky lloj indosamenti quhet indosament i plotë. Indosamenti blanko ekziston kur përmban vetëm nënshkrimin e indosantit. Në rast të kalimit te prurësi, në vend të emrit të indosatarit shënohet fjala “prurësi”.

Letra me vlerë mund të kalohet ashtu siç kalohet prokura, përkatësisht siç ndodh kalimi i pengut.

Me kalimin e së drejtës nga letra me vlerë kalojnë të gjitha të drejtat nga i zoti i mëparshëm tek i zotin i ri.

Indosatari i fundit e provon të drejtën e vet që përmban letra me vlerë sipas radhës së pandërprerë të indosamentave. Ndalea e kalimit të së drejtës te letra me vlerë sipas urdhrit bëhet me klauzolën “jo sipas urdhrit” ose me shënimin e një klauzole të ngjashme. Pas kësaj ndalese, kalimi i letrës me vlerë mund të bëhet me anë të cesionit.

Shuarja e detyrimit

Është normale se detyrimi që përmban letra me vlerë shuhet me përmbushjen e tij, domethënë, atëherë kur dhënësi i letrës me vlerë ia përmbush të zotit ligjor të letrës me lërë detyrimin që është objekt i drejtës që përmban letra me vlerë. Kjo mënyrë e përmbushjes është parashikuar me dispozitën e nenit 236 par. 1 i LMD. Kërkesa që përmban letra me vlerë shuhet edhe me anë të fuzionimit, përkatësisht kur kërkesa i takon dhënësit të letrës me vlerë, nëse me ligj të veçantë nuk është caktuar ndryshe. Dhënësi i ndërgjegjshëm i letrës me vlerë sipas prurësit lirohet nga detyrimi me përmbushjen e detyrimit sipas prurësit edhe atëherë kur prurësi nuk është i zoti ligjor i letrës me vlerë. Mirëpo, në qoftë se dhënësi i letrës me vlerë sipas prurësit ka pasur dijeni ose ka qenë i detyruar të dijë se prurësi nuk është i zoti ligjor i letrës me vlerë as nuk është autorizuar nga i zoti ligjor i letrës me vlerë, është i detyruar të refuzojë përmbushjen, në të kundërtën, do të jetë përgjegjës për shpërblimin e dëmit. Dhënësi i letrës me vlerë është i detyruar ta refuzojë përmbushjen e detyrimit edhe në rast se atë ia ka ndaluar organi kompetent shtetëror ose kur ka ditur ose ka qenë i detyruar të dijë se ka filluar procedura për amortizimin ose anulimin e letrës me vlerë.

Prapësimet kundër kërkesave për përmbushjen e detyrimeve që përmban letra me vlerë

Kundërshtimet në kërkesën për përmbushjen e detyrimit që përmban letra me vlerë janë parashikuar me dispozitën e nenit 239 i LMD.

Kundër kërkesë së të zotit të letrës me vlerë, dhënësi i letrës mund të paraqesë prapësime, të cilat kanë të bëjnë me dhënieën e vetë letrës, siç është falsifikimi; prapësime që dalin nga përmbajtja e letrës, siç janë, afatet ose kushtet dhe prapësime ndaj vetë të zotit të letrës, siç janë kompensimi, të metat e procedurës së parashikuar me ligj për fitimin e letrës me vlerë dhe mungesa e autorizimit.

Në qoftë se letra me vlerë gjendet ende në duart e të zotit të parë (të drejtpërdrejtë), atëherë dhënësi i letrës me vlerë, kundër kërkesës së tij, mund t'i paraqesë të gjitha prapësimet nga kontrata themelore.

Në qoftë se letra me vlerë gjendet në duart e personit tek i cili i zoti i parë i letrës me vlerë e ka kaluar të drejtën që përmban letra me vlerë, atëherë dhënësi mund t'i paraqesë kundër kërkesës së tij vetëm ato prapësime, të cilat dalin nga vetë letra me vlerë, por jo

edhe ato prapësime të cilat dalin nga kontrata themelore. Nga kjo rregull bën përjashtim rasti kur i zoti i letrës me vlerë është marrë vesh me të zotin e mëparshëm që ky t'ia kalojë të drejtën që përmban letra me vlerë, me qëllim të shmangies së prapësimit, të cilin do t'ia bënte dhënësi i letrës të zotit të parë sipas kontratës themelore. Në atë rast, dhënësi do të mund t'i paraqet të gjitha ato prapësime ndaj kërkesës së të zotit të dytë të letrës me vlerë që do t'i kishte paraqitur edhe ndaj të zotit të parë, që kanë të bëjnë me kontratën themelore.

Letrat dhe shenjat e legjitimitit

Nga letrat me vlerë duhen dalluar letrat dhe shenjat e legjitimitit, të cilat nuk janë letra me vlerë. Sipas së drejtës së detyrimeve, si letra të legjitimitit konsiderohen biletat e hekurudhës, biletat e teatrit dhe biletat e tjera hyrëse, triskat dhe dokumentet e ngjashme, të cilat përmbajnë një detyrim të caktuar të dhënësit të tyre, në të cilat nuk është shënuar kreditori. Dhënësi i letrës legjitimuese detyrohet ta përmbushë detyrimin e shënuar në letër ndaj poseduesit të saj. Si person i autorizuar që mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit konsiderohet prurësi i letrës me vlerë. Në qoftë se nga letrat e tilla nuk mund të kuptohet nëse është fjala për letrën sipas prurësit, sipas emrit apo sipas urdhrit, përkatësisht nëse mund të kalohet e drejta e përmbajtur në to, atëherë lidhur me to do të zbatohen përshtatshmërisht dispozitat përkatëse që kanë të bëjnë me letrat me vlerë (neni 241 i LMD).

Shenjat e legjitimitit gjithashtu nuk janë letra me vlerë. Si shenja të legjitimitit konsiderohen shenjat e gardërobës dhe shenja të ngjashme, të cilat përbëhen nga copa letre, metali ose materiali tjetër, në të cilat zakonisht është shtypur ndonjë numër ose është shënuar numri i sendeve të dorëzuara, të cilat rëndom nuk përmbajnë diçka të caktuar për detyrimin e dhënësit të tyre dhe shërbejnë vetëm për të treguar se kush është kreditori në marrëdhënien e detyrimit me rastin e krijimit të së cilës janë dhënë.

Dhënësi i shenjave të legjitimitit lirohet nga detyrimi, kur prurësit ia përmbush me mirëbesim detyrimin, por për prurësin nuk vlen supozimi se ai është kreditori i vërtetë ose që ai është i autorizuar të kërkojë përmbushjen dhe, në rast kontesti, është i detyruar të provojë cilësinë e vet të kreditorit. Kreditori mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit, edhe po ta ketë humbur shenjën e legjitimitit. Në pikëpamje të çështjeve të tjera, në çdo rast të veçantë duhet respektuar vullneti i përbashkët i dhënësit dhe marrësit të shenjës dhe ajo që është e rëndomtë.

EFEKTET E DETYRIMEVE

Rregullat e përgjithshme

1) Përbushja e detyrimit dhe pasojat e mospërbushjes

Efektet themelore të detyrimit, pa marrë parasysh bazën e krijimit të tij, janë që debitori ta përbushë atë ashtu siç është përcaktuar, kurse autorizimet e kreditorit janë që të kërkojë nga debitori ta përbushë detyrimin. Debitori është i detyruar ta përbushë detyrimin e vet sipas përbajtjes së detyrimit në vendin, kohën dhe mënyrën e parashikuar për përbushjen e tij. Te detyrimet kontraktuese në rast se nuk është caktuar afati i përbushjes së detyrimit, kurse qëllimi i veprimit, natyra e detyrimit dhe rrethanat tjera nuk kërkojnë një afat të caktuar të përbushjes, kreditori mund të kërkojë përbushjen menjëherë. Në rast se nuk është caktuar vendi i përbushjes së detyrimit, kur detyrimi ka të bëjë me dorëzimin e sendit të paluajtshëm, përbushja e detyrimit të tillë bëhet në vendin ku gjendet paluajtshmëria, kur ka të bëjë me sendin e luajtshëm, në vendin ku gjendet selia, përkatësisht vendbanimi i debitorit, ndërsa në rast se detyrimi duhet të përbushet në të holla, vendi i përbushjes është në selinë, vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin e kreditorit. Në rast se debitori nuk e përbush fare detyrimin e vet, nuk e përbush me rregull ose e përbush me vonesë, kreditori mund të kërkojë përbushjen e detyrimit dhe shpërblimin e dëmit, të cilin e pëson për atë shkak.

Që kreditori të mund të kërkojë shpërblimin e dëmit për shkak të mospërbushjes ose përbushjes jo të rregullt duhet të plotësohen këto kushte: 1) që debitori të mos e ketë përbushur fare detyrimin e vetë ose ta ketë përbushur me vonesë atë; 2) që të mos ekzistojë ndonjë bazë e parashikuar me ligj për lirimin e debitorit nga përgjegjësia; 3) që kreditori vërtet të ketë pësuar dëmin; 4) që të ekzistojë lidhja kauzale mes dëmit dhe mospërbushjes së detyrimit, përkatësisht vonesës së debitorit në përbushjen e detyrimit dhe 5) që kreditori të provojë ekzistimin e dëmit, llojin dhe masën e tij si dhe lidhjen kauzale.

Supozohet se debitori është fajtor për mospërbushjen e detyrimit ose përbushjen e parregullt të tij. Mirëpo, ai mund të lirohet nga përgjegjësia për shpërblimin e dëmit të shkaktuar nga mos përbushja ose përbushja e parregullt, në rast se provon se mos përbushja e detyrimit ose vonesa në përbushjen e detyrimit kanë ardhur pa fajin e tij, për shkak të ndikimit të forcës madhore, për shkak të rrethanave të shkaktuara pas lidhjes së kontratës, të cilat nuk ka mundur t'i parandalojë, t'i mënjanojë ose t'u shmanget për fajin e kreditorit ose të personit të tretë.

Në rast të mospërbushjes ose përbushjes me vonesë të detyrimit nga ana e debitorit, kreditori ka të drejtën e shpërblimit të dëmit real dhe të fitimit të humbur, të cilën debitori në kohën e lidhjes së kontratës ka qenë i detyruar ta parashikojë si pasojë të mundshme të cenimit të kontratës, duke i pasur parasysh faktet të cilat atëherë i ka ditur ose ka qenë i detyruar t'i dinte. Në rast se debitori ka vepruar me mashtrim, me

qëllim, me pakujdesi ekstreme, kreditori ka të drejtën e shpërblimit të plotë të dëmit, pa marrë parasysh që debitori nuk ka ditur për rrethanat e veçanta, si pasojë e të cilave është shkaktuar dëmi.

Për të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar me dispozitat të cilat kanë të bëjnë me shpërblimin e dëmit të shkaktuar për pasojë të cenimit të detyrimeve kontraktuese, vlejné rregullat e përgjithshme për shpërblimin e dëmit jo kontraktor.

Penalet gjyqësore

Penalet gjyqësore LMD i njeh si ndëshkim kontraktor. Ky është një mjet i sigurimit personal lidhur me përmbushjen e kontratës. Ky paraqet një marrëveshje me të cilin debitori detyrohet t'i paguajë kreditorit një shumë të caktuar të hollash ose t'ia shpërblejë ndonjë dobi tjetër materiale, në rast të mospërmbushjes ose mospërmbushjes së rregullt të kontratës (neni 275 i LMD). Në qoftë se nga kontrata nuk del diçka tjetër, ekziston supozimi se ndëshkimi është kontraktuar për rastin kur debitori e ka përmbushur detyrimin me vonesë.

Kushti penal ose ndëshkimi kontraktor në doktrinën juridike është i njohur me emrin "stipulatio poenae", ndëshkimi konvencional etj. Ai ka kuptim të dyfishtë: si shumë e caktuar më parë e dëmit të supozuar, e cila ka për t'iu paguar kreditorit në rast të mospërmbushjes ose përmbushjes me vonesë të kontratës dhe si ndëshkim kontraktor, ngase shuma e caktuar më parë, fakti se është kontraktuar dhe kontrata nuk është përmbushur fare ose nuk është përmbushur me rregull, ka për t'u paguar pavarësisht se kreditori nuk ka pësuar kurrfarë dëmi.

Masa e ndëshkimit kontraktor mund të caktohet në një shumë fikse (p.sh. 1.000 €), me përqindje nga vlera e përgjithshme e detyrimit kryesor (0,5% nga vlera e detyrimit kryesor për çdo ditë vonese) ose në ndonjë mënyrë tjetër.

Marrëveshja e kushtit penal mund të kontraktohet në formë të parashikuar për kontratën kryesore me përmbushjen e së cilës ka të bëjë, si pjesë përbërëse e saj në formë të një klauzole ose në formë të marrëveshjes së veçantë, por në çdo rast ka karakter aksesor dhe e pëson rrjedhimet e kontratës kryesore.

Kur ndëshkimi kontraktor është kontraktuar në rast të mospërmbushjes së kontratës, kreditori mund të kërkojë ose përmbushjen e kontratës, ose pagesën e ndëshkimit kontraktues, ndërsa kur është kontraktuar për rastin e mospërmbushjes së rregullt, kreditori mund të kërkojë përmbushjen e kontratës dhe pagesën e ndëshkimit kontraktues. Nëse kreditori ka pranuar përmbushjen e kontratës, është i detyruar që ta njoftojë debitorin pa vonesë se e rezervon edhe të drejtën e pagesës së shumës së ndëshkimit kontraktues, përndryshe nuk do të mund ta kërkonte pagesën e asaj shume.

Në qoftë se shuma e kushtit penal është kontraktuar me një shumë tepër të lartë, me kërkesë të debitorit, gjykata do ta ulë atë.

Kreditori ka të drejtë të kërkojë ndëshkimin kontraktues edhe në qoftë se tejkalon shumën e dëmit të shkaktuar, por nuk ka të drejtë të akumuloj (bashkojë) të dy këto kërkesa, përveç kur dëmi është më i latë sesa shuma e ndëshkimit kontraktues, në të cilin rast ka të drejtë të kërkojë dallimin deri te shpërblimi i plotë i dëmit.

Kamatëvonesa

Në teorinë juridike kamata konsiderohet si çmim, të cilin dikush e paguan për përdorimin e të hollave të huaja ose sendeve të tjera të zëvendësueshme, qoftë ato sende t'i jenë lënë atij në dispozicion me kontratë, qoftë t'i ketë shfrytëzuar pa kontratë.

Kur flitet për kamatëvonesën, mendohet për çmimin e përdorimit të hollave ose të sendit, por edhe për shpërblimin e dëmit real ose të supozuar, të cilin kreditori e pëson për shkak se është privuar nga mundësia e përdorimit të hollave ose të sendit për pasojë të vonesës së debitorit.

LMD përmban dispozita që rregullojnë çështjen e kamatëvonesës si në rastin kur për shkak të vonesës kreditori ka pësuar dëm, ashtu edhe në rastin kur nuk e ka pësuar atë. Debitori që vonohet në përmbushjen e detyrimit në të holla është i detyruar të paguajë, përveç kryegjësë, edhe kamatën (neni 382 par. 1 i LMD). Lartësia e kamatëvonesës tetë përqind (8%) në vit (neni 382 par. 2 i LMD).

Ndëshkimi kontraktues, përkatësisht kushti penal nuk mund të kontraktohet te detyrimet në të holla.

Kreditore ka të drejtën e kamatëvonesës pa marrë parasysh nëse ka pësuar ndonjë dëm për shkak të vonesës së debitorit, por nëse ka pësuar dëm që është më i lartë sesa shuma që do ta marrë në emër të kamatëvonesës, ai ka të drejtë të kërkojë dallimin deri te shpërblimi i tërësishëm i dëmit.

Mbi kamatën e arritur e të papaguar kontraktore ose mbi kamatëvonesë nuk rrjedh kamatëvonesa. Kjo do të thotë se nuk është e lejuar llogaritja e kamatës mbi kamatë. Ajo mund të llogaritet nga dita e paraqitjes së kërkesës në gjykatë për pagimin e saj.

Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit (Padia pauliana - actio pauliana)

Kundërshtimi i veprimeve juridike të debitorit është një institucion juridik, me anë të cilit kreditore, me qëllim të përmbushjes së kërkesës së vet, kundërshton veprimin juridik të debitorit, me të cilin e zvogëlon pasurinë e tij në dobi të pasurisë së personave të tretë, duke synuar t'i bishtnojë përmbushjes së detyrimit ndaj kreditorit. Në të drejtën e detyrimeve ky institut është rregulluar me dispozitat e neneve 261 – 266 të LMD. Kundërshtimin e veprimeve juridike të debitorit kreditore mund ta ndërmarrë pasi më parë nuk ka mundur ta realizojë kërkesën e arritur për pagesë as me anë të dhunës nëpërmjet të gjykatës. Këtë kreditore e bën me paraqitje të padisë, e cila quhet padia pauliana (actio pauliana) ose me kundërshtim kundër personit të tretë, të cilit debitoria ka kaluar pasurinë e tij dhe ky më së shpeshti është bashkëkontraktuesi i tij ose i personave të tjerë, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë nxjerrin ndonjë përfitim pasuror.

Si veprim juridik kuptohet edhe disponimi tjetër i debitorit, që ka të bëjë me lëshimin e realizimit të ndonjë të drejte, për të cilin shkak zvogëlohet ose nuk rritet pasuria e tij.

Objekt kundërshtimi mund të jenë veprimi juridik, me të cilin kalohet e drejta e pronësisë së sendit apo ndonjë e drejte tjetër reale, marrja e borxhit, falja e borxhit, heqja dorë nga e drejta e trashëgimisë etj.

Që të mundur të paraqitet padia pauliana duhet të plotësohen këto prezumime: 1) që kreditori të jetë i dëmtuar me veprimin juridik të debitorit; 2) që debitori të ketë pasur për qëllim ta dëmtojë kreditorin; 3) që personi i tretë të ketë pasur dijeni për keqbesimin e debitorit që dëshiron ta dëmtojë kreditorin, por dijenia e personave të tretë për keqbesimin e debitorit, për synimin e tij për ta dëmtuar kreditorin nuk duhet të provohet kur debitori pasurinë e vet ia tjetërson personave të afërm ose pasurinë e tjetërson pa shpërblim.

Nuk mund të kundërshtohen për shkak të dëmtimit të kreditorit dhuratat e rëndomta, të bëra në raste solemne, dhuratat shpërblyese, si dhe dhuratat e bëra në shenjë mirënjohjeje, në përpjesëtim me mundësitë materiale të debitorit.

I padituri mund t'i shmanget kundërshtimit, në qoftë se e përmbush detyrimin e debitorit.

Në qoftë se gjykata e pranon kërkesëpadinë, veprimi juridik e humb efektin juridik vetëm ndaj paditësit dhe vetëm për atë që është e mjaftueshme për përmbushjen e kërkesës së tij. Kjo do të thotë se i padituri është i detyruar t'ia kthejë pasurisë së debitorit atë që ka marrë sipas bazës së veprimit të kundërshtuar në masën që është e nevojshme të përmbushet kërkesa e kreditorit.

E drejta e paraqitjes së padisë parashkruhet brenda afatit njëvjeçar, kur veprimet e tij janë me keqbesim, dolozive (dolus) dhe familjare, ndërsa brenda afatit trevjeçar në rastet kur disponimi i pasurisë është realizuar pa shërbimet të cilat i bën debitori ndaj pasurisë së vet. Afati llogaritet nga dita e ndërmarrjes së veprimit juridik.

E drejta e nëdorësisë (jus retentionis)

E drejta e nëdorësisë ose e retencionit është e drejtë e kreditorit që ta nëdorëmbajë sendin e debitorit, i cili gjendet në duart e tij, përderisa nuk i paguhet kërkesa e arritur. Kreditori një të drejtë të tillë mund të shfrytëzojë edhe kur debitori bëhet insolvent për të paguar borxhin edhe atëherë kur e drejta e tij nuk ka arritur për pagesë.

E drejta e nëdorësisë mund të realizohet në këto kushte: e drejta e nëdorësisë mund të realizohet vetëm lidhur me kërkesat e arritura për pagesë; mund të realizohet mbi sende të caktuara të debitorit, përveç mbi ato që përjashtohen me ligj; kjo e drejtë realizohet në bazë të kërkesës në të holla dhe që sendi të gjendet në posedim të kreditorit.

E drejta e nëdorësisë përjashtohet në këto raste: 1) kur posedimi i sendit i është marrë debitorit pa vullnetin e tij; 2) kur debitori ia ka dhënë kreditorit sendin për ruajtje dhe kur është fjala për prokurën, letërnjoftimin, korrespondencën dhe sende të ngjashme, si dhe për sende që nuk mund t'i ekspozohen shitjes publike.

Kreditori është i detyruar ta kthejë sendin sapo t'i paguhet kërkesa ose t'i jepet garancia përkatëse se do t'i bëhet pagesa e kërkesës. Kreditori ka të drejtë që, nga sendi i debitorit të cilin e ka ndalur, të arkëtojë kërkesën nga vlefata e sendit njësoj

sikurse edhe kreditori pengmarrës, por është i detyruar që, para se të fillojë realizimin e arkëtimit, për qëllimin e vet ta njoftojë me kohë debitorin.

Të drejtat e kreditorit në disa raste të veçanta

Dispozitat e neneve 271-275 të LMD ia mundësojnë kreditorit që në ca raste të veçanta, shumë më lehtë dhe më shpejtë t'i realizojë dhe t'i mbrojë të drejtat e tij. Në vend që të drejtat e tij t'i realizojë në procedurë kontestimore dhe përmbaruese: të paraqesë padi, gjykata të marrë vendim të formës së prerë, me të cilën e detyron debitorin t'ia përmbushë një detyrim kreditorit, të kalojë pa sukses afati për përmbushjen vullnetare të detyrimit dhe në fund të kërkohet realizimi i kërkesës në procedurën përmbaruese -me këto dispozita është parashikuar që varësisht nga lloji i detyrimit, kreditori të ndër marrë veprime, me të cilat do t'i realizonte ato të drejta.

Kur detyrimi i debitorit ka të bëjë me dhënie të sendit të caktuar, sipas llojit, ndërsa debitori bie në vonesë, kreditori, pasi që më parë ta ketë njoftuar debitorin, mundet që, sipas zgjedhjes së vet, ta blejë sendin e llojit të njëjtë dhe të kërkojë nga debitori shpërblimin e çmimit dhe shpërblimin e dëmit ose të kërkojë sendet që debitori i ka borxh dhe shpërblimin e dëmit.

Kur detyrimi ka të bëjë me ndonjë bërje dhe debitori atë detyrim nuk e përmbush me kohë, kreditori, pasi më parë ta njoftojë debitorin, mundet vetë, me shpenzime të debitorit, ta kryejë punën të cilën është dashur ta bënte debitori, të kërkojë nga debitori shpërblimin e dëmit për shkak të vonesës dhe shpërblimin e dëmit tjetër, të cilin do ta kishte pësuar për shkak të mënyrës së këtillë të përmbushjes.

Kur detyrimi i debitorit ka të bëjë me mos bërje, kreditori ka të drejtën e shpërblimit të dëmit për vetë faktin që debitori ka vepruar në kundërshtim me detyrimin e vet. Në qoftë se diçka është ndërtuar në kundërshtim me detyrimin, kreditori mund të kërkojë që ajo të mënjanohet me shpenzime të debitorit dhe debitori t'ia shpërblejë dëmin të cilin e ka pësuar lidhur me ndërtimin dhe mënjanimin e objektit ndërtimor, por nëse gjykata gjen se interesi i kreditorit dhe interesi shoqëror kërkon që ajo që është ndërtuar mos të rrënohet, debitori mund të detyrohet që kreditorit t'ia shpërblejë dëmin në të holla.

SHUARJA E DETYRIMEVE

Qëllimi i fundit i krijimit të çdo marrëdhënieje të detyrimeve është realizimi, përkatësisht përmbushja e tyre. Përmbushja është kryerja e atij veprimi nga ana e debitorit, të cilin ka qenë i detyruar të kryejë, përkatësisht realizimi i së drejtës së kreditorit, e cila i takon nga detyrimi. Ekzistojnë shumë mënyra të shuarjes së detyrimeve, por përmbushja është mënyra e rregullt, më e natyrshme dhe më e shpeshtë e shuarjes së detyrimit. LMD rregullat e shuarjes së detyrimeve i ka parashikuar me dispozitat e neneve 276 -374.

Detyrimi shuhet kur përmbushet dhe në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

LMD, me dispozitën e nenit 277 par. 1-5, ka paraparë rregullat e përgjithshme, sipas të cilave detyrimi mund të shuhet me përmbushje.

Kush mund ta bëj përmbushjen

Ekziston një rregull e përgjithshme se detyrimin e përmbush debitori, sepse ai është i detyruar ndaj kreditorit. Por, këtë mund ta bëjë edhe personi i tretë, kur ka ndonjë interes juridik që detyrimi të përmbushet, siç është rasti me dorëzanin, pengdhënësin, kundërshtarin sipas padisë pauliana. Në këto raste kreditori është i detyruar të pranojë përmbushjen edhe kur këtë e kundërshton debitori. Përmbushjen mund ta bëjë edhe personi i tretë, i cili nuk ka ndonjë interes juridik dhe kreditori është i detyruar ta pranojë një përmbushje të tillë me kusht që me të jetë dakorduar edhe debitori, me përjashtim kur, sipas kontratës ose natyrës së vet detyrimit, këtë duhet ta bëjë personalisht debitori. Kreditori mund të pranojë përmbushjen e detyrimit nga personi i tretë pa dijeninë e debitorit, bile edhe kur debitori ta ketë njoftuar se nuk është dakord që personi i tretë ta përmbushë detyrimin e tij. Nga kjo rregull del se kreditori ka të drejtë të pranojë përmbushjen e detyrimit nga personi i tretë, pa dijeninë dhe pëlqimin e debitorit, ngase me këtë mënyrë të përmbushjes së detyrimit assesi nuk i rrezikohet e drejta e debitorit. Kreditori nuk mund të pranojë përmbushjen e detyrimit nga personi i tretë, pa pëlqimin e debitorit vetëm në rast se debitori ka ofruar që vetë ta përmbushë menjëherë detyrimin.

Përmbushjen juridikisht të vlefshme mund ta bëjë vetëm debitori i aftë për të vepruar. Nga kjo rregull ekziston përjashtimi në rastin kur ekzistimi i detyrimit është i padyshimtë dhe në qoftë se ka arritur për pagesë (neni 278 par. 1 i LMD). Por, mund të kontestohet përmbushja e detyrimit të parashkruar ose borxhit i cili rrjedh nga loja ose basti.

Përmbushja me subrogim

Përmbushja me subrogim është një ndër mënyrat e shuarjes së detyrimit, përkatësisht përmbushja e detyrimit nga personi i tretë. Në rast se një person e përmbush detyrimin në vend të debitorit në bazë të kontratës se lidhur me kreditorin, para përmbushjes ose me rastin e përmbushjes, te përmbushësi kalojnë të gjitha të drejtat ose një pjesë e tyre nga kreditori i mëparshëm ndaj debitorit (neni 280 par. 1 i LMD). Përmbushja me subrogim, përveç në bazë të kontratës, mund të jetë edhe në bazë të ligjit. Kjo mund

të ndodhë në rast se detyrimin e përmbush personi që ka interes juridik, me ç' rast te përmbushësi kalon kërkesa e kreditorit të mëparshëm sipas vetë ligjit dhe kjo ndodh në momentin e përmbushjes së detyrimit. Persona të tillë mund të jenë: pengdhënësi, dorëzani, kundërshtari i kundërshtimit të veprimeve juridike të debitorit etj.

Në rast të përmbushjes së detyrimit të pjesshëm, te përmbushësi kalojnë të gjitha kërkesat aksesore, me të cilat është siguruar përmbushja e kërkesës, vetëm në qoftë se nuk janë të nevojshme për përmbushjen e pjesës tjetër të pa përmbushur, por mund të kontraktohet që përmbushësi t'i shfrytëzojë garancitë në përpjesëtim me kërkesat e tij, por mund të kontraktohet edhe që përmbushësi të ketë të drejtë përparësie të inkasimit.

Kreditori është i detyruar që përmbushësit t'i dorëzojë provat, me të cilat provohet ose sigurohet kërkesa. Përmbushësi nuk mund të kërkojë nga kreditori më tepër sesa iu ka paguar atij sipas bazës së subrogimit. Kreditori që ka pranuar përmbushjen nga personi i tretë nuk përgjigjet për ekzistimin dhe pagueshmërinë e kërkesës, por në një rast të tillë nuk përjashtohet zbatimi i rregullave të pasurimit pa bazë.

Kujt i bëhet përmbushja

Ekziston një rregull e përgjithshme se përmbushja medoemos duhet t'i bëhet kreditorit ose personit të caktuar me ligj, me aktgjykim, me kontratë të lidhur mes kreditorit dhe debitorit apo personit që është caktuar nga vetë kreditori. Përmbushja mund t'i bëhet edhe personit të tretë, në qoftë se kreditori, më vonë, dakordohet me atë përmbushje ose është shërbyer me të (neni 286 par. 1 e 2 të LMD). Nëse përmbushja i bëhet kreditorit tërësisht të paafitë për të vepruar, debitori lirohet nga përgjegjësia, në qoftë se një përmbushje e tillë është e dobishme për kreditorin ose objekti i përmbushjes akoma gjendet tek ai.

Lënda e përmbushjes

Lëndë e përmbushjes është ajo që debitori i ka borxh kreditorit. Ky përbëhet nga përmbajtja e detyrimit, të cilën debitori është i detyruar ta përmbushë dhe nuk mund ta përmbushë me asgjë tjetër, por as kreditori nuk mund të kërkojë diç tjetër (neni 288 par. 1 LMD). Mirëpo, debitori dhe kreditori mund të merren vesh që debitori ta përmbushë detyrimin me diç tjetër e jo me atë që ka borxh. Në atë rast ekziston zëvendësimi i përmbushjes. Te zëvendësimi i përmbushjes fjala është për ndërrimin e lëndës së detyrimit dhe bazës së tij. (p.sh., në vend të rrobave, dorëzon stofin etj.). Nga zëvendësimi i përmbushjes duhet dalluar dhënia për përmbushje, e cila ekziston në qoftë se debitori ia jep kreditorit ndonjë send ose të drejtën e shitjes së tij dhe nga çmimi i realizuar të arkëtojë kërkesën e vet.

Koha e përmbushjes

LMD përmban rregulla që kanë të bëjnë me kohën e përmbushjes së detyrimit (neni 295 - 299). Detyrimi duhet të përmbushet brenda afatit të caktuar me kontratë. Nëse afati nuk është caktuar me kontratë, kurse qëllimi i veprimit, natyra e detyrimit dhe

rrethanat e tjera nuk kërkojnë ndonjë afat për përmbushjen e detyrimit, kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij menjëherë, por edhe debitori mund të kërkojë nga kreditori që menjëherë ta pranojë përmbushjen. Në rastin kur është kontraktuar afati në interes të debitorit, ai ka të drejtë ta përmbushë detyrimin para afatit të caktuar, por është i detyruar ta lajmërojë kreditorin për qëllimin e vet, duke pasur kujdes që përmbushja të mos bëhet në kohë të papërshtatshme. Në raste tjera, kur debitori ofron përmbushjen para afatit, kreditori mund të refuzojë përmbushjen, por edhe mund ta pranojë dhe ta rezervojë të drejtën e shpërblimit të dëmit, në qoftë se për këtë e njofton menjëherë debitorin. Në rastin kur afati është kontraktuar në interes të kreditorit, ndërsa debitori nuk i ka dhënë sigurimin e premtuar, ai ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit para afatit. Kur caktimi i afatit është lënë në vullnetin e kreditorit apo të debitorit, pala tjetër, po qe se i autorizuari nuk e cakton afatin as sipas tërheqjes së vërejtjes, mund të kërkojë nga gjykata që ta caktojë një afat të përshtatshëm për përmbushjen e detyrimit.

Vendi i përmbushjes së detyrimit

Debitori është i detyruar ta përmbushë detyrimin, ndërsa kreditori ta pranojë përmbushjen në vendin e caktuar me veprim juridik ose me ligj. Kur vendi i përmbushjes nuk është caktuar, as nuk mund të caktohet sipas qëllimit të veprimit juridik, natyrës së detyrimit ose rrethanave tjera, përmbushja e detyrimit bëhet në vendin e selisë, përkatësisht në vendbanimin ose vendqëndrimin e debitorit, të cilin ky e ka pasuar në kohën e lindjes së detyrimit

Detyrimet në të holla përmbushen në vendin e kreditorit. Në qoftë se detyrimi përmbushet me anë të virmanit, detyrimi në të holla përmbushet në vendin ku gjendet banka, në të cilën administrohen mjetet financiare të kreditorit.

Llogaritja e përmbushjes (Imputation)

Efekti themelor i përmbushjes është shuarja e detyrimit. Kur mes debitorit dhe kreditorit ekzistojnë shumë marrëdhënie të detyrimeve dhe debitori detyrimet e veta të njëlllojta (p.sh. në të holla) i përmbush pjesërisht, ngase nuk ka mundësi t'i përmbushë të gjitha detyrimet në tërësi dhe sipas radhës së arritjes, shtrohet çështja e radhës së llogaritjes së përmbushjes së detyrimeve. Llogaritja e radhës së përmbushjes së detyrimeve bëhet sipas këtyre rregullave: 1) së pari llogaritja bëhet sipas deklaratës së debitorit, të cilën mund ta bëjë më së voni me rastin e përmbushjes së detyrimit (debitori mund të cekë se cilin nga borxhet e konsideron të përmbushur, ai mund të thekson që borxhi i arritur më vonë të shuhet me bërjen e një pagese para borxhit të arritur më herët); 2) në mungesë të deklaratës së debitorit për llogaritjen e radhës së përmbushjes së detyrimit, detyrimet përmbushen sipas radhës së arritjes së detyrimit për pagesë; 3) nëse më shumë detyrime kanë arritur njëkohësisht, së pari paguhen ato detyrime të cilat më së paku janë siguruar, po kur të gjitha janë njësoj të siguruara, së pari përmbushen detyrimet të cilat për debitorin janë barrë më e rëndë; 4) nëse të gjitha detyrimet janë njësoj të rënda, përmbushen sipas radhës së sajimit, por nëse janë sajuar

njëkohësisht, ajo që është paguar në emër të përmbushjes radhitet në të gjitha detyrimet proporcionalisht me shumat e tyre. Në rast se debitori, përveç kryegjësë, ka borxh edhe kamatën dhe shpenzimet, llogaritja bëhet ashtu që së pari përmbushen shpenzimet, pastaj kamata dhe në fund kryegjësja.

Dhënia e dëftesës dhe kthimi i fletobligacionit

- a) *Debitori që ka përmbushur detyrimin, ka interes të sigurojë provën me të cilën do të provojë se detyrimi është përmbushur, në mënyrë që të mbrohet nga kërkesat e kreditorit, të cilat mund t'i paraqiten më vonë për të njëjtin borxh. Nëse përmbushja është bërë përmes bankës, atëherë si provë për pagesën e bërë shërben dëftesa e çekut. Ekziston supozimi se, nëse debitori posedon dëftesën për pagesën e borxhit kryesor, i ka paguar edhe shpenzimet dhe kamatën, po qe se ato kanë ekzistuar. Kur është fjala për detyrimet e kohëpaskohshme, siç janë qiraja dhe kërkesat e tjera, kërkesat e sajuara me anë të shpenzimit të rrymës, telefonit, ujit, debitori që posedon dëftesën, me të cilën e ka paguar kërkesën e arritur më vonë, supozohet se i ka paguar edhe kërkesat e arritura më herët.*
- b) *Debitori që ka marrë dëftesën për pagimin e borxhit, ka të drejtë të kërkojë edhe kthimin e fletobligacionit, përkatësisht dokumentin për borxhin e paguar, ngase kreditori nuk ka arsye ta mbajë fletobligacionin për borxhin që është paguar. Pas kthimit të fletobligacionit supozohet se debitori e ka përmbushur detyrimin në tërësi ndaj kreditorit. Ky supozim është i rrëzueshëm, ngase mund të provohet e kundërta, por barrën e provës e mban kreditori.*

VONESA

1. Vonesa e debitorit dhe kreditorit

Vonesa përgjithësisht ekziston atëherë kur debitori detyrimin e vet nga marrëdhënia detyimore e arritur për pagesë nuk e përmbush më kohë, si dhe kur kreditori, pa arsye, e refuzon pranimin e përmbushjes së detyrimit të ofruar nga debitori.

Debitori bie në vonesë kur nuk e përmbush detyrimin e vet brenda afatit të caktuar. Nuk është me rëndësi për çfarë arsye debitori nuk e ka përmbushur detyrimin e vet brenda afatit të caktuar. Nëse afati i përmbushjes së detyrimit nuk është caktuar, debitori bie në vonesë kur kreditori ia tërheq vërejtjen që ta përmbushë detyrimin e vet, përkatësisht, e fton gojarisht, me shkrim, me vërejtje jo gjyqësore ose në ndonjë mënyrë tjetër që ta përmbushë detyrimin, përveç në rastet kur vonesa është shkaktuar për arsytet për të cilat me ligj përjashtohet përgjegjësia e debitorit për shpërblimin e dëmit.

Debitori që bie në vonesë e keqëson pozitën e vet, ngase kreditori ka të drejtë ta shkëputë kontratën dhe të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit për mospërmbushje, për të cilën përgjigjet.

Vonesa e kreditorit është një rast shumë më i rrallë në raport me atë të debitorit. Vonesa e kreditorit ekziston kur ai, pa arsye të bazuara, refuzon pranimin e përmbushjes ose, me sjelljet e tij, e pengon atë. Vonesa e kreditorit ekziston edhe në rastin kur ai është i gatshëm të pranojë përmbushjen e detyrimit të njëkohshëm të debitorit, por nuk ofron përmbushjen e detyrimit të arritur të tij. Kreditori nuk bie në vonesë, po qe se provon që në kohën e ofertës së përmbushjes ose në kohen e caktuar për përmbushje, debitori nuk ka mundur ta përmbushë detyrimin e vet.

Efektet e vonesës së kreditorit janë të tilla, ashtu që me rënien e kreditorit në vonesë shuhet vonesa e debitorit, dhe tek ai kalon rreziku i zhdukjes së rastësishme ose i dëmtimit të sendit, pastaj nuk ecën afati i kamatës dhe është i detyruar që debitorit t'i shpërblejë dëmin e shkaktuar për atë shkak, për të cilin dëm edhe përgjigjet.

Depozitimi dhe shitja e sendit borxh

Për t'iu shmangur debitori pasojave, të cilat mund të shkaktohen nga pengesat, për shkak të cilave nuk mund ta përmbushë detyrimin e vet, ligji e autorizon atë të ndërmarrë veprimin e depozitimit dhe shitjen e sendit. Këtë mund ta bëjë në këto raste: kur kreditori është në vonesë, i panjohur, kur nuk është e sigurt se kush është kreditor dhe ku gjendet dhe kur kreditori është i paafhtë për të vepruar e nuk ka të autorizuar. Debitori depozitimin e sendit mund ta bëjë te gjykata kompetente në vendin e përmbushjes e, sipas nevojës, edhe te çdo gjykatë kompetente lëndore, ndërsa këto gjykata janë të detyruara ta pranojnë një depozitim të tillë. Sendet të cilat nuk janë të përshtatshme për depozitim në gjykatë, gjykata mund t'ia besojë personit të tretë për ruajtje me shpenzime dhe në llogari të kreditorit. Te kontratat në ekonomi, depozitimi

i sendit bëhet në depo publike. Për depozitimn debitori është i detyruar ta njoftojë kreditorin, sapo të jetë e mundur.

Me depozitimn e sendit në gjykatë apo në depon publike shkaktohen këto efekte juridike: a) debitori lirohet nga detyrimi në momentin e dorëzimit të sendit në gjykatë, përkatësisht në depon publike; b) nëse debitori ka qenë në vonesë, vonesa e tij ndërpritet; c) nga momenti i dorëzimit, përkatësisht depozitimit, rreziku i zhdukjes së rastësishme ose dëmimit kalon te kreditori; dhe d) nga dita e depozitimit ndërpritet ecja e afatit të kamatës.

Në qoftë se sendi është i papërshtatshëm për ruajtje ose shpenzimet e ruajtjes së tij tejkalojnë vlerën e vet sendit, debitori mund ta shesë në shitje publike, në vendin e përmbushjes ose në ndonjë vend tjetër, nëse është në interes të kreditorit dhe shumë e realizuar të hollave, pas zbritjes së shpenzimeve të shitjes, do t'i depozitohet në gjykatën e atij vendi. Sendet e vlerës së vogël ose ato që kanë çmimin vijues, debitori mund t'i shesë pa ankand publik. Malli që prishet lehtë duhet të shitet pa zvarritje. Debitori është i detyruar që, para shitjes, ta njoftojë kreditorin për qëllimin për ta shitur sendin dhe, pas shitjes, ta njoftojë për çmimin e realizuar dhe depozitimn e tij në gjykatë.

Gjykata do t'i dorëzojë kreditorit sendin e depozituar në kushtet e caktuara nga debitori.

MËNYRAT TJERA TË SHUARJES SË DETYRIMEVE

1. Shuarja e detyrimit me kompensim (Compensatio)

Kompensimi është një ndër mënyrat e shuarjes vullnetare të detyrimit. Kompensimi është një lloj llogaritjeje e kërkesave të ndërsjella të dy personave, nga të cilët njëri ka rolin e kreditorit dhe tjetri të debitorit. Ajo bëhet në atë mënyrë që një person, në një marrëdhënie detyimore, është në rolin e kreditorit, ndërsa në marrëdhënien tjetër të detyrimit ndaj personit të njëjtë është në rolin e debitorit; mes debitorit dhe kreditorit bëhet llogaritja e borxhit me kërkesën. Kompensimi ka rolin e dy pagesave. Qëllimi i kompensimit është thjeshtimi i procedurës së përmbushjes së dy detyrimeve të ndërsjella.

Prezumimet për t'u bërë kompensimi janë: a) ekzistimi i kërkesave të ndërsjella; b) kërkesat të jenë të një lloji dhe 3) kërkesat të kenë arritur. Kompensimi nuk realizohet me përmbushjen e vetëm të këtyre kushteve, por është e nevojshme që njëra palë të deklarojë se e bën kompensimin dhe, pas një deklarate të tillë, konsiderohet se kompensimi është bërë në momentin kur janë plotësuar kushtet e cekuar më sipër.

Kompensimi mund të jetë: a) i plotë, kur shumata e vlefës së kërkesave është e njëjtë dhe me kryerjen e kompensimit të detyrimeve të tilla, detyrimet shuhet në tërësi dhe b) i pjesshëm, kur detyrimet, sipas vlerës, janë të ndryshme dhe me kompensimin e kërkesave të tilla, detyrimi me vlerë më të vogël shuhet, ndërsa detyrimi më vlerë më

të madhe shuhet pjesërisht deri në masën e vlerës së detyrimit më të vogël, kurse për pjesën tjetër më të madhe mbetet edhe më tutje.

Kompensimi sipas mënyrës së sajimit mund të jetë: a) në bazë të kontratës (kompensimi kontraktues); b) kompensimi ligjor, i cili sajohet sipas forcës ligjore dhe c) kompensimi i njëanshëm, i cili sajohet në bazë të kërkesës jashtë gjyqësore ose gjyqësore të njëjës palë.

Me anë të kompensimit nuk mund të shuhen këto kërkesa: 1) kërkesat që nuk mund të sekuestrohen; 2) kërkesa e sendit ose e vlerës së sendit, i cili iu ka dhënë debitori për ruajtje ose hua ose të cilin debitori e ka marrë padrejtësisht ose e ka mbajtur padrejtësisht; 3) kërkesat e krijuara me dëmin e shkaktuar me dashje; 4) kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar me dëmtimin e shëndetit ose me shkaktimin e vdekjes dhe 5) kërkesa që rrjedh nga detyrimi i ushqimit ligjor (alimentacionit).

2. Falja e borxhit

Falja e borxhit është një ndër mënyrat e shuarjes së detyrimit. Falja e borxhit sajohet atëherë kur kreditori i deklaroi debitorit se nuk do të kërkojë borxhin dhe debitori bie dakord me këtë. Falja e borxhit domethënë është kontratë, në bazë të së cilës kreditori dhe debitori e shuajnë detyrimin pa përmbushjen e borxhit. Përderisa nuk ekziston pëlqimi i vullnetit të dy palëve, nuk mund të ketë as falje të vlefshme juridike të borxhit, por mund të ekzistojë eventualisht deklarata e njëanshme e kreditorit që nuk do ta kërkojë borxhin. Motiv i faljes së borxhit mund të jetë qëllimi i dhurimit (bami-rësisë) apo me shpërblim. Sipas vëllimit, falja e borxhit mund të jetë e plotë, në të cilin rast në tërësi shuhet kërkesa e borxhit kryesor dhe e kërkesave dytësore, ndërsa falja e pjesshme e borxhit ekziston kur borxhi shuhet pjesërisht në masën që është falur. Falja e pjesës së borxhit kryesor ka për pasojë edhe faljen e kërkesave dytësore (dorëzania, kamata etj.), të cilat kanë të bëjnë me pjesën e falur të borxhit, por jo edhe e kundërta.

Falja e përgjithshme i shuan të gjitha kërkesat e kreditorit ndaj debitorit, përveç të atyre për të cilat kreditori nuk ka ditur se ekzistojnë në momentin kur është bërë falja.

3. Përtëritja (novacio)

Përtëritja është formë e shuarjes së detyrimit. Kjo është një kontratë e lidhur mes kreditorit dhe debitorit, me të cilën detyrimin e vjetër e zëvendësojnë me një detyrim të ri. Që të mund të jetë përtëritja juridikisht e vlefshme, duhen plotësuar këto kushte: a) duhet të ekzistojë detyrimi i vjetër juridikisht i vlefshëm; b) të sajohet detyrimi i ri juridikisht i vlefshëm; c) të ekzistojë ndërrimi i objektit ose bazës juridike mes detyrimit të vjetër dhe atij të ri; të ekzistojë qëllimi i përtëritjes, i cili duhet të shprehet në mënyrë të qartë.

Marrëveshja për modalitetet e afatit, vendit, mënyrës së përmbushjes së detyrimit, kamatës, kontraktimi i kushtit penal, sigurimit të përmbushjes së detyrimit, dhënies së dokumentit të ri për borxhin nuk konsiderohen përtëritje.

Efektet juridike të përtëritjes kanë të bëjnë me shuarjen e detyrimit të vjetër dhe sajimin e detyrimit të ri. Me shuarjen e detyrimit të vjetër shuhen edhe pengu dhe dorëzania, përveç kur me dorëzanësin dhe pengdhënësin është kontraktuar diç tjetër. Kështu ndodh edhe me të drejtat e tjera sekondare.

4. Konfondimi

Detyrimi shuhet edhe në atë mënyrë që i njëjti person bëhet kreditor dhe debitor në të njëjtën marrëdhënie të detyrimit. Në këtë rast, detyrimi shuhet ngase logjikisht askush nuk mund t'i ketë borxh vetvetes. Kur është rasti me persona fizikë, Konfondimi ndodh kur kreditori e trashëgon debitorin ose anasjelltas. Kur bëhet fjalë për persona juridikë shuarja e detyrimit vjen me anë të integritimit apo fuzionimit të kreditorit dhe debitorit. Kur dorëzani kalon në rolin e kreditorit, detyrimi i borxhliut kryesor nuk shuhet. Në rastin kur detyrimi ka të bëjë me kërkesën që regjistrohet në librat publikë, që të mund të konsiderohet detyrimi i shuar në bazë të konfondimit, është e domosdoshme të bëhet çregjistrimi nga librat publikë.

5. Pamundësia e përmbushjes së detyrimit

Pamundësia e përmbushjes së detyrimit është një ndër mënyrat e shuarjes së detyrimit. Detyrimi shuhet kur përmbushja e tij bëhet e pamundur për shkak të rrethanave për të cilat debitori nuk përgjigjet. Që të shuhet detyrimi për shkak të pamundësisë së përmbushjes, duhet të plotësohen këto kushte: a) që pamundësia të jetë shkaktuar pas sajimit të detyrimit; b) që të mos jetë shkaktuar për fajin e debitorit, por me ndikimin e forcës madhore - si pasojë e ngjarjes të cilën debitori nuk ka mundur të parashikojë dhe, nëse ka parashikuar, nuk ka mundur ta pengojë ose ta shmangë dhe c) debitori të mos jetë vonuar me përmbushjen, të mos ketë kaluar afati i caktuar i përmbushjes.

Shuarja e detyrimit për pamundësinë ndodh vetëm me kërkesë të debitorit. Debitori është i detyruar të provojë rrethanat të cilat përjashtojnë përgjegjësinë e tij.

Detyrimi nuk shuhet kur objekt përmbushjeje të detyrimit janë sendet e caktuara sipas llojit, por nëse kemi të bëjmë me sende që duhen marrë nga një masë e caktuar, detyrimi shuhet kur zhduket e tërë masa (neni 336 i LMD).

6. Kalimi i kohës - denoncimi

Marrëdhënia e përhershme e borxhit me afat të caktuar shuhet kur skadon afati, përveç kur me kontratë ose ligj është caktuar që, pas skadimit të afatit, marrëdhënia e borxhit të vazhdohet në kohë të pacaktuara, nëse nuk denoncohet me kohë (neni 338 i LMD). Për të ekzistuar ky rast i shuarjes së detyrimit sipas kësaj dispozite, duhet të plotësohen këto kushte: të ekzistojë marrëdhënia juridike mes kreditorit dhe debitorit; marrëdhënia e detyrimeve të jetë me pretime të përhershme; detyrimi duhet të jetë i afatizuar. Edhe marrëdhëniet në të cilat nuk është caktuar afati i kohëzgjatjes, mund të shuhen me anë të denoncimit. Me anë të denoncimit detyrimi pushon pas skadimit të afatit të caktuar me kontratë, me ligj ose brenda afatit të arsyeshëm. Palët mund të merren

vesh me kontratë që marrëdhënia detyrimore të shuhet me vetë dorëzimin e denoncimit. Denoncimi mund të jepet në çdo kohë, përveçse në kohë të papërshtatshme. Në rast të shuarjes së detyrimit me denoncim, kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e asaj pjese të detyrimit e cila ka arritur para skadimit të afatit të denoncimit, përkatësisht shuarjes së detyrimit.

7. Vdekja

Vdekja e njërit pjesëmarrës në marrëdhënien e detyrimeve, parimisht, nuk shpie te shuarja e detyrimit, ngase detyrimet kanë karakter pasuror dhe të drejtat dhe detyrimet pasurore të vdekurit kalojnë te pasardhësit e tyre universalë apo singular.

Shuarja e detyrimit për shkak të vdekjes së kreditorit a debitorit mund të ndodhë vetëm në rast se veprimi juridik është lidhur duke pasur parasysh cilësitë personale të pjesëmarrësve të detyrimit (neni 340 i

LMD), siç është rasti me kontratën e sipërmarrjes, detyrimin e shpërblimit të dëmit jomaterial (në rastin e vdekjes së të dëmtuarit), detyrimin ushqimor (në rastin e vdekjes së personit që ka marrë ushqim). Kërkesat e tilla periodike mund të trashëgohen vetëm atëherë kur ato kanë arritur për pagesë para vdekjes së bartësit të kësaj të drejte.

8. Parashkrimi

Parashkrimi është një institucion i së drejtës së detyrimeve, sipas të cilit kreditori, për shkak të qëndrimit tij pasiv ndaj së drejtës së tij brenda afatit e caktuar me ligj, e humb të drejtën e mbrojtjes së asaj të drejte, po qe se debitori shpreh vullnetin që të shfrytëzojë të drejtën, e cila sajohet për të nga sjellja e tillë e kreditorit. Kjo do të thotë se me anë të parashkrimit shuhet e drejta që për të kërkuar me anë të padisë përmbushjen e detyrimit (neni 341 par. 1 i LMD). Sipas kësaj dispozite ligjore, me anë të parashkrimit nuk humbet e drejta, si e tillë, por shuhet e drejta për mbrojtje gjyqësore të së drejtës subjektive civile, përkatësisht detyrimore. Parashkrimi ndodh kur kalon afati i caktuar me ligj, brenda të cilin kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit.

Në të drejtën pozitive të detyrimeve te ne parashkrimi vetvetiu nuk prodhon efekt juridik, por është e nevojshme që debitori t'i referohet atij me paraqitje të prapësimit.

Me ligj caktohen afatet e përgjithshme dhe ato të veçanta. Afati i përgjithshëm i parashkrimit është caktuar me nenit 352 të LMD, sipas të cilit kërkesat parashkruhen për 5 vjet, përveç kur me ligj të veçantë është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit. Afati tre vjeçar vlen për parashkrimin e kërkesave të ndërsjella që përmbajnë kontratat e qarkullimit të mallrave dhe të shërbimeve (neni 355 i LMD), kërkesat e vërtetuara me aktgjykim të formës së prerë të gjykatës ose me vendim të organit tjetër kompetent (neni 361 i LMD) parashkruhen në afat prej 10 vitesh ndërsa kërkesat për shpërblimin e dëmit të shkaktuara me vepër penale (neni 358 të LMD), parashkruhen në afat subjektiv prej tre vitesh dhe afatin objektiv prej pesë vitesh përveç kur për ndjekjen penale është parashikuar një afati më i gjatë i parashkrimit.

Kërkesat e palëve kontraktuese, sipas bazës së kontratës së sigurimit, përkatësisht të palës së tretë të kontratës së sigurimit të jetës, parashkruhen për 5 vjet, ndërsa për kontratat e tjera për 3 vjet. Afati fillon të llogaritet nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijani për dëmin e shkaktuar (afati subjektiv), por te sigurimi i jetës kërkesa parashkruhet brenda afatit objektiv prej 10 vjetësh, ndërsa në rastet tjera brenda afatit prej 5 vjetësh.

Afatet e veçanta të parashkrimit janë më të shkurtra. Afati njëvjeçar vlen për parashkrimin e kërkesave për këto raste: pagimin e shpërblimit për shpenzimin e energjisë elektrike, gazit, ujit, shërbimeve të ndërmarrjeve komunale, shërbimet e televizionit, shërbimet e PTT-ës. Brenda afatit prej 3 vjetësh parashkruhen kërkesat sipas bazës së kontratës së qirasë të banesave dhe lokaleve afariste.

Gjatë ecjes së afatit të parashkrimit mund të ndodhin disa ngjarje, të cilat e ndalin apo ndërpresin afatin e parashkrimit. Afati pushon të ecë në këto raste: mes bashkëshortëve; mes prindërve dhe fëmijëve, përderisa zgjatë e drejta prindore; mes të mbrojturit dhe kujdestarit të tij dhe organit të kujdestarisë derisa zgjat kujdestaria dhe mes dy personave të cilët jetojnë në bashkësi jashtëmartesore; gjatë mobilizimit dhe rrezikut të drejtpërdrejtë të luftës, lidhur me kërkesat e personave në detyra ushtarake; për kërkesat e personave të punësuar në amvisni të huaj ndaj punëdhënësit ose anëtarëve të familjes së tij, të cilët jetojnë me të; gjatë kohës për të cilën kreditori, për shkak të ekzistimit të pengesave të pakapërcyeshme që nëpërmjet gjykatës të kërkohej përmbushja e detyrimit.

Ndërprerja e parashkrimit ekziston në këto raste: kur debitori e pohon borxhin; me paraqitjen e padisë në gjykatë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit, të ndërmarrë kundër debitorit në gjykatë, me qëllim të vërtetimit të ekzistimit të sigurimit ose realizimit të kërkesës, me përjashtim kur kreditori e tërheq padinë, kur refuzohet ose hidhet poshtë padia ose anulohet veprimi i ndërmarrë i sigurimit.

Në rast të ndërprerjes së parashkrimit, afati i parashkrimit fillon të ecë që nga fillimi, ndërsa koha e cila ka skaduar para ndërprerjes së shkaktuar nuk llogaritet.

Afati subjektiv i parashkrimit ka të bëjë me fillimin e ecjes së afatit të parashkrimit nga dita kur i dëmtuari ka marrë dijani për dëmin e shkaktuar dhe dëmtuesin.

Afati objektiv i parashkrimit ka të bëjë me fillimin e ecjes së afatit prej momentit të shkatërrimit të dëmit.

LLOJET E NDRYSHME TË DETYRIMEVE

1. Detyrimet në të holla

Detyrimi në të holla përkufizohet si detyrim, objekt pagimi i të cilit është shuma e të hollave qoftë ajo të jetë caktuar që në fillim të sajimit të detyrimit (te kontrata e huas, e shitblerjes etj.), qoftë të caktohet më vonë (shpërblimi i dëmit kontraktues ose dëmit deliktor jokontraktues). Sipas së drejtës pozitive, ekziston parimi i përgjithshëm i nominalizmit monetar sipas të cilit, kur debitori merr përsipër detyrimin objekt i të cilit është shuma e të hollave, është i detyruar të paguajë atë numër të njësive të të hollave sa ka qenë numri i njësive të të hollave në momentin e krijimit të detyrimit, përveç kur ligji cakton diçka tjetër (neni 375 i LMD). Mirëpo, në ekonomin jostabile mund të ndodhin ndryshime në fuqinë blerëse të të hollave dhe të ndryshojë vlera reale e detyrimit prej momentit të krijimit të detyrimit deri brenda afatit të arritjes së detyrimit për pagesë, ashtu që, po qe se një parim i tillë respektohet me rreptësi, mund të dëmtohet kreditori apo, e kundërta, kur fuqia blerëse e monedhës rritet, në atë rast mund të dëmtohet debitori, ngase me pagesën e të njëjtës njësi të shumës së të hollave, të cilat janë caktuar në momentin e krijimit të detyrimit, debitori do të paguajë një vlerë reale më të madhe. Për këto arsye, ligji bën përjashtime nga parimi i nominalizmit monetar dhe lejon kontraktimin e të ashtuquajturave klauzola të indeksit, sipas të cilave, shuma e detyrimit në të holla lidhet me ndryshimin e çmimeve të mallit ose shërbimeve të shprehura në indeksin e çmimeve, të cilat janë në lidhje të drejtpërdrejtë ekonomike me objektin e veprimit juridik, me kusht që të mos kenë karakter spekulativ dhe kontraktimi i një klauzole të tillë të jetë sigurimi i standardit jetësor të palëve kontraktuese (neni 376 i LMD).

Ekzistojnë edhe klauzola kontraktuese, të cilat mund të përmbajnë shkallën rrëshqitëse (evazive), sipas të cilave lejohet të kontraktohet çmimi që varet nga çmimi i materialit dhe punës dhe elementeve të tjera, të cilat ndikojnë në masën e shpenzimeve të prodhimit në kohë të caktuar dhe në një vend të caktuar. Kjo mundësi zbatohet te kontratat sipas të cilave, njëra palë detyrohet të prodhojë dhe të dërgojë prodhime të caktuara si dhe te kontrata e ndërtimit.

2. Detyrimet alternative

Detyrimi alternativ ekziston kur detyrimi përbën disa objekte, por debitori, për tu liruar nga përgjegjësia, është i detyruar të dorëzojë vetëm një objekt. Një detyrim i tillë ekziston kur debitori detyrohet t'i dorëzojë kreditorit njërin prej dy sendeve: një televizori apo lavatriçe. E drejta e zgjedhjes i takon debitorit, përveç kur me kontratë është kontraktuar diçka tjetër (neni 387 i LMD). Kjo e drejtë mund t'i takojë edhe kreditorit ose një personi të tretë. Debitori mund ta shfrytëzojë të drejtën të zgjedhë kohën brenda së cilës, në procedurën e përmbarimit, njëra nga sendet që e ka borxh të mos i dorëzohet kreditorit sipas zgjedhjes së tij. Për zgjedhjen e bërë personi i autorizuar duhet ta njoftojë palën tjetër dhe nga ai moment zgjedhja nuk mund të ndërrohet. Me

bërjen e zgjedhjes konsiderohet se detyrimi që nga fillimi ka qenë i thjeshtë dhe objekti i detyrimit ka qenë sendi i zgjedhur.

Në qoftë se zgjedhjen duhet ta bëjë personi i tretë dhe ai nuk e bën këtë, secila palë mund të kërkojë që zgjedhjen ta bëjë gjykata.

Në rastin kur një objekt detyrimi bëhet i pamundur për pasojë të rrethanave, për të cilat palët nuk janë përgjegjëse, detyrimi kufizohet në sendin tjetër të mbetur.

Në rastin kur sendi zhduket për fajin e debitorit, të cilit i takon e drejta e zgjedhjes, ai do ta dorëzojë sendin tjetër të mbetur. Në rastin kur sendi zhduket për fajin e kreditorit, e drejta e zgjedhjes i takon debitorit, i cili mund të zgjedh sikur t'ia kishte dorëzuar sendin e zhdukur ose t'ia dorëzojë sendin e mbetur dhe të kërkojë nga kreditori shpërblimin e dëmit. Në rastin kur sendi zhduket për fajin e debitorit, ndërsa e drejta e zgjedhjes i takon kreditorit, ky mund të kërkojë ose sendin e mbetur, ose shpërblimin e dëmit.

3. Detyrimet fakultative

Detyrimi fakultativ ekziston kur debitori ka borxh një send të caktuar, por i lejohet që të lirohet nga detyrimi i tij me dorëzimin e një sendi tjetër të caktuar. Kreditori është i autorizuar që nga debitori të kërkojë vetëm sendin që është objekt detyrimi. Nëse objekti i detyrimit zhduket për shkak të forcës madhore, kreditori nuk mund ta kërkojë sendit tjetër.

Me kontratë ose me ligj mund të parashikohet që kreditori, në vend të sendit të cilin debitori ia ka borxh, të kërkojë dorëzimin e ndonjë sendi tjetër të caktuar, në të cilin rast debitori është i detyruar t'ia dorëzojë atë send, po qe se këtë e kërkon kreditori. Në kërkesat fakultative zbatohen rregullat e detyrimeve fakultative dhe alternative.

4. Detyrimet e pjesëtueshme

Detyrimi është i pjesëtueshëm në qoftë se ajo që debitohet mund të pjesëtohet dhe të përmbushet në pjesët që kanë cilësi të njëjta siç ka i tërë objekti dhe në qoftë se me këtë pjesëtim nuk humbet asgjë nga vlera e vet, ndërsa në të kundërtën detyrimi është i papjesëtueshëm. Kemi të bëjmë me detyrim të pjesëtueshëm, sipas dispozitës së nenit 396 par. 1 i LMD, në qoftë se borxhi mund të ndahet dhe të përmbushet në pjesë të cilat kanë të njëjtat cilësi sikurse i tërë objekti i detyrimit dhe në qoftë se me atë ndarje ai nuk humb asgjë nga vlera e tij. Për vërtetimin e këtyre cilësive të detyrimit janë me rëndësi dy elemente: a) që borxhi të mund të ndahet në pjesë të cilat kanë cilësi të njëjta sikurse edhe tërësia (p.sh. detyrimet në të holla; e pjesëtueshme është edhe sasia e drithit, e pemëve të llojit përkatës etj.); b) dhe se ajo që është borxh, me një ndarjen të tillë të mos humbet nga vlera e saj (në qoftë se detyrimi në shumën prej 1.000€ ndahet në dy detyrime prej nga 500 € ose në qoftë se detyrimi prej 1.000 kg grurë ndahet në dy dhënie prej nga 500 kg.).

Detyrimet e pjesëtueshme krijohen në bazë të kontratës, trashëgimisë ose në bazë të ligjit. Detyrimet e pjesëtueshme ndahen në ato aktive dhe pasive, varësisht nga ajo

se në cilën anë ka më shumë persona: në qoftë se ka më shumë kreditorë, çdo kreditor mund të kërkojë pjesën që i takon e nëse ka më shumë debitorë, çdo debitor ka borxh vetëm pjesën që ka në ngarkesë. Në rast se detyrimi ndahet në më shumë debitorë ose kreditorë dhe nuk ekziston një marrëveshje e kundërt, detyrimi ndahet në pjesë të barabarta mes tyre dhe secili nga debitorët përgjigjet për pjesën e vet, ndërsa secili nga kreditorët mund të kërkojë vetëm pjesën e tij përkatëse.

5. Detyrimet solidarë

Detyrimi solidar ekziston kur në një marrëdhënie detyrimore marrin pjesë shumë persona, qoftë në anën e debitorit, qoftë në anën e kreditorit. Detyrimi solidar mund të krijohet në bazë të veprimit juridik, ligjit dhe me testament.

Varësisht nga ajo se në cilën anë të debitorit apo kreditorit marrin pjesë shumë persona, detyrimet ndahen në detyrimet solidarë aktive dhe detyrimet solidarë pasive.

- 1) Detyrimi solidar pasiv ekziston kur në marrëdhënien e detyrimit ka një kreditor dhe shumë debitorë dhe secili debitor i detyrimit solidar është përgjegjës ndaj kreditorit për tërë detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e tij nga cilido debitor deri atëherë kur detyrimi të përmbushet në tërësi, por kur një debitor e përmbush detyrimin, detyrimi shuhet dhe të gjithë debitorët tjerë lirohen prej tij. Nga shumë debitorë solidarë, secili mund të ketë borxh me afat tjetër përmbushjeje dhe në kushte të ndryshme e me dallime të tjera. Secili debitor solidar mund t'i referohet propësimi të kompensimit dhe të bëjë kompensimin deri në masën e pjesës së vet të borxhit, për të cilën pjesë borxhi zvogëlohet ndaj debitorëve të tjerë. Falja e borxhit ndaj njërit prej debitorëve i liron të gjithë debitorët e tjerë, po qe se kjo nuk është bërë me qëllim që ta lirojë nga borxhi vetëm debitorin të cilit iu ka falur borxhi dhe me këtë rast do të zvogëlohet borxhi për pjesën e tij. Me përtëritjen e borxhit me njërin prej debitorëve mund të shuhet detyrimi në tërësi, por nëse kreditori dhe debitori detyrimin e kanë kufizuar vetëm në pjesën e detyrimit të debitorit, me të cilin është arritur marrëveshja e përritjes së detyrimit, detyrimi i debitorëve të tjerë nuk shuhet, por zvogëlohet për pjesën e debitorit pjesëmarrës të përtëritjes së borxhit. Ujdia e lidhur mes kreditorit dhe njërit nga debitorët nuk ka efekt juridik ndaj debitorëve të tjerë, por ata kanë të drejtë ta pranojnë atë ujdi, përveç në rastin kur ujdia është kufizuar vetëm me debitorin që ka lidhur ujdinë. Kur te një person bashkohen cilësia e kreditorit dhe e një debitori të detyrimit të njëjtë solidar, detyrimi i debitorëve të tjerë solidarë zvogëlohet me shumën që i përket debitorit të fuzionuar. Vonesa e kreditorit ndaj njërit prej debitorëve ka efekt juridik ndaj të gjithë debitorëve të tjerë, ashtu që në atë rast detyrimi shuhet në tërësi edhe ndaj debitorëve tjerë. Debitori që ka përmbushur borxhin ka të drejtë të kërkojë nga bashkëborxlinjtë e tjerë t'ia kompensojnë pjesën e detyrimit përkatës e cila ju takon atyre. Nëse në mes të debitorëve nuk ka marrëveshje lidhur me pjesën përkatëse të borxhit, borxhi ndahet në pjesë të barabarta.
- 2) Detyrimi aktiv solidar ekziston kur në anën e kreditorit marrin pjesë shumë persona, ndërsa në anën e debitorit një person. Çdo kreditor është i autorizuar ta kërkojë

përbushjen e tërë detyrimit. Në rast se një kreditor e ka arkëtuar borxhin, detyrimi shuhet edhe për kreditorët e tjerë. Ky lloj i detyrimit solidar nuk mund të supozohet, por ekziston vetëm kur është kontraktua ose është caktuar me ligj. Debitori mund t'ia përbushë detyrimin atij kreditori të cilin e zgjedh vetë, deri atëherë kur ndonjë nga kreditorët nuk kërkon përbushjen e detyrimit. Secili prej kreditorëve solidarë është i autorizuar të ndërmarrë ato veprime me të cilat i mbron edhe interesat e kreditorëve të tjerë. Debitori mund të bëjë kompensimin e kërkesës së tij me kërkesën e njërit nga kreditorët, në të cilin rast borxhi ndaj kreditorëve të tjerë zvogëlohet deri në masën e kërkesës së debitorit. Borxhi i debitorit ndaj kreditorëve të tjerë zvogëlohet edhe në rast të faljes së borxhit nga ana e njërit prej kreditorëve ose përtëritja e borxhit me njërin nga kreditorët. Ujdia e lidhur mes njërit nga kreditorët solidar dhe debitorit nuk ka efekt ndaj kreditorëve të tjerë, por ata kanë të drejtë ta pranojnë ujdinë, përveç në rastin kur ajo është kufizuar në pjesën e borxhit të kreditorit, i cili e ka lidhur ujdinë. Pjesa e borxhi që kalon te njëri nga kreditorët në rast fuzionimi, secili nga kreditorët e tjerë ka të drejtë ta kërkojnë pjesën e vet përkatëse. Vonesa e debitorit ndaj njërit nga kreditorët ka efekt edhe ndaj kreditorëve të tjerë. Të njëjtin efekt e ka edhe pohimi i borxhit nga debitori. Renoncimi i debitorit nga e drejta e parashkrimit ndaj njërit prej kreditorëve ka efekt edhe ndaj të gjithë kreditorëve të tjerë. Secili nga kreditorët solidarë ka të drejtë të kërkojë nga kreditori që ka bërë arkëtimin e borxhit prej debitorit që t'ia dorëzojë pjesën që i takon. Në qoftë se me marrëveshje mes kreditorëve nuk është caktuar ndryshe, secilit kreditor solidar i takon pjesa e barabartë e borxhit.

- 3) Detyrimet e papjesëtueshme janë ato detyrime objekti i të cilave nuk mund të ndahet në shumë pjesë alikuote e të mos ndryshojë thelbi i tij dhe të mos zvogëlohet vlefë e tij (p.sh. kafsha e gjallë, fotografia artistike etj.). Në detyrimet e këtilla, në të cilat ka shumë debitorë ose kreditorë, zbatohen përshtatshmërisht dispozitat që kanë të bëjnë me detyrimet solidare.

NDËRRIMI I KREDITORIT OSE I DEBITORIT

Ndërrimi i kreditorit ose debitorit është një formë e kalimit të kërkesës me kontratë (kalimi - cessio). Kalimi është kontratë me të cilën kreditori kalues - cedenti e kalon kërkesën të cilën e ka ndaj debitorit (cesusit) te personi i tretë - pranuesi (cesionarin). Kalimi i kërkesës në të drejtën pozitive të detyrimeve është rregulluar me dispozitat e neneve 420 - 429 të LMD. Sipas këtyre rregullave, kreditori me kontratën e lidhur me personin e tretë mund t'ia kalojë kërkesën e vet atij personi. Që të mund të bëhet kalimi i ligjshëm i kërkesës sipas kontratës së kalimit, duhet të plotësohen këto kushte: a) që të lidhet kontrata e kalimit të kërkesës - kjo kontratë parimisht mund të lidhet në çfarëdo forme, me përjashtim kur është fjala për kërkesën që ka të bëjë me pasurinë e paluajtshme, kur duhet të lidhet në formën me shkrim dhe nënshkrimet e palëve të legalizohen; b) që debitori të njoftohet për kalimin e kërkesës dhe c) që kërkesa të jetë e mundshme të përbushet - detyrimet në të holla ose ato që kanë të bëjnë me ndonjë bërje.

Kontrata e kalimit nuk ka efekt juridik ndaj debitorit, në qoftë se kalimi i kërkesës është i ndaluar me ligj ose është e lidhur me personalitetin e kreditorit ose, për nga

natyra e saj, është e tillë që nuk mund të kalohet; në qoftë se debitori dhe kreditori janë marrë vesh që kërkesa të mund të kalohet te tjetri ose të mos mund të kalohet pa pëlqimin e debitorit.

Me kalimin e kërkesës krijohen raporte të reja mes cedentit, cesusit dhe cesionarit. Cesionari merr pozitën e kreditorit dhe fiton të gjitha të drejtat ndaj debitorit, të cilat i ka pasur kreditori i vjetër. Pozita e debitorit nuk ndryshon. Ai ka të drejtë t'i paraqesë të gjitha prapësimet ndaj kreditorit të ri, të cilat ka mundur t'i paraqesë edhe ndaj kreditorit të vjetër si dhe prapësimet të cilat ai i ka personalisht.

Cedenti është i detyruar t'i dorëzojë cesionarit fletobligacionet ose dokumentet e tjera, me të cilat mund të provohet ekzistimi i kërkesës së kaluar. Në qoftë se kalimi i kërkesës është bërë me shpërblim, cedenti është përgjegjës ndaj cesionarit edhe për ekzistimin e kërkesës në momentin e bërjes së kalimit.

Cedenti përgjigjet për pagueshmërinë e kërkesës së bartur në qoftë se ka qenë e kontraktuar me cesuesin - kreditorin e ri, por vetëm deri në lartësi të shumës të cilën e ka marrë nga cesionari, si dhe për pagueshmërinë e kamatës, shpenzimeve lidhur me kalimin dhe shpenzimet e procedurës ndaj debitorit.

Rastet e veçanta të bartjes së kërkesës ekziston kur kreditori i vjetër nuk e ka njoftuar debitorin për kalimin që është bërë dhe në atë rast debitori është i detyruar që detyrimin t'ia përmbushë kreditorit të vjetër ndërsa kreditori i vjetër t'ia kalojë të riut.

Kur debitori në vend të përmbushjes e kalon kërkesën e vet me lidhjen e kontratës së kalimit, detyrimi i debitorit shuhet deri në shumën e kaluar, por kur kërkesën e kalon vetëm me qëllim arkëtimi, detyrimi i tij shuhet përkatësisht zvogëlohet atëherë kur kreditori e bën arkëtimin e kërkesës së kaluar.

NDËRRIMI I DEBITORIT

Marrja e borxhit është kontratë e lidhur mes debitorit dhe personit të tretë, sipas së cilës personi i tretë, me pëlqimin e kreditorit, merr përsipër detyrimin e debitorit dhe bëhet vetë debitor në vend të debitorit të vjetër. Kjo mënyrë e ndërrimit të debitorit është rregulluar me dispozitat e neneve 430-437 të LMD. Përmbajtja e detyrimit, pas arritjes së marrëveshjes së marrjes së borxhit, mbetet e njëjtë. Debitori i ri ka të njëjtën pozitë që e ka pasur debitori i vjetër ndaj kreditorit. Ai mund t'i paraqesë të njëjtat prapësime ndaj kreditorit, të cilat rrjedhin nga veprimi juridik i lidhur mes kreditorit dhe debitorit të vjetër dhe prapësimet të cilat i ka vetë ndaj kreditorit. Në rast se në kohën kur kreditori ka dhënë pëlqimin në kontratën e lidhur mes debitorit të vjetër dhe debitorit të ri, debitori i ri ka qenë tepër i ngarkuar me borxhe dhe këtë kreditori nuk e ka ditur e as ka qenë i detyruar ta dijë, atëherë debitori i vjetër nuk lirohet nga borxhi, ndërsa kontrata e marrjes së borxhit konsiderohet si kontratë e hyrjes në borxh dhe debitori i ri ka të njëjtën pozitë që ka pasur debitori i vjetër.

Kur lidhet kontrata mes kreditorit dhe personit të tretë sipas së cilës personi i tretë detyrohet ta përmbushë detyrimin e debitorit ndaj tij, i treti hyn borxh krahas me debitorin. Në atë rast kemi të bëjmë me kontratë të hyrjes borxh.

Kontrata e marrjes përsipër të përmbushjes është kontratë e lidhur mes debitorit dhe personit të tretë, sipas së cilës personi i tretë detyrohet ndaj debitorit ta përmbushë detyrimin e tij ndaj kreditorit. Ai është përgjegjës ndaj debitorit, nëse nuk e përmbush detyrimin me kohë, por ai nuk e ka marrë përsipër borxhin e as nuk ka hyrë në borxh ndaj kreditorit.

LLOJET E CAKTUARA TË KONTRATAVE

1. KONTRATA E SHITJES

Kontrata e shitjes është ai lloj kontrate sipas së cilës një person (shitësi) detyrohet që personit tjetër (blerësit) t'ia kalojë pronësinë e sendit përkatësisht ndonjë të drejtë, ndërsa personi tjetër (blerësi) detyrohet që shitësit t'i paguajë çmimin e caktuar. Sipas LMD, me kontratë të shitjes shitësi detyrohet që sendin të cilin e shet t'ia dorëzojë blerësit, ashtu që blerësi të fitojë të drejtën e disponimit përkatësisht të pronësisë, ndërsa blerësi detyrohet që shitësit t'i paguajë çmimin (neni 438 i LMD). Shitësi i ndonjë të drejte detyrohet që blerësit t'ia kalojë të drejtën e shitur dhe kur ushtrimi i asaj të drejte kërkon dorëzimin e posedimit të sendit, detyrohet t'ia dorëzojë edhe posedimin e sendit.

Kontrata e shitjes ka këto karakteristika: është kontratë e dyanshme detyrimore, kontratë me shpërblim, komutative; është kontratë me emër, ngase është e rregulluar me ligj dhe në qarkullimin juridik ka emër të caktuar; është kontratë konsensuale, ngase lidhet thjesht me arritjen e pëlqimit të vullnetit të palëve, me përjashtim të kontratës së shitjes së paluajtshmërisë për lidhjen e së cilës kërkohet forma me shkrim dhe legalizimi i nënshkrimit të palëve kontraktuese.

Për lidhjen e kontratës së vlefshme të shitjes duhet të plotësohen kushtet e përgjithshme, për të cilat është bërë fjalë më pjesën e përgjithshme dhe kushtet e veçanta, të cilat kanë të bëjnë me elementet thelbësore të kësaj kontrate, që janë sendi dhe çmimi.

- a) *Sendi është element thelbësor i kontratës, pa të cilin kontrata nuk mund të ekzistojë. Ai, sipas dispozitës së nenit 34 par. 2 të LMD, mund të jetë çdo send dhe e drejtë që është në qarkullim juridik, përveç sendit i cili, sipas ligjit, është jashtë qarkullimit. Sendi, si element i kësaj kontrate, mund të jetë edhe send i mëvonshëm. E drejta mund të jetë element i kësaj kontrate, në qoftë se është vetëm e drejtë e kalueshme pasurore (e drejta e pronësisë, e uzusfruktit, e autorit etj).*
- b) *Çmimi është shuma e të hollave, të cilën blerësi është i detyruar t'ia paguajë shitësit, si kundërvlerë për sendin ose të drejtën të cilën e ka blerë nga shitësit. Çmimi duhet të jetë i caktuar apo i caktueshëm.*

Detyrimet e shitësit janë:

- ta ruaj sendin me kujdes të shtëpiakut të mirë derisa t'ia dorëzojë blerësit;
- t'ia dorëzojë blerësit në kohën dhe vendin e caktuar me kontratë.

Dorëzimi i sendeve të luajshme bëhet me dorëzimin e thjeshtë fizik të sendit (traditio) (dorëzimi i një lavatriçeje); dorëzimi simbolik (traditio brevi manu) (dorëzimi i çelësit të banesës, automjetit etj); kur sendin e ka në posedim sipas kontratës së qirasë, por më vonë, sipas kontratës së shitjes, e blen dhe vazhdon ta mbajë dhe ekziston dorëzimi constitutum possessorium, kur pronari e tjetëron sendin, por vazhdon ta mbajë sipas bazës së qirasë.

Në qoftë se kontrata e shitjes përfshin edhe transportin e sendit - mallit, dorëzimi i bëhet transportuesit të parë të blerësit ose personit që organizon transportin. Kur me kontratë nuk është caktuar vendi i dorëzimit të sendit, sipas LMD, ai dorëzohet në vendin në të cilin në kohën e lidhjes së kontratës shitësi e ka pasur vendbanimin e në mungesë të vendbanimit, vendqëndrimin e tij, por në qoftë se shitësi e ka lidhur kontratën në kuadër të ushtrimit të veprimtarisë së rregullt ekonomike, dorëzimi bëhet në vendin ku gjendet selia e tij. Në qoftë se në momentin e lidhjes së kontratës, kontraktuesi ka pasur dijeni për vendndodhjen e sendit, përkatësisht ku duhet të prodhohet, dorëzimi bëhet në atë vend (neni 454 par. 1 dhe 2 të LMD).

Dorëzimi faktik i sendit të paluajshëm bëhet në vendin ku ndodhet sendi, ndërsa dorëzimi juridik bëhet me regjistrimin e sendit në librat publikë të tokës.

Dorëzimi i sendit bëhet në kohën e caktuar me kontratë, përveç në rastin kur data e dorëzimit nuk është caktuar: Shitësi është i detyruar t'ia dorëzojë blerësit sendin brenda afatit të arsyeshëm pas lidhjes së kontratës, duke pasur parasysh natyrën e sendit dhe rrethanat e tjera. Nëse natyra e detyrimit ose rrethanat e tjera nuk kërkojnë ndonjë afat të caktuar për dorëzimin e sendit, shitësi mund të kërkojë dorëzimin e menjëhershëm të sendit.

Shitësi është i detyruar t'ia dorëzojë blerësit sendin individualisht të përcaktuar ose të përcaktuar sipas llojit të caktuar, sipas kontratës, në atë gjendje në të cilën ka qenë në momentin e lidhjes së kontratës.

Rrezikun e zhdukjes ose të dëmtimit të rastësishëm të sendit e mban shitësi dhe, në rast të zhdukjes apo dëmtimit të sendit individualisht të përcaktuar, për pasojë të rrethanave për të cilat palët nuk janë përgjegjëse, kontrata shuhet, ndërsa kur është fjala për zhdukjen apo dëmtimin e sendeve të përcaktuara sipas llojit, shitësi është i detyruar t'ia dorëzojë blerësit sendin tjetër. Refuzimi i dorëzimit të sendit mund të bëhet në rast se është caktuar përmbushja e një çastshme e detyrimeve - dorëzimi i sendit dhe pagesa e çmimit njëkohësisht.

- Shitësi është i detyruar ta mbrojë blerësin nga të metat fizike dhe juridike të sendit. Për këtë më gjerësisht u shpjegua në pjesën që ka të bëjë me përgjegjësin për të metat materiale dhe juridike të përmbushjes (neni 461 të LMD).
- Shitësi është i detyruar ta pranojë çmimin e shitblerjes në mënyrën, kohën dhe vendin e parashikuar me kontratë. Nëse pa arsye refuzon pranimin e çmimit, shitësi

bie në vonesë dhe blerësi çmimin mund ta depozitojë në gjykatë dhe t'i shfrytëzojë autorizimet e veta ligjore, të cilat rezultojnë nga cenimi i detyrimit kontraktor, siç janë kalimi i rrezikut të zhdukjes ose dëmtimit të rastësishëm të sendit, ecja e kamatës etj.

Detyrimet e blerësit janë :

- pagimi i çmimit në kohën dhe vendin e caktuar me kontratë. Në qoftë se me kontratë nuk është caktuar koha dhe vendi dhe nuk ekziston ndonjë mënyrë e caktuar sipas dokeve të tjera, pagesa bëhet në momentin dhe vendin në të cilin dorëzohet sendi. Në qoftë se blerësi nuk e përmbush detyrimin në kohën dhe vendin e parashikua sipas këtyre rregullave, ai bie në vonesë dhe i mban pasojat që rrjedhin nga vonesa e tij.
- Blerësi është i detyruar ta marrë sendin nga shitësi në kohën dhe vendin e caktuar sipas kontratës. Në rast të refuzimit pa arsye të pranimit të sendit, ai bie në vonesë dhe për këtë arsye rreziku i zhdukjes së sendit kalon tek ai.

RASTET E VEÇANTA TË KONTRATËS PËR SHITJE

Shitja me të drejtën e parablerjes

Sipas kontratës së shitjes me të drejtën e parablerjes, shitësi e rezervon për vete të drejtën që në rast se blerësi vendos ta tjetërsojë sendin, së pari t'ia ofrojë shitjen atij. Sipas kësaj kontrate, blerësi është i detyruar ta njoftojë shitësin për qëllimin shitjes së sendit një personi të caktuar, për kushtet e shitjes dhe t'ia ofrojë atij për ta blerë sendin me të njëjtin çmim (neni 510 i LMD). Palët me kontratë mund të caktojë një afat brenda të cilit shitësi është i detyruar të deklarohet nëse do ose jo ta shfrytëzojë të drejtën e parablerjes. Nëse kjo nuk është caktuar me kontratë, atëherë vlen afati prej 30 dite nga dita kur shitësi e ka njoftuar për qëllimin e shitjes së sendit një personi tjetër. Shitësi që deklaron se do ta blejë sendin, është i detyruar që njëkohësisht ta paguajë çmimin e ofruar personit tjetër ose ta depozitojë atë në gjykatë dhe nëse personit tjetër iu ka caktuar afati për pagesën e çmimit, ai mund ta shfrytëzojë këtë afat, po qe se ofron sigurim të mjaftueshëm. Në qoftë se blerësi e tjetërson sendin pa e njoftuar shitësin ose nuk e ka njoftuar saktësisht atë për kushtet e shitjes dhe nëse tjetri ka pasur dijeni ose nuk ka qenë i detyruar të dijë për të drejtën e parablerjes, përkatësisht për njoftimin e pasaktë të shitjes, shitësi ka të drejtë që brenda afatit prej 6 muajve, nga dita kur ka marrë dijeni për kalimin e së drejtës së sendit, përkatësisht për kushtet e sakta të kontratës, të kërkojë anulimin e kontratës së shitjes që i është bërë një personi të caktuar dhe kalimin e pronësisë së sendit mbi shitësin në kushte të njëjta. E drejta e parablerjes shuhet pesë vjet pas lidhjes së kontratës, nëse me kontratë nuk është parashikuar ndonjë afat më i shkurtër. E drejta e parablerjes është e drejtë personale, e cila nuk mund të tjetërsohet dhe as të trashëgohet.

E drejta ligjore e parablerjes mund të jetë e parashikuar me ligj. Sipas kësaj të drejte, një person është i autorizuar të kërkojë nga personi tjetër që dëshiron ta shesë një send që atij t'i ofrojë shitjen e atij sendi. Rregullat e shitjes me të drejtë parablerjeje zbatohen përshtatshmërisht edhe tek e drejta ligjore e parablerjes.

E drejta e parablerjes është caktuar me ligje të veçanta. Ajo ekziston në këto raste: a) e drejta e parablerjes e bashkëpronarëve të sendeve (tokës, objektit ndërtimor, banesës), kur secili bashkëpronar ka pjesën alikuote dhe çdonjëri ka të drejtën e parablerjes; b) e drejta e parablerjes së materialit arkivor, monumenteve historike (e drejta e Kuvendit Komunal për të blerë material arkivor dhe monumente historike); e drejta e parablerjes së tokës ndërtimore, ndërtesave (e drejta e Kuvendit Komunal); c) e drejta e parablerjes së tokës bujqësore (e drejta e kooperativës bujqësore); d) e drejta e parablerjes së pyllit (e drejta e ekonomisë së pyjeve); e) e drejta e parablerjes së tokës bujqësore në dobi të kooperativës bujqësore, përkatësisht të pronarit kufitar të tokës bujqësore.

Përveç këtyre llojeve të kontratës së shitjes, ekzistojnë edhe këto lloje të tjera : kontrata e shitjes me provë (blerja me provë); shitja sipas modelit apo mostrës; shitja me specifikim; shitja me kushte; shitja me pagim të çmimit me këste; shitja me anë të akreditivit; urdhri i shitjes.

Kontrata për këmbimin (Permutatio)

Kontrata për këmbimin është një kontratë e dyanshme detyruese, sipas së cilës secili kontraktues detyrohet ndaj bashkëkontraktuesit të vet ta dorëzojë sendin që këmbehet, kështu që ai të fitojë të drejtën e pronësisë.

Kjo kontratë është një ndër kontratat më të vjetra. Është shfaqur në kohën kur ka ekzistuar ekonomia e pazhvilluar. Në qarkullimin e mallrave nuk ka ekzistuar ndonjë send që të ketë shërbyer si mjet i ligjshëm i pagesës, ashtu që qarkullimi i sendeve është dashur të bëhet me shkëmbimin e sendit për send.

Kjo kontratë edhe tani e ka rëndësinë e vet në qarkullimin e mallrave. Është e rregulluar me ligj (nenet 534 dhe 535 të LMD). Si palë kontraktuese paraqiten si personat fizikë, ashtu edhe personat juridikë. Tani shkëmbimi është i zakonshëm në rastin e arondacionit dhe shpronësimit të tokës kur mund të bëhet shkëmbimi i tokës për tokë, shkëmbimi i së drejtës së sendit të luajtshëm për një send të luajtshëm ose shkëmbimi i të drejtave të cilat janë në qarkullimin juridik.

Për lidhjen e kësaj kontrate është e nevojshme të plotësohen kushtet e përgjithshme për lidhjen e kontratës.

Nga kontrata e shkëmbimit për secilin bashkëkontraktues krijohen të drejta dhe detyrime si ato që krijohen te kontrata e shitjes për shitësin dhe blerësin.

Kontrata për huan (Mutum)

Sipas kontratës për huan, një person (i cili quhet huadhënës) detyrohet që një personi tjetër (i cili quhet huamarrës) t'ia dorëzojë një shumë të caktuar të hollash ose një masë të caktuar sendesh të zëvendësueshme, kurse huamarrësi detyrohet që, pas skadimit të afatit të caktuar, ta kthejë shumën e njëjtë të hollave përkatësisht masën e njëjtë të sendeve me cilësi dhe të llojit të njëjtë.

Kontrata e huas është me detyrime të dyanshme. Është kontratë me emër, ngase është e rregulluar me ligj (neni 567 - 576 të LMD). Për sajimin e kësaj kontrate, përveç kushteve të përgjithshme që kërkohen për lidhjen e çdo kontrate, duhet të plotësohen këto kushte: të jetë arritur pëlqimi lidhur me objektin e huas, me kohën e kthimit dhe me shpërblimin (nëse kontrata lidhet me shpërblim) dhe të bëhet individualizimi i objektit (të caktohet shuma e të hollave ose e sendeve të zëvendësueshme).

Detyrimet e huadhënësit:

- huadhënësi është i detyruar t'ia dorëzojë huamarrësit shumën e të hollave ose sendeve në kohën e caktuar me kontratë, por nëse koha nuk është kontraktuar, atëherë kjo bëhet sipas kërkesës së huamarrësit. Mirëpo, huadhënësi mund ta refuzojë dorëzimin e objektit të huas, në qoftë se gjendja materiale e huamarrësit është e tillë që nuk është e sigurt nëse ky do të mund ta kthejë huan ose jo, ndërsa për këtë huadhënësi në momentin e lidhjes së kontratës nuk ka pasur dijeni ose gjendja materiale e huamarrësit është keqësuar pas lidhjes së kontratës. Huadhënësi është i detyruar ta përmbushë detyrimin e vet vetëm po qe se huamarrësi ose dikush tjetër për të jep sigurim të mjaftueshëm se huaja do të kthehet;
- huadhënësi është i detyruar ta mbrojë huamarrësin për të metat materiale të sendeve, të cilat janë objekt i kontratës dhe
- huamarrësit t'ia shpërblejë dëmin e shkaktuar për pasojë të metave materiale të sendeve. Mirëpo, në rast se huaja ka qenë pa shpërblim, huadhënësi është përgjegjës për shpërblimin e dëmit, po qe se ka qenë me keqbesim, domethënë, kur ka pasur dijeni ose nuk ka mundur të mos kishte dijeni për faktin që ka të bëjë me të metat e sendit, për të cilat nuk e ka njoftuar huamarrësin.

Detyrimet e huamarrësit janë:

- huamarrësi është i detyruar që, brenda afatit të caktuar me kontratë, t'ia kthejë huadhënësit të njëjtën sasi dhe cilësi të sendit dhe në qoftë se nuk është caktuar afati i kthimit, është i detyruar ta kthejë objektin e huas brenda afatit të arsyeshëm, i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se dy muaj, nga dita kur huadhënësi ka kërkuar t'ia kthehet huaja. Në qoftë se borxhi është dhënë në formë sendesh të zëvendësueshme e huamarrësi nuk është në gjendje të kthejë sasinë dhe cilësinë e njëjtë të sendeve, ky është i detyruar që huadhënësit t'i paguajë shumën e të hollave, e cila i përgjigjet vlerës së sendeve që kanë në kohën e kthimit në vendin e caktuar me kontratë për kthimin e sendit. Huamarrësi mund ta kthejë borxhin edhe para afatit të caktuar, por është i detyruar që për këtë ta njoftojë me kohë huadhënësin dhe t'ia shpërblejë dëmin.

Në praktikë lidhen disa lloje të kontratave për huan: huaja e destinuar (kur me kontratë është caktuar qëllimi i përdorimit të hollave të marra hua); huaja investive e lidhur mes bankës dhe huamarrësve (ndërmarrjet, zeztarët, prodhuesit bujqësorë individualë); huaja e emisionit krijohet kur huadhënësi që ka shpallur huan ka lëshuar fletobligacionet për huan e dhënë; kontratë për huan me anuitete lidhet kur huaja kthehet në anuitete të caktuara; kontrata për kontratën e huas së lombardit lidhet atëherë kur huaja merret në atë mënyrë që, për sigurimin e kthimit të borxhit, jepen peng letra me vlerë, metale të çmueshme dhe sende tjera.

KONTRATA E QIRASË (LOKATIO CONDUKTIO OPERUM)

Sipas kontratës së qirasë, një person (qiradhënësi) detyrohet t'ia dorëzojë sendin e caktuar personit tjetër (qiramarrësit) për përdorim, ndërsa ky person (qiramarrësi) t'i paguajë për të një shpërblim të caktuar dhe të njëjtin send t'ia kthejë pas skadimit të afatit të caktuar.

Kjo kontratë ka këto karakteristika: është kontratë me emër, ngase është e rregulluar me ligj (neni 585- 614 të LMD); me detyrime të dyanshme; me shpërblim; konsensuale; me prestime të vazhdueshme; formale në raste të caktuara me ligj (qiraja e lokalit afarist, e shtëpisë); kauzale dhe e pavarur.

Kushtet për lidhjen e kësaj kontrate janë kushte të përgjithshme, të cilat janë të domosdoshme për lidhjen e të gjitha kontratave të tjera detyrimore dhe kushtet e veçanta që janë: objekti i kontratës së qirasë - sendi që është i pakonsumueshëm; qiraja - e cila mund të caktohet në të holla apo në natyrë dhe kohëzgjatja e qirasë - e cila mund të jetë e caktuar dhe e pacaktuar.

Detyrimet e qiradhënësit janë: a) t'ia dorëzojë qiramarrësit sendin në gjendje të caktuar me kontratë dhe, nëse kjo nuk është caktuar me kontratë, në gjendje që të mund të përdoret për qëllimin për të cilin është lidhur kontrata; b) ta mbrojë qiramarrësin lidhur me të metat materiale dhe juridike të sendit; c) ta mirëmbajë sendin në gjendje të rregullt dhe t'i paguajë të gjitha detyrimet lidhur me sendin, përveç riparimeve të imta të cilat vijnë si pasojë e përdorimit të rëndomtë të sendit gjatë kohëzgjatjes së kontratës.

Detyrimet e qiramarrësit janë: a) ta marrë sendin dhe ta përdorë me kujdesin e shtëpiakut përkatësisht të ekonomistit të mirë, ashtu siç është caktuar me kontratë ose sipas destinimit të sendit; b) të paguajë qiranë brenda afatit dhe shumën e caktuar me kontratë ose ligj dhe, në mungesë të marrëveshjes ose ligjit, ashtu siç është e zakonshme në vendin ku sendi i është dorëzuar qiramarrësit. Në qoftë se nuk është kontraktuar ndryshe e as nuk ekzistojnë doke të mira në vendin e dorëzimit të sendit, qiramarrësit i paguhet qiraja në çdo gjysëmvetor, kur sendi është dhënë me qira në kohëzgjatje më shumë se një vit dhe, kur qiraja zgjatë më pak, pas skadimit të atij afati. c) ta ruajë sendin gjatë kohëzgjatjes së kontratës dhe ta përdorë atë sipas destinimit të sendit dhe ç) pas shuarjes së qirasë, ta kthejë sendin të padëmtuar në vendin ku iu ka dorëzuar.

Kontrata e qirasë shuhet: a) pas skadimit të afatit, po qe se kontrata është lidhur për një afat të caktuar, përveç kur qiramarrësi vazhdon ta shfrytëzojë sendin, ndërsa qiradhënësi nuk kundërshton, kur konsiderohet se është lidhur kontratë e re për një afat të pacaktuar; b) me denoncim, kur kontrata është lidhur në kohë të pacaktuar dhe, për pasojë të rrethanave të rastit ose dokeve të vendit, nuk mund të caktohet afati. Secila palë mund ta denoncojë kontratën, duke respektuar afatin e denoncimit, të caktuar me kontratë dhe me ligj, e në mungesë të marrëveshjes ose ligjit, afati i denoncimit është 8 ditë; c) në rast të zhdukjes së sendit për shkak të forcës madhore.

NËNQIRAJA

Kontrata e nënqirasë është e rregulluar me dispozitat e neneve 603 – 605 të LMD. Është një kontratë e veçantë e qirasë, sipas së cilës një person që ka cilësinë e qiramarrësit detyrohet që sendin e marrë me qira t'ia dorëzojë për përdorim dhe shfrytëzim (nënqira) personit tjetër, i cili quhet nënqiramarrës në përdorim, ndërsa ky detyrohet që për të t'ia paguajë një shpërblim të caktuar.

Kontrata e qirasë ka efekt juridik inter partes. Nga kjo rregull ekziston përjashtimi, kur qiramarrësi sendin e marrë me qira ia jep me qira tjetrit vetëm në qoftë se me të nuk i shkaktohet dëm qiradhënësit dhe me kusht që qiramarrësi të garantojë se nënqiramarrësi do ta përdorë sendin sipas kontratës së qirasë.

Kontrata e nënqirasë mund të lidhet pa lejen e qiradhënësit, përveç kur ekziston ndonjë rast i arsyeshëm që kërkon pëlqimin e tij, për shkak të cilit mund ta refuzojë dhënien e lejes. Në qoftë se sendi i marrë me qira është dhënë me gjithë mungesën e lejes së qiradhënësit, ndërsa sigurimi i një lejeje të tillë ka qenë i parashikuar me kontratë ose ligj, qiradhënësi mund të kërkojë denoncimin e kontratës së qirasë.

Në mes të qiradhënësit dhe nënqiramarrësit nuk krijohet marrëdhënie e drejtpërdrejtë, mirëpo, qiradhënësi, për realizimin e kërkesave të veta nga qiramarrësi, të krijuara nga qiraja, mund të kërkojë drejtpërdrejt nga nënqiramarrësi arkëtimin e shumës të cilën ky i ka borxh qiramarrësit sipas bazës së nënqirasë.

Kontrata e nënqirasë shuhet në çdo rast kur shuhet kontrata e qirasë.

TJETËRSIMI I SENDIT TË MARRË ME QIRA

Kontrata e qirasë mund të shuhet edhe me tjetërsim të sendit, i cili është objekt dorëzimi në përdorim të qiramarrësit. Në rast tjetërsimi të sendit i cili më parë është dhënë me qira, në vend të qiradhënësit vjen fituesi i sendit dhe, pas kësaj, krijohen të drejta dhe detyrime të qirasë mes fituesit dhe qiramarrësit. Shuarja e kësaj kontrate është e rregulluar me dispozitën e nenit 606 të LMD, ashtu që, kur sendi për të cilin është lidhur kontrata e qirasë i është dorëzuar ndonjë tjetrit me qira, fituesi i sendit paraqitet në vend të qiradhënësit dhe merr përsipër detyrimet e tij ndaj qiramarrësit, po qe se në momentin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit ka pasur dijeni për ekzistimin e kontratës së qirasë. Fituesi i sendit nuk mund të kërkojë nga qiramarrësi kthimin e sendit para skadimit të afatit të caktuar me kontratë, por në qoftë se afati nuk është caktuar me kontratë ose me ligj, kjo ndodh para skadimit të afatit denoncues. Në qoftë se fituesi i sendit në momentin e lidhjes së kontratës së tjetërsimit nuk ka pasur dijeni për ekzistimin e kontratës së qirasë, ai nuk është i detyruar t'ia dorëzojë sendin qiramarrësit. Në një rast të tillë kontrata e qirasë shuhet dhe qiramarrësit i mbetet mundësia që nga qiradhënësi të kërkojë shpërblimin e dëmit.

Kur për shkak të tjetërsimit të sendit të dhënë me qira të drejtat dhe detyrimet kalojnë te fituesi i sendit, qiradhënësi mund ta denoncojë kontratën e qirasë, duke respektuar afatet e parashikuara me kontratë dhe ligj.

KONTRATA E DEPOZITËS (DEPOSITUM)

Kontrata e depozitës është një kontratë e tillë, sipas së cilës një person (depozitarrësi) detyrohet ta pranojë sendin nga personi tjetër (depozituesi), ta ruajë dhe ta kthejë atë kur ky ta ketë kërkuar një gjë të tillë.

Kjo kontratë është me emër, ngase është e rregulluar me dispozitat e neneve 726 - 743 të LMD. Kjo kontratë është konsensuale, e dyanshme detyruese, kontratë bamirëse ose me shpërblim dhe kontratë e vazhdueshme.

- Detyrimet e depozitarrësit janë: a) ta ruajë sendin, në rast se depozita është pa shpërblim, sikurse sendin e vet, ndërsa në rast se depozita është me shpërblim, me kujdesin e shtëpiakut të mirë, përkatësisht ekonomistit të mirë; b) ta kthejë sendin me të gjitha frytet pas skadimit të afatit të kontraktuar, kurse para skadimit të afatit - sapo ta kërkojë depozituesi, përveç nëse afati i kthimit nuk është kontraktuar ekskluzivisht në dobi të depozituesit dhe c) depozituesit t'ia shpërblejë dëmin për shkak dëmtimit eventual të sendit gjatë kohëzgjatjes së depozitës.
- Detyrimet e depozituesit janë: a) t'ia paguajë depozitarrësit shpenzimet e arsyeshme të bëra lidhur me ruajtjen e sendit; b) t'ia shpërblejë dëmin e pësuar gjatë ruajtjes së sendit dhe c) t'ia paguajë shpërblimin për ruajtjen e sendit (po qe se kontrata është me shpërblim).

Ligji parashikon lloje të veçanta të depozitës: a) depozita jo e rregullt (në rastin kur në depozitë janë dhënë sendet e zëvendësueshme me të drejtën që depozitarrësi t'i shpenzojë ato dhe me detyrimin që t'i kthejë sendet në të njëjtën sasi dhe me të njëjtën cilësi, në të cilin rast në marrëdhëniet e palëve zbatohen rregullat e kontratës së huas, përveç kohës dhe vendit të kthimit të sendeve, kur zbatohen rregullat e kontratës së depozitës; b) depozita e domosdoshme (kur sendi i besohet depozitarrësit në rast të ndonjë nevoje të domosdoshme - në rast zjarri, tërmeti, përmbytjesh, kur depozitarrësi është i detyruar ta pranojë sendin për ruajtje dhe ta ruajë atë me kujdes të shtuar - të shtëpiakut përkatësisht ekonomistit të mirë dhe c) depozita hoteliere, sipas së cilës hotelieri konsiderohet si depozitarrës lidhur me sendet që i sjellin mysafirët dhe përgjigjet për humbjen ose dëmtimin e tyre në masën e vlerës së sendit të dëmtuar por jo më tepër se deri në shumën prej pesëmijë (5.000,00) Euro përveç në rastin kur ekzistojnë rrethanat që përjashtojnë përgjegjësinë e depozitarrësit (neni 738 i LMD). Hotelieri është i detyruar ta shpërblejë dëmin e tërë, nëse mysafiri ia ka dhënë sendin për ruajtje dhe dëmi është shkaktuar për fajin e tij apo të personelit për të cilin përgjigjet – 738 par. 3 i LMD. Hotelieri është i detyruar ta pranojë sendin të cilin mysafiri e sjell, përveç kur për këtë nuk posedon kushte të përshtatshme hapësinore ose ruajtja e sendeve tejkalon mundësit e hotelierit.

Në teori dhe praktikë ekzistojnë edhe këto lloje të depozitave: depozita e përbashkët - kur disa persona depozitojnë për ruajtje një sasi të sendeve të zëvendësueshme; depozita gjyqësore kur ruhen sendet e sekuestruara sipas urdhrit të gjykatës; depozitat e mbyllura kur dorëzohen për ruajtje sendet e mbyllura në zarf ose ambalazh të vulosur.

KONTRATA E PENGUT

Kontrata e pengut është kontratë e tillë, sipas së cilës një person (pengdhënësi), debitori ose ndonjë person i tretë i dorëzon personit tjetër (pengmarrësit) një send të luajtshëm ose i kalon ndonjë të drejtë (interes pasuror), në të cilën ekziston e drejta e pronësisë, me qëllim që para kreditorëve të tjerë të mund të arkëtojnë nga vlera e tij, në qoftë se kërkesa nuk do t'i jetë paguar pas arritjes.

Kontrata e pengut është kontratë me emër, ngase është e rregulluar me dispozitat e Ligjit për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore (LPDTS nenet 136 - 148). Më parë kjo lëmi rregullohej me dispozitat e LMD e cila ishte në fuqi në atë kohë (nenet 966 – 996) dhe me Rregulloren e Pengut të UNMIK-ut nr. 2001/5 e cila ka hyrë në fuqi më 7 shkurt 2001 por me hyrjen në fuqi të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës më këto dispozita ligjore nuk aplikohen nga se me dispozitën e nenit 1058 të LMD është paraparë se dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta zyrtare e RSFJ-së, nr. 29/78, 39/85 dhe 57/89) pushojnë së ekzistuari. Në këtë dispozitë janë paraparë edhe përjashtimet nga kjo rregull por këto nuk kanë të bëjnë me pengun. Në këtë vend është me rëndësi të theksohet edhe përmbajtja e dispozitës së nenit 1057 i LMD e cila parasheh këtë: “Dispozitat e këtij ligji nuk zbatohen në marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para hyrjes në fuqi të këtij ligji”. Pra në marrëdhëniet e detyrimeve të palëve të cilat janë krijuar pas datës 16 dhjetor 2012 pra gjashtë muaj pas

publikimit të Ligjit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës²⁰ aplikohen dispozitat e LMD ndërsa për raportet e krijuara para kësaj date vlejné dispozitat e theksuara më lartë.

Pengu është mjet real i sigurimit të përmbushjes së kontratës. Palët kontraktuese mund të jenë çdo person fizik dhe juridik. Nga kontrata e pengut krijohet detyrimi juridik i pengut mes kreditorit dhe debitorit.

Në të drejtën kontraktore të pengut, pengdhënës është personi që i jep pengmarrësit të drejtën e pengut mbi sendin ose të drejtën që është objekt i kontratës, ndërsa pengmarrës është personi në favor të cilit jepet pengu, i cili ka kërkesë sipas kontratës juridike detyrimore.

Objekt kontrate mund të jetë çdo pasuri e luajtshme ose e drejtë (interes pasuror), e cila është në pronësi të dhënësit të sendit peng që, sipas ligjit, mund të jetë në qarkullim. Pasuritë nëntokësore dhe hidrokarburet si dhe të drejtat në to mund të lihen peng në përputhje me dispozitat ligjore për bartjen dhe për të drejtën në ngarkim me pasuritë nëntokësore dhe hidrokarburet apo të drejtat e tilla. Sendi që është në bashkëpronësi mund të lihet peng vetëm në qoftë se të gjithë bashkëpronarët ose pronarët e përbashkët e japin pëlqimin për këtë. Një person që është pronar i një pjese të një pasurie të luajtshme mund ta lë peng atë interes edhe pa pëlqimin e pronarëve të pjesëve të tjera të pasurisë (neni 139 par. 3 i LPDTS).

Ligji dallon këto lloje të pengut: a) pengu posedimor është ai lloj pengu sipas të cilit pengmarrësi merr në posedim sendin i cili është lënë peng dhe e mban deri në shuarjen e pengut sipas ndonjë baze të caktuar ligjore; b) pengu standard është ai lloj pengu sipas të cilit sendi i lënë peng ngelë në posedim të pengdhënësit edhe pas lidhjes së kontratës së pengut dhe pengdhënësi është i autorizuar ta shfrytëzojë atë sipas destinimit tij të caktuar; c) pengu ligjor.

Pengu standard mund të krijohet: a) kur ekziston një marrëveshje e vlefshme e pengut; b) kur pengmarrësi ka dhënë disa vlera ose, në fakt, i ka dhënë para pengdhënësit; c) kur pengdhënësi ka të drejtë mbi pasurinë e dhënë peng dhe ç) kur në rastin e pengut posedimor, sendi i lënë peng është në posedim të pengmarrësit.

Supozohet se pengu nuk është posedimor, përveç kur palët kontraktuese të pengut shprehimisht kanë parashikuar që pengu të jetë posedimor, përndryshe, pengdhënësi ruan të drejtën ta posedojë, ta përdorë dhe në çdo mënyrë tjetër t'i gëzojë të gjitha të drejtat mbi sendin e lënë peng (neni 134 par. 1 i LPDTS). Pengu posedimor krijohet, vendoset dhe perfeksionohet në kohën kur pengdhënësi dhe pengmarrësi nënshkruajnë marrëveshjen e pengut dhe sendi i lënë peng është në posedim të pengmarrësit ose të autorizuarit të tij (neni 134 par. 2 i LPDTS).

Kontrata e pengut është një kontratë aksesore, ngase vlefshmëria juridike e saj varet nga fakti nëse detyrimi i siguruar për të cilin jepet pengu është i vlefshëm dhe i ekzekutueshëm.

Që të jetë një kontrata e pengut e vlefshme, duhet të jenë plotësuar, përveç kushteve të përgjithshme që nevojiten për lidhjen të gjitha kontratave të tjera detyrimore, edhe

20 LMD është publikuar në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës nr. 16 të dt. 19 qershor 2012,

këto kushte të veçanta: a) kontrata duhet të jetë e hartuar me shkrim; b) të jetë i përshkruar detyrimi i cili duhet të sigurohet; c) të jetë përshkruar sendi i cili është lënë peng ç) të jenë shënuar të dhënat se qëllimi i kontratës është caktimi i një pengu për pengmarrësin; d) të përmbajë nënshkrimet e palëve kontraktuese ose të autorizuarve të tyre dhe dh) të përmbajë datën e lidhjes së kontratës. Si datë e lidhjes së kontratës konsiderohet data kur palët ose të autorizuarit e tyre e kanë nënshkruar kontratën. Këto kushte konsiderohen si kushte thelbësore të kontratës së pengut dhe duhet të jenë plotësuar në mënyrë kumulative. Mungesa e njërit prej tyre ka për pasojë nulitetin e kontratës. Palët mund të parashikojnë me marrëveshje edhe kushte të tjera dhe ato t'i ndryshojnë më vonë, sipas vlerësimit të tyre.

Kontrata e pengut nuk i nënshtrohet detyrimit të noterizimit, përveç kur caktohet me marrëveshje të palëve kontraktuese.

Për të perfeksionuar një kontratë të pengut standard është e nevojshme të regjistrohet një deklaratë njoftimi, e cila regjistrohet në zyrën e regjistrimit të pengut dhe duhet të përmbajë të dhëna të nevojshme lidhur me: pengdhënësin, personin që është përgjegjës për detyrimin e siguruar (në qoftë se nuk është pengdhënësi) dhe pengmarrësin, identifikimin specifik ose të përgjithshëm të detyrimit të siguruar, shumën maksimale të borxhit, të siguruar e të shprehur në para, identifikimin specifik ose të përgjithshëm të sendit të lënë peng, nënshkrimin e pengdhënësit ose të autorizuarit të tij si dhe datën e lidhjes së kontratës së pengut. Personi i cili nënshkruan deklaratën në emër të pengdhënësit duhet të jetë i pavarur nga pengmarrësi.

Kohëzgjatja e regjistrimit është tri vjet, nga data e regjistrimit. Pas skadimit të këtij afati, pengu bëhet i pa perfeksionuar, përveç kur perfeksionohet me posedim.

Pengmarrësi mund të regjistrojë një njoftim vazhdimi brenda tre muajve, para skadimit të kohës së regjistrimit të deklaratës fillestare të njoftimit.

Shuarja e pengut.- Pengu shuhet në këto raste: kur pengmarrësi jep një deklaratë të nënshkruar nga ai, e cila përmban të dhëna se pengmarrësi nuk ka më kërkesa për pengun që përmban deklarata e njoftimit; sipas marrëveshjes së palëve kontraktuese; me përmbushjen e detyrimit të siguruar ose me shuarjen për ndonjë arsye tjetër; me shuarjen e sendit ose të drejtës së pengut apo ndonjë zëvendësimi të tyre; kur sendi i lënë peng ose e drejta e pengut ndryshohet ose inkorporohet me ndonjë send tjetër ose të drejtë tjetër e cila nuk ekziston në ndonjë formë të identifikueshme apo të ndashme; kur sendi ose e drejta e lënë peng bëhet pronë e pengmarrësit; kur në rastin e pengut posedimor, përfundon pronësia e pengmarrësi mbi sendin e lënë peng; kur kërkesa e siguruar me anë të së drejtës së pengut bartet, por kjo bartje nuk e përfshinë të drejtën e pengut dhe në kur një palë e tretë në mënyrë të vlefshme e fiton sendin ose të drejtën e pengut në pajtim me dispozitat e LPDTS.

Mospërmbushja dhe ekzekutimi.- Në rast të mospërmbushjes së detyrimit të siguruar me peng, pengmarrësi mund të marrë në posedim kolateralin nëpërmjet: a)

procedurës gjyqësore; b) nga vetë pengmarrësi, në qoftë se kjo mund të bëhet pa prishur qetësinë publike dhe c) administrativisht.

Në rast të mospërbushjes, pengmarrësi mund ta shesë, ta japë me qira ose ta tjetërsojë sendin e lënë peng në një mënyrë tjetër dhe nga të ardhurat e realizuara në atë mënyrë të arkëtojë kërkesën e siguruar me peng si dhe shpenzimet, të cilat shkaktohen lidhur me të. Shitja e sendit të lënë peng mund të bëhet me ankand publik ose me shitje të drejtpërdrejtë. Metoda, koha, vendi dhe kushtet e shitjes duhet të jenë në frymën e kushteve të arsyeshme tregtare. Për kushtet dhe kohën e shitjes së kolateralit duhet të njoftohet pengdhënësi të paktën 14 ditë para shitjes së sendit.

Pengmarrësi nuk mund të blejë kolateralin, përveç kur shitja bëhet publike ose private, në qoftë se sendi i lënë peng shitet në një treg të njohur ose për kolateralin ekzistojnë çmime të njohura standarde. Pengdhënësi, personi përgjegjës për detyrimin e siguruar ose çdo garantues tjetër a borxhli i dytë mund të fitojë sendin e lënë peng, duke përmbushur të gjitha detyrimet e siguruara nga sendi i lënë peng, si dhe shpenzimet e arsyeshme të bëra nga pengmarrësi lidhur me marrjen e sendit të lënë peng në posedim, shpenzimet lidhur me shitjen e sendit të lënë peng dhe shpenzimet e tjera të shkaktuara në procedurat e përbarimit gjyqësor përkatësisht administrativ.

KONTRATA PËR DORËZANINË

Kontrata e dorëzaniës është kontratë e tillë, sipas së cilës dorëzani obligohet t'i përmbushë kreditorit detyrimin e plotfuqishëm të debitorit, në qoftë se ky nuk e bën këtë (neni 1009 i LMD). Kontrata e dorëzaniës është një mjet personal i sigurimit të përmbushjes së kontratës. Kjo kontratë është kontratë formale, ngase deklarata e dorëzaniës ka efekt juridik vetëm nëse është bërë në formën me shkrim. Kontrata e dorëzaniës është kontratë aksesore, ngase është e lidhur me kontratën kryesore si në pikëpamje të lindjes, ashtu edhe të shuarjes së kontratës si dhe vlefshmërisë juridike të saj. Detyrimi i dorëzaniës nuk mund të jetë më i madh se detyrimi i debitorit dhe nuk mund të transferohet pa kalimin e detyrimit kryesor.

Objekt detyrimi mund të jetë çdo detyrim juridikisht i vlefshëm, pa marrë parasysh përmbajtjen e tij.

Dorëzania mund të jepet edhe për detyrimin e kushtëzuar dhe detyrimin e caktuar të ardhshëm.

Ligji dallon a) dorëzaniën e rëndomtë (dorëzania supsidiare), sipas së cilës kreditori mund të kërkojë nga dorëzani përmbushjen e detyrimit pasi më parë të ketë kërkuar nga debitori, i cili, me gjithë thirrjen me shkrim, nuk e ka përmbushur detyrimin brenda afatit të caktuar. Kreditori nuk është i detyruar që për realizimin e kërkesës së vet t'i drejtohet më parë debitorit: në qoftë se është e qartë se nga mjetet e debitorit nuk mund ta realizojë kërkesën ose debitori kryesor ka falimentuar dhe b) dorëzaniën solidare, në qoftë se dorëzani, i detyruar si dorëzanë pagues, i përgjigjet kreditorit si debitori kryesor për tërë detyrimin dhe kreditori mund të kërkojë përmbushjen e detyrimit qoftë nga debitori kryesor, qoftë nga dorëzani ose nga të dy në të njëjtën kohë; c) bashkëdorëzania ekziston kur shumë dorëzanë përgjigjen solidarisht, pa marrë parasysh

nëse i kanë garantuar kreditorit së bashku ose secili veç e veç, përveç kur detyrimi i tyre me kontratë është rregulluar ndryshe; ç) dorëzani i dorëzantit ekziston kur një person garanton pagesën e kërkesës së kreditorit, në qoftë se atë nuk e përmbushin as debitori kryesor, as dorëzani. Kreditori mund të kërkojë pagesën nga dorëzani i dorëzantit pasi që më parë pa sukses të ketë kërkuar këtë nga debitori kryesor dhe dorëzani. Nëse dorëzani i dorëzantit e përmbush detyrimin, ai ka të drejtën e regresit vetëm ndaj debitorit kryesor.

KONTRATA PËR DËRGIMIN - ASIGNACIONI (ASIGNATIO)

Asignacion do të thotë dërgim. Asignacioni në të drejtën pozitive të detyrimeve është rregulluar me dispozitat e neneve 1032 -1046 të LMD.

Asignatio është deklarim i vullnetit të një personi (dërguesit - asignantit), me të cilin e autorizon personin tjetër (ekzekutuesin e dërgimit - asignatin) që, për llogari të tij, t'i kryej diçka të caktuar personit të tretë, marrësit të asignacionit (asignatarit) dhe e autorizon këtë që të pranoj këtë kryerje në emër të vet.

Prezumimet për ekzistimin e asignacionit juridikisht të vlefshëm janë: marrëveshja paraprake mes dërguesit (asignantit) dhe shfrytëzuesit të dërgimit (asignatarit) dhe deklarata e ekzekutuesit - të dërguarit (asignatit) për pranimin e dërgimit. Me plotësimin e këtyre kushteve lind veprimi i tre anshëm juridik.

Me anë të asignacionit krijohen këto raporte juridike: a) raporti mes dërguesit (asignantit) dhe ekzekutuesit të dërgimit (asignatit); b) raporti mes dërguesit (asignantit) dhe shfrytëzuesit të dërgimit (asignatarit); c) raporti i shfrytëzuesit të dërgimit (asignatarit) dhe ekzekutuesit të dërgimit (asignatit).

Asignacioni përmban autorizim të dyfishtë. Njëri, i dhënë asignatit që ta kryejë një punë për llogari të asignantit dhe tjetri, i dhënë personit të tretë - asignatarit që ta pranojë atë përmbushje në emër të vetin.

Asignacioni mund të fillojë mbi baza të ndryshme. Asignanti dëshiron t'i sigurojë një dobi të caktuar asignatarit (causa donandi), t'i paguajë borxhin, të cilin e ka ndaj tij (causa solvendi) ose ta kreditojë (causa credendi).

Raporti mes dërguesit (asignantit) dhe pranuesit të dërgimit (asignatarit)

Ky më së shpeshti është raport mes debitorit dhe kreditorit. Në qoftë se dërguesi, si debitor, merret vesh me pranuesin e dërgimit si kreditor të vetin që borxhin e vet, të cilin e ka ndaj tij, do t'ia paguajë në atë mënyrë që, me autorizimin e dërguesit do ta përmbushë personi i tretë - ekzekutuesi i dërgimit (asignati), atëherë mes dërguesit - asignantit dhe shfrytëzuesit -asignatarit është lidhur kontrata e modalitetit të përmbushjes së detyrimit, me kusht suspenziv që personi i tretë – ekzekutuesi (asignati), t'i deklarojë asignatarit se e pranon dërgimin. Mirëpo, detyrimi i dërguesit ndaj asignatarit shuhet vetëm pas pagesës së borxhit nga ana e asignatit. Prandaj, marrëveshja e arritur mes dërguesit dhe shfrytëzuesit të dërgimit përmbushet vetëm atëherë kur përmbushet prestimi (borxhi) nga ana e asignatit. Për këtë arsye thuhet se dërgimi nuk është përmbushje.

Raporti mes ekzekutuesit - asigntit dhe shfrytëzuesit të dërgimit – asigntarit

Për këtë raport është me rëndësi që ekzekutuesi – asignti ta njoftojë shfrytëzuesin asigntarin për pëlqimin e pranimit të dërgimit. Në atë rast asigntari fiton të drejtën që të kërkojë nga asignti përmbushjen e detyrimit që është objekt dërgimi. Deklarata e pranimit të dërgimit është e përvokueshme.

Në momentin kur shfrytëzuesi i dërgimit ka pranuar nga ekzekutuesi (asignti) deklaratën se e pranon dërgimin, mes të tyre krijohet një marrëdhënie e detyrimeve, e cila është plotësisht e pavarur dhe e ndarë nga ajo që ekziston mes dërguesit dhe ekzekutuesit të dërgimit.

Raporti mes dërguesit - asigntit dhe ekzekutuesit të dërgimit - asigntit

Edhe ky raport është i pavarur dhe i ndarë nga raporti mes ekzekutuesit të dërgimit dhe shfrytëzuesit të dërgimit, nga njëra anë, dhe raportit të dërguesit dhe ekzekutuesit të dërgimit, nga ana tjetër. Në qoftë se mes dërguesit dhe shfrytëzuesit të dërgimit është arritur marrëveshja e dërgimit dhe në qoftë se ekzekutuesi i dërgimit është debitor i dërguesit, atëherë ekzekutuesi i dërgimit është i detyruar të përmbushë objektin e detyrimit, në bazë të autorizimit të dërguesit - drejtpërdrejt shfrytëzuesit të dërgimit.

Kalimi.-Dërgimi mund t'i kalohet një personit tjetër dhe kështu me radhë personave të tjerë, sipas rregullave të parashikuara për kalimin e letrave me vlerë sipas prurësit, përkatësisht sipas urdhrin. Kjo rezulton nga fakti se ligji parasheh dy forma të dërgimit: a) dërgimi në formë të letrës në prurësin (neni 1045 LMD) dhe në formë të letrës sipas urdhërit (neni 1046 i LMD).

Parashkrimi.- LMD afatin e parashkrimit e ka rregulluar me dispozitën e nenit 1036 par. 1 vetëm përkitazi me realizimin e së drejtës së asigntarit ndaj asigntit. Sipas kësaj dispozite, e drejta e tij parashkruhet brenda afatit prej një viti. Parashkrimi, në qoftë se për përmbushjen e prestimit nuk është caktuar afati, fillon të ecë kur asignti ka pranuar dërgimin e kur ai e ka pranuar atë para se t'i jepet asigntarit, afati fillon të ecë prej ditës kur këtij t'iu ketë dhënë ai. Për çështje të tjera, që kanë të bëjnë me parashkrimin, vlejné dispozitat e parashkrimit në përgjithësi (neni 341 -374 të LMD).

KONTRATA PËR URDHËRIN - DEKRETIT (CONTRAKTUS MANDATI)

Sipas kontratës për urdhërin, dekretmarrësi detyrohet ndaj dekretdhënësit që për llogari të tij të kryejë punë të caktuara, ndërsa dekretdhënësi detyrohet që dekretmarrësit t'i paguajë shpërblimin e caktuar.

Kontrata e urdhërrit është kontratë me emër, ngase është e rregulluar me ligj (nenet 763-784 të LMD).

Kontrata e urdhërrit është kontratë e veçantë e së drejtës së detyrimeve dhe e së drejtës tregtare. Palët kontraktuese të kontratës së urdhërrit mund të jenë persona fizikë dhe juridikë. Objekti i kësaj kontrate mund të jetë kryerja e punëve juridike ose punëve fizike dhe shërbimet intelektuale nga ana e dekretmarrësit, me shpërblim ose pa shpërblim. Baza e detyrimit të dekretdhënësit shërben si bazë e kryerjes së punëve nga ana e dekretmarrësit.

- Detyrimet e dekretmarrësit janë: a) të kryej urdhrin sipas udhëzimeve të marra nga dekretdhënësi, me kujdesin e ndërmarrësit të mirë, përkatësisht shtëpiakut të mirë, duke mbetur në kufijtë e tij dhe të kujdeset krejtësisht për interesat e dekretdhënësit dhe të udhëhiqet prej tyre. Kur konsideron se kryerja e urdhrin sipas udhëzimeve të tij do të ishte e dëmshme për dekretdhënësin, dekretmarrësi është i detyruar t'ia tërheqë vërejtjen për të dhe të kërkojë udhëzime të reja e nëse dekretdhënësi nuk jep udhëzime të reja për kryerjen e punës, të cilën duhet kryer, dekretmarrësi është i detyruar t'i ketë parasysh interesat e dekretdhënësit; b) ta kryejë detyrimin e dekretdhënësit personalisht, përveç kur dekretdhënësi ka lejuar që punët t'ia besojë një personit tjetër ose për shkak të rrethanave të veçanta është e domosdoshme që ta bëjë atë; c) t'i paraqesë llogari dekretdhënësit për punët e kryera dhe t'i kthejë tërë atë që ka marrë në bazë të kryerjes së punëve të besuara; ç) t'i paraqesë llogari dekretdhënësit për gjendjen e punëve dhe ta bëjë këtë edhe para afatit të caktuar; d) në qoftë se është shërbyer për nevojat e veta me të hollat e dekretdhënësit, të cilat i ka marrë nga ai, është i detyruar t'i paguajë kamatën me përqindjen më të lartë kontraktore të lejuar (neni 770 i LMD).
- Detyrimet e dekretdhënësit janë: a) që sipas kërkesës së dekretmarrësit t'i japë shumën e caktuar të hollave për shpenzimet e parashikuara; b) t'ia paguajë të gjitha shpenzimet e nevojshme, të cilat i ka bërë lidhur me zbatimin e dekretit, edhe atëherë kur munda i tij ka qenë i pasuksesshëm, me kamatë nga dita kur janë bërë; c) është i detyruar t'i marrë përsipër të gjitha detyrimet, të cilat i ka marrë mbi vete, duke i kryer në emër të vetin punët e besuara ose, në ndonjë mënyrë tjetër, ta lirojë prej tyre; ç) dekretdhënësi ka për detyrë t'ia shpërblejë dëmin dekretmarrësit, të cilin e ka pësuar pa fajin e vet gjatë zbatimit të dekretit të marrë me një shumë të zakonshme, por nëse për këtë nuk ka doke, t'ia paguajë kompensimin e drejtë; nëse nuk është kontraktuar ndryshe, t'ia paguajë shpërblimin për punën e kryer.

Shuarja e dekretit.- Kontrata e dekretit shuhet në këto mënyra: a) me anë të dorëheqjes (dekretdhënësi mund të heqë dorë nga kontrata, në të cilin rast dekretmarrësit i takon e drejta e shpërblimit përkatës dhe shpërblimi për dëmin të cilin e pëson me dorëheqjen nga kontrata, në qoftë se për dorëheqje nuk ka pasur arsye); b) me anë të denoncimit (dekretmarrësi mund ta denoncojë kontratën kur të dëshirojë, por jo në kohë të papërshtatshme dhe është i detyruar t'ia shpërblejë dëmin dekretdhënësit, të cilën ky e pëson për shkak të denoncimit të dekretit në kohë të papërshtatshme, përveç kur për denoncimin kanë ekzistuar arsye të bazuara); c) me vdekjen e personit fizik, përkatësisht shuarjen e personit juridik; dhe ç) me anë të humbjes së aftësisë për punë të personit fizik qoftë ky dekretdhënësi, qoftë dekretmarrësi, përkatësisht me falimentimin e personit juridik; d) me marrëveshje të palëve kontraktuese dhe dh) me përbushjen e kontratës.

KONTRATA PËR DHURATËN (DONATIO)

Sipas kontratës së dhuratës, një person (dhuratëdhënësi) detyrohet që personit tjetër (dhuratëmarrësit), t'i kalojë pa shpërblim të drejtën e pronësisë së sendit të vet ose ndonjë të drejtë tjetër. Është kontratë e së drejtës së detyrimeve, e cila është e rregulluar me dispozitat e LMD (nenet 536 – 548).

Karakteristikat e kësaj kontrate janë: është kontratë formale, ngase lidhet në formë të shkruar ose me dorëzim të sendit; është kontratë bamirëse; kontratë me detyrime të njëanshme, me të cilat bëhet kalimi i përhershëm i së drejtës së pronësisë së sendit ose ndonjë të drejtë tjetër pa pagesë nga një person te personi tjetër.

Për lidhjen e kësaj kontrate, përveç kushteve të përgjithshme të cilat janë të nevojshme për lidhjen e çdo kontrate detyrimore, duhen plotësuar edhe këto kushte të veçanta: arritja e marrëveshjes për kalimin pa pagesë të së drejtës së sendit ose të ndonjë të drejtë tjetër; përcaktimi i sendit ose i së drejtës që është objekt kontrate; forma e lidhjes së kontratës përkatësisht dorëzimi i sendit.

Objekt i kontratës së dhuratës mund të jenë sendet e luajtshme, të paluajtshme dhe të drejtat pasurore, të cilat janë të kalueshme dhe janë në qarkullim. Baza e kontratës është qëllimi i bamirësisë (animus donandi) të dhuratëdhënësit për t'i dhënë sendin apo për t'ia kaluar ndonjë të drejtë pasurore dhuratëmarrësit pa shpërblim.

Detyrimet e dhuratëdhënësit janë: që t'ia dorëzojë sendin ose t'ia kalojë të drejtën dhuratëmarrësit në kohën, mënyrën dhe në vendin e caktuar në kontratë, ndërsa kur nuk ka afat të dorëzimit të sendit, dorëzimi duhet të bëhet kur dhuratëmarrësi kërkon këtë ose brenda afatit të arsyeshëm plotësues, i cili është afat i arsyeshëm sipas dokeve të mira ose moralit; të kujdeset për ruajtjen e sendit deri në momentin e dorëzimit; ta kalojë rrezikun e zhdukjes së rastësishme të sendit deri në momentin e dorëzimit të tij dhe t'i përgjigjet dhuratëmarrësit për shpërblimin e dëmit të shkaktuar për të metat e sendit, të cilat kanë ekzistuar në qoftë se dhuratëdhënësi ka qenë i pandërgjegjshëm - kur sendi ka pasur të meta të fshehura, për të cilat dhuratëdhënësi ka pasur dijeni dhe për to nuk e ka njoftuar dhuratëmarrësin.

Kontrata për dhuratën lidhet në formë të shkruar (neni 541 i LMD), përveç nëse sendi apo e drejta nuk është bartur menjëherë nga dhuratëdhënësi tek dhuratëmarrësi në mënyrë që dhuratëmarrësi të mund të disponoj pa pengesa me sendin apo të drejtën e dhuruar. Nëse kontrata nuk është lidhur në mënyrën e paraparë si ma lartë atëherë dhuratëmarrësi nuk ka mundësi që të kërkoj me anë të padisë përmbushjen e saj.

Në praktikë janë të njohura disa lloje të veçanta të kontratës së dhuratës: a) kontrata e ndërsjellë e dhuratës, e cila në të vërtetë është një lloj e kontratës së shkëmbimit, ndërsa në rast se prestimet e ndërsjella nuk janë ekuivalente, për pjesën e tepërt të vlerës së prestimit të njëres palë do të ekzistojë kontrata e dhuratës; b) kontrata e përzier e dhuratës ekziston kur, përveç kontratës së dhurimit, është lidhur edhe kontrata e shitjes; kontrata me dekret ekziston kur dhuratëdhënësi i jep një send dhuratëmarrësit me një ngarkesë të caktuar që diçka t'i japë ose t'i bëjë personit tjetër.

Parimisht, kontrata e dhuratës është e parevokueshme. Mirëpo, ekzistojnë rastet në të cilat ajo mund të revokohet. Dhuratëdhënësi mund ta revokojë dhuratën në këto raste: kur dhuratëmarrësi është treguar deri në fund mosmirënjohës ndaj dhuratëdhënësit (neni 543 i LMD); në qoftë se dhuratëdhënësi është varfëruar dhe ka mbetur pa mjete materiale të nevojshme për ekzistencë, të cilat rrethana janë shkaktuar pas lidhjes së kontratës; që me revokimin e kontratës dhuratëmarrësi të mos mbetet pa mjete të nevojshme për ekzistencë; që sendi i cili është objekt i dhurimit ose vlera e tij të gjenden në pasurinë e dhuratëmarrësit; dhuratëdhënësi mund ta revokojë dhuratën në qoftë se ndodh anulimi i martesës për fajin e dhuratëmarrësit, me kusht që dhurata të jetë me vlerë të madhe. Trashëgimtarët e domosdoshëm mund të kërkojnë reduktimin e dhuratës, në qoftë se iu ka cenuar pjesa e tyre e domosdoshme trashëgimore, e cila nuk mund të plotësohet nga reduktimi i disponimeve testamentare të trashëgimlënësit.

Kontrata e dhuratës mund të revokohet brenda një viti nga dita kur dhuratëdhënësi ka mësuar për arsyet e evokimit ndërsa heqja dorë nga e drejta e revokimit të kontratës mbi dhuratën është e pavlefshme.

KONTRATA PËR DORËZIMIN DHE NDARJEN E PASURISË (KONTRATA E DORËZIMIT)

Sipas kontratës për dorëzimin dhe ndarjen e pasurisë dorëzuesi merr përsipër të dorëzojë dhe ndajë pronën tek pasardhësit e tij/saj, tek fëmijët e adoptuar dhe pasardhësve të fëmijëve të adoptuar. Është po ashtu kontratë e së drejtës së detyrimeve, e cila është e rregulluar me dispozitat e LMD (nenet 549 – 559).

Karakteristikat e kësaj kontrate janë: është kontratë formale, ngase lidhet në formë të aktit noterial; është kontratë bamirëse; kontratë me detyrime të njëanshme, me të cilat bëhet kalimi i përhershëm i së drejtës së pronësisë së sendit ose ndonjë të drejte tjetër pa pagesë nga një person te personi tjetër.

Për lidhjen e kësaj kontrate, përveç kushteve të përgjithshme të cilat janë të nevojshme për lidhjen e çdo kontrate detyrimore, duhen plotësuar edhe këto kushte të veçanta: duhet të sigurohet pëlqimi i të gjithë pasardhësve, nëse ndonjëri prej pasardhësve nuk e jep pëlqimin, ai këtë mund ta bëjë më vonë në të njëjtën formë;

vetëm pasuria ekzistuese e dorëzuesit, pjesërisht ose në tërësi mund të përfshihet në dorëzim dhe ndarje; kontrata duhet të jetë në formë të aktit noterial.

KONTRATA PËR MBAJTJEN E PËRJETSHME

Me anë të kontratës për mbajtjen e përjetshme, një palë kontraktuese (dhënësi i mbajtjes) merr përsipër të ndihmojë palën tjetër kontraktuese apo ndonjë person tjetër (marrësin e mbajtjes) dhe pala tjetër kontraktuese deklaron se ai apo ajo do të dorëzojë të parit (dhënësit të mbajtjes) të gjithë pasurinë apo një pjesë të pasurisë së tij apo sajë, e përbërë nga pasuria e përgjithshme dhe pasuria e luajtshme e dedikuar për ta përdorur dhe gëzuar pasurinë e përgjithshme. Me ç’ rast dorëzimi i tillë shtyhet deri në kohën e vdekjes së dorëzuesit. Është po ashtu kontratë e së drejtës së detyrimeve, e cila është e rregulluar me dispozitat e LMD (nenet 560 – 566).

Karakteristikat e kësaj kontrate janë: është kontratë formale, ngase lidhet në formë të aktit noterial; është kontratë aleatore me që prestimet e saj nuk janë të përcaktuara saktësisht në pikëpamje të kohëzgjatjes së saj përkatësisht ajo zgjatë gjersa të vdesë dorëzuesi; kontratë me detyrime të dyanshme.

Për lidhjen e kësaj kontrate, përveç kushteve të përgjithshme të cilat janë të nevojshme për lidhjen e çdo kontrate detyrimore, duhen plotësuar edhe këto kushte të veçanta: me këtë kontratë gjithashtu mund të përfshihen edhe pasuri tjetër e luajtshme të marrësit të mbajtjes, e cila duhet të theksohet në kontratë; kontrata duhet të jetë në formë të aktit noterial.

Ndryshimi i rrethanave mund të ndryshojë marrëdhëniet e tyre në kontratë ose të shkaktojë anulimin e kontratës mbi mbajtjen e përjetshme. Këtë mund ta bëjë gjykata me propozimin e njëjës prej palëve kontraktuese.

■ E DREJTA E PROCEDURËS CIVILE

1. Nocioni:

E drejta procedurale civile është pjesë e së drejtës pozitive dhe si e tillë i përfshin të gjitha rregullat juridike në bazë të së cilave zhvillohet realizimi i të drejtave subjektive nga marrëveshjet juridiko-civile në jetën e përditshme.

E drejta procedurale civile si e tillë përmban rregullat themelore mbi organizmin e gjykatave si dhe të organeve tjera që kanë për detyrë të bashkëpunojnë me gjykatat. Poashtu, ajo përmban edhe rregulla juridike në bazë të së cilave përcaktohen prezumimet për kryerjen e aktivitetit procedural, si dhe rregulla me të cilat përcaktohen pasojat juridike të këtij aktiviteti.

2. Llojet e procedurave gjyqësore civile:

As mbrojtja gjyqësore në procedurë civile nuk është e organizuar në mënyrë unike. Kjo varet kryesisht nga cilësitë e raportit juridiko-civil lidhur me të cilin zhvillohet procedura konkrete, andaj për këtë mbrojtja juridike jepet në rend të parë në procedurën kontestimore, por edhe në atë jokontestimore dhe përmbaruese ose në atë të falimentimit.

- a) *Pra, duke u nisur nga e gjithë kjo procedura kontestimore mund të themi lirisht se është metodë apo rrugë e veprimit, ose ecuri që ndiqet me rastin e dhënies së mbrojtjes gjyqësore për të drejtën konkrete subjektive. Procedurën si tërësi e përbëjnë veprimet të cilat i kryejnë subjektet e një procesi kontestimor. Të gjitha ato e përbëjnë një tërësi të vetme sepse i lidh i njëjti qëllim. Veprimet e tilla i quajmë procedurale dhe ato kryesisht kryhen nga ana e tre subjekteve kryesore të procesit konkret gjyqësor: paditësit (apo paditësve), të paditurit (apo të paditurve) dhe gjykatës. Paditës është personi i cili paraqet kërkesë (kjo bëhet përmes padisë) në gjykatë për sigurimin e mbrojtjes gjyqësore për një të drejtë të tij subjektive civile për të cilën ai konsideron se i është cenuar. I paditur është personi kundër të cilit drejtohet një kërkesë e tillë e parashtruar në gjykatë ndërsa gjykata është subjekti i tretë i cili me anë të vendimit të vet e jep mbrojtjen gjyqësore të kërkuar në rastin konkret. Gjykata në këto raste vepron sipas rregullave të procedurës kontestimore. Me kontest duhet kuptuar situatën në të cilën një person pretendon se i takon një e drejtë subjektive civile ndaj personit tjetër, e ky e mohon ekzistimin e saj apo nga ndonjë shkak tjetër e mohon detyrimin e tij që të sillet në mënyrën e caktuar nga ana e atij personi.*
- b) *Procedurën përmbaruese e përbëjnë veprimet të cilat i kryejnë subjektet e interesuara: kreditori në njërën anë, dhe debitori si palë kundërshtare në anën tjetër. Kjo procedurë vihet në veprim në bazë të vendimit përfundimtar të procedurës kontestimore me të cilin gjykata e ka detyruar të paditurin që të sillet në mënyrën e caktuar. Kështu, nëse i padituri nuk ka vepruar në pajtimin me*

vendimin e tillë (detyruës- kondemnator) brenda afatit të caktuar nga gjykata, paditësi mund t'i drejtohet gjykatës kompetente me kërkesë që vendimi i tillë përfundimtar të ekzekutohet me dhunë.

- c) *Procedurën jokontestimore e përbëjnë veprimet procedurale që kryhen nga subjektet e caktuara me qëllim të rregullimit të një raporti të caktuar, të ndryshimit të statusit të një personi, të themelimit apo ndryshimit të një të drejte pasurore etj. Të gjitha procedurat për të cilat u bë fjalë më lartë e përbëjnë procedurën gjyqësore civile. Të gjitha ato janë rregulluar me ligj, si në pikëpamje të rolit të subjekteve procedurale, ashtu edhe në pikëpamje të vlefshmërisë, radhës së kryerjes dhe efektit të veprimeve të kryera nga ta.*

3. Burimet juridike:

Në ushtrimin e funksionit gjyqësor gjykatat janë të pavarura dhe gjykojnë në bazë të kushtetutës, ligjit dhe akteve juridike të përgjithshme të tjera. Në sistemet bashkëkohore juridike, ku bënë pjesë edhe sistemi i ynë, burim të së drejtës, parimisht, janë vetëm rregullat e shkruara juridike. Kontratat ndërkombëtare zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi, në mënyrë direkte pasi të jenë shpallur në mënyrën e paraparë me kushtetutë. Kushtetuta është burim themelor i së drejtës procedurale civile, sepse me disa nga dispozitat e saja parashihen disa parime mbi gjyqësinë në përgjithësi, e vetvetiu edhe për gjyqësinë civile, si pjesë përbërëse e saj.

Procedura kontestimore, jokontestimore dhe përmbartimore rregullohen ekskluzivisht me ligj. Burim kryesor i procedurës kontestimore është Ligji për Procedurën Kontestimore (L. nr. 03/L-006 i dt. 30.06.2008 i shpallur me Dekretin e Presidentit të RK nr. DL-04502008 i datës 29.07.2008 i cili zbatohet prej 06 tetor 2008 – Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38 e dt. 20.09.2008) dhe ligji nr. 04/L-118 i dt. 13.09.2012 Për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i shpallur me dekretin e Presidentit të RK DL-045 2012 i datës 28.09.2012; Procedura jokontestimore është rregulluar me Ligjin për procedurën jokontestimore Ligji 2008/03 – L – 007 i datës 20.11.2008 i shpallur me dekretin e Presidentit të RK DL-068-2008 i datës 13.12.2008; Procedura përmbartimore është rregulluar me Ligjin për Procedurën Përmbartimore nr. 2012/04/L-139 të dt. 20.12.2012 i dekretuar me dekretin e Presidentit të RK DL nr. – 01-2013 të dt. 03.01.2013; Dispozitën lidhur me ekzekutimin e vendimeve të dhëna në çështjet që kanë të bëjnë me martesën dhe me statusin prindëror e përmban Ligji për Familjen i Kosovës nr. 2004/32 i dt. 20.01.2006 (Reg. e UNMIK-ut nr. 2006/7 e dt. 16.02.2006).

Me këtë rast dhe në këtë vend duhet potencuar se Kosova poashtu ka obligim të respektimit të konventave dhe rekomandimeve ndërkombëtare detyrim ky i cili ka rrjedhë nga rregullorja nr. 1999/24 dhe 2000/59 të cilat kanë të bëjnë me Ligjin në fuqi në Kosovë e të cilat në dispozitat fillestare të tyre parashohin se ligj në fuqi në Kosovë do të jenë përveç rregulloreve të shpallura nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm dhe ligjit në fuqi në Kosovë i cili përfundimisht ka vlejte gjerë me dt. 22.03.1989 edhe respektimi i standardeve të drejtave të njeriut ndërkombëtarisht të

njohura e pastaj taksativisht janë theksuar 7 konventa dhe marrëveshje ndërkombëtare e me Kushtetutën e Republikës së Kosovës e cila ka hyrë në fuqi me dt.15.06.2008 në kapitullin e II-të të saj konkretisht në nenin 22 parashihet Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare të cilat kanë prioritet, në rast të konfliktit ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike e që janë:

- 1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- 2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- 3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- 4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- 5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- 6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- 7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- 8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

PROCEDURA KONTESTIMORE

-Subjektet në procedurën kontestimore-

Kontesti juridiko-civil lind midis dy personave. Cilësinë e palëve në gjykim ata e fitojnë në momentin e paraqitjes së padisë në gjykatë. Për ekzistimin e procesit kontestimor nevojitet ekzistimi i tri subjekteve: palët dhe gjykata. Palët ndërgjyqëse janë: pala paditëse dhe pala e paditur. Paditësi me padi e cakton të paditurin. Gjyqtari për zgjidhjen e kontestit të palëve caktohet nga ligji (apo me vullnetin e palëve te gjykatat jo-shtetërore - arbitrazhi) dhe akti mbi ndarjen vjetore të punës në gjykatë. Përveç subjekteve të përmendura që janë të domosdoshme, në procesin kontestimor mund të paraqiten edhe subjekte të tjera siç janë: përfaqësuesi i palës (ligjor apo me prokurë), prokurori publik, ndërhyrësi, dëshmitarët, ekspertët, interpreti, dhe procesmbajtësi.

Me ligjin mbi procedurën kontestimore caktohen rregullat e procedurës në bazë të cilave gjykata ordinere shqyrton dhe vendosë në kontestet nga marrëdhëniet personale e familjare, nga marrëdhëniet e punës si dhe nga marrëdhëniet pasurore dhe nga marrëdhëniet e tjera civilo-juridike të personave fizikë e të personave civil-juridik, të bashkësive shoqërore-politike e personave shoqërore juridik të tjerë, përveç nëse disa nga kontestet e theksuara janë vënë me ligj të veçantë në kompetencë të gjykatës tjetër ose të organit shtetëror respektivisht të organit shoqëror. (rasti i zgjedhjes së kontesteve tek e ashtuquajtura HPD dhe AKP).

Në procedurën kontestimore gjykata vendosë brenda kufijve të kërkesave që janë vënë në procedurë. Këtu posaçërisht duhet potencuar se gjykata nuk mund të refuzojë të vendosë mbi kërkesën për të cilën është kompetente.

PARIMET E PROCEDURËS KONTESTIMORE

-Nocioni-

Me nocionin e parimit në procedurën kontestimore nënkuptojmë rregullat themelore në bazë të së cilave zhvillohet aktiviteti gjatë tërë procedurës i subjekteve të procesit e me të vetmin qëllim që të arrihet mbrojtja juridike e së drejtës së supozuar të cenuar subjektive apo me qëllim që të konstatohet se për një gjë të tillë nuk ka vend (veprimi i palës kundërshtarë). Parimet e kësaj procedure i caktojnë metodat e veprimit që kryhen gjatë shqyrtimit të çështjes juridike dhe vendosjes mbi të. Parimet pra i japin vulën kryesore institucioneve të procedurës kontestimore në bazë të së cilave zhvillohet kjo procedurë.

Për zhvillimin e procedurës kontestimore vlejné parimet siç janë:

1) Parimi i disponibilitetit dhe ofcialitetit (ex officio):

Sipas këtij parimi paditësit si iniciator i procedurës kontestimore i njihet e drejta që procedurën e inicuar me padi t'a përfundojë me tërheqjen e padisë apo me heqjen dorë nga kërkesëpadija – veprime këto procedurale të mundësuar me dispozitën e nenit 149 të LPK. Procesi mund të përfundojë edhe me veprimet disponibile të palëve edhe atëherë kur ato arrijné që të lidhin ujdi gjyqësore për objektin e kontestit për të cilin zhvillohet procedura. Mirëpo, edhe procedura ankimore poashtu mund të përfundojë me anë të veprimit të tillë disponibil të palëve dhe atë me tërheqjen e mjetit të goditjes së vendimit (neni 186.3 të LPK). Ky parim më së miri është i përcaktuar në maksimën latine: “nemo iudex sine actore”- që do të thotë se nuk ka proces kontestimor pa kërkesën e personit të autorizuar.

2) Parimi i dëgjimit të dyanshëm të palëve (kontradiktor):

Sipas këtij parimi gjykata ka detyrë që çdo njëres nga palët t'ia japë mundësinë që ta paraqesë mendimin lidhur me çështjen mbi të cilën është duke u zhvilluar procedura, e gjithashtu edhe mundësinë e deklaramit rreth thënieve dhe pretendimeve të palës kundërshtarë. Ky parim, i cili është i njohur edhe si parimi i kontradiktorialitetit obligon gjykatën që secilës nga palët në kontest t'i mundësojë pjesëmarrje aktive dhe njëherit të sigurojë barazinë e palëve procedurale para gjykatës në prezantimin dhe grumbullimin e fakteve relevante për të vendosur në mënyrë meritore një çështje konkrete juridike (neni 5 i LPK). Vetëm në rastet e përcaktuara me ligj gjykata ka të drejtë të vendosë mbi kërkesën për të cilën palës kundërshtarë nuk i është dhënë mundësia që të deklarohet (neni 5.2 i LPK).

3) Parimi i udhëzimit të palës:

Me qëllim të evitimit të dëmit eventual që mund ta pësoj pala e pa udhëzuar në punët juridike është paraparë detyra e gjykatës që atë ta udhëzojë se cilat veprime procedurale mund t'i kryejë, sa herë që konstaton se pala nga padijenia nuk i shfrytëzon

të drejtat procedurale që i takojnë sipas këtij ligji (neni 11 i LPK). Njëherit, gjykata gjatë këtij udhëzimi e njofton palën edhe me pasojat e moskryerjes së veprimeve të tilla procedurale. Mirëpo, kjo detyrë e gjykatës ka të bëjë vetëm me udhëzimin për të drejtat procedurale e jo edhe për të drejtat e natyrës materialo-juridike. Gjykata nuk guxon palën ta udhëzojë mbi të drejtën e saj materialo – juridike nga se ajo përfaqëson tejkalim të kompetencave të gjykatës por thjeshtë, duhet ngelë vetëm brenda suazave të detyrës së paraparë me ligj, p.sh. duke i shpjeguar palës domethënien e instituteve procedurale, ndërprerjen e procedurës, tërheqjen e padisë, etj.

4) Parimi i ekonomicitetit të procedurës:

Aktiviteti procedural duhet të kryhet në kohë sa më optimale, me punë sa më të pakët si dhe me harxhime sa më të vogla. Për këtë qëllim, ligji ka paraparë se procedura e shkallës së parë, si rregull, përbëhet prej dy seancave gjyqësore: seancës përgatitore dhe seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes, pastaj në procedurën e shkallës së parë dhe procedurën sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, vepron gjyqtari individual (i vetëm) ndërsa në procedurën e shkallës së dytë dhe procedurën sipas revizionit vepron trupi gjykues prej tre gjykatësve, poashtu është paraparë p.sh. marrja e provave nëpërmjet gjykatës së porositur, bashkimi i dy gjykimeve, mos caktimi i seancës përgatitore, bashkimi i kërkesë - padive, përfshirja e dy të paditurve me një padi të vetme si dhe situatën kur gjykata ka mundësi të nxjerrjes së aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes – neni 150 i LPK) etj.

5) Parimi shkresor dhe verbal:

Para se të jepet vendimi për kërkesë-padinë, nga gjykata kërkohet (neni 7 i LPK) që të vërtetohet plotësisht dhe saktësisht gjendjen faktike në të cilën mbështetet kërkesë padia. Në këtë drejtim ligji obligon palët që gjykatës t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat mbështetin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Komunikimi i palëve me gjykatën në fazën përgatitore (parashtrimi i kërkesave, propozimeve dhe informatave të tjera) dhe atë sipas mjeteve të goditjes së vendimeve kryhet kryesisht në formën e shkruar. Komunikimi i palëve me gjykatën bëhet në mënyrë verbale gjatë seancave kur ato me vetë iniciativë apo me kërkesën e gjykatës marrin pjesë në seancë përgatitore apo në shqyrtimin kryesor të çështjes.

6) Parimi i publicitetit:

Sipas këtij parimi gjykata për kërkesë-padinë zakonisht vendosë në bazë të shqyrtimit të çështjes juridike të zhvilluar në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike. Ky parim është shprehur në nenin 4 të LPK- së, pra seanca gjyqësore mbahet me dyer të hapura. Gjykata e shqyrtton çështjen në seancë jo-publike vetëm në rastet e përcaktuara me ligj. Për një veprim të tillë gjykata duhet të sjellë vendim përkatës mbi mbajtjen e seancës jo-publike përveç te kontestet statusore në të cilat sipas ligjit procedura është jo-publike.

7) **Parimi i vlerësimit lirisht të provave:**

Sipas këtij parimi gjykata nuk është e lidhur e as e kufizuar me rregulla të posaçme formale për të provuarit. Pretendimin e caktuar gjykata e merr si të provuar vetëm pasi të jetë bindur në saktësinë dhe vërtetësinë e tij duke mos qenë e kufizuar me kurrfarë dispozite ligjore.

8) **Parimi i pandërmjetësisë:**

Sipas këtij parimi e që është i shprehur në nen. 4. të LPK gjykata vendosë për kërkesë-padinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike. Por ky parim nuk mund të zbatohet në procedurat instancionale, sepse në to vendoset në bazë të shkresave përveç kur gjykata instancionale më e lartë vendosë që çështjen ta hapë dhe të bjen vendim vet lidhur me atë çështje juridike. Sipas këtij parimi gjykata drejtpërdrejtë dhe me anë të shqisave personale njoftohet me natyrën dhe përmbajtjen e mjeteve provuese të ofruara nga palët dhe pa ndërmjetësimin e tjetërkujt vendosë për vlerën provuese të tyre.

9) **Parimi i shfrytëzimit me ndërgjegje i të drejtave procedurale:**

Një prej standardeve kryesore në të drejtën bashkëkohore është ai se titullari i një të drejte nuk guxon ta keqpërdorë atë. Atij i njihet një e drejtë me qëllim që të shfrytëzohet për atë që është dedikuar, e jo për qëllime të tjera. Me LPK (neni 9) kërkohet nga palët që me ndërgjegje t'i shfrytëzojnë të drejtat procedurale të cilat ua njeht ligji, kurse nga gjykata që ta pamundësojë keqpërdorimin e tyre.

KOMPETENCA E GJYKATAVE

Nocioni dhe llojet e kompetencës

Me termin kompetencë në pikëpamje objektive kuptojmë rrethin e punëve të një organi apo fushë veprimtarinë e një organi. Në pikëpamje subjektive, kompetenca është e drejtë dhe detyrë e organit që të veprojë në çështjen e caktuar juridike. Me rregullat me të cilat përkufizohet rrethi i punëve të gjykatave, caktohet kompetenca lëndore, vendore (e përgjithshme dhe e veçantë) dhe funksionale në procedurën kontestimore.

1. Kompetenca lëndore:

Në procedurën kontestimore gjykatat në Kosovë gjykojnë brenda kufijve të kompetencës së vetë lëndore të caktuar me ligj.

E këtij lloji është kompetenca në bazë të së cilës gjykatat e një kategorie kanë të drejtë dhe detyrë të gjykojnë disa çështje juridike për shkak të llojit, natyrës dhe vlerës së objektit të tyre. Me rregullat për këtë kompetencë caktohet rrethi i punëve të gjykatave të llojeve të ndryshme si dhe ai i gjykatave të rangut të ndryshëm, por të llojit

të njëjtë. Kriteret për caktimin e kompetencës lëndore janë: objekti i kontestit, (kriteri kauzal) dhe vlera e objektit të kontestit (kriteri vlerësor).

Gjykata Supreme është kompetente të vendosë mbi kërkesën për mbrojtjen e ligshmërisë; duke përfshirë edhe kontestet mbi shpërblimin e dëmit që lindin nga veprimet juridike kundërkushtetuese dhe kundërligjore, apo nga veprimet me të cilat organizatat apo punëdhënësit në territorin e Kosovës vihen në një pozitë të pa-barabartë në tregun unik. Poashtu, Gjykata Supreme është kompetente të vendosë edhe mbi revizionin e ushtruar kundër vendimeve të plotfuqishme si mjetin e jashtëzakonshëm juridik. Kjo gjykatë poashtu është kompetente të ushtrojë edhe veprime të tjera që i janë vënë në kompetencë me ligj.

Më pastaj në ligj në nenin 30 të LPK theksohet se kur për përcaktimin e vlerës së objektit të kontestit si masë për caktimin e kompetencës lëndore të përbërjes së gjykatës, të së drejtës për deklarimin e revizionit e në raste të tjera të parashikuara në ligj është kompetente vlera e objektit të kontestit e si vlerë e objektit të kontestit merret parasysh vetëm vlera e kërkesës kryesore. Kamatat, shpenzimet procedurale, penalitetet e kontraktuara dhe kërkesat tjera aksesore, nuk merren parasysh nëse nuk përbëjnë kërkesën kryesore.

Në qoftë se kërkesa ka të bëjë me dhëniet e ardhshme që përsëriten, vlera e objektit të kontestit llogaritet sipas shumës totale të tyre, por jo më tepër se deri në shumën që i përgjigjet shumës totale të dhënieve për një kohë prej pesë vjetësh.

Në qoftë se një padi e ngritur kundër një të padituri përfshin disa kërkesa që mbështeten në të njëjtën bazë faktike dhe juridike, atëherë vlera e objektit të kontestit caktohet sipas shumës së përgjithshme të vlerës së të gjitha kërkesave.

Në qoftë se kërkesat në padi rezultojnë nga baza të ndryshme, apo në qoftë se janë theksuar kundër disa të paditurve, vlera e objektit të kontestit caktohet sipas vlerës së secilës kërkesë veç e veç.

Ndërsa, kur kontesti zhvillohet mbi ekzistimin e raportit mëditjes apo të qirasë, ose nga raporti i shfrytëzimit të banesës apo i lokaleve të punës, vlera e kontestit llogaritet sipas shumës njëvjeçare të mëditjes, respektivisht të qirasë, përveç në qoftë se është fjala për raportin mëditës apo të qirasë që vlen për një kohë më të shkurtër të kontraktuar.

Në qoftë se me padi kërkohet vetëm dhënia e sigurisë për ndonjë kërkesë apo për vendosjen e të drejtës së pengut, vlera e objektit të kontestit caktohet sipas shumës së kërkesës që duhet siguruar. Në qoftë se objekti i pengut ka një vlerë më të vogël se kërkesa që duhet siguruar, si vlerë e objektit të kontestit do të merret vlera e objektit të pengut.

Në qoftë se kërkesëpadia nuk ka të bëjë me të holla, por paditësi në padinë e tij thekson se pranon që në vend të përmbushjes së kërkesëpadiisë të marrë shumën e caktuar të hollave, atëherë si vlerë e objektit të kontestit do të merret kjo shumë.

Në raste të tjera, kur kërkesëpadia nuk ka të bëjë me të holla, vendimtare do të jetë vlera e objektit të kontestit të cilën e ka theksuar paditësi në padinë e tij.

Në qoftë se në rastin si më lartë paditësi e ka theksuar pa dyshim tepër lartë ose shumë më pak vlerën e objektit të kontestit, kështu që shtrohet pyetja e kompetencës

lëndore, të përbërjes së gjykatës apo të së drejtës së deklarimit të revizionit, gjykata, jo më vonë se në seancën përgatitore e në qoftë se seanca përgatitore nuk është mbajtur atëherë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike, por para se të filloj shqyrtimi, shpejtë dhe në mënyrë të përshtatshme do t'a caktojë, përkatësisht do t'a verifikojë saktësinë e vlerës së treguar në padi nga paditësi.

2. Kompetenca territoriale:

E këtij lloji është kompetenca në bazë të së cilës gjykata, që është kompetente në pikëpamje lëndore, mund të gjykojë çështjen juridike që ka ndonjë lidhje me territorin ku ajo e zhvillon veprimtarin e saj. Gjykatave të shkallës së parë me ligj u është caktuar territori brenda të cilët e ushtrojnë funksionin e tyre gjyqësor. Varësisht nga raporti që ekziston midis palëve dhe territorit të gjykatës së caktuar, apo midis objektit të kontestit dhe territorit të gjykatës së caktuar, caktohet se cila prej disa gjykatave të llojit të njëjtë do të jetë e kompetencës territoriale për gjykim në çështjen konkrete juridiko-civile. Përveç se me ligj, kompetenca territoriale mund të caktohet me marrëveshje të palëve, e në rastet e parapara me ligj me vendim të gjykatës së lartë. Kompetenca territoriale e caktuar me ligj është e përgjithshme (*forum generale*) ose e posaçme (*forum speciale*). Kompetenca territoriale e posaçme është ose ekskluzive (*forum exclusive*), ose e zgjedhur (*forum electivum*) ose ndihmëse (*forum subsidiale*) ose retorzive.

a) Kompetenca e përgjithshme territoriale:

Për këtë kompetencë është paraparë rregulli *actor sequitur forum rei*. Me ligj është paraparë që pala paditëse padinë kundër palës së paditur ta ngritë në gjykatë në territorin e së cilës kjo e ka vendbanimin e nëse jo atëherë në territorin e së cilës e ka vendqëndrimin. Kur si i paditur paraqitet personi juridik - e kompetencës së përgjithshme territoriale është gjykata në territorin e së cilës ndodhet selia e tij. Pra, në qoftë se me ligj nuk është caktuar kompetenca ekskluzive territoriale e ndonjë gjykate tjetër, për gjykim është kompetente gjykata që ka kompetencë të përgjithshme territoriale për të paditurin.

b) Kompetenca e veçantë territoriale:

Me rregullat për këtë kompetencë caktohet gjykata e cila do të jetë ekskluzivisht kompetente që t'a zgjidhë kontestin konkret. Konteste të tilla janë ato në lidhje me pronësinë dhe të drejtat sendore të tjera mbi sendet e paluajtshme, në kontestet për shkak të pengim- posedimit mbi sendin e paluajtshëm, si dhe në kontestet nga raportet e qiradhënies së paluajtshmërisë, ose nga kontratat për shfrytëzimin e banesave apo të lokaleve të punës, për këto konteste është kompetente vetëm gjykata në zonën në të cilën ndodhet sendi i paluajtshëm. E nëse sendi i paluajtshëm ndodhet në zonën e disa gjykatave atëherë është kompetente çdonjëra nga to. Ndërsa për kontestet për pengim-posedimi në sendet e luajtshme është kompetente, përpos gjykatës me kompetencë të përgjithshme territoriale, edhe gjykata në zonën e së cilës ka ndodhur pengimi.

Pra, Gjykata në territorin e së cilës ndodhet sendi i paluajtshëm është ekskluzivisht kompetente (*forum rei sitae*) për zgjidhjen e kontestit lidhur me të.

c) *Kompetenca territoriale e zgjedhur:*

Me dispozitat ligjore për këtë kompetencë paditësi autorizohet që të zgjedhë se a do t'ia paraqes padinë kundër të paditurit gjykatës e cila për të është e kompetencës së përgjithshme territoriale apo gjykatës tjetër të cilën e ka caktuar ligji duke e marrë parasysh interesin e paditësit. Kjo kompetencë është paraparë për kontestet familjare, për kontestet lidhur me ushqimin ligjor, për shpërblimin e dëmit, për kontestet nga garancioni i prodhuesit, nga marrëdhënia e punës etj. Kështu p.sh. në kontestin për shpërblimin e dëmit padia mund të paraqitet qoftë në gjykatën në territorin e të cilës i padituri e ka vendbanimin, qoftë në gjykatën në territorin e së cilës është shkaktuar dëmi ndërsa në qoftë se dëmi është shkaktuar për shkak të vdekjes apo të lëndimit të rëndë trupor, kompetente është përpos gjykatave si më lartë, edhe gjykata në zonën e së cilës paditësi (i lënduari apo anëtar i familjes së të vdekurit) e ka vendqëndrimin e vet.

Për gjykim në kontestet për mbrojtjen e së drejtës në bazë të garancisë shkresore kundër prodhuesit që e ka dhënë garancinë është kompetente përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale për të paditurin, edhe gjykata me kompetencë të përgjithshme territoriale për shitësin, i cili gjatë shitjes së sendit i ka dhënë blerësit garancinë shkresore të prodhuesit.

Tek kontestet martesore për konstatimin e ekzistimit apo të mosekzistimit të martesës, për anulimin apo zgjidhjen e saj, kompetente është përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, edhe gjykata në territorin e së cilës bashkëshortët kanë pasur vendbanimin e fundit të përbashkët.

Te vërtetimi i (mos) ekzistimit të atësisë apo të amësisë, fëmija mund të ngrejë padi qoftë në gjykatën e kompetencës së përgjithshme territoriale qoftë në gjykatën në territorin e së cilës e ka vendbanimin apo vendqëndrimin.

Tek çështjet nga marrëdhënia trashëgimore juridike përpos gjykatës së kompetencës së përgjithshme territoriale, me kompetencë territoriale është edhe gjykata në territorin e së cilës ndodhet gjykata që zbaton procedurën trashëgimore- kjo, gjersa procedura trashëgimore të mos përfundojë me vendim të formës së prerë.

ç) *Kompetenca territoriale ndihmëse:*

Me rregullat për këtë kompetencë mundësohet caktimi i gjykatës që do të jetë kompetente në rastet në të cilat nuk mund të zbatohen rregullat themelore për kompetencën territoriale. Kështu, mundësohet që paditësi padinë t'a paraqesë në gjykatën e shtetit tonë, edhe pse për të paditurin nuk ekziston kompetenca e përgjithshme tokësore në vendin tonë, si dhe ngritja e padisë kundër më tepër pjesëmarrësve në një raport juridiko-civil nga i cili ka lindur kontesti. Kështu p.sh., kur kemi të bëjmë me bashkëndërgjygjësinë materiale, paditësi mund t'a paraqesë padinë në cilëndo gjykatë e cila është e kompetencës së përgjithshme territoriale, bile për njërin prej të paditurve.

d) Kompetenca territoriale retorzive:

Nëse në shtetin e huaj shtetasi i jonë mund të paditet në gjykatën e cila sipas kritereve të LPK-së nuk do të ishte kompetente, atëherë edhe kundër shtetasi të shtetit të tillë në vendin tonë mund t'i paraqitet padia gjykatës në bazë të njëjtit kriter (neni 62 i LPK).

3. Kompetenca funksionale:

Me rregullat për kompetencën funksionale caktohet kompetenca e gjykatave për vendosje për mjetet e goditjes së vendimeve, apo për kryerjen e punëve të caktuara. Kështu, p.sh. me rregullat e tilla bëhet ndarja e instancave midis gjykatave të ndryshme, apo caktimi i gjykatës përkatëse si gjykatë kompetente për sigurimin e provave dhe për dhënien e ndihmës juridike, ose caktimi i gjykatës e cila e zgjidhë konfliktin lidhur me kompetencën.

4. Kompetenca kontraktuale:

Kjo është rasti kur palët merren vesh që një çështje të caktuar të tyre juridike t'a gjykojë gjykata, e cila sipas rregullave ligjore nuk do të ishte kompetente në pikëpamje territoriale për një gjë të tillë. Kjo marrëveshje mund të lidhet vetëm me shkrim dhe të jetë e firmosur nga të dy palët dhe të ketë të bëjë me kontestin konkret, ose me disa konteste, por që rezultojnë nga një raport i caktuar materialo-juridik dhe vetëm para se të jetë ngritur padia në gjykatë. Dokumentin mbi marrëveshjen, paditësi duhet t'ia bashkangjesë padisë. Ajo mund të jetë pjesë (klauzolë) e kontratës materialo-juridike. Me marrëveshjen mbi kompetencën territoriale mund të kontraktohet edhe kompetenca territoriale e gjykatës së huaj, por vetëm kur njëra palë është me shtetësi të huaj. Me të njëjherësh themelohet kompetenca territoriale e gjykatës së caktuar nga palët dhe përjashtohet ajo e caktuar me ligj.

Gjykata vlerëson kryesisht menjëherë pas marrjes së padisë, nëse është kompetente.

Ky vlerësim i kompetencës bëhet në bazë të thënieve në padi dhe në bazë të fakteve që i ka të njohura gjykata.

Po që se gjatë procedurës ndryshohen rrethanat në të cilat është bazuar kompetenca e gjykatës, apo në qoftë se paditësi e pakëson kërkesë- padinë, gjykata e cila ka qenë kompetente në kohën e paraqitjes së padisë mbetet gjithnjë kompetente megjithëse për shkak të këtyre ndryshimeve do të ishte kompetente gjykata tjetër ordinare e të njëjtit lloj.

Gjykata gjatë krejt procedurës kujdeset kryesisht nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore.

Kur gjykata gjatë procedurës vërteton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente ordinare por ndonjë organ tjetër i vendit apo i huaj do të deklarohet inkompetente, do ti abrogojë veprimet e zbatuara në procedurë dhe do t'a hedhë poshtë padinë.

Në rastin kur është mbajtur seanca përgatitore, apo në seancën e parë për në seancën kryesore ka hyrë në shqyrtim rreth çështjes kryesore, gjykata më e lartë e shkallës së parë, si me rastin e kundërshtimit ashtu edhe kryesisht nuk mund të deklarohet me inkompetencë lëndore për objektet nga kompetenca e gjykatës më të ulët të shkallës së parë të njëjtit lloj.

Gjykata mund të shpallet jokompetente në pikëpamje territoriale vetëm sipas prapësimit të palës së paditur të parashtuar me anë të përgjigjes në padi. Ndërsa, kryesisht mund të shpallet inkompetente vetëm kur ekziston kompetenca territoriale ekskluzive e ndonjë gjykate tjetër, por më së voni deri në momentin e paraqitjes së përgjegjës në padi.

5. Konflikti në lidhje me kompetencën:

Kur gjykata të cilës i është paraqitur padia konstaton se nuk është kompetente, ajo me aktvendim shpallet jokompetente dhe lëndën i'a dërgon gjykatës për të cilën mendon se është kompetente. Po që se gjykata të cilës i është dërguar lënda konsideron se është kompetente pikërisht gjykata që i'a ka dërguar lëndën, ose ndonjë gjykatë tjetër, atëherë ajo do t'ia dërgoj lëndën, brenda afatit prej tri ditësh, gjykatës që duhet t'a zgjidhë këtë konflikt kompetence. Kjo është pra situata e cila quhet konflikt kompetence. Konflikti lind siç po shihet sikurse kur gjykata e dytë mendon se është kompetente pikërisht gjykata e parë, ashtu edhe kur mendon se për gjykim është kompetente gjykata e tretë. Gjykata e dytë pa dhënë vendim, lëndën ia dërgon gjykatës që është më e lartë. Kjo gjykatë vendosë se cila nga gjykatat në konflikt do ta gjykojë çështjen juridike. Kur bien në konflikt dy gjykata komunale, konfliktin e zgjidh gjykata e Apelit. Kundër vendimit të kësaj gjykate nuk lejohet ankimi, sepse ai është i natyrës administrative e jo veprim procedural i gjykatës. Sipas dispozitës së nenit 15.3 të LPK-së, caktimin e kompetencës territoriale dhe zgjidhjen e konfliktit për kompetencë e bën trupi gjykses prej tre gjykatësve.

6. Kompetenca e gjykatave në kontestet me element ndërkombëtar:

Përkufizimi i kompetencës midis gjykatave tona dhe atyre të huaja bëhet sipas rregullave mbi kompetencën gjyqësore ndërkombëtare (*competence internationale*) të vendit tonë. Kompetenca ndërkombëtare duhet dalluar nga ajo territoriale, edhe pse e para zakonisht lidhet me atë të dytën. Rregullat për këtë kompetencë gjykatës sonë i japin përgjigje në pyetjen se a është kompetente apo jo për çështjen juridike me element të huaj e cila i është paraqitur me padi. Sipas LPK-së, gjykata jonë është kompetente për zgjidhjen e çështjes juridike, nëse: a) kompetenca e saj për zgjidhjen e kontestit me element ndërkombëtar është paraparë shprehimisht me ligj apo me kontratë ndërkombëtare, ose, nëse b) kur kompetenca e saj del nga dispozitat e ligjit për kompetencën territoriale (neni 28 i LPK). Vendimi i gjykatës së huaj i dhënë në pajtim me rregullat procedurale për kompetencën ndërkombëtare gëzon njohje në vendin tonë.

Ai nuk do të gëzojë njohje në shtetin tonë poqëse për çështjen për të cilën është dhënë ai ka qenë e paraparë kompetenca ekskluzive e gjykatës sonë.

7. Caktimi i kompetencës territoriale nga gjykata e lartë:

Caktimi i kompetencës territoriale nga gjykata e lartë bëhet në dy forma: në formë të delegimit apo në formë të ordinimit. Sipas rregullave të delegimit, gjykata e lartë e cakton gjykatën e cila do të gjykojë në çështjen juridike në vend të gjykatës së paraparë me LPK si kompetente për gjykimin e saj (neni 63 dhe 64 i LPK). Në disa raste delegimi (*forum delegatum*) paraqitet si masë e domosdoshme, si p.sh. kur në gjykatën kompetente, me numër të vogël gjyqtarësh, është bërë përjashtimi i të gjithë gjyqtarëve apo numrit të pamjaftueshëm të tyre për gjykim. Në rastet tjera delegimi i çështjes në gjykatën jokompetente bëhet për shkaqe të arsyeshme dhe të dobishme, si p.sh. kur në territorin e saj ndodhen mjetet provuese. Këtë delegim mund t'a propozojë pala apo gjykata kompetente. Kompetente për vendosje për propozimin është gjykata më e lartë e vendit.

Në rastet kur sipas dispozitave të ligjit nuk mund të konstatohet se cila gjykatë e vendit tonë është kompetente në pikëpamje territoriale, edhe pse me siguri çështja juridike konkrete hynë në juridiksionin civil të vendit tonë. Në rast të tillë atë e cakton Gjykata Supreme me propozim të palës e cila e ngritë padinë (neni 65 i LPK).

8. Vazhdimi i kompetencës:

Kompetencën e saj gjykata e çmon sipas detyrës zyrtare duke i marrë parasysh rrethanat që ekzistojnë në momentin e ngritjes së padisë (neni 17 i LPK). Ndryshimet që kanë ndodhur pas momentit të përmendur nuk janë relevante. Këtë situatë procedurale e quajmë perpetuatio fori (*vazhdim i kompetencës*). Mirëpo, nuk mund të ketë perpetuatio fori nëse gjatë gjykimit ndryshojnë rrethanat të cilat e bëjnë kompetent për çështjen juridike organin administrativ.

PËRBËRJA E GJYKATËS DHE PËRJASHTIMI I GJYQTARIT NGA GJYKIMI

1. Përbërja e gjykatës:

Me përbërjen e gjykatës kuptojmë përbërjen në të cilën ajo gjykon, që domethënë vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë, apo për mjetin e goditjes së vendimit gjyqësor. Me anë të dispozitave për përbërjen e gjykatës parashihet se kush e jep vendimin, në rastet e përmendura, trupi gjykues apo gjyqtari i vetëm. Gjykata e shkallës së dytë dhe në procedurën sipas revizionit vepron trupi gjykues i cili përbëhet prej tre gjykatësve profesional. Në gjykatën e shkallës së parë si dhe në procedurën sipas propozimit për përsëritjen e procedurës sipas dispozitave të LPK – neni 15.1 vepron gjyqtari individual (i vetëm).

2. Përfashtimi i gjyqtarit nga gjykimi:

Objektiviteti dhe paanësia e gjyqtarit që duhet ta zgjidh kontestin midis palëve është kërkesë nga plotësimi i së cilës varet autoriteti i punës së organeve gjyqësore. Në gjykimin konkret mund të ekzistojnë rrethanat të ndryshme të cilat e sjellin në dyshim objektivitetin dhe paanësinë e gjyqtarit. Ato mund të jenë të natyrës materiale, morale etj. Disa nga rrethanat e tilla e përjashtojnë gjyqtarin ex lege nga gjykimi, kurse të tjerat ndikojnë që me vendim të kryetarit të gjykatës (vendimi ky i natyrës administrative) të bëhet përjashtimi i gjyqtarit. Shkaqet e përjashtimit të gjyqtarit në ligj numërohen shprehimisht dhe taksativisht. Të tilla janë p.sh. qenia e gjyqtarit palë, përfaqësues i palës, bashkëkreditor, apo bashkëdebitor i palës ose i obliguar për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert; në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo, në qoftë se është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë, në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose te organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit, në qoftë se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë, në qoftë se është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi.

Kur vërtetohet se ekzistojnë rrethanat në fjalë, vetë gjyqtari kërkon nga kryetari i gjykatës që të caktojë zëvendësin e tij. Nëse ai nuk vepron kështu, pala ka të drejtë që të bëjë kërkesë për përjashtimin e tij dhe caktimin e zëvendësit. Shkaqet nga neni 67 paragrafi 1 pika g) për përjashtimin e gjyqtarit nga gjykimi theksohen kështu: **“në qoftë se ekzistojnë rrethanat të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij”** pra nuk numërohen shprehimisht dhe taksativisht në ligj. Mirëpo, shkaqe të tilla mund të jenë p.sh. gjinia e gjakut e gjyqtarit me njërin palë në shkallë më të largët se ajo e paraparë si

shkak për përjashtimin e tij nga gjykimi, mandej miqësia apo armiqësia e tij me palën, etj. Edhe këtu iniciativën mund ta marrë gjyqtari apo pala.

Nuk është e lejuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit në këto raste, si vijon:

- a) *Me të cilën kërkohet përjashtimi i të gjithë gjyqtarëve të gjykatës që do të mund të gjykonin në një kontest të caktuar;*
- b) *Për kërkesën për të cilën është vendosur njëherë;*
- c) *Në të cilën nuk është arsyetuar shkaku në bazë të të cilit kërkohet përjashtimi.*

Një kërkesë të tillë e hedhë poshtë gjyqtari që është duke proceduar çështjen dhe kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankesë e posaçme.

Mbi kërkesën e palës për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës

Supreme të Kosovës vendosë seanca e përgjithshme e gjyqtarëve të saj.

Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk lejohet ankimi, kurse kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa e tillë nuk lejohet ankimi i veçantë.

Dispozitat mbi përjashtimin e gjyqtarëve do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe ndaj procesmbajtësve.

Mbi përjashtimin e procesmbajtësit vendosë gjyqtari i çështjes.

PALËT DHE PËRFAQËSUESIT E TYRE

1. Nocioni i palës- Zotësia për të qenë palë:

Në procesin kontestimor gjithmonë paraqiten dy palë: paditësi (*actor*) dhe i padituri (*reus*). Subjekti i së drejtës (*personi fizik apo personi juridik*) e fiton cilësinë e palës paditëse apo të palës së paditur me vetë faktin e paraqitjes së padisë në gjykatë. I padituri bëhet subjekti i së drejtës pa vullnetin e tij.

Personi fizik e fiton zotësinë për të qenë palë që nga momenti i lindjes kurse personi juridik që nga momenti i regjistrimit në regjistrin përkatës. Zotësinë procedurale (pra mundësinë për të kryer veprime procedurale në gjykim) personi fizik e fiton me moshën 18 vjeçare (madhore) ndërsa i mituri që nuk e ka fituar plotësisht zotësinë për të vepruar, ka zotësi procedurale brenda kufijve në të cilët i njihet zotësia për të vepruar. Zotësia procedurale është cilësi e palës që personalisht dhe vleftësisht të kryej veprime procedurale. Pala me moshë më të vogël se 18 vjeç nuk e ka zotësinë procedurale, dhe në emër dhe llogari të saj, kryen veprime procedurale përfaqësuesi i saj ligjor (prindi apo kujdestari). Për palën që është person juridik, veprime procedurale në gjykim kryen personi fizik i caktuar me statutin e tij.

2. Përfaqësuesit e palëve:

E drejta procedurale, sikurse edhe ajo materiale, i njeh tre lloj përfaqësuesish: përfaqësuesin ligjor, përfaqësuesin e personit juridik dhe përfaqësuesin me prokurë (vullnetar).

- a) **Përfaqësuesi ligjor.**- *Përfaqësues të këtillë janë prindërit dhe kujdestari. Ata nuk i emëron vetë pala. Autorizimet e përfaqësuesit ligjor dalin drejtpërdrejt nga ligji apo nga akti i organit të kujdestarisë. Të miturin, i cili nuk është nën kujdestari, e përfaqësojnë, sipas ligjit, prindërit e tij bashkërisht. Kjo që u tha vlen edhe për atë të moshës madhore, të cilëve u është vazhduar e drejta prindore. Për pjesëmarrje në seancë gjykata i thërret të dy prindërit, por në letërthirrje shënohet vërejtja se përfaqësimi do të konsiderohet i rregullt edhe po që se në gjykatë paraqitet vetëm njëri nga ata. Parimisht, përfaqësuesi ligjor ka të drejtë që në emër të palës ti kryej të gjitha veprimet procedurale të cilave u jep shkas procesi gjyqësor konkret (nen. 77.1 i LPK).*

Në qoftë se gjatë procedurës para gjykatës të shkallës së parë tregohet se procedura e zakonshme rreth përcaktimit të përfaqësuesit ligjor për të paditurin do të zgjaste shumë, kështu që për këtë arsye do të mund të lindin pasoja të dëmshme për njëren apo për të dy palët, gjykata do ti caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm.

Nën kushtin nga paragrafi 1 i nenit 79 të LPK gjykata do ti caktojë të paditurit përfaqësuesin e përkohshëm sidomos në këto raste:

- a) *në qoftë se i padituri nuk e ka zotësinë procedurale, ndërsa nuk ka përfaqësuesin ligjor; b) në qoftë se ekzistojnë interesat e kundërta të të paditurit dhe të përfaqësuesit ligjor të tij, c) në qoftë se të dy palët kanë të njëjtin përfaqësues ligjor, Gjykata do t'i caktoj palës së paditur përfaqësuesin e përkohshëm edhe në këto raste: a) në qoftë se vendqëndrimi i të paditurit është i panjohur, kurse i padituri nuk ka përfaqësues me prokurë, b) në qoftë se i padituri ose përfaqësuesi ligjor i tij, nuk kanë përfaqësues me prokurë, ndodhen jashtë shtetit, kurse dërgimi i shkresave nuk ka mundur tu bëhet. Për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm gjykata do ta njoftojë pa shtyrje organin e kujdestarisë, si dhe palën kur kjo është e mundshme. Përfaqësuesi i përkohshëm ka në procedurë, për të cilën është caktuar, të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor. Këto të drejta dhe detyra përfaqësuesi i përkohshëm i ushtron derisa të paraqiten në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi me prokurë i tij, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftojë gjykatën se e ka caktuar kujdestarin. Në qoftë se përfaqësuesi i përkohshëm i është caktuar të paditurit për shkaqe të treguara në nenin 79 paragrafi 3 a dhe b të këtij ligji, gjykata brenda afatit prej shtatë ditësh do të japë shpallje, e cila do të botohet në gazetën zyrtare dhe afishohet në tabelën e gjykatës së çështjes, e sipas nevojës edhe në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme. Sipas ligjit të Kosovës para gjykatës të së cilës zhvillohet*

procedura, pala mundet vetë të ndërmarrë veprime në procedurë. Përfaqësuesi i tij ligjor mund të ndërmarrë veprime në procedurë vetëm gjersa ky shtetas të mos deklarojë se e ndërmerr vetë zhvillimin e kontestimit.

- b) *Përfaqësuesi i **personit juridik**.- Personat juridik marrin pjesë në qarkullimin juridik me anë të personave fizik, të cilët kryejnë veprime relevante. Personat fizik që veprojnë në emër të personave juridik caktohen zakonisht me statutin e tyre.*
- c) *Përfaqësuesi me **prokurë**.- Pala ka të drejtë që gjykimin ta ndjekë personalisht ose me anë të përfaqësuesit të zgjedhur (nen. 85 i LPK). Ai e mbështet autorizimin për përfaqësim në vullnetin e palës. Përfaqësuesin me prokurë pala që nuk ka zotësi procedurale e cakton nëpërmjet përfaqësuesit ligjor të saj. Autorizimi për përfaqësim quhet prokurë e cila është shkresë (dokument) në të cilën përmbahet autorizimi i tillë. Varësisht nga vëllimi i autorizimeve që jepen përfaqësuesit nga pala, prokura mund të jetë e përgjithshme dhe në bazë të saj përfaqësuesi mund ti kryejë të gjitha veprimet procedurale të cilave u jep shkas procesi, apo speciale, që do të thotë se në bazë të saj përfaqësuesi mund ti kryejë veprimet procedurale të caktuara.*

3. Legjitimimi real dhe procedural:

Përfaqësuesi është i detyruar që gjykatës t'ia paraqesë prokurën me shkrim qysh me rastin e kryerjes së veprimit procedural të parë. Nuk ka pengesë që përfaqësuesi me prokurë t'ia kaloj këtë personit tjetër (substituimi i përfaqësuesit). Personi të cilit i kalohet prokura (substituti) e përfaqëson palën, e jo përfaqësuesin e parë (substituensin). Me kalimin e prokurës ndryshimi bëhet vetëm në raportin e jashtëm (ndaj gjykatës dhe palës kundërshtare). Avokatin, si përfaqësues të palës, mund ta zëvendësojë ex lege praktikanti i zënë me punë në zyrën e tij, por vetëm në gjykatën e shkallës së parë (neni 90.4 i LPK). Pala e përfaqësuar ka të drejtë që të paraqitet në seanca gjyqësore dhe të kryej veprime procedurale krahas përfaqësuesit të saj, ta plotësojë çdo veprim të tij, si dhe ta ndryshoj apo ta revokoj veprimin e tij. Kështu, nga shkak se pala është dominus litis. Palën e përfaqësuar gjykata ka të drejtë t'a thërras në seancë me qëllim që nga ajo drejtpërdrejt të informohet lidhur me faktet e rëndësishme.

Gjykata i cakton afat për dorëzimin e prokurës personit që pretendon se është autorizuar nga pala për përfaqësim. Deri atëherë, mund ti lejohet kryerja e veprimeve procedurale. Nëse afati kalon pa sukses, gjykata më tutje vepron sikurse të mos ishte kryer veprimi procedural nga përfaqësuesi i tillë (*negociorum gestor*). Pala ka të drejtë që më vonë ti njohë veprimet e tija.

Palët mund të ndërmarrin veprime në procedurë personalisht ose me anë të autorizuesit, por gjykata mund të ftojë palën, që ka përfaqësues që në gjykatë personalisht të deklarohet për faktet që duhet vërtetuar në procedurën konkrete.

Pala të cilën e përfaqëson autorizuesi mund të vijë kurdoherë para gjykatës dhe të japë deklarata përpos autorizuesit të vetë.

Përfaqësues me prokurë i palës mund të jetë çdo person që ka zotësi të plotë për të vepruar.

Në qoftë se gjykata konstaton se përfaqësuesi i palës, që nuk është avokat nuk është i zoti ta kryej këtë detyrë, atëherë ajo duhet ta njoftoj palën me pasojat e dëmshme që mund të lindin për shkak të përfaqësimit të këtillë.

Veprimet në procedurë të cilat i kryen përfaqësuesi i palës brenda kufijve të autorizimit kanë efekte juridike sikur t'i ketë kryer vetë pala. Pala mund t'a ndryshojë ose t'a revokojë deklaratën e përfaqësuesit të vetë në seancën në të cilën është dhënë deklarata e tillë.

Në qoftë se përfaqësuesi i palës e ka pohuar ndonjë fakt në seancë, në të cilën nuk ka qenë e pranishme pala, apo në qoftë se ai e ka pohuar ndonjë fakt me anë të parashtrësës, kurse pala më vonë e ndryshon apo revokon pohimin e tillë, gjykata i vlerëson të dy deklaratat në pajtim me këtë ligj.

Pala mund t'a autorizojë përfaqësuesin e saj që t'i kryejë vetëm disa veprime të caktuara apo të gjitha veprimet në një procedurë.

Në qoftë se pala i'a ka dhënë prokurën për ndjekjen e çështjes në gjyq personit që është avokat, por pa i caktuar më për së afërmi autorizimet e tij, avokati në bazë të prokurës së këtillë është i autorizuar që:

- a) *t'i kryejë të gjitha veprimet në procedurë, e sidomos të paraqes padinë, ta tërheqë atë, ta parashtrorë përgjigjen në padi, ta pohojë kërkesëpadinë ose të heqë dorë nga kërkesëpadia, të lidhë pajtimin gjyqësor, të parashtrorë mjetin e goditjes së vendimit si dhe të heqë dorë nga kjo e drejtë apo ta tërheqë mjetin e tillë të parashtruar, por edhe të propozojë caktimin e masave të përkohshme të sigurimit të kërkesave;*
- b) *të parashtrorë kërkesë për ekzekutimin ose sigurimin dhe të kryejë veprime të nevojshme lidhur me kërkesën e tillë;*
- c) *të pranorë prej palës kundërshtare shpenzimet procedurale të caktuara nga gjykata;*
- d) *t'a autorizojë avokatin tjetër me shkrim që të kryejë disa veprime të caktuara procedurale, por jo edhe që të veprojnë në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.*

Për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës avokati i nevojitet prokurë e veçantë, në qoftë se nga koha kur vendimi është bërë i formës se prerë kanë kaluar më tepër se gjashtë muaj.

Avokatin mund ta zëvendësojë praktikanti që është duke punuar tek ai, por vetëm para gjykatës së shkallës së parë, nën konditat nga neni 90.4 i LPK.

Në qoftë se pala në prokurë nuk ia ka caktuar me hollësisht autorizimet përfaqësuesit, përfaqësuesi që nuk është avokat mundet në bazë të prokurës së tillë, t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale, por gjithmonë i nevojitet autorizim shprehimor për tërheqjen e padisë, për pohimin e kërkesëpadisë apo për heqjen dorë nga ajo, për lidhjen e pajtimit gjyqësor, për heqjen dorë nga e drejta e paraqitjes së mjetit të goditjes së vendimit, apo për tërheqjen e tij dhe për kalimin e prokurës një personi tjetër, si dhe për paraqitjen e mjeteve të jashtëzakonshme të goditjes së vendimeve.

Përfaqësuesi me prokurë i palës që është person juridik edhe kur nuk është avokat, mund t'i kryejë të gjitha veprimet nga paragrafi 1 i këtij neni pa pasur nevojë për autorizim shprehimor të saj. Pala e jep autorizimin për përfaqësim në formë të shkruar ose gojarisht në procesverbal tek gjykata.

Pala që nuk di shkrim /lexim ose që nuk është në gjendje të nënshkruhet do të vejë në prokurën e shkruar, shenjën e gishtit tregues. Në qoftë se në këtë rast prokura i jepet personit që nuk është avokat, nevojitet prania e dy dëshmitarëve, të cilët do të nënshkruhen në prokurë.

Po që se dyshohet në vërtetësinë e prokurës, gjykata mund të vendosë me aktvendim që të paraqitet prokura e verifikuar. Kundër këtij aktvendimi nuk lejohet ankimi.

I autorizuari për përfaqësim ka për detyrë që në veprimin e parë gjatë procedurës të paraqes prokurën.

Gjykata mund të lejojë që veprimet në procedurë për palën përkohësisht ti kryejë personi që nuk e ka paraqitur prokurën, por njëkohësisht do ti urdhërojë këtij personi që më vonë në një afat të caktuar, ta paraqes prokurën ose autorizimin e palës për kryerjen e shqyrtimit kontestimor.

Për derisa të mos kalojë afati për paraqitjen e prokurës, gjykata do ta shtyjë marrjen e vendimit përfundimtar. Në qoftë se ky afat kalon pa sukses, gjykata do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi pa prokurë, dhe do të vazhdojë ta procedojë çështjen pa i marrë në konsideratë veprimet e kryera nga ai.

Gjykata ka për detyrë që gjatë gjithë procedurës të kujdeset nëse personi që prezantohet si përfaqësues është i autorizuar për përfaqësim. Po që se gjykata konstaton se personi që prezantohet si përfaqësues nuk është i autorizuar nga pala për një gjë të tillë, do t'i anulojë veprimet procedurale të kryera nga personi i tillë, po që se veprimet e tija pala nuk i ka pranuar më vonë.

Pala mund ta revokojë në çdo kohë prokurën, kurse autorizuesin mund ta denoncojë në çdo kohë.

Revokimi, respektivisht denoncimi i prokurës duhet ti komunikohet gjykatës para së cilës zhvillohet procedura, me shkrim ose me gojë në procesverbal.

Revokimi, respektivisht denoncimi i prokurës vlenë për palën kundërshtare që nga momenti kur ti jetë komunikuar.

Neni 94.4 i LPK parasheh që pas denoncimit të prokurës përfaqësuesi ka për detyrë që edhe 15 ditë të kryejë veprime procedurale për palën që ia ka dhënë atë, po që se është nevoja që të evitohet ndonjë dëm që mund t'i shkaktohet brenda kësaj kohe.

Ndërsa neni 95.1 i LPK parasheh këtë risi: Me vdekjen e personit fizik, gjegjësisht me shuarjen e personit juridik shuhet edhe prokura të cilën ai e ka dhënë. Më pare të autorizuarit i cili ishte avokat nuk i shihej prokura siç ndodhte me përfaqësuesin me prokurë i cili nuk ishte avokat (neni 100 i LPK paraprake).

GJUHA NË PROCEDURË

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë kanë të drejtë që në procedurën para gjykatës të përdorin gjuhën e vet apo gjuhën të cilën e kuptojnë.

Në qoftë se procedura nuk zhvillohet në gjuhën e palës, gjegjësisht të pjesëmarrësve të tjerë në procedurë, do të sigurohet sipas kërkesës së tyre përkthimi gojarisht në gjuhën e tyre apo në gjuhën që e kuptojnë, i të gjitha parashtrësve dhe provave shkresore, si dhe i asaj që parashtrëhet në seancë gjyqësore.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë do të njoftohen me të drejtën që procedurën verbale ta ndjekin në gjuhën e tyre me anë të përkthyesit. Ato mund të heqin dorë nga e drejta e përkthimit, po që se deklarojnë se e njohin gjuhën në të cilën zhvillohet procedura. Në procesverbal do të shënohet se u është dhënë udhëzimi për të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre, si dhe deklaratat e palëve dhe të pjesëmarrësve të tjerë lidhur me udhëzimin e dhënë nga gjykata.

Përkthimin e bëjnë përkthyesit.

Shpenzimet e përkthimit mbetën në ngarkim të buxhetit të gjykatës.

Letërthirrjet, vendimet dhe shkresat tjera gjyqësore u dërgohen palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurë në gjuhën që është në përdorimin zyrtar në gjykatë.

Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë i dërgojnë gjykatës paditë, ankesat dhe parashtrësat e tjera të tyre në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë.

Në qoftë se në gjykatë është në përdorim edhe ndonjë gjuhë e pakicave në Kosovë gjykata do tu dërgojë në këtë gjuhë letrat gjyqësore atyre palëve dhe pjesëmarrësve, në procedurë që i përkasin kësaj pakice dhe që në procedurë e përdorin këtë gjuhë. Palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë mund të kërkojnë që letrat gjyqësore tu dërgohen në gjuhën në të cilën zhvillohet procedura.

Shpenzimet e përkthimit në gjuhën e kombit dhe të pakicave të Kosovës, që lindin me aplikimin e dispozitave të kushtetutës dhe të këtij ligji mbi të drejtën e pjesëmarrësve të kombeve dhe të pakicave të Kosovës për përdorimin e gjuhës së vetë, ngarkojnë mjetet e buxhetit të gjykatës.

PARASHTRËSAT

Forma e veprimeve procedurale.- Veprimet procedurale palët i kryejnë sipas rregullit në seanca gjyqësore gojarisht, kurse jashtë seancave me shkrim. Disa nga veprimet e palëve gjithmonë kryhen në formë të shkruar. Të tilla janë: padia, përgjigja në padi, mjetet e goditjes së vendimeve deklaratat e tjera, propozimet e njoftimet etj.

Pjesët përbërëse të parashtresës.- Në aspektin e jashtëm parashtresa përbëhet prej tri pjesëve: pjesës hyrëse, përmbajtjes së deklaratës dhe nënshkrimit (firmës) të parashtruesit.

Pjesa hyrëse e përmban: emrin e gjykatës së cilës i drejtohet parashtresa; numrin e dosjes së lëndës po që se kontesti është inicuar më parë; emërtimin e palës, të përfaqësuesit ligjor apo me prokurë (pala emërtohet duke u treguar roli procedural i saj, emri dhe mbiemri i saj, profesioni vendbanimi - kur është në pyetje personi fizik - emri apo firma dhe selia, kur si palë paraqitet personi juridik); vlera e objektit të kontestit (kur nga ajo varet kompetenca lëndore e gjykatës); emërtimin e parashtresës; numrin e kopjeve dhe shkresave që i bashkëngjiten parashtresës, me vërejtje se a janë origjinal apo kopje.

Përmbajtjen e parashtresës e përbënë deklarata, të cilën pala ia parashtron gjykatës. Deklarata mund të ketë rëndësinë e kërkesës, propozimit apo të kumtesës. Kur kemi të bëjmë me kërkesën, për veç kërkesës së formuluar kjashtas, në këtë pjesë të parashtresës duhet të tregohen faktet në të cilat mbështetet kërkesa, si dhe mjetet provuese lidhur me çdo fakt. Krahas saj, në fund të deklaratës mund të tregohet propozimi i palës lidhur me kërkesën e saj, e në rast se palës i duket e arsyeshme tregohet edhe mendimi juridik lidhur me kërkesën.

Parashtresa në fund nënshkruhet nga ana e palës apo përpiluesit të saj si përfaqësuesit ligjor të palës apo ai me prokurë duke ja bashkëngjitur të njëjtës edhe autorizimin përkatës.

Shkresat të cilat i bashkëngjiten parashtresës i dorëzohen gjykatës në origjinal ose të kopjuara (nen. 101 i LPK). Ato zakonisht e kanë rëndësinë e mjetit provues. Kopja e shkresës i bashkëngjitet secilit ekzemplar të parashtresës (nen. 101 i LPK).

DËRGIMI I SHKRESAVE

MËNYRA E DËRGIMIT

Parimi kontradiktoritetit mund të realizohet në tërësi vetëm nëse palëve u jepet mundësia që të njoftohen me përmbajtjen e veprimeve procedurale të shkruara si dhe me kohën dhe vendin e caktuar për kryerjen e veprimeve procedurale. Realizimit të kësaj detyre i shërben instituti i komunikimit. Veprimet shkresore të palës kundërshtare, vendimet gjyqësore, urdhëresat, kumtesat dhe thirrjet në formë shkresore barten dhe i dorëzohen personit të cilit i janë dedikuar ato- adresantit. Veprimi i tillë i gjykatës quhet komunikim. Komunikimi i kryer protokollohet me një lloj të posaçëm procesverbali të cilin e quajmë dëftesë të komunikimit.

Dërgimin e shkresave e bënë gjykata sipas detyrës zyrtare, nëpërmjet postës, me anë të nëpunësit gjyqësor apo nëpërmjet organit shtetëror të komunës. Në disa raste adresanti dhe marrësi i shkresës nuk është person i njëjtë. Kur pala vepron në procedurë nëpërmjet përfaqësuesit, shkresat nuk i dorëzohen palës, edhe pse ajo është adresant, veçse përfaqësuesit të saj ligjor apo me prokurë.

Përfaqësuesi për pranimin e shkresave

Kur paditësi apo përfaqësuesi i tij ndodhët në botën e jashtme, e nuk kanë përfaqësues në Kosovë, kanë për detyrë që me rastin e paraqitjes së padisë në gjykatë të emërojnë përfaqësuesin për pranimin e shkresave. Po që se ata nuk veprojnë kështu, gjykata me shpenzimet e paditësit ia emëron këtij përfaqësuesin për marrjen e shkresave dhe nëpërmjet tij thirret paditësi apo përfaqësuesi i tij, që brenda afatit të caktuar ta emërojnë përfaqësuesin për marrjen e shkresave. Po që se pala apo përfaqësuesi i saj nuk e cakton përfaqësuesin për marrjen e shkresave brenda afatit të caktuar, gjykata e hedhë poshtë padinë me anë të aktvendimit të cilin ia dërgon paditësit, apo përfaqësuesit të tij, nëpërmjet përfaqësuesit për marrjen e shkresave të emëruar nga ajo.

Dërgimi i shkresave nga vetë palët

Dërgimi i shkresave palës kundërshtare, përveç shkresave që duhet dorëzuar personalisht, mund të bëhet me pëlqimin e gjykatës, edhe nga vete pala.

Në situatën e tillë, pala një ekzemplar do t'ia dërgojë palës kundërshtare në pajtim me dispozitat e këtij ligji mbi komunikimin, kurse ekzemplar të tjetër gjykatës, me njoftim se palës tjetër i është bërë dërgimi që më parë.

SEANCAT DHE AFATET

Seancat

Seancë quhet pjesa e kohës gjatë së cilës subjektet kryesore të procesit dhe pjesëmarrësit e tjerë të tij kryejnë veprime procedurale. Seancën e cakton ex officio gjykata atëherë kur një gjë e tillë e parasheh ligji apo e kërkojnë nevojat procedurale.

Personat që duhet të jenë të pranishëm në seancë i thërret gjykata. Një gjë e tillë ajo e bënë me anë të letërthirrjes, në të cilën tregohet lënda, koha dhe vendi i kryerjes së aktivitetit procedural si dhe roli procedural i të ftuarit. Ajo duhet të përmbajë edhe udhëzimin për pasojat që lindin në rast të mosardhjes në seancë (nen. 123.4). Së bashku me thirrjen apo ftesën për seancë gjykata ka për obligim që palët së paditur ti dërgoi edhe një kopje të aktit inicial të procedurës (padinë) së bashku me shkresat eventuale të prezantuara nga ana e personit i cili ka inicuar procedurën përveç kur caktohet seanca për pajtim te kontestet martesore.

Afatet

- 1) **Shqyrtime hyrëse-** Zakonisht,veprimet procedurale nga gjykata dhe palët kryhen në kohën e caktuar dhe në vendin e caktuar, Gjykatat shtetërore janë të përhershme dhe veprimtaria e tyre lidhet për vendin e caktuar me ligj në të cilën ndodhet lokali ku ushtrohet aktiviteti gjyqësor. Përjashtimisht, veprimet procedurale gjykata i kryen jashtë ndërtësës gjyqësore. I tillë është rasti me komunikimin e shkresave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve dhe palëve të sëmurura, mandej me shikimin në vend të sendit të paluajtshëm etj. Për kryerjen e veprimeve procedurale nga gjykata dhe palët LPK i parasheh seancat dhe afatet. Në të kundërtën gjykimet nuk do të mbaronin shpejt. Afatet caktohen zakonisht për kryerjen e veprimeve të shkruara, kurse seancat për kryerjen e veprimeve orale (gojarisht).
- 2) **Afatet ligjore dhe gjyqësore.-** Afat quhet distanca kohore brenda së cilës duhet të kryhet apo mund të kryhet veprimi procedural i caktuar. Varësisht nga ajo se kush i cakton, afatet ndahen në afate ligjore dhe gjyqësore. Afatin e caktuar nga ligji nuk mund ta ndryshoj as gjykata e as palët. Ligjor është p.sh. afati për paraqitjen e ankesës (neni 176 i LPK): ai për paraqitjen e propozimit për restitutio in integrum (neni 130 i LPK), ai për kërkimin e shpenzimeve në rast të tërheqjes së padisë (neni 463 i LPK) etj. Afatet gjyqësore gjykata është e autorizuar t'i caktoj vet p.sh. në bazë të nenit 102 të LPK, për korrigjimin e parashtresës, për dorëzimin e dokumentit, për dorëzimin e mendimit të shkruar nga eksperti (neni 366 i LPK) etj.

Afatet ligjore quhen prekluzive, sepse pas skadimit të tij nuk mund të kryhet veprimi procedural i afatizuar. Të gjitha afatet e kanë ditën e fillimit (dies a quo) dhe të fundit (dies ad quem). Afati është i natyrës subjektive nëse fillimi i tij varet nga dijenia e palës për ngjarjen që është relevante për llogaritjen e afatit, apo nga mundësia e saj që ta kryej veprimin procedural. Afati është i natyrës objektive, nëse llogaritja e tij bëhet

nga momenti në të cilin shkaktohet fakti relevant, duke mos marrë parasysh dijeninë subjektive të palës për faktin e tillë.

Afatet të cilat caktohen nga gjykata mund të zgjaten me propozimin e personit të interesuar, po që se për këtë gjë ekzistojnë shkaqet e arsyeshme. Propozimi duhet të paraqitet para skadimit të afatit zgjatja e të cilit kërkohet. Po që se gjykata e lejon zgjatjen e afatit kundër një vendimi të tillë ankesa nuk është e lejuar (neni 125.4 i LPK).

Njësia kohore për llogaritjen e afateve sipas ligjit e edhe për afatet e caktuara nga gjykata janë ditët, muajt dhe vitet. Kur afati është caktuar në ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme. Në qoftë se p.sh., ngjarja (dorëzimi i vendimit) nga e cila duhet llogaritur afatin 15 ditor (për ankesë) ka ndodhur me 28 shkurt, afati fillon të nesërmen pra me 29 shkurt e nëse nuk ka këtë ditë atëherë me 1 mars është dita e parë e afatit i cili do të skadojë me 15 mars në mesnatë. Kur dita e fundit e afatit bie të dielën ose në një ditë feste shtetërore apo ndonjë ditë tjetër kur nuk punon gjykata, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.

Afatet e caktuar në muaj, respektivisht në vite përfundohen me skadimin e asaj dite të muajit të fundit respektivisht të vitit që sipas numrit të vet i përgjigjet ditës kur ka filluar afati. Në qoftë se nuk ka ditë të tillë në muajin e fundit afati përfundon ditën e fundit të atij muaji.

Kur parashtresa është e lidhur me afat, konsiderohet se është dhënë në afat, po që se para se të ketë skaduar afati, i dorëzohet gjykatës kompetente.

Në qoftë se parashtresa është dërguar me anë të postes me letër rekomande apo në rrugë telegrafike, dita e dorëzimit në postë konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatën të cilës i është drejtuar. Po që se parashtresa është dërguar me anë të telefaksit si ditë e dorëzimit konsiderohet dita kur telefaksi është pranuar në gjykatë.

Në qoftë se parashtresa është dërguar në rrugë telegrafike kurse nuk përmban çdo gjë që nevojitet për të vepruar sipas saj, do të konsiderohet se është dhënë në afat, vetëm po që se brenda afatit tre ditor nga dita kur telegrami i është dorëzuar postës, në gjykatë dorëzohet parashtresa drejtpërsëdrejti apo me anë të letrës rekomande.

Për personat që ndodhën në ushtri në shërbim të detyrueshëm ushtarak, dita e dorëzimit të parashtresës në njësinë ushtarake, gjegjësisht në institucionin ushtarak konsiderohet si ditë e dorëzimit në gjykatë.

Për personat e privuar nga liria dita e dorëzimit të parashtresës në drejtorinë e burgut, të institucionit ndëshkimor korrektues apo të shtëpisë edukative – korrektuese konsiderohet si ditë kur i është dorëzuar gjykatës.

Në qoftë se parashtresa që lidhet me afat i është dorëzuar apo dërguar gjykatës jokompetente brenda afatit, kurse në gjykatën kompetente arrin pas skadimit të afatit, do të konsiderohet se është ruajtur afati po që se paraqitja e saj në gjykatën jokompetente mund t'i vishet padijenisë apo gabimit të hapur të parashtruesit.

KTHIMI NË GJENDJEN E MËPARSHME

Kthimi në gjendjen e mëparshme i njohur me maksimën - restitutio in integrum.- është situata kur pala për shkaqe të arsyeshme (sëmundja, aksidenti në komunikacion, mosarritja me kohë e mjetit të komunikacionit publik në qendrën e gjykatës, prishja në automobilin me të cilin pala është nisur për në gjykatë, vërshimi, tërmeti e shumë e shumë raste të tjera të ndryshme) nuk ka mundur të marrë pjesë në seancë, apo ta kryej veprimin procedural brenda afatit prekluziv, ajo ka të drejtë që nga gjykata të kërkoj kthimin në gjendjen e mëparshme.

Këtë kërkesë pala duhet ta paraqes brenda afatit 7 ditor nga dita në të cilën është hequr pengesa për kryerjen e veprimit procedural (nen. 130.2 i LPK). Pas kalimit të 60 ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohet kthimi në gjendjen e mëparshme(neni 130.3), pa marrë parasysh se kur është hequr pengesa. Ky afat brenda të cilit fillon dhe mbaron së ecuri afati 7 ditor (subjektiv) për paraqitjen e propozimit për restitutio quhet objektiv.

Propozimit për restitutio pala duhet t'ia bashkangjesë veprimin procedural (p.sh. ankesën) të cilën nuk e ka kryer brenda afatit ligjor prekluziv. Seancën gjykata nuk e cakton fare në qoftë se janë të ditura botërisht (notore) faktet mbi të cilat është bazuar propozimi i palës për restitutio (nen. 133.2 i LPK).

Kundër aktvendimit të gjykatës mbi lejimin e kthimit në gjendjen e mëparshme nuk lejohet ankesa e veçantë dhe në nenin 133.4 të LPK parashihet se kundër aktvendimit me të cilin refuzohet propozimi për kthimin në gjendje të mëparshme nuk lejohet ankim i veçantë, përveç kur propozimi paraqitet nga shkaku i dhënies së aktgjykimit për shkak të mungesës së palës së paditur nga seanca gjyqësore.

PROCESVERBALET

Procesverbali gjyqësor është dokument publik të cilin e përpilon gjykata për veprimet procedurale të kryera gojarisht, në seancë apo jashtë seancës, nga palët dhe pjesëmarrësit e tjerë në procedurë (neni 134 i LPK). Procesverbali përmban shënime të protokolluara mbi veprimet e ndërmarra procedurale gjatë seancave dhe jashtë tyre. Procesverbali e ka përmbajtjen e tij në kuptimin formal dhe në kuptimin material. Përmbajtjen në kuptimin formal (pjesët përbërëse) të procesverbalit e përbëjnë: pjesa hyrëse, përshkrimi i veprimeve të kryera dhe nënshkrimi. Në pjesën hyrëse procesverbali duhet t'i përmbajë: emrin e gjykatës, vendin ku kryhet veprimi, ditën dhe orën kur kryhet veprimi, objektin e kontestit dhe emrat e palëve të pranishme ose të personave të tjerë, si dhe të përfaqësuesve ligjorë ose me prokurë të tyre, procesverbali duhet të përmbajë të dhëna esenciale për përmbajtjen e veprimit të kryer. Në procesverbalin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes duhet të përfshihet sidomos: nëse seanca është mbajtur me dyer të hapura apo të mbyllura, përmbajtja e deklaratave të palëve, propozimet e tyre, provat që i kanë ofruar, provat që janë shfrytëzuar, duke u treguar përmbajtja e thënieve të dëshmitarëve dhe ekspertëve, vendimet e gjykatës të marra në

seancë, por edhe vendimi burimor i dhënë pas përfundimit të seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes juridike.

Procesverbali duhet të mbahet rregullisht, në të nuk guxon të fshihet asgjë, të shtohet ose të ndryshohet. Pjesët e tija të anuluar duhet të mbeten të lexueshme.

Përpilimi i procesverbalit bëhet në atë mënyrë që i njëjti përpilohet duke i treguar gjyqtari procesmbajtësit me zë se çka do të shkruajë në procesverbal. Me lejen e gjyqtarit, pjesëmarrësit në procedurë përmbajtjen e deklaratave të tyre mund ta diktojnë në procesverbal nëpërmjet procesmbajtësit.

Palët kanë të drejtë ta lexojnë ose të kërkojnë që t'u lexohet procesverbali, si dhe të paraqesin kundërshtimet e veta në përmbajtjen e procesverbalit. Këtë të drejtë e kanë edhe personat e tjerë, deklarata e të cilëve është përfshirë në procesverbal, por vetëm sa i përket pjesës së procesverbalit që e përmban deklaratën e tyre.

Korrigjimet apo shtesat lidhur me kundërshtimet e palëve apo të personave të tjerë në përmbajtjen e procesverbalit, apo me iniciativën e gjyqtarit, bëhen në fundin e procesverbalit. Me kërkesën e subjekteve të përmendura shkruhen në procesverbal edhe kundërshtimet e tyre të pa aprovuara nga gjyqtari.

Gjyqtari mund të vendosë që procesverbali të mbahet me anë të mjeteve teknike gjegjëse, apo me anë të stenografimit.

Po që se procesverbali nuk është mbajtur në formë të shkruar, procesverbali i shkruar duhet të përpilohet brenda afatit prej tri ditësh. Brenda tri ditëve të tjera palët kanë të drejtë ta shikojnë dhe kopjojnë procesverbalin e shkruar dhe të bëjnë kundërshtime lidhur me parregullsitë eventuale të tij.

Mbi kundërshtimin nga paragrafi 3 i këtij neni vendosë gjyqtari jashtë seance.

Shiriti i magnetofonit mund të shlyhet pas skadimit të afatit për kundërshtim, e nëse pala ka bërë kundërshtim lidhur me saktësinë e procesverbalit, pasi të bëhet i formë së prerë vendimi mbi çështjen kryesore.

Procesverbali nënshkruhet nga gjyqtari, procesmbajtësi, palët, përkatësisht nga përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i palës, si dhe nga interpreti.

Dëshmitari dhe eksperti e nënshkruajnë deklaratën e vet në procesverbal vetëm atëherë kur dëgjimi i tyre bëhet në gjykatën e porositur.

Personi që nuk dinë shkrim dhe lexim ose personi që nuk mund të nënshkruhet do të vejë në procesverbal shenjën e gishtit tregues, kurse procesmbajtësi e shkruan nën shenjën e gishtit emrin dhe mbiemrin e tij.

Po që se pala, përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj, dëshmitari apo eksperti largohet para se të nënshkruhet në procesverbal apo refuzon të nënshkruhet, kjo rrethanë shënohet në procesverbal dhe tregohet arsyeja e mos nënshkrimit.

Në qoftë se vendimi merret në trup gjykues, për këshillimin dhe votimin përpilohet procesverbal i veçantë. Po që se në gjykatën e lartë, lidhur me mjetin e goditjes së vendimit, vendimi është marrë unanimisht, nuk do të përpilohet procesverbal, por në vendimin burimor do të vihet shënim për këshillimin dhe votimin.

Procesverbali mbi këshillimin dhe votimin duhet të përmbajë rrjedhën e votimit dhe vendimin që është marrë. Procesverbalin e nënshkruajnë anëtarët e trupit gjykues dhe procesmbajtësi.

Procesverbali mbi këshillimin dhe votimin mbyllet në një zarf të veçantë.

Ky procesverbal mund të shikohet vetëm nga gjykata më e lartë kur vendosë mbi mjetin juridik, e në këtë rast procesverbali do të mbyllet përsëri në një kopertinë të veçantë në të cilën do të shënohet se procesverbali është shikuar.

VENDIMET GJYQËSORE

Gjykata e përfundon shqyrtimin kryesor kur konsideron se objekti i gjykimit është shqyrtuar mjaft dhe se mund të fillojë vendosje meritore. Mirëpo kolegji mund të vendosë që shqyrtimi të rihapet në qoftë se me rastin e këshillimit konstaton se çështja ende nuk është përgatitur për vendosje.

Në shumicën dërmuese të rasteve procedura kontestimore merr fund me vendim gjyqësor. Me vendimin me të cilin pranohet apo refuzohet kërkesëpadia, gjykata e kryen detyrën e saj. Efekt të njëjtë ka edhe vendimi me të cilin gjykata e hedhë poshtë padinë për shkak se nuk ekzistojnë kushtet e natyrës procedurale (prezumimet procedurale) të domosdoshme për vendosje meritore mbi kërkesëpadinë. Vendimin e parë e quajmë meritore, sepse me të çështja juridike (kontesti) zgjidhet në themel. Vendimi i dytë është i natyrës procedurale, sepse me të gjykata nuk shprehet në themel të çështjes. Edhe të parin e edhe të dytin i quajmë vendime përfundimtare, sepse me dhënien e tyre merr fund procedimi i një çështjeje nga gjykata kompetente.

Parimisht, në procedurën kontestimore gjykata nuk krijon të drejta subjektive e as që i ndryshon apo i ndërpret të drejtat e tilla ekzistuese. Ajo vetëm bënë konkretizimin e së drejtës materiale duke e zbatuar normën juridike abstrakte mbi gjendjen faktike të konstatuar në procesin kontestimor. Nga ky parim përjashtim bënë aktgjykimi transformues. Me të cilin ndryshohen ose prishen raportet juridike që janë objekt i tërthortë i gjykimit.

Ligji për Procedurën Kontestimore në dispozitën e nenit 141.1 parasheh që kur Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstaton se është shkelur ndonjë e drejtë ose liri themelore e njeriut e paraparë në Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe të Lirive të Njeriut dhe në Protokollin plotësues të Konventës, pala brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita që ka marrë formë të prerë vendimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, mund të parashtrijë kërkesë për ndryshimin e vendimit me të cilin është shkelur ajo.

Kërkesa parashtrihet në Gjykatën e Kosovës që ka vepruar në shkallë të parë, në procedurën në të cilën është marrë vendimi, me të cilin është shkelur e drejta ose liria themelore e njeriut.

Në procedurën sipas kërkesës për ndryshimin e vendimit me të cilin është shkelur e drejta apo liria e njeriut, në mënyrë të përshtatshme zbatohen dispozitat e këtij ligji për përsëritjen e procedurës.

Në procedurën e përsëritur gjykata është e detyruar që t'i marrë në konsideratë qëndrimet e shprehura në vendimin e formës së prerë të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut me të cilin është konstatuar shkelja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Gjykata jep vendime në seancë gjyqësore apo jashtë seance. Ato jepen në formë të aktgjykimit apo të aktvendimit. Mbi kërkesëpadinë gjykata vendosë me aktgjykim, kurse në procedurën sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit me aktvendim. Në procedurën e dhënies së urdhërpagesës aktvendimi me të cilin aprovohet kërkesëpadia jepet në formë të urdhërpagesës. Për të gjitha çështjet tjera gjykata vendosë me anë të aktvendimit kurse vendimi mbi shpenzimet procedurale i përmbajtur në aktgjykim konsiderohet aktvendim.

AKTGJYKIMI

Me aktgjykim gjykata vendosë për themelësinë e kërkesëpadisë e cila është objekt i gjykimit (procedimit). Përveç vendimit për kërkesëpadinë, në aktgjykim përmbahet edhe vendimi për kërkesën aksesore (kamata dhe dënimi kontraktual), e edhe vendimi për shpenzimet gjyqësore, për vetëm në qoftë se një gjë të tillë e kanë kërkuar ndonjëra nga palët. Pjesa e aktgjykimit që i përmban këto vendime quhet dispozitiv. Përveç tij ai e ka edhe pjesën hyrëse edhe pjesën arsyetuese.

Sipas llojit të mbrojtjes, të cilin e jep me pranimin e kërkesëpadisë, aktgjykimi mund të jetë detyrues (kondemnator), vërtetues (deklarator) ose transformues (konstitutiv). Aktgjykimi me të cilin refuzohet kërkesëpadia, gjithmonë është vërtetues, pa marrë parasysh llojin e padisë lidhur me të cilin është dhënë. Me të konstatohet se kërkesëpadia është e pathemeltë.

Aktgjykimi dënues është aktgjykimi me të cilin pranohet kërkesëpadia dhe detyrohet i padituri që të përmbushë prestimin e detyruar në dobi të paditësit. Me të caktohet afati për ekzekutimin vullnetar të prestimit (afati paritiv).

Aktgjykimi vërtetues quhet aktgjykimi me të cilin gjykata në dispozitivin e tij njuh vetëm qenien ose mosqenien e një marrëdhënie juridike, të një të drejte, të një fakti juridik, vërtetësinë apo jo vërtetësinë e një dokumenti. Këtë aktgjykim gjykata e jep lidhur me padi njohje pozitive kur konstaton se kërkesëpadia është e themeltë, prandaj edhe e pranon atë.

Aktgjykimi transformues është aktgjykimi me të cilin pranohet si e themeltë kërkesëpadia e parashtruar me padi transformimi. Me këtë aktgjykim gjykata e ndryshon apo e anulon raportin juridik nga i cili për palët dalin të drejta dhe detyrime. Ky aktgjykim ndikon ndaj të gjithëve (erga omnes). Ndërkaq ai me të cilin refuzohet kërkesa e paditësit ndikon vetën midis palëve (inter partes). Mirëpo, në disa raste, si p.sh., në kontestet martesore apo të atësisë, edhe aktgjykimi me të cilin refuzohet kërkesëpadia ndikon erga omnes.

Sipas rëndësisë, të cilin e ka për përfundimin e kontestit, aktgjykimi mund të jetë përfundimtar apo i ndërmjetshëm.

Aktgjykimi i ndërmjetshëm quhet ai me të cilin gjykata vendosë vetëm për themelësinë e bazës juridike në të cilin paditësi e mbështetë kërkesëpadinë, por jo edhe lartësinë e kërkesëpadisë. Këtë aktgjykim gjykata e jep në gjykimin në të cilin objekt kontesti është kërkesa në të holla apo në sende të zëvendësueshme.

Duke e marrë parasysh pjesëmarrjen e të paditurit në procedurë, aktgjykimi mund të jetë aktgjykim për shkak të mungesës, apo kontradiktor.

Ndërsa duke marrë parasysh formen mund të kemi aktgjykim në bazë të pohimit, në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, aktgjykim për shkak të padëgjueshmërisë – mosbindjes, aktgjykim për shkak të mungesës.

a) Aktgjykimi i pjesshëm

Ky lloj aktgjykimi nxjerrët nga ana e gjykatës në rastet kur disa prej kërkesëpadive, për shkak të pohimit ose në bazë të shqyrtimit të mjaftueshëm, njëra ose disa sosh, janë pjekur për vendim definitiv dhe meritore apo në qoftë se vetëm pjesa e një kërkesë është pjekur për vendim meritore, gjykata mundet, në pikëpamje të kërkesave të përgatitura, përkatësisht të pjesës së kërkesës së përgatitur, ta përfundoj shqyrtimin dhe ta jep aktgjykimin (aktgjykimi i pjesshëm).

b) Aktgjykimi në bazë të pohimit

Në rastin kur i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit).

c) Aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

Po që se paditësi heq dorë nga kërkesëpadia apo një pjesë e saj gjykata pa shqyrtim të mëtejshëm e jep aktgjykimin me të cilin e refuzon kërkesëpadinë në pjesën nga e cila paditësi ka hequr dorë apo në tërësi.

d) Aktgjykimi për shkak të padëgjueshmërisë - mosbindjes

Ky lloj i aktgjykimit i paraparë në dispozitën e nenit 150 të LPK nxjerrët nga ana e gjykatës në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes),

Në situatën kur nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, gjykata cakton seancë përgatitore dhe po që se në seancën e këtillë paditësi nuk e ndryshon padinë, jep aktgjykim me të cilin e refuzon kërkesëpadinë.

Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin refuzohet propozimi i paditësit që të jepet aktgjykimi për shkak të mosbindjes nuk lejohet ankimi.

e) *Aktgjykimi për shkak të mungesës*

Në situatën kur të paditurit padia nuk i është dërguar për përgjigje, por vetëm bashkë me letërthirrje për në seancë përgatitore, e ai nuk vjen në seancë deri në përfundimin e saj, apo në seancën e parë për shqyrtim kryesor, nëse seanca përgatitore nuk është caktuar fare, gjykata me propozimin e paditësit apo sipas detyrës zyrtare e jep aktgjykimin me të cilin aprovohet kërkesëpadia.

f) *Aktgjykimi pa shqyrtim kryesor të çështjes*

Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të LPK), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.

DHËNIA, HARTIMI ME SHKRIM DHE DËRGIMI I AKTGJYKIMIT

Gjykata e jep aktgjykimin më së voni brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e përfundimit të shqyrtimit kryesor. Koha në të cilën jepet aktgjykimi quhet dita në të cilën ai hartohet me shkrim.

Pas përfundimit të shqyrtimit kryesor gjykata i njofton palët e pranishme për ditën e dhënies së aktgjykimit. Po që se ndonjëra nga palët nuk ka marrë pjesë në seancën për shqyrtimin kryesor, gjykata me shkrim do të njoftoj atë për ditën e dhënies së aktgjykimit.

Në qoftë se palët janë njoftuar rregullisht për ditën e dhënies së aktgjykimit, afati për ankim kundër aktgjykimit fillon te ecë ditën e nesërme pas dorëzimit të aktgjykimit.

Pjesët përbërëse të aktgjykimit.- nga përmbajtja e nenit 160 të LPK, del se aktgjykimi i hartuar me shkrim përbëhet nga tri pjesë: a. Pjesa e hyrjes, b. Pjesa urdhëruese – dispozitivi dhe c. Pjesa arsyetuese dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.

Pjesa hyrëse e aktgjykimit përmban: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit, emrin dhe mbiemrin, vendbanimin, gjegjësisht vendqëndrimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë, tregimin e shkurtër të objektit të kontestit dhe vlerën e tij, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, tregimin e palëve, të përfaqësuesve të tyre ligjor dhe me prokurë që kanë qenë të pranishëm në seancën për shqyrtimin e tillë si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi.

Dispozitivi i aktgjykimit përmban: vendimin me të cilin aprovohen apo refuzohen kërkesat e veçanta që kanë të bëjnë me çështjen kryesore dhe kërkesat aksesore, vendimin për ekzistimin apo mosekzistimin e kërkesës së parashtruar me qëllim kompensimi të saj me kërkesëpadinë si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.

Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar

ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.

Gjykata posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale i ka zbatuar me rastin e vendosjes mbi kërkesat e palëve. Kur është nevoja gjykata deklarohet edhe lidhur me qëndrimet e palëve për bazën juridike të kontestit, si dhe për propozimet dhe prapësimet e tyre, për të cilat gjykata nuk ka bërë arsyetime të vendimeve që i ka dhënë me herët gjatë procesit gjyqësor.

Në pjesën arsyetuese të aktgjykimit për shkak të mosbindjes, aktgjykimit në bazë të pohimit, aktgjykimit në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpapia, apo të aktgjykimit për shkak të mungesës, jepen vetëm arsyet që e justifikojnë dhënien e aktgjykimeve të këtuilla.

Po që se palët pas shpalljes së aktgjykimit kanë hequr dorë nga e drejta e ankimit, si dhe kur ato nuk kanë kërkuar shprehimisht që aktgjykimi, që do tu dërgohet, ta përmbajë pjesën arsyetuese, gjykata nuk do ta arsyetojë posaçërisht aktgjykimin e dhënë, por vetëm do të tregojë se palët kanë hequr dorë nga ankimi dhe se nga ky shkak aktgjykimi nuk është arsyetuar.

Aktgjykimi plotësues

Po që se gjykata nuk ka vendosur mbi të gjitha kërkesat që është dashur të përfshihen me aktgjykim, ose kur vetëm një pjesë e kërkesës ka mbetur pa u përfshirë me të, pala mundet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur i është dorëzuar aktgjykimi t'i propozojë gjykatës që të bëjë plotësimin e tij.

Po që se pala nuk paraqet propozim për plotësimin e aktgjykimit do të konsiderohet se papia është tërhequr në pjesën që ka mbetur pa u përfshirë me aktgjykimin e dhënë.

Propozimi i vonuar apo i pathemeltë për plotësimin e aktgjykimit, hidhet poshtë përkatësisht refuzohet nga gjykata pa u caktuar seancë gjyqësore.

Korrigjimi i aktgjykimit

Gabimet në emra dhe numra, si dhe gabimet tjera në shkrim dhe llogaritje, mungesat në aspektin e formës së aktgjykimit dhe mospajtimi i kopjes me origjinalin e aktgjykimit, i korrigjon gjykata në çdo kohë.

Korrigjimi i gabimeve bëhet me aktvendim të posaçëm që shkruhet në fund të origjinalit të aktgjykimit, kurse palëve u dërgohet kopja e aktvendimit të tillë.

Po që se midis origjinalit dhe kopjes së aktgjykimit ekziston mospajtimi në pikëpamje të ndonjë vendimi të përmbajtur në dispozitivin e aktgjykimit, palëve do t'u dërgohet kopja e korrigjuar e aktgjykimit, duke treguar se me këtë kopje të aktgjykimit zëvendësohet kopja e mëparshme e aktgjykimit. Në rast të këtuillë afati për ankim kundër pjesës së korrigjuar të aktgjykimit fillon të ecë nga dita e dorëzimit të kopjes së korrigjuar të aktgjykimit.

Për korrigjimin e aktgjykimit gjykata vendosë pa dëgjimin e palëve.

Forma e prerë e aktgjykimit

Vendimet e formës së prerë. – sikurse interesat e përgjithshme ashtu edhe ato individuale kërkojnë që marrëdhëniet juridike të palëve të përcaktuara në vendimet e gjykatave, të jenë të qëndrueshme, përfundimtare dhe të pandryshueshme në kuptimin, që më vonë këto marrëdhënie të mos kenë mundësi të kundërshtohen. Një gjë të tillë e kërkon edhe siguria juridike që duhet të ekzistoj në çdo sistem shoqëror dhe juridik. Marrëdhëniet e ndryshme juridike të palëve në grindje caktohen në mënyrë përfundimtare atëherë kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë.

Në shkencën juridike për formën e prerë të vendimeve bëhet fjalë në dy kuptime. Së pari, ajo e ka domethënien se vendimi nuk mund të goditet më me mjet të zakonshëm goditjeje (forma e prerë në kuptimin formal). Së dyti me formë të prerë kuptohet efekti i vendimit si akt juridik (forma e prerë në kuptimin material).

Vendimi bëhet i formës së prerë në kuptimin material në momentin kur bëhet i formës së prerë në kuptimin formal ndaj të dy palëve. Forma e prerë në kuptimin material ka të bëjë me përmbajtjen e vendimit dhe shprehet në efektin e tij ndaj kontestit të zgjidhur. Mirëpo, duhet theksuar se palët të drejtat dhe detyrimet mund ti rregullojnë ndryshe nga ajo që është thënë në vendimin e formës së prerë. Kështu sepse çdo marrëveshje e palëve e lidhur në pajtim me ligjin, është më e fortë se “vet ligji” dhe vendimi gjyqësor qoftë ai edhe i formës së prerë.

Në aspektin subjektiv vendimi i formës së prerë ndikon në palët që kanë marrë pjesë në procedurën në të cilën është dhënë vendimi. Kjo është e kuptueshme kur dihet se palët me aktivitetin dhe sjelljet e tyre kanë ndikuar që të jepet vendimi i përmbajtjes së caktuar. Ndërkaq në aspektin objektiv me fuqinë juridike të vendimit përfshihet vendimi mbi kërkesëpadinë.

Andaj lirisht mund të thuhet se vendimi i shkallës së parë merr formë të prerë: a) kur nuk është bërë ankim kundër tij brenda afatit të caktuar nga ligji, b) kur pala heq dorë nga e drejta e ankimit, c) kur ankesa e paraqitur është tërhequr, ç) kur ankesa e paraqitur me vendim të gjykatës së shkallës së dytë refuzohet si e pathemeltë e vendimi i shkallës së parë, i goditur me ankesë vërtetohet (lihet në fuqi). Vendimi i gjykatës së shkallës së dytë menjëherë bëhet i formës së prerë sepse kundër tij nuk lejohet fare ankimi (si mjet i goditjes së zakonshme).

AKTVENDIMET

Duke marrë parasysh formën në të cilën jepen ato, vendimet gjyqësore ndahen në aktgjykime, dhe aktvendime. Me aktgjykim gjykata gjithmonë vendosë për kërkesëpadinë, dmth. për objektin e kontestit, kurse me aktvendim gjykata vendosë për çështje tjera. Gjykata vetëm përjashtimisht vendosë për kërkesëpadinë me aktvendim dhe atë në procedurën sipas padisë për shkak të pengim posedimit (neni 142 i LPK) dhe në procedurën mandatore në të cilën kërkesëpadia pranohet me anë të urdhërpagesës, e cila konsiderohet si një lloj i aktvendimit (neni 142.4 i LPK). Vendimi mbi shpenzimet procedurale në aktgjykim konsiderohet aktvendim.

Të gjitha aktvendimet që jepen në seancë gjyqësore i shpallë gjyqtari. Aktvendimi i shpallur në seancën gjyqësore u dërgohet palëve në kopje të verifikuara vetëm nëse mund të goditen me ankesë të posaçme, apo nëse në bazë të aktvendimit mund të kërkohet menjëherë përmbartimi, apo nëse një gjë të tillë e kërkon drejtimi i procesit. Gjykata është e lidhur për aktvendimet e saja, po që se ato nuk i përkasin drejtimit të procesit, apo nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe. Në rastet në të cilat aktvendimi nuk i dërgohet palëve, ai ndaj tyre prodhon efekt posa të jetë shpallur. Aktvendimet të cilat gjykata i jep jashtë seancave gjyqësore u komunikohen palëve duke iu dërguar kopja e vërtetuar e aktvendimit.

Po që se me anë të aktvendimit refuzohet propozimi i njëres nga palët, pa dëgjim paraprak të palës kundërshtarë, atëherë kësaj të dytës nuk i dërgohet aktvendimi i tillë.

Aktvendimi duhet ta ketë arsyetimin po që se kundër tij mund të bëhet ankim i veçantë, e mund të përmbajë atë edhe në ndonjë rast tjetër kur gjykata e quan të nevojshme një gjë të tillë.

Aktvendimet e formës së prerë gjohet e shqiptuar sipas dispozitave të këtij ligji përmbartohen sipas detyrës zyrtare.

Në fund të përkujtojmë se dispozitat e neneve 146, 153, 160 dhe 169 paragrafi 2 të LPK në mënyrë të përshtatshme aplikohen edhe kur kem të bëjmë me aktvendimet.

MJETET E ZAKONSHME TË GODITJES

E drejta e ankimit

Gjyqtari sa do i mirë, i kujdesshëm dhe i përgatitur që të jetë mund të gabojë në dhënien e vendimeve. Gabimi mund të bëhet si në të çmuarit e fakteve ashtu edhe me rastin e zbatimit të normave procedurale apo të atyre materiale. Për ndreqjen dhe zhdukjen e gabimeve të vendimeve është pranuar prej sistemit procedural që nëpërmjet mjeteve të goditjes të bëhet shqyrtimi i çështjes nga një gjykatë tjetër.

Andaj kundër aktgjykimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15) nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me këtë ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër. Në kontestet nga raportet në të cilat është dhënë aktgjykimi në bazë të kambialit apo çekut, afati për ankim është shtatë (7) ditor. Ankimi i bërë brenda afatit të përcaktuar me ligj pengon që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë në pjesën e goditur me ankim dhe në fund mbi ankimin kundër aktgjykimit vendosë gjykata e shkallës së dytë.

Sipas LPK neni 176 – 184, ankesa kundër aktgjykimit dhe neni 206 – 207 ankesa kundër aktvendimit janë mjete të goditjes së zakonshme të vendimeve gjyqësore. Mjetin me të cilin goditet urdhërpagesa ligji e quan prapësim (kundërshtim - neni 497.1 i LPK).

Pala mund të heqë dorë nga e drejta e ankimit që nga momenti kur i është dorëzuar aktgjykimi, deri në momentin e dhënies së vendimit të gjykatës së shkallës së dytë pala mund ta tërheqë ankesën e paraqitur.

Deklarata për heqjen dorë nga e drejta e ankimit dhe ajo për tërheqjen e ankesës nuk mund të revokohet.

Përmbajtja e ankesës

Ankesa është mjetë i rregullt i goditjes së aktgjykimit të shkallës së parë, pa përjashtim. E drejta e ankimit kundër aktgjykimit është e garantuar me kushtetutë. Ajo prodhon efekt suspenziv, sepse e pengon aktgjykimin që të marrë formë të prerë, si dhe efekt devolutiv, sepse me paraqitjen e saj themelohet kompetenca e gjykatës së shkallës së dytë që ta shqyrtoj dhe ekzaminoj aktgjykimin e goditur. Në këtë aspekt, kufizime ka kur është në pyetje aktgjykimi në bazë të pohimit dhe aktgjykimi në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadiat të cilat mund të goditen për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, apo nga shkak se deklarata e pohimit, gjegjësisht e heqjes dorë nga kërkesëpadiat, është dhënë në lajthitje apo nën ndikimin e dhunës apo mashtrimit.

Ankesa shprehet në formë të aktit të shkruar. Përveç elementeve që duhet ti ketë çdo veprim i shkruar procedural ankesa duhet të përmbajë: tregimin e aktgjykimit kundër të cilit paraqitet ankimi, deklaratën se aktgjykimi kundërshtohet në tërësi ose në pjesën e caktuar, shkaqet e ankimit me arsyetim dhe nënshkrimin e paraqitësit të ankimit. Është e preferuar që ankesa të përmbajë edhe propozimin për vendimin të cilin gjykata e shkallës së dytë duhet ta jep sipas mendimit të ankuesit.

Në qoftë se ankesa nuk i përmban elementet e më larta (pra ankesa është jo e plotë), gjykata e shkallës së parë me anë të aktvendimit, kundër të cilit nuk lejohet ankimi, e thërret ankuesin që brenda afatit prej shtatë ditësh ta plotësojë ankesën e paraqitur dhe po që se ankuesi brenda afatit të më lartë nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë ankesën si jo të plotë.

Në ankesë nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të propozohen prova të reja, përveç se kur ankuesi jep prova se pa fajin e vet nuk ka mundur t'i paraqesë, përkatësisht t'i propozojë gjer në përfundimin e shqyrtimit kryesor në gjykatën e shkallës së parë.

Duke i treguar faktet e reja, ankuesi ka për detyrë që t'i përmendë provat me të cilat faktet e tilla do të vërtetoheshin, kurse duke i treguar provat e reja, ka për detyrë t'i përmendë faktet të cilat me provat e tilla duhet vërtetuar.

Prapësimi i parashkrimit dhe prapësimi me qëllim kompensimi, që nuk janë paraqitur në gjykimin e shkallës së parë, nuk mund të paraqiten me ankesë.

Po që se me paraqitjen e fakteve të reja dhe me propozimin e provave të reja, shkaktohen shpenzime procedurale në procedurën e ankimit, shpenzimet e tilla i mbetën në ngarkim palës që i ka paraqitur faktet e reja, përkatësisht që i ka propozuar provat e reja.

Shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimi

Duke i marrë parasysh gabimet dhe parregullësit në të cilat bazohet ankesa, në ligj shprehimisht është bërë klasifikimi i shkaqeve të ankimit në këto tri lloje: a) për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, b) për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe c) për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore- Veprimi i gjykatës është me të meta formale në qoftë se me rastin e kryerjes së tij nuk është zbatuar fare, apo është zbatuar gabimisht dispozita e caktuar procedurale. Mirëpo, nuk janë të rëndësishë së njëjtë të gjitha shkeljet e dispozitave procedurale. Disa nga to as që janë paraparë si shkak për ankim. Shkeljet e tilla mund ti quajmë jothelbësore. Thelbësore janë ato shkelje të ligjit të cilat janë në lidhje kauzale, efektivisht apo potencialisht, me vendimin e padrejtë apo me cenimin e ndonjë interesi tjetër të mbrojtur juridikisht në procesin kontestimor. As shkeljet thelbësore nuk janë të rëndësishë së njëjtë. Për disa nga to vetë ligji prezumon se ndikojnë ose mund të ndikojnë gjithmonë në dhënien e vendimit të gabuar. Këtë lloj shkeljesh shkenca juridike e quan shkelje thelbësore absolute.

Shkeljet thelbësore relative- Ligji nuk përmend veç e veç shkeljet thelbësore relative. Një gjë e tillë as që është e mundur. Sepse, me çdo veprim procedural të saj gjykata mund të shkelë ndonjë dispozitë procedurale. Shkelje thelbësore relative është, p.sh. refuzimi i paarsyeshëm i propozimit të palës për shfrytëzimin e ndonjë mjeti provues, e një gjë e tillë ka mundur të ndikojë që gjendja faktike të mos vërtetohet në mënyrë të plotë. Mos marrja e pëlqimit nga pala për caktimin e ekspertit; refuzimi i pa justifikuar i propozimit për përjashtimin e gjyqtarit nga shkaku të cilin e vlerëson vetë gjykata, lejimi në kundërshtim me ligjin i pjesëmarrjes së publikut në séance, mos njoftimi nga ana e gjykatës palën me të drejtën e saj që në gjykim ta përdor gjuhën e tij etj. Shkeljet thelbësore relative gjykata e shkallës së dytë i merr parasysh vetëm në qoftë se ankuesi shprehimisht i përmendë ato në ankesën e tij.

Shkeljet thelbësore absolute- Kur kemi shkelje të këtilla aktgjykimi i goditur anulohet pa marrë parasysh se a është i drejtë apo jo i drejtë në aspektin materialo juridik. Në rast të tillë ai anulohet nga shkaqet formale (procedurale) për vetë faktin se janë shkelur dispozitat procedurale. Shkeljet që gjithmonë e kanë për pasojë anulimin e vendimit, LPK shprehimisht dhe taksativisht i ka përmendur në nen. 182.2.

Të gjitha shkeljet esenciale absolute mund ti klasifikojmë në tri grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë shkeljet e dispozitave të prezumimeve procedurale. Në grupin e dytë bëjnë pjesë shkeljet që kanë të bëjnë me disa parime të procedurës kontestimore. Në grupin e tretë bëjnë pjesë shkeljet e rregullave të vendosjes dhe të vendimit.

Varësisht nga ajo se me çka kanë të bëjnë shkeljet e grupit të parë i ndajmë: në shkelje të prezumimeve në lidhje me gjykatën; në shkelje në lidhje me palët; në shkelje të prezumimeve në lidhje me objektin kontestit.

Shkeljet e prezumimeve në lidhje me gjykatën janë:

- përbërja jo e rregullt e gjykatës,
- gjyqtari i përjashtuar,
- jo kompetenca gjyqësore,
- jo kompetenca lëndore e gjykatës.

Shkeljet e prezumimeve në lidhje me palët janë:

- pazotësia për të qenë palë,
- pazotësia procedurale (për të vepruar në procedurë),
- përfaqësimi jo i rregullt i palës.

Shkeljet e prezumimeve në lidhje me objektin e kontestit janë:

- ekzistimi i prezumimeve procedurale negative (shkelja e parimit Ne bis in idem).

Shkeljet e grupit të dytë kanë të bëjnë me shkeljet e dispozitave të cilat i përbëjnë disa nga parimet e procedurës kontestimore, e ato janë:

- shkeljet e parimit të pa ndërmjetësisë,
- shkeljet e parimit të dëgjimit të dy palëve në procedurë,
- shkelja e parimit të kontradiktoritetit,
- shkelja e parimit të publicitetit (gjykimit me dyer të hapura) dhe
- shkelja e rregullave për gjuhën në të cilën duhet të zhvillohet procedura.

Shkelja e grupit të tretë kanë të bëjnë me rregullat mbi vendosjen në përgjithësi dhe me rregullat që kanë të bëjnë me përpilimin me shkrim të aktgjykimit. Shkelje të këtyre janë:

- vendosja në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 3 të LPK (disponimi i palejueshëm i palëve),
- dhënia e aktgjykimit për shkak të pohimit, mosbindjes, mungesës, heqjes dorë nga kërkesëpadija, ose pa mbajtjen e shqyrtimit kryesor,
- pohimit pa qenë të plotësuar kushteve për një gjë të tillë.
- dhënia e aktgjykimit për shkak të mungesës pa qenë të plotësuar kushtet ligjore,
- tejkalimi i kërkesëpadiës dhe
- shkelja e rregullave për formën dhe përmbajtjen e aktgjykimit.

Konstatimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike- Sipas LPK (neni 183) ekziston vërtetimi i gabuar apo jo i plotë i gjendjes faktike kur gjykata gabimisht e ka vërtetuar ndonjë fakt vendimtar, përkatësisht kur faktin e tillë nuk e ka vërtetuar fare.

Zbatimi i gabueshëm i së drejtës materiale ekziston kur gjykata nuk e ka zbatuar dispozitën e së drejtës materiale që është dashur ta zbatojë, apo kur dispozitën e tillë nuk e ka zbatuar në mënyrë të drejtë.

Procedura sipas ankesës

Procedura sipas ankesës zhvillohet në dy seksione. Në të parin vepron gjykata e shkallës së parë kurse në të dytin gjykata e shkallës së dytë.

Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare. Ankesën e paraqitur tej afatit të parashikuar me ligj, atë të palejueshme ose jo të plotë, e hedhë poshtë me aktvendim gjykata e shkallës së parë pa caktuar fare seancë gjyqësore. Përgjigja në ankesë bëhet në afat prej 7 dite.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë, gjykata e shkallës së parë ankesën dhe përgjigjen në ankesë, nëse është paraqitur me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej shtatë ditësh më së shumti.

Gjyqtari relator, po që nevoja, nga gjykata e shkallës së parë mund të kërkojë raport për shkeljet e dispozitave procedurale dhe mungesat tjera të përmendura në ankesë, si dhe të kërkojë që, me qëllim të konstatimit të shkeljeve, përkatësisht mungesave të tilla, të bëhen hetimet e duhura.

Kufijtë e ekzaminimit të aktgjyimit të shkallës së parë

Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK.

Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë mbi ankesën

Vendimi i gjykatës së ankimit sipas ankesës është ose i natyrës procedurale ose i natyrës meritore. Është u natyrës procedurale vendimi me të cilin ajo nuk shprehet në lidhje me vetë kërkesëpadinë. Për shkak të rëndësisë së tij procedurale ai jepet në formë të aktvendimit. Të natyrës procedurale janë: aktvendimi me të cilin hedhë poshtë ankesën si të vonuar jo të plotë apo të palejueshme, ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë, aktvendimi me të cilin anulohet aktgjykimi i goditur dhe çështja juridike kthehet për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Vendimi i gjykatës së ankimit është i natyrës meritore në qoftë se me të ajo shprehet në lidhje me kërkesëpadinë. Për shkak të rëndësisë së tij materialo-juridike vendimi i natyrës meritore jepet në formë të aktgjykimit. I tillë është aktgjykimi me të cilin refuzohet ankesa si e pathemeltë dhe vërtetohet aktgjykimi i goditur, aktgjykimi me të cilin gjykata e ankimit e ndryshon

aktgjykimin e goditur. Gjykata e shkallës së dytë nuk është e lidhur për propozimin e parashtruar ne ankesë.

Gjykata e çështjes ka për detyrë që menjëherë pasi t'i arrijë aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, të caktojë seancën përgatitore apo seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes e cila duhet të mbahet më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor pas arritjes së aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë, si dhe t'i kryejë të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë të gjitha çështjet kontestuese që i ka ofruar gjykata e shkallës së dytë në aktvendimin e saj.

Gjykata e shkallës së dytë nuk mund ta ndryshojë aktgjykimin e shkallës së parë në dëm të palës ankuese, po që se vetëm ajo ka bërë ankim, e jo edhe pala kundërshtare. Kjo rregull (ndalimi i të a.q. *reformatio in peius*) shprehimisht është paraparë vetëm kur sipas ankesës jepet aktgjykimi me të cilin ndryshohet ai i goditur me ankesë.

Në arsyetimin e aktgjykimit, gjegjësisht të aktvendimit, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë thëniet në ankesë që kanë qenë të rëndësishme vendimtare për dhënien e vendimit të saj.

Gjykata e shkallës së dytë ia kthen të gjitha shkresat e lëndës gjykatës së shkallës së parë me një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh të vendimit të vet për t'ua dërguar palëve dhe personave të interesuar, si dhe një ekzemplar për gjykatën e shkallës së parë. Gjykata e shkallës së dytë e bënë një gjë të këtillë brenda afatit tridhjetë (30) ditor nga dita e dhënies së vendimit të saj.

ANKESA KUNDËR AKTVENDIMIT

Sipas ankesës së posaçme kundër aktvendimit zhvillohet procedurë e veçantë. Kjo ankesë është mjetë goditjeje me karakter devolutiv, i njëanshëm dhe zakonisht me efekt suspenziv.

Në procedurën që zhvillohet sipas saj në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat për ankesën kundër aktgjykimit.

Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë lejohet ankimi, po që se me këtë ligj parashihet shprehimisht se ankimi i veçantë nuk lejohet,

Aktvendimi kundër të cilit nuk lejohet ankim i veçantë mund të përmbahet menjëherë.

MJETET E JASHTËZAKONSHME TË GODITJES

Revizioni është mjet i goditjes së jashtëzakonshme me të cilin pala e goditë për shkak të shkeljes së ligjit aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës së shkallës së dytë të dhënë sipas ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë. Shkaqet për paraqitjen e revizionit nga pala janë:

- a) *shkelja thelbësore dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182. paragrafi 2 të LPK, me përjashtim të shkeljeve të parapara në nenin 182 paragrafi 2 pikat (f,h,i dhe m).*

- b) *shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 të këtij ligji që është bërë në procedurën e gjykatës së shkallës së dytë.*
- c) *zbatimi i gabuar i të drejtës materiale.*
- d) *tejkalimit i kërkesëpadisë, në qoftë se kjo shkelje është bërë në procedurën para gjykatës së shkallës së dytë.*

- 2) Revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike.
- 3) Kundër aktgjykimit të dhënë në procedurën e shkallës së dytë me të cilën vërtetohet aktgjykimi në bazë të pohimit, revizioni mund të paraqitet vetëm për shkaqet nga paragrafi 1 pika a), b) dhe d) të këtij neni.
- 4) Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë me të cilin vërtetohet aktgjykimi i shkallës së parë revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga paragrafi 1 pika a) e këtij neni, përveç nëse ekzistimi i tyre nuk është përmendur në ankesë, përpos kur bëhet fjalë për shkeljet për të cilat kujdeset sipas detyrës zyrtare gjykata e shkallës së dytë dhe ajo e revizionit”.

Me revizion pala nuk mund të goditë vendimin e gjykatës së shkallës së dytë të dhënë në kontestet vlera e të cilave është më e vogël se ajo e caktuar me ligj (neni 211.2 të LPK).

Në kontestet pasurore-juridike me rëndësi sociale të posaçme revizioni është i lejueshëm pa marrë parasysh vlerën e objektit të kontestit. Të tilla janë: a) kontestet në lidhje me ushqimin ligjor, b) kontestet për shpërblimin e dëmit për ushqimin e humbur, për shkak të vdekjes së dhëniesit të ushqimit, c) në kontestet nga marrëdhëniet e punës të cilat i fillon i punësuari kundër vendimit për shuarjen e marrëdhënies së punës.

Kompetente për vendosje lidhur me revizionin është Gjykata Supreme. Afati për paraqitjen e tij është 30 ditë nga dita në të cilën palës i është dorëzuar aktgjykimi i shkallës së dytë. As afati për paraqitjen e revizionit e as revizioni i paraqitur nuk janë pengesë për përmbarimin e aktgjykimit të formës së prerë të goditur. Ai, pra, nuk prodhon efekt suspensiv. Në procedurën sipas revizionit në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat e parapara për ankesën kundër aktgjykimit, por vetëm në qoftë se ligji nuk ka dispozita që vlejnjë posaçërisht për procedurën sipas tij (nen. 227 të LPK).

Pasi të arrijë përgjigja në revizion (afati 7 ditor) apo pas skadimit të afatit për përgjigje (poashtu afati 7 ditor), revizionin dhe përgjigjen, nëse është paraqitur, gjykata e shkallës së parë ia dërgon gjykatës së revizionit, bashkë me dosjen e lëndës, brenda afatit shtatë ditor, nëpërmjet gjykatës së shkallës së dytë.

Revizioni kundër aktvendimit

Sipas nen. 228 të LPK palët mund të paraqesin revizion edhe kundër aktvendimeve të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin përfundon procedura (dhe shuhet litispendenza) në mënyrë të prerë. Mirëpo, në qoftë se është fjala për aktvendimet të cilat jepen në

kontestet në të cilat nuk lejohet revizioni kundër aktgjykimit, atëherë revizioni nuk lejohet as kundër aktvendimeve të tilla. Ligji shprehimisht parasheh se në dy raste revizioni lejohet gjithmonë: a) kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin hidhet poshtë ankesa, dhe b) kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin vërtetohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë me të cilin është hedhur poshtë revizioni i paraqitur kundër vendimit përfundimtar. Revizioni është i lejueshëm edhe kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin është vendosur mbi propozimin për përsëritjen e procedurës. Revizioni nuk lejohet kundër aktvendimit mbi shpenzimet procedurale.

Në procedurën sipas revizionit kundër aktvendimit në mënyrë adekuate aplikohen dispozitat e këtij ligji mbi revizionin kundër aktgjykimit.

Përsëritja e procedurës

Sipas ligjit, çdo procedim i përfunduar me vendim të formës së prerë (qoftë ai aktgjykim apo aktvendim), mund të përsëritet sipas propozimit të palës, kur për një gjë të tillë ekzistojnë shkaqet e përmendura në nenin 232 të LPK. Propozimi për përsëritjen e procedurës është mjetë i jashtëzakonshëm i goditjes, i kufizuar, jo suspensiv, i dy anshëm. Procedura mund të përfundojë me anë të aktgjykimit, me anë të aktvendimit me të cilën padia hidhet poshtë apo me anë të aktvendimit me të cilën konstatohet se ka përfunduar procedura me anë të veprimit procedural disponibël të palëve.

Shkaqet në bazë të cilave pala mund ta propozojë përsëritjen e procedurës në shkencë klasifikohen në tri grupe: a) shkeljet më të rënda të dispozitave procedurale; b) veprat penale të pjesëmarrësve në procedurë të cilat kanë mundur të ndikojnë në përmbajtjen e vendimit, dhe c) faktet dhe provat e reja.

Afati për paraqitjen e propozimit për përsëritjen e procedurës është tridhjetë (30) ditë dhe fillon të ecë nga dita në të cilën pala ka marrë dijeni për shkakun e përsëritjes, përkatësisht nga dita në të cilin e ka fituar mundësinë për shfrytëzimin e shkakut të tillë, por jo më vonë se 5 vite nga dita në të cilën vendimi ka marrë formën e prerë, përveçse kur përsëritja kërkohet nga shkaqet e përmendura në nenin 232 pika a dhe b e këtij ligji. (kur palës me veprim të kundërligjshëm e sidomos në rast të mos thirrjes për në seancë nuk i jepet mundësia që të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore dhe kur si palë ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë ndërgjyqëse, palën nuk e ka përfaqësuar personi i autorizuar apo përfaqësuesi ligjor të palës me pazotësi procedurale, dhe kur ky nuk ka patur autorizim për kryerjen e veprimeve të caktuara procedurale).

Mbi propozimin për përsëritjen e procedurës vendosë siç është shpjeguar më parë gjykata e shkallës së dytë, dhe atë gjyqtari individual i cili nuk ka marrë pjesë në dhënien e vendimit të shkallës së dytë në procedurën e mëparshme.

Propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitet gjithmonë gjykatës që e ka dhënë vendimin e shkallës së parë duke treguar në propozim sidomos: bazën ligjore në mbështetje të së cilës kërkohet përsëritja e procedurës, rrethanat nga të cilat rezulton

se propozimi është paraqitur në afatin ligjor dhe mjetet provuese me të cilat arsyetohen thëniet e propozuesit.

Propozimin për përsëritjen e procedurës të paraqitur pas afatit ligjor, atë jo të plotë, apo të palejueshëm, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së parë me anë të aktvendimit pa mbajtur seancë gjyqësore. Mirëpo, po që se gjykata e shkallës së parë nuk e hedhë poshtë propozimin, një ekzemplar të tij ia dërgon palës kundërshtare, e cila ka të drejtë që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor të përgjigjet lidhur me të.

Pasi të arrijë përgjigja lidhur me propozimin, apo pasi të skadojë afati për përgjigje, gjykata propozimin, bashkë me përgjigjen në të, po që se është paraqitur, me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë brenda afatit prej tetë (8) ditësh.

Gjykata e shkallës së dytë vendosë mbi propozimin për përsëritjen e procedurës zakonisht jashtë seance për shqyrtim kryesor. Po që se gjykata vjen në përfundim se është i domosdoshëm shqyrtimi i tillë, ajo do të veprojë në pajtim me dispozitat e neneve 191 dhe 193 të këtij ligji (hapja e seancës para kësaj gjykate).

Në aktvendimin me të cilin lejohet përsëritja e procedurës shqiptohet vendimi me të cilin anulohet ai i dhënë në procedurën e mëparshme. Kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin aprovet propozimi për përsëritjen e procedurës nuk lejohet ankimi. Ankesa kundër aktvendimit të gjykatës së shkallës së dytë me të cilin refuzohet propozimi për përsëritjen e procedurës i paraqitet të njëjtës gjykatë, e cila sipas ankesës vendosë në trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtar.

Në procedurën e përsëritur në gjykatën e shkallës së parë nuk mund të veproj gjyqtari që ka dhënë vendimin në procedurën e mëparshme ndërsa Gjykata e shkallës së parë e cakton seancën përgatitore menjëherë pasi t'i arrijë aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë, e më së voni brenda afatit tetë (8) ditor.

RAPORTI MIDIS REVIZIONIT DHE PROPOZIMIT PËR PËRSËRITJEN E PROCEDURËS

Në qoftë se në afatin për paraqitjen e revizionit pala e paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës vetëm nga shkaqet për të cilat mund të paraqitet revizioni, do të konsiderohet se pala e ka paraqitur revizionin. Po që se pala paraqet revizionin për shkakun se në procedurën e shkallës së parë apo të shkallës së dytë është vendosur mbi kërkesën për të cilën ka ekzistuar vendimi i formës së prerë, apo për kërkesën nga e cila paditësi ka hequr dorë në një procedurë të mëhershme apo, për të cilën ekziston ujdia gjyqësore, dhe në të njëjtën kohë, apo më, vonë paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës, nga cilido shkak i përmendur në nenin 232 të këtij ligji, gjykata e ndërprente procedurën sipas propozimit për përsëritjen e procedurës derisa të përfundoj procedura sipas revizionit.

Po që se pala paraqet revizionin nga cilido shkak, përveçse nga shkaqet e përmendura në paragrafët e sipërm, dhe në të njëjtën kohë, apo më vonë, paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës, nga shkaqet e nenit 232 pika c) dhe d) të këtij ligji që janë argumentuar me anë të aktgjykimit penal të formës së prerë, gjykata do ta ndërpresë

procedurën sipas revizionit derisa mos të përfundojë procedura lidhur me propozimin për përsëritjen e procedurës.

Në të gjitha rastet e tjera në të cilat pala paraqet revizionin, kurse në të njëjtën kohë apo me vonë e paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës, gjykata do të vendosë se cilën procedurë do ta vazhdojë e cilën do ta ndërpresë, duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit, e sidomos shkaqet nga të cilat janë paraqitur të dy mjetet e goditjes si dhe provat e propozuara nga palët.

Dispozitat e nenit 242 paragrafët 1 dhe 3 të këtij ligji do të aplikohen edhe kur pala se pari ka paraqitur propozimin për përsëritjen e procedurës e pas kësaj e ka paraqitur revizionin. Në të gjitha rastet tjera në të cilat pala e paraqet propozimin për përsëritjen e procedurës e pas kësaj e paraqet revizionin gjykata, zakonisht, e ndërpretë procedurën sipas revizionit derisa mos të përfundojë procedura sipas propozimit për përsëritjen e procedurës, përveçse kur konstaton se ekzistojnë shkaqe të justifikueshme për veprim ndryshe.

Aktvendimin nga neni 242 të këtij ligji e jep gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë po që se propozimi për përsëritjen e procedurës arrin në gjykatën e shkallës së parë para se lënda sipas revizionit t'i jetë dërguar gjykatës së revizionit. Në qoftë se propozimi për përsëritjen e procedurës arrin pasi t'i jetë dërguar lënda gjykatës së revizionit, aktvendimin nga neni 242 të këtij ligji e jep gjykata e revizionit.

Aktvendimin nga neni 242 të këtij ligji e jep gjyqtari i gjykatës së shkallës së parë, përveç kur lënda, në kohën kur revizioni arrin në gjykatën e shkallës së parë, sipas propozimit për përsëritjen e procedurës i është dërguar gjykatës së lartë për vendosje, në të cilin rast aktvendimin e jep gjykata e lartë. Kundër aktvendimeve të më larta nuk lejohet ankimi.

KËRKESA PËR MBROJTJEN E LIGJSHMËRISË

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është mjetë goditjeje jo suspenziv, devolutiv, por i kufizuar me të cilin prokurori publik e goditë vendimin e formës së prerë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, në qoftë se shkelja ka të bëjë me kompetencën territoriale, po qe se gjykata e shkallës së parë e ka nxjerrë aktgjykimin pa seancë kryesore, kurse e ka pasur detyrë ta mbajë seancën kryesore, po qe se është vendosur për kërkesën, rreth së cilës kontestimi është në vazhdim, apo në qoftë se në kundërshtim me ligjin, është përjashtuar publiku në seancën kryesore dhe për shkak të aplikimit të gabueshëm të së drejtës materiale.

Prokurori publik nuk mund të ngrejë kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë për shkak të kapërcimit të kërkesë-padisë dhe as për shkak të vërtetimit të gabueshëm apo jo të plotë të gjendjes faktike.

Sipas dispozitave të këtij ligji gjykata me kompetencë për të vendosur për kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë do të veprojë edhe kur vërteton se ekziston shkelja esenciale e dispozitave të procedurës kontestimore që është bërë në procedurë para gjykatës të shkallës së parë.

Kompetent për ngritjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është Prokurori publik i Kosovës. Për të vendosë Gjykata Supreme. Nuk është me rëndësi se a është bërë vendimi i formës së prerë në shkallë të parë apo në shkallë të dytë. Kjo vlen edhe kur janë në pyetje aktvendimet.

Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë mund të paraqitet brenda afatit tre mujor nga dita në të cilin vendimi është bërë i formës së prerë. Mirëpo, në qoftë se kundër vendimit të shkallës së dytë është paraqitur revizioni afati për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë është 30 ditor, dhe fillon nga dita në të cilën prokurorit publik i është dërguar një ekzemplar i revizionit të asaj pale revizioni i së cilës i është dërguar më herët. Në qoftë se kundër të njëjtit vendim paraqitet edhe revizioni i palës e edhe kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e prokurorit publik, gjykata për këto dy mjete goditjeje vendosë me një vendim të vetëm (neni 249 i LPK). Për seancën në të cilën shqyrtohet dhe vendoset për Kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, gjykata e lajmëron prokurorin.

GJYKIMI NË SHKALLË TË PARË: NGRITJA E PADISË

Nocioni dhe përmbajtja e padisë

Padia është veprim i parë procedural me të cilën vihet në veprim procesi kontestimor. Padinë e paraqet paditësi. Ai me të nga gjykata kërkon mbrojtje juridike të përmbajtjes së caktuar, duke pasur parasysh të paditurin e caktuar. Mbrojtjen juridike gjykata e jep me anë të vendimit të saj.

Aspektin material të padisë e përbën kërkesa e paditësit që gjykata të vendosë mbi çështjen juridike kontestuese. Kur flasim për padinë në aspektin procedural (formal) e kemi parasysh vetë shkresën (dokumentin-parashtresën) në të cilën paditësi e shpreh kërkesën që gjykata ti japë mbrojtje juridike me anë të vendimit të përmbajtjes së caktuar.

Me përmbajtjen e padisë caktohet programi i procesit kontestimor.

Padia në kuptimin formal (shkresa) e ka pjesën e përmbajtjes që është e detyrueshme, dhe mund ta ketë pjesën e përmbajtjes që është fakultative. Ajo duhet ta ketë pjesën nga e cila shihet se cilës gjykatë i drejtohet, cilat janë palët dhe shënimet për identifikimin e tyre. Përveç kësaj, padia paqjetër duhet ti ketë edhe këto elemente:

- a) *kërkesën e caktuar në pikëpamje të çështjes kryesore dhe kërkesave aksesore;*
- b) *faktet mbi të cilat paditësi e bazon kërkesën;*
- c) *provat me të cilat vërtetohen faktet e tilla;*
- d) *vlerën e kontestit;*
- e) *bazën juridike dhe*
- f) *të dhënat e tjera që duhet t'i ketë çdo parashtresë (neni 99 i këtij ligji).*

Gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë. Gjykata do të veprojë sipas padisë edhe kur paditësi nuk e ka treguar bazën juridike të kërkesëpadisë.

Paditësi ka për detyrë që padisë t'ia bashkangjësë vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar.

Në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.

Llojet e padive- Paditë i ndajmë ose i klasifikojmë në lloje të ndryshme sipas njërit nga këto kritere që ndiqen: **materialo-juridike** ose **proceduralo-juridike**. Nga pikëpamje të së drejtës materiale paditë u përshtaten degëve të kësaj të drejte, prandaj ato i ndajmë në **civile, familjare, të punës** etj. Nga pikëpamja e së drejtës procedurale paditë ndahen në disa lloje varësisht nga qëllimi që ndjekë paditësi me anë të padisë dhe varësisht nga fakti se çfarë vendimi kërkon të marrë gjykata. Sipas **qëllimit të paditësit**, paditë i ndajmë në padi **vërtetimi** (njohje apo deklarative), në padi **detyrimi** (kondemnatore) dhe në padi **ndryshimi** (transformimi, konstitutive).

- a) **Paditë vërtetimi** (njohje, deklarative)- Padi njohje e quajmë padinë me të cilën paditësi mund të kërkojë me padi që gjykata vetëm të konstatojë ekzistimin, përkatësisht mosekzistimin e një të drejte apo të një raporti juridik, ose vërtetësinë, gjegjësisht mos vërtetësinë e ndonjë dokumenti. Intervenimi i gjykatës me këtë lloj padie kërkohet para se të bëhet shkelja e normës juridike në të cilën bazohet e drejta subjektive e paditësit. Me vendimin e gjykatës pengohet shkelja që mund të bëhet në të ardhmen. Me të vetëm konstatohet gjendja juridike ekzistuese, pa u detyruar i padituri që të bëjë diçka. Në bazë të këtij vendimi nuk mund të inicohet procedura përmbarimore. Me padi vërtetimi nuk mund të kërkojë nga gjykata që ta vërtetojë ndonjë fakt apo gjendje faktike. Me këtë padi mund të kërkojë p.sh., vërtetimi se ekziston kontrata e shitblerjes, kontrata mbi ndërtimin, mandej se ekziston e drejta e pronësisë, e drejta e autorit, e drejta e trashëgimit, e drejta e shfrytëzimit. E këtij lloji është edhe padia për vërtetimin e martesës, atësisë, amësisë etj.
- b) **Paditë detyrimi** (kondemnatore) - Me këtë lloj padie paditësi kërkon nga gjykata që me aktgjykim ta urdhëroj të paditurin që në dobi të paditësit ta përmbush një prestim (ta dorëzojë një send, ta paguaj një shumë të hollash, ta kryej ose jo një punë ose shërbim). Me këtë padi paditësi mund të kërkojë që i padituri të pësojë diç: p.sh. ta lejoj paditësin që ta shfrytëzojë të drejtën e kalimit mbi sendin e pa luajtshëm të tij, ose që të mos veprojë, p.sh. që ta ndërprej shqetësimin e mëtejshëm të paditësit në shfrytëzimin e qetë të banesës, që në të ardhmen të mos përdor firmën e paditësit etj. Me padinë në fjalë mund të kërkojë detyrimi i palës së paditur që të japë deklaratën e përmbajtjes së caktuar: p.sh. shkresën në bazë të cilës mund të regjistrohet e drejta e caktuar në regjistrin publik (clausula intabulandi).

- c) **Padi ndryshimi-** Parimisht, me anë të vendimit gjyqësor nuk mund të krijohen, ndryshohen apo shuhen raportet juridiko-civile, e as të drejtat subjektive civile. Për një gjë të tillë shërbejnë veprimet materialo- juridike dhe deklaratat e vullnetit të subjekteve të së drejtës. Mirëpo, në disa raste të veçanta, sidomos për ndryshimin e raporteve juridike të caktuara, nevojitet që të ekzistoj vendimi gjyqësor i formës së prerë. Në rastet e tilla, me padinë në fjalë nga gjykata mund të kërkohet që ajo me aktgjykim ta themeloj një raport juridik, mandej që ta ndryshoj përmbajtjen e raportit ekzistues apo që ta anuloj atë. E këtillë është p.sh. padia me të cilën kërkohet zmadhimi i mjeteve për ushqim i caktuar më parë me aktgjykim, caktimi i kohës për përmbushjen e detyrimit ose dhënia e deklaratës materialo-juridike nga i padituri me të cilën lejohet regjistrimi i të drejtës reale në librin e tokave. Në shembullin e fundit, kur vendimi bëhet i formës së prerë, supozohet se i padituri e ka dhënë deklaratën e përmendur, dhe në bazë të tij mund të bëhet regjistrimi përkatës. E këtij lloji është edhe padia me të cilën kërkohet zvogëlimi i dënimit të kontraktuar apo zvogëlimi i shpërblimit të kontraktuar për punën e avokatit. Shembull për padinë me të cilën nga gjykata kërkohet anulimi ose shuarja e raportit juridik është padia për shkurorëzim të bashkëshortëve apo për anulimin e martesës së tyre, mandej për anulimin e kontratës apo firmës etj.

Në disa raste me këtë padi nga gjykata mund të kërkohet që me vendimin e saj ta ndryshoj situatën procedurale. Padi të këtilla procedurale janë: padia për anulimin e aktgjykimit të arbitrazhit; padia me të cilën personi i tretë kërkon që nga gjykata ta shpallë të palejueshëm ekzekutimin me të cilën është përfshirë pjesa e pasurisë së tij; padia me të cilën debitori gjatë ekzekutimit parashtrohet prapësime, duke kërkuar që gjykata me vendim të saj ta shpallë ekzekutimin si të pa lejueshëm. As në bazë të aktgjykimit të dhënë sipas kësaj padie nuk mund të inicohet procedura përmbartuese sepse me të nuk kemi detyrim për prestim të të paditurit.

Përfshirja e disa kërkesëpadive në një padi

Në një padi paditësi mund t'i përfshij disa kërkesa kundër të njëjtës palë të paditur me kusht që ato të gjitha janë të lidhura me të njëjtën bazë faktike dhe juridike.

Në qoftë se kërkesat nuk janë të lidhura me të njëjtën bazë faktike dhe juridike, ato mund të përfshihen në një padi kundër të njëjtës palë të paditur vetëm po që se e njëjta gjykatë është e kompetencës lëndore për secilën nga këto kërkesa dhe kur për të gjitha kërkesat është e përcaktuar i njëjti lloj i procedurës, e gjykata vjen në përfundim se përfshirja e kërkesëpadive të tilla në një padi i kontribuon ekonomisë së procedimit (bashkimi kumulativ i kërkesëpadive). Po që se një gjë e tillë nuk i kontribuon ekonomisë së procedimit, gjykata, më së voni në seancën përgatitore, sjellë aktvendim për ndarjen e procedurës.

Paditësi mundet në një padi t'i përfshijë dy apo më tepër kërkesëpadi që janë të ndërlidhura midis tyre, dhe të kërkojë që gjykata ta aprovojë të dytën me radhë vetëm po që se e para refuzohet (bashkimi eventuale i kërkesëpadive). Ky bashkim i kërkesëpadive mund të bëhet vetëm po që se gjykata është e kompetencës lëndore për çdonjërin nga kërkesat e përfshira në një padi, dhe nëse për të gjitha kërkesat është përcaktuar i njëjti lloj i procedurës.

Me aktgjykimin me të cilin aprovet kërkesëpadija nën një shuhet gjyqvarësia e krijuar lidhur me kërkesëpadijën në numrin 2.

Kundërpadija

Kundërpadija është padi e palës së paditur kundër paditësit e parashtruar në procesin të cilin i dyti e ka vënë në veprim me padi kundër palës së paditur. Me anë të kundërpadijës i padituri (në procesin e parë sipas padisë) në të njëjtën gjykatë dhe në të njëjtin proces e parashtron kërkesëpadijën e tij të veçantë (neni 256 i LPK). Me kundërpadi themelohet edhe një raport proceduralo - juridik, me role të kundërta të palëve. Palës së paditur kundërpadija i shërben si mjet mbrojtës. Ajo nuk është e detyruar që kërkesën (kundërkërkesën) e saj që e ka ndaj paditësit ta realizoj me anë të kundërpadijës. Një gjë e tillë ajo mund ta bëjë me anë të padisë me të cilën inicon proces kontestimor të veçantë.

Ligji i njeh tri lloj kundërpadijesh: ***konekse, kompenzuese dhe prejudiciale***. Të parën i padituri mund ta paraqesë në qoftë se në mes të kërkesës së përfshirë me kundërpadi dhe asaj të përfshirë me padi nuk ka dallim në pikëpamje të bazës juridike, sepse të dyja e kanë të njëjtën bazë juridike. Kështu p.sh. nëse paditësi me padi ka kërkuar që i padituri t'ia dorëzojë sendin, i padituri me kundër padi mund të kërkojë që paditësi t'ia paguaj çmimin blerës të sendit. Të dytën i padituri mund ta paraqesë në qoftë se kërkesa e tij mund të kompensohet me kërkesën e paditësit. Kjo mundësi sidomos shfrytëzohet kur edhe kërkesëpadija e edhe kundërkërkesa përbëhen në të holla. Të tretën i padituri mund ta paraqes kur me kundërpadi kërkohej vërtetimi i ndonjë të drejte apo raporti juridik nga ekzistimi apo mosekzistimi i të cilit varet tërësisht apo pjesërisht vendimi mbi kërkesën e paditësit (kundërpadija prejudiciale). Me kundërpadijën prejudiciale i padituri kërkon, p.sh. që gjykata me aktgjykim të konstatojë se sendi, kthimin e të cilit paditësi e kërkon në bazë të pronësisë, është i tij e jo i paditësit. Kjo kundërpadi gjithmonë ka karakter deklarativ. Kur gjykata e pranon kundërkërkesën si të themeltë ajo me të njëjtin aktgjykim e refuzon kërkesëpadijën si të pa themeltë.

Edhe kundërpadija është padi, prandaj po që se gjatë gjykimit tërhiqet padia apo hudhet poshtë si e palejueshme, atëherë gjykimi vazhdon të zhvillohet lidhur me kundërpadijën. Kundërpadija mund të paraqitet derisa nuk ka përfunduar seanca përgatitore, gjegjësisht seanca e parë për shqyrtimin kryesor, po që se seanca përgatitore nuk është mbajtur fare. Pas këtij afati kundërpadija mund të ngrihet vetëm me pëlqimin e paditësit.

Ndryshimi i padisë

Ndryshim të padisë përbënë ndryshimi i njëjtësisë së kërkesëpadisë, zmadhimi i kërkesëpadisë apo parashtrimi edhe i një kërkesë tjetër krahas asaj ekzistuese.

Padia nuk quhet e ndryshuar po që se paditësi e ka ndryshuar bazën juridike të kërkesëpadisë, po që se e ka zvogëluar kërkesëpadinë, apo po që se i ka ndryshuar, plotësuar apo përmirësuar, thëniet e caktuara në padi.

Paditësi mund ta ndryshojë padinë më së voni deri në përfundimin e seancës përgatitore apo deri në fillimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se seanca përgatitore nuk është caktuar fare. Në rast të këtillë gjykata të paditurit duhet t'i jep kohë të nevojshme që të përgatitet për shqyrtim të padisë së ndryshuar.

Pas përfundimit të seancës përgatitore, e më së voni deri në mbylljen e seancës për shqyrtim kryesor, gjykata mund ta lejoj ndryshimin e padisë vetëm po që se konstaton se ndryshimi nuk ka për qëllim zvarritjen e gjykimit dhe po që se i padituri pajtohet me ndryshimin e padisë.

Konsiderohet se ekziston pëlqimi i të paditurit për ndryshimin e padisë po që se ai fillon të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes së padisë të ndryshuar, pa e kundërshtuar më parë ndryshimin.

Kundër aktvendimit me të cilin lejohej apo refuzohet ndryshimi i padisë nuk lejohet ankimi i veçantë.

Në qoftë se paditësi e ndryshon padinë, duke kërkuar nga e njëjta bazë faktike sendin tjetër apo një shumë të hollash, i padituri nuk mund ta kundërshtoj atë po që se ndryshimi është pasojë e rrethanave të krijuara pas ngritjes së padisë.

Po që se paditësi e ndryshon padinë ashtu që në vend të të paditurit të parë ta padisë një person tjetër për një ndryshim të tillë është i nevojshëm pëlqimi i personit që duhet të hyjë në gjykim në vend të paditurit, e po që se i padituri ka filluar të marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes kryesore, nevojitet edhe pëlqimi i tij. Personi i cili hynë në gjykim në vend të palës së paditur duhet ta pranojë atë në gjendjen në të cilën ndodhet në momentin kur hyn në të.

Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi. Padia mund të tërhiqet edhe më vonë, deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor, në qoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda shtatë (7) ditësh nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë. Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi. Padia e tërhequr konsiderohet se nuk është paraqitur asnjëherë dhe mund të paraqitet në gjykatë përsëri.

Ekzistimi i gjyqvarësisë (Litispedenca)

Gjyqvarësia krijohet që në momentin në të cilin të paditurit i dorëzohet padia, pra nga momenti kur pala kundërshtare është njoftuar

për kërkesën e parashtruar për zhvillimin e procedurës kundër saj. Gjatë kohës së ekzistimit të gjyqvarësisë për të njëjtën kërkesëpadi nuk mund të iniciohet gjykim i ri midis palëve të njëjta. Po që se, prapëseprapë, bëhet një gjë e tillë, gjykata do ta hedhë poshtë padinë.

Gjykata gjatë gjithë procedurës, sipas detyrës zyrtare, kujdeset nëse është në zhvillim e sipër gjykimi tjetër për të njëjtën kërkesëpadi midis palëve të njëjta.

Në qoftë se ndonjëra nga palët e tjetëron, gjatë zhvillimit të procedurës sendin apo të drejtën e kërkuar me padi, një gjë e tillë nuk pengon që procedimi të përfundojë midis palëve të njëjta dhe personi që e ka fituar sendin apo të drejtën gjatë zhvillimit të gjykimit mund të hyjë në procedurë, në vend të paditësit apo të paditurit, vetëm me pëlqimin e të dy palëve ndërgjyqëse ndërsa aktgjykimi i cili do të nxjeret nga ky rast prodhon efekt edhe ndaj fituesit të sendit apo të drejtës gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor.

Bashkëndërgjyqësia

Përveç se kur me një padi përfshihen disa kërkesa, me një procedurë kontestimore të vetme mund të përfshihen disa raporte procedurale dhe në rastin në të cilën me një padi disa persona paraqiten në rolin e palës paditëse apo në rolin e palës së paditur (bashkëndërgjyqësia, bashkimi subjektiv). Në procesin kontestimor të këtillë ka aç raporte proceduralo-juridike sa janë edhe paditës apo të paditur. Në procesin e tillë gjyqësor çdo bashkëndërgjyqës e parashtron kërkesëpadinë e vetë apo ndaj çdo njërit nga ta është e drejtuar kërkesëpadi e palës kundërshtare. Nga kjo del përfundimi se në çdo procedim në të cilën kemi bashkëndërgjyqësi, njëkohësisht kemi edhe bashkim objektiv të disa kërkesave materialo - juridike. Kjo vlen edhe për gjykimin në të cilën bashkëndërgjyqësia është unike, ku kërkesat e bashkuara janë plotësisht identike.

Me rregullat për institutin e bashkëndërgjyqësisë arrihen dy qëllime kryesore: ekonomia e gjykimit dhe siguria juridike (zgjidhja e njëjtë e kontesteve të njëjta). Bashkëndërgjyqësia është institut fakultativ.

Ajo është e domosdoshme vetëm përjashtimisht (bashkëndërgjyqësia e detyrueshme). Ajo është gjithmonë rezultat procedural i aktivitetit të palës paditëse. As pala e paditur e as gjykata, me vendimin e saj nuk mund të krijoj bashkëndërgjyqësinë. Mirëpo, në disa raste atë mund ta krijojnë faktet jashtë procedurale, si p.sh. vdekja e palës gjatë gjykimit. Në rast të këtillë në vend të palës së vdekur vijnë trashëgimtarët universal.

Bashkëndërgjyqësia quhet aktive kur më tepër subjekte në një proces kontestimor marrin pjesë me cilësi të paditësit. Ajo është pasive, kur më tepër subjekte paraqiten në rolin e palës së paditur. Bashkëndërgjyqësia është e dyanshme atëherë kur edhe në rolin e palës paditëse, e edhe në rolin e palës së paditur, paraqiten më tepër subjekte.

Ekzistojnë tri lloj bashkëndërgjyqësisë: bashkëndërgjyqësia materiale dhe formale, bashkëndërgjyqësia primare dhe e mëvonshme dhe bashkëndërgjyqësia ligjore.

a) *Bashkëndërgjyqësia materiale dhe formale -*

Bashkëndërgjyqësi materiale kemi në ato raste në të cilat midis bashkëndërgjyqësve ekziston, qysh para se të filloj procesi kontestimor, dhe jashtë tij, lidhja e caktuar juridike apo reale (faktike) në aspektin e objektit të kontestit. Mund të ekzistoj bashkësia juridiko procedurale midis bashkëpronarëve, bashkëtrashëgimtarëve, bashkëshortëve, (kur ushtrojnë padi apo kur i paditë tjetri - rasti i padisë së fëmiut kundër të dy prindërve për vërtetimin apo mohimin e atësisë apo amësisë). Në bashkësi reale (faktike) janë p.sh., bashkëkryerësit e një delikti civil, apo të dëmtuarit në një aksident të komunikacionit. Në gjykimin e vënë në veprim kundër tyre, apo nga ta kemi bashkëndërgjyqësi materiale.

Bashkëndërgjyqësi formale kemi në rastet në të cilat midis bashkëndërgjyqësve, jashtë dhe para procesit kontestimor, nuk ekziston as bashkësia juridike e as ajo faktike në aspektin e objektit të kontestit. Bashkëndërgjyqësit e këtillë i lidhë vetëm procesi kontestimor i njëjtë i vënë në veprim me padi me të cilën bashkërisht padisin apo paditën më tepër subjekte të së drejtës. Në situata të tillë janë, p.sh., disa paditës të cilët nga bashkësia e sigurimit kërkojnë ç'dëmtim të bazuar në ngjarjen jetësore të ngjashme; disa të paditur nga të cilët kërkohet pagimi i qirasë për banesat që i shfrytëzojnë veç e veç.

b) *Bashkëndërgjyqësia primare dhe e mëvonshme-*

Primare quhet bashkëndërgjyqësia që themelohet me anë të padisë dhe në momentin e ngritjes së saj. Kjo varet nga vullneti i paditësit. Në rast të bashkëndërgjyqësisë formalisht e kemi vetëm një padi, por në pikëpamje materialo-juridike i kemi aç padi sa edhe bashkë-paditës apo bashkë të paditur. Prandaj, lidhur me çdo padi materialo-juridike themelohet nga një raport proceduralo - juridik. Çdo njëri nga ta përbën gjykim (proces) në veti dhe është i pavarur nga të tjerët, por prapë se prapë formalisht përbëjnë një tërësi procedurale dhe zakonisht jepet një aktgjykim i vetëm. Në nenin 264 të LPK përmenden kushtet nën të cilat dy apo më tepër subjekte padisin apo paditen bashkërisht. Një gjë e tillë është e mundur:

- 1) në qoftë se janë në bashkësi juridike në pikëpamje të objektit të kontestit, apo nëse të drejtat ose detyrimet e tyre burojnë nga e njëjta bazë faktike apo juridike; 2) në qoftë se objekt kontesti janë kërkesat apo detyrimet e llojit të njëjtë, që janë të bazuara në themelin faktik apo juridik esencialisht të ngjashëm dhe nëse ekziston kompetenca lëndore dhe territoriale e të njëjtës gjykatë për secilën kërkesë dhe për secilin të paditur, dhe 3) në qoftë se një gjë e tillë parashikohet me ndonjë ligj tjetër.

Bashkëndërgjyqësia e mëvonshme themelohet pas ngritjes së padisë: 1) në qoftë se deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor paditësi primar i bashkohet paditësi tjetër, apo në qoftë se padia zgjerohet, duke e përfshirë edhe një të paditur tjetër (neni 264.2 të

LPK); 2) në qoftë se shkaktohet sukcesioni procedural në anën e palës paditëse apo të paditur dhe në vend të paditësit apo të paditurit primar në gjykim hyjnë dy a më tepër pasardhës juridik të tyre.

Pala e re ka detyrë që gjykimin në të cilën hynë ta pranojë në gjendjen ekzistuese. Andaj edhe kërkohet pëlqimi i saj.

c) Bashkëndërgjyqësia ligjore- Me LPK dhe dispozitat e disa ligjeve të tjera posaçërisht është paraparë mundësia e bashkëndërgjyqësisë për disa situata juridike. Të tilla janë p.sh.: bashkëndërgjyqësia me të paditurin eventual (neni 265 i LPK), bashkëndërgjyqësia e palëve sipas padisë së personit të tretë (ndërhyrësit kryesor, neni 266 i LPK), bashkëndërgjyqësia e debitorit kryesor dhe e dorëzanit (neni 267 i LPK). Te rasti i bashkëndërgjyqësisë me të paditurin eventual paditësi mund ti përfshijë me një padi të vetme dy të paditur duke i propozuar gjykatës që kërkesë padia kundrejt të dytit të pranohet vetëm në qoftë se kundrejt të parit tregohet si e pa-themeltë.

Te rasti i bashkëndërgjyqësisë së palëve sipas padisë së personit të tretë, ky i fundit me padinë e tij p.sh. nga gjykata kërkon që ti dorëzohet sendi i lidhur me të cilin është duke u zhvilluar procesi gjyqësor.

Sipas padisë së këtillë, palët kundërshtare bëhen bashkëndërgjyqës.

Pozita procedurale e bashkëndërgjyqësve- Bashkëndërgjyqësia si efekt të përbashkët e ka atë se dy apo më tepër gjykime në pikëpamje formale zhvillohen si një. Aktiviteti procedural që kryhet në gjykimet e tilla e përbënë një tërësi të vetme procedurale e bashkëndërgjyqësve mund të jetë e ndryshme në llojet e ndryshme të bashkëndërgjyqësve. Varësisht nga pozita e tillë bëhet dallimi midis bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë dhe unike.

Te rasti i bashkëndërgjyqësisë së thjeshtë (neni 268 i LPK) pozita procedurale e një bashkëndërgjyqësi nuk varet nga pozita procedurale e bashkëndërgjyqësit tjetër. Çdo njëri nga ta është palë e pavarur në gjykim dhe veprimet apo mosveprimet e tij nuk i shkojnë as në dëm e as në dobi të bashkëndërgjyqësit tjetër. Pozita e tyre, pra është e njëjtë sikurse të ishin paditur apo të kishin paditur posaçërisht. Këtu gjykata ndaj çdonjërit bashkëndërgjyqës mund të marrë vendim me përmbajtje të ndryshme. Mirëpo, mund të marrë edhe vendim unik.

Te rasti i bashkëndërgjyqësisë unike (neni 269 i LPK) karakteristik themelore është ajo se kontesti, sipas ligjit apo për shkak të natyrës së raportit materialo-juridik nga i cili ka lindur, mund të zgjidhet vetëm në mënyrë të njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve, të cilët e përbëjnë një palë unike. Këtu procesi gjyqësor jo vetëm formalisht, veçse edhe materialisht është një, sepse vendimi meritor mund të jetë i njëjtë ndaj të gjithë bashkëndërgjyqësve. Unike, p.sh., është bashkëndërgjyqësia në gjykimin në të cilën bashkëpronarët e kërkojnë sendin nga i padituri apo në të cilën bashkëshortët janë paditur me padi për anulimin e martesës etj. Këtu ligji e ka paraparë fiksionin, sipas të cilit të gjithë bashkëndërgjyqësit konsiderohen si një palë (neni 269 i LPK).

Fillimisht u theksua se bashkëndërgjyqësia është institut procedural fakultativ. Mirëpo, në disa raste ajo është e domosdoshme, dhe në to paditësi patjetër me padi

duhet ta themeloj bashkëndërgjyqësinë pasive, duke i përfshirë me padi të gjitha subjektet që janë pjesëmarrës të raportit materialo-juridik. Në qoftë se paditësi nuk vepron kështu, atëherë gjykata me aktvendim duhet ta hedhë poshtë padinë për shkak të mungesës së legjitimitimit procedural në anën e palës së paditur. Rregullat procedurale që vlejné për bashkëndërgjyqësinë unike, vlejné edhe për bashkëndërgjyqësinë e domosdoshme. Mirëpo, e kundërta nuk vlen. Bashkëndërgjyqësi të domosdoshme kemi p.sh. në gjykimin sipas padisë për anulimin e martesës së ngritur nga personi i tretë; në gjykimin në të cilin njëri nga bashkëpronarët e kërkon ndarjen e sendit të përbashkët; në gjykimin në të cilin kërkohet anulimi i kontratës së lidhur nga debitori, sepse me padi, përveç debitorit duhet patjetër të përfshihet edhe personi i tretë.

Pjesëmarrja e personave të tretë në procesin kontestimor

Të drejtat dhe interesat e palëve ndërgjyqëse, të cilat mbrohen në procesin kontestimor, janë dukuri shoqërore dhe nuk mund të ekzistojnë të izoluar nga të drejtat dhe interesat e subjekteve me të cilat ndodhen në marrëdhënie familjare, ekonomike etj. Këto marrëdhënie ndikojnë që pasojat e veprimit të një subjekti të reflektohen, herë-herë edhe në interesat e subjekteve të tjera. E gjithë kjo mund të ndikojë që personat e tretë të jenë të interesuar se si do të përfundoj procesi kontestimor midis palëve ndërgjyqëse. Kjo vlen sidomos në rastet në të cilat aktgjykimi i dhënë në një gjykim e shtrin efektin e tij, për veç se ndaj palëve ndërgjyqëse, edhe ndaj personit të tretë, që nuk ka qenë pjesëmarrës në gjykim. Ndikimi i aktgjykimit mund të jetë i favorshëm apo i disfavorshëm për të tretin. Në disa raste aktgjykimi mund të ketë ndikim edhe në interesat e bashkësisë shoqërore. Nuk ka dyshim se në rastet e përmendura personit të tretë duhet mundësuar që me aktivitetin procedural të tij ti mbrojë interesat personale në procesin që është duke u zhvilluar midis paditësit dhe të paditurit.

Personin që merr pjesë në procesin e huaj e quajmë ndërhyrës apo intervenient, kurse pjesëmarrjen e tij e quajmë ndërhyrje apo intervenim. Konditat e ndryshme nën të cilat mund të ndërhyhet në gjykimin e huaj, si dhe pozita procedurale që mund ta ketë ndërhyrësi, e shkaktojnë dallimin midis tri llojeve të ndërhyrësve: ndërhyrësit e zakonshëm dhe ndërhyrësit me pozitë të bashkëndërgjyqësit unik. Kushdo mund të ndërhyjë në një proces kontestimor që zhvillohet ndërmjet personave të tjerë, kur ka interes juridik për të mbështetur njërën ose tjetrën palë ndërgjyqëse, me të cilën bashkohet në gjykim për ta ndihmuar atë.

- a) *Pjesëmarrja e ndërhyrësit të zakonshëm- Ndërhyrësi i zakonshëm ndërhyr në gjykimin e huaj duke iu bashkuar njëres nga palët me qëllim që ta ndihmoj dhe ta kontrolloj mënyrën, në të cilën ajo e ndjekë çështjen juridike në procedim. Ky ka interes juridik që palës së cilës i bashkohet ta fitoj gjykimin (neni 271.1 i LPK). Ndërhyrësi nuk është as palë e as përfaqësues i palës së cilës i bashkohet. Ndërhyrësi ka të drejtë që ti kryej të gjitha veprimet procedurale përveç atyre të natyrës disponibile. Ai mund të ndërhyjë në gjykim deri në përfundimin e tij me aktgjykim të formës së prerë, si dhe gjatë procedurës së vazhduar me anë të mjetit të goditjes së zakonshme apo të jashtëzakonshme (neni 273.2 i LPK). Deklaratën për ndërhyrje ndërhyrësi e jep me shkrim apo gojarisht në*

gjykatën e shkallës së parë. Kur ndonjëra nga palët e kundërshton ndërhyrjen, për lejueshmërinë e tij vendosë gjykata. Kundër aktvendimit të gjykatës me të cilin aprovohet pjesëmarrja e ndërhyrësit nuk lejohet ankesa e posaçme, (neni 272.3 i LPK).

- b) *Pjesëmarrja e ndërhyrësit me pozitë të bashkëndërgjyqësit unik- Personi i tretë që ndërhyrë në gjykimin e huaj e fiton pozitën e ndërhyrësit me pozitë të bashkëndërgjyqësit unik, në qoftë se aktgjykimi, që duhet të jepet në të prodhon efekte të njëjta sikurse ndaj palës ashtu edhe ndaj ndërhyrësit (neni 274). Efektin e tillë e cakton vetë ligji, apo natyra e raportit juridik lidhur me të cilën jepet aktgjykimi. Ndërhyrës i këtij lloji është p.sh. personi i tretë që ka të drejtë, sipas ligjit, ta kërkojë anulimin e martesës së palëve, personi që gjatë gjykimit lidhur me një send e blenë atë nga njëra palë dhe i bashkohet asaj, pasi që kundërshtari i saj nuk ka pranuar që të bëhet suksesimi procedural, kreditori në procedurën falimentuese etj. Këtij ndërhyrësi sipas dispozitës së nenit 274.2 i LPK i njihet e drejta që të godit edhe vendimin e formës së prerë edhe po që se nuk ka marrë pjesë në gjykimin e tillë në të cilin ai tani ndërhyr.*

Emërimi i paraardhësit juridik

Personi që është paditur si posedues i një sendi apo si shfrytëzues i një të drejte pasurore dhe që pretendon se sendin e posedon, respektivisht se të drejtën e shfrytëzon në emër të personit të tretë mundet, më së voni në seancën përgatitore, e po që se kjo nuk është mbajtur, atëherë në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, nëpërmjet gjykatës ta thërras atë person të tretë (paraardhës juridik) që në vend të tij të hyjë si palë e paditur në gjykim.

Pëlqimi i paditësit, që në vend të palës së paditur nga ai të hyjë në gjykim paraardhësi juridik, nevojitet vetëm në qoftë se paditësi kundër të paditurit parashtron edhe kërkesa që nuk varen nga ajo se a e mbanë në posedim ose jo sendin në emër të paraardhësit, respektivisht e ushtron ose jo të drejtën e caktuar në emër të paraardhësit juridik.

Në qoftë se paraardhësi juridik që është thirr rregullisht nuk vjen në seancë gjyqësore apo nuk pranon që të hyjë në procesin kontestimor në vend të palës së paditur, atëherë ky i fundit nuk mund të kundërshtojë pjesëmarrjen në shqyrtimin e çështjes së ngritur me padi kundër tij.

Njoftimi i personit të tretë për procesin gjyqësor

Secila palë mund të thërret në gjykimin e çështjes një person me të cilin mendon se e ka të përbashkët çështjen, ose nga i cili mund të kërkohet një garanci ose shpërblim, që lidhet me përfundimin e çështjes. Personi i tretë thirret me kërkesë të shkruar që mund të paraqitet deri në përfundimin e gjykimit me vendim të formës së prerë. Në shkresën e tillë, e cila personit të tretë i dërgohet nëpërmjet gjykatës së çështjes, tregohet shkaku i thirrjes dhe gjendja në të cilën ndodhet procesi kontestimor. Pala që e ka njoftuar personin e tretë për procesin gjyqësor nuk mund të kërkojë për këtë

arsye ndërprerjen e gjykimit, shtyrjen e seancës, apo zgjatjen e afateve për kryerjen e veprimeve procedurale.

Ndërprerja e gjykimit dhe pushimi i gjykimit

Aktiviteti procedural i subjekteve kryesore zakonisht kryhet pa ndërprerje dhe përfundonb me dhënien e vendimit meritor për kërkesëpadinë. Mirëpo, mund të krijohen situata në të cilat veprimtaria procedurale domosdo duhet të ndalet, përkundër faktit se ende nuk janë krijuar kushtet për vendosje meritore, gjë që është qëllim kryesor i çdo procesi kontestimor. Në rastet e tilla rrethanat e krijuara, me vullnetin e subjektit kryesor, por herë-herë, edhe pa vullnetin e tyre, e vonojnë dhënien e vendimit meritor. Rrethanat e tilla e shkaktojnë, zakonisht, vetëm ndaljen e përkohshme të aktivitetit procedural. Raporti proceduralo-juridik kryesor ende ekziston. Kur kalojnë shkaqet e ndaljes, aktiviteti procedural vazhdon të zhvillohet nga pika në të cilën është zhvilluar para ndaljes, bashkohet në një tërësi unike me pjesën që zhvillohet nga momenti kur kalojnë shkaqet e ndaljes.

Ndalja në fjalë bëhet në dy forma: në formë të ndërprerjes dhe në formë të pushimit.

Ndërprerja e procedurës- Shkaqet e ndërprerjes LPK i ndan në dy grupe. Në të parin bëjnë pjesë ngjarjet jashtë procedurale për shkak të cilave ndërprerja bëhet sipas fuqisë ligjore. Grupin e dytë të shkaqeve e përbëjnë rrethanat në të cilat gjykata me vendimin e saj mund ta ndërpresë procedurën. Efektet e ndërprerjes janë të njëjta në të dy rastet.

- a) *ndërprerja e procedurës sipas fuqisë ligjore.- Këtë lloj ndërprerje e shkaktojnë:*
- kur pala ndërgjyqëse vdes ose e humbë zotësinë procedurale, e nuk ka caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim; b) kur përfaqësuesi ligjor i palës vdesë ose shuhet autorizimi i tij për përfaqësim, e pala nuk ka të caktuar përfaqësues me prokurë në gjykim; c) kur pala që është person juridik pushon së ekzistuari, respektivisht kur organi kompetent jep vendim të formës së prerë për ndalimin e punës tij; ç) kur paraqitet propozimi për fillimin e procedurës së falimentimit në kontestet në të cilat i padituri është debitor falimentues; d) kur për shkak të luftës ose për shkaqe të tjera pushon puna në gjykatë; dh) kur ndërprerja e gjykimit parashihet me ndonjë ligj tjetër.
- b) *Ndërprerja e procedurës me vendimin e gjykatës- Gjykata e ndërpret procedurën:*
- po që se ka vendosur që vetë të mos e zgjidhë çështjen paraprake (neni13 i këtij ligji);
 - po që se pala ndodhet në zonën e cila, për shkak të ngjarjeve të jashtëzakonshme (vërshimet, tërmeti etj) është shkëputur nga gjykata.

Gjykata mund ta caktojë ndërprerjen e gjykimit në qoftë se vendimi mbi kërkesëpadinë varet nga fakti nëse është kryer delikti ekonomik apo vepra penale që ndiqet sipas detyrës zyrtare, kush është kryerësi dhe nëse ai është i përgjegjshëm, e sidomos kur paraqitet dyshimi se dëshmitari ose eksperti ka dhënë deklaratë të rreme, apo se dokumenti i përdorur si mjet provues është i rremë.

Pushimi i gjykimit shkaktohet kur vdes pala, apo kur mbaron se ekzistuari, po që se objekt kontesti janë të drejtat që nuk mund të kalojnë në trashëgimtarët e palës, përkatësisht në pasardhësin juridik të saj. Në këtë rast aktvendimi për pushimin e gjykimit i dërgohet palës kundërshtare, trashëgimtarëve, përkatësisht pasardhësit juridik të palës, pasi të jenë caktuar ata.

Trashëgimtarëve të palës së vdekur, sipas propozimit të palës kundërshtare apo sipas detyrës zyrtare, gjykata ua cakton përfaqësuesin e përkohshëm të cilit ia dërgon aktvendimin mbi pushimin e gjykimit, po që se konstaton se procedura trashëgimore mund të zgjasë shumë kohë. Deri sa të bëhet i formës së prerë aktvendimi mbi pushimin e gjykimit, lidhur me afatet për kryerjen e veprimeve juridike, me të drejtat e palëve dhe veprimet e gjykatës në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat mbi ndërprerjen e gjykimit.

Ndihma juridike

Gjatë procesit kontestimor nganjëherë tregohet e nevojshme që të sigurohet ndonjë provë e cila gjendet në territorin e gjykatës tjetër territoriale dhe e gjendur në një situatë të tillë gjykata e cila duhet siguar atë provë i drejtohet gjykatës përkatëse për ndihmë. Në një situatë të tillë gjykatat kanë për detyrë t'i japin njëra tjetrës ndihmë juridike. Në qoftë se gjykata e lutur nuk është kompetente për kryerjen e veprimit për të cilin është lutur, do t'ia dërgoj lutjen gjykatës kompetente, respektivisht organit tjetër shtetëror, e për këtë gjë do ta njoftojë gjykatën nga e cila i ka ardhur lutja. Po që se gjykatës së lutur nuk i është e njohur gjykata kompetente, përkatësisht organi shtetëror tjetër, gjykata e lutur ia kthen lutjen gjykatës së çështjes.

Gjykatat u japin ndihmë juridike gjykatave të huaja në rastet e përcaktuara me anë të kontratave ndërkombëtare, si dhe kur ekziston reciprociteti në dhënien e ndihmës juridike. Në rast dyshimi për ekzistimin e reciprocitetit, njoftime jap Ministria përkatëse.

Në qoftë se me kontratë ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe, gjykatat do t'i marrin në procedim lutjet për dhënien e ndihmës juridike të gjykatave të huaja vetëm po që se janë dërguar në rrugë diplomatike dhe në qoftë se lutja dhe shkresat që i janë bashkangjitur janë hartuar në gjuhën që është në përdorim zyrtar në gjykatë, apo në qoftë se është bashkangjitur përkthimi i tyre i legalizuar në atë gjuhë.

Po që se me kontratë ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe, lutjet e gjykatave të vendit për ndihmë juridike u dërgohen gjykatave të huaja në rrugë diplomatike. Lutjet dhe shkresat tjera që i bashkëngjiten duhet të hartohen në gjuhën e shtetit të lutur, ose duhet t'u bashkëngjitet përkthimi i tyre i legalizuar në atë gjuhë.

Mosrespektimi i gjykatës

Gjykata gjatë zhvillimit të procedurës has në situata të ndryshme kur pala qoftë paditëse apo e paditur tregon mos respekt ndaj saj për çfarë me ligj është paraparë mundësia e dënimit me gjobë deri në 500 Euro për palën, përfaqësuesin ligjor, përfaqësuesin me prokurë, apo ndërhyrësin i cili me veprimet procedurale i ka keqpërdorur rëndë të drejtat që i janë njohur me këtë ligj.

Në situatën kur me veprimin procedural si ma lartë ndonjërit nga pjesëmarrësit në procedurë i është shkaktuar dëm i natyrës juridiko civile, me kërkesën e të dëmtuarit gjykata vendosë për kompensimin e dëmit në të njëjtin proces gjyqësor.

Me dënim në të holla prej 100- 500 Euro gjykata e gjobitë palën apo pjesëmarrësin tjetër në procedurë i cili me anë të parashtrësës e fyen gjykatën.

Në qoftë se pjesëmarrësi në procedurë apo personi që është i pranishëm në vendin ku mbahet seanca për shqyrtimin e çështjes e fyen gjykatën, apo pjesëmarrësit tjerë në procedurë, e pengojnë punën apo nuk i respektojnë urdhërat e gjyqtarit për mbajtjen e rendit dhe qetësisë, gjykata do ta qortojë atë. Po që se qortimi tregohet i pasuksesshëm, gjykata personin e qortuar do ta largojë nga vendi ku mbahet seanca gjyqësore ose do ta dënoj me gjobë deri në 500 Euro, kurse mundet edhe ta largojë edhe ta dënoj me gjobë.

Në qoftë se pala apo përfaqësuesi me prokurë i saj largohet nga vendi i seancës, seanca do të mbahet pa praninë e tyre. Po që se përfaqësuesi me prokurë i palës edhe gjatë zhvillimit të mëturjeshëm të procedurës bënë veprime të më larta, gjykata mund t'ia ndaloj përfaqësimin e mëturjeshëm të palës.

Gjykata e dënon me gjobë deri në 500 Euro përfaqësuesin për marrjen e shkresave i cili në kundërshtim me obligimin e tij ligjor nuk e njofton gjykatën për ndërrimin e adresës. Përfaqësuesin e këtillë, me kërkesën e palës, gjykata e detyron me shpenzimet e shkaktuara me mos njoftimin pa justifikim për ndryshimin e adresës.

Personin që pa arsye refuzon ta marrë shkresën, si dhe atë që në mënyrë tjetër e pengon dorëzimin e shkresës, duke vështirësuar apo pamundësuar kështu zbatimin e dispozitave të këtij ligji mbi dorëzimin e shkresave, gjykata e dënon me gjobe deri në 500 Euro.

Kur dëshmitari që është thirrur nuk paraqitet pa shkaqe të arsyeshme, ose pa leje apo shkak të arsyeshëm largohet nga vendi ku duhet të dëgjohet, gjykata do të urdhërojë sjelljen e tij me detyrim dhe pagimin e shpenzimeve të sjelljes me detyrim, si dhe do ta dënojë me gjobë deri në 500 Euro.

Në qoftë se dëshmitari vjen në vendin e mbajtjes së seancës dhe përkundrajt paralajmërimin mbi pasojat, refuzon të dëshmojë apo të përgjigjet në pyetjet konkrete, kurse gjykata shkaqet e refuzimit i quan të pa arsyeshme, mund ta dënojë me gjobë deri në 500 Euro, e në qoftë se edhe pas kësaj refuzon të dëshmojë, mund ta burgos. Burgimi zgjatë gjersa dëshmitari të mos pranojë të dëshmojë, apo gjersa dëshmia e tij të mos bëhet e panevojshme, por jo më tepër se tridhjetë (30) ditë.

Me kërkesën e palës, gjykata do të vendosë që dëshmitari e ka për detyrë t'i paguaj shpenzimet të cilat i ka shkaktuar me mosardhjen e vet të paarsyeshme, respektivisht me refuzimin e pajustificuar për të dëshmuar.

Gjykata mund ta dënoj me gjobë deri në 1000 Euro ekspertin që pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk e dorëzon brenda afatit të caktuar konstatimin dhe mendimin e vet, apo që pa arsye nuk vjen në seancë edhe pse është thirrur rregullisht.

Me dënim të njëjtë gjykata e dënon ekspertin që pa ndonjë arsye refuzon ekspertimin.

I njëjti kriter vlen edhe për interpretin gjyqësor.

SIGURIMI I KËRKESËPADISË

Nganjëherë tregohet e domosdoshme që të bëhet sigurimi kërkesëpadisë nga shkakut se po që se pritet rezultati përfundimtar i kontestit i cili pritet të zhvillohet atëherë ekziston frika se do të bëhet i pamundur realizimi i kërkesës së pritur nga gjykimi i ardhshëm dhe në një situatë të tillë ligja parasheh mundësinë e sigurimit të kërkesëpadisë.

Për vendosje mbi propozimin për sigurim të paraqitur para se të jetë ngritur padia për fillimin e procedurës kontestimore, si dhe gjatë procedurës së tillë, është kompetente gjykata që vepron sipas padisë. Vendimin mbi masën e sigurimit e jep gjykata që vepron në shkallë të parë, kurse gjykata më e lartë atëherë kur propozimi për marrjen e saj është paraqitur pas dërgimit të dosjes së lëndës sipas ankesës në këtë gjykatë.

Pasi të jetë bërë i formës së prerë aktgjykimi mbi kërkesëpadinë, për propozimin e sigurimit vendosë gjykata që do të ishte kompetente për vendosje mbi kërkesëpadinë në shkallë të parë.

Masa e sigurimit mund të caktohet:

- a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij, dhe b) në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtyllë pala kundërshtarë do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit. Po që se nuk është përcaktuar ndryshe me ligj, gjykata e cakton masën e sigurimit vetëm nën kushtet që propozuesi i sigurimit, brenda afatit të caktuar nga gjykata, ashtu siç parashihet me Ligjin mbi Procedurën Përmbartimore, jep garanci në masën dhe në llojin e caktuar nga gjykata, për dëmin që mund t'i shkaktohet palës kundërshtarë me caktimin dhe ekzekutimin e masës së sigurimit. Po që se propozuesi nuk jep garanci brenda afatit të caktuar gjykata e refuzon propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Me kërkesën e propozuesit gjykata mund ta liroj atë nga detyrimi i dhënies së garancisë po që se konstatohet se nuk ka mundësi financiare për një gjë të tillë.

Për sigurimin e kërkesës në të holla mund të caktohen këto masa të sigurimit:

- a) *ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta tjetërsojë, fshehë, ngarkojë ose disponojë me pasurinë e caktuar me vlerë të mjaftueshme për sigurimin e kërkesës së propozuesit të sigurimit. Ky ndalim do të regjistrohet në regjistrin publik përkatës;*
- b) *ruajtja e pasurisë me të cilën ka të bëjë ndalimi nga pika e sipërme nga gjykata në depozitën e saj, kur ka mundësi për një gjë të tillë, apo duke iu dhënë në posedim propozuesit të sigurimit apo personit të tretë;*
- c) *ndalimi debitorit të kundërshtarit të sigurimit që këtij të fundit t'i përmbushet kërkesa apo dorëzohet sendi, si dhe ndalimi kundërshtarit të sigurimit që ta pranojë sendin, ta realizojë kërkesën apo të disponojë me të;*
- d) *parashënimi i së drejtës së pengut mbi sendin e paluajtshëm të kundërshtarit të sigurimit, apo mbi të drejtën e regjistruar në sendin e paluajtshëm, gjerë në vleftën e kërkesës kryesore, me kamata dhe shpenzime procedurale, për të cilën është dhënë aktgjykimi i cili ende nuk është bërë i ekzekutueshëm.*

Aktvendimi me të cilin caktohet masa e sigurimit i dërgohet kundërshtarit të sigurimit, debitorit të kundërshtarit të sigurimit, e kur është rasti edhe regjistrin publik përkatës. Masa e sigurimit konsiderohet e zbatuar në momentin kur aktvendimi i dorëzohet kundërshtarit të sigurimit apo debitorit të tij, po që se i është dorëzuar këtij të fundit, apo regjistrin publik përkatës, varësisht nga ajo se cila nga këto tri data të dorëzimit është më e hershme në pikëpamje kohore. Kundërshtari i sigurimit i cili vepron në kundërshtim të aktvendimit për ndalimin e tjetërsimit, fshehjes, ngarkimit apo të disponimit me pasurinë përgjigjet sipas rregullave të së drejtës civile. Pas parashënimit të ndalimit, e deri sa ai të jetë në fuqi, nuk është i mundshëm regjistrimi në regjistrin publik i asnjë ndryshimi të të drejtave të krijuara në bazë të disponimit vullnetar të kundërshtarit të sigurimit.

Tjetërsimi apo ngarkimi në kundërshtim me urdhrin e gjykatës mbi ndalimin e tjetërsimit, fshehjes apo disponimit me pasurinë nuk ka efekt juridik ndaj propozuesit, përpos kur ka vend për aplikimin e rregullave mbi mbrojtjen e fituesit të ndershëm.

Masa e sigurimit siç u vërejt më lartë mund të propozohet para inicimit dhe gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor kontestimor si dhe pas përfundimit të tij, derisa ekzekutimi të përfundojë plotësisht. Propozimi paraqitet në formë të shkruar. Në qoftë se propozimi është i lidhur me procesin gjyqësor që është në zhvillim e sipër, ai mund të paraqitet edhe gojarisht në seancë gjyqësore.

Në propozimin për caktimin e masave të sigurimit propozuesi i sigurimit duhet ta tregojë në të kërkesën, për sigurimin e të cilës bënë propozim, masën e sigurimit që e propozon, mjetet dhe objektin e masës të sigurimit. Në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim. Propozuesi i

sigurimit ka për detyrë, po që se ka mundësi, që mjetet provuese t'ia bashkëngjitë propozimit.

Përveçse në rastet e përcaktuara me këtë ligj, masa e sigurimit nuk mund të caktohet po që se kundërshtari i sigurimit nuk ka pasur mundësinë që të deklarohet për propozimin e caktimit të saj. Propozimin për caktimin e masave të sigurimit gjykata, bashkë me shkresat që i janë bashkangjitur, ia dërgon kundërshtarit të sigurimit me njoftim se mund të paraqesë përgjigje të shkruar brenda afatit shtatë (7) ditor.

Me propozim të propozuesit të sigurimit të paraqitur me propozim për caktimin e masës së sigurimit gjykata mund ta caktojë masën e përkohshme të sigurimit pa njoftim dhe dëgjim paraprak të kundërshtarit të sigurimit, po që se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshëm pretendimin se masa e sigurimit është e bazuar dhe urgjente dhe se me veprim ndryshe do të humbte qëllimi i masës së sigurimit.

Vendimin nga paragrafi 1 të këtij neni gjykata ia dërgon kundërshtarit të sigurimit menjëherë. Kundërshtari i sigurimit brenda afatit prej tre (3) ditësh në përgjigjen e tij mund t'i kontestojë shkaqet për caktimin e masës së përkohshme të sigurimit, e pas kësaj gjykata duhet të caktojë seancë në tri ditët e ardhshme. Përgjigja e kundërshtarit të sigurimit duhet të përmbajë pjesën arsyetuese.

Në aktvendimin mbi caktimin e masës së sigurimit gjykata e përcakton llojin e masës, mjetet me të cilat ajo do të realizohet dhunshëm dhe objektin e masës së sigurimit, duke i aplikuar përkatësisht rregullat e procedurës gjyqësore përmbartuese. Gjikata sipas detyrës zyrtare ia dërgon aktvendimin mbi caktimin e masës së sigurimit gjykatës përmbartuese kompetente me qëllim të ekzekutimit të tij të përdhunshëm dhe regjistrimit publik me qëllim të regjistrimit në të.

Kur masa e sigurimit caktohet para se të jetë ngritur padia, me vendimin me të cilin caktohet masa e sigurimit caktohet edhe afati jo më i shkurtër se tridhjetë (30) ditor brenda të cilit propozuesi i sigurimit duhet të ngritë padinë.

Kundër aktvendimit të shkallës së parë mbi masën e sigurimit mund të paraqitet ankesa brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e dorëzimit të tij. Ankesa i dërgohet kundërshtarit të sigurimit i cili brenda afatit prej tre (3) ditësh nga dorëzimi ka të drejtë të paraqesë në gjykatë përgjigjen në ankesë.

Mbi ankesën vendosë gjykata e shkallës së dytë brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor nga dita në të cilën i arrin përgjigja në ankesë apo skadimit të afatit për paraqitjen e saj.

Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e aktvendimit.

Kundër aktvendimit mbi masën e përkohshme nuk lejohet ankimi. Masat e sigurimit të kërkesëpadisë i zbaton gjykata që do të ishte kompetente për ekzekutimin e aktgjykimit të formës së prerë.

MJETET PROVUESE DHE MARRJA E PROVAVE

Veprimet kryesore të ndërmarra nga ana e gjykatës kanë për të vetmin qëllim zbulimin e së vërtetës rreth çështjes në kontest, dhe çdo gjykim për zbulimin e kësaj të vërtete nuk është gjë tjetër, veçse një proces njohje. Njohje racionale nënkupton qenien e tri elementeve: objektit të njohjes, mjetet me të cilat realizohet njohja dhe vet procesi i njohjes.

Objekti i të provuarit- Objekti i të provuarit janë pretendimet e palëve për ekzistimin apo mosekzistimin e fakteve nga të cilat varet zbatimi i të drejtës materiale në procesin kontestimor. Me nocionin e faktit përfshihet çdo rrethanë, për të cilën norma juridike e lidhë ndonjë efekt, e i cili është i përcaktuar konkretisht në hapësirë dhe kohë. Fakt relevant mund të jetë ngjarja që ka ndodhur në të kaluarën apo gjendja e cila ka ekzistuar ose aktualisht ende ekziston. Fakti relevant juridik mund të jetë i botës materiale apo shpirtërore. Ja disa fakte për të cilat norma juridike mund të lidhë efekte juridike: veprimi apo mosveprimi me të cilin është shkaktuar një dëm; pagimi i një shume të hollash; cilësia fizike e një sendi; vënia në dijeni e një personi në lidhje me deklaratë apo me përmbajtjen e saj; vlera e një shërbimi; dijenia në lidhje me një rrethanë etj.

Objekt i të provuarit bëhet vetëm me faktet relevante që janë kontestuese midis palëve. Kontestuese janë faktet lidhur me të cilat palët shprehin mendime të kundërta. Nuk kanë nevojë të provohen faktet e pohuara nga palët, mandej faktet e ditura botërisht, si dhe faktet e prezumuara nga ligji (por mund të provohet mosekzistimi i tyre). Prezumimi ligjor është rregull sipas të cilit gjykata është e detyruar që të marrë si ekzistues një fakt në çoftë se ekziston tjetri fakt i përcaktuar nga ligji. P.sh. kur debitorit i është kthyer dokumenti për borxhin, prezumohet se borxhi është shlyer. Pohimi i fakteve është veprim procedural i njëanshëm me të cilin pala deklaron se janë të vërteta faktet në të cilat kundërshtari i saj e bazon kërkesën e tij. Këto tri llojesh gjykata i merr për themel të vendimit të saj pa i provuar fare.

Mjetet provuese- Mjet provues quajmë çdo burim nga i cili me anë të organeve të shqisave nxjerrim njohuri për vërtetësinë e thënies se ekziston apo nuk ekziston një fakt për të cilin lidhet pasoja juridike e caktuar. Me ligj si mjete provuese janë parashikuar: këqyrja në vend, shkresat, dëshmitarët, ekspertët dhe palët.

Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Provat merren në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes (përveç përjashtimeve kur kjo provë duhet të merret përpara një gjykate tjetër – gjykatës së porositur).

KQYRJA NË VEND

Këqyrja në vend ndërmerret sa herë që çmohet e nevojshme që për vërtetimin e ndonjë fakti, apo për sqarimin e ndonjë rrethane, duhet të bëhet vrojtimi i drejtpërdrejt nga gjykata e çështjes. Ky mjet provues shërben për të vënë gjyqtarin në mundësi që të marrë dijeni për gjendjen dhe cilësitë e personave dhe sendeve.

Marrja e provës me anë të këqyrjes së drejtpërdrejtë mund të bëhet edhe me bashkëveprimin e ekspertit. Po që se sendi që duhet këqyrë nuk mund të sjellët në gjykatë apo në qoftë se sjellja e tij do të shkaktoje shpenzime të mëdha, gjykata e bënë këqyrjen e sendit në vendin ku ai ndodhet dhe me atë rast hartohet procesverbali.

SHKRESAT

Fuqia provuese e shkresave

Shkresat janë objekt material në të cilin me anë të shenjave të shkruara është shprehur një mendim. Duke marrë parasysh hartuesin, Ligji i dallon shkresat publike dhe shkresat tjera.

Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të. Të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike. Lejohet që të provohet se në shkresën publike faktet janë konstatuar jo saktësisht apo se shkresa është hartuar në mënyrë jo të rregullt. Po që se gjykata dyshon në autenticitetin e shkresës, mund të kërkojë që për këtë të deklarohet organi nga i cili shkresa duhet të jetë hartuar. Po që se me kontratë ndërkombëtare nuk është përcaktuar ndryshe, shkresat publike të huaja të legalizuara sipas ligjit, kanë, me kusht reciprociteti, të njëjtën fuqi provuese sikurse shkresa publike e vendit.

DËSHMITARËT

Dëshmitar është personi i cili i jep gjykatës deklaratë në lidhje me perceptimin e fakteve në të kaluarën duke mos e dhënë mendimin e tij mbi faktin e perceptuar. Parimisht, çdo person, pa marrë parasysh moshën e tij, ka zotësi për të qenë dëshmitar dhe po që se thirret nga ana e gjykatës si dëshmitar ka për detyrë t'i përgjigjet thirrjes, e në qoftë se me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ka për detyrë edhe të dëshmojë.

Si dëshmitarë mund të pyetën vetëm personat që kanë aftësi të japin informata mbi faktet që duhet të provohen. Në këtë drejtim të miturit nën katërbëdhjetë vjeç mund të pyeten si dëshmitar vetëm kur thëniet e tyre janë të domosdoshme për zgjidhjen e çështjes.

Dëshmitari mund të refuzojë të dëshmojë në këto raste:

- a) *mbi atë që pala ndërgjyqëse ia ka besuar si përfaqësuesit të vetë me prokurë;*
- b) *mbi atë që pala ose personi tjetër ia ka treguar dëshmitarit si rrëfyesit të vetë;*
- c) *mbi faktet që i ka marrë në dijeni dëshmitari si avokat, si mjek ose në ushtrimin e ndonjë profesioni apo veprimtarie tjetër, po që se ekziston detyrimi që të ruhet si sekret ajo që merr në dijeni gjatë ushtrimit të profesionit apo të veprimtarisë së vet.*

Personat e këtillë gjykata i njofton me të drejtën e refuzimit të dhënies së deklaratës së dëshmitarit.

Dëshmitari mund të refuzojë përgjigjen në pyetjet e caktuara, në qoftë se për këtë ekzistojnë arsye të rëndësishme, e sidomos në qoftë se me përgjigjen në këto pyetje, do t'ia ekspozonte përgjegjesisë penale vetës, apo të afërmit e tij të gjinisë së gjakut në vijë vertikale deri në cilëndo shkallë, e në vijë horizontale deri në shkallën të tretë përfundimisht, bashkëshortin e vet, ose të afërmit e gjinisë së krushqisë deri në shkallë të dytë përfundimisht, edhe po që se ka pushuar martesë, personin me të cilin jeton në bashkësi jashtëmartesore, apo kujdestarin e vet, ose personin nën kujdestarinë e tij, adoptuesin apo të adoptuarin e vet.

Gjykata ka për detyrë ta njoftojë dëshmitarin me të drejtën e refuzimit të përgjigjes në pyetjet e natyrës së përmendur më lartë.

EKSPERTËT

Për dhënien e përgjigjes në pyetjet, në të cilat gjykata has gjatë gjykimit, shpeshherë është e nevojshme dijenia profesionale nga lëmi i shkencës, ekonomisë, mjekësisë, artit, apo nga ndonjë veprimtari tjetër shoqërore. Dhënia e ndihmës së tillë në të shumtën e rasteve qëndron në atë se ai ia bënë të mundur gjykatës konstatimin e faktit i cili është objekt i të provuarit.

Marrjen e provës me anë të ekspertizës gjykata e cakton me vendim i cili duhet të përmbajë:

- a) *emrin, mbiemrin dhe profesionin e ekspertit;*
- b) *objektin e kontestit;*
- c) *vëllimin dhe lëndën e ekspertimit;*
- d) *afatin për paraqitjen me shkrim të konstatimit dhe mendimit.*

Eksperti gjithmonë thirret në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Mendimin e ekspertit gjykata e çmon lirisht, sikurse edhe provat tjera. Mirëpo, në praktikën gjyqësore, në të shumtën e rasteve gjykata e përvetëson mendimin e ekspertit.

Dispozitat ligjore lidhur me ekspertimin në mënyrë të përshtatshme zbatohen edhe për interpretët gjyqësor.

DËGJIMI I PALËVE

Në të drejtën tonë duhet dalluar rreptësishtë provën me anë të dëgjimit të palëve nga i ashtuquajtur dëgjim informativ i tyre apo thjeshtë deklaram i tyre rreth pretendimeve të tyre rreth kontestit konkret. Kur palët shërbejnë si mjet provues, roli i tyre është i ngjashëm me atë të dëshmitarit. Kjo provë ka karakter subsidiar, sepse gjykata mund ta përdorë (por nuk është e obliguar) në çoftë se nga provat e tjera nuk ka mundur të

formoj bindjen e saj për saktësinë e fakteve, apo kur nuk ekzistojnë prova të tjera. Gjykata vendosë ta marrë në pyetje vetëm njëërën nga palët, në qoftë se është e bindur se tjetra nuk ka dijeni për faktin kontestues. Ky mjet provues nuk është i besueshëm, sepse interesi personal i palëve ndikon që ato mos ta flasin gjithmonë të vërtetën. Nga kjo arsye është paraparë se pala nuk është e detyruar të pranoj rolin e mjetit provues. Mirëpo, kur e pranon një gjë të tillë, pala përgjigjet penalisht për dhënien e dëshmisë së rreme.

Duhet pasur kujdes të veçantë me rastin e administrimit të kësaj prove edhe për faktin se të dy palët kundërshtare njëkohësisht duhet ftuar me ftesa të posaçme për tu marrë në pyetje në cilësinë e palëve dhe duhet njoftuar se në rast të mosardhjes së tyre pala kundërshtare do të merret në pyetje dhe se në një situatë të tillë kur palët nuk i përgjigjen ftesës së gjykatës ndaj tyre nuk mund të përdoret kurfar mase shtrëngimi e as që të njëjtat të detyrohen për të dhënë deklaratë.

SIGURIMI I PROVËS (PARAPROVA)

Në situatën kur një provë, nga e cila varet zgjidhja e kontestit ose që ndikon në sqarimin e tij, ka rrezik të zhduket ose të vështirësohet marrja e saj, me kërkesën e palës së interesuar mund të urdhërohet marrja para kohës së saj, qoftë gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor qoftë para fillimit të tij.

Kërkesa për sigurimin e provës mund të bëhet para dhe gjatë procedurës së iniciuar për përsëritjen e gjykimit të përfunduar me vendim të formës së prerë por gjithsesi po që se plotësohen kushtet e mësipërme.

Kompetente për sigurimin e provës është gjykata që është duke shqyrtuar çështjen e në rast se padia nuk është ngritur ende, gjykata e vendit ku ka banim personi që do të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret. Në rastet e ngutshme kërkesa për sigurimin e provës mund të paraqitet në gjykatën e vendit ku ka banim personi që do të pyetet ose ku ndodhet sendi që duhet të këqyret, përkundrejt faktit se padia është ngritur.

Në kërkesën për sigurimin e provës duhet të tregohen prova që do të merret, rrethanat dhe faktet për vërtetimin e të cilave shërben ajo dhe arsyet që e justifikojnë marrjen e saj përpara se të vijë koha normale për marrjen e provave. Në kërkesë duhet të tregohet emri dhe mbiemri i palës kundërshtare, përveç kur ajo është e panjohur.

Kopja e kërkesës i komunikohet palës kundërshtare, përveç kur ajo nuk dihet ose kur marrja e provës nuk lejon shtytje.

Në qoftë se palës kundërshtare nuk i është dërguar me parë kërkesa për sigurimin e provës, atëherë ajo i dërgohet bashkë me aktvendimin me të cilin është pranuar dhe caktuar seanca për marrjen e provës.

Palës kundërshtare të panjohur, apo të cilës nuk i dihet vendbanimi, gjykata mund t'ia emëroj përfaqësuesin e përkohshëm me qëllim që të marrë pjesë në seancën e caktuar për marrjen e provës. Për emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm nuk ka nevojë të bëhet shpallje publike.

Në rastet e ngutshme gjykata mund të vendosë që prova të merret para se t'i dërgohet vendimi, me të cilin është pranuar kërkesa për sigurimin e provës, palës kundërshtare.

Kundër aktvendimit të gjykatës, me të cilin pranohet propozimi për sigurimin e provës, si dhe kundër aktvendimit me të cilin vendosëet që marrja e provës të filloj para se aktvendimi t'i dërgohet palës kundërshtare, nuk lejohet ankimi.

Mosparaqitja e palës që ka kërkuar sigurimin e provës në seancën për marrjen e provës sjell refuzimin e propozimit, përveç kur marrjen e saj e kërkon pala kundërshtare ose kur gjykata çmon se kjo është në dobi të procesit gjyqësor.

PËRGATITJA E SHQYRTIMIT KRYESOR

Gjykata menjëherë pasi t'i arrij padia i fillon përgatitjet për shqyrtim kryesor të çështjes. Këto përgatitje përfshijnë ekzaminimin paraprak të padisë, dërgimin e padisë palës së paditur për përgjigje të domosdoshme, mbajtjen e seancës përgatitore dhe caktimin e seancës për shqyrtim kryesor të çështjes. Gjatë përgatitjes së shqyrtimit kryesor palët mund të dërgojnë parashtresa në të cilat i tregojnë faktet dhe provat të cilat mendojnë ti propozojnë për marrje.

Me qëllim që çështja të përgatitet sa më mirë për t'u zgjidhur shpejt e drejt, gjykata që nga momenti i arritjes së padisë e deri në momentin e caktimit të seancës për shqyrtim kryesor të çështjes me aktvendim vendosë për:

- a) *dhënien e përgjigjes në padi nga pala e paditur;*
- b) *sigurimin e provës;*
- c) *tërheqjen e padisë;*
- d) *ndryshimin e padisë;*
- e) *ndërprerjen e procedurës;*
- f) *pjesëmarrjen e ndërhyrësit;*
- g) *hyrjen e paraardhësit juridik në procesin gjyqësor;*
- h) *veçimin apo bashkimin e dy proceseve gjyqësore;*
- i) *caktimin apo zgjatjen e afateve gjyqësore;*
- j) *caktimin apo shtytjen e seancave;*
- k) *rivendosjen në gjendjen e mëparshme;*
- l) *masat e përkohshme të sigurimit;*
- m) *sigurimin e shpenzimeve procedurale;*
- n) *lirimin e palës nga pagimi i shpenzimeve procedurale;*
- o) *deponimin e paradhënies për shpenzimet e veprimeve procedurale;*
- p) *caktimin e ekspertit;*
- q) *emërimin e përfaqësuesit të përkohshëm;*
- r) *dërgimin e shkresave gjyqësore;*

- s) *masat për përmirësimin dhe plotësimin e parashtrësive;*
- t) *rregullsinë e përfaqësimit dhe të prokurës;*
- u) *mos kompetencën e gjykatës;*
- v) *bashkimin e padive;*
- w) *pushimin e gjykimit kur hedhet poshtë padia apo kur tërhiqet ajo, si dhe të gjitha çështjeve tjera që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit.*

Kundër aktvendimeve të dhëna gjatë përgatitjes së shqyrtimit kryesor që kanë të bëjnë me drejtimin e gjykimit nuk lejohet ankimi.

Gjatë fazës së përgatitjes së shqyrtimit kryesor gjykata mund të japë aktgjykimin në bazë të pohimit, aktgjykimin në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia, aktgjykimin për mos bindje, aktgjykimin për shkak të mungesës si dhe të miratojë ujdinë gjyqësore të palëve.

SHQYRTIMI PARAPRAK I PADISË

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata mund të nxjerrë aktvendim mbi shpalljen jokompetente dhe lëndën të ja dërgojë gjykatës për të cilën mendon se është kompetente për gjykimin e çështjes së ngritur me padi (mungesa e kompetencës territoriale apo lëndore), përveçse kur kemi të bëjmë me çështjet për të cilat për nga natyra e tyre, apo sipas dispozitave të këtij ligji, aktvendimi mund të jepet vetëm në fazën e mëtutjeshme të procesit kontestimor.

Nëse gjykata konstaton se padia është e pakuptueshme apo jo e plotë, apo se ekzistojnë mungesa që kanë të bëjnë me zotësinë e paditësit apo të paditurit që të bëhet palë ndërgjyqëse, apo me përfaqësimin ligjor të tyre, apo mungesa që i përkasin autorizimit të përfaqësuesit që ta inicioj procedurën kontestimore, kur autorizimi i tillë kërkohet me ligj, gjykata me qëllim të heqjes së mungesave të tilla i ndërmeret masat e nevojshme të përcaktuara me këtë ligj (neni 79 dhe 102 i këtij ligji – respektivisht caktimi i përfaqësuesit të përkohshëm apo ftesa palës për eliminimin e të metës së vërejtur).

Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se:

- a) *çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore;*
- b) *palët kanë lidhë kontratë për zgjidhjen e kontestit të tyre nga arbitrazhi;*
- c) *për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca);*
- d) *çështja është gjë e gjykuar (res iudicata);*

- e) *për objektin e kontestit është lidhur ujdia gjyqësore, se paditësi në gjykatë ka hequr dorë nga kërkesëpadia, se nuk ekziston interesi juridik i paditësit për padi vërtetimi;*
- f) *padia është paraqitur pas skadimit të afatit, po që se me dispozita të posaçme është parashikuar afati për paraqitjen e saj;*
- g) *paditësi brenda afatit të caktuar nga gjykata nuk i ka hequr mungesat nga neni 79 dhe 102 të këtij ligji.*

Gjykata, në qoftë se konsideron se nuk ka material procedural të mjaftueshëm për dhënien e aktvendimit mbi ndonjë çështje që është paraqitur gjatë shqyrtimit paraprak të padisë, do të vendosë lidhur me të pasi të arrijë përgjigja në padi e të paditurit ose gjatë seancës përgatitore apo në seancën për shqyrtim kryesor të çështjes, po që se nuk është mbajtur seanca përgatitore.

PËRGJIGJA NË PADI

Gjykata padinë, me shkresat e bashkangjitura, ia dërgon të paditurit për përgjigje brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita kur është paraqitur në gjykatë padia e rregullt dhe e plotë. I padituri, pasi t'i dorëzohet padia, me shkresat e bashkangjitura eventualisht, ka për detyrë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, të përgjigjet me shkrim në padi. Me rastin e dërgimit të padisë gjykata do ta udhëzojë të paditurin për detyrimin e tij, për përmbajtjen që duhet ta ketë përgjigja në padi si dhe për pasojat procedurale në rast se nuk e paraqet në gjykatë, brenda afatit të duhur, përgjigjen në padi.

Në përgjigje i padituri duhet t'i parashtrojë prapësimet procedurale eventuale dhe të deklarojë se a e pohon apo e kundërshton kërkesëpadinë, si dhe të tregojë të dhënat që domosdo duhet t'i ketë çdo parashtrësë.

Po që se i padituri e konteston kërkesëpadinë, përgjigja në padi duhet t'i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla.

Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.

Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia.

Kërkesëpadia është e pathemeltë, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetë kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

SEANCA PËRGATITORE

Pasi të arrijë përgjigja në padi gjykata e konvokon seancën përgatitore.

Po që se i padituri nuk ka paraqitur përgjigje në padi, e nuk janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit kontumacional, gjykata do ta konvokojë seancën përgatitore pas skadimit të afatit ligjor për paraqitjen e përgjigjes në padi.

Datën e mbajtjes së seancës përgatitore gjykata do ta caktojë, sa herë që është e mundur, pasi të jetë konsultuar me palët ndërgjyqëse.

Seanca përgatitore mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën gjykatës i ka arritur përgjigja në padi e të paditurit.

Seanca përgatitore është e detyrueshme, përveçse në rastet në të cilat gjykata, pasi t'i këtë arritur përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk ka fakte kontestuese apo kur, nga shkak i pandërlkueshmërisë së kontestit, vjen në përfundim se nuk ka nevojë të konvokohet seanca përgatitore.

Në letërthirrjen për në seancë përgatitore gjykata i njofton palët për pasojat e mosardhjes në seancë, si dhe për detyrën që më së voni në seancën përgatitore duhet t'i parashtrajnë të gjitha faktet në të cilat i mbështesin kërkesat e tyre, si dhe t'i propozojnë të gjitha provat që dëshirojnë të merren gjatë procedurës, por edhe që në seancë t'i sjellin të gjitha shkresat dhe sendet që dëshirojnë t'i përdorin si mjete provuese.

Letërthirrja për në seancë përgatitore, si rregull, u dërgohet palëve së paku shtatë (7) ditë para ditës në të cilën mbahet ajo.

Varësisht nga rezultati i shqyrtimit në seancën përgatitore gjykata do të vendosë se çka do të jetë objekt shqyrtimi dhe cilat prova do të merren, në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Në qoftë se në seancën përgatitore nuk vjen pala paditëse, edhe pse është thirrur rregullisht, padia konsiderohet e tërhequr, përveç kur i padituri kërkon që seanca të mbahet.

Po që se në seancën përgatitore nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht shqyrtimi vazhdon të bëhet me palën paditëse të pranishme.

Ndërmjetësimi dhe pajtimi gjyqësor

Po që se gjykata e gjen të nevojshme një gjë të tillë, atëherë ajo më së voni në seancën përgatitore, duke marrë parasysh natyrën e kontestit dhe rrethanat tjera, u propozon palëve ndërgjyqëse që kontestin ta zgjidhin në procedurën e ndërmjetësimit të rregulluar me ligj të veçantë. Zgjidhjen e kontestit me anë të ndërmjetësimit mund ta propozojnë edhe vetë palët me marrëveshjen e tyre. Propozimin e këtillë palët mund ta bëjnë deri në përfundimin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes.

Gjykata gjatë gjithë procedurës, e sidomos në seancën përgatitore, bënë të gjitha përpjekjet, por në mënyrën që nuk e rrezikon paanësinë e saj, për të zgjidhur kontestin me pajtim, kur e lejon natyra e çështjes. Me qëllim që të kontribuojë në pajtimin gjyqësor

gjkata mund t'ua bëjë palëve propozimin si të arrijnë pajtimin, duke i marrë parasysh dëshirat e palëve, natyrën e kontestit, raportet midis tyre si dhe rrethanat e tjera.

Po që se pajtimi gjyqësor bëhet pas dhënies së aktgjykimit të shkallës së parë, atëherë gjykata me aktvendim e anulon aktgjykimin e tillë. Aktgjykimi anulohet nga gjykata e shkallës së parë edhe kur pajtimi është bërë gjatë zhvillimit të procedurës së shkallës së dytë.

Pajtimi gjyqësor mund të goditet vetëm me anë të padisë.

Pajtimi gjyqësor anulohet, në qoftë se është përfunduar nën ndikimin e lajthimit, mashtrimit apo dhunës. Pajtimi gjyqësor anulohet edhe po që se në përfundimin e tij ka marrë pjesë pala me pazotësi procedurale, apo nëse palën e tillë nuk e ka përfaqësuar përfaqësuesi ligjor apo nëse palën e ka përfaqësuar personi i pa autorizuar, ose personi që nuk ka pasur autorizimin e nevojshëm për kryerjen e veprimeve procedurale të veçanta, përveç kur veprimet e tilla janë aprovuar më vonë nga vet pala.

Padia për anulimin e pajtimit gjyqësor nga paragrafi 2 dhe 3 të këtij neni mund të ngrihet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e marrjes së dijenisë për shkakun e anulimit, e më së voni brenda afatit prej një (1) viti nga dita e përfundimit të pajtimit gjyqësor.

Konvokimi i seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes

Në seancën përgatitore gjykata me aktvendim e cakton:

- a) *ditën dhe orën e mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor të çështjes;*
- b) *çështjet që do të shqyrtohen dhe bisedohen në seancën kryesore ;*
- c) *provat që do të merren në seancën kryesore;*
- d) *personat që do të thirren për në seancë kryesore.*

Seanca kryesore do të mbahet, si rregull, më së voni brenda afatit tridhjetë (30) ditor nga dita në të cilën është mbyllur seanca përgatitore.

Gjykata mund të vendosë që seanca për shqyrtim kryesor të çështjes të mbahet menjëherë pas asaj përgatitore.

Palës që nuk ka qenë e pranishme në seancën përgatitore, bashkë me letërthirrjen për në seancë kryesore i dërgohet edhe kopja e procesverbalit të verifikuar nga seanca përgatitore.

SHQYRTIMI KRYESOR

1. Zhvillimi i shqyrtimit kryesor

Shqyrtimi kryesor është faza qendrore e procedurës kontestimore. Atë e përbëjnë veprimet procedurale të gjykatës dhe palëve, të kryera në një apo më tepër seanca, me qëllim të shoshitjes dhe shqyrtimit të fakteve nga të cilat varet themëlsia e kërkesëpadisë. Seancën e hapë gjyqtari i çështjes si dhe e shpallë objektin e shqyrtimit, e mandej verifikon paraqitjen e të ftuarëve dhe heton shkaqet e mosparaqitjes në seancë si dhe rregullsinë e thirrjeve të atyre që nuk kanë ardhur. Kur konstatohet se thirrja e palëve nuk është bërë me rregull, seanca shtyhet dhe caktohet për një ditë tjetër. Mungesa pa arsye e paditësi do të ketë si konsekuencë që të konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri deklaron se kërkon që të zhvillohet shqyrtimi kryesor i çështjes në mungesë të paditësit e po që se në seancën për shqyrtim kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet pa praninë e tij.

Po që se më parë nuk është mbajtur seanca përgatitore, shqyrtimi kryesor i çështjes zhvillohet në këtë mënyrë:

- a) *paditësi jep shpjegime të thukta rreth kërkesave të parashtruar në padi;*
- b) *i padituri në mënyrë të thuktë e paraqet përgjigjen në padi;*
- c) *po që se është propozuar marrja e provës me anë të dëgjimit të palëve, së pari pyetet paditësi e mandej i padituri;*
- d) *merren në pyetje dëshmitarët, së pari ata të propozuar nga pala paditëse e mandej ata të propozuar nga pala e paditur;*
- e) *merren provat e tjera, përfshirë edhe ekspertimin;*
- f) *pas marrjes së të gjitha provave, të dy palët, por së pari paditësi e mandej i padituri, i drejtohen gjykatës me shpjegimet përfundimtare, me të cilat i përmbledhin aspektet faktike dhe juridike të çështjes kryesore;*
- g) *gjykata mund t'i lejoj paditësit që shkurtimisht të deklarohet lidhur me fjalën përfundimtare të palës së paditur;*
- h) *po që se paditësit i është lejuar deklarimi rreth fjalës së fundit të palës së paditur, atëherë edhe kësaj i lejohet që shkurtimisht të deklarohet rreth thënieve të fundit të palës paditëse.*

Kështu gjykata e formon bazën faktike të vendimit të saj.

Nga deklarata e palëve gjykata njoftohet me kërkesat e palëve, me faktet relevante si dhe me mjetet provuese që i ka në disponim. Në bazë të këtyre elementeve gjykata e jep aktvendimin për të provuarit, në të caktohet objekti i të provuarit, pranohet apo refuzohet prova e propozuar nga pala dhe caktohet mënyra e marrjes së provave (mënyra e shfrytëzimit të informatave që i japin provat lidhur me faktin). Gjykata e përfundon

shqyrtimin kryesor kur konsideron se objekti i gjykimit është shqyrtuar mjaft dhe se mund të fillojë vendosja meritore.

2. Shtyrja dhe vazhdimi i seancës gjyqësore për shqyrtimin kryesor

Gjykata mund ta shtyj seancën e konvokuar për shqyrtim kryesor para se të filloj ajo, po që se konstaton se nuk janë plotësuar prezumimet ligjore për mbajtjen e saj, apo se provat e caktuara për marrje nuk do të mund të bëhen të pranishme deri në fillimin e seancës.

Gjykata ka për detyrë që, më së voni shtatë (7) ditë para fillimit të seancës, që të bëjë verifikimin nëse janë plotësuar kushtet për mbajtjen e shqyrtimit kryesor.

Kur e shtyn seancën, gjykata, për kohën e mbajtjes së seancës së shtyrë menjëherë i njofton të gjithë personat e thirrur më parë.

Me propozimin e palës gjykata mund ta shtyjë seancën e filluar vetëm nga këto shkaqe:

- a) *në qoftë se pa fajin e palës që e propozon shtyrjen e seancës nuk ka mundësi që të merret ndonjë provë e caktuar për marrje, e që është e rëndësishme për dhënien e vendimit të ligjshëm;*
- b) *në qoftë se të dy palët bashkërisht e propozojnë shtyrjen e seancës me qëllim të zgjidhjes paqësore të kontestit apo me qëllim të pajtimit gjyqësor.*

Pala mund ta propozojë shtyrjen e seancës vetëm një herë nga shkak i njëjtë.

Gjykata nuk ka për detyrë që ta njoftojë për vendin dhe kohën e seancës së re palën që nuk ka qenë e pranishme në seancën e shtyrë përkundrejt thirrjes së rregullt.

Në seancën e re të caktuar pas shtyrjes së shqyrtimit të çështjes, veprimet procedurale të kryera do të kryhen përsëri vetëm po që se gjykata konsideron se një gjë e tillë është e domosdoshme për dhënien e vendimit të ligjshëm.

Seanca për shqyrtimin kryesor të çështjes nuk mund të shtyhet për kohë të pa caktuar.

Seanca kryesore dëgjimore nuk mund të shtyhet më shumë se tridhjetë (30) ditë, përveç rasteve të përcaktuara me ligj.

Gjyqtari ka për detyrë ta njoftojë kryetarin e gjykatës për secilën shtyrje të seancës. Ky i fundit mbanë evidencë për shtyrjet e seancave për secilin gjyqtar.

Në qoftë se shtyhet seanca, gjyqtari ka për detyrë që t'i merr të gjitha masat e mundshme me qëllim që të hiqen shkaqet që e kanë shkaktuar shtyrjen, si dhe me qëllim që në seancën e ardhshme të përfundoj normalisht shqyrtimi i çështjes

3. Mbajtja e seancës kryesore me dyer të hapura

Shqyrtimi kryesor i çështjes në parim bëhet publikisht.

Gjykata lejon, me vendim të arsyetuar, që gjykimi i çështjes tërësisht apo pjesërisht, të bëhet në seancë me dyer të mbyllura (jo publike), vetëm kur:

- a) është e nevojshme të ruhet një sekret zyrtar dhe rendi publik;
- b) përmendën sekrete tregtare, apo shpikjesh, nga publikimi i të cilave do të cenoheshin interesa që mbrohen me ligj;
- c) përmenden rrethana nga jeta intime private e palëve dhe e pjesëmarrësve të tjerë në proces.

Aktvendimin për zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura gjykata duhet ta arsyetojë dhe ta shpallë publikisht.

SHPENZIMET PROCEDURALE

1. Përbërja e shpenzimeve procedurale

Shpenzimet procedurale përbëhen nga harxhimet e bëra gjatë dhe lidhur me procesin gjyqësor. Shpenzimet procedurale përfshijnë edhe shpërblimet për punën e avokatit e të personave të tjerë të cilëve ligji u jep të drejtën e shpërblimit.

Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta. Shpenzimet për dëshmitarët, ekspertet dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend parapaguhet nga pala që i ka kërkuar, në shumën që ka caktuar gjykata me aktvendim.

Kur marrjen e provës e propozojnë të dy palët bashkërisht, atëherë gjykata vendosë që shumën e nevojshme për pagimin e shpenzimeve paraprakisht ta deponojnë të dy palët në pjesë të barabarta. Gjykata do të heqë dorë nga marrja e provës në qoftë se shumën e nevojshme për mbulimin e shpenzimeve nuk deponohet në afatin e caktuar nga gjykata.

Përfundimisht nga dispozitat e paragrafit 3 të këtij neni, në qoftë se gjykata cakton sipas detyrës zyrtare marrjen e provave për vërtetimin e fakteve lidhur me zbatimin e nenit 3 paragrafi 3 të këtij ligji, kurse palët nuk e deponojnë shumën e caktuar, atëherë shpenzimet për marrjen e provave do të paguhet nga mjetet e gjykatës.

Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë gjyqësor, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore.

Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë

shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve.

Gjykata mund të vendosë që njëra palë t'i shpërblej të gjitha shpenzimet që kanë pasur pala kundërshtare dhe ndërhyrësi që i është bashkuar, në qoftë se pala kundërshtare nuk ka pasur sukses vetëm në pjesën proporcionalisht të pa rëndësishme të kërkesës së vet, kurse për shkak të kësaj pjese nuk janë krijuar shpenzime të veçanta.

Me rastin e vendosjes se cilat shpenzime do t'i shpërblehen palës, gjykata do të marrë parasysh vetëm ato shpenzime që kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në gjyq. Se cilat shpenzime kanë qenë të nevojshme, si dhe mbi shumën e shpenzimeve, vendosë gjykata duke çmuar me kujdes të gjitha rrethanat.

Pala ka për detyrë që, pavarësisht nga ajo se cili e ka fituar procesin gjyqësor, t'ia shpërblejë palës kundërshtare shpenzimet që ia ka shkaktuar me faj të vet ose me rastin që i ka ndodhur asaj.

Në qoftë se i padituri nuk i ka dhënë shkas padisë, nga shkaku se e ka pohuar kërkesëpadinë dhe ka qenë i gatshëm ta përmbushë detyrimin e vet, paditësi duhet t'ia shpërblej të paditurit shpenzimet e procedurës.

Kur prokurori publik apo Ombudspersoni marrin pjesë në procesin kontestimor si palë ndërgjyqëse, atyre u takon e drejta në shpenzimet procedurale sipas dispozitave të këtij ligji, por jo edhe e drejta e shpërblimit për punën e kryer.

Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën.

Pala duhet ta paraqes kërkesën për pagimin e shpenzimeve më së voni deri në përfundimin e shqyrtimit që i paraprinë vendosjes mbi shpenzimet, e po që se është fjala për dhënien e vendimit pa u bërë shqyrtim paraprakisht, atëherë pala ka për detyrë që kërkesën për shpenzimet e procedurës ta parashtrrojë në propozimin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë.

Në rastin nga neni 456 i LPK, në qoftë se tërheqja e padisë, apo e mjetit me të cilin është goditur vendimi i shkallës së parë, nuk është bërë gjatë shqyrtimit direkt të çështjes nga gjykata e shkallës së dytë, kërkesa për shpërblimin e shpenzimeve mund të paraqitet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes së njoftimit për tërheqjen e padisë, përkatësisht mjetit të goditjes.

Kur gjykata e hedhë poshtë ose e refuzon mjetin e goditjes së vendimit, atëherë ajo duhet të vendosë edhe për shpenzimet e krijuara në procedurën sipas mjetit të tillë të goditjes.

2. Shpenzimet në procedurën e sigurimit të provës

Shpenzimet e procedurës për sigurimin e provave i bartë pala e cila e ka paraqitur kërkesën për sigurimin e provës (paraprova). Ajo ka për detyrë që t'i paguaj edhe shpenzimet palës kundërshtare, respektivisht përfaqësuesit të përkohshëm të emëruar të asaj.

Këto shpenzime propozuesi i sigurimit të provës mund t'i realizoj me vonë si shpenzime gjyqësore, varësisht nga suksesi në procesin gjyqësor të mëvonshëm.

3. Lirimi nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore

Gjykata e liron nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore palën e cila, sipas gjendjes së vet të përgjithshme pasurore është në pamundësi t'i përballojë ato shpenzime pa dëmtuar ushqimin e domosdoshëm të vet dhe të familjes së ngushtë të saj.

Ky lirim përfshin lirimin nga pagimi i taksave gjyqësore dhe lirimin nga deponimi i paradhënies për shpenzimet e dëshmitarëve, të ekspertëve të këqyrjes në vend si dhe të shpalljeve gjyqësore.

Gjykata mund ta lirojë palën vetëm nga taksat gjyqësore po që se me pagimin e tyre do të pakësoheshin dukshëm mjetet për ushqimin e saj dhe të familjes së ngushtë të saj.

Vendimin mbi lirimin nga shpenzimet gjyqësore gjykata e jep brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës.

Kur pala është liruar nga pagimi i të gjitha shpenzimeve gjyqësore, gjykata e shkallës së parë, me kërkesën e saj, vendosë që ta përfaqësoj avokati, po që se kjo është e nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të saja.

Kur pala është liruar nga të gjitha shpenzimet gjyqësore, nga mjetet financiare të gjykatës bëhet parapagimi për shpenzimet e dëshmitarëve, ekspertëve, këqyrjes direkte si dhe të publikimit të shpalljeve gjyqësore dhe harxhimeve faktike të përfaqësuesit të caktuar.

Aktvendimi mbi lirimin nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore dhe mbi emërimin e përfaqësuesit mund të anulohet nga gjykata e shkallës së parë gjatë zhvillimit të procesit gjyqësor, po që se vërtetohet se pala është në gjendje t'i bartë të gjitha shpenzimet procedurale. Në rast të këtillë gjykata duhet të vendosë nëse pala do t'i kompensojë krejtësisht apo pjesërisht shpenzimet dhe taksat gjyqësore nga të cilat është liruar me parë, si dhe harxhimet faktike dhe shpërblimin për përfaqësuesin e emëruar nga gjykata.

Taksat dhe shpenzimet e paguara nga mjetet financiare të gjykatës, si dhe harxhimet faktike dhe shpërblimi për përfaqësuesin e emëruar të palës përbëjnë pjesë të shpenzimeve gjyqësore.

Në qoftë se kundërshtari i palës së liruar nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore është ngarkuar me pagimin e shpenzimeve gjyqësore, kurse konstatohet se ai nuk është në gjendje t'i paguaj ato, gjykata pas konstatimit të tillë mund të vendosë që shpenzimet e tilla t'i paguajë tërësisht apo pjesërisht pala e liruar, pikërisht nga objekti i kontestit që i takon si palë gjyqësore. Me këtë detyrim të palës gjyqësore, të liruar

më parë nga pagimi i shpenzimeve gjyqësore, nuk prekët e drejta e saj që t'i paguhen nga pala kundërshtare gjyqëmbësore të gjitha shpenzimet gjyqësore sipas rregullave të përgjithshme.

PROCEDURAT E POSAÇME KONTESTIMORE

Dispozitat e LPK janë të përshtatshme në rendë të parë për zgjidhjen e kontesteve thjeshtë pasuroro-juridike. Në disa konteste me veçori të posaçme dispozitat e tilla nuk mund të jenë instrument plotësisht adekuat për zgjidhjen e tyre. Nga ky shkak ka pasur nevojë të institutohen procedime të posaçme për zgjidhjen e tyre. Rregullat për zhvillimin e procedimeve të tilla i përbëjnë procedurat e posaçme kontestimore. Procedurat e posaçme janë paraparë për shkaqe të ndryshme. Disa nga to janë pasojë e llojit të raporteve materialo-juridike nga të cilat lindin kontestet, kurse të tjerat pasojë e rëndësisë shoqërore të cilin e kanë raportet e tilla. Në disa raste vendimmarrëse ka qenë nevoja që mbrojtja juridike të realizohet sa më shpejtë e cila gjë ka ndikuar që procedura të reduktohet në masë të madhe. Mirëpo, rregullat e procedurës së përgjithshme kontestimore aplikohen (si burim subsidiar) edhe në gjykimet e posaçme në lidhje me të gjitha çështjet për të cilat nuk janë paraparë rregulla të veçanta.

Vetë LPK i ka rregulluar disa procedura të posaçme: procedurën e zgjedhjes së kontesteve nga marrëdhënia e punës; kontestet për shkak të pengimit të posedimit; kontestet e vlerës së vogël; atë për dhënien e urdhërpagesës; kontestet tregtare, dhe Procedura e gjykimeve të arbitrazhit edhe pse këto gjykime mbahen edhe sipas Rregullave të posaçme mbi arbitrazhin.

PROCEDURA NË KONTESTET NGA MARRËDHËNIA E PUNËS

Në kontestet nga marrëdhënia e punës, e sidomos me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave gjyqësore, gjykata gjithmonë do të ketë parasysh nevojën e zgjidhjes së ngutshme të kontesteve nga marrëdhënia e punës. Pra te këto konteste kërkohet zgjidhja e shpejtë e kontestit në ç'drejtim LPK parasheh afate shtatë ditore për përmbushjen e ndonjë detyrimi (afati paritiv), i njëjti afat është i paraparë edhe për ankesë vendimit gjyqësor dhe në fund meqenëse nuk ka dispozita të tjera të posaçme në këtë kapitull përshtatshëmrisht zbatohen dispozitat tjera të LPK.

PROCEDURA NË KONTESTET PËR SHKAK TË PENGIMIT TË POSEDIMIT

Me rastin e caktimit të afateve dhe konvokimit të seancave edhe te këto konteste LPK obligon gjykatën që gjithmonë t'i kushtoj kujdes nevojës së zgjidhjes së ngutshme të kontesteve për shkak të pengimit të posedimit, por duke marrë parasysh natyrën e secilit rast konkret.

Shqyrtimi i çështjes sipas padisë për shkak të pengimit të posedimit do të kufizohet vetëm në konstatimin dhe të provuarit e fakteve të gjendjes së fundit të posedimit dhe të pengimit të bërë. Përfshihet mundësia e shqyrtimit lidhur me të drejtën e posedimit, me bazën juridike, ndërgjegjshmërisë ose pandërgjegjshmërinë e posedimit. Përfshihet mundësia që në kontestet për shkak të pengimit të posedimit të parashtrahet kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar me anë të veprimeve me të cilat është bërë pengimi i posedimit.

Afatin për përmbushjen e detyrimeve që u janë caktuar palëve gjykata e cakton varësisht nga rrethanat e çdo rasti konkret ndërsa afati për paraqitjen e ankesës është shtatë (7) ditor. Për shkaqe të rëndësishme gjykata mund të vendosë që ankesa mos ta pengojë përmbarimin e aktvendimit.

Kundër aktvendimeve të dhëna në kontestet për shkak të pengimit të posedimit revizioni nuk është i lejuar.

Paditësi e humbet të drejtën që në procedurën përmbaruese të përmbushë detyrimin e aktvendimit me të cilin i padituri urdhërohet që ta përmbushë detyrimin e caktuar, po që se nuk e ka iniciuar procedurën përmbaruese brenda afatit prej 30 ditësh pas skadimit të afatit parativ.

Përsëritja e procedurës së përfunduar me vendim të formës së prerë në kontestet për shkak të pengimit të posedimit lejohet vetëm nga shkaqet e përcaktuara në nenin 232 pika a) dhe b) të LPK, dhe vetëm brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën është bërë i formës së prerë aktvendimi përfundimtar.

Edhe te këto konteste meqenëse nuk ka dispozita të tjera të posaçme në këtë kapitull përshtatshmërisht zbatohen dispozitat tjera të LPK.

PROCEDURA NË KONTESTET E VLERËS SË VOGËL

Konteste të vlerës së vogël, në vështrim të dispozitave të LPK, janë kontestet në të cilat kërkesëpadija ka të bëjë me kërkesa në të holla, shuma e të cilave nuk është më e madhe se 500 Euro. Por si konteste të vlerës së vogël konsiderohen edhe kontestet në të cilat kërkesëpadija nuk ka të bëjë me kërkesë në të holla, por në të cilat paditësi në padinë e tij ka theksuar se pranon që, në vend të përmbushjes së kërkesës jo në të holla, t'i paguhet shuma e të hollave që nuk është me e madhe se 500 Euro. Kontest i vlerës së vogël konsiderohet edhe ai në të cilin objekt i kërkesëpadiisë nuk është shuma e të hollave, por dorëzimi i sendit të luajtshëm vlera e të cilit, e treguar në padi nga paditësi, nuk e kalon shumën prej 500 Euro.

Nuk konsiderohen konteste të vlerës së vogël, në kuptimin e dispozitave të këtij ligji, kontestet lidhur me sendet e paluajtshme, kontestet nga marrëdhëniet e punës dhe kontestet për shkak të pengimit të posedimit.

Në procedurën sipas padisë për zgjidhjen e kontestit më vlerë të vogël ankimi i veçantë lejohet vetëm kundër aktvendimit me të cilin përfundon procesi gjyqësor i shkallës së parë. Aktvendimet e tjera, kundër të cilave sipas këtij ligji lejohet ankimi i veçantë mund të goditën vetëm me anë të ankesës kundër vendimit me të cilin përfundon

E DREJTA E PROCEDURËS CIVILE

procedura dhe këto aktvendime nuk u dërgohen palëve posaçërisht, por shpallen në seancë gjyqësore dhe inkorporohen në vendimin përfundimtar.

Në procedurën për zgjidhjen e kontesteve me vlerë të vogël, procesverbali nga seanca për shqyrtimin kryesor, përveç të dhënave nga neni 135 paragrafi 1 i LPK, përmban:

- a) *deklaratat e palëve me rëndësi esenciale, e sidomos ato me të cilat tërësisht apo pjesërisht pohohet kërkesëpadia, ose hiqet dorë nga kërkesëpadia, me të cilat ndryshohet apo tërhiqet padia, si dhe deklarata mbi heqjen dorë nga e drejta e ankimit;*
- b) *përmbajtjen esenciale të provave të marra;*
- c) *vendimet kundër të cilave lejohet ankimi dhe që janë shpallur në seancën për shqyrtimin kryesor të çështjes;*
- d) *nëse palët kanë qenë të pranishme me rastin e shpalljes së aktgjykimit, e po që se kanë qenë të pranishme, a janë udhëzuar në cilat kushte mund të bëjnë ankim.*

Po që se pala paditëse e ndryshon kërkesëpadinë me anë të zmadhimit të saj duke kapërcyer kështu kufirin prej 500 Euro, procedura e filluar do të vazhdohet dhe përfundohet sipas dispozitave për procedurën kontestimore të përgjithshme të këtij ligji.

Po që se paditësi deri në përfundimin e seancës për shqyrtimin kryesor të çështjes që është duke u zhvilluar sipas dispozitave mbi procedurën e përgjithshme kontestimore e zvogëlon kërkesëpadinë nën shumën prej 500 Euro, procedura e mëtejme do të zhvillohet sipas rregullave të këtij ligji për procedurën për zgjidhjen e kontesteve me vlerë të vogël.

Në qoftë se paditësi nuk vjen në seancën e parë të shqyrtimit kryesor të çështjes, përkundrejt thirrjes së rregullt, do të konsiderohet se e ka tërhequr padinë, përveçse kur i padituri në seancën e tillë kërkon që të vazhdohet me shqyrtimin e çështjes në mungesë të paditësit.

Po që se nga seanca e parë për shqyrtimin e çështjes kryesore mungojnë të dy palët ndërgjyqëse, përkundrejt thirrjes së rregullt, do të konsiderohet se paditësi e ka tërhequr padinë.

Aktgjykimi ose aktvendimi me të cilin përfundohet procedura e zgjidhjes së kontestit me vlerë të vogël mund të goditet me ankesë vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Në aktgjykimin, përkatësisht aktvendimin nga paragrafi 1 të këtij neni ,gjykata ka për detyrë t'i përmendë shkaqet në bazë të të cilave mund të bëhet ankimi.

Kundër aktgjykimit ose aktvendimit të shkallës së parë, palët mund të ankohen brenda afatit prej shtatë (7) ditësh.

Në procedurën e zgjidhjes së kontesteve me vlerë të vogël afati paritiv për përmbushjen e premtimit dhe ai për dhënien e vendimit plotësues është shtatë (7) ditor.

PROCEDURA E DHËNIES SË URDHËRPAGESËS

Kur kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesë në të holla që është bërë e realizueshme, e që provohet me dokument të besueshëm që i është bashkangjitur padisë në origjinal apo kopje të legalizuar, atëherë gjykata do ta urdhëroj të paditurin që ta përmbushë kërkesëpadinë (urdhërpagesa).

Dokumente të besueshme konsiderohen sidomos:

- a) *dokumentet publike;*
- b) *dokumentet private, në të cilat nënshkrimin e debitorit e ka verifikuar organi kompetent për verifikime;*
- c) *kambialet dhe çeqet me protestë dhe faturë kthyesë, po që se janë të nevojshme për themelimin e kërkesës;*
- d) *ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave;*
- e) *faturat;*
- f) *dokumentet që sipas dispozitave ligjore të posaçme kanë rëndësinë e dokumenteve publike.*

Gjykata e jep urdhërpagesën, edhe kur paditësi nuk e kërkon një gjë të tillë, po që se i gjen të plotësuar kushtet për dhënien e saj.

Në rastet në të cilat, sipas Ligjit mbi procedurën përmbarese, mund të kërkohej ekzekutimi në bazë të dokumentit të besueshëm, gjykata e jep urdhërpagesën vetëm po që se paditësi e bënë të besueshëm ekzistimin e interesit juridik për dhënien e urdhërpagesës.

Po që se paditësi nuk e bënë të besueshëm ekzistimin e interesit juridik për dhënien e urdhërpagesës, gjykata e hedhë poshtë padinë si të palejueshme.

Kur kërkesëpadia ka të bëjë me kërkesën në të holla që është bërë e realizueshme e që nuk është më e madhe se 500 Euro, gjykata e jep urdhërpagesën kundër të paditurit edhe po që se padisë nuk i është bashkangjitur dokumenti i besueshëm, por në padi është treguar baza juridike e kërkesës dhe shuma e detyrimit si dhe provat me anë të të cilave mund të provohet vërtetësia e pretendimeve të paditësit.

Urdhërpagesa nga paragrafi I e këtij neni mund të jepet vetëm kundër debitorit kryesor.

Në urdhërpagesë gjykata do të caktojë se i padituri ka për detyrë që brenda shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet lidhur me kambialin dhe çekun brenda tri (3) ditësh, pasi t'i dorëzohet urdhërpagesa me shkrim ta përmbushë kërkesën e padisë bashkë me shpenzimet gjyqësore që i ka caktuar gjykata, ose që brenda të njëjtit afat ta paraqesë prapësimin kundër urdhërpagesës. Në urdhërpagesë gjykata e paralajmëron të paditurin se prapësimi i paraqitur me vonesë do të hedhet poshtë.

Në qoftë se gjykata nuk e aprovon propozimin për dhënien e urdhërpagesës, atëherë ajo do ta vazhdojë procedurën e përgjithshme sipas padisë.

I padituri mund ta goditë urdhërpagesën vetëm me anë të prapësimit.

Po që se urdhërpagesa goditet vetëm në pikëpamje të vendimit mbi shpenzimet procedurale, atëherë vendimi i këtillë mund të goditet vetëm me anë të ankesës kundër aktvendimit.

Në aktgjykimin mbi çështjen kryesore gjykata do të vendosë nëse urdhërpagesa mbahet në fuqi tërësisht apo pjesërisht ose anulohet.

Në qoftë se gjykata pas dhënies së urdhërpagesës shpallet jokompetente në pikëpamje lëndore, atëherë ajo e anulon urdhërpagesën dhe pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi mbi inkompetencën ia dërgon lëndën gjykatës për të cilën mendon se është e kompetencës lëndore.

Po që se gjykata pas dhënies së urdhërpagesës konstaton se është inkompetente në pikëpamje territoriale, ajo nuk do ta anulojë urdhërpagesën, por pasi të bëhet i formës së prerë aktvendimi mbi inkompetencën do t'ia dërgoj lëndën gjykatës për të cilën mendon se është e kompetencës territoriale.

PROCEDURA NË KONTTESTET TREGTARE

Kontestet tregtare konsiderohen mosmarrëveshjet që lindin midis subjekteve të veprimtarisë ekonomike në lidhje me kontratat dhe veprimet tjera juridike të cilat shërbejnë kryerjes së veprimtarisë ekonomike dhe qarkullimit të mallrave apo të shërbimeve të ndryshme. Në këto konteste kompetenca tokësore caktohet në bazë të vendit në të cilin i padituri është dashur ta mbushë prestimin. Në procedurën për zgjidhjen e kontesteve tregtare zbatohen dispozitat e këtij ligji për procedurën e përgjithshme kontestimore, po që se në dispozitat e këtij kreu nuk është përcaktuar diç tjetër.

Rregullat procedurale për procedurën e zgjidhjes së kontesteve tregtare zbatohen në të gjitha kontestet për të cilat sipas Ligjit mbi Gjykatat është kompetente gjykata tregtare, përveçse në kontestet për të cilat është kompetente sipas tërheqjes (atraksionit) së kompetencës lëndore.

Në këto konteste gjyqtari është i autorizuar që në rastet e ngutshme të konvokojë seanca me anë të telefonit apo telegramit.

Revizioni në kontestet tregtare nuk lejohet në qoftë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit të formës së prerë nuk i kalon 10.000 Euro.

Në procedurën e zgjidhjes së kontesteve tregtare vlejnë këto afate:

- a) afati prej shtatë (7) ditësh për përgjigje në padi;
- b) afati prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh për paraqitjen e propozimit për kthimin në gjendjen e mëparshme nga neni 130 paragrafi 3 i këtij ligji;
- c) afati prej shtatë (7) ditësh për ankesën kundër aktgjykimit apo aktvendimit;
- d) afati prej tri (3) ditësh për paraqitjen e përgjigjes në ankesë;
- e) afati prej shtatë (7) ditësh (afati paritiv) për përbushjen e detyrimit në të holla, e për përbushjen e premtimit jo në të holla gjykata mund të caktoj afat më të gjatë.

Në procedurën për zgjidhjen e kontesteve tregtare të vlerës së vogël konsiderohen vetëm ato konteste në të cilat padia ka të bëjë me kërkesë në të holla e cila nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.

Konsiderohen konteste të vlerës së vogël edhe kontestet në të cilat padia nuk ka të bëjë me kërkesë në të holla, por paditësi në padinë e tij deklaron se pranon që, në vend të premtimit jo në të holla, t'i paguhet shuma e të hollave që nuk e kalon atë prej 3.000 Euro.

Konsiderohet kontest i vlerës së vogël edhe kontesti në të cilin objekt kontesti nuk është shuma e të hollave por dorëzimi i sendit të luajtshëm vlera e të cilit, e përmendur nga paditësi në padi, nuk e kalon shumën prej 3.000 Euro.

PROCEDURA E GJYKIMEVE TË ARBITRAZHIT

Me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore është paraparë që procedura e Arbitrazhit rregullohet me ligj të veçantë dhe njohja dhe përbarimi i vendimeve të tribunaleve të huaja bëhet në përputhje me Konventën e NJU JORK-ut për njohjen dhe përbarimin e vendimeve të huaja të arbitrazhit.

Pra, procedura e arbitrazhit është e rregulluar me Ligjin për Arbitrazhin²¹, dhe tani pas hyrjes në fuqi të ndryshimit dhe plotësimit të LPK nuk ka më dualizëm rreth procedurës së arbitrazhit të cilën procedurë e parashihnin në mënyrë paralele dhe LPK pa ndryshimet e përmendura e edhe Ligji për Arbitrazhin.

Arbitrazhi nënkupton marrëveshjen e arritur ndërmjet dy ose më shumë personave, që disa ose të gjitha kontestet juridike, të cilat kanë lindur ose që mund të lindin ndërmjet tyre, do t'i nënshtrohen arbitrazhit. E vet arbitrazhi është institucion jo shtetëror i përbërë prej një apo më tepër subjektësh të cilëve palët me marrëveshje ia besojnë zgjidhjen e kontestit me anë të vendimit të cilin ligji e barazon me aktgjykimin e formës së prerë. Arbitrat e arbitrazhit i zgjedhim vetë palët. Vendimi i arbitrazhit jepet në formë të shkruar dhe sipas ligjit ai quhet vendim në dallim prej urdhërit të cilin ka të drejtë ta bie arbitrazhi me rastin e ndërprerjes së procedurës së arbitrazhit (neni 33.2 i Ligjit për Arbitrazhin).

21 Ligji për Arbitrazhin nr. 2007/02 – L75 i datës 26.01.2007 i shpallur nga ana e PSPP me dt. 05.06.2008 në Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2008/30,

Ekzistojnë arbitrazhet institucionale (të përhershme) dhe ato të përkohshme (ad hoc). Të parat zakonisht formohen pranë Odave Ekonomike. Arbitrazhi ad hoc themelohet me anë të kontratës së palëve me detyrë që ta zgjidhë vetëm kontestin konkret. Pas zgjidhjes së tij ai pushon së ekzistuari. Ndryshe nga ky arbitrazhi institucional është organizatë permanente e themeluar me qëllim që ta kryejë funksionin gjyqësor sa herë që palët i paraqiten me kërkesë që ta zgjidhin kontestin e tyre.

Pra, palët mund të merren vesh që zgjidhjen e kontestit, lidhur me të drejtat me të cilat mund të disponojnë lirisht, t'ia besojnë arbitrazhit.

Marrëveshja për arbitrazh mund të bëhet nga palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar apo për zgjidhjen e kontesteve që mund të lindin midis tyre nga raporti materialo-juridik i caktuar. Marrëveshja për arbitrazhin është e vlefshme vetëm po që se është lidhur në formë të shkruar.

Marrëveshja për arbitrazh konsiderohet e lidhur në formë të shkruar edhe kur është lidhur me këmbimin e letrave, telegrameve, telekseve apo mjeteve tjera të telekomunikacionit që e mundësojnë provën e shkruar mbi marrëveshjen e përfunduar.

Marrëveshja për arbitrazh konsiderohet e lidhur në formë të shkruar edhe po që se është lidhur duke u këmbyer padia, në të cilën paditësi pretendon se ekziston marrëveshja dhe përgjigja në padi, në të cilën i padituri nuk e mohon një gjë të tillë.

Numri i arbitrave të arbitrazhit duhet të jetë gjithmonë tek.

Po që se me marrëveshjen e palëve nuk është caktuar numri i arbitrave, atëherë secila nga palët e emëron nga një arbitër, kurse këta të dy bashkë e zgjedhin kryetarin e arbitrazhit.

Në qoftë se palët për zgjidhjen e kontestit të caktuar e kanë kontraktuar kompetencën e arbitrazhit, gjykata të cilës i është paraqitur padia për zgjidhjen e të njëjtit kontest dhe midis palëve të njëjta, sipas prapësimit të të paditurit shpallet jokompetente, i anulon veprimet procedurale të kryera dhe me aktvendim e hedhë poshtë padinë si të palejueshme.

Prapësimin pala e paditur mund ta parashtrojë më së voni në momentin e paraqitjes së përgjigjes në padi.

Palën e cila në bazë të marrëveshjes për arbitrazh duhet ta emëroj arbitrin mund ta ftojë pala kundërshtare që brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor ta bëjë emërimin e tillë si dhe ta njoftojë për emërimin e bërë.

Ftesa është e vlefshme vetëm po që se pala e cila e ka bërë atë e ka emëruar arbitrin e vet dhe për një gjë të këtillë e ka njoftuar palën kundërshtare.

Kur në bazë të marrëveshjes për arbitrazh emërimin e arbitrave duhet ta bëjë personi i tretë, çdonjëra nga palët mund t'ia bëjë ftesën personit të tillë.

Personi i ftuar që ta bëjë emërimin e arbitrit të arbitrazhit është i lidhur me emërimin e kryer posa të njoftohet për emërimin pala kundërshtare, respektivisht njëra nga palët.

Ne qoftë se arbitri nuk emërohet në kohën e duhur, e nga marrëveshja nuk del diç tjetër, arbitrin e propozon gjykata shtetërore sipas propozimit të palës.

Po që se arbitrat nuk mund të pajtohen rreth zgjedhjes së kryetarit, e nga marrëveshja e palëve për arbitrazh nuk del diç tjetër, kryetarin e arbitrazhit, sipas propozimit të cilitdo arbitër apo të cilësdo palë, e emëron gjykata shtetërore.

Për emërimin e arbitrit, përkatësisht të kryetarit të arbitrazhit është kompetente gjykata e shkallës së parë e cila do të ishte kompetente për zgjidhjen e kontestit po të mos ekzistonte marrëveshja për arbitrazh.

Secila nga palët mund të kërkojë me padi që gjykata shtetërore ta shfuqizojë marrëveshjen për arbitrazh në qofte së:

- a) *palët brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga ftesa e parë për emërimin e arbitrit nuk mund të merren vesh për zgjedhjen e arbitrit që do të duhej ta emëronin bashkërisht;*
- b) *personi i cili në vete marrëveshjen për arbitrazh është emëruar arbitër nuk dëshiron apo nuk mund ta ushtrojë misionin e besuar.*

Për në seancën për shqyrtimin e kërkesës së paditësit gjykata i fton të dy palët, por ajo mund të merr vendim edhe kur palët e ftuara rregullisht nuk paraqitën në seancën e këfillë.

Deklaratën për pranimin e misionit që i është besuar arbitri duhet ta bëjë me shkrim. Një gjë të tillë arbitri mund ta bëjë edhe ashtu që e nënshkruan marrëveshjen e palëve për arbitrazh.

Arbitri ka për detyrë të përjashtohet kur ekzistojnë shkaqet e përjashtimit të parashikuara për përjashtimin e gjyqtarit të gjykatës shtetërore me këtë ligj.

Përjashtimi i arbitrit mund të kërkohej nga palët edhe atëherë kur arbitri nuk i ka kualifikimet e duhura për të cilat ato janë marrë vesh, si dhe kur ai nuk i përmbushë detyrat.

Pala e cila vetë, apo bashkërisht me palën tjetër, e ka emëruar arbitrin mund ta kërkojë përjashtimin e tij vetëm nëse shkak i përjashtimit ka lindur, apo pala ka marrë dijëni për të, pasi të jetë emëruar arbitri.

Kur mungon marrëveshja, pala duhet t'ia paraqes kërkesën për përjashtimin e arbitrit arbitrazhit brenda afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor nga dita në të cilën ka marrë dijëni për emërimin e arbitrit apo për cilëndo rrethanë e cila arbitrin e bënë të papërshtatshëm për detyrën e besuar. Kërkesa për përjashtimin e arbitrit duhet të jetë me shkrim dhe t'i përmbajë shkaqet e përjashtimit.

Po që se arbitri, përjashtimin e të cilit e ka kërkuar pala, nuk tërhiqet nga arbitrazhi, vendimin mbi përjashtimin e merr gjykata e arbitrazhit në përbërjen e te cilës paraqitet edhe arbitri i tillë.

Në qoftë se kërkesa për përjashtimin e arbitrit mbetet e pasuksesshme, pala që e ka bërë kërkesën e tillë mund t'i drejtohet gjykatës shtetërore që ta merr vendimin për përjashtimin e arbitrit. Këtë kërkesë pala duhet ta paraqesë brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi i arbitrazhit me të cilin është

refuzuar kërkesa e saj për përjashtimin e arbitrit (më hollësisht për procedurën e përjashtimit shih nenin 11 të Ligjit për Arbitrazhin).

Gjykata e arbitrazhit ka të drejtë që të vendosë për kompetencën e vet, si dhe mbi prapësimet e palëve lidhur me ekzistimin dhe vlefshmërinë e marrëveshjes për arbitrazh (neni 14 i Ligjit për Arbitrazhin).

Prapësimin për inkompetencën e arbitrazhit i padituri duhet ta parashtrojë me anë të përgjigjes në padi. Kur konstatohet se paraqitja me vonesë e prapësimi është e justifikueshme, arbitrazhi mund ta marrë në konsideratë prapësimin e vonuar.

Po që se arbitrazhi e quan veten kompetent për zgjidhjen e kontestit, secila nga palët mund të kërkojë nga gjykata shtetërore që të vendosë lidhur me problemin e lindur. Kërkesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën palës i është dorëzuar vendimi i arbitrazhit.

Ne qoftë se palët nuk janë marrë vesh ndryshe, procedurën e arbitrazhit e cakton vetë arbitrazhi.

Ndaj dëshmitarëve, palëve dhe personave të tjerë që marrin pjesë në procesin e arbitrazhit, arbitrazhi nuk mund të përdorë mjete shtrënguese e as të shqiptojë dënime.

Arbitrazhi mund të kërkojë nga gjykata shtetërore e kompetencës territoriale ndihmë juridike në formë të marrjes së provave të cilat nuk mund t'i merr vet.

Në procedurën e marrjes së provave do të zbatohen dispozitat e këtij ligji mbi marrjen e provave nga gjykata e porositur.

Arbitrazhi mund të jep vendim në mbështetje të parimit të ndershmërisë (ex aequo et bono) vetëm po që se palët e kane autorizuar për një gjë të tillë.

Kur arbitrazhi përbëhet prej disa arbitrave, aktgjykimi merret me shumicën e votave, po që se me marrëveshjen për arbitrazh nuk është përcaktuar diç tjetër.

Vendimi i arbitrazhit duhet ta ketë pjesën arsyetuese përveç nëse palët janë pajtuar që arsyet të mos ceken.

Originalin e vendimit dhe të gjitha kopjet e tij i firmosin të gjithë arbitrat.

Vendimi quhet i vlefshëm edhe po që se ndonjëri nga arbitrat e refuzon firmosjen e tij, por vetëm në qoftë se atë e kanë firmosur shumica e arbitrave. Në rast të këtillë në vendim konstatohet arsyeja e refuzimit apo mungesës së nënshkrimit të ndonjërit prej arbitrave.

Vendimi i arbitrazhit e ka ndaj palëve fuqinë e vendimit të formës së prerë po që se me marrëveshjen për arbitrazh nuk është përcaktuar mundësia e goditjes së vendimit në arbitrazhin e shkallës së dytë.

Vendimi i arbitrazhit mund të anulohet sipas kërkesës së palës. Pra, secila palë mund të kërkojë nga gjykata anulimin e vendimit të arbitrazhit.

Anulimi i vendimit të arbitrazhit mund të kërkohet nëse:

a) *Paditësi dëshmon se:*

(i) *njëra palë në marrëveshjen e arbitrazhit nuk ka pasur zotësinë për të vepruar;*

(ii) *marrëveshja e arbitrazhit nuk është e vlefshme sipas së drejtës së caktuar nga palët ose nga tribunali i arbitrazhit ose, në mungesë të një caktimi të tillë, sipas ligjit të zbatueshëm në Kosovë;*

(iii) *paditësi nuk është njoftuar me rregull në lidhje me emërimin e një arbitri ose mbi procedurën e arbitrazhit, ose për arsye tjera nuk ka qenë në gjendje të paraqesë rastin e tij;*

(iv) *vendimi nuk ka të bëjë me çështjen e shqyrtuar nga tribunali i arbitrazhit ose ka të bëjë me një çështje për të cilën nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit, ose vendimi përfshinë çështje për të cilat nuk është kompetent tribunali i arbitrazhit. Në këto raste, nëse vendimi mbi çështjet për të cilat është kompetent tribunali i arbitrazhit mund të ndahet nga çështjet tjera, atëherë kjo pjesë e vendimit mund të ekzekutohet;*

(v) *përbërja e tribunalit të arbitrazhit ose procedura e arbitrazhit nuk ka qenë në pajtim me dispozitat e këtij ligji ose me marrëveshjen e arbitrazhit, me kusht që mangësia e tillë të ketë patur ndikim në vendimin e tribunalit; ose*

b) *Gjykata konstaton se:*

(i) *arbitrazhi në fjalë është i ndaluar me ligj; ose*

(ii) *ekzekutimi i vendimit do të cenonte ose do ishte në kundërshtim me rendin publik (ordre public).*

Padia për anulimin e vendimit të tribunalit të arbitrazhit i dorëzohet gjykatës jo më vonë se nëntëdhjetë ditë pas pranimit të vendimit të tribunalit të arbitrazhit nga pala përkatëse përveç nëse palët janë marrë vesh ndryshe.

Kur kërkohet anulimi i vendimit të tribunalit të arbitrazhit, Gjykata mundet, nëse kjo është e arsyeshme, ta anulojë vendimin dhe t'ia kthejë lëndën tribunalit të arbitrazhit që ta inicojë sërish procedurën e arbitrazhit ose që t'i merr ato veprime, të cilat sipas vlerësimit të tribunalit të arbitrazhit do të mënjanojnë arsyet për anulimin e vend

Sa i përket arbitrazhit ndërkombëtar duhet theksuar se subjektet e ndryshme ndërkombëtare të cilat hyjnë në raportet juridiko – civile me subjektet vendore posaçërisht kur është fjala për vlera të larta të këtyre raporteve nuk janë të gatshme që të pranojnë zgjidhjen e këtyre kontesteve në rast të mosmarrëveshjeve eventuale

tek arbitrazhi vendor jo vetëm pse një arbitrazh i tillë ende nuk është jetësuar sa duhet tek ne në Kosovë por edhe nga shkakut se të njëjtat më me kënaqësi pranojnë që këto konteste eventuale nga marrëveshjet e lidhura të zgjidhen ndonjë prej arbitrazheve tani të njohura ndërkombëtare të cilat kanë përvojë të duhur dhe kanë arbitra të profesionalizuar në lëmit përkatëse për zgjidhjen e këtyre kontesteve andaj edhe në marrëveshjet dhe kontratat e tyre bilaterale me partnerët vendor gati gjithnjë parapëlqejnë që kontestin eventual ta zgjidhin tek arbitrazhi ndërkombëtar.

Përndryshe duhet theksuar se te ne në Kosovë në kuadër të Odës Ekonomike është themeluar një mekanizëm arbitrazhi. Ky mekanizëm i njohur si Gjykata e Arbitrazhit është themeluar në bazë të aktit themelues të tribunalit të përhershëm të arbitrazhit në Odën Ekonomike të Kosovës me dt. 27.06.2011 dhe për momentin numëron 27 arbitra vendor dhe ndërkombëtar dhe rregulla institucionale, si dhe ka filluar të nxjerrë vendime të arbitrazhit.

Në kuadër të Ligjit të Kosovës për Arbitrazhin nuk ekzistojnë rregulla ose dispozita të veçanta të cilat aplikohen për rastet me karakter ndërkombëtar. Por çka është edhe më e rëndësishme, në Ligjin e Kosovës për Arbitrazhin nuk ekziston asnjë ndalesë për zbatimin e tij për rastet e kontesteve ndërkombëtare. Pra, është e qartë që edhe në rastet me karakter ndërkombëtar, Ligji i Kosovës për Arbitrazhin do të mund të zbatohet dhe atë në dy situata:

- 1) Atëherë kur palët janë pajtuar për ta zbatuar atë, dhe
- 2) Atëherë kur rregullat e së drejtës private ndërkombëtare shpjen në zbatimin e tij.

BURIMET JURIDIKE DHE LITERATURA

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës 2008;
- Amandamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës – lidhur me përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës -vendimi i Kuvendit të RK nr. 04-V-436 i datës 07.09.2012 i shpallur në G. Z. të RK nr. 25 të dt. 07.09.2012;
- Amandamenti i Kushtetutës së Republikës së Kosovës – vendimi i Kuvendit të RK nr. 04-V-553 i datës 14.03.2013 i shpallur në G. Z. të RK nr. 7 të dt. 26.03.2013;
- Rreg. e UNMIK-ut nr. 1999/10 Për shfuqizimin e legjislacionit diskriminues lidhur me çështjet banesore dhe të drejtat mbi pronën;
- Rreg. e UNMIK-ut nr. 1999/24 dhe nr. 2000/59 dt. Për Ligjin në fuqi në Kosovë;
- Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore, Ligji nr. 03/L-154 i datës 25.06.2009 i dekretuar me Dekretin e Presidentit të RK DL-016-2009 dhe i shpallur në GZ nr. 57 datë 04.08.2009;
- Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Ligji nr. 04/L-077 i datës 10 maj 2012 i shpallur me Dekretin e Presidentit të RK DL-024-2012 i datës 30 maj 2012 dhe i shpallur në GZ nr. 16 të dt. 19 qershor 2012;
- Ligji për Familjen i Kosovës, 2004/32, Gazeta Zyrtare e IPVQ-ve, nr. 4/2006 e datës 1 shtator 2006;
- Ligji për Trashëgiminë i Kosovës (më tutje LT) nr. 2004/26 i datës 28 korrik 2004 i shpallur nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (më tutje PSSP) me dt. 04 shkurt 2005;
- Ligji për Gjykatat ligji nr. 03/L-199 i datës 22.07.2010, dhe ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat;
- Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (L. nr. 02/L-37 i dt. 27.07.2006 – Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 10 e dt. 01.03.2007);
- Ligji Për Arbitrazhin (L. nr. 02/L-75 i dt. 26.01.2007 i shpallur nga ana e PSPP me rregulloren nr. 2008/30 me dt. 05.06.2008– Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 37 e dt. 10.09.2008);
- Ligji për Shoqëritë tregtare 02/L-123 i dt. 27.09.2007 dhe ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shoqëritë tregtare nr. 04/L-006 i dt. 23.6.2011;
- Ligji për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Ligji nr. 03/L-182 i dt. 01.07.2010;
- Ligji për Shitjen e Banesave për të cilat ekziston e drejta banesore ligji nr. 04/L-061 i dt. 21.12.2011 i shpallur në GZ të RK nr. 1 të dt. 12.01.2012;
- Ligji mbi Noterinë (ligji nr. 03/L-010 i shpallur në GZ të RK nr. 42 të dt. 25.11.2008, me ndryshimet dhe plotësimet Ligji nr. 04/L-002 i shpallur në GZ të RK nr. 7 të dt. 10.08.2011;
- Ligji për Ndërmjetësimin, nr. 03/L-057 i shpallur në GZ të RK nr. 41 të dt. 01.11.2008;

E DREJTA E PROCEDURËS CIVILE

- Ligji për Procedurën Kontestimore (L. nr. 03/L-006 i dt. 30.06.2008 i shpallur me Dekretin e Presidentit të RK nr. DL-04502008 i datës 29.07.2008 i cili zbatohet prej 06 tetor 2008 – Gaz. Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 38 e dt. 20.09.2008);
- Ligji nr. 04/L-118 i dt. 13.09.2012 Për ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore i shpallur me dekretin e Presidentit të RK DL-045-2012 i datës 28.09.2012;
- Ligji për Procedurën Jokontestimore Ligji 2008/03 – L – 007 i datës 20.11.2008 i shpallur me dekretin e Presidentit të RK DL-068-2008 i datës 13.12.2008;
- Ligji për Procedurën Përmbartimore nr. 2012/04/L-139 të dt. 20.12.2012 i dekretuar me dekretin e Presidentit të RK DL nr. – 01-2013 të dt. 03.01.2013;
- Abdulla Aliu, E Drejta Civile, Pjesa e përgjithshme, Prishtinë 2013;
- Abdulla Aliu, Burimet e së Drejtës Civile në Kosovë, Prishtinë 1999;
- Alajdin Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e përgjithshme, botimi i dytë, Prishtinë, 2002;
- Alajdin Alishani, E drejta e detyrimeve, pjesa e veçantë, botimi i dytë, Prishtinë, 2002;
- Andrija Gams, Hyrje në të Drejtën Civile, Prishtinë, 1986;
- Komentari i Ligjit për Familjen i Kosovës botimi i parë Prishtinë 2012 i autorëve Aliu Abdulla, Gashi Haxhi & Vokshi Adem

KONVENTAT NDËRKOMBËTARE:

- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive
- Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj;
- Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj;
- Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare;
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor;
- Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas;
- Konventa për të Drejtat e Fëmijës;
- Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera
- Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

SHKURTESAT

- LMD Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve
- LPDTS Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore
- LFK Ligji për Familjen e Kosovës
- LPK Ligji për Procedurën Kontestimore
- LPP Ligji për Procedurën Përmbartimore
- LTK Ligji për Trashëgiminë
- LPJ Ligji për Procedurën Jokontestimore
- PSPP Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB
- HPD Habitati – Drejtoria për çështje pronësoro - banesore
- AKP Agjencioni Kosovar i Pronës
- GZ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës
- RK Republika e Kosovës
- IPVQ Institucionet e Përkohshme Vetëqeverisëse
- Par. Paragrafi
- UNMIK United Nation Mission in Kosovo (Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë).

E DREJTA TREGTARE 4

HYRJE

E drejta tregtare është një degë juridike komplekse e cila merret me pozitën juridike të subjekteve ekonomike dhe komerciale si dhe me afarizmin e tyre juridik në treg.

Ekonomitë në tranzicion, sikurse është kjo e Republikës së Kosovës, ndërmarrin hapa që të zhvillojnë një legjislacion i cili përveç se rregullon afarizmin në ato ekonomi, këta hapa edhe përkrahin tranzicion e përshpejtuat, rrjedhimisht edhe rregullimin e afarizmit në Kosovë.

Nevoja e Kosovës për zhvillim të shpejtë dhe të qëndrueshëm ekonomik ka bashkuar burimet dhe resurset e institucioneve të Republikës së Kosovës me palë të interesuara dhe donatorë të huaj drejt zhvillimit dhe implementimit të një legjislacioni ekonomik, që përkrah këtë zhvillim. Zhvillimi dhe implementimi i këtij legjislacioni, edhe pse tani në masë më të madhe i përfunduar, vazhdon të mbetet sfidë, si për ndërmarrjet dhe afaristët, ashtu edhe për ushtruesit e detyrave juridike dhe sistemin gjyqësor.

Në vazhden e këtyre përpjekjeve të vazhdueshme, në Kosovë tanimë aplikohen një sërë ligjesh tregtare dhe ekonomike. Por, përveç këtyre ligjeve që janë ne fuqi e që janë të publikuara në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, ka edhe burime tjera të rëndësishme që duhen konsultuar gjatë ushtrimit të profesionit e që ndërlidhen me të drejtën tregtare. Këto burime tjera, që nuk duhet anashkaluar, janë: Konventa e Neë York e vitit 1958 për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave si dhe Konventa e dokumente tjera të rëndësishme dhe të domosdoshme në ushtrimin e profesionit të juristit.

Pra, doracaku për përgatitjen e provimit të jurispruencës, përkatësisht pjesa e doracakut që trajton të Drejtën Tregtare shpalos kornizën ligjore që mbulon sferën e së drejtës ekonomike që rregullon pozitën juridike të subjekteve ekonomike dhe afarizmin e tyre në tregun e Republikës së Kosovës.

SHOQËRITË TREGTARE

Ligji për Shoqëritë Tregtare është ligj elementar mbi të cilin ndërtohet e Drejta Tregtare (e Drejta Ekonomike). Ligji i Shoqërive Tregtare përfshin mënyrën e detalizuar në çdo aspekt, që ka të bëjë me shoqëritë tregtare, përmes të cilave mund të zhvillohen veprimtaritë afariste në Kosovë, i cakton kushtet e regjistrimit, i përcakton dispozitat ligjore të cilat nxisin dhe lehtësojnë themelimin, funksionimin dhe shpërbërjen e rregullt dhe efektive të shoqërive tregtare, duke inkuadruar në ligj edhe funksionet e “Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës”(ARBK).

LLOJET E SHOQËRIVE TREGTARE NË KOSOVË

Ligji për Shoqëritë Tregtare shprehimisht përcakton se në Kosovë nëpërmes njërës nga format e shoqërive tregtare zhvillohen veprimtaritë tregtare në Kosovë:

Biznesi Individual “B.I.”

Ortakëria e Përgjithshme “O.P.”

Shoqëria Komandite “SH.K.M”

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “SH.P.K”

Shoqëria Aksionare “SH.A.”

BIZNESI INDIVIDUAL (“B.I.”)

Biznesi individual është shoqëri tregtare e personave që nuk është i ndarë nga pronari i saj. Biznesi individual është organizuar në atë mënyrë që një (1) person e ushtron afarizmin në emër të vet dhe për llogari të vet. Personi i cili ushtron një veprimtari afariste, de jure ose de fakto, përmes një biznesi individual, ka përgjegjësi të pakufizuar personale, qoftë të regjistruar apo të pa regjistruar, ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të shkaktuara, ose të imponuara nga një ligj ose kontratë në një biznes individual nëse:

- personi ka mundësi që të kontrollojë shfrytëzimin dhe disponimin e këtyre pronave ose asetëve, dhe
- ka dëshmi të mjaftueshme për të konkluduar se një person ose shoqëri tjetër është emëruar formalisht si pronar kryesor me qëllim të mbrojtjes së pronës ose asetëve nga përgjegjësia e personit që menaxhon biznesin individual.

Përgjegjësia dhe prona.- Personi i cili ushtron një veprimtari afariste, de jure ose de fakto, përmes një biznesi individual ka përgjegjësi të pakufizuar personale për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera që dalin nga Biznesi Individual (B.I), ose të cilat imponohen me Ligj ose me kontratë. Përgjegjësia është e pa kufizuar dhe përfshin pronën dhe pasuritë e çfarëdo lloji të cilat në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë janë në pronësi të pronarit të biznesit individual, pa marrë parasysh se a shfrytëzohet

prona ose pasuritë në fjalë për qëllime afariste, personale apo familjare. Kjo përgjegjësi mund të mbrojtë asetet ose pronën dhe nuk përjashtohet përgjegjësia në rast se:

- kontrata e cila ka krijuar këtë përgjegjësi shprehimisht i përjashton nga përgjegjësia pronën ose asetet,
- personi ose shoqëria që ka pretendime është pajtuar që këto asete ose prona të mos i nënshtrohen pretendimeve të tij, ose
- një akt themelor normativ për përmbarimin e vendimeve gjyqësore ose për falimentim, shprehimisht i lejon gjykatës ose organit të arbitrazhit që të mbrojtë pronën ose asetet e caktuara nga kjo përgjegjësi.

Biznesi individual nuk është person juridik, pavarësisht nga kjo, ai mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë i paditur, në emër të tij apo të pronarit.

ORTAKËRIA E PËRGJITHSHME (“O.P.”)

Ortakëria e përgjithshme është shoqëri e dy apo më shumë personash dhe/ose shoqëri e bashkëpunimit në ushtrimin e veprimtarive tregtare, pavarësisht nga ajo se a vendoset ky bashkëpunim në bazë të një kontrate të shkruar, marrëveshjeje gojore apo mirëkuptimi.

Ortakëria definohet thjesht si kontratë, përmes së cilës dy apo më shumë persona pajtohen t’i kombinojnë asetet apo fuqinë punëtore me qëllim të realizimit të përfitimit të përbashkët, nga dy ose më shumë persona, të cilët angazhohen në afarizëm me qëllim të përfitimit dhe i ndajnë së bashku përfitimet dhe detyrimet e shoqërisë.

Ortakëria e përgjithshme themelohet përmes regjistrimit ose si pasojë e ligjit.

Ortakëria e Përgjithshme, sipas ligjit, themelohet kur dy apo më shumë persona dhe/ose shoqëri bashkëpunojnë në ushtrimin e veprimtarive tregtare, pavarësisht nga ajo se a vendoset ky bashkëpunim në bazë të një kontrate të shkruar, marrëveshjeje gojore apo mirëkuptimi.

Nëse Ortakëria e Përgjithshme themelohet përmes regjistrimit, ortakët e përgjithshëm janë persona dhe/ose shoqëri të përcaktuara si ortakë të përgjithshëm në memorandumun “O.P.” dhe marrëveshjen e së njëjtës, nëse ajo ekziston.

Nëse “O.P.” është themeluar në bazë të ligjit, personat dhe/ose shoqëritë të cilat bashkëpunojnë në ushtrimin e veprimtarisë tregtare, janë ortakë të përgjithshëm të “O.P.”

Ortakëria e Përgjithshme nuk është person juridik. Pavarësisht nga kjo, ai mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të jetë i paditur, në emër të saj.

Interesi i një ortaku të përgjithshëm në ortakërinë e përgjithshme përfshin të drejtën e ndarjes së fitimit dhe shpërndarjes, si dhe të drejtat tjera të ortakut të përgjithshëm, po edhe detyrimet e ortakut të përgjithshëm, që janë përcaktuar në këtë pjesë. Numri i

ortakëve të përgjithshëm në ortakëri të përgjithshme mund të ketë dy (2) ose më shumë persona dhe/ose shoqëri, duke përfshirë shoqërinë tregtare, si ortak të përgjithshëm.

Përgjegjësia në një ortakëri të përgjithshme është te secili ortak i “O.P.”, secili është përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera të “O.P.”. Përgjegjësia është e pakufizuar, njësoj si për “B.I”. Përgjegjësia shtrihet në tërë pronën dhe asetet të cilat janë në pronësi të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të ortakëve të përgjithshëm, pavarësisht nga shfrytëzimi i pronës ose aseteve. Të gjithë ortakët janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës, pa kufizim për të siguruar funksionin e “O.P.” në pajtim me detyrimet ligjore dhe rregullatore në Kosovë. Nëse një person ose shoqëri bashkohet në “O.P.”, që më vonë i bashkohet “O.P.” ekzistuese, ai person po ashtu bëhet bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet e “O.P.”, përfshirë edhe detyrimet paraprake, në mënyrë të njëjtë sikurse edhe ortakët e përgjithshëm ekzistues.

Kjo përgjegjësi e përbashkët nuk mund të shmanget, njëri prej tyre të jetë përgjegjës, ndërsa tjetri jo. Të drejtat e palëve tjera kundër ortakëve të përgjithshëm, nuk preken nga marrëveshja e “O.P.”.

Përgjegjësia ndërmjet ortakëve të përgjithshëm rregullohet me marrëveshjen për “O.P.”, nëse ekziston. Ortakëria e përgjithshme duhet ta rregullojë emrin e saj tregtar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve. Emri zyrtar i “O.P.” duhet të përfshijë, së paku, emrin e njërit ortak të përgjithshëm, nëse ortaku i përgjithshëm është për, të shfrytëzohet emri i plotë zyrtar. Duhet të përfshihet në fund shkurtesa “O.P.”, adresa në Kosovë ku ushtrohet veprimtaria kryesore, adresa e zyrës së regjistruar të “O.P.” tregtare, emri dhe adresa e secilit ortak të përgjithshëm, deklarata me shkrim e nënshkruar nga secili ortak i përgjithshëm.

Ortakëria e përgjithshme duhet të regjistrojë emrin e saj tregtar në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK).

Themelimi i “O.P.” bëhet me marrëveshje për “O.P.”, por kjo nuk kërkohet me ligj. Me themelimin e marrëveshjes “O.P.” shmanget nga problemet të cilat mund të shfaqen në të ardhmen.

Marrëveshja për “O.P.” rregullon marrëdhëniet e brendshme ndërmjet ortakëve dhe “O.P.”, ajo në asnjë mënyrë nuk i rregullon të drejtat e palëve të tjera. Me marrëveshje ortakët e përgjithshëm mund të përcaktojnë: çka ndodh në rast se një ortak largohet nga “O.P.” ose vdes – pjesëmarrja në fitim dhe humbja;

Anëtarët e “O.P.”, kontributet në ortakërinë e përgjithshme dhe çështjet e tjera të organizimit të brendshëm.

Fitimet, humbjet, alokimet dhe shpërndarja e një ortakërie të përgjithshme ndodhen në mënyrë të barabartë ndërmjet ortakëve të përgjithshëm, kjo mund të ndryshohet përmes marrëveshjes për ortakëritë e përgjithshme.

Përveç nëse përcaktohet ndryshe në marrëveshjen e “O.P.”, të gjithë ortakët e përgjithshëm kanë një ndarje të barabartë të të gjitha fitimeve, humbjeve alokimive dhe shpërndarjes së “O.P.”.

Brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga përfundimi i çdo viti kalendarik, "O.P." duhet të llogaris dhe të regjistrojë të gjitha fitimet apo humbjet gjatë atij viti dhe të ndajë përqindjen e fitimeve ose të humbjeve në llogaritë e ortakëve të përgjithshëm.

Nëse ortakëria e përgjithshme ka pasur humbje të parave, ortakët e përgjithshëm janë përgjegjës për atë humbje. Secili ortak i përgjithshëm është personalisht përgjegjës për çdo detyrim të ortakërisë së përgjithshme, secili ortak duhet të kontribuojë në mënyrë të barabartë për të kompensuar humbjet e pësuar, përveç nëse përcaktohet ndryshe në marrëveshje e "O.P."-së, të gjithë ortakët e përgjithshëm kanë të drejtë në një ndarje të barabartë të të gjitha fitimeve, humbjeve, alokimive dhe shpërndarjeve të "O.P.". Çdo ortak i përgjithshëm i "O.P." duhet të japë kontributin e tij për mbulimin e barabartë të humbjeve që rrjedhin nga veprimtaria tregtare e "O.P.", përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen "O.P."

Shpërbërja dhe likuidimi vullnetar i "O.P."- Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e "O.P." dhe sipas dispozitave të ligjit në fuqi, "O.P." mund të shpërbëhet dhe të likuidohet, pas votimit me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve të përgjithshëm.

SHOQËRIA KOMANDITE ("SH.K.M")

Shoqëria Komandite ("SH.K.M") është formë e ortakërisë që përveç një ose më shumë ortakëve të përgjithshëm ka edhe një ose më shumë ortakë të kufizuar që bashkëpunojnë me qëllim të ushtrimit të veprimtarisë afariste fitimprurëse si bashkëpunëtorë. Ortakët e përgjithshëm, në të gjitha aspektet kryesore, janë juridikisht në të njëjtën pozitë sikurse ortakët e "O.P.". Sidoqoftë, ortakët e kufizuar, njëlloj sikurse aksionarët e një korporate, kanë përgjegjësi të kufizuar dhe nuk kanë kompetenca menaxhuese.

Shoqëria Komandite nuk e ka cilësinë e personit juridik. Pavarësisht nga kjo, ajo mund të lidhë kontratë, të posedojë pronë, të ushtrojë padi dhe të paditet në emrin e saj.

Cilido person ose shoqëri tregtare mund të jetë ortak i përgjithshëm ose i kufizuar i Shoqërisë Komandite.

Përgjegjësia.- Në një "SH.K.M", ortaku i përgjithshëm, bashkërisht dhe personalisht, pa kurrfarë kufizimi, është përgjegjës për borxhet dhe detyrimet e Shoqërisë Komandite. Në anën tjetër, ortaku i kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e tjera të Shoqërisë Komandite.

"SH.K.M" themelohet pas regjistrimit të Memorandumit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve Kosovare "ARBK".

Gjithashtu, çdo Shoqëri Komandite është e detyruar ta ketë një Marrëveshje "SH.K.M". Kjo marrëveshje është dokument ligjor i cili rregullon çështjet e brendshme ndërmjet ortakëve të kufizuar dhe atyre të përgjithshëm. Secili ortak i Shoqërisë Komandite është i detyruar ta zbatojë marrëveshjen në fjalë dhe ta theksojë në të, nëse ky ortak është i përgjithshëm apo i kufizuar. Marrëveshja e "SH.K.M"-së duhet të përmbajë së paku:

- dispozitat që rregullojnë menaxhimin e Shoqërisë Komandite dhe veprimtarinë e saj afariste;
- dispozitat që rregullojnë të gjitha çështjet e tjera të cilat ortakët dëshirojnë t'i përfshijnë në marrëveshje.

Kufizimet dhe përgjegjësia e ortakëve të kufizuar: Edhe pse “SH.K.M” nuk është person juridik, ajo mund të hyjë në marrëveshje dhe të detyrohet nga ato. Megjithatë, vetëm ortaku i përgjithshëm (personi ose shoqëria) ka autorizim të veprorë në emër të “SH.K.M”, ose t'i krijojë asaj detyrime. Për ndryshe, ortaku i kufizuar nuk ka kurrfarë autorizimi të veprorë në emër të “SH.K.M” ose t'i krijojë detyrime asaj. Nëse një ortak i kufizuar përfshihet në një transaksion në emër të “SH.K.M”, transaksioni i tillë është i detyrueshëm vetëm nëse një ortak i përgjithshëm, formalisht dhe me shkrim, e miraton transaksionin e tillë.

Kufizimet mbi kontrollimin dhe menaxhimin: Ortaku i kufizuar nuk mund të marrë pjesë në kontrollimin ose menaxhimin e veprimtarisë afariste ose aktiviteteve të Shoqërisë Komandite. Megjithatë, shprehimisht është përcaktuar se aktivitetet në vijim nuk përbëjnë shkelje të ndalesës së sipër cekur:

- nëse është punëtor ose kontraktues i Shoqërisë Komandite ose i një ortaku të përgjithshëm;
- nëse është ortak, pronar, menaxher, aksionar, drejtor ose zyrtar i një ortaku të përgjithshëm i cili është shoqëri tregtare;
- nëse voton për miratimin e një ndryshimi ose plotësimi të memorandumit ose marrëveshjes së Shoqërisë Komandite,
- nëse ortaku i kufizuar ka të drejtë vote për miratimin e këtyre ndryshimeve dhe plotësimeve;
- nëse voton për shpërbërjen ose jo të Shoqërisë Komandite, nëse ortaku i kufizuar ka të drejtë vote mbi këtë çështje, ose
- nëse ndërmerri masa për zbatimin (ekzekutimin) ose mbrojtjen e të drejtave të ortakëve të kufizuar.

Nëse ortakët e kufizuar marrin pjesë në kontrollimin dhe menaxhimin e veprimtarisë ose aktiviteteve të “SH.K.M”, ata do të jenë përgjegjës për të gjitha borxhet dhe detyrimet tjera të Shoqërisë Komandite, në shkallë të njëjtë sikurse ortakët e përgjithshëm.

Bartja e interesit në “SH.K.M”.- Në rast se nuk është përcaktuar ndryshe me marrëveshje, ortaku i kufizuar mund ta bartë (transferojë) interesin e tij në Shoqërinë Komandite, vetëm pas dhënies së pëlqimit nga të gjithë ortakët e përgjithshëm. Bartja e interesit në Shoqërinë Komandite përfshin edhe bartjen e të gjitha të drejtave dhe detyrimeve të ortakut të kufizuar.

Edhe një çështje e cila rregullohet në masë të madhe me Marrëveshjen e “SH.K.M” është bartja e interesit të “SH.K.M” në rast të vdekjes së një ortaku të kufizuar. Nëse nuk është përcaktuar me Marrëveshje, atëherë me vdekjen e ortakut të kufizuar, i cili është person fizik, interesi i tij në Shoqërinë Komandite kalon te trashëgimtarët e tij/

saj ligjorë. Në rast të shpërbërjes ose të likuidimit të një ortaku të kufizuar, i cili është shoqëri tregtare, interesi i ortakut në fjalë në Shoqërinë Komandite bartet në përputhje me ligjin sipas të cilit bëhet shpërbërja e shoqërisë së tillë.

Pranimi i ortakëve të përgjithshëm plotësues: Nëse marrëveshja e “SH.K.M” nuk i përcakton kushtet dhe procedurat në fjalë, atëherë pranimi i ortakëve të përgjithshëm plotësues bëhet vetëm pas dhënies së pëlqimit me shkrim nga të gjithë ortakët e përgjithshëm dhe të kufizuar.

Fitimet dhe humbjet.- Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e “SH.K.M”, fitimet do të shpërndahen dhe humbjet do të ndahen njëjloj ndërmjet ortakëve të përgjithshëm dhe të kufizuar, në bazë të vlerës së kontributeve të tyre përkatëse.

Tërheqja e ortakut të kufizuar: Nëse nuk është përcaktuar me marrëveshjen e “SH.K.M”, atëherë ortaku i kufizuar mund të tërhiqet nga “SH.K.M”, pas dorëzimit të një njoftimi me shkrim të të gjithë ortakëve të përgjithshëm, brenda një afati prej jo më pak se nëntëdhjetë (90) ditësh, para kohës së tërheqjes. Me këtë rast, ortaku i cili tërhiqet, ka të drejtë në ndarje e cila është e barasvlershme me interesin e tij në “SH.K.M”.

Në përgjithësi, tërheqja e një ortaku të kufizuar, nuk e detyron “SH.K.M” të shpërbëhet. Mirëpo, duhet të shpërbëhet, nëse tërheqja e ortakut të kufizuar e lë “SH.K.M” pa asnjë ortak të kufizuar.

Shpërbërja dhe përmbyllja e veprimtarisë.- “SH.K.M” mund të vazhdojë të ekzistojë përderisa ajo përbëhet nga së paku një ortak i përgjithshëm dhe së paku një ortak i kufizuar. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e “SH.K.M”, ortaku i kufizuar nuk është i autorizuar ta bëjë shpërbërjen e Shoqërisë Komandite.

Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e Shoqërisë Komandite, neto asetet e Shoqërisë Komandite u shpërndahen në mënyrë të barabartë ortakëve të kufizuar dhe atyre të përgjithshëm.

“SH.K.M” e ndërpret veprimtarinë afariste dhe duhet të shpërbëhet, për shkak të:

- skadimit të afatit ose kohëzgjatjes së Shoqërisë Komandite, nëse afati ose kohëzgjatja ekzistojnë;
- ndonjë ngjarjeje tjetër të specifikuar me memorandumin ose marrëveshjen e Shoqërisë Komandite, si ngjarje që kërkon shpërbërjen e Shoqërisë Komandite;
- një vendimi të ortakëve për shpërbërjen e shoqërisë, në përputhje me marrëveshjen e Shoqërisë Komandite;
- nxjerrjes dhe dorëzimit nga udhëheqësi i “ARBK”, të njoftimit për çregjistrimin e Shoqërisë Komandite
- nxjerrjes së një vendimi gjyqësor për shpërbërjen e Shoqërisë Komandite, ose
- një vendimi të gjykatës për falimentimin, në bazë të Ligjit për Falimentimin, me të cilin Shoqëria Komandite shpallet e falimentuar dhe kërkohet shpërbërja e saj.

Shoqëria Komandite nuk e ka cilësinë e personit juridik, por ajo, pavarësisht nga statusi i saj, mund të hyjë në marrëdhënie kontraktuese, të lidhë kontrata, të posedojë pronë, të ushtrojë padi të paditet në emër të saj.

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR (“SH.P.K”)

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “SH.P.K” është strukturë e re e organizimit e cila është paraparë me ligj. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është person juridik e cila është e ndarë edhe e dallueshme nga pronarët. Një pronar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk është bashkëpronar dhe nuk disponon me interes të transferueshëm në pronën e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar. Është formë e organizimit e cila ofron përgjegjësi të kufizuar të të gjithë pronarëve të saj. Pronarët kanë përgjegjësi personale të kufizuar për borxhet dhe veprimet “SH.P.K”. Veçori të njëjta të “SH.P.K” i përngjajnë më shumë një ortakërie, e cila lejon fleksibilitet në menaxhimin dhe përfitimin nga tatimi i kanalizuar.

Parimet e përgjithshme të “SH.P.K”.- “SH.P.K” është person juridik dhe ka personalitet juridik të ndarë nga pronarët e saj. Ka kompetenca për të ushtruar padi ose për të qenë i paditur, të lidhë kontrata, të huazojë të holla dhe t’iu nënshtrohet borxheve dhe detyrimeve tjera, të votojë, të shesë ose në mënyrë tjetër të disponojë me aksionin ose interesin, tjetëron në një shoqëri tjetër tregtare, përveç Biznesit Individual, të zgjedh ose të emërojë menaxherët, punonjësit dhe agjentët e shoqërisë, duke përcaktuar detyrat dhe kompensimin e tyre.

Përgjegjësia.- “SH.P.K” është përgjegjëse për të gjitha borxhet saj dhe detyrimet tjera me të tëra asetet. Megjithatë, përgjegjësia nuk shtrihet në asetet personale të provave të saj, d.m.th pronarët nuk janë personalisht përgjegjës për borxhet dhe detyrimet e “SH.P.K”-së.

Themelimi.- SH.P.K” themelohet vetëm pas regjistrimit të statutit sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare. Statuti është dokument themelues dhe konstituiv i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar. Statuti, para se të regjistrohet “SH.P.K”, duhet të dorëzohet në Agjencinë e Regjistrimit të Biznesit të Kosovës (ARBK), në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Çdo ndryshim i statutit bëhet përmes ndryshimit dhe plotësimit të statutit, i cili ekziston në dosjen e ARBK-së. Asnjë ndryshim dhe plotësim në statut nuk ka karakter detyrues ndaj palëve të treta derisa këto ndryshime dhe plotësime të dorëzohen në mënyrë të rregullt në ARBK.

Çdo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar duhet të ketë një marrëveshje të shoqërisë të nënshkruar nga pronarët e evidentuar në statutin burimor i cili përmban dispozitat që rregullojnë menaxhimin dhe veprimtarinë e shoqërisë. Marrëveshja rregullon pjesën më të madhe të marrëdhënieve të brendshme ndërmjet pronarëve të “SH.P.K”. Marrëveshja nuk mund t’i kufizojë të drejtat e palëve të treta.

Marrëveshja për “SH.P.K”, së paku, duhet të ketë dispozitat:

- se shoqëria do të menaxhohet nga një ose më shumë drejtorë menaxhues;
- rregullat specifike në lidhje me kohën, bendin, qëllimin ose procedurën e votimit në mbledhjen e pronarëve;
- specifikimet lidhur me kategoritë e pronarëve dhe të drejtat e tyre të votimit (ose mos votimit), preferencat tjera;
- përcaktimin e votave dhe aksioneve të pronarëve (nëse do të bëhet në bazë të kapitalit, ose në ndonjë mënyrë tjetër);
- listën e veprimeve të cilat kërkojnë shumicën absolute, ose ato të cilat mund të merren nga drejtori menaxhues, pa votim të pronarëve;
- mënyrën e zgjedhjes së çështjeve kur pronarët nuk mund të arrijnë marrëveshje për zgjidhjen e çështjeve, kur pronarët nuk mund të arrijnë marrëveshje/të marrin vendim;
- të drejtat e pronarëve për t’ua shitur interesat e tyre një ose më shumë pronarëve tjerë në bazë të kushteve të akorduara paraprakisht;
- se disa menaxherë të caktuar do të kenë detyra dhe autorizime specifike, dhe/ose
- rregullat për rregullimin e bartjes së interesit pronësor në pajtim me këtë Ligj.

Marrëveshja e shoqërisë nuk mund të përfshijë dispozitat:

- që janë në kundërshtim me statutin e shoqërisë,
- që kufizojnë të drejtat e një pronari në informacion ose qasje sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare,
- që eliminojnë ose zvogëlojnë detyrimet për mbrojtjen, mirëbesimin, lojalitetin dhe mos konkurrencën sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare,
- që eliminojnë ose zvogëlojnë kufizimet lidhur me shpërndarjet për pronarët ose,
- përgjegjësinë personale për shkeljen e kufizimeve të parapara në Ligjin e Shoqërive Tregtare,
- që në çfarëdo mënyre i kufizojnë të drejtat, sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare të kreditorëve ose palëve të tjera të treta, ose
- që eliminojnë ose zvogëlojnë kërkesat e këtij ligji, përveç nëse
- dispozitat përkatëse të marrëveshjeve të shoqërisë janë lejuar sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare,
- Ajo dispozitë përmban ose i nënshtrohet fjalëve “përveç nëse marrëveshja e shoqërisë përcakton ndryshe” ose fjalë të ngjashme.

Në rast të konfliktit ndërmjet statutit dhe marrëveshjes së shoqërisë, statuti mbizotëron.

Kontributet e pronarëve: Kontributi i një pronari në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar në shkëmbim me një interes pronësor, mund të bëhet në

- të holla,
- pronë tjetër materiale ose jo-materiale ose
- me punë ose shërbime të ekzekutuara për shoqërinë. Premtimi për ekzekutimin e punëve ose shërbime në të ardhmen nuk kualifikohet si kontribut i vlefshëm dhe nuk kompensohet me interesa pronësore.

Vlera e kontributeve jo materiale përcaktohet:

- në bazë të dispozitave të aplikuara të marrëveshjes së shoqërisë, ose
- nëse marrëveshja e shoqërisë nuk përmban dispozita për vlerësimin e kontributeve jo materiale, pas marrëveshjes unanime të të gjithë pronarëve.

Shpërndarja e pronarëve: Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mund të shpërndajë pronarët e saj në çdo kohë, me miratimin unanimit të pronarëve ose me metodë tjetër votimi, që kërkon numër më të vogël të votave, siç parashihet në marrëveshjen e shoqërisë. Përveç nëse është përcaktuar ndryshe në marrëveshjen e shoqërisë, çdo shpërndarje për pronarët, duhet të jetë e barabartë për të gjithë. Kur pronari fiton të drejtën për marrjen e shpërndarjes, ai bëhet kreditor i pa siguar i shoqërisë në raport me shpërndarjen. Përveç nëse caktohen ndryshe me marrëveshjen për “SH.P.K”, pranuesi është përgjegjës për detyrimet e bartësit për dhënien e kontributeve dhe për të kthyer kontributet e ndaluara, përveç nëse pranuesi nuk e ka ditur (dhe nuk ka mundur) të informohet për ato përgjegjësi kur ai është bërë pronar. Pronari bartës mbetet përgjegjës ndaj shoqërisë për detyrimet që janë mbledhur para mbajtjes.

Pronari i cili dëshiron të bartë interesin e tij, duhet të informojë shoqërinë, përndryshe bartja nuk është e vlefshme.

Përfundimi i pronësisë.- Një person ose shoqëri përfundon së qeni pronar në një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, në rast të:

- vdekjes së pronarit ose shpërbërjes së shoqërisë,
- tërheqjes vullnetare të personit ose shoqërisë
- përjashtimit ose kur shoqëria bëhet debitor në falimentim,
- personi ose shoqëria përfundojnë të kenë një interes pronësor në shoqëri, ose
- rasteve tjera të cilat janë përcaktuar në marrëveshjen e shoqërisë të cilat kërkojnë përfundimin e pronësisë së një pronari ose shoqërie.

Tërheqja ose përjashtimi e një pronari.- Pronarët e “SH.P.K” mund të tërhiqen nga shoqëria, në çdo kohë, pasi t’i dorëzohet shoqërisë dhe të gjithë pronarëve të tjerë një njoftim me shkrim, me kusht që, nëse tërheqja e shkel marrëveshjen e shoqërisë, shoqëria mund të kërkojë dëmshpërblim nga pronari i cili tërhiqet, për shkelje të marrëveshjes. Në përgjithësi, marrëveshja për “SH.P.K” përcakton kushtet, procedurat dhe pasojat e tërheqjes apo përjashtimit. Me marrëveshjen e shoqërisë mund të parashikohet edhe ndalimi i bartjes së atij interesi. Personi ose shoqëria përfundon së qeni pronar, ky person ose kjo shoqëri brenda nëntëdhjetë (90) ditësh nga përfundimi ka të drejtë të pranojë: çfarëdo pagese ose shpërndarje në të cilën ka të drejtë sipas marrëveshjes së shoqërisë dhe, nëse nuk është e përcaktuar me marrëveshjen e shoqërisë, vlerën e drejtë të interesit pronësor. Shumës që duhet të paguhet, i zvogëlohet shumja e dëmeve të shkaktuara nga tërheqja ose përjashtimi. Vlera e shpërndarjes që i jepet një pronari që tërhiqet bëhet në bazë të vlerës së drejtë të tregut.

Qeverisja dhe menaxhimi.- Përveç, nëse është përcaktuar ndryshe, në marrëveshjen e shoqërisë, të gjitha të drejtat e votimit të pronarëve në shoqëri janë të barabarta dhe vendimi për shumicën e thjeshtë gjatë votimit do t’i kontrollojë të gjitha çështjet. Në përgjithësi, të drejtat e votimit të pronarëve rregullohen nga marrëveshja për “SH.P.K”. Nëse nuk bëhet marrëveshje e tillë, atëherë të drejtat e votimit të pronarëve janë të barabarta. Megjithëse ka disa çështje të cilat duhet të vendosen me votë unanime, shumica e çështjeve vendoset me shumicë votash. Marrëveshja për “SH.P.K” mund të vendos kërkesa më të larta apo më të ulëta të votimit kur vendoset për çështje specifike, ku kërkohet për disa çështje vota unanime e pronarëve.

Emërimi dhe shkarkimi i drejtorëve menaxhues.- Pronarët e shoqërisë do të përcaktojnë në statut ose në një ndryshim dhe plotësim të statutit ose të marrëveshjes së shoqërisë, personin ose personat e caktuar, për të shërbyer si drejtorë menaxherë. Pronarët duhet të votojnë dhe të emërojnë një ose më shumë drejtorë menaxhues të “SH.P.K”. Drejtor menaxher mund të jetë, por nuk ka nevojë të jetë, njëri nga pronarët, por duhet të jetë person fizik. Drejtori menaxher vazhdon të punojë në atë cilësi deri sa të shkarkohet ose të zëvendësohet nga pronarët dhe pronarët nuk kanë nevojë të deklarojnë arsyen për shkarkimin (zëvendësimin) e tij. Një drejtor menaxher nuk ka nevojë të jetë pronar.

Drejtori menaxher është i autorizuar të përfaqësojë “SH.P.K, përfshirë udhëheqjen e veprimtarisë së shoqërisë dhe nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë afariste në emër të shoqërisë. Këto veprime të drejtorëve menaxherë janë të detyrueshme për shoqërinë përveç nëse veprimi është jashtë autorizimit të drejtorit menaxher sipas marrëveshjes së shoqërisë dhe personi ose shoqëria në të cilën drejtori menaxher ka punuar dhe ka ditur se drejtorit menaxhues i mungon autorizimi për atë veprim. Drejtori menaxher është i detyruar të përgatisë dhe të mbajë librat dhe dokumentet e shoqërisë dhe të përgatisë një pasqyrë financiare vjetore, raportin për menaxhimin e shoqërisë dhe këto t’ia prezantojë pronarëve në çdo vit financiar të shoqërisë dhe tu mundësojë të gjithë pronarëve të shoqërisë qasje

në të gjitha këto dokumente për shqyrtim dhe kopjim. Drejtori menaxhues i shoqërisë është i detyruar të veprorë gjithmonë me mirëbesim, duke vepruar me autoritet dhe në interesin më të mirë të shoqërisë me kujdesin dhe vëmendjen për përgjegjësitë e tij.

Detyrimi i kujdesit afarist është obligues për drejtorin menaxhues dhe përfshin detyrimin e kryerjes së obligimeve me ndershmëri, përgjegjësi profesionale. Drejtori menaxhues dhe personat tjerë përgjegjës nuk japin përgjegjësi dhe llogari, po që se detyrat i kryejnë me ndershmëri. Kujdesi i afaristit të mirë nënkupton shkallën e kujdesit që kishte për të vepruar personi me kujdes të arsyeshëm i cili kishte për të poseduar dije profesionale, shkathtësi dhe përvojë për ushtrimin e detyrës në mënyrë të arsyeshme ndaj shoqërisë.

Drejtori menaxher i “SH.P.K” nuk mund të angazhohet, të merr pjesë ose të ketë interes në ndonjë veprimtari afariste, e cila i bënë konkurrencë “SH.P.K”-së.

Shpërbërja dhe likuidimi.–“SH.P.K” mund të shpërbëhet në disa raste të veçanta. “SH.P.K” do të shpërbëhet dhe veprimtaria e saj tregtare do të përmbyllet, në raste të:

- skadimit të kohëzgjatjes (nëse ka të tillë) të theksuar në statut ose në ndonjë rrethanë tjetër të përcaktuar në statut ose në marrëveshjen e shoqërisë që mund të shkaktojë shpërbërjen ose përfundimin e ekzistencës;
- vendimit të pronarëve për shpërbërjen apo përfundimin e ekzistimit të shoqërisë;
- pranimit të njoftimit për çregjistrim nga ARBK;
- pranimit të një urdhri të gjykatës me të cilën kërkohet përfundimi i ekzistencës së shoqërisë ose shpërbëhet sipas një dorëzimi të ligjit të zbatueshëm në Kosovë (duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin për falimentim) ; nëse
- koha për ankesë në këtë urdhër ka skaduar dhe
- nuk ka ankesë në pritië në shqyrtim nga ndonjë gjykatë e nivelit më të lartë.

Nëse shpërbëhet vullnetarisht, veprimtaria e shoqërisë përmbyllet dhe asetet likuidohen sipas ligjit. Nëse shpërbëhet dhe shoqëria nuk ka falimentuar, gjykata do ta mbikëqyrë përmbylljen e veprimtarisë dhe likuidimin sipas procedurave të përcaktuara me ligj. Nëse shpërbërja kërkohet sipas ligjeve të zbatueshme për falimentim, gjykata zbaton dhe respekton dispozitat e ligjeve për falimentim që rregullojnë përmbylljen e veprimtarisë dhe likuidimin e shoqërisë.

Nëse shpërbërja e “SH.P.K” është e detyruar, “SH.P.K” ndjek procedurat e caktuara në bazë të mbikëqyrjes së gjykatës, përmbyllet dhe likuidohet, ose ndjek procedurat e caktuara me ligjin e Kosovës për likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridike (kur “SH.P.K” ka falimentuar).

Gjatë likuidimit, asetet e shoqërisë do të paguhën dhe/ose shpërndahen sipas rendit të përparësisë së përcaktuar në Ligjin për Likuidim, Falimentim dhe Riorganizim.

Në ekonomi, bashkimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuara mbahet sipas planit për bashkim, që është në pajtim me ligjin, për një ose me shumë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, mund të bashkohet me një kompani të themeluar sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare “SH.P:K” të cilat duan të bashkohen duhet të kenë planin për bashkim, që është një dokument i hollësishëm që përcakton tërë kornizën e bashkimit të dy shoqërive të cilat duan të bashkohen. Pas përfundimit të bashkimit, palët e bashkimit duhet të dorëzojnë planin e bashkimit në ARBK. Bashkimi hyn në fuqi pas regjistrimit dhe shoqëritë që bashkohen vazhdojnë të jenë një subjekt i vetëm, i cili do të merr të gjitha përgjegjësitë, të drejtat dhe interesat e shoqërive që bashkohen.

“SH.P.K”-së i lejohej të bashkohet me personin juridik të huaj me kusht që ai të sigurojë se ky bashkim bëhet në pajtim me kërkesat që zbatohen nga Ligji i Shoqërive Tregtare dhe shoqëria tregtare mbijetuese, duhet të zbatohet të gjitha kërkesat që zbatohen me këtë ligj.

Bashkimi i shoqërisë dhe i personave të huaj juridikë: Një ose më shumë persona të huaj juridikë dhe një ose me shumë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të Kosovës, mund të bashkohen si vijon:

- secila shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e Kosovës e cila merr pjesë në bashkim është përgjegjëse për të siguruar se bashkimi do të bëhet në pajtim me ligjin;
- korporata e mbijetuar duhet t’i zbatojë, t’i respektojë të gjitha kërkesat e zbatueshme të këtij ligji dhe elementet e tjera të ligjit të zbatueshëm në Kosovë. Pa kufizuar përgjegjësinë e detyrimit të mësipërm, është me rëndësi të veçantë që, nëse shoqëria tregtare themelore sipas ligjeve ose një juridiksioni të huaj jashtë Kosovës, shoqëria tregtare e mbijetuar duhet t’i përmbushë plotësisht dispozitat e zbatueshme sipas ligjit.

SHOQËRIA AKSIONARE (“SH.A.”)

Shoqëria aksionare “SH.A.” është shoqëri afariste e lejuar sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare. Shoqëria aksionare është person juridik në pronësi të aksionarëve të saj, por është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët. Aksionari i një shoqërie aksionare nuk është bashkëpronar dhe nuk ka interes të transferueshëm në pronën ose asetet e shoqërisë. Shoqëria aksionare mund të ketë vetëm një aksionar. Aksionet në shoqërinë aksionare janë njësitë në bazë të të cilave ndahen interesat pronësore në shoqëri. Shoqëria aksionare është në pronësinë e një ose më shumë aksionarëve dhe e cila është juridikisht e ndarë dhe e veçantë nga aksionarët e saj (praktikisht është korporatë). Shoqëria lëshon certifikata të pronësisë ose aksione në shkëmbim të secilit kontribut dhe aksionarët janë të lirë të bartin interesin e tyre pronësor ose t’iu shesin aksionet e tyre personave të tjerë në çdo kohë.

Sipas Ligjit të Shoqërive Tregtare, shoqëria aksionare është person juridik, si u cek më lart, në pronësi të një ose më shumë pronarëve (aksionarëve). Shoqëria aksionare ka kompetenca të ushtrrojë padi ose të paditet, të lidhë kontrata, të huazojë të holla dhe t’i nënshtrohet borxheve dhe detyrimeve tjera, të zgjedhë ose të emërojë menaxherët,

punonjësit dhe agjentët e shoqërisë dhe të përcaktojë detyrat dhe kompensimet e tyre etj.

Pronësia mbi njësitet "SH.A." është interes personal dhe mund të bartet varësisht prej kufizimeve të përcaktuara në ligj ose në marrëveshjen e shoqërisë. Shoqëria aksionare lëshon certifikata si dëshmi për pronësinë, megjithë këto certifikata nuk janë të domosdoshme.

Shoqëria aksionare është përgjegjëse për të gjitha borxhet dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet dhe pasurinë e saj. Kjo përgjegjësi nuk shtrihet edhe në asetet personale të pronarëve d.m.th. pronarët nuk janë përgjegjës personalisht për borxhet dhe detyrimet e shoqërisë aksionare, çka do të thotë se asnjë person, shoqëri tregtare ose shoqëri tjetër, nuk është përgjegjës për detyrimet e shoqërisë aksionare, vetëm për shkak se është aksionar në këtë shoqëri.

Statuti dhe rregulloret.- Shoqëria aksionare themelohet pas regjistrimit të statutit të saj sipas ligjit. Statuti është dokument themelues dhe konstitutiv i shoqërisë aksionare. Ndryshimet dhe plotësimet në statut nuk kanë efekt juridik për derisa të miratohet nga aksionarët dhe të dorëzohet në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK) në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare.

Rregulloret.- Janë dokumente, të cilat miratohen, ndryshohen ose revokohen nga aksionarët ose bordi i drejtorëve. Rregulloret përmbajnë dispozitat për menaxhimin dhe funksionimin e shoqërisë. Rregulloret rregullojnë çështjet e brendshme, por nuk mund të rregullojnë të drejtat e palëve të treta.

Nëse shfaqet konflikt ndërmjet statutit dhe rregulloreve të shoqërisë, statuti mbizotëron. Në raste të tilla, dispozitat përkatëse të rregulloreve, konsiderohen të revokuara ose të ndryshuara në masën e nevojshme për eliminimin e mos përputhjes.

Menjëherë pas regjistrimit të shoqërisë aksionare, drejtorët fillestarë të emëruar me statut, duhet të mbajnë mbledhje organizative për të kompletuar organizimin e shoqërisë përmes zgjedhjes së zyrtarëve fillestarë, si dhe të ushtrojnë veprimtaritë përkatëse nën autorizimin e tyre.

Shoqëria aksionare mund të emetojë dy lloj aksionesh, aksione të thjeshta dhe aksione të privileguara. Shoqëria duhet të emërojë se paku një aksion të thjeshtë. Aksionet duhet të kenë vlerën e theksuar nominale. Nëse aksioni ka vlerën e theksuar nominale, atëherë kjo vlerë duhet të jetë më së paku 1 (një) Euro cent. Vlera e theksuar nominale në një aksion të thjeshtë ose të privilegjuar, mund të jetë

- por nuk është e detyrueshme,
- më e madhe se 1 (një) euro.

Aksionet e certifikuara.- Janë aksione të cilat përfaqësohen nga certifikata e aksioneve, kurse aksionet e pa certifikuara janë aksione të cilat nuk e përfaqësojnë asnjë lloj dokumenti.

Shoqëria aksionare mund të krijojë dhe të emitojë letra të tjera me vlerë, përveç aksioneve

- bonde,
- letra me vlerë të konvertueshme në aksione, dhe
- mundësi për blerjen e aksioneve.

Aksionet paguhen proporcionalisht dhe mund të paguhen në të holla dhe përmes letrave me vlerë. Bondet janë njëra prej mënyrave që shoqëria aksionare të rrisë kapitalin e saj për investime.

Kapitali themeltar.- Kapitali themeltar për një shoqëri aksionare është 10.000 €, ose shuma e gjithmbarshme e vlerës nominale e të gjitha aksioneve të emetuara nga shoqëria në kohën e regjistrimit fillestar. Kapitali themeltar paraqet shumën nominale që është në dispozicion në përmbushjen e pretendimeve të kreditorëve.

Shpërndarjet.- Bordi i drejtorëve të shoqërisë aksionare, nëse është i autorizuar në bazë të statutit ose me vendim të aksionarëve, mund të deklarojë dhe të paguajë dividend (shpërndarje) në të gjitha, por jo më pak se të gjitha aksionet e emetuara të çfarëdo lloji ose kategorie. Bordi i drejtorëve ka të drejtë të ndërmerr këtë veprim në çdo kohë.

Për blerjen e aksioneve të veta shoqëria aksionare duhet të autorizohet me vendim të aksionarëve që miratojnë blerjen. Ky vendim duhet të miratohet me shumicë votash.

Shoqëria aksionare nuk mund të pranojë aksionet e veta si sigurim (garanci) për ndonjë detyrim që një person ose shoqëri e ka ndaj shoqërisë aksionare.

Bordi i drejtorëve.- Çdo shoqëri aksionare duhet të ketë një bord të drejtorëve. Veprimtaria tregtare e shoqërisë menaxhohet nga ose sipas udhëzimeve të bordit të drejtorëve. Çdo drejtor duhet të jetë person fizik. Statuti i shoqërisë mund të përcaktojë kushte të tjera për kualifikimin e drejtorit. Drejtori nuk është i detyruar që të jetë banor i Kosovës, përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statutin e shoqërisë. Nuk është e nevojshme që drejtori të jetë aksionar i shoqërisë përveç nëse është përcaktuar ndryshe në statutin e shoqërisë. Bordi i drejtorëve merr vendime për menaxhimin strategjik që i rezervohet aksionarëve. Bordit i takojnë disa të drejta vendimmarrëse ekskluzive të përcaktuara me ligj. Anëtarët e bordit të drejtorëve zgjidhen në mbledhjen vjetore të aksionarëve, mirëpo ndodh që ata të zgjidhen edhe në mbledhjet e veçanta.

Numri i anëtarëve në bordin e drejtorëve duhet të caktohet me statut. Për një shoqëri, me më pak se dhjetë aksionarë, bordi duhet të ketë një (1) ose më shumë anëtarë, për një shoqëri me dhjetë ose më shumë aksionarë, bordi duhet të ketë jo më pak se tre (3) anëtarë, për një shoqëri me pesëqind (500) ose më shumë aksionarë, bordi duhet të ketë jo më pak se shtatë (7) anëtarë të bordit.

Bordi duhet të mbajë së paku një mbledhje vjetore, por mund të mbajë edhe më shumë. Drejtorëve duhet t’u dërgohet njoftimi për mbledhje dhe vendimet kryesore

merren gjatë këtyre mbledhjeve, në mënyrë që një veprim i huaj të hyjë në fuqi. Shumica e drejtorëve që janë të pranishëm duhet të votojnë për atë veprim.

Bordi i drejtorëve punëson zyrtarët, kryesisht menaxhmentin e lartë të shoqërisë aksionare. Këta zyrtarë drejtojnë veprimtarinë e përditshme të shoqërisë dhe kanë të gjitha autorizimet që u janë dhënë nga bordi përmes rregulloreve të shoqërisë.

Detyrimet e drejtorëve dhe zyrtarëve.- Drejtorët dhe zyrtarët kanë detyrimin e kujdesit ndaj shoqërisë aksionare dhe detyrimin e moskonkurrencës. Këto parime janë shpjeguar në hollësi në pjesën që flet për “SH.P.K”. Megjithatë, drejtorët dhe zyrtarët e shoqërisë janë të mbrojtur sipas Rregullit të Gjyimit Afarist, nëse ata ushtrojnë detyrën në përputhje me këtë rregull. Detyrimet të cilat drejtorët dhe zyrtarët i kanë ndaj kompanisë mund të zbatohen përmes proceseve gjyqësore.

Kompetencat e aksionarëve.- Siç u tha më lart, shoqëria aksionare duhet të mbajë mbledhjen vjetore të aksionarëve brenda 60 ditësh pasi bordi të merr pasqyrat e audituara financiare të shoqërisë për secilin vit kalendarik. Shoqëria aksionare mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme të aksionarëve. Edhe aksionarët kanë disa kompetenca ekskluzive që rezervohen për ata me ligj. Gjatë marrjes së vendimeve, votimi nga aksionari mund të bëhet personalisht ose përmes përfaqësuesit. Aksionarët kanë disa kompetenca ekskluzive dhe atë për:

- ndryshimin dhe plotësimin e statutit dhe të rregulloreve të shoqërisë,
- zgjedhjen dhe shkarkimin e drejtorëve,
- miratimin e planit të bashkimit,
- shpërndarjen e shoqërisë,
- emërimin e auditorëve të pavarur, dhe
- miratimin e pasqyrave financiare të shoqërisë.

Aksionarët votohen personalisht apo përmes përfaqësuesve të tyre. Kuorumi i shumicës së votave të aksionarëve që kanë të drejtë vote është i nevojshëm për vendimmartje të vlefshme në kuvendin e shoqërisë së aksionarëve. Vendimet janë të vlefshme nëse votojnë shumica e aksionarëve që kanë të drejtë vote dhe që prezantojnë në mbledhje. Nëse nuk mbahet mbledhja e aksionarëve brenda 6 muajsh, pas përfundimit financiar të shoqërisë, apo 14 muaj pas mbledhjes së fundit të aksionarëve, apo pas 12 muajsh, pas regjistrimit fillestar të shoqërisë, gjykata kompetente mund të nxjerrë vendim për mbajtjen e mbledhjes me kërkesën e drejtorit ose aksionarit i cili ka të drejtë pjesëmarrëjeje dhe vote në mbledhjen e caktuar.

Bashkimet.- Për bashkimin e shoqërisë bordi i drejtorëve harton palnin e bashkimit që i dorëzohet kuvendit të aksionarëve për miratim. Ky plan duhet të përmbajë të gjitha informatat e nevojshme ekonomike dhe ligjore, e sidomos llojin e shoqërisë, kushtet dhe rrethanat e bashkimit të propozuar, mënyrën dhe bazat e kuvendit të aksioneve të secilës shoqëri që bashkohet, mjetet financiare ose pasurinë tjetër, aksionet, letrat me

vlerë, borxhet e shoqërisë së mbajtur ose të cilido aksionar të shoqërisë mbijetuese dhe informatat tjera me rëndësi, tekstin e plotë të statutit dhe rregulloreve të shoqërisë, të drejtat që janë bartur nga shoqëria e mbijetuar në poseduesin e aksioneve dhe informatat tjera më rëndësi. Për planin e bashkimit të shoqërisë duhet të votojnë së paku 2/3 e aksionarëve të cilët kanë të drejtë vote në shoqëri. Bashkimi hyn në fuqi kur plani i bashkimit dorëzohet në ARBK.

Aksionarët mund të refuzojnë, po edhe të kërkojnë pagesa të plota nga shoqëria, nëse ka reperkusione negative me ndryshimin dhe plotësimin e statutit, të cilat manifestohen nëpërmes bashkimit ose ndarjes. Vlera që duhet t'i paguhet aksionarit që nuk pajtohet është vlera e tregut të aksioneve.

Shpërbërja dhe likuidimi.- Shoqëria aksionare mund të shpërbëhet dhe veprimtaria e saj të likuidohet, në çdo kohë, me një vendim të bordit të drejtorëve dhe aksionarëve, si vijon:

- bordi i drejtorëve i shoqërisë apo aksionarët duhet të miratojnë një vendim për shpërbërjen ose likuidimin e propozuar dhe duhet ta dorzojnë për miratim në mbledhjen e aksionarëve, që mund të jetë mbledhje vjetore ose e jashtëzakonshme,
- njoftimi me shkrim për propozimin dhe planin duhet t'iu dërgohet të gjithë aksionarëve që kanë të drejtë pjesëmarrjeje në mbledhje dhe
- në mbledhje, propozimi miratohet me votën pohuese të së paku 2/3 të
- aksionarëve që kanë të drejtë vote në propozim në këtë mbledhje.

Statuti i shoqërisë.- Duhet të zëvendësohet me 2/3 e votave që kërkohen, duke cekur çfarëdo metode të votimit që i tejkalon dy të tretat e votave të aksionarëve që kanë të drejtë vote në çështje dhe jo më pak se dy të tretat e aksioneve të secilit grup votues, që ka të drejtë në votim grupor mbi atë çështje.

Shoqëria aksionare në mënyrë të detyruar shpërbëhet në këto raste, dhe atë;

- me skadimin e periudhës kohore në shoqëri në pajtim me ligjin në fuqi;
- me urdhrin e gjykatës për shpërbërjen e shoqërisë për shkak se nuk mund të vazhdojë veprimtarinë tregtare si pasojë e paligjshmërive;
- bllokimit në vendimarrjeje, pa ftesën paguese apo falimentimit të shoqërisë dhe shpërbërjes së saj sipas Ligjit për Likuidim, Riorganizim të Personave Juridikë në Falimentim;
- kur vlera e aseteve në to është më e vogël se minimumi i kapitalit themelor që kërkohet sipas ligjit.

Shpërbërja e aseteve të shoqërisë në likuidim duhet të bëhet në bazë të prioritetit të caktuar në ligjet përkatëse të falimentimit.

AGJENCIA E REGJISTRIMIT TË BIZNISEVE TË KOSOVËS (ARBK)

Themelimi i Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK): Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës regjistron emrat tregtarë në Kosovë, themelohet si agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

ARBK ka për detyrë të regjistrojë shoqëritë tregtare dhe shoqëritë e huaja tregtare, në pajtim me dispozitat dhe kërkesat e Ligjit të Shoqërive Tregtare. ARBK është gjithashtu e autorizuar dhe përgjegjëse për kryerjen e funksioneve tjera të përcaktuara me këtë ligj. ARBK nuk është në asnjë mënyrë agjenci për kontrollimin e saktësisë së informacionit të dhënë nga paraqitësi i dokumenteve apo ndonjë organ licencues. Detyrimi për ofrimin e informacionit të saktë për formularët e regjistrimit dhe për marrjen e të gjitha licencave që kërkohen për veprimtari tregtare mbetet përgjegjësi e paraqitësit të dokumentave. ARBK e udhëheq drejtori i Zyrës së Regjistrimit të Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtarë.

ARBK menaxhon me dokumente për të cilat është përgjegjëse. Këto dokumente krijohen si pjesë e procesit të regjistrimit ose për përkrahjen e këtij procesi. Të gjitha dokumentet e dorzuara në ARBK, apo të krijuara nga ajo, janë dokumente publike pa përjashtim dhe duhet të vendosen në dispozicion të të gjithë personave që i krijojnë ato.

Të gjitha dokumentet e dorëzuara duhet të jenë të nënshkruara nga personi i autorizuar, ndërsa ARBK-ja duhet t'i përmbahet procedurave të parapra me ligj. Roli i ARBK-ë është vetëm formal, informues dhe administrativ. Ata thjesht e regjistrojnë dokumentin ashtu si është dorëzuar në përputhje me kushtet e përcaktuara me ligj. Pra, nuk verifikon informatat.

Kushtet e regjistrimit- ARBK është rreptësisht e detyruar që formalisht dhe zyrtarisht të regjistrojë një dokument të dorzuar në atë zyrë, nëse ky dokument i dorëzon kushtet e përcaktuara me ligj dhe kushtet tjera specifike të përcaktuara me ligj.

Shqyrtimi i çështjeve kontestuese bëhet me procedurë administrative. Mjetet juridike janë në dispozicion të personave ose shoqërive të prekura, të cilat në mirëbesim i besojnë ARBK-së, e regjistrimit që ka shkelur ligjin. Megjithatë, për të fituar këtë të drejtë, personat e prekur duhet të ndjekin udhëzimet procedurale të caktuara me ligje. Këto procedura janë të domosdoshme për të fituar të drejtën për qasje në gjykatë.

Emri i Shoqërisë.- Për tu regjistruar në ARBK, shoqëria tregtare duhet të ketë emrin e saj. Megjithatë, regjistrimi i emrit të shoqërisë tregtare në ARBK nuk ofron mbrojtje të pronës intelektuale për emrin e biznesit. Emri duhet të përmbajë këto shkurtesa:

- për Biznes Individual – “B.I.”
- për Ortakësi të Përgjithshme – “O.P.”
- për Shoqëri Komandite – “SH.K.M”
- për Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar – “SH.P.K”
- për Shoqëri Aksionare – “SH.A.”

ARBK mund të korrigojë gabimet e saj në çdo kohë. Në këtë rast, ajo duhet t'i bashkëngjitet me shënim që tregon natyrën, datën, kohën dhe arsyet e korrigjimit dhe menjëherë ia dorzon shoqërisë përkatëse tregtare shënimin e sipër cekur.

Një shoqëri tregtare mund t'i korrigojë gabimet e saj në çdo kohë me paraqitjen e aplikacionit gjegjës në ARBK.

ARBK duhet të ruaj përherë të gjitha shënimet dhe dokumentat, duke përfshirë dokumentet e pranuar ose të regjistruara, duhet të ruajë kopjet elektronike të të gjithë arkivës në një bazë të sigurt kompjuterike të të dhënave. ARBK duhet të mbajë kopjet origjinale në letër të të dhënave për së paku pesë (5) vite. Të dhënat në letër, që janë më të vjetra se pesë (5) vite, nuk duhet të shkatërrohen, por të njëjtat barten në Arkivin e Kosovës.

Shoqëria tregtare nuk mund të angazhohet në veprimtari tregtare me një emër tjetër tregtar nga emri zyrtar i regjistruar në ARBK.

Certifikata e regjistrimit të emrit tregtar- Pas pranimit të kërkeses së paraparë me ligj, ARBK-ja lëshon certifikatën e regjistrimit të emrit tregtar dhe ia dërgon atë paraqitësit të kërkesës. Kjo agjenci mund të refuzojë lëshimin e kësaj certifikate vetëm nëse konstaton se emri tregtar aktualisht është i rezervuar ose i regjistruar në ARBK nga një person ose shoqëri tjetër tregtare, që nuk e lejon shfrytëzimin e emrit nga paraqitësi i kërkesës.

Certifikata e Regjistrimit të Emrit Tregtar është dëshmi se emri i treguat është regjistruar në ARBK për shfrytëzim ekskluziv nga paraqitësi i kërkesës, e cila hyn në fuqi në ditën e lëshimit të certifikatës.

Regjistrimi i emrit tregtar në ARBK nuk krijon çfarëdo të drejtash mbi markat tregtare lidhur me këtë emër tregtar. ARBK-ja pas pranimit të njoftimit formal me shkrim mbi vendin që shfrytëzohet nga një person ose shoqëri, menjëherë duhet ta revokojë certifikatën e regjistrimit të emrit tregtar.

Regjistrimi i emrit tregtar është i vlefshëm për një periudhë kohore prej tri (3) vitesh nga hyrja në fuqi e Certifikatës së Regjistrimit. Kërkesa për vazhdimin e tillë përmban të dhënat e njëjta si ato që kërkohen me ligj dhe duhet të ceket se kërkesa vjen për vazhdimin e një regjistrimi ekzistues. Vazhdimi vlen për pesë (5) vite. Nëse regjistrimi i një emri tregtar skadon në nëntëdhjetë (90) ditët e ardhme, ARBK duhet menjëherë t'i dërgojë shoqërisë përkatëse tregtare një njoftim me shkrim me të cilin

- e njofton shoqërinë tregtare për skadimin e afërt të afatit, dhe
- e njofton shoqërinë tregtare mbi të drejtën e saj për vazhdim sipas ligjit.

NDËRMARRJET PUBLIKE

Sipas Ligjit për Ndërmarrjet Publike, ndërmarrjet publike (“NP”) janë ndërmarrje në pronësi të Republikës së Kosovës apo të komunave përkatëse. Ato NP që janë në pronë të Republikës quhen Ndërmarrje Publike Qendrore, ndërsa ato në pronësi të komunave, quhen Ndërmarrje Publike Lokale.

Ndërmarrjet publike organizohen si shoqëri aksionare në përputhje me Ligjin e Shoqërive Tregtare. Nëse një NP nuk është e organizuar si shoqëri aksionare, në datën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, përkatësisht më 15 qershor 2008, ato NP kanë afat prej 150 ditësh për tu organizuar si shoqëri aksionare. Aksionari ekskluziv i NP qendrore është Republika e Kosovës dhe Qeveria ka kompetenca ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit. Sa u përket NP lokale, komuna përkatëse është aksionari ekskluziv dhe komisioni komunal i aksionarëve ka kompetenca ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit.

Ndërmarrjet e reja publike mund të themelohen vetëm me vendim të Qeverisë dhe ndërmarrja e re publike do të jetë NP qendrore.

Çdo NP qendrore do të ketë nga pesë deri në shtatë drejtorë. Në NP qendrore, ata zgjedhen nga Qeveria, përveç njërit, përkatësisht kryeshëfit ekzekutiv, që zgjedhet nga bordi i drejtorëve. Drejtorët zgjedhen nga ata kandidatë që rekomandohen nga komisioni rekomandues.

Në NP lokale duhet të kenë pesë drejtorë, prej të cilëve katër zgjedhen në mbledhjen e aksionarëve. Drejtori i pestë, përkatësisht kryeshëfi ekzekutiv, zgjedhet nga bordi i drejtorëve të NP-së lokale.

Me ligj parashtrihen kushtet për të shërbyer si drejtor i një ndërmarrjeje publike, si vijon:

të mos jetë denuar për vepër penale apo civile (përgënjeshtim, korrupsion, vjedhje etj),

të mos jetë shpallur njeri që ka ndërmarrë sjellje jo profesionale, që ka shkelur kodin etik, ka përvetësuar-keqpërdorur paratë publike apo informatat e fituara si zyrtar publik ose ka keqpërdorur postin për përfitime personale,

- nuk ka bërë përgënjeshtime materiale nën çfarëdo dëshmie nën betim,
- nuk ka falimentuar në 10 vitet e fundit.

Kërkohet që drejtorët të jenë të pavarur, sipas kritereve të numëruara me ligj, që secili bord të ketë së paku dy drejtorë, që janë ekspertë të kontabilitetit, të mos përgënjeshtërojnë gjatë procesit të aplikimit për drejtor dhe çdo drejtor të vijojë një kurs trajnimi në vit për qeverisje të korporatave.

Detyrat e bordit.- Janë mbikëqyrja e veprimtarisë së zyrtarëve të NP për tu siguruar se veprimtaria e zyrtarëve është në përputhje me Planin e Biznesit për atë vit financiar. Njëherit drejtorët kanë detyra të besuara (fiduciare), shkelja e të cilave kërkon shkarkim të drejtorit nga posti i tij, pas një hetimi të hollësishëm dhe të kohshëm.

Zyrtarët e NP-ve zgjedhen dhe emërohen nga bordi i drejtorëve të NP. Zyrtarët shërbejnë në përputhje me detyrate e tyre të caktuara në rregulloret e brendshme të NP-së. Secila NP duhet të ketë kryeshefin ekzekutiv, zyrtarin kryesor financiar dhe të thesarit, këshilltarin e përgjithshëm/sekretarin korporativ dhe një zyrtar për auditim të brendshëm. Përveç saj, nëse NP është më e madhe dhe ka veprimtari të llojllojshme, atëherë bordi i drejtorëve mund të përcaktojë me rregullore edhe dy zyrtarë, përkatësisht dy poste të zëvendës kryetarit. Drejtorët edhe zyrtarët kanë detyra të besuara (fiduciare), shkelja e të cilave ka për pasojë shkarkimin e zyrtarit nga posti i tij.

Konflikti i interesave.- Një ndër kërkesat më të rëndësishme ligjore është që drejtorët dhe zyrtarët e një NP mos të hyjnë në marrëveshjen me NP ku janë të angazhuar, përveç nëse ato marrëveshje miratohen paraprakisht nga aksionarët. Gjithashtu, çfarëdo interesi personal i drejtorëve dhe zyrtarëve të NP-së që mund të ketë ndikim në vendimmarrje për NP-në, duhet të zbulohet tërësisht me shkrim para bordit të drejtorëve të NP-së. Natyrisht, kur një drejtor ka interesa personale, atij i ndalohet pjesëmarrja në mbledhje apo ndikimi në diskutime rreth interesave të tij, në përputhshmëri me interesat e tyre në NP.

TRANSFERIMI I PRONËS SHOQËRORE NË ATË PRIVATE NË REPUBLIKËN E KOSOVËS

Transferimi i pronës shoqërore në atë private në Republikën e Kosovës është bërë kusht specifik i statusit politiko- shoqëror që ka Kosova nën mbikëqyrje ndërkombëtare të saj nga ana e UNMIK-ut dhe më pastaj nga EULEX-i. Kjo është bërë me themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit me të cilën ka udhëhequr UNMIK-u.

Në qershor të vitit 2008, në bazë të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili është i aplikueshëm prej 29 qershorit 2008, themelohet Agjencia Kosovare e Privatizimit sipas ardhjes së Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, të gjitha asetet dhe përgjegjësitë e saj do të jenë astete dhe përgjegjësi të agjencisë.

Agjencia Kosovare e Privatizimit si suksesor juridik (AKM-së) është themeluar si organ i pavaruar që kishte zotësi të plotë juridike, në veçanti aftësi për të lidhur kontrata, për të marrë vendime, për ta ruajtur dhe për ta shitur pasurinë dhe kompetenca ligjore për përmbushjen e obligimeve që dalin nga afarizmi. AKP ka zotësi juridike që të padisë dhe të paditet në emër të saj. Kësisoj, ajo i administronte ndërmarrjet shoqërore dhe pasurinë e tyre, kujdesej për ruajtjen apo për rritjen e vlerave dhe të seancave për sukses të aktiviteteve të atyre subjekteve që i administron. AKP është e autorizuar që të administrojë:

- ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse iu kanë nënshtuar transformimit apo jo.

- të gjitha asetet që ndodhen në territorin e Kosovës, pavarësisht a janë të organizuara si subjekte apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose para 22 marsit 1989, pavarësisht nëse iu kanë nënshtruar transferimit apo jo, sipas ligjit i AKP-së,
- pjesët e ndërmarrjeve jashtë territorit të Kosovës, nëse Agjencia ka qasje në administrimin e asaj pasurie.

Agjencia kujdeset që paraprakisht ta vërtetojë se a është bërë transferimi i pronës konform me dispozitat ligjore në fuqi, e jo vetëm improvizimi i transferimit dhe ta vërtetojë faktin se transferimi eventual nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut.

Agjencia emëron dhe zëvendëson kryetarin apo drejtorët dhe menaxherët e ndërmarrjes; konstituon, konfirmon, ose riformon bordin mbikëqyrës, bordin menaxhes, këshillin e punëtorëve ose të organit tjetër menaxhues. Agjencia miraton planet e biznesit dhe planet e investimit të ndërmarrjes, nxjerr dhe ndryshon afatet e themelimit dhe të akteve të përgjithshme normative, regjistron ndërmarrjet të cilat nuk janë regjistruar në mënyrë adekuate, organizon, riorganizon, menaxhon ato, jep koncesione që lidhen me ndërmarrjet, transferimin, ndërmarrjen në korporata, dhënie me koncesion- kontratë me qiranë e një pjese të veprimtarisë së ndërmarrjes, apo krejt ndërmarrjen, falimentimin dhe likuidimin.

Privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore.- Përmes themelimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe të delegimit të autorizimeve në këtë agjenci të gjërave publike administrative mbi këto ndërmarrje dhe asete, duke përfshirë, por pa ua kufizuar mandatin dhe autoritetin për shitjen ose bartjen e këtyre ndërmarrjeve dhe/ose aseteve në investitorë privatë, ose likuidimin e tyre përmes një procesi të hapur, transparent konkurrues dhe pa vonesa.

Metoda e preferuar e agjencisë për të privatizuar ndërmarrjet shoqërore të cilat kanë afarizëm të qëndrueshëm është metoda e “spin Off”-it, përmes së cilës asetet dhe detyrimet e kufizuara të një ndërmarrjeje shoqërore barten në njësinë e themeluar të NSH.

Ndërmarrja e re (New co).- Ndërmarrja e re do t’i shitet një investitori dhe të hyrat nga shitja do të depozitohen në një llogari, të cilat do të pëdoren për përmbushjen e obligimeve të mbetura të NSH, si dhe kërkesat tjera, duke përfshirë edhe kërkesat në pronësi. Pastaj NSH do të likuidohet.

Agjencia mund të bëjë likuidimin e NSH-ve të cilat nuk do të jenë subjekt i psocedurës së spin-Offit.

Në rrethanat e jashtëzakonshme dhe për një numër të kufizuar të rasteve, agjencia me miratimin e bordit, mund t’i japë me qira një investitori asetet e një NSH-je të caktuar nëpërmes të një kontrate afatgjate të qiradhënies.

Agjencia do t’i njoftojë, së paku dhjetë ditë përpara, punëtorët e NSH-ve dhe administratën përkatëse komunale lidhur me publikun e planifikuar të njoftimit për tenderim për shitjen e aseteve të NSH-ve, likuidimit apo të një forme tjetër të privatizimit.

Asetet e NSH-së për listën për spin-Off do tu ofrohen për shitje investitorëve të mundshëm përmes procedurës së tenderimit të hapur publik.

Kualifikueshmëria e ofertuesve.- Në parim, të gjithë personat fizikë dhe juridikë, do të konsiderohen ofertues të kualifikuar, pavarësisht nga vendndodhja ose veprimtaria e tyre, afarizmi, shtetësia apo vendbanimi, përveç:

- ndërmarrjeve publike dhe shoqërore,
- departamenteve të qeverisë ose institucioneve qeveritare,
- personave fizikë ose juridikë të cilët aktualisht janë në procedurë të falimentimit ose të josolvendës (paaftësisë për të paguar) dhe
- personave fizikë të cilët janë fajtorë për ndonjë krim i cili është kryer pas qershorit 1999, apo të cilët janë subjekt i zhvillimit të procedurave kriminale ndaj tyre.

Likuidimi i ndërmarrjeve shoqërore.-

Në përputhje me Ligjin për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, likuidimi vullnetar i ndërmarrjeve shoqërore bëhet me iniciativën e Agjencisë Kosovare të Privatizimit, nëse likuidimi është në interes të kreditorëve ose pronarëve përkatës. Procesi i likuidimit do të ushtrohet në bazë të procedurës së përcaktuar në Ligjin e Shoqërive Tregtare, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe në këtë ligj dhe në përputhje me Ligjin për Likuidimin dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Falimentim. Në raste të likuidimit, të gjitha kompetencat e organeve menaxhuese dhe mbikëqyërse të ndërmarrjeve të tilla i kalohen komisionit të likuidimit. Secili komision i likuidimit do të ketë një anëtar ndërkombëtar, i cili emërohet nga Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar. Anëtarët tjerë, të cilët duhet të kenë përvojë përkatëse, emërohen nga Agjencia, e cila duhet të ketë së paku një anëtar nga komuniteti jo shqiptar në Kosovë. Përndryshe, procesi i shpërbërjes dhe likuidimit bëhet në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Teragtare dhe Ligjin për Likuidim dhe Riorganizim të Personave Juridikë në Falimentim.

Riorganizimi i ndërmarrjeve shoqërore.- Riorganizimi i ndërmarrjeve shoqërore bëhet në përputhje me Ligjin për Likuidim dhe Riorganizimin e Personave Juridikë në Falimentim.

Procedura në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme për çështje të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit, tani Agjencisë Kosovare të Privatizimit:

Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit i jep juridiksion ekskluziv Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për të gjitha paditë kundër Agjencisë. Dhoma e Posaçme e pranon vetë padinë kundër Agjencisë, nëse pala ankuese dorëzon dëshminë se e ka njoftuar kryesuesin e bordit për dorëzimin e një padie të tillë, së paku 60 ditë para dorëzimit të padisë në Dhomën e Posaçme.

Dhoma e Posaçme ka juridiksion për çështjet që kanë të bëjë me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit. Kjo u themelua me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2002/13. Dhoma e

Posaçme përbëhet nga kolegji prej pesë (5) gjyqtar, nga të cilët tre janë ndërkombëtarë, ndërsa dy janë banorë të Republikës së Kosovës.

Kërkesat.- Të drejtë për paraqitjen e kërkesave për pagesa në Dhomën e Posaçme kanë personat që kërkojnë pronësi apo të drejta pronësore, huadhënësit dhe personat e tjerë që kërkojnë interesat e drejtpërdrejta në lëndën e paraqitur, agjencia, ndërmarrjet apo korporatat që janë nën autoritetin administrativ të agjencisë për të marrë vendime për lëndën.

Ndërsa të akuzuarit në proceset gjyqësore në Dhomën e Posaçme do të kufizohen në agjenci, ndërmarrje e korporatë, që është apo ka qenë nën kontrollin administrativ të agjencisë, personat ndaj të cilëve agjencia ka ndonjë pretendim, personat që konsiderohen plotësisht të nevojshëm nga Dhoma e Posaçme për të marrë vendime për lëndën.

Kërkuesi i pagesës mund të bëjë kërkesën për kundërshtimin e një vendimi ose veprimi të agjencisë brenda 9 ditësh.

FALIMENTIMI, LIKUIDIMI DHE RIORGANIZIMI I PERSONAVE JURIDIKË

Procedura e falimentimit në Kosovë rregullohet me Ligjin për Likuidim dhe Riorganizim të Personave Juridikë në Falimentim. Ndërsa ish pasuritë e ndërmarrjeve shoqërore mbesin jashtë shtrirjes së ligjit dhe rregullohen me dispozita të veçanta. Si pasojë, ka një moskoordinim në përdorimin e rregullave komerciale të falimentimit për zgjidhjen e një procesi i cili ka ndikim shoqëro-ekonomik dhe madje personal të mbylljes së kompanive të më parshme me përbërje të ndryshme. Ligji përcakton rregullat e përparësitë në mes të kreditorëve si një bazë për praktikën e udhëheqjes komerciale për falimentimet.

Falimentimi është një gjendje e shpallur ligjore e pamundësisë apo mundësisë së zvogëluar të një personi fizik apo juridik që t'i paguajë detyrimet ndaj kreditorëve. Sipas ligjit, çdo person juridik mund të jetë debitor, duke përfshirë kompanitë komerciale, ortakëritë e kufizuara dhe të përgjithshme. Ligji nuk kujdeset për falimentuesit konsumatorë. Mirëpo këto janë të përjashtuara nga shtrirja e ligjit, nga agjencitë qeveritare, zotërimi i ndërmarrjeve shoqërore, kompanitë e sigurimeve, pensionale dhe institucionet financiare. Falimentimi mund të jetë vullnetar apo i detyrueshëm.

Falimentimi vullnetar.- Është proces i iniciuar nga vetë personi që ka vështërsi me pagesën e detyrimeve ndaj kreditorëve, pra, kërkimi i tij për mbrojtje nga gjykata.

Falimentimi i detyruar.- Ndodh kur kreditorët e një personi paraqesin kërkesën e falimentimit që t'i shpëtojë një pjesë e kredisë që debitori ia ka borxh apo që të fillojë riorganizimin e një shoqërie.

Kompetente për paraqitjen e kërkesës për falimentim të personave juridikë është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike (për tërë territorin e Republikës së Kosovës).

Fillimi i procedurës së falimentimit.- Rasti i falimentimit fillon me paraqitjen e kërkesës me shkrim në gjykatë nga ana e debitorit, kreditorit apo grupit të kreditorëve. Forma dhe përmbajtja e kërkesës përcaktohet me rregulloret e ekzekutimit.

Debitori mund të paraqesë kërkesë vetëm nëse:

- është me pëlqimin e debitorit të drejtorëve ose organit udhëheqës në përputhje me statutin, dokumentet e themelimit ose marrëveshjen e ortakërisë, dhe
- nëse debitori i plotëson kushtet vijuese:
 - a) *debitori ka dështuar në pagesën e borxhit për më shumë se 60 ditë;*
 - b) *borxhi është për më shumë se 5000 € dhe*
 - c) *debitori në përgjithësi nuk është duke i paguar borxhet e tij brenda afatit të caktuar.*

Menjëherë pas paraqitjes së kërkesës, gjykata e informon ARBK-në.

Debitori ka një afat prej (5) pesë ditësh që ta kundërshtojë kërkesën, duke paraqitur në gjykatë njoftimin me shkrim të kundërshtimit, me ç'rast gjykata mban një sencë brenda (7) ditësh, ku vendos fatin e kërkesës. Kushtet për refuzim të kërkesës janë të parapara me ligj. Në rastin kur gjykata pranon rastin, ajo fillon procedurën e falimentimit.

Kur pranohet rasti nga gjykata, debitori ka të drejtë që të parashtrojë një deklaratë për qëllimin e riorganizimit brenda një afati 2 ditorë. Nëse debitori është i paafte për riorganizim, atëherë procedura shndërrohet në likuidim.

Administratori dhe bordi i kreditorëve.- Administratori emërohet nga gjykata brenda një afati (2) dy ditorë pas pranimit të rastit. Debitorët që kanë (60%) gjashtëdhjetë përqind apo më shumë të shumës së borxhit të debitorit, mund të kërkojnë nëpërmes kërkesës me shkrim nga gjykata zëvendësimin e administratorit të rastit.

Për administrator falimentues mund të emërohet vetëm personi fizik, i cili ka kualifikim shkollor superior, të drejtimit ekonomik, apo juridik, të cilitdo nëndrejtim, që ka provim profesional për administrator falimentues, që është i pajisur me licencë, që është i përfshirë në listën e administratorëve, që ka aftësi profesionale dhe përvojë për të menaxhuar dhe për të udhëhequr procedurën e falimentimit.

Përveç të drejtave të përcaktuara me ligj dhe rregullat e zbatimit, administratori ka të drejtë:

- të merr menjëherë në posedim pasurinë e debitorit;
- të thërret seancën e kreditorëve dhe të kryesojë seancat e tilla
- të fillojë dhe të vazhdojë procedurat gjyqësore dhe administrative që kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave të debitorit;

E DREJTA TREGTARE

- të shpërbejë si përfaqësues i autorizuar zyrtarisht për pasurinë e debitorit me pëlqimin e gjykatës,
- të punësojë dhe të mbikëqyrë punën e të punësuarve të vartësve dhe ekspertëve për administrimin e drejtë të rastit,
- të mbyllë llogarinë bankare të debitorit dhe të hapë llogarinë e veçantë të falimentimit në bankën e lejuar nga gjykata,
- të bëjë pagesën e kreditorëve në llogari të kërkesave të miratuara dhe
- të detyrojë debitorin apo përfaqësuesin e caktuar të menaxhmentit të debitorit të pasurisë së debitorit.

Administratori është i detyruar ta rrisë vlerën e pasurisë, të mirëmbajë dhe të mbrojë pasurinë, të kryejë shpejt dhe në mënyrë të bindshme zgjedhjen e rastit, dhe, kur është e duhur, të udhëheqë me biznesin e pasurisë.

Pasuria e falimentimit.- Me regjistrimin e kërkesës themelohet pasuria e falimentimit që përbëhet nga e gjithë pasuria e debitorit në kohën e paraqitjes së kërkesës, si dhe nga e tërë pasuria e mbledhur nga administratori në emër të debitorit gjatë kohës së procedurës ose rrjedhjes normale të biznesit. Kjo pasuri nuk përfshin mjetet e pensioneve ose të drejtat e fituara. Çfarëdo shitje, disponim, bartje apo dhënie me qira e pasurisë është e ndaluar totalisht para emërimit të administratorit, ndërsa pas emërimit të tij/saj, kjo mund të bëhet vetëm me vendim të gjykatës. Prej dhe nga data e emërimit të administratorit, përveç ndalesave të cekura më lart, ndalohet krijimi i pengjeve ose hipotekave kundër pasurisë gjatë rrjedhës normale të biznesit kur biznesi vazhdon të funksionojë.

Kur pasuria gjendet jashtë Kosovës, administratori do t'iu drejtohet gjykatave kompetente me njoftimin e sekuestrimit, vulosjes ose marrjes së pronësisë së tillë. Duhet të ceket se administratori ka të drejtë të shesë mallrat që prishen shpejt në përputhje me procedurat e parapara të këtij ligji.

Administratori klasifikon dhe bënë inventarizimin fizik të pasurisë jo më vonë se dyzet e pesë (45) ditë pas emërimit të tij. Me kërkesë të administratorit, gjykata mund të zgjasë këtë afat me rast veçanërisht të rëndësishëm apo të komplikuar ose kur ekzistojnë rrethanat e arsyeshme.

Çfarëdo shitje, disponim, bartje apo dhënie me qira e pasurisë është e ndaluar totalisht, para emërimit të administratorit, ndërsa pas emërimit të tij/saj kjo mund të bëhet vetëm me vendim të gjykatës.

RIORGANIZIMI

Propozimi për riorganizim quhet “Plan i Riorganizimit”. Çdo propozim për debitorin, që nuk kërkon likuidimin e menjëhershëm nga administratori do tu nënshtrohet dispozitave të riorganizimit. Propozimi do të formulohet me dokument me shkrim, i njohur si plani i riorganizimit. Planin për riorganizim mund ta paraqes debitori, administratori, kreditorët që posedojnë së paku 30% të kërkesave të siguruara, kreditori me 30% të kërkesave të pa siguruara ose personat që posedojnë së paku 30% të kapitalit në pronësi e debitorit, qoftë në formë të aksioneve, ose të ngjashme.

Planin e riorganizimit përmban një paraqitje të shkruar të përgjithshme në veprimtarinë biznesore të debitorit dhe rrethanat që shpiten në vështirësinë financiare, të gjitha jo më shumë se dy faqe, metodat dhe mjetet për realizimin e planit, periudhat kohore për realizimin e planit, deklarinimin se kush do ta menaxhojë organizatën, pjesët e tjera të parapara me ligj.

Kreditorët e siguruar dhe të pa siguruar kanë të drejtë të votojnë për apo kundër planit të riorganizimit. Nëse plani konfirmohet nga vota e kreditorëve, atëherë kjo konsiderohet një kontratë e re për përmbushjen e kërkesave të paraqitura në të. Në atë rast, prona e falimentimit shuhet dhe prona i kthehen debitorit. Prej atij momenti dhe tutje, debitori dhe menaxheri i tij vazhdojnë me zbatimin e planit të riorganizimit.

Në rastin kur debitori shkel planin e riorganizimit, çdo kreditor ka të drejtë që ta njoftojë gjykatën për këtë shkelje. Nëse gjykata konstaton se ka ndodhur shkelje e planit, atëherë ajo nxjerr vendim për evitimin e shkeljes, për shndërrimin e rastit në likuidim, i lejon debitorit të paraqes amendamente të planit (ku kërkohet miratimi i tij nga kreditorët), apo ndonjë vendim tjetër konform me këtë ligj.

LIKUIDIMI

Likuidimi është shitja e tërë pasurisë së falimentimit nga ana e administratorit. Të gjitha të ardhurat nga shitja e pasurisë bëhen pronë e pasurisë së falimentimit (pasuria e falimentos). Kjo pasuri financiare pastaj përdoret për tu paguar detyrimet e debitorit ndaj kreditorëve, sipas prioriteteve të përcaktuara me ligj, që janë:

- kërkesat e siguruara, pa shpenzimet e arsyeshme të shitjes, konform ligjit
- kërkesat prioritare, duke përfshirë:
- shpenzimet gjyqësore,
- shpenzimet e administratorit,
- shpërblimin i administratorit,
- shpenzimet e administratorit për mirëmbajtjen e pasurisë,
- shpenzimet e riorganizimit,
- financimet e riorganizimit,
- pagesat dhe shpenzimet e personelit gjatë kohës së administrimit të rastit,
- shpenzimet e bordit të kreditorëve,

- kërkesat e preferuara për nënpunësit e pa paguar,
- kërkesat e pasiguruara,
- kërkesat e pronarëve të debitorit, aksionarëve, anëtarëve themelues, pjesëmarrësve.

Në çdo kategori, kërkesat e siguruara do të përmbushen në pajtim me prioritet e tyre në bazë të ligjit.

Në likuidim, pas mbylljes së rastit, debitori në pikëpamje ligjore do të konsiderohet i shpërbërë. Gjykata do të nxjerrë një vendim për mbylljen e rastit dhe përfundimin, jo më vonë se (5) pesë ditë pas mbylljes së rastit. Gjykata poashtu mund të nxjerrë vendim për heqjen e emrit të kompanisë së shpërbërë nga regjistri aktiv i bizneseve.

Në rastin e riorganizimit, pas mbylljes së rastit, debitori do të konsiderohet financiarisht i rimëkëmbur dhe mund të vazhdojë veprimtarinë biznesore pa kufizim të mëtejme apo mbikëqyrje.

PUNËT BANKARE RREGULLAT E PËRGJITHSHME TË PUNËVE BANKARE

Punët bankare janë punë të atilla ligjore të cilat për objekt kanë qarkullimin e parave dhe të letrave me vlerë, si dhe shërbimet e caktuara të cilat i kryejnë bankat për klientët e tyre lidhur me pagesat (qarkullimin e parave) dhe të letrave me vlerë. Në lidhje me pagesat bankat i kryejnë punët e ndryshme bankare, nga të cilat disa janë me origjinë shumë të vjetër, ndërsa të tjerat janë relativisht të kohëve të fundit. Edhe punët bankare klasike me zhvillimin e ekonomisë bashkëkohore dhe me pë modifikime të caktuara. Përveç kësaj zhvillohen edhe të ashtuquajturat punë parabankare, si dhe llojet e specializuara të punëve të cilat i kryejnë bankat në të ashtuquajturin treg financiar. Afarizmi bankar është veprimtari i veçantë ekonomike, i cili përveç qarkullimit të parave përmban edhe disa transaksione dhe produkte tjera financiare. Në përgjithësi, bankat dhe institucionet financiare lehtësojnë veprimet afariste dhe shpesh ndodh që bankat dhe institucionet financiare lehtësojnë veprimet afariste dhe shpesh ndodh që bankat të specializohen për çështje specifike financiare që kërkohen nga tregu.

Llojet-

- Punët bankare në teorinë juridike klasifikohen në: aktive, pasive dhe neutrale, duke u nisur nga kriteret e funksionit të bankës në punën e caktuar.
- Si punë aktive bankare konsiderohen ato punë tek të cilat banka paraqitet si kreditor i klientit të saj (format e ndryshme të kontratave për kredi),
- Si punë pasive bankare konsiderohen punët tek të cilat banka paraqitet si debitor i klientit të saj (depozitat e kursimit, llogaritë rrjedhëse etj). Së fundi:
- Punë neutrale bankare konsiderohen ato punë bankare tek të cilat banka nuk paraqitet si kreditor as si debitor i klientit të saj, por kryen punë të caktuara të pagesave si përfaqësues, komisionar ose ndërmjetësues i klientit (akreditues, garantues etj).

Depozitat bankare.- Janë punë të atilla bankare tek të cilat klienti deponon te banka mjete financiare ose sende të tjera (depozit monetar),

Punët e kredisë.- Janë punë të atilla të cilat banka i lë në dispozicion klientit mjete të caktuara monetare (forma të ndryshme të kontratave për kredi).

Punët shërbyese bankare.- Janë punë të atilla tek të cilat banka, sipas urdhërit të klientit të saj, i kryen shërbime të caktuara personit të tretë (akreditiv, garanci bankare, dhënie e letrave me vlerë, pagesa, inkasimi dokumentar, si dhe punë të tjera shërbyese që kanë të bëjnë me paratë dhe letrat me vlerë).

Përgjegjësia e bankës nga punët të cilat i kontraktton me klientët e vet janë të natyrës kontraktuale dhe u nënshtrohet rregullave të përgjithshme të përgjegjësive kontraktuale dhe të lirimit nga përgjegjësia (sipas ligjit ose në bazë të klauzolës kontraktuale, përveç në rast të qëllimit apo të neglizhencës së madhe dhe ndonjëherë të neglizhencës së zakonshme). Nga ana tjetër, përgjegjësia e bankës ndaj personave të tretë është e natyrës së deliktit. Përgjegjësia profesionale e bankës në teorinë juridike shpjegohet me idenë e rrezikut ose me “ misionin e shërbimit publik” të saj.

Kushtet dhe procedura për licencimin e institucioneve financiare dhe siguruese

Asnjë institucion financiar apo sigurues nuk mund të ketë veprim afarist në Republikën e Kosovës pa u licencuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës. Për të aplikuar për licencë preliminare, aplikanti duhet të dorzojë:

- kualifikimet dhe përvojën e anëtarëve administrues;
- shumën e kapitalit;
- planin e biznesit;
- informatat bazike dhe të dhënat financiare për aksionarët;
- informatat shtesë që aplikanti i konsideron të rëndësishme.
-

Për institucionet e huaja, që nuk dëshirojnë të licencohen në Republikën e Kosovës, ka kushte tjera të cilat aplikohen për licencim.

Forma dhe struktura korporative e bankave dhe institucioneve financiare:

Forma dhe struktura korporative e bankave dhe institucioneve financiare është si Shoqëri Aksionare. Pra, bankat mund të regjistrohen dhe të licencohen vetëm nëse organizohen sikur shoqëri aksionare.

Forma dhe struktura korporative e ndërmarrjeve siguruese:

Forma dhe struktura korporative e ndërmarrjeve siguruese është si shoqëri aksionare anonime. Ndërmjetësuesit e shitjes së ndërmarrjeve siguruese mund të jenë edhe forma tjera të shoqërive tregtare të njohura nga Ligji për Shoqëritë Tregtare.

Kompetencat dhe instrumentet e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka kompetenca:

- të rekomandojë udhëzime të gjera politike Kuvendit dhe Qeverisë në fushat që i ka në përgjëgjasi;
- të vendos dhe të zbatojë masat për sistemet e marrëveshjeve mbi transaksionet e valutave vendore dhe të huaja në Kosovë, të mbikëqyrë dhe të rregulojë pagesat;
- të posedojë dhe të veprojë me një apo më shumë sisteme pagesash;
- të veprojë si bankar në Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe të ofrojë këshilla financiare me kërkesë të kësaj Ministrie;
- të veprojë si agjent fiskal i Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
- të mbajë depozita të valutave të huaja për Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave dhe subjektet tjera publike;
- të sigurojë furnizim adekuat të bankënotave dhe monedhave për rregullimin e transaksioneve me para të gatshme;
- të mbajë thesar për ruajtjen e sigurt të valutave dhe letrave me vlerë;
- të licencojë, të mbikëqyrë dhe të rregullojë institucionet financiare;
- të kryejë analiza të rregullta ekonomike dhe monetare të ekonomisë së Kosovës, të bëjë publike rezultatet dhe t'i paraqes propozime e masa Kuvendit dhe Qeverisë në bazë të analizave të tilla;
- të mbikëqyrë dhe të rregullojë agjentët e shitjes në këmbimin e valutave, ndërmjetësuesit e ujdisë dhe fondet e ndërsjella;
- të miratojë auditorët e jashtëm të institucioneve financiare;
- të vendosë standarde të kontabilitetit për institucione financiare në Kosovë në harmoni me standardet ndërkombëtare financiare të raportimit.

Transaksionet e pagesave.- Funkcionet kryesore të bankave kanë të bëjë pikërisht me transaksionet e pagesave. Ka disa lloje të transaksioneve që janë të ofruara për nevojat e ndryshme të klientëve dhe rrethanave të afarizmit, disa prej tyre janë:

Urdhërpagesat.- Urdhërpagesa është një instrument financiar në të cilin një person paguan një shumë të caktuar në bankë në të mirë të një përfituesi tjetër. Kjo procedurë zëvendëson pagesën e drejtperdrejtë të personit përfitues dhe banka shfrytëzohet si ndërmejtësues. Me rastin e pagesës, banka i lëshon paguesit urdhërpagesën.

KONTRATA E KREDISË

Me kontratën e kredisë banka detyrohet që shfrytëzuesit të kredisë t'ia lërë në dispozicion një shumë të caktuar të të hollave në kohë të caktuar ose të pa caktuar, me destinim ose pa destinim të caktuar. Në këtë rast shfrytëzuesi-kreditmarrësi duhet t'ia paguajë bankës kamatën e kontraktuar, shumën e marrë t'ia kthejë bankës në kohën dhe mënyrën e përcaktuar në kontratë. Kur nënshkruhet kontrata, banka është e detyruar t'ia transferojë shfrytëzuesit shumën e të hollave të parapara me kontratë me pritjen se shfrytëzuesi do t'i kthejë ato në kohën dhe metodën e përcaktuar me kontratë.

Në anën tjetër, *kontrata për debit* është një kontratë ku klienti deponon një shumë të hollash në xhirollogari rrjedhëse në bankë dhe tërheq të holla nga bankomatët, apo ngarkon atë xhirollogari në vende të ndryshme afariste, nëpërmes një karteje të lëshuar nga banka. Ngarkesa lejohet deri në shumën e deponuar në xhirollogarinë bankare. Pra, kjo zëvendëson bartjen e të hollave nga klienti dhe zëvendëson ato me një kartelë të lëshuar dhe të autorizuar për përdorim nga banka.

Përgjegjësia juridike e bankave

Bankat dhe institucionet financiare që ofrojnë produkte financiare në tregun e Kosovës duhet t'i përbahen ligjeve dhe akteve nënligjore që janë në fuqi në Kosovë. Përveç kësaj, mund të ndodh që bankat e huaja që veprojnë në Kosovë të kenë detyrime ligjore që t'i zbatojnë edhe ligjet e vendeve amë ku janë të regjistruara. Prandaj, çdo bankë që vepron në Kosovë, duhet të ketë parasysh kornizën e plotë ligjore vendore dhe ndërkombëtare me qëllim që të evitojë ndonjë përgjegjësi të pa dëshirueshme.

Letrat me vlerë

Letrat me vlerë janë dokumente të shkruara, me lëshimin e të cilave krijohet detyrimi me shprehje të njëanshme të vullnetit, pra, letra me vlerë është dokument i shkruar, me të cilin poseduesi i saj detyrohet ta plotësojë detyrimin e regjistruar në atë dokument të poseduesit ligjor të saj. Poseduesi ligjor i letrës me vlerë ka të drejtë të kërkojë prej lëshuesit të saj të përmbush detyrimin e shënuar në atë letër me vlerë. Ekzistojnë letra me vlerë veç e veç (kambiali) dhe serik (aksioni). Letrat me vlerë mund të lëshohen nga personat juridikë (aksionet) dhe fizikë (çeku).

Kontrata për depozitën e të hollave

Kontrata për depozitën e të hollave është një kontratë e thjeshtë në mes të bankës dhe klientit, që mund të jetë fizik apo juridik, me anë të së cilës banka garanton ruajtjen e të hollave për klientin, siç është kamata, kamata më e lartë për afatizimin, etj.

Me këtë kontratë banka e fiton të drejtën të disponojë të hollat e depozituara, ndërsa klienti rezervon të drejtën që të tërheq të hollat e deponuara.

Kontrata për akreditivin

Akreditivi është një instrument pagese, me të cilin banka akredituese (banka e lëshimit) detyrohet që, sipas urdhërit të komitentit, në bazë të dokumentave të perezantuara në përputhje me kushtet e kontraktuara (apo pa dokumnta), ta kryejë pagesën ose ta autorizojë bankën tjetër (bankën korresponduese) që t'ia bëjë pagesën personit të tretë (shfrytëzuesit të akreditivit) ose me urdhërin e saj (kalimi i urdhërit) ose sipas urdhërit të komitentit, vetë ajo ose me ndihmën e bankës tjetër, të paguajë, akceptojë ose ta blejë kambialin e tërhequr prej shfrytëzuesit të akreditivit, me kusht që të jetë vepruar në përputhje me akreditivin e hapur të bankës së lëshimit.

Ka disa lloje të akreditivit dokumentar:

- akreditivi i revokuar dhe ai i parevokuar,
- akreditivi i konfirmuar dhe i pakonfirmuar,
- akreditivi i kalueshëm dhe i pakalueshëm
- akreditivi i ndashëm dhe i pandashëm.

Kontrata për sigurim

Kjo kontratë lidhet në mes të kompanisë të sigurimeve dhe të sigurusarit si kontraktues i sigurimit. Me këtë kontratë kontraktuesi i sigurimit detyrohet që në bazë të parimit të reciprocitetit dhe të solidaritetit, të bashkojë një sasi të mjeteve në bashkësitë e sigurimit, kurse bashkësia e sigurimit detyrohet që, nëse ndodh ngjarja që përbën rasti i sigurimit, t'ia paguajë të siguruarit ose ndonjë personi tjetër kompensimin ose shumën e kontraktuar ose të bëjë diç tjetër.

Polica e sigurimit

Është provë për lidhjen e kontratës së sigurimit dhe ajo i përmban të gjitha elementet e kontratës.

- palët kontraktuese,
- sendin apo personin e siguruar
- rrezikun e përfshirë me sigurinë
- kohëzgjatjen e sigurimit dhe afatet e mbulesës
- shumën e sigurimit
- preminë, datën e lëshimit dhe nëshshkrimin e palëve.

Kontrata e sigurimit është kontratë formale sipas qasjes, e dyanshme me ngarkim. Ajo konsiderohet e lidhur kur palët nënshkruajnë policën e sigurimit ose fletëmbulesën e sigurimit dhe ajo paraqet dëshmi për lidhjen e kontratës.

Të siguruarit janë të detyruar: ta bëjë pagesën e premisë brenda afatit të parashikuar në kontratë, t'i paraqesin rrethanat për vlerësimin e rrezikut, të marrin masa, sa është e mundur, për të penguar shkaktimin e dëmit, ta lajmërojnë siguresin brenda një afati sa më të shkurtër për ndodhjen e rastit të siguruar.

Të siguruarit janë të detyruar: ta njoftojnë të siguruarin për kushtet e sigurimit, t'ia dorëzojnë atij policën e sigurimit, t'ia kompensojnë dëmin kur ndodh rasti i siguruar, të bëjnë pagesën e shpenzimeve të detyrueshme dhe të domosdoshme.

Sigurimi pa Policë- Me kushtet e sigurimit mund të parashikohen rastet nën të cilat marrëdhëniet kontraktuese nga sigurimi lind nga vet pagimi i primisë.

Kontrata për faktoring

Kontrata për faktoring paraqet transaksion të atillë ligjor në të cilin faktori e blen kërkesën e klientit me zbritje (në maturim ose para maturimit) me ose pa të drejtën e regresit të faktorit të shitësit të kërkesës-factoring i vërtetë, apo i punës ligjore me të cilën ceduesi i kërkesës e obligon që të transferojë në faktorët ekzekutues apo në kërkesat e ardhshme për ta paguar, kurse faktori obligohet që përmes provizionit dhe pagesës së shpenzimeve të bëjë pagesat e kërkesave (dhe eventualisht të garantojë për pagesën e klientit-factoring i vërtetë, në të dy rastet, varësisht nga kontrata, faktori mund të kryejë edhe shërbime të tjera të faktoringut. Te faktoringu i parë mungon funksioni garantues i faktoringut, sepse kërkesa përfundimisht është blerë, kurse nga ana tjetër, në bazë të dispozitave të veçanta në kontratë, transferuesi (shitësi) i kërkesës (klienti) mund t'i garantojë faktorit pagesën e kërkesës nga debitori (të drejtën e regresit të faktorit nga klienti).

Kjo kontratë paraqet një punë të atillë kredituese-bankare me të cilën klienti i bankës obligohet t'i bart në bankë kërkesat ekzekutuese ose kërkesat e ardhme që i përmban kontrata për shitjen e mallit, respektivisht të kryejë shërbime që lidhen me blerësin, përkatësisht shfrytëzuesin e shërbimeve, kurse për këtë banka obligohet që me provizion dhe me kompensim të shërbimeve të arkëtojë kërkesat dhe eventualisht të garantojë arkëtimin, si dhe të kreditojë klientin.

Faktori (banka) mund t'i ofrojë klientit të tij shërbime të tjera përkatëse, siç janë: marketingu, hulumtimi i bonitetit të partnerëve potencialë të komitentit, udhëheqja e kontabilitetit, drejtimi i kontesteve e të tjera.

Në bazë të kontratës të faktoringut, komitenti detyrohet të bartë në bankë të gjitha kërkesat e veta të cilat i ka ndaj partnerëve në një rajon të caktuar në momentin e lidhjes së kontratës dhe të cilat krijohen gjatë kohës sa zgjatë ajo. Në këtë mënyrë, banka merr rolin e kreditorit sipas atyre kërkesave për t'i relizuar ato ndaj debitorëve të komitentit.

Komitenti ka të drejtë të kërkojë nga banka që prej vlerës së kërkesave të kaluara të paguajë një përqindje të caktuar-diskontin (kamatat e paarritura, shpenzimet e veta dhe provizionet) në momentin e cedimit të kërkesës me çka banka e kreditorin komintenin e vet. Kontrata lidhet zykonisht me afat të gjatë, por ajo ka të bëjë me kërkesa të shkurta të arritjes-deri në 6 muaj. Kreditimi bëhet me plasimin e mallit.

Kontrata për forfeting

Kontrata për forfeting është një transakcion ligjor në të cilën forfetingieri blen nga komitenti i vet kërkesën e paarritur të kredisë, me zbritje të caktuar që e ngarkon komitentin (klientin) dhe me mohimin e asaj të drejte për regres, sipas shitësit të kërkesës së atillë (komitentit-klientit) nëse kjo kërkesë mbetet e pa paguar nga pala e tretë. Prandaj, kontrata për forfeting, për nga natyra e vet ligjore, përfaqëson kontratën e përzier, e cila me vete përfshin një numër kontratash tjera, para së gjithash kontratën për shitje (blerësi merr kërkesën dhe me të mund të disponojë më tutje lirisht, kurse përgjegjësia e shitësit për pagesën e kërkesës është e përjashtuar) dhe kontrata për kredi (koha nga shitja e kërkesës deri te maturimi i saj).

Kontrata e forfetingut është punë bankare tek e cila banka (forfëtuesi) e blen nga komitenti i saj kërkesën e pa arritur në të holla, me një diskont të caktuar, në të cilën ngarkohet ai dhe heq dorë nga regresi ndaj shitësit të një kërkesë të tillë, nëse kjo kërkesë mbetet e pa ralizuar nga personi i tretë.

Palët kontraktuese në këtë kontratë janë bankat dhe komitenti i saj. Kjo kontratë përdoret sidomos në afarizmin ndërkombëtar ekonomik, si punë në të cilën marrin pjesë eksportuesi, si komitetni, banka e tij dhe importuesi, si dhe debitori i eksportuesit. Në këtë marrëdhënie të forfetingut nuk mund të marrë pjesë edhe banka e importuesit, e cila quhet banka korresponduese.

Forfetingu ka të bëjë me kërkesat që arrijnë për një afat më të gjatë mbi 6 muaj në punët ekonomike me afat të gjatë, p.sh. livrimi i pajimeve industriale, kryerja e punimeve investuese në botën e jashtme etj. Pra, karakteristikë e kësaj kontrate është se komitenti detyrohet t'ia bart bankës kërkesën e caktuar, kurse banka detyrohet ta marrë dhe ta blejë kërkesën prej komitentit, duke e ulur vlerën e kërkesës për aq sa është diskonti i kontraktuar. Banka merr përsipër rrezikun në rast të mos realizimit të kërkesës dhe për këtë nuk ka të drejtën e kompensimit nga komitenti.

KONKURRENCA NË TREG

Konkurrenca është një situatë në një treg në të cilën shitësit e një produkti apo shërbimi përpiqen në mënyrë të pavarur të tërheqin blerës për të arritur një objektiv të caktuar tregtar, për shembull, fitime shitje dhe/ose pjesë të tregut. Rivaliteti konkurrues midis firmave mund të ekzistojë për çmimet, shërbimet, cilësinë, ose një kombinim i tyre dhe faktorëve të tjerë, që mund të vlerësojnë klientët.

Në disa raste konkurreca ka për qëllim uljen e çmimi me qëllim që të godasë konkurrentët. Në raste të tjera ndërmarrjet mund të shkojnë përtej përcaktimit të tregut, konkurrenca shihet si një proces rivaliteti ndërmjet ndërmarrjeve të cilat kërkojnë të fitojnë klientelë me kalimin e kohës. Ky rivalitet mund të ndodhë në shumë mënyra të kësaj, duke përdorur aftësitë novatore e sipërmarrëse të tyre, për të zhvilluar produkte dhe shërbime të reja, të përdor fuqi të veçanta, mundësi apo përparësi të tjera që ato kanë, me synim kryesor që të plotësojnë nevojat e konsumatorëve më shumë se sa konkurrentët e tyre.

Konkurrenca e ndershme dhe e pashtrembëruar është gurëthemeli i një ekonomie tregu. Për këtë arsye, Komisioni Evropian (mekanizëm i BE) ka miratuar legjislacion përkatës për të promovuar një konkurrencë lojale në mes të shteteve anëtare të BE-së. Konkurrenca njihet si një ndër shtyllat kryesore dhe çështjet më sensitive në politikat e BE-së. Para se të anëtarësohen në BE, të gjitha shtetet duhet të plotësojnë një numër të madh kriteresh që kanë të bëjnë me ekonominë e tregut, prej të cilave shumica janë të ndërlidhura me konkurrencën. Për më tepër, Komisionit Evropian iu kanë dhënë kompetencat e nevojshme për të ushtruar kontroll mbikëqyrës dhe zbatues në lidhje me ligjin e BE-së për konkurrencën, për të garantuar një konkurrencë efektive në tregun e brendshëm të shteteve evropiane.

Në vazhdim të përpjekjeve për të miratuar legjislacion në përputhje me kriteret e BE-së, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Konkurrencën.

Marrëveshjet e ndaluara te përjashtimet

Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve, vendimi i një shoqate të ndërmarrjeve ose një praktike të ndërmarrjeve është e ndaluar nëse mund të ndikojë në tregtinë brenda Kosovës dhe mund të ndikojë në mënyrë të dukshme në parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konkurrencës në Kosovë.

Ndalesat e vendosura në mënyrë specifike zbatohen për një marrëveshje, vendim ose praktikë që:

- në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë përcakton çmimin shitës ose blerës ose çfarëdo afati apo kushti tjetër në tregti ose biznes;
- kufizon ose kontrollon prodhimin, tregun, zhvillimin teknologjik ose investimet;
- kufizon, ndan ose merr pjesë në tregun ose në një apo më shumë burime të furnizimit;
- zbaton kushte të ndryshme për transaksione të ngjashme me ndërmarrje të tjera, duke i vendosur ato në një pozitë të papëlqyeshme konkurruese;
- kushtëzon që lidhja e kontratës të varet nga palët tjera kontraktuese, përmes kushteve të tjera plotësuese që për nga natyra e tij/saj e që sipas natyrës dhe praktikës së zakonshme tregtare, nuk kanë lidhshmëri me objektin e kontratës së tillë.

Marrëveshja ose vendimi që është i ndaluar me këto rregulla është e pavleshme dhe e pazbatueshme. Personi, ndërmarrja ose shoqata e ndërmarrjeve që tenton të ekzekutojë, detyrojë dhe/ose ushtrojë marrëveshjen, vendimin ose praktikën në fjalë, do të dënohet me gjoba administrative dhe penale që përcaktohen me këtë ligj.

Përjashtimet dhe lirimet.- Ndalimet e lartpërmendura nuk zbatohen për disa marrëveshje të veçanta. Këtu në radhë të parë përfshihet:

- një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjeve, nëse ndërmarrjet e tilla janë pjesë e një njësie të vetme ekonomike. Në veçanti, marrëveshjet ndërmjet ndërmarrjes amë dhe degëve të saj, ose degëve që kanë një ndërmarrje të përbashkët, nuk u nënshtrohen; ose

- një marrëveshje që ka për qëllim të ndikojë në shkrirjen e dy ndërmarrjeve; me kusht që ky përjashtim të vlejë vetëm për dispozitat e asaj marrëveshjeje që është drejtëpërdrejt e lidhur dhe e nevojshme për kryerjen e shkrirjes.

Gjithashtu, ekzistojnë përjashtime nga ndalesa, përkastësisht përjashtohen marrëveshjet mbi:

- a) *zbatimin e njëllojshëm të standardeve ose kushteve biznesore;*
- b) *specializmin;*
- c) *racionalizmin;*
- d) *disa raste tjera specifike të caktuara.*

Marrëveshjet vertikale

Ndalimi themelor në marrëveshjet që kufizojnë lirinë e palëve për caktimin e çmimeve dhe kushteve në transaksionet me palët e treta: Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve lidhur me mallrat ose shërbimet dhe që ndikon në një treg brenda Kosovës është e ndaluar për aq sa ajo e kufizon lirinë e palës për vendosjen e çmimeve në ngarkim të palëve të treta ose çfarëdo kushti thelbësor në marrëveshjet e lidhura me palët e treta.

Kontrollimi i shpërdorimit të transaksioneve ekskluzive tregtare.- Marrëveshja ndërmjet ndërmarrjeve që përfshin mallrat ose shërbimet dhe që vendos mbi njërën palë një kufizim të lirisë së shfrytëzimit të mallrave të furnizuara ose të mallrave ose shërbimeve tjera; një kufizim të lirisë së blerjes ose shitjes së mallrave dhe shërbimeve të tjera për palët e treta; një kufizim mbi lirinë e shitjes së mallrave të furnizuara palëve të treta; ose një obligim për blerjen e mallrave ose shërbimeve që nga karakteri i tyre ose praktika e zakonshme komerciale, nuk kanë të bëjnë me lëndën themelore të marrëveshjes në një fjalë, ndalohen nëse kufizimet ose obligimet e tilla dukshëm e dëmtojnë tregun e mallrave ose shërbimeve përkatëse.

Marrëveshjet mbi pronën intelektuale dhe sekretin afarist

Marrëveshja mbi shitjen ose licencimin e të drejtave të pronës intelektuale apo sekretit afarist ndalohet gjer në atë masë sa vendos kufizime ndaj veprimtarive ekonomike të blerësit ose licencëmarrësit që nuk kanë të bëjnë me shfrytëzimin ose mbrojtjen e të drejtave përkatëse apo sekretet.

Në këtë kategori hyjnë:

- marrëveshjet për shitjen ose licencimin e patentës ose modelit praktik (qoftë të dhënë ose të kërkuar) ose topografinë e qarkut të mbyllur të mbrojtur me ligj ose modifikimet gjenetike të farës;
- marrëveshjet për shitjen ose licencimin e zbulimeve, metodave të përpunimit, projekteve, arritjeve tjera që çojnë përpara teknologjinë e arritjeve që çojnë përpara kultivimin e bimëve në lëmin e rritjes së bimëve, për atë sa ato përfaqësojnë

sekrete të rëndësishme afariste dhe janë njëjtësuar në mënyrë mjaft të arsyeshme në marrëveshje;

- marrëveshjet e përziera për shitjen ose licencimin e të dyjave, të drejtës së mbrojtur të sipërthekësuar; dhe
- marrëveshjet për shitjen ose licencimin e të drejtave të pronës intelektuale, siç janë markat tregtare, modelet e depozituara, të drejtat autoriale (përfshirë programet kompjuterike), për aq sa kjo marrëveshje lidhet me marrëveshjen për të drejtën e mbrojtur, ose një arritje e pambrojtur apo një marrëveshje e përzier dhe ndihmon për arritjen e qëllimit kryesor të shitjes ose licencimit të të drejtave të pronës intelektuale ose arritjeve të pambrojtura.

Keqpërdorimi i pozitës dominuese

Sipas ligjit në Kosovë, ndalohet shpërdorimi i pozitës dominuese nga një apo më shumë ndërmarrje. Për të konstatuar shpërdorimin e pozitës dominuese, së pari duhet të përcaktohet ekzistimi i kësaj pozite.

Konstatimi i ekzekutimit të pozitës dominante

Ndërmarrja ka pozitë dominuese nëse, si furnizues ose blerëse e disa llojeve të caktuara të mallrave ose shërbimeve, ajo:

- nuk i nënshtrohet konkurrencës së vërtetë; ose
- ka fuqi superiore në treg në krahasim me konkurrentët e saj ekzistues ose potencialë.

Për të konstatuar këtë, merret parasysh veçanarisht pjesëmarrja dhe pozita e saj në tregun përkatës, fuqia e saj financiare, qasja e saj ndaj furnizimeve ose tregjeve, lidhjet e saj me ndërmarrjet e tjera, pengesat juridike ose faktike për hyrjen e ndërmarrjeve të tjera në treg, konkurrenca aktuale ose potenciale me ndërmarrjet e themeluara brenda ose jashtë Kosovës, lehtësia ose vështirësia me të cilën ajo mund të ndryshojë furnizimin e mallrave ose shërbimeve të tjera, si dhe aftësia e furnizuesve ose klientëve të saj që të zhvillojnë afarizëm me ndërmarrje të tjera.

Një ndërmarrje konsiderohet të ketë pozitë dominuese nëse ka pjesëmarrje me të madhe se 40% në treg. Ky konsiderim nuk është i aplikueshëm në rast se ndërmarrja në fjalë bindshëm demonstroi se është e ekspozuar para një konkurrence të konsiderueshme ose që nuk ka pozitë superiore në treg në krahasim me konkurrentët e vet, duke i marrë parasysh faktorët e specifikuar më lart.

Konstatimi i shpërdorimit të pozitës dominuese.- Shpërdorimi i ndaluar i pozitës dominuese ekziston nëse, si furnizues ose blerës i disa llojeve të caktuara të mallrave ose shërbimeve, një ose më shumë ndërmarrje me pozitë dominuese:

- a) *ndikojnë negativisht në konkurrencën e tregut, duke dëmtuar aftësinë e ndërmarrjeve tjera për konkurrim në treg;*

- b) *kërkojnë pagesa ose kushte të tjera afariste, që dallojnë nga ato që do të mbizotëronin po të kishte konkurrencë efektive;*
- c) *shfrytëzojnë pozitën në treg për të krijuar ndërmarrje tjera që i dhurojnë atij qëllime privilegjuese, përveç nëse qëllimi është i arsyeshëm për një trajtim të tillë favorizues.*

Praktikat e ndaluara

Ndalimi i diskriminimit dhe i pengimit të padrejtë.- Një ndërmarrje dominuese, një shoqëri e ndërmarrjeve ose një ndërmarrje që i cakton çmimet me pakicë, nuk duhet ta pengojë drejtëpërsëdrejt apo tërthorazi një ndërmarrje tjetër në aktivitetet e saja afariste, ose drejtëpërsëdrejt apo tërthorzi ta trajtojë atë ndryshe nga ndërmarrjet tjera të ngjashme, përveç nëse ekziston arsytimi objektiv për trajtimin e tillë. Një pengim i tillë ekziston kur në ndërmarrje, pa arsye objektive, shpesh ofron mallra ose shërbime me çmimin i një malli apo shërbimi të tillë.

Ndalimi i bojkotimeve dhe praktikave të tjera kufizuese.- Asnjë person ose ndërmarrje nuk duhet të kërkojë nga një person ose ndërmarrje tjetër që të refuzojë e (bojkotojë) shitjen ose blerjen, me qëllim të dëmtimit të një personi ose ndërmarrje tjetër. Ligji gjithashtu ndalon personat apo ndërmarrjet që të kërcënojnë apo t'i shkaktajnë dëme personave ose ndërmarrjeve të tjera, ose të nxisin ato që të zhvillojnë aktivitete të ndaluara me ligj.

Ndalimi i rekomandimeve.- Asnjë ndërmarrje ose shoqatë e ndërmarrjeve nuk duhet të bëjë rekomandime që kanë për qëllim të ndikojnë në shmangien e një ndalimi të vendosur nga ligji. Gjithashtu, nuk duhet tu bëjë rekomandime blerësve të mallrave për të kërkuar ose ofruar çmime të caktuara gjatë rishitjes palëve të treta, për përdorimin e metodave të caktuara të vendosjes së çmimeve, ose të ruajtjes së çmimeve më të larta ose më të ulëta.

Sanksionet juridike.-

Nëse konstatohet se ka pasur shkelje të Ligjit për Konkurrencën, atëherë, ekzistojnë pasojat juridike për personin i cili e ka bërë atë shkelje.

Komisioni Kosovar i Konkurrencës, për shkeljen e ligjit, mund të nxjerr urdhër që kërkon:

- përmbytjen nga ekzekutimi, zbatimi dhe/ose kryerja e marrvëshjes;
- shpalljen e marrvëshjes të pavlerë, të shfuqizuar dhe të pazbatueshme;
- nga individit shkelës ndërmarrjen e masave të nevojshme për të siguruar eliminim e veprimeve antikonkurrenente, p.sh. që shkelja të mos përsëritet më;
- të shpall gjoba mbi pronarët, zyrtarët ose menaxherët e përfshirë në aktin antikonkurrent;

- të shpall gjoba mbi ndërmarrjen e përfshirë në aktin antikonkurrent
- përmbajtjen nga sjeljet e tilla ;
- të kërkojë nga ndërmarrja shkelëse marrjen e masave të nevojshme për të siguruar eliminim e veprimeve antikonkurrente dhe që shkelja të mos përsëritet më;
- të shpallë gjoba mbi pronarët, zyrtarët ose menaxherët e përfshirë në aktin e sjelljes shkelëse;
- të shpall gjobë mbi ndërmarrjen e përfshirë në aktin e sjelljes shkelëse.

Natyrisht, personat e dëmtuar nga ana e personit apo ndërmarrjes që shkel këtë ligj kanë të drejtë të parashtimit të ankesës në gjykatën përkatëse, duke kërkuar ndër të tjera kompensim të dëmit dhe ndërprerje të aktivitetit të ndaluar.

INVESTIMET E HUAJA

Mjedisi i favorshëm ligjor për ekonominë e tregut, liria e aktivitetit ekonomik dhe siguria e pronës garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Për të gjithë investitorët, si të jashtëm ashtu edhe ata të brendshëm, parashikohen garancione kushtetuese sa i përket të drejtave ligjore të barabarta. Në mënyrë specifike, Kushtetuta parasheh se investitorëve të jashtëm u garantohet nxjerrja e lirshme e fitimit dhe kapitalit të investuar jashtë vendit, në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm.

Kushtetuta e Kosovës paraqet një bazament për sigurimin e kornizës ligjore e cila ndihmon dhe inkurajon investimet e huaja, legjislacioni bazë, në fakt, është miratuar vite më parë, pikërisht për shkak të rëndësisë së ofrimit të mbrojtjes ligjore për ata investitorë të huaj që janë të interesuar të investojnë në Kosovë. Investitorëve para së gjithash u intereson të investojnë në një vend ku sundon ligji, ku të drejtat pronësore janë të garantuara dhe natyrisht, ku u ofrohet trajtim i barabartë.

Përmes miratimit të Ligjit për Investimet e Huaja pranohet fakti se investimet e huaja luajnë një lojë të rëndësishme në zhvillimin e mirëfilltë ekonomik dhe mirëqenien e përgjithëshme ekonomike të Kosovës dhe, në të njëjtën kohë, paraqiten këto tri synime kryesore të ligjit:

- 1) Të mundësojë integrimin e plotë të Kosovës në ekonominë regionale, evropiane dhe botërore, duke inkurajuar bartjen e kapitalit, teknologjisë moderne, njohurisë (knoëhoë), shërbimeve financiare dhe intelektuale, aftësive menaxhuese dhe informative në Kosovë;
- 2) Të përmirësojë dhe të zgjerojë kapacitetin e Kosovës për të pranuar dhe dërguar mallra, shërbime dhe kapital në tregjet e huaja; dhe
- 3) Të ngrisë parashikueshmërinë, stabilitetin dhe transparencën e sistemit ligjor në Kosovë dhe paluajtshmërinë e tij me standardet evropiane dhe ndërkombëtare.

Të drejtat, garancitë dhe privilegjet e investitorëve të huaj:

Trajtimi i përgjithshëm.- Kosova u ofron trajtim të drejtë dhe të barabartë investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre në Kosovë. Në asnjë rast trajtimi, mbrojtja ose siguria që kërkohet nga ligji nuk duhet të jetë më i disfavorshëm se sa ai që garantohet sipas ligjit ndërkombëtar. Ligji obligon Kosovën që të mos pengojë me anë të veprimeve ose mosveprimeve të pa arsyeshme ose diskriminuese veprimtarinë, menaxhimin, mirëmbajtjen, shfrytëzimin ose largimin e një shoqërie investuese në Kosovë, ose ndonjë investim nga investitorët e huaj në Kosovë dhe në veçanti të mos ndërhyjë në veprimtaritë e ligjshme, të drejtat dhe investimet e ligjshme të investitorëve të huaj. Të gjitha autoritete publike që dështojnë ose nuk i respektojnë të drejtat dhe garancitë e siguruar me ligj për investitorët e huaj dhe investimet e tyre, janë përgjegjës për të paguar kompensim për dëmet e shkaktuara si pasojë e veprimeve të tyre dhe asnjë lloj imuniteti ligjor nuk mund të shfrytëzohet si mbrojtje nga kjo përgjegjësi.

Mosdiskriminimi- Përveç të drejtave specifike, garancioneve dhe privilegjeve që u mundësohen investitorëve të huaj dhe investimeve të tyre, sipas ligjit, investitorët e huaj dhe investimet e tyre duhet të jenë në pajtim të plotë me ligjin e zbatueshëm në Kosovë dhe t'i bartin të drejtat dhe detyrimet njëllor si edhe investitorët e brendshëm. Pa paragjykuar marrëveshjet ndërkombëtare dhe ato bilaterale që mund t'i lidhë Kosova, është e paligjshme që të diskriminohen në çfarëdo mënyre investitorët e huaj në bazë të shtetësisë, prejardhjes, vendbanimit, bendit të themelimit, autorizimit ose kontrollit. Në mënyrë të veçantë, ligji parasheh se Kosova nuk duhet të diskriminojë investitorët e huaj në këto fusha:

- mbrojtjen dhe sigurinë,
- bërjen e investimit,
- aktivitetet ekonomike dhe të tjera në të cilat mund të bëhet investimi, dhe
- blerjen, zgjerimin, menaxhimin ose largimin e investimeve.

Përputhshmëria dhe detyrimet.-Të gjitha aktet që nxirren nga ndonjë autoritet publik, që kanë të bëjnë me të drejtat ose detyrimet e investitorëve të huaj, duhet të jenë në përputhje të plotë me autorizimet e atij autoriteti publik. Në të kundërtën, investitorët e huaj, të drejtat ose detyrimet e të cilëve janë prekur me atë akt, kanë të drejtë të kërkojnë kompensim për të gjitha dëmet e shkaktuara si pasojë e besimit në aktin ose detyrimin e tillë. Kjo e drejtë për kompensim natyrisht që nuk merret parasysh në rastet kur investitori i huaj ka qenë i njoftuar me kohë se akti në fjalë tejkalon autorizimet e autoritetit publik që e ka nxjerrë atë akt.

Të gjitha llojet e detyrimeve ndaj investitorëve të huaj, qofshin ato të krijuara me ligj, marrëveshje, akt administrativ, ose ndryshe, duhet të përmbushen në bazë të shpejtë, të vazhdueshme dhe me mirëbesim.

Stabiliteti i regjimit të investimeve.- Ligjet, rregulloret apo aktet e tjera juridike nuk mund të zbatohen në mënyrë retroaktive në dëm të investitorëve të huaj. Megjithatë, Ligji për Investimet e Huaja parasheh që nëse investitori i huaj ka bërë një investim në Kosovë dhe branda periudhës pesëvjeçare, menjëherë pas bërjes së investimit, ndonjë dispozitë e atij ligji ndryshohet ose revokohet dhe kjo ka ndikim negativ në investimet e huaj ose në investimin e tij, atëherë investitori i huaj ka të drejtë në kompensim nga Qeveria e Kosovës për të gjitha dëmet dhe shpenzimet e shkaktuara si pasojë e ndryshimit ose revokimit të tillë.

Shpenzimi dhe kompensimi.- Nacionalizimi dhe shpronësimi i pronave të investitorëve të huaj nuk mund të bëhet, përveç në raste përjashtimore të parapara me ligj, për të cilat përcaktohet kompensimi proporcional sipas vlerës në treg të pronës së caktuar.

Nacionalizimi.- Ligji përcakton se investimet në vijim nuk i nështrohen asnjë forme të nacionalizimit

- investimi i bërë në Kosovë nga një investitor i huaj,
- organizata e investimeve të huaja, ose
- asetet e investitorit të huaj, organizatës së investimeve të huaja ose një personi të huaj, qoftë apo jo i ndërlidhur me një investim në Kosovë.

Shpronësimi.- Investimet e huaja në Kosovë, organizata e investimeve të huaja dhe asetet e investitorit ose investimeve të huaja, gjithashtu nuk i nështrohen shpronësimit (eksproprijimit). Megjithatë, përkundër kësaj ndalese, Ligji përcakton se Kosova mund të eksproprijojë asetet e një investitori të huaj, organizate të huaj ose personi të huaj nëse eksproprijimi:

- bëhet për një qëllim të qartë dhe legjitim publik,
- nuk bëhet me synime diskriminimi,
- bëhet në mënyrë jo diskriminuese,
- bëhet në përputhshmëri me proceset e parashtruara me ligj dhe përcillet me një pagesë apo kompensim efektiv, adekuat dhe të menjehershëm.

Kompensimi.- Nëse iu ka shkaktuar dëmi, investitori i huaj ka të drejtë në kompensim të shpejtë dhe në valutë të konvertueshme. Kompensimi gjithashtu duhet të jetë sipas vlerës së tregut të asetit përkatës, menjëherë pasi që akti i eksproprijimit të jetë ndërmarrë, me kusht që vlera e tregut e asetit përkatës:

të rregullohet në rast të ndryshimit të vlerës së tregut si pasojë e vetë eksproprijimit, ose ndonjë njohurie paraprake ose pritje të eksproprijimit privat ose publiku, dhe

- të vendoset në bazë të një valute të konvertueshme.

Në rastet kur me ligj kërkohet që të bëhet kompensimi për dëmet dhe shpenzimet e shkaktuara nga veprimet ose mos veprimet që nuk përbëjnë një akt ekspropriimi, shuma e kompensimit në fjalë duhet të jetë e barabartë me vlerën e tregut të dëmeve dhe shpenzimeve të shkaktuara, që llogariten nga data e shkaktimit të dëmit (sipas Ligjit për Investimet e Huaja). Pagesa e të gjitha kompensimeve që kërkohen me ligj garantohet nga Qeveria e Kosovës edhe nëse veprimi që ka shkaktuar dëme ose shpenzime bëhet nga ndonjë autoritet tjetër publik në Kosovë. Nëse Qeveria e bënë këtë kompensim në emër të autoritetit tjetër publik, pastaj ka të drejtë të kërkojë kompensim nga ai autoritet përmes procedurave ligjore dhe proceseve administrative.

Zgjidhja e kontesteve lidhur me investimet e huaja.-

Mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve të investimit-

Sikur edhe në çdo kontakt, edhe në marrëveshje me mes të një investitori të huaj dhe në Kosovë mund të përcaktohet mënyra dhe procedura e zgjidhjes së kontesteve eventuale që mund të lindin. Nëse një marrëveshje e tillë ka ekzistuar dhe mund të evitohet si dokument i shkruar, investitori i huaj mund të kërkojë që mosmarrëveshja të zgjidhet sipas procedurës apo kushtit të paraparë me shkrim. Në mungesë të marrëveshjes ndërmjet palëve, investitori i huaj mund të kërkojë që kontesti të zgjidhet përmes arbitrazhit. Për më tepër, investitori i huaj mund të zgjedhë edhe rregulla procedurale të arbitrazhit që do të përdoren për zgjidhjen e kontestit. Sipas Ligjit për Investimet e Huaja, investitori mund të zgjidhë nga këto rregulla procedurale:

- Konventën e QNZKI-së (ICSID- Qendra Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve të Investimit), nëse investitori i huaj është shtetas i një vendi të huaj dhe vendi i tij dhe Kosova janë palë në konventën në fjalë në kohën e dorëzimit të kërkesës për arbitrazh,
- Rregullat Lehtësuese Shtesë të QNZKI-së, nëse kushtet juridike “ratione personae” të nenit 25 të Konventës së QNZKI-së janë përmbushur në kohën e dorëzimit të kërkesës për arbitrazh,
- Rregullat e UNCITRAL-it dhe në raste të këtylla autoriteti emëruar i përmendur në to është Sekretari i Përgjithshëm i QNZKI-së, ose
- Rregullat e Organizatës Ndërkombëtare të Tregtisë.

Pëlqimi i Kosovës për dorëzimin e një Kontesti të Investimit për arbitrazh jepet me Ligjin për Investimet e Huaja, pra nuk kërkohet pajtim eksplicit dhe marrëveshje e ndarë nga Kosova. Ndërkaq, pëlqimi i investitorit të huaj mund të jepet në çdo kohë, qoftë me dorëzimin e një kërkesë për arbitrazh ose duke i paraqitur Agjencisë një kërkesë me shkrim në të cilën jepet pëlqimi sipas (Ligjit për Investime të Huaja). Përveç nëse investitori i huaj dhe Kosova pajtohen ndryshe me shkrim, të gjitha arbitrazhet lidhur me raste të investimit duhet të mbahen në një vend anëtar të BE-së që gjithashtu është palë në Konventën e Neë York-ut për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit.

Ligji i aplikueshëm në zgjidhjen e kontesteve të investimit.- Palët zakonisht merren vesh me shkrim për rregullat procedurale dhe për ligjin që do të aplikohet nga gjykata ose tribunali i arbitrazhit për zgjidhjen e kontestit. Në rast se një marrëveshje e tillë mungon, Ligji parashih zgjidhjen e kontestit përmes gjykatës ose tribunalit sipas rregullave të së drejtës ndërkombëtare private (konfliktit të ligjit) dhe rregullave tjera të së drejtës ndërkombëtare publike që janë të zbatueshme për çështjet kontestuese (sipas Ligjit për Investimet e Huaja).

Natyra përfundimtare e vendimeve të arbitrazhit.- Të gjitha vendimet e arbitrazhit të marra në lidhje me kontestet e investimeve që mbulohen nga Ligji për Investimet të Huaja konsiderohen përfundimtare dhe obligative për palët në kontestet, duke përfshirë Kosovën. Sipas Ligjit, një vendim i tillë është i zbatueshëm në Kosovë në të njëjtën mënyrë si edhe vendimet e gjykatës më të lartë në Kosovë. Asnjë lloj i imunitetit nuk mund të shfrytëzohet si mbrojtje ndaj zbatimit të vendimit në fjalë (sipas Ligjit për Investimet e Huaja).

Marrëveshjet bilaterale për investime.- Marrëveshjet bilaterale për investime kryesisht lidhen në formë të traktateve dhe kanë për qëllim përcaktimin e kushteve për investime private të shtetasve apo kompanive të një shteti në një shtet tjetër. Ky lloj investimi njihet me emrin *Investim i huaj direkt*.

Shumica e marrëveshjeve bilaterale lidhen me qëllim të garantimit të të drejtave të investitorëve të huaj në territorin e shtetit ku ata investojnë, që kryeshtisht përfshijnë garanca si trajtimi i barabartë, mbrojtja nga eksproprijimi (shpronësimi), mekanizmat alternative për zgjidhjen e kontesteve (siç është arbitrazhi) etj.

Marrëveshjet për investime zakonisht aplikohen për të gjitha llojet e aseteve, pa marrë parasysh a janë pronë e luajtshme apo e paluajtshme dhe pa marrë parasysh sektorin e investimit. Kjo do të thotë se këtu përfshihen edhe të drejtat në pronësi intelektuale, të cilat pa marrë parasysh a janë regjistruar apo jo, janë investime të mbrojtura sipas marrëveshjeve bilaterale për investim.

Sot në botë ekzekutohen me mijëra marrëveshje bilaterale që kanë të bëjnë me fusha të ndryshme të investimeve. Kosova ka lidhur një numër marrëveshjesh për tregti të lirë me shtetet e rajonit të cilat kanë për qëllim inkurajimin e investimeve të këtyre shteteve në Kosovë.

KONCESIONET

Koncesioni nenkupton një kontratë të lidhur ndërmjet një autoriteti kontraktues dhe një koncesioneri ku objekti kryesor i kontratës është zbatimi i një projekti të infrastrukturës dhe ku përmushja e kontratës nga koncesionari shpërblehet tërësisht ose pjesërisht me dhënie të së drejtës së shfrytëzimit të infrastrukturës. Autoriteti kontraktues përfshin autoritetet publike që në bazë të ligjit në fuqi të standardeve në Kosovë, i është dhënë e drejta për të dhënë koncesione. Këtu, në radhë të parë, hyn

çdo organ publik qendror, rajonal, komunal, apo lokal, çdo ministri, departament apo agjenci që ushtron kompetenca ekzekutive, legjislativë, rregulative, administrative ose gjyqësore, çdo organ i së drejtës publike, si dhe çdo asoacion i një ose më shumë organeve të tilla.

Duke patur parasysh nevojën për harmonizimin e procedurave për dhënien e koncesioneve në pajtim me standardet dhe praktikën e pranuar ndërkombëtare, në vitin 2006 është miratuar Ligji për Procedurën e Dhënies së Koncesioneve. Ky Ligj u miratua me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të parimeve të përgjithshme të transparencës, ekonomisë dhe drejtësisë gjatë dhënies së kontratatës së koncesionit, përmbajtjen e kontratës së koncesionit si dhe çështje të tjera të ndërlidhura.

Paraseleksionimi i ofertuesve.-

Procedura e parasiteksionimit të ofertuesve është paraparë me Ligjin për Procedurën e Dhënies së Koncesioneve. Autoriteti Kontraktues zhvillon procedurën e parasiteksionimit me qëllim të identifikimit të ofertuesve të kualifikuar për zbatimin e projektit të paraparë. Ftesa për pjesëmarrje në procedurën e parasiteksionimit publikohet në pajtim me dispozitat përkatëse të ligjit për prokurim publik dhe kjo ftesë përmbanë këto të dhëna:

- a) *përshkrimin e infrastrukturës;*
- b) *një indikacion të elementeve tjera thelbësore të projektit, si p.sh. shërbimet që duhen të kryhen nga koncesioneri ose aranzhmanet financiare të parapara nga autoriteti kontraktues;*
- c) *një përmbledhje të kushteve kryesore të Kontratës së Koncesionit që do të lidhet, nëse këto kushte janë të njohura në këtë fazë;*
- d) *mënyra dhe vendi i dorëzimit të kërkesave për parasiteksionim dhe afati i dorëzimit si datë dhe kohë e specifikuar që i jep ofertuesit kohë të mjaftueshme për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës; dhe*
- e) *mënyrën dhe kohën e marrjes së dokumentacionit të para-seleksionimit.*

Dokumentacioni i parasiteksionimit duhet të plotësojë kriteret e parasiteksionimit të parapara me Ligj. Për tu kualifikuar për procedurë seleksionimi, ofertuesit e interesuar duhet të plotësojnë kritere objektivisht të arsyeshme të cilat autoriteti kontraktues i konsideron si të përshtatshme për procedurën përkatëse, siç janë të cekura në dokumentacionin e parasiteksionimit. Këto kritere përmbajnë së paku këto elemente:

- kualifikime adekuate profesionale dhe teknike, fuqi punëtore, pajisje dhe mjete tjera fizike që janë të nevojshme për zbatimin e projektit, përfshirë dizajnimin, ndërtimin, veprimin dhe mirëmbajtjen;
- aftësi të mjaftueshme për të drejtuar aspektet financiare të projektit dhe aftësi për të përmbushur nevojat e financimit ;
- aftësi të nevojshme drejtuese dhe organizative, besueshmëri dhe përovvojë, përfshirë aty edhe përovvojën në veprimin e infrastrukturave të ngajshme.

Autoriteti kontraktues merr vendim lidhur me kualifikimet e secilit ofertues i cili ka dorëzuar kërkesë për paraseleksionim, duke marrë parasysh vetëm ato kritere që janë paraparë në dokumentacionin e paraseleksionimit. Pas kësaj procedure, autoriteti kontraktues radhit sipas rangut të ofertuesit të cilët i plotësojnë kriteret e paraseleksionimit dhe përgatit listën e ofertuesve që do të ftohen për të dorëzuar propozimet e tyre. Gjatë përgatitjes së listës autoriteti kontraktues përcakton rangun vetëm sipas mënyrës së paraparë në dokumentacionin e paraseleksionimit.

Kërkesa për propozime.- Në fazën e parë të procedurës ofertuesit ftohen të dorëzojnë propozime fillestare lidhur me specifikacionet e projektit, indikatorët për vlerësimin e kryerjes së punës, aranzhmanet financiare dhe karakteristikat tjera të projektit, si dhe lidhur me kushtet kryesore të kontratës së propozuar nga autoriteti kontraktues. Autoriteti kontraktues fton në mbledhje dhe mban diskutime me secilin ofertues lidhur me kërkesën fillestare për propozime. Pas shqyrtimit të propozimeve të pranuar, autoriteti kontraktues mund të rishqyrtojë dhe, sipas nevojës, të riformulojë kërkesën fillestare për propozime duke shlyer, modifikuar ose shtuar ndonjë element të specifikacioneve fillestare të projektit. Në fazën e dytë të procedurës, autoriteti kontraktues fton ofertuesit të dorëzojnë propozime përfundimtare përkitazi me një pako të vetme të specifikimeve të projektit, indikatorëve për vlerësimin e kryerjes së punës ose kushteve të kontratës.

Kërkesa për propozime përmban së paku këto të dhëna:

- informata të përgjithshme që mund të kërkohen nga ofertuesit kështu që ata të mund të përgatisin dhe të dorëzojnë propozimet e tyre, përfshirë aty edhe afatin për dorëzim ;
- specifikacionet e projektit dhe indikatorët për vlerësimin e kryerjes së punës, përfshirë aty edhe kërkesat e autoritetit kontraktues që i përkasin standardeve të sigurisë dhe mbrojtjes së mjedisit;
- kushtet e kontratës të propozuar nga autoriteti kontraktues, duke theksuar se cilat kushte konsiderohen si jo të negociueshme;
- kontraktues, nëse ka të tillë, për të identifikuar propozime të pamjaftueshme;
- peshën përkatëse që i jepet çdo kriteri të vlerësimit dhe mënyrën në bazë të së cilës këto kritere zbatohen gjatë vlerësimit dhe refuzimit të propozimeve.

Kërkesa për propozime përcakton kushtet lidhur me nyrën, formën, vlerën dhe kushtet tjera që kanë të bëjnë me mjetin e sigurimit i cili kërkon për të siguruar ofertën, si dhe kushtet lidhur me personin që e jep një mjet të tillë sigurues.

Me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të propozimeve teknike merren parasysh korrektësia teknike, paluajtshmëria me standarde për mbrojtjen e mjedisit, zbatueshmëria operationale, si dhe cilësia e shërbimeve dhe masat që merren për të siguruar vazhdimin e kësaj cilësie. Ndërkaq, në vlerësimin e propozimeve financiare

dhe komerciale shqyrtohen në veçanti vlerat aktuale të taksave, të njëjësive të çmimeve dhe pagesave tjera gjatë periudhës së koncesionit, vlera aktuale e pagesave të drejtpërdrejta të propozuara nga autoriteti kontraktues, shpenzimet e dizajnit dhe ndërtimit, të veprimit dhe të mirëmbajtjes, vlera aktuale e shpenzimeve kapitali, si dhe të veprimit dhe mirëmbajtjeve, vëllimi i ndihmës financiare nga ndonjë autoritet publik, nëse ka nevojë për një gjë të tillë, korrektësia e aranzhmaneve financiare të propozuara, shkalla e pranueshmërisë së kushteve të negociueshme të kontratës së propozuar nga autoriteti kontraktues në kërkesën për propozime dhe potenciali për zhvillim ekonomik dhe shoqëror i ofruar nga propozimet.

Negociatat për lidhjen e kontratës së koncesionit.- Pas vlerësimit të propozimeve bëhet rangimi i të gjitha propozimeve në bazë të kriterëve të vlerësimit dhe autoriteti kontraktues e fton në negociata përfundimtare për lidhjen e kontratës së koncesionit ofertuesin që ka rangun më të lartë. Nëse bëhet e qartë për autoritetin kontraktues që negociatat me ofruesin e ftuar nuk do të rezultojnë në lidhjen e kontratës së koncesionit, atëherë autoriteti kontraktues e njofton ofertuesin se e ka ndërmend të ndërprejë negociatat dhe i jep atij kohë të mjaftueshme që të formulojë më mirë ofertën e tij përfundimtare. Nëse autoriteti kontraktues nuk e konsideron këtë propozim si të pranueshëm, atëherë i ndërpret negociatat me ofertuesin përkatës. Në vijim, autoriteti kontraktues fton për negociata ofertuesit tjerë sipas rangut që kanë deri sa të arrihet lidhja e kontratës së koncesionit ose të refuzohen të gjitha propozimet e mbetura. Autoriteti kontraktues nuk mund të rifillojë negociata me një ofertues me të cilin janë ndërprerë negociatat për shkak të arsyeve të lartpërmendura.

Pas përfundimit të negociatave me ofertuesit të cilëve vendoset t'i jepet koncesioni, autoriteti kontraktues shpall publikisht dhënien e kontratës në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Prokurimin Publik. Shpallja duhet ta identifikojë koncesionarin dhe ta jap një përmbledhje të elementeve kryesore, të identifikojë koncesionarin dhe të jep një përmbledhje të elementeve kryesore të kontratës së koncesionit.

Kontrata e koncesionit.- Sipas Ligjit për Procedurën e Dhënies së Koncesioneve, kontrata e koncesionit përmban së paku këto elemente:

- natyrën dhe vëllimin e punëve dhe shërbimeve që duhet të kryhen nga koncesionari,
- kushtet për kryerjen e këtyre shërbimeve dhe vëllimin e ekskluzivitetit të të drejtave të koncesionarit sipas kontratës së koncesionit, nëse parashihet një gjë e tillë,
- ndihmesën që autoriteti kontraktues mund t'ia jap koncesionarit për marrjen e licencave dhe lejeve nëse këto janë të nevojshme për zbatimin e projektit,
- çdo kërkesë që ka të bëjë me themelimin dhe kapitalin bazë të një personi juridik,
- pronësia mbi mjetet që kanë të bëjnë me projektin dhe detyrimet e palëve, sipas nevojës, lidhur me përvetësimin e vendit ku do të zbatohet projekti dhe të servituteve të nevojshme,
- shërbimin e koncesionarit, qoftë në formë të tarifave ose të taksave për shfrytëzimin ose kryerjen e shërbimeve, metodave dhe formulat për llogaritjen ose përshtatjen

e tarifave ose taksave të tilla dhe pagesat, nëse ka të tilla, që mund të kryhen nga autoriteti kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik,

- procedurat për shqyrtim dhe miratimin e dizajneve inxhinjerie, planeve të ndërtimit dhe specifikacioneve të autoritetit kontraktues, si dhe procedurat për testimin dhe inspektimin përfundimtar, miratimin dhe pranimin e infrastrukturës,
- vëllimin e detyrimit të koncesionarit për të siguruar, sipas nevojës, modifikimin e shërbimeve me qëllim të përmbushjes së kërkesës aktuale për shërbimin, vazhdimësinë dhe ofrimin e shërbimit nën kushte kryesisht të barabarta për të gjithë shfrytëzuesit,
- të drejtën e autoritetit kontraktues ose të ndonjë autoriteti tjetër publik për të mbikëqyruar kryerjen e punëve dhe shërbimeve nga ana e koncesionarit si dhe vëllimin dhe kushtet nën të cilat autoriteti kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik i autorizuar mund të urdhërojë ndryshime që i përkasin punës dhe kryerjes së shërbimit ose ndërmerr masa tjera të përshtatshme për të siguruar që një infrastrukturë mbahet në veprimin në mënyrë të duhur dhe që shërbimet kryhen në pajtim me ligjin dhe me dispozitat e kontratës,
- vëllimin e detyrimit të koncesionarit që t'i raportojë dhe ta informojë autoritetin kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik mbi veprimet e veta,
- mekanizmat që merren me shpenzimet shtesë dhe pasojat tjera që mund të realizojnë nga një urdhër i autoriteti kontraktues ose të ndonjë autoriteti tjetër publik, përfshirë aty çdo lloj kompensimi që mund t'i takojë koncesionarit,
- për aq sa konsiderohet e nevojshme, të drejtat e autoritetit kontraktues që të shqyrtojë dhe miratojë kontrata të rëndësishme të cilat do të lidhë koncesionari, në veçanti ato me aksionarët e koncesionarit ose persona të tjerë të ndërlidhur,
- garancionet e përmbushjes dhe polisat e sigurimit që do të sigurohen nga koncesionari lidhur me implementimin e projektit,
- të drejtat dhe detyrimet e palëve nëse ndonjëra palë nuk e përmbush kontratën,
- kushtet nën të cilat ndonjëra palë mund të lirohet nga përgjegjësia për mos përmbushjen ose vonesën në përmbushjen e një detyrimi që rrjedhin nga kontrata e koncesionit për shkaqe që janë jashtë kontrollit të palës,
- kohëzgjatja e kontratës së koncesionit, si dhe të drejtat dhe detyrimet e palëve pas kalimit të kohëzgjatjes ose të shkëputjes së kontratës,
- mënyrën e llogaritjes së kompensimit,
- të drejtën kompetente dhe mekanizmat për zgjidhjen e konflikteve që mund të krijohen mes autoritetit kontraktues dhe koncesionarit,
- të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me informatat sekrete.

Ofertuesi i suksesshëm ka për detyrë të themelojë një informatë të veçantë të një shoqërie tregtare, nëse kjo është kërkuar nga autoriteti kontraktues. Çdo kërkesë lidhur me kapitalin minimal të një personi juridik të tillë dhe të procedurës për marrjen e miratimit nga ana e autoritetit kontraktues për statutin dhe rregulloret e punës së tij, si dhe për ndryshimet thelbësore të tyre duhet të përcaktohen në kontratën e koncesionit

në pajtim me kushtet e parapara në kërkesën për propozime. Kontrata e koncesionit gjithashtu specifikon se cilat mjete janë ose do të bëhen pronësi publike dhe të cilat mjete janë ose do të bëhen pronësi private e koncesionarit. Të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit sipas kontratës së koncesionit nuk mund t'i barten palëve të treta pa pëlqimin e autoritetit kontraktues.

Kohëzgjatja, vazhdimi dhe shkëputja e kontratës së koncesionit.- Kohëzgjatja e koncesionit përcaktohet në kontratën e koncesionit, duke marrë parasysh kohëzgjatjen maksimale të lejuar në ligjin përkatës. Autoriteti kontraktues mund ta japë pëlqimin për vazhdimin e kohëzgjatjes së kontratës së koncesionit për një periudhë kohore prej jo më shumë se 10 vjetë, përveç nëse nuk është paraparë ndryshe me ligj të veçantë. Autoriteti kontraktues ka për detyrë ta japë pëlqimin për vazhdimin e kontratës së koncesionit, kur:

- ka vonesë në kryerjen e punës ose ndërprerje të punës për arsye të fuqisë madhore,
- projekti suspendohet nga autoriteti kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik, ose
- ka një rritje të shpenzimeve si pasojë e kërkesave të autoritetit kontraktues të cilat nuk kanë qenë të parapara fillimisht në kontratën e koncesionit, nëse koncesionari nuk është në gjendje të mbulojë këto shpenzime pa një vazhdim të kontratës së koncesionit.

Shkëputja e kontratës së koncesionit nga autoriteti kontraktues lejohet nëse nuk mund të pritet me arsye që koncesionari do të jetë në gjendje ose i gatshëm të përmbushë detyrimet e veta, ose për arsye madhore në interesin publik, me kusht që koncesionari t'i paguhet kompensimi i paraparë në kontratën e koncesionit.

Në anën tjetër, koncesionari mund ta shkëput kontratën e koncesionit vetëm në rastet vijuese:

- në rast se autoriteti kontraktues ose ndonjë autoritet tjetër publik nuk përmbush një detyrim thelbësor lidhur me kontratën e koncesionit,
- nëse janë plotësuar kushtet për një revidim të kontratës së koncesionit sipas ligjit, mirëpo palët nuk janë pajtuar për revidimn e kontratës së koncesionit, ose
- nëse shpenzimet e koncesionarit për përmbushjen e kontratës së koncesionit janë ngritur dukshëm ose nëse vlera e shërbimit që koncesionari merr për përmbushjen e kontratës bjen dukshëm si rezultat i një veprimi ose mosveprimi të autoritetit kontraktues, dhe
- palët janë pajtuar për një revidim të kontratës së koncesionit.

Secila palë ka të drejtë ta shkëput kontratën e koncesionit nëse përmbushja e detyrimit të saj bëhet e pamundur për arsye të fuqisë madhore. Poashtu, palët mund ta shkëpusin kontratën e koncesionit me marrëveshje. Kontrata e koncesionit parasheh se si llogaritet kompensimi që i takon palës kontraktuese përkatëse në rast të një shkëputjeje të kontratës së koncesionit, duke përfshirë në llogaritjen e kompensimit,

sipas rrethanave, vlerën e punës së kryer sipas kontratës së koncesionit, shpenzimet ose humbjet që ka pasur ndonjëra palë, përfshirë aty edhe fitimin e humbur.

PRONËSIA INTELEKTUALE

Pronësia intelektuale po zë vend gjithnjë më të madh në tregtinë ndërkombëtare dhe, duke ditur rëndësinë e krijimit të një sistemi efikas për mbrojtjen, jo vetëm të bartësve të të drejtave të pronës intelektuale, por edhe të shoqërisë në përgjithësi. E drejta në pronë përfshin të drejtën për të poseduar, shfrytëzuar, shitur dhe asgjësuar një objekt apo mall që të takon. Megjithatë, e drejta pronësore nuk kufizohet vetëm me të drejtën për të pasur mall të luajtshëm apo patundshmëri. Kjo e drejtë përfshin edhe veprën apo rezultatin që rezulton nga puna origjinale apo produktet mendore, quhet pronë intelektuale.

Pronësia intelektuale në esencë përfshin katër lloje të ndryshme produktive mendore që mund të dalin si rezultat i punës intelektuale të nejerëzve. Ato janë:

- markat tregtare
- të drejtat e autorit
- patentat
- dizajnet industriale.

Përveç këtyre katër llojeve, shumë autorë theksojnë se si pronë intelektuale mbrohen edhe të drejtat e përafërta, siç janë, p.sh, fshehtësitë tregtare.

Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale tashmë është bërë një ndër fushat më të rëndësishme për bizneset e tyre, identifikohen me një emër, shenjë, formë, dizajn dhe produkt të caktuar. Prandaj, me qëllim që dikush tjetër të mos krijojë avantazhe nga përdorimi i këtyre shenjave, llogove, etj, në pothuajse secilin vend të botës, këto të drejta mbrohen me ligj. Tashmë është miratuar një numër i madh i konventave ndërkombëtare të cilat merren me këtë çështje.

Pronësia intelektuale paraqet të drejta specifike edhe të drejta të tjera të cilat i kanë autorët, shpikësit dhe bartësit tjerë të pronës intelektuale. Pronësia intelektuale nuk është pronësi konkrete materiale mbi ndonjë lëndë, por është e drejtë, përkatësisht përmbledhje e autorizimeve të cilat rregullojnë shtetëror të vendit e njohin si bartës të së drejtës së pronës intelektuale. Duke iu falënderuar konventave multilaterale të shumëhershme, lëmia e pronësisë intelektuale është njëra nga degët e rralla të drejtës e cila gëzon shkallë të lartë të harmonizimit në sisteme të mëdha juridike.

Pronësia intelektuale (PI).- I referohet krijimeve mendore, shpikjeve, veprave letrare dhe artistike, simboleve, emrave, imazheve, dizajneve të përdorura në afarizëm. Titullarët e këtyre të drejtave mund t'i ndalojnë të tjerët që t'i përdorin krijimet e tyre

pa autorizime paraprake ose mund të lejojnë shfrytëzimin dhe përdorimin e tyre në shkëmbim të kompensimit material përpjekjet dhe investimet e tyre gjatë krijimtarisë. Pronësia intelektuale shënon edhe të drejtat të cilat kanë të bëjnë me:

- letërsi, vepra artistike dhe shkencore
- interpretime artistike dhe interpretuse dhe kryejnë veprime artistike, fonograme dhe radio emisione,
- shpikje në të gjitha lëmitë e aktiviteteve njerëzore,
- zbulime shkencore ,
- mostra dhe modele industriale,
- marka tregtare dhe shërbyese, si dhe emra tragtare dhe emërtime tregtare,
- mbrojtjen nga konkurrenca jo lojale dhe të gjitha të drejtave tjera lidhur me pronësinë intelektuale në lëminë e industrisë, shkencës, letërsisë dhe lëminë artistike.

Pronësia intelektuale ndahet në dy kategori:

Në pronsi industriale, që përfshin të drejtat lidhur me:

- markat tregtare
- emrat tragtare,
- patentat,
- dizajnet industriale,
- indikacionet (treguesit) gjeografikë,
- varietetet e reja bimore,
- tipografitë e qarqeve te integruara, dhe
- mbrojtjen nga konkurrenca e pa drejtë

Të drejtat e autorit dhe të drejtat tjera te përfaqërta.-

Të drejtat e autorit janë të drejtat që u njihen personave të caktuar për krijimtarinë e tyre në fushën e letërsisë, shkencës dhe artit dhe përfshijnë në mes tjerash: romanet, poezitë, kompozimet muzikore, skulpturat, pikturat, vizatimet, krijimet kinematografike, arkitekturën, koreografinë, fotografimin dhe krijimet tjera të ngjashme.

Kjo degë e pronësisë intelektuale përfshin edhe të ashtuquajturat të drejta të tjera të përfaqërta me të drejtën e autorit,

- të drejtat e artistëve intepretues (këngëtarët, muzikantët tjerë, valltarët, aktorët dhe të tjerët të cilët interpretojnë vepra),
- producentët e fonogrameve, producentët e filmave dhe organizatat transmetuese.

Mbrojtja e te drejtave të pronës intelektuale eëhtë një ndër çështjet e rëndësishme të zhvillimit të së drejtës, të drejtave të njeriut, tregtisë, administratës publike dhe kriminalitetit.

Mbrojtja e të drejtave të pronësisë intelektuale nuk përmban në vete një çështje të një vendi, por është pjesë e pa ndarë e zhvillimeve rajonale dhe ndërkombëtare, realizimi me efektivitet i mbrojtjes së kësaj të drejte, përmban një shqetësim në të gjithë botën duke marrë parasysh mundësitë e mëdha që ekzistojnë për realizimin e shkeljeve, si rrjedhojë e zhvillimeve globale dhe teknologjike.

Shkeljet e të drejtave të pronësisë intelektuale, sot konsiderohen si krime të dimensioneve globale me efekte të gjera në ekonomi dhe qeverisje të një vendi.

Trafikimi i produkteve fallce dhe pirateria, është një nga aktivitetet kriminale me fitimprurëse të krimit të organizuar.

Pronësia intelektuale mbrohet edhe me Direktivat e Këshillit të Evropës edhe me ligjet e Republikës së Kosovës, Direktivat e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për mbrojtjen ligjore të shpikjeve bioteknologjike, Direktivat e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për zbatimin e të drejtave dhe të pronësisë intelektuale dhe me Direktivat e Parlamentit dhe Këshillit Evropian për Mbrojtje Ligjore të Dizajneve.

Në Republikën e Kosovës janë miratuar ligjet për mbrojtjen e pronësisë intelektuale dhe industriale:

- Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta,
- Ligji për Patentat,
- Ligji për Markat Tregtare,
- Ligji për Dizajnin Industrial,
- Ligji për Treguesit Gjeografikë dhe për Emërtimet e Origjinës,
- Ligji për Përcaktimin e të Drejtave dhe Mbrojtjen e Topografisë së Qarqeve të Integruara.

PRONËSIA INDUSTRIALE

MARKAT TREGTARE

Marka tregtare është një shenjë dalluese e cila identifikon mallra apo shërbime të ofruara nga një individ apo ndërmarrje. Markat tregtare konsiderohen si pronë intelektuale, sepse janë rezultat i punës artistike dhe intelektit të personave apo ndërmarrjeve të cilat identifikohen me këte markë, prandaj mbrohen edhe me ligj. Në Kosovë, këtë fushë e rregullon Ligji për Markat Tregtare, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Numri i shkeljeve të të drejtave mbi markat tregtare është i shumtë, sidomos në vendet ku nuk ka sundim të ligjit. Shfrytëzuesit e paautorizuar të markave tregtare mund të përfshijnë shumë keqpërdorues markash të tjetërkujt, duke shkaktuar konfuzion tek konsumatorët.

Shenjat të cilat mund të mbrohen si Marka Tregtare.- Të gjitha shenjat, në veçanti fjalët, duke përfshirë edhe emrat personalë, vizatimet, shkronjat, numrat, markat zërore (audio), trajtat tredimensionale, duke përfshirë edhe trajtat e mallreve ose mbështjelljen apo paketimin tjetër të tyre, ngjyrat, kombinimet e ngjyrave, që janë në gjendje të dallojnë një mall ose shërbim që ofrohet nga një ndërmarrje nga mallrat dhe shërbimet që ofrohen nga ndërmarrje të tjera, mund të mbrohen si marka tregtare.

Qëllimi dhe fushëveprimi i Ligjit për Markën Tregtare.- Qëllimi i miratimit të këtij ligji është mbrojtja adekuatë e markave tregtare, emërtimeve tregtare në përputhshmëri me konventat ndërkombëtare, si dhe me legjislacionin dhe praktikën e BE-së. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, ndërmarrjet dhe autoritetet publike.

Mbrojtja e Markës Tregtare: Masat mbrojtëse që sigurohen me ligj, vlejné për shenjat që:

- janë regjistruar si marka tregtare në Regjistrin e Markave Tregtare,
- deri në atë masë sa ajo shenjë, përmes shfrytëzimit gjatë ushtrimit të aktiviteteve afariste, njihet si markë tregtare brenda qarqeve përkatëse afariste,
- që është bërë e njohur si markë tregtare.

Emërtimet tregtare.- Simbolet e kompanive, si dhe emërtimet e punëve mbrohen si markë tregtare. Simboli i kompanisë është shenja që shfrytëzohet gjatë aktiviteteve afariste si emër, si emër i firmës ose si emërtim i veçantë i një ndërmarrjeje. Simboli i kompanisë ose shenjat e tjera që kanë për qëllim të dallojnë një aktivitet nga një tjetër dhe që janë të njohura brenda qarqeve përkatëse si shenjë dalluese e një kompanie të caktuar është e barabartë me emërtimet e veçanta të një ndërmarrjeje.

Me ligj mbrohen edhe titujt e punimeve nga fushat e ndryshme. Titulli i një pune është emri ose emërtimi i veçantë i një publikimi të shtypur, një veprë kinematografike, veprë muzikore, shfaqjeje teatrore ose pune të ngjashme.

Simbolet e kompanive, si dhe emërtimet e punës mbrohen si emërtime tregtare.

- Simbolet e kompanive, si dhe emërtimet e punëve, mbrohen si emërtime tregtare.
- Simboli i kompanisë është shenja që shfrytëzohet gjatë aktiviteteve afariste si emër, si emër i firmës ose si emërtim i veçantë i një ndërmarrjeje.
- Simboli i kompanisë ose shenjat e tjera që kanë për qëllim të dallojnë një aktivitet nga një tjetër dhe që janë të njohura brenda qarqeve përkatëse si shenjë dalluese e një kompanie të caktuar është e barabartë me emërtimet e veçanta të një ndërmarrjeje.

Me ligj mbrohen edhe titujt e punimeve nga fushat e ndryshme. Titulli i një pune është emri ose emërtimi i veçantë i një publikimi të shtypur, një veprë kinematografike, veprë muzikore, shfaqjeje teatrore ose pune të ngjashme.

Markat tregtare të cilat mund të regjistrohen janë të pakufizuara. Markat mund të jenë kombinim fjalësh, shkronjash dhe numrash. Ato mund të përbëhen nga skica

, simbole, shenja tredimensionale, si formë dhe ambalazhimi i mallrave, shenja dëgjimore, si tingujt muzikorë ose vokalet, aromat ose ngjyrat që përdoren si tipare dalluese.

Përveç markave që identifikojnë burimin tregtar të mallrave dhe shërbimeve, ekzistojnë edhe kategori të tjera të markave tregtare:

Markat kolektive zotërohen nga një shoqatë, anëtarët e së cilës i përdorin ato për të identifikuar me një nivel cilësie dhe kërkesa të tjera të vendosura nga shoqata (për shembull shoqata e kontabilistëve, inxhinierëve ose arkitektëve).

Markat certifikuese përdoren si tregues cilësie, prejardhjeje, metode të prodhimit apo karakteristikave tjera të përbashkëta të mallrave apo shërbimeve.

Pronari i një marke tregtare ka të drejtë të vendos se kush mund të përdor ose jo markën tregtare. Pronari i markës mund ti japë autorizim apo licencën palëve të tjera për përdorimin e markës, në bazë të kushteve për të cilat është rënë dakord në mënyrë të ndërsjelltë. Pronari mund t'ia shesë, gjithashtu të drejtën dikujt tjetër, i cili më pas, bëhet pronari i ri i kësaj marke.

Mbrojtja e markës mbaron me përfundimin e afatit të saj dhe kjo markë mbetet e vlefshme për përdorim publik. Kjo nënkupton që pronari nuk zotëron me të drejta ekskluzive mbi markën e cila iu vihet të tjerëve në dispozicion për tu shfrytëzuar për qëllime tregtare.

Në Republikën e Kosovës markat tragtare regjistrohen nga Agjencia e Pronësisë Industriale (API) në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë.

Përparësia dhe vjetërsia.-

E drejta e mbrojtjes së Markës Tregtare është e kushtëzuar me datën e fitimit të së drejtës së përparësisë si datë e përcaktimit të vjetërsisë.

Në rast të një konflikti ndërmjet të personave apo ndërmarrjeve se kujt i takon një markë tregtare, vjetërsia e së drejtës mbi atë markë e përcakton përparësinë e të drejtave për secilin. Për një markë të paraqitur për regjistrim ose të regjistruar, data e paraqitjes është ajo që e përcakton datën e përparësisë.

Kushtet për mbrojtjen e Markave Tregtare me Regjistrim.-

Në meny, që të mbrohet marka tregtare, duhet të ekzistojë pronësia mbi atë markë të regjistruar tregtare. Markën tregtare mund ta regjistrojë:

- personi fizik,
- personi juridik, dhe
- një ndërmarrje që nuk është person juridik, nëse ka zotësi juridike për t'i fituar të drejtat dhe përgjegjësitë.

Bazat absolute për refuzimin e regjistrimit.-

Si markë tregtare nuk mund të regjistrohen markat të cilat përmbajnë këto karakteristika:

- markat tregtare që nuk përmbajnë ndonjë veçori dalluese,
- markat tregtare të cilat përbëhen ekskluzivisht prej shenjave ose indikacioneve që mund të shfrytëzohen në tregti për përcaktimin e llojit, cilësisë, sasisë, qëllimit, vlerës, prejardhjes gjeografike, kohës së prodhimit të mallrave, ofrimit të shërbimeve dhe veçorive tjera të mallrave dhe shërbimeve,
- markat tregtare të cilat përbëhen ekskluzivisht prej shenjave ose indikacioneve të cilat janë të zakonshme në gjuhën e përditshme ose me mirëbesim, si dhe praktikat e zakonshme tregtare,
- markat tregtare që janë të një natyre të tillë që mund të pritet se do të mashtrojnë publikun, veçmas për llojin, cilësinë, ose prejardhjen gjeografike të mallrave ose shërbimeve,
- markat tregtare që përmbajnë stemën shtetërore, flamurin ose emblemën e një shteti,
- markat tregtare që përmbajnë stemën shtetërore, flamurin ose ndonjë emblemë tjetër zyrtare të Kosovës, ose ndonjë komune, asoacioni komunash ose asoacioni tjetër komunal brenda Kosovës,
- markat tregtare që përmbajnë një shenjë zyrtare, emblemë ose vulë, që ndikon në kontrollin ose garantimin e një autoriteti publik ose ndërmarrjeje publike,
- markat tregtare që përmbajnë stemën shtetërore, flamurin, vulën ose ndonjë shenjë tjetër të një organizate ndërkombëtare,
- markat tregtare, shfrytëzimi i të cilave është në kundërshtim me ndonjë dispozitë tjetër ligjore ose rregullative në Kosovë,
- markat që janë në kundërshtim me moralin dhe rendin publik,
- markat tregtare që nuk mund të paraqiten grafikisht.

Bazat relative për refuzimin e regjistrimit.-

Regjistrimi i një marke tregtare do të refuzohet ose anulohet në rastet si në vijim;

- nëse marka tregtare është identike me një markë të mëhershme tregtare,
- nëse mallrat e shërbimet mbrohen nga marka e mëhershme tregtare,
- nëse, për shkak të identitetit ose ngjashmërisë me një markë të mëhershme të paraqitur për regjistrim ose të regjistruar, si dhe ngjashmërisë së mallrave ose shërbimeve të ofruara nga të dy markat tregtare, ekziston mundësia e çorientimit të publikut në lidhje me atë se cila është marka tregtare e regjistruar e cila është ajo për të cilën kërkohet regjistrimi,
- nëse marka tregtare është identike ose e ngjashme me ndonjë markë të paraqitur për regjistrim ose të regjistruar të mëhershme tregtare,

- nëse regjistrimi i markës tregare kërkohet për mallrat ose shërbimet që nuk janë të ngjashme me ato që mbulohen nga markat tregtare të mëhershme të paraqitura për regjistrim ose janë të regjistruara,
- nëse shfrytëzimi i markës së mëvonshme tregtare, pa arsye të mira, do të shfrytëzohej në mënyrë të padrejtë, ose do të ishte shkatërruese për regjistrim ose të regjistruar.

Efekti i markave të regjistruara tregtare.-

Pronari i markës së regjistruar tregtare mban të drejta ekskluzive lidhur me mallrat ose shërbimet e mbuluara nga regjistrimi. Ai ka të drejtë në:

- shfrytëzimin e markës tregtare,
- autorizimin për të tjerët për shfrytëzimin e markës tregtare,
- lejimin e shfrytëzimin nga të tjerët, ose
- shfrytëzimin mjete juridike kundër shkeljes së markës tregtare.

Shkelja e të drejtës së markës së regjistruar tregtare.-

Asnjë person ose ndërmarrje gjatë aktiviteteve tregtare nuk mund të shfrytëzojë një shenjë që është në masë substancionale identike, ose e ngjashme me një markë të regjistruar tregtare, pa lejen e pronarit të markës tregtare. Shfrytëzimi i paautorizuar i markës tregare konsiderohet si shkelje e të drejtave për markën e regjistruar tregare.

Personat dhe ndërmarrjet nuk mund të shfrytëzojnë një shenjë gjatë ushtrimit të aktiviteteve afariste kur ekziston mundësia se shfrytëzimi i tillë mund të mashtrojë ose të shkaktojë hamendje të publikut, duke përfshirë edhe ngatërrimin e shenjës me markën tregtare.

TË DREJTAT E AUTORIT

Të drejtat e autorit janë ndër format më të vjetra të pronës intelektuale dhe përfshinë të drejtat mbi veprat e autorëve në lëminë e letërsisë, shkencës dhe artit. Nga të gjitha të drejtat tjera që burojnë nga prona intelektuale, të drejtat e autorit janë ato që shkilen më së shumti dhe kontrabandimi i këtij lloji të pronës tashmë ka marrë formën e krimit të organizuar në një numër të madh vendesh. Me qëllim të luftimit të kësaj dukurie dhe krijimit të infrastrukturës ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për të Drejtat e Autorit në vitin 2006.

Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit.-

Ligji për të Drejtat e Autorit përcakton pronësinë intelektuale që u takon interpretuesve të artit, producentëve dhe autorëve të të drejtave të autorit dhe mbrojtjen e tyre, si dhe zbatimin e Ligjit ndaj Personave të Huaj.

Prona intelektuale që mund të mbrohet si e drejtë e autorit.-

E drejta e autorit është e posaçme, e cila i takon autorit si subjekt të pronës intelektuale mbi veprën e vet. Kjo e drejtë i takon autorit me vetë faktin e krijimit të veprës, prandaj nuk kërkohet plotësim paraprak i çfarëdo formaliteti administrativë. E drejta e autorit përmban:

- autorizimet ekskluzive personale për mbrojtjen pacenueshmërinë së veprës së autorit dhe personalitetit të autorit (në vijim: të drejtat morale të autorit),
- autorizimet ekskluzive ekonomike për të mbrojtur interesat ekonomike të autorit (në vijim; të drejtat ekonomike të autorit),
- autorizimet tjera të autorit (në vijim, të drejtat tjera të autorit).

Veprat e mbrojtura.-

Vepra të autorit janë krijimet intelektuale origjinale në lëmin e letërsisë, të shkencës dhe artit, që janë të shprehura në çfarëdo mënyre. Vepra të autorit konsiderohen sidomos:

- veprat gojore, siç janë fjalimet, leksionet, tregimet dhe veprat e ngjashme të shprehura gojarisht,
- veprat e shkruara, siç janë tekstet në librat, broshurat, gazetatat ditore dhe tekstet të tjera në lëmin e letërsisë, të literaturës shkencore e profesionale, si dhe programet kompjuterike,
- veprat muzikore, me ose pa tekst, pavarësisht a janë të shënuara përmes notave apo në ndonjë mënyrë tjetër,
- veprat teatrore, teatrore-muzikore dhe të kukullave, përfshirë edhe radiodramat,
- veprat filmike (kinematografike dhe televizive) dhe veprat e tjera audiovizuale në vijim: veprat audiovizuale),

- veprat fotografike dhe veprat e bëra ngjashëm procesit fotografik, siç janë fotografitë artistike, fotomontazhet, fotoafishet, fotografitë e raportëve, etj,
- vepra e artit figurativ në lëmin e vizatimit, të pikturës, grafikës, skulpturës,
- veprat e arkitekturës, siç janë skicat, planet, maketat dhe objektet e ndërtuara të veprave arkitekturore dhe të inxhinjerisë nga fusha e arkitekturës, urbanizmit, arkitekturës së peizazhit dhe rregullimit të enterierit,
- veprat skenografike,
- veprat e artit aplikativ, si dhe të dizajnit industrial e grafik,
- veprat hartografike (hartat, planet, skicat, demonstrimet tredimensionale) në lëmin e gjeografisë dhe topografisë,
- prezantimet e natyrës shkencore, edukative e teknike (vizatimet teknike, grafikonet, tabelat, ekspertizat, demonstrimet tredimensionale).

Autori .-Autor është personi fizik i cili e ka krijuar veprën. Personi, emri i të cilit, përkatësisht firma, pseudonimi apo shenja e tij është në ekzemplarin e veprës ose është theksuar me rastin e publikimit të veprës, supozohet autor i veprës, respektivisht titullar i së drejtës, derisa nuk provohet ndryshe. Të drejtat e autorit në veprat e botuara, autori i të cilave është i panjohur (vepra anonime dhe vepra e botuar me pseudonim apo shenjë), supozohet se është i autorizuar t'i realizojë botuesi, përderisa nuk zbulohet identiteti i autorit. Po që se edhe botuesi mbetet anonim, supozohet se është i autorizuar t'i realizojë personi që ka bërë publikimet e veprës. E drejta e autorit zgjatë gjatë gjithë jetës së autorit dhe 70 vjet pas vdekjes së tij, ndërkaq e drejta e autorit ndaj veprës anonime ose me pseudonim zgjatë 70 vjet që nga dita e shpalljes së ligjshme të veprës.

Autori mund të ushtrojë të drejtat e tij personalisht apo përmes agjentit. Të drejtat morale të autorit nuk mund të kalohen prej autorit në persona të tjerë ndërsa të drejtat ekonomike dhe të drejtat e tjera, si dhe zbatimi i të drejtave morale që zgjasin pas vdekjes së autorit, kalohen në përputhje me legjislacionin për trashëgimi.

Shkelja e të drejtave të autorit

Personi, të cilit i janë cenuar të drejtat që mbrohen me këtë ligj (titullari i së drejtës), mund të kërkojë mbrojtjen e të drejtave të tij dhe zhdëmtimin përkatës në varësi me cenimin. Ai gjithashtu mund të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar nga shkelja, duke përfshirë edhe tërheqjen e gjithë fitimit për shkak të dëmit të shkaktuar nga shkelja, duke përfshirë edhe tërheqjen e gjithë fitimit që shkelësi ka përfituar nga përdorimi i të drejtës së huaj të autorit. Kur prodhuesi apo shpërndarësi i kopjes shkel të drejtat e autorit, me kërkesë të bartësit të të drejtave ato kopje do të konfiskohen nga autoritetet doganore gjatë importit apo eksportit në raste kur shkelja është e evidente.

PATENTAT

Patentat janë shpikje apo zbulime që mundësojnë zgjidhjen e një problemi specifik në një fushë të teknologjisë. Shpikje mund të jetë një produkt ose proces, ose mund të ketë të bëjë me një produkt dhe një proces. Konsiderohet e patentueshme çdo shpikje, nga çdo fushë teknike, që është risi, ka shkallë risie dhe që është e zbatueshme në industri. Shpikjet e patentueshme mbrohen me patent sipas Ligjit. Në Kosovë, kjo lëmi rregullohet me Ligjin mbi Patentat.

Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit.-

Ky ligj, sikurse edhe ligjet për marka tregtare dhe të drejtat e autorit, ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave mbi pronën intelektuale. Shpikjet janë pjesë e rëndësishme e kësaj prone dhe përkundër numrit jo aq të madh të shpikjeve teknike e industriale në Kosovë, është miratuar ligji për mbrojtjen e tyre. Ky Ligj përcakton dispozitat për shpikje të cilat në fushën e teknologjisë mundësojnë zgjidhjen e një problemi specifik.

Lëndët e Mbrojtura me Patentim

Shpikja është risi nëse nuk përmbahet në njohurinë e mëparshme. Për përcaktimin e risisë, detajet e njohurisë së mëparshme mund të shqyrtohen vetëm individualisht. Me njohuri të mëparshme kuptohet gjithçka që iu ka bërë e njohur publikut në botë, me ane të shkrimit ose në formë gojore, nëpërmjet përdorimit ose në çfarëdo mënyre tjetër para datës së aplikimit për patentim.

Lëndët që mbrohen me patentim janë shpikjet që kanë të bëjnë me:

- produktin që përbëhet nga materiali biologjik ose që përmban material biologjik,
- procesin me të cilin prodhohet, përpunohet ose përdoret ai material biologjik,
- material biologjik i izoluar nga mjedisi i tij natyror ose që prodhohet me proces teknik madje edhe kur me herët ka ndodhur në natyrë.

Ligji përjashton nga patentimi:

- zbulimet, teoritë shkencore dhe metodat matematikore,
- krijimet estetike,
- skemat, rregullat dhe metodat për kryerjen e akteve mendore, lojërat ose kryerje veprimtarish tregtare,
- programet kompjuterike,
- prezantimet e informacioneve.

Nuk do të konsiderohen të patentueshme shpikjet, shfrytëzimi komercial i të cilave do të ishte neëkundërshtim me rendin publik ose moralin publik, veçanarrisht:

- proceset e klonimit të qenieve njerëzore,
- proceset për modifikimin identitetit gjenetik të linjes gjenezore (embrionale) të qenieve njerëzore,
- përdorimi i embrioneve njerëzore për qëllime industriale ose komerciale,
- proceset për modifikimin e identitetit gjenetik të kafshëve që potencialisht mund të shkaktojnë vuajtje të tyre pa kurrfarë dobie të rëndësishme medicinale për njerëz ose kafshë, si dhe shtazëve që krijohen si rezultat i proceseve të tilla.

Shpikësi dhe e drejta e patentimit.-

Shpikësi është person, i cili me punën e vet krijuese ka bërë shpikjen. Shpikës nuk konsiderohet personi i cili gjatë shpikjes ka ofruar vetëm ndihmë teknike. Shpikësi e ka të drejtën e patjetërsueshme që të njihet titulli i shpikësit dhe pronarit të patentës në aplikimin për patentin në të gjitha dokumentet e nxjerra në lidhje me njohjen e patentimit, siç janë aplikimi i publikuar dhe specifikimi i patentimit dhe regjistrin e patentimeve, me përjashtim të rastit kur shpikësi kërkon që të mos përmendet emri i tij.

E drejta e patentimit i përket shpikësit ose trashëgimtarit të tij të ligjshëm. Nëse shpikja është krjuar me punën e përbashkët të dy e më shumë shpikësve, e drejta e patentimit u përket shpikësve ose trashëgimtarëve të ligjshëm të tyre, përveç në rast se ata merren vesh ndryshe.

Patenta i ofron mbrojtësit të saj mbrojtje ligjore për një shpikje. Mbrojtja jepet për një afat të caktuar prej 20 vjetësh.

Mbrojtja me patentë do të thotë se një shpikje nuk mund të hidhet në treg, të përdoret, të shpërndahet apo të shitet pa miratimin e pronarit të patentës. Këto të drejta mbi patentën zbatohen nga gjykata, e cila ka autoritetin të ndalojë shkeljen e patentës. Nga ana tjetër, gjykata mund të vendosë edhe shpalljen e një patente si të paligjshme, si rezultat i një kërkesë të suksesshme nga të tretët.

DIZAJNI INDUSTRIAL

Dizajni industrial është aspekti dekorativ apo estetik i një produkti. Dizajni nënkupton formën e jashtme të produktit në tërësi apo të një pjese të produktit, veçanërisht nga forma, trajta, ngjyra, teksti dhe materiali i vet produktit. Sikurse edhe të drejtat tjera, edhe dizajni industrial mbrohet si pronë intelektuale me Ligjin për Dizajnin Industrial të miratuar nga Kuvendi i Kosovës⁷

Qëllimi dhe fushëveprimi i ligjit.-

Me ligj rregullohen kushtet e mbrojtjes së dizajnit industrial, e drejta e mbrojtjes, fitimi, vëllimi dhe vlefshmëria e mbrojtjes, të drejtat ekskluzive, procedurat për regjistrim, ndryshimet në dizajnin industrial, ndërperja e vlefshmërisë dhe anulimi i dizajnit industrial, depozitimi ndërkombëtar i dizajnit, mbrojtja juridiko-civile dhe dispozitat kundërvajtëse.

Fitimi dhe mbrojtja e dizajnit industrial.-

Dizajni industrial fitohet me nxerrjen e vendimit për regjistrimin e dizajnit industrial dhe regjistrimin në regjistër. Data e regjistrimit në regjistër është data e nxerrjes të vendimit për regjistrimin e dizajnit industrial.

Me dizajni industrial mbrohet dizajni në atë masë në të cilën është risia dhe i cili ka karakter të veçantë. Dizajni i produktit konsiderohet risi nëse nuk është identik me dizajnin e vënë në dispozicion të publikut para datës së aplikimit për regjistrimin e dizajnit industrial, gjegjësisht nëse është kërkuar e drejta e përparësisë. Nuk mbrohet dizajni i cili është në kundërshtim me interesin publik dhe parimet morale.

Mbrojtja e dizajnit industrial zgjatet në periudhë prej 5 vjetësh, e me së tepërmi për periudhën prej njëzet e pesë (25) vitesh, duke llogaritur nga data e paraqitjes së aplikacionit. Bartësi i dizajnit industrial, i cili kërkon vazhdimin e mbrojtjes, duhet që gjatë vitit të fundit të i' a paraqes Zyrës kërkesën për vazhdimin e mbrojtjes të dizajnit industrial. Periudha e re e mbrojtjes fillon me datën e kalimit të afatit të periudhës së mëparshme të mbrojtjes.

Mbrojtja e dizajneve industriale ndihmon zhvillimin ekonomik duke nxitur elementin krijues në sektorët industrialë dhe prodhues, si dhe në artet e artizanatet tradicionale. Ato ndikojnë në zgjerimin e veprimtarive tregtare dhe eksportin e produkteve vendore.

Sipas Ligjit për të Drejtën e Autorit, dizajni industrial gjithashtu mund të mbrohet si vepër arti nëse i plotëson kushtet e përcaktuara me Ligjin për të Drejtën e Autorit. Dizajni mund të gëzojë mbrojtje paralele me të drejtën e autorit dhe të regjistrimit të dizajnit.

Dizajnuesi- është personi fizik i cili ka krijuar dizajnin industrial. Nëse dizajni është krijuar në bazë të kontratës me porosi, e drejta për dizajnin i takon porositësit të dizajnit nëse me kontratë nuk është paraparë ndryshe.

Nëse dizajnin e ka krijuar dizajnuesi gjatë kryerjes së detyrave të punës si i punësuar apo duke i zbatuar këshillat e punëdhënësit ka të drejten për fillimin e procedurës për fitimin e dizajnit industrial, nëse me kontrat nuk është parapar ndryshe.

Përsnat fizik dhe juridik, vendas dhe të huaj gëzojnë të drejta të barabarta për fitimin dhe mbrojtjen e dizajnit sipas ligji.

Regjistrimi ndërkombëtar i dizajnit bëhet në pajtim me dispozitat e Marrëveshjes së Hages.

Aplikacioni për regjistrim ndërkombëtar të dizajnit industrial paraqitet drejt për drejtë në Zyren Ndërkombëtare.

KONTRATAT TREGTARE /KOMERCIALE

KONTRATA PËR SHITJEN

Baza juridike e rregullimit të kontratave të shitjes së mallrave mbështetet në Rregulloren e Shitjes së Mallrave dhe në Ligjin e Marëdhënieve Detyrimore.

Rregullorja e shitjes së mallrave bazohet kryesisht në Konventen e KB-së.

Kontrata e shitjes së mallrave është kontratë me e shpeshtë në qarkullimin juridiko-ekonomik dhe se pa të nuk mund të paramendohet qarkullimi i mirëfilltë i mallrave.

Veçoritë specifike në kontratat e shitjes së mallrave janë:

- palët kontraktuese në të shumtën e rasteve janë Shoqëritë Tregtare, personat juridikë dhe personat tjerë që merrën me veprimtarinë e ndersjelltë afariste;
- si rregull i kontratës së qarkullimit të mallrave paraqiten sendet e luajtshme të dedikuara për treg;
- në raste të caktuara, objekt i kësaj kontrate mund të jenë edhe paluajtëshmritë, si edhe disa të drejta (e drejta e pronës industriale);
- si rregull, këto kontrata janë joformale. Kontrata konsiderohet e lidhur nëse palët në çfardo mënyre kanë arritur pëlqimin për elementet esenciale të kontratës;
- këto kontrata janë të plotfuqishme nëse janë lidhur në formën me shkrim në raste kur është parashikuar ashtu.
- palët në afarizmin e qarkullimit të mallrave e ushtrojnë-kryejnë veprimtarinë e vet me shpërblim, pra nxjerrin përfitime, prandaj edhe përgjegjësia e tyre është më e gjerë kundrejt pjesëmarrësve tjerë në qarkullimin juridik. Pasi që këto i kryejnë nga veprimtaria e rregullt, supozohet se i njohin mirë rregullat e profesionit dhe janë të detyruar sipas tyre dhe të bartin rrezikun e përgjegjësiwe.

Kontrata e shitjes është kontratë detyrimore.- Me këtë kontratë krijohet raporti detyrimor në mes të palëve kontraktuese - blerësit dhe shitësit.

Kjo kontratë është kontrat konsesuale e cila lidhet thjeshtë në bazë të vullnetit të shitësit dhe blerësit të cilët merren veshë për objektin dhe çmimin, elemente këto esenciale të lidhjes së kontratës.

Elementet kryesore të kontratat e shitjes së mallrave janë: objekt i kontratës dhe çmimi dhe pa këto elemente nuk ekziston kontrata. Kontraktuesit mund me vullnetin e tyre ta zgjerojnë rrethin e elementeve thelbësore. Dallimi ndërmjet elementeve të parashikuara me ligj dhe vullnetin e palëve është vetëm në krijimin e tyre të cilat kushtëzojnë ekzistimin e kontratës.

Në këtë lloj kontrate, shitësi detyrohet që mallin që është t'ia dorëzoj blerësit, ashtu që blerësi të fitojë të drejtën e disponimit dhe pronësisë mbi mallin e shitur, dhe t'ia paguaj shitësit çmimin përkatës për atë mallë.

Formimi i kontratës së shitjes.-

Oferta:

Propozimi për lidhjen e kontratës paraqet një *ofertë*, nëse:

- a) *i drejtohet një apo më shumë personave specifkë;*
- b) *tregon qëllimin e ofertuesit për të qenë i lidhur (i obliguar) nga ajo ofertë, në rast të pranimit;*
- c) *përcakton cilësinë dhe sasinë e mallit; dhe*
- d) *përcakton çmimin e mallit në mënyrë të qartë apo tërthorzi.*

Oferta konsiderohet e efektshme në momentin kur ajo i arrinë të ofertuarit në selinë e tij të biznesit, apo nëse ajo nuk dihet, në rezidencën e tij.

Pranimi:

Pranimi paraqet një deklaratë të shprehur në mënyrë gojore apo në mënyrë tjetër, që qartë shpreh vullnetin e lirë për tu pajtuar me kushtet e paraqitura në një ofertë. Efektshmëria e pranimit fitohet në momentin kur ky pranim arrin të ofertuesi (paraqitësi i ofertës). Heshtja apo mosveprimi nuk paraqesin pranim të ofertës në kontratat e shitjes. Megjithatë, ka raste kur palët mund të merren vesh që heshtja për mosveprimin e njëres palë do të konsiderohet si pajtim apo pranim, edhe pse rastet e tilla janë të rralla. Pranimi gjithashtu mund të bëhet përmes një veprimi, nëse palët janë marrë vesh ashtu ose kanë krijuar praktika të tilla në kontrata të mëhershme.

Kundërofta.-

Ka raste kur përgjigja nuk paraqet pranim të ofertës, por kundëroftë. Një deklaratë që është përgjigje ndaj një oferte, por që paraqet elemente të ndryshme nga ato të paraqitura në ofertë, paraqet kundëroftë. Megjithatë, nëse e elementet që ndryshojnë nuk kanë rëndësi esenciale, atëherë, nuk konsiderohen refuzim dhe nuk përbëjnë kundëroftë. Elemente esenciale, në radhë të parë, konsiderohen pjesët e ofertës që

kanë të bëjnë me çmimin, cilësinë dhe sasinë e mallit, kohën e dorëzimit të mallit, mënyrën e zgjidhjes së mosëmarrveshjeve eventuale, etj.

Revokimi i ofertës dhe i pranimit.-

Si oferta ashtu edhe pranimi i saj mund të revokohen nëse plotësohen kushtet e caktuara. Oferta mund të revokohet nëse letra (apo informata) mbi revokimin e saj arrin te i ofertuari, para se ta nisë ai pranimin.

Është me rëndësi të theksohet se ka disa oferta që konsiderohen të parevokueshme:

- a) *në radhë të parë, oferta bëhet e parevokueshme nëse ajo përcakton kohën brenda së cilës mund të bëhet pranimi, pra cakton datën deri kur ajo ofertë duhet të pranohet më së largu,*
- b) *së dyti, oferta bëhet e parevokueshme, nëse mënyra se si është bërë ajo e ka shtyrë të ofertuarin të mbështetet në të dhe të besojë se ajo është e parevokueshme.*

Pranimi, në anën tjetër, mund të revokohet nëse letra (apo informata) për revokimin arrin te ofertuesi para pranimit apo në të njejtën kohë me pranimin.

Momenti i lidhjes së kontratës.-

Momenti i lidhjes së kontratës është kur pranimi i ofertës arrin efektshmerinë e vet. Pra, një kontratë konsiderohet përfundimisht e lidhur atëherë kur pranimi arrin te ofertuesi. Momenti i “arritjes” konsiderohet të jetë momenti kur vullneti për pranim i shprehet ofertuesit në mënyrë gojore apo i dërgohet atij personalisht, në adresën e biznesit të tij ose në rezidencën e tij.

Siç do të paraqitet më poshtë, që nga momenti i lidhjes së kontratës, për palët lindin të drejta dhe detyrime të caktuara, të cilat në rast se nuk përmbushen, mund të sjellin si pasojë kompensimin për dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar.

Të drejtat dhe detyrat e shitësit dhe të blerësit.-

Secila kontratë parasheh të drejta dhe obligime të caktuara për palët. Zakonisht, këto të drejta dhe obligime janë të barabarta, pra, asnjëra palë nuk është në pozitë të disfavorshme.

Të drejtat dhe detyrat e shitësit.-

Në çdo kontratë të shitjes obligimet kryesore të shitësit janë dorëzimi i mallit dhe i dokumenteve me anë të të cilave transferohet e drejta pronësore mbi atë mall. Në këmbim të kësaj, shitësi ka të drejtë në vlerën në para të atij malli, pra, ta pranojë pagesën e çmimit nga blerësi.

Shitësi ka për detyrë ta dorëzojë mallin në datën e përcaktuar me kontratë, por nëse palët nuk janë marrë vesh për këtë çështje, atëherë malli duhet të dorëzohet brenda afati të arsyeshëm. Afati i arsyeshëm përcaktohet varësisht nga rrethanat dhe lloji i

mallit. P.sh, nëse malli që shitet janë fruta apo ndonjë lloj ushqimi tjetër, atëherë afati i arsyeshëm konsiderohet të jetë shumë më i shkurtër se sa në raste kur mund të shitet materiali ndërtimor apo ndonjë mall tjetër që nuk prishet apo dëmtohet me kalimin e kohës.

Ndër obligimet më të rëndësishme të shitësit është edhe dërgimi i mallit që është në përputhje me kushtet e parapara në kontratë, sa i përket cilësisë, sasisë dhe përshkrimit. Konsiderohet se mallrat janë konform kontratës, nëse:

- a) *janë të përshtatshme me qëllimet për të cilat mallrat e përshkrimit të njëjtë zakonisht do të përdoren;*
- b) *janë të përshtatshme për çfarëdo qëllimi të veçantë për të cilin është njoftuar shitësi në kohën e nënshkrimit të kontratës;*
- c) *posedojnë cilësitë e mallrave të cilat shitësi i ka treguar blerësit si mostër ose model;*
- d) *janë të mbajtura apo të paketuara në mënyrën e zakonshme për mallrat e tilla në mënyrë që ato të ruhen dhe të mbrohen.*

Përveç kushteve të lartpërmendura, shitësi gjithashtu duhet të dërgoj mallin në të cilin nuk ka kërkuar apo të drejtën, personi i tretë dhe i cili nuk shkelë ndonjë të drejtë të pronës intelektuale.

Në rastë se blerësi nuk përmbush pjesën e tij të kontratës, atëherë shitësi ka të drejtë të kërkojë anulimin e kontratës. Ai mund ta shfrytëzojë këtë të drejtë vetëm nëse mospërmbushja e blerësit kualifikohet si shkelje fundamentale e kontratës. Kjo kryesisht lidhet me raste kur blerësi nuk paguan çmimin e mallit apo refuzon të pranohet mallin që shitësi i ka dërguar sipas kontratës. Shitësi poashtu ka të drejtë të kërkojë kompenzimin e dëmit që i është shkaktuar në rast se blerësi nuk kryen obligimet e veta.

Të drejtat dhe detyrat e blerësit.-

Detyrimi kryesor i blerësit është pagesa e çmimit për mallin që e dërgon shitësi, si dhe pranimi i atij malli. Detyrimi i blerësit për ta paguar çmimin përfshin ndërmarrjen e hapave dhe formaliteteve që parashihen me kontratë apo me ligj. Ka raste kur palët nuk janë marrë veshë për çmimin e saktë që duhet të paguhet, por thjesht pajtohen të paguhet çmimi i tregut në vendin e njëres apo tjetres palë. Në raste të tilla, blerësi duhet ta bëjë pagesën sipas mënyrës që është përcaktuar në kontratë. Blerësi poashtu duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e arsyeshme për të pranuar mallin që e dërgon shitësi.

Përveç dy detyrimeve kryesore të lartpërmendura, blerësi gjithashtu duhet të bëjë inspektimin apo ekzaminimin e mallit që ta shohë nëse ai përputhet me kërkesat e përcaktuara në kontratë. Në rast se ai vëren ndonjë mospërputhje në cilësinë apo sasinë e mallit, ka për obligim që menjëherë ta njoftojë shitësin. Nëse kjo ndodh, blerësi ka të drejtë të kërkojë nga shitësi dy gjëra: e para, ta zëvendësojë mallin, pra ta dërgojë mallin që përputhet me kërkesat cilësore, dhe së dyti, nëse nuk mund të dërgohet mall tjetër, të zbritet çmimi në proporcion me mungesat e mallit.

Sikurse shitësi, ashtu edhe blerësi, ka të drejtë të kërkojë anulimin e kontratës në rast të shkeljeve fundamentale nga ana e shitësit dhe mund të kërkojë kompensim të dëmit të shkaktuar nga ajo shkelje.

Pasojat për mospërbushjen e kontratës.-

Zakonisht, për çfarëdo shkelje të kontratës, pra, pa marrë parasysh seriozitetin e shkeljes, pala e dëmtuar ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmit të shkaktuar, si dhe të kërkojë fitimin e humbur.

Të drejtat më specifike për kompensim palët mund t'i kenë vetëm në rast të shkeljes fundamentale të kontratës. Shkelja e kontratës, e bërë nga njëra prej palëve, konsiderohet fundamentale nëse rezulton në dëmtim të tillë për palën tjetër në masën sa thellësisht ta zhvesh nga ajo që i takon me kontratë. Zakonisht kemi raste të tilla nëse shitësi ka dërguar mall jo konform me kontratën dhe vetëm nëse:

- malli nuk mund të shitet sërish në treg, dhe
- malli është tërësisht i pa përdorshëm.

Përkundër këtij standardi shumë të lartë për përcaktimin e shkeljes fundamentale, shumë gjykata kanë vendosur se ajo ekziston nëse pjesa dërmuese e mallit nuk përshtatet me kërkesat e blerësit.

Si pasojë e mospërbushjes së kontratës, secila nga palët mund të kërkojë anulimin e kontratës. Pas anulimit, shitësi e ka për detyrë të kthejë çmimin e paguar, ndërsa blerësi të kthejë mallin. Nëse, megjithatë, malli nuk mund të kthehet në gjendje të njëjtë, sepse është dëmtuar gjatë përdorimit, atëherë blerësi duhet ta kompensojë shitësin për dëmin e shkaktuar.

KONTRATA PËR TRANSPORTIN E MALLRAVE

Është kontratë me të cilën transportuesi detyrohet që të kryejë me shpërblim transportin e mallit në vendin caktuar, dërguesit ose personit të caktuar (marrësit). Karakteristikë e kësaj kontrate është ajo që, përveç kontraktuesve, mund të paraqitet edhe personi i tretë, pranuesi i dërgesës. Kontrata për transportin është kontratë reale e dyanshme me ngarkesë.

Detyrat kryesore të transportuesit janë:

- pranimi i mallit prej dërguesit dhe transportimi e atij malli deri në vendin e kontraktuar,
- ruajtja e mallit gjatë tërë kohës sa zgjatë transporti,
- plotësimi i urdhërave të dërguesit ose pranuesit të mallit, dhe
- dorëzimi i mallit të pranuesit pas përfundimit të transportit.

Transporti i mallit mund të kryhet me rrugë të ndryshme, kështu që, varësisht nga lloji i transportit, ekzistojnë lloje të ndryshme të kontratave për transportin, siç janë: kontrata për transport rrugor, kontrata për transport hekurudhor, kontrata për transport detar, kontrata për transport përmes lumenjve dhe liqeneve, dhe kontrata për transport të përzier.

INCOTERMET

Rregullat Incoterms (International Commercial Terms) apo Termat Ndërkombëtare Tregtare janë një seri e termave të para - përcaktuara komerciale botuar nga Dhoma Ndërkombëtare e Tregtisë (ICC), që janë përdorur gjerësisht në transaksionet tregtare ndërkombëtare apo proceset e prokurimit. Një seri e termave të tregtisë të paraqitura në formë të tri shkronjave lidhur me praktikatat kontraktuese të zakonshme të shitjes. Rregullat Incoterms janë të destinuara kryesisht për të komunikuar në mënyrë të qartë detyrat, kostot dhe rreziqet që lidhen me transportin dhe shpërndarjen e mallrave.

Rregullat Incoterms pranohen nga qeveritë, autoritetet ligjore dhe praktikuesit e gjithë botës për interpretimin e termave që përdoren më së shpeshti në tregtinë ndërkombëtare. Ato kanë për qëllim reduktimin ose heqjen e të gjitha pasigurive që lindin nga interpretimet e ndryshme të rregullave në vende të ndryshme. Si të tilla, ato janë përfshirë rregullisht në kontratat e shitjes në gjithë botën.

Botuar për herë të parë në vitin 1936, rregullat Incoterms janë azhurnuar periodikisht. Azhurnimi i fundit, ai i teti, është versioni Incoterms 2010 - pasi që është publikuar më 1 janar 2011.

Rregullat janë zhvilluar dhe mirëmbahen nga ekspertë dhe praktikantë që bëhen së bashku nga ICC dhe janë bërë standard në vendosjen e rregullave të biznesit ndërkombëtar.

Për më shumë, të gjitha kontratat e bëra sipas Incoterms 2000, do të mbeten të vlefshme edhe pas 2011. Për më tepër, edhe pse ne rekomandojmë përdorimin e Incoterms 2010, pas vitit 2011, palët në një kontratë për shitjen e mallrave mund të bien dakord për të zgjedhur çdo version të rregullave Incoterms pas 2011. Megjithatë, është e rëndësishme që të specifikojë qartë Incoterms zgjedhur versionin e vitit 2010 apo Incoterms 2000, apo ndonjë version më parë.

Incotermet 2010 kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2011.

Vetëm transporti tokësor i lundrueshëm dhe detar

CFR Shpenzimet dhe transporti i mallrave (porti i destinimit)

Shitësi duhet të paguajë kostot dhe transportin e mallrave në mënyrë që të sjellë mallrat në portin e destinuar. Megjithatë, rreziku transferohet tek blerësi në momentin që mallrat hyjnë brenda në anije. Vetëm transporti detar dhe sigurimi i mallrave NUK përfshihet. Sigurimi është në koston e blerësit.

CIF Shepnzimet, sigurimi dhe transporti i mallrave (porti i destinimit)

Pikërisht njëjtë si CIF përveç se shitësi duhet të sigurojë dhe paguajë për sigurimin për blerësin. Vetëm transporti detar.

FAS Pa pagesë pranë anijes (porti i caktuar për ngarkim)

Shitësi duhet të vendosë mallrat pranë anijes në portin e caktuar. Shitësi duhet t'i sigurojë mallrat për eksport. Të përshtatshme vetëm për transportin detar, por jo edhe për transportin e kombinuar detar në kontejnerë (shih Incoterms 2010, ICC Publikimi 715). Ky term është përdorur zakonisht për ngarkesa të rënda ose mallra masive.

FOB pa pagesë në anije (porti i caktuar për ngarkim)

Shitësi duhet vetë të ngarkojë mallrat në anijen e caktuar nga blerësi ku kostoja dhe rreziku do të ndahet në binarët e anijes. Shitësi, por JO transporti i kombinuar në kontejnerë (shih Incoterms 2010, botimi ICC 715). Blerësi është i obliguar që të udhëzojë shitësin për detajet e anijes dhe të portit ku mallrat do të ngarkohen dhe ku nu ka referenca apo rregulla për përdorimin e bartësit apo dërguesit. Ajo nuk përfshin transportin ajror. Ky term është keqpërdorur në masë të madhe gjatë tre dekadave të fundit, që nga viti 1980 ka paraparë që FCA duhet të përdoret për ngarkesat në kontejner.

Cila do mënyrë e transportit

CIP Ngarkesa dhe sigurimi paguhet (emërtimi i vendit dhe destinimit)

Transporti në kontejner/i kombinuar është ekuivalent me CIF. Shitësi paguan për ngarkesën dhe sigurimin deri në pikën e destinimit, por kur mallrat dorëzohen, rreziku klon te blerësi i parë.

CPT Ngarkesa i paguhet (emërtimi i vendit dhe destinimi)

Transporti gjeneral në kontejner/ i kombinuar është ekuivalent me CFR: Shitësi paguan për ngarkesën dhe sigurimin deri në pikën e destinimit, por kur mallrat dorëzohen, rreziku kalon te bartësi i parë.

DAP Dorëzuar në vendin (emërtimi i vendit)

Sipas DAP, dorëzimi bëhet kur shitësi ia vë mallrat në destinacionin e blerësit në vendin e caktuar, në veturën e cila është e gatshme për dorëzim (që do të thotë, nuk është dorëzuar ende).

DAT Dorëzuar në terminal (emërtimi i vendit)

Sipas DAP, dorëzimi bëhet kur shitësi vë mallrat në destinacionin e blerësit për praninë në terminalin e caktuar.

DDP Dorëzuar, detyrimi është paguar (emërtimi i vendit të destinuar)

Ky term nënkupton që shitësi paguan për të gjitha shpenzimet e transportit dhe ka barrën e rrezikut deri në dorëzimin e mallrave dhe pagesës së detyrimit. Gjithashtu, përdoret në shkëmbim me termin “vendbanimi i lirë”, term më i kompletuar për blerësin. Në shumicën e vendeve importuese, taksat sikurse që janë (po jo vetëm ato) TVSH-ja dhe akcizat nuk duhet të konsiderohen si parapagim që është kryer si taksë përfunduese. Prandaj, TVSH-ja dhe akcizat zakonisht nuk paraqesin shpenzim të drejtpërdrejtë për importuesin, pasi që ato do të kompensohen me shitjen e tyre në tregun vendor.

EXË Es Ëorks (emërtimi i vendit)

Shitësi i vë mallrat në disponim në lokacionin e vet. Blerësi është përgjegjës për të gjitha shpenzimet. Ky term tregtar vë përgjegjësinë më të madhe te blerësi dhe detyrimet më të vogla te shitësi. Ky term shpesh herë përdoret kur bëhen koutimet fillestare për shitjen e mallrave pa ndonjë shpenzim të përfshirë. Ky term nënkupton se shitësi i ka të gatshme mallrat për marrjen në datën sipas marrëveshjes. Blerësi paguan të gjitha shpenzimet e transportit dhe gjithashtu mban rrezikun për sjelljen e mallrave në destinimin përfundimtar.

FCA Transporti i lirë (emërtimi i vendit)

Shitësi i dorëzon në kujdestari bartësit të parë (të caktuar nga blerësi) mallrat e gatshme për eksport, në vendin e caktuar. Ky term është i përshtatshëm për të gjitha format e transportit, duke përfshirë bartjen me avion, tren, rrugë dhe në transport detar në kontejnerë/të kombinuar. Kjo është “mbledhje kargo”, term ky i cili përdoret për ngarkesat detare në kontejner, si LCL apo FCL.

KONTRATA PËR LICENCËN

Me këtë kontratë, dhënësi i licencës detyrohet t'ia kalojë marrësit të licencës, në tërësi ose pjesërisht, të drejtën e shfrytëzimit të shpikjes, patentës, përvojës dhe dijes teknike, mostrës ose modelit, kurse fituesi i licencës detyrohet që për këtë t'ia paguajë atij një kompensim të caktuar.

Pra, licenca është formë juridike e kalimit të autorizimit për shfrytëzimin-përdorimin e objektit të së drejtës së pronësisë industriale, p.sh. kalimin e së drejtës së shfrytëzimit të modelit të mbrojtur, patentës, dijes dhe përvojës. Kjo kontratë mund të lidhet në kohë të pacaktuar ose në kohë të caktuar prej 5-10 vjetësh

Kontrata e licencës (licenca e kontraktuar) është formale dhe ajo mund të jetë e rëndomtë, ekskluzive dhe e përzier.

Licenca e rëndomtë.- I jep shfrytëzuesit të drejtën e shfrytëzimit të objektit të licencës në përputhje me kontratën, por dhënësi i licencës e ruan të drejtën që licencën për të njëjtin objekt t'ua jep personave të tjerë, përkatësisht, ruan të drejtën që të shfrytëzojë vetë atë.

Licenca ekskluzive.- I jep shfrytëzuesit të drejtën ekskluzive të shfrytëzimit të objektit të asaj licence, ashtu që dhënësi i licencës nuk ka të drejtë që licencën për të njëjtin objekt t'ua japë personave të tjerë dhe as nuk ka të drejtë ta shfrytëzojë vetë objektin e licencës.

Licenca e përzier.- Është ajo me të cilën shfrytëzuesit të licencës i jepet e drejta ekskluzive e objektit të licencës në një rajon, kurse e drejta joekskluzive në rajonin tjetër. Nëse në kontratë për licencën nuk është përcaktuar lloji i licencës, atëherë konsiderohet se kemi të bëjmë me licencë të rëndomtë.

KONTRATA PËR DEPOZITËN

Kontrata për depozitën është një lloj i kontratës për shërbimin me anë të së cilës depozitari apo ruajtësi detyrohet që sendin që e ka dorëzuar deponenti (lënësi) ta ruajë dhe t'ia kthejë deponentit pas kalimit të kohës së caktuar. Ky shërbim kryhet pa shpërblim ose në rast të caktuar paraprakisht, përcaktohet shpërblimi adekuat me kontratë. Në kontratën për depozitën, depozitari ka të drejtë që thjesht ta ruajë lëndën e depozitës, pra nuk fiton të drejtën e pronësisë mbi atë lëndë.

Një lloj i veçantë i kontratës për depozitën është kontrata për *depozitat financiare* me të cilën banka detyrohet që të pranojë, kurse depozituesi të depozitojë në bankë një shumë të caktuar të hollash. Në këtë kontratë banka është depozitari dhe e fiton të drejtën t'i depozitojë të hollat e depozitara. Banka hap llogarinë e klientit të vet në dobi dhe në barrë të të cilit regjistrohen kërkesat dhe borxhet lidhur me shumën e depozituar. Me kërkesë të klientit, banka është detyruar t'ia kthejë atij shumën e depozituar.

KONTRATA PËR MAGAZINIM

Me anë të kësaj kontrate magazinieri detyrohet ta pranojë, strehojë dhe ta ruajë mallin, që i takon palës tjetër dhe të veprojë sipas urdhërave të saj, kurse ajo kontratë është reale, e dyanshme, me ngarkesë. Me punët e magazinimit mund të merren vetëm subjektet ekonomike.

Detyrimet e magazinierit janë:

- të publikojë kushtet e përgjithshme në të cilat e merr mallin për strehim dhe ruajtje;
- të mbajë libra afaristë, posaçërisht ditarin e magazinimit;
- të marrë në ruajtje dhe magazinimin e ofruar, nëse merret me magazinimin dhe ruajtjen e atij të mallit dhe nëse e ka të angazhuar ambientin e magazinës;
- t'ia kompensojë të gjitha dëmet komitentit, përveç atyre të cilat kanë ardhur si pasojë e të metave vetjake ose fuqisë madhore;
- ta shesë mallin në rast urgjence dhe për këtë sa më shpejt ta njoftojë komitentin, të cilit ia lëshon fletëmagazinimin, nëse është fjala për magazinë publike, si dhe
- të veprojë sipas urdhërit të komitentit në lidhje me mallin e magazinuar, p.sh. të sigurojë mallin, t'ia dorëzojë mallin e personit të tretë, etj.

Të drejtat e magazinierit janë:

- e drejta e provizionit për ruajtjen e provizionit për ruajtjen e mallit, dhe;
- e drejta e kompensimit të shpenzimeve të domosdoshme të shkaktuara nga ruajtja e mallit.

Për sigurimin e të drejtave të veta, respektivisht për pegesën e provizionit dhe të shpenzimeve, magazinieri i përket e drejta ligjore e pengut dhe e retencionit të mallit të depozituar.

Kemi disa lloje të magazinave: magazina doganore, magazina publike, magazina e lirë doganore dhe magazina e kosignacionit.

KONTRATA PËR URDHËRIN

Kontrata për urdhërin ndryshe njihet edhe me emrin kontratë për dekretin. Në këtë kontratë dekretmarrësi merr për detyrë të kryejë punë të caktuara në llogari të dekretdhënësit. Kjo kontratë mund të përfshijë kryerjen e punëve faktike ose juridike nëpërmes një personi të tretë të veçantë. Kjo është një kontratë e dyanshme, konsensuale që krijon të drejtat dhe detyrime për të dyja palët, pra dekretdhënësi dhe dekretmarrësin. Gjithashtu, është kontratë me shpërblim dhe komutative.

KONTRATA PËR KOMISIONIN

Kontrata për komisionin është kontratë joformale edhe pse rekomandohet të jetë e formës së shkruar. Me anë të kësaj kontrate një person (komisioner) detyrohet që me kompensim (provizion), të lidhë kontratë në emër të vet dhe për llogari të tjetrit (komitentit), kurse komitentit detyrohet që komisionarit për këtë t'ia paguajë provizionin e kontraktuar. Në qarkullimin e mallrave komisionet paraqiten si komisione të shitjes, të blerjes dhe të transportit, të cilat njihen si komisione të rregullta, ku komisionari përgjigjet vetëm për zgjedhjen e ndërgjegjshme të personit të tretë, me të cilin lidh kontratë, por nuk përgjigjet për kompensimin e detyrimit nga personi i tretë.

Detyrimet e komisionarit janë:

- të zbatojë urdhërin me kujdesin e ekonomistit të mirë,
- të veprojë sipas urdhërave të komitentit,
- t'i mbrojë interesat e komitentit,
- të ruajë mallin e komitentit,
- të informojë komitentin për të gjitha faktet dhe rrethanat me rëndësi lidhur me zbatimin e urdhërit të komitentit,
- t'i japë llogari komitentit për urdhërin e zbatuar, dhe
- t'ia dorëzojë komitentit të gjitha fitimet për punën e kryer.

Të drejtat e komisionarit janë:

- e drejta e provizionit,
- e drejta e kompensimit të shpenzimeve, dhe
- e drejta e pengut.

KONTRATA PËR PËRFAQËSIM TREGTAR

Sipas kësaj kontrate, përfaqësuesi tregtar detyrohet që të kujdeset gjithmonë që personat e tretë të lidhin kontrata me urdhërdhënësin e tij dhe në atë kuptim, të ndërmjetësojë midis tyre, si dhe me të marrë të autorizimit, të lidhë kontrata me persona të tretë, në emër dhe për llogari të urdhërdhënësit, kurse ky i fundit detyrohet që përfaqësuesit t'ia paguajë kompensimin e caktuar (provizionin e përfaqësimit).

Edhe kjo kontratë është joformale, e dyanshme me ngarkesë, e cila mund të lidhet vetëm duke i dhënë urdhër përfaqësuesit tregtar.

Detyrimet e përfaqësuesit tregtar janë:

- që gjatë realizimit të kontratës të paraqitet si ekonomist i mirë;
- t'iu përmbahet udhëzimeve të urdhërdhënësit;
- të lajmërojë urdhërdhënësit për të gjitha ngjarjet me rëndësi;

E DREJTA TREGTARE

- t'i mbrojë interesat e urdhërdhënësit;
- të ruajë fshehtësinë afariste;
- të mbajë librat afaristë;
- të lëshojë vërtetimin për punën e kryer; etj.

Të drejtat e përfaqësuesit tregtar janë:

- e drejta e provizionit;
- e drejta e kompensimit të shpenzimeve të veçanta; dhe
- e drejta e paradhënies lidhur me shpenzimet, me qenë se përfaqësimi është veprimtari që kryhet në kohë të vazhduar.

KONTRATA PËR NDËRMEJTËSIMIN

Kontrata për ndërmjetësimin është kontratë e tillë e qarkullimit të mallrave, në bazë të së cilës ndërmjetësuesi detyrohet që palën tjetër – komitentin, ta sjellë në kontakt me ndonjë person tjetër të tretë, me qëllim që komitenti të lidhë me të ndonjë kontratë të qarkullimit të mallrave. Është karakteristike se kjo është një kontratë e dyanshme me ngarkesë, joformale dhe zakonisht, është kontratë sipas qasjes, kurse urdhërdhënësi detyrohet ta paguajë një provizion të caktuar për ndërmjetësim.

Detyrimet e ndërmjetësimit janë:

- gjetja e partnerit përkatës afarist për komitentin e vet;
- mbrojtja dhe ruajtja e interesave të komitentit dhe të personave të tretë;
- ruajtja e fshehtësisë afariste,
- mbajtja e ditarit të ndërmjetësimit;
- ruajtja e mostrave dhe kujdesit që ato të mos ngatërrohen (nëse lidhja e kontratës është bërë me anë të mostrave).

Të drejtat e ndërmetësuesit janë:

- e drejta e provizionit dhe
- e drejta e kompensimit të shpenzimeve, nëse këto janë paraparë shprehimisht me kontratë.

KONTRATA PËR FRASHINZINGUN

Kontrata mbi frashizingun është kontratë e dyanshme detyruese, ngase palëve kontraktuese i krijon të drejta dhe detyra. Është kontratë me prestime të përhershme, sepse marrëdhëniet e krijuara në bazë të kësaj kontrate, zgjasin disa vjet. Prestimet midis frashizingdhënsit dhe frashizingmarrësit zgjasin prej krijimit të kësaj kontrate deri në shuarjen e saj. Kjo kontratë është kontratë kumulative, sepse palët kontraktuese konkretisht dhe me afër i dinë të drejtat dhe detyrat e veta.

Është kontratë me të cilën midis dy subjekteve ekonomike si palë kontraktuese vendoset marrëdhënia afariste për një kohë më të gjatë, gjatë së cilës dhënësi i franshizës i jep pranuesit të saj një grup të caktuar të shërbimeve afariste dhe të drejtave të mbrojtura, të cilat pranuesi i franshizës ka të drejtë t'i shfrytëzojë në afarizmin e vet, në kushte saktësisht të përcaktuara dhe me kompensim të kontraktuar.

Kontrata mbi frashizingun është kontratë me shpërblim, sepse çdo palë kontraktuese për atë çka merr kjo kontratë jep kundërshpërblim të caktuar.

Kontrata mbi frashizingun është kontratë formale, sepse duhet të përpilohet në formën me shkrim dhe të nënshkruhet nga palët kontraktuese. Këtu duhet theksuar se kjo dispozitë është diç më tepër se dispozita për sanksionimin e formës së kontratës.

Për lidhjen e çdo kontrate në të drejtën civile duhet të plotësohen këto kushte. Pra duhet të ekzistojë pajtimi i vullnetit të palëve kontraktuese, lënda e kontratës, baza e kontratës, aftësia punuese e palëve.

Objektet e franshizës munt të jenë: emri tregtar, ose ndonjë shenjë e jashtme, dija dhe përvoja teknike ose afariste, shkollimi i kuadrove të pranuesit të franshizës, konsultimet përkatëse gjatë afarizmit në bazë të franshizës, etj.

Franshizën zakonisht ua japin subjekteve të tjera ekonomike firmat e suksesshme të cilat janë të njohura në treg për mallra ose shërbime të caktuara (franshiza prodhuese, tregtare ose afariste). Në këtë mënyrë krijohet një zinxhir i tërë subjektesh ekonomike të lidhur me të njëjtin dhënës të franshizës, të cilat punojnë në mënyrë të pavarur, por që njihen në mënyrë unike në treg.

Frashizingu afarist më shpesh paraqitet si vijon.-

Frashizingu prodhues.- Është lloj i veçantë i kontratës mbi frashizingun. Ekziston kur në bazë të kontratës mbi frashizingun, frashizingdhënësi i bart frashizingmarrësit prodhimin e caktuar të mallit, p.sh. prodhimi i Coca colës, prodhimi i ushqimit të shpejtë (McDonald's), prodhimi i Pepsi Colës.

Frashizingu afarist (për qarkullim).- Frashizingu afarist ose për qarkullim është lloj i veçantë i kontratës mbi frashizingun. Me anë të kësaj kontrate bëhet qarkullimi i caktuar i prodhimeve ose mallrave të caktuara. Kontratat për frashizingun afarist ose për qarkullim vijnë në shprehje në shumë lëmi. Këtë e themi, sepse zbatohet në lëmin e prodhimit të automobilave dhe mjeteve të ndryshme motorike, në shitjen e

tyre, në shitjen e pijeve të ndryshme alkoolike dhe joalkoolike, me shitjen e benzinës ose në shitjen e ushqimit të përgatitur shpejt.

Frashizingu për dhënieën e shërbimeve.- Frashizingu për dhënieën e shërbimeve të caktuara është lloji i veçantë i kontratës mbi frashizingun. Kjo kontratë supozon kontratën mbi frashizingun midis frashizingdhënieës dhe frashizingmarrësit, sepse me këtë bart të drejta për dhënieën e shërbimeve nga ana e frashizingmarrësit. Zakonisht, këto shërbime janë në lëmin e organizimit të pastrimit kimik, në lëmin e turizmit, në lëmin e dhënieës së kredisë dhe marrëdhënieve kreditore, në lëmin e dizajnit industrial etj.

KONTRATA PËR LIZING

Është një kontratë sipas së cilës dhënieësi i lizingut detyrohet që shfrytëzuesit të lizingut t'ia dorëzojë për shfrytëzimin të përkohshëm ndonjë send (ose grup sendesh), kurse ky detyrohet që dhënieësit t'ia paguajë kompensimin e caktuar, me të drejtën që shfrytëzuesi i lizingut, pas skadimit të afatit të lizingut, ta blejë atë send ose ta vazhdojë lizingun.

Objekt të lizingut janë rëndom sendet (pajisjet, pajimet, automjetet, etj). Dhënieësi i lizingut, përveç dorëzimit të sendit, ka për obligim edhe mirëmbajtjen, montimin, aftësimin e kuadrit të shfrytëzuesit të lizingut. Rëndësi të madhe ka lizingu financiar, i cili mundëson kreditimin për furnizimin e sendit të caktuar.

Kemi disa lloje të lizingut dhe këto sipas natyrës së objektit të lizingut:

- lizingu i sendeve të konsumueshme (automjete, aparatet emëvisërisë);
- lizingu investues, që jepet në formë të pajimeve (makinave investive);
- lizingu i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme;
- lizingu sipas kohëzgjatjes (që mund të jetë afatshkurtër dhe afatgjatë);
- lizingu sipas pozitës së dhënieësit të lizingut (lizingu që e realizojnë shoqëritë e lizingut, lizingu i koncerneve dhe lizingu i prodhuesit financiar).

KONTRATA MBI “KNOË-HOË”

Kontrata “knoë hoë” (mbi bartjen) është një grup dijesh (idesh) dhe përvojash të caktuara të cilat janë të zakonshme në një lëmi të teknikës, në afarizmin në përgjithësi dhe është produkt i praktikës afariste amerikane, të cilat sot janë pranuar në tërë botën e afarizmit.

Me lidhjen e kontratës mbi “knoë-hoë” krijohet marrëdhënie juridike ndërmjet bartësit të dijesh dhe të përvojës dhe fituesit, shfrytëzuesit të dijesh dhe të përvojës, ku bartësi obligohet që të cedojë dije dhe përvojë të shfrytëzuesit, kurse shfrytëzuesi obligohet që të shfrytëzojë këtë dije dhe përvojë, duke paguar shpërblim të caktuar. Nga ky përkufizim padyshim rrjedh se dija dhe përvoja mund të bartet në bazë të kësaj kontrate.

Me kontratën “knoë-hoë” njëra palë kontraktuese detyrohet t’ia bartë dijen apo përvojën afariste në pikëpamje të teknikës apo teknologjisë, si dhe dijen e saj afariste dhe financiare te pala tjetër, kurse pala tjetër obligohet që asaj, për këtë, t’ia paguajë shpërblimin e kontraktuar në bazë të shfrytëzimit të fshehtësisë afariste.

Bartesi i knoë-hoë, me anë të këtij institucioni civil bart dije dhe përvojë në lëmin e teknikës, në lëmin e financave, në lëmin e rrjedhave në treg, në lëmin e rrjedhave të administratës, në rrjedhat e prodhimit, në rrjedhat e propagandës ose reklamimit, në lëmin e inzhinjerit, në lëmin e ndërtimit së ulët dhe të lartë etj.

Këtë “knoë-hoë” të krijuar titullari e ruan si sekret të vetin për kryerjen e aktivitetit të vet me cilësi të duhur. Në qoftë se dija dhe përvoja i bartet personit tjetër, atëherë “knoë-hoë” humb karakterin sekret ndaj personave të tretë, ose më së paku ndaj shfrytëzuesit të dijesh dhe përvojës konkrete.

Parimisht mund të thuhet se kontrata mbi “knoë-hoë” është kontratë pa emër, sepse ende nuk është sanksionuar në shumicën e ligjeve në mënyrë transparente ose të qëndrueshme. Meqë duhet thënë se doktrina juridike dhe praktika gjyqësore dhe pjesërisht disa ligje, atë e sanksionojnë ose atë e përkrahin.

Kontrata mbi “knoë-hoë” është kontratë e dyanshme detyruese, sepse i krijon të drejta dhe detyra bartësit dhe shfrytëzuesit të dijesh dhe përvojës së caktuar.

Kjo kontratë e përmendur, dija dhe përvoja e bartur, u sjellin përparësi përkatëse palës kontraktuese para konkurrentëve të saj, që nuk i dinë këto përvoja. Pra, i mundëson kontraktuesit ta posedojë dijen se si duhet të veprohet konkretisht në prodhimin ose në afarizëm në përgjithësi.

“Knoë-hoë” ka lindur në lëmin e teknikës dhe zhvillimin e saj e ka përfaqësuar nga shpikja e patentuar. Por më vonë ai e ka fituar përmbajtjen me të pasur dhe kuptimin më të gjerë, kështu që, përveç lëmisë së teknikës ka filluar të paraqitet si faktor i rëndësishëm në afarizmin ekonomik, duke u bërë i domosdoshëm për organizimin e punës dhe afarizmit, atë financiar, komercial, për marketing, arsimimin e kuadrove dhe lëmin e afarizmit etj.

Kjo është kontratë formale që nuk e gëzon mbrojtjen e drejtpërdrejtë juridike, sepse nuk është e paraparë shprehimisht me ligj, por në disa përmbajtje mbrohet veç e veç në bazë të fshehtësisë afariste të ndërmarrjes.

KONTRATA PËR MENAXHMENT

Sipas kësaj kontrate, pronari i ndërmarrjes ose vetëm ndërmarrja ia beson një personi tjetër menaxhimin dhe kontrollin e afarizmit të asaj ndërmarrjeje për një periudhë dhe kompensim të caktuar.

Menaxhimi i ndërmarrjes më së shpeshti i besohet ndërmarrjes së specializuar për llojin përkatës të veprimtarisë, pra që ofron dije dhe përvojë në fushën e planifikimit, organizimit, financave, marketingut dhe të ngjashme, e cila në këtë punë paraqitet si menaxhuese dhe operatore. Ndërmjet kontraktuesve krijohet marrëdhënia afariste. Në këtë mënyrë, ndërmarrjes i mundësohet shfrytëzimi i përvojës dhe dijes së huaj për menaxhim, duke u krijuar kështu për një afarizëm dhe zhvillim më të suksesshëm të saj. Kohëzgjatja e kontratës është zakonisht prej 2-5 vjet, me mundësi përsëritjeje.

ZGJIDHJA JASHTËGJYQËSOSE E KONTESTEVE EKONOMIKE

Në botën bashkëkohore të afarizmit dhe teknologjisë, bizneset kanë interes për zgjidhjen e kontesteve jashtë procedurës gjyqësore. Një vëmendje e posaçme është përqendruar në marrëveshjet paraprake, të cilat në shumicën e rasteve e përjashtojnë juridiksionin e gjykatave. Opsionet të cilat janë në dispozicion të palëve, përveç gjykatave, si forma alternative janë:

- negociimi;
- ndërmjetësimi dhe
- arbitrazhi.

Në terminologjinë juridike të sotme këto zgjidhje quhen Metoda Aternative për Zgjedhjen e Kontesteve. Në botën bashkëkohore të afarizmit dhe teknologjisë, bizneset, më shumë se kurdoherë, janë të prira për t'i zgjidhur kontestet jashtë procedurës klasike gjyqësore. Një vëmendje e posaçme është përqendruar në marrëveshjet paraprake, me ç'rast palët pajtohen lidhur me llojin e mekanizmit për zgjidhjen e kontestit i cili do të shfrytëzohet në rast të paraqitjes së ndonjë kontesti mes tyre. Këto marrëveshje paraprake, në shumicën e rasteve, shprehimisht e përjashtojnë juridiksionin e gjykatave. Në dekadat e kaluara, megjithatë, bizneset po vetëdijësohen për rëndësinë e zgjidhjes së kontesteve të tyre në mënyrë joformale dhe ndërmarrin të gjithë hapat e nevojshëm për t'iu shmangur procedurave gjyqësore.

Megjithatë, nevojat dhe synimet e biznesit ndryshojnë varësisht nga lloji i transaksionit. Është me rëndësi të vlerësohet se cila mënyrë e zgjedhjes së kontestit i përgjigjet më mirë transaksionit në fjalë. Kjo e imponon nevojën për përfshirjen e klauzolave të ndryshme të Zgjidhjeve Alternative të Kontesteve në kontratat “shabllon” të kompanive. Në shumicën e rasteve, kompanitë zgjedhin një lloj të Zgjidhjeve Alternative të Kontesteve dhe në kontratë përfshijnë klauzola të cilat rregullojnë të gjitha kontestet eventuale ndërmjet palëve. Megjithatë, ka raste, siç janë kontratat komplekse me shumica të mëdha parash, kur aplikohet një proces me shumë nivele për zgjidhjen e kontesti. Për shembull, klauzola për zgjidhjen e kontestit mund ta përcaktojë përdorimin edhe të ndërmjetësimit edhe të arbitrazhit, ose mund të fillojë duke përcaktuar se zgjidhja e kontestit do të bëhet me anë të negociatave me mirëbesim mes palëve dhe më pas të vazhdojë me ndërmjetësim, si zgjidhje e dytë dhe të përfundojë, me arbitrazhin si zgjidhje e fundit.

ARBITRAZHI

Arbitrazhi është një nga mënyrat alternative dhe e fikase të zgjedhjes së kontesteve, i cili mund të plotësojë nevojat e kompanive për zgjedhje të shpejtë të kontesteve. Arbitrazhi është procedurë e cila ditëve të tashme globalisht dominon në kontestet në mes të bizneseve, individëve, dhe shteteve. Kontestet më të komplikuar dhe me vlera më të mëdha zgjidhen nga Tribunalet e arbitrazheve nëpër botë. Procedura e arbitrazhit është transparente dhe ofron mjete të kontrollit të procedurës nga palët. Procedura është e paraparë me rregullat e arbitrazhit, por kohëzgjatja, administrative i provave dhe çështjeve të tjera mund të vendosen me pajtimin e palëve në konteste. Palët kanë të drejtë të zgjedhin arbitrit.

Kosova nuk ka histori të gjatë të përdorimit të arbitrazhit si mekanizëm për zgjedhjen e kontesteve. Ka raste shumë të rralla kur bizneset parashohin arbitrazhin në rast të mosmarrëveshjeve eventuale, edhe pse kohëve të fundit numri i këtyre rasteve po rritet, në veçanti kur palët në kontratë vijnë nga dy vende të ndryshme, pra kur kemi marrëveshje me element ndërkombëtar.

Nevoja për promovimin e arbitrazhit si alternativë ndaj gjykatave është e evidente, në veçanti për shkak të stërngarkesës së gjykatave me lëndë, të përparësive që i ofron arbitrazhi, të përshtatshmërisë së arbitrazhit për zgjedhjen e kontesteve ekonomike, të mundësisë së palëve të përcaktojnë procedura me shumë më pak formalitete, dhe shumë përparësi të tjera. Si rezultat i kësaj, dhe duke e parë nevojën për përkrahjen e metodave alternative për zgjedhjen e mosmarrëveshjeve, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për Arbitrazhin.

Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit në Odës Ekonomike të Kosovës

Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit (TPA), është i themeluar nga Kuvendi i Odës Ekonomike (OEK) të Kosovës dhe është në përputhje me Ligjin për Arbitrazhin dhe Ligjin për Odën Ekonomike të Kosovës.

Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit funksionon në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës.

Tribunali i Arbitrazhit themelohet pas inicimit të procedurës së arbitrazhit dhe përbëhet nga një ose tre arbitra.

Në Tribunalin Përhershëm të Arbitrazhit në Odën Ekonomike të Kosovës zgjidhen kontestet ekonomike në mes të shoqërive tregtare/biznisore të regjistruara në Kosovë në ARBK apo jashtë saj, pavarësisht statusit të tyre (biznes individual, ortakëri e përgjithshme, shoqëri komandite, shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, apo shoqëri aksionare).

Përparësitë dhe mangësitë e arbitrazhit

Ekzistojë shumë përparësi të arbitrazhit si mekanizëm për zgjidhjen e kontesteve. Megjithatë, ka edhe disa shqetësime të perceptuara lidhur me shfrytëzimin e arbitrazhit nga bizneset. Efikasiteti në shpenzime dhe kohë, ruajtja e fshehtësisë (kofidencialiteti), fleksibiliteti, parashikueshmëria, neutraliteti dhe ekspertiza e arbitrave, natyra përfundimtare e vendimeve dhe ekzekutimi më i lehtë i vendimeve, janë disa prej përparësive të perceptuara të arbitrazhit. Sidoqoftë, një numër i madh i bizneseve e konsiderojnë fleksibilitetin – mundësinë për ta përshtatur arbitrazhin sipas nevojave dhe rrethanave specifike – si përparësinë më të madhe të arbitrazhit. Dobitë dhe shqetësimet potenciale të arbitrazhit ndryshojnë varësisht nga kompania, transaksioni dhe nga kontesti. Për më tepër, përderisa disa veti të arbitrazhit konsiderohen si të përparësisë nga disa biznese (p.sh vendimi përfundimtar pa mundësi ankese ose heqje dorë nga mbrojtja procedurale), disa të tjerë i shohin këto veti pengesë. Në anën tjetër, edhe pse në shumicën e rasteve thuhet se arbitrazhi kushton më lirë se procedura gjyqësore, ka raste kur shpenzimet janë të barabarta.

Përzgjedhja e llojit të duhur të arbitrazhit

Palët gëzojnë mjaft fleksibilitet lidhur me përcaktimin e procedurës dhe nivelit të formalitetit. Kështu që, edhe kur një kërkesë është paraqitur para Tribunalit të Arbitrazhit palët mund të vendosin për llojin specifik të arbitrazhit që ata dëshirojnë.

Pasi që palët janë përcaktuar për arbitrazhin si formën e dëshiruar për zgjidhjen e kontesteve, ata duhet të vendosin nëse dëshirojnë të arbitrojnë në bazë të rregullave të një instituti të arbitrazhit, apo të procedurave ad-hoc.

Arbitrazhi institucional.- Ky lloj i arbitrimit ka një numër përparësish, prej të cilave veçohet mundësia e përfshirjes së rregullave të institucionit të zgjedhur të

arbitrazhit në kontratë. Për këtë arsye, në vend se të hartohet nga fillimi, palët mund të mbështeten në rregullat e arbitrazhit të një institucioni të caktuar, të cilat janë formuluar nga profesionistët. Edhe një përparësi është klauzolë shabllon i arbitrazhit i cili ofrohet nga institucionet arbitruese. Në shumë raste, palët e shikojnë klauzolën shabllon të siguar nga institutet dhe thjesht e përfshijnë në kontratë. Një gjë e tillë i shmang konfliktet eventuale lidhur me vlefshmërinë e klauzolës, të cilat mund të shfaqen nëse klauzola nuk është hartuar saktë nga palët. Përzgjedhja e arbitrave është, padyshim, një prej përparësive me të rëndësishme që ofron arbitrazhi institucional. Në vend të ballafaqimit të mundshëm në mes të palëve lidhur me përzgjedhjen e arbitrave, është më lehtë që ketë shërbim ta ofrojë agjencia administruese. Institucionet e arbitrazhit janë shumë të avancuara në këtë aspekt dhe posedojnë lista me arbitër të cilët zakonisht janë më të mirët që mund të emërohen. Përveç kësaj, përmes arbitrazhit institucional, palët nuk kanë nevojë të negociojnë çmimin e arbitrit. Këtë ua lënë institucionit dhe e lirojnë veten nga kjo barrë. Edhe përparësi tjetër e këtij lloji të arbitrazhit është respekti gjyqësor kundrejt integritetit të vendimeve të marra nga institucioni i arbitrazhit. Është më shumë e mundshme që gjykata ta lë anash vendimin e një arbitrazhi ad hoc se sa të një arbitrazhi institucional. Edhe një karakteristikë tjetër e dobishme e arbitrazhit institucional është mundësia e dëgjimit të lëndës dhe marrjes së vendimit, edhe nëse njëra palë dështon të paraqitet. Kjo mundësi e procedimit, në mungesë të palës së sfiduar, zakonisht është e përfshirë në rregullat e arbitrazhit të institucioneve të ndryshme. Në anën tjetër, një vendim i tillë është shumë vështirë të zbatohet në arbitrazhet ad hoc.

Arbitrazhi Ad Hoc.- Përparësia kryesore e ofruar nga kjo formë e arbitrazhit është fleksibiliteti. Palët kanë të gjithë hapësirën e nevojshme për të marrë vendime lidhur me procedurat dhe ta përshtatin procesin sipas dëshirave dhe nevojave të tyre. Një përparësi tjetër janë shpenzimet. Arbitrazhi ad hoc zakonisht kushton më pak se një arbitrazh institucional, pasi që palët nuk kanë nevojë t'i paguajnë shpenzimet institucionale, por thjesht të negociojnë çmimin e shërbimeve të arbitrave. Për më tepër, arbitrazhi ad hoc është vlersuar si më i shpejtë se arbitrazhi institucional, sepse nuk ka nevojë t'i kalojë procedurat të cilat zakonisht marrin kohë.

Arbitrazhi i përgjithshëm.- Është një veçori e re e arbitrazhit, kryesisht i shfrytëzuar në procese të arbitrazhit ndërkombëtar. Ekzistojnë vetëm një numër i vogël institucioneve të cilat kanë përfshirë dispozitat e arbitrazhit të përshpejtuara në rregullat e tyre procedurale. Për këtë arsye, kjo veçori e re nuk mund të hyjë në fuqi, përveç nëse palët e kanë paraparë atë në klauzolën e tyre të arbitrazhit. Është më e preferuar që vetë institucionet të ofrojnë rregulla specifike të cilat do të aplikoheshin në rast të proceseve të përjashtuara. Këto procedura do të shkurtonin kohën e paraqitjes së kërkesave, përgjigjeve dhe dokumenteve të tjera relevante, si dhe do të përcaktonte procedurën që duhet ndjekur nga kolegji arbitrues. Për më tepër, institucionet duhet të sigurojnë që proceset e përshpejtuara të lejohen vetëm për raste të caktuara dhe duhet të sigurojnë dispozita që qartësojnë se cilat janë këto raste. Tribunalit duhet t'i jepet

kompetenca për të vendosur anash çdo çështje e cila është trajtuar në mënyrë jo të mirëfilltë në formën e përjashtuar.

Marrëveshja e Arbitrazhit

Arbitrazhi zakonisht përfshihet në klauzolën e zgjedhjes së forumit për të treguar marrëveshjen e palëve mbi përdorimin e kësaj forme për zgjedhjen e kontesteve eventuale mes tyre. Siç është cekur më lart, arbitrazhi mund të përdoret vetëm nëse palët shprehimisht janë pajtuar për këtë. Pa e specifikuar, arbitrazhi nuk mund të organizohet dhe të mbahet pa përcaktimin e tij në klauzolën e zgjedhjes së forumit. Palët mund të pajtohen për përdorimin e arbitrazhit në një nga mënyrat në vijim.

Duke përfshirë një klauzolë të arbitrazhit në kontratën e tyre.- Mënyra më e zakonshme e përcaktimit të arbitrazhit si formë e zgjidhjes së kontesteve eventuale mes palëve është duke iu referuar arbitrazhit në klauzolën e zgjedhjes së forumit. Në këtë klauzolë zakonisht përcaktohet edhe institucioni i arbitrazhit para të cilit do të zhvillohet procesi, si dhe rregullat procedurale që do të aplikohen gjatë dëgjimeve. Disa klauzola janë edhe më të hollësishme dhe përcaktojnë edhe mënyrat e zgjedhjes së arbitrave dhe përcaktojnë shkallën e sekretit që do të aplikohet për rastin në fjalë. Klauzolat e arbitrazhit mund të kenë forma të ndryshme, por më të shpeshta janë dy forma:

- klauzolat që nxjerrin në arbitrazh mosmarrëveshjet ekzistuese (në gjuhën frënge: kompromis)
- këto klauzola nuk përdoren shpesh, posaçërisht kur marrin parasysh faktin se nëse një mosmarrëveshje tashmë ekziston është shumë vështirë të arrihet një marrëveshje për shkak të nivelit të mosbesimit dhe armiqësisë mes palëve. Megjithatë, palët mund të pajtohen për një klauzolë të arbitrazhit pas shfaqjes së kontestit, sepse mund të kenë interesa të përbashkëta për zgjedhjen e një mekanizmi të zgjidhjes së kontestit që është më ekonomike dhe më efikase në aspektin kohor dhe më kofidencial dhe më pak kundërshtues.
- klauzolat që mbulojnë kontestet që mund të shfaqen në të ardhem (në gjuhën frënge: clause compromissoire)
- kjo klauzolë është më e shpeshtë dhe më e lehtë arrihet një marrëveshje para shfaqjes së një kontesti

Duke hartuar një marrëveshje të arbitrazhit, veçmas nga kontrata kryesore.- Kjo marrëveshje është zakonisht më e hollësishme sesa një klauzolë e thjeshtë e arbitrazhit dhe i referohet çështjes në fjalë (apo marrëveshjes kontraktuese) që e mbulon. Marrëveshjet e veçanta të arbitrazhit pëlqehen nga kompanitë që rregullisht e zgjedhin arbitrazhin si formë të zgjidhjes së kontesteve dhe që dëshirojnë ta “përshtatin” atë sipas

nevojave të tyre specifike. Për këtë arsye, ata hartojnë marrëveshje më të hollësishme dhe i shmangen përfshirjes së një klauzole të shkurtër të arbitrazhit në kontratë.

Termi “marrëveshje e arbitrazhit” përdoret për t’iu referuar cilëso nga format e përmendura më sipër. Është jashtëzakonisht e rëndësishme për palët të vendosin për shkallën e detajeve që dëshirojnë ta përfshijnë në këtë klauzolë apo marrëveshje. Me poshtë janë paraqitur disa çështje që duhet të konsiderohen gjatë hartimit të marrëveshjeve për arbitrazh.

Elemente të përgjithshme:

Disa çështje të përgjithshme që duhet të merren parasysh me rastin e hartimit të klauzolave të arbitrazhit janë konsiderimi i mostrave të klauzolave që ofrohen nga institucionet e ndryshme të arbitrazhit, shqyrtimi i versioneve të ndryshme të rregullave të arbitrazhit, zgjedhja midis arbitrazhit institucional ose ad-hoc, dërgimi nga pjesë të caktuara të rregullave të zgjedhura të arbitrazhit, shqyrtimi i mundësisë për arbitrazh online (përmes internetit) dhe së fundi, që është edhe më e rëndësishmja, shikohen shpenzimet e arbitrazhit, pra, tarifat e arbitrave dhe shpenzimet tjera që ndërlidhen me organizimin e procedurave të arbitrazhit.

Elementet themelore.-

Pasi që të merren parasysh faktorët e përgjithshëm të cekur më lart, palët duhet të pajtohen për elementet themelore që do t’i përmbajë klauzola e arbitrazhit. Këtu përfshihen miratimi i arbitrazhit si metodë për zgjedhjen e kontestit në fjalë, natyra përfundimtare e vendimeve që do të merret nga tribunali i arbitrazhit, fushëveprimi i klauzolës së arbitrazhit (d.m.th. çfarëdo lloj kontestesh që dalin nga kontrata përfshihen dhe mund të zgjidhen përmes arbitrazhit), numri i arbitrave, vendi ku do të mbahet arbitrazhi, gjuha që do të përdoret gjatë arbitrazhit, si dhe institucioni dhe rregullat e arbitrazhit që do të aplikohen.

Elemente të tjera ndihmëse.-

Përveç elementeve kyçe, disa elemente të tjera ndihmëse, do duhej të shqyrtohen dhe të vendoset nëse është e nevojshme të hyjnë në klauzolën ose marrëveshjen e arbitrazhit. Këtu kryesisht përfshihen metoda e zgjedhjes së arbitrave, kualifikimet e arbitrave, fshehtësia (kofidencialiteti) i procedurës së arbitrazhit, masa e zbulimeve (hulumtimeve) që lejohen, rregullat për masat e përkohshme, mundësia e ankimit ndaj vendimit përfundimtar të arbitrazhit, shpenzimet dhe honoraret e arbitrave.

Tribunali i Arbitrazhit:

Ligji i Kosovës për Arbitrazhin thekson se “Tribunali i Arbitrazhit përbëhet nga një arbitër i vetëm ose nga një trup arbitrash, me kusht që numri i arbitrave të këtij trupi të jetë një numër tek”. Kjo do të thotë se palët mund të zgjedhin që të kenë një arbitër të

vetëm ose më shumë arbitra, varësisht nga specifikat e rastit. Janë një varg faktorësh të cilët duhet të merren parasysh gjatë marrjes së këtij vendimi.

Shuma e parave në fjalë.- Në përgjithësi këshillohet që palët të zgjedhin një arbitër të vetëm kur kanë të bëjnë me shuma të vogla të parave dhe, në anën tjetër, të zgjedhin një panel prej tre arbitrash kur kanë të bëjnë me shuma të mëdha të parave. Po ashtu besohet se kur palët janë nga shtete të ndryshme, nga sisteme të ndryshme ligjore dhe ekonomike, paneli prej tre arbitrash është zgjedhje më e mirë.

Ekspertiza e arbitrave.- Në rastet e ndërlikuara kur kërkohet ekspertizë e konsiderusheme në lëndën e kontestit në fushën e ndërtimtarisë ose pronës intelektuale, është gjithmonë më mirë të kemi një panel që përbëhet nga arbitra me përvojë nga fusha përkatëse. Në këto raste, këshillohet që të kemi një panel prej tre arbitrash, sepse një tribunal me shumë anëtarë mund t'u ofrojë palëve një shumëllojshmëri të ekspertizave.

Orari.- Përcaktimi i orarit është në fakt një argument kundër shfrytëzimit të paneleve, për shkak se është shumë më e vështirë për një panel prej tre ose më shumë arbitrash që të pajtohet mbi datat e mbajtjes së dëgjimeve dhe procedurave të tjera. Ky është një problem i cili shfaqet sidomos nëse arbitrit vijnë nga shtete të ndryshme dhe kështu palët do të përfundojnë duke i përshtatur oraret e tyre si dhe ato të arbitrave.

Mëditjet e arbitrave.- Mëditjet të cilat duhet të paguhën nga palët janë shumë më të ulëta, nëse kemi të bëjmë me një arbitër të vetëm. Mirpo, në raste të mëdha, shpenzimet shtesë për pagesën e dy arbitrave të tjerë nuk kanë një çmim shumë i lartë për një panel i cili është në gjendje që të bashkojë ekspertizën e më shumë individëve dhe ta analizojë një çështje së bashku.

Atributet kryesore të një arbitri efektiv konsiderohen paanshmëria, pavarësia, efikasiteti dhe përvoja profesionale. Paanshmëria është atributi më i rëndësishëm që një palë do të kërkojë nga një arbitër. Ndonjëherë nuk është e qartë, që nga fillimi, nëse një arbitër është plotësisht i paanshëm për arsye se anshmëria e tij do të dallohet vetëm gjatë vazhdimit të procedurave. Paanshmëria është një nga standardet e kërkuara nga një arbitër edhe me Ligjin e Kosovës për Arbitrazhin. Në krahasim me paanshmërinë, pavarësia është një nocion objektiv dhe mund të përcaktohet në fazën e hershme, duke filluar nga procesi i emërimit. Mungesat e pavarësisë së një arbitri mund të jenë rezultat i mardhënieve paraprake ekonomike, financiare ose të tjera me palën. Pavarësia e arbitrit, poashtu, kërkohet me Ligjin e Kosovës për Arbitrazhin. Gjithashtu, efikasiteti i një arbitri çmohet shumë, posaçërisht pasi që arbitrazhi njihet si një mekanizëm i shpejtë për zgjidhjen e kontesteve dhe palët e zgjedhin atë pikërisht për shkak të efikasitetit në kohë. Prandaj, është me rëndësi që të zgjedhen arbitrat të cilët janë në gjendje që ta gjejnë të vërtetën në mënyrë efikase. Kualifikimet profesionale të një arbitri janë elemente të rëndësishme për palët gjatë procesit të përzgjedhjes, pasi që është e

rëndësishme të kemi arbitra të cilët posedojnë trajnim dhe shkollim të përshtatshëm, si dhe të cilët kanë përvojën e dëshirueshme në rolin e arbitrit dhe profesionin e tyre në përgjithësi. Kualifikimet të cilat kërkohen nga palët në marrëveshjen e arbitrazhit duhet t'i kenë arbitrit dhe kjo poashtu është e paraparë në Ligjin e Kosovës për Arbitrazhin.

PROCEDURA E ARBITRAZHIT

Një çështje mund të dërgohet në arbitrazh në dy raste: rasti i parë është kur mes palëve tashmë ekziston një marrëveshje e arbitrazhit e cila e përcakton arbitrazhin si metodën e zgjedhur për zgjidhjen e kontestit dhe situata e dytë është kur palët pajtohen për përdorimin e arbitrazhit pasi që kontesti të ketë lindur.

Në të dyja këto raste, është gjithmonë paditësi ai i cili e inicion rastin, duke paraqitur padinë para Tribunalit të Arbitrazhit të përzgjedhur nga palët. Në vijim janë radhitur hapat që ndërmerren gjatë procesit të arbitrazhit:

- Kërkesa për Arbitrin – e parashtruar nga Paditësi;
- Padija – e parashtruar nga Paditësi;
- Përgjigja në Padi – e parashtruar nga i Padituri;
- Emërtimi i Arbitrit ose Arbitrave
- Konstituimi i Tribunalit të Arbitrazhit;
- Fillimi i dëgjimeve gojore;
- Argumentet gojore nga Paditësja dhe nga i Padituri;
- Paraqitja e provave (dëshmitarë, ekspertë, etj);
- Shqyrtimi nga ana e Tribunalit të Arbitrazhit;
- Marrja e vendimit.

Sa i përket hapit të parë, ligje të ndryshme përmbajnë rregulla të ndryshme lidhur me kohën kur konsiderohet të ketë filluar procedura e arbitrazhit. Megjithatë, rregulla më e përdorur është ajo e paraparë edhe në Ligjin e Kosovës për Arbitrazhin, ku thuhet se “nëse palët nuk janë pajtuar ndryshe, procedura e arbitrazhit lidhur me një kontest të caktuar fillon në ditën kur kërkesa që kontesti t'i nënshtrohet arbitrazhit pranohet nga pala e paditur.

Edhe pse Ligji u lejon të palëve të merren vesh për ndonjë procedurë tjetër, ligji parashih që në rastë se një marrëveshje e tillë nuk ekziston, atëherë procedura fillon në kohën kur pala e paditur e pranon një kopje të Kërkesës për Arbitrim, të cilën pala paditëse ia ka dërguar Tribunalit të arbitrazhit. Pala e paditur, zakonisht konsiderohet ta ketë pranuar kopjen e Kërkesës për Arbitrin në ditën kur ajo dorëzohet personalisht, apo në adresën e saj postare, në vendin ku banon, ose në vendin ku e ushtron veprimtarinë afariste.

Kërkesa për Arbitrin zakonisht pasohet me Padinë e Paditësit, e cila paraqet pozitën e Paditësit lidhur me rastin. Pas pranimit të Kërkesës për Arbitrim dhe të Padisë nga i padituri, ai duhet të përgatitë Përgjigjen në Padi. Ligji i Kosovës për Arbitrazhin, gjithashtu, parashih disa parime të përgjithshme të cilat aplikohen gjatë procesit të

arbitrazhit, siç janë, trajtimi i barabartë i palëve, liria e palëve të zgjedhin përfaqësuesit e tyre dhe të pajtohen për procedurën e arbitrazhit, si dhe të drejtën e Tribunalit të Arbitrazhit për të caktuar procedurën dhe rregullat e aplikueshme për rastin, në rast se palët nuk janë pajtuar vet për këto çështje.

Procedura e marrjes së vendimit të arbitrazhit

Vendimi i Arbitrazhit është vendim përfundimtar i Tribunalit të Arbitrazhit për rastin përkatës dhe është i barabartë me vendimin e lëshuar nga një gjykatë.

Rregullat për marrjen e vendimit janë mjaft të detajuara në të gjitha ligjet dhe institucionet e arbitrazhit. Ligji i Kosovës për Arbitrazhin së pari e sqaron se cilin ligj duhet ta zbatojë Tribunali i Arbitrazhit gjatë marrjes së vendimit. Në këtë aspekt, Ligji parasheh që Tribunali i Arbitrazhit mund t'i referohet këtyre tri ligjeve, siç janë:

- ligji i përcaktuar nga palët si i aplikueshëm për lëndën e kontestit;
- në rast se nuk është përcaktuar nga palët, atëherë ligji i përcaktuar në bazë të rregullave të së drejtës private ndërkombëtare; dhe
- në të gjitha rastet tjera, legjislacioni i Kosovës.

Në rastin e parë vlen ligji i zgjedhur nga vetë palët, kurse në rastin e dytë, tribunali duhet t'i referohet rregullave të së drejtës private ndërkombëtare. Në rastet me elementet ndërkombëtare, Tribunali i Arbitrazhit zbaton të drejtën të cilën palët e kanë caktuar si të drejtë kompetente për aspektet materiale të kontestit. Në mungesë të një caktimi të tillë nga palët, Tribunali i Arbitrazhit zbaton të drejtën e përcaktuar nga rregullat e së drejtës ndërkombëtare private. Në të gjitha rastet tjera, Tribunali i Arbitrazhit e zbaton legjislacionin e Kosovës. Në të gjitha rastet, Tribunali i Arbitrazhit vendos në pajtim me dispozitat e kontratës, duke marrë parasysh uzancat tregtare që vlejné për rastin konkret.

Në procedurën e arbitrazhit me më shumë se një arbitër, çdo vendim i Tribunalit të Arbitrazhit merret me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të Tribunalit të Arbitrazhit, përveç nëse palët pajtohen ndryshe. Përveç çështjes procedurale drejtuesi i Tribunalit të Arbitrazhit vendos vet, nëse për këtë është i autorizuar nga palët ose nga të gjithë anëtarët e Tribunalit të Arbitrazhit.

FORMA DHE EFEKTI I VENDIMIT

Ligji i Kosovës për Arbitrazhin parasheh kushtet formale minimale për një vendim të nxjerrë nga një Tribunal i Arbitrazhi. Tribunali i Arbitrazhit mund të marrë vendim të veçantë për çështje të ndryshme në kohë të ndryshme.

Duhet të plotësohen kushte për një vendim të arbitrazhit, dhe atë:

- të gjitha vendimet duhet të përpilohen me shkrim dhe do të jenë përfundimtare dhe detyruese për palët. Palët do të zbatojnë të gjitha vendimet pa vonesë;
- Tribunali i Arbitrazhit do të deklarojë arsye mbi të cilat është bazuar vendimi, përveç nëse palët janë pajtuar se nuk duhet të jepen arsye;
- vendimi duhet të nënshkruhet nga arbitrat dhe duhet të përmbajë datën në të cilën është marrë vendimi, si dhe të tregojë vendin e arbitrazhit. Kur ka më shumë se një arbitër dhe asnjëri prej tyre nuk arrin të nënshkruajë, vendimi do të përmbajë arsyetim për mungesën e nënshkrimit. Tribunali i Përhershëm do të vërtetojë ve vendimi është miratuar sipas rregullave të brendshme të Tribunalit të Përhershëm;
- vendimi mund të bëhet publik me pëlqimin e të gjitha palëve, ose ku dhe në masën që zbulimi është i nevojshëm nga një palë sipas ligjit, për të mbrojtur ose për të ndjekur një të drejtë ligjore, ose në lidhje me procedurat ligjore përpara një gjykate ose organi kompetent;
- kopjet e vërtetuara të vendimit, të nënshkruara nga arbitrat, do t'i dorëzohen palëve nga Tribunali i Përhershëm.

Një çështje të cilën ligji nuk e adreson është çështja nëse Tribunali i Arbitrazhit do të publikojë edhe mendimet kundërshtuese të arbitrave të cilët nuk janë pajtuar me vendimin e shumicës. Me qenë se kjo çështje varet nga sistemi ligjor i secilit vend, tribunalet e arbitrazhit dhe gjykata në Kosovë duhet të nxjerrin vendime në bazë të praktikave ligjore të vendit.

Si rregull e përgjithshme, vendimi i arbitrazhit është përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët. Vendimi për palët e ka efektin e njëjtë juridik sikurse një aktgjykim i plotëfuqishëm dhe detyruet i gjykatës. Kjo është pikërisht arsyeja pse bizneset zgjedhin arbitrazhin për t'i zgjidhur kontestet. Megjithatë, ka edhe përjashtime për rrethana të caktuara, kur vendimi i Tribunalit të Arbitrazhit lejohet të shqyrtohet nga gjykata kompetente.

Arbitërit gëzojnë diskrecion të gjerë në strukturimin e vendimit dhe kjo përkrahet fuqishëm nga kufizimet e spektrit të shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të arbitrazhit. Shumë shpesh, çështja se a ka nevojë për shqyrtim gjyqësor të vendimit të arbitrazhit, varet nga mënyra se si arbitrit i përpilojnë vendimet. Për këtë arsye, nëse kjo nuk është paraparë në ligjin e zgjedhur nga palët, ata duhet të përpilojnë një marrëveshje të arbitrazhit e cila parasheh që arbitrit të cekin arsyet në vendimin e arbitrazhit. Megjithatë, një numër i ekspertëve dhe i autorëve të arbitrazhit në fakt kanë deklaruar që një vendim i publikuar i cili përfshin arsyeshmërinë e vendimit, mund t'i rritë shanset për një shqyrtim gjyqësor. Kjo për shkak se arsyetimi i vendimit zakonisht i jep palëve arsye shtesë për ta kontestuar vendimin dhe për ta apeluar atë para një gjykate.

Palët, në anën tjetër, mund të pajtohen në kontratën e tyre që vendimi i arbitrazhit të mos jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm dhe të pajtohen që të apelohej në gjykatë. Në këtë mënyrë ata mund të pajtohen për një shqyrtim të zgjedhur gjyqësor ose për një shqyrtim privat të vendimit. Edhe pse kjo u mundëson palëve ta shqyrtojnë rastin edhe më tutje, sidomos në rastet kur vendimi i nxjerrë nga Tribunali i Arbitrazhit është i

paarsyeshëm, megjithatë, dobitë e kësaj duhet të peshohen kundër shpenzimeve shtesë dhe obligimeve të tjera të cilat palët duhet t'i bartin.

Një element i rëndësishëm për t'u mbajtur në mend është që gjykatat nuk mund ta shfuqizojnë një vendim të nxjerrë nga Tribunali i Arbitrazhit për çfarëdo arsye. Shumica e sistemeve ligjore lejojnë vetëm shqyrtimin gjyqësor deri në atë masë që gjykata thjesht të analizojë nëse arbitrit kanë tejkaluar kompetencat e tyre, nëse vendimi është i bazuar në një marrëveshje të vlefshme të arbitrazhit, ose nëse vendimi është fituar përmes korrupsionit, falsifikimit, ose nga keqpërdorimi i detyrës nga arbitrit. Kështu që, gjykata nuk mund ta shfuqizojë vendimin në bazë të aplikimit të gabueshëm të ligjit ose për gabime në fakte.

Përmbartimi dhe njohja e vendimeve të arbitrazhit

Varësisht nga vendi ku ndodhet arbitrazhi, vendimet e arbitrazhit kanë një spektër të gjerë. Ato më të zakonshmet janë për kompensim financiar të dëmeve të palës. Përveç asaj, në disa raste mundësia është që paneli i arbitrave të lëshojë vendime të tjera që urdhërojnë një palë të bëjë diçka, apo ta pangojë një palë nga kryerja e ndonjë veprimi. Gjithashtu, mund të urdhërojnë veprim në përputhje me detyrimet e palës sipas kontratës në fjalë, ose ta anulojnë ndonjë dokument zyrtar (p.sh. kontratë, titull, etj).

Një nga arsyet për përdorimin e madh të arbitrazhit në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në tregtinë ndërkombëtare është lehtësia e zbatimit dhe ekzekutimit të vendimeve të arbitrazhit në vendet e huaja, sidomos në krahasim me vendimet e gjykatave. Arsyeja për zbatimin më të lehtë të këtyre vendimeve është Konventa e Neë York-ut e vitit 1958, që ka hyrë në fuqi më 7 qershor 1959.

Kjo konventë zbatohet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit, që janë në territorin e një shteti të ndryshme prej atij ku kërkohen njohja dhe ekzekutimi i vendimeve dhe që u përkasin marrëveshjeve midis personave fizikë dhe juridikë. Ajo zbatohet gjithashtu për vendimet e arbitrazhit që nuk konsiderohen si vendime të arbitrazhit në shtetin ku kërkohet dhe ekzekutimi i tyre. Vendimet e arbitrazhit do të përfshijnë jo vetëm vendimet që kanë dhënë arbitrat e emruar për çdo rast, por gjithashtu edhe ato që kanë dhënë organet e përhershme të arbitrazhit të cilave iu kanë nënshtruar palët.

Në momentin kur do të nënshkruhet, ratifikohet ose do të thirret në këtë Konventë, ose do të njoftohet zgjatja sipas nenit 10, çdo shtet mundet, në bazë reciprociteti, të deklarojë se do të zbatojë konventën për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve, që janë dhënë vetëm në territorin e shtetit tjetër. kontraktues. Mund të deklarojë gjithashtu se do të zbatohet konventa vetëm për mosmarrëveshjet e lindura nga marrëdhëniet juridike, kontraktorë ose jokontraktorë, të cilat konsiderohen si marrëdhënie tregtare nga legjislacioni kombëtar i shtetit që bënë këtë deklaratë. Gati të gjitha vendet e mëdha komerciale janë nënshkruese të kësaj konvente.

Përmbartimi i një vendimi është gjëja më e rëndësishme në arbitrazh. Vendimi i arbitrazhit, i cili nuk njihet ose nuk përmbartohet nga gjykata kompetente vendore, nuk ka asnjë vlerë praktike. Pikërisht për këto arsye, Ligji i Kosovës për Arbitrazhin

i parasheh kushtet ligjore për përmbarrimin edhe njohjen e vendimeve të arbitrazhit vendor dhe atij ndërkombëtar.

Për sa u përket vendimeve të arbitrazhit vendor, Ligji parasheh që “Vendimi i arbitrazhit i cili është nxjerrë nga një tribunal i arbitrazhit brenda Kosovës ekzekutohet pasi që të shpallet i ekzekutueshëm nga Gjykata”. Gjykatat e Kosovës i njohin vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme dhe i ekzekutojnë ato nëse vendimet e arbitrazhit të nxjerra jashtë Kosovës si të plotfuqishme i ekzekutojnë ato nëse vendimet në fjalë janë njohur dhe janë shpallur të ekzekutueshme.

Ligji i Kosovës për Arbitrazhin i trajton vendimet e lëshuara nga arbitrazhi komercial ndërkombëtar në mënyrë të unisuar, pa marrë parasysh se ku janë nxjerrë ato, dhe nxitë përmbarrimin e tyre në Kosovë. Këto dispozita, të cilat e trajtojnë përmbarrimin dhe njohjen, janë të bazuara në Konventën e Neë- Jorkut të vitit 1958 mbi Njohjen dhe Përmbarrimin e Vendimeve të Arbitrazhit të Huaj.

Për të kërkuar që vendimi i arbitrazhit të ekzekutohet, pala e interesuar duhet të veprojë si në vijim:

- ta përgatisë kërkesën për njohje dhe përmbarrim;
- ta bashkëngjësë një kopje të vërtetuar të vendimit në fjalë;
- ta përkthejë vendimin në gjuhën zyrtare të gjykatës (nëse është në gjuhë të huaj);
- ta bashkëngjësë një kopje të marrëveshjes së arbitrazhit e cila është lidhur në formë të shkruar;
- duhet të sigurohet që nuk ekziston asnjë bazë për refuzimin e përmbarrimit nga gjykata.

Kur të plotësohen këto kushte, pala mund të kërkojë njohjen dhe përmbarrimin e vendimit në gjykatë.

Vendimi i arbitrazhit i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit për Çështje Ekonomike.

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike njeh vendimet e arbitrazhit.

Pas njohjes së vendimit të arbitrazhit, ekzekutimi bëhet përmes procedurës së rregullt, të njëjtë me procedurën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore.

NDËRMJETËSIMI

Ndërmjetësimi.- Është veprimtari jashtëgjyqësore, që realizohet nga një person i tretë (ndërmjetësuesi), për zgjidhje të mosmarrëveshjeve ndërmjet subjekteve të së drejtës në pajtim me kushtet e parashikuara në ligj.

Ndërmjetësuesi është pala e tretë, neutrale, e autorizuar të ndërmjetësojë në mes dy palësh me qëllim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në pajtim me parimet e ndërmjetësimit.

Ngjashëm me arbitrazhin, edhe ndërmjetësimi ka një histori të gjatë që fillon që nga kohët e lashta, me rastet e para të paraqitura në kohën e Babilonit, Greqisë Antike dhe Romës. Në fakt, gjatë disa periudhash historike ndërmjetësuesit janë konsideruar njerëz me status dhe respekt të lartë në shoqëri. Në kohët moderne, ndërmjetësimi i ka rrënjët në diplomaci. Përderisa tani, ndërmjetësimi zakonisht është hapi i parë që ndërmerret në mosmarrëveshjet biznesore.

Ndërmjetësuesi luan rolin e vetëm të ndihmësit e jo të zgjidhësit të mosmarrëveshjeve. Pra, ai i ndihmon palët që ta kuptojnë konfliktin dhe të punojnë drejt zgjidhjes së konfliktit. Varësisht nga ndërmjetësuesi, ka disa lloje të ndërmjetësimit.

Ndërmjetësimi vlerësues: Këtu, ndërmjetësuesi e vlerëson rastin dhe iu tregon palëve argumentet e forta dhe të dobëta të qëndrimit të tyre, nëse ato vendosin ta paraqesin lëndën në gjykatë.

Ndërmjetësimi ndihmues: Ky lloj i ndërmjetësimit përqendrohet në ndihmimin e palëve që ta arrijnë një marrëveshje dhe zgjidhje të problemit. Kjo marrëveshje nuk është imponuese, pra, palët nuk janë të detyruara ta pranojnë atë.

Ndërmjetësimi transformues: Nëpërmes këtij lloji të ndërmjetësimit, ndërmjetësuesi mundohet që t'i ndihmojë palëve që të komunikojnë më mirë, sepse mendimi është që mosmarrëveshja është rezultat i komunikimit të dobët dhe i armiqësisë së palëve.

Disa nga kërkesat dhe parakushtet kryesore për çdo ndërmjetësues janë:

- detyrat për t'i informuar palët për procesin e ndërmjetësimit;
- nevoja që ndërmjetësuesi të ketë qëndrim neutral dhe t'i paraqesë konfliktet e interesit;
- çdo informatë që paraqitet në ndërmjetësim duhet të mbahet konfidenciale;
- ndërmjetësuesit nuk duhet të ofrojnë udhëzime ligjore, por t'i drejtojnë palët në ligjet që aplikohen;
- ndërmjetësuesit duhet të ndërmjetësojnë vetëm në sfera në të cilat janë ekspertë.

Përparësitë e ndërmjetësimit

- Ndërmjetësimi ka shumë përparësi në zgjidhjen e kontesteve dhe mosmarrëveshjeve biznesore. Disa nga ato janë:
- të gjitha diskutimet gjatë ndërmjetësimit janë konfidenciale,
- ndërmjetësuesi është neutral,
- asgjë që thuhet gjatë ndërmjetësimit nuk mund të përdoret si fakt nëse lënda shkon në gjykatë,
- palët nuk armiqësohen sikur kur lënda është në gjykatë,
- ndërmjetësuesi është ekspert në lëminë rreth së cilës ka mosmarrëveshje,
- kushton shumë më lirë, sepse zakonisht angazhohet vetëm një ndërmjetësues,
- është proces më efikas,
- zakonisht i përmirëson raportet mes palëve,
- inkurajon palët që të zgjidhin problemin,
- atmosfera është më e relaksuar me proceset gjyqësore apo arbitrazhin,
- rregullat procedurale janë më fleksibile.

Të metat e ndërmejtësimit.-

Disa nga të metat e ndërmjetësimit që përmenden më së shpeshti janë:

- nuk ka vendim të ndërmjetësuesit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve;
- ju jep rast palëve që të stërzgjasin zgjidhjen e problemit duke iu qasur ndërmjetësimit vetëm për të humbur kohë;
- korporatat e mëdha mund të bëjnë presion të palejueshëm mbi ndërmjetësuesin në mosmarrëveshje të mëdha komerciale, duke iu kërcënuar atij/asaj me humbje të punës në të ardhmen;
- meqë ndërmjetësimi nuk bazohet në rregulla të definuara që më parë, mund të ketë befasi dhe ta zë një palë të papërgaditur.

Procedura gjatë ndërmjetësimit.-

Procedura gjatë ndërmjetësimit është joformale dhe zakonisht e padefinuar para se të fillojë ndërmjetësimi. Mirëpo, zakonisht palët paraqesin nga një dokument fillestar ku përshkruajnë qëndrimin e tyre rreth mosmarrëveshjeve dhe bashkëngjesin dokumentacionin që ka të bëjë me mosmarrëveshje (p.sh. kontratat, dokumentet zyrtare, komunikimet mes palëve, etj). Ai prezantim pastaj pasohet nga disa takime në mes palëve të ndërmjetësuar nga ndërmjetësuesi dhe të kufizuara në temat nga rendi i ditës i përcaktuar nga ndërmjetësuesi. Pas asaj, nëse arrihet një marrëveshje, palët pajtohen për pikat e marrëveshjes, nga të cilat pastaj përpilojnë marrëveshjen formale që nënshkruhet nga palët.

Për të arritur një marrëveshje rreth problemit të palëve, ndërmjetësuesi zakonisht ua ofron ekspertizën e tij palëve, duke iu ndihmuar palëve që të komunikojnë, të

negociojnë, duke e përmirësuar ambientin emocional (zvogëlimin e agresionit, armiqësisë, etj), duke ua dhënë palëve një kornizë procedurale si dhe sugjerime për zgjidhjen e mosmarrëvshjes.

Zgjedhja e ndërmjetësuesit

Zgjedhja e ndërmjetësuesit ka një rëndësi të veçantë, sepse ai është person i cili ndihmon dhe lehtëson zgjidhjen e mosmarrëvshjes së palëve. Kur zgjedhet një ndërmjetësues, palët, ndër të tjera, duhet të kenë parasysh:

- vetitë personale (komunikimin, inteligjencën, durimin, optimizmin, etj);
- kualifikimet profesionale dhe përvojën në fushën e ndërmjetësimit në përgjithësi dhe në fushën e mosmarrëvshjes në veçanti;
- konfliktet e interesit;
- çmimin e ndërmjetësuesit.

Ndërmjetësuesi mund të jetë çdo person i cili i plotëson kushtet e përgjithshme për punësim në përputhje me ligjin në fuqi.

Ndërmjetësuesi sipas ligjit duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

- të ketë diplomë universitare;
- të ketë kaluar me sukses kursin e trajnimit për ndërmjetësim;
- të ketë ndërmjetësuar nën mbikëqyrjen e një ndërmjetësuesi, të paktën në gjashtë seanca;
- të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale me dashje për të cilën parashihet dënimi mbi gjashtë muaj burgim;
- të ketë cilësi të larta morale;
- të jetë i regjistruar në regjistrin e ndërmjetësuesve.

Të drejtat dhe detyrimet e ndërmjetësuesit, në njërin anë dhe të palëve në anën tjetër, caktohen para fillimit të procedurës së ndërmjetësimit. Ndërmjetësuesi dhe palët pajtohen për të drejtat dhe detyrimet të cilave duhet tu përmbahen deri në përfundim të procedurës, në pajtim me ligjin në fuqi dhe normat e moralit.

Shtetasi i huaj mund të shërbejë si ndërmjetësues në Kosovë në raste individuale dhe sipas kushtit të reciprocitetit, pas marrjes së pëlqimit paraprak nga Ministria e Drejtësisë.

BURIMET JURIDIKE

- KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
- LIGJI Nr.02./L-123 PËR SHOQËRITË TREGTARE
- LIGJI Nr.02/L-33 PËR INVESTIMET E HUAJA
- LIGJI Nr.02/L-44 PËR PROCEDURËN E DHËNIES SË KONCESIONEVE
- LIGJI Nr.2003/4 PËR LIKUIDIM DHE RIORGANIZIMIN E PERSONAVE JURIDIKË NË FALIMENTIM
- LIGJI Nr.03/L-087 PËR NDËRMARRJET PUBLIKE
- LIGJI Nr.02/L-75 PËR ARBITRAZHIN
- LIGJI Nr.03/L-057 PËR NDËRMJETËSIM
- KONVENTA E NJU JORKUT – 1958 – PËR NJOHJEN DHE EKZEKUTIMIN E VENDIMEVE TË HUAJA TË ARBITRAZHIT
- LIGJI Nr.03/L-209 PËR BANKËN QENDRORE TË R. SË KOSOVËS
- LIGJI Nr.03/L-229 PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
- LIGJI Nr.04/L-028 PËR DIZAJNIN INDUSTRIAL
- LIGJI Nr.04/L-026 PËR MARKAT TREGTARE
- LIGJI Nr.04/L-029 PËR PATENTAT
- LIGJI Nr.04/L-033 PËR DHOMËN E POSÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS, PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AKP
- LIGJI Nr.03/L-067 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
- LIGJI Nr.04/L-065 PËR TË DRJETAT E AUTORIT DHE TË DREJTAT E PËRAFËRTA
- LIGJI Nr.04/L-093 PËR BANKAT INSTITUCIONET MIKROFINANCIARE DHE INSTITUCIONET FINANCIARE JOBANKARE
- LIGJI Nr.04/L-077 PËR MARRËDHËNIET E DETYRIMEVE
- LIGJI Nr.04/L-121 PËR MBROJTJEN E KONSUMATORIT

E DREJTA E PUNËS

5

HYRJE

Burimet e brendshme të së drejtës së punës janë aktet juridike të cilat i nxjerr organi më i lartë legjislativ i shtetit me të cilët rregullohen dhe sanksionohen këto marrëdhënie shoqërore. Kushtetua është akti më i lartë juridik i shtetit me të cilën përcaktohen parimet e përgjithshme dhe bazat e rregullimit të marrëdhënieve shoqërore, ekonomike dhe politike të shtetit e në kuadër të tyre përcaktohen edhe parimet dhe bazat e rregullimit të marrëdhënieve shoqërore të punës, prandaj kushtetua është burim themelor edhe i së drejtës së punës. Ligji pas kushtetutës është burimi më i rëndësishëm i së drejtës në përgjithësi pra edhe i së drejtës së punës.

Aktet nënligjore janë tri lloje: aktet të cilat i nxjerrin organet ekzekutive dhe ato administrative, aktet dypalëshe dhe shumëpalëshe dhe aktet autonome të cilat i nxjerrin subjektet e ndryshme autonome të cilat i nxjerrin subjektet e ndryshme juridike, ndërmarrjet, shoqatat, institucionet si dhe organizatat dhe Bashkësit tjera. Interpretimi i normave juridike e nënkupton shpjegimin të cilin e jep organi kompetent i shtetit për atë se si duhet kuptuar një dispozitë ligjore. Nga kjo rezulton se interpretimi i detyrueshëm nuk e ka karakterin e dispozitës juridike, prandaj shikuar nga ky aspekt interpretimi nuk konsiderohet si burim i së drejtës. Megjithatë në teorinë e së drejtës, ekziston mendimi se interpretimi i detyrueshëm i dispozitave ligjore i obligon zbatuesit e ligjit sidomos gjatë aplikimit të tij, prandaj në këto raste interpretimi konsiderohet pjesë përbërëse e ligjit dhe si i tillë ai mund të shërbejë edhe si burim i së drejtës në përgjithësi edhe i së drejtës së punës.

Praktika gjyqësore-në parim nuk është burim i së drejtës. Kjo sepse qëndrimet juridike në bazë të të cilave sajohet praktika gjyqësore nuk përfaqësojnë norma juridike, për çka gjykatat nuk kanë për detyrë që t'u përmbahen atyre. Shikuar nga pikëpamja e karakterit dhe përmbajtjes, praktika gjyqësore përmban qëndrime të përgjithshme në formë udhëzimesh për atë se si duhet vepruar në rastin e vendosjes në çështje konkrete

dhe në raste të ngjashme, ndërsa qëllimi i tyre është që të përmirësohen gabimet të cilat bëhen nga gjykatat dhe që ato të mos përsëriten më. Për rrjedhojë, pasi që normat juridike në bazë të të cilave sajohet praktika gjyqësore janë të obligueshme për gjykatat dhe duke qenë se praktika gjyqësore jepet me qëllim të zbatimit të drejtë të atyre normave, rrjedh konkludimi se praktika gjyqësore bashkë me normat juridike është detyruese për gjykatat, prandaj shikuar nga kjo pikëpamje mund të thuhet se ajo në një farë mënyre edhe përfaqëson burim të së drejtës.

BURIMET E JASHTME

Në burimet e jashtme të së drejtës së punës bëjnë pjesë marrëveshjet dhe aktet tjera juridike të miratuara apo të lidhura në shkallë ndërkombëtare. Këto akte e përbëjnë të drejtën ndërkombëtare të punës, e cila në formë të caktuar ka efekte juridike në të drejtën nacionale të punës të shteteve përkatëse. Varësisht nga ajo se cili organ i nxjerr aktet ndërkombëtare si dhe nga fakti se kush merr pjesë në lidhjen e tyre dallojnë këto lloje të burimeve ndërkombëtare të së drejtës: 1.burimet universale; 2.burimet regjionale; 3.marrëveshjet apo kontratat ndërkombëtare dhe 4.aktet e miratuara nga organizatat e specializuara.

BURIMET UNIVERSALE

Burimet universale janë ato akte të cilat janë miratuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe nga organet e saj të cilat përmbajnë rregulla dhe dispozita të karakterit universal. Të tilla ndër më kryesoret konsiderohen Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike Sociale dhe Kulturore.

BURIMET E SË DREJTËS SË PUNËS

E drejta e punës ka dy lloje të burimeve të rregullimit burimet të jashtme (ndërkombëtare) dhe burime të brendshme (kombëtare). Kjo nuk do të thotë se këto dy lloje burimesh duhet të jenë të ndryshme. Përkundrazi burimet e brendshme duhen të jenë në përputhje me parimet dhe standardet e burimeve të jashtme, (me konventat, protokollat dhe rekomandime). Edhe harmonizimi i burimeve të brendshme gjithnjë e më tepër po bëhet kusht për pranimin dhe aderimin e shteteve në organizmat e caktuar ndërkombëtar si anëtare e tyre.

BURIMET E JASHTME TË SË DREJTËS SË PUNËS-KONVENTAT E ONP

Ndarja ndërkombëtare e punës migrimi i fuqisë punëtore prej një vendi në tjetrin, veprimi, zhvillimi dhe përhapja e kompanive multinacionale në shtete dhe kontinente me sisteme shoqërore-ekonomike dhe me shkallë të zhvillimit që ndryshon shumë prej një vendi në tjetrin, pastaj tendenca e klasës punëtore për të përmirësuar kushtet e punës dhe pozitën e vet, ka ndikuar që, në planin ndërkombëtar, të bëhet njëfarë unifikimi i

së drejtës së punës. Ky unifikim ka pasur parasysh kërkesat objektive të kohës dhe të kushteve të caktuara. Në këtë drejtim, rolin më të rëndësishëm e ka luajtur Organizata Ndërkombëtare e Punës, si agjenci e specializuar e OKB-së. Prej themelit të vet (në vitin 1919), kjo organizatë deri më tash ka miratuar shumë akte që i përkasin së drejtës së punës, qofshin ato konventa, rekomandime a protokolle, për çështje, veprimtari dhe fusha të ndryshme të së drejtës së punës. Këtu po përmendim disa nga konventat:

- 1) Konventa nr. 2 në lidhje me papunësinë (1921).
- 2) Konventa nr.4 (dhe ajo nr.89) në lidhje me punën e grave në ndërrimin e natës (1921 përkatësisht 1951).
- 3) Konventa nr.5 (dhe nr.123) përcaktimin e moshës minimale për punësim në industri dhe në miniera (1921, respektivisht 1966).
- 4) Konventa nr.18 (dhe nr.42) për kompensimin e punëtorëve për sëmundjet profesionale (1927, përkatësisht 1936).
- 5) Konventa nr.29 (dhe nr.105) mbi punën e detyruar (1932, përkatësisht 1959).
- 6) Konventa nr.47, për uljen e orëve të punës në 40 orë në javë (1957).
- 7) Konventa nr.48, për krijimin e skemës ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Invalidëve dhe Sigurimet Sociale të të moshuarve, të të vejave dhe jetimëve (1938).
- 8) Konventa nr.52 (dhe nr.132) për lejet vjetore të paguara (1939, përkatësisht 1970).
- 9) Konventa nr.6 (dhe nr.86) për kontratën e punës për punëtorët vendas (1948, përkatësisht 1953).
- 10) Konventa nr.87, për liritë sindikale dhe mbrojtjen e të drejtave sindikale (1950).
- 11) Konventa nr.81 (dhe rekomandimi 89) për inspektimin e punës në industri e tregti (1950).
- 12) Konventa nr.88, për organizimin e shërbimit të punësimit (1950).
- 13) Konventa nr.97, për migrimin për punësim (1952).
- 14) Konventa nr.98, për të drejtën e organizimit dhe negociatat kolektive (1951).
- 15) Konventa nr.100, për barazinë e pagave të meshkujve dhe të grave për punë të njëjta (1953).
- 16) Konventa nr.102 (dhe nr.117) për standardin minimal të sigurimit social (1955, përkatësisht 1964).
- 17) Konventa nr.111, kundër diskriminimit në punësim dhe profesion (1960).
- 18) Konventa nr.122, për politikën e punësimit (1960).
- 19) Konventa nr.144, për negociatat tri palëshe për zbatimin e standardeve ndërkombëtare të punës (1976).
- 20) Konventa nr.148, për mbrojtjen në punë (1979).
- 21) Konventa nr.151, për marrëdhëniet e punës në sektorin publik (1989).
- 22) Konventa nr.154, për marrëveshje kolektive (1983).
- 23) Konventa nr.155, për mbrojtjen e shëndetit në punë (1983).
- 24) Konventa nr.168, për nxitjen e punësimit dhe mbrojtjen kundër papunësisë (1991).

Përmbledhja e të gjitha këtyre akteve përbën një sistem të tërë të burimeve heteronome të së drejtës ndërkombëtare të punës, sistem ky që mund të konsiderohet si një kodeks ndërkombëtar i punës. Me parimet dhe normat e këtyre konventave e rekomandimeve rregullohen pothuajse të gjitha elementet më kryesore të së drejtës së punës punësimi, mosha, kushtet e punës, orari i punës, pagat, pushimet, mbrojtja në punë, liritë dhe të drejtat sindikale, mbrojtja e veçantë e femrave, rinisë dhe invalidëve, mbrojtja shëndetësore, politika dhe sigurimet sociale, orientimi dhe rehabilitimi profesional e çështje të tjera.

KARTA SOCIALE EVROPIANE.

Karta sociale evropiane mund të konsiderohet si një plotësim i një konventës evropiane i të drejtave të njeriut përsa u përket të drejtave ekonomike e sociale të punëtorëve dhe të qytetarëve në përgjithësi. Ndonëse këtë Kartë e ka miratuar Këshilli i Evropës (në Torino më 1961), në mirëmbajtjen dhe miratimin e saj ka kontribuar shumë Organizata Ndërkombëtare e Punës, me standardet që përmbajnë konventat e kësaj organizate.

Karta sociale evropiane, si kontratë ndërshtetërore e shteteve amtare të Këshillit të Evropës, që ka hy në fuqi më 1965, me dy protokollat e saj (1988 dhe 1991), garanton një mbrojtje gjithëpërfshirëse të të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore. Në kartë dhe protokolle janë përshirë 23 të drejta e parime themelore, të cilat më tutje janë zbrërthyer në 80 nën standarde të atyre të drejtave si dhe obligimet e shteteve amtare. Karta dhe sidomos protokollit i vitit 1991, ka përcaktuar edhe mekanizmat dhe organet e kontrollit të zbatimit të të drejtave të caktuara e të pranuar nga shtetet amtare. Karta ka përcaktuar këto të drejta themelore:

- 1) të drejtën në punë,
- 2) të drejtën për kushte të arsyeshme të punës,
- 3) të drejtën për kushte të siguruara dhe të shëndosha të punës,
- 4) të drejtën për pagë të drejtë,
- 5) të drejtën për organizim,
- 6) të drejtën për negociata kolektive,
- 7) të drejtën e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje të veçantë,
- 8) të drejtën e grave të punësuar për mbrojtje të veçantë,
- 9) të drejtën për orientimin profesional,
- 10) të drejtën për arsimimin profesional
- 11) të drejtën për mbrojtjen shëndetësore,
- 12) të drejtën për sigurimin social,
- 13) të drejtën për shfrytëzimin e shërbimeve sociale,
- 14) të drejtën për ndihmë sociale dhe mjekësore,
- 15) të drejtën e personave me të meta fizike ose psikike për arsimin profesional dhe rehabilitim social,
- 16) të drejtën e familjes për mbrojtje sociale, juridike dhe ekonomike,

- 17) të drejtën e nënës dhe fëmijës për mbrojtje sociale dhe ekonomike,
- 18) të drejtën për tu marrë me aktivitete (pune) të paguara në territorin e palëve tjera,
- 19) të drejtën e punëtorëve migrante dhe të familjeve të tyre për mbrojtje dhe nidhmë,
- 20) të drejtën e mundësisë dhe orientimit të barabartë në lëminë e punësimit dhe të profesionit, pa diskriminim në bazë të gjinisë,
- 21) të drejtën për informim dhe zhvillim,
- 22) të drejtën e pjesëmarrjes për caktimin dhe përmirësimin e kushteve të punës dhe të ambientit, dhe
- 23) të drejtën e personave të moshuar për sigurim social.

LIGJI I PUNËS

Ky ligj ka për qëllim të rregullojë të drejtat dhe detyrimet nga marrëdhënia e punës, siç përcaktohen me këtë ligj.

Dispozitat e këtij ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektorit privat dhe publik në Republikën e Kosovës. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit dhe punëdhënësit, punësimi i të cilëve rregullohet me ligj të veçantë nëse ligji i veçantë nuk parashikon zgjidhje për çështje të caktuara nga marrëdhënia e punës. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe për të punësuarit me shtetësi të huaj dhe personat pa shtetësi, të cilët janë të punësuar tek punëdhënësit në territorin e Republikës së Kosovës, nëse me ligj nuk është rregulluar ndryshe. Dispozitat e këtij ligji nuk janë të aplikueshme për marrëdhëniet e punësimit brenda misioneve ndërkombëtare, misioneve diplomatike dhe konsulore të shteteve të huaja. Pranisë Ushtarake Ndërkombëtare të vendosur në Republikën e Kosovës në bazë të propozimit gjithëpërfshirës për statusin dhe organizatat ndërkombëtare qeveritare. Me nenin 3 të këtij ligji janë caktuar përkufizimet-shprehjet e përdorura në këtë ligj dhe kuptimet e tyre: i punësuar-i personi fizik i punësuar për të kryer punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin; punëdhënësi-personi fizik ose juridik i cili siguron punë të punësuarit dhe i paguan pagën për punën ose për shërbimet e kryera; organizatat e të punësuarve-sindikatat të cilat janë të pavarura, vullnetare e themeluar për realizimin dhe mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve; Kontrata kolektive-marrëveshja ndërmjet organizatave të punëdhënësve dhe organizatave të të punësuarve me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, në pajtim me këtë ligj dhe me kontratën kolektive.

Akti i brendshëm i punëdhënësit-akti i cili rregullon të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës, në pajtim me këtë ligj dhe me kontratën kolektive. Marrëdhënia e punës-një marrëveshje ose rregullim kontraktuar ndërmjet një punëdhënësit dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përgjegjësiive specifike nga i punësuarin nën mbikëqyrjen e punëdhënësit, kundrejt një pagesë të dakorduar, zakonisht në formë të parave. Kontrata e punës-akti individual e cila lidhet ndërmjet punëdhënësit e të punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me kontratën kolektive dhe me aktin e brendshëm të punëdhënësit. Praktikanti-personi i kualifikuar

i cili themelon për herë të parë marrëdhënie pune, me qëllim që gjatë punës praktike të aftësohet për punë të caktuara.

Neni (5) të këtij ligji rregullon ndalimin e të gjitha llojeve të diskriminimit. Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligje tjera në fuqi. Dispozitat e ligjit nr.2004/3 Kundër Diskriminimit do të zbatohen drejtpërsëdrejti kur është në pyetje marrëdhënia e punës e lidhur në mes të të punësuarit dhe punëdhënësit. Me nenin (6) të këtij ligji parashihet ndalimi i punës së detyruar ose të dhunshme, përjashtimisht punë e detyruar nuk konsiderohet puna të cilin e kryejnë personat e dënuar me aktgjykim të formës së prerë gjatë vuajtjes së dënimit ose në raste të shpallur sipas nenit 131 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

KUSHTET DHE KRITERET PËR THEMELIMIN E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç. Ndërkaq marrëdhënia e punës mund të themelohet edhe me personat të moshës 15 (pesëmbëdhjetë) deri në 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, të cilët mund të punësohen për punë të lehta që nuk paraqesin rrezik për shëndetin ose zhvillimin e tyre dhe nëse ajo punë nuk është e ndaluar me ndonjë ligj ose akt nënligjor, ndërsa asnjë punëdhënës nuk mund të lidh kontratë pune me ndonjë person nën moshën 15 (pesëmbëdhjetë) vjeç. Për pranimin e punëmarrësve në marrëdhënie pune, punëdhënësi në sektorin publik është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës.

KONTRATA E PUNËS.

Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruar nga punëdhënësi dhe i punësuarit. Kontrata përfshinë elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji. Kontrata e punës mund të lidhet për: një periudhë të pacaktuar; një periudhë të caktuar dhe për punë specifike. Kontrata e punës është rregulluar sipas nenit 10 të Ligjit të Punës, ndërsa përmbajtja e kontratës së punës, drejtat dhe detyrimet të punëdhënësit dhe punëmarrësit janë rregulluar me nenin 11 të këtij ligji.

Të drejtat dhe detyrimet të cilat nuk janë të përcaktuara me kontratën e punës, rregullohen me dispozitat e këtij ligji, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Neni 13 të ligjit rregullon të drejtat e të punësuarit në rast të ndërrimit të punëdhënësit-ndërrimit statusor, përkatësisht të ndërrimit të punëdhënësit, punëdhënësi i ardhshëm nga punëdhënësi paraprak në përputhje me kontratën kolektive dhe kontratat e punës i merr përsipër të gjitha detyrimet dhe përgjegjësit nga marrëdhënia e punës të cilat janë të aplikueshme në ditën e ndërrimit të punëdhënësit. Obligimet e punëdhënësit si dhe drejtat e punëmarrësit rregullohen me pikën 2,3 dhe 4 të këtij neni.

Me Ligjin e Punës rregullohen, punë provuese lidhjen e kontratës me praktikantët, caktimi i të punësuarit në vendin e punës si dhe sistemimi i përkohshëm i punësuarit përkohësisht pa pëlqimin paraprak kryerja e të cilave kërkon përgatitje më të ulët profesionale nga përgatitja të cilin posedon raste të caktuara me nenin 18 të këtij ligji.

ORARI I PUNËS

Orari i punës nënkupton, periudhën kohore gjatë së cilës i punësuar kryen punë ose shërbime më të mira të punëdhënësit. Me këtë ligj rregullohet orari jo i plotë i punës, orari i shkurtuar i punës, puna më e gjatë se orari i plotë i punës, ndarja dhe ndryshimi i orarit të punës, puna e natës si dhe ndalimi i zgjatjes së orarit të punës.

Me Kreun V të Ligjit rregullohen pushimet dhe mungesat nga puna gjatë orarit të punës, pushimi ditor, pushimi javor, pushimi vjetor, pushimi vjetor për punëtorët e arsimit, pushimi në ditën e festave zyrtare, orari i shfrytëzimit të pushimit vjetor, kompensimi për mosshfrytëzimin e pushimit vjetor, dhe mungesa nga puna me pagesë.

MBROJTJA DHE SIGURIA NË PUNË

Ligji rregullon çështjen e mbrojtjes dhe sigurinë në punë. I punësuar ka të drejtë në sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit në ambientin e përshtatshëm të punës, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës. Punëdhënësi është i detyruar të sigurojë kushtet e nevojshme për mbrojtje në punë me të cilat sigurohet mbrojtja e jetës e shëndetit të të punësuarve në pajtim me ligjin.

Mbrojtja e përgjithshme në punë më detajshet rregullohet me nenin 42 të Ligjit të Punës. Neni 43 të këtij ligji rregullon në të cilat raste i punësuar mund të caktohet në punët që janë me rrezik të shtuar. Në punët dhe detyrat e punës në të cilat ekziston rreziku i shtuar i lëndimit, sëmundjes profesionale ose sëmundjeve tjera, mund të caktohet i punësuar i cili i plotëson kushtet e veçanta për punë, në bazë të aftësive shëndetësore; kualifikimit profesional; përvojës së fituar në punë dhe moshës. Me këtë ligj është caktuar, mbrojtja e të rinjve, femrave dhe personave me aftësi të kufizuara, nenet prej 46-48.

Pushimi i lehonisë neni 49 i këtij ligji është caktuar prej 12 muajve. Me prezantimin e certifikatës mjekësore femra e punësuar mund ta fillojë pushimin e lehonisë deri në 45 ditë para datës kur pritet të lindë. Në periudhën prej 28 ditëve para datës kur pritet të lind, punëdhënësi me pëlqimin e femrës shtatzënë, mund të kërkojë që ajo ta fillojë pushimin e lehonisë. Gjashtë muajt e parë pushimit të lehonisë pagesa bëhet nga punëdhënësi me kompensim prej 70% të pagës bazë. Tre muajt në vijim pushimi i lehonisë paguhet nga Qeveria e Kosovës me kompensim 50% të pagës mesatare në Kosovë. Femra e punësuar ka të drejtë me këtë ligj që të zgjasë pushimin e saj të lehonisë edhe për 3 muaj të tjerë pa pagesë. Femrës së punuar i takon pushimi i lehonisë për humbjen e fëmijës, nëse femra e punësuar lind fëmijën e vdekur, ose nëse fëmija i vdes para skadimit të pushimit të lehonisë. Sipas konstatimit të mjekut për sa kohë i nevojitet të këndellet

nga lindja dhe nga gjendja psikike e shkaktuar nga humbja i fëmijës, por ajo më pak se 45 ditë dhe për këtë kohë i takojnë të gjitha të drejtat mbi bazën e pushimit të lehonisë. Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t'ia shkëpus kontratën të punësuarit dhe t'ia ndërrojë vendin e punës, përveç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas nenit 76 të këtij ligji.

Në rast të sëmundjes ose të paaftësisë së përkohshme për punë, i punësuarit është i obliguar të informoj punëdhënësin menjëherë ose më së largu gjatë ditës së mungesës nga puna pika 2,3 dhe 4 është rregulluar me nenin 84 të këtij ligji.

PAGA DHE BENIFICIONET E TË PUNËSUARVE

Me nenin 55 të këtij ligji rregullohet, paga, kompensimi i pagës dhe të ardhurat e tjera. I punësuarit ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me kontratën e punës, në pajtim me këtë ligj, kontratën kolektive dhe aktin e brendshëm të punëdhënësit. Të drejtën për pagë, pagën shtesë, kompensimin në pagë dhe të ardhurat tjera i punësuarit i realizon sipas marrëveshjes së arritur me punëdhënësin për punën e kryer dhe kohën e kaluar në punë, të përcaktuar me kontratën e punës. Paga paguhet në afatet e përcaktuara me kontratë kolektive, aktin e brendshëm të punëdhënësit ose kontratën e punës më së paku 1 herë në muaj. Ligji rregullon edhe pagën shtesë, pagën minimale (nenin 56 dhe 57), kompensimi i pagës neni (neni 58), kur i punësuarit ka të drejtë për kompensim në pagë, gjatë ditëve të festave, në të cilat nuk punohet, gjatë kohës së shfrytëzimit të pushimit vjetor; gjatë aftësisë dhe përsosjes profesionale për të cilën është dërguar dhe gjatë ushtrimit të funksioneve publike për të cilat nuk paguhet. Kompensimi i pushimit mjekësor neni (59), kompensimi i lëndimit në punë, mungesa në punë për shkak të pasigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit (neni 61), kompensimi i dëmit nga i punësuarit neni (63), kompensimi i dëmit për punëdhënësin (neni 65), rregullohet me Ligjin e Punës të Kosovës.

NDËRPRERJA E MARRËDHËNIES SË PUNËS

Ndërprerja e marrëdhënies së punës është njëri ndër institucionet kyçe të marrëdhënies juridike të punës. Ajo drejtpërsëdrejti është i ndërlidhur me themelimin e marrëdhënies së punës, me ekzistimin e kësaj marrëdhënie si dhe me realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të punonjësit dhe punëdhënësit nga marrëdhënia e punës. Me ndërprerjen e marrëdhënies së punës punonjësi e humb statusin që e kishte dhe si rrjedhojë ai pushon të gëzojë të drejtat nga marrëdhënia e punës, të cilat i realizonte gjatë ekzistimit të saj, siç është e drejta në pagë dhe në pagesa dhe kompensime tjera etj. Për këtë arsye e duke pasur parasysh pasojat e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ligjdhënësi i ka përcaktuar rastet dhe kushtet në të cilat punonjësiti mund t'ia ndërprehet marrëdhënia e punës. Në këtë mënyrë për punonjësiti është garantuar siguri juridike në marrëdhënien e punës si dhe mundësia që punonjësi të mund kërkojë mbrojtjen e të drejtave të cënuara me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, në rastet kur ajo është bërë në kundërshtim me ligjin.

Sipas ligjit në fuqi (Ligji i Punës) marrëdhënia e punës themelohet me lidhjen e kontratës së punës, prandaj ajo edhe përfundon me ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Sipas nenit 67 të Ligjit të Punës ndërprerja e kontratës së punës sipas fuqisë ligjore ndërpritet: me vdekjen e të punësuarit, me vdekjen e punëdhënësit kur puna e kryer apo shërbimet e ofruara nga punëtori janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vazhdohet me pasardhësit e punëdhënësit, me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës, kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç, me ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për vërtetimin e humbjes së aftësive për punë, nëse i punësuari shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjasë më tepër se 6 (gjashtë) muaj, me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes dhe rastet e tjera të përcaktuara sipas ligjeve në fuqi.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës mund të ndërpritet me marrëveshje (neni 68), ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit e cila marrëveshje bëhet në formë të shkruar në të cilin rast punëdhënësi është i obliguar t'i paguajë të punësuarit pagën, për ditët e punës deri në ndërprerje. Ndërprerja e marrëdhënies së punës mund të ndërpritet edhe nga ana e të punësuarit i cili ka të drejtë të ndërprejë kontratën në mënyrë të njëanshme. Në këtë rast i punësuari me kontratë në kohë të caktuar për ndërprerjen e kontratës së punës, duhet ta informojë punëdhënësin paraprakisht në formë të shkruar në afatin prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, ndërsa i punësuari me kontratë në kohë të pacaktuar në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh.

NDËRPRERJA E KONTRATËS SË PUNËS NGA ANA E PUNËDHËNËSIT

Me këtë ligj rregullohet e drejta e punëdhënësit që mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi të caktuar me (neni 70 nga pika 1.1 gjer në pikën 1.3). Me pikën 1.4 rregullohet që punëdhënësi mund t'ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes në: raste të rënda të sjelljes së keqe të punonjësit; dhe për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës. Punëdhënësi duhet ta njoftojë të punësuarin për largimin e tij/saj menjëherë pas rastit që shpie në largim, ose sapo punëdhënësi të jetë vënë në dijeni të atij rasti. Me pikën 1.6 rregullohen rastet kur punëdhënësi mund t'ia ndërpres kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur: i punësuari është fajtor për përsëritjen e një të keqe, sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim. Neni 70.2 dhe 3 rregullon obligimet e punëdhënësit lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës për rastet e cekura më lart. Marrëveshjet kolektive ose Aktet e Brendshme të punëdhënësit mund të specifikojnë llojet e keqe të sjelljeve ose të shkeljeve të detyrimeve të cilat bëjnë që i punësuari t'i nënshtrohet ndërprerjes të kontratës së punës pa periudhë të paralajmërimit, qoftë pas një rasti të vetëm dhe qoftë pas shkeljeve të përsëritura. Koha e njoftimit për ndërprerjen e kontratës së punës rregullohet me nenin (71) të këtij ligji.

LARGIMI I PËRKOHSHËM NGA PUNA

I punësuari mund të largohet përkohësisht nga puna kur ndaj tij kanë filluar procedurat penale, për shkak të dyshimit të bazuar të veprës penale, kur i punësuari është në vuajtje të paraburgimit; kryen shkelje të obligimit të punës të përcaktuara me këtë ligj. Kompensimi i pagës gjatë largimit të përkohshëm nga puna të punësuarit i takon e drejta në pagë në lartësi prej 50%. Largimi i përkohshëm nga puna sipas nenit 73 të këtij ligji, mund të zgjasë më së shumti 6 (gjashtë) muaj, periudhë në të cilën punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t'ia shkëpusë kontratën e punës.

Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës për shkak të largimit kolektiv nga puna neni (76), nga par.1 të nenit 70 të këtij ligji ku përfshihen së paku 10% të punësuarve por jo më pak se 20 (njëzetë) të punësuar, të larguar brenda intervalit kohor prej 6 (gjashtë) muajsh, e cila ndërprerje llogaritet si largim kolektiv nga puna. Në rastet e largimit të shkallës së gjërë nga puna, zbatohen dispozitat nga par.3 i këtij neni. Gjatë kohës së largimit të përkohshëm nga puna, sipas nenit 73 të këtij ligji, të punësuarit i takon e drejta e kompensimit në pagë në lartësi prej 50%. Largimi i përkohshëm nga puna sipas nenit 73 të këtij ligji mund të zgjasë më së shumti 6 (gjashtë) muaj, periudhë në të cilën punëdhënësi është i obliguar që të punësuarin ta kthejë në punë ose t'ia shkëpus kontratën e punës.

MBROJTJA E TË DREJTAVE NGA MARRËDHËNIA E PUNËS

Me dispozitat e Ligjit të Punës është rregulluar mbrojtja e të drejtave për të punësuarit. I punësuari i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqes kërkesë te punëdhënësi për realizimin e të drejtave të shkelura. Sipas dispozitave të këtij ligji punonjësi ka të drejtë të kërkojë mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës te organet e punëdhënësit, në gjykatë, mbrojtja përmes ndërmjetësimit, te inspektorati i punës dhe te organet tjera të parapara me ligj. Sipas kërkesës së punësuarit për realizimin e të drejtave të shkelura nga marrëdhënia e punës, punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, ndërsa vendimi nga par.2 të (nenit 78), të Ligjit të Punës i dorëzohet të punësuarit në formë të shkruar brenda afatit prej 8 ditësh. Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij (neni 79), ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 par.2 të këtij ligji në afatin vijues (prej 30 ditësh), mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente.

Gjykata ofron mbrojtjen e të drejtave nga marrëdhënia e punës nëse paraprakisht punonjësi ka kërkuar mbrojtjen interne, nëse me ligj nuk është caktuar ndryshe dhe nëse padia është dorëzuar në gjykatë në afatin e paraparë. Gjatë vendosjes lidhur me ndërprerjen e kontratës së punës, gjykata vepron sipas (neni 80), të Ligjit të Punës. I punësuari dhe punëdhënësi mund t'i zgjidhin mosmarrëveshjet nga puna dhe në bazë të punës përmes ndërmjetësimit. Inspektorati i punës ofron mbrojtjen administrative e

cila gjithashtu realizohet në procedurë administrative i cili sipas ankesës të punësuarit duhet të nxjerr vendim lidhur me ankesën brenda 30 (tridhjetë) ditëve. Për shkeljen e dispozitave të këtij ligji nga ana e punëdhënësit, Inspektorati i Punës do t'i shqiptojë masat ndëshkuese bazuar në Ligjin për Inspektoratin e Punës.

MASAT DISIPLINORE PËR SHKELJEN E DETYRAVE TË PUNËS

Me Ligjin e Punës neni (85), parashihen masa disiplinore për shkeljen e detyrave të punës, të punësuarit që do t'i shqiptohet, si vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim, ulje në pozitë, suspendimit të përkohshëm dhe ndërprerje të marrëdhënies së punës. Masat ndëshkuese, vërejtje me gojë, vërejtje me shkrim dhe ulje, degradim të pozitës, do të shqiptohen për shkelje të lehta të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës, ndërsa masat ndëshkuese, suspendimi i përkohshëm dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës do të shqiptohen për shkelje të rënda të detyrave të punës në pajtim me Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratën e Punës. Sipas (nenit 86) të këtij ligji vendimi për shqiptimin e masave ndëshkuese për shkeljen e detyrave të punës e nxjerr, organi kompetent i punëdhënësit apo punëdhënësi. Punëdhënësi i cili nuk e ka statusin e personit juridik ose personi të cilin ai e autorizon.

MARRËVESHJA KOLEKTIVE

Marrëveshja kolektive mund të lidhet ndërmjet organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij dhe organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshje mund të lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Marrëveshja kolektive mund të lidhet në nivel të vendit, nivel të degës dhe nivel të ndërmarrjes. Marrëveshja duhet të jetë në formë të shkruar në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës. Marrëveshja kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se 3 (tri) vjet. Marrëveshja kolektive nuk mund të përfshijë dispozitat e tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës se sa ato të përcaktuara në këtë ligj.

Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji të cilat rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë e bënë Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligji nr.2003/19 për sigurinë në punë, mbrojtje dhe shëndetit të punësuarve dhe mbrojtjen e ambientit të punës. Punëdhënësit janë të obliguar që aktet e brendshme me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës, t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji, jo më vonë se 6 (gjashtë) muaj pas hyrjes në fuqi të tij. Deri në nxjerrjen e akteve të brendshme në afatin e lartcekur, drejtpërsëdrejti aplikohen dispozitat e këtij ligji.

MARRËDHËNIA E PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL

Në legjislacionin e punës për shërbimin civil dhe sektor të ndryshëm të Shërbimeve Publike miratohen ligje të veçanta, me të cilat rregullohen marrëdhëniet e punës dhe kushtet specifike në ato lëmi. Prej kësaj ka rrjedh edhe kategorizimi në punëtorët dhe nëpunës (të administratës shtetërore), që si emërtime përdoren gati në të gjitha legjislacionet e punës të vendeve të ndryshme. Marrëdhënia e punës në shërbimin civil janë të rregulluara me Rregulloren e UNMIK-ut nr.2001/36 Mbi Shërbimin Civil të Kosovës, me Urdhëresën Administrative nr.2003/2 për Zbatimin e Rregullores dhe me një numër aktesh dhe udhëzimesh të nxjerra në pajtim me dispozitat e Rregullores të Urdhëresës. Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës 03/L-149 datë 13.05.2010, i shpallur me dekretin nr.DL-022-02010 datë 14.06.2010, nga Presidenti i Republikës së Kosovës me të cilin kreu X. neni (94) Dispozitat Përfundimtare dhe Kalimtare përcakton se pas hyrjes në fuqi ky ligj shfuqizon: Urdhëresën Administrative nr.2003/02-për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovës, Udhëzimin Administrativ nr.MSHP.2006/12-Masat për Ngritjen e Punësimit të Nëpunësve Civil në organet e Administratës Publike, Udhëzimin Administrativ nr.09/2006 mbi Zbatimin e Procedurave për Funkcionimin e Komisionit për Emërime të Larta Publike, Dispozitat e Rregullores së ndryshuar të UNMIK-ut nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovës dhe të Urdhëresës Administrative nr.2003/02 për Zbatimin e Rregullores së UNMIK-ut nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë, do të vazhdojnë të zbatohen për të gjitha kategoritë e nëpunësve që nuk rregullohen shprehimisht me këtë ligj. Me nenin 95 të këtij ligji janë përcaktuar rregullat e aplikueshme deri në miratimin e rregulloreve të reja, me kusht që të mos jenë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri shqyrtimin dhe miratimin e rregulloreve nga Ministria përgjegjëse për Administratë Publike ose Qeveria, udhëzime të caktuara me nenin (95), vazhdojnë të mbeten në fuqi. Brenda 1 (një) vit nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha kontratat e punës në Shërbimin Civil të Kosovës për pozitat të cilat për nga natyra, funksioni dhe detyrat janë pozita të përhershme, zëvendësohen me shkresa të emërimit siç është përcaktuar me këtë ligj dhe me aktet e reja nënligjore.

Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës rregullon statusin e nëpunësve civil si dhe marrëdhënien e tyre të punës në Institucionet e Administratës Qëndrore dhe Komunale. Për qëllim të këtij ligji, institucionet e administratës qëndrore dhe komunale që hyjnë në fushën e veprimit të këtij ligji përfshijnë: administratën e Kuvendit, administratën e Presidencës, Zyrën e Kryeministrit dhe ministrit, agjencitë ekzekutive, agjencitë e pavarura dhe ato rregullatore dhe administratën komunale.

Nëpunësit e administratës së Kuvendit të Republikës së Kosovës janë pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës. Kushtet specifike për orarin e punës dhe kompensimet rregullohen me akt të veçantë të Kryesisë së Kuvendit.

- Personeli diplomatik dhe konsullar, si dhe personeli administrativ i dërguar jashtë vendit ose i punësuar në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi;

- Personeli civil i punësuar në Policinë e Kosovës, në Forcën e Sigurisë së Kosovës, në doganat e Kosovës në Shërbimin Korrektues të Kosovës, është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi;
- Personeli administrativ i punësuar në sistemin gjyqësor dhe prokuroria është pjesë e Shërbimit Civil të Kosovës dhe i nënshtrohet këtij ligji dhe legjislacionit përkatës në fuqi; me përjashtim të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Me këtë ligj neni (4) janë përcaktuar kategoritë e punonjësve publike të cilët nuk janë pjesë e shërbimit civil. Në bazë të këtij ligji statusi i nëpunësit civil nuk aplikohet për kategoritë e mëposhtme: stafi mësimor i sistemit arsimor, stafi mjekësor i sistemit shëndetësor, krijuesit dhe përformuesit e artit, zyrtarët policor të Policisë së Kosovës, zyrtarët doganor të Doganave të Kosovës, zyrtarët korrektues të shërbimit korrektues të Kosovës dhe pjesëtarët e forcës së sigurisë së Kosovës, të emëruarit politik dhe të gjithë ata që emërohen në pozita nga të emëruarit politik dhe anëtarëve të kabineteve të tyre që nga kabineti i Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe Kabinetet e Ministrave. Marrëdhënia e tyre e punës rregullohet me Ligjin e Punës, ligje të veçanta me marrëveshje kolektive ose me rregullore sektoriale. Instituti i Kosovës për Administratë Publike (KAP), është përgjegjës për zbatimin e politikave dhe strategji të trajnimit, arsimimit dhe zhvillimit të kapaciteteve në shërbimin civil. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil është një institucion i pavarur për mbikëqyrjen e ligjshmërisë së menaxhimit në shërbimin civil dhe rregullohet me ligj të veçantë.

Pranimi në shërbimin civil të Kosovës bëhet në pajtim me parimet e meritës, aftësisë profesionale, paanshmërisë, mundësive të barabarta, mosdiskriminimit dhe përfaqësimit të barabartë; në bazë të konkursit publik dhe pas verifikimit të zotësisë së veprimit të kandidatëve. Në shërbimin civil të Kosovës ekzistojnë pozitat e nëpunësve civil të karrierës-të cilët ushtrojnë funksionet në bazat të përhershme për arritjen e objektivave të përgjithshme institucionale dhe pozitat e nëpunësve civil të jo karrierës-të cilët ushtrojnë funksionet me kohëzgjatje të kufizuar deri në 2 (dy) vjet, për zbatimin e projekteve të caktuara, zëvendësimi i përkohshëm i nëpunësve të përhershëm civil dhe në rastet të mbingarkesave në punë. Funkionarët publik nuk mund të emërohen me vendim ekzekutiv të Qeverisë në pozitat të cilat me ligj u janë rezervuar nëpunësve civil dhe shërbimit civil nuk do të rezervojë asnjë pozitë për zyrtarët publik.

MARRËDHËNIA E PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL

Nëpunësit civil themelojnë marrëdhënien e punës pas përfundimit me sukses të procedurave të pranimit të përcaktuara me këtë ligj dhe me aktet përkatëse nënligjore dhe pas pranimit të një shkrese të emërimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas përfundimit të procedurës nga institucioni kompetent i administratës publike në të cilën do të gjejë punë nëpunësi civil. Nëpunësi civil në pozita e karrierës pranohen në punë pa afat. Nëpunësit civil në pozitat të jo karrierës pranohen në punë me afat të caktuar. Nëpunësit civil në punë provuese të cilët nuk janë konfirmuar në pozicionin e punës, mund të paraqesin ankesë kundër këtij vendimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës,

në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, prej komunikimit të vendimit nga njësia e personelit. Personeli i punësuar në shërbimin civil ndahet në katër kategori funksionale: nëpunës civil të nivelit të lartë drejtues, nëpunësi civil të nivelit drejtues, nëpunës civil të nivelit profesional dhe nëpunës civil të nivelit tekniko-administrativ.

Me nenin (28) të Ligjit për Shërbimin Civil rregullohet transferimi i nëpunësve civil i cili mund të bëhet në formë të ricaktimit në vend tjetër të punës dhe si transferim i përkohshëm në detyra tjera. Me nenin 31 të këtij ligji rregullohet mënyra në cilat raste nëpunësit civil mund të refuzojnë kryerjen e funksioneve dhe detyrave, përveç atyre të përcaktuara me përshkrimin e detyrave të punës, nëse kryerja e këtyre funksioneve apo detyrave do të ishte në dëm të interesave dhe të drejtave të tyre të ligjshme; do të rrezikonte shëndetin e tyre; do të kërkonte një kualifikim më të lartë ose trajtim të ndryshëm profesional nga ai i dhënë. Orari i punës së nëpunësve civil nuk do të tejkaloj 40 (dyzetë) orë në javë, përveç nëse është përcaktuar ndryshe me këtë ligj. Çdo nëpunësit civil me këtë ligj është caktuar pushimi gjatë orarit të punës si dhe drejtat e femrave shtatzënë, nënave me fëmijë deri në moshën 3 vjeç dhe nëpunësve civil me aftësi të kufizuara. Me nenin (39) të këtij ligji është rregulluar pushimi vjetor, kohëzgjatja e pushimit, ndërsa pushimi vjetor nuk mund të shndrohet në formë tjetër kompensimi monetar ose jo monetar. Drejta në pagë nëpunësit civil kompensohet përmes sistemit të pagave i cili rregullohet me ligj të veçantë.

Ligji për shërbimin civil parasheh masat disiplinore për shkelje të detyrës, që ka ndodhur si rezultat i fajit të tyre, sikur që është përcaktuar me ligj. Përgjegjësia personale për kryerjen e një vepre penale ose kundravajtje gjatë ushtrimit të detyrave administrative nuk e përjashton përgjegjësinë disiplinore të nëpunësit civil, me kusht që vepra gjithashtu të përbëjë shkelje të detyrës, siç është përcaktuar me këtë ligj. Në rast të inicimit të procedurës penale kundër nëpunësit civil për kryerjen e veprës penale gjatë ushtrimit të mandatit, që mund të rezultojë në krijimin e kushteve për ngritjen e padisë kundër nëpunësit civil, të gjitha procedurat disiplinore lidhur me rastin nuk mund të inicohen deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente. Nëse nëpunësi civil i akuzuar për kryerjen e veprës penale shpallet i pafajshëm: ai do të kthehet në vendin e punës, asnjë masë disiplinore nuk do të merret kundër nëpunësit civil, pas shpalljes i pafajshëm ose përjashtimit nga një procedurë penale. Nëpunësit civil janë përgjegjës për çfarëdo shkelje të parimeve të përcaktuara sipas këtij ligji të përshkruar në nenin (64).

Masat disiplinore zbatohen në mënyrë graduale dhe në proporcion me pasojat dhe dëmet e shkaktuara nga sjellja e nëpunësit civil. Rastet e shkeljeve jashtëzakonisht të rënda përcaktohen me akt nënligjor. Shkeljet e detyrave të punës ndahen në shkelje të lehta dhe të rënda-serioze. Për shkelje të lehta shqiptohen masat disiplinore: vërejtje gojore, vërejtje me shkrim që vendoset në dosjen personale të shërbyesit civil. Për shkelje të rënda serioze shqiptohen masat disiplinore: pezullimi nga puna dhe ndalimi 1/3 të rrogës për një periudhë deri në 2 (dy) muaj nga Komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë; largimi nga zyra dhe transferimi në një lokacion tjetër me detyra të ngjashme dhe ndalimi i gradimit deri në 5 (pesë) vjet nga Komisioni disiplinor dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës në shërbimin civil nga komisioni

disiplinor. Ligji rregullon neni (67) masa disiplinore që mund të zbatohen për shkeljet e detyrave të përcaktuara për shkelje të lehta dhe për shkelje të rënda.

Çdo institucion i administratës publike i cili punëson nëpunës civil themelohet një komision disiplinor për marrjen e masave disiplinore në rast të shkeljes së rëndë të ligjit të shërbimit civil apo të akteve nënligjore. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit disiplinor emërohen nga Sekretari i Përgjithshëm apo nga pozitat ekuivalente të institucioneve përkatëse dhe anëtarët e komisionit disiplinor nuk mund të shërbejnë si anëtarë të komisionit të ankesave të institucionit përkatës. Kryesuesi dhe anëtarët e komisionit disiplinor janë nga radhët e nëpunësve civil me përgatitje superiore shkollore, emërohen në periudhë 2 (dy) vjeçar, me mundësi vazhdimi dhe duhet të pasqyrojnë diverzitetin e shoqërisë Kosovare duke përfshirë sidomos diverzitetin gjinor. Kompetencat e komisionit disiplinor është rregulluar me nenin 71 të këtij ligji.

PEZULLIMI, NDËRPRERJA DHE PËRFUNDIMI I MARRËDHNIES SË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL.

Marrëdhënia e punës në shërbimin civil mund të pezullohet, ndërpritet dhe të përfundojë sipas kushteve të parapara me këtë ligj nenet (83, 84 dhe 85). Nëpunësit civil shkarkohet nga shërbimi civil për shkak të performancës dhe rezultateve të dobëta, shkeljes së kodit të mirësjelljes dhe shkeljes së ligjit i cili ka rezultuar me vepër penale, siç është përcaktuar me ligj. Pas zhvillimit të procedurës disiplinore, organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucionin punëdhënës i dorëzon nëpunësit përkatës civil një njoftim me të cilin bëhet e ditur ndërprerja e marrëdhënies së punës dhe shkaqet e ndërprerjes dhe udhëzimin për hapat e mëtejme. Procedurat e shkarkimit nga shërbimi civil përcaktohen me akte nënligjore nga Ministria përgjegjëse për administratë publike. Marrëdhënia e punës e nëpunësit civil përfundon me krijimin e kushteve dhe fakteve, pavarësisht nga dëshira e nëpunësit civil ose institucionit neni (90) të këtij ligji. Nëpunësit civil informohet për përfundimin e punësimit, 6 (gjashtë) muaj moshë 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeç, para datës së pensionimit, nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit të institucionit punëdhënës. Nëpunësit civil mund të kërkojnë pensionim të parakohshëm jo më shumë se 2 (dy) vjet para afatit të përcaktuar për pensionimin e tyre.

Pas hyrjes në fuqi, ky ligj shfuqizon Urdhëresën Administrative dhe Udhëzimet Administrative të cekura në nenin (94). Rregullat e aplikueshme deri në miratimin e rregulloreve të reja, me kusht që të mos janë në kundërshtim me këtë ligj dhe deri në shqyrtimin dhe miratimin e rregulloreve nga Ministria përgjegjëse për administratë publike ose Qeveria, Udhëzimet Administrative të caktuara me nenin (95) vazhdojnë të mbeten në fuqi.

Ligji për Shërbimin Civil neni (96) rregullon zëvendësimin e kontratave të punës të shërbimit civil me shkresa të emërtimit. Të gjitha procedurat disiplinore të iniciuara para hyrjes në fuqi të këtij ligji, zhvillohen në përputhje me Udhëzimin Administrativ nr.2003/04 procedurat e disiplinës të këtij ligji.

Pjesë përbërëse e ligjit për shërbimin civil është:

-Ligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nr.03/L-192 i cili ka hy në fuqi më 02.09.2010. Ky ligj përcakton organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm Këshilli) Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil është organ i pavarur që i raporton Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe i cili zgjedh ankesat e nëpunësve si dhe siguron respektimin e të gjitha rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil në Republikën e Kosovës. Këshilli përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve që emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente. Përbërja e këshillit pasqyron karakterin shumë etnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku 2 (dy) anëtarë emërohen nga komunitetet jo shqiptare dhe së paku 2 (dy) anëtar të jenë gjinisë femërore. Për tu zgjedhur anëtarë i këshillit kandidati duhet të ketë kualifikime dhe t'i plotësojë kushtet të caktuara me nenin 5 të këtij ligji. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditësh para kalimit të mandatit anëtarit të këshillit apo pas shpalljes së vendit të lirë të punës për arsye të tjera, Kuvendi i Kosovës në pajtim me Rregulloren e Punës nxjerr shpalljen publike, brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj. Emërimet e propozuara që pranohen, shqyrtohen nga një komision ad hoc i Kuvendit të Kosovës. Anëtarët e Këshillit emërohen për mandat 5 (pesë) vjeçar, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat tjetër. Anëtari i Këshillit nuk ka të drejtë që gjatë mandatit të tij të ushtrojë ndonjë funksion tjetër apo të merr pjesë aktive në aktivitete politike. Kryetari i Këshillit udhëheq punën dhe koordinon aktivitetet e anëtarëve të këshillit.

FUNKSIONET E KËSHILLIT.

Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil kundër vendimeve të organit të punësimit në të gjitha institucionet e shërbimit civil në përputhje me rregullat dhe parimet e parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil të Republikës së Kosovës. Nëpunësi civil i cili është i pakënaqur me vendim të organit të punësimit, lidhur me pretendimin për shkeljen e rregullave dhe parimeve të parashtruara në Ligjin për Shërbim Civil, ka të drejtë të ankohet në Këshill. Në emër të Këshillit ankesat i shqyrton dhe i vendos kolegji i përbërë nga 3 (tre) anëtarë të këshillit. Rregullat dhe procedurat për ankesa caktohen nga Këshilli i përcaktuar me nenin 12 të këtij ligji. Në rastet kur këshilli bindet se përmes vendimit të kundërshtuar janë shkelur parimet apo rregullat e shërbimit civil, ai nxjerr vendim me shkrim i cili i drejtohet zyrtarit të nivelit të lartë drejtues apo përgjegjësitar kryesor të organit përkatës të punësimit i cili është përgjegjës për zbatimin e vendimit të këshillit.

Vendimi i këshillit paraqet vendimin administrativ të formës së prerë dhe ekzekutohet nga zyrtarit të nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. Ekzekutimi duhet të bëhet brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të vendimit. E drejta e ankesës është rregulluar me nenin 14 të këtij ligji. Moszbatimi i vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i institucionit paraqet shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës. Brenda afatit prej 30 (tridhjetë) ditëve nga

dita e kalimit të afatit për ekzekutim, pala mund të fillojë procedurën e ekzekutimit në Gjykatën Komunale (Themelore) sipas Ligjit për Procedurën Përmbareuese kundër personit dhe institucionit përgjegjës për ekzekutim, për dëmet materiale dhe jo materiale që janë shkaktuar me këtë vendim. Këshilli miraton Rregulloren e Punës dhe Kodin e Etikës.

Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji (02.09.2010), shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut nr.2008/12 për ndryshimin e rregullores nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil në Kosovë.

SIGURI NË PUNË, MBROJTJE TË SHËNDETIT TË PUNËSUARVE DHE AMBIENTIT TË PUNËS.

Qëllimi i Ligjit për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës, është që të parandalohen, lëndimet në punë, sëmundjet profesionale në vendin e punës dhe të mbrohet ambienti i punës. Punëdhënësi është i obliguar të krijoj kushtet për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës për punëmarrësit e tij. Punëdhënësi është i obliguar për t'i mbuluar të gjitha shpenzimet për krijimin e të lënduarve në punë dhe sëmundjeve profesionale. Krijimi i Fondit për sigurimin shëndetësor, nga kontributet e punëdhënësve për të gjithë punëmarrësit, i liron punëdhënësit prej obligimeve për bartjen e shpenzimeve. Ligji ka përcaktuar obligimet dhe përgjegjësit e punëdhënësit dhe të drejtat dhe përgjegjësit e punëmarrësit dhe veçmas mbrojtjen e kategorive të veçanta më të rrezikuara (të rinjtë, gratë shtatzëna, personat me aftësi të kufizuar). Caktohen masa dhe krijimi i kushteve të mbrojtjes në punë nga uji, ajri, drita, zjarri, elektriciteti, zhurma, dridhjet, substancat kimike.

Me akte nënligjore, në zbatim me ligjin dhe me standardet përkatëse, Ministria e Punës i përkufizon më hollësisht kushtet, masat, mënyrën dhe mjetet e mbrojtjes në punë. Ligji parashikon masa ndëshkimore (gjoba) prej 100 deri 35.000 €, për punëdhënësit të cilët nuk i zbatojnë masat e caktuara të mbrojtjes në punë. Me këtë ligj është caktuar kategoria e personave të cilët gëzojnë të drejtën e mbrojtjes së përgjithshme dhe asaj të veçantë në punë duke përfshirë (përfaqësuesit e administratës shtetërore, shfrytëzuesit e shërbimeve, bashkëpunëtorët afarist), punëmarrësit në shërbim civil. Ky ligj nuk ka të bëjë me Pjesëtarët e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, Shërbimit Policor të Kosovës dhe Shërbimit të Zjarrfikësve.

Punëdhënësi është i obliguar të organizoj dhe të ndërmer masa të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës përfshirë parandalimin e rreziqeve në punë ofrimin e informatave, trajnimeve organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar, mirëmbajtur makinerinë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendin e punës mundësit për të shkuar në vendin e punës. Punëdhënësi për sigurinë e punëmarrësve sipas nevojës është detyruar të bëjë kualifikimin dhe trajnimin e punëmarrësve në pajtim me standardin evropian. Punëdhënësi pajis të punësuarin me pajisjet personale mbrojtëse, e cila është e paraparë për mbrojtjen kundër ekspozimit

të dëmtimeve edhe rreziqeve në punë. Punëdhënësi do t'i bartë shpenzimet dhe do të bëjë zëvendësimin e pajisjeve personale mbrojtëse në intervale të rregullta kohore dhe çdo herë kur është e domosdoshme. Punëdhënësi i përgjigjet punëmarrësit për dëmin e shkaktuar me rastin e lëndimit në punë dhe sëmundjen profesionale që ka të bëjë me punën, sipas parimit të përgjegjësiive objektive të së drejtës së detyrimeve.

TË DREJTAT DHE PËRGJEGJËSITË E PUNËMARRËSIT

Punëmarrësi ka të drejtë dhe obligim për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit dhe ambientit të punës. Punëmarrësi është i obliguar t'i përmbahet masave të nevojshme për siguri në punë, mbrojtjes së shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës, kujdesit për sigurinë dhe shëndetin e tij dhe të personave të tjerë të ndikuar nga veprimet e tija në punë, shfrytëzon në mënyrë të duhur mjetet e sigurisë dhe pajisjet personale mbrojtëse (PPM), ato i përdorë me kujdes dhe i mban në gjendje funksionale. Punëmarrësit gjithashtu duhet të kenë përgjegjësi për të siguruar mbrojtjen dhe shëndetin e të gjithë personave e të ndikuar nga veprimet në punën e tyre. Punëmarrësi ka të drejtë ta refuzojë punën, nëse ai ka arsye të kësaj se ekziston rrezik i drejtpërdrejtë për jetën dhe shëndetin e tij. Nëse punëdhënësi konsideron se refuzimi i punës është i pabazuar menjëherë duhet të lajmërojë inspektorin e punës.

Autoritetet e inspektoratit të punës do të autorizohen t'i kontrollojnë dhe përcjellin implementimin dhe zbatueshmërinë e masave për siguri në punë, mbrojtjen të shëndetit të të punësuarve dhe ambientit të punës.

LIGJI PËR INSPEKTORATIN E PUNËS NË KOSOVË

Punët e mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit të Punës dhe të ligjeve të tjera, të cilat kanë të bëjnë me marrëdhëniet në punë, kushtet e punës, mbrojtjen në punë dhe çështje të tjera në punë e në lidhje me punën i kryen organi kompetent i pushtetit shtetëror, i caktuar me ligj të veçantë-Ligji për Inspektoratin e Punës. Në lëminë e së drejtës së punës, inspektimi bëhet duke i shkuar aktet e përgjithshme dhe ato individuale, si dhe kushtet dhe mënyrën e punës së subjekteve juridike ose atyre fizike të mbikëqyrura. Inspektoratet janë të autorizuar dhe të detyruar të ndërmarrin masa administrative, me qëllim që gjendjen e konstatuar dhe veprimtarinë e subjekteve të mbikëqyrura ta vënë në përputhje me ligjet dhe aktet e tjera. Nuk është e mjaftueshme vetëm të kemi institucionin e inspektoratit, por ai duhet të jetë i organizuar mirë dhe efikas. Një inspektorat efikas mund të kontribuojë shumë që puna jo formale (jo legale, puna e zezë), të vihet në binarë ligjore. Kemi përshtypjen se inspektorati i punës do të gjente shkelje të ligjeve të punës te secili subjekt që do ta kontrollonte, si në sektorin shoqëror-publik ashtu edhe në sektorin privat. Me veprimet parandaluese dhe me një politik adekuatë ndëshkimore, inspektorati i punës do të kontribuonte që t'u mbrohen të drejtat shumë punëtorëve, por edhe t'i detyronte punëtorët dhe punëdhënësit të paguanin obligimet e tyre tatimore e të kontributeve të caktuara me ligj.

FUNKSIONET E INSPEKTORATIT TË PUNËS

Inspektorati i Punës do të mbikëqyr zbatimin e Ligjit të Punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë. Do t'iu siguron informacion teknik dhe këshilla punëdhënësve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore. Do të njoftoj Ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në Ligjin e aplikueshëm. Do t'ju jep këshilla për çështje lidhur me Ligjin e Punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të ndonjë ndërmarrjeje. Inspektori i punës si autoritet ekzekutiv themelohet nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe është përgjegjës para kësaj Ministrie në lidhje me koordinim e veprimeve ekzekutive sa i përket Inspektoratit të Punës në Kosovë. Autoriteti i Inspektoratit të Punës përbëhet nga Kryeinspektori i Punës dhe Inspektorët e Punës të cilët ushtrojnë funksionet e tyre në tërë Kosovën. Me qëllim të zbatimit të Ligjit nga fushveprimtaria e tij autoriteti i inspektoratit të punës koordinon veprimet dhe bashkëpunon me qeveritë komunale, inspekcionet tatimore, inspekcionet shëndetësore me autoritet tjera relevante dhe me Policinë e Kosovës. Kryeinspektorin e punës e emëron Qeveria me propozim të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale. Inspektorët Komunal i zgjedhë Kuvendi i Komunës. Ligji ka përcaktuar autorizimet e kryeinspektorit (neni 4) dhe të inspektorëve të punës (neni 5), për sa u përket veprimeve, kontrollit, urdhrave, vendimeve, gjobave, procedurave të ankesës, raportimeve dhe çështjeve të tjera lidhur me kontrollin e zbatimit të ligjeve në lëminë e punës.

Ligji për Inspektoratin e Punës nr.2002/9 ka pasur ndryshimet lidhur me “fjalët” në ligj dhe disa plotësime me ligjin nr.03/L-017. Për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për Inspektoratin e Punës nr.2002/9 më 29.04.2008. Me nenin 1 të Ligjit për Ndryshimin e Ligjit fjalët “Autoritet i Inspektoratit të Punës” është zëvendësuar me fjalët Inspektorati i Punës. “Ndryshimet në fjalët janë rregulluar me nenin 3,4,5 dhe 6” të Ligjit të lartpërmendur.

E DREJTA E PUNËS DHE PROCESI I PRIVATIZIMIT

-Agjencia Kosovare të Privatizimit

Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej “Agjencia”), është organ i pavarur publik i cili ushtron funksionet dhe përgjegjësit në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur dhe shitur pronën si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj, si dhe të padisë e të paditet në emër të saj. Agjencia është pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), që është themeluar dhe rregulluar në bazë të Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12 Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit dhe të gjitha asetet dhe përgjegjësit e saj do të jenë asete dhe përgjegjësi të Agjencisë. Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, Agjencia është e autorizuar për administrim, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe (ose likuidimin e ndërmarrjeve dhe asetëve të përkufizuara). Me nenin 2 të këtij ligji janë caktuar autorizimet dhe administrimi i agjencisë.

Agjencia ka kompetenca që të administrojë, ndërmarrjet në pronësi shoqërore, pavarësisht nëse i janë nënshtruar transformimit apo jo, të cilat kanë qenë pronë në pronësi shoqërore me ose pas 22 marsit 1989, përveç rasteve të rregulluara sipas par.2 të këtij neni (5) dhe të gjitha aksionet në korporata dhe korporatat vartëse të themeluara sipas këtij ligji dhe të gjithë interesat në pronësi shtetërore në një ndërmarrje apo subjekt tjetër juridik, pavarësisht nëse ajo ndërmarrje apo subjekt juridik i është nënshtruar transformimit. Nëse ndërmarrja i është nënshtruar transformimit, ky transformim nuk do të ndikojë në të drejtat dhe kompetencat e Agjencisë sipas par.1 dhe 2 të këtij neni si dhe neneve 6,8 ose 9 të këtij ligji, përveç nëse: transformimi është bazuar dhe është kryer në përputhje të plotë me ligjin në bazë të cilit është bërë transformimi; janë përmbushur të gjitha obligimet që ndërlidhen me Transformimin, qofshin ato që kanë dal gjatë apo pas transformimit, qofshin ato të shqiptuara në bazë të ligjit apo ndonjë kontrate-përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm në, përmbushjen e plotë të detyrimeve që kërkojnë pagesën e kompensimit të plotë dhe lëshimin e aksioneve; dhe transformimi nuk ka qenë diskriminues dhe nuk i ka shkelur parimet e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Agjencia ka kompetenca të gjëra dhe ekskluzive administrative mbi të gjitha ndërmarrjet, asetet, interesat, aksionet dhe pronën që bie në fushëveprimin e nenit 5.1 dhe 5.2 të këtij ligji. Ky autoritet përfshinë çdo veprim që agjencia e konsideron të arsyeshëm dhe të duhur, brenda kufijve të burimeve administrative të Agjencisë, për të mundur më mirë shitjen likuidimin, transferimin apo ndonjë zgjidhje tjetër të ndërmarrjes, asetit apo interesit në pronësi shtetërore. Bordi i Agjencisë mund të inicioj likuidimin e ndonjë ndërmarrje, korporate, aseti ose një pjesë të saj, përmes lëshimit të vendimit për likuidim nëse mendon se procedura e tillë është në interes të kreditorëve ose pronarëve përkatës. Procesi i likuidimit do të ushtrohet në bazë të procedurave të përcaktuara të këtij ligji. Me nenin (11) të këtij ligji është caktuar organizimi dhe menaxhimi i Agjencisë. Agjencia ka Bordin e Drejtorëve, Drejtorin Menaxhes dhe

dy Zëvendës Drejtor Menaxhues, Drejtori i Sekretarisë Ekzekutive si dhe personelin profesional dhe teknik.

Përbërja e bordit është caktuar me nenin (8) të këtij ligji. Procedurat e Bordit caktohen me aktet nënligjore të Agjencisë të miratuara nga Bordi. Për zbatimin e kompetencave të saj sipas këtij ligji, Agjencia mund të lëshoj urdhra dhe shqiptoj gjokat e përcaktuara në nenin (27) ndaj ndërmarrjeve, punonjësve dhe personave të tjerë me funksione menaxhuese ose mbikëqyrëse mbi ndërmarrjet për rastet të caktuara me këtë nen. Çdo drejtor i ndërmarrjes dhe çdo person tjetër me funksion menaxhues dhe mbikëqyrës mbi ndërmarrjen është përgjegjës për çfarëdo dëmi të shkaktuar ndërmarrjes si rezultat i mosrespektimit të udhëzimeve të ligjshme të përfaqësuesit të autorizuar të Agjencisë që vepron sipas autorizimeve të Agjencisë: Agjencia autorizohet të kërkojë në emër të ndërmarrjes në fjalë pagimin e dëmit të tillë në gjykatën kompetente. Asnjë procedurë ligjore kundër një ndërmarrje nuk do të mbahet në gjykatë nëse kërkuesi nuk siguron dëshmi me shkrim se Agjencisë i është paraqitur njoftimi me shkrim lidhur me ngritjen e padisë në të cilën duhet të specifikohet emri i kërkuesit, emri i ndërmarrjes dhe të dhënat e tjera identifikuese, baza e ankesës dhe ndihma e kërkuar. Agjencia ka të drejtë ligjore që të kërkojë çfarëdo të drejtash për një ndërmarrje në gjykatën kompetente në emër të asaj ndërmarrje. Dhoma e Veçantë ka juridiksion ekskluzivisht për të gjitha paditë kundër Agjencisë. Dhoma e Veçantë nuk do të pranojë asnjë padi kundër Agjencisë përveç nëse pala paditëse dorëzon dëshminë se e ka njoftuar kryesuesin e Bordit për dorëzimin e një padie të tillë së paku 60 (gjashtëdhjetë) ditë para dorëzimit të saj. Me kërkesën e Agjencisë Dhoma e Veçantë mund të pezullojë hapjen e procedurës së padisë që është bërë kundër Agjencisë për një afat i cili nuk mund t'i kalojë 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të padisë së tillë për të mundësuar një zgjidhje miqësore.

Ky ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër të së drejtës në Kosovë që është në kundërshtim me të. Pa paragjykim ndaj aplikimit të përgjithshëm të fjalisë së mëparshme, parashihet në mënyrë specifike që Ligji për Procedurën Administrative nuk do të vlejë: për çfarëdo veprim të ndërmarrë nga Agjencia sipas autorizimeve të këtij ligji lidhur me privatizimin, likuidimin, shitjen, transferimin, ristrukturimin, riorganizimin apo mënyrat tjera të zgjedhjes së një ndërmarrje, korporate apo aset, dhe për trajtimin për caktimin nga Agjencia të autoritetit të likuidimit të çfarëdo pretendimi, apo interesi të bërë apo të pohuar nga cilido person si kreditor apo pronar i supozuar. Me këtë ligj shfuqizohet ligji nr.03/L-067, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Agjencia merr përsipër të gjitha asetet dhe detyrimet të cilat ajo ose paraardhësja e saj i ka mbajtur, fituar apo shkaktuar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12. Bordi dhe Menaxhmenti i Agjencisë i përmbushin të gjitha përgjegjësitë e cilido bordi ose menaxhmenti paraardhës të emëruar sipas Rregullores së UNMIK-ut nr.2002/12.

Pa paragjykim ndaj fushëveprimit të përgjithshëm të paragrafit të mëparshëm apo paragrafit 2 të nenit 3 të këtij ligji, parashihet në mënyrë specifike që Agjencia është trashëgimtarja ligjore dhe ekskluzive e cilësdo apo të gjitha të drejtave dhe obligimeve të AKM-së që janë specifikuar apo kanë dal në lidhje me ndonjë kontratë që është ekzekutuar më parë nga AKM-ja dhe një apo më shumë palë të treta që si objekt kryesor

të tyre kanë pasur menaxhimin, operimin, shitjen, transferimin, likuidimin apo ndonjë mënyrë tjetër të disponimit me ndërmarrjen, korporatën asetin apo çfarëdo interesi në cilëndo nga këto. Çdo referim i kontratave të tilla në AKM do të interpretohet në mënyrë përfundimtare se nënkupton Agjencinë.

Me Rregulloren nr.2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësinë Shoqërore me nenin (10) të Rregullores janë rregulluar të drejtat të punësuarve. Për shkak të statusit të veçantë të të punësuarve në ndërmarrjet shoqërore përkritazi me këto ndërmarrje dhe ndikimit që privatizimi do të ketë në këtë status, të punësuarit e tillë kanë të drejtë parësore të përfitojnë një pjesë të të ardhurave nga privatizimi. Kjo pjesë do të jetë 20% e të ardhurave nga shitja e aksioneve të një filiali korporate në varësi të një ndërmarrjeje me pronësi shoqërore, që është privatizuar në përputhje me nenin 8 të Rregullores nr.2002/12. Shuma ndahet në dobi të të punësuarve me të drejta legjitime në përputhje me këtë nen. Organi përfaqësues i të punësuarve të ndërmarrjes me pronësi shoqërore në fjalë, në bashkëpunim me Federatën e Sindikatave të Pavarura të Kosovës, harton, në baza jo diskriminuese dhe ia dërgon Agjencisë, listën e të punësuarve me të drejta legjitime që kanë të drejtë për të marrë pagesat në pajtim me nenin 10.1. Agjencia shqyrton listën dhe bënë ndryshimet e nevojshme për të siguruar qasje të barabartë për të gjithë punonjësit me të drejta legjitime në Fondet që duhen shpërndarë. Lista zyrtare e të punësuarve me të drejta legjitime e lëshuar nga Agjencia, së bashku me njoftimin për të drejtën e ankesës, në pajtim me nenin 10.6 publikohen në dy ditë pune të njëpasnjëshme dhe me fundjavën vijuese në gazetën kryesore në gjuhën shqipe e me tirazh të gjërë në Kosovë dhe në gazetën kryesore në gjuhën serbe.

Punëtori konsiderohet si legjitim nëse është regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më se 3 (tri) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorit, të cilit pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin qenë të diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme në pajtim me nenin 10.6.

Agjencia e vendos shumën e rezervuar, në nenin 10.1, në një llogari garacimbajtjeje të cilën Federata e Sindikatave të Pavarura të Kosovës ua shpërndanë të punësuarve me të drejta legjitime si vijon: 75% e shumës i shpërndahet në sasi të njëjta secili prej të punësuarve me të drejta legjitime.

-25 përqindëshi i mbetur i shumës u shpërndahet të punësuarve me të drejta legjitime në shuma në përpjesëtim me numrin e muajve që çdo i punësuar ka punuar në ndërmarrjen me pronësi shoqërore.

Pas paraqitjes së kërkesës nga indivi apo individët me të drejtë të cënuar, ankesa lidhur me listën e të punësuarve me të drejta legjitime, e përcaktuar nga Agjencia dhe shpërndarja e fondeve nga llogaria e garacimbajtjes e paraparë me nenin 10.5 i nënshtrohet shqyrtimit nga Dhoma e Posaçme, në pajtim me nenin 4.1 (g) të Rregullores 2002/13 (çështje të tjera të tilla që mund t'i caktohen me ligj). Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të nenit 10.3 të listës së të punësuarve me të drejta legjitime. Dhoma

e Posaçme shqyrton çfarëdo ankese në bazë të përparësisë dhe merr vendim për këto ankese brenda 40 ditëve pas dorëzimit të tyre. Çfarëdo ankese e dorëzuar në Dhomën e Posaçme me bazë diskriminimi si shkak për mos përfshirjen në listën e të punësuarve me të drejta legjitime, duhet të shoqërohet me dëshmi të dokumentuara për diskriminimin e pretenduar. Shuma e plotë e fondeve nga llogaria për garancimbajtje, në çfo rast do të lirohet për tu shpërndarë nga agjencia jo më vonë se 60 ditë pas datës së botimit përfundimtar të listës së të punësuarve me të drejta legjitime.

ANKESAT E BËRA SIPAS RREGULLORES NR.2003/13.

-Ankesat lidhur me listën e punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën.

Procedura për ankesat e bëra sipas nenit 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/13 të datës 09.05.2003, (“Ankesat nga neni 10.6”), do të udhëhiqet sipas kësaj Urdhërese Administrative (nr.2008/6) datë 11.06.2008, e cila do të zbatohet përshtatshmërisht (mutatis mutandis), për ankesat nga neni 10.6. Pas pranimit të listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën sipas nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/13, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit publikon një listë të përkohshme të punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën bashkë me një njoftim për publikun mbi të drejtën e çdo personi që brenda 20 ditësh të parashtrijë ankese në këtë agjenci për përfshirje në listë ose kundërshtimin e listës së punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën.

Kërkesa ose kundërshtimi i tillë duhet të mbështetet në fakte dhe të përmbajë bazën ligjore për kërkesën apo kundërshtimin shqyrtuar nga AKM-ja gjatë hartimit të listës në gjuhën angleze dhe në gjuhën e ankuesit. Këto komente dërgohen brenda 3 ditëve ankuesit. Njoftimi i publikut përmban një kopje të formularit për dorëzimin e kërkesës ose kundërshtimit. Ky formular përcakton se duhet të përfshihen informacione që i duhen Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit për të vlerësuar atë kërkesë ose kundërshtim. Pas pranimit të kërkesës ose kundërshtimit në lidhje me listën e punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën Agjencia Kosovare e Mirëbesimit kërkon paraqitjen e dëshmive dhe informacioneve të tjera nëse janë të nevojshme për të vlerësuar si duhet ato kërkesa ose kundërshtime. Pas parashtrimit të të gjitha dëshmive Agjencia Kosovare e Mirëbesimit i jep mundësinë secilës palë ose avokatit ose që e përfaqëson palën të paraqesin argumentet e tyre për mbështetjen e kërkesës ose kundërshtimit.

Pas zgjidhjes së të gjitha kërkesave dhe kundërshtimeve, nëse është e nevojshme, Agjencia Kosovare e Mirëbesimit e bënë përshtatjen e listës së punëtorëve të cilat gëzojnë të drejtën dhe me vendim të Bordit të Drejtorëve në pajtim me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/13, e cila përmban një arsytim për përfshirjen ose përjashtimin e secilit person në listë dhe pranimin ose refuzimin e kundërshtimeve të tjera ndaj listës, krijon zyrtarisht listën e punëtorëve të cilat gëzojnë të drejtën. Lista e krijuar e punëtorëve të cilët gëzojnë të drejtën publikohet në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores nr.2003/13. Ankesa e bërë në pajtim me nenin 10.6 të Rregullores së UNMIK-ut nr.2003/13 para Dhomës së Posaçme bëhet me shkrim, e cila duhet

të përmbajë emrin ose emrat e personit ose të personave në emrin e të cilëve bëhet ankesa (ankuesit) dhe adresën e secilit ankues për dërgim. Bazat e detajuara ligjore dhe faktike ku mbështet kërkesa për përfshirje ose kundërshtim të listës së punëtorëve të cilat gëzojnë të drejtën të krijuar nga Agjencia apo shpërndarjen e fondeve nga llogaria garancimbajtëse e paraparë me nenin 10 të Rregullores nr.2003/13. Dhoma e Posaçme ia dërgon një kopje të ankesës Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit brenda tri ditëve nga dita e regjistrimit në regjistër.

LIGJI MBI PENSIONET NË KOSOOVË NR.2001/35.

E drejta e sigurimit social, në përgjithësi dhe e drejta e sigurimit pensional, në veçanti, kanë një trajtim të rëndësishëm në normat juridike. Kjo vërejtje është objekt garantimi edhe me kushtetuta dhe ligje sistemore, por edhe me ato të veçanta. E drejta e pensionit, si e drejtë origjinare pasurore, personale, fitohet në bazë të punës individuale, ndarjes dhe deponimit në fonde të caktuara të kontributit të punëtorit e të punëdhënësit, gjatë marrëdhënies së punës, sipas kushteve të caktuara me ligj. Me Rregulloren nr.2001/35, për Pensionet në Kosovë, është bërë një shkëputje totale nga sistemi i mëparshëm i pensioneve. Rregullorja aplikon një sistem të sigurimit pensional qeveritar (publik) dhe privat. Ndërkaq, parashikon tri forma (shtylla) të pensioneve:

- pensionin bazë,
- pensionin e bazuar në kontribute të obligueshme, dhe
- pensionin plotësues.

Dy format e para janë të obligueshme për punëtorët dhe punëdhënësit, ndërsa forma e tretë është mbi baza vullnetare. “Pension bazë (më tej “pension bazë”), do të thotë një pension që administrata pensionale u paguan të gjithë qytetarëve të Kosovës e kanë arritur moshën e pensionimit. “Pensioni i bazuar në kursime individuale” (më tej “pensioni i kursimeve individuale”) do të thotë një pension që Fondi ua paguan të gjithë personave në moshën e pensionimit që i plotësojnë kushtet sipas kësaj Rregulloreje lidhur me kontributet pensionale. “Pension plotësues i punëdhënësit” do të thotë një pension që punëdhënësi ua siguron punonjësve të vet në përputhje me këtë Rregullore.

“Pension plotësues individual” do të thotë një pension që qytetarët e blejnë nga personat fizik dhe nga dhënësit e licencuar të pensioneve në përputhje me këtë Rregullore. Dy forma e para janë të obligueshme për punëtorët dhe punëdhënësit, ndërsa forma e tretë është mbi baza vullnetare. Pensioni bazë, si formë e obligueshme, u paguhet të gjithë qytetarëve të Kosovës me banim të përhershëm në Kosovë, të cilët kanë arritur moshën 65 vjeç. Kjo moshë vlen për të dy gjinitë. Pensioni bazë paguhet nga mjetet e buxhetit të Kosovës. Administrata e Pensioneve është themeluar në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Shumën e pensionit bazë e cakton Kuvendi i Kosovës, ndërsa mjetet sigurohen në buxhetin e Kosovës. Shuma e pensionit bazë do të përcaktohet sipas metodologjisë të cilën do ta miratojë Kuvendi, kështu që e

njëjta shkallë do të zbatohet për të gjithë pensionistët që i plotësojnë kushtet e pensionit të pleqërisë dhe se shkalla e pensionit për vitin vijues do të përcaktohet gjatë procesit të buxhetit brenda kufijve të gjithmbarshëm të fondeve që u ndahen institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes për pensionet bazë të pleqërisë nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Forma e dytë e obligueshme e sigurimit pensional është Fondi si person juridik i pavarur me qëllimin e vetëm dhe ekskluziv të administrimit dhe menaxhimit të llogarive individuale për pensionet e bazuara në kursime, në investim të kujdesshëm dhe në ruajtjen e mjeteve pensionale dhe pagimin e të ardhurave që krijohen në llogaritë individuale për blerjen e anuiteteve për pensionet e bazuara në kursime, si një administrues i besuar që vepron në emër të pjesëmarrësve dhe shfrytëzuesve. Fondi është person juridik jo fitimprurës i aftë për të paditur dhe për t'u paditur në emër të vet.

ARKËTIMI I KONTRIBUTEVE PËR FINANCIMIN E PENSIONEVE TË KURSIMEVE INDIVIDUALE.

Çdo punëdhënës është i obliguar që të kontribuojë në emër të punonjësve të vet në Fondin e kursimit pensional. Punonjësit obligohen që të kontribuojnë në emër të vet në kursimet pensionale. Obligimet e punëdhënësit dhe të punonjësit fillojnë në ditën e parë të punësimit të punëdhënësi për punonjësit që kanë arritur moshën (18) vjeçar. Çdo punëdhënës paguan një shumë që është baras me 5% të rrogës së tërësishme të tij ose të saj. Punëdhënësit mund të kontribuojnë vullnetarisht një shumë plotësuese deri në 10% të rrogës vjetore, për një shumë të përgjithshme prej 15% të rrogës. Po ashtu punonjësit mund të kontribuojnë vullnetarisht një shumë plotësuese deri në 10% të rrogës së tyre vjetore, për kontributin e përgjithshëm prej 15% të rrogës. Në rastet kur rrogat paguhen kryesisht në natyrë, punëdhënësit paguhen 5% të vlerës së tregut të pagesës në natyrë dhe punonjësi i paguan 5% të vlerës së tregut të pagesës në natyrë Administratës Tatimore. Në rastet kur rrogat janë më të vogla se paga minimale, punëdhënësi i paguan 5% të rrogës minimale Administratës Tatimore dhe punonjësi paguan 5% të rrogës minimale Administratës Tatimore. Administrata Tatimore ka përgjegjësi dhe të drejta të njëjta lidhur me inspektimin, vlerësimin dhe zbatimin e pagesave të kontributeve që ajo i ka rreth tatimit në të ardhura. Llogaria individuale është pronë e personave përkatës. Ajo pronë nuk mund të ndalet, të transformohet as të tjetërsohet në ndonjë mënyrë tjetër. Mirëpo shfrytëzimi i mjeteve nga ajo llogari është e kushtëzuar me arritjen e moshës së pensionit. Në rast të vdekjes së punëtorit, paratë nga llogaria e tij mund t'i tërheqë familja.

Fondi duhet të emërojë një mbrojtës të vetëm, të cilit ia delegon obligimin për mbrojtjen e mjeteve pensionale dhe lidh marrëveshje për mbrojtjen e tyre. Mbrojtësi dhe punonjësit e tij të cilët kanë liri veprimi sa u përket fondit pensional, sipas kësaj Rregulloreje janë të besuarit e Fondit. Fondi e përzgjedh mbrojtësin me konkurs ndërkombëtar. Kushtet dhe procedura për udhëheqjen e tenderit, duke përfshirë edhe kërkesat paraprake të kualifikimit për mbrojtësin, shumën dhe përbërjen e aksioneve të tij, arsyet dhe procedurën e pezullimit ose anulimit të licencës së tij i përcakton në

përputhje me këtë Rregullore subjekti i prokurimit qendror të Kosovës ose trashëguesi e tij.

Forma e shtylla e tretë e sigurimit pensional është një formë plotësuese vullnetare e kontributit të punëtorëve dhe punëdhënësve. Punëdhënësi mund të formojë fond plotësues pensioni për punëtorin e vet, ndërsa edhe punëtorët mund të blejnë pension plotësues nga kompania e caktuar ose t'i depozitojë mjetet vullnetare (si kursimet) të një banke të licencuar.

Pagesa e kontributeve të obligueshme për pension ka filluar të zbatohet në mënyrë të diferencuar, në dy data të ndryshme:

- punëdhënësit që janë agjenci shtetërore “ndërmarrje shtetërore” ose shoqërore, ose punëdhënësi të mëdhenj me 500 ose më tepër punonjës, me 1. mars 2002;
- të gjithë punëdhënësit e tjerë, 1 janar 2002;
- personat e vetëpunësuar nga të cilat kërkohet që të kontribuojnë si punëdhënës dhe si punonjës, më 1 mars 2003;
- punëdhënësit e punëtorëve bujqësor dhe punëtorët e vetëpunësuar bujqësorë, me 1 mars 2003, dhe
- kontributet vullnetare mund të fillojnë përpara datave efektive të paraqitura këtu.

Nëse Kuvendi konstaton se kontributet e kërkuara nga punëdhënësit nuk mund të fillojnë me datat e sipërshenuara, ai mund t'i ndërrojë këto data. Përveç, mënyrës së përcaktuar me këtë nen, data efektive e kësaj Rregulloreje do të jetë 01.03.2002, nëse Kuvendi nuk e përcakton ndryshe. Duke filluar nga data 1 janar 2005, personat me banim të përhershëm në Kosovë mund të zgjidhen një opcion alternativ të menaxhimit të Fondit, me kusht që BQK-ja të ketë licencuar sigurues të tjerë alternativë të pensioneve të kursimeve individuale dhe të ketë nxjerrë rregulla për menaxhimin e mjeteve, mbrojtëjen dhe marketingun e aranzhmaneve të tilla alternative. Departamenti i pensioneve i BQK-së është i autorizuar që t'i licencojë këtë sigurues duke filluar nga viti 2005 në përputhje me procedurat e miratuara nga Kuvendi.

Me nenin 35 të ligjit është caktuar se ky ligj e shfuqizon çdo dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me te.

Me Ligjin nr.03/L-084 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 për Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/35 për Fondin Pensional të Kosovës datë 15.06.2008, janë bërë ndryshimet me fjalët, ashtu që secilën herë që përmendet “Rregullorja” ajo zëvendësohet me fjalën “Ligji”. Në vend të “Autoritetit Bankar dhe pagesave të Kosovës-BPK” zëvendësohet me “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës-BQK. Teksti i tërës pjesës hyrëse të Rregullores zëvendësohet me formulimin-Kuvendi i Republikës së Kosovës” dhe nenit 7 të Ndryshimit me nenin 4.1 të Rregullores shprehje “PSSP” zëvendësohet me fjalën “Kuvendi” dhe fshihet shprehja “dhe të miratuar nga PSSP-ja”. Me nenin 8 fshihet shprehje “Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes”. Në vend të-Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës zëvendësohet me fjalën “Fondi”. Me nenin 13 të Ndryshimeve në nenin 5.7 të Rregullores shprehja “UNMIK” zëvendësohet me fjalën “Qeverisë”.

KONFLIKTI ADMINISTRATIV 6

1. Shqyrtime të përgjithshme lidhur me konfliktin administrativ

Zhvillimi i konfliktit administrativ paraqet një garanci për mbrojtjen e të drejtave të palëve nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Kur organi kompetent administrativ e përfundon procedurën administrative duke nxjerrur një akt administrativ përfundimtar, kundër të cilit pala e pakënaqur nuk ka mundësi që të zbatojë mjetin e rregullt juridik (ankesën), atëherë lind konflikti në mes të palës dhe organit kompetent që ka nxjerrur aktin përkatës administrativ.

Sipas kësaj, konflikti administrativ mund të definohet si një situatë juridike e re që fillohet përmes padisë, kundër një akti administrativ të cilin paditësi e konsideron si të paligjshëm dhe kërkon anulimin e tij.

Çdokush që paraqet një interes të ligjshëm mund t'i drejtohet gjykatës, me qëllim që kjo e fundit të përcaktojë dhe të përmirësojë situatën juridike të pavlefshme që ka krijuar akti, pavarësisht se nga ky atakim mund të preket një palë tjetër.

Sistemi ynë i së drejtës ka për qëllim që të arrijë funksionimin e një administrate efikase me qëllim të realizimit të drejtpërdrejtë të interesave shoqërore (objektive), nga njëra anë dhe interesave individuale (subjektive) në anën tjetër.

Konsiderohet që koncepti i konfliktit administrativ duhet të përcaktohet përmes precizimit të lëndës së konfliktit të caktuar dhe shkaqeve të ngritjes së atij konflikti, në lidhje me qëllimin.

Gjykata kompetente duke vendosur mbi konfliktin administrativ i qaset zgjidhjes së një konflikti duke vendosur mbi kërkesat që parashtrohen në padi pa i tejkaluar kompetencat e saj. Gjykata në çdo rast çmon provat në bazë të bindjes së saj të brendshme.

Në këtë kuptim roli i gjykatës është një rol rishikues, por brenda këtij roli ajo është arbitri që të përcaktojë ligjshmërinë e veprimit, mosveprimit apo aktit të organit të administratës shtetërore apo publike, duke vendosur një balancë në mes të interesit të përgjithshëm, interes të cilin kanë detyrim ta mbrojnë dhe ta realizojnë organet e

administratës, dhe interesit privat, të subjekteve të tjera, interesa të cilat ato nuk kanë të drejtë ti cenojnë, veçse në mënyrën e përcaktuar me ligj dhe në përputhje me të.

Konflikti administrativ do të thotë rishikimi gjyqësor i veprimtarisë administrative dhe njëherit konsiderohet si një element i rëndësishëm i kontrollit të gjithë veprimtarisë administrative në përgjithësi.

Ky kontroll i punës së administratës i kontribuon kultivimit të një fryme ligjore në ushtrimin e të gjitha veprimeve nga ana e administratës. Nëse pa administratë nuk do të mund të funksiononte shoqëria, pa një kontroll të arsyeshëm nga ana e gjykatës nuk do të mund të jetonim në një shtet të së drejtës, nuk do të mund të jetonim në një klimë të sundimit të ligjit, por në të kundërtën, do të gjendeshim para abuzimeve të organeve të pushtetit.

Drejtësia administrative mund të konsiderohet si një fazë në procesin e vendimmarrjes së administratës dhe si një instrument për të justifikuar veprimet administrative. Në traditën e doktrinës kontinentale gjejmë frazat si: “gjykimi i administratës është ende pjesë e procesit të administrimit” ose shqyrtimi gjyqësor i veprimit administrativ është vazhdim i veprimtarisë së administratës publike me mjete të tjera “.¹

Për vite të tëra hulumtimet empirike janë përpjekur të përcaktojnë shkallën e ndikimit të shqyrtimit gjyqësor në marrjen e vendimeve administrative. Kjo detyrë është përcjellur me vështirësi sepse hulumtimet empirike vuajnë nga mungesa e punës analitike duke izoluar ndikimin e shqyrtimit gjyqësor nga shumë presione të tjera normative brenda fushës administrative. Por në vitet e fundit, përvojat e vendeve të ndryshme tregojnë se me rritjen e mirqënjes sociale, legjislacionet në fushën e rishikimit gjyqësor të veprimtarisë administrative kanë filluar të japin vëmendje ndaj mosveprimit të paligjshëm të qeverisë për të mos frenuar, por për të stimuluar qeverinë.²

Shqyrtimi gjyqësor i veprimtarisë administrative për kohë të gjatë është kufizuar në shumicën e vendeve evropiane. Ky kufizim është krijuar mbi idenë se, për shkak të parimit të ndarjes së pushteteve, gjyqtarët nuk duhet të ndërhyjnë në detyra ekzekutive. Për më tepër, ka pasur një opinion të përhapur që gjyqtarët nuk janë në gjendje për të ndërhyrë në mënyrë efikase në çështje administrative. Megjithatë, kjo pikëpamje ka ndryshuar në masë të madhe në 50 vitet e fundit dhe ideja se një veprim administrativ do ti nënshtrohet një kontrolli gjyqësor ka arritur një progres të madh.³

1 Jean-Marie Woehrling, SIGMA Support for Improvement in Governance and Management. A joint initiative of the OECD and the European Union, principally financed by the Protecting Legality: Public administration and judiciary in EU countries . How to conciliate executive accountability and judicial review, Conference on Public Administration Reform and European Integration, Budva, Montenegro, 26-27 March 2009, p.8.

2 Jerry L. Mashaw, Richard A. Merrill and Peter M. Shane, Administrative Law, The American Public Law System: cases and Material 816 (3rd edition, West Publishing, 1992).

3 Jean-Marie Woehrling, SIGMA Support for Improvement in Governance and Management. A joint initiative of the OECD and the European Union, principally financed by the Protecting Legality: Public administration and judiciary in EU countries . How to conciliate executive accountability and judicial review, Conference on Public Administration Reform and European Integration, Budva, Montenegro, 26-27 March 2009, p.3.

Veprimtaria e organeve administrative përshinë tërësinë e akteve dhe të veprimeve të ndryshme, nëpërmes të cilave formohet dhe shfaqet vullneti i administratës shtetërore. Ky vullnet i administratës shtetërore, i shprehur në aktet administrative individuale apo normative gjen pasqyrimin e tij në Kushtetutë, në ligje apo dispozita të tjera me karakter nënligjor, por kjo nuk mund të konceptohet si një veprimtari e pagabueshme dhe aq më tepër e pakontrollueshme nga askush. Andaj, mbikëqyrja e kësaj veprimtarie ekzekutive i nënshtrohet kontrollit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

Kontrolli paraqet një raport të atillë shoqëror në të cilën njëra palë-ushtuesi i kontrollit, ushtron veprime të kontrollit të punës së tjetrit (apo rezultateve të asaj pune) përmes caktimit të masave paraprake, vlerësimit të efikasitetit të arritur, dhe në fund, sipas nevojës, vjen edhe deri te intervenimi i ushtuesve të kontrollit, në lidhje me kontrollin e lëndës.

Një ndër format e kontrollit të jashtëm është kontrolli që ushtrohet nga ana e gjykatave.

Sipas juristit të njohur amerikan Horsky, gjykata nuk është që të përcaktojë rastin sipas këndvështrimit të saj, por në vend të kësaj, të përcaktojë nëse organi i administratës shtetërore ushtron diskrecionin e deleguar apo jo.

Lidhur me ushtrimin e kontrollit ndaj akteve administrative, në teorinë juridike dhe praktike ekzistojnë tri sisteme:

Sistemi sipas të cilit konfliktet administrative-juridike i zgjidh vet administrata. Ky sistem më së shumti është zbatuar në ish Republikën Socialiste Sovjetike, dhe në disa vende ish socialiste. Sipas sistemit të tillë konfliktet administrativo-juridike janë zgjidhur nga organet e administratës shtetërore në procedurë instancionale apo hierarkike. Gjykatat kanë zgjidhur konfliktet e tilla vetëm në raste të veçanta (p.sh. konfliktet e marrëdhënieve të punës)

Sistemi i gjykatave të veçanta (specializuara) administrative sipas të cilit sistem, zgjidhja e konflikteve administrative bëhet nga gjykatat administrative. Ky sistem ekziston në Francë, Gjermani, Austri, dhe vende të tjera perëndimore

Sistemi Anglosakson, sipas të cilit zgjidhja e konflikteve administrative bëhet nga gjykatat e kompetencës së përgjithshme.

Sistemi Evropian paraqet themelimin e gjykatave të specializuara administrative për zgjidhjen e konflikteve administrative. Në këtë drejtim, gjykatat e specializuara administrative janë të autorizuara në shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve administrative.

Shtetet që i përkasin këtij sistemi⁴ janë të bazuara në parimin e rreptë të ndarjes së pushteteve, sipas të cilit sistemi gjyqësor nuk ka të drejtë të shqyrtojë ligjshmërinë e akteve administrative. Prandaj, gjykatat e veçanta administrative nuk ushtrojnë funksione të tjera përveç ushtrimit të mbikëqyrjes gjyqësore ndaj akteve administrative përfundimtare

Franca konsiderohet si djepi i krijimit të gjykatës së parë të specializuar administrative, ku Këshilli i Shtetit (Conseil d-Etat) është themeluar në vitin 1801,

4 Gjermania, Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Greqia, Italia, Luksemburgu, Holanda, Polonia, Bullgaria, etj.

ndërsa kjo traditë u zgjerua më vonë në vende të tjera si Gjermania (1863), Austria (1875) etj. Në vendet që i përkasin këtij sistemi, gjykatat administrative ose tribunalet nuk kanë funksione të tjera përveç shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së akteve administrative.

Në sistemin Anglo-Saxon, kontrolli gjyqësor mbi aktet e lëshuara nga administrata publike ushtrohet nga gjykatat e kompetencës së përgjithshme. Ky sistem zbatohet në Angli, Shtetet e Bashkuara, Australi, Zelandë të re, Izrael, etj. Këto vende nuk kanë gjykatat administrative si organe të veçanta gjyqësore për të kontrolluar aktet administrative, por këto procedura kryhen nga gjykatat e rregullta.

Sot, dallimet ndërmjet këtyre dy sistemeve janë duke u zvogëluar dhe janë duke u zbatuar disa zgjidhje të përziera në lidhje me kontrollin gjyqësor të vendimeve administrative.

Lidhur me fillimin e konfliktit administrativ ekzistojnë dy sisteme: 1) sistemi i klauzolës së përgjithshme dhe 2) sistemi i numërimit.

Sipas sistemit të klauzolës së përgjithshme, konflikti administrativ mund të ngritët kundër të gjitha akteve administrative. Sipas këtij sistemi, mundësia e ngritjes së konfliktit administrativ bëhet me një klauzolë të përgjithshme, e jo me numërim të materieve të veçanta administrative.⁵

Sipas sistemit të numërimit, konflikti administrativ mund të fillohet vetëm ndaj disa akteve të caktuara administrative.

Në histori, së pari ka filluar të zbatohet sistemi i numërimit, për shkak se fillimisht kanë qenë të lejuara vetëm disa akte administrative kundër të cilave mund të fillohej konflikti administrativ, e tek më vonë ka filluar aplikimi i sistemit të klauzolës së përgjithshme i cili ka përparësi, në krahasim me sistemin e numërimit.

Në të drejtën tonë është përvetësuar sistemi i klauzolës së përgjithshme me enumeracion negativ, ku janë përcaktuar përjashtime nga rregulli i klauzolës së përgjithshme, që do të thotë se tek ne, konflikti administrativ mund të fillohet kundër të gjitha akteve administrative, përveç rasteve të veçanta të parapara ekskluzivisht me ligj, në të cilat nuk mund të ngritët konflikti administrativ. Neni 15 i LKA-së⁶, shprehimisht përcakton se konflikti administrativ nuk mund të zhvillohet:

- a) *a) kundër akteve të nxjerra në çështjet, në të cilat është siguruar mbrojtja gjyqësore jashtë konfliktit administrativ;*
- b) *b) kundër akteve të nxjerra në çështjet rreth të cilave, sipas dispozitës së ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ; dhe*
- c) *c) kundër akteve administrative, që përbëjnë një detyrim të përgjithshëm, të nxjerra nga organet e administratës, përveç kur ato cenojnë të drejtat e ligjshme të palëve.*

5 Slavoljub Popovic, Jovanka Savinsek, Komentar Zakona o upravnim sporovima, Beograd, 1997.

6 Ligji Nr. 03/L-202, Për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Prishtinë: Viti V, Nr.82, 21 Tetor 2010.

Në konfliktin administrativ gjykata nuk është në pozitë të mbivaresisë as në raport me paditësin e as me palën e paditur, prandaj gjykata vendos në mënyrë autoritative, objektive dhe profesionale.

2. Objekti i konfliktit administrativ

Objekt i shqyrtimit në procedurën e konfliktit administrativ është akti administrativ. Akt administrativ quhet çdo urdhër, vendim, apo veprim që merret nga autoritetet administrative për rregullimin e një rasti të veçantë ose rasteve të përgjithshme në sferën e të drejtës publike.⁷

Akti administrativ, duke qenë i autorizuar nga ligji ka automatikisht pasoja ligjore. Në këtë kuptim, një akt administrativ është një akt juridik. Aktet administrative mund të krijojnë të drejta, privilegje, pushtete, përgjegjësi dhe detyra, ose mund t'i ndryshojnë, apo shuajnë ato.

Akt administrativ është çdo vendim i organit⁸ të administratës publike cili merret në fund të një procedure administrative në ushtrimin e autorizimeve publike dhe që prek, në mënyrë të favorshme ose jo të favorshme të drejtat e njohura ligjërisht, liritë ose interesat e personave fizikë ose juridikë përkatësisht palës tjetër në vendosjen e çështjes administrative.⁹

Akti administrativ është një nga format, mund të themi më kryesore, në veprimtarinë ekzekutive dhe vendim marrëse të administratës publike. E gjithë veprimtaria ekzekutive e çdo organi administrativ publik konkretizohet përfundimisht në momentin e nxjerrjes së aktit, sepse është akti administrativ, ai që krijon marrëdhënie të reja juridike për subjektet që ju drejtohet, që i ndryshon këto marrëdhënie të krijuara më parë, duke i përsosur më shumë, ose edhe i shuan këto marrëdhënie.

Akti administrativ për të qenë objekt i konfliktit administrativ duhet të plotësojë këto kushte:

Vendimi duhet të nxirret nga ana e organit shtetëror, organizatës ose bashkësisë tjetër që ushtron autorizime publike;

Akti administrativ duhet të jetë i nxjerrur në një çështje administrative;

Me aktin administrativ duhet të vendoset mbi ndonjë të drejtë ose detyrim të individit apo organizatës;

Akti administrativ duhet të jetë konkret dhe individual;

Akti administrativ duhet të jetë përfundimtar në procedurën administrative.¹⁰

7 Esat Stavileci, Mirlinda Batalli, Sokol Sadushi, "E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative, Prishtinë 2012, fq. 129.

8 Neni 3 i LKA-së, shprehjes "Organ" përcakton kuptimin e organeve të administratës publike, organeve të qeverisjes qendrore dhe organeve tjera në varësi të tyre, organeve të vetëqeverisjes lokale dhe organeve në varësi të tyre, kur në ushtrimin e autorizimeve publike vendosin për çështjet administrative.

9 Ligji Nr. 03/L-202, Për Konfliktet Administrative, neni 3.1.2. Gazeta Zyrtare e Republikë së Kosovës, Prishtinë: Viti V, Nr.82, 21 Tetor 2010.

10 Agur Sokoli, E Drejta Procedurale Administrative, Prishtinë, 2014, fq. 222.

Konflikti administrativ mund të fillohet kundër aktit administrativ të nxjerrë në shkallë të dytë, si dhe ndaj aktit administrativ të nxjerr në shkallë të parë ndaj të cilit pala nuk ka të drejtë ankese. Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrur akt përkatës administrativ në rast të heshtjes së administratës, si për shembull: në rast se organi kompetent në afatin e caktuar nuk nxjerrë aktin administrativ, i cili do të duhej të ishte përfundimtar, përkatësisht kundër të cilit nuk ka vend për ankesë, palës i është dhënë mundësia që të ngrit konfliktin administrativ, për shkak se në këtë rast organi i administratës ka heshtur, duke mos e nxjerrur aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative.¹¹

3. Shkaqet e fillimit të konfliktit administrativ

Në të drejtën tonë dallohen dy grupe të shkaqeve për fillimin e konfliktit administrativ:

- a) *shkaqet formalo - juridike (jokompetenca, shkelja e procedurave ligjore, vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike, etj);*
- b) *shkaqet materialo - juridike (shkelja e të drejtave ligjore dhe keqpërdorimi i autorizimit).*

3.1 Shkaqet formalo-juridike

- a) *Jokompetenca. Me jokompetencë kuptojmë pamundësinë juridike të një organi që të nxjerrë një akt për shkak se ai organ nuk ka autorizim ligjor për të vendosur një çështje të caktuar administrative. Në këtë aspekt dallohet: a) jokompetenca reale-lëndore, e cila ekziston në rast se një organ nxjerrë një akt kur ai organ sipas ligjit nuk ka të drejtë të nxjerrë akte të tilla dhe*
- b) *jokompetenca territoriale, e cila ekziston në rast se një akt administrativ e ka nxjerrur organi i një komune, e në fakt është dashur që ai akt të nxirret nga organi i një komune tjetër.*

Çështja e jokompetencës vlerësohet nga gjykata sipas detyrës zyrtare. Për shkak të jokompetencës, gjykata mund të prish aktin administrativ në procedurë paraprake apo të rregullt.

- a) *Shkelja e rregullave procedurale (gabimet në formë). Ekziston mundësia që një akt administrativ të kontestohet për shkak se në procedurën e nxjerrjes së atij akti, nuk është vepruar sipas rregullave ligjore meqë në këtë rast gjykata*

¹¹ Shih si e përshkruan këtë situatë neni 29.1 i LKA-së: Konflikti administrativ si pasojë e heshtjes së organit të administratës së shkallës së dytë mund të fillojë në qoftë se ky organ në afatin e caktuar kohor (30 ditësh dhe as në afatin e mëtejshëm prej 7 ditësh pas kërkesës së përsëritur nga pala) nuk e nxjerr aktin administrativ i cili do të duhej të ishte përfundimtar. Mirëpo, konflikti administrativ si pasojë e heshtjes së administratës mund të fillohet edhe ndaj organit të administratës së shkallës së parë (nën kushtet e njëjta si të organi i shkallës së dytë) në qoftë se ndaj aktit përfundimtar të këtij organi nuk është e lejuar ankesa.

është e autorizuar që ta anuloj aktin e tillë administrativ. Shkelja e rregullave procedurale mund të qëndrojë në atë që janë shkelur rregullat sipas të cilave duhet të nxirret akti dhe shkelja e rregullave ligjore në bazë të cilave është nxjerrur akti.

- b) *Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike. Në lidhje me kontrollin gjyqësor të gjendjes faktike në të drejtën tonë është përvetësuar sistemi sipas të cilit gjykatës i njihet e drejta që të hyjë në vërtetimin e gjendjes faktike dhe ta prish aktin administrativ nëse vërteton se organet që e kanë nxjerrur aktin nuk e kanë vërtetuar plotësisht gjendjen faktike. Megjithatë, në raste të veçanta përvetësohet edhe sistemi sipas të cilit gjykatës i lejohet që jo vetëm të lëshohet në kritikën e gjendjes faktike, por edhe i njihet e drejta që vetë të vërtetojë gjendjen faktike.*

Gjykata është e autorizuar që ta prish aktin administrativ për shkaqet vijuese:

së pari, nëse gjykata vlerëson se në procedurën administrative nuk është vërtetuar gjendja faktike në pika të caktuara. Sipas kësaj, ligji mban llogari për rrethana të tilla të cilat mund të shpijnë drejt nxjerrjes së aktit jo ligjor;

së dyti, gjykata mund të prish aktin administrativ, po qe se vërteton se ekzistojnë kontradikta në mes të gjendjes së vërtetuar faktike të paraqitur në aktin e kontestuar dhe shkresave të lëndës;

së treti, gjykata është e autorizuar që ta prish aktin e kontestuar administrativ nëse vërteton se në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike është nxjerrur përfundim jo i drejtë .

3.2 Shkaqet materialo-juridike

- a) *Zgjidhja jo e drejtë e çështjeve ligjore (shkelja e rregullave materialo-juridike). Nëse gjatë procedurës administrative nuk vërtetohet ekzistimi i shkaqeve formalo-juridike për prishje të aktit administrativ, gjykata do ta prish aktin e tillë në rast se vërteton se një çështje e caktuar juridike është zgjidhur në mënyrë të gabuar. Zgjidhja jo e drejtë e një çështje juridike ekziston në rast se me aktin administrativ është shkelur ndonjë rregull materialo-juridike, në rast se me rastin e nxjerrjes së aktit administrativ nuk është zbatuar fare ligji apo ai është zbatuar në mënyrë të gabuar.*
- b) *Keqpërdorimi i autorizimit. Ky shkak përmendet në të drejtën franceze në kuptim të teorisë së keqpërdorimit të autorizimit. Ky shkak për prishjen e një akti administrativ bazohet në idenë se organet administrative janë të detyruara që ti ushtrojnë autorizimet e tyre në interes dhe në të mirë të detyrës zyrtare. Nëse para nxjerrjes së aktit administrativ ekziston qëllim tjetër e jo ai për të cilin është dhënë autorizimi, atëherë organi do ta shkel autorizimin e tij. Sipas kësaj, keqpërdorim të autorizimit kryen ai organ i cili autorizimin e tij e përdor për qëllime të tjera, e jo për ato të cilat i janë besuar.*

4. Llojet e konfliktit administrativ

Mbi ndarjen e konflikteve administrative ekzistojnë kritere të ndryshme. Kjo ndarje bëhet në: konflikte administrative mbi ligjshmërinë e aktit administrativ dhe konflikt i juridiksionit të plotë,¹² konflikte administrative subjektive dhe objektive, e poashtu në teori përmenden edhe konfliktet administrative paraprake dhe plotësuese, konfliktet administrative të përgjithshme dhe të veçanta si dhe konflikte administrative të shkallës së parë dhe shkallës së dytë.

4.1 Konflikti administrativ mbi ligjshmërinë e aktit administrativ

Çdo akt administrativ i nxjerrur në pajtim me dispozitat ligjore, konsiderohet si akt administrativ i ligjshëm. Por, ndodh që organet dhe subjektet e tjera gjatë ushtrimit të autorizimeve publike të nxjerrin akte administrative jo të ligjshme, me të cilat vendoset për të drejtat dhe detyrimet e personave juridik dhe palëve të tjera në procedurën administrative. Në rastin e tillë gjykata vlerëson se me aktin administrativ kontestues a është shkelur ligji në kuptim formal apo material. Pra, objekt i konfliktit administrativ mbi ligjshmërinë e aktit, është vlerësimi i ligjshmërisë të atij akti e jo edhe zgjidhja e çështjes administrative. Në rast se gjykata vërteton se akti administrativ nuk është nxjerrur në mënyrë të ligjshme, ajo do të anulohet aktin e tillë dhe do të ja dërgojë organit apo subjektit tjetër, në vendosje të sërishme me qëllim të mënjanimin të paligjshmërisë.

4.2 Konflikti i juridiksionit të plotë

Konflikti i juridiksionit të plotë ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave subjektive, do të thotë se objekt i këtij konflikti është vërtetimi i situatës individuale juridike. Në situatë të tillë gjykata ka mundësi që ta ndryshojë, ta prish apo ta vërtetojë aktin e caktuar administrativ. Vendimi i nxjerrur në procesin administrativ të juridiksionit të plotë, në tërësi e zëvendëson aktin e anuluar administrativ. Konfliktet e juridiksionit të plotë paraqiten qoftë pavarësisht, qoftë lidhur me konfliktet mbi ligjshmërinë e aktit administrativ.

Ligji mbi konfliktet administrative parasheh disa lloje të konfliktit administrativ të juridiksionit të plotë. I pari është ai në të cilin gjykata pos vlerësimit të ligjshmërisë vendos edhe për kompensimin e dëmit të shkaktuar me rastin e ekzekutimit të aktit administrativ.

Lloji i dytë i konfliktit administrativ të juridiksionit të plotë është ai në të cilin gjykata vetë e zgjidh çështjen administrative në rast se plotësohen disa kushte, si: 1) që natyra e çështjes e lejon këtë, 2) që të dhënat e procedurës sigurojnë bazë të mjaftueshme për zgjidhje të tillë.

Në konfliktin e juridiksionit të plotë, autorizimet e gjykatës janë shumë më të mëdha se sa në konfliktet mbi ligjshmërinë e akteve administrative. Ky lloj i konfliktit është më efikas ngase mundëson realizimin më të shpejtë të drejtave të palës, sepse

12 Dr. Esat Stavileci, "Hyrje në Shkencat Administrative", Prishtinë, 1997, fq. 185.

çështja administrative përfundon në gjykatë dhe nuk i kthehet më organit kompetent për vendosje.

4.3 Konfliktet administrative subjektive dhe objektive

Konflikte administrative subjektive janë ato konflikte të cilat ngritën nga ana e personit fizik apo juridik, për shkak të shkeljes së të drejtës subjektive.

Konflikte administrative objektive janë ato konflikte të cilat ngritën nga ana e personit fizik apo juridik për shkak të shkeljes së të drejtës objektive, përkatësisht për vërtetimin e ligjshmërisë së aktit pa marrë parasysh se për të drejtat e kujt është fjala.

4.4 Konflikti paraprak dhe plotësues

Konflikt administrativ paraprak quhet ai konflikt në të cilin gjykata vendos për konfliktin administrativ në atë çështje administrative që më parë nuk ka vepruar organi kompetent, ndërsa konflikt administrativ plotësues është ai konflikt në të cilin gjykata vendos pas nxjerrjen së aktit administrativ në procedurë administrative.

4.5 Konflikti administrativ i përgjithshëm dhe i veçantë

Konflikti i veçantë administrativ ka karakter të veçantë dhe ka të bëjë me çështjet në të cilat ndryshe nga ligji është eliminuar mbrojtja administrative – gjyqësore - e në të cilat organi para se të nxjerrë aktin konkret, ka tejkaluar kufijtë e kompetencës. Parimisht, konflikti administrativ ka karakter të përgjithshëm, pasi që mund të fillohet dhe zhvillohet kundër të gjitha akteve administrative.

4.6 Konflikti administrativ i shkallës së parë dhe shkallës së dytë

Konflikti administrativ i shkallës së parë, respektivisht shkalla e parë në të cilën përfundon procedura e konfliktit administrativ paraqet një ndër parimet themelore. Kjo do të thotë se vendimi i gjykatës mbi përfundimin e një procedure administrative-gjyqësore bëhet menjëherë i plotfuqishëm.

Mirëpo, dyshkallshmëria e konfliktit administrativ është paraparë si mundësi edhe në vendin tonë sepse palës i është dhënë mundësia e apelimit të gjitha vendimeve gjyqësore të cilat nxirren për gjatë kësaj procedure nga gjykata e shkallës së parë. Nderkaq, vendimi i gjykatës së shkallës së dytë, gjegjësisht vendimi i gjykatës së apelit është i formës së prerë.

5. Procedura e konfliktit administrativ

Procedura e Konfliktit Administrativ është procedurë e veçantë gjyqësore e cila rregullohet me Ligjin për Konfliktet Administrative (tutje LKA).¹³ Sipas këtij ligji, rregullohet kompetenca, përbërja e gjykatës dhe rregullat e tjera procedurale në bazë të cilave gjykata kompetente vendosë për ligjshmërinë e akteve administrative me të cilat organet kompetente të administratës publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, si dhe për ligjshmërinë e veprimeve të organeve administrative.

Përmes procedurës së konfliktit administrativ sigurohet mbrojtja gjyqësore e të drejtave dhe interesave juridike të personave fizik, juridik dhe palëve të tjera, të cilat të drejta dhe interesa janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike.

Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve administrative përfundimtare, me të cilat organet e administratës, gjatë ushtrimit të autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative (neni 9 i LKA-së).

5.1 Gjykata kompetente për zgjidhjen e konfliktit administrativ

Në Republikën e Kosovës, si gjykatë kompetente për të vendosur në procedurën e konfliktit administrativ në shkallë të parë është Departamenti për Çështjet Administrative që vepron në Gjykatën Themelore të Prishtinës, për gjithë territorin e Republikës së Kosovës.¹⁴

Departamenti për Çështje Administrative i Gjykatës Themelore në Prishtinë gjykon dhe vendos në konfliktet administrative sipas padive kundër akteve administrative përfundimtare dhe për çështjet e tjera të përcaktuara me ligj. Të gjitha çështjet në Departamentin për Çështje Administrative, gjykohen nga një (1) gjyqtar profesionist, përpos nëse me ligj nuk parashihet ndryshe.¹⁵

Neni 32 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se “Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj”, në këtë kontekst si gjykatë kompetente për të gjykuar në shkallë të dytë në procedurën e konfliktit administrativ është Gjykata e Apelit. Andaj, mbi bazën e ankesës në procedurën e konfliktit administrativ, vendosë Gjykata e Apelit, gjegjësisht, Departamenti për Çështje Administrative që vepron në kuadër të kësaj gjykate. Gjykata e Apelit - Departamenti për Çështje Administrative shqyrton dhe gjykon lëndët në kolegje prej tre (3) gjyqtarëve profesionistë, përveç nëse me ligj parashihet ndryshe.¹⁶

13 Ligji Nr. 03/L-202, Për konfliktet administrative, Gazeta Zyrtare e Republikë së Kosovës, Prishtinë: Viti V, Nr.82, 21 Tetor 2010.

14 Neni 11, paragrafi 3 dhe neni 12, paragrafi 1.2. i Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat.

15 Neni 14 i Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat.

16 Neni 19 dhe 20 i Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat.

Aktgjykimet e Gjykatës së Apelit janë të formës së prerë. Mirëpo, sipas nenit 22 të Ligjit për Gjykatat e po ashtu edhe sipas nenit 24 të LKA-së, është Gjykata Supreme e Kosovës që vepron si instancë e fundit brenda sistemit gjyqësor të vendit tonë e që është kompetente për shqyrtimin e mjeteve të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatave të Republikës së Kosovës.

5.2 Parimet e procedurës së konfliktit administrativ

Ashtu si procedurat e tjera gjyqësore, edhe procedura e konfliktit administrativ i parashihet pothuajse të gjitha parimet juridike që e pasqyrojnë shtetin e së drejtës. Në këtë kontekst edhe ligji për Konfliktet Administrative i vendit tonë, si parime themelore të kësaj procedure përcakton: Parimin e ligjshmërisë; Parimin e deklarimit të palës; Parimin e shqyrtimit verbal; Parimin e efikasitetit dhe Parimin e ndihmës së palës së painformuar.

5.3 Parimi i ligjshmërisë

Parimi i ligjshmërisë është parimi themelor i të gjitha procedurave juridike duke përfshirë edhe procedurën e konfliktit administrativ. Parimi i ligjshmërisë, përveç se është parimi themelor i procedurës së konfliktit administrative, ky parim është edhe parim kushtetues, e i cili është paraparë në të gjitha kushtetutat e vendeve demokratike, e poashtu, këtë parim e proklamoi edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës sepse mbi bazën e parimit të ligjshmërisë, realizohet nënshtrimi ndaj normave juridike i të gjithë qytetarëve e po ashtu edhe organeve shtetërore. Në këtë kontekst, shih nenin 4 të LKA-së ku shprehimisht thotë se: në konfliktin administrativ gjykata kompetente vendos në bazë të kushtetutës dhe ligjeve.

Andaj, si funksion i veçantë i parimit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrative mund të themi së është realizimi i ligjshmërisë në procedurë.

5.4 Parimi i deklarimit të palës

Sipas parimit të deklarimit të palës në procedurën e konfliktit administrativ, gjykata duhet që t'i jep mundësinë secilës palë që të deklarohej, mbi të gjitha kërkesat dhe pretendimet e palëve të tjera dhe mbi të gjitha faktet dhe çështjet juridike, që janë objekt i konfliktit administrativ. Pra, mbi bazën e këtij parimi, gjykata duhet t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohej rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare. Një mundësi e tillë mund të ju kufizohet palëve në këtë procedurë vetëm në rastet e parashikuara me ligj (shif nenin 5 të LKA-së).

5.5 Parimi i shqyrtimit verbal

Sipas parimit të shqyrtimit verbal, gjykata në procedurën e konfliktit administrativ, vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve. Pra, sipas këtij parimi, gjykata vendosë në bazë të shqyrtimit verbal, të drejtpërdrejt dhe publik.

Parimisht, mbi bazën e këtij parimi, në procedurën e konfliktit administrativ, gjykata vendos pas shqyrtimit verbal i cili mbahet në seancën e shqyrtimit kryesor të konfliktit dhe e cila seancë duhet të jetë e hapur për publikun. Mirëpo, gjykata mund të vendosë edhe në seancë të mbyllur në rast se mund të zbulohen faktet që kanë të bëjnë me jetën private të palëve, mbi sekretin shtetëror, profesional, tregtar dhe me adoptimin (neni 38.3 i LKA-së). Pra në bazë të vlerësimit të vet, gjyqtari mund të përjashton publikun nga seanca e shqyrtimit verbal me anë të vendimit dhe të cilin ju komunikon palëve të procedurës së konfliktit administrativ (shih nenin 38.5 dhe 38.6 të LKA-së).

Mirëpo, pavarësisht këtij parimi, gjykata mund të vendosë çështjen e konfliktit administrativ edhe pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur për një gjë të tillë, palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar (neni 38.5 i LKA-së).

Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës, gjegjësisht procedurën e konfliktit administrativ. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre, porse në këtë rast vetëm lexohen parashtrësat e tyre. Andaj, nëse në shqyrtim nuk merr pjesë paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, në këtë rast gjykata e vazhdon procedurën dhe e shqyrton konfliktin administrativ edhe pa praninë e palëve (shih nenin 41 të LKA-së).

5.6 Parimi i efikasitetit

Sipas parimit të efikasitetit në procedurën e konfliktit administrativ gjykata duhet ta zbaton procedurën dhe ta zgjidh konfliktin administrativ shpejtë dhe pa zvarritje, duke iu shmangur veprimeve dhe shpenzimeve të panevojshme, me çka e pamundëson keqpërdorimin dhe zvarritjen e realizimit të drejtave të palëve, të pjesëmarrësve të tjerë në konflikt dhe vendimin e nxjerrë në afat të parashikuar.

Pra, mbi bazën e parimit të efikasitetit, gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura e konfliktit administrativ të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas ligjit për konfliktet administrative.

5.7 Parimi i ndihmës së palës së painformuar

Sipas parimit të ndihmës së palës së pa informuar në procedurën e konfliktit administrative gjykata duhet të kujdeset që mos informimi i palës dhe pjesëmarrësve të tjerë në konflikt, të mos jetë në dëm të drejtave, të cilat i kanë në bazë të ligjit. Andaj, mbi bazën e këtij parimi, gjyqtari i cili e zhvillon procedurën e konfliktit administrativ

ka për detyrë që ta informon palën për të drejtat e saj në procedurë si dhe për të drejtat që pala i ka në bazë të dispozitave materiale.

Gjithashtu, më këtë parim nënkuptojmë së gjyqtari i cili e zhvillon procedurën e konfliktit administrativ duhet ta udhëzoj palën se cilat veprime procedurale mund t'i kryejë, sa herë që konstaton se ajo nga pa dijenia nuk i shfrytëzon të drejtat procedurale që i takojnë sipas ligjit për konfliktet administrative.

6. Fillimi i konfliktit administrativ

Sipas nenit 13 dhe 14 të LKA-së, konflikti administrativ në vendin tonë mund të filloj apo iniciohet nëpërmes tri mënyrave si më poshtë:

- Konflikti Administrativ mund të iniciohet vetëm kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë;
- Konflikti administrativ mund të fillohet edhe kundër aktit administrativ të shkallës së parë, kundër të cilit në procedurën administrative ankimi nuk është i lejuar;
- Konflikti administrativ mund të fillojë edhe kur organi kompetent nuk ka nxjerrë akt përkatës administrativ sipas kërkesës ose ankesës së palës, nën kushtet e parashikuara me ligj.¹⁷

6.1 Mundësia e fillimit të konfliktit administrativ si pasojë e heshtjes së administratës

Në rast se organi kompetent në afatin e caktuar nuk nxjerrë aktin administrativ, i cili do të duhej të ishte definitiv, përkatësisht kundër të cilit nuk lejohet ankesa, palës i është dhënë mundësia që të iniciojë konfliktin administrativ, për shkak se në këtë rast organi i administratës ka heshtur.

Rastet më të shpeshta të zbatimit të këtij instituti janë rastet kur organi i shkallës së dytë lidhur me ankesën e palës nuk ka nxjerrur aktin përkatës administrativ në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të saj, ndërsa nuk e ka nxjerrur as në afatin plotësues prej shtatë (7) ditësh që nga intervenimi i palës. Mirëpo kemi raste kur mund të hapet konflikti administrativ edhe në rastin e heshtjes së organit të administratës së shkallës së parë, por vetëm atëherë kur kundër aktit administrativ të organit shkallës së parë nuk është e lejuar ankesa.

Sipas parimit të dyshkallshmërisë së procedurës administrative, në qoftë se organi i shkallës së parë nuk nxjerrë akt administrativ sipas kërkesës së palës në afatin e caktuar, pala ka të drejtë t'i paraqes ankesë organit të shkallës së dytë, dhe ti kërkojë këtij të fundit që të urdhërojë organin e shkallës së parë për nxjerrjen e aktit përkatës administrativ ose që organi i shkallës së dytë vetë të nxjerrë aktin administrativ nëse arsyet e organit të shkallës së parë, për shkak të mos nxjerrjes së aktit nuk janë të bazuara dhe të pranueshme. Në rast se edhe organi i shkallës së dytë nuk ndërmer

¹⁷ Në këtë rast kemi të bëjmë me institutin e heshtjes së administratës.

kurrfarë veprimi, sipas kërkesës së palës, mund të ngritët konflikti administrativ, duke kërkuar intervenimin e gjykatës kompetente.

Konflikti administrativ ndaj organit të shkallës së parë për shkak të heshtjes së administratës mund të fillohet në qoftë se kundër aktit administrativ të këtij organi nuk lejohet ankesa. Ky konflikt administrativ mund të fillohet në qofte së brenda tridhjetë (30) ditësh¹⁸, organi i administratës nuk e ka nxjerr aktin administrativ (pozitiv apo negativ) sipas kërkesës së palës, ndërsa ky organ nuk e nxjerrë aktin administrativ as në afatin e mëtejme prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur nga ana e palës. Pra, në qofte se kanë kaluar tridhjetë (30) ditë nga dita kur është parashtruar kërkesa e palës dhe organi i njëjtë nuk e ka nxjerrë asnjë vendim në lidhje me këtë kërkesë, ndërsa pala e ka parashtruar edhe një kërkesë të përsëritur si formë e rikujtimit të këtij organi që të veproj në lidhje me kërkesën e tij/saj dhe kanë kaluar edhe shtatë (7) ditë të tjera pa përgjigje të organit të shkallës së parë të administratës, në këto raste, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa. Do të thotë, në këtë rast, pala ka të drejtë të fillojë konfliktin administrativ ndaj organit të shkallës së parë, për shkak të heshtjes së administratës.

Në një formë thuajse të njëjtë, në vendin tonë mund të fillojë konflikti administrativ për shkak të heshtjes së administratës edhe ndaj organit të shkallës së dytë. Neni 29, pika 1 e LKA-së përcakton se nëse organi i shkallës së dytë nuk e ka nxjerrë vendimin brenda tridhjetë (30) ditësh ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë, ndërsa nuk e nxjerrë as në afatin e mëtejme prej shtatë (7) ditësh me kërkesë të përsëritur, pala mund të fillojë konfliktin administrativ sikur t'i është refuzuar ankesa.

6.2 Padia ne procedurën e konfliktit administrativ

Procedura e konfliktit administrativ fillohet me anë të padisë.

Në aspektin formal-juridik, padia është një veprim i shkruar, që në të njëjtën kohë i drejtohet gjykatës nga pala paditëse, me qëllim të inicimit të mekanizmave për realizimin e mbrojtjes gjyqësore, në një çështje administrative.

Neni 3 i LKA-së e ka sqaruar edhe kuptimin e çështjes administrative duke e trajtuar si “situata e veçantë, e pakontestueshme, e me interes publik, në të cilën drejtpërdrejt nga dispozitat juridike, rezulton nevoja që sjellja e ardhshme e palës, të përcaktohet në mënyrë juridike – autoritative”.

Në aspektin material-juridik, padia është kërkesë e subjektit juridik për shqyrtimin e situatës kontestuese me anën e anulimit të aktit konkret administrativ për të cilin pohohet se është i paligjshëm.¹⁹

Padia në këtë procedurë, nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe. Porse, paditësi,

18 Ose në një afat më të shkurtër të caktuar me dispozita të veçanta rreth ankimit të palës kundër vendimit të organit të shkallës së parë.

19 Agur Sokoli, E Drejta Procedurale Administrative, Prishtinë, 2014, fq. 222. fq.231

mund të kërkoj nga organi, akti i të cilit ekzekutohet që ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, e i cili dëm vështirë së do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Organi kompetent i administratës nxjerrë vendim për shtyrje të ekzekutimit brenda afatit prej tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës për shtyrje (neni 22.4 i LKA-së). Paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrje të ekzekutimit të aktit administrativ i cili është objekt i konfliktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor ku për këtë kërkesë, gjykata duhet të vendos brenda tri (3) ditëve nga data e marrjes së kërkesës së tillë (neni 22.6. dhe 22.7 i LKA-së).

Në procedurën e konfliktit administrativ, me padi mund të kërkohej:

- anulimi ose shpallja e pavlefshme e aktit kontestues;
- nxjerrja e aktit administrativ, i cili nuk është nxjerrur në afatin e parashikuar; dhe
- kthimi i sendeve të marra dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar me ekzekutimin e aktit administrativ të kontestuar (nenit 26 të LKA-së).

Sipas rregullit me një padi, mund të goditet vetëm një akt administrativ, ndërkaq rasti i padisë kolektive ekziston kur disa persona me një padi kontestojnë të njëjtin akt administrativ, p.sh bashkëshorti dhe bashkëshortja paraqesin padi kundër vendimit me të cilin ju merret banesa. Objekt i padisë, është një akt administrativ i cili goditet në tërësi apo pjesërisht.

6.3 Palët e autorizuara për parashtrimin e padisë në konfliktin administrativ

Si palë të autorizuara për të parashtruar padi apo si palë që ka të drejtë për të filluar procedurën e konfliktit administrativ (me anë të padisë) janë:

- Personi fizik si dhe personi juridik, nëse vlerëson se me aktin administrativ përfundimtar në procedurën administrative, i është shkelur ndonjë e drejtë apo interes ligjor;²⁰

- Të drejtë të inicijojë konfliktin administrativ ka edhe organi i administratës, kundër vendimit, që është marrë në bazë të ankesës në procedurën administrative, nëse konsideron se është shkelur ndonjë e drejtë ose interes i tij;²¹

20 Shih Aktgjykimin A.nr.928/2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, ku palë paditëse ka qenë personi fizik ndërkaq palë e paditur ka qenë organi i administratës gjegjësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamenti i Administratës Pensionale të Republikës së Kosovës. Po ashtu shih edhe aktgjykimin e Gjykatës së Apelit në çështjen e konfliktit administrative sipas ankesës ku palë paditëse ka qenë personi juridik gjegjësisht N.P.P.”AMO” ndërsa palë e paditur ka qenë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës.

21 Shih Aktgjykimin A.nr. 659/2012 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, ku palë paditëse ka qenë organi i administratës, kundër vendimit, që është marrë në bazë të ankesës në procedurën administrative, gjegjësisht MBPZHR-Agencia Pyjore e Kosovës në Prishtinë, ndërkaq palë e paditur ka qenë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këto aktgjykime janë të qasshme në këtë link: <http://www.md-ks.net/?page=1,214&offset=0>

- Avokati i Popullit;
- Shoqatat dhe organizatat e tjera, të cilat veprojnë në mbrojtje të interesave publike.
- Prokurori shtetëror kompetent ose organi tjetër i autorizuar me ligj, nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në favor të personit fizik apo personit juridik.

Po ashtu, konfliktin administrativ mund ta iniciojë prokurori shtetëror kompetent ose personi i autorizuar nëse me aktin administrativ është shkelur ligji në dëm të organeve të qeverisjes qendrore dhe të organeve të tjera në varësi të tyre, të organeve të vetëqeverisjes lokale dhe të organeve në varësi të tyre, kur janë shkelur të drejtat pronësore të këtyre organeve (neni 10 i LKA-së).

6.4 Palët në procedurën e konfliktit administrativ

Palë në konfliktin administrativ janë: a) paditësi, b) i padituri dhe c) personi i interesuar (neni 18-21 i LKA-së).

a) Paditësi në konfliktin administrativ

Paditës në konfliktin administrativ quhet personi i cili me qëllim të mbrojtjes së të drejtave subjektive ose interesave të drejtpërdrejta të bazuara në ligj paraqet padi për konfliktin administrativ.

Paditës pra është ai person i cili nuk është i kënaqur me aktin administrativ përfundimtar të nxjerrur në procesin administrativ.

Paditës në konfliktin administrativ mund të jenë: personat fizik; personat juridik; organet shtetërore; shoqatat dhe organizatat (grupet e njerëzve); prokurori shtetëror dhe avokati i popullit.

b) I padituri në konfliktin administrativ

Palë e paditur në konfliktin administrativ është organi, akti i të cilit kontestohet.

Po ashtu, palë e paditur në procedurën e konfliktit administrativ mund të jetë edhe organi i cili sipas kërkesës së palës ose ankesës së saj nuk e nxjerrë aktin në afatin e caktuar ligjor dhe të njëjtin nuk ia dërgon palës (heshtja e administratës).

Palë e paditur mund të jetë edhe organi shtetëror përkatësisht organizata apo bashkësia tjetër e cila ushtron autorizime publike, akti i së cilës kontestohet, apo në qoftë se ky organ nuk e nxjerrë aktin në afatin e caktuar ligjor dhe të njëjtin nuk ia dërgon palës (heshtja e administratës).

Në një çështje administrative në të cilën vendosin dy apo më shumë organe dhe secila prej tyre ka për detyrë që të vendos mbi atë çështje, këto organe arrijnë marrëveshjen se cili prej tyre do të nxjerrë vendimin ashtu që në këtë rast palë e paditur konsiderohet organi i cili e ka nxjerrur aktin administrativ.

c) Personi i interesuar në konfliktin administrativ

Person i interesuar në konfliktin administrativ konsiderohet personi të cilit anulimi i aktit administrativ do ti shkaktonte dëm. Ky person në konfliktin administrativ ka interes që akti i kontestuar të mbetet në fuqi, që do të thotë që interesat e tij janë të kundërta me ato të palës paditëse. Personi i interesuar ekziston kur është fjala për çështjet administrative dypalëshe apo shumëpalëshe.

Personi i interesuar mund të paraqitet në konfliktin administrativ kur prokurori shtetëror ka filluar konfliktin administrativ kundër një akti administrativ i cili supozohet si i kundërligjshëm dhe me atë akt është shkëlur ligji në dobi të një individi apo personi juridik. Në këtë rast ekziston pala e paditur, paditësi dhe pala e tretë e interesuar.

6.5 Afati kohor për paraqitjen e padisë

Në procedurën e konfliktit administrativ, padia paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, që nga data e dorëzimit të aktit administrativ përfundimtar palës. Ky afat vlen edhe për organet e autorizuara për paraqitjen e padisë në konfliktin administrativ, ndërkaq nëse akti nuk ju dërgohet atyre organeve, padia mund të paraqitet në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh nga dita e dërgimit të aktit administrativ palës në favor të së cilës është nxjerrë akti (neni 27 i LKA-së).

Padia i dorëzohet gjykatës drejtpërdrejtë apo me postë. Në rast se padia dorëzohet me anë të postës, ajo dorëzohet në formën urgjente, ngase si ditë e dorëzimit të padisë konsiderohet dita e dorëzimit gjykatës drejtpërdrejtë, qoftë gojarisht, në procesverbal apo me shkrim. Nëse padia nuk ju është dorëzuar gjykatës por organit tjetër, ndërsa i arrin gjykatës kompetente pas skadimit të afatit të caktuar, do të konsiderohet e paraqitur me kohë po që se paraqitja e saj para këtij organi ka qenë si pasojë e mosdijes apo e ndonjë gabimi të paraqitësit (neni 28 i LKA-së).

Padia duhet të përmbajë:

- Emërtimin e gjykatës të cilës i paraqitet padia;
- Emrin, mbiemrin dhe vendbanimin, respektivisht selinë e paditësit dhe të paditurit, aktin administrativ kundër të cilit është drejtuar padia;
- Arsyet pse ngritët padia, si dhe në cilin drejtim dhe vëllim propozohet anulimi i aktit administrativ;

Aktin administrativ kundër të cilit është e drejtuar padia;

Kërkesën e caktuar në pikëpamje të sendit apo shumës së dëmit të pësuar, nëse me padi kërkohet kthimi i sendit ose kompensimi i dëmit.

Bashkë me padinë paraqitet edhe nga një kopje e padisë dhe aneksit për organin e paditur dhe për çdo person të interesuar, nëse ekzistojnë të tillë.

Duke pasur parasysh se procedura e konfliktit administrativ fillon sipas maksimës private, do të thotë kjo procedurë inicohet çdo herë më kërkesën e palës, gjegjësisht

me parashtrimin e padisë gjykatës kompetente si mjet juridik për fillimin e konfliktit administrativ. Në këtë kontekst, paditësi mund të heq dorë nga padia gjithnjë derisa të merret vendimi, në të cilin rast gjykata e pezullon procedurën me vendim. Procesi ndërpritet edhe në rastin kur organi gjatë konfliktit administrativ nxjerrë aktin e ri administrativ, me të cilin ndryshohet apo lihet jashtë fuqisë akti i kontestuar administrativ apo në rastin e heshtjes administrative nxjerrë akt të ri administrativ, ndërsa paditësi deklaron se me aktin e nxjerrur është i kënaqur. Në rast se paditësi nuk do të ishte i kënaqur me atë akt, gjykata do të vazhdojë procesin (neni 31 i LKA-së).

6.6 Çështja paraprake në procedurën e konfliktit administrativ

Neni 32 i LKA-së e ka përcaktuar edhe mundësinë e zgjidhjes së çështjes paraprake nga gjykata që zhvillon konfliktin administrativ, në qoftë së një gjë e tillë mund të haset për gjatë zhvillimit të kësaj procedure. Gjithashtu, sipas këtij neni, gjykata që e zhvillon konfliktin administrativ, në qoftë së hasë në çështjen paraprake, ka mundësi edhe të ndërpres procedurën e konfliktit administrativ deri në nxjerrjen e vendimit mbi çështjen paraprake, nga ana e organit kompetent.²²

Vendimi i gjykatës mbi çështjen paraprake ka efekt juridik vetëm në konfliktin administrativ, në të cilin ajo çështje është zgjidhur (neni 32 i LKA-së).

22 Pra, sipas kësaj dispozite, mund të vërejmë së në vendin tonë është inkorporuar sistemi austriako-gjerman sa i përket zgjidhjes së çështjes paraprake në procedurën e konfliktit administrativ, sepse sipas këtij sistemi, organi që vendosë në çështjen kryesore, i njëjti organ mund të vendosë sipas vlerësimit të lirë nëse vetë do ta zgjidhë çështjen paraprake nga kompetenca e organit tjetër, apo do ta ndërprejë procedurën për çështjen kryesore.

7. Fillimi i procedurës së konfliktit administrativ mbi bazën e padisë.

Ashtu siç është cekur edhe me lartë procedura e konfliktit administrativ fillohet me anë të padisë dhe e njëjta i drejtohet gjykatës kompetentë për zhvillimin e kësaj procedure.²³ Pra, padia është veprim mbi bazën e së cilës inicohet/fillohet procedura e konfliktit administrativ. Pa padi nuk ka konflikt administrativ, sepse në këtë procedurë vlen maksima private që do të thotë së gjykata nuk mund ta fillojë konfliktin administrativ pa e pranuar padinë nga ana e paditësit.

Në procedurën e konfliktit administrativ, dallohen dy faza themelore lidhur me trajtimin e padisë siç janë: a) procedura paraprake sipas padisë dhe b) procedura e rregullt sipas padisë.

7.1 Procedura paraprake e konfliktit administrativ.

Në këtë proces konstatohet rregullsia formale e padisë, përkatësisht se padia a është paraqitur në rregull në pikëpamje të përmbajtjes së saj, të paraqitjes brenda afatit, a është e lejueshme dhe e paraqitur nga personi i autorizuar. Në këtë proces ekzistojnë dy faza: Në fazën e parë vlerësohet padia në pikëpamje të përmbajtjes së saj, përkatësisht se a është padia e plotë dhe e kuptueshme, gjersa në fazën e dytë vlerësohet rregullsia e padisë në pikëpamje të paraqitjes së saj në kohë, të lejueshmërisë dhe se a është paraqitur nga personi i autorizuar.

Nëse padia nuk është e plotë, ose është e pakuptueshme, në këtë situatë, gjyqtari duhet ta ftojë paditësin sipas nevojës, edhe me anë të gjykatës tjetër ordinare, që brenda afatit prej tetë (8) ditëve, t'i mënjanojë të metat e padisë. Me këtë rast paditësi do të udhëzohet se si duhet të veprojë, si dhe njëherit do të paralajmërohet për pasojat që do të lindin në rast se nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës. Nëse paditësi brenda afatit prej tetë (8) ditëve, nuk i mënjanon të metat e padisë, ndërkaq ato janë të atilla sa që e pengojnë punën e gjykatës, në këtë rast, gjykata do ta hedh poshtë padinë me vendim. Mirëpo, gjykata mund të hedhë poshtë padinë në këtë fazë të kësaj procedure edhe mbi arsyet si më lartë, vetëm nëse nuk konstaton se akti administrativ i kontestuar është i pavlefshëm (neni 33.2 i LKA-së). Në të kundërtën, gjykata nuk mund të hedhë poshtë padinë në këtë fazë nëse konstaton se akti administrativ, mbi bazën të cilit ka filluar konfliktin administrativ është i pavlefshëm. Pra, në këtë situatë, gjykata duhet të vazhdoj procedurën pavarësisht mos veprimit të paditësit sipas udhëzimit të gjykatës sa i përket mënjanimin të të metave të padisë, apo edhe pas kalimit të afatit tetë ditor kur paditësi nuk i mënjanon këto mangësi të padisë.

Sipas nenit 34 të LKA-së, gjykata e hedh poshtë padinë me vendim për arsyet e mëposhtme:

- Në qoftë se padia është paraqitur pas kalimit të afatit ose është e parakohshme;
- Në qoftë se akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ;
- Në qoftë se është e qartë se me aktin administrativ, që kontestohet me padi, nuk

²³ Në vendin tonë, kjo padi i dërgohet Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamentit për Çështje Administrative.

- preken të drejtat e paditësit ose interesi i tij i drejtpërdrejtë i bazuar në ligj;
- Në qoftë se kundër aktit administrativ, i cili kontestohet me anë të padisë, mund të bëhet ankimi, kurse ankimi nuk është bërë fare apo nuk është bërë në kohën e duhur;
- Në qoftë se është fjala për çështjen për të cilën sipas dispozitës shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrative dhe;
- Në qoftë se ekziston vendimi i formës së prerë, i nxjerr në konfliktin administrativ, për të njëjtën çështje.

Në qoftë se organi gjatë kohës së procedurës së konfliktit administrativ nxjerrë aktin tjetër me të cilin ndryshohet apo humbet fuqia e aktit administrativ kundër të cilit është ngritur konflikti administrativ, si dhe në rastin kur nxjerrë më vonë aktin administrativ, ky organ pos paditësit do të njoftojë edhe gjykatën, para së cilës është ngritur konflikti administrativ. Në këtë rast gjykata do të ftojë paditësin që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh të deklaroj nëse me aktin e nxjerrë në afatin e mëvonshëm është i kënaqur ose nuk heq dorë nga padia, respektivisht nëse padinë e zgjeron edhe në aktin tjetër.

Nëse paditësi deklaron se me aktin e nxjerrur në afatin e mëvonshëm është i kënaqur apo nëse nuk e jep deklaratën brenda afatit të caktuar, gjykata do të nxjerrë vendimin mbi pezullimin e procedurës.

Nëse paditësi deklaron se nuk është i kënaqur me aktin e ri, gjykata do të vazhdojë procedurën e rregullt.

7.2 Procedura e rregullt e konfliktit administrativ

Procedura e rregullt e konfliktit administrative zhvillohet në qoftë se ka përfunduar procedura paraprake dhe në këtë procedurë, gjykata nuk ka nxjerr asnjë vendim sa i përket hedhjes poshtë të padisë apo të pezullimit të procedurës së konfliktit administrativ mbi kushtet e parapara dhe të përcaktuara më lartë të faza e procedurës paraprake.

Andaj, në qoftë se gjykata nuk e ka hedhur poshtë padinë, për shkaqe formale, atëherë kalon në procedurën e rregullt sipas padisë. Pra, në këtë fazë, gjykata lëshohet në shqyrtimin e ligjshmërisë së aktit administrativ brenda kufijve të kërkesës nga padia, përkatësisht, arsyeshmërisë së heshtjes përfundimtare nga administrata.²⁴

Procedura e rregullt e konfliktit administrativ fillon kur gjykata nga një kopje të padisë dhe të dokumenteve të bashkëngjitura në përgjigje ja dërgon palës së paditur dhe personave të interesuar. Përgjigjja në padi jepet në afat prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dorëzimit të padisë në përgjigje palës. Në afatin e caktuar pala ka për detyrë t'i dërgojë gjykatës të gjitha shkresat që kanë të bëjnë me lëndën. Nëse pala e paditur edhe pas kërkesës së dytë nuk i dërgon shkresat e lëndës, apo nëse deklaron se nuk mund t'i dërgojë, gjykata do të vendosë për çështjen edhe pa shkresat e lëndës (neni 37 LKA-së). Pas kalimit të afatit për dhënien e përgjigjes në padi, gjykata kalon në vendosjen e

24 Agur Sokoli, E Drejta Procedurale Administrative, Prishtinë 2014, fq. 238.

konfliktit administrativ, gjegjësisht në vlerësimin e ligjshmërisë së aktit administrativ të kontestuar.

Nëse gjykata nuk e hedh poshtë padinë në procedurën paraprake, kurse konstaton se akti administrativ i kontestuar përmban të meta esenciale, që e pengojnë të çmuarit e ligjshmërisë së aktit, në këtë rast gjykata mund të anulon me aktgjykim aktin administrativ të kontestuar, edhe pa e dërguar padinë në përgjigje tek pala e paditur dhe personi i interesuar (neni 35 i LKA-së).

7.3 Seanca gjyqësore në konfliktin administrativ

Në konfliktin administrativ gjykata vendos në seancë të hapur. Pas pranimit të përgjigjes në padi, nga pala e paditur, respektivisht personi i interesuar, gjyqtari cakton ditën e shqyrtimit dhe në shqyrtim i fton palët dhe personat e interesuar.

Parimisht, gjykata në këtë procedurë vendos për gjendjen faktike përmes shqyrtimit verbal dhe vlerësimit të fakteve (neni 38.2 i LKA-së). Mirëpo, gjykata mund të vendosë çështjen edhe pa shqyrtim verbal, nëse ka fakte të mjaftueshme dhe kur palët kanë dhënë pëlqimin e tyre në formë të shkruar. Gjithashtu, mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës, gjegjësisht rrjedhën e procedurës së konfliktit administrativ. Për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre, porse në këtë rast lexohen parashtrësit e tyre dhe në qoftë se gjykata nuk e shtynë shqyrtimin, konflikti administrativ shqyrtohet edhe pa praninë e palëve (neni 41 i LKA-së).

Përajshimisht, në procedurën e konfliktit administrativ, gjykata mund të vendosë në seancë të mbyllur në rast se mund të zbulohen faktet që kanë të bëjnë me jetën private të palëve, mbi sekretin shtetëror, profesional, tregtar me adoptimin, etj. Palët, ekspertët dhe përkthyesit (nëse është e nevojshme), duhet të jenë të pranishëm në seancën e mbyllur (neni 38.3 dhe 38.4 i LKA-së).

Seanca e shqyrtimit drejtohet nga gjyqtari i cili e gjykon çështjen e konfliktit administrativ.

Pas kësaj i jepet fjala paditësit që ta arsyetojë padinë, e pastaj përfaqësuesit të palës së paditur dhe personave të interesuar, që t'i arsyetojnë pretendimet e tyre (neni 42 i LKA-së).

Mungesa e palës në shqyrtimin verbal nuk e pezullon punën e gjykatës, përkatësisht rrjedhën e procedurës së konfliktit administrativ. Andaj, për shkak të mungesës së palëve nuk mund të konstatohet se ato kanë hequr dorë nga kërkesat e tyre, porse në këtë rast, lexohen parashtrësit e tyre. Nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, në këtë rast, gjykata e shqyrton konfliktin edhe pa praninë e palëve (neni 41 i LKA-së). Mbi shqyrtimin mbahet procesverbali në të cilin përfshihen faktet dhe rrethanat esenciale dhe i cili nënshkruhet nga gjyqtari që gjykon çështjen dhe procesmbajtësi.

8. Mënyra e vendosjes së konfliktit administrativ

Akti administrativ mund të kundërshtohet si për shkak të aplikimit jo të drejtë të së drejtës materiale, ashtu edhe për shkak të aplikimit jo të drejtë të rregullave procedurale. Në rast të anulimit të aktit administrativ, gjykata mund të ja kthejë lëndën organit në riprocedurë apo vetë ta vendosë çështjen administrative.

Pra, në procedurën e konfliktit administrativ, gjykata vendosë për çështjen e konfliktit në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative. Në procedurën e konfliktit administrativ, vërtetohen faktet mbi bazën e të cilave është nxjerrë akti administrativ që është objekt i konfliktit administrativ. Poashtu, në procedurën e konfliktit administrativ vërtetohet edhe rrjedha e të gjitha fazave të procedurës administrative, gjegjësisht, gjykata e vërteton se a janë respektuar të gjitha rregullat e procedurës administrative që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes administrative, gjegjësisht nxjerrjen e aktit administrative të kontestuar.

Nëse gjykata konstaton se zhvillimi i përsëritur i procedurës në organin administrativ kompetent do të shkaktonte për paditësin ndonjë dëm, i cili me vështirësi do të riparohet, apo nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative, apo nëse në të njëjtin konflikt administrativ është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi administrativ kompetent nuk ka vepruar sipas aktgjykimit, në këtë rast, gjykata mundet edhe vetë të vërtetojë gjendjen faktike ose me anë të organit tjetër dhe në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin (neni 43.3 i LKA-së).

Po ashtu, nëse gjykata konstaton se konflikti nuk mund të zgjidhet në bazë të fakteve të vërtetuara gjatë procedurës administrative, për shkak të ekzistimit të kontradiktave në akte, ose konstatohet se nuk janë respektuar rregullat procedurale që do të ishin të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes, në këtë rast, gjykata e anulon me aktgjykim aktin e kontestuar. Në rast të tillë organi kompetent (organi i cili e ka nxjerrë aktin administrativ të kontestuar dhe që është palë e paditur) ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ (neni 43.2 i LKA-së). Pra, në këtë situatë, gjykata me aktgjykim vetëm e anulon aktin administrativ të kontestuar dhe njëkohësisht e detyron organin e administratës (palën e paditur) që ta nxjerr një akt të ri administrativ.

Kur gjykata e anulon aktin, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ (si në rastin e më sipërm), lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar. Në këtë rast, organi kompetent (pala e paditur) është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën administrative të zhvilluar për nxjerrjen e aktit administrativ tashmë të anuluar. Në këtë rast, organi kompetent (nxjerrësi i aktit të anuluar) duhet që, në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxjerrë një akt tjetër, dhe duke iu përmbajtur aktgjykimit të gjykatës.²⁵ Organi kompetent, në këtë rast duhet ta nxjerrë aktin e ri (që e zëvendëson aktin e

²⁵ Në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin administrativ të ligjshmërisë së aktit administrativ.

anuluar) jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit i cili e anulon aktin e kontestuar (neni 65 i LKA-së).

Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit, e nxjerrë aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës, apo në kundërshtim me vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën, kurse paditësi paraqet një padi të re, në këtë rast gjykata e anulon aktin e kontestuar dhe, si rregull, vetë do të vendosë çështjen me aktgjykim dhe aktgjykimi i tillë e zëvendëson aktin e organit kompetent (neni 67.1 i LKA-së). Në këtë rast, gjykata e njofton organin që ushtron mbikëqyrjen e organit administrativ (palës së paditur në procedurën e konfliktit administrativ).

Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit administrativ nuk nxjerrë menjëherë, e jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të gjykatës me anë të së cilit aktgjykim, gjykata ka vendosur vet për çështjen administrative dhe që njëkohësisht është zëvendësuar akti i anuluar, në këtë rast, pala mund të kërkojë, me parashtrësë të veçantë, nxjerrjen e aktit të tillë nga ana e organit kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ

Nëse organi kompetent nuk e nxjerrë aktin brenda shtatë (7) ditësh nga kjo kërkesë, pala mund të kërkojë nxjerrjen e aktit të tillë nga gjykata që ka nxjerrë aktgjykimin (neni 68.1 i LKA-së). Në bazë të një kërkesë të tillë, gjykata kërkon nga organi kompetent njoftimin mbi shkaqet për të cilat akti administrativ nuk është nxjerrë. Në këtë rast, organi kompetent ka për detyrë ta japë këtë njoftim menjëherë, dhe jo më vonë se brenda shtatë (7) ditësh. Nëse nuk e bën këtë, apo nëse njoftimi i dhënë, sipas mendimit të gjykatës, nuk e arsyeton moszbatimin e aktgjykimit të gjykatës, në këtë rast, gjykata e nxjerrë vendimin, i cili e zëvendëson aktin e organit kompetent. Këtë vendim gjykata ia dërgon organit kompetent për ekzekutim dhe për këtë gjë njëkohësisht e njofton edhe organin që ushtron mbikëqyrjen e organit i cili në afatin e caktuar nuk e ka nxjerrë aktin në zbatim të aktgjykimit të gjykatës,²⁶ (neni 68.2 i LKA-së).

Pra, në këtë situatë, gjykata e nxjerrë aktin administrativ, njëjtë sikurse të ishte organi i administratës që ka qenë kompetent për nxjerrjen e aktit administrativ dhe aktin e tillë e dërgon tek organi kompetent për ekzekutim e i cili ka për detyrë që ta ekzekutojë vendimin e tillë.

Andaj, gjykata e vendosë çështjen vet në këto raste:

Nëse zhvillimi i procedurës pran organit kompetent do të shkaktonte ndonjë dëm për paditësin, i cili do të përmirësohej me vështirësi;

Nëse organi kompetent pas anulimit të aktit e nxjerrë aktin administrativ në kundërshtim me pikëpamjen juridike të gjykatës;

Nëse në bazë të dokumenteve zyrtare ose të provave të tjera në shkresat e lëndës është e qartë se gjendja faktike ndryshon nga ajo që është vërtetuar në procedurën administrative;

26 Në këtë situatë kemi të bëjmë me konfliktin administrativ të juridiksionit të plotë.

Nëse në të njëjtin kontest është anuluar një herë akti administrativ, kurse organi kompetent nuk ka vepruar plotësisht sipas aktgjykimit, apo nuk e ka nxjerrë menjëherë, e jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh, aktin e ri administrativ ose aktin në zbatimin e aktgjykimit të gjykatës.

Ligjshmërinë e aktit administrativ të kontestuar, gjykata e shqyrton brenda kufijve të kërkesës nga padia, porse nuk obligohet nga shkaqet e padisë dhe për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare (neni 44 i LKA-së).

9. Vendimi në konfliktin administrativ

Gjykata vendos mbi konfliktin administrativ me aktgjykim. Aktgjykimi në procedurën e konfliktit administrativ është “Vendim i gjykatës së autorizuar me ligj me të cilin zgjidhet një konflikt administrativ, që në thelb, paraqet “mbrojtje gjyqësore të ligjshmërisë së akteve administrative”.²⁷

Aktgjykimi mbi konfliktin administrativ shpallet menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit verbal. Në raste të ndërlikuara gjykata mund të heqë dorë nga shpallja verbale e aktgjykimit, respektivisht të vendimit, por jo më vonë se brenda tetë (8) ditësh duhet të nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin. Nëse pas përfundimit të shqyrtimit verbal gjykata nuk e nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin për arsye se duhet më parë të vërtetojë faktin e atillë, për shqyrtimin e të cilit nuk nevojitet një shqyrtim i ri verbal, në këtë rast, gjykata e nxjerrë aktgjykimin, respektivisht vendimin, brenda tetë (8) ditësh nga data kur ta ketë vërtetuar këtë fakt (neni 47.2 dhe 47.3 i LKA-së).

Me aktgjykim padia aprovohet ose refuzohet si e pabazuar. Nëse padia aprovohet, gjykata anulon aktin administrativ të kontestuar (neni 46 i LKA-së). Përveç aktgjykimeve, gjykata nxjerrë edhe vendime në formë të aktvendimeve, kur vendos për çështje sekondare gjatë procedurës (hedhja poshtë e padisë, pezullimi i procedurës së konfliktit administrativ etj.).

9.1 Aktgjykimi aprovues në procedurën e konfliktit administrativ

Në procedurën e konfliktit administrativ, gjykata nxjerrë aktgjykim aprovues në rastet kur konstaton se është shkelur dispozita materiale apo procedurale nga ana e organit të administratës për gjatë nxjerrjes së aktit administrativ. Në këtë rast aprovohet padia dhe nga ana e gjykatës anulohet akti administrativ i kontestuar, po qe se konstaton se ai akt është i paligjshëm.

Pas nxjerrjes së aktgjykimit aprovues, apo aktgjykimit mbi anulimin e aktit administrativ të kontestuar, lënda i kthehet organit kompetent (palës së paditur) akti i të cilit është anuluar dhe ky organ është i detyruar që të nxjerrë akt të ri administrativ në përputhje me pikëpamjet juridike të gjykatës të dhënë në aktgjykim.²⁸

²⁷ Esat Stavileci, “Fjalor shpjegues i termave administrativë”, Prishtinë, 2010, fq. 40.

²⁸ Shih Aktgjykimin aprovues A.nr. 659/2012 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me anë të së cilit gjykata e aprovon padinë e paditëses ndërsa e anulon aktin administrativ

Karakteri i detyrueshëm i aktgjykimeve në procedurën e konfliktit administrativ bazohet në nenin 65 të LKA-së. Sipas kësaj dispozite, kur gjykata e anulon aktin, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, në këtë rast, lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar. Nëse sipas karakterit të çështjes që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që, në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një akt tjetër (sipas pikëpamjes juridike të gjykatës të dhënë në aktgjykim), organi kompetent ka për detyrë ta nxjerrë aktin e ri administrativ pa shtyrje, dhe jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit. Organi kompetent, në këtë rast, është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurë.

9.2 Aktgjykimi refuzues në procedurën e konfliktit administrativ

Në procedurën e konfliktit administrativ gjykata nxjerrë aktgjykim refuzues në qoftë së vërteton se akti administrativ i cili ka qenë objekt i konfliktit administrativ është i ligjshëm, që do të thotë se, nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit. Në këtë rast, refuzohet padia e paditësit ndërsa mbetet i në fuqi (i pa ndryshuar) akti administrativ i kontestuar.

Në procedurën e konfliktit administrativ, gjykata nxjerrë aktgjykim refuzues edhe në qoftë se i vlerëson si të pa bazuara pretendimet e paditësit në padi; në qoftë se pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur; në qoftë se pretendimet e paditësit janë në kundërshtim edhe me provat e paraqitura nga paditësi etj.²⁹

Andaj, gjykata nxjerrë aktgjykim refuzues nëse konstaton se në çështjen administrative është vërtetuar drejtë gjendja faktike nga pala e paditur, si dhe janë zbatuar në tërësi dispozitat e procedurës administrative dhe të ligjit material kur është nxjerrë akti administrativ i kontestuar.

9.3 Vendimi/Aktvendimi në procedurën e konfliktit administrativ

Në procedurën e konfliktit administrativ, gjykata mund të nxjerrë edhe vendime në formë të aktvendimeve. Zakonisht, gjykata i emëron aktet e saja si vendime në procedurën paraprake të konfliktit administrativ.

Në procedurën paraprake të konfliktit administrativ, gjykata e hedh poshtë padinë me vendim pa u lëshuar në shqyrtimin meritor të kërkesëpadisë në qoftë se konstaton

te kontestuar dhe e kthen çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i administratës (pala e paditur).

Do të thotë, në këtë rast lënda kthehet në gjendjen në të cilin ishte para se të ishte nxjerrë akti i anuluar dhe organi i administratës është i obliguar që në ri-procedurën administrative të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në aktgjykimin aprovues. Aktgjykimi i qasshëm në këtë link: <http://www.md-ks.net/?page=1,214&offset=0>

29 Shih Aktgjykimin refuzues A.nr. 1217/2010 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me anë të së cilit gjykata e refuzon padinë e palës paditëse dhe në këtë rast, mbetet në fuqi akti administrative i kontestuar. Aktgjykimi i qasshëm në këtë link: <http://www.md-ks.net/?page=1,214&offset=40>

se: padia është e jashtë afatshme apo e parakohshme; në qoftë se akti administrativ nuk është përfundimtar, ka mundur të paraqitet ankesa por nuk është paraqitur fare ose nuk është bërë në kohën e duhur, pra, nuk janë shtjerrur të gjitha mjetet e rregullta juridike në procedurën administrative; në qoftë se akti që kontestohet me padi nuk është akt administrativ; në qoftë se padia është e parregullt (te metat e padisë, paditësi nuk i ka mënjanuar në afatin e caktuar); në qoftë se ekziston aktgjykimi i formës së prerë i nxjerrë në konfliktin administrativ për të njëjtën çështje (çështje e gjykuar); në qoftë se me aktin administrativ që kontestohet nuk preket në të drejtat ose interesat juridike të paditësit; në qoftë se është fjala për çështjet për të cilën sipas dispozitave shprehimore të ligjit nuk mund të zhvillohet konflikti administrativ.

Gjykata gjithashtu mund ta përfundon konfliktin administrativ me vendim në këto dy raste edhe tek procedura e rregullt si:

- a) *Me rastin e heqjes dorë të paditësit nga padia – atëherë gjykata me aktvendim e pezullon procedurën e konfliktit administrativ, sepse, në konfliktin administrativ aplikohet maksima private që do të thotë se, konflikti administrativ çdo herë fillohet me kërkesën e palës dhe;*
- b) *Kur organi i paditur nxjerrë akt tjetër administrativ, me të cilin ndryshohet ose anulohet akti administrativ i cili kontestohet me padi, po qe se, paditësi deklaron se me aktin administrativ të nxjerrë më pas është i kënaqur ose në afatin e caktuar prej 15 ditësh nuk jep kurrfarë deklaratë, atëherë gjykata nxjerrë vendim mbi pezullimin e procedurës së konfliktit administrativ (neni 36 i LKA-së).³⁰*

9.4 Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit/vendimit ne procedurën e konfliktit administrativ

Forma e aktgjykimit në procedurën e konfliktit administrativ është e ngjashme me përmbajtjen e aktgjyqimeve në procedura të tjera gjyqësore. Po ashtu, duke ju referuar dispozitave ligjore që e rregullojnë këtë procedurë, aktgjykimi i përpiluar me shkrim duhet të përmbajë: pjesën hyrëse, dispozitivin, arsyetimin dhe udhëzimin mbi të drejtën e ankimit kundër aktgjykimit.

Pjesa hyrëse e aktgjykimit/vendimit përmban: emrin e gjykatës e cila vendos për çështjen e konfliktit administrativ, emrin dhe mbiemrin e gjyqtarit (kryesuesit të kolegjit të gjyqtarëve) dhe procesmbajtësit, emërtimin e palëve dhe të përfaqësuesve të tyre ligjor, objektin e konfliktit, ditën e përfundimit të shqyrtimit kryesor, si dhe ditën kur është dhënë aktgjykimi/vendimi.

30 Shih Aktvendimin A.nr.702/10 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, me anë të së cilit gjykata e hedhë poshtë padinë e paditësit R.M si të parakohshme dhe të palejueshme. Aktvendimi i qasshëm në këtë link: <http://www.md.ks.net/repository/docs/Aktvendimi,nr.702-2010.pdf>

Dispozitivi i aktgjykimit/vendimit përmban: vendimin me të cilin aprovohet padia dhe anulohet akti administrativ i kontestuar apo refuzohet padia si dhe vendimin mbi shpenzimet procedurale.

Arsyetimi i aktgjykimit/vendimit përmban: përshkrimin e rrjedhës së procedurës së konfliktit administrativ prej fillimit e gjer të nxjerrja e aktgjykimit; kërkesat e palëve si dhe faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar; cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar gjykata pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato. Gjithashtu, gjykata në arsyetim të aktgjykimit/vendimit posaçërisht tregon se cilat dispozita të së drejtës materiale dhe formale i ka zbatuar me rastin e vendosjes së konfliktit. Pra, në arsyetim të aktgjykimit/vendimit shkruhet se pse miratohet padia dhe se pse anulohet akti administrativ i kontestuar, apo në qoftëse refuzohet padia, pse refuzohet e njëjta.

Këshilla juridike e aktgjykimit/vendimit: Pjesë e aktgjykimit/vendimit të nxjerrë në procedurën e konfliktit administrativ është edhe e drejta e ankesës apo këshilla juridike, ku pas shpalljes së aktgjykimit/vendimit, gjyqtari apo kryesuesi i kolegjit të gjyqtarëve i udhëzon palët për të drejtën e përdorimit të mjeteve juridike.

Aktgjykimi origjinal, përkatësisht aktvendimi nënshkruhet nga gjyqtari që gjykon çështjen (kryesuesi i kolegjit) dhe procesmbajtësi, kurse palëve u jepen kopje të legalizuara.

Nëse padia aprovohet, gjykata e anulon aktin e kontestuar administrativ. Me aktgjykim me të cilin anulohet akti administrativ, gjykata vendos edhe mbi kërkesën e paditësit për kthimin e sendit, respektivisht për shpërblimin e dëmit, në rast se të dhënat e procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë.

10. Mjetet juridike në procedurën e konfliktit administrativ

Mjetet juridike në procedurën e konfliktit administrativ janë mjetet e rregullta juridike dhe mjetet e jashtëzakonshme juridike. Mjet i rregullt juridik është ankesa derisa mjete të jashtëzakonshme janë: kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe kërkesa për rishikimin e procedurës së konfliktit administrativ .

10.1. Ankesa si mjet i rregullt juridik

Ankesa si mjet i rregullt juridik në procedurën e konfliktit administrativ mund të parashtrohet ndaj aktgjykimit/vendimit të gjykatës së shkallës së parë, respektivisht gjykatës themelore në Prishtinë – Departamentit për Çështje Administrative.

Ankesa në këtë procedurë e ka efektin suspenziv sepse përderisa është parashtruar brenda afatit kohor dhe nga palët e autorizuara, aktgjykimi/vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk mund të ekzekutohet. Andaj, ankimi i bërë brenda afatit të përcaktuar me

ligj pengon që aktgjykimi/vendimi të bëhet i formës së prerë në pjesën e goditur me ankim.³¹

Gjithashtu, ankesa në këtë procedurë e ka edhe efektin devolutiv sepse mbi bazën e ankesës nuk vendos gjykata e shkallës së parë e cila e ka nxjerrë aktgjykimin që është objekt i ankesës, porse në këtë rast vendos gjykata e shkallës së dytë, respektivisht Gjykata e Apelit.

Parimisht, e drejta e ankesës në konfliktin administrativ mund të shfrytëzohet vetëm në kushtet e përcaktuara me ligj. Mirëpo, ankesën si mjet të rregullt juridik e ka paraparë neni 23 i LKA-së, ku paragrafi 2 i këtij neni përcakton se: kundër vendimit të nxjerrë në konfliktin administrativ, ankesa mund të paraqitet te gjykata kompetente për çështje administrative e shkallës së dytë, ku sipas ligjit për Gjykatat e Republikës së Kosovës, si gjykatë e shkallës së dytë është Gjykata e Apelit e cila është kompetente të shqyrtoj të gjitha ankesat e ushtruara kundër vendimeve të gjykatave themelore.

Ankesa mund të parashtrohet nga palët e procedurës së konfliktit administrativ gjegjësisht nga: paditësi, organi i paditur dhe personi i interesuar, dhe e njëjta mund të parashtrohet: për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës apo për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjithashtu ankesa duhet të përmbajë: të dhënat lidhur me aktgjykimin i cili atakohet (numrin dhe datën e aktgjykimit); deklaratën se aktgjykimi kundërshtohet në tërësi ose në pjesën e caktuar; shkaqet e ankimit me arsyetim dhe nënshkrimin e paraqitësit të ankimit.

Në qoftë se ankesa nuk i përmban këto elemente, e njëjta do të konsiderohet si jo e plotë dhe gjykata e shkallës së parë me anë të aktvendimit, kundër të cilit nuk lejohet ankesë, e thërret ankuesin që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh ta plotësojë ankesën e paraqitur. Po që se ankuesi brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nuk vepron sipas kërkesës së gjykatës, gjykata me aktvendim e hedhë poshtë ankesën si jo të plotë.³²

10.2. Procedura sipas ankesës

Ankesa kundër aktgjykimit apo vendimit mund të ushtrohet në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit/vendimit, gjykatës së shkallës së dytë, gjegjësisht gjykatës së apelit, përmes gjykatës së shkallës së parë e cila e ka nxjerrë aktgjykimin/vendimin.

Ankesa duhet të përmbajë: emërtimin e gjykatës të cilës i paraqitet ankesa, emrin, mbiemrin dhe vendbanimin, respektivisht selinë e paditësit dhe të paditurit, aktgjykimin/vendimin kundër të cilit është drejtuar ankesa si dhe arsyet pse parashtrohet ankesa. Ankesa i dorëzohet gjykatës drejtpërsëdrejti ose i dërgohet me postë rekomande. Dita

31 Shih nenin 176 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore. Sqarim: sipas nenit 63 të LKA-së mundë të aplikohen përshtatshmërisht edhe dispozitat e ligjit për Procedurën Kontestimore nëse LKA nuk përmban dispozita për procedurën e ankimit në konfliktet administrative.

32 Shih nenin 178 dhe 179 Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, ku përshtatshmërisht mund të zbatohet ky nen edhe në Procedurën e Konfliktit Administrativ sa i përket ankimit.

e paraqitjes së ankesës në postë rekomande, konsiderohet si ditë kur i është dorëzuar ankesa gjykatës.

Nëse ankesa nuk i është dorëzuar gjykatës, por organit tjetër jo kompetent, ndërsa i arrin gjykatës pas skadimit të afatit për paraqitjen e saj, në këtë rast do të konsiderohet se është paraqitur me kohë, nëse paraqitja e saj në këtë organ ka qenë si pasojë e mos dijes apo e gabimit të hapur të paraqitësit (shih nenin 28 të LKA-së i cili aplikohet përshtatshmërisht edhe sa i përket ankesës).

Ashtu siç u cek me lartë, ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të mjaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare dhe gjykata e shkallës së parë, përkatësisht gjykata e cila ka nxjerrë aktgjykimin, vendimin e goditur, vlerëson anën formale të saj, se a është paraqitur nga pala e autorizuar, a është ushtuar në afatin ligjor, etj.

Gjykata e shkallës së parë mund ta hedhë poshtë ankesën me aktvendim pa caktuar fare seancë gjyqësore në qoftë se ankesa është paraqitur pas afatit të parashikuar me ligj (15 ditor) apo është jo e plotë dhe e palejueshme.

Në qoftë se gjykata e shkallës së parë vlerëson se ankesa është e lejueshme, është parashtruar nga pala e autorizuar, është e afatshme dhe e plotë, në këtë rast kjo gjykatë ia dërgon palës kundërshtare një ekzemplar të ankesës e cila ka mundësi që, brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankesë.

Një ekzemplar të përgjigjes në ankesë gjykata e shkallës së parë ia dërgon edhe ankuesit menjëherë, ose më së voni brenda afatit shtatë (7) ditor nga arritja e saj në gjykatë.

Përgjigja në ankesë e paraqitur pas afatit nuk do të merret në shqyrtim nga gjykata e shkallës së dytë.³³

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë, apo pas skadimit të afatit për përgjigje në ankesë,

gjykata e shkallës së parë ankesën dhe përgjigjen në ankesë, nëse është paraqitur me të gjitha shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë në afat prej shtatë (7) ditësh.

Pra, pasi që gjykata shkallës së parë, përkatësisht gjykata kompetente, e cila e ka nxjerrur aktgjykimin, përkatësisht vendimin e goditur, vërteton se janë përmbushur kushtet për ngritjen e ankesës, në këtë rast të njëjtën bashkë me shkresat e lëndës ia dërgon gjykatës së shkallës së dytë për të vendosur.

33 Shih nenin 186 dhe 187 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, ku dispozitat e këtij ligji aplikohen përshtatshmërisht edhe ne procedurën e konfliktit administrativ sipas nenit 63 të LKA-së.

10.3. Procedura në gjykatën e shkallës së dytë gjegjesisht në Gjykatën e Apelit

Gjykata e shkallës së dytë vendosë për ankesën në procedurën e konfliktit administrativ në seancë të kolegjit i cili përbëhet nga tre gjyqtar. Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave procedurale.³⁴

10.4. Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë (Gjykatës së Apelit) mbi ankesën në procedurën e konfliktit administrativ

Gjykata e shkallës së dytë (Gjykata e Apelit) mund:

- a) *ta hedhë poshtë ankesën si të vonuar, jo të plotë apo të palejueshme;*³⁵
- b) *ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta hedhë poshtë padinë;*
- c) *ta prishë aktgjykimin e goditur dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë;*
- d) *ta refuzoj ankesën si të pathemeltë dhe ta vërtetoj aktgjykimin e goditur;*
- e) *ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë.*³⁶

Gjykata e shkallës së dytë me aktgjykim e refuzon ankesën dhe e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë nëse konstaton se nuk ekzistojnë shkaqet nga të cilat është goditur aktgjykimi. Pra, Gjykata e shkallës së dytë mund ta refuzojë ankesën me aktgjykim nëse vërteton se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar ligjshmërinë e aktit dhe ka nxjerrur aktgjykim të rregullt.³⁷

Në qoftë se gjykata e shkallës së dytë e aprovon ankesën, në këtë rast edhe e anulon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata e shkallës së dytë mund ta anulon aktgjykimin e atakuar me ankesë në procedurën e konfliktit administrativ dhe në të njëjtën kohë të anulon edhe aktin administrativ i cili ka qenë objekt i konfliktit administrativ në gjykatën e shkallës së parë.³⁸

34 Shih nenin 194 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, ku dispozitat e këtij ligji aplikohen përshtatshmërisht edhe në procedurën e konfliktit administrativ sipas nenit 63 të LKA-së.

35 Ankesën e vonuar, jo të plotë, apo jo të lejueshme, e hedhë poshtë gjykata e shkallës së dytë me aktvendim, po që se nuk e ka bërë një gjë të tillë gjykata e shkallës së parë nën rrethanat siç janë të përshkruara të pjesa e procedurës sipas ankesës.

36 Shih nenin 195 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, ku dispozitat e këtij ligji aplikohen përshtatshmërisht edhe në procedurën e konfliktit administrativ sipas nenit 63 të LKA-së.

37 Shih Aktgjykimin refuzues të Gjykatës së Apelit A.A.nr.17/2015 me të cilin aktgjykim kjo gjykatë e refuzon ankesën e palës paditëse dhe e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

38 Shih Aktgjykimin aproves të Gjykatës së Apelit A.A.nr.76/2015 me të cilin aktgjykim kjo gjykatë e aprovon ankesën e palës paditëse dhe e anulon aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, gjithashtu me të njëjtin aktgjykim e anulon edhe aktin administrativ i cili ka qenë objekt i fillimit të procedurës së konfliktit administrativ në gjykatën e shkallës së

Nëse gjykata e shkallës së dytë e anulon aktgjykimin/vendimin, në këtë rast, është e detyrueshme që lëndën t'ia kthejë gjykatës së shkallës së parë (gjykatës themelore) e cila e ka nxjerrur aktgjykimin/vendimin e anuluar. Në këtë situatë, gjykata e shkallës së parë (themelore) ka për detyrë që të ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale dhe ta shqyrtojë çështjen në mënyrën e përcaktuar nga gjykata e cila ka vendosur lidhur me ankesën.

Vendimet e gjykatës së shkallës së dytë janë të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme ku ndaj këtyre vendimeve palët e procedurës së konfliktit administrativ mund ti parashtrojnë vetëm mjetet e jashtëzakonshme juridike.

11. Mjetet juridike të jashtëzakonshme

Mjete të jashtëzakonshme juridike në procedurën e konfliktit administrativ janë:

- 1) Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor;
- 2) Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë; dhe
- 3) Kërkesa për rishikimin e procedurës së konfliktit administrativ.

11.1. Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor

Në procedurën e konfliktit administrativ, kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor si mjet i jashtëzakonshëm juridik, i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve nga dita e dërgimit të aktgjykimit/vendimit kundër të cilit pala në procedurën e konfliktit administrativ e parashtron kërkesën e tillë (neni 24 dhe neni 50 i LKA-së).

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor duhet të përmbajë emërtimin e aktgjykimit/vendimit gjyqësor të gjykatës së shkallës së dytë i cili është i formës së prere, si dhe shkaqet dhe vëllimin në të cilin propozohet rishqyrtimi.

Kjo kërkesë mund të parashtrohet për dy shkaqe:

- a) *për shkak të shkeljes së drejtës materiale, dhe*
- b) *për shkak të shkeljes së rregullave procedurale (neni 24.2 i LKA-së).*

Kërkesa e palejueshme apo e paraqitur jashtë afatit të caktuar, apo kërkesa e parashtruar nga ana e personave të paautorizuar, do të hedhet poshtë me aktvendim nga ana e Gjykatës Supreme.

Nëse Gjykata Supreme e vlerëson se kërkesa është e rregullt, në këtë rast, kërkesën e njëjtë, ia dërgon palës së kundërt e cila, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të japë përgjigjen në kërkesën e bërë (neni 52 i LKA-së). Po ashtu, brenda këtij

afati, gjykata, kundër vendimit të së cilës është paraqitur kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm dhe organi i paditur, kanë për detyrë që, me kërkesën e gjykatës, t'i dërgojnë edhe të gjitha shkresat e lëndës (neni 52 i LKA-së).

Gjykata Supreme vendos mbi kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit në seancë jopublike, gjersa vendimi i kundërshtuar ekzaminohet vetëm brenda kufijve të kërkesës.

Gjykata Supreme me aktgjykim e refuzon ose e aprovon kërkesën e parashtruar. Me aktgjykimin me të cilin refuzohet kërkesa, Gjykata Supreme e vlerëson se gjykata e shkallës së dytë i ka zbatuar drejtë dispozitat e procedurës dhe të ligjit material gjatë nxjerrjes së vendimit gjyqësor kundër të cilit është parashtruar ky mjet i jashtëzakonshëm juridik.³⁹

Ndërsa, me aktgjykimin me të cilin kërkesa aprovohet, Gjykata Supreme mund ta prish ose ta ndryshojë vendimin gjyqësor kundër të cilit është paraqitur kërkesa. Nëse Gjykata Supreme e prish vendimin gjyqësor, lënda i kthehet gjykatës vendimi i së cilës është prishur. Në këtë situatë kjo gjykatë (vendimi i së cilës është prishur) ka për detyrë të ndërmarr të gjitha veprimet procedurale dhe t'i shqyrtojë çështjet për të cilat është paralajmëruar nga gjykata e cila ka vendosur mbi kërkesën (neni 54 i LKA-së).

11.2. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë

Këtë kërkesë mund ta paraqesë prokurori shtetëror në qoftë se me vendimin gjyqësor është shkelur ligji i aplikueshëm, dispozita tjetër apo akti i përgjithshëm. Kjo kërkesë i parashtrohet Gjykatës Supreme të Kosovës (neni 25 i LKA-së) dhe mund të paraqitet kundër vendimit të plotfuqishëm të gjykatës. Kjo kërkesë mund të paraqitet brenda afatit prej nëntëdhjetë (90) ditëve nga data kur u është dërguar palëve vendimi gjyqësor, kundër të cilit paraqitet kërkesa.⁴⁰

Sa i përket procedurës mbi bazën e kësaj kërkesë, Gjykata Supreme vepron njëjtë si edhe te kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

39 Shih Aktgjykimin refuzues të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Nr. ARJ-UZVP.nr.5/2015, në çështjen e Konfliktit Administrativ përmes së cilit aktgjykim kjo gjykatë e refuzon si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm gjyqësor të parashtruar nga Korporata Energjetike e Kosovës kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Aktgjykimi i qasshëm në këtë link: <http://www.md-ks.net/repository/docs/Aktgjykimi,nr.3202014.pdf>

40 Shih nenin 245 të Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore, ku dispozitat e këtij ligji aplikohen përshtatshëmish edhe ne procedurën e konfliktit administrativ sipas nenit 63 të LKA-së.

11.3. Kërkesa për rishikimin e procedurës së konfliktit administrativ

Kërkesën për rishikimin e procedurës së konfliktit administrativ si mjet të jashtëzakonshëm juridik mund ta kërkojë vetëm pala në këtë procedurë.

Përsëritja e procedurës mund të kërkohe brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve (afati subjektiv) nga data e dërgimit të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën, me kusht që atë shkak nuk ka mundur ta përdor gjatë procedurës së zhvilluar. Pasi të kenë kaluar tre (3) vjet (afati objektiv) nga plotfuqishmëria e vendimit, përsëritja nuk mund të kërkohe (neni 57 i LKA-së).

Pala, mund të parashtrojë këtë kërkesë, gjegjësisht mund të kërkojë rishikimin e një vendimi gjyqësor, që ka marrë formë të prerë për këto arsye:

- 1) në qoftë se pala mëson për fakte të reja, apo në qoftë se konstaton ose krijon mundësi të përdorë prova të reja në bazë të cilave konflikti do të mund të zgjidhej në mënyrë më të favorshme për të, po të ishin përdorur apo shtruar këto fakte në procedurën e mëparshme gjyqësore. Nuk është e mjaftueshme ekzistimi i cilave do fakte të reja, vetëm është e nevojshme që faktet të kenë atë kualitet që të mundësojnë sjelljen e një vendimi më të favorshëm. Rishikimi i procedurës nuk mund të kërkohe poqëse gjykata nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike, por është vepruar sipas gjendjes faktike të vërtetuar gjatë procedurës administrative, apo kur vendimi është prishur pasi që gjykata ka gjetur që gjendja faktike në procedurën administrative nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë apo të plotë.
- 2) Në qoftë se vendimi i gjykatës është marrur si pasojë e veprës penale të gjyqtarit apo punëtorit në gjykatë, ose vendimi është nxjerrur me veprim mashtrues të përfaqësuesit në gjykatë ose të autorizuarit të palës, të kundërshtarit të tij ose të përfaqësuesit apo të autorizuarit të kundërshtarit, kurse veprimi i tillë përbën vepër penale;
- 3) Nëse vendimi është bazuar në aktgjykimin e nxjerrë në çështjen penale apo civile, kurse ky aktgjykim është prishur më vonë me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- 4) Në qoftë se dokumenti në të cilin bazohet vendimi është fals ose është ndryshuar ose është ndryshuar fals, apo në qoftë se dëshmitari, eksperti, ose pala gjatë dëgjimit para gjykatës ka dhënë deklaratë false, kurse vendimi i gjykatës është bazuar në këtë deklaratë;
- 5) Në qoftë se pala konstaton apo krijon mundësi ta përdor vendimin e mëparshëm të nxjerrë në të njëjtin kontest administrativ;
- 6) Në qoftë se personit të interesuar nuk i është dhënë mundësia që të marrë pjesë në konfliktin administrativ. Sipas dispozitave të Ligjit mbi Konfliktin administrativ personat e interesuar konsiderohen si palë, dhe gjykata ka për detyrë që personit të interesuar të ja vë padinë në përgjigje (neni 55 i LKA-së).

Kërkesa për rishikimin e procedurës së konfliktit administrativ, gjegjësisht, rishikimi i vendimeve gjyqësore për arsyet e lartë shënuara, lejohet vetëm atëherë kur

këto rrethana janë vërtetuar me vendim të formës së prerë nga gjykata kompetente (neni 56 i LKA-së).

Mbi kërkesën për rishikimin e procedurës së konfliktit administrativ vendos gjykata, që ka nxjerrë vendimin dhe në seancë jopublike (neni 60 i LKA-së).

Kërkesa për rishikimin e procedurës duhet të përmbajë:

- aktgjykimin apo vendimin e nxjerrur në procedurë, rishikimi i të cilit kërkohet;
- bazën ligjore të rishikimit dhe provat, përkatësisht rrethanat që e bëjnë të besueshëm ekzistimin e kësaj baze;
- rrethanat nga të cilat vërehet se kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor, dhe me të cilën gjë kjo provohet;
- në çfarë vëllimi dhe drejtimi propozohet ndryshimi i aktgjykimit, respektivisht aktvendimit të nxjerrë në procedurë, rishikimi i së cilit kërkohet.

Gjykata kompetente për vendosjen e këtij mjeti juridik, vepron njëjtë sikurse tek procedura ankimore. Kundër vendimit gjyqësor të nxjerrë mbi kërkesën për rishikimin e procedurës së konfliktit administrativ mund të paraqiten mjete juridike që lejohen në çështjen kryesore.

12. Shpenzimet e procedurës së konfliktit administrativ

Me shpenzime të cilat mund të shkaktohen në konfliktin administrativ kuptohen shpenzimet për dëshmitarë, ekspert, taksa gjyqësore për padi, ankesë, shpenzime të avokatëve etj.

Sipas nenit 64 të LKA-së, në konfliktin administrativ secila palë i bart shpenzimet e veta. Sa i përket taksës gjyqësore, në rast se njëra nga palët e kësaj procedure dështon të paguaj taksën gjyqësore për padi, gjykata nxjerrë aktvendim ku konsideron se pala paditëse është tërhequr nga padia e që rrjedhimisht pezullohet edhe procedura e konfliktit administrativ.⁴¹

41 Shih Aktvendimin A.nr.1536/2013 të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal, me të cilin vendim kjo gjykatë e pezullon procedurën e konfliktit administrativ duke u bazuar në nenin 253.5 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, ku përcaktohet se: në qoftë se paditësi nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr. Aktvendimi i qasshëm në këtë link: <http://www.md-ks.net/?page=1,214&offset=160>

13. Karakteri i detyrueshëm i aktgjykimit

Karakterit i detyrueshëm i aktgjykimit të nxjerrë në procedurën e konfliktit administrative bazohet në nenin 65 të LKA-së. Sipas këtij neni, kur gjykata e anulon aktin administrativ, kundër të cilit ka filluar konflikti administrativ, lënda kthehet në gjendjen në të cilën ishte para se të ishte nxjerrë akti administrativ i anuluar.

Nëse sipas karakterit të çështjes, që ka qenë objekt i konfliktit, duhet që, në vend të aktit të anuluar administrativ, të nxirret një akt tjetër, në këtë rast organi kompetent i administratës (pala e paditur) ka për detyrë ta nxjerrë aktin tjetër pa shtyrje dhe jo më vonë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga data e dërgimit të aktgjykimit. Në këtë rast, organi kompetent i administratës, është i obliguar nga pikëpamja juridike e gjykatës, si dhe nga vërejtjet e gjykatës lidhur me procedurën administrative që është zhvilluar për gjatë nxjerrjes së aktit administrative tashmë të anuluar.

Vendimet e gjykatës të nxjerrura në procedurën e konfliktit administrativ, mund të ekzekutohen atëherë kur bëhen të plotfuqishme dhe të ekzekutueshme (neni 66 i LKA-së). Në këtë procedurë vendimet e gjykatës së shkallës së dytë (gjykatës së apelit) janë vendimet gjyqësore të formës së prerë, mirëpo vendime të formës së prerë mund të bëhen edhe vendimet e gjykatës së shkallës së parë pas kalimit të afatit pesëmbëdhjetë (15) ditor për ankesë, në qoftë se ankesa nuk është parashtruar brenda këtij afati dhe nga pala e autorizuar.

LITERATURA

- Stavileci Esat, Batalli Mirlinda, Sadushi Sokol, “E Drejta Administrative – Organizimi dhe Veprimtaria Administrative, Prishtinë 2012.
- Stavileci Esat, “Fjalor shpjegues i termave administrativë”, Prishtinë, 2010.
- Stavileci Esat, ”Hyrje në Shkencat Administrative”, Prishtinë, 1997.
- Sokoli Agur, “E Drejta Procedurale Administrative”, Prishtinë, 2014.
- Sadushi Sokol “E drejta Administrative 2, Shkaqet ligjore te rishikimit gjyqësor”, Tiranë 2000.
- Popovic Slavoljub i Jovanka Savinsek, Komentar Zakona o upravnim sporovima, Beograd, 1997.
- Jean-Marie Woehrling, SIGMA Support for Improvement in Governance and Management. A joint initiative of the OECD and the European Union, principally financed by the Protecting Legality: Public administration and judiciary in EU countries. How to conciliate executive accountability and judicial review, Conference on Public Administration Reform and European Integration, Budva, Montenegro, 26-27 March 2009.
- Jerry L. Mashaw, Richard A. Merrill and Peter M. Shane, Administrative Law, The American Public Law.

BURIME TË LEGJISLACIONIT:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
- Ligji Nr. 02/L-28, Për Procedurën Administrative.
- Ligji Nr. 03/L-202, Për Konfliktet Administrative.
- Ligji Nr. 04/L-118 Për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.
- Ligjit Nr. 03/L-006 Për Procedurën Kontestimore.
- Ligjit Nr. 03/L-199 për Gjykatat.

AKTE GJYQËSORE:

- Aktgjykimi Nr: ARJ-UZVP.nr.5/2015 - Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.
- Aktgjykimi Nr: A.A.nr.17/2015, Gjykata e Apelit.
- Aktgjykimi Nr: A.A.nr.76/2015, Gjykata e Apelit.
- Aktgjykimi Nr: A.nr. 659/2012, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.
- Aktgjykimi Nr: A.nr.928/2013 të Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.
- Aktgjykimi Nr: A.nr. 1217/2010, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.
- Aktvendimi Nr: A.nr.1536/2013, Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative – Divizioni Fiskal
- Aktvendimi Nr: A.nr.702/10 të Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.
- System: cases and Material 816 (3rd edition, West Publishing, 1992).

MBROJTJA EUROPIANE E LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT

7

KËSHILLI I EUROPËS

THEMELIMI DHE ORGANIZIMI

Këshilli i Evropës është organizata më e vjetër politike e kontinentit të Evropës. U themelua pas Luftës së dytë Botërore, me datën 5 maj 1949, kur qeveritë e dhjetë shteteve evropiane u takuan në Londër me një mision të madh: që vrasjet, shkatërrimet dhe vuajtjet e njerëzve të mos përsëriten “kurrë më”.

Këshilli i Evropës, ka për qëllim që të punoj për arritjen e një “uniteti më të madh midis anëtarëve” për të garantuar lirinë individuale, lirinë politike dhe sundimin e ligjit, parime këto që përbëjnë themelin e demokracisë kuptimplote dhe që ndikojnë në jetërat të gjithë evropianëve.

Nga një organizatë e përbërë nga dhjetë anëtarë, Këshilli i Evropës është zhvilluar sot në një organizatë të vërtetë ndërqeveritare gjithë-evropiane, me dyzet e shtatë shtete anëtare dhe me një shtet, Bellorusinë, që ka status të kandidatit, por ende nuk është shtet anëtarë, për shkak të mosplotësimit të kushteve bazë për anëtarësim -- . respektimin e parimit të sundimit të ligjit dhe të parimit të gëzimit të të drejtave të njeriut për të gjithë personat brenda juridiksionit të saj të të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale.

Republika e Kosovës si shteti më i ri evropian, përveç vullnetit, gatishmërisë, dhe aftësisë që të përmbushë kriteret për anëtarësim, duhet që të siguroj shumicën prej dy të tretave të anëtarëve të Këshillit të Evropës, për të fituar të drejtën që të merr ftesë nga Komiteti i Ministrave për anëtarësim. Që nga viti 1951, Komiteti i Ministrave që përfundimisht e aprovon anëtarësimin e një shteti të ri nëse ai e siguron shumicën prej dy të tretave, zakonisht për një gjë të tillë e kërkon mendimin e Asamblesë konsultative, jo vetëm lidhur me ftesën për anëtarësim, por edhe për numrin e ulëseve që shtetit të

ri do t'i sigurohen në Asamble. Para se të dërgohet Ftesa për anëtarësim, Komiteti i Ministrave e përcakton numrin e ulëseve për shtetin e ri, si dhe shumën e kontributit financiar që shteti i ri duhet ta bëj.

Të gjitha shtetet anëtare e kanë për obligim që lirinë, dinjitetin njerëzor dhe mirëqenien e individit ta kenë parim bazë të veprimit të pushtetit. Sot, Këshilli i Evropës si organizatë ndërqeveritare personifikon zotimin e përbashkët të rreth 800 milion evropianëve për të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundim të ligjit.

Kosova është e lidhur ngushtë me Këshillin e Evropës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës shprehimisht e parashikon zbatimin e drejtpërdrejtë të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut si dhe Protokollet e saj (neni 22 i Kushtetutës), si dhe përcakton se “të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 53 i Kushtetutës). Duhet gjithashtu të theksohet se i tërë ndërtimi i sistemit juridik të Republikës së Kosovës është i bazuar në instrumentet e Këshillit të Evropës. Gjithashtu, është e një rëndësie të veçantë pjesëmarrja, si anëtarë vëzhgues, i Asociacionit të Komunave të Kosovës në Kongresin e Autoriteteve Lokale dhe Rajonale.

OBJEKTIVAT

Objektivat e Këshillit të Evropës, si organizatë ndërqeveritare, edhe sot janë po aq të rëndësishme dhe relevante, sikurse edhe para gati pesëdhjetë vjetësh, kur kjo organizatë u themelua:

- a) *të mbrojtë të drejtat e njeriut, demokracinë pluraliste dhe sundimin e ligjit;*
- b) *të avancoj vetëdijen dhe të inkurajoj zhvillimin e identitetit dhe diversitetit kulturor të Evropës;*
- c) *të gjej zgjidhje për problemet me të cilat ballafaqohet shoqëria evropiane (si diskriminimi i minoriteteve, ksenofobia, jotoleranca, mbrojtja e mjedisit jetësor; klonimi i njeriut; sida; droga, krimi i organizuar, etj);*
- d) *të ndihmoj konsolidimin e stabilitetit evropian duke e mbështetur reformën politike, legjislativë dhe kushtetuese.*

Këshilli i Evropës vazhdon të punoj drejt idealeve demokratike, duke e siguruar universalitetin e të drejtave të njeriut, nëpërmjet të ndërtimit dhe të avancimit të standardeve të përbashkëta nëpër të gjitha vendet anëtare, në të mirë të të gjithëve, pa marrë parasysh se cilët janë ata dhe prej nga janë. Popujt e Evropës kanë të drejtë t'i gëzojnë të gjitha të drejtat e tyre, civile, politike ekonomike, sociale dhe kulturore. Në këtë drejtim, Këshilli i Evropës synon që t'i mbrojtë dhe t'i avancoj të gjitha këto të drejta si pjesë të një tërësie të pandarë.

VEPRIMTARIA

Këshilli i Evropës merret me programe të ndryshme nga fusha e të drejtave të njeriut. Madje, edhe shumë veprimtari të tjera qoftë të fushës shoqërore, juridike, arsimore, apo kulturore, përfshijnë një shkallë të rëndësishme të çështjeve nga fusha e të drejtave të njeriut. Këtu do t'i përmendim vetëm disa nga veprimtaritë më të rëndësishme të Këshillit të Evropës:

- 1) Mbrojtja e të drejtave civile dhe politike nëpërmjet të mekanizmit të procedurës individuale të ankesave, ku shkeljet e të drejtave të njeriut mund të shqyrtohen nga Gjykata për të drejtat e njeriut;
- 2) Mbrojtja e të drejtave ekonomike dhe sociale nëpërmjet të sistemit të monitorimit dhe të përgatitjes dhe të paraqitjes së raporteve për obligimet e shteteve, si dhe nëpërmjet të sistemit të ankesave kolektive;
- 3) Mbrojtja e personave të privuar nga liria nëpërmjet të sistemit të vizitave nga ana e Komitetit për parandalimin e torturës dhe të ndëshkimeve apo trajtimeve çnjerëzore a poshtëruese;
- 4) Mbrojtja e të drejtave të minoriteteve;
- 5) Puna drejtë barazisë së gruas dhe burrit;
- 6) Ndërmarrja e veprimeve kundër racizmit, ksenofobisë, anti-semitizmit dhe jotolerancës;
- 7) Puna në bashkëpunim të ngushtë me mediat mbi çështjet që janë të lidhura me lirinë e shprehjes dhe çështjet e tjera të të drejtave të njeriut;
- 8) Avancimi i vetëdijes për të drejtat e njeriut dhe inkurajimi i arsimimit për të drejtat e njeriut nëpër shkolla dhe midis grupeve profesionale;
- 9) Puna me organizatat dhe institucionet për të drejtat e njeriut (Ombudspersonat, Komisionet nacionale për të drejtat e njeriut, etj.).

ORGANET

- 1) Komiteti i Ministrave është organ vendim-marrës i Këshillit të Evropës. Ai përbëhet nga Ministrat e jashtëm të dyzet e pesë shteteve anëtare, ose nga përfaqësuesit e tyre diplomatik të vendosur në Strasburg.

Me anëtarësim në Këshillin e Evropës, shtetet e marrin obligimin që t'i pranojnë parimet e sundimit të ligjit dhe të drejtën e qytetarëve të tyre në të drejtat dhe liritë fundamentale. Gjithashtu, ato e marrin për obligim që të bashkëpunojnë në mënyrë të sinqertë dhe efektive për të arritur unitet më të madh dhe për të ndihmuar përparimin ekonomik dhe social. Secili shtet anëtar është përgjegjës për respektimin e këtyre zotimeve. Komiteti i ministrave siguron që shtetet të respektojnë zotimet e veta. Në rast të ndonjë shkeljeje serioze, Komiteti i Ministrave mund të suspendoj përfaqësimin e shtetit anëtar gjegjë, t'a thërras atë që të heq dorë nga anëtarësia, apo madje edhe të vendosë se ai shtet ka pushuar të jetë anëtar i Këshillit të Evropës.

Komiteti i Ministrave siguron që konventat dhe marrëveshjet midis shteteve anëtare zbatohen. Kjo është sidomos kritike kur është fjala për tekstet për të drejtat e njeriut (më i rëndësishmi prej të cilëve, Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut, pastaj

Karta Sociale Evropiane, Konventa Evropiane për parandalimin e torturës, dhe Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare) e përcakton makinerinë mbikëqyrëse. Përgjegjësia e Komitetit të Ministrave ndaj Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut e pasqyron rëndësinë e kësaj Konvente, që është gur themeli i sistemit evropian të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Duke i mbikëqyrrur shtetet anëtare në ekzekutimin e aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut, Komiteti i Ministrave luan rol esencial në ruajtjen e kredibilitetit të këtij sistemi, që është unik në botë.

Në përputhshmëri me filozofinë që e udhëheqë zgjerimin e Këshillit të Evropë që nga rënja e murit të Berlinit, Komiteti i Ministrave i ka ushtruar përgjegjësitë e veta në frymë konstruktive dhe të paanshme, duke e theksuar dialogun dhe vendosjen graduale të kushteve politike dhe materiale për zhvillim të dobishëm pozitiv. Deri më tani, është filluar me sistemin monitorues që siguron se të gjitha shtetet anëtare i respektojnë obligimet e tyre. Komiteti i ministrave u siguron të gjithë anëtarëve kushtet dhe mjetet për të mbështetur dhe zhvilluar vlerat fundamentale të Këshillit të Evropës. Zgjerimi i Këshillit të Evropës bëri që të ndodhin ndryshime të rëndësishme në organizimin dhe rolin që ai ka, sidomos në aspektin politik të punës së tij.

- 2) **Asambleja Parlamentare** është organ këshillëdhënës i Këshillit të Evropës. Ajo është Asambleja më e vjetër ndërkombëtare parlamentare, e përbërë nga anëtarët e parlamenteve të zgjedhur në mënyrë demokratike. Anëtarët e Asamblesë parlamentare zgjedhën nga ana e parlamenteve të shteteve anëtare, nga radhët e anëtarëve të vet. Secili shtet, varësisht nga madhësia e popullsisë, përfaqësohet nga delegacioni që përbëhet nga 2, deri në 18 anëtarë. Kompozicioni delegacioneve të shteteve anëtare domosdo duhet të sigurojë përfaqësimin e drejtë të partive politike, ose të grupeve në parlamentet e tyre. Asambleja parlamentare ka pesë grupe parlamentare: Grupin socialist, Grupin e Partisë popullore Evropiane, Grupin Demokratik Evropian, Grupin liberal, demokratik dhe Reformues dhe Grupin e të Majtëve Evropian. Disa anëtarë të Asamblesë kanë vendosur që t'i mos i bashkohen asnjërit grup.
- 3) **Kongresi i Autoriteteve Rajonale dhe Lokale të Evropës** është organ konsultativ që i përfaqëson autoritetet lokale dhe rajonale.

Ky organ i Këshillit të Evropës ka rol të veçantë në Kosovë. Veprimtaria e Kongresit në Kosovë përfshinë:

- a) *ndihmën për të hartuar tekstet ligjore për komuna dhe zgjedhje;*
- b) *vëzhgimin e zgjedhjeve komunale;*
- c) *organizimin e vizitave për Presidentin e Kongresit dhe sigurimin e dialogut me institucionet vendore të pushtetit;*
- d) *mbështetjen e iniciativave të Komunave të Kosovës;*
- e) *ndihmën OSBE-së për ndërtimin e institutit trajnues të qeverisjes lokale.*

■ KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NATYRA JURIDIKE E KONVENTËS

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore është e arritura më e madhe e Këshillit të Evropës. Është hapur për nënshkrim në Romë, me datën 4 nëntor 1950 dhe ka hyrë në fuqi në shtator të vitit 1953.

Ndryshe nga Deklarata universale për të drejtat e njeriut, edhe pse e hartuar sipas modelit të saj, Konventa evropiane për të drejtat e njeriut jo vetëm që e ka formuluar katalogun e të drejtave të njeriut, por edhe e ka siguruar sistemin e kontrollit për zbatimin e saj. Në të vërtetë, qëllim i Këshillit të Evropës ishte që me këtë Konventë të bëhen hapat e parë për zbatimin e të drejtave të caktuara të vendosura me Deklaratën universale për të drejtat e njeriut të vitit 1948.

Sipas të drejtës ndërkombëtare, Konventa evropiane për të drejtat e njeriut është marrëveshje ndërkombëtare. Është hartuar, lidhur dhe ratifikuar sipas praktikës dhe rregullave që vlejnë për marrëveshjet ndërkombëtare. Megjithatë, kjo është vetëm njëra anë e saj. Dispozitat që i rregullojnë garancat e të drejtave materiale të njeriut, para Esenca e Konventës, i ngjanë katalogut kushtetues të të drejtave të njeriut.

Që të dy këto aspekte të Konventës duhet marrë në konsideratë së bashku, edhe pse aspekti “kushtetues” i Konventës, me kalimin e kohës është bërë dominant. Kjo sidomos bie në sy nëse i shikojmë parimet e interpretimit. Në të drejtën klasike ndërkombëtare, marrëveshjet ndërkombëtare zakonisht interpretohen duke u fokusuar në mënyrë të kufizuar dhe strikte në interpretimin e obligimeve të shteteve (travaux préparatoires). Përkundrazi, mënyra e interpretimit të dispozitave të Konventës evropiane të të drejtave të njeriut i ngjanë plotësisht interpretimit që e bëjnë gjykatat nacionale. Këtu merren parasysh edhe zhvillimet e shoqërisë moderne dhe Konventa shiqohet si “instrument i gjallë”. Kjo është gjithashtu, karakteristikë e karakterit kushtetues të Konventës.

PËRMBAJTJA E KONVENTËS

1. HISTORIKU I ZHVILLIMIT

Krahas përcaktimit të katalogut të të drejtave dhe lirive civile dhe politike, Konventa ka ndërtuar edhe sistemin e zbatimit të obligimeve të përcaktuara ndaj shteteve kontraktuese. Me këtë rast, kjo përgjegjësi u ishte besuar tri institucioneve: Komisionit Evropian për të drejta të njeriut (i themeluar në vitin 1954), Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut (e themeluar në vitin 1959), si dhe Komitetit të ministrave.

Sipas Konventës së vitit 1950, në rastet kur shtetet kontraktuese kishin pranuar të drejtën individuale të ankesës, parashtruesit individual të ankesës (individët, grupet e individëve, ose organizatat joqeveritare) mund të parashtronin ankesa kundër shteteve kontraktuese për shkeljet e pohuara të të drejtave të siguruar me Konventë.

Në fillim, ankesat kalonin nëpër shqyrtimin paraprak të Komisionit që e përcaktonte pranimin e tyre. Nëse ankesat konsideroheshin të pranueshme dhe nuk ishte arritur ndonjë zgjidhje miqësore për rastin, Komisioni e përpilonte raportin ku i parashtronte faktet, por edhe e shprehte mendimin mbi anën ligjore të rastit. Raporti i dërgohej Komitetit të ministrave.

Në rastet kur shteti i paditur e kishte pranuar jurisdikcionin e obligueshëm të Gjykatës, Komisioni ose cilido shtet kontraktues i interesuar kishte në dispozicion periudhën prej tre muajsh pasi që raporti t'i dorëzohej Komitetit të ministrave, mbrenda të cilës mund t'i dorëzonte rastin Gjykatës për vendosje përfundimtare dhe juridikisht të obligueshme. Individët nuk kishin të drejtë që t'ia paraqitnin rastet Gjykatës.

Nëse rasti nuk i paraqitej gjykatës, Komiteti i ministrave vendoste se a kishte patur shkelje të Konventës, dhe në rastet kur ishte e përshtatshme, i siguronte satisfakcion viktimës. Komiteti i ministrave ishte gjithashtu përgjegjës për mbikqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve të Gjykatës.

2. ZHVILLIMET EMËPASTAJME- PROTOKOLET

Që nga hyrja në fuqi e Konventës, janë miratuar 12 protokole të saj. Protokollet Nr. 1, 4, 6 dhe 7 të Konventës i shtuan edhe më tutje të drejta dhe liri katalogut të siguar me Konventë, derisa Protokoli Nr. 2 ia njohu Gjykatës pushtetin për të dhënë mendime këshillëdhënëse. Protokoli Nr. 9 iu mundësoi parashtruesve individual të ankesave që t'i paraqesin rastet e tyre para Gjykatës, nëse shteti i paditur ishte ratifikues i Protokollit, dhe një gjë e tillë pranohej nga Komisioni i kontrollit. Me Protokollin Nr. 11 u ristrukturua makineria e zbatimit të Konventës. Protokoli Nr. 12 e ndalon plotësisht diskriminimin, për ndryshim nga teksti bazë i Konventës që e ndalon diskriminimin në mënyrë të limituar, respektivisht vetëm sa i përket gëzimit të të drejtave të tjera, mbrojtja e të cilave sigurohet me Konventë. Protokollet e tjera kanë të bëjnë me organizimin dhe procedurën para institucioneve të vendosura me Konventë.

3. GJYKATA E RE EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Periudha tranzitore

Me datën 11 maj 1994, Protokoli Nr. 11 i Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut u hap për nënshkrime. Me këtë protokoll kërkohej ratifikimi nga të gjitha shtetet kontraktuese të konventës dhe hyri në fuqi një vit pas ratifikimit të fundit të depozituar, më 1998. Po atë vit, me datën 31 tetor 1998, konform këtij protokoll, Gjykata e vjetër pushoi të funksionojë dhe më 1 nëntor, filloi të funksionojë Gjykata e re Evropiane për të drejta të njeriut. Megjithatë, sipas Protokollit 11 ishte përcaktuar që Komisioni duhet të vazhdon të funksionojë edhe për një vit (deri me datën 31 tetor 1999) për t'u marrë me rastet që ishin proklamuar të pranueshme para datës së hyrjes në fuqi të Protokollit 11.

Organizimi i gjykatës

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut e themeluar në bazë të Konventës së ndryshuar dhe plotësuar me Protokollin Nr. 11 përbëhet nga numri i barabartë i gjyqtarëve me numrin e anëtarëve të shteteve kontraktuese të konventës. Gjyqtarët zgjedhën nga Asambleja parlamentare e Këshillit të Evropës me mandat prej gjashtë vjetësh. Mandati i gjysmës së gjyqtarëve të zgjedhur në zgjedhjet e para skadon pas tre vjetësh, në mënyrë që të sigurohet që mandati i gjysmës së gjyqtarëve të përtërihet çdo tre vjet. Mandati i gjyqtarit gjithashtu skadon pasi që ata ta arrijnë moshën 70 vjeçare.

Gjykata plenare e zgjedhë Kryetarin e Gjykatës, dy nënkryetarë dhe dy kryetarë të sektorëve për periudhën prej tre vjetësh.

Sipas Rregullave të Gjykatës, gjykata është e ndarë në katër sektorë, përbërja e të cilëve është e fiksuar për tre vjet dhe është e balancuar në pikëpamje gjeografike dhe gjinore, si dhe ka parasyshtë sistemet e ndryshme juridike të shteteve kontraktuese. Secili sektor kryesohet nga kryetari, me ç'rast dy nga kryetarët e sektorëve janë njëkohësisht nënkryetarë të Gjykatës. Kryetarët e sektorëve ndihmohen, dhe kurdo që është e nevojshme zëvendësohen nga nënkryetarët e sektorëve.

Secili sektor në përbërjen e vet e ka nga një komision prej tre gjyqtarëve të cilët zgjedhën me mandat prej dymbëdhjetë muajsh. Komisionet janë shumë të rëndësishëm për strukturën e re të Gjykatës, meqenëse janë përgjegjës për punën e filtrimit që në të kaluarën është bërë nga Komisioni.

Brenda çdo sektori, mbi baza të rotacionit, janë themeluar dhomat e përbëra nga shtatë anëtarë, njëri nga të cilët është kryetar i sektori, dhe tjetri gjyqtar i zgjedhur nga shteti për të cilin bëhet fjalë për rastin e caktuar. Nëse ky i fundit nuk është anëtar i sektorit, atëherë shërben si anëtar ex officio i dhomës. Anëtarët e sektorit që nuk janë anëtarë të plotë të Dhomës, janë anëtarë alternativ të saj.

Dhoma e madhe e përbërë nga shtatëmbëdhjetë gjyqtarë themelohet për tre vjet. Përveç Kryetarit, nënkryetarëve dhe kryetarëve të sektorëve që janë anëtarëve ex officio, ajo është e formuar në baza të rotacionit nga dy grupe, që ndërrohen çdo nëntë muaj. Këto grupe janë të përbëra nga anëtarë të zgjedhur në mënyrë që të krijojnë balancë gjeografik dhe t'i reflektojnë traditat e ndryshme juridike.

Procedura para gjykatës

Secili shtet kontraktues, ose individ që pohon se është viktimë e ndonjë shkeljeje të Konventës (ankesë individuale), ka mundësi që drejtpërdrejtë të parashtrij ankesë para Gjykatës në Strasburg, me të cilën deklaron se njëri nga shtetet kontraktuese të Konventës e ka shkelur ndonjë të drejtë të siguruar me Konventë.

Procedura para Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut është publike. Parimisht, marrja në pyetje e palëve është publike, nëse Dhoma, apo Dhoma e madhe nuk vendosë ndryshe në rast të rrethanave të jashtëzakonshme. Gjithashtu janë publike edhe ankesat dhe dokumentet e tjera që i janë paraqitur Regjistrit të Gjykatës nga palët.

Parashtruesit individual të ankesave mund t'i parashtrojnë ankesat individualisht, megjithëqë përfaqësimi juridik rekomandohet, madje edhe kërkohet me rastin e marrjes në pyetje, ose pasi që të deklarohet ankesa e pranueshme. Këshilli i Evropës e ka themeluar një skemë të ndihmës juridike për parashtruesit e ankesave që nuk kanë mundësi që të sigurojnë përfaqësim juridik.

Gjuhë zyrtare të Gjykatës janë anglishtja dhe frëngjishtja, por ankesat mund të hartohen në njërën nga gjuhët zyrtare të shteteve kontraktuese. Pasi që të deklarohet ankesa si e pranueshme, duhet të përdoret njëra nga gjuhët zyrtare të Gjykatës, përveç nëse kryetari i dhomës, apo i Dhomës së madhe e autorizon vazhdimin e përdorimit të gjuhës në të cilën është hartuar ankesa.

4. PROCEDURA PËR PRANIMIN E ANKESËS

4.1 Kriteri i pranimit

Procedura e ankesës e përcaktuar me Protokollin 11 të Konventës, për herë të parë në historinë e të drejtës ndërkombëtare, e krijon të drejtën e individit që t'i bëj shtetet përgjegjëse para gjykatës ndërkombëtare për shkeljet e paraqitura të obligimeve të tyre ndërkombëtare. Asnjëherë më parë, dhe asnjë procedurë tjetër ndërkombëtare nuk u lejon individëve qasje të drejtpërdrejtë në një gjykatë ndërkombëtare, me pushtet që të nxjerrë aktgjykime juridikisht të obligueshme në të drejtën ndërkombëtare. Aktgjykimet e Gjykatës Evropiane për të drejtat e njeriut ekzekutohen nga Komisioni i ministrave.

Sipas nenit 34 të Konventës, e drejta në ankesë individuale është tani pjesë e obligueshme e Konventës, megjithëqë ajo mbetet opsionale për territoret e jashtme, “për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilave përgjegjës është shteti”.

Jurisdikcioni i Gjykatës është i kufizuar. Ankesat mund të merren në konsideratë vetëm nëse i plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara me nenin 35 të Konventës. Shkurtimisht, këto janë kriteret që domosdo duhet t'i plotësoj një ankesë:

- Të parashtrohet nga personi i autorizuar;
- Të ketë të bëj me çështjen e rregulluar me Konventë;
- Të ketë të bëj me periudhën brenda të cilës shteti është i obliguar t'i përmbahet konventës;
- Të ketë të bëj me jurisdikcionin për të cilin Konventa shtrihet;
- Të parashtrohet pas shterjes së të gjitha mjeteve juridike të brendshme;
- Të jenë shtruar të gjitha argumentet e Konventës në gjykatat e brendshme;
- Të parashtrohet brenda 6 (gjashtë) muajsh nga dita e shfrytëzimit të mjetit të fundit juridik të brendshëm.

Duhet theksuar se neni 34 jo vetëm që vendos obligimin në shtetet që t'u lejojnë individëve të parashtrojnë ankesa para Gjykatës evropiane për të drejtat e njeriut, por edhe i obligon ato “që në asnjë mënyrë mos të pengoj ushtrimin efektiv të kësaj të drejte”. Kështu p.sh. në rastin Akdivar v. Turke, Gjykata me aktgjykim ka vendosur që:

Është i rëndësishë parësore veprimi efektiv i sistemit të peticionit individual, i vendosur me nenin 25 të Konventës ((tani ky është neni 35), që parashtruesit, apo parashtruesit potencial të ankesës, të kenë mundësi të komunikojnë lirisht me Komisionin (tani, Gjykatën), pa iu nënshtruar asnjë forme të presionit nga ana e pushtetit, që të heqin dorë, apo ta modifikojnë ankesën e tyre.

Në këtë rast, parashtruesit e ankesës ishin marrë në pyetje nga policia lidhur me ankesën që ia kishin parashtruar autoriteteve të Strasburg-ut, madje në disa raste, marrja në pyetje edhe ishte filmuar. Nga ata ishte kërkuar që të nënshkruajnë deklarata me të cilat mohohet se i kishin parashtruar ankesë Gjykatës. Gjykata konkludoi se me atë rast ishte shkelur neni 34, pa marrë parasysh faktin se parashtruesit e ankesës ia kishin arritur t'i drejtohen Gjykatës përkundër sjelljes së atillë të pushtetarëve turq. Megjithëkëtë, në rastin Aydin v. Turkey, Gjykata ka theksuar nevojën për provë konkrete dhe të pavarur për përzierjen e pushtetit. (Komisioni kishte vendosur se ekzistonte shkelje e nenit 34 në bazë të faktit se pushtetarët turq nuk ia kanë arritur që të sigurojnë asnjë arsyetim të besueshëm për kontaktet që i kishin bërë me parashtruesen e ankesës dhe anëtarët e familjes së saj.) Me këtë rast, Komisioni kishte marrë vendim se në ato rrethana nuk ekzistonte evidencë e mjaftueshme për të lejuar mundësinë që të konkludohet se:

pushtetarët e kanë kërcënuar, apo shqetësuar parashtruesin e ankesës, apo anëtarët e familjes së saj në rrethanat që ne i kemi shqyrtuar, për t'a shtrënguar atë që të heq dorë, apo që ta modifikon ankesën, apo në ndonjë mënyrë tjetër janë përzier në të ushtruarit e të drejtës së saj në peticion individual.

Në rastin Cruz Varas v. Suedisë, Gjykata ka marrë vendim që mospasja e pushtetarëve që të veprojnë në përputhshmëri me Rregullën 39 të indicies, nuk mund të barazohet me shkelje të nenit 34. (Rregulla 39 përcakton se Gjykata, apo kur është më e përshtatshme, Kryetari i saj, mund t'iu përcakton palëve cilëndo masë të përkohshme, miratimi i të cilës duket i dëshirueshëm për interesin e palëve, apo për mbarëvajtjen e rregullt të procedurës.)

4.2 RATIONE PERSONAE -

- Kush kundër kujt mund të parashtrij ankesë?

i) Parashtruesi i ankesës.- Sipas Konventës, ankesat mund të parashtrihen nga “cilido person, organizatë joqeveritare, ose grup individësh” që paraqet se është viktimë e shkeljes. (Neni 34 i Konventës)

Kjo do të thotë se Konventa i përfshinë personat fizik, përfshirë këtu fëmijët dhe personat e tjerë pa zotësi për të vepruar (Rasti X and Y v. Holanda), pa marrë parasysh se a përfaqësohen nga prindërit e tyre, ose grupet e njerëzve, personat juridik siç janë kompanitë (rasti The Sunday Times v. Mbretëria e Bashkuar), organizatat joqeveritare (rasti Open Door and Dublin Well Woman v. Irlanda), institucionet fetare (rasti Canea Catholic Church v. Greqia) dhe partitë politike (Rasti Liberal Party v. Mbretëria e Bashkuar). Shumë nga vendimet kyçe të Komisionit dhe të Gjykatës kane qenë dhe janë rezultat i rasteve të inicjuara nga kompanitë komerciale lidhur me veprimtaritë e tyre komerciale.

Për të filluar procedurën para Gjykatës, individët, apo personat juridik nuk është e domosdoshme të jenë shtetas të ndonjë shteti antar të Këshillit të Evropës (rasti Ahmed v. Austria). Megjithatë, kjo mund të jetë me rëndësi lidhur me të drejtat e tyre substanciale sipas nenit 1 të Protokollit 1 (rasti Gasus Dossier- Und Fördertechnik GmbH v. Holanda). Ata nuk është e domosdoshme të jenë themeluar (është fjala këtu për personat juridik), apo të jenë banorë në territorin e tij, madje as të jenë fizikisht prezent atje. Madje, nuk është e domosdoshme që t’ a kenë vizituar atë shtet ndonjëherë. Nëse janë prezent, nuk është e domosdoshme të jenë prezent në mënyrë të ligjshme, sipas të drejtës nacionale (rasti D. V. Mbretëria e Bashkuar).

Parashtruesit e ankesës nuk mund të jenë anonim, por ata kanë të drejtë të kërkojnë që emri i tyre të mbetet në konfidencë, megjithëqë duhet t’ i zbulohen shtetit kundër të cilit bëhet ankesa.

Ankesat nuk mund të bëhen nga organet e pushtetit komunal, siq janë komunitat, ose nga krijesat e tjera shtetërore. Çështja se çka e përbën një organizatë shtetërore nuk është gjithmonë e qartë. Në rastin Holy Monasteries v. Greqia është vendosur se pasi që parashtruesit e ankesës nuk e kanë ushtruar pushtetin shtetëror, ata nuk mund të konsiderohen si krijesa shtetërore. Me atë rast Gjykata kishte gjykuar se ata ishin nën mbikëqyrje shpirtërore të ipeshkvit lokal, e jo nën mbikëqyrje të shtetit.

ii) Parashtruesit grupor të ankesave. - Të drejtë për të parashtruar ankesë kanë edhe organizatat joqeveritare dhe grupet e individëve. Kjo i përjashton këshillat e pushtetit komunal, por nuk i përjashton politikanët në cilësi individuale, ose partitë politike (Liberal Party v. Mbretëria e Bashkuar dhe rasti The United Communist Party of Turkey and Others v. Turqia).

Konventa nuk e njih akcio popularis, do të thotë ankesën e parashtruar nga personat e interesuar që nuk janë vet viktimë e shkeljes (X. v. Austria). Si rrjedhojë, organizatat joqeveritare, ose grupet e individëve nuk mund të parashtrij ankesë, thjeshtë për të kontestuar një veprim konkret të ndërmarrë nga shteti, si çështje të tyre primore.

Rregulla 45 (2) kërkon që ankesat e parashtruara nga organizatat joqeveritare, ose grupet e individëve të jenë të nënshkruara nga personat e autorizuar për ta përfaqësuar organizatën, ose grupin. Në rastet kur grupi nuk ka bazë juridike (pra, kur nuk ka cilësi të personit juridik), Gjykata kërkon që ankesa të jetë e nënshkruar nga të gjithë anëtarët.

Nëse një shoqatë profesionale parashtron ankesë në emër të anëtarëve të saj (pra jo si viktimë e shkeljes së të drejtave të saj), ajo duhet të identifikoj anëtarët viktimë të shkeljes dhe duhet të paraqes vërtetim që është e autorizuar t'i përfaqësoj ata. Nëse nuk ia arrin që të identifikon anëtarët, ankesa do të konsiderohet anonime dhe do të hidhet poshtë.

Organizatat sindikale dhe organizatat joqeveritare nuk mund të parashtrojnë ankesa në emër të anëtarëve të vet, por ato mund të parashtrojnë ankesa kundër veprimeve ndaj sindikatës (rasti *Swedish Engine Drivers' Union v. Suedia*), apo vet organizatës. Kuptohet, ato kanë mundësi që t'i përfaqësojnë anëtarët e vet.

iii) Viktima. - Neni 34 përcakton që parashtruesi i ankesës domosdo duhet të argumentoj se është “viktimë e shkeljes”. Ekzistojnë tri lloj viktimash: aktuale, potenciale dhe indirekte.

Viktimat aktuale.- Viktimë aktuale është ai person që tashmë është afektuar nga shkelja e pohuar. Me këtë rast nuk është e domosdoshme që të paraqiten fakte për dëmin e shkaktuar. Kjo çështje ka të bëjë me nenin 41.

Në rastin *Modinos v. Qipro*, vet ekzistenca e ligjeve që ndalojnë aktet seksuale homoseksuale midis personave madhor me pëlqimin e tyre, është konkluduar si fakt që e bën parashtruesin e ankesës viktimë, edhe pse ai ende nuk ishte ndjekur konform ligjit, dhe se qeveria e kishte bërë të qartë se nuk do të përdorë atë ligj.

Viktimat potenciale.- Viktimë potenciale është ajo që është në rrezik të jetë drejtpërdrejtë e afektuar nga një ligj, apo akt administrativ. Raste klasike janë rastet e individëve që janë të kërcënuar të përjashtohen nga vendi nga ana e autoriteteve të emigracionit, veprime këto që ende nuk janë ndërmarrë. Raste të tjera janë p.sh. dispozitat e ligjeve të sukcesionit që kanë të bëjnë me fëmijët jolegjitim që ende nuk janë në gjendje të trashëgojnë, ose legjislacioni që lejon dënime fizike të fëmijës i cili në të vërtetë nuk është dënuar. (Rasti *Campbell And Cosans v. Mbretëria e Bashkuar*).

Viktimat indirekte.- Viktimë indirekte është ajo që drejtpërdrejtë afektohet nga shkelja që drejtpërdrejtë i bëhet një personi tjetër. P.sh. anëtarët e familjes të ndonjë personi të burgosur, të deportuar, apo të vvarë. (Rasti *Abdulaziz, Cabales and Balkandali v. Mbretëria e Bashkuar*).

4.3 Pala kundër të cilës parashtrohet ankesa

Palë të konventës janë vetëm shtetet, ndaj vetëm shtetet palë të konventës mund të bëjnë shkelje. Në rastet kur një sërë organesh shtetërore janë përgjegjës për shkelje, nuk është e domosdoshme që të identifikohet se cili nivel i shtetit është përgjegjës, për t'u përmbushur kjo kërkesë. (Rasti *Foti and Others v. Italia*).

Ankesat nuk mund të parashtrohen lidhur me sjelljen e personave, apo institucioneve private dhe Gjykata vazhdimisht e përsëritë faktin se ajo nuk është “gjykatë e shkallës së katërt,” pra nuk mund të veproj si gjykatë e apelit ndaj vendimeve të gjykatave nacionale (rasti Winterwerp v. Holanda). Megjithatë, kjo nuk do të thotë se veprimet, apo mosveprimet e aktorëve jo- shtetëror janë plotësisht jashtë fushëveprimit të jurisdikcionit të Konventës. Shtetet duhet që të sigurojnë që liritë dhe të drejtat e mbrojtura me Konventë janë të garantuara në mënyrë efektive (rasti Young, James and Webster v. Mbretëria e Bashkuar). P.sh. në rastin Plattform Ärzte für das Leben v. Austria, Gjykata ka vendosur që shtetet domosdo duhet të ndërmarrin masa të përshtatshme për t’i mbrojtur demonstruesit nga ndërhyrja e personave privat që kanë për qëllim që të prishin mbarëvajtjen e demonstratave.

4.4 RATIONE TEMPORIS

-Kufizimet kohore me rastin eparashtrimit të ankesave

Sipas nenit 35, ankesat duhet të parashtrohen brenda gjashtë muajsh nga vendimi përfundimtar i marrë nga autoriteti nacional.

Gjykata mund t’i shqyrton vetëm ankesat që pohojnë se shteti i ka shkelur obligimet e veta të përcaktuara me Konventë. Shtetet mund të trajtohen përgjegjëse vetëm për shkeljet që janë bërë pasi që ato i kanë ndërmarrë këto obligime, do të thotë, pasi që e kanë ratifikuar Konventën.

4.5 RATIONE LOCI

-Vendi ku është bërë shkelja

Shtetet mund të jenë përgjegjëse vetëm për shkeljet që bëhen brenda jurisdikcionit të tyre. Gjithçka që ndodhë në territorin e tyre normalisht që ndodhë brenda jurisdikcionit të tyre. Mirëpo, të gjitha ngjarjet që ndodhin jashtë territorit të tyre nuk janë automatikisht jashtë jurisdikcionit të tyre. Në rastin Piermont v. Franca, Gjykata ka vendosur që nuk kishte ndodhur shkelje e nenit 2 të Protokollit 4, meqenëse Polinezia Frënge duhet shikuar si territor i veçantë sipas nenit 5 (4) të Protokollit 4. Komisioni kishte vendosur se përjashtimi i një individi nga ambasada nuk përbën shkelje të nenit 3 të Protokollit 4, meqenëse ambasada nuk konsiderohet “territor” sipas qëllimeve të asaj dispozite (rasti V. v. Danimarka), derisa refuzimi i vizës nga ana e zyrës diplomatike jashtë vendit është çështje mbrenda jurisdikcionit të shtetit (rasti Amkrane v. Mbretëria e Bashkuar).

Test vendimtar për jurisdikcionin është fakti se a ushtron, apo jo shteti de facto kontroll mbi ngjarjet në pyetje. Në rastin Loizidou v. Turqia, Gjykata ka vendosur që Turqia mund të ushtronte kontroll efektiv mbi rajonin e Qipros veriore, dhe prandaj mund të jetë përgjegjëse për shkeljet që atje janë bërë, përkundër faktit se ai territor ishte jashtë territorit shtetëror turk.

4.6 RATIONE MATERIAE

- Lidhur me Çka mund të parashtrohet ankesa?

Që nga momenti kur Protokoll 11 ka hyrë në fuqi, shtetet nuk kanë më mundësi që të përjashtojnë të drejtën e individit që të parashtror ankesë lidhur me cilindo protokoll që ato e kanë ratifikuar. Sipas sistemit të vjetër, një gjë e këtillë nuk ishte e garantuar.

Gjykata mund t'i shqyrtoj vetëm ankesat lidhur me liritë dhe të drejtat që i përfshinë Konventa. Meqenëse Gjykata nuk mund ti gjykoj çështjet që janë plotësisht jashtë sferës së Konventës, është me rëndësi që të studiohet me vëmendje Kapitulli 12, në mënyrë që të vendoset nëse çështja për të cilën parashtrohet ankesa është e arsyeshme.

4.7 SHTERRJA E MJETEVE JURIDIKE VENDORE

Harxhimi i mjeteve juridike vendore është një ndër aspektet më të rëndësishme procedurale. Sipas nenit 1 të Konventës, shtetet janë të obliguara që të sigurojnë liritë dhe të drejtat e përcaktuara me të për çdo person brenda jurisdikcionit të vet. Ky obligim përfshinë detyrën që të ekziston baza juridike për t'i siguruar ato të drejta. Ky obligim fundamental i përcaktuar me nenin 1 është i ngritur në nivel më të lartë me nenin 13 që kërkon që “çdokujt që liritë dhe të drejtat e përcaktuara me këtë konventë i shkelen, do të ketë mundësi të parashtrimit të mjeteve juridike para organeve të pushtetit nacional...”. Me këto dispozita nënvizohet se përgjegjësia parësore për sigurimin e këtyre të drejtave qëndron mbi institucionet shtetërore. Roli i Gjykatës Evropiane është vetëm që të intervenoj në rast se shteti palë i Konventës dështon që t'a bëjë këtë gjë.

Nga kjo rrjedhë se ankesat nuk duhet t'i parashtrohen gjykatës para se të shtjerrën të gjitha mjetet juridike të brendshme.

4.8 KONVENTA EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT DHE OPERACIONET NDËRKOMBËTARE PAQËSORE

-Vendimi për Pranueshmërinë e Rasteve Behrami dhe Behrami Kundër Francës dhe Saramati Kundër Francës, Gjermanisë dhe Norvegjisë

Me datën 2 maj 2007, Gjykata, me shumicë votash, ka deklaruar se ankesa e Behrami dhe Behrami, si dhe ajo Saramati kundër Francës dhe Norvegjisë janë të papranueshme. Shtetet respondente e kundërshtuan jurisdikcionin *ratione loci* duke argumentuar, përveç tjerash, se ankuesit nuk ishin banorë të “hapësirës juridike” të Konventës. Siç ishte theksuar nga Gjykata, Neni 1 i Konventës kërkon nga palët kontraktuese që të garantojnë të drejtat e përcaktuara me Konventë për individët që janë nën jurisdikcionin e tyre, e që është parësisht jurisdikcion territorial. Sipas vlerësimit të Gjykatës, nocioni i “jurisdikcionit personal”, ose *ratione personae* ishte çështje që duhej shqyrtuar. Megjithatë, sipas vlerësimit të Gjykatës, çështja e jurisdikcionit ekstraterritorial ishte çështje marginale, duke argumentuar se çështje thelbësore në të vërtetë ishte se a është kompetencë e Gjykatës të vlerësojë në bazë të Konventës kontributin e shteteve në prezencat civile dhe të sigurisë të mbështetura nga Këshilli i Sigurimit.

Rasti Behrami kishte të bënte me veprimet e UNMIK-ut dhe të KFOR-it në Komunën e Mitrovicës në mars të vitit 2000. Derisa luanin, fëmijët gjetën disa bomba të padetonuara, të cilat kishin mbetur nga bombardimet e NATO-s të vitit 1999. Në mesin e fëmijëve ishin dy fëmijët e Agim Behramit, Gadafi dhe Bekimi. Kur njëra nga njësitet e bombave eksploduan, Gadafi u vra, derisa Bekimi mori lëndime të rënda dhe mbet përgjithmonë i verbër. Ankeas e parashtruar Gjykatës ishte bazuar në nenin 2 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, duke argumentuar se trupat franceze të KFOR-it kishin dështuar t'i shënojnë dhe/ose t'i neutralizojnë bombat për të cilat ishin në dijeni se gjendeshin në atë vend.

Rasti Saramati kishte të bënte me një Kosovar që ishte arrestuar në prill të vitit 2001 në bazë të dyshimit për tentim vrasjeje dhe posedimit të jashtëligjshëm të armës. Ai ishte liruar në qershor, por ishte arrestuar përsëri në korrik. Periudha e paraburgimit të tij vazhdimisht ishte zgjatuar nga Komandanti i KFOR-it, derisa ishte akuzuar më në fund në janar të vitit

2002. Ankesa e tij ishte bazuar në Nenin 5 të Konventës, në nenin 5 lidhur me nenin 13, si dhe në nenin 6, meqenëse thirrej në faktin se ishte paraburgosur në mënyrë jashtëgjyqësore dhe pa të drejtë qasje në gjykatë. Ankesa ishte bërë kundër Francës dhe Norvegjisë, sepse Komandantët e KFOR-it që kishin lëshuar urdhër të paraburgimit, ishin oficer norvegjez dhe francez.

Rastet Behrami dhe Saramati ishin rastet e para me të cilat është ballafaquar Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut dhe të cilat kishin të bënin me ankesat kundër prezencës ndërkombëtare të sigurisë. Gjykata vendosi ti konsiderojë ankesat të papranueshme, në bazë të mungesës së kompetencës racione personae për të shqyrtuar nëse sjellja e prezencës ndërkombëtare të sigurisë ishte në përputhshmëri me dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Duhet theksuar, se një vendim i këtillë i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut do të ketë implikime serioze në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në operacionet paqësore. Shumë autorë të respektuar të së drejtës ndërkombëtare kanë shprehur shqetësim se vendimi për papranueshmërinë e këtyre rasteve, mund ta degradojë rëndësinë e Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut dhe ta bëjë irrelevante në operacionet ndërkombëtare paqësore.

■ TË DREJTAT E MBROJTURA ME KONVENTË DHE ME PROTOKOLET E KONVENTËS

1. OBLIGIMET NEGATIVE DHE POZITIVE TË SHTETEVE

Neni 1 përcakton se shtetet do t'ia sigurojnë secilit brenda jurisdikcionit të vet të drejtat dhe liritë e përcaktuara me Konventë. Edhe pse shkelja e nenit 1 nuk mund të jetë bazë për t'iu ankuar Gjykatës Evropiane, ky nen duhet të shqyrtohet në hollësi me rastin e çdo ankese, meqenëse me këtë nen iu përcaktohen shteteve obligime negative dhe pozitive. Shteteve iu ndaloheq që të ndërhyjnë në të drejtat dhe liritë e mbrojtura, përveq në rastet kur vet Konventa e lejon një gjë të tillë. Megjithatë, disa të drejta, siq janë ato të përcaktuara me nenin 3, janë absolute, dhe shtetet në asnjë rrethanë nuk kanë të drejtë të përdorin torturën, ose ndëshkimet a trajtimet çnjerëzore apo poshtëruese, nëpërmes të asnjë organi shtetëror. Disa të drejta dhe liri të tjera mund të kufizohen dhe një veprim i tillë të arsyeohet, por barra mbetet në shtetin për të arsyetuar një kufizim të tillë. P.sh. sipas nenit 8, shteti nuk mund të ndërhyjë në jetën e familjes dhe se secila ndërhyrje automatikisht do të konsiderohet shkelje e Konventës, nëse nuk arsyetohet sipas nenit 8, paragrafit 2.

Për Gjykatën Evropiane është joqenësore se cili organ shtetëror ka bërë shkelje të Konventës. Nëse del nga legjislacioni i brendshëm se institucioni i paditur është institucion shtetëror, për veprimet e atij institucioni është automatikisht përgjegjës shteti.

Nëse shteti është i obliguar që të siguron ndonjë gjë, siq është p.sh. arsimimi sipas Protokollit 1, neni 2, ai nuk mund të lirohet nga ky obligim duke ia deleguar këtë obligim ndonjë institucioni privat. Prandaj, ai mbetet drejtpërdrejtë përgjegjës për sjelljet e institucionit privat dhe shkeljet e mundshme Konventës me përdorimin e masave të caktuara disiplinore në shkolla private (rasti Costello-Roberts v. Mbretëria e Bashkuar.

Përgjegjësitë e shtetit sipas nenit 1 nuk kanë për qëllim vetëm që t'a obligojnë shtetin të përmbahet nga ndërhyrja në jetën private dhe familjare të personit. Në rastin Marckx v. Belgjika, Gjykata kishte vendosur që përveq këtij obligimi parësor negativ, ekzistojnë edhe obligime pozitive të natyrshme për respektimin efektiv të jetës familjare. Në atë rast kjo do të thoshte se mungesa e njohjes së barazisë së plotë të fëmijës së lindur nga prindër të pamartuar nga ana e legjislacionit belg, ishte shkelje e nenit 8.

Neni 1 i obligon shtetet që të sigurojnë që ligjet e tyre të cilat mundësojnë sjellje që mund të shkaktojnë shkelje të Konventës, të shpallen të paligjshme. Në rastin Young James and Webster v. Mbretëria e Bashkuar, Gjykata kishte marrë vendim që ishte bërë shkelje e nenit 11 i cili përcaktonte të drejtën për të mos iu bashkuar sindikatave, nëse ligji lejonte përjashtim nga puna për një refuzim të tillë. Shteti ishte përgjegjës për faktin se ligji i tij i brendshëm e konsideronte të ligjshëm përjashtimin e atillë nga puna.

Se a kërkon neni 1 që një sjellje e tillë e paligjshme të konsiderohet shkelje civile apo penale, varet nga natyra e rastit.

Në rastin X. & Y. v. Holanda, Gjykata ka vendosur që sanksioni civil ishte i pamjaftueshëm për t'i mbrojtur të drejtat e e personit të moshës madhore me të meta nervore që kishte qenë viktimë e sulmit seksual.

Obligimi pozitiv që të sigurohet që të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Konventë i gëzojnë të gjithë personat brenda jurisdikcionit të shtetit nuk plotësohet vetëm duke siguruar që legjislativi i brendshëm është në përputhshmëri me Konventën. Ky obligim konsiston edhe në atë që shteti të siguroj që individët të kenë qasje efektive në gjykatë nëse të drejtat dhe liritë e tyre kontestohen, e në raste të caktuara, individëve duhet t'u sigurohet edhe ndihma juridike nëse është e domosdoshme.

Megjithatë, në përgjithësi, shteti nuk mund të konsiderohet përgjegjës për aktet e individëve privat. Një vrasje, apo plaçkitje e paparashikuar, e bërë nga ndonjë kriminel nuk mund t'a bëjë shtetin të përgjigjet në bazë të nenit 2, ose 8, ose të nenit 1 të Protokollit 1. Por, shteti duhet të ndërmerret të gjitha masat e duhura për të siguruar që individët privat të mos i shkelin të drejtat e mbrojtura të të tjerëve. Në rastin Plattform Ärzte für das Leben v. Austria, Gjykata kishte vendosur që shteti domosdo duhet që të ndërmerret hapa të nevojshëm në mënyrë që të pengoj demonstruesit kundërshtarë të ndërhyjnë në demonstrata paqësore. Në rastin Osman v. Mbretëria e Bashkuar, Komisioni kishte vendosur që shteti e ka për obligim të ndërmerret masa të përshtatshme për të mbrojtur fëmijën në rrezik nga mësuesi me çrregullime mentale, si dhe në rastin K.L. and Others v. Mbretëria e Bashkuar, Komisioni kishte vendosur që t'a pranoj rastin nën nenin 3 dhe që kishte të bënte me dështimin e pushtetit lokal për të mbrojtur fëmijët e keqtrajtuar nga prindërit e tyre.

2. E DREJTA NË JETË

Neni 2 i përcakton obligim pozitiv shtetit që të mbrojë të drejtën në jetë dhe gjithashtu e siguron listën e plotë të situatave kur vrasja mund të lejohet. Me fjalë të tjera, me këtë nen individ mbrohet nga marrja arbitrare e jetës nga ana e shtetit, por me këtë nen nuk vihet jashtë ligjit dënimi gjyqësor me vdekje. Për ta përmirësuar këtë gjë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës në vitin 1985 e ka miratuar Protokollin Nr. 6 me të cilin anulohet dënimi me vdekje në kohë të paqes. Asambleja parlamentare vazhdon që të paraqet propozime për ndalim të plotë të dënimit me vdekje si në kohë paqeje, edhe në kohë të luftës.

Gjykata Evropiane i ka pranuar disa ankesa që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtës në jetë, sipas Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Shembujt më të këqij të marrjes së paarsyeshme të jetës paraqiten gjatë kohës së luftës dhe gjatë trazirave qytetare, dhe në të kaluarën kanë shkaktuar konteste gjyqësore ndërshtetërore nën Konventën Evropiane. Në rastin gjyqësor të filluar nga Qiproja kundër Turqisë pas intervenimit turk në pjesën veriore të Qipros në korrik dhe gusht të vitit 1974, Komisioni kishte vendosur që atje ishin bërë vrasje të paligjshme të shkallës së gjerë, vendim ky që ishte mbështetur rezervë nga Komiteti i Ministrave. Në rastin tjetër gjyqësor

McCann and others v. Mbretëria e Bashkuar, Gjykata kishte vendosur se vrasja e tre terroristëve, anëtarë të IRA, të dyshuar në pjesëmarrje në misionin e vendosjes së një bombe, paraqet marrje të paarsyeshme të jetës. Derisa Gjykata kishte refuzuar padinë se vrasjet ishin të paramenduara, ajo e kishte kritikuar kontrollin dhe organizimin e veprimit të forcave të sigurimit.

3. NDALIMI I TORTURËS DHE I NDËSHKOMEVE A TRAJTIMEVE ÇNJERËZORE DHE POSHTËRUESE

Neni 3 me të cilin ndalohet tortura dhe ndëshkimet dhe trajtimet çnjerëzore dhe poshtëruese, paraqet të drejtë të patjetërsueshme sipas Nenit 15 të Konventës. Sikurse edhe nenin 2, Gjykata në një nga aktgjykimet e saj (rasti Ahmed v. Austria) kishte konsideruar se “ky nen ruan një ndër vlerat themelore të shoqërive demokratike të Këshillit të Evropës, ndaj duhet të interpretohet në mënyrë precize. Ndërsa tortura dhe trajtimi çnjerëzor nënkuptojnë sulm fizik dhe dhunë të panevojshme, trajtimi poshtërues nënkupton sjelljen që ka për qëllim që ta bëjë viktimën të vuaj dhe të poshtërohet.

Në rastin gjyqësor Ireland v. Mbretëria e Bashkuar, Gjykata kishte vendosur se keqtrajtimi domosdo duhet të:

përmbajë së paku një shkallë minimale mizorie në mënyrë që të përfshihet me nenin 3. Nga natyra e gjërave, vlerësimi i këtij minimumi është shumë relativ: varet nga rrethanat e rastit, si kohëzgjatja e trajtimit, efektet e tij fizike dhe psikike, ndërsa në disa raste edhe nga gjinia, mosha dhe gjendja shëndetësore e viktimës.

Më tutje, Gjykata i kishte definuar këto tri kategori të keqtrajtimit:

Tortura: Trajtim i paramenduar çnjerëzor që shkakton vuajtje serioze dhe mizore.

Trajtimi çnjerëzor: Trajtim që shkakton vuajtje fizike dhe mentale.

Trajtimi poshtërues: Trajtim që i ngjall viktimës ndjenjë të frikës, ankthit dhe të inferioritetit, që eposhtëron viktimën dhe mund të shkatërron rezistencën fizike dhe morale të viktimës.

Sa i përket ndëshkimit trupor, Gjykata ka vendosur që ndëshkimi trupor si pjesë e dënimit penal është i barabartë me ndëshkimin poshtërues, ndaj edhe me të bëhet shkelje e Nenit 3.

a) *Kushtet gjatë mbajtjes në burg*

Neni 3 paraqet obligim shume më të madh për shtetet sa i përket të burgosurve, se sa vetëm thjeshtë përmbajtja nga ndëshkimi fizik. Edhe në rastet kur të burgosurit janë totalisht jokooperativ, shteti nuk lirohet nga obligimi i vet nga neni 3. Përveç kësaj, shtetet e kanë për detyrë që në mënyrë kontinuele të shqyrtojnë përgatitjen dhe organizimin e burgjeve, në mënyrë që të sigurojnë shëndetin dhe mirëqenien e të burgosurve, në pajtim me “kërkesat e rregullta dhe të arsyeshme të mbajtjes në burg”.

Gjykata është treguar e aftë që të dënojë në mënyrë të drejtpërdrejtë sjelljen e policisë nacionale, në rastet kur të burgosurit janë ankuar për keqtrajtim. Në rastin Ribitsch v. Austria, parashtruesi i ankesës kishte argumentuar që ishte goditur nga policia derisa mbahej në paraburgim, në mënyrë që të shtrëngohej të pranoj veprën për të cilën ishte akuzuar. Qeveria nuk kishte kontestuar se z. Ribitsch i kishte marrë plagët derisa ishte në paraburgim. Në këtë rast, Gjykata kishte konkluduar se ishin shkelur të drejtat e parashtruesit të ankesës konform nenit 3, meqenëse qeveria e Austrisë nuk kishte qenë në gjendje që të siguroj asnjë arsytim bindës për plagët që i kishte marrë parashtruesi i ankesës. Gjykata kishte theksuar që:

Sa i përket personit të privuar nga liria, çdo përdorim i forcës fizike që nuk ishte bërë në mënyrë strikte i domosdoshëm për shkak të sjelljes së tij, e cenon dinjitetin njerëzor dhe në parim është shkelje e të drejtës së paraparë me nenin 3 të Konventës.

4. E DREJTA NË LIRI DHE SIGURI TË PERSONIT

Kjo e drejtë është e mbrojtur me nenin 5 të Konventës. Rastet më të hershme të paraqitura në Strasburg, kishin të bënin me mbrojtjen e të drejtës në liri dhe siguri. Nga 10.000 rastet e para, gati një e treta vinin nga individët e privuar nga liria. Neni 5 ka të bëjë me mbrojtjen e lirisë fizike dhe në veçanti me lirinë nga arresti, apo ndalimi (burgosja arbitrare). Me këtë dispozitë garantohej të drejtat e caktuara procedurale, si e drejta për t’u informuar menjëherë për arsyen e arrestit, e drejtën për të dalë para gjyqtarit pa vonesë, si dhe e drejta në procedurë nëpërmes të cilës gjykata me shpejtësi mund të vendoset për ligjshmërinë e arrestit, ndalimit (burgosjes), apo vazhdimit të ndalimit.

Komiteti për parandalimin e torturës, gjatë vizitave që iu bënë shteteve, nuk ka hezituuar asnjëherë që t’i thekson këto të drejta procedurale, jo vetëm sa i përket mbrojtjes juridike, apo mungesës së kësaj mbrojtjeje, por edhe sa i përket zbatimin e ligjit në praktikë.

Shembujt e rasteve më të rëndësishme të vendosura sipas nenit 5 janë këto në vijim:

- **BOZANO V. FRANCE, 1986.**- Sipas vendimit të Gjykatës, rrethanat nën të cilat është bërë arresti dhe deportimi i ankuesit nga Franca në Zvicër, e bëjnë arrestin të paligjshëm dhe në kundërshtim me të drejtën në siguri të personit.
- **BROGAN AND OTHERS V. THE UNITED KINGDOM, 1988.** - Sipas vendimit të Gjykatës, mbajtja e parashtruesit të ankesës, sipas legjislacionit mbi parandalimin e terrorizmit për periudhën që i tejkalon 4 ditë, pa vendosur fare për ligjshmërinë e ndalimit, e shkelë të drejtën e personit që pa vonesë dhe menjëherë të merret në pyetje nga gjyqtari.
- **DE WILDE, OOMS AND VERSYP V. Belgjika, 1970/71.** - Sipas vendimit të gjykatës, procedura që i ishte lejuar parashtruesve të ankesës për të kontestuar ligjshmërinë e ndalimit të tyre, nuk i kishte mundësuar atyre që si duhet dhe me te gjithat garancitë e nevojshme t'i përdornin mjetet juridike të nevojshme për ta kontestuar privimin e tyre të gjatë nga liria, prej shtatë muajsh, deri në një vit e nëntë muaj.

5. E DREJTA NË GJYKIM TË DREJTË DHE TË PAANSHËM

E drejta në gjykim të drejtë dhe të paanshëm, si në procedurë civile, ashtu edhe në atë penale, është e garantuar me nenin 6 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut. Është kjo e drejta për shkeljen e të cilës parashtruesit e ankesës para Gjykatës Evropiane më së shumti thirren.

Koncepti i gjykimit të drejtë dhe të paanshëm përbëhet nga shumë elemente. Esenca e kësaj të drejtë qëndron në “gjykimin e drejtë, të paanshëm dhe publik, mbrenda kohës së arsyeshme dhe nga ana e gjykatës së pavarur dhe të paanshme, të ndërtuar me ligj.”

Neni 6 gjithashtu përmban:

- parimin e supozimit të pafajësisë derisa të vërtetohet me prova fajësia,
- të drejtën e të pandehurit të disponoj me kohë dhe mjete adekuate për t'a përgatitur mbrojtjen,
- të drejtën që të mbrohet personalisht, ose të ketë ndihmë juridike,
- të drejtën që të ftoj dëshmitarë, si dhe
- pa pagesë të gëzoj ndihmën e përkthyesit nëse është e nevojshme.

Çështje e rëndësishme për Komisionin dhe për Gjykatën, që nga fillimi i punës ka qenë kohëzgjatja e procedurës civile dhe penale e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Një numër shumë i madh vendimesh kundër shteteve anëtare, kishte të bënte më çështjen e kohëzgjatjes së procedurave. Me këtë rast është me rëndësi të përmendet Italia, si një vend që për të ndalur fluksin e ankesave para Këshillit Evropian lidhur me kohëzgjatjen e procedurës, është dashur që të shqyrtoj një numër dispozitash të Kodit të procedurës civile dhe të Kodit të procedurës penale.

Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut siguron mbrojtje të mëtutjeshme të rëndësishme për çështjen e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm. Neni 13 parashikon të

drejtën në mjet efektiv juridik për shkeljet e paraqitura të Konventës. Në fakt, nëse nuk ekziston mundësia për mjet efektiv juridik në të drejtën e mbrendshme, kjo gjë mjafton që të konsiderohet se ekziston shkelje e Konventës. Shteti kontraktues i Konventës Evropiane domosdo duhet që të siguroj mundësinë e shfrytëzimit të mjeteve juridike efektive për shkeljet e pohuara të konventës.

Të drejtat e tjera që janë të lidhura me çështjen e gjykimit të drejtë janë këto në vijim:

- Neni 7 -- liria nga legjislacioni penal retroaktiv,
- Protokoli Nr. 7, neni 2 -- e drejta e ankesës në çështjet penale,
- Protokollin Nr. 7, neni 3 -- kompensimi për dënimin e gabueshëm dhe
- Protokollin Nr. 7, neni 4 -- e drejta që të mos gjykohet, ose të dënohet personi dy herë për veprën e njëjtë penale

këto:

Shembujt më të rëndësishëm të rasteve të vendosura sipas nenit 6 janë

KÖNIG V. GERMANY, 1978 – Gjykata mori vendim lidhur me shkeljet që kishin të bënin me kohëzgjatjen e procedurës në kontestin për heqjen e të drejtës në udhëheqje të klinikës dhe të ushtrimit të profesionit të mjekut, procedurë që kishte zgjatur gati 10 vjet në të njëjtën shkallë.

MILASI V. ITALIA, 1987 – Kontesti kishte të bënte me kohëzgjatjen e procedurës penale prej dhjetë vjetësh në të njëjtën shkallë.

AIREY V. IRLANDA, 1979 – Gjykata kishte marrë vendim që parashtruesit të ankesës iu kishte mohuar e drejta në qasje efektive gjykatës, meqenëse asaj nuk i ishte siguruar ndihma e avokatit në procedurën e ndarjes, atëherë kur kjo gjë ishte më se e nevojshme.

ALLENET DE RIBEMONT, 1995 – Me aktgjykim, gjykata mori vendim që disa deklarata publike të bëra nga Ministri i punëve të brendshme dhe nga disa zyrtarë të lartë të policisë rreth fajësisë së parashtruesit të ankesës, derisa ai ishte ndaluar, ishin shkelje e parimit të supozimit të pafajësisë.

6. LIRIA E SHPREHJES, MENDIMIT, E NDËRGJEGJËS DHE E RELIGJIONIT

Liria e shprehjes, e mbrojtur me nenin 10 të Konventës konsiderohet si një ndër shtyllat e demokracisë. Ajo është kusht qenësor për gëzimin e shumë lirive dhe të drejtave të tjera dhe është shprehje e realizimit të lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe religjionit, liri këto të mbrojtura me nenin 9. Në aktgjykimin e rastit *Handyside v. Mbretëria e Bashkuar*, të vitit 1976, Gjykata evropiane kështu e definon lirinë e shprehjes: “Liria e shprehjes u referohet jo vetëm informacioneve, apo ideve që pranohen pozitivisht ... por edhe atyre që ofendojnë, alarmojnë, ose e shqetësojnë Shtetin, ose ndonjë pjesë të popullsisë... Kjo do të thotë se çdo “formalitet, “kusht”, “restriksion,” apo dënim i përcaktuar në këtë sferë, domosdo duhet të jetë proporcional me qëllimin legjitim që dëshirohet të arrihet.

Gjykata Evropiane ka gjykuar shumë raste që kishin të bënin me këtë të drejtë. Një ndër rastet më të famshme ishte rasti *Sunday Times v. Mbretëria e Bashkuar* i vitit 1979. Ky rast kishte të bënte me ndalesën e bërë nga gjykata për t’u ndalur publikimi i një artikulli nga gazeta *Sunday Times*, derisa gjykimi ishte duke vazhduar. Artikulli kishte të bënte me zbulimin e faktit se shumë foshnje vuanin nga defekte të lindjes, meqenëse nënat e tyre gjatë shtatëzanisë kishin marrë ilaçin thalidomide. Gjykata Evropiane, kishte vendosur me aktgjykim se ndalesa e botimit ishte shkelje e lirisë së shprehjes, meqenëse artikulli i *Sunday times-it* ishte me interes publik legjitim dhe se publiku kishte të drejtë ta dijë përmbajtjen e tij, edhe pse gjykimi ishte duke vazhduar. Për shkak të këtij aktgjykimi, e drejta angleze që e rregullonte çështjen për mosbindjes së gjykatës ishte ndryshuar.

Rastet e tjera që kishin të bënin me lirinë e shprehjes përfshijnë:

- Humbjen e disa të drejtave nga fusha e lirisë së shprehjes të përcaktuara në Belgjikë për kolaboracion me forcat okupuese (*De Beckker v. BELGIKA*, 1962)
- Kritika dy gjyqtarëve porotë në Greenland, Danimarkë (*Barfod v. DANIMARKA*, 1989)
- Shpifjet ndaj nëpunësve publik në Islandë (*Thorgeir Thorgeirson v. islanda*, 1992)
- Restriksionet në dhënien e këshillave agjencioneve në Irlandë për sigurimin e informacioneve për gratë shtatzëna lidhur me mundësitë e abortit në Britani të Madhe (*Open Door and Dublin Well Woman v. IRLANDA*, 1992)
- Refuzimi u dhënës së lejes një kompanie që merrej me elektronikë që t’i shfaqë publikut një program nga një televizion i huaj, i marrë me antenë satelitore private (*Autronic AG v. Zvicra*, 1990)
- Dënimi penal për fyerjen e qeverisë për shkak të shkuarjen e një artikulli, me të cilin vëmendja e publikut është përqendruar në vrasjet dhe sulmet e bëra nga grupet e armatosura mbi qytetarët bask. Në artikull ishte pohuar që këto grupe

ishin duke vepruar pa u ndëshkuar fare dhe se qeveria ishte përgjegjëse për këtë gjë. (Castells v. Spain,1992)

Megjithatë, Konventa përcakton që liria e shprehjes përmban edhe detyra dhe përgjegjësi, dhe mund t'i nënshtrohet kufizimeve të ndryshme, “të domosdoshme për shoqërinë demokratike”. Gjykata Evropiane në mënyrë strikte i ka zbatuar këto kufizime. Për shembull, në rastin Handyside v. Mbretëria e Bashkuar, të vitit 1976, Gjykata kishte vendosur që shteti kishte pas arsye për ta ndaluar publikimin “The Little Red School Book,” një libër arsimit seksual, që konsiderohej “publikim i pahijshëm”, duke pasur parasysh efektet që mund ti kishte në lexuesit e rinj.

7. E DREJTA NË ARSIM

E drejta në arsim është përcaktuar me nenin 2 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut dhe rëndësia e kësaj të drejte është vërtetuar edhe më me aktgjykimin e rastit Kjeldsen, Busk and Pedersen v. Danimarka (1976), ku shprehimisht theksohet se “arsimi është qenësor për ruajtjen e ‘shoqërisë demokratike’...”

Në kuadër të kësaj të drejte, një ndër rastet më të njohura të vendosura nga Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut ishte Cambell and Cosans v. Mbretëria e Bashkuar,1982, që kishte të bënte me rrahjen e nxënësve shkollat shtetërore. Gjykata Evropiane, jo vetëm që kishte vendosur që rrahja ishte kundër të drejtave të prindërve që fëmijë të tyre të edukohen sipas bindjeve të tyre filozofike, por edhe kishte vendosur që përjashtimi nga shkolla i njerit prej fëmijëve që kishte refuzuar ta pranoj rrahjen, ishte shkelje e të drejtës së tij në arsim. Rezultat i këtij aktgjykimi ishte heqja e dënimit trupor në shkollat shtetërore në Britani të Madhe.

Një rast tjetër i vendosur nga Gjykata në vitin 1967, “Rasti gjuhësor i Belgjikës”, kishte të bënte me diskriminimin në mundësi të shkollimit fillor, ku fëmijët franko-folës nuk kishin mundësi të shkolloheshin në gjuhën frënge në rajonet e tjera të afërta.

Në sferën e arsimit, çështje të ndryshme janë shqyrtuar nga Këshilli i Evropës, duke përfshirë:

- Dhunën dhe zgjidhjen e konflikteve në shkolla;
- Maltretimin në shkolla;
- Edukimin për tolerancë dhe mirëkuptim reciprok;
- Historinë pa urrejtje – parandalimin që historia të keqpërdoret për të inkurajuar ndjenja të nacionalizmit antagonist dhe superioritet kulturor dhe racor
- Arsimimin për mirëkuptim ndërkulturor
- Arsimimin për vlera demokratike;
- Gjuhët moderne për komunikim.

Në këtë kontekst, Këshilli Evropian i ka miratuar një varg masash me të cilat është njohur dhe pranuar rëndësia e arsimit në shkollë dhe jashtë saj. Rëndësi veçanërisht të madhe në këtë drejtim i kushtohet punës në arsim për të drejtat e njeriut.

8. E DREJTA NË SHFRYTËZIMIN E PAPENGUAR TË PASURISË

Një prej çështjeve më të vështira me të cilën janë ballafaquar në kohë të fundit shtetet e Evropës lindore dhe qendrore është çështja e restituimit të pronës dhe nevoja që të merren parasysh kërkesat e ndryshme të të drejtës në pronësi.

Neni 1 i Protokollit Nr. 1 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut e mbron të drejtën në shfrytëzim të papenguar të pasurisë, apo të drejtën në pronësi.

Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut i ka vendosur një mori rastesh që kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të fushës së të drejtës së pronësisë. Këto në vijim janë disa nga rastet më të njohura të shqyrtuara nga Gjykata:

- Rasti **HOLY MONASTERIES V. GREQIA**, 1974 që kishte të bënte me marrjen e pronës së kishës greke dhe shndërrimin e saj në pronë shtetërore;
- Rasti **LITHGOW AND OTHERS V. MBRETËRIA E BASHKUAR**, 1986 që kishte të bënte me kompenzimin e pronarëve të aksioneve për pronën e nacionalizuar;
- Rasti **LOIZIDOU V. TURQIA**, 1995, që kishte të bënte me restriksionet në qasje ndaj pronës në Qipron Verior;
- Rasti **DARBY V. SUEDIA**, 1990, që kishte të bënte me obligimin për t'i paguar tatim kishës;
- Rasti **INZE V. AUSTRIA**, 1987, që kishte të bënte me ndarjen e një ferme fëmiut legjitim duke e diskriminuar fëmiun e lindur jashtë martesës.

9. E DREJTA NË ZGJEDHJE TË LIRA

Një ndër qëllimet qendrore të Këshillit të Evropës është që të mbroj dhe të avancoj demokracinë pluraliste. Pa zgjedhje të lira, nuk mund të ketë demokraci. Në rastin Mathieu Mohin and Clerfayt v. Belgjika e vendosur nga Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në vitin 1987, Gjykata e kishte interpretuar në këtë mënyrë të drejtën në zgjedhje të lira: “E drejta në zgjedhje të lira është e një rëndësie parësore ... meqenëse e mbron parimin karakteristik të demokracisë.”

Që të dy, Gjykata Evropiane dhe Komisioni Evropian për të drejtat e njeriut e kanë theksuar rëndësinë e mbajtjes së zgjedhjeve të lira në intervale të arsyeshme dhe me votim të fshehtë (Protokollit Nr. 1, neni 3).

■ KARTA SOCIALE E EVROPES

Karta Sociale Europiane i garanton të drejtat sociale dhe ekonomike të njeriut. Është miratuar në vitin 1961, është ndryshuar në vitin 1996 dhe ka hyrë në fuqi në vitin 1999 dhe gradualisht, si e tillë e zëvendëson traktatin e vitit 1961.

1. E DREJTA NË PUNË

Neni 1 i Kartës Sociale Evropiane përcakton se shtetet palë domosdo duhet të “pranojnë si një prej qëllimeve dhe përgjegjësive të tyre parësore, arritjen dhe ruajtjen e një niveli sa më të lartë të punësimit që është e mundur, me aspiratë që të arrihet punësim i plotë.”

Shumica e dispozitave të kësaj karte kanë për qëllim që të mbrojnë jo vetëm të drejtën në punë, duke përfshirë edhe ndihmën për ngritje profesionale, por gjithashtu edhe kushtet në të cilat njerëzit punojnë dhe nën të cilat ata janë të punësuar.

Këto përfshijnë:

- Neni 2, par. 1: Orët e arsyeshme ditore dhe javore të punës;
- Neni 2 par. 2: Festat publike me pagesë;
- Neni 2, par. 3: Pushimin vjetor me një minimum prej dy javësh;
- Neni 2, par. 5: Pushim javor;
- Neni 3: Rregulla të sigurisë dhe shëndetësisë në punë;
- Neni 3 i Protokollit shtesë: Pjesëmarrjen në përcaktimin dhe në përmirësimin e kushteve të punës dhe mjedisit të punës;
- Neni 4: Kompensim të drejtë, përfshirë të ardhurat e njëjta (për gra dhe burra), për punë të vlerës së njëjtë, shkallë më të lartë të kompensimit për punë jashtë orarit dhe të drejtë në një afat të arsyeshëm të njoftimit për ndërprerje të punësimit dhe
- Neni 1, par.4 dhe nenet 9, 10 dhe 15, par 1: Ndihmë për ngritje profesionale.

Duhet theksuar se Karta sociale evropiane parasheh edhe mbrojtje të veçantë për kategoritë e caktuara të punëtorëve që janë në pozitë më të disfavorshme dhe më të dobët në tregun e punës. Me të, mbrojtje e veçantë i është siguruar edhe fëmijëve (neni 7). Me Kartën sociale evropiane,mosha minimale për t’u pranuar në punë përcaktohet mosha 15 vjeç, dhe një moshë më e pjekur për punë që konsiderohen të rrezikshme dhe dëmshme për shëndetin. Komiteti i pavarur i ekspertëve, këtë dispozitë të Kartës e ka interpretuar në mënyrë që të kuptohet se puna nuk guxon që t’i privoj fëmijët nga shkollimi, se fëmijët gjatë periudhës së shkollimit nuk duhet të punojnë më gjatë se gjysma e pushimit shkollor dhe se numri i orëve të punës gjatë vitit shkollor duhet që të jetë i limituar në mënyrë strikte. Më tutje, Karta sociale evropiane garanton paga dhe pagesa të drejta për punëtorë të rinj dhe fillestarë në punë, të drejtë në pushim

minimal vjetor me pagese prej 3 javësh për punëtorë nën 18 vjeç, dhe ndalon, me disa përjashtime, punën e natës për punëtorë më të rinj se 18 vjeç.

Neni 15 i Kartës sociale përcakton mbrojtje të veçantë edhe për persona me aftësi të kufizuara, duke iu ndihmuar atyre që të bëhen pjesë e fuqisë punëtore nëpërmjet të trajnimit profesional dhe rehabilitimit.

Karta sociale siguron mbrojtje të veçantë edhe për nëna, në mënyrë që të garantoj barazinë midis burrit dhe të gruas, duke e përcaktuar me nenin 8 minimumin prej 12 javësh të pushimit të lindjes me pagesë. Sipas Kartës sociale të reviduar, kjo periudhë është zgjatuar në 14 javë.

Me nenin 18 dhe 19, Karta sociale evropiane i rregullon edhe të drejtat e punëtorëve migruar, të cilët janë në të shumtën e rasteve të diskriminuar në punësim. Me këto dispozita rregullohen të drejtat e punëtorëve migruar në çështjet si kompensimi, kontratat kolektive, dhe tatimet, me ç'rast ata nuk guxojnë të jenë të diskriminuar në raport me punëtorët vendas.

Këshilli evropian e ka miratuar edhe një Konventë për të mbrojtur punëtorët migruar, Konventën Evropiane për statusin juridik të punëtorëve migruar, që ka hyrë në fuqi me datën 1 maj 1983. Dispozitat e kësaj Konventë përfshijnë aspektet qenësore të gjendjes juridike të punëtorëve migruar dhe në veçanti pranimin në punë, lejet e punës dhe të qëndrimit, bashkimin e familjes, vendosjen, kushtet e punës dhe të drejtat sindikale, transferin e kursimeve, sigurimin social dhe kthimin e migruarëve në vendlindjet e tyre.

2. E DREJTA NË MBROJTJE SOCIALE

Karta sociale evropiane përmban një numër dispozitash me të cilat rregullohen aspekte të ndryshme të së drejtës në mbrojtje sociale, si :

- E drejta në mbrojtje shëndetësore ;
- E drejta në sigurim social dhe
- E drejta në ndihmë sociale dhe shëndetësore si dhe në shërbime sociale

E drejta në mbrojtje shëndetësore. – Sipas interpretimit të Komitetit të pavarur të ekspertëve, Neni 11 i Kartës sociale evropiane përcakton se është detyrë e shteteve që të krijojnë përkujdesje shëndetësore për tërë popullatën. Kjo, sipas tyre, përfshinë mbrojtje të veçantë për nëna, fëmijë dhe për persona në moshë të shtyrë, parandalimin dhe diagnostifikimin e sëmundjeve, ndërtimin e një sistemi për arsim shëndetësor, dhe programe adekuate të vaksinimit.

E drejta në sigurim social. – Neni 12 i Kartës sociale evropiane kërkon nga shtetet që të themelojnë dhe të mbajnë sistem të sigurimit social, dhe që të bëjnë përpjekje për t'a avancuar atë sistem në nivel më të lartë.

Këshilli evropian ka ndërtuar edhe mekanizma të tjerë që të inkurajoj shtetet për të ndërtuar sistem adekuat të sigurimit social. Instrumentet më të rëndësishme në këtë

drejtim janë: Kodi evropian i sigurimit social, i nënshkruar me 16 prill 1964 dhe në fuqi nga data 17 mars 1968 dhe Konventa evropiane për sigurim social me Marrëveshjen suplementare për zbatimin e saj.

MBROJTJA E TË DREJTAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE

Konventa Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut siguron mbrojtje minimale për pakicat kombëtare. Në tekstin e saj, pakicat kombëtare vetëm përmenden në pjesën ku rregullohet mbrojtja nga diskriminimi (neni 14). Megjithatë, Këshilli i Evropës që në ditët e hershme të tij, në një numër rastesh e ka shqyrtuar çështjen e pakicave kombëtare. Ky interes i Këshillit të Evropës është avancuar sidomos në dhjetëvjetëshin e fundit.

Sot, mbrojtja e pakicave kombëtare është çështje qendrore e Këshillit të Evropës. Ndaj, një ndër aktivitetet e rëndësishme të kësaj organizate ndërqeveritare është edhe zhvillimi i standardeve ndërkombëtare, juridikisht të obligueshme për shtetet anëtare.

Një ndër të arriturat më të mëdha të Këshillit të Evropës në këtë drejtim është Konventa kornizë për mbrojtjen e pakicave kombëtare, e miratuar me datën 10 nëntor 1994 nga Komiteti i Ministrave të Këshillit të Evropës. Konventa kornizë u hap për nënshkrime me datën 1 shkurt 1995, dhe hyri në fuqi me datën 1 shkurt 1998.

Edhe pse kjo konventë nuk është instrumenti i parë i Këshillit të Evropës për mbrojtjen e pakicave kombëtare, ky instrument është më gjithëpërfshirësi në këtë fushë. Më herët, në tetor të vitit 1992, brenda kornizës institucionale të Këshillit të Evropës është miratuar Karta evropiane për gjuhët rajonale dhe minoritare. Me këtë konventë inkurajohen shtetet palë që të mbrojnë gjuhët rajonale dhe minoritare, megjithëse nuk ju siguron asnjë mbrojtje atyre që i flasin ato gjuhë.

Konventa kornizë për mbrojtjen e minoriteteve është instrumenti i parë multilateral, juridikisht i obligueshëm që i dedikohet mbrojtjes së pakicave kombëtare. Me këtë dokument bëhet e qartë që mbrojtja e minoriteteve është pjesë integrale e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Për nga natyra e vet, Konventa kornizë dallon nga konventat e zakonshme. Në njërën anë, ajo është Konventë, meqenëse është instrument juridikisht i obligueshëm i të drejtës ndërkombëtare. Në anën tjetër, termi “kornizë” tregon që parimet e përfshira në këtë instrument nuk janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në vendimet juridike të brendshme të shteteve kontraktuese, por duhet që të zbatohen nëpërmjet të legjislationit nacional dhe të politikës së përshtatshme qeveritare. Natyra specifike e këtij instrumenti përpunohet në pjesën e dytë të Konventës kornizë, që kryesisht përfshinë dispozita të tipit programor.

Përveç Preambulës, Konventa Kornizë përmban 32 nene dhe është e ndarë në 5 pjesë. Kjo Konventë nuk e bën definimin e termit “pakicë kombëtare, meqenëse në këtë fazë ishte e pamundur që të arrihej pajtueshmëri midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës për ta definuar se çka nënkuptohet me termin pakicë kombëtare.

Në Pjesën e parë elaborohen parimet e përgjithshme duke përfshirë parimin që mbrojtja e pakicave kombëtare dhe e personave që i takojnë pakicave kombëtare është pjesë mbrojtjes ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Në këtë pjesë gjithashtu përcaktohet që secili person që i takon ndonjë pakice kombëtare është i lirë që të zgjedhë që të trajtohet apo jo si pjesëtar i pakicës kombëtare, dhe me këtë rast, i është e garantuar që të mos jetë i diskriminuar nga një gjë e tillë.

Pjesa e dytë është pjesa më e rëndësishme operative e Konventës kornizë, meqenëse përfshinë dispozita që përcaktojnë parime më specifike. Këto parime përfshijnë spektër të gjerë të çështjeve si:

- Mos-diskriminimin;
- Përparimin e barazisë efektive;
- Përparimin dhe ruajtjen e kulturës, religjionit, gjuhës dhe traditave;
- Lirinë e tubimit, organizimit kolektiv, të shprehurit, mendimit, ndërgjegjës dhe religjionit;
- Qasje në media dhe përdorim të tyre;
- Arsim,
- Kontakte ndërkufitare dhe bashkëpunim,
- Pjesëmarrje në jetën ekonomike, kulturore dhe sociale;
- Ndalimin e asimilimit të dhunshëm.

Pjesa e tretë përfshinë dispozita të ndryshme rreth interpretimit dhe zbatimit të Konventës kornizë;

Pjesa e katërt i përmban dispozitat mbi monitorimin e zbatimit të konventës kornizë, dhe

Pjesa e pestë, përmban dispozita përfundimtare, të modelit të konventave dhe marrëveshjeve të tjera të lidhura brendaornizës institucionale të Këshillit të Evropës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, me nenin 22 përcakton se Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare është drejtpërdrejtë e aplikueshme në Republikën e Kosovës, në tërësinë e saj, dhe se në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike. Gjithashtu, Kushtetuta, në nenin 58 përcakton se Republika e Kosovës do të promovoj frymën e tolerancës, dialogut dhe do të mbështesë pajtimin ndërmjet komuniteteve dhe do të respektoj standardet e përcaktuara me Konventën Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare dhe me Kartën Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Pakicave.

Neni 123 i Kushtetutës përcakton se Republika e Kosovës e respekton Kartën Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale dhe e zbaton atë në masën e kërkuar nga vendi nënshkrues.

Rrjedhimisht, me Kushtetutën e vet, Republika e Kosovës, i garanton standardet më të larta evropiane për respektimin dhe mbrojtjen e pakicave kombëtare.

